AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
BOTIME TË VEÇANTA CXXXVII
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE
LIBRI 46

PAJAZIT NUSHI

LEKSIKON I PSIKOLOGJISË

Vëllimi II

N-ZH

PRISHTINË
2014

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SPECIAL EDITIONS CXXXVII
SECTION OF SOCIAL SCIENCES
BOOK 46

PAJAZIT NUSHI

LEXICON OF PSYCHOLOGY
Volume II
N-ZH

Approved for publication at the meeting of the Section of Social Sciences,
held on 20th March, 2014, after review by
academician Ekrem Murtezai and prof. dr. Neki Juniku.

Editor: Academician Mark Krasniqi, Secretary of Section of Social Sciences.

PRISHTINA
2014

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
BOTIME TË VEÇANTA CXXXVII
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE
LIBRI 46

PAJAZIT NUSHI

LEKSIKON I PSIKOLOGJISË
Vëllimi II
N-ZH

U miratua për botim në mbledhjen e Seksionit të Shkencave Shoqërore,
mbajtur më 20 mars 2014, në bazë të recensioneve të
akademik Ekrem Murtezait dhe prof. dr. Neki Junikut.

Redaktor: Akademik Mark Krasniqi, Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore.

PRISHTINË
2014

Copyright © ASHAK

N

N = simbol i faktorit numerik në aftësitë parësore; N = numri i pjesëtarëve të një mostre, modeli, gjedhe.

NACIONALIZ/ËM, - MI. m. Term sociologjik e juridik më tepër se psikologjik; derivat i termit komb. Nacionalizmi në kuptimin e përgjithshëm dhe të veçantë ka përbërës të rëndësishëm psikologjikë. Emërton konceptin e dashurisë së fuqishme të njeriut për kombin, krenarinë që i përket kombit dhe angazhimin e pasionuar të tij për kombin, historinë, ekonominë, gjuhën, kulturën, vlerat, tiparet kryesore psikike dhe vendin e vet. Nacionalizmi shfaqet në disa forma, ndër të cilat dallohen:

a. **Egoizmi nacional** – Dashuria, interesi, përqendrimi i një pjesëtari të një kombi të caktuar vetëm në vetitë, në vlerat dhe në rëndësinë e kombit të vet, duke u dhënë këtyre cilësi të çmuara dhe duke besuar thellë këto veti;

b. **Fetishizimi nacional** – Ngritja e vlerave të kombit të një individi të caktuar në shkallën më të lartë, duke i atribuuar edhe fuqi të mbinatyrshme. Fetishizimi nacional përshkruhet me mahnitje për përkatësinë e individit ndaj kombit të vet. Ai bashkëjeton me ndjenjën e përçmimit të vlerave të kombeve të tjera dhe të pjesëtarëve të tyre;

c. **Lidhja nacionale** – Ndjenjë e ndërlikuar, e krijuar nga ndjenjat pozitive dhe nga sistemi i qëndrimeve pozitive të individit ndaj kombit të tij dhe tipareve të atij kombi (gjuha, historia, kultura, tradita e vlerat sociale, kultura, vendi etj.). Lidhja nacionale njëkohësisht nënkupton gjallërimin e emocioneve negative ndaj mossuksesit të kombit, të pjesëtarëve të vet, ndaj fyerjes së tyre dhe rrezikimit të kombit. Lidhja emocionale e njeriut me kombin mbështetet në zhvillimin e vetëdijes kombëtare të secilit pjesëtar të një kombi të caktuar. Pikërisht në këtë kuptim lidhja kombëtare ose nacionale e individit ndryshon nga nacionalizmi;

d. **Karakteri nacional** – Strukturë e ndërlidhur tiparesh karakteristike psikologjike të pjesëtarëve të një kombi (historia, gjuha e vlerat e përbashkëta,

sjelljet, parimet e jetës, qëndrimet themelore të sjelljeve, synimet karakteristike etj.). Në mbështetje të kësaj strukture psikologjike një Shqiptar dallohet nga qytetari i Alaskës, nga Arabi, Irlandezi etj. Megjithëkëtë, termi karakter nacional është një konstrukt hipotetik që ka qenë i pranishëm më shumë në psikologjinë klasike, përkatësisht në etnopsikologji se në literaturën bashkëkohore të psikologjisë;

e. **Paragjykimi nacional** – Qëndrim i patundur me të gjitha vetitë refuzuese të një individi ndaj një kombi tjetër dhe ndaj pjesëtarëve të atij kombi, shih - ***PARAGJYKIMI.***

NAIVITET, - I. m. Tipar karakterizues i një individi të painformuar sa dhe si duhet, e me përvojë të kufizuar. Mjedisi i tij kërkon informim, përvojë dhe dije më të gjerë dhe më të thellë. Naiviteti e bën njeriun të pasigurt në sjellje dhe të gatshëm për të besuar lehtë dhe shpejt në qëndrimet dhe mendimet e të tjerëve.

NARCIZ/ËM, - MI. m. I ardhur në shqipe nga mitologjia greke *Narkissos*, emri i birit të Zotit të detit, Kefizit që hetoi dashurinë e Ekos ndaj tij. Afërdita e dënoi këtë në vetmi dhe ai duke kaluar kohën pranë një pellgu uji dhe duke parë figurën e trupit të tij në sipërfaqen e ujit të pastër u dashurua me vetveten. Narcizmi në kuptimin e përgjithshëm është ndjenja e ndërlikuar e dashurisë, e kënaqësisë, e admirimit etj. të njeriut ndaj vetes, përkatësisht ndjenjë e ndërlikuar e vetëkënaqësisë dhe e vetëpëlqimit, ku shpërfillet kufiri ndërmjet botës së jashtme dhe personalitetit. Termi me këtë kuptim u përdor në fillim nga mjeku seksolog Elis Havelok (Ellis Havelock, 1859 – 1939), kurse në psikanalizë është përdorur nga psikanalisti Karl Abraham me kuptimin e tërheqjes së libidos nga një objekt i pushtuar i mjedisit të jashtëm në vetë subjektin. Këtë dukuri e ka hasur kryesisht te individët e sëmurë me skizofreni. Këtë kuptim të termit narcizëm të Karl Abrahamit e ka përdorur edhe Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1939) në disa nga veprat e tij, si: "Mbi narcizmin", "Përtej parimit të kënaqësisë", por duke bërë dallim ndërmjet kuptimit të termit autoerotizëm dhe narcizëm dhe duke theksuar se egoja e njeriut është një rezervuar i libidos, nga ku energjia e tij derdhet në objekte të jashtme, por gjithmonë një libido e tillë është në gjendje të rikthehet në organizmin e njeriut. Në mbështetje të kësaj lëvizjeje të libidos narcizmi nuk shpjegohet si shkallë zhvillimi, por si ngecje e libidos në organizëm, duke mos pasur mundësi të drejtohet në objekte të jashtme. Sipas Frojdit, narcizmi është gjendje e dashurisë për veten e atij individi, i cili tërë dashurinë e tij e ka përqendruar mbi vete. Kjo gjendje paraqitet te fëmijët në fazën kur ai ende nuk ka vendosur lidhje me botën e jashtme, përkatësisht kur e tërë energjia e libidos është e përqendruar në egon e tij. Narcizmi fillon në moshën e hershme; më pas, në kushtet e zhvillimit normal të njeriut, narcizmi zotërohet por nuk humbet krejtësisht nga repertori i sjelljeve të njeriut. Zigmund Frojdi ka bërë ndarjen e narcizmit në narcizëm parësor dhe dytësor:

a. **Narcizmi parësor** – Fazë e hershme e zhvillimit të libidos, kur ajo është përqendruar në egon e tij, përkatësisht në trupin e vet para se të drejtohet në

objektet e mjedisit të jashtëm. Kjo fazë është normale për zhvillimin psikoseksual të fëmijës në moshën e hershme;

b.Narcizmi dytësor – Dashuri ndaj vetes që lind nga zëvendësimi i drejtimit të libidos nga të tjerët në vetveten e tij. Te narcizmi dytësor dallohet identifikimi i një individi me një individ tjetër dhe përvetësimi i tij duke e bërë atë pjesë të unit.

NARCIZMI I DALLIMEVE TË VOGLA. Dukuri social-psikologjike, të cilën e ka përshkruar hollësisht Zigmund Frojdi. Narcizmi i dallimeve të vogla është theksimi i dallimeve etike, psikologjike dhe i sjelljeve kulturore të përbashkëta të pjesëtarëve të një bashkësie, populli, kombi etj. ndaj të tjerëve dhe mosdurimi i të tjerëve. Ky dallim shkakton vlerësimin e të gjitha tipareve të të tjerëve sipas parimeve, normave dhe standardeve të bashkësisë së vet. Ky vlerësim mund të sjellë mosdurim, urrejtje, armiqësi, madje edhe luftë ndaj të tjerëve.

NARKOANALIZ/Ë, – A. f. Formë e psikanalizës që karakterizohet me dhënie të disa substancave narkotike pacientit, sidomos nga grupi i drogave të barbiturateve, me qëllim ndikimin në qendrat subkortikale të trurit që çojnë në gjendje gjumi. Në këtë gjendje ngadalësohen proceset njohëse apo kognitive, shkaktohet gjendja e indiferencës emocionale dhe pasivizohen proceset psikomotorike. Kështu pacienti është në gjendje t`i shpalosë pengesat psikike (fobitë). Këtë lëndë të shpalosur terapisti e shfrytëzon për shërimin e pacientit. Narkoanaliza sot përdoret rrallë ose nuk përdoret fare.

NARKOLEPSI, - A. f. Formë e çrregullimit të gjumit që shfaqet me episode të shkurtra gjumi kohë pas kohe, me çrregullim të ritmit të gjumit të natës, me tepri gjumi gjatë ditës e natës etj. Pacienti në gjendje narkolepsie përjeton imponimin e fuqishëm të gjumit në çdo lloj kushtesh, madje edhe atëherë kur kjo gjendje nuk është në interes të njeriut. Narkolepsinë e shkaktojnë disa substanca biokimike me ndikim në sistemin nervor qendror. Kjo gjendje mund të jetë gjendje shoqëruese e disa çrregullimeve të tjera psikike.

NARKOMANI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *ναρκω* "shtangie" dhe *μανία* "çmenduri". Gjendje jonormale e njeriut që shkaktohet nga dëshira e sëmurë dhe intensive e disa individëve, më tepër të moshës rinore, për të futur në organizmin e vet narkotikë dhe substanca drogash (barbiturate, heroinë, morfinë etj). Kjo gjendje është shumë e rrezikshme për organizmin. Në fillim të marrjes së ndonjë narkotiku i riu përjeton qetësim, kënaqësi, eufori, ëndërrim të çuditshëm etj. dhe marrja sistematike e drogave e nënshtron organizmin dhe njeriu bëhet i varur nga marrja e këtyre dozave. Kjo gjendje shkakton çrregullime fiziologjike (godit qendrat e rëndësishme të sistemit nervor) e psikike dhe dezintegrim të personalitetit. Madje, kur bëhen orvatje të ndërprerjes së marrjes së drogave, shfaqet gjendje ankthi, dhembje, neveri, kthim i ushqimit, dridhje duarsh, pesimizëm etj., prandaj narkomani e ka shumë të vështirë kthimin në gjendje psikike normale.

NARKOTERAPI, - A. f. Formë e psikoterapisë që përdor gjendjen e gjumit të të sëmurit me qëllim mënjanimin e disa çrregullimeve psikike. Çrregullimet më të shpeshta që mund

të mënjanohen me anë të narkoterapisë kanë të bëjnë kryesisht me gjendjen neurotike të njeriut.

NARKOTIK, - Ë. m. Në farmakologji narkotikët janë substanca psikofarmakologjike, që përdoren si medikamente (barna) për zbutjen e largimin e dhembjeve, por përdoren edhe në formë drogash. Narkotikët mund të jenë natyrorë dhe artificialë. Marrja e narkotikëve shkakton gjendje të qetësimit të organizmit, të ankthit, të gjumit dhe të humbjes së kontrollit të vetëdijshëm të njeriut për një kohë të caktuar. Besohet se narkotikët ushtrojnë ndikim në mekanizmat metabolikë të qelizave nervore. Marrja e tyre pas pak kohe shkakton varësinë e njeriut nga narkotikët.

NARKOZ/Ë – A f. Gjendje psikologjike e fiziologjike, që manifestohet me zvogëlim të dukshëm të aktivitetit të njeriut, me humbje të përkohshme të vetëdijes dhe të ndijimeve të dhembjes. Ka përdorim të madh në kirurgji, kurse në psikologji zbatohet për hulumtime, ku kafshët i nënshtrohen narkozës. Gjendja e narkozës shkaktohet me marrjen e substancave farmakologjike, narkotikëve. Besohet se narkotikët veprojnë në qelizat e trurit.

NATIVIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *nativus* "i (e) lindur". Nativizmi është pikëpamje doktrinash ekstreme, sipas së cilës zhvillimi i tërësishëm organik e psikik i organizmit është rezultat i faktorëve të lindur, pikërisht faktorëve trashëgues. Faktorët e jashtëm nuk janë faktorë qenësorë në zhvillimin e organizmit, përkatësisht ata mund të ndikojnë në ngadalësimin ose përshpejtimin e zhvillimit organik e psikik, por ndikimi i tyre i përket grupit të faktorëve me rëndësi dytësore. Sipas nativizmit proceset psikike, në rend të parë perceptimi, por edhe kujtesa, mendimi e të folurit, emocionet dhe motivet e njeriut kanë bazë biologjike dhe, në zhvillimin e tyre, ndikimi i të mësuarit dhe edukimi përgjithësisht është i vogël dhe i parëndësishëm. Nativizmi është i lidhur kryesisht me Mesjetën, kur mendimtarët e krishterë kanë konsideruar se e tërë natyra e njeriut, duke përfshirë edhe kapacitetin e inteligjencës, strukturën e zhvillimin e njeriut e kanë përcaktuar të tjerët, natyra e njeriut është e lindur dhe e pandryshueshme. Në literaturën bashkëkohore të psikologjisë pikëpamja e doktrinës ekstreme për zhvillimin e natyrës së njeriut pothuajse nuk haset.

NATYRALIZ/ËM, - MI. m. Pikëpamje e përgjithshme për dukuritë, objektet, proceset dhe ndërlidhjet e tyre, shkaqet e të cilave duhet kërkuar në natyrë, përkatësisht në rregullsitë, parimet dhe ligjet e natyrës. Sipas natyralizmit edhe zhvillimi i dukurive, proceseve psikike dhe i sjelljeve të njeriut duhen kërkuar në natyrën zhvillimore të vetë njeriut. Dukuritë psikike duhen gjurmuar dhe shpjeguar njësoj si edhe dukuritë natyrore e biologjike, fizike, kimike etj. Rrjedhimisht me këtë psikologjia është shkencë natyrore.

NDARJA E KONCEPTEVE. Sipas parimeve të caktuara mund të ndahen në nocione abstrakte dhe konkrete, të veçantë dhe të përgjithshëm, mendorë dhe organikë etj. Koncepti konkret (lapsi, pëllumbi, shtëpia etj.) është nocion i lehtë për ta përkufizuar, sepse

nocioni konkret përgjithëson vetitë e dukurive, të objekteve, të proceseve konkrete, si: shtëpia është ndërtesa e kufizuar me mure dhe e mbuluar me kulm që shërben për banim. Koncepti abstrakt (bukuria, drejtësia, liria etj.) është koncept i mendjes së njeriut dhe përkufizohet vështirë. Sipas shkallës së përgjithësimit nocionet mund të jenë të veçantë (ahu i maleve të Sharrit, Nënë Tereza, rrezja gama etj.), përgjithësim vetish të veçanta të një objekti, individi, dukurie etj. dhe të përgjithshëm – përgjithësim vetish të përbashkëta të anëtarëve të një grupi, klase, lloji, gjinie etj. (pemët e maleve të Sharrit, shenjtoret humaniste, rrezet gama etj.). Sipas përmbajtjes së tyre nocionet ndahen në shumë grupe. Grup nocionesh të tilla mund të përbëjnë nocionet mendore - grup procesesh, dukurish, sjelljesh mendore të përkufizuara sipas mentalizmit (perceptim, kënaqësi, vullnet etj.). Nocionet organike janë ato përmbajtje mendore që kanë të bëjnë me organet e qenies së gjallë (gjëndrat, lëkura, organi vestibular etj.).

NDARJA E KUJTESËS SIPAS KOHËZGJATJES. Përmbajtjet e përvojës dhe të asaj që mësohet kanë kohëzgjatje të ndryshme në kujtesën e njeriut. Disa nga gjurmët e mbetura të asaj që përjetohet dhe mësohet zgjasin shkurt dhe shumë shkurt, disa të tjera kanë kohë zgjatjeje të gjatë dhe ka të tjera që zgjasin gjithë jetën. Nisur nga parimi i kohëzgjatjes së asaj që njeriu e përvetëson kujtesa ndahet në tri lloje:

1. **Kujtesa shqisore** – Kujtesë me kohëzgjatje shumë të shkurtër që ka të bëjë me mbajtjen në mend të asaj që shohim ose dëgjojmë brenda një ose dy sekondash. E tillë është kujtesa ekonike dhe kujtesa ikonike:
   a. **Kujtesa ekonike** – Kujtesë dëgjimore, kujtesë jehonë që ka të bëjë me analizën e informacionit dëgjimor apo akustik. Kujtesa ekonike, dëgjimore ose akustike ka rëndësi të veçantë për marrëveshjen ndërmjet njerëzve gjatë komunikimit gjuhësor ndërmjet tyre: pa kujtesë ekonike a dëgjimore, pikërisht akustike njeriu që merr informacion gojor do të harronte fjalët paraprake të çka fliten;
   b. **Kujtesa ikonike** – Kujtesë pamore ose figurative që karakterizohet me mbajtjen në mend të figurave të një filmi rreth një sekonde. Kujtesa e tillë pamore mundëson lidhjen e figurave rrjedhëse të një filmi dhe të kuptuarit e përmbajtjes së tyre. Këtë lloj kujtese e ka argumentuar si të qenësishme psikologja amerikane Georg Sperling.
2. **Kujtesa afatshkurtër** – Mbajtja mend dhe riprodhimi i asaj që njeriu sheh ose dëgjon brenda disa minutave. Kujtesa afatshkurtër është shumë e ndjeshme ndaj informacioneve të reja, ndaj të cilave individi reagon me shpejtësi të madhe. Kujtesa afatshkurtër manifestohet në rastet kur, numrin e një telefoni të sapo dëgjuar e mbajmë në mend vetëm brenda një kohe shumë të shkurtër dhe sapo kërkojmë lapsin për ta shënuar e harrojmë. Kujtesa afatshkurtër ka kapacitet të vogël, përkatësisht kjo manifestohet në mbajtjen mend të 7 + 2 ose 7 - 2 numrave. Me hulumtimin e kujtesës afatshkurtër u mor posaçërisht psikologu amerikan Xhorxh A. Miler (George A. Miller, 1920 -);

3. Kujtesa afatgjatë – Mbajtja mend, rinjohja dhe riprodhimi i përvojës dhe i informacioneve të mësuara, si edhe i lidhjeve ndërmjet tyre për një kohë të gjatë, që sillet prej disa minutave deri në disa orë, ditë, muaj e vite të tëra. Kujtesa afatgjatë është kujtesë në kuptimin e plotë të saj. Kapaciteti i kujtesës afatgjatë është shumë i madh. Informacionet e kujtesës afatgjatë kanë mundësi të kalojnë prej kujtesës afatshkurtër në kujtesën afatgjatë dhe të ruhen e riprodhohen pas një kohe të gjatë, po qe se i plotësojnë këto kushte minimale: synimin, dëshirën, motivimin dhe synimin e të mësuarit për të mbajtur mend dhe për të riprodhuar përmbajtjet e duhura, të mësuarit dhe të mbajturit mend, si dhe riprodhimin e kuptimshëm të asaj që mësohet, përsëritjen e herë pas hershme të këtyre informacioneve, përforcimin e tyre në kujtesën afatgjatë me anë të ushtrimeve të llojeve të ndryshme etj. Bazën neurologjike të kalimit të informacioneve prej kujtesës afatshkurtër në kujtesën afatgjatë e përbën hipotamusi. Me studimin e kujtesës afatgjatë u mor sidomos psikologu amerikan Xhon R. Anderson (John R. Anderson, 1839). Sipas tij kujtesa afatgjatë ndahet në kujtesën implicite dhe në kujtesën eksplicite. Kujtesa afatgjatë për nga përmbajtja ndahet në kujtesën motorike dhe në kujtesën fjalësore.

a. Kujtesa motorike – Mbajtje mend dhe riprodhim i drejtë, i koordinuar dhe i shpejtë i lëvizjeve dhe i lidhshmërisë së tyre në një tërësi harmonike, siç janë shkathtësitë dhe shprehitë (ngasja e biçikletës, notimi, të shkruarit në tastierën e kompjuterit etj.). Kujtesa motorike mbështetet në të mësuarit e lëvizjeve të gjymtyrëve dhe të trupit të njeriut, që organizohet sipas parimeve e rregullave të posaçme të të mësuarit të shprehive dhe të shkathtësive. Kujtesa motorike ka të bëjë me dijet tona që i përkasin mënyrës si kryhet një veprim dhe, natyrisht, procesi dhe përmbajtja e kujtesës motorike mësohen. Rezultatet e disa hulumtimeve neurologjike kanë treguar se dëmtimet e ganglioneve bazale, si edhe disa dëmtime të trurit të vogël janë bartëse të kujtesës motorike.

b. Kujtesa fjalësore – Kujtesa fjalësore ose verbale ka të bëjë me mbajtjen mend, rinjohjen dhe me riprodhimin e drejtë të fjalëve dhe lidhjeve kuptimore të tyre në fjali dhe në lidhjen e fjalive në mes tyre. Kujtesa fjalësore është bazë e pazëvendësueshme e përvetësimit të drejtë të gjuhës amtare dhe të gjuhëve të tjera, përkatësisht e komunikimit të drejtë në mes individëve që komunikojnë në një gjuhë të caktuar, e cila ka parime, rregulla dhe ligje të zhvillimit dhe të zbatimit të drejtë të saj.

NDER, - I. m. Term i etikës, por me komponentë të theksuar psikologjikë. Nderi është ndjenjë e ndërlikuar që merr karakterin e tiparit të karakterit të njeriut, atëherë kur njeriu beson dhe është i bindur se kualitetet njerëzore janë të nivelit të lartë, se dinjiteti i tij qëndron lart dhe e gjithë qenia e tij nderohet nga të tjerët. Nderi i njeriut shfaqet në raportin e njeriut ndaj të tjerëve, konkretisht në të gjitha angazhimet, orvatjet dhe në organizimin e atyre sjelljeve me të cilat ai shmanget nga gënjeshtrat, mashtrimet dhe nga pështjellimet.

NDËRGJEGJ/E, - JA. f. Sistem i ndërlikuar por dhe koherent mendimesh të lidhura me sjelljet morale të njeriut. Si sistem koherent ndërgjegjja zhvillohet dhe formohet në bazë të të mësuarit social duke u bërë në këtë mënyrë "gjykatës i brendshëm" i njeriut, që përcakton çfarë është pozitive dhe çfarë është negative, e mirë dhe e keqe, e drejtë dhe e padrejtë në mendimet dhe në sjelljet e tij dhe të të tjerëve. Strukturën e këtij sistemi e përbëjnë rregullat, parimet, normat morale dhe përbrendësimi i tyre i vetëdijshëm nga ana e njeriut. Ndërgjegjja ka përmasa ndjenjash e motivesh, që vështirë dallohen njëra nga tjetra. Sjelljet e njeriut që janë në përputhje me parimet e me normat morale shkaktojnë vetëkënaqësi, kurse sjelljet e kundërta me parimet dhe me normat morale shkaktojnë ndjenjën e fajit dhe atë të pendimit. Në strukturën e shfaqjes së ndërgjegjes dallohen këto komponentë vlerësues: qëndrimi dhe sjellja ndaj detyrës që ka individi i caktuar, përgjegjësia që ndien ai ndaj detyrës dhe ndaj realizimit të duhur të saj. Ndërgjegjja në psikologji duhet dalluar nga vetëdija. Në psikologji dallohen dy pikëpamje për ndërgjegjen:

a. **Pikëpamja psikanalitike** – Pikëpamje që e konsideron ndërgjegjen një nga funksionet e superegos. Struktura e personalitetit që është e lidhur drejtpërdrejt me super egon zhvillohet më vonë dhe qëndron mbi egon. Super egoja e ndëshkon egon për veprimet e këqija, për frikën që duhet të ketë egoja nga ndërgjegjja, por edhe e përkrenon për sjelljet pozitive, të drejta, të mira dhe, me këtë rast, njeriu përjeton ndjenjën e krenarisë, të gëzimit etj. Një ndërgjegje e tillë zhvillohet dhe formohet në bazë të shpërblimit e falënderimit të sjelljeve të drejta dhe të ndëshkimit të sjelljeve të padrejta;

b. **Pikëpamja humaniste** – Pikëpamje e psikologjisë humaniste të Abraham H. Maslout (Abraham H. Maslow, 1908 – 1970). Sipas kësaj pikëpamjeje ndërgjegjja është rregullator i mendimeve dhe i sjelljeve të njeriut, ndërgjegjja është "zëri brendshëm" i unit të njeriut. Ky zë tërheq vërejtjen që njeriu me mendimet dhe me sjelljet e tij të mos e pengojë zhvillimin e natyrshëm të tij drejt karakterit burimor njerëzor. Ndërgjegjja duhet të krijojë kushte që njeriu të zhvillohet dhe të bëhet i natyrshëm, të bëhet ai që është në realitet.

NDËRLIDHJE, - A. f. Marrëdhënie të ndërsjella ndërmjet dy ndryshoreve. Në psikologji marrëdhënie të tilla mund të jenë marrëdhënia ndërmjet aftësisë së të mësuarit me kuptim dhe të mësuarit mekanik të një grupi subjektesh, ndërmjet inteligjencës dhe suksesit shkollor, ndërmjet fuqisë motivuese për punë dhe aftësisë së njeriut për llojin e caktuar të punës etj. Shkalla e marrëdhënies së tillë mund të jetë e ndryshueshme dhe e mundshme të përcaktohet numerikisht. Në psikometri dallojmë disa lloje ndërlidhjesh:

a. **Ndërlidhja drejtvizore** – Paraqitja grafike e shkallës së marrëdhënies në formë drejtëzash. Paraqitje të tilla mund të ketë marrëdhënia ndërmjet rezultateve të përftuara nga matja e zhvillimit fizik dhe atij psikik të fëmijëve të një grupmoshe të caktuar. Në psikometri paraqitjet e tilla janë të rralla;

b.Ndërlidhja dytësore – Ndërlidhje pozitive e dy ndryshoreve, kur kjo ndërlidhje është rezultat i ndërhyrjes së ndikimit të një faktori të tretë. Ndërlidhja e tillë mund të gjendet kur masim rezultatin e arritur në zhvillim të inteligjencës së nxënësve të moshave të ndryshme të një shkolle dhe zhvillimit fizik të tyre. Në një matje të tillë përftohet shkallë e lartë e ndërlidhjes ndërmjet këtyre dy ndryshoreve, por kjo shkallë e lartë është rezultat i ndikimit të faktorit të moshës së nxënësve të asaj shkolle. Këtë mund ta provojmë me anë të konstatimit të shkallës së marrëdhënieve të pjesshme ose parciale;

c.Ndërlidhja lineare – Forma më e thjeshtë e lidhjes ndërmjet dy ndryshoreve. Kjo formë e ndërlidhjes ka të bëjë me ato matje, kur me rritjen e një ndryshoreje shfaqet rritja e ndryshores tjetër, ose me rritjen e njërës zvogëlohet në mënyrë përpjestimore edhe ndryshorja tjetër. E tillë mund të jetë shfaqja e suksesit të arritur nga një klasë nxënësish në gjuhën e huaj dhe në gjuhën amtare;

d.**Ndërlidhja negative** – Formë lidhjeje që ka të bëjë me marrëdhënie të kundërta ndërmjet rezultateve të matjes së një ndryshoreje dhe të një ndryshoreje tjetër. Ndërlidhje të tilla mund të shfaqen kur konstatojmë numerikisht se nxënësit e mirë në lexim kanë arritje të dobëta në matematikë, ose, përkundrazi nxënësit me rezultat të mirë në matematikë kanë rezultat të dobët në lexim;

e.Ndërlidhja pozitive – Formë e paraqitjes së rezultateve të arritura nga ana e nxënësve të një klase kur masim numerikisht rezultatin pozitiv të arritur në gramatikë dhe atë pozitiv të arritur në matematikë.

NDËRLIDHJA NEGATIVE. Ndërlidhja ose korrelacioni negativ ka të bëjë me raportin e dy ndryshoreve, kur njëra rritet, kurse tjetra zvogëlohet. Raste të tilla kemi në psikologji, si: numri i viteve kalendarike në moshë të shtyrë shtohet, kurse aftësia e mbajtjes në mend të informacioneve të reja zvogëlohet, pesha e organizmit të njeriut shtohet, shpejtësia e lëvizjeve bie etj. Shih – ***KORRELACIONI.***

NDËSHKIM, - I. m. Term i psikologjisë forensike. Në psikologjinë e përgjithshme termi ndëshkim nënkupton ndikimin e një ngacmuesi a nxitësi në zvogëlimin e mundësisë që reagimi, sjellja e caktuar e organizmit të njeriut të shuhet shkallë–shkallë, sepse i sjell dëm fëmijës, nxënësit, pacientit etj.

NDIJ/Ë, - A. Shih – ***SHQISA.***

NDIJIM, - I. m. Forma elementare e përjetimit të një cilësie të atij trupi, procesi, dukurie etj., kur trupi vepron drejtpërdrejt në shqisën e caktuar të njeriut. Ndijimi është e dhënë e thjeshtë shqisore, që shkaktohet nga ndikimi i drejtpërdrejtë i proceseve fiziko-kimike në shqisën e caktuar. Në këtë kuptim flitet për ndijim dëgjimor, kromatik, lëkuror, nuhatës, pamor, shijor, tingullor, ndijim trysnie, ndijim termik, ndijim vestibular etj. Ndijimi si entitet i veçantë psikik është rezultat i abstraktimit mendor; ndijimi nuk ekziston i ndarë nga procesi i perceptimit. Ndijimet dallohen sipas modalitetit: ndijimet e të parit, të dëgjimit, të nuhaturit, të shijuarit, të dhembjes, të prekjes, shtypjes, të nxehtësisë, të ftohtësisë, të lëvizjeve, të pozicionit

të trupit dhe ndijimet organike. Ndijimet kanë këto veçori: cilësinë ose kualitetin (ndijimi i ngjyrës së kuqe, të gjelbër, të kaltër, ndijim i ëmbël, i hidhët etj., ndijim i tonit, i zhurmës etj.); intensitetin (i njelmët, shumë i njelmët, jashtëzakonisht i njelmët etj.); kohëzgjatjen (zgjat aq kohë sa ndikon trupi në shqisën e caktuar: shumë shkurt, shkurt, tepër gjatë etj.); shtrirjen (dhembja në një pjesë të lëkurës, nxehtësia e gjithë trupit etj.) dhe tonin emocional (kënaqësia ose pakënaqësia).

NDIJIMET EKSTEROCEPTIVE. Ndijimet e lidhura drejtpërdrejt me shqisat që gjenden në sipërfaqen e organizmit të trupit të njeriut. Me anën e këtyre shqisave njeriu pasqyron cilësitë e objekteve, të dukurive, të proceseve të botës së jashtme duke shndërruar energjinë ndikuese të tyre në ndijim përkatës. Në këtë grup ndijimesh hyjnë:

a. **Ndijimet pamore –** Ndijimet e dritës, ngjyruesit (kromatike) dhe jongjyruesit (akromatike) me intensitet të caktuar. Ndijimet pamore shkaktohen nga ndikimi që ushtrojnë valët elektromagnetike prej 760 deri në 380 milimikron (mμ) në syrin e njeriut. Baza fiziologjike e ndijimeve të të parit është sistemi shqisor, ku bëjnë pjesë: syri, nervi pamor ose optik dhe qendra ndijimore e të parit në cipën e trurit;

b. **Ndijimet dëgjimore –** Ndijime tonesh dhe zhurmash të cilat në kushte të caktuara ushtrojnë ndikim në veshët e njeriut. Ndijimet dëgjimore shkaktohen nga valët ajrore me dendësi dridhjesh prej 16 – rreth 20.000 dridhjesh në sekondë. Këto dridhje valësh ajrore vënë në lëvizje ose dredhin timpanin e veshit. Dridhja e timpanit shkakton lëvizje të lëngut në brendësinë e veshit të brendshëm dhe ngacmon qelizat receptore të të dëgjuarit. Ngacmimi i tyre bartet në formë impulsesh nervore deri në qendrën e dëgjimit;

c. **Ndijimet e lëkurës –** Ndijime të të prekurit, të ftohtësisë, të nxehtësisë dhe të dhembjes. Ndijimet e lëkurës shkaktohen nga ndikimi i drejtpërdrejtë i ngacmuesve mekanikë, termikë, elektrikë etj., që ndodhen në gjendje të lëngët, të ngurtë dhe flurore;

d. **Ndijimet e të nuhaturit –** Ndijime erërash e cilësish të ndryshme të erërave që shkaktojnë trupat flurorë kur ushtrojnë ndikim në hundën e njeriut dhe aktivizojnë receptorët e saj. Grimcat e erës së futur në hundë me anën e frymëmarrjes shndërrohen në masë kimike, që ngacmojnë receptorët e nuhatjes ose ata olfaktorë të lidhur me nervin hundor dhe ngacmimi i tij bartet në formë impulsesh nervore në qendrën e nuhatjes në zonën e korteksit, duke kaluar paraprakisht nëpër bulbin olfaktor. Këto impulse nervore shndërrohen në ndijim nuhatës të caktuar;

e. **Ndijimet e të shijuarit –** Ndijimet e shijes janë: e ëmbla, e hidhëta, e njelmëta dhe e tharta. Këto shkaktohen nga disa ndryshime kimike që pëson ushqimi në gojën e njeriut duke ngacmuar pupritë e gjuhës nën të cilat gjenden receptorët e shijes. Ky ngacmim shkakton shqetësim të nervit VI dhe IX dhe shqetësimi në formë impulsesh nervore bartet deri në pjesën parietale ose tepore të cipës së trurit të madh, duke kaluar paraprakisht nëpër pjesën vazhduese të palcës së kurrizit dhe talamus. Maja e gjuhës është e përshtatshme për pranimin e ndikimeve

të ëmbla, pjesa e përparme e gjysmës së gjuhës reagon ndaj të njelmëtës, dy anët e gjuhës reagojnë ndaj të thartës dhe pjesa e fundit e gjuhës reagon ndaj të hidhurës. Ndijimet e të shijuarit janë të lidhura ngushtë me ndijimet e të nuhaturit.

NDIJIMET INTEROCEPTIVE. Ndijime organike me anën e të cilave bëhemi të vetëdijshëm për gjendjen e organizmit tonë. Ndijimet organike janë: ndijimet e mundimit, të lodhjes, të dhembjes së trupit ose të pjesëve të tij (të lukthit, të veshkave, të organeve të frymëmarrjes etj.) Ndijimet e tilla janë difuze dhe vështirë mund të përshkruhen saktësisht. Këto ndijime ende nuk i kanë të saktësuara receptorët e tyre.

NDIJIMET KINESTETIKE. Ndijime me anën e të cilëve njeriu bëhet i vetëdijshëm për pozitën, lëvizjen, fuqinë, mundin e organizmit ose të pjesëve të veçanta të tij. Ndijimet kinetstetike i përkasin grupit të proprioceptorëve. Në grupin e ndijimeve kinestetike bëjnë pjesë edhe ndijimet statike ose ndijimet e baraspeshimit të trupit, që shkaktohen nga ngacmimi I receptorëve të organit vetstibular.

NDIJIMET ORGANIKE. Tërësi ndijimesh që kanë të bëjnë me perceptimin e gjendjes së organizmit nga ana e njeriut. Në ndijimet organike hyjnë: ndijimi i dhembjes së kokës, ndijimet e ndryshimeve në funksionin e zemrës, të lukthit, të organeve seksuale etj. Këto ndijime njihen edhe si ndijime viscerale.

NDIJIMET PROPRIOCEPTIVE. Ndijime që kanë të bëjnë me përjetim të lëvizjeve dhe të gjendjes statike të organizmit të njeriut, si edhe të organeve të tij. Në grupin e ndijimeve proprioceptive hyjnë këto lloje ndijimesh: ndijimet muskularo–motorike ose ndijimet kinestetike, që janë ndijime lëvizjesh të muskujve, të mbajtjes së trupit të organizmit dhe të pjesëve të caktuara të tij, më tepër të gjymtyrëve të trupit. Këto ndijime shkaktohen nga ndikimi që ushtrojnë disa procese të muskujve në receptorët e lëvizjeve të vendosura në muskuj, në kërcej dhe në sipërfaqen e disa eshtrave. Në këtë grup ndijimesh hyjnë edhe ndijimet statike. Këto kanë të bëjnë me informacionet mbi gjendjen e trupit të njeriut dhe të ndryshimit të gjendjes së trupit, si edhe të pjesëve të tij, sidomos me ndryshimin e pozicionit të kokës. Me anën e këtyre ndijimeve njeriu kupton vendndodhjen e trupit e të pjesëve të tij në hapësirë, ndryshimin e ruajtjen e baraspeshës ndaj fuqisë gravitacionale të caktuar etj.

NDIJIMETSOMATOSENSORIKE. Të gjitha ndijimet trupore të njeriut, ku hyjnë ndijimet e lëkurës (të prekjes, të dhembjes dhe të temperaturës), ndijimet kinestetike (të lëvizjeve dhe të vendndodhjes së trupit e pjesëve të tij në një hapësirë të caktuar) dhe ndijimet organike ose viscerale, ku hyjnë ndijimet e shqisave të organeve të brendshme (të lukthit, të mëlçisë dhe të zorrëve) dhe shfaqen me ndijimin e dhembjeve të atyre organeve, të ligështisë së organizmit dhe të lodhjes së shpejtë të tij.

NDIJIMET SOMATOSTETIKE. Term përmbledhës për ndijimet e lëkurës, përkatësisht për ndijimet e të prekurit, të dhembjes dhe të temperaturës dhe për ndijimet kinestetike

(të lëvizjes, të vendndodhjes së trupit dhe pjesëve të tij, të fuqisë, të mundimit dhe të rrotullimit të tij, si edhe për ndjijmet e ndryshimeve në lukth, në mëlçi dhe në zorrë), të shkaktuara nga ngacmimi i proprioceptorëve.

NDIJIMET TEMPERATURORE. Ndjijmet e temperaturës, e pikërisht ndjijmet e të ftohtit dhe të nxehtit. Këto ndjijime shfaqen si rrjedhojë e ndikimit të energjisë termike të trupave në receptorët e lëkurës së njeriut. Besohet se këta receptorë janë mbaresat e nervave të lirë. Nga këta dallohen mbaresat në afërsi të sipërfaqes së lëkurës, pikërisht të epidermës, që reagojnë ndaj ngacmuesve të ftohtë dhe mbaresave diçka më thellë në lëkurë, në shtresën e dermës, që reagojnë ndaj ngacmuesve të nxehtë. Receptorët e tillë janë të shpërndarë në të gjithë lëkurën, por jo në mënyrë jo të barabartë. Për nxehtësi numri i këtyre trupthave, përkatësisht i receptorëve llogaritet në 30 000, kurse për ftohtësi numri i tyre është shumë më i madh. Karakteristika e ndjijmeve të temperaturës është përshtatja relativisht e shpejtë e lëkurës në temperaturën e ngacmuesve të saj. Në përjetimin e cilësisë së ftohtësisë dhe të nxehtësisë së ngacmuesve ka ndikim të pjesshëm edhe temperature e trupit të njeriut. Në kushtet normale, kur temperatura e trupit është 32 gradë Celsius, nën këtë nivel njeriu përjeton ftohtësi dhe mbi këtë nivel nxehtësi. Nën 14 gradë Celsius dhe mbi 44 gradë Celsius të temperaturës së lëkurës njeriu përjeton dhembje.

NDIJIMET VESTIBULARE. Ndjijmet e njeriut për vendndodhjen e trupit dhe të kokës së tij, si edhe për baraspeshën trupore dhe për lëvizjet e trupit dhe të pjesëve të tij. Baza e këtyre ndjijmeve gjendet në receptorët e aparatit vestibular. Ngacmues i këtyre receptorëve është shkalla e shpejtimit të lëvizjeve të kanaleve gjysmëharkore në veshin e brendshëm. Falë ndjijmeve të këtilla njeriu është në gjendje ta njohë vendndodhjen e trupit, të kokës dhe të pjesëve të tjera të tij në raport me tokën, të njohë lëvizjen djathtas – majtas, lart – poshtë, përpara – mbrapa, ashtu sikurse njohim vendndodhjen tonë kur rrotullohemi në një rreth me sy mbyllur. Këto ndjijime na mundësojnë edhe përmirësimin e vendndodhjes së trupit dhe mbajtjes së baraspeshës së tij dhe të pjesëve të tij.

NDIJIMI I NGJYRAVE. Shndërrimi i valëve elektromagnetike me gjatësi të caktuar që ndikojnë në receptorët e të parit, duke shkaktuar proces neurofizilogjik, nga i cili përftohet ndjijmi i një ngjyre të caktuar. Cilësinë ose kualitetin e ndjijmit të ngjyrës e përcakton gjatësia e valëve elektromagnetike, sipas këtij rendi: e kaltra ka gjatësi valësh prej rreth 480 nanometër (nm), e gjelbra prej rreth 580 nanometër, e verdha prej rreth 580 nanometër dhe e kuqja ka gjatësi valësh elektromagnetike prej rreth 700 nanometër.

NDIJIMI I NGJYRAVE KOMPLEMENTARE. Ndjijmi i ngjyrës neutrale që përftohet nga përzierja e dy ngjyrave kromatike.

NDIJIMI MUSKULOR. Përjetim i vetëdijshëm i tensionit dhe i fuqisë së lëvizjeve të organeve dhe të trupit të njeriut. Me anën e ndjijmeve muskulore marrim informacione për gjendjen e trupit dhe për lëvizjen e

organeve të tij. Shih - ***NDIJIMET KINESTETIKE.***

NDIJIMI PAMOR. Cilësia e një perceptimi të një trupi, që ka të bëjë me përjetimin e cilësisë pamore të dritës ose të ngjyrave të saj (dritës apo të tij (trupit).

NDIJIMI STATIK. Lloj i ndijimit interoceptiv me anë të të cilit njeriu mban drejtpeshimin e trupit dhe të pjesëve të tij, duke përcaktuar këtë si dhe raportin ndërmjet vendndodhjes së pjesëve të trupit në një hapësirë të caktuar me sy të mbyllur.

NDIKIMI INFORMATIV. Në teorinë e informacionit dhe të psikologjisë sociale nënkupton organizimin e mendimeve dhe të sjelljeve të një individi në një diskutim me përmbajtje pak të njohur ose të panjohur për të, sipas rrjedhës së zhvillimit të atij diskutimi nga ana e të tjerëve dhe sjellja e këtij individi sipas sjelljes së atyre që kanë informacion për përmbajtjen e atij diskutimi, për atë fushë gjeografike, për atë situatë etj. Në rastet e këtilla individi nuk mbetet pa reaguar, por reagimet e tij mbështeten në sjelljet e të tjerëve. Kjo mbështetje te të tjerët lind nga besimi ynë se të tjerët kanë informacione më të plota dhe më të sigurta për temën e diskutimit.

NDIKIMI NORMATIV. Ndikimi shoqëror në plotësimin e nevojave dhe të motiveve psiko-sociale, duke iu përmbajtur normave dhe kërkesave të mjedisit social.

NDJENJ/Ë, - A. f. Në shqip ka disa kuptime: kuptim të veçantë (ndjenja estetike, fetare, morale etj.); kuptim të njëjtë me termin emocion (ndjenja e dashurisë, e hidhërimit, e pikëllimit etj.); kuptim të një aspekti ose të një ane të emocioneve (ndjenjë e mirëqenies, e përjetimit të një të ardhme të zymtë, e përjetimit të një gjendjeje të rëndë etj.). Në psikologji Vilhelm Vunti (Wilhelm Wundt, 1832 – 1920) ka trajtuar karakterin tripërmasor të ndjenjave (kënaqësi – pakënaqësi, qetësim – shqetësim dhe tendosje – shtendosje), duke mos përmendur termin emocion tripërmasor. Për këto shkaqe përcaktimi i kuptimit të saktë të termit ndjenjë është e vështirë. Megjithëkëtë, kuptimi i termit ndjenjë në psikologji ka përdorim më të shpeshtë me kuptimin e termit emocion. Por, ka raste, kur termi ndjenjë ka kuptim të veçantë. Ndër rastet e tilla dallohen:

a. Ndjenja e bashkësisë – Përjetim i njeriut se ai është pjesë e një strukture shoqërore të qëndrueshme dhe më të gjerë, që i plotëson atij motivin e sigurisë. Ndjenja e bashkësisë është e lidhur me perceptime, me qëndrime dhe me marrëdhënie sociale të veçanta;

b. Ndjenja fetare – Përjetim i ndërlikuar besimi e bindjeje që përçon qëndrimin e ngulitur të njeriut në fuqi mbinatyrore të identifikuar me Zotin e gjithësisë dhe me fuqinë e gjithëmbarshme të tij. Ndjenja fetare është rezultat i socializimit dhe edukimit të njeriut në mesin familjar fetar e social;

c. Ndjenja intelektuale – përjetim i individit të caktuar ndaj punës intelektuale dhe fryteve të saj. Ndjeja intelektuale shfaqet në habinë, në çudinë, në dyshimin etj. ndaj përmbajtjes së caktuar intelektuale, ndaj metodave gjurmuese të saj etj. Ndjenja intelektuale është e pandashme me motivin e kureshtjes së njeriut;

d.Ndjenja morale – Ndjenjë e ndërlikuar kënaqësie, gëzimi, entuziazmi etj. për punë dhe për një detyrë të realizuar, në përputhje me parimet e me normat morale, si edhe ndjenjë e fajit, e pendimit, e turpit etj. të njeriut për vlerësimin negativ të rezultateve të punës,të sjelljeve ndaj të tjerëve, për mosrealizim të detyrës etj.;

e.Ndjenja e mossuksesit – Përjetim i posaçëm i shkaktuar nga rezultatet e pavlefshme të punës e të angazhimit të një individi në përfundimin e punës dhe të detyrës së tij. Në një vlerësim të tillë ndikon shumë vlerësimi i të tjerëve për punën e bërë, për detyrën e realizuar pjesërisht ose të realizuar keq etj.;

f. Ndjenja e të qeshurit – Ndjenjë kënaqësie e shkaktuar nga një situatë e papritur dhe e jashtëzakonshme, që në thelb nuk prek vlerat e atij që i përjeton situatat që shkaktojnë të qeshurën. Ndjenja e qeshurit ka formë specifike të shfaqjes së saj. Ndjenjën e të qeshurit zakonisht e shkaktojnë të tjerët, por ka raste kur edhe vetë subjekti i caktuar mund të bëhet objekt përqeshjeje për veten e tij;

g.Ndjenja e suksesit – Ndjenjë që ka të bëjë me përjetimin e kënaqësisë së veçantë të një subjekti, kur të tjerët ia vlerësojnë pozitivisht rezultatet e punës së tij, pikërisht kur rezultatet e arritura përputhen me nivelin e kërkesave që njeriu ia parashtron vetes.

h.Ndjenja e së bukurës – Përjetim ndjenjor i veçantë, kur njeriu konstaton dhe ndjen kënaqësi të posaçme që një ngacmues (pikturë, poezi, skulpturë, etj.) me masën e duhur, drejtpeshimin e përmasave të pjesëve të saj dhe me raportet e kombinuara dhe harmonike ndërmjet tyre i shkakton njeriut kënaqësi të veçantë, sepse ia plotëson kriteret estetike të tij duke përçuar këtë përjetim me një fije habie të këndshme. Ndjenjë të këtillë shkakton, p.sh., poezia e Ali Podrimes "Unë, biri yt Kosovë", soditja e panoramës së grykës së Valbonës, skulptura e Naim, Sami dhe Abdyl Frashërit në Parkun e Tiranës, piktura "Mona Liza" etj. Ndjenja e së bukurës ka edhe përmasë motivuese; kjo e shtyn njeriun të ndërmarrë veprime për të shijuar dhe krijuar të bukurën në veshjen e trupit të vet, në orenditë shtëpiake, të zyrës, të oborrit të fabrikës, të vendit të punës etj.

i. Ndjenja e së shëmtuarës – Përjetim negativ dhe reagim refuzues i ngacmuesve të tillë që janë në raport kundërshtues me kriteret e së bukurës për njeriun dhe rrezikojnë dëmtimin e kritereve të këtilla. Ky kuptim i së shëmtuarës është sa estetik, aq edhe psikologjik. Ana ose aspekti psikologjik i saj ka të bëjë me polin e kundërt të asaj që është e bukur, sepse e shëmtuara shkakton pakënaqësi, refuzim dhe sjellje të kundërt ndaj saj, rrjedhimisht mosdurim dhe largim të njeriut ndaj së shëmtuarës.

j. Ndjenja e zbrazëtisë psikike – Ndjenjë subjektive e ngushtë, që ka të bëjë me përjetimin e mosplotësimit të një dëshire të rëndësishme të një individi, duke mos qenë në gjendje t`ia shpjegojë vetes shkakun e saktë të mosplotësimit të asaj dëshire. Ndjenja e zbrazëtisë është e lidhur ngushtë me përjetimin e mërzisë, por ndryshon nga mërzia sepse i përket përjetimit subjektiv që ka njeriu për mosplotësimin e asaj dëshire.

NDJENJA E ALIENACIONIT. Formë e alienacionit që shpreh një ndjenjë personale që përjetohet në formën e asaj gjendjeje kur individi, atë që e ka konsideruar të afërt, madje edhe të tij (gjësendin, njeriun, situatën) tashmë e përjeton gjithnjë e më shumët të largët, të huaj e jo të vetën. Dikur fqinjin, kroin, situatën familjare etj. i ka konsideruar të pandarë nga ai, të lidhura emocionalisht me to, madje edhe të perceptuara si tërësi të përbashkët; tashmë i përjeton emocionalisht të largëta, të huaja për të.

NDJENJA E FAJIT. Ndjenja e moralit të një individi që shpreh pakënaqësinë që përjeton ai, kur vlerëson se mendimet, sidomos sjelljet e tij, janë të padrejta, e me të cilat ka shkelur parimet dhe normat morale të tij, duke përjetuar padrejtësi të posaçme për akte të tilla, që i përkasin ndërgjegjes së tij. Ndjenja e fajit nuk ka të bëjë me frikën nga faktorët e brendshëm dhe as me turpin ndaj tyre, por me një ndjenjë të brendshme për vlerësimin personal të ulët dhe për rrezikimin e dinjitetit të tij. Ndjenja e fajit konsiderohet se luan rolin e një "substance psikike", rregulluese të sjelljeve të njeriut. Për ndjenjën e fajit dallohen disa kuptime në terminologjinë psikologjike të shkollave të psikologjisë si më poshtë:

a. **Shkolla psikanalitike** – Shkollë psikologjike që konsideron se ndjenja e fajit ka të bëjë me frikën e super egos që buron nga frika objektive e dënimit të njeriut prej humbjes së dashurisë së prindërve, si edhe nga dënimi i tij prej një individi që ka pozitë të lartë në shoqëri dhe gëzon autoritet të posaçëm. Ndjenja e fajit sipas psikanalizës është mekanizëm mbrojtës i pavetëdijshëm që i kundërvihet energjisë së shtytësve të njeriut, si energjisë së shtytësit të agresivitetit;

b. **Shkolla bihejvioriste** – Shkollë psikologjike që konsideron se ndjenja e fajit është reagim i mësuar që bëhet pengesë për të ndërmarrë kryerjen e formave të atyre sjelljeve që mjedisi social i dënon;

c. **Shkolla humaniste** – Shkollë psikologjike që konsideron se ndjenja e fajit shfaqet atëherë kur njeriu kryen sjellje të pajtueshme me parimet dhe normat morale të mjedisit, por me sjellje të tilla është vënë kundër parimeve dhe normave morale të personalitetit të brendshëm të tij.

NDJENJA E INFERIORITETIT. Në literaturën e psikologjisë bëhet dallim kuptimor ndërmjet *Kompleksit të inferioritetit* - shih dhe ndjenjës së inferioritetit. Ndjenja e inferioritetit ka të bëjë me një qëndrim negativ të individit ndaj vetes së tij. Kjo ndjenjë mbështetet në kompleksin e inferioritetit, sepse nuk përjetohet e lirë nga qëndrimet dhe sjelljet e njeriut ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve.

NDJENJA E PAPËRSOSSHMËRISË. Ndjenjë e përjetimit të vetvetes me mungesa, pamjaftueshmëri dhe me zhvillim të papërshtatshëm. Një zhvillim i tillë i individit që ka ndjenjën e papërsosshmërisë mund të përjetohet në fushën e zhvillimit fizik, psikik ose moral; pavarësisht nga kjo ndjenja e papërsosshmërisë merr përmasa të fuqishme motivuese për të arritur shkallën e përsosjes së asaj fushe me anë të sjelljeve gjithnjë e më të përsosura.

NDJENJA E VLERËS MË TË MADHE. Ndjenjë e fuqisë dhe e mbifuqisë së individit që e përjeton veten mbi të tjerët, duke konsideruar se ai ka aftësi, dijeni, qëndrueshmëri emocionale, gatishmëri për punë etj. të një niveli dhe cilësie më të lartë se të tjerët. Për këtë shkak njeriu që ka përjetim të tillë për veten konsideron se duhet të qëndrojë mbi të tjerët, t`i sundojë të tjerët. Ka raste kur ndjenja e vlerës më të madhe është e theksuar dhe mbisunduese në mendimet dhe në sjelljet e një individi të caktuar. Në raste të tilla bëhet fjalë për kompleksin e vlerës më të madhe, të vlerës mbi të tjerët.

NDJENJA E VLERËS MË TË VOGËL. Term kyç në psikologjinë individuale të psikiatrit të njohur austriak Alfred Adler (Alfred Adler, 1870 – 1937), që njihet edhe si ndjenja e inferioritetit. Kuptimi i këtij termi paraqitet në dy forma elementare: në fillim kuptimi i termit ndjenja e vlerës më të vogël ka pasur të bëjë me vlerën e ulët funksionale të një organi të trupit të njeriut, kurse më vonë u zgjerua kuptimi i këtij termi. Ky kuptim i ndjenjës së vlerës më të ulët ka zgjeruar dukshëm shtrirjen domethënëse të këtij termi. Gjithësekush që në fëmijëri ka dalluar të meta specifike, të cilat ka bërë përpjekje t'i zotërojë, madje edhe t`i mbizotërojë. Në këtë kuptim ndjenja e vlerës më të ulët ka marrë kuptimin e një motivi të fuqishëm në veprimtarinë e gjithëmbarshme të njeriut.

NDJENJAT ASTENIKE. Ndjenja negative (pakënaqësia, pikëllimi, dërrmimi subjektiv etj.) që frenojnë veprimtarinë e njeriut duke ushtruar ndikim negativ në veprimtarinë e gjithëmbarshme dhe duke zhvilluar qëndrim pasiv ndaj asaj që ndodh rreth tij, sikurse edhe me vetë njeriun.

NDJENJAT ESTETIKE. Grup i ndërlikuar i ndjenjave të njeriut që përjetohen ndaj një akti estetik (kompozimi muzikor, poezie, pikture, skulpture etj.), ku janë "derdhur" e përzier edhe ndjenjat e krijuesit. Përjetimi i ndjenjave estetike bazohet në vlerësimin individual të aktit krijues ose të objektit të natyrës; kur vlerësimi i tyre është pozitiv lind ndjenja e gëzimit, e haresë, e entuziazmit etj., dhe kur individi e vlerëson negativisht kohezionin, harmoninë, lidhjen e elementeve të një trupi apo të një akti krijues, atëherë lindin emocione të pakënaqësisë, të mërzisë, të neverisë etj.

NDJENJAT MORALE. Ndjenja të ndërlikuara që formohen gjatë zhvillimit moral të njeriut dhe kanë të bëjnë me reagimin subjektiv të njeriut ndaj parimeve dhe normave morale të atij mjedisi ku ai jeton dhe vepron. Në strukturën e ndjenjave morale bëjnë pjesë këto ndjenja të veçanta: ndjenja e detyrës së njeriut ndaj obligimeve personale, familjare, profesionale etj., ndjenja e altruizmit, ndjenja e drejtësisë etj. si edhe ndjenjat e kundërta: ndjenja e fajit, e pakënaqësisë nga mospërmbushja e normave morale, e turpit etj.

NDJENJAT RELIGJIOZE. Besimi i thellë i njeriut në vlerën e parë, intime, më të rëndësishme dhe mbisunduese në sferën emocionale dhe të vullnetit të tij.

NDJES/Ë, - A. f. Term i psikologjisë së religjionit i ardhur nga të folurit

e përditshëm. Në të folurit e përditshëm ndjesa ka kuptimin e kërkesës së të falurit ndaj tjetrit ose të tjerëve, për shprehjen e rëndë, mendimin e pavend, për aktivitetin e gabuar etj. Në psikologjinë e religjionit ndjesa është strukturë e ndërlikuar dhe e ndërlidhur mendore, emocionale dhe motivuese e shoqëruar me gatishmërinë për të shprehur faljen e mëkateve të bëra më pare nga dikush që ka vdekur. Me këtë kuptim duhet marrë shprehja "Ndjesë pastë".

NDJESI, - A. f. Një ndër termat me kuptim të vështirë për t'u përcaktuar. Në shqip termi ndjesi shpesh ka kuptimin e termit ndijim si "përjetim subjektiv i cilësisë së një ngacmuesi të një shqise të caktuar mbi bazën anatomike e fiziologjike të energjisë së ngacmuesit, të shqisës ngacmuese, të nervit bartës të kësaj energjie e deri në qendrën e caktuar të trurit, ku kjo energji shndërrohet në ndijim të veçantë". Në këtë kuptim bëhet fjalë për "ndjesinë e të prekurit", "ndjesinë e ngjyrës", "ndjesinë e shijës" etj. Në rastet e këtilla anglishtja përdor termin "sens". Ka shprehje ku termi *ndjesi* emërton shkallën e lartë të ndjeshmërisë shqisore ndaj një ngacmuesi me shkallë të ulët intensiteti, ndaj ndryshimeve të nivelit të ulët të këtij ngacmuesi, që në kushte normale nuk shkakton ndijim. Megjithëkëtë, këtu bëhet fjalë për ndijim. Ka gjykime me fjali përkatëse ku termi ndjesi përdoret për të emërtuar formën e veçantë të vetëdijes së njeriut, që nuk ka të bëjë me ndijim, si p.sh., "Ai ka ndjesi për të bërë mirë", "Ka ndjesi për drejtësi", "Ka ndjesi për të përjetuar gjendjen e vështirë të tjetrit", "Ishte tepër i ndjeshëm ndaj kuptimit të atyre fjalëve të thepisura" etj. Në shprehjet e tilla termi ndjesi ka kuptim më të afërt me termin ndjenjë dhe kuptim shumë të largët me termin ndijim. Për këto raste anglishtja përdor termin *feeling*. Për këtë shkak duhet bërë dallimi ndërmjet termit "ndijim" – "sensacion", "ndjesi" – sens" "ndjeshmëri" – "sensibilitet", "ndjenjë" – "feeling" dhe kuptimit të tyre në situata foljore të ndryshme.

NDJESHMËRI, - A. f. 1. Veçori e përgjithshme e qenieve të gjalla për të reaguar ndaj ngacmuesve biologjikë dhe ndryshimeve të tyre në mjedisin ku ato zhvillohen.

NDJESHMËRI. 2. Aftësia e analizatorit për të reaguar ndaj ngacmuesit përkatës dhe ndaj ndryshimeve më të vogla të tij. Rezultat i një reagimi të tillë është një ndijim i caktuar.

NDJESHMËRI. 3. Në psikofizikë, aftësia e organit shqisor për të reaguar ndaj ngacmuesve me intensitet më të ulët, pra që shkakton ndjeshmëri absolute, si dhe aftësia e ndjeshmërisë së një shqise ndaj ndryshimeve më të vogla të dy ngacmuesve.

NDJESHMËRIA E TESTIT. Një ndër veçoritë metrike të testit ose të secilit mjet matës psikologjik. Ndjeshmëria e testit ka të bëjë me hartimin e një testi në mënyrë të tillë, kur ai është sajuar nga pyetje dhe detyra që mundësojnë njohjen e ndryshimeve më të vogla në madhësinë e një ndryshoreje që provohet dhe, mbi këtë bazë, diferencim të mirë të subjekteve në fushën ku ata provohen. Ndjeshmëria e tillë e një testi është e lidhur me gjatësinë e testit të zbatuar në një grupmoshë të caktuar

subjektesh. Ndjeshmëria e testit shfaqet në shpërndarjen relativisht të madhe të rezultateve të përftuara nga zbatimi i një testi. Ndjeshmërinë e një testi e tregon shpërndarja e rezultateve rreth vlerës mesatare të tyre. Ndjeshmëria e një testi emërtohet edhe me termin testi diskriminues.

NDJESHMËRIA EMOCIONALE. Shqetësimi emocional i njeriut ndaj dukurive, mendimeve të shprehura, ndaj objekteve etj. që kanë intensitet ngacmimi të ulët.

NDRYDHJA. Mekanizëm mbrojtës i pasuksesshëm që shpreh një angazhim të pavetëdijshëm, për të nxjerrë nga vetëdija e njeriut ato përmbajtje, ngjarje etj. që janë të lidhura me dëshira të ndaluara, kryesisht dëshira seksuale.

NDRYSHIMI STATISTIKOR I RËNDËSISHËM. Në psikometri emërton atë vlerë statistikore që nuk është e rëndësishme (dallimi ndërmjet dy vlerave statistikore të të mesmeve aritmetike ose koeficienti i caktuar i ndërlidhjes a korrelacionit etj.), por ajo vlerë numerike vërtetë është e qenësishme për popullatën që e përfaqëson. Vlera statistikore e rëndësishme përcaktohet me anë të z – vlerës (kur kemi shpërndarje të rezultateve në formë normale ose kumbonare), me t – vlerë (kur kampionet janë të vogla) dhe me anë të X në katror (kur ndryshoret janë ndryshore cilësore ose kualitative).

NDRYSHOR/E, - JA. f. I ardhur nga latinishtja *variabilitas* "ndryshueshmëri". Termi variabël përdoret herë pas here edhe në tekstet shqipe të psikologjisë, megjithëse shqipja ka termin burimor ndryshore. Emërton përmbajtjen konkrete psikologjike që ndryshohet. Në psikologji ndryshorja është cilësia e një objekti, procesi etj., që mund të rritet ose ulet, varësisht nga kushtet dhe ndryshimi i tyre. Ndryshorja zakonisht përkufizohet me termin operacional dhe ka rëndësi në hulumtimet empirike. Në këtë kuptim dallojmë dy lloje themelore të ndryshoreve:

a. **Ndryshore e varur** – Proces psikonervor, lloj sjelljeje etj. që ndryshon varësisht nga një ose më shumë kushte dhe nga ndryshimi i tyre. Ndryshorja e varur është rezultat i ndikimit që ushtron drejtpërdrejtë në të ndryshorja e pavarur. Ndryshorja e varur duhet të ketë mundësi të vëzhgohet saktësisht, të regjistrohen ndryshimet e saj dhe mundësisht të maten saktësisht ndryshimet e saj;

b. **Ndryshore e pavarur** – Ndryshore e cila në hulumtimet eksperimentale futet dhe ndryshon nga ana e eksperimentuesit, me qëllim që të konstatojë dhe të masë ndikimin e saj në ndryshoren e varur. Ndryshore e pavarur mund të jetë dukuria fizike, kimike, sociale, përkatësisht sjellja e caktuar e individëve të tjerë, si edhe ndryshimi i gjendjes së organizmit të njeriut. Ndryshorja e pavarur quhet ndryshore eksperimentale, sepse zbatohet në hulumtime eksperimentale për të parë dhe matur ndikimin e saj në një dukuri tjetër, përkatësisht ndikimin e saj në ndryshoren e varur prej saj.

NDRYSHORJA E RASTËSISHME. Ndryshorja shkakore e rastit nga e cila rrjedh pasoja e caktuar. Ndërmjet këtyre dy ndryshoreve ekziston një lidhje e qëndrueshme, e cila mundëson

shpjegimin, kontrollin e ndryshimeve dhe parashikimin e zhvillimit të ndryshores së caktuar ose të ndryshimit të intensitetit të saj, varësisht nga shkalla e ndryshimit të ndryshores së rastësishme.

NDRYSHORJA EKSPERIMENTALE. Ndryshore e pavarur që mund të jetë metoda konstante e të mësuarit, ndikimi i pandryshuar i intensitetit të dritës në hulumtimin e ndijimeve pamore etj. Këtë ndryshore hulumtuesi e mban në formë të njëjtë, ose e ndryshon me qëllim dhe sistematikisht, me qëllim që të identifikojë ndikimin e kësaj ndryshoreje në zhvillimin e një dukurie ose në ndryshimin e saj.

NDRYSHORJA KONTROLLUESE. Ndryshore ose variabël që kontrollohet në një eksperiment dhe ka karakter të qëndrueshëm ose konstant.

NDRYSHORJA NDËRHYRËSE. Ndryshore psikologjike ndërmjetësuese e brendshme ndërmjet ngacmuesit dhe reagimit ndaj tij. Ndryshorja ndërhyrëse nuk ka mundësi të perceptohet drejtpërdrejt (koncepti i egos) e as të matet, por mund të interpretohet. Pikërisht për të ka mundësi të arrihet në përfundim në bazë të manipulimit të ndryshores së pavarur dhe vëzhgimit të ndryshimeve në ndryshoren e varur. Termi ndryshore ndërhyrëse ka hyrë në psikologji nga hulumtimet e neobihejvioristëve, të cilët e zgjeruan formulën e njohur të tyre S – R me formulën plotësuese S – O – R.

NDRYSHORJA ORGANIZMIKE. Proces, gjendje fiziologjike e organizmit ose tipar i caktuar i personalitetit, që mund të konsiderohet konstrukt hipotetik. Kjo ndryshore mund të jetë e varur ose e pavarur. Ndryshorja organizmike ndryshon nga ndryshoret e tjera, sepse ka të bëjë me gjendjen e organizmit në tërësinë e vet, dhe ka të bëjë me personalitetin në tërësi e jo vetëm me një proces a gjendje të tij.

NDRYSHORJA SITUACIONALE. Ndryshorja psikologjike që i atribuohet situatës së jashtme. Adhurimi, shpërblimi, si edhe dënimi dhe roli i tyre në sjelljen që provohet i atribuohet situatës së jashtme që shkakton nxitje në aktivitetin e njeriut, përkatësisht ndryshim të sjelljes që provohet në situatën eksperimentale.

NDRYSHUESHMËRI, - A. f. Në kuptimin e përgjithshëm të këtij termi ndryshueshmëria emërton paqëndrueshmërinë konstante të një dukurie, objekti, procesi etj., ose të një veçorie të tyre. Ndryshueshmëria e tillë ka të bëjë me një individ të caktuar, me grup individësh, si edhe me ndryshimet e një brezi nga brezi tjetër. Ka ndryshueshmëri organike e psikike, që mund të jenë rezultat i një procesi zhvillimor të pandërprerë, kur grumbullimi sasior i ndryshimeve shndërrohet në ndryshim cilësor dhe këto barten nga një gjeneratë në gjeneratën tjetër.

NDRYSHUESHMËRIA E DUKURIVE PSIKIKE. Veçori themelore e proceseve psikike dhe e sjelljeve. Ndryshueshmëria shfaqet në forma të ndryshme: ndryshon intensiteti, kohëzgjatja, shtrirja, cilësia etj. Ndryshueshmëri të tilla shkaktojnë vështirësi në gjurmimin e tyre.

NEFS, - I. m. I ardhur nga arabishtja. Term i psikologjisë fetare islame.

Në të folmen e përditshme në disa krahina shqipfolëse përdoret në kuptimin e unit fetar te njeriu, por edhe në kuptimin e shpirtit fetar të tij. Në këtë kuptim nefsi përbëhet nga një substancë shpirtërore, që është e lëvizshme. Pohohet se ka edhe kuptimin e lakmisë së tepruar të njeriut ndaj partnerit të gjinisë tjetër të tij. Kuptimi i termit nefs (haset edhe në formën neps) lidhet me kuptimin e kontekstit ku ky term përdoret. Në psikologjinë bashkëkohore shqipe nuk haset, por ka përdorim të madh në psikologjinë fetare islame.

NEGATIVIZ/ËM, - MI. f. I ardhur nga latinishtja *negativus* "mohues", por i ngulitur në terminologjinë e psikologjisë. Negativizmi është qëndrim i përgjithshëm që shfaqet në formë prirjeje për të reaguar negativisht ndaj kërkesave të ndryshme, ndaj pritjes së reagimit pozitiv. Qëndrimi i tillë manifestohet edhe atëherë, kur reagimi negativ e dëmton individin. Shfaqet në rastet e veçanta te disa çrregullime psikike, siç është rasti me skizofreninë katatonike. Negativizmi shfaqet gjatë dy fazave zhvillimore të njeriut: në fazën e zhvillimit ndërmjet moshës 2 – 4-vjeçare dhe në fazën e adoleshencës – shprehje e kundërshtimeve të kërkesave të autoritetit. Në këto faza negativizmi i shfaqur ka karakter kalues dhe është dukuri normale. Negativizmi shfaqet në dy forma kryesore:

a. **Negativizmi aktiv** – Sjellje kundër asaj që kërkohet. Për sjellje kundërshtuese fëmija nuk ka arsye objektive, por "këtë e bën për inat"; negativizmi aktiv është shprehje e nevojës së brendshme për të afirmuar veten e tij. Në psikopatologji shfaqet në përshkrimin e strukturës së ndryshimeve psikike të disa sëmundje psikike, si: prapambetja e zhvillimit intelektual, demenca mendore, katatonia etj.;

b. **Negativizmi pasiv** – Qëndrim i përgjithshëm i përmbajtjes nga kërkesat e parashtruara, për të mohuar me këmbëngulje kërkesën, lutjen etj. të prindërve ose të tjerëve, që kryesisht nuk shoqërohet me aktivitet konkret.

NEGATIVIZMI KATATONIK. Rezistenca e madhe e të sëmurit për të ngelur në gjendjen e ngrirë, të shtanguar trupore. Kjo formë katatonike shfaqet duke refuzuar kërkesën e ndryshimit të gjendjes së ngrirë të tij ose duke vepruar kundër asaj që kërkohet për ta ndryshuar gjendjen e vet duke mare pozicion trupor të çuditshëm dhe duke ngelur në atë pozicion për një kohë të gjatë.

NEKROFILI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *νεκρο* "i (e) vdekur" dhe *φιλή* "dashuri". Nekrofilia është dashuria e çuditshme e disa individëve, për të perceptuar trupin e të vdekurve ose pjesët e tij. Nekrofilia mund të shfaqet edhe te disa individë, të cilët për objekt të kënaqësisë seksuale kanë partnerin e vdekur. Nekrofilia është fenomen i shmangies nga plotësimi normal i motivit seksual. Nekrofilia është alteracion për biofilinë – dashurinë për jetën. Nekrofilia është synim i sëmurë (patologjik) i njeriut, i cili ka jetë të varfër, si edhe te disa individë me shkallë të ulët të zhvillimit të inteligjencës. Kjo sëmundje zhvillohet në ato mjedise të varfra familjare dhe sociale, ku mbisundon qeverisja totalitare. Sipas psikanalistit social Erik

From (Erich Fromm, 1900 – 1980) nekrofilia është dashuri, synim ndaj gjithë asaj që është e vdekur dhe që zhduket. Sipas tij "Njeriu është qenie e lindur me biofili biologjike, por ka edhe potencial psikologjik për nekrofili…".

NEKROMANI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *νεκρο* "i (e) vdekur" dhe *μανία* "çmenduri". Nekromania është dëshirë e sëmurë (patologjike) e disa individëve, që ka të bëjë me entuziazmin e tyre ndaj të vdekurve, sidomos me dëshirën seksuale ndaj individëve të vdekur duke kërkuar plotësimin e motivit seksual me trupin e partnerit të vdekur. Nekromania është dukuri e rrallë.

NEOANALIZ/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *νέος* "i ri" dhe *αναλυζης* "zbërthim". Rrymë psikanalitike, sipas së cilës gjatë zhvillimeve ndërpersonale veprimtaria e njeriut karakterizohet nga konflikte dhe frustrime, të cilat ushtrojnë ndikim të fuqishëm në zhvillimin e pikëpamjeve dhe të sjelljeve të njeriut. Neoanaliza filloi të zhvillohet pas vitit 1933.

NEOASOCIACIONIZ/ËM, - MI. m. Vazhdimësi e teorisë asociacioniste, përkatësisht e lidhjes së ideve sipas empiristëve anglezë. Kjo vazhdimësi ka të bëjë me zgjerim të lidhjeve e ndërlidhjeve të faktorëve psikikë, në rend të parë të faktorëve të njohjes ose faktorëve kognitivë: proceset psikike dhe sjelljet e njeriut neoasociacionizmi i shpjegon si rezultat i lidhjeve të veçanta të koncepteve a nocioneve, të përfytyrimeve, të pohimit të lidhjeve ndërmjet koncepteve etj. Neoasociacionizmi nuk e mbështet zhvillimin e proceseve psikike dhe të sjelljeve sipas formulës bihejvioriste S(timul) – R(eagim).

NEOBIHEJVIORIZ/ËM, - MI. m. Vazhdimësi e shkollës bihejvioriste, por me elemente të reja, të cilat i japin kësaj shkolle karakter modifikues. Neobihejviorizmi është qasje e veçantë e hulumtimit të proceseve psikike dhe të sjelljeve, që filloi të zhvillohet rreth viteve `30 të shekullit njëzet. Nga bihejviorizmi neobihejviorizmi mori elementet thelbësore (studimin e reagimeve dhe të sjelljeve, si edhe metodën e vëzhgimit objektiv të tyre, por nga skema e përgjithshme e bihejviorizmit S – R (stimul – reagim) futi ndryshoren ndërhyrëse dhe skema e përgjithshme e neobihejviorizmit mori trajtën S – O – R (stimul – organizëm – reagim). Përfaqësuesit eminentë të neobihejviorizmit janë: Klark L. Hall (Clark L. Hull, 1884 – 1952), Eduard K. Tolman (Edward Ch. Tolman, 1886 – 1959), Burhus F. Skiner (Burhus F. Skinner (1904 – 1990) etj. Këta dhe neobihejvioristët e tjerë janë përkrahës së qasjes molare në psikologji. Në kohët e mëvonshme, sidomos nga gjysma e dytë e shekullit të njëzet, lindi një rrymë edhe më e re, si edhe më elastike e neobihejviorizmit. Kjo rrymë u quajt neo–neobihejviorizëm. Karakteristike për këtë rrymë më të re është kthimi në strukturat psikologjike të koncepteve mentale, që bihejviorizmi dhe pjesërisht edhe neobihejviorizmi i kishte përjashtuar nga logjika e psikologjisë dhe nga terminologjia e psikologjisë. Në dekadat e në vitet më të vonshme konceptet mentale dhe termat e tyre (mendimi, ndjenjat, nevojat etj.) filluan të konsiderohen struktura psikike me funksione të ndërlikuara,

duke zënë vend kryesor në hulumtimet psikologjike. Përfaqësuesit më të njohur të neo-neobihejviorizmit janë: Orval H. Maurer (Orval H. Mawrer, 1907 – 1982), Xhorxh Miler (George A. Miller, 1920 –) etj.

NEOCEREBELUM, - I. m. Në anatominë e sistemit nervor i ardhur nga latinishtja *neocerebellum*. Pjesa më e re e trurit të vogël, përkatësisht e cerebelumit. Kjo pjesë shtrihet prej pjesës anësore të korteksit deri te bërthama dentante. Rezultatet më të reja të hulumtimit të funksioneve të neocerebelumit tregojnë se kjo pjesë luan rol të rëndësishëm jo vetëm në rregullimin e lëvizjeve dhe të sjelljeve të vullnetshme, por edhe në zhvillimin e disa proceseve kognitive: të folurit dhe kujtesa.

NEOFENOMENALIZ/ËM, - MI. m. Modifikimi i fenomenologjisë së psikologut dhe teologut gjerman Franc Brentano (Franz Brentano, 1838 – 1917), të psikologut pak të njohur Shtumf, si edhe të disa filozofëve. Sipas tyre për njohjen objektive të vetvetes dhe të zhvillimeve psikologjike të njeriut duhet zbatuar metoda e përshkrimit të drejtpërdrejtë dhe të paorientuar të dukurive psikike.

NEOFROJDIZ/ËM, - MI. m. Rrymë vazhduese e psikanalizës, por me përmbajtje të reformuar të psikanalizës klasike të Zigmund Frojdit (Simund Freud, 1856 – 1939). Reformimi ka të bëjë me theksimin e rolit të faktorëve socialë në zhvillimin dhe formimin e personalitetit. Faktorët socialë zëvendësuan rolin e faktorëve biologjikë dhe mekanikë në zhvillimin psikik të njeriut të psikanalizës klasike. Përfaqësuesit më të njohur të neofrojdizmit janë: Erik From (Erich Fromm, 1900 – 1980), Hari S. Saliven (Harry S. Sulivan, 1892 – 1949), Karen Hornei (Karen Horney,1885 – 1952), të cilët nuk e kanë mohuar thelbin e psikanalizës, por theksin e shpjegimit të personalitetit nuk e kanë vënë në libidon dhe as në shtytësit (faktorët thelbësorë të psikanalizës ortodokse të Zigmund Frojdit, por në faktorët e jashtëm zhvillimorë (faktorët kulturorë, socialë, ndërpersonalë, ankthin themelor) etj. Dyshimet e para ndaj psikanalizës klasike i kanë hedhur Karl G. Jung (Carl G. Jung, 1875 – 1961) dhe Alfred Adler (Alfred Adler, 1870 – 1937), madje edhe duke u ndarë nga Zigmund Frojdi. Por, këta të fundit nuk i përkasin rrymës së neofrojdizmit.

NEOKORTEKS, - I. m. Emërtim latin i pjesës më të re të cipës ose kores së trurit të madh, që përbëhet nga pjesa frontale ose ballore, parietale ose tepore, temporale dhe tëmthore. Neokorteksi është pjesa e ndërlikuar (cipa a korja) e trurit të madh dhe bartëse anatomike e fiziologjike e proceseve psikike të ndërlikuara (perceptimi, kujtesa, mendimi e të folurit, emocionet), si dhe e sjelljeve duke përfshirë edhe veprimet e vullnetshme të njeriut. Këtë pjesë e përbëjnë edhe lidhjet e ndërlikuara ndërmjet qendrave të këtyre proceseve dhe sjelljeve të një hemisfere, të dy hemisferave, si edhe ato ndërmjet qendrave dhe nënqendrave të trurit, duke siguruar në këtë mënyrë zhvillimin e përbashkët dhe integrues të proceseve psikike dhe të sjelljeve të njeriut.

NEOLALI, - A. f. I ardhur në shqipe në terminologjinë e psikopatologjisë nga greqishtja *νέος* "i ri (e re)" dhe *λαλεω* "llomotit". Prirje e çuditshme e disa individëve për të krijuar fjalë të reja dhe për t`i përdorur ato në monolog. Te kjo dukuri fjalët e vjetra nuk humbasin, por përdoren me kuptime të ndryshme, shpesh me kuptim të ri.

NEOLOGJIZ/ËM, - MI. m. Fjalë të reja ose fjalë të vjetra, madje edhe fraza të vjetra, që marrin kuptim të ri. Në terminologjinë e psikologjisë dallohen disa përpjekje për të emërtuar konceptet e reja sipas emërtimeve në gjuhët e huaja, më tepër të gjuhës angleze. Në krijimin e fjalëve të reja më tepër shfrytëzohet analogjia e krijimit të këtyre fjalëve në gjuhët e huaja. Në psikiatri neologjizmat janë fjalëformime pa kuptim për dëgjuesin normal, por psikotikët këtyre fjalëve u japin kuptim të posaçëm. Krijimi i fjalëve të reja haset në disa raste të sëmundjeve psikike (te skizofrenët, te ata që e kanë të dëmtuar trurin etj). Këta individë orvaten t`i shfaqin mendimet dhe përvojën e tyre me fjalë e me terma të rinj, të kuptueshëm vetëm për ta.

NEOPOZITIVIZ/ËM, - MI. m. Term i terminologjisë së filozofisë të rrethit të mendimtarëve të Vjenës të shekullit të njëzet, me në krye Rudolf Karnap (Rudolph Carnap, 1891 – 1970). Sipas pikëpamjes së këtij drejtimi filozofik, përkatësisht të logjikës, vetëm konceptet operacionale janë koncepte shkencore së bashku me emërtimet e tyre. Sintaksën logjike të shprehjeve shkencore e përbëjnë kryesisht konceptet dhe termat operacionalë, kurse të tjerat duhet dëbuar nga gjuha shkencore. Neopozitivizmi konsiderohet se ka ndikuar në zhvillimin e psikologjisë, sidomos në zhvillimin e bihejviorizmit.

NERV, - I. m. Tufë fijezash nervore që përbëhen nga qeliza të veçanta, të mbështjella me cipë të posaçme që ka ngjyrë të bardhë. Nervat lidhin organet e shqisave me strukturat e Sistemit Nervor Qendror, si edhe strukturat e sistemit të muskujve dhe të gjëndrave. Nervi ka dy cilësi themelore: ndjeshmërinë dhe përçimin e impulseve nervore. Te njeriu dallohen 12 çifte nervash trunore ose kafkore që dalin nga pjesët e veçanta të trurit dhe 31 çifte nervash të boshtit kurrizor.

NERVAT KRANIALË. Shih – ***NERVAT TRUNORË; NERVAT KAFKORË.***

NERVAT KURRIZORE. Term përmbledhës për 31 çifte nervore që dalin nga palca kurrizore. Secili nerv i trurit është i lidhur me nervat kurrizorë me rrënjët e përparme dhe të prapme. Rrënjët e përparme nervëzojnë muskujt e thellë të shpinës dhe një pjesë të lëkurës së njeriut, kurse degët e prapme të nervave të kurrizit nervëzojnë lëkurën, muskujt e përparmë të trupit dhe muskujt e gjymtyrëve.

NERVAT SOMATIKË. Në psikologjinë fiziologjike emërtojnë tërësinë e nervave të muskujve skeletorë, ku përfundojnë fijezat e sistemit nervor dhe të organeve shqisore me mbaresa të qelizave nervore aferente, që bartin impulset nervore deri në qendrat përkatëse ndijimore.

NERVAT SPINALË. 31 çifte nervash që dalin nga palca e kurrizit dhe hyjnë në palcën kurrizore. Bartin impulse

nervore kryesisht të natyrës motorike nga truri në muskuj e në gjëndra dhe sjellin impulse nervore nga periferia e organizmit në qendrat e cipës së trurit të madh. Këto nerva komunikojnë me pjesët e tjera të trupit nëpërmjet zbrazëtirave të unazave kurrizore.

NERVAT TRUNORË. Emërtim përmbledhës për 12 çifte nervash që dalin nga trungu i trurit. Nervat trunorë ose kafkorë janë: 1) Nervi i nuhatjes (*nervus olfactorius*), bartës i impulseve nervore nga receptorët e nuhatjes në qendrën e nuhatjes; 2) Nervi pamor (*nervus opticus*), që përbëhet nga degët e ganglioneve dhe bart impulse nervore nga receptorët e retinës së të parit në qendrën pamore të trurit nëpërmjet kiazmës optike; 3) Nervi i lëvizjes së syrit (*nervus oculo-motorius*), që përbëhet nga fijezat nervore që inervojnë muskujt e syrit dhe mundësojnë lëvizjet e tyre; 4) Nervi çikrikor (*nervus trochlearis*) që bën të mundur lëvizjet e syve; 5) Nervi trinjak (*nervus trigeminus*) që ka fijeza nervore aferente dhe eferente, që bartin impulse nervore nga receptorët e të ftohtit, të ngrohjes, të dhembjes etj. të vendosur në kokën e njeriut; 6) Nervi largues (*nervus abducens*), që ka të bëjë me ato fijeza nervore që janë të vendosura në muskujt e syve dhe vënë në lëvizje sytë; 7) Nervi i fytyrës (*nervus facialis*), që përbëhet nga fijezat nervore aferente dhe fijezat nervore eferente: fijezat nervore aferente bartin impulset nervore të shijes së ushqimeve, kurse fijezat nervore eferente vënë në lëvizje muskujt e fytyrës (mimika) dhe janë në lidhje me gjëndrat e pështymës dhe me ato të lotëve;8) Nervi i dëgjimit dhe i baraspeshës së trupit (*nervus vestibulocochlearis*), që ka fijeza nervore aferente, që bartin impulse nervore nga organi vestibular i veshit të brendshëm, si edhe fijeza nervore aferente, që bartin impulse nervore nga receptorët në kërmillin e veshit të brendshëm; 9) Nervi *glosofaringeus* (*nervus glosopharyngeus)*, që përbëhet nga fijezat nervore që bartin impulse nervore nga receptorët e shijes të vendosur në fund të gjuhës dhe nga receptorët për prekje, nxehtësi, ftohtësi, e dhembje në zgavrën e gojës, kurse fijezat nervore eferente lidhen me gjëndrat pështymore; 10) Nervi endacak (*nervus vagus*), që përbëhet prej fijezave nervore aferente dhe eferente. Ato aferente janë në lidhje me receptorët e organeve të brendshme, kurse ato eferente bartin impulse nervore në organet e ndryshme të vendosura në ije dhe në zgavrën barkore; 11) Nervi shtesor (*nervus accessories*), që është i përbërë nga fijezat nervore që mundësojnë lëvizjen e kokës dhe të anëve të trupit; 12). Nervi hipoglosus (*nervus hypoglossus*) ka fijeza nervore që kontrollojnë lëvizjet e gjuhës.

NERVËZIMI RECIPROK. Sistem neurofiziologjik i inervimit të çiftit të nervave antagonistë të muskujve dhe i rregullimit të lëvizjeve koordinuese të tyre. Në këtë sistem tkurrja e njërës palë të çiftit të muskujve antagonistë shkakton lëshimin e çiftit tjetër dhe e kundërta, lëshimi i njërës palë shkakton tkurrjen e palës tjetër. Ky raport shkaktohet sepse ngacmimi nervor i njërës palë të muskujve shkakton fleksion (tkurrje) në njërin dhe lëshim ose shtrirje në muskulin tjetër. Në funksionimin e muskulit të zemrës pjesa simpatike e sistemit nervor autonom e shpejton funksionin e zemrës, kurse

pjesa parasimpatike e ngadalëson këtë funksion.

NERVI ABDUKCIONAL. Nervi VI kafkor që me fijezat e veta e inervon muskulin e jashtëm të kokërdhokut të syrit duke shkaktuar lëvizje të tij nga brenda jashtë. Dëmtimi i tij shkakton çrregullim në lëvizjen e kokërdhokut të syrit.

NERVI FYTYROR. Nervi VII i trurit, i cili e ka bërthamën në pjesën e brendshme të trurit. Nervi fytyror del nga pjesa e trurit tëmthor e temporal dhe degëzohet nën gjëndrat që ndodhen në pjesën e poshtme të veshit. Degët e nervit të fytyrës inervojnë muskujt e fytyrës dhe bartin impulse nervore te këta muskuj (mbaresat motorike të nervit të fytyrës). Mbaresat sensorike të nervit të fytyrës bartin impulse nervore nga pjesa e përparme e gjuhës në qendrën e shijimit. Çrregullimi i funksionit të nervit të fytyrës shkakton paralizën e tërësishme ose të pjesshme të muskujve të fytyrës.

NERVI MOTORIK. Nerv në trajtë gërsheti fijesh nervore. Nervi motorik është nervi nxjerrës që shtrihet prej qendrave të caktuara të fushës motorike dhe përfundon me degëzime fijesh nervore në muskuj dhe në gjëndra. Nervi motorik kryen funksionin e bartjes së impulsive nervore nga qendrat motorike në muskuj dhe në qendra.

NERVI NUHATOR. I ardhur nga latinishtja *nervus olphactorius*. I përket nervave krania ose të trurit. Përbëhet nga fijet e qelizave neuroepiteliale, mbaresat e të cilave shtrihen në brendësinë e cipës së zgavrave të hundës. Ky është nervi nuhator i grupit të nervave të trurit, që bart impulse nervore nga receptorët e epitelit olfaktor deri në cerebrum.

NERVI OKULOMOTORIK. Nervi III i tubit të nervave të trurit, i përbërë kryesisht nga fijezat nervore që inervojnë muskujt e lidhur me lëvizje të syve.

NERVI PAMOR. I ardhur nga latinishtja *nervus opticus.* Çifti II i nervave të trurit, i përbërë nga dy degë nervore, ku secila prej tyre bart impulse pamore nga shtresa e qelizave të ganglioneve të rrjetëzës ose retinës të secilit sy në kiazmën pamore ose optike, dhe prej këtu kryqëzohen aksonet që bartin impulse pamore nga pjesa e brendshme e gjysmës së secilës rrjetë ose retinë të syrit, duke formuar dy trakte nervore. Nga këto trakte secila bart impulse pamore përfaqësuese nga gjysma e fushës pamore të rrjetëzës a retinës deri në traktin optik.

NERVI VESTIBULAR. Nerv i njohur me termin latin *nervus vestibularis*, i cili përbën njërën nga degët e nervit kafkor VIII, që bart impulse nervore nga qelizat vestibulare deri në trurin e vogël dhe në lukth.

NERVOR, - E. mb. Që i përket nervit, që ka të bëjë me nerva.

NEURILEM/Ë, - A. f. Cipë shumë e hollë, mbështjellëse e qelizave të glisë dhe e degëve të tyre. Neurilema është e zhvilluar dhe e formuar nga qelizat Shvan, të zbuluara nga anatomisti gjerman Teodor Shvan (Theodor Schvann,1810 – 1882). Qelizat Shvan prodhojnë mbështjellësin e mielinës në degët e qelizave nervore që gjenden jashtë Sistemit Nervor Qendror.

NEURITE, - T. m. Fije të gjata të qelizave nervore, përbërëse të një pjese të neuronit. Këto fije janë pak të degëzuara. Funksioni kryesor i tyre është bartja e impulsive nervore Nga trupi i një qelize nervore në trupin e një tjetër qelize nervore, në fije nervore të muskujve dhe në ato të gjëndrave. Shih – ***AKSONA.***

NEUROGLITË. asnj. Shtrojë e brendshme e indit nervor që kryen funksionin e lidhjes së indeve të sistemit nervor. Në sistemin nervor ka 10 herë më shumë neuroglish se qeliza nervore. Hasen dy lloj neuroglish: astrocitet dhe oligodendrocitet. Astrocitet kryejnë funksionin e lidhjes së qelizave nervore me kapilaret e enëve e gjakut dhe në këtë mënyrë i furnizojnë qelizat nervore me gjak. Oligodendrocitet prodhojnë mbështjellësin proteinë–qumështor të shumë fijezave nervore brenda Sistemit Nervor Qendror. Neuroglitë marrin pjesë në proceset e kujtesës.

NEUROHORMON/I, - E. m. Substanca biokimike që janë pothuajse identike me neurotransmiterët. Këto, duke bartur gjak, ndikojnë në llojet e ndryshme të qelizave të organizmit, duke përfshirë edhe qelizat nervore.

NEUROLINGUISTIK/Ë, - A. f. Disiplinë kognitive në zhvillim që ka filluar të merret me lidhjet dhe raportet ndërmjet psikolinguistikës dhe neurologjisë. Kjo disiplinë gjurmon më afër lidhjet dhe marrëdhëniet ndërmjet funksioneve të pjesëve të trurit dhe zhvillimit të gjuhës dhe të të folurit. Çështja kryesore e neurolinguistikës është gjurmimi i bazës neurologjike, i proceseve neurologjike të cipës ose kores së trurit të madh të funksioneve simbolike, në rend të parë të të folurit. Për këtë qëllim shfrytëzon edhe rezultatet e neuropatologjisë së të folurit. Në zhvillimin e neurolinguistikës ka kontribuar posaçërisht psikologu rus Aleksandër R. Luria (Alexander R. Luria, 1902 – 1977).

NEUROLOGJI, - A. f. Disiplinë e shkencave mjekësore që merret me gjurmimin e strukturës dhe të funksioneve të sistemit nervor, duke u shtrirë edhe në gjurmimin e ndryshimeve të sistemit nervor te të sëmurët me etimologji nervore. Neurologjia është e lidhur ngushtë me neuropsikiatrinë dhe neuropsikologjinë.

NEUROMODULATOR, - Ë. m. Substanca kimike kryesisht aminoacide, që marrin pjesë në bartjen e impulseve nervore në sinapsa, duke ndryshuar ndjeshmërinë e neuroneve passinaptikë për neurotransmitera. Kjo substancë kimike kryesisht ka karakterin e neuropeptideve, që prodhohen nga mbaresat e aksoneve të neuroneve parasinaptikë. Funksioni i neuromodulatorëve nuk kufizohet vetëm në atë të neurotransmiterëve, por shpërndahet edhe jashtë tyre duke kryer funksionin e neuroneve ose duke ndihmuar funksionimin e rregullt të neuroneve.

NEURON, - I. m. Qelizë nervore, njësia elementare morfologjike dhe funksionale e sistemit nervor. Neuroni përbëhet prej bërthamës, protoplazmës, kromozomeve dhe prej fijeve nervore me zgjatimet karakteristike të tyre. Zgjatime të tilla janë dentritet dhe neuriti i neuronit, sidomos dendritet. Dentritet janë të shkurtër dhe në fund

kanë degëzim të ndërlikuar, kurse neuriti është fije e gjatë jo aq e degëzuar. Neuritet dhe dendritet, sipas vendndodhjes dhe funksionit që kryejnë, kanë lidhje me qeliza nervore të tjera dhe me shqisa. Neuronet lidhen ndërmjet tyre dhe kjo lidhje kryhet me anë të dendriteve dhe të neuriteve. Lidhja e tyre në formë të rrjetit të ndërlikuar përbën sistemin nervor. Termi neuron u përdor për herë të parë nga anatomisti dhe mjeku spanjoll Santiago R. Kajal (Santiago R. Cajal, 1852 – 1934). Neuroni ka përbërje dhe funksione si edhe qelizat e tjera, por ka edhe funksione të posaçme, nga të cilat më karakteristike janë: ndjeshmëria dhe përçueshmëria e impulsive nervore. Vendi kalues i impulsive nervore nga neuriti i një neuroni në dendritin e neuronit tjetër quhet sinapsa. Këtë e ilustron figura e mëposhtme:



Në anatominë e sistemit nervor dallohen dy lloje neuronesh: neurone të tipit Golxh 1 dhe neurone të tipit Golxh 2. U quajtën sipas emrit të zbuluesit të tyre, histologut italian Kamilo Golxhi (Camilo Golgi, 1843 – 1926).

NEURONET BIPOLARE. Qelizat e sistemit nervor, që kanë vazhdime fijesh nervore të kundërta – një neurit ose akson dhe dentritet përball neuritit, përkatësisht në drejtime të kundërta të tipit të neuronit. Neuronet e këtilla gjenden më tepër në rrjetëzën a retinën e syrit të njeriut, ku lidhen qelizat receptore me qelizat e ganglioneve, përkatësisht ku prodhohen impulse nervore në kunjëza dhe në shkopthat dhe prej këndej barten në qelizat bipolare.

NEUROPATI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *νεύρωμα* "qelizë nervore" dhe *pathos* "sëmundje". Neuropatia është term përmbledhës për sëmundjet organike dhe funksionale të Sistemit Nervor, e më tepër për sëmundjet që rrjedhin nga lëndimi kronik i nervave. Në psikopatologjinë bashkëkohore sëmundjet neuropatike janë sëmundje organike, kurse sëmundjet neurotike ose psikogjene janë sëmundje psikike funksionale.

NEUROPEPTID/I, - E. m. Zinxhir i shkurtër prej dy ose tri neuropeptidesh ose aminoacidesh. Ky zinxhir kryen funksionin e neurotransmetuesit. Shih – ***NEUROTRANSMETUESIT.***

NEUROPSIKIATRI, - A. f. Degë e sistemit të shkencave të mjekësisë që merret me hulumtimin e raporteve ndërmjet proceseve nervore dhe çrregullimeve të këtyre proceseve dhe të sjelljeve të njeriut. Neuropsikiatria ka për detyrë të japë përgjigje të saktë në pyetjen: cila është baza neurologjike e sëmundjes psikike të caktuar dhe e çrregullimit të sjelljeve të njeriut?

NEUROPSIKOLOGJI, - A. f. Fushë e veçantë e psikologjisë fiziologjike që hulumton lidhjet ndërmjet trurit – proceseve psikike – sjelljeve të njeriut të shëndoshë dhe të atij të sëmurë. Neuropsikologjia merret posaçërisht me përshkrimin dhe me shpjegimin e

sëmundjeve psikike të shkaktuara nga proceset patologjike të disa strukturave të trurit ose të çrregullimit të funksioneve të tyre. Kjo nëndisiplinë e psikologjisë fiziologjike ka filluar të marrë karakterin e psikofiziologjisë zbatuese ose aplikative, me detyrën që me anën e testeve psikologjike të zbulohet dhe të identifikohet dëmtimi organik i trurit. Themelet e zhvillimit të neuropsikologjisë janë të lidhura me emrin e psikologut rus Aleksandër R. Luria (Alexander R. Luria, 1902 – 1977).

NEUROPSIKOLOGJIA KOGNITIVE. Disiplinë shkencore relativisht e re, që merret me studimin e bazës neurale të proceseve kognitive (të perceptimit, të vëmendjes, të kujtesës, të mendimit me të folur etj.). Neuropsikologjia kognitive hulumton çrregullimet e proceseve kognitive te ata të sëmurë, të cilët kanë disfunksione nervore të ndryshme në nivel të çrregullimit të qelizave nervore, të lidhjeve ndërmjet tyre, të qendrave nervore dhe të ndërlidhjeve funksionale të tyre.

NEUROTIK, - E. mb. Që i përket një individi neurotik, që ka të bëjë me një neurotik. I tillë mund të jetë çrregullimi neurotik, kërkesa neurotike, procesi neurotik, zgjidhja neurotike e situatave problemore etj. Zakonisht neurotik mund të jetë çrregullimi funksional i mendimit, i ndjenjave e i sjelljeve të njeriut. Çrregullime të tilla kanë të bëjnë me neurozat.

NEUROTRANSMETUES, - I. m. Substancë specifike kimike që çlirohet nga neuronet, përkatësisht nga sinapsa e fshikëzat e saj dhe, duke lëvizur në hapësirën sinoptike që mundëson bartjen e impulsive nervore nga neuroni parasinaptik në neuronin pas-sinaptik, në muskuj dhe në gjëndra. Neurotransmetuesit si substanca specifike sintetizohen në formë nyjash lidhore në neuronin parasinaptik. Nyjat lidhëse pëlcasin kur impulset nervore arrijnë në pjesën e fundit të aksoneve të neuroneve parasinaptike dhe, me këtë rast, dredhin cipën e neuroneve pas-sinaptike. Këtu neurotransmiterët lidhen me disa receptorë specifikë dhe cipat e neuroneve pas-sinaptike depolarizohen dhe hiperpolarizohen. Depolarizimi mund të shpjerë deri në paraqitjen e impulsit nervor në neuronet pas-sinaptike, kurse hiperpolarizimi mund të shpjerë në bllokimin e impulsive nervore. Neurotransmiterët luajnë rol shumë të rëndësishëm në veprimtarinë e qelizave nervore dhe të gjithë Sistemit Nervor. Çrregullimet sasiore e strukturore dhe funksionale të neurotransmetuesve shpien në çrregullime psikike të ndryshme. Sasia e zvogëluar e disa strukturave të acetilkolinës (e dopaminave) mund të shkaktojë sëmundjen e Parkinsonit, sasia e tepruar mund të shpjerë në forma të ndryshme të skizofrenisë. Janë identifikuar një numër relativisht i madh neurotransmetuesish, që përcaktojnë veprimtarinë e gjithëmbarshme të qelizave nervore. Dallimet biokimike ndërmjet neuroneve shkaktojnë funksione të ndryshme të qelizave nervore, që manifestohen edhe në ndryshimet e përjetimeve psikike dhe të sjelljeve të njeriut. Neurotransmetuesit zakonisht ndahen në dy lloje:

a. Neurotransmetues klasikë – acetilkolina, monoaminat, biogjenet, aminoacidet, monoksidi karbonhidrat etj.;

b. Neurotransmetues neuropeptidë aktivë – hormone, sidomos endomorfina. Ky grup neurotransmetuesish së bashku me neurotransmetuesit klasikë mbisundojnë aktivitetin e qelizave nervore. Funksionin e tyre e kryejnë në mbështetje të disa sistemeve biokimike (dopaminergjikë, kolinergjikë, noradrenergjikë etj.).

NEUROZ/Ë, - A. f. Term psikiatrik i vjetër që nënkuptonte një sëmundje nervore, sipas greqishtes *νεύρωμα* "nerv". Sot neuroza emërton formën e lehtë të çrregullimit funksional, që nuk ka bazë organike. Neuroza ka të bëjë me atë formë të çrregullimit psikik, që ka këto karakteristika kryesore: individi që vuan nga kjo sëmundje e lehtë psikike mban raport të drejtë me mjedisin dhe me ndryshimet e tij, por përjeton dobësim relativisht të qëndrueshëm të kontrollit të vetëdijshëm të sjelljeve të tij në raport me të tjerët; shfaqet me frikë patologjike të një forme dhe intensiteti të ndryshëm; me dobësim të funksionit të egos dhe dallim relativisht të madh ndërmjet dëshirave e synimeve dhe realizimit konkret të tyre; me dobësim të përqendrimit të vëmendjes, të arsyetimit të sjelljeve dhe të veprimeve; me frikë shoqëruese të sjelljeve të zakonshme; me vështirësi në marrjen e vendimeve, si edhe me çrregullime somatike. Neurozat sipas shfaqjes së tyre në sjelljet dhe në proceset psikike të njeriut, ndahen në disa grupe. Sipas Sigmund Frojdit, këto ndahen në neuroza të ankthit, të fobisë, obsesive–kompulsive dhe histerike. Po sipas këtij psikanalisti neurozat ndahen në neuroza aktuale, traumatike dhe në psikoneuroza ku bëjnë pjesë: histeria, fobitë, neurozat obsesive–kompulsive, përkatësisht neurozat e domosdoshme. Neurozat kanë bazë psikogjene: rrjedhin nga përjetimi i konflikteve, nga mossuksesi në plotësimin e motiveve të rëndësishme të njeriut, nga kushtet e vështira të punës dhe të jetës, nga përjetimet e rënda të moshës së fëmijërisë etj. Në psikiatri sot termi neurozë përdoret rrallë. Në DSM IV (Manuali Diagnostik i Ripunuar i Shoqatës Psikiatrike Amerikane) termi neurozë nuk ekziston. Në literaturën e psikopatologjisë klasike hasen disa lloj neurozash, nga të cilat veçohen:

a. **Neuroza aktuale**. Term i përdorur nga Zigmund Frojd dhe psikanalisti amerikan me origjinë austriake Vihelm Rajh (Wilhelm Reich, 1897 – 1957) që emërton sjelljen neurotike të njeriut, të shkaktuar nga konfliktet e brendshme, frustrimet ose edhe nga dëmtimi i funksioneve të strukturave organike të organizmit. Rajh më pas i vlerësoi këto shkaqe – si shkaqe të përbashkëta për të gjitha neurozat.

b. **Neuroza biologjike** – Përjetim i presionit të vazhdueshëm të frikës dhe ankthit nga njohuria për paaftësinë e organeve të caktuara, sidomos të trurit, për të kryer si duhet funksionin e tyre në trupin e njeriut;

c. **Neuroza e ankthit** – Forma akute dhe kronike e simptomave të frikës në sjelljet e njeriut, që shfaqet zakonisht me panik. Neuroza e ankthit u përshkrua nga Sigmund Frojdi (Zigmund Freud, 1856 – 1939) që nga viti 1895. Individët që vuajnë nga simptomat e neurozës së ankthit janë nën presionin e përhershëm se atyre do t`u ngjasë diçka e papritur, fatkeqësi (përmbytje e shtëpisë, djegie e pasurisë etj.). Dukurive të rastësishme u japin kup-

tim parandjenjat se diçka e keqe do të ngjasë. Sipas Frojdit neuroza e ankthit shfaqet nga shndërrimi i libidos në frikë;

d. **Neuroza e anoreksisë** – Çrregullim i të ngrënit të ushqimeve, çrregullim i ritmit të marrjes së ushqimit, i sasisë dhe i cilësisë së ushqimeve me pasoja negative për zhvillimet e proceseve biokimike të organizmit;

e. **Neuroza e dhunshme** – Lloj neuroze prej së cilës njeriu çlirohet me vështirësi. Neuroza e dhunshme shfaqet me mendim, përfytyrim dhe veprim neurotik**.**

f. **Neuroza e fatit** – Pritje e tensionuar e fatkeqësisë së karakterit periodik. Njeriu me ngarkesë të neurozës së fatit e konsideron veten "lodër" në duart e të tjerëve. Ai që vuan nga neuroza e fatit e konsideron veten të pafat, ai është i lindur për të përjetuar vazhdimisht situata të rrezikshme, që do t`i përsëriten herë pas here;

g. **Neuroza e karakterit** – Strukturë e formuar dhe e qëndrueshme e atyre tipareve karakteristikë të karakterit, që kanë zëvendësuar simptomat e neurotike të njeriut. Tiparet e këtilla individi i përjeton dhe është i vetëdijshëm për natyrën e tyre. këto tipare shtangohen në strukturën e karakterit të njeriut dhe luajnë rolin e ndalimit të energjisë së shtytësve në sjelljet e njeriut dhe të lehtësimit të shfaqjes së kërkesave të ndërgjegjes në rregullimin e manifestimit të tyre. Ky raport pengon shfaqjen e simptomave të neurozave dhe psikozave. Për këtë shkak struktura psikologjike e karakterit të njeriut të tillë është varfëruar. Neuroza e karakterit është term i psikanalizës.

h. **Neuroza e luftës** – Pengesë psikike funksionale e disa luftëtarëve, që zhvillohet nga çrregullimi i lehtë i qëndrueshmërisë emocionale. Neuroza e luftës shkaktohet nga mundimi dhe rraskapitja e luftëtarëve**;**

i. **Neuroza e situatës** – Tërësi reagimesh e sjelljesh të një karakteri nevrik që shkaktohen nga situata jo të zakonshme të njeriut. Të këtilla zakonisht janë situata që shkaktojnë ankth, frikë, stres, sidomos ato që shkaktojnë trauma te njeriu. Në situata të këtilla shfaqen forma të çorientimit të njeriut (vendi i ri i punës, ekipi i panjohur bashkëpunues, vendbanimi i ri etj.**).**

j. **Neuroza eksperimentale** – Diagnozë e studiuesit rus Ivan O. Pavllov, e cila është produkt i vënies së kafshëve dhe njerëzve në kushtet e formimit të refleksit të kushtëzuar, kur këta nuk kanë mundësi ta bëjnë dallimin nuansor të ngacmuesit të kushtëzuar. Për shkakun e sipërpërmendur të provuarit në kushte eksperimentale zhvillon një gjendje të konfliktit të tyre që mund të ketë edhe pasoja të rënda në shëndetin mendor. Kështu, qeni është mësuar për të reaguar pozitivisht ndaj një figure rrethore dhe marrjes së ushqimit, kur kjo figurë shndërrohet ngadalë në elips për këtë shkak atij nuk i jepet ushqim. Ndërsa, kur qeni nuk është në gjendje ta dallojë elipsin nga rrethi, te ai shfaqet veprimi neurotik. Në hulumtimet e I. Pavllovit gjendja neurotike apo neuroza eksperimentale e qenit shfaqet me refuzim të hyrjes në laboratorin hulumtues, me lehje të padurueshme, me orvatje të sulmit ndaj aparateve etj. Situata të ngjashme i hasim edhe te njerëzit.

k. **Neuroza kompensuese** – Neuroza kompensuese emërton konceptin e sjelljes neurotike të atij individi, i cili

pas përjetimit të stresit të rëndë ka dëshirë të madhe për t`u siguruar materialisht duke iu referuar traumës së përjetuar. Nën ndikimin e dëshirës së fuqishme për kompensim të tillë te ai shfaqen sjellje neurotike.

l. **Neuroza masive** – Sëmundje e shumë njerëzve në rruzullin tokësor që e kanë humbur pjesërisht ose tërësisht kuptimin e jetës dhe të zhvillimit. Këta njerëz vuajnë relativisht gjatë nga ndjenja e boshllëkut të jetës së brendshme të tyre, sepse konsiderojnë që jeta e tyre është e pakuptimtë. Termin neurozë masive e ka futur në terminologjinë e psikiatrisë dhe të psikologjisë psikiatri austriak Viktor E. Frenkël (Viktor E. Frankl, 1905 – 1997).

m. **Neuroza narcizoide** – Reagim karakteristik në psikanalizë, kur individi ka grumbulluar energji të dashurisë ndaj vetes, deri në atë shkallë sa kjo energji e grumbulluar bëhet shkaktare për të mos dashur të tjerët. Në të vërtetë ky individ nuk do askënd, përveç egos e trupit të vet. Dashuria ndaj vetes i kundërvihet dashurisë ndaj të tjerëve dhe e pengon dashurinë ndaj të tjerëve.

n. **Neuroza profesionale** – Formë e neurozës që shkaktohet nga disa situata të jetës dhe aktivitetit profesional të njeriut dhe nga droja e frika e vazhdueshme e përsëritjes së tyre etj.

o. **Neuroza simptomatike** – Sjellje tipike të njeriut nevrik që nuk paraqesin bazë të ndonjë sindrome, por janë sjellje të pastra, të kulluara neurotike. Vështirë të dallohet kuptimi i termit nerozë nga ai i termit neurozë simptomatike.

p. **Neuroza traumatike** – Turbullirë psikike me sjellje të paekuilibruara psiko-emocionale, që nuk kanë bazë organike e fiziologjike. Këto neuroza lindin si pasojë e ngjarjeve të papritura të shoqëruara me frikë të madhe. Neuroza traumatike shfaqet jo vetëm me frikë të madhe, por edhe me shqetësime të mëdha, me gjendje dëshpëruese etj. dhe janë shprehje të drejtpërdrejta të traumave të përjetuara. Në psikanalizë neuroza traumatike shfaqet kur libidoja shndërrohet në frikë.

q. **Neuroza vegjetative** – Formë e sjelljes neurotike të njeriut që shfaqet kryesisht me ngritjen e shqetësimit të sistemit nervor vegjetativ. Shqetësimi i këtillë i përshtatet lindjes së frikës dhe fobisë ndaj një objekti të caktuar. Është term i vjetër i psikopatologjisë.

NEUTRAL, - E. mb. Që përcakton karakterin asnjanës të një ngacmuesi, situate etj. Këtë kuptim ka edhe termi ngacmuesi neutral. Me këtë term emërtohet ai ngacmues i organizmit (drita, zëri, kontakti termik, elektrik etj.), që në gjurmimet eksperimentale të procesit të kushtëzimit nuk shkakton kurrfarë reagimi, por me kalimin e kohës i njëjti ngacmues mund të shndërrohet në ngacmues kushtëzues.

NEUTRALIZIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *neutralis*. Neutralizimi ose asgjësimi është term i psikanalizës, e pikërisht i psikologjisë së egos. Neutralizimi emërton konceptin e procesit të zbutjes dhe të asgjësimit të energjisë së shtytësit seksual dhe atij agresiv me karakteristikat e tyre që burojnë nga periudha e zhvillimit të fëmijërisë së hershme. Neutralizimi është shkak i ndryshimit pozitiv cilësor të shfaqjes infantile ose primitive të shtytësit seksual dhe atij agresiv, i pranishëm

gjithsesi edhe për egon, duke i kontribuar në këtë mënyrë edhe zhvillimit e formimit të personalitetit.

NEVERITJ/E, - A. f. Lloj i ndjenjës që lidhet drejtpërdrejt me ndijimin e mundimit të madh, me përjetim të sikletit dhe me sjellje të largimit, të ikjes nga objekti që shkakton neveri. Objekte të neverisë mund të jenë disa lloje ushqimesh, erërash, njerëzish etj. Me rastin e përjetimit të neverisë zhvillohet reagimi fizik i organizmit të njeriut ndaj objektit të neverisë. Reagimi i tillë mund të jetë pasojë e refleksit të formuar, përkatësisht pasojë e refleksit të kushtëzuar (lidhje e objektit dëmtues të organizmit me reagimin specifik ndaj tij). Në zhvillimin e ndjenjës së neverisë ndikim të fuqishëm ushtron kriteri i formuar i dallimit të lëndëve, të sjelljeve etj. të dobishme – të dëmshme, të mira – të këqija, të bukura – të shëmtuara etj.

NEVOJ/Ë, - A. f. Emërtim i konceptit dinamik të personalitetit që ka të bëjë me gjendjen fiziologjike e psikologjike të njeriut, të shkaktuar nga mungesa e asaj që është e domosdoshme ose e dëshirueshme për funksionimin normal, për ekzistencën e organizmit dhe e shoqëruar me synimin e njeriut për ta tejkaluar këtë gjendje, duke arritur dhe zotëruar objektivin e asaj nevoje. Nevojat e nxisin aktivitetin e organizmit dhe i drejtojnë sjelljet e tij në lëndën e plotësimit të tyre. Ky është kuptimi edhe atëherë kur kemi të bëjmë me nxjerrjen jashtë organizmit të asaj që është e tepërt dhe që pengon zhvillimin psikobiologjik të tij. Si në rast mungese, ashtu edhe në rast teprie nevoja ka përmasë dinamike dhe e shtyn njeriun të veprojë duke e drejtuar veprimtarinë e tij në një objektiv të caktuar. Në këtë kuptim ky term emërton gjendjen fiziologjike dhe psikologjike e sociale të shkaktuar nga çrregullimi i baraspeshës psikobiologjike e psikosociale të organizmit. Nevoja përmbledh tri gjendje strukturore: 1) Mungesën (e ushqimit, të shoqërisë, të kureshtjes etj.), të shoqëruar me energji pozitive ndaj objektivit përkatës të nevojës; 2) Plotësimin (marrja e sasisë së duhur të ushqimit, prania e mjedisit shoqëror, nderimi i mjaftueshëm etj.) me strukturë dinamike asnjanëse ose neutrale dhe 3) Mungesën (e ushqimit, të shoqërisë, të vetafirmimit etj.) me strukturë dinamike të theksuar, të drejtuar në plotësimin e asaj mungese ("valenca pozitive, asnjanëse dhe negative"). Plotësimi i nevojave është i domosdoshëm për funksionimin normal të organizmit dhe për shëndetin e tij. Shumësia e nevojave karakterizon dinamikën e gjithëmbarshme të njeriut. Sipas natyrës së tyre nevojat mund të jenë tri llojesh: nevoja biologjike, nevoja sociale dhe nevoja psikologjike. Sipas zhvillimit nevojat mund të jenë nevoja të lindura dhe nevoja të formuara.

a. **Nevojat biologjike** – Nevoja të domosdoshme për funksionimin normal të organizmit dhe shëndetin trupor. Të tilla janë: nevoja për frymëmarrje (oksigjen), ujë, ushqim dhe gjumë;

b. **Nevoja sociale** – Nevoja për të jetuar dhe për t'u zhvilluar në mjedis me të tjerët, nevoja për t`i ikur vetmisë, si: nevojat morale, për komunikim me të tjerët, për arritje shoqërore të nivelit sa më të lartë etj.;

c.Nevoja psikologjike – Nevoja të vetëdijshme dhe të pavetëdijshme të personalitetit. Nevoja psikologjike janë: nevoja për të dashur, për të qenë i dashur, për të nderuar suksesin e tjetrit etj. Plotësimi i tyre cilësor e sasior siguron shëndetin mendor të njeriut. Ndarja e tillë është ndarje relative. Të gjitha nevojat biologjike e sociale kanë përmasë psikologjike, kur njeriu bëhet i vetëdijshëm për nevojën që ka dhe kur reagon ndaj tyre.

NEVOJA E SIGURISË. Nevojë themelore dhe e përgjithshme gjithënjerëzore. Nevoja e sigurisë ka të bëjë me prirjen e njeriut për të mënjanuar gjithë atë që e ngadalëson, e pengon, e vështirëson mbrojtjen e zhvillimit fizik, psikik e shoqëror, si edhe integritetin e personalitetit të njeriut dhe jetën e tij. I shtyrë nga nevoja e sigurisë njeriu largohet nga kontakti me atë dukuri, objekt, njeri etj. që ia kërcënon famën dhe autoritetin e tij. Disa nga psikologët, si Eduard MekDugal, Abraham Maslou etj. nevojën e sigurisë e konsiderojnë nevojë themelore të qenies njerëzore.

NEVOJAT E FORMUARA. Nevoja të mësuara psiko-sociale gjatë socializimit dhe edukimit individual të njeriut në familje dhe në mjedisin e gjerë shoqëror. Këto nevoja quhen edhe nevoja dytësore. Nevojat e formuara janë ndërmjetësime socio-psikologjike për plotësimin e nevojave parësore, të nevojave të domosdoshme për njeriun dhe zhvillimin e tij. Të tilla janë nevojat e mësuara për të jetuar dhe bashkëpunuar me të tjerët dhe për të tjerët. Në fillim zhvillohen nga varësia e foshnjës nga e ëma dhe të tjerët në familje, kurse më pas nevoja për të qenë me të tjerët, për t`i plotësuar nevojat biologjike me ndihmën e të tjerëve dhe për t`iu larguar vetmisë marrin karakter të pavarur. Numri më i madh i nevojave të njeriut janë nevoja të mësuara, kurse mënyra e plotësimit të të gjitha nevojave është produkt i të mësuarit.

NEVOJAT ELEMENTARE SIPAS MAREJ. Psikologu amerikan Henri A. Marej (Henri A. Marrey, 1893) ka dalluar këtë grup nevojash të dinamikës së njeriut:

a.Nevoja për mbisundim – Nevoja për mbisundim ose zotërim ndaj të tjerëve shfaqet në angazhimin e njeriut për t`i kontrolluar dhe sunduar të tjerët;

b.Nevoja për mbrojtje –Nevojë e njeriut për të ndërmarrë një aktivitet të posaçëm me qëllim të mbrojtjes së unit të vet**;**

c.Nevoja e përkrahjes – Pritja e njeriut për ta ndihmuar dhe për t`u udhëhequr drejt nga të tjerët;

d.Nevoja e nënshtrimit ndaj të tjerëve – Vlerësimi i angazhimit të të tjerëve dhe entuziazmi i tij për arritjet e të tjerëve, sidomos të udhëheqësve të tij etj.

NEVOJAT NEUROTIKE. Në psikologjinë e personalitetit të Karen D. Hornej (Karen D. Horney, 1883 – 1952) emërton dhjetë nevoja që zhvillohen për zgjidhjen e pavetëdijshme të ankthit bazal. Këto nevoja zhvillohen që nga fëmijëria me qëllim të gjetjes së atyre zgjidhjeve të pafuqisë fëmijërore, për t`u gjendur në mjedisin nga i cili ai pret ndihmë dhe siguri dhe kërkon dashamirës, miq dhe shokë. Në procesin e zhvillimit të tillë të raportit të fëmijës me mjedisin e tij social, ekonomik, fetar etj. ai zhvillon këto synime me të tjerët: synimin për të lëvizur

kah të tjerët, për të ikur nga të tjerët dhe për të qenë kundër të tjerëve. Në kuadrin e këtyre synimeve dhe të drejtimeve sociale të tyre te ai zhvillohen dhjetë nevoja neurotike: 1) për t`u dashur nga të tjerët dhe për t`u lejuar prej tyre sjelljet e tij; 2) për partner; 3) për reduktim të jetës së tij në kufij të ngushtë; 4) për të qenë i fuqishëm; 5) për respekt; 6) për famë; 7) për sukses; 8) për vetëmjaftueshmëri; 9) për pavarësi dhe 10) për përsosje. Ndër këto nevoja dallohen posaçërisht këto:

a. **Nevoja për famë** – Nevojë neurotike për ta entuziazmuar mjedisin me sjelljet e tij. Njeriu i tillë e mbivlerëson veten dhe vazhdimisht pret respekt dhe nderim nga të tjerët;

b. **Nevoja për të qenë i fuqishëm** – Synim i fuqishëm për të qenë mbi të tjerët, për t`i sunduar të tjerët;

c. **Nevoja për t`u dashur nga të tjerët** – Nevojë për t`i kënaqur të tjerët dhe për të jetuar sipas rregullave të jetës së tyre të mirë. Njeriu me nevojë të tillë neurotike goditet shumë keq nga imtësitë negative ndaj tij;

d. **Nevoja për partner** – Nevojë dhe dëshirë e përhershme dhe e pangopur për dashuri. Njeriu me nevojë të tillë e mbiçmon rolin e dashurisë në jetën dhe aktivitetin e tij, duke e konsideruar dashurinë "çelës" dhe "ilaç" për gjithçka në jetë;

e. **Nevoja për vetëmjaftueshmëri** – Nevojë që manifestohet me zhgënjim të njeriut ndaj të tjerëve, ndaj bashkëpunimit me të tjerët dhe me rolin e tyre në shoqëri etj.

f. **Nevoja për të reduktuar jetën në kufij të ngushtë** – Nevojë neurotike për të jetuar i heshtur, i qetë dhe i thjeshtë. Njeriu me nevojë të tillë ka kërkesa të thjeshta ndaj të tjerëve dhe përgjithësisht ndaj mjedisit të tij.

NEVOJAT NJERËZORE ELEMENTARE. Psikanalisti social Erik From (Erich Fromm, 1900 – 1980) ka theksuar rolin e faktorëve socialë në zhvillimin e personalitetit të njeriut. Nga kjo pikënisje ai ka dalluar këto nevoja elementare njerëzore në dinamikën e secilit:

a. **Nevoja për identitet** – Nevoja e lidhur me vetëdijen e njeriut për ta njohur vetveten e tij. Kjo nevojë lidhet drejtpërdrejt me pyetjen "Kush jam unë"?, përkatësisht me kërkesën për të gjetur origjinën dhe pozitën e vet;

b. **Nevoja e drejtimit të njeriut në kaosin e natyrës** – Nevoja e depërtimit të njeriut në dukuritë pak ose aspak të njohura, dhe e renditjes së informacioneve e lidhjeve të reja në një rreth njohurish, ku ka rend, ku ka sistem;

c. **Nevoja e lidhjes së njeriut me të tjerët** – Ikja nga vetmia dhe bashkimi i njeriut me të tjerët në mjedisin e tij për ta zotëruar ndjenjën e izolimit dhe për të siguruar shëndet të duhur mendor;

d. **Nevoja e tejkalimit të vetvetes** – Nevojë specifike njerëzore që ka të bëjë me angazhimin krijues të tij për t`u ngritur mbi pasivitetin dhe rastësitë e ekzistencës dhe për të depërtuar në fushën e lirisë dhe të veprimtarisë së qëllimshme;

e. **Nevoja për sigurim jetësor** – Nevoja për të qenë i mbrojtur, i parrezikuar, i sigurt në jetën dhe në aktivitetin e njeriut. Krahas Erik Fromit këtë nevojë e kanë theksuar edhe Alfred Adler (Alfred Adler, 1870 – 19370, Karen Hornej (Karen Horney, 1885 – 1952) etj.

NEVOJAT PARËSORE. Nevoja të lindura, të lidhura drejtpërdrejt me jetën dhe me zhvillimin jetësor të njeriut.

NEVRALGJI, - A. f. I ardhur nga latinishtja *neuralgia*. Nevralgjia emërton llojet e ndryshme të dhembjeve nervore. Ndër dhembjet e tilla më të njohura janë: nevralgjia arteriosklerotike, diafragmatike, iskiake (e nervit ndijor) etj.

NEVRASTENI, - A. f. Në psikiatri i ardhur nga greqishtja *νευρ* "nerv" dhe *αοθένεια* "dobësi, dobësi nervash". Nevrastenia është dobësi, ligështi e përgjithshme trupore e psikike e njeriut me çrregullime të vogla të funksionimit të organeve të caktuara, që shoqërohet me mbivlerë të dhembjeve si edhe me përqendrim të tepruar të vëmendjes së njeriut në gjendjen e tij. Nevrastenia konsiderohet sëmundje kronike, që zgjat rreth katër vjet. Mund të shkaktohet nga puna e rëndë, si pasojë e konflikteve të rënda dhe frustrimeve të njëpasnjëshme etj. Shenjat karakteristike të nevrastenisë janë: lodhja e shpejtë e njeriut, pagjumësia, përqendrimi i dobët i vëmendjes, mungesa e interesimit për ndryshimet e jashtme etj. Shërimi i atij që vuan nga nevrastenia është i mundshëm me anë të kombinimit të psikoterapisë me farmakoterapi. Për njohje të nevrastenisë, të shkaqeve, të rrjedhës dhe të shërimit nga kjo sëmundje nevojitet njohja integrale e gjenetikës, e neuroanatomisë, e neurofiziologjisë, e psikofiziologjisë dhe e psikoendokrinologjisë.

NEVRASTENIA E FRIKËS. Formë e frikës që shfaqet me atakime paniku dhe me sjellje paniku të ikjes nga mjedisi dhe nga nxitësit e sjelljeve të tilla të atij mjedisi. Me rastin e përjetimit të nevrastenisë së frikës konsiderohet se aktivizohen trungu i trurit, pjesa limbike e trurit dhe pjesa paraballore e cipës ose e kores së trurit të madh.

NEVRIK, - E. mb. Që ngacmohet lehtë, që zemërohet dhe reagon vrullshëm ndaj objektit që i ka shkaktuar nevrikosje, duke mos e përmbajtur veten e tij.

NËNA SKIZOFRENE. Term togfjalësh i përshtatur nga anglishtja *double bid* "lidhje e dyfishtë". Nëna skizofrene është nëna, e cila me sjellje imponuese ndaj fëmijës së vet, por me ftohtësi emocionale dhe me largësi prej saj mund të shkaktojë skizofreni, sepse në të njëjtën kohë e shtyn ta dojë dhe e refuzon nga vetja e saj. Këtë term e ka futur në terminologjinë e psikiatrisë dhe të psikologjisë klinike antropologu britanik Gregori Bejtson (Gregory Bateson, 1904).

NGACMIM, - I. m. Procesi i ndikimit të një ngacmuesi në organet e trupi të njeriut, i shoqëruar me ndryshimet neurofiziologjike dhe fiziologjike të tyre. Ky proces shkaktohet nga ngacmuesit e jashtëm e të brendshëm dhe konsiston në reagimin përkatës të një organi të caktuar ndaj atij ngacmuesi.

NGACMUES, - I. m. I përdorur më tepër në psikofiziologji dhe psikofizikë. Në psikofiziologji dhe në psikofizikë ngacmuesi është ndryshimi i energjisë fiziko–kimike (akustike, mekanike, optike etj.) i një trupi, procesi etj. të jashtëm ose të brendshëm, që me cilësinë, intensitetin dhe kohëzgjatjen e duhur është në gjendje të shkaktojë ndijim ose perceptim të tij.

Organizmi i njeriut ka shqisa të specializuara dhe receptorë të posaçëm për marrjen e llojit të caktuar të ndryshimeve fiziko-kimike. Ngacmuesit ndahen në disa lloje:

a. **Ngacmuesi adekuat** – Trupi, procesi natyror etj. që me cilësinë e energjisë së tij dhe me intensitetin e vet është në gjendje të shkaktojë reagim të një receptori ose të disa receptorëve ndaj ngacmuesve të tillë, që janë zhvilluar deri në formën e përsosjes së organeve shqisore të njeriut;

b. **Ngacmuesi indiferent** – Ngacmues që vepron në shqisat e organizmit por nuk shkakton ngacmim të tyre, pra ndikimi i tyre nuk shkakton reagim;

c. **Ngacmuesi joadekuat** – Ngacmues jo i natyrshëm për një organ shqisor të caktuar, ndaj të cilit shfaqet reagim shqisor (rryma e ulët elektrike kur vepron në shqisën e shijes shkakton ndijim të shijes, ndijim të të prekurit, të të parit etj.;

d. **Ngacmuesi i kushtëzuar** – Drita, zëri etj. që në fillim kanë karakter neutral dhe organizmi ose një shqisë e caktuar e tij është indiferent ndaj tyre, por me shfaqjen e tyre të lidhur me ngacmuesit e pakushtëzuar dhe me përsëritjen disa herë të tyre shkaktojnë reagim të organit shqisor të njëjtë me ngacmuesin e pakushtëzuar. Reagimi ndaj ngacmuesit të kushtëzuar është produkt i të mësuarit;

e. **Ngacmuesi i pakushtëzuar** – Çdo ngacmues i natyrshëm, që me ndikimin e tij në organizëm shkakton reagim të tij ose të një organi të caktuar ndaj atij ngacmuesi. Ngacmuesi i tillë dhe reagimi ndaj tij është reagim i lindur, përkatësisht jo i mësuar (rrjedha e pështymës kur në gojë vepron ushqimi, mbyllja ose hapja e bebes (pupilës) së syrit, kur në syrin e njeriut vepron drita e dobët ose drita e fortë etj.). Ndaj këtyre ngacmuesve organizmi reagon vazhdimisht në një mënyrë të caktuar.

NGACMUESI AVERSIV. Ngacmues i organizmit të njeriut, ndaj të cilit individi reagon me ikje, me largim ndaj tij. Reagimi i tillë është produkt i të mësuarit. Ngacmues aversivë mund të jenë rrobat, veshja e një njeriu, ushqimi i përgatitur në një kuzhinë, syzat e tjetrit etj.

NGACMUESI FIZIK. Ngacmues i trupave fizikë që ushtrojnë ndikim në një shqisë të caktuar me energjinë natyrore, si edhe me ndryshimet fizike të intensitetit që mund të matet me njësi matëse objektive. Ngacmues fizikë janë: drita - tallaze elektromagnetike gjatësish dhe shpejtësish të caktuara; zëri - lëvizje tallazesh ajrore që me intensitetin e caktuar ngacmojnë veshin e njeriut, trupi i lëngët dhe i ngurtë që me energjinë termike ushtron ndikim në shqisën e të prekurit etj.

NGACMUESI FIZIOLOGJIK. Substancë farmakologjike që marrin punëtorët për të përballuar lodhjen nga puna, duke zvogëluar ndijimin e lodhjes. Këto substanca kanë efekt të shkurtër dhe janë të dëmshëm për organizmin. Me termin ngacmues fiziologjikë emërtohen edhe format e aktivitetit dhe marrja e disa lëngjeve që rrisin rezultatin e punës (pastrimi i faqeve me ujë të ftohtë, noti, gjimnastika, shëtitja në pyll, kafja, çaji etj.), por kohëzgjatja e faktit të tyre është e shkurtër.

NGACMUESI FUNKSIONAL. Ngacmuesi që ka funksion kontrollimin e reagimit ose të përgjigjes së organizmit ndaj atij ngacmuesi (mbajtja në mend dhe riprodhimi i drejtë i rrokjes MIB, duke shndërruar këtë rrokje në emërtim të Ministrisë së Punëve Brendshme, ky shndërrim bëhet ngacmues funksional i mbajtjes në mend dhe i riprodhimit të suksesshëm të rrokjes MIB).

NGACMUESI I KUSHTËZUAR. Ngacmues të tillë si: drita, ngjyra, tingulli etj. që për organizmin janë neutralë, por që, së bashku me dhënien e ushqimit, përkatësisht të ngacmuesit të pakushtëzuar, shndërrohen në faktorë shkakorë për reagim të ngjashëm me atë të ushqimit. Qeni duke iu ekspozuar disa herë dritës elektrike–ushqimit arrin një çast kur vetëm drejtimi ndaj tij i dritës elektrike shkakton derdhjen e jargëve. Ngacmuesi i kushtëzuar vetëm (pa dhënie të ushqimit) nuk shkakton reagim të gjëndrave jargore, por pas disa përsëritjesh dritë elektrike–ushqim ai fillon të reagojë me aktivizim të gjëndrave jargore, sepse pret që pas dritës elektrike do të marrë ushqim. Termi ngacmues i kushtëzuar i përket fiziologjisë së Ivan P. Pavllovit (Ivan P. Pavlov, 1849 – 1936) dhe ka të bëjë vetëm me kushtëzimin klasik.

NGACMUESHMËRI, - A. f. Formë elementare e zhvillimit psikik te kafshët dhe te njerëzit që ka të bëjë me gatishmërinë e organizmit ose të një organi, përkatësisht sistemi organesh, për të reaguar ndaj ndikimit që ushtrojnë lëndët e ndryshme të mjedisit të jashtëm në organizëm. Ngacmueshmëria shfaqet me ndryshimin morfologjik dhe fiziologjik të neuroneve gjatë reagimit të tyre ndaj ngacmuesve.

NGADALËSIM, - I. m. I ardhur në psikologji nga përkthimi i teksteve psikologjike nga anglishtja, por ka prejardhje nga latinishtja *retardare* "ngadalësoj". Në psikologji emërton konceptin e vonesës në zhvillimin psikik, ose të një ose disa strukturave psikike dhe tipareve të veçanta të personalitetit. Në përkthimet e teksteve psikologjike shpesh bëhet fjalë për ngadalësim mendor, që është zhvillim i vonuar mendor i njeriut. Shih – ***PRAPAMBETJA MENDORE.***

NGASJ/E, - A. f. Ringjallje e një dëshire, e një synimi, e një interesi etj. ose fuqizimi i tyre me anën e nxitësve të posaçëm, të cilët luajnë rol të rëndësishëm, sidomos në çastin kur njeriu luhatet ose përpiqet t`i shmanget realizimit të tyre.

NGASHËNJIM, - I. m. Veprimi me të cilin njeriu josh tjetrin për dukurinë, objektin, veçorinë, veprimin etj. Mjet ngashënjimi mund të jetë shprehja e bukur, paraqitja e jashtme e njeriut, premtimi i dhënë etj.

NGASHËRI, - A. f. Përjetim i gjendjes së dhembjes, të mallëngjimit, të keqardhjes etj. për bashkëluftëtarin, mikun, shokun etj. të humbur.

NGATHTËSI, - A. Shih – ***PLOGËSHTIA.***

NGAZËLLIM. Shih – ***SHEND.***

NGOPJE, - A. f. Gjendja psikike e fiziologjike e organizmit të njeriut, kur është e plotësuar një nevojë, kur realizohet një dëshirë, kur organizmi

i njeriut nuk ndien nevojë për angazhim, për plotësim të asaj dëshire a nevoje, të atij motivi etj. Për ngopjen dhe ndijimin e ngopjes së organizmit ekziston një mekanizëm i posaçëm fiziologjik, me anën e të cilit përjetohet gjendja e ngopjes, madje edhe atëherë kur uji, ushqimi nuk ka arritur në indet dhe në qelizat e organizmit.

NGOPJA E NGJYRAVE. Cilësi e veçantë e ngjyrave që ka të bëjë me pastërtinë e ngjyrave kromatike. Ngjyra më e pastër është ajo ngjyrë që formohet prej valëve elektromagnetike me gjatësi të njëjtë. Sa më shumë të dallohet një ngjyrë nga ngjyra e zezë, përkatësisht sa më larg të jetë një ngjyrë nga ngjyra e zezë, aq më e pastër është kjo ngjyrë, aq më e ndezur është. Ngjyrat me shkallë të ulët ngopjeje janë ngjyra të zbehta, kurse ngjyrat me shkallë të lartë ngopjeje valësh të njëjta elektromagnetike janë ngjyra të ndritshme, të gjalla dhe të plota. Shih – ***SATURACIONI.***

NGOPJA FAKTORIALE. Përmbajtja e matricës faktoriale me disa faktorë të përbashkët për shumë ndryshore psikologjike. Niveli i ngopjes faktoriale përcakton ndryshueshmërinë e një ndryshoreje psikologjike të lidhur drejtpërdrejt me funksionin e faktorit të identifikuar. Niveli i kësaj ngopjeje mundëson shpjegimin e masës së pjesëmarrjes së një faktori në variancën e ndryshores së provuar, e pikërisht në çfarë niveli të korrelimit është një ndryshore me faktorin e përftuar me anë të analizës faktoriale. Ngopja faktoriale në disa tekste të psikometrisë emërtohet me termin ngarkesë faktoriale.

NGROHTË (I, E). mb. Që ka të bëjë me njërin ndër ndijimet e lëkurës me temperaturë pak më të lartë se temperatura normale e lëkurës. Ndijimi i ngrohjes duhet dalluar nga ndijimi i nxehtësisë. I ngrohtë mund të jetë ajri, rrobat, uji etj., kur kanë temperature disi më të lartë se temperatura normale e trupit të njeriut, pikërisht pak më të lartë se 32 gradë Celsius. Por, ndijimi i tillë varet nga shkalla e përshtatjes së lëkurës.

NGULITJ/E, - A f. Term i etologjisë që paraqet një formë elementare të të mësuarit, karakteristike për disa lloje kafshësh (kryesisht shpendësh), që shfaqet në fazën e hershme të zhvillimit, pikërisht gati menjëherë pas lindjes ose pas pak kohësh (disa orë pas lindjes së tyre ose pas një ose dy ditësh). Ngulitje nuk është sjellje e trashëguar, por lloj i të mësuarit të kufizuar. Ka dy forma manifestimi: formën pozitive dhe formën negative. Forma pozitive është veprim i zogjve të porsalindur (i guçave, i rosave, i sorrave etj.), që e përqendrojnë të parit në një objekt të madh që lëviz e që gjendet pranë tij (zakonisht nëna e tyre) dhe zogu i porsalindur fillon të imitojë lëvizjet, zërin e s`ëmës; fillon të notojë duke ndjekur zogun më të madh, madje edhe njeriun, kur ai ose ajo noton në ujin e një bazeni, liqeni, përroi etj., fillon të imitojë zërin e rosës së madhe, sapo ajo të largohet nga të vegjëlit e saj etj. Forma negative e ngulitjes ka të bëjë me sjellje të largimit të të vegjëlve nga objekti i madh, kur më të mëdhenjtë e tyre të të njëjtit lloj fekondohen. Ngulitja konsiderohet formë elementare e të mësuarit, e lidhur ngushtë me aktivitetin instinktiv të një lloji të caktuar

kafshësh (ka karakter të përgjithshëm, uniform për pjesëtarët e gjithë llojit të caktuar të kafshëve, shfaqet gati menjëherë pas lindjes, pëson ndryshime të vogla dhe të parëndësishme gjatë jetës dhe përvojës, ngulitet në sistemin nervor dhe nuk eleminohet gjatë jetës etj.). Kjo formë e të mësuarit ka kuptim biologjik, sepse duke ndjekur të madhin, zogu i vogël mbrohet nga i madhi, e siguron ushqimin në atë vend ku ushqehet edhe i madhi, i largohet rrezikut njësoj si i madhi etj. Quhet ngulitje, sepse sjelljet e tilla mbeten të përhershme në jetën e këtyre kafshëve, përkatësisht të shpezëve, duke ndikuar vazhdimisht në aktivitetin social të tyre. Termin ngulitje e përdori i pari etologu austriak Konrad Lorenc (Konrad Lorenz, 1903 – 1989) dhe më pas u studiua nga ana e disa hulumtuesve duke i dhënë, madje, edhe termin burimor të anglishtes *imprinting*.

NGULM, - I. m. Paluhatshmëria e njeriut për realizimin e një dëshire, synimi, vendimi etj. Ngulmi ka strukturë kognitive të ndërlikuar, ku marrin pjesë disa procese: mendimi, besimi e bindja e njeriut se ajo dëshirë, synim, vendim etj. duhet patjetër të realizohet, sepse njeriu ka besim dhe është i bindur se me rezultatet e realizimit të asaj dëshire ai plotëson, kënaq dëshirën, synimin dhe vendimin personal. Ngulmi i shfaqur vazhdimisht në sjelljet e njeriut merr përmasën e një qëndrimi.

NGURRIM, - I. m. Gjendje psikologjike e njeriut, kur ai nuk prononcohet në mënyrë të prerë për një vendim të caktuar dhe për veprimtarinë e posaçme të tij. Pozitën e tillë mendore dhe emocionale e shkakton luhatshmëria e shkaktuar nga ndikimi që ushtron në njeriun fuqia e dy dëshirave, dy motiveve, dy synimeve etj. me fuqi tërheqëse gati të njëjtë.

NGUSHËLLIM, - I. m. Përpjekje e qëllimshme e njeriut për t`ia lehtësuar dëshpërimin, hidhërimin, pikëllimin etj. një njeriu tjetër, për humbjen e asaj që ka përbërë pjesën qenësore psikologjike të subjektivitetit të tij. Ngushëllimin e përjeton njeriu në bazë të dëshpërimit, të keqardhjes dhe të pikëllimit që ai ndien për tjetrin. Zakonisht ngushëllimi është i lidhur me marrjen pjesë në pikëllimin e tjetrit.

NGJASHMËRIA E NGACMUESVE. Sipas psikologjisë geshtaltiste emërton njërin ndër parimet e perceptimit, sipas të cilit ngacmuesit e ngjashëm krijojnë mundësi reale për të përjetuar një tërësi perceptive. Këtë mundësi nuk e kanë ngacmuesit me formë, strukturë etj. të ndryshëm. Shih - ***PARIMET GESHTALTISTE TË PERCEPTIMEVE.***

NGJYR/Ë, - A. f. Ngacmues fizik që shkakton ndijim të ndërlikuar pamor nga ndikimi që ushtron në syrin e njeriut, përkatësisht në receptorët e të parit. Ngjyra ka tri përbërës fizikë: gjatësia e valëve elektromagnetike (prej rreth 480 deri në rreth 700 nanometër), pastërtia e ngjyrës dhe intensiteti i saj. Këtë e dallojmë në figurën e mëposhtme:



NGJYRA ASNJANËSE. Ngjyra akromatike dhe secila nuancë e tyre, që shtrihet në vazhdimësinë bardh e zi. Ngjyrë asnjanëse ose neutrale mund të jetë ngjyra e bardhë e papastër, ngjyra e përhimët, ngjyra e zezë e çelët etj.

NGJYRA E TONIT. Njëra ndër veçoritë e tonit, që përcaktohet nga ana e strukturës së valëve të ndërlikuara zanore me tone të lartë, të cilët e përcjellin tonin themelor dhe emërtohen edhe me termin *mbiton*. Sipas ngjyrës së tonit dallojmë përjetimin e tonit me lartësi e intensitet të njëjtë që prodhohet nga instrumentet e ndryshëm muzikorë (toni A në kitarë, në piano, në violinë etj.).

NGJYRA KOMPLEMENTARE. Ngjyra që gjenden përballë njëra tjetrës në rrethoren e ngjyrave. Përzierja e dy ngjyrave kromatike (e kuqe – e gjelbër; e verdhë – e kaltër) duke plotësuar njëra tjetrën japin ngjyrën e murrme kur dy ngjyrat kromatike përzihen në raportin 1:1.

NGJYRAT KROMATIKE. Grup ngjyrash i përbërë nga ngjyra e kuqe, e verdhë, e gjelbër dhe e kaltër, si edhe nga nuancat ndërmjet tyre. Cilësia e këtyre ngjyrave dallohet nga e zeza dhe e murrmja dhe e bardha, që nuk i përkasin grupit të ngjyrave kromatike. Cilësia e këtyre ngjyrave dhe ndijimi i cilësisë së tyre përcaktohet nga gjatësia e valëve elektromagnetike: ndijimin e së kuqes e shkaktojnë valët elektromagnetike me interval gjatësie valore ~ 700 – 635 nm, të ngjyrës së portokalit pre ~ 635 – 590 nm, të verdhës prej ~ 590 – 560 nm, të gjelbrës prej ~ 560 – 490 nm, të kaltrës prej 490 – 450 nm dhe ngjyrës vjollcë ~ 490 – 40 nm. Intervali i freguencave valore për ngjyrat e përmendura është i ndryshueshëm. Kjo dallohet në figurën e mëposhtme:

Ngjyrat dhe dukshmëria e spektrit të dritës

Ngjyra	Intervali i gjatësisë valore	Intervali i frekuencës
e kuqe	~ 700–635 nm	~ 430–480 THz
portokalli	~ 635–590 nm	~ 480–510 THz
e verdhë	~ 590–560 nm	~ 510–540 THz
e gjelbër	~ 560–490 nm	~ 540–610 THz
e kaltër	~ 490–450 nm	~ 610–670 THz
vjollcë	~ 450–400 nm	~ 670–750 THz

Raporti ndërmjet nuancave të këtyre ngjyrave paraqitet në figurën e mëposhtme:



Ngjyrat komplementare (të kundërta)

Valët me gjatësi elektromagnetike të përmendura më sipër, duke vepruar në receptorët e të parit, përkatësisht në qelizat receptore të retinës së syrit shkaktojnë ndijimin e cilësisë përkatëse të ngjyrës. Ndijimi i ngjyrës varet edhe prej ngopjes (pastërtisë) së ngjyrës, prej ndriçimit dhe prej cilësive kromatike të mjedisit.

NGJYRAT SPEKTRALE. Të gjitha nuancat e ngjyrave që gjenden në një shtrirje prej rreth 380 nanometër deri në rreth 740 nanometër. Kjo shtrije krijohet prej këtyre ngjyrave: vjollcë, blu, e kaltër, e gjelbër, e portokalltë dhe e kuqe, secila me intensitet të ndryshëm ndriçues. Shih – ***RRETHI I NGJYRAVE.***

NGJYRAT TERCIARE. Ngjyrat e përftuara nga përzierja e ngjyrave parësore me ngjyrat e afërta dytësore, duke dhënë cilësinë e ngjyrës bardhë – e zi, e gjelbër – e kaltër, e kuqe – e kaltër etj.

NGJYRES/Ë, - A. f. Tërësi e harmonizuar ngjyrash e sipërfaqes së jashtme të një gjësendi, orendi shtëpiake, peizazhi etj. që shkakton reagim pozitiv të njeriut ndaj saj, kënaqësi dhe lë mbresa te ai. Ngjyresa me këtë kuptim thua se i jep ndriçim të posaçëm gjësendit, orendisë, peizazhit etj.

NIHILIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *nihil* "asgjë". Term i përgjithshëm për ato forma të koncepteve që mohojnë botëkuptimin, parimet, normat e vlerat dhe ka përmasa të qëndrimit mohues ndaj gjithçkaje. Nihilizmi shtrihet edhe në fushën e psikologjisë. Nihilizmi psikologjik është mohim i vlerave të rezultateve të gjurmimeve psikologjike, me pretekst se dukuritë shpirtërore, psikike, proceset dhe sjelljet gjoja nuk mund të njihen.

NIHILIZMI PSIKOLOGJIK. I ardhur nga latinishtja *nihil* "asgjë". Qëndrim mohues i fakteve, i ligjeve, i parimeve, i sistemeve të koncepteve psikologjike të argumentuara në psikologjinë shkencore. Sipas këtij qëndrimi të shoqëruar me sjellje mospërfillëse ndaj arritjeve psikologjike shpirti dhe dukuritë shpirtërore nuk kanë mundësi të njihen, sepse këto i takojnë Zotit dhe çdokush që pyet për çështjet shpirtërore, duhet të heqë dorë nga përgjigjja dhe duhet të drejtohet në të madhin Zot, sepse kjo është çështje e tij. Për nihilizmin psikologjik nuk vlejnë as metodat dhe as procedurat hulumtuese të proceseve psikike dhe të sjelljeve, kurse rezultatet e pamohueshme nga këndvështrimi shkencor janë as më pak se "hiçi", përkatësisht këto nuk kanë kurrfarë vlere njohëse të ekzistencës psikologjike. Ky qëndrim i përket më tepër fazës së hershme të zhvillimit të mendimit psikologjik.

NIJET, - I m. I ardhur nga arabishtja, që në shqip ka depërtuar kryesisht me anë të turqishtes *niyet* "cak, qëllim, objektiv". Ka përdorim në të folurën e përditshme nga shqipfolësit e disa vendeve. Ka marrë karakterin e termit

në psikologjinë e fesë islame, ku gjen zakonisht zbatim.

NIKOTINË, - A. m. Lloj specifik i ngacmuesit të organizmit, sidomos i organeve të frymëmarrjes, që është i përqendruar në duhan. Marrja në forma të ndryshme e nikotinës rrit aktivitetin e disa neurotransmetuesve si edhe të neuroneve dhe fijezave të tyre. Me përdorimin e nikotinës njeriu bëhet i varur prej tij, pothuaj njësoj si edhe ai që përdor drogat. Ekzistojnë receptorë të posaçëm në Sistemin Nervor Qendror, si edhe në muskujt skeletorë.

NIKTALOPI, - A f. I ardhur nga latinishtja *nyctalopia*. Niktalopia është çrregullim i të parit, që shfaqet në dy forma: 1) Të parit gjatë dritës së ditës i ngjashëm me të parit në errësirë dhe 2) Të parit e dobët në errësirë. Ai që vuan nga niktalopia i sheh objektet, dukuritë, situatat e jashtme si njeriu normal që këto i dallon gjatë errësirës së natës, kurse ai që vuan nga të verbuarit e natës ka pamje të dobët në errësirë. Shkak i këtij çrregullimi pohohet se është mungesa e vitaminës A dhe i të metës së retinës ose të rrjetëzës së syrit.

NIMFOMANI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *βουφεν* "nuse, nimfa" dhe *μανία* "çmenduri". Nimfomania emërton dëshirën e tepruar seksuale të femrave, përkatësisht pangopshmërinë seksuale të femrave. Nimfomania shfaqet me përfytyrime të vazhdueshme seksuale, shpesh me shtim të aktivitetit seksual (masturbim, sjellje provokuese seksuale, mospërmbajtje sjelljesh etj.), me kërkesën e vazhdueshme të disa femrave për të ndërruar partnerët seksualë. Kjo shoqërohet me sjellje të çuditshme dhe konsiderohet se është shprehje e çrregullimit të thellë psikik. Mund të shfaqet te femrat që vuajnë nga histeria (formë e vetafirmimit), te narkomania (zëvendësim i përjetimit të të droguarit) dhe te skizofrenia (përpjekje për rivënie të kontaktit të humbur me njerëz). Psikanaliza e shpjegon nimfomaninë si formë të fshehjes së paaftësisë së përjetimit seksual. Kjo quhet ndryshe edhe urrejtje e shtypur e femrës ndaj meshkujve. Shih – ***SATIRIAZA***.

NIRVANA. f. Term religjioz i budizmit që emërton gjendjen psikike të njeriut të shkaktuar dhe të drejtuar nga nevoja për t`u çliruar nga interesimi për botën e dukuritë e saj, sidomos për t`u çliruar nga interesimi për qenien e vet (për natyrën, dëshirat, nevojat, funksionin, raportet e tij me të tjerët etj.). Çlirimi i tillë i individit pohohet se është arritje e vërtetë e urtësisë dhe e lirisë individuale. Nirvanën psikanaliza e shpjegon formë të shprehjes së shtytësit të vdekjes së njeriut. Shih – ***TANATOSI.***

NISM/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *initiare* "filloj". Fillimi i një mendimi, i një veprimi të ri nga ana e një individi, kur ai merr nismën për një sjellje të re duke nxitur edhe të tjerët për ndërmarrjen e veprimeve që kanë të bëjnë me realizimin e asaj iniciative ose nisme. Nisma përjetohet nga ana e iniciuesit si gatishmëri mendore, ndijore dhe vepruese të drejtuar kah qëllimi i qartë dhe zakonisht shoqërohet me veprime konkrete për të arritur deri në qëllimin e iniciuar.

NISTAGMUS – I. m. Emërtim i lëvizjeve horizontale spontane të

kokërdhokut të syrit (rrallë edhe i lëvizjeve vertikale) dhe i lëvizjeve të ngadalshme të kthimit të kokërdhokut të syrit në pozicion normal. Në raste të tilla njeriu humb kontrollin e lëvizjes së muskujve të syrit. Nistagmusi shkaktohet nga ngacmimi i aparatit vestibular të veshit, nga rrotullimi shumë i shpejtë i automobilit, i trenit, nga mbushja e kanalit të jashtëm të veshit me ujë të ngrohtë ose të ftohtë etj. Mund të jetë edhe simptomë e dëmtimit të trurit të vogël.

NIVEL, - I m. I ardhur nga frëngjishtja *niveau* "hapësirë horizontale". Termi nivel në shqipe ka arritur të ngulitet. Me termin nivel emërtohet shkalla e arritjes së individit në zotërimin e një shkathtësie, shkalla e zhvillimit intelektual, rangu i arritur në matjen e një ndryshoreje psikologjike etj. Në psikologji hasen këto lloj nivelesh:

a. **Niveli alfa** – Shkalla e rëndësisë së sigurisë individuale në përfundimin e nxjerrë nga përpunimi statistikor i të dhënave të përftuara nga matja e një ose dy ndryshoreve në psikometri, përkatësisht shkalla e rrezikimit të vlerës së të vërtetës statistikore;

b. **Niveli i aspiratës** – Shkalla e brendshme individuale e njeriut, në bazë të së cilës ai e vlerëson suksesin konkret të arritur në një fushëveprimi të caktuar. Niveli i aspiratës së një individi është koeficienti i përftuar nga raporti ndërmjet shkallës së pritur në veprimtarinë e investuar dhe të suksesit konkret të arritur në atë veprim. Niveli i aspiratës varet nga ambicia e njeriut, nga aftësia, motivacioni dhe nga përvoja e tij;

c. **Niveli i përshtatjes së individit** – Shkalla e përshtatjes së individit ndaj mjedisit a rrethit ku jeton dhe punon, sikurse edhe ndaj kërkesave të atij mjedisi;

d. **Niveli i arritjeve** – Shkalla e suksesit e arritur në testin e dijenisë ose në testin e aftësive nga ana e një individi.

e. **Niveli i vetëdijes** - Shkalla e caktuar e të qenit të vetëdijshëm të një individi për rëndësinë e një çështjeje, për suksesin e arritur, vlerën e zgjidhjes së një problemi etj. Niveli ose shkalla e vetëdijes së individit nënkupton shtrirjen e funksionit të vetëdijes së tij prej skajit negativ që ka të bëjë me mungesën e plotë të vetëdijes, shih - ***KOMA,*** deri në skajin pozitiv, përkatësisht deri në të qenit e vetëdijes së plotë të individit për një çështje të caktuar dhe rëndësinë e saj.

f. **Niveli i deprivimit** - Shkalla e durimit të mungesës së një objekti, të ushqimit, të ujit etj. nga ana e një ose disa individëve. Niveli i deprimimit zbatohet zakonisht në kushte hulumtuese, kur caktohet se ai grup subjektesh u deprimua nga ushqimi dy ditë.

NOCIONI. Shih – ***KONCEPTI.***

NOMINALIZ/ËM, - MI. m. Në filozofi nënkupton konceptet a nocionet e përgjithshme (personaliteti, psikika, shoqëria etj.), që janë vetëm fjalë e që nuk emërtojnë asgjë reale, ngaqë realisht ekzistojnë vetëm objektet e veçanta, përkatësisht personaliteti, psikika, shoqëria etj. e caktuar që ka emër dhe mbiemër individual dhe që dallon nga të gjithë të tjerët. Nocionet ose konceptet e përgjithshme janë vetëm fjalë dhe nuk kanë status të nocioneve ose koncepteve shkencore.

NOMOGRAMË, - A. m. Mjet grafik i thjeshtë i përfitimit të një vlere të panjohur nga vlerat e njohura

numerike, të rreshtuara në anën e majtë dhe në anën e djathtë të kolonës së kësaj vlere të panjohur. Kështu, p.sh., nga mbledhja e vlerave numerike të gjatësisë së trupit dhe të peshës së tij te individët e një togu ushtarak përftohet sipërfaqja e trupit të secilit ushtar. Monograma zakonisht paraqitet në formë tabele.

NOO – DINAMIKA. Term i psikiatrit amerikan me origjinë austriake Viktor Frankël (Viktor Frankl, 1905 – 1997). Sipas tij dinamika shpirtërore e njeriut sillet ndërmjet dy poleve: qëllimit mendor që duhet të realizohet dhe vetë njeriut që duhet ta realizojë atë qëllim të tij. "Kjo është shtrirje normale dhe njerëzore e personalitetit pa domethënie religjioze" - ka pohuar Viktor Frankël.

NOOLOGJI, - A. f. Në psikologjinë e psikiatrit amerikan me origjinë austriake Viktor Frankël (Viktor Frankl, 1905 – 1997) emërton konceptin e asaj që është e përbashkët për të gjithë njerëzit. Psikologjia ka detyrë të studiojë pikërisht vetitë dhe tiparet e përbashkëta për të gjithë njerëzit.

NORADRENALINË, - A. f. Në psikofiziologji emërton hormonin që rrjedh nga thelbi i gjëndrave mbiveshkore. Noradrenalina ka edhe emërtimin norepinefrinë. Kohët e fundit termi noradrenalinë ka edhe një kuptim: noradenalina është neurotransmiter i grupit të substancave biokimike, që në qelizat e Sistemit Nervor Qendror sintetizojnë aminoacide. Noradrenalina kryen funksione të rëndësishme fiziologjike në organizmin e njeriut, si: rregullon gjendjen e organizmit gjatë fjetjes dhe gjatë zgjimit, ushtron ndikim në zhvillimin e gjendjeve emocionale dhe në koordinimin e sjelljeve të njeriut. Sasia e noradrenalinës dhe e adrenalinës shtohet gjatë kohë së përjetimit të një stresi.

NORM/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *norma* "masë, rregull". Në psikologji termi normë zbatohet më tepër për të emërtuar një vlerë statistikore (vlera e së mesmes aritmetike, e shmangies standard etj.), që ka karakter përfaqësues dhe shërben si masë, si bazë për krahasim të vlerës individuale të të njëjtit lloj me normën përfaqësuese. Termi normë ka edhe kuptimin e sjelljes tipike të anëtarëve të një grupi social**.** Thyerjet e normave sociale të sjelljeve zakonisht çojnë në sanksione nivelesh të ndryshme, madje, deri në përjashtim të një anëtari të tillë nga grupi social i një mjedisi kulturor të caktuar.

NORMA GRUPORE. Sjellja e anëtarëve të një grupi kryesisht të vogël sipas përcaktimeve të pranuara për organizimin e një grupi të caktuar. Normat mund të jenë spontane dhe të përcaktuara me miratimin e të gjithë anëtarëve të atij grupi. Normat e tilla shërbejnë si standard për vlerësimin e sjelljeve të secilit anëtar të këtij grupi.

NORMAL, - E. mb. I ardhur nga rrënja e fjalës *normë* "masë, rregull". Mbiemri normal ka kuptime të ndryshme në disiplinat ku përdoret. Por, kuptimi i përgjithshëm ka të bëjë me atë që përbën themelin e të gjitha formave të sjelljeve të njeriut. Caktimi i kufirit të shtrirjes së normalitetit dhe i strukturës përmbajtësore të tij, si edhe përcaktimi i prerë i kufirit normal/jonormal është çështje e pazgjidhur

plotësisht edhe sot. Në statistikë ka kuptimi e asaj që nuk shmanget nga zhvillimi mesatar, përkatësisht nga zhvillimi natyror i sjelljeve tipike për një grup social të caktuar. Shpërndarja ose distribuimi i të dhënave të përftuara nga matja e një ndryshoreje është normale kur këto të dhëna shpërndahen kryesisht në formën e kambanës së Gausit, përkatësisht kur nuk shmangen nga shpërndarja e formës këmbanore të Karl F. Gausit (Carl F. Gauss, 1777 – 1959). Në këtë kuptim normalja është lidhje ndërmjet normës së një grupi individësh dhe rastit individual të një individi të atij grupi. Me këtë kuptim sot përdoret shumë termi normal ose normale Por, një përkufizim i tillë është jo i plotë.

NORMALITETI NË PSIKANALIZË. Mendimi psikanalitik i Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) ka të bëjë me vazhdimësinë normale–jonormale dhe me shkallët kaluese pa kufij të asaj që është normale ose jonormale. Sipas tij gjatë zhvillimit psiko-seksual të njeriut, personaliteti i shëndoshë ka ego dhe ndërgjegje të qëndrueshme. Personaliteti i shëndoshë është në gjendje të vendosë lehtë dhe shpejt raport të drejtë ndërmjet idit, egos dhe super–egos, duke qenë në gjendje të kontrollojë sjelljet dhe t`i ndryshojë këto në të mirë të raportit harmonik ndërmjet këtyre instancave psikike të personalitetit. Personaliteti i shëndoshë ka energji të drejtuar në punë produktive. Vendimtare për zhvillim normal të personalitetit, sipas Frojdit, është zhvillimi psiko-seksual i tij, sepse raportet ndërmjet energjisë së shtytësve, sidomos të shtytësit seksual dhe egos ndryshojnë vazhdimisht, këto mund të pengohen, mund të ngecin në zhvillimin e tyre, madje edhe ngecjet e përkohshme mund të shndërrohen në ngecje të përhershme etj. Ngecjet e tilla të shoqëruara me regres të sjelljeve dhe me shtypje të dëshirave dhe të synimeve, si edhe me frustrime të llojllojshmeve të ndryshme shpien në çrregullime psikike të ndryshme dhe e çrregullojnë baraspeshën e zhvillimeve normale me rrjedha penguese.

NORMAT E ZHVILLIMIT. Koha e përcaktuar e zhvillimit normal të aftësive, të koncepteve abstrakte, të psikomotorikës etj. te fëmijët, te të rinjtë e një moshe të caktuar. Me norma të zhvillimit matet përparimi i zhvillimit të fëmijës. Koha e tillë përcaktohet zakonisht me muaj dhe me vite. Norma të këtilla kohore për zhvillim normal përcaktohen nga rezultati i arritur nga ana e 2/3 ose ¾ e numrit të duhur të të provuarve. Norma të zhvillimit janë normat e Arnold L. Gezel (Arnold L. Gessell, 1880 – 1961). Shih – ***TESTI I GEZELIT.***

NORMAT KULTURORE. Norma që kanë të bëjnë me pikëpamjen e përgjithshme dhe me ato sjellje karakteristike të anëtarëve të një mjedisi kulturor, që janë të pranueshme dhe kanë status të përgjithshëm pozitiv për një mjedis kulturor, kur ai mjedis i vlerëson mendimet dhe sjelljet të drejta dhe të rregullta. Si të tilla ato vlerësohen lart nga ana e atij mjedisi dhe bartësi i tyre nderohet, respektohet dhe shpërblehet. Kur mendimet dhe sjelljet e një individi nuk përputhen me mendimet dhe me sjelljet pozitive, atëherë bartësi i tyre anashkalohet, mënjanohet dhe dënohet. Normat kulturore kanë

karakter evolutiv dhe këto ndryshojnë prej një mjedisi në një mjedis tjetër.

NORMAT SOCIALE. Në sociologjinë dhe psikologjinë sociale janë rregulla dhe standarde të shkruara dhe të pashkruara të një mjedisi social të caktuar, që përcaktojnë kufijtë e sjelljeve individuale të lejueshme dhe të pranueshme për atë mjedis.

NORMATIV, - E. mb. Që përputhet me normën, që i përket grupit të normës ose që ka të bëjë me normën e caktuar.

NOSTALGJI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *νοστ* "kthim në vendlindje" dhe *αλγία* "dhembje". Ndjenjë e ndërlikuar dhe e ndërlidhur e mallit, e pikëllimit, e dashurisë etj. ndaj vendlindjes, e zhvilluar dhe e stabilizuar nga përjetimet e lidhura me vendlindjen që nga mosha e hershme fëmijërore. Nostalgjia është e manifestuar me intensitet dhe me forma të ndryshme, sidomos te të mërguarit. Në literaturën bashkëkohore nostalgjia konsiderohet se është formë e regresionit të sjelljeve të njeriut.

NREM. Fazë e veçantë e gjumit, ku nuk ka lëvizje të kokërdhokut të syve. NREM është shkurtesë e termave të anglishtes Non (Jo) – Rapid (Shpejt) – Eye (Sy) – Movements (Lëvizje). Për shkak se nuk ka lëvizje të kokërdhokut të syve në këtë fazë, kjo fazë e gjumit emërtohet edhe me termin jo – REM (Non – REM) e gjumit. Shih – ***FAZA REM***.

NUANC/Ë, - A. f. I ardhur nga frëngjishtja, që përdoret edhe në shqipe, sidomos në terminologjinë e ndijimeve pamore. Nuanca emërton përjetimin e ndryshimit ndërmjet ngjyrave, të kuptimit ndërmjet dy koncepteve etj., të cilat njeriu është në gjendje t`i hetojë. Në fushën e ndijimeve pamore nuanca e ngjyrës është vetë ngjyra, cilësia e së cilës përcaktohet nga gjatësia dhe nga intensiteti i valëve elektromagnetike. Nuanca të pastra të ngjyrave që prodhohen nga burimi i dritës me gjatësi valësh saktësisht të caktuara në natyrë gati nuk ka. Rrezet laser janë nuanca të pastra.

NUHATJ/E, - A. f. Proces fiziologjik e psikik i njohjes së erërave të trupave flurorë, të cilët gjatë marrjes frymë nga ana e njeriut dhe e disa kafshëve ngacmojnë trupthat neuroepitelialë, përkatësisht receptorët e nuhatjes të vendosur në cipën e brendshme të pjesës së brendshme të hundës. Truptha të tillë njihen me emërtimin trupthat Shulc dhe përbëjnë një sasi prej rreth 600.000 sosh. Këta truptha janë të lidhur me skajet e fijeve nervore që përfundojnë në qendrën e të nuhaturit, në "bririn" e veçantë të trurit dhe në dredhën e hipokampit.

NUSHI Pajazit. Psikolog shqiptar. Lindi në Gjakovë (Kosovë) më 8.01.1933. Kreu studimet për psikologji në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit më 1955. U doktorua në psikologji në Universitetin e Prishtinës më 1984. Më 1958 ka dhënë provimin shtetëror për psikologji dhe psikologji pedagogjike me rezultat shumë të mirë. Prej vitit 2000 anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe anëtar i rregullt prej vitit 2008. Gjatë viteve 1957–1961 shërbeu si profesor i psikologjisë në Shkollën Normale të Prizrenit, në periudhën 1961-1966 në shkollën Normale të Prishtinës, Drejtor i Entit për

Përparim e Arsim në Kosovë, ligjërues i psikologjisë në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë, Ligjërues në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar i psikologjisë së përgjithshme derisa doli në pension. Nënkryetar i Shoqatës Mbarëshqiptare të Psikologëve. U mor më tepër me terminologjinë e psikologjisë, posaçërisht me terminologjinë shqipe të psikologjisë. Ka drejtuar disa projekte hulumtuese, si: *Zbatimi i televizionit edukativ në ish Federatën e Jugosllavisë, Të zhdukurit në Luftën e Kosovës më 1998 - 1999, Përdhunimet seksuale gjatë zhvillimit të operacioneve luftarake në Kosovën e viteve 1998 – 1999* etj. Kryetar shumëvjeçar i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë, Këshilltar i lartë shkencor në Institutin për krime lufte të Kosovës etj. Veprat kryesore të Pajazit Nushit nga fusha e psikologjisë janë: *"Fjalor i psikologjisë",* 1987; *"Sistemi i grafisë së tingujve të shqipes dhe vetitë perceptive e përmasat e lexueshmërisë së shkronjave të alfabetit të gjuhës shqipe",* 1988; "Psikologjia" për klasën II gjimnaz" (fitues i Çmimit "Naim Frashëri"); *"Psikologjia e Përgjithshme I dhe II",* 1999 dhe 2002; "*Inteligjenca dhe masa e zhvillimit të saj ndër shqiptarët e moshës madhore",* 2004; "*Kujtesa dhe trajtimi i saj në literaturën shqipe nomotike",* 2008; *"Fjalor shpjegues i psikanalizës",* 2010.

NXEHTË (I, E). mb. Cilësi e trupave të ngurtë, të lëngët e flurorë, të cilët në kushte të posaçme të ndikimit të tyre në lëkurën e njeriut janë në gjendje të shkaktojnë ndijimin e nxehtësisë. Trupat e tillë shkaktojnë ndijim, kur e kanë temperaturën mbi 32 gradë Celsius. Intensiteti i ndijimit të nxehtësisë varet nga shkalla e nxehtësisë së trupave dhe nga shkalla e përshtatjes së lëkurës ndaj temperaturës së mjedisit dhe temperaturës paraprake të lëkurës. Ndijimi i nxehtësisë mund të luhatet prej nxehtësisë së ulët, nxehtësisë së mesme e deri në nxehtësi të lartë, me shumë nuanca kalimi prej një shkalle të nxehtësisë në shkallën tjetër.

NXËNIT (TË). as. Veprimtaria e pandërprerë e përftimit të përvojës dhe e ndryshimeve relativisht të qëndrueshme të sjelljeve të njeriut. Të nxënit ka të bëjë me zgjerimin dhe thellimin e vazhdueshëm të njohurive, me përvetësimin e shkathtësive dhe të shprehive dhe me zhvillimin e gjithëmbarshëm e sistematik të njeriut dhe të sjelljeve të tij. Të nxënit është faktori kryesor i zhvillimit dhe i formimit të personalitetit. Kjo veprimtari zhvillohet gjatë gjithë jetës së njeriut dhe është e lidhur drejtpërdrejt me të. Këtë e dallojmë në shprehjen "Njeriu plaket duke nxënë". Në shqipe termi nxënie ka karakter të termit sinonimik të mësuar. Konsiderojmë se të mësuarit është aktivitet i lidhur më shumë me zotërimin e përmbajtjes së lëndëve shkollore. Shih – ***TË MËSUARIT.***

NXITËS, - I. m. Emërtim për konceptin e çdo lloj trupi apo procesi fizik e kimik, biologjik e social, si edhe për energjinë mekanike, fizike, kimike, biologjike, optike, termike të brendshme a të jashtme, që vepron në organizmin e njeriut ose në shqisat e caktuara të tij dhe nxit e vë në veprim organizmin ose një pjesë të tij, duke shkaktuar njëkohësisht reagim, ndijim a perceptim ndaj atij trupi, ndaj energjisë vepruese

mbi organizmin ose ndaj një organi të tij, si dhe duke shkaktuar ndryshim në sjelljet e tij. Të tillë mund të jenë trupat fizikë, qeniet biologjike, situatat sociale etj.

NYJAT AKSIONALE. Nyjë nervore të aksonit në formë gungash të vogla prej nga aksoni hyn në trupin e qelizës nervore. Mu te nyjat apo gungat e tilla zhvillohen impulset nervore, që barten në qelizën tjetër nervore ose prej këndej në organe ekzekutive (në muskuj dhe në gjëndra).

NYJAT NERVORE. Emërtim i grupit të qelizave të lidhura nervore që, me ca përjashtime, gjenden jashtë Sistemit Nervor Qendror. Shih – ***GANGLIONI.***

NYJAT SHPINORE. Fije nervore të ndërlidhura me receptorët e lëkurës dhe të muskujve, por trupi i këtyre fijeve nervore gjendet në rrënjën palcës kurrizore. Tërësia e trupave të këtyre qelizave nervore përbën nyjën gungore të shpinës që gjendet në rrënjën e palcës kurrizore. Fijet e këtyre nyjave nervore bartin impulse nervore nga proprioceptorët dhe interoceptorët e trupit, të gjymtyrëve dhe të palcës kurrizore në qendrat e trurit. Në terminologjinë e anatomisë nyjat shpinore njihen me termin latinisht *ganglio spinale*.

NJ

NJELMËSI, - A. f. Një nga katër cilësitë themelore të shijes. Njelmësinë e shkakton ushqimi, që në përbërjen e tij ka kripën NaCl – klorur natriumi. Ushqimi me kripë është ngacmues i shqisës së shijes ose i gjuhës dhe i receptorëve të puprrive të saj. Kripa në shkrirës të gojës së njeriut pëson ndryshime që ngacmojnë receptorët e gjuhës. Ky zbërthim i lëndëve ushqimore me përbërje kimike të posaçme ngacmon puprritë dhe receptorët e tyre në gjuhë, duke vënë në lëvizje mekanizmin e ndijimit të shijes së njelmët. Shih – ***GJUHA.***

NJERËZI, - A. f. Term i përdorur më tepër në etikën e psikologjisë. Njerëzinë e përbëjnë tiparet morale të njeriut: fisnikëria, dinjiteti, gatishmëria për t`i dalë në krah të tjerëve dhe për të sakrifikuar, nderimi, respektimi dhe shkathtësia për t`u sjellë burrërisht edhe ndaj armikut. Shih – ***BURRËRIA.***

NJERI, - U. m. Qenie biologjike, shoqërore e psikike, i rendit të primatëve nga të cilët u zhvillua njeriu i sotëm (*Homo Sapiens*), shkalla më e lartë e zhvillimit të të gjitha qenieve të gjalla. Njeriu i sotëm ka strukturë anatomike, fiziologjike, morfologjike të ndërlikuar dhe ndryshon shumë nga qeniet e gjalla të rendit më të lartë zhvillimor. Te njeriu janë të pranishme ndryshimet më të mëdha anatomike, fiziologjike, shoqërore dhe psikologjike. Këtë e karakterizon zhvillimi i vetëdijes - tipar themelor i njeriut - që u zhvillua gjatë luftës për ekzistencë dhe gjatë procesit të pandërprerë të përmirësimit të kushteve të jetës. Tiparet e shkallës më të lartë të zhvillimit psikik të njeriut të vetëdijshëm janë: zhvillimi i aftësisë së të folurit dhe të menduarit, krijimi e përsosja e vazhdueshme e mjeteve të punës, zhvillimi i aftësive kognitive, pikërisht zhvillimi i aftësisë së të folurit dhe të menduarit, i jetës emocionale, shumëllojshmëria e motiveve të tij, krijimi dhe përsosja e vazhdueshme e mjeteve të punës, i procesit dhe i rrugëve më të dobishme të të jetuarit në bazë të mendimit krijues, si dhe parashikimi i së ardhmes. Por, struktura e natyrës njerëzore të njeriut dhe integriteti i saj është ndër çështjet më të ndërlikuara në psikologjinë e personalitetit.

NJERIU PRAGMATIK. I ardhur nga greqishtja *πραγματικός* "vepru-es". Njeriu pragmatik ose pragmatist është një individ praktik, me qëndrime konkrete e jo teorike, individi që konsideron se dobia e një veprimi është vlera më e lartë, që drejtohet nga konkretja dhe e dobishmja për të dhe për mjedisin e ngushtë dhe të gjerë. Njeriu pragmatik shfaq sjellje të përshtatshme dhe është fleksibël në ndryshimin e tyre sipas kërkesës së situatave të ndryshme. Qëndrimet dhe bindjet e tij janë të paqëndrueshme.

NJERIU ROMANTIK. Njeriu romantik është një individ entuziast, një individ ndjenjash, optimist dhe shpresëdhënës, i cili iu nënshtrohet gjithmonë ëndërrimeve.

NJËMENDËSI, - A. f. Tërësi faktesh dhe raportesh mendore që përputhen me realitetin dhe si të tilla nuk mund të mohohen. Njëmendësia karakterizon objektivitetin e mendimit të njeriut. Term përmbledhës për të gjitha objektet, dukuritë dhe proceset ekzistuese (të natyrës, të shoqërisë, të mendjes dhe raportet ndërmjet tyre) në ndryshim nga dukuritë, proceset dhe përjetimet psikike të njeriut. Njëmendësia subjektive i përket terminologjisë së psikologjisë dhe ka të bëjë me dukuritë, proceset, përjetimet psikike, si edhe me gjendjen psikike e me ndryshimet e vazhdueshme të tyre.

NJËSIA MOTORIKE. Emërtim i një tërësie themelore qelizash nervore dhe i të gjitha fijezave muskulore të inervuara nga degët e këtyre qelizave që janë të lidhura drejtpërdrejt me strukturat muskulore dhe atë të gjëndrave. Një njësi e tillë është aktiviteti i sistemit neuromuskulor. Njësia motorike ka një fije nervore eferente të një neuroni motorik dhe fijen e caktuar muskulore që inervohet prej saj.

NJËSIA STATISTIKORE. Përbërës i veçantë i një mase të dhënash të një grupi të caktuar, e përftuar nga matja e një ndryshoreje psikologjike. Njësi statistikore është e dhëna e pikave të fituara në testin e dijes nga gjuha amtare e një nxënësi të klasës IV të shkollës së mesme, në kuadrin e arritjeve të secilit nxënës të asaj klase në testin e përmendur.

NJËSIA TOTE. Term i ardhur në psikologjinë kognitive nga anglishtja Test "test" – Operate "veprim" – Test "test" – Exit "dalje". Kjo është njësia themelore e sjelljeve normale të njeriut. Ka të bëjë me kontrollin paraprak të secilës sjellje të motivuar. Nëse rezultati i kontrollit dhe i verifikimit të kushteve dhe mundësive të realizimit të asaj sjelljeje është pozitiv, atëherë individi ndërmerr veprimin apo sjelljen e parashikuar. Nëse ky rezultat është negativ, atëherë individi nuk e ndërmerr veprimin e paramenduar.

NJOHJ/E, - A. f. Procesi i të qenit të vetëdijshëm të njeriut për objektet, cilësitë, dukuritë etj., dhe për raportet ndërmjet tyre, e shoqëruar me besimin dhe bindjen e njeriut se dija e tillë është e vërtetë. Njohja mbështetet në ekzistencën e njohësit (të subjektit) dhe të objektit të njohjes, por në psikologji objekti dhe subjekti i njohjes janë të përqendruara në vetë njeriun. Njohja, duke përfshirë edhe njohjen e vetvetes dhe të raportit të njeriut me mjedisin, si edhe raportet me ndryshimet e tij, përbën bazën e sistemit të

dijeve teorike dhe praktike. Njohja mund të jetë dy llojesh:

a. **Njohja ndijore** – Njohje që mbështetet në funksionin psikonervor të njeriut dhe ka të bëjë drejtpërdrejtë me njohjen e cilësive të një objekti të caktuar, me perceptimin e objektit, të dukurive, të proceseve etj., si edhe me përfytyrimin e tyre në bazë të ndikimit të drejtpërdrejtë të tyre në shqisat e njeriut, si edhe të përjetimeve të figurave të tyre pas përfundimit të procesit të perceptimit;

b. **Njohja racionale** – Të kuptuarit e fakteve, të simboleve e kuptimit së tyre, si edhe të raporteve ndërmjet tyre me anë të mendjes së njeriut. Njohja racionale mbështetet në përpunimin mendor të dhënave shqisore, në koncepte a nocione, gjykime dhe përfundime, si edhe në simbole dhe në kuptimin ndërmjet tyre. Me njohje racionale njihen raportet thelbësore, të përgjithshme dhe relativisht të përhershme të trupave, të dukurive dhe të proceseve objektive dhe subjektive. Pikërisht këtu ndryshon njohja racionale nga ajo ndijore ose shqisore me të cilën kjo njohje ka lidhje të posaçme.

NJOHURI, - A. f. Tërësi e organizuar dhe e sistematizuar informacionesh e dijesh që z[zotëruara nga një individ i caktuar ose grupi i tyre, si edhe shkalla e zhvillimit të kulturës së një mjedisi të caktuar. Një njohuri e tillë është rezultat i angazhimit të proceseve kognitive të njeriut. Këto njohuri janë shprehje e përmbajtjes së kujtesës afatgjatë, shih – ***KUJTESA.*** Njohuritë e njeriut janë të shumëllojshme. Në psikologjinë bashkëkohore zakonisht bëhet fjalë për dy lloj njohurish:

a. **Njohuria deklarative –** Njohuri mbi dukuritë, proceset e objektet, si edhe relacionet ndërmjet tyre, e mbështetur në koncepte e raporte që ato kanë dhe e shoqëruar me shfaqjen e saktë fjalësore apo verbale. Njohuri deklarative është pohimi 4 x 4 = 16; "Skënderbeu është hero kombëtar i shqiptarëve"; "qeliza është njësia biologjike e organizmit të qenieve të gjalla" etj. Njohuria eksplicite ka karakter eksplicit, e pikërisht kjo shfaqet shprehimisht;

b. **Njohuria procedurale –** Njohuri funksionale, që e tregojmë duke përshkruar dhe shpjeguar si të veprohet, si të sillemi në situata të caktuara. Të shkruarit në kompjuter, llogaritjet me anë të mjetit llogaritës etj., që i përkasin llojit të njohurive procedurale. Njohuritë procedurale përbëjnë bazën kognitive të shkathtësive dhe të shprehive të njeriut. Këto lloj njohurish i shfaqim më lehtë me sjellje se sa i përshkruajmë a i shpjegojmë me fjalë. Pikërisht për këtë shkak njohuritë procedurale quhen njohuri implicite, pra që nënkuptohen.

NJOLLA E VERDHË. Njollë e rrjetëzës ose e retinës së syrit e njohur në terminologjinë e anatomisë së syrit me termin latin *macula lutea*. Njolla e verdhë gjendet në pjesën qendrore të rrjetëzës ose të retinës së syrit dhe ka shtrirje shumë të vogël (rreth një milimetër katror). Në njollën e verdhë gjenden vetëm kunjëzat me formë të zgjatur, që e bëjnë të mundur mprehtësinë më të madhe të të parit të objekteve në njollën e verdhë se sa në pjesët e tjera të rrjetëzës ose të retinës së syrit. Në pjesën qendrore të njollës

së verdhë gjendet gropëza qendrore e mbushur me kunjëza. Enët e gjakut dhe qelizat ganglionare gjenden pak më larg gropëzës qendrore. Kjo largësi e tyre bën të mundur depërtimin më të lehtë të rrezeve të dritës. Pikërisht për këtë shkak njolla e verdhë shkakton shikim të mprehtë të objekteve.

NJOLLAT E TESTIT TË RORSHAHUT. Njolla të pikës së shkrimit që është e hedhur mu në mesin e faqes së përthyer të një letre shkrimi të pastër, dhe që nga puthitja e dy pjesëve simetrike të së njëjtës faqe të kësaj letre u formuan figura të pacaktuara nga shpërndarja simetrike e ngjyrës së shkrimit në dy faqet e letrës. Seria e njollave të Rorshahut të përftuara sipas mënyrës së përshkruar më lart përbëhet prej dhjetë njollash, që janë të standardizuara. Nga këto figura njollash pesë prej tyre janë akromatike (zi e bardhë, dy të tjera kanë pak ngjyrë kromatike dhe duken si të përhimëta, kurse tri të tjera janë me ngjyra kromatike (e verdhë, e kuqe, e gjelbër, e kaltër dhe me nuanca të ndërmjetme ndërmjet këtyre). Këto dhjetë "figura" njollash formojnë testin e Rorshahut, të njohur sipas psikiatrit zviceran Herman Rorshah (Hermann Rorschach, 1884 – 1922). Një test i tillë zbatohet me qëllim të njohjes së personalitetit dhe të karakteristikave të dinamikës së tij. Nga subjekti kërkohet të interpretojë atë çfarë sheh në ato figura. Në interpretimin e tyre subjekti shfaq dëshirat e veta, sidomos ato të shtypura ose të ndrydhura, konfliktet emocionale. Nga zbatuesi pritet vlerësimi i orientimit jetësor të subjektit, ngarkesat emocionale, prirjet neurotike etj. Shih – ***TESTI RORSHAH.*** Njollat e testit të Rorshahut përbëjnë njërën ndër format më të rëndësishme të teknikave projektuese. Shih – ***TEKNIKA PROJEKTUESE.***

O

O - në psikologji përdoret shpesh si simbol për organizmin dhe për objektin.

OBJEKT, - I. m. 1. I ardhur nga latinishtja *objectum* "diçka e vënë përballë njeriut". Në kuptimin më të gjerë "gjithçka ekzistuese". Në psikologji është dukuri, gjendje e një procesi psikik, sjellje e njeriut dhe lindja e zhvillimi i tyre, për të cilat njeriu është i vetëdijshëm, si edhe për ato të pavetëdijshme, që njeriu synon t`i njohë, ndaj të cilave ka qëndrim të caktuar dhe ka drejtuar sjelljet e tij. Me këtë kuptohet ndërlidhja e ngushtë ndërmjet proceseve mendore – veprimeve të vullnetshme dhe asaj përmbajtjeje ndaj së cilës është drejtuar, angazhuar dhe përqendruar sistemi i proceseve psikike dhe i sjelljeve të njeriut. Objekt i psikologjisë janë të gjitha përmbajtjet e jetës dhe të aktivitetit të njeriut.

OBJEKT 2. Në teorinë psikanalitike individi, një pjesë ose përfytyrimi i tij, por edhe çdo gjësend tjetër, që lidhen për plotësimin e shtytësve të ndryshëm të njeriut. Në plotësimin e shtytësit seksual, përkatësisht në arritjen e qëllimit psikoseksual, atij i nevojitet objekti i caktuar, përkatësisht partneri ose individi imagjinar sipas fazave të zhvillimit psikoseksual të tij. Objekt i tillë në psikanalizë mund të jetë individi ndaj të cilit pacienti reagon vetëm kur është i tëri ose i pjesshëm, kur pacienti reagon ndaj një pjese të trupit të partnerit, si, p.sh. ndaj gjoksit të femrës, ndaj syve, flokëve etj. Në psikanalizë zgjedhja e objektit bëhet sipas drejtimit të libidos: kur objekti psikoseksual zgjidhet sipas vetë njeriut, kjo zgjedhje e objektit në psikanalizë quhet zgjedhje narciziste e objektit dhe kur objekti psikoseksual zgjidhet në bazë të ndryshimeve që ka partneri me zgjedhësin e objektit, atëherë kjo zgjedhje quhet zgjedhje anaklitike e objektit psikoseksual.

OBJEKT 3. Në psikologji është përmbajtje psikike që përbën jetën psikike. E tillë është jeta psikike e njerëzve dhe e kafshëve, dukuritë, gjendjet, proceset psikike të vetëdijshme dhe të pavetëdijshme, personaliteti dhe tiparet e personalitetit, si edhe lindja e zhvillimi i tyre. Jeta e tillë me të gjitha dukuritë e saja mund të studiohet në bazë të

shfaqjes objektive të tyre, si edhe në bazë të përjetimeve të drejtpërdrejta ose të mëtejshme të njeriut. Shih – ***PSIKOLOGJIA.***

OBJEKT 4. Në teorinë kognitive, kur gjësendi, dukuria, procesi etj., bëhet i vetëdijshëm se objekti është i qenësishëm, ose gjendet jashtë tij dhe fëmija mund ta drejtojë dhe përqendrojë vëmendjen dhe energjinë psikike në atë objekt. Sipas psikologut zviceran Zhan Pijazhe (Jean Piget, 1896 – 1980) objekti është koncepti i zhvilluar te fëmija, kur ai arrin të konstatojë se objekti gjendet jashtë tij dhe se ai mund ta ndryshojë vendin, mund të lëvizë në hapësirën e caktuar, pavarësisht nga vendqëndrimi i fëmijës dhe nga sjelljet e tij.

OBJEKT I DASHUR. Një individ tjetër ndaj të cilit është drejtuar dashuria dhe me të janë të lidhura emocionet pozitive.

OBJEKTI I HIPERKATEKSIT. Objekt në të cilin është angazhuar e gjithë energjia e libidos, duke shkaktuar pasoja negative ndaj objekteve të tjerë të mjedisit të caktuar.

OBJEKTI I HUMBUR. Përjetim i veçantë i njeriut për atë objekt të dashur, të mirë, pozitiv etj., që nuk është më pronë e tij dhe për të cilin ka mbetur vetëm përfytyrimi i shfaqur me mallëngjim.

OBJEKTI I JASHTËM. Çdo objekt që njeriu e përjeton si objekt jashtë personalitetit të tij.

OBJEKTI I KATEKSIT. Objekti i jashtëm ose përfytyrimi i tij, ndaj të cilit njeriu e ka angazhuar libidon e tij.

OBJEKTI I PËRHERSHËM. Partneri në të cilin zakonisht është e angazhuar libido, duke përjashtuar të gjithë të tjerët dhe duke e konsideruar objekt konstant të dashurisë së tij.

OBJEKTI QËLLIMOR. Objekt fizik, biologjik, shoqëror etj. i mjedisit të jashtëm, ndaj të cilit është drejtuar fuqia motivuese e njeriut, me qëllim të zotërimit dhe përdorimit të tij për plotësim të nevojave të caktuara të tij. Objekt qëllimor mund të jetë ajri i pastër, uji, ushqimi etj., që gjenden jashtë njeriut që ky synon t`i arrijë, dhe që, me marrjen e futjen e tyre në organizëm të plotësojë nevojat biologjike të qenies së vet. Objekt qëllimor mund të jetë drita e hënës, konflikti social i punëtorëve të një fabrike, toleranca fetare e popullsisë së këtij mjedisi, etj., ku njeriu synon të njohë strukturën, intensitetin dhe zhvillimin e tyre për qëllime të caktuara, si p.sh. për qëllim të plotësimit të motivit të kureshtjes së tij.

OBJEKTIV, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *objectum* "lëndor", që është real, që ekziston pavarësisht nga subjekti, përkatësisht nga bindjet, dëshirat, interesat, mendimi, nevojat, qëndrimet, synimet etj. të njeriut.

OBJEKTIVUAR (I, E). mb. Që ka fituar karakterin e objektit, të një realiteti. Si koncept ndeshet më tepër në teorinë psikanalitike.

OBNUBILACION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *obnibilus* "mbuluar me hije". Lidhet më tej me terminologjinë e psikiatrisë, që emërton dukurinë e rrallë të errësimit të vetëdijes me kthjellime të përkohshme të saj.

OBSERVIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *observation* "vëzhgim"**.** Observimi i dukurive, objekteve, proceseve, situatave etj. dhe i përvojës së lidhur

me to merr përmasa shkencore, kur kontrollohen kushtet e ndryshimit të tyre, kur observimi ka karakter sistematik, objektiv dhe të vlefshëm. Në këtë këndvështrim ai është ndër metodat e para hulumtuese në psikologji. Sot zbatohet më tepër në psikologjinë zhvillimore dhe në psikologjinë e fëmijëve.

OBSESION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *obsesio* "pushtoj". Obsesioni ka domethënie të përgjithshme dhe të veçantë. Domethënia e përgjithshme e tij ka të bëjë me preokupimin e mendimit të njeriut me një ide, përfytyrim, pikëpamje, synim etj. që mund të ketë kohëzgjatje jo të rëndomtë dhe për këtë gjendje të tij njeriu është i vetëdijshëm. Domethënia e veçantë e tij i përket më tepër psikopatologjisë dhe psikiatrisë. Në këto disiplina obsesioni është ideja pushtuese e gjendjes shpirtërore, që përsëritet, është neveritëse dhe jologjike e shoqëruar me frikë, me ankth dhe kundër vullnetit të pacientit, të cilin, ky I fundit nuk arrin ta komandojë, ta kontrollojë dhe nga e cila ai e ka të vështirë të shkëputet. Këtë pacienti është në gjendje ta kuptojë, por ai nuk arrin ta frenojë idenë, pikëpamjen, synimin preokupues të gjendjes shpirtërore të tij. Mendimet e përfytyrimet obsesive paraqiten më tepër në rastet e neurozës obsesive – konvulsive dhe rrallëherë janë të pranishme te ata që vuajnë nga melankolia dhe nga skizofrenia.

OBSKURANTIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *obscures* "i errët". Synim dhe kundërshtim i qëllimshëm, sistematik dhe i organizuar i një individi, grupi individësh ose i organeve të pushtetit kundër arsimit, shkollimit dhe zhvillimit të mendimit shkencor. Qëllimi i atyre që zbatojnë obskurantizmin është që popullsinë e një vendi ta lënë në një shkallë të ulët zhvillimi, në errësirë, për ta sunduar më lehtë atë. Obskurantizmi mund të nxitet nga shkaqe politike dhe fetare. Në ditët e sotme është i pranishëm gjithnjë e më pak.

OFENDIM, - I. m. Formë e shprehjes së agresivitetit të njeriut, kur ai e vlerëson tjetrin si qenie të panjerëzishme dhe të parëndësishme. Ofendimi emërton fyerjen që i bëjmë tjetrit me fjalë a me sjellje të posaçme, me të cilën cenon dinjitetin, nderin dhe sedrën e tij.

OFSHAM/Ë, - A. f. Shfaqje objektive e brengosjes, e dëshpërimit, e mallkimit të një individi ndaj një individi tjetër, apo sjelljes së tij. Ofshama shfaqet me ndryshimin e ritmit, të ngjyrës dhe të intensitetit të frymëmarrjes dhe të zërit të njeriut.

OFTALMOLOGJI, - A. f. Disiplinë e shkencave mjekësore, e cila merret me studimin e syrit dhe të mjekimit të sëmundjeve të lidhura me sy. Termi rrjedh nga greqishtja *οφθαλμός* "syri" dhe *λογία* "shkenca". Me këtë term lidhen edhe termat: ***oftalmometri*** - matje e formës së syrit, e rrezes së kokërdhokut të syrit si edhe të cilësive të tjera të syrit dhe të procesit së të parit ***oftalmoplegji*** - paralizë e muskujve të syrit; ***oftalmospeltroslop*** - aparat për të gjurmuar verbërinë e syrit të njeriut ndaj ngjyrave etj.

OKSIPITAL, - E. mb. Që i përket zverkut, term i anatomisë. Në psikologjinë fiziologjike shënohet si pjesa e zverkut e trurit të njeriut, përkatësisht e asaj pjese të trurit që gjendet në

anën e fundit të kafkës dhe shpjegon funksionin e kësaj pjese në zhvillimin e proceseve psikofiziologjike.

OKULOMOTORIK, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *oculus* "syri" dhe *motorius* "që lëviz". Term i përdorur në terminologjinë e anatomisë dhe të psikologjisë fiziologjike, që cilëson tri lloj lëvizjesh dhe koordinimin e tyre. Këto lëvizje janë: lëvizja e kokërdhokut të syrit me anë të muskujve të jashtëm të syrit, lëvizjet e përshtatjes së lentës së syrit me muskulin e saj dhe mbledhjen e shtrirjen e bebes së syrit në varësi nga sasia e rrezeve të dritës që veprojnë në të.

OKULTIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *occultus* "i, e mefshtë". Të mësuarit mbi diçka të mefshtë, mbindijore. Okultizëm i përket më tepër parapsikologjisë dhe emërton dukurinë e njohjes së dukurive psikike, që nuk mund të njihen me procese njohëse normale, si edhe rregullsitë e ligjet e tyre. Këtu hyjnë edhe dukuritë e çuditshme, si magjia, spiritizmi, telepatia etj. Shih - ***PARAPSIKOLOGJIA.***

OLFAKSION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *olfactus* "nuhatje". Në psikofiziologji emërtohet si proces i ndijimit të erës së trupave flurorë, që njeriu e përjeton me anë të frymëmarrjes me hundë. Receptorët për olfaksion gjenden në epitelin e pjesës së sipërme të hundës, përkatësisht në cipën ose membranën e mukozës së pjesës së sipërme të hundës. Ngacmuesit e këtyre receptorëve janë disa substanca kimike në gjendje flurore, që shkrihen në lëngun hundor, i cili e zbut epitelin hundor.

OLFAKTOMETËR, - I. m. Instrument me të cilin provohet aroma e trupave flurorë, pragu i ndjeshmërisë dhe intensiteti i ndijimit të aromës së një trupi në gjendje flurore të tij. Rregullon sasinë dhe intensitetin e aromës së ngacmuesve të receptorëve të nuhatjes dhe shërben për matjen e intensitetit të ngacmuesve të receptorëve të nuhatjes dhe të ndijimit të tyre. Ekzistojnë disa lloj olfaktometrash, që janë emërtuar sipas zbuluesve të tyre. Ndër këta më i njohuri është olfaktometri Cvardemaker, i njohur sipas zbuluesit të saj, fiziologut holandez Henrik Cvardemaker (Henrik Zwaardemaker, 1857 – 1930).

OLFAKTOR, - E. mb. Që lidhet me procesin e nuhatjes dhe përfshin shqisën e të nuhaturit, përjetimin e aromës dhe matjen e saj.

OLIGARKI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *ολιγά* "pak". Në sociologji ka edhe strukturë psikologjike, sepse si formë qeverisjeje nga një numër i vogël individësh, mbështetet në lakminë për të pasur sa më shumë, për t`u pasuruar sa më tepër etj.

OLIGOFRENI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *ολίγος* "pak" dhe *φρέν* "mendje". Në psikiatri dhe psikopatologji,paraqet një formë të prapambetjes mendore. Emërto llojet e ndryshme të zhvillimit të pamjaftueshëm mendor. Shfaqet në forma të ndryshme, ndër të cilat dallohet sidomos paaftësia e individit për t`iu përshtatur mjedisit dhe kërkesave e normave sociale të atij mjedisi. Në psikologjinë bashkëkohore shkalla e oligofrenisë quhet "*retardim mental*" – "prapambetje mendore" dhe përcaktohet me koeficient të inteligjencës nën 0,70. Mund të jetë pasojë e sëmundjeve trashëguese, e lëndimit

të trurit gjatë lindjes etj. Shih – ***IDIOTËSIA; IMBECILIZMI; DEBILIZMI.***

OLPORT Gordon (Gordon ALLPORT). Psikolog. Lindi më 1897 dhe vdiq më 1967. Kreu studimet për psikologji në Universitetin e Harvardit, ku ka punuar edhe Uiljam MekDugali. Në vijim mbrojti doktoratën për psikologjinë e personalitetit me tezën "Mbi tiparet e personalitetit dhe marrëdhëniet shoqërore". Qe ligjërues i etikës shoqërore në një shkollë të mesme, por shpejt, më 1930, u zgjodh asistent e më pas profesor i psikologjisë dhe drejtor i departamentit të psikologjisë në Universitetin e Harvardit. Mori pjesë në studime speciale të psikologjisë në Gjermani dhe në Angli dhe prej këtej mendimi psikologjik europian i asaj kohe depërtoi edhe në pjesën e bregdetit lindor të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Megjithëse jetoi dhe veproi në kohën e lulëzimit të bihejviorizmit dhe të psikanalizës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës Gordon Olporti konsideroi se si bihejviorizmi, ashtu edhe psikanaliza e reduktojnë personalitetin e njeriut dhe nuk ishte përkrahës i tyre. Ka pasur një kulturë të gjerë përgjithësisht për psikologjinë, sidomos për psikologjinë e personalitetit. Në këtë fushë ka përpunuar gjerësisht tiparet e personalitetit dhe autonominë funksionale të motiveve. Këto dy koncepte me termat e tyre janë produkt i aktivitetit teorik dhe empirik të Gordon Olportit. Ishte përkrahës parimor i testeve të personalitetit si edhe i qasjes faktoriale të personalitetit, por njëkohësisht ishte edhe kritikues i procedurës së testimit dhe të analizës faktoriale të strukturës së personalitetit. Veprat kryesore të tij janë: *"Personality: A Psychological Interpretation"* – (*"Personaliteti: interpretimi psikologjik"*), 1937; "*The Nature of Prejudice"* – (*"Natyra e paragjykimeve"*), 1954; *"Becoming: Basic Considerations for a Psychology of Personality"* – (*"Përshtatja: konsiderata themelore për psikologjinë e personalitetit",* 1955; "*Personality and Social Encounter"* – (*"Personaliteti dhe përballja shoqërore"*), *1960; "Pattern and Growth in Personality"* – (*"Përbërja dhe zhvillimi i personalitetit"*), 1961.

OMNIPOTENC/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja. Në psikopatologji dhe psikiatri emërton ndjenjën e gjithëfuqishme të mendimeve të njeriut, që ka besim dhe bindje se mund ta ndryshojë mjedisin sipas dëshirave të tij. Një mendim i tillë është i pandashëm nga besimi dhe bindja në vetvete dhe në fuqinë e tij. Omnipotenca shfaqet te disa lloj çrregullimesh të rënda psikike, si te paranoja dhe skizofrenia.

ONANI, - A f. Vjen nga mitologjia greke. Onani kishte pranuar të hynte në lidhje martesore me gruan e vëllait të vdekur, siç e kish urdhëruar i ati, por nuk kishte pranuar të kryente marrëdhënie seksuale me të, duke demonstruar derdhjen e spermës në tokë. Më vonë onania morri domethënien e provokimit të orgazmës në mënyrë mekanike, përkatësisht të vetëstimulimit seksual. Shih – ***MASTURBIMI.***

ONIRIZ/ËM, - MI. I ardhur nga greqishtja *όνειρο* "ëndërr". Ndryshim çrregullues i gjendjes së vetëdijes së njeriut, që shfaqet gjatë kohës kur ai nuk është në gjendje gjumi, por ka përfytyrime shumë të gjalla, "ëndërron" për objekte, situata etj., që objektivisht

nuk ekzistojnë, por që e preokupojnë plotësisht, duke e vënë atë në gjendje gjumi. Në një gjendje të tillë njeriun mund ta shpjerë marrja e alkoolit në sasi të tepërt, që mund të shkaktojë edhe gjendje deliri . Kur ai "zgjohet" nga kjo gjendje has vështirësi për të dalluar, si dhe sa duhet, realen nga ëndrra.

ONIROMANTI, - A. f. I ardhur nga greqishtja dhe me përdorim të rrallë. Në parapsikologji emërton gjoja aftësinë e disa individëve për të parashikuar të ardhmen me anë të shpjegimit të ëndrrave. Oniromantia nuk ka të bëjë me psikanalizën, por u jep përbërësve të ëndrrave domethënie të caktuar. Kështu, shfaqja në ëndërr e vdekjes sjell jetën, ndërsa shfaqja në ëndërr e ujit të turbullt sjell sëmundje.

ONOMATOPE, - A. f. I ardhur nga greqishtja *ονοματο* "emër" dhe *ποιία* "bëj, tingullim". Onomatopea është emërtim i krijuar nga imitimi i zërave të disa frymorëve, si: *ciu – ciu, ki – ki – ri – ki, mjau* etj. Ka teori të origjinës së gjuhës që e shpjegojnë prejardhjen e lashtë të gjuhës nga imitimi i tillë i zërave të zogut, të gjelit ose këngëtarit, të maces.

ONTOGJENEZ/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *οντο* "qenie" dhe *γένεση* "lindje". Procesi i lindjes dhe i zhvillimit të individit, të organeve, të aftësive dhe të funksioneve të tyre që nga fillesa (ndryshimet organike, morfologjike e funksionale të organeve) deri në zhvillimin e plotë, përkatësisht në pjekurinë e tyre. Ontogjeneza ka edhe domethënien e disiplinës shkencore, që merret me studimin e lindjes dhe të zhvillimit të organizmave. Ky term ka përdorim të gjerë në psikologjinë gjenetike ose zhvillimore.

ONTOLOGJI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *οντο* "qenie" dhe *λογία* "shkencë". Degë e disiplinave të filozofisë, e cila merret me studimin e esencës së qenies, të ekzistencës së saj, pavarësisht nga cilësitë individuale e specifike të objekteve dhe të situatave të ndryshme. Në ontologji kemi të bëjmë me konceptet e kategorive themelore të së parës filozofi në domethënien e plotë të këtij termi (qenie, gjuhë, numër etj.). Në të hasim edhe sistemet konceptuale të mendjes së njeriut dhe të zhvillimit të saj.

OPERACION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *operationis* "punë – ue", "veprim– ue" etj. Veprimi i qëllimshëm me anën e të cilit njeriu ndryshon cilësitë, raportet, sasitë etj., ndërmjet dukurive, objekteve, proceseve, situatave etj. Një aktivitet i tillë në psikologjinë e personalitetit ka të bëjë me angazhime të vetëdijshme për të ndryshuar strukturën dhe gjendjen e brendshme psikike të vetë njeriut. Në psikologjinë e Zhan Pijazhes (Jean Piaget, 1896 – 1980) termi operacion emërton aktivitetin mendor që zhvillohet në planin e brendshëm simbolik të mendimit të njeriut që merr disa cilësi të veçanta, si vënia e rendit ndërmjet koncepteve, klasifikimi i tyre etj.

OPERACIONAL, - E. mb. Që ka të bëjë me veprimin e caktuar empirik, duke përjashtuar çdo kuptim teorik e metafizik.

OPERACIONALIZ/ËM, - MI. m. Pikëpamje filozofike e metodologjike e zhvilluar më shumë në kuadrin e fizikës nga ana e fizikanit dhe filozofit

Persi Brizhman (Percy Bridgeman, 1882 – 1961), sipas të cilit konceptet duhen përkufizuar me anë të metodës së përkufizimit operacional, përkatësisht duke caktuar domethënien e termave me anë të operacioneve që këta kryejnë në kuadrin e një sistemi të caktuar konceptual. Kështu, fuqia e shtytësit të urisë përkufizohet saktësisht duke përcaktuar numrin e orëve të organizmit të privuar nga ushqimi, inteligjenca është aftësi që mat një test, kushtëzimi është tërësi procedurash eksperimentale etj. Operacionalizmi është pikëpamje mbi konceptet e përkufizuara sipas metodës operacionale. Në psikologji të gjitha konceptet që nuk janë përkufizuar me anë të metodës së përkufizimit operacional duhen pezulluar nga statusi shkencor i tyre në terminologji. Praktikisht kjo do të thotë që nga terminologjia e psikologjisë duhet të largohen të gjitha konceptet mentaliste. Këtë qasje konceptuale të termave psikologjikë e hasim kryesisht në terminologjinë bihejvioriste, sidomos të asaj të tipit të Barus F. Skinerit (Burrhus F. Skinner, 1904 – 1990), sipas të cilit "operacionalizmi është procedurë e kumtimit të: 1) vëzhgimeve personale 2) procedurave manipuluese dhe llogaritëse të lidhura me dukuritë e vëzhgimit, 3) hapave logjikë e matematikë që shpien nga qëndrime të hershme në qëndrime të mëvonshme, dhe 4) asgjë më tepër". Pikëpamja operacionaliste ka ushtruar ndikim të fuqishëm sidomos në terminologjinë e shkollës dhe të drejtimit bihejviorist. Mirëpo, shumë nga termat e psikologjisë nuk mund të përcaktohen vetëm me anë të operacionalizmit. Kështu thelbi i kuptimit së urisë dhe i shkakut të saj nuk mund të përcaktohen vetëm duke matur kohën e privimit të organizmit nga ushqimi. Për këtë shkak operacionalizmi bashkëkohor në psikologji është më i pranishëm, sepse vetëm disa nga konceptet mund të përkufizohen sipas metodës operacionale.

OPERANT, - I. m. Veprim apo sjellje që mbetet i/e njohur me efektet konkrete të tij që ndikojnë në mjedisin ku gjendet kafsha, përkatësisht me ndryshimet që shkakton kafsha në mjedisin ku gjendet, kur ajo ngacmohet me një ngacmues të atij mjedisi. Në domethënien e ngushtë operantët janë veprimet a sjelljet e njëjta dhe spontane kur këto bëhen mjete me të cilat arrihet modifikimi i sjelljes ndaj një ngacmuesi të caktuar. Kështu, miu i madh hap derën e kafazit me anë të këmbës ose të hundës së tij, duke e ndrydhur dorëzën e derës së kafazit. Në këtë aktivitet, operant quhet ndrydhja e dorëzës së derës. Haset në psikologjinë e Barus F. Skenerit (Burrhus F. Skinner, 1904 – 1990).

OPIATE. asnj. Grup barnash apoide a farmakologjike, që mund të përdoren për zbutje dhembjesh, si droga (heroina, kodeina, morfina, opiumi, petidina etj.). Opiatet zakonisht ndahen në opiate të natyrshme, gjysëmsintetike dhe opiate endogjene. Pavarësisht nga natyra ato kanë këto cilësi kryesore: 1) Zvogëlojnë, zbusin dhe eliminojnë dhembjet, 2) Qetësojnë organizmin dhe ndikojnë në përgjumjen e tij dhe 3) Shkaktojnë ndryshime pozitive në gjendjen emocionale të organizmit të njeriut, që përjetohen në formë euforie, mirëqenie dhe qetësimi të organizmit. Marrja e opiateve është e

rrezikshme, pasi organizmi mësohet shpejt me to e krijon shpejt varësi prej tyre.

OPINIONI PUBLIK. I ardhur nga frëngjishtja *l`opinion publique* "mendim popullor". Mendim, pikëpamje, qëndrim pozitiv ose negativ i shfaqur haptas nga ana e një grupi ose e gjithë mjedisit shoqëror që ka të bëjë me një çështje me rëndësi të përgjithshme ekonomike, shoqërore, politike etj. për atë grup ose mjedis shoqëror. Një përcaktim i tillë i anëtarit të një mjedisi shoqëror ka lidhje të ngushtë me besimin dhe bindjen e tij për çështjen që gjurmohet. Opinioni publik matet dhe të dhënat e përftuara nga të anketuarit përpunohen në mënyrë statistikore. Rezultatet e gjurmimit të opinionit publik ushtrojnë ndikim të rëndësishëm në përgatitjen dhe miratimin e vendimeve të rëndësishme arsimore, edukative, ekonomike, fetare, kulturore, politike etj. për anëtarët e atij mjedisi. Opinioni ose mendimi publik i nënshtrohet evoluimit të tij. Në këtë proces rol të rëndësishëm luajnë media dhe mjetet e tjera të informimit.

OPIUM, - I. m. Substancë psikofarmakologjike që përftohet nga lëngu i lules së kuqe të hashashit, sidomos nga ato kokrra të hashashit, që janë ende të papjekura. Është ndër substancat psikofarmakologjike të lashta, që ka dy cilësi kryesore: zbut edhe eliminon dhembjet e organizmit ose të pjesëve të tij dhe shkakton përgjumjen e organizmit të njeriut duke larguar tensionet emocionale, frikën, ankthin etj. Nga opiumi mund të përftohen edhe substanca të tjera opiatesh si, heroina, kokaina, morfina etj. Marrja e tyre nga njeriu mund ta shpjerë këtë në gjendje varësie nga opiatet.

OPORTUNIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *opportunus* "i përshtatshëm". Formë e mendimit dhe e sjelljes së njeriut, e organizuar sipas kushteve, rrethanave dhe raporteve të ndryshueshme pa marrë parasysh idealet, parimet, rregullat dhe normat morale, si dhe synimet afatgjata të mjedisit shoqëror. Baza psikologjike e oportunizmit qëndron në kënaqësinë, lavdinë, prestigjin, dobinë materiale të përkohshme, si edhe në gatishmërinë për kompromise. Mendimi, qëndrimet dhe sjelljet oportuniste hasen më tepër në psikologjinë politike dhe te politikanët. Mendimi dhe sjelljet oportuniste, si tipare të personalitetit janë trajtuar edhe nga psikologu amerikan Gordon V. Olport (Gordon V. Allport, 1897 – 1967). Sipas tij "sjellja oportuniste është në kundërshtim me sjelljen burimore të njeriut".

OPTIK/Ë, - A. f. Degë e fizikës që merret me studimin e dritës dhe të lidhjes e raportit ndërmjet saj ose valëve elektromagnetike me gjatësi të caktuara dhe procesit të të parit të dritës dhe të ngjyrave. Zhvillimi i optikës ka mundësuar njohjen e ligjeve të shpërndarjes dhe të përthyerjes së dritës dhe ka ndikuar edhe në zhvillimin e psikofiziologjisë së të parit, si edhe në njohjen e natyrës së perceptimit pamor.

OPTIK, - E. mb. I ardhur nga *οπτικός* "pamor", që përcakton atë që ka të bëjë me optikën, me të parin, me syrin.

OPTIMIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *optimus* "më i miri". Ka kuptim të përgjithshëm dhe të veçantë

psikologjik. Kuptimi i përgjithshëm ka të bëjë me qëndrimin, sipas të cilit shfaqet gatishmëria e njeriut për të vëzhguar anët pozitive (të mira, të dobishme, të kënaqshme etj.) të një dukurie a procesi dhe për të vepruar ndaj tyre në varësi nga një qëndrim i tillë.

OPTOTIP, - I. m. Aparat që shërben për të matur mprehtësinë e të parit të objekteve. Optotipi zakonisht përbëhet nga një tabelë, në të cilën shkronjat ose numrat jepen me madhësi të ndryshme dhe nga subjekti kërkohet që të lexojë shkronjën ose numrin me madhësi më të vogël.

ORAL, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *oris* "gojë", që cilëson atë që i përket gojës apo buzëve. Haset më tepër në psikanalizë dhe në psikolinguistikë, ku dallohen këto sintagma: ***EROTIZMI ORAL; FIKSIMI ORAL; KARAKTERI ORAL; SADIZMI ORAL; FAZA ORALE; ZONA ORALE*** – shih**.**

ORDINAT/Ë, - A. f. Boshti vertikal në sistemin koordinativ, që shënohet zakonisht me y (ipsilon). Vlerat sasiore mund të konkretizohen me paraqitjen grafike të tyre përgjatë ordinatës së caktuar, kurse pozicioni i vlerave përcaktohet në bazë të pikëprerjes së ordinatës me abshisën e sistemit koordinativ, përkatësisht me drejtëzën horizontale të këtij sistemi ose me x (iks).

OREKS, - I. m. Ëndje, shije për ujë e ushqim në radhë të parë. Oreksi ka të bëjë me synimin e njeriut për të plotësuar ato nevoja biologjike, që lindin nga proceset fiziologjike të organizmit. Këto procese shkaktojnë oreks, por edhe ëndja e shija për ushqim të caktuar ndikon në kërkim të një lloji të caktuar të ushqimit. Në një përdorim tjetër kuptohet edhe si ëndje seksuale.

ORGAN, - I. m. Pjesë e organizmit të qenieve të gjalla (të bimës, të kafshës dhe të njeriut) që ka përbërje shumëqelizore dhe indore të përbashkët dhe që është e organizuar në një njësi funksionale të veçantë në kuadrin e përbashkët të organizmit. Te njeriu, sikurse edhe te disa kafshë të rendit të lartë disa organe janë të lidhura ndërmjet tyre dhe kryejnë funksione të përbashkëta. Të tillë janë: organet e frymëmarrjes, të lëkurës, të muskujve, të ndijimeve, të sistemit nervor, të skeletit, seksuale, të sekretimit, të tretjes. Zakonisht ndahen në organe vegjetative dhe në organe që kanë të bëjnë me jetën, me dukuritë, me proceset psikike dhe me sjelljet e njeriut.

ORGANI I KORTIT. Strukturë e ndërlikuar e veshit të brendshëm që gjendet në kërmill dhe është mbështetur në murin e poshtëm të kanalit koklear. Këtu bëjnë pjesë membrana bazilare, qelizat vibruese receptore të përforcuara në të dhe membrana tektoriale. Organi i Kortit luan rol të rëndësishëm në procesin receptor të tingujve dhe të zhurmave. Struktura e këtij organi mori emrin e zbuluesit të saj Alfons G. Korti (Alfonso G. Corti, 1822 – 1876), studiuesit të njohur italian të anatomisë.

ORGANI INFERIOR. Sipas Alfred Adlerit (Alfred Adler, 1870 – 1937) lidhet me psikologjinë e komplekseve dhe emërton konceptin mbi të metat e një organi ose mosfunksionimin real apo imagjinar të një organi të trupit të

njeriut. Ky koncept mund ta shpjerë njeriun në inferioritet, përkatësisht në ndjenjën e vlerës më të vogël, më të ulët.

ORGANI NDIJIMOR. Tërësi organike dhe funksionale e sistemit të shqisave të njeriut, që përbën thelbin e njohjes së trupave, të dukurive dhe të cilësive të tyre. Organi ndijimor përbëhet nga shqisat, e receptorët e saj, nga nervat e caktuar të shqisave, nga rrugët nervore nëpër të cilat bartet impulsi nervor deri në qendrat përkatëse të cipës apo kores së trurit të madh dhe nga qendrat trunore, ku impulset nervore shndërrohen në ndijime dhe në një proces të ndërlikuar të perceptimit të tyre. Organe ndijimore janë: organi i të parit, të dëgjuarit, të prekurit me modalitetet e tyre, i dhembjes, i temperaturës, i të nuhaturit, i të shijuarit, i lëvizjeve dhe i ndijimeve organike.

ORGANI PËRFUNDIMTAR I RUFINIT. Lloj receptori i prekjes që vihet në veprim nga prekja e lëkurës. Pjesa më e madhe e organeve të rufinit gjendet në zbrazëtirat dhe veglat e eshtrave. Këto aktivizohen me rastin e rrotullimit të eshtrave.

ORGANI SHQISOR. Shih – ***SHQISA.***

ORGANI VESTIBULAR. Organ receptorik për pozitën e trupit dhe të kokës dhe për ndryshimet pozitës së trupit dhe të kokës së njeriut. Organi vestibular gjendet në pjesën e veshit të brendshëm; përbëhet nga tri kanale në formë gjysmëharkore dhe nga dy qeska të njohura me termin utrikulus dhe sakulus. Kanalet gjysmëharkorë janë të mbushur me lëngun e njohur me termin endolimf. Në qeska gjenden qime ndijimore të zhytura në lëngun xhelatinoz me kristale të kalciumit. Endolimfa lëviz kur trupi i njeriut ose koka e tij lëviz me shpejtësi ose me ngadalësi dhe, me këtë rast, ngacmohen qimet ndijimore me kristale të kalciumit të njohura me termin otolitët dhe statolitët. Me rastin e lëvizjes së kokës ose të trupit otolitët dhe statolitët vënë në lëvizje endolimfën në kanalet gjysmë harkore duke bartur impulset reaguese të këtilla në qendrën e trurit, me të cilin rast njeriu bëhet i vetëdijshëm për pozitë e trupit, për lëvizjen e tij, si edhe për pozitën e kokës dhe lëvizjet e saj.

ORGANICIZ/ËM, - MI. m. Në sociologji haset në studimet e filozofit anglez Herbert Spenser (Herbert Spencer, 1820 – 1903). Sipas tij shoqëria dhe zhvillimi i saj duhen trajtuar në mënyrë analitike me sistemin e koncepteve biologjike. Sipas kësaj pikëpamjeje individi – përbërës i një grupi shoqëror është i njëjtë me përbërësin e organizmit biologjik dhe zhvillimi shoqëror është i ngjashëm me zhvillimin biologjik.

ORGANIK, - E. mb. Që emërton veçorinë e një organi, të asaj që është trupore, e brendshme dhe që i përket ekzistencës së tij. Është pjesë përbërëse e termave psikologjikë të karakterit sintagmor:

ANKCIOZITETI ORGANIK;
ÇRREGULLIMET ORGANIKE;
ÇRREGULLIMI ORGANIK MENDOR;
INFERIORITETI ORGANIK;
MOTIVET ORGANIKE;
NDIJIMET ORGANIKE;
PSIKOZA ORGANIKE;
SINDROMA ORGANIKE-MENDORE – shih.

ORGANIZAT/Ë, - A. f. Term i përgjithshëm që përdoret në partitë politike, në ushtri, në korporata etj. Në psikologji merr kuptim të posaçëm, sidomos në psikologjinë sociale dhe të punës. Në psikologjinë sociale ka të bëjë me një tërësi individësh dhe veprimesh të tyre të lidhur reciprokisht ndërmjet tyre, me një strukturë të stabilizuar anëtarësh, ku secili e ka të caktuar vendin dhe rolin e tij dhe të gjithë veprojnë drejt një qëllimi a objektivi të përbashkët. Kuptohet më tepër si një organizatë formale, ku rregullat, normat, drejtimi dhe raportet e sjelljeve ndërmjet anëtarëve të këtij grupi përcaktohen nga ana e vet anëtarëve të atij grupi. Në psikologjinë e punës organizata punuese është një bashkësi punëtorësh, që karakterizohet nga pjesëmarrja e anëtarëve në veprimtarinë e përbashkët, ku ka ndarje pune, funksionesh, rolesh dhe një hierarki drejtuese të zgjedhur.

ORGANIZATA FORMALE. Organizatë me qëllime, detyrime dhe norma të qarta të sjelljeve të anëtarëve të saj, të tilla si: korporatat, bashkësitë fetare, organizatat politike etj. Në këto organizata të gjithë anëtarët veprojnë sipas ndarjes së punëve profesionale dhe sipas rregullave dhe detyrimeve të tyre.

ORGANIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga greqishtja *ὄργανο* "vegël, mjet". Përdoret në terminologjinë e biologjisë, të antropologjisë, psikologjisë etj. Në psikologji emërton konceptin e qenies së ndërlikuar të një sistemi organesh të integruara mirë në një tërësi të gjallë harmonike, në individualitetin e një qenieje të gjallë, që është e aftë të jetojë dhe të veprojë në mjedisin e caktuar. Në këndvështrimin e disa shkollave e drejtimeve psikologjike ka kuptim të veçantë. Kjo vlen posaçërisht për bihejviorizmin, ku me termin organizëm emërtohet qenia e kafshëve dhe e njerëzve, ku rregullsitë, ligjet dhe sistemi i tyre vlen si për organizmin e kafshëve, ashtu edhe për atë të njerëzve.

ORGANIZIM, - I. m. Tërësi e bashkërenditur veprimesh, pjesësh me funksion të ndërsjellë e të koordinuar në një sistem të përbashkët të një tërësie të caktuar.

ORGANIZIMI I PERCEPTIMEVE. Sistem i ndërlikuar raportesh ndërmjet strukturave të ngacmimeve që formojnë tërësinë perceptuese të një tërësie, përvoje për një objekt të caktuar. Organizimi i perceptimeve është koncept dhe term i psikologjisë geshtaltiste. Organizimi i perceptimeve sipas psikologjisë geshtaltiste realizohet sipas parimeve apo ligjeve të veçanta perceptuese, si: parimi i afërsisë, i ngjashmërisë, i pandërpreshmërisë, i formës së mirë. Shih – ***PARIMET E ORGANIZIMIT TË PERCEPTIMEVE.***

ORGANIZIMI I PERSONALITETIT. Bashkërenditja rregulluese e tipareve kryesore të sjelljeve të personalitetit, si dhe ndërlidhja e qëndrueshme e tyre, karakteristikë për këtë tip personaliteti.

ORGANIZIMI TONOP. Term i neurofiziologjisë që emërton organizimin anatomik e fiziologjik të fushës parësore të dëgjimit të pjesës têmthore të trurit. Në këtë fushë arrijnë ngacmimet apo informacionet akustike dhe shpërndarja e tyre i përgjigjet shpërndarjes së dridhjeve të membranës bazilare. Tonet me frekuencë të

lartë dredhin pjesën me formë vezore të membranës bazilare dhe dridhjeve të tilla u përgjigjet me reagim pjesa e përparme e fushës parësore të cipës së trurit, kurse toneve me frekuencë u përgjigjen pjesët e tjera të vendosura në fushën e ulët nervore.

ORGANOGJENEZ/Ë, – A. f. Në embriologji emërton procesin e zhvillimit dhe të formimit të organeve, duke u nisur nga zhvillimi i shtresave qelizore të gastritisit, që kanë aftësi për t`u zhvilluar.

ORGAZ/ËM, - MA. m. Proces i ndërlikuar fiziologjik dhe psikologjik, që ka të bëjë me kulmimin e përjetimit të ndjenjës seksuale gjatë procesit të plotësimit të motivit seksual me partnerin e caktuar dhe përjetohet pas një shqetësimi të madh të organizmit. Strukturën e këtij procesi e përbën ndërthurja e veprimeve të pavullnetshme, aktivizimi i muskujve të organit seksual dhe ngërçet e tij, ndryshimet neurofiziologjike të organizmit (përshpejtimi i rrahjes së ritmit të zemrës, ngritja e tensionit të gjakut, zmadhimi i bebëzave të syrit, klithmat specifike etj.), të cilat lidhen ngushtë me kënaqësinë e madhe të kryerjes së aktit seksual dhe përfundojnë me ejakulim, përkatësisht me derdhjen e spermës jashtë organizmit. Kulmi i kënaqësisë seksuale ka karakter individual, por te femrat ritmi i kulmit është më i ngadalshëm se te meshkujt. Pas përfundimit të aktit seksual vihet re ulja graduale e tensionit të gjakut dhe organizmi qetësohet shkallë-shkallë. Dallohen disa forma të orgazmës: ***orgazma femërore*** (kulmi i kënaqësisë seksuale te femrat, që karakterizohet nga zgjatja kohore, rritja e klitorisit dhe kthimi i tij në gjendje normale pas pak minutash nga përfundimi i orgazmës); ***orgazma mashkullore*** (kulmi i kënaqësisë seksuale te meshkujt, që përjetohet me derdhjen e spermës); ***orgazma e padëshiruar*** (orgazma e përjetuar gjatë dhunimit seksual, që shoqërohet me komplekse faji dhe turpi).

ORGONOMI, - A. f. Qëndrime dhe pikëpamje mbi personalitetin nga Vilhelm Rajh (Wilhelm Reich, 1897 – 1957), sipas të cilit, te të gjitha qeniet e gjalla ekziston një energji e karakterit biofizik, e cila është bartëse e gjithëmbarshme e jetës së njeriut, duke përfshirë aktivitete të ndryshme, madje edhe veprimtarinë krijuese të tij. Kuptimi i termit orgonomi është i ngjashëm me kuptimin e termit mesmerizëm. Ai u përpoq të argumentojë ekzistencën e kësaj energjie dhe mbi konceptin e saj zhvilloi forma terapeutike të ndryshme. Duke mos qenë në gjendje të argumentojë besimin e madh të tij në një energji të tillë, hasi në kundërshtarë të mëdhenj, madje edhe shkeli rendin juridik e shoqëror në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Për këtë shkak ai u burgos dhe pas pak kohësh vdiq.

ORGJI, - A. f. I ardhur nga greqishtja dhe lidhet me misterin pagan. Përjetim i argëtimit, i dëfrimit të nivelit të lartë dhe i entuziazmit gjatë marrjes së alkoolit, këndimit, lojës, sjelljeve agresive të pakontrolluara të individëve të gjinive të ndryshme dhe mospërmbajtje ndaj parimeve dhe normave elementare të moralit në raportet ndërmjet tyre.

ORIENTIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *orientalis* "i lindjes, lindja e diellit". Në të folurën e përditshme ka

kuptimin e drejtimit. Në psikologji është drejtim i njeriut, i aktiviteteve të tij drejt një qëllimi të caktuar, të qenit të vetëdijshëm ku gjendemi, përse gjendemi këtu ose atje, ku shkojmë në situate të ndryshme duke përfshirë edhe situatat problemore dhe duke kërkuar drejtimin mendor e veprues për zgjidhjen e tyre. Në terminologjinë e psikologjisë hasim këto sintagma, ku gjendet edhe termi orientim: orientimi i vëmendjes, orientimi në detyrë, orientimi në objektiv.

ORIENTIMI I VËMENDJES. Drejtim i vëmendjes në objektivin e caktuar, ku ajo do të përqendrohet.

ORIENTIMI NË DETYRË. Gatishmëri e qëndrueshme e sjelljeve të njeriut, sipas së cilës ai angazhon gjithë energjinë e vet psikike, kur ka të bëjë me një detyrë të caktuar të vetën ose të marrë nga të tjerët. Një orientim i tillë merr karakter të tiparit të personalitetit, kur shfaqet vazhdimisht gjatë aktivitetit të tij; një tipar i tillë është ndër ato tipare që karakterizon personalitetin e formuar të njeriut.

ORIENTIMI NË OBJEKTIV. Drejtimi i energjisë psikike me qëllim të caktuar dhe organizimi i kësaj energjie dhe i lëvizjeve, përkatësisht i veprimeve të njeriut drejt zotërimit të atij qëllimi konceptual.

ORIENTIMI PROFESIONAL. Veprimtari e organizuar e shërbimeve të specializuara për informim dhe këshillim të të interesuarve për zgjedhjen e duhur të profesionit jetik. Për një orientim të tillë nevojitet saktësimi i aftësive, interesave, tipareve të personalitetit, motivacionit, qëllimit jetësor etj., për të mundësuar orientimin ose drejtimin e një të riu në profesion ose studim, që ai të ketë sukses. Kjo arrihet me anë të testimit të posaçëm të të interesuarve për zgjedhjen e drejtë të profesionit. Orientimi profesional konsiderohet si fushë e posaçme e psikologjisë së punës.

ORTOGJENEZ/Ë, - A. f. Teoria e zhvillimit të qenieve nga faktorët e brendshëm, të cilët kontrollojnë dhe drejtimin e zhvillimin psikofizik. Ortogjeneza haset edhe në teori të caktuara të zhvillimit psikosocial të shoqërisë dhe të anëtarëve të saj.

ORVATJ/E, - A. f. Angazhim psikofizik i individit për realizimin e një qëllimi të caktuar. Në strukturën e orvatjes dallohet përfytyrimi i objektit ose i një ideje të caktuar që njeriu synon ta arrijë, ndjenja pozitive për suksesin e mundshëm të arritjes në atë qëllim dhe veprimet e caktuara që organizohen në drejtim të zotërimit të atij qëllimi. Në gjurmimet eksperimentale orvatja është njësi e përbërë nga ngacmuesi dhe nga reagimi ndaj tij.

ORVATJE DHE GABIME. Formë e të mësuarit që ka të bëjë me procesin e eliminimit të gabimeve dhe të përforcimit të atyre lëvizjeve dhe reagimeve që shpien në realizim të qëllimit të caktuar. Shih – ***TË MËSUARIT NË BAZË TË ORVATJEVE DHE GABIMEVE.***

OSGUD Charles (Charles OSGOOD). Psikolog amerikan. Lindi më 1916. U diplomua për psikologji në Kolegjin Darmut më 1939 dhe doktoroi në Universitetin e Jelit gjashtë vite pas diplomimit, më 1945. Nga viti 1949 punoi në Universitetin Ilinois të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. U vlerësua si

një ndër njohësit enciklopedikë të psikologjisë. Diferenciali semantik është koncept dhe term i tij. U mor me gjurmimin objektiv të kuptimit të fjalëve dhe të evoluimit të tyre, duke zbatuar metodën hulumtuese të shkallëzimit vlerësues të kuptimit dhe metodën e analizës faktoriale. Duke u mbështetur në raportin personal të njeriut ndaj kuptimit të fjalëve u përpoq të depërtojë në njohjen e këtij raporti me anën e mbiemrave të një gjuhe. Përcaktoi tri përmasa të kuptimit psikologjik të mbiemrave me shkallën bipolare: 1) Përmasën e vlerësimit (të valencës) të shprehur me mbiemrat: i pastër – i ndytë, i këndshëm – i pakëndshëm dhe i bukur – i shëmtuar; 2) Përmasën e fuqisë (potencës) psikologjike të shprehur me mbiemrat: i fortë – i dobët, i rëndë – i lehtë, i madh – i vogël dhe 3) Përmasën e aktivitetit të shprehur me mbiemrat: i ftohtë – i ngrohtë, i shpejtë – i ngadalshëm, aktiv – pasiv. Me qasje gjurmuese të tilla fitoi autoritetin e një hulumtuesi të vërtetë në përmasa botërore. Veprat kryesore: "*Method and Theory in Experimental Psychology" – "Metoda dhe teoria në psikologjinë eksperimentale*"), 1953; *"The Measurement of Meaning" – ("Matja e kuptimit")* (bashkautor me George Suci dhe Percy Tannenbaum), 1957.

OSMORECEPTOR, - I. m. Receptor i supozuar që reagon përkatësisht ndaj dukurisë osmotike, ndaj sasisë së lëngjeve brendaqelizorë, si dhe ndaj shtypjes osmotike të qelizave. Osmoreceptorët besohet se janë përqendruar në hipotalamus dhe rregullojnë prodhimin e hormonit antidiureutik.

OTOLIT, - I. m. Gurëza të veshit të brendshëm në formë kristalesh të vogla me përbërje karbonat kalciumi që gjenden brenda endolimfës së labirintit membranor. Kryejnë funksionin receptor të ndijimit të baraspeshës së trupit të njeriut. Lëvizja e kokës vë në lëvizje endolimfën dhe, në këtë rast, otolitet ngacmojnë qelizat receptore, të cilat, me kthimin e informacionit ndihmojnë në ruajtjen e baraspeshës së kokës dhe të trupit. Shih – ***ORGANI VESTIBULAR.***

OTOSKLEROZ/Ë, - A. f. Dobësim sistematik i dëgjimit të tingujve e zhurmave që shkaktohet nga ngurtësimi i pjesëve të veshit të mesëm (të kullës, uzegjisë e çekiçit) dhe nga pamundësia e bartjes së dridhjeve të tyre në pjesët e tjera të veshit.

OVACION, - I. I ardhur nga latinishtja që emërton përshëndetje me duartrokitje, me ngazëllim dhe me entuziazëm të jashtëzakonshëm.

P

P – simbol i individit; simbol i aftësisë së perceptimit**;**

P- – personalitet me organizim tiparesh të dobëta;

P+ – personalitet me organizim të mirë tiparesh.

Pa – parashtesë mohimi, me të cilën formohen termat që tregojnë mungesën e një cilësie, të një raporti, të një tipari etj.

PAAFTËSI, - A. f. Mungesë aftësie dhe zhvillim i pamjaftueshëm, me të cilën përballet një individ në zgjidhjen e ngadalshme e të vështirë të problemeve dhe të situatave problemore brenda një kohe të caktuar. Kjo pasqyrohet edhe në mungesën e aftësisë së duhur të një individi për zgjidhjen shpejt dhe me sukses të detyrave në një fushëveprim të caktuar.

PAANËSI, -A. f. Përcaktueshmëria e një individi në vlerësimin e një gjykimi, të një supozimi, të një veprimi etj. në kushtet e mungesës së ndikimit që mund të ushtrojnë në të ambiciet, dëshirat, paragjykimet, qëndrimet etj.

PABESUESH/ËM, - ME (I, E). mb. Mungesë e ndjenjës së besimit të një individi ndaj tjetrit, ndaj një gjykimi, një qëndrimi, një veprimi etj. që rrjedh nga argumentimi i pamjaftueshëm i tij.

PABURRËRI, -A. f. Mungesë guximi, qëndrimi, vendosmërie e trimërie për realizimin e një detyre, kërkese, qëllimi etj. dhe për zotërimin e pengesave që shfaqen në rrugën e realizimit të tij.

PACIENT/E, - I. Term i mjekësisë, i ardhur nga latinishtja *patiens* "ai që pëson, që është i sëmurë". Ka përdorim të caktuar edhe në psikologji. Emërton konceptin e individit të sëmurë fizik ose psikik, që i nënshtrohet mjekimit nga mjeku, nga ekipi i mjekëve të një fushe të caktuar ose nga psikoterapeuti. Termi pacient shfrytëzohet më tepër për ata individë që vuajnë nga sëmundjet fizike, kurse në psikologji, përkatësisht në psikologjinë klinike përdoret më tepër termi klient për individin që ka çrregullime psikike, pikërisht probleme të natyrës psikike.

PADIJENI, - A. f. Mungesë njohurish të caktuara. **PADURUESH/ËM, - ME (I, E).** mb. Humbje e durimit për të përballuar kërkesat, pengesat, shqetësimet etj.

PAGJUMËSI, -A. f. Pamundësia për të fjetur normalisht, çrregullimi i gjumit. Pagjumësia shfaqet në forma të ndryshme, si: zgjimi disa herë gjatë natës dhe, lidhur me këtë, ngritja e shpeshtë nga shtrati. Rrjedh nga aktivizimi i nivelit të lartë të neuroneve të formacionit retikular, nga çrregullimi i frymëmarrjes, nga ngarkesat e shqetësimet e ndryshme psikike etj. Pagjumësia pengon zhvillimin normal të aktivitetit intelektual dhe fizik të njeriut. Në literaturën e psikologjisë klinike pagjumësia emërtohet me termin latin *insomnia*.

PAJTIM, - I. m. Institucion i trashëguar dokesh e zakonesh të gjakmarrjes; akti i të falurit të gjakut prej gjakësorit dhe rivendosja e marrëdhënieve të mira ndërmjet palëve apo familjeve të grindura, të cilat para këtij akti gjendeshin në raport gjakmarrjeje. Gjakmarrja ka përmasë të theksuar psikologjike. Këtë e karakterizon motivi i vetaktualizimit të personalitetit dhe ruajtja e autoritetit shoqëror të të dëmtuarit.

PAKËNAQËSI, - A. f. Ndjenjë e kundërt e kënaqësisë që shkaktohet nga mosplotësimi i dëshirës, i motivit, i nevojës së njeriut dhe nga ndikimi i posaçëm që ushtron mbi njeriun cilësia e një dukurie, objekti, veprimi etj. Disa lloj ndijimesh shkaktojnë vazhdimisht pakënaqësi (shija e hidhët e një lëngu, dhembja, mundimi etj.). Pakënaqësia së bashku me kënaqësi ka karakterin e emocionit elementar.

PALCA E ZGJATUR. Palca e zgjatur e kolonës vertebrore është pjesë e trungut të trurit. Kjo shtrihet prej pjesës së sipërme të palcës kurrizore – urës së Varolit deri te kryqëzimi piramidal i trurit. Në palcën e zgjatur gjenden disa qendra nervore me rëndësi vitale si ajo e frymëmarrjes, e qarkullimit të gjakut, e funksionit të zemrës etj. Këtu gjenden edhe nukleuset e nervave IX, X, XI e XII. Në literaturën e psikologjisë fiziologjike shpesh përdoret termi latin *medulla oblongata*.

PALCA KURRIZORE. Palca kurrizore është term i anatomisë së sistemit nervor, e njohur me termin e latinishtes *medulla spinalis*. Kjo është pjesë përbërëse e Sistemit Nervor Qendror. Gjendet e mbyllur në kanalin rruazor. Shih – ***SHTYLLA KURRIZORE.*** Palca kurrizore te njeriu ka një gjatësi prej 40 - 45 cm dhe një peshë prej 28 gr. Kjo lidhet me trurin nëpërmjet pjesës vazhduese të saj, kurse pjesa e poshtme e saj përfundon me ngushtimin konik. Palca kurrizore përbëhet prej trupit të qelizave nervore dhe prej fijeve vazhduese të këtyre qelizave. Trupi i qelizave nervore të palcës kurrizore përbën pjesën e përhimët, kurse fijezat nervore të tyre përbëjnë pjesën e bardhë të palcës kurrizore. Pjesa e bardhë e palcës kurrizore gjendet në periferi të asaj të përhimët që përbën pjesën qendrore të palcës. Fijet e trupit të qelizave nervore janë të grupuara dhe secili prej këtyre grupeve kryen funksione të posaçme. Nëpërmes rrugës piramidale barten impulse nervore prej qendrave të trurit në muskuj, duke mundësuar kryerjen e lëvizjeve e të veprimeve të vullnetshme të njeriut. Palca kurrizore kryen dy funksione kryesore: 1) Bart impulse nervore nga organet e trupit në qendrat përkatëse dhe 2) Nëpërmjet saj barten impulse nervore të këtyre qendrave në muskuj, gjëndra dhe në pjesët periferike të trupit. Në palcën kurrizore gjenden

qendrat nervore të muskujve skeletorë, qendrat nervore të ndjeshmërisë dhe qendrat e pjesës simpatike dhe parasimpatike të sistemit nervor autonom ose vegjetativ. Funksionet e këtyre qendrave të palcës kurrizore gjenden nën kontrollin e qendrave të larta të sistemit nervor. Trupi i qelizave nervore të palcës që përbën pjesën e përhimët të saj bart impulse nervore të shkaktuara nga ngacmimi i receptorëve të dhembjes, të prekjes, të temperaturës, të receptorëve të muskujve, të eshtrave në pjesët e larta të Sistemit Nervor Qendror, kurse një pjesë e këtyre ngacmimeve barten në qelizat nervore të pjesës së përparme të palcës të pjesës së përhimët, ku kryhen lëvizjet refleksive. Në pjesën qafore të palcës së kurrizit gjendet formacioni retikular i lidhur me formacionin retikular të trungut të trurit. Struktura e palcës kurrizore dallohet qartë në figurën e mëposhtme:



PALEOKORTEKS, - I. m. Emërtim i vjetër i zhvillimit filogjenetik të cipës ose kores së trurit të madh.

PALEOPSIKOLOGJI, - A. f. Term i greqishtes që emërton orvatjet e gjurmimit të sjelljeve arkaike të jetës psikike të njerëzve që nga koha më e lashtë, nga koha parahistorike. Për këtë qëllim shërbejnë dhe shfrytëzohen gjetjet arkeologjike (vendosja e të vdekurve në varr me të gjitha mjetet artistike përreth kufomës). Paleopsikologjisë i përket edhe gjurmimi i miteve, i formave të komunikimit ndërmjet njerëzve, i ritualeve etj. Me studimin e arketipave të pavetëdijes kolektive Karl G. Jungu (Carl G. Jung, 1874 – 1961) i përket gjurmimeve me karakter paleopsikologjik.

PALILALI, - A. f. Çrregullim i të folurit që karakterizohet me përsëritje fjalësh e fjalish të njëjta, por me shpejtësi relativisht të madhe. Palilalia është shpesh pasojë e dëmtimit të qelizave nervore dhe simptomë e sëmundjeve ekstrapiramidale.

PANDËRGJEGJSH/ËM, - ME (I, E). mb. Që nuk e ka të zhvilluar ndërgjegjen, që nuk ka arritur t`i përvetësojë parimet dhe normat morale dhe t`i drejtojë e organizojë sjelljet e tij sipas këtyre parimeve dhe normave morale. Pasojë e pandërgjegjshmërisë së njeriut është vlerësimi i sjelljeve të padrejta, të pamoralshme, të fajshme etj. Termi pandërgjegjshmëri duhet dalluar nga kuptimi i termit vetëdije. Në shqip këto dy terma herë-herë zëvendësohen njëri me tjetrin.

PANDRYSHUESHMËRIA E PERCEPTIMEVE. Dukuria e perceptimit të objekteve tashmë të njohura, duke u mbështetur në përvojën e fituar dhe duke e konsideruar perceptimin e tyre konstant, pavarësisht nga ndryshimet e bëra në ato objekte dhe në kushtet e në rrethanat në të cilat ato perceptohen. Në kuadrin e dukurisë së pandryshueshmërisë së perceptimit të objekteve të njohura dallojmë këto terma:

a. **Pandryshueshmëria e formës së objekteve** – Përderisa figura e formës së objekteve në retinën e syrit të

njeriut ndryshon në varësi nga këndvështrimi, perceptimi i formës së atij trupi mbetet i pandryshueshëm, pra forma perceptohet e drejtë. Kështu, figura e rrethit e parë anash shkakton pamje tjetër; njeriu e percepton këtë të pandryshuar;

b. **Pandryshueshmëria e madhësisë së trupave** – Prirja e njeriut për ta perceptuar madhësinë e një trupi të pandryshuar, pavarësisht nga ndryshimi i madhësisë së figurës retinore nga largësia ndërmjet atij trupi dhe subjektit, i cili e percepton atë trup;

c. **Pandryshueshmëria e ndriçimit të objektit** – Shkalla e ndriçimit të objektit perceptues nuk ndryshon, pavarësisht nga ndryshimi relativisht i madh i shkallës së ndriçimit të mjedisit ku gjendet objekti perceptues.

d. **Pandryshueshmëria e perceptimit të formës** Veçori e perceptimit të objekteve dhe të figurave të tyre. Pavarësisht nga ndryshueshmëria e formës së objekteve ose figurave të tyre që bien në rrjetëzën (në retinën) e syrit, forma e atij objekti ose asaj figure për perceptuesin mbetet e pandryshueshme. Rol të rëndësishëm në këtë proces luan përvoja e perceptuesit.

PANIK, - U. m. I ardhur nga mitologjia greke *Pano* "Zot i frikës" që emërton frikën e madhe që përhapet shpejt në një masë të madhe njerëzish, duke mos pasur mundësi kontrolli të saj nga ana e tyre. Paniku shkaktohet nga rreziku i madh real ose i imagjinuar, nga i cili secili orvatet të largohet sa më shpejt. Rreziqet më të shpeshta të panikut janë ato që shkaktohen nga vërshimet, nga zjarri e përhapja e tij, nga tërmeti etj., si edhe nga pasiguria e njerëzve për t`i përballuar ato.

PANKREAS, - I. m. Gjëndër me sekretim të brendshëm dhe të jashtëm që gjendet para lukthit dhe përbëhet prej kokës, trupit dhe prej bishtit. Ka gjatësi prej 15 – 20 cm dhe një peshë prej rreth 70 – 100 gram. Në pjesën më të madhe të pankreasit prodhohet lëngu pankreatik që ndikon në tretjen e ushqimit. Në brendësinë e pankreasit gjenden të ashtuquajturit "ishuj të Langerhansit", që janë bartës të funksionit të posaçëm të kësaj gjëndre. Pankreasi prodhon insulinën, që është rregullator i tretjes së sheqerit në gjak dhe e shfrytëzimit të sasisë së duhur për zhvillimin e proceseve organike në organizëm.

PANORAM/Ë, – A. f. Paraqitje e bukur, me një rregull të caktuar dhe sipas një parimi të të dhënave të përgjithshme të një ndryshoreje psikologjike. Panorama është paraqitje në formë të një tabloje e të dhënave të sistemuara sipas një parimi të caktuar. Shih – ***PARAQITJA GRAFIKE E TË DHËNAVE PSIKOLOGJIKE.***

PANPSIKIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga fjala greke *pan* "gjithëpërfshirës" dhe *psikos* "shpirt". Është term që i përket më tepër terminologjisë së filozofisë dhe për këtë shkak në fjalorët profesionalë psikologjikë haset rrallë. Panpsikizmi është doktrinë filozofike, sipas së cilës vetëm psikika është reale dhe jo vetëm njeriu, por e tërë bota organike dhe inorganike, është e përçuar me shpirt, me psikikë. Sipas kësaj doktrine, posaçërisht sipas psikanalizës, të gjitha format e sjelljeve të njeriut mund të shpjegohen me rolin e shtytësit seksual në zhvillimin e gjithëmbarshëm të jetës psikike. Panpsikizmi

është realiteti përfundimtar i qenësishëm. Shih – ***ANIMIZMI.***

PANSEKSUALIZ/ËM, - MI. m. Doktrinë psikologjike, e cila i atribuohet më tepër psikanalizës klasike të Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939). Sipas kësaj doktrine e tërë jeta psikike dhe sjelljet e gjithëmbarshme të njeriut, duke përfshirë edhe krijimtarinë kulturore burojnë nga shtytësi seksual dhe roli i tij në zhvillimin psikofizik të njeriut. Termi panseksualizëm haset kryesisht në përmbajtjen e atyre teksteve, që kanë karakter kritik dhe dënues ndaj psikanalizës, sipas pikëpamjes së hershme të Zigmund Frojdit (para vitit 1920).

PANTEIZ/ËM, - MI. m. Formë e botëkuptimit, sipas së cilit gjithësia është vetë Perëndia, zoti. Natyra e gjithëmbarshme me të gjitha dukuritë e saj është mishërim i Perëndisë. Objektet, dukuritë dhe të gjitha raportet e tyre të shumëllojshme janë qenie të zotit. Termi panteizëm i përket më tepër terminologjisë së teologjisë dhe asaj të filozofisë, por kuptimi i këtij termi prek në formë të posaçme edhe dukuritë e jetës psikike**.**

PANVITALIZ/ËM, - MI. m. Doktrinë e posaçme, sipas së cilës gjithësia, objektet, dukuritë dhe raportet fizike ndërmjet tyre kanë jetë, janë të përçuara me jetë, janë të gjallë. Baza gjithëpërfshirëse e qenies së tyre është jeta.

PAPËRGJEGJSH/ËM, - ME (I, E). mb. Që nuk e ka të zhvilluar fare ndjenjën e përgjegjësisë ndaj detyrës, ndaj mikut, shokut etj., që nuk di të dallojë sjelljen e drejtë, të mirë, të moralshme, të ndershme, të pëlqyeshme etj. ndaj sjelljes së keqe, të pamoralshme, të pandershme, të papëlqyeshme etj. Papërgjegjshmëria është pasojë e mospërvetësimit të sistemit të parimeve e normave morale të shoqërisë në një mjedis të caktuar, e pikërisht kjo është pasojë e zhvillimit të pamjaftueshëm dhe të duhur të ndërgjegjes.

P

PAPIL/Ë, - A. f. Term i anatomisë i ardhur nga latinishtja *papilla* "thumb, puprri"; *papilla mammae* "thumb i gjirit", *papilla duodenal* "puprri dymbëdhjetëgishtore" etj. Papila emërtohen strukturat e imëta anatomike të pjesës së brendshme të gjuhës, brenda të cilave gjenden qelizat receptore të shijes së ushqimit. Këto puprri kanë forma të ndryshme dhe secila prej tyre reagon ndaj cilësisë së veçantë të shijes.

PAPILA E NERVIT OPTIK. Puprri e formës së palcës së rrumbullakët me ngjyrë të bardhë. Kjo pllakë gjendet në fund të kokërdhokut të syrit dhe prej saj hynë në kokërdhokun e syrit nervat dhe enët e gjakut që e furnizojnë syrin me gjak. Në anatominë e syrit kjo pllakë është e njohur me termin *papilla nervi optici*.

PAPJEKURIA EMOCIONALE. Përjetim dhe reagim emocional që është karakteristik për moshën më të re, sidomos për moshën fëmijërore, në ndryshim nga ajo e moshës së pjekur të njeriut. Përjetimin dhe reagimin e papjekurisë emocionale të individit e karakterizon paaftësia e individit për t`i përjetuar dhe shprehur gjendjet emocionale, si edhe sjelljet e lidhura me to që i përkasin moshës e jo nivelit fëmijëror të këtyre gjendjeve dhe sjelljeve. Të papjekurit emocionalisht nuk janë në gjendje t`i kontrollojnë

emocionet e veta, intensiteti i reagimit emocional shprehet sipas ligjit "gjithçka – asgjë" ose "krejt – hiç" etj. Papjekuria emocionale mundet të jetë pasojë e çrregullimeve psikofizike të njeriut të rritur, pasojë e prapavajtjes ose e regresionit të sjelljeve të përgjithshme, pasojë e agresivitetit, e infantilizmit të përgjithshëm, e egocentrizmit etj.

PAQËNDRUESHMËRIA EMOCIONALE. Gjendje e paraparë e reagimit emocional, ngaqë një njeri i caktuar me labilitet emocional, i shfaq dhe i përjeton emocionet e veta në mënyra të ndryshme, zakonisht të papërshtatshme, duke mos përjashtuar edhe reagimet emocionale të skajshme.

PARADIGM/Ë, - A. f. Term me prejardhje nga greqishtja *παράδειγμα* që ka kuptimin e modelit, të shembullit të pikënisjes, sipas të cilit ndërtohet, zhvillohet një sistem idesh, një parim, ligj, teori etj., duke u marrë si shembull studimor nga të tjerët. Termi përdoret në gjuhësi, në historinë e zhvillimit të mendimit, në sociologji, filozofi etj. Në psikologji termi paradigmë përdoret për të emërtuar modelin e qasjes hulumtuese të një çështjeje ose shpjegimin e jetës psikike dhe të zhvillimit të saj etj. Në zhvillimin e mendimit psikologjik hasim këto paradigma kryesore: 1) Proceset psikike dhe sjelljet e njeriut duhet të gjurmohen sipas modelit shkak – rrjedhim ose pasojë; 2) Njeriu nuk është qenie e vetëdijshme (fillesat e zhvillimit të psikologjisë); 3) Njeriu është qenie e pavetëdijshme dhe irracionale (psikanaliza); 4) Njeriu është qenie e vetëdijshme, e mirë dhe racionale e drejtuar kah ardhmëria e tij (psikologjia humaniste).

PARADISPOZIT/Ë, - A. f. Term i biologjisë dhe i psikologjisë klasike që sot përdoret rrallë. Paradispozita është faktor i lindur që me energjinë e vet drejton zhvillimin e vetive trupore dhe të tipareve psikike në një drejtim të caktuar. Ky kuptim i përket termit biologjik paradispozitë. Në psikologji paradispozita është gatishmëria potenciale e shfaqur kryesisht në formë prirjeje për zhvillim të sjelljeve dhe të tipareve psikike të personalitetit dhe përjetime të veçanta të njeriut. E tillë mund të konsiderohet paradispozita për fatkeqësi në punë dhe ajo e reagimit negativ dhe me pakënaqësi ndaj fatkeqësive.

PARADOKS, - I m. Term i ardhur nga greqishtja *παράδοξη* "i, e papritur". Paradoski është pohim i formuluar në atë mënyrë që duket se ka elemente të përmbajtjes, me të cilat individi bie në kundërshtim me vetveten, ose me atë që dihet, me përvojën dhe me qëndrimin e argumentuar. Paradoksi në pamje të parë ka trajtën e mendimit absurd. Por, analiza e thellë e paradoksit zbulon të kundërtën, përkatësisht thelbin e një mendimi ose nivelin e lartë mendor të asaj shprehjeje paradoksale. Karakter paradoksi ka mendimi i Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) "Fëmija është baba i njeriut", që do të thotë, se jeta e fëmijës dhe përvojat e tij përcaktojnë kahen dhe zhvillimin e të rriturit. Paradokset e këtillë shkaktojnë sa ndjenjën e habisë, aq edhe pabesueshmërinë e njeriut në një pohim të tillë. Por, pas një analize të paradokseve dallohet kuptimi i nivelit më të lartë të atij paradoksi.

PARADOKSAL, - E. mb. Që ka përmbajtje të një paradoksi, që është e papritur, e pabesueshme, që i përket një paradoksi të caktuar. Sintagmat e mëposhtme janë terma togfjalëshash psikologjikë:

a. **Gjumi paradoksal** – Fazë e gjumit të njeriut që karakterizohet nga lëvizja e shpejtë e syve dhe prania e valëve trunore të fazës REM, të cilat tregojnë gjendjen e zgjuar të subjektit;

b. **Intenca paradoksale** – Formë e teknikës logoterapeutike që ka të bëjë me kërkesën e psikoterapeutit që të metën e vet ta theksojë me veprimtarinë e kundërt nga ajo që ai dëshiron. E tillë është intenca e njeriut, i cili ka frikë të dalë jashtë shtëpisë së tij natën, sepse dyshon se nuk do të kthehet gjallë; psikoterapeuti e kërkon pikërisht këtë nga pacienti i tij. Një teknikë të tillë ka zbatuar psikiatri amerikan me origjinë austriake Viktor Frankël (Viktor Frankl, 1905 – 1997);

c**. Ndijimi paradoksal i ftohtësisë** – Ndijim i ftohtësisë, pavarësisht nga fakti se ngacmuesi i lëkurës është trupi i ngrohtë prej 45 gradësh Celsius, por ky trup ngacmon qelizën receptore të ftohjes;

d. **Ndijimi paradoksal i nxehtësisë** – Përjetim i ndijimit të nxehtësisë kur lëkura ngacmohet me një trup të ftohtë, që ka temperaturën rreth 29 – 31 gradë Celsius;

e. **Synimi paradoksal** – Orvatjet që njeriu të arrijë një qëllim të caktuar, duke vepruar në të kundërtën e tij.

PARADOKSI AUBERT – FLAISHEL. Dukuri paradoksale që shfaqet kur, me rastin e vështrimit të një objekti lëvizës, lëvizja e tij duket më e ngadalësuar kur vëzhgojmë në të njëjtën kohë sfondin e objektit lëvizës. Këtë dukuri e kanë përshkruar dhe shpjeguar mjekët gjermanë Herman L. R. Aubert dhe Ernst Flaishel (Ernst Fleischl, 1846 – 1891).

PARADOKSI I FEHNERIT. Shkalla e pandryshueshmërisë së ndriçimit të një ngjyre ndryshon kur e njëjta ngjyrë shihet me një sy (shikim monokular), pas shikimit paraprak me dy sy (shikim binokular) të së njëjtës ngjyrë. Shikimi i tillë i ngjyrës shkakton ndriçim të shkallës më të lartë të asaj ngjyre, e cila në fillim është parë me dy dhe më pas shikohet me një sy. Paradoksi i këtillë u definua nga Teodor G. Fehner (Theodor G. Fechner, 1803 – 1887), mjek dhe psikolog gjerman.

PARAFAZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *παρά* "pranë" dhe *νοια* "të folur". Parafazia është dukuria e përdorimit të fjalëve të gabuara me tinguj të çuditshëm. Parafazia ka trajtën e çrregullimit të të folurit, ku gjatë të folurit zëvendësohen rrokjet brenda një fjale, zëvendësohen edhe fjalët e tëra me fjalë joadekuate etj. Ky çrregullim dhe deformim fjalësh është simptomë e afazisë Vernik, sipas zbuluesit të saj, neurologut gjerman Karl Vernike (Carl Wernicke, 1848 – 1905). Parafazia paraqet pengesë serioze për komunikim të rregullt ndërmjet bashkëbiseduesve.

PARAFILI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *para* "pranë" dhe *philia* "synim" që përmbledh forma të ndryshme të shqetësimit seksual, të shkaktuar nga ata stimuj që shoqëria i konsideron të papranueshëm nga natyra dhe mënyra e kryerjes së kënaqësisë seksuale, si dhe e kushteve dhe e rrethanave të

kryerjes së këtij akti. Parafilia emërton në kuptimin e përgjithshëm të këtij termi të gjitha format e shmangies së shtytësit e motivit seksual nga karakteri natyror i tij. Të tilla forma shmangieje janë: ekzibicionizmi, mazokizmi, pedofilia, sadizmi, nekrofilia, zoofilia etj.

PARAFORMIZ/ËM, - MI. m. Term i embriologjisë i ardhur nga latinishtja *praeformare* "i paraformuar". Doktrinë sipas së cilës të gjitha strukturat e organizmit dhe karakteristikat e tij janë të pranishme në përmasa të vogla qysh në embrion; embrioni është organizëm në miniaturë. Paraformizmi ushtroi ndikim negativ në zhvillimin e psikologjisë zhvillimore. Kuptimi bashkëkohor i paraformizmit konsideron se karakteristikat e organizmit janë të dhëna në embrion në formën e kodit gjenetik dhe se zhvillimi i organizmit ka të bëjë me rrjedhje të procesit zhvillimor sipas rendit të këtij kodi. Zhvillimi i tillë emërtohet edhe me termin paraformacionizëm.

PARAFRAZI, - A. f. Çrregullim i të folurit që ka të bëjë me përdorimin e padrejtë të shprehjes së mendimeve të njeriut gjatë të folurit të tij me të tjerët.

PARAFRENI, - A. f. Term përmbledhës për të gjitha format e çrregullimit të mendjes dhe të funksioneve të saj. Parafrenia emërton kryesisht paranojën dhe format e psikozës *demencia prekoks*. Psikiatri gjerman Emil Krepelin (Emil Kraepelin, 1856 – 1926) e ka përdorur termin parafreni për të emërtuar skizofrenin paranojak**.**

PARAGRAMATIZ/ËM, - MI. m. Shprehje e gabuar mendimesh, ndjenjash dhe veprimesh që nuk përputhet me rregullat gramatikore të një gjuhe të caktuar.

PARAGJYKIM, - I. m. Term emërtues i atij gjykimi pozitiv ose negativ i përcaktuar paraprakisht nga ana e një individi për një individ tjetër ose për të tjerët, që ka për bazë besimin dhe bindjen e gabuar, që nuk ka mbështetje në argument, në mendimin logjik dhe në përvojë. Paragjykimi zakonisht është qëndrim i rrënjosur negativ ndaj anëtarëve të një grupimi shoqëror, përkatësisht ndaj një grupi religjioz, ndaj anëtarëve të një sekti fetar, ndaj një bashkësi etnike, socio-ekonomike, racore etj. Paragjykimet shpesh bëhen sunduese në sjelljet e njeriut ndaj pjesëtarëve të atij grupimi, të cilët i paragjykon. Sjelljet e bazuara në paragjykime zakonisht janë sjellje agresive, diskriminuese dhe mospërfillëse. Në strukturën psikologjike të gjykimeve mbisundojnë ndjenjat negative, mos durimi, refuzimi i bashkëpunimit etj. me anëtarët a atij grupimi, ndaj të cilit njeriu ka paragjykim. Së bashku me ndjenjat negative paragjykimet kanë edhe komponente të tjera negative. Këto janë stereotipat e sjelljeve të njeriut. Krahas ndjenjave të fuqishme dhe stereotipave strukturën e paragjykimeve e përbëjnë edhe komponentja konotative, përkatësisht sjellja dhe veprimi i caktuar ndaj objektit të paragjykimit. Paragjykimet zhvillohen dhe formohen në bazë të të mësuarit social. Këto janë rezistuese ndaj ndryshimeve të tyre, ndryshojnë me vështirësi të mëdha, madje, edhe atëherë kur kundërargumentet janë të fuqishme. Në formimin e tyre rol të rëndësishëm luajnë mjetet e informacioneve, sidomos televizioni. Këto mjete po ashtu luajnë

rol të rëndësishëm edhe në zbutjen e asgjësimin e tyre, por ndryshojnë me vështirësi të madhe, kurse çrrënjosja e tyre është proces i gjatë, i ndërlikuar dhe gati i pamundshëm.

PARAKINEZI, - A. f. Pengesë serioze e lëvizjeve të gjymtyrëve dhe e trupit, sidomos pengesë e kryerjes së lëvizjeve delikate, të holla dhe të mirëfillta. Parakinezia paraqitet shpesh te ata që vuajnë nga forma e skizofrenisë katatonike.

PARAKOMPENSIM, – I. m. Term i psikologjisë individuale të Alfred Adlerit (Alfred Adler, 1870 – 1937) që ka të bëjë me insistimin e tepruar të një individi, jo vetëm për të kompensuar një mungesë fizike apo psikike, por edhe për ta zhvilluar atë në nivelin mbimesatar të zhvillimit, me qëllim të asgjësimit të ndjenjës së inferioritetit. Njeriu me zhvillim fizik të dobët ushtrohet më tepër për të arritur zhvillim mbimesatar të muskulaturës së tij; dikush me shkollim të kufizuar mëson ditë e natë për të mos vuajtur nga ndjenja e inferioritetit pranë të individëve të tjerë me shkollim të lartë etj. Ky është parakompensimi pozitiv. Parakompensimi negativ është largimi i plotë nga mjedisi shoqëror për të mos përjetuar ndjenjën e inferioritetit, për shkak të mungesës së një aftësie, dijeve nga njëra fushë etj.

PARALAKS/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *παράλλαξη* "ndryshim". Paralaksa është ndryshimi i të parit të një objekti kur ky shihet nga këndvështrime të ndryshme, përkatësisht nga pozicioni i lëvizjes së subjektit. Kur subjekti lëviz anash objektit që gjendet në afërsi, objekti duket se lëviz në anën e kundërt, kurse objekti që gjendet në largësi duket se lëviz krahas lëvizjes së subjektit që e percepton atë objekt. Nëse objekti shihet herë me njërin sy e herë me syrin tjetër, atëherë duket se ai është objekt i lëvizshëm.

PARALALI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *παραλαλέα*. Formë e çrregullimit të të folurit, e metë në të folur. Paralalia manifestohet në shqiptimin e gabuar të një shkronje, rrokjeje apo fjale si edhe në zëvendësimin e shqiptimit të një shkronje me shqiptimin e shkronjës tjetër, si: (g)unjëzoi në vend të (gj)unjëzoi, s(kop) në vend sh(kop), r(eth) në vend rr(eth) etj.

PARALEKSI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *παρά* "pranë" dhe *λεξη* "fjalë" që ka të bëjë me paaftësinë e leximit të qartë të fjalëve. Ai që vuan nga paraleksia i lexon në formë të deformuar fjalët e shkruara drejt, i kalon palexuar fare fjalët, sidomos nyjat, parafjalët e lidhëzat. Për këto lëshime gjatë procesit të leximit ai nuk është i vetëdijshëm. Shih – ***DISLEKCIONI.***

PARALEL, - E. mb. I ardhur nga greqishtja *παραλληλία*. Dukuri, procese etj. që gjenden njëri pranë tjetrit, që zhvillohen krahas njëri-tjetrit, që zgjaten në të njëjtin drejtim, por nuk takohen. Me këtë mbiemër janë formuar këta terma psikologjike:

a. **Forma paralele të testeve** – Dy ose tri lloj testesh me strukturë, përmbajtje dhe me qëllim e kuptim të njëjtë ose shumë të ngjashëm dhe për këtë shkak këto lloje testesh kanë vlerë, besueshmëri, objektivitet dhe ndjeshmëri shumë të afërt, kështu rezultatet e përftuara nga zbatimi i tyre nuk kanë dallim statistikor të rëndësishëm;

b. Proces paralel – Në psikologjinë e kujtesës është rrjedha e zhvillimit të mbajtjes mend, e riprodhimit dhe e përpunimit të informacioneve. Akti i vendosjes dhe i transformimit të informacioneve të kujtesës zhvillohet paralelisht ose në formë serike. Shih – ***KUJTESA.***

PARALELIZ/ËM, - MI. m. Mënyra, procese, veprime etj. që kryhen krahas njëra-tjetrës, në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin drejtim, duke pasur raport të caktuar ndërmjet tyre. Në terminologjinë e psikologjisë dallohen këto sintagma me termin paralelizëm:

a. Paralelizmi biogjenetik – Proces i ngjashëm i zhvillimit individual me atë të zhvillimit të përgjithshëm të një llojit të caktuar të qenieve të gjalla (Ernest Hekël – Ernest Haeckel, Stenli Hol – Hall Stanley);

b. Paralelizmi psikofizik – Rrjedhje paralele e sistemeve të proceseve psikike me sistemet e proceseve neurofiziologjike. Secili prej këtyre sistemeve ka rrjedhat e veta specifike dhe paraqet ndryshore të pavarura njëra nga tjetra, por ka karakter rrjedhash të koordinuara. Paralelizmi psikofizik konsiderohet doktrinë e përgjithshme e psikologjisë, që është përpjekur të shpjegojë raportin shpirt-trup. Sipas kësaj doktrine të fundshekullit të nëntëmbëdhjetë sistemi i proceseve psikike ka si korrespondues sistemin e proceseve neurofiziologjike dhe, përkundrazi, sistemi i proceseve neurofiziologjike ka korrespondent të vetin sistemin e proceseve psikike, por këto dy procese paralele rrjedhin pavarësisht njëri nga tjetri. Këtë e ka formuluar filozofi gjerman Gotfrid V. Lajbnic (Gottfried W. Leibniz, 1646 – 1718). Kësaj doktrine i përkasin edhe studiuesit gjermanë të psikologjisë Teodor Fehner (Theodor Fechner, 1801 – 1887) dhe Ernst Veber (Ernst Weber, 1795 – 1878).

c. Paralelizmi psikonervor – Formë e posaçme e paralelizmit psikofizik. Sipas paralelizmit psikonervor dukuritë psikike dhe proceset e tyre kanë rrjedha të posaçme, si dhe dukuritë nervore dhe proceset e tyre. Për dukuritë psikike dhe proceset e tyre ekziston një veprimtari nervore e posaçme. Kësaj pikëpamjeje i përkasin fiziologët e psikologët Herman Helmholc (Hermann Helmholtz, 1821 – 1894) dhe Vilhelm Vunt (Wilhelm Wundt (1832 – 1920).

PARALELOGRAMI SANDER. Formë e iluzionit pamor që ka të bëjë me perceptimin e diagonaleve me gjatësi reale të njëjtë, por që diagonalja e paralelogramit më të vogël duket më e vogël se diagonalja me gjatësi të njëjtë e paralelogramit të madh. Këtë e ilustron figura e mëposhtme:



Largësia e diagonales AX është e njëjtë me largësinë e diagonales AY, por syri i njeriut këtë nuk e dallon.

Iluzioni i këtillë u emërtua iluzion i Sanderit, sipas studimit të publikuar më 1926 nga psikologu gjerman Fridrih Sander (Friedrich Sander, 1889 – 1971). Përmendet edhe me emërtimin iluzion i Lukisit, e pikërisht nga Mateu Lukis (Mathew Luckish, 1883 – 1967).

PARALINGUISTIK/Ë, - A. f. Term me origjinë nga greqishtja *para* "pranë" dhe nga latinishtja *lingua* "gjuhë". Paralinguistika merret me gjurmimin e atyre shenjave komunikuese ndërmjet njerëzve që i përkasin zërit, tempit të të folurit, theksimit të fjalëve, pauzave gjatë të folurit etj. Këto shenja i përkasin komunikimit jofjalësor. Kësaj disiplinë shkencore i interesojnë mënyrat e komunikimit, si shprehen mendimet, ndjenjat etj., por jo edhe çfarë është ana morfologjike, leksikore e sintaksore e një gjuhe të caktuar. Shenjat e paralinguistikës i përkasin anës ekspresive të të folurit dhe i kontribuojnë të kuptuarit e plotë të asaj që kumtohet. Fjala "zjarr" ka theksim tjetër kur përmendet "zjarri shkatërrues i një ndërtese" dhe e njëjta fjalë ka tjetër kuptim dhe formë tjetër theksimi, kur urdhërohet "zjarr" në shërbimin ushtarak.

PARALIZ/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *παράλνση "shtangim*, humbje e aftësisë së lëvizjes" që emërton zakonisht humbjen e aftësisë së kryerjes së veprimeve të vullnetshme të njeriut. Paraliza shfaqet në disa forma: paraliza e gjithë trupit (diplegji), paraliza e njërës anë të trupit (hemiplegji), paraliza e njërës gjymtyrë të trupit të njeriut (monoplegji) etj. Paraliza shkaktohet nga dëmtimi i disa strukturave të trurit, nga proceset patologjike të trurit, nga atrofia e muskujve dhe nga dëmtimi i rrugëve eferente nervore. Rezultatet e gjurmimeve më të reja tregojnë se paraliza është pasojë e dëmtimit të pjesëve të larta të neuromave motorike. Në raste të tilla njeriu humb kontrollin e lëvizjes së muskujve. Por, kur dëmtohen pjesët e poshtme të neuroneve motorike, atëherë kemi të bëjmë me humbjen e aftësisë së lëvizjeve të veprimeve të vullnetshme të njeriut.

PARALIZA PROGRESIVE. Atrofizim i qelizave të indeve nervore, pasojë e infektimit të sifilizit që godet qendrat e rëndësishme të cipës ose kores së trurit të madh, me pasoja të rënda çrregulluese të proceseve mendore të të folurit, të kujtesës dhe që shoqërohet me çrregullime të reagimeve refleksive. Procesi i paralizës progresive mund të ndalohet me anën e antibiotikëve, por funksionet e goditura nga kjo formë e paralizës nuk kanë mundësi të kthehen në gjendje normale.

PARAMET/ËR – RI. m. Term i statistikës dhe i matematikës. Në psikometrinë parametrike është një vlerë e caktuar e të gjithë anëtarëve të një popullate, karakteristikë e të gjithë anëtarëve të asaj popullate (vlera e së mesmes aritmetike, e shmangies standarde, koeficienti i korrelacionit). Kjo vlerë ndryshon nga vlera dhe nga karakteristika e anëtarëve të një modeli të caktuar, të përzgjedhur nga populata provuese.

PARAMIMI, - A. f. Formë e çrregullimit të koordinimit të lëvizjeve të pjesëve të trupit dhe të përjetimit të një gjendjeje emocionale. Në rastin e paramimisë gjestet e njeriut nuk përputhen me disa ndryshime fiziologjike, që shprehin mendimin ose gjendjen e caktuar emocionale të tij. Në rastet e këtilla ndryshimet e lëvizjes së muskujve, të ngjyrës së lëkurës së fytyrës, të folurit etj. nuk koordinojnë me ndryshimet e lëvizjes së trupit të atij njeriu dhe këto ndryshime

nuk përputhen me përjetimin e një gjendjeje të caktuar emocionale.

PARAMNEZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *παρά* "kundër" dhe *mnesis* "kujtesë". Paramnezia është formë e kujtesës së çrregulluar që emërton dukurinë e pohimit të një individi që ka përjetuar ndodhi, ngjarje etj., të cilat në të vërtetë nuk i ka përjetuar dhe disa prej tyre as që ka qenë e mundur t`i përjetojë. Paramnezi do të thotë kujtim i gabuar ose iluzion i ndodhive dhe i ngjarjeve të pa përjetuara. Këtë përzierje kujtimesh individi në gjendje paramnezike e përjeton duke mos qenë i sigurt nëse ajo çka kujton ka qenë ëndërr apo kujtim i vërtetë.

PARANDIJIM, - I. m. Dukuri e rrallë parapsikologjike, e cila ka të bëjë me përjetimin e besimit të njeriut në një ndijim që nuk mbështetet në kushte empirike.

PARANDJENJ/Ë, - A. f. Përjetim i besimit të individit në frikën, pikëllimin, zemërimin etj. që do të vijë duke mos pasur shkak as shkas objektiv për një përjetim të tillë. Parandjenja i përket grupit të dukurive parapsikologjike.

PARANOJ/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *παρά* "pranë" dhe *νοια* "mendje", *παράνοια* "çmenduri". Termi paranojë i përket terminologjisë së psikiatrisë dhe emërton atë formë të çrregullimit funksional psikik, që ka të bëjë me përjetimin e ideve sumanute, përkatësisht me ide të ngulitura të përndjekjes së njeriut nga të tjerët, të armiqësisë ndaj tij, të përjetimit të madhështisë së paqenë, të xhelozisë së tepruar, të persekutimeve të ndryshme që vetëm ai i njeh. Idetë e këtilla janë gati të pamundura të ndryshojnë përballë argumenteve të padiskutueshme. Te ata që vuajnë nga paranoja struktura kognitive, funksioni i proceseve intelektuale dhe koherenca e përmbajtjes së mendimeve është ruajtur, nuk është rrënuar, por ai ka një grumbulli idesh sumanute të ndërlidhura në formë të "nyjave", të ngulitura dhe po qe se ngacmohet ndonjëra nga idetë e kësaj "nyje", atëherë te individi paranojak fillojnë të shfaqen përjetime dhe sjellje të çuditshme në mënyrën e të menduarit dhe në sjelljet e tij. Kuptimin e termit paranojë e ka përkufizuar drejt psikiatri gjerman Emil Krapelin (Emil Kraepelin (1856–1926), sipas të cilit: "Paranojën e karakterizon zhvillimi i sistemit të ngadalshëm dhe të fshehtë sumanut, i përhershëm dhe i pamundshëm për ta rrëzuar, por edhe ruajtja e qartësisë dhe e rendit të mendimeve, të vullnetit dhe të veprimeve".

PARANOJAK, - E. mb. Që karakterizon njeriun te i cili paraqiten çrregullime sistematike në përmbajtjen, në mënyrën dhe në lidhjen e mendimeve për përndjekësit, armiqtë, persekutuesit etj. që vetëm ai njeh. Këta e pengojnë individin paranojak që të shfaqë madhështinë, mendimet e rëndësishme dhe të mprehta që vetëm ai është në gjendje t`i përcaktojë. Me mbiemrin paranojak janë formuar këto sintagma terminologjike:

a. **Ankthi paranojak** – Frikë e paarsyeshme me kohëzgjatje të qëndrueshme nga armiqtë dhe përndjekësit e supozuar të një individi paranojak. Ky term haset më tepër në literaturën psikanalitike, ku ankthi paranojak ka të bëjë me synimet e shtypura ose të ndrydhura homoseksuale;

b. **Gjendja paranojake** – Formë akute e çrregullimeve paranojake, që zakonisht kalon shpejt. Gjendja paranojake shfaqet me kërkesën për ndryshimin e punës, të vendit të punës, të kushteve të jetesës etj. Kjo gjendje manifestohet më shpesh te të rinjtë, të cilët largohen nga shtëpia e tyre, te të arratisurit, te emigrantët etj.;

c. **Çrregullimi paranojak i personalitetit** – Gjendje e skajshme paranojake, që shfaqet me ankesa, me ndjeshmëri të tepruar ndaj atyre individëve që ngacmojnë atë individ, me dyshimin se ai do të sulmohet shpejt nga individët e tjerë që vetëm ai i njeh etj. Personaliteti paranojak ka tiparet e paranojës, ku mbisundojnë tipari i pabesueshmërisë ndaj njerëzve, qëndrueshmëria e ideve të madhështisë, mbindjeshmëria ndaj ankesave dhe ndaj kundërargumenteve, xhelozia e tepruar etj.

d. **Skizofrenia paranojake** – Formë e çmendurisë rinore e theksuar posaçërisht nga psikiatri gjerman Emil Krepelin (Emil Kraepelin, 1856 – 1926) dhe nga psikiatri zviceran Eugen Blojler (Eugen Bleuer, 1857 – 1939). Skizofrenia paranojake te një individ është lloj psikoze, që shfaqet me këto simptoma kryesore: ide fikse të përndjekjes, të drejtimit të mendimeve të tij nga një individ tjetër, me tipare të mendimit autist etj. Ai që vuan nga psikoza skizofrenike nuk ka sistem koherent të mendimeve dhe të të folurit, shpesh idetë e tij shoqërohen me sulme agresive ndaj atyre, të cilët ai mendon se e përndjekin, e torturojnë dhe i imponojnë mendimet dhe qëndrimet e tij.

PARANORMAL, - E. mb. Që ka të bëjë me atë që është jashtë kufirit të normales, jashtë zhvillimit normal të proceseve psikike, të rrjedhës, të brendisë dhe të koordinimit të tyre dhe të sjelljeve normale të njeriut, që i përket fushës zhvillimore jashtë rregullsive, parimeve, ligjeve zhvillimore të jetës psikike, që ka të bëjë me ato zhvillime që i përkasin fushës jashtëshkakore. Të tilla janë: telekinezia, perceptimi jashtëshqisor, telepatia etj.

PARAPLEGJI, - A. f. Term me prejardhje nga greqishtja që shpreh paralizën e gjymtyrëve të poshtme (të këmbëve) të trupit të njeriut. Paraplegjia shkaktohet nga dëmtimi i strukturës organike të qendrave të caktuara të trurit ose nga çrregullimi i funksionit të tyre.

PARAPRAKSI, - A. f. Gabime të vogla në lëvizjen e gishtërinjve të dorës, në zhvillimin e shkathtësive të dorës e të gishtërinjve të saj, në rrokjen e objekteve, në procesin e të shkruarit, në të folur, në kujtim të informacioneve etj. Sipas Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) gabimet e tilla janë rezultat i ndikimit të dëshirave të pavetëdijshme ose i konflikteve të brendshme të njeriut.

PARAPSIKOLOGJI, - A. f. Fushë kufizuese në psikologji, që merret me studimin e dukurive psikike që zhvillohen pranë dhe jashtë psikologjisë, pra që zhvillohen jashtë rregullave, parimeve dhe ligjeve të zhvillimit të jetës psikike të njeriut dhe të dukurive psikike paranormale. Dukuritë hulumtuese të parapsikologjisë janë dukuritë paranormale, të cilat ndahen në dy grupe: 1) Dukuri parapsikologjike fizike (telekinezia, materializimi i disa mendimeve abstrakte, përkatësisht vënia në lëvizje e trupave sipas

dëshirës e vullnetit të njeriut) dhe 2) Dukuri parapsikologjike kognitive (perceptimi jashtëshqisor i trupave, të vrojtuarit e panoramës të së kaluarës të një individi ose të vrojtuarit e panoramës të së ardhmes së tij etj.) Disa studiues konsiderojnë se parapsikologjia mund të përcaktohet si degë e veçantë e psikologjisë, ose që tashmë troket në derën e psikologjisë shkencore. Interesimi për njohjen e këtyre dukurive dhe shpjegimin e tyre është i madh, madje sot këto dukuri emërtohen "Pas dukuri". Por, argumentimi i tyre është i dyshimtë për shumë studiues dhe për këtë shkak ekziston një skepticizëm i theksuar për njohjen e bazës ligjore të dukurive psikike paranormale. Ky skepticizëm mbështetet në këto argumente: përsëritja e dukurive paranormale has në vështirësi nga ana e subjekteve, rezultatet eksperimentale të hulumtimit të disa dukurive paranormale kanë dhënë rezultate të ndryshme, nuk është dalluar mekanizmi psikik që mbështet dukuritë paranormale dhe zhvillimin e tyre, deri tani nuk ekziston teoria e shpjegimit të dukurive paranormale etj. Megjithëkëtë, psikologjia ka për detyrë që t`i shpjegojë këto dukuri.

Burimet:

V. N. Pushkin & A. P. Dubrov: *"Parapsihologija i Sovremenioe Estestvoznanie"* – (*"Parapsikologjia dhe psikologjia eksperimentale"*), Moskva, 1967.

PARAQITJA GRAFIKE E NGJYRAVE. Ngjyrat dhe cilësitë e tyre konkretizohen me paraqitjen e tyre në formë të piramidës së dyfishuar boshtore. Në këtë piramidë secila ngjyrë zë vendin e vet sipas ngopjes, ndriçimit dhe nuancave kombinuese të saj. Këtë e dallojmë në figurën e mëposhtme:



PARAQITJA GRAFIKE E TË DHËNAVE PSIKOLOGJIKE. Formë e konkretizimit të të dhënave statistikore, të raporteve ndërmjet tyre, të rrjedhës etj. Paraqitja grafike e këtyre të dhënave bëhet me anë të tabelave të veçanta. Në këto tabela regjistrohen të dhënat psikologjike, përkatësisht rezultatet numerike në një tërësi radhësh horizontale dhe shtyllash vertikale. Shih – ***PASQYRA E TË DHËNAVE STATISTIKORE.***

PARASOMNI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *παρά* "pranë" dhe *σομνος* "gjumë" që nënkupton formën e çrregullimit të gjumit, që shfaqet me lëvizje gjatë të fjeturit, me ecje duke fjetur, me të folur gjatë fjetjes, me frikën e natës, me kërcitje të dhëmbëve gjatë fjetjes etj. Çrregullimet e tilla janë të lidhura me disa çrregullime të sistemit nervor autonom.

PARASHIKIM, - I. m. Përcaktim mendor i asaj që do të ngjasë në të ardhmen, i pasojave të rrjedhës së një dukurie, i ndryshimeve të mundshme të një procesi, i drejtimit të zhvillimit

të një procesi të caktuar etj. Me anën e parashikimit njeriu orvatet t'i paraprijë asaj që do të ndodhë në kushte dhe në raporte të caktuara. Vlera e parashikimit është e kushtëzuar së paku nga tri faktorë: nga aftësia e individit, nga njohja e saktë e gjendjes së tashme të një dukurie, situate etj. dhe nga njohja e saktë e parimeve dhe e ligjeve të zhvillimit të dukurive të një fushëveprimi të caktuar në një disiplinë shkencore.

PARATIROID. Shih – ***GJËNDRA PARATIROIDE***.

PARAZITIZ/ËM, - MI. m. Mënyrë jetese e organizmit në kurriz të tjetrit, por pa i shkaktuar dëm dhe duke mos e eliminuar atë.

PARCIAL, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *partialis* "i pjesshëm".

PARESTEZI, - A. f. Lloj halucinacioni që ka të bëjë me çrregullimin e ndjeshmërisë së organeve të brendshme të njeriut. Parestezia shfaqet me përjetimin e të prekurit dhe të temperaturës së rritur të organeve të brendshme, ndërkaq receptorët e këtyre ndijimeve nuk janë ngacmuar dhe nuk kanë funksionuar.

PAREZ/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *paresis* "dobësim". Pareza emërton pamundësinë e pjesshme të realizimit të veprimeve të vullnetshme të njeriut. Te pareza dobësohet fuqia motorike e një ose e dy gjymtyrëve, e shoqëruar me ngadalësim të ritmit të lëvizjeve. Pareza është pasojë e dëmtimit të disa pjesëve të Sistemit Nervor Qendror, sidomos e dobësimit funksional të fijeve nervore të këtij sistemi, që lidhin qendrat e Sistemit Nervor Qendror me muskuj, përkatësisht me muskulin e gjymtyrës së caktuar.

PARIETAL, - E. mb. Term i anatomisë i ardhur në shqipe nga latinishtja *parietalis* "parietal" që përcakton muret ndarëse të ndonjë organi ose të ndonjë zgavre të organizmit. Me këtë kuptim cilësohen eshtrat murore të kafkës në mesin e secilës anë të kafkës, që shtrihen ndërmjet eshtrave të pjesës zverkore dhe atyre ballore.

PARIM, - I. m. Mendim i përgjithshëm themelor për raportet esenciale, që nxirret nga studimi i një fushe të caktuar të objekteve, të dukurive dhe të raporteve ndërmjet tyre. Një mendim i tillë ka vlerë fondamentale për atë fushë raportesh esenciale të objekteve, të dukurive, të proceseve etj. Psikologjia është më tepër disiplinë shkencore e rregullave të përgjithshme, përkatësisht e parimeve, se sa disiplinë ligjesh e teorish. Përmbajtja e lëndës së psikologjisë mbështetet në parimet psikologjike, të nxjerra nga rezultatet hulumtuese të proceseve, të gjendjeve dhe të tipareve psikologjike, si edhe të raporteve thelbësore ndërmjet tyre. Parimet më të njohura janë parimet e përgjithshme të psikologjisë, parimet e psikologjisë zhvillimore, parimet e psikologjisë geshtaltiste.

PARIMET E ORGANIZIMIT TË PERCEPTIMEVE. Parime shpjeguese të perceptimeve të konceptuara në psikologjinë geshtaltiste. Sipas parimeve të psikologjisë geshtaltiste organizimi perceptues i objekteve, proceseve dhe situatave ka karakter të njëjtë për të gjithë njerëzit, përkatësisht ka karakter të përgjithshëm. Parimi themelor i psikologjisë geshtaltiste ka të bëjë me pohimin se tërësia gjithmonë është cilësi e veçantë që nuk formohet

nga pjesët përbërëse të saj dhe as nga raportet e këtyre pjesëve. Kjo cilësi quhej "geshtalt", shih – ***PSIKOLOGJIA GESHTALTISTE.*** Në kuadër të këtij parimi themelor geshtaltistët kishin zbërthyer edhe këto parime organizuese të perceptimeve (në literaturën e psikologjisë këto parime shpesh emërtohen me termin ligje):

a. **Parimi i afërsisë** – Prirja e organizmit të njeriut që ngacmuesit e afërt njëri me tjetrin të perceptohen si tërësi. Këtë e ilustron figura e mëposhtme:



b. **Parimi i fatit të përbashkët** – Perceptimi më i lehtë dhe më i shpejtë i tërësive të ngacmuesve që kanë drejtim të njëjtë. Këtë e ilustron figura e mëposhtme:



c. **Parimi i formës së mirë** – Perceptimi i ngacmuesve simetrikë është më i lehtë dhe më i shpejtë, sepse formojnë figura të qëndrueshme, kanë formë të mirë, sikurse shihet në figurën e mëposhtme.



d. **Parimi i izomorfizmit** – Parim themelor i psikologjisë së perceptimit. Sipas këtij parimi perceptimi mbështetet në njëjtësimin strukturor të proceseve neurofiziologjike me ato të përvojës së njeriut. Perceptimi për dukurinë, objektin, procesin etj. formësohet sipas ligjeve të njëjta të zhvillimit dhe të organizimit të proceseve nervore në trurin e njeriut;

e. **Parimi i ngjashmërisë** – Ngacmuesit e ngjashëm grupohen në tërësi të veçantë dhe për këtë shkak njeriu këta i percepton si tërësi të posaçme, siç shihet më poshtë:



f. **Parimi i përmbylljes së ngacmuesve** – Prirje e organizmit të njeriut që edhe figurat e mangëta t'i perceptojë si tërësi e veçantë. Ky parim dallohet në figurën e mëposhtme:



Burimet*:*

Wolfgang Köhler: *"Gestalt Psychology - An Introduction to New Concepts in Modern Psychology" - ("Psikologjia geshtaltiste. Hyrje në konceptet e reja të psikologjisë moderne",* Mentor Books, 1965.

Spencer A. Rathus: *"Essentials of Psychology"* – (*"Psikologjia esenciale)"*, (fifth edition), Harcourt Brace College Puvlishers, 1988.

Charles G. Morris, Albert A. Maisto: "*Psikologjia – shkenca e proceseve mendore dhe e sjelljes njerëzore"*, Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë, 2008, fq. 113 – 117.

PARIMET E PËRGJITHSHME TË PROCESEVE PSIKIKE DHE TË SJELLJEVE. Përgjithësime mbi proceset psikike dhe sjelljet që i përkasin psikologjisë së përgjithshme. Pjesë përbërëse e tyre janë:

a. **Parimi i aktivizimit të përgjithshëm të trurit** – Parim që shpjegon angazhimin e shumë qelizave të cipës apo kores së trurit në zhvillimin e proceseve dhe të sjelljeve të ndërlikuara të njeriut. Këtë parim e kishte formuluar fiziologu dhe psikologu amerikan Karl S. Leshli (Karl S. Leshley, 1890 – 1958). Sipas tij, cipa apo korja e trurit të madh funksionon si sistem i tërësishëm në zhvillimin e proceseve dhe të sjelljeve të ndërlikuara, përkatësisht zhvillimi i proceseve psikike dhe i sjelljeve të ndërlikuara nuk është i lidhur dhe as i lokalizuar vetëm me një qendër të cipës së trurit, por me funksionimin e shumë indeve dhe qelizave nervore të kësaj cipe;

b. **Parimi i diferencimit dhe i integrimit** – Prirja e zhvillimit të strukturave organike dhe funksioneve të tyre nga ato më të përgjithshme, kah ato të veçanta dhe të specializuara, që njëkohësisht integrohen në tërësi sjelljesh të nivelit më të lartë gjatë zhvillimit dhe formimit të personalitetit. Kjo prirje dallohet në zhvillimin emocional (nga reagimi shqetësues emocional i foshnjës kah zhvillimi i kënaqësisë e pakënaqësisë, i frikës, i dashurisë etj.);

c. **Parimi i homeostazës** – Prirja zhvillimore vetërregulluese që fillon nga ndryshimi negativ i gjendjes së organizmit, që vë në veprim mekanizmat filologjikë me funksionimin e të cilave organizmi kthehet në gjendjen e mëparshme. Uria vë në veprim mekanizmin e plotësimit të këtij motivi për ta kthyer organizmin në gjendjen e mëparshme të urisë;

d. **Parimi i konservimit** – Emërtim i konceptit, sipas të cilit sasia e një substance nuk ndryshon, pavarësisht nga ndryshimi i formës dhe i shtrirjes së saj;

e. **Parimi i konkretizimit** – Prirja e zhvillimit dhe e organizimit të sjelljeve vetëm në bazë të kushteve, të rrethanave dhe të raporteve aktuale objektive, e jo në mbështetjeje të asaj çfarë do të vijë në të ardhmen. Këtë parim e ka përcaktuar Kurt Levini (Kurt Lewin, 1890 – 1947);

f. **Parimi i kursimit** – Prirja e organizmit që ai të përcaktohet për atë lloj sjelljeje që kërkon angazhim sa më të paktë të energjisë psikike dhe që është sa më i thjeshtë;

g. **Parimi i lokalizimit të funksioneve psikike** – Parim klasik i psikologjisë, sipas të cilit formave të ndryshme të jetës psikike të njeriut dhe të sjelljeve të tij u përgjigjen qendrat e caktuara të trurit të njeriut. Dëmtimi i strukturave qelizore të njërës qendër të trurit shkakton çrregullimin e funksionit të caktuar psikik dhe të formës së posaçme të sjelljes së njeriut. Rezultatet e hulumtimeve eksperimentale në fushën e fiziologjisë eksperimentale treguan se një parim i tillë nuk mund të argumentohet, sidomos për funksionet e larta psikike;

h. **Parimi parsimonie** – Synimi i njeriut për t`i dhënë përparësi shpjegimit më të thjeshtë të një dukurie, kur për këtë dukuri ekzistojnë dy teori;

i. **Parimi i përforcimit** – Prirja e zhvillimit të formave të reja të sjelljeve në bazë të përforcimit të tyre

me shpërblim të atyre reagimeve që ishin të dobishme, që çonin kafshën në qëllimin e caktuar, pra, duke mos shpërblyer reagimet që nuk çonin në atë qëllim. Ky parim ka qenë i theksuar sidomos nga ana e psikologut bihejviorist amerikan Barus F. Skiner (Burrhus F. Skinner, 1904–1990);

j. **Parimi i rendit të përhershëm të zhvillimit të organizmit** – Prirje e zhvillimit të organizmit sipas një rendi të përhershëm dhe të pandryshueshëm të tij, thuajse ky rend është i përcaktuar gjenetikisht. Sipas këtij parimi nëse fëmija kishte arritur zhvillimin intelektual të fazës së operacioneve formale ai i ka kaluar fazat paraprake, pra fazën e zhvillimit intelektual paraoperacional dhe atë konkret etj. Këtu fjala është për fazat e zhvillimit intelektual të psikologut zviceran Zhan Pijazhes (Jean Piaget, 1896 – 1980).

PARIMET E PSIKANALIZËS. Përgjithësime të mendimit psikanalitik të Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1857-1939), të tilla si:

a. **Parimi i aktualitetit** – Shpjegim i sjelljeve të njeriut të lidhura me kohën dhe me kushtet aktuale të shfaqjes së tyre. Parimi i aktualitetit është përcaktuar si parim hulumtues i sjelljeve nga ana e psikologes amerikane me origjinë gjermane Karen Hornei (Karen Horney, 1883 – 1952) që i përket neopsikanalizës. Sipas saj përvojat e kaluara të njeriut kanë rëndësi për njohjen dhe shpjegimin e sjelljeve të caktuara vetëm në atë masë sa janë të pranishme në mendjen e njeriut në çastin e shfaqjes së një sjelljeje të caktuar;

b. **Parimi i kënaqësisë/i pakënaqësisë së shtytësve** – Parim i psikanalizës së Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939). Sipas këtij parimi energjia psikike e njeriut është e drejtuar kah kënaqësisë, në bazë të plotësimit të shtytësve (në rend të parë të shtytësit seksual) dhe largimit nga pakënaqësia dhe tensioni psikik, për shkak të mosplotësimit të kërkesës së shtytësve, sidomos të shtytësit seksual. Zigmund Frojdi këtë parim e ka konsideruar parim themelor të zhvillimit të jetës psikike;

c. **Parimi i realitetit** – Parim bazë i psikanalizës, sipas të cilit egoja dhe impulset e egos së njeriut orvaten të gjejnë mënyra të plotësimit të shtytësve ose të ngasësve të idit, por që janë të pranishme për mjedisin real shoqëror të njeriut.

Burimet:

Sigmund Freud: *"Uber psychoanalyse"* – (*"Mbi psikanalizën"),* Clark University Press, 1909.
Zigmund Frojd: *"Pesë leksione mbi psikanalizën",* Tiranë, 2004.

PARIMET E PSIKOLOGJISË GESHTALTISTE. Shih **– *PSIKOLOGJIA GESHTALTISTE.***

PARIMET E PSIKOLOGJISË ZHVILLIMORE. Përgjithësime në formë parimesh mbi zhvillimin fizik e psikik të fëmijëve, ndër të cilat hasen:

a. **Parimi alternativ i zhvillimit** – Prirje e përgjithshme e zhvillimit psikik, sipas së cilës intensiteti dhe ritmi i zhvillimit fizik e psikik zëvendësohet njëri nga tjetri. Kështu, përparimi i fëmijës në procesin e të folurit zëvendëson ngadalësimin ose ngecjen e tij në procesin e të ecurit;

b. **Parimi cefalokaudal i zhvillimit** - Zhvillimi i embrionit dhe i foshnjës nga koka në drejtim të këmbëve. Sipas këtij parimi zhvillimi fizik i embrionit

ecën nga koka,në trup dhe përfundon në këmbë; ndjeshmëria e shqisave fillon nga buzët e syri në drejtim të duarve dhe përfundon me zhvillimin e këmbëve etj.;

c. **Parimi i zhvillimit hove-hove** – Prirja e zhvillimit të disa proceseve dhe sjelljeve jo me ritëm të njëjtë, por me ritëm të ngadalësuar për një fazë zhvillimi dhe me një ritëm të përshpejtuar në fazën tjetër, derisa zhvillimi i atij procesi apo asaj forme të sjelljes të mos stabilizohet;

d. **Parimi proksimodistal** – Prirja zhvillimore sensomotorike e organizmit të foshnjës nga qendra trupore në pjesët periferike të organizmit, përkatësisht nga koka e trupi dhe më pas zhvillimi kah duart e këmbët dhe më në fund zhvillimi i gishtërinjve.

PARIMET E SHOQËRIMIT TË PËRFYTYRIMEVE. Orvatje shpjegimesh të shoqërimit apo të lidhjes së përfytyrimeve. Shpjegimi i shoqërimit apo i lidhjes ndërmjet tyre bëhet sipas këtyre parimeve, që në tekstet psikologjike shpesh quhen edhe ligje:

1) Parimi i fqinjësisë – Lidhja ndërmjet dy përfytyrimeve që përftohet ngaqë objektet e tyre janë perceptuar në të njëjtën kohë ose në të njëjtin objekt, ose njëri pas tjetrit (përfytyrimi i violinistit tërheq paraqitjen e përfytyrimit të violinës së tij).

2) Parimi i ngjashmërisë – Lidhja ndërmjet dy përfytyrimeve që përftohet ngaqë ato kanë ngjashmëri ndërmjet tyre (portreti i njeriut zgjon përfytyrimin e vetë njeriut).

3) Parimi i kontrastit – Një përfytyrim shoqërohet me një përfytyrim tjetër, ngaqë ato kanë karakteristika të kundërta (përfytyrimi i njeriut të shëmtuar zgjon përfytyrimin e njeriut të bukur dhe të dy shoqërohen njëri me tjetrin).

4) Parimi i kauzalitetit – I ardhur nga latinishtja *causa* "shkak", perceptimi i shkakut dhe i efektit të tij është faktor i lidhjes së përfytyrimit të shkakut dhe të rrjedhimit, gjegjësisht i shoqërimit të dy përfytyrimeve ndërmjet tyre. (Përfytyrimi i qiriit të ndezur në dhomën e errët zgjon përfytyrimin e shkrepëses, me të cilën është ndezur qiriri). Parimi i kauzalitetit është parim i konstatuar nga Ivan Pavllovi, kurse tri të parat janë parime të vendosura qysh nga Aristoteli.

PARIMI FILOGJENETIK. Parimi i njohur në sistemin e koncepteve të evolucionit dhe në psikologjinë zhvillimore. Sipas këtij parimi "Ontogjeneza është rikapitullim i filogjenezës" që ka kuptimin: "Individi gjatë zhvillimit të tij përsërit parahistorinë e paraardhësve të llojit të tij". Përgjithësues i mendimit të tillë për parimin filogjenetik ka qenë biologu - evolucionist Stenli Hol (Stanley Hall, 1844 – 1924)). Këtij përgjithësimi i kanë dhënë edhe përmasat e doktrinës, pra, të teorisë dhe, rrjedhimisht, e kanë emërtuar teoria e rekapitullimit, me anën e saj biologjike dhe psikologjike. Ana biologjike ka të bëjë me zhvillimin e qenieve, sidomos në fazën embrionale sipas këtij parimi, kurse ana psikologjike ka të bëjë, në rend të parë, me zhvillimin e perceptimit dhe të proceseve të tjera kognitive. Por, parimi filogjenetik përmendet më tepër si metodë hulumtuese në psikologjinë zhvillimore dhe në biologji. Rezultatet e kufizuara në hulumtimet psikologjike e kanë bërë të njohur më tepër si përgjithësim me vlerë të metodës gjurmuese.

PARIMI I REALITETIT. Parim që në psikanalizë ka kuptimin e njohjes graduale nga ana e fëmijës të asaj që është reale, mjedisit fizik, biologjik e shoqëror dhe zhvillimin e vetëdijes së tij për t`iu përgjigjur kërkesave dhe nevojave të këtij mjedisi dhe formimin e egos së lidhur me këtë mjedis.

PARIMOR, - E. mb. Që mbështetet në parime. Parimor është individi që mendimet, qëndrimet dhe sjelljet i zhvillon, i organizon dhe i realizon sipas parimeve të caktuara morale, duke iu përmbajtur vazhdimisht këtyre parimeve. Sjelljet e tilla janë tipare të karakterit dhe të personalitetit atëherë, kur këto marrin karakter konstant, përkatësisht kur dihet se njeriu parimor i ndodhur në kushte të caktuara dhe në situata të veçanta do të reagojë sipas parimeve të tij.

PARIT (TË). asnj. Formë ndijimore normale e dallimit të dukurive, të objekteve dhe të cilësive të tyre, që ka të bëjë me dritën dhe me rrezet e saj ngacmuese të syrit, kur këto kanë gjatësi valësh prej rreth 380 – 700 milimikronësh. Një formë e tillë shkakton ndijimin dhe perceptimin e dukurive, të objekteve dhe të situatave reale të mjedisit që na rrethon. Me anë të të parit përftohen të dhëna dhe informacione të shumta, që mundësojnë vendndodhjen e njeriut në mjedisin ku ai gjendet. Këto të dhëna dhe informacione përpunohen në qendrat parësore dhe dytësore të të parit, që gjenden në pjesën zverkore të cipës, apo kores së trurit të madh. Të parit mundëson njohjen e sasisë së dritës që reflekton një trup, ndryshimet e sasisë së dritës të një mjedisi, njohjen e formës dhe të madhësisë së objekteve, si edhe ndryshimet e tyre, të vendndodhjes dhe të lëvizjes së objekteve etj. Pohohet se deri 90 % të informacioneve për botën që na rrethon përftohen nga të parit, duke i mundësuar njeriut sjelljet e duhura në një hapësirë të caktuar.

PARIT VERBOR (TË). Term i patologjisë që emërton sjelljen pamore të njeriut të organizuar sipas figurës së objekteve dhe dukurive që bien në njollën e verbër të syrit, përkatësisht në fushën e verbër të rrjetëzës apo retinës. Pohohet se në rastet e tilla pacientët tregojnë reagim ndaj ngacmuesve të fushës së verbër të retinës, ndonëse janë të pavetëdijshëm për ngacmuesit e tillë. Këtë dukuri e ka zbuluar neuropsikologu britanik Lorens Vajskranc (Lawrence Weiskrantz, 1926).

PARKINSONIZ/ËM, - MI. m. Term përmbledhës për simptomat e sëmundjes së Parkinsonit, e cila shfaqet pas moshës së pjekurisë dhe ka karakter paravajtës. Simptomat kryesore të sëmundjes së Parkinsonit janë këto: dridhje të vrazhda të gjymtyrëve (të duarve dhe të këmbëve), ngadalësim i ritmit të veprimeve të vullnetshme, ngurtësim i muskujve të fytyrës, lodhje e organizmit, humbje e pjesshme e aftësisë së baraspeshës trupore etj. me reflektime të posaçme në çrregullimin e jetës psikike të njeriut (depresion, mbajtje mend e dobët, e folur e turbullt, simptomë e hipokondrisë etj.). Sëmundja e Parkinsonit është sëmundje neuropsikike e shprehur më tepër në fushën e çrregullimeve psikomotorike të një spektri të gjerë. Kjo sëmundje shkaktohet nga dëmtimi toksik i disa pjesëve të cipës së trurit, nga zvogëlimi

dhe mungesa e dopaminave në ganglionatet e nervave bazale etj. U emërtua parkinsonizëm, sipas përshkruesit të parë të kësaj sëmundjeje mjekut anglez Xhejms Parkinson (James Parkinson, 1755 – 1824), i cili botoi studimin mbi këtë sëmundje rreth vitit 1817.

PARMI, - A. f. Term emërtues i konceptit apo nocionit burimor të atij tipari të temperamentit që ka të bëjë me reagim të dobët dhe të ngadalshëm të tij ndaj stresit. Te personaliteti me tipar të tillë konstatohet mbisundimi i funksionit të sistemit parasimpatik ndaj atij simpatik dhe për këtë shkak ky tipar i temperamentit u quajt parmi dhe u shënua me shkronjën H+. Personat me këtë tipar të temperamentit, por të zhvilluar në nivel të lartë dallohen nga këto cilësi: guximi, prirja për t`u shoqëruar, shkalla e lartë e aftësisë komunikuese me të tjerët etj. Termi parmi i përket teorisë së personalitetit të formuluar nga psikologu amerikan i lindur në Angli, Rajmond B. Katel (Reymond B. Catell, 1905 – 1998). Ky identifikoi faktorin H+ dhe faktorin H-, në bazë të zbatimit të metodës së analizës faktoriale. Në këtë teori konstatojmë se faktori H+ gjendet kryesisht te individët delikuentë dhe te tipat sociopatë.

PAROKSIZ/ËM, - MI. m. Term emërtues për sulme befasuese të rënda të karakterit çrregullues të dukurive emocionale. Paroksizmi shfaqet edhe në situata të posaçme të njeriut, kur ky papritmas shpërthen në hidhërim dhe në zemërim të pakontrolluar të shoqëruar me piskamë të madhe.

PAROSMI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *παροσμια* që emërton çrregullimin e shqisës së nuhatjes dhe forma të ndryshme të mosnjohjes së erës së trupave flurorë, siç janë anosmia, disosmia, hiposmia etj.

PASION, - I. m. Term i ardhur nga latinishtja *passio* "vuaj" që ka pësuar ndryshime në kuptimin e tij. Në fillim të përdorimit të këtij termi pasioni ka emërtuar përkeqësim e vuajtje në emër të Perëndisë. Më pas ka emërtuar dashurinë e theksuar e të pafund ndërmjet partnerëve. Në psikologjinë bashkëkohore termi pasion emërton dëshirimin, dhënien me gjithë shpirt mbas dikujt, mbas diçkaje, etj.; emërton shpesh atë gjendje emocionale të fuqishme dhe të pandashme nga nevoja e njeriut për t'u lidhur me objektin, me njerëzit e tjerë dhe me veprimet e caktuara të tyre. Pasioni zgjat relativisht shumë kohë, duke tërhequr vazhdimisht njeriun drejt objektit, procesit dhe veprimit të caktuar. Pasione të këtilla mund të jenë: pasioni ndaj muzikës, letërsisë, religjionit etj. Pasionet e njeriut janë gjendje biopsikike të rrënjosura në psikikën e tij, që shpesh njeriu nuk arrin t`i kontrollojë. Këto pasione janë burim i zhvillimit të interesimeve të ndryshme të një individi të caktuar me përmasa të theksuara frymëzuese. Domethënie të këtillë kanë derivatet gramatikore e këtij termi, si: pasionant(e), pasionale, pasion etj.

PASIV, - E. mb. Që ka të bëjë me mungesën e veprimtarisë, të reagimeve të njeriut ndaj objekteve, proceseve, situatave etj. Pasiviteti cilëson gjendjen e njeriut, kur ai nga mos ambicja, mosinteresimi, mos nevoja etj. lejon që situatën e tij ta kontrollojnë

ndikimet e jashtme, duke qenë vetë indiferent ndaj saj dhe ndryshimeve të asaj situate. Situatat e këtilla njeriu pasiv i pranon pa pikë dëshire për t'u angazhuar në ndryshimin e tyre. Mbiemri pasiv haset në termat e mëposhtëm psikologjikë:

P

a. **Fjalori pasiv** – Fjalor që emërton numrin e caktuar të atyre fjalëve, kuptimi i të cilave është i njohur për atë individ të gjuhës amtare, por që nuk është në gjendje t`i zbatojë në procesin e të folurit;

b. **Qëndrimi pasiv** – Qëndrim me të cilin njeriu ka një përcaktim kognitiv ndaj gjendjes, situatës, objektit etj., por këtë përcaktim nuk e shoqëron angazhimi konkret i veprimtarisë së tij për ta ndryshuar atë gjendje, situatë, objekt etj.;

c. **Personaliteti pasiv-agresiv** - Formë e çrregullimit të sjelljeve dhe të veprimeve të atyre individëve, të cilët kanë qëndrim konstant negativ ndaj kërkesave shoqërore, ndaj drejtuesve të repartit në punë, që kërkojnë angazhim më të madh në punë etj., ose që nuk i përgjigjen dëshirave dhe synimeve të tij;

d. **Të mësuarit pasiv** – Formë joproduktive e të mësuarit, mënyrë e angazhimit të nxënësit, të studentit dhe të secilit që merr pjesë në fitimin e dijeve, por duke mos u angazhuar në përpunimin e informacioneve dhe në lidhjet ndërmjet tyre.

PASIVIZ/ËM, - MI. m. Raport jo ndikues i njeriut ose i njerëzve të një mjedisi të caktuar ndaj asaj çfarë ngjet në atë mjedis. Pasivizmi ka të bëjë me largimin nga angazhimi dhe nga veprimtaria, e drejtuar nga ndryshimi i faktorëve, i kushteve, i raporteve etj. të një situate të caktuar. Pasivizmi është qëndrim i përgjithshëm i njeriut, që shoqërohet nga mungesa e besimit dhe e bindjes në aftësitë dhe në mundësitë e tij, për t`i drejtuar sjelljet dhe veprimet e tij sipas objektivave dhe dëshirave të tij.

PASNDIJIM, - I. m. Përjetim ndijimor, kryesisht i të parit, që lind pas ndërprerjes së ndikimit të ngacmuesit pamor në syrin e njeriut. Përjetimi i tillë zgjat shumë shkurt. Pasndijimi mund të jetë pozitiv ose negativ. Pasndijimi pozitiv ka të bëjë me përjetimin e një cilësie të njëjtë me atë të ngacmuesit paraprak të syrit, ka karakter të paqëndrueshëm dhe paraqitet kryesisht pas ngacmuesit intensiv të syve. Pasnisjimi negativ ka të bëjë me shfaqjen e cilësisë tjetër nga ana e cilësisë së ngacmuesit paraprak të syve. Pasndijimi negativ shfaqet pas atij pozitiv dhe zgjat më shumë se pasndijimi pozitiv. Pasndijimi është pasojë e vazhdimësisë së aktivitetit shqisor që i është nënshtruar ngacmuesit të caktuar.

PASNDIJIMI HERING. Term që emërton dukurinë e paraqitjes së pasndijimit të të njëjtës cilësi si ajo e ngacmuesit paraprak të syve të njeriut. Shih – ***PASNDIJIMI***. Mori emrin e fiziologut gjerman Hajnrih E. Hering (Heinrich E. Hering, 1866 – 1944).

PASQYRA E TË DHËNAVE STATISTIKORE. Paraqitje e veçantë e rezultateve, e vlerave sasiore të përftuara nga zbatimi i metodave dhe i procedurave matëse të ndryshoreve psikologjike. Pasqyra të illa janë kryesisht tabelat klasifikuese të arritjeve të një grupi subjektesh në matjen e shkallës së zhvillimit të aftësive, të zotërimit të informacioneve nga fusha e caktuar

e dijeve etj. Hartimi i tabelave bëhet sipas kritereve të përcaktuara në statistikë. Me anën e pasqyrave të tilla krijohet mundësia e përpunimit statistikor të rezultateve, sidomos të atyre që kanë numër të madh të dhënash. Shih – ***PARAQITJA GRAFIKE E TË DHËNAVE PSIKOLOGJIKE.***

PASQYRIM, - I. m. Term i zbatuar më tepër në procesin e njohjes së dukurive, të objekteve, të proceseve e të cilësive të tyre, që emërton njohuritë për to në formë kopjesh të tyre. Pasqyrimi rrjedh nga dukuria e ndikimit të ndërsjellë të objekteve e të dukurive që pësojnë ndryshim prej njëri-tjetrit. Dallojmë disa lloj pasqyrimesh:

a. **Pasqyrimi fizik** – Gjurma e ndikimit të një objekti në tjetrin që paraqitet në forma të shumëllojshme të ndryshimit të tij;

b. **Pasqyrimi biologjik** – Formë e pasqyrimit të ndryshimit të mjedisit të kafshëve te të cilat këto ndryshime shkaktojnë edhe ndryshim të veprimeve të tyre;

c. **Pasqyrim psikik** – Imitimi i sjelljeve, i figurave të objekteve dhe riprodhimi i tyre nga ana e kafshëve të nivelit të lartë dhe të njeriut.

PATERNALIZ/ËM, - MI. m. Term burimor nga latinishtja *pater* "baba". Paternalizmi është raport patronal ndaj të tjerëve, të cilët ai (udhëheqësi, peshkopi, oficeri etj.) i vlerëson të tjerët në pozicion të nivelit më të ulët dhe sillet ndaj tyre thuajse këta janë të papjekur, janë fëmijë. Prindërit, që nuk duan ose nuk kanë mundësi të dallojnë se fëmijët e tyre tashmë janë rritur, duke ushtruar raport mbisundues ndaj tyre, shkaktojnë edhe vonesë në pjekurinë e tyre psikike, madje edhe në sjelljen e nivelit të fëmijëve, ndonëse ata tashmë janë rritur. I përafërt është edhe raporti ndërmjet autoriteteve politike ndaj anëtarëve të partive të tyre. Raporti i tillë ndërmjet drejtuesve autoritarë dhe individëve mundëson zhvillimin e sjelljeve të varura të individëve të tjerë ndaj drejtuesit të tyre.

PATETIK, - E. mb. I ardhur nga greqishtja *παθετικός*.Ky mbiemër cilëson nxitjen shqetësuese të ndjenjave; përcakton gjendjen që përshkohet nga shqetësimi i nivelit të lartë psikik të njeriut, për shkak të përshtypjes së thellë që shkakton një pikturë, një kompozim etj. Me këtë rast shfaqet ndjenja e entuziazmit të madh, e lidhur me respekt ndaj krijuesit të asaj vepre. Këtë kuptim ky term e ka më tepër në estetikë.

PATOBIOGRAFI, - A. f. Analiza e të dhënave biografike të një personaliteti, historia e zhvillimit të tij, me qëllim të përshkrimit psikanalitik të një personaliteti të caktuar. Patobiografia zakonisht ka të bëjë me personalitete të njohura në fushën letrare, politike, shkencore, ushtarake etj. Studime të tilla janë ajo e Zigmund Frojdit për Uillsonin, e Erik Fromit për Hitlerin, e Eriksonit për Gandin etj. Vepra e Marin Barletit për Skënderbeun nuk është shkruar për qëllime patobiografike, por ka mundësi që të analizohet për qëllime të këtilla.

PATOLOGJI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *πάθεια* "sëmundje", *λογος* "shkencë". Patologjia është shkenca mbi sëmundjet, shkaqet, procesi i zhvillimit, format e manifestimit, pasojat e zhvillimit të asaj sëmundje për të sëmurin etj. Në psikologjinë klinike

patologjia është disiplina që merret me hulumtimin e shkaqeve ose me etiologjinë e sëmundjeve psikike, me zhvillimin dhe me format e manifestimit të saj, pavarësisht nga baza e çrregullimit të strukturës organike të sëmundjeve. Këtë kuptim e ka termi patologji edhe në psikiatri. Në mjekësi termi patologji ka kuptim më të ngushtë: "shkenca që studion simptomat e sëmundjeve trupore me bazë të caktuar organike".

PATOLOGJIA SOCIALE. Disiplinë e shkencave shoqërore, që merret me studimin e dukurive patologjike të një mjedisi të caktuar shoqëror ose social. Dukuri të këtilla janë alkoolizmi, delikuenca, narkomania, prostitucioni etj. Patologjia shoqërore merret me studimin e sjelljeve dëmtuese ose shkatërruese të marrëdhënieve të rregullta të shoqërisë, pra me studimin e sjelljeve shmangëse nga rendi, rregullat dhe parimet e përgjithshme të zhvillimit të shoqërisë. Në kuadrin e saj studiohen edhe kushtet dhe raportet normale dhe jonormale të zhvillimit të sjelljeve dëmtuese e shkatërruese të shoqërisë. Kjo është e lidhur ngushtë me disa disiplina, si: e drejta familjare, forenzika, kriminologjia, psikologjia sociale etj.

PATOMIMI, - A. f. Formë e imitimit të sëmundjes nga ana e atyre individëve, të cilët stimulojnë për të pas konsideratës ndaj tyre. Në thelb këtu kemi të bëjmë me tiparin e formuar në strukturën e personalitetit, i cili ka përmasë të theksuar motivuese. Ky individ bën çmos që mjedisi i tij ta konsiderojë si të veçantë dhe me sjelljet e veta tregon se kërkon argument për të shfaqur ndaj tij kujdes të veçantë.

PATOPSIKOGJEN, - E. mb. Term i përbërë nga tri fjalë burimore të greqishtes: *πάθος* "sëmundje", *ψυχή* "shpirt" dhe *γένος* "lindje", që emërton shkaktarin e sëmundjes psikike dhe burimin e saj e lidh me lindjen e organizmit, gjegjësisht me kromozomet e qelizave.

PATOPSIKOLOGJI, - A f. Term i vjetër i psikopatologjisë, që, si edhe psikopatologjia, emërton disiplinën e sistemit të shkencave të psikologjisë, që merrej me origjinën, shkaqet, format, etj. të sëmundjeve psikike

PATOS, - I. m. I ardhur nga greqishtja *πάθος* "shpërthim dëshirash, mendimesh, ndjenjash, etj." Kuptimi i këtij termi ka pësuar ndryshime. Në fillim të përdorimit të tij ka emërtuar vuajtjen, durimin shpirtëror mbi bazën e fesë së krishterë. Më vonë emërtoi entuziazmin e fisnikëruar me shprehje të dallueshme të emocioneve të përziera të euforisë, të simpatisë, të dashurisë me intensitet të lartë. Gjendja psikike me patos të këtillë është shpeshherë e fuqishme dhe merr përmasa mbisunduese ndaj proceseve mendore dhe sjelljeve të njeriut të mbisunduar nga një gjendje e tillë. Për këtë shkak patosit i atribuohet përmasa motivuese; sjelljet e njeriut me patos janë të ngarkuara me ndjenja me intensitet të lartë, ku patosi konsiderohet se është burim karakteristik i "zjarrit ndjenjor", i cili vë në lëvizje aktivitetin psikik të njeriut. Gjendja e këtillë ushtron ndikim negative në objektivitetin e gjykimeve vlerësuese.

PATRIARKAT, - I. m. I ardhur nga latinishtja *patriarchatus* "kryetar fisi", që emërton kohën e sundimit të plotë

të meshkujve, të burrit në marrëdhëniet familjare e shoqërore, përkatësisht sundimin tradicional të burrit në një fis të caktuar, përkatësisht të burrit në familje, duke respektuar hierarkinë e sundimit të burrave ndaj grave, përkatësisht ndaj femrave dhe të moshuarve ndaj të rejave dhe të rinjve. Si mbiemër termi patriarkat haset në këta togfjalësha psikologjikë:

a. **Edukata patriarkale** – Edukatë e familjes patriarkale, ku zhvilloheshin vetitë e sjelljes pozitive ndaj eprorit mashkull në familje, ndaj respektit të të vjetërve dhe mohimit të rolit dytësor të gruas në familje. Edukata familjare patriarkale zhvillonte sistem sjelljesh sipas modelit të të mësuarit imitues, në bazë të identifikimit të të rinjve në familje me prindin mashkull, duke shfrytëzuar edhe porositë e këshillat e të mëdhenjve, që kishin të bënin me atë se sjelljet kanë kuptim kur zbatohet sistemi i vlerave patriarkale;

b. **Familja patriarkale** – Organizim i tillë i raporteve familjare, ku fjalën, vendin dhe kryefjalën e kishte mashkulli më i vjetër i asaj familjeje, autoriteti më i lartë i familjes. Anëtarët e familjes patriakale i nënshtroheshin autoritetit të kryeplakut mashkull të familjes. Në familjet e tilla femrat ishin pothuajse të përjashtuara nga punët shoqërore, religjioze etj., dhe me edukimin e fëmijëve në familjen patriarkale merreshin kryesisht nënat e tyre.

PATRIOTIZ/ËM, - MI. m. Term që rrjedh nga latinishtja *patria* "atdhe". Patriotizmi është ndjenjë pozitive ndaj atdheut. Kjo ndjenjë është strukturë e ndërlikuar shoqërore, morale e politike, të cilin e përbën ndjenja e dashurisë, e krenarisë, e gëzimit etj. për atdheun, popullin e vendin, gjuhën, kulturën, traditën dhe sistemin e vlerave të tij, si edhe gatishmëria për kultivimin e sistemit të vlerave dhe mbrojtjen e atdheut nga rreziku i copëtimit, i pushtimit etj. Patriotizmi është sistem qëndrimesh i formuar i njeriut që ka përmasë subjektive dhe përjetohet në formë pasive (armiqësie, hidhërimi, zemërimi etj.), kur atdheu dhe zhvillimi ekonomik, kulturor e shoqëror frenohet ose përjeton humbje, si edhe në formën aktive kur, së bashku me ndjenjat e hidhërimit dhe të zemërimit, angazhohen motive gatishmërie për të luftuar dhe sakrifikuar për të. Përbën strukturën më të rëndësishme të vetëdijes kombëtare. Mbi këtë bazë zhvillohet aktiviteti i pavarësisë politike të popullit të një vendi. Termi patriotizëm shfaqet më vonë nga ai "patriot". Zhvillimi i ndjenjës të patriotizmit është ndër detyrat e procesit të edukimit dhe të arsimimit të brezave të rinj që fillon nga edukata familjare, parashkollore dhe shkollore.

PATURPËSI, - A. f. Mungesë e ndjenjës së turpit së atij individi, i cili përjeton ndjenjën e mirëqenies, kur të tjerët ndjehen keq për sjelljet e tij ndaj tyre. I paturpshëm është ai, i cili vlerëson se nuk ka përse të shqetësohet e të frikësohet nga sjelljet shmangëse të tij nga normat e sjelljeve kulturore ndaj të tjerëve. Prania e paturpësisë ka të bëjë me mosshqetësimin e tij që me sjelljet e padrejta ndaj individit tjetër ka bërë që ky individ të ndryshojë qëndrimin e tij për të, pra të marrë qëndrim negativ ndaj tij.

PAUZ/Ë, - A. f. Term i ardhur nga latinishtja *pausa* që nënkupton pushimin e shkurtër gjatë të folurit, të lexuarit,

të mësuarit etj. Në psikologji termi pauzë ka kuptim të posaçëm brenda një procesi, pjesëve të një sjelljeje etj. Haset në disa togfjalësha psikologjike të tillë si:

a. **Pauza e reagimit operant** – Pushim i shkurtër, i përkohshëm I ndërprerjes së reagimit të disa kafshëve ndaj përforcimit të atyre sjelljeve që çojnë në formësim të sjelljes së tërësishme;

b. **Pauza fiksuese në procesin e leximit** – Pushim shumë i shkurtër i lëvizjes së kokërdhokut të syrit gjatë procesit të leximit të një teksti, kur gjatë këtyre pauzave fiksohet ose ngulitet përkohësisht forma e shkronjave, e rrokjeve dhe e fjalëve, duke dhënë mundësinë e përcaktimit të lidhjes së shkronjave, të rrokjeve në fjalë e fjali, pra duke krijuar mendësi të përpunimit të atyre informacioneve dhe kuptimit të përmbajtjes së tyre;

c. **Pauza memece** – Pushim i shkurtër gjatë leximit, kur lexuesi planifikon fjalën dhe fjalinë që do të pasojë dhe orvatet të kuptojë kuptimin e saj të plotë;

d. **Pauza të përmbushura** – Ndërprerje e shkurtër e të folurit shqip me shoqërim të zanoreve "a-ha", "domethënë", "hm", "shih – shih"etj.

PAVETËDIJSH/ËM, - ME (I, E). mb. Që nuk është i vetëdijshëm për gjendjen, impulset dhe lëvizjet e tij, që nuk di asgjë për to, megjithëse këto janë pjesë e personalitetit të njeriut. Argument i fuqishëm i ekzistencës së pavetëdijshme te njeriu është gjendja hipnotike e tij, si edhe sugjestionet e pas hipnozës. Të pavetëdijshme janë lëvizjet e gjymtyrëve (të duarve ose të këmbëve) ose të trupit tonë në gjumë. E pavetëdijshme është gjendja e njeriut në komë. Ky term ka kuptim të posaçëm në psikanalizë. Në psikanalizë *i, e pavetëdijshme* është fusha psikike e njeriut që krijon përmbajtjen e idit, dëshirat, kujtimet, përfytyrimet, shtytësit primitivë të shtypur e të ndrydhur të njeriut që shkaktojnë ankth, sikur të bëhen të vetëdijshme. Përpos tyre, të pavetëdijshmen e formojnë ato përmbajtje (dëshira, kujtime, përfytyrime etj.) që dikur kanë qenë të vetëdijshme, por të cilat, njeriu i ka dëbuar nga vetëdija e tij. Por, thelbin e së pavetëdijshmes e formojnë shtytësit. Përmbajtja e këtillë e së pavetëdijshmes ka të bëjë me proceset kognitive ose të njohjes, me ato emocionale dhe me proceset motivuese, që kanë karakter dinamik. Karakteri dinamik i tyre ka të bëjë me plotësimin e tyre (p.sh., të shtytësit seksual), pavarësisht nga situata reale dhe nga parimi i realitetit, si edhe nga koha e hapësira, entitete këto të panjohura për të pavetëdijshmen. Këto përmbajtje njohin vetëm plotësimin dhe kënaqjen e tyre. Përmbajtjet e këtilla njeriu i njeh në manifestimin e tyre, në mendimet, ndjenjat dhe në sjelljet e tij, por njohja e drejtpërdrejtë e tyre është e pamundur. Metoda e gjurmimit të tyre i atribuohet Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939), sipas të cilit, ëndrrat, të kujtuarit dhe komentimi i tyre është rruga mbretërore e njohjes së të pavetëdijshmes". Të pavetëdijshmen e kanë përmendur më parë se Zigmund Frojdi disa mendimtarë e krijues. Me mbiemrin *i, e pavetëdijshëm* hasen këta togfjalësha të terminologjisë psikologjike:

a. **Dije e pavetëdijshme** – Ide, informacione, lidhje të tyre që janë pronë e

njeriut; njeriu nuk është i vetëdijshëm për dije të tilla;

b. **Kujtesa e pavetëdijshme** – Në psikanalizë kujtesa që emërton mbajtjen mend të ndjenjave, të ngjarjeve dhe të atyre sjelljeve që nuk mund të riprodhohen;

c. **Motive të pavetëdijshme –** Dëshirat, nevojat e shtytësit të veprimtarisë së njeriut, për të cilët njeriu është i pavetëdijshëm, megjithëse drejtojnë dhe përcaktojnë sjelljet dhe veprimet e tij;

d. **Shtytës të pavetëdijshëm –** Faktorë ngasës të veprimtarisë së njeriut, për të cilët njeriu nuk është i vetëdijshëm (disa impulse primitive dhe disa procese fiziologjike e shtyjnë njeriun të ndërmarrë një veprimtari të caktuar, duke mos ditur vetë ai për procese të këtilla;

e. **Procese njohëse të pavetëdijshme –** Mendime, gjykime vlerësuese, madje edhe forma të zgjidhjes së situatave problemore, për të cilat njeriu është i pavetëdijshëm.

PAVETËDIJSHMJA KOLEKTIVE (E). Term i psikologjisë komplekse të Karl G. Jungut (Carl G. Jung, 1875 – 1961), i cili e ka vënë në përdorim që prej vitit 1933. Sipas Karl G. Jungut e pavetëdijshmja kolektive është struktura më e vjetër, sistemi më i thellë i psikikës së njeriut, madje më i thellë se e pavetëdijshmja individuale. Këtë e përbëjnë përvojat e trashëguara të mijëra gjeneratave para nesh dhe u takon të gjithëve. E pavetëdijshmja kolektive ka karakter universal dhe përftohet nga gjurmët e përvojave të shumë brezave, që kanë lënë gjurmë nervore dhe aktivizimi i tyre lehtëson procesin e përshtatjes sonë ndaj kushteve, raporteve dhe ndryshimeve të tyre. Ky sistem i tillë i përvojave të brezave paraprakë ushtron ndikim në mënyrën e perceptimit të realitetit, në mënyrën e mendimit të njeriut dhe në ndjenjat tona. Ky sistem është sistem individual, i cili është ngulitur në trurin e njeriut dhe luan rol në aktivitetin e tij. Strukturat e sistemit të pavetëdijes kolektive Karl. G. Jungu i ka dalluar në figurat e ëndrrave, në mite, në simbole etj. Format e përjetimit të strukturave të veçanta të këtij sistemi Karl G. Jungu i ka quajtur arketipa. Shih – ***ARKETIPAT.***

Burimet:

Carl Gustav Jung: *"Psikologjia e së pavetëdijshmes 1"* Tiranë.

Carl Gustav Jung: *"Psikologjia e së pavetëdijshmes 2*, Tiranë.

Carl Gustav Jung: *"Njeriu dhe simbolet e tij"*, Tiranë, 2010.

PAVETËDIJSHMJA PERSONALE (E). Nivel i posaçëm i pavetëdijes, që ka të bëjë me idetë, ndjenjat, përvojat e shtypura etj. të njeriut. Togfjalëshi e pavetëdijshmja personale ka të bëjë me psikanalizën e Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) dhe me teorinë e personalitetit të Karl G. Jungut (Carl G. Jung, 1875 – 1961).

Burimet:

Sigmund Frojd: *"Ese mbi psikanalizën",* Tiranë, 2006.

Karl Gustav Jung*: "Frojdi dhe Psikanaliza",* Tiranë, 2003.

Karl Gustav Jung: *"Ese mbi gjurmimin e pavetëdijes*", Tiranë.

Zigmund Frojd: *"Shakaja dhe lidhja e saj me të pavetëdijshmen",* Tiranë, 2005.

PAVLLOV Ivan (Ivan PAVLOV). Fiziolog dhe mjek rus. Lindi në Rjasan (Ryazan) më 14.09.1849 dhe vdiq

në Leningrad më 27.02.1936. Ndikoi në zhvillimin e psikologjisë, sidomos të refleksologjisë, duke u bërë njëkohësisht faktor ndikues në zhvillimin e bihejviorizmit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Themelues i shkollës së veprimtarisë së lartë nervore në Rusi që me aktivitetin eksperimental të saj nxiti zhvillimin e psikologjisë neurologjike. Pas përfundimit të studimeve për mjekësi u pranua asistent për lëndën e fiziologjisë. Mbrojti doktoratën më 1883 pas mbrojtjes me sukses të tezës "Mbi inervimin e muskulit të zemrës dhe qarkullimin e gjakut". Më 1884, tashmë docent për lëndën e fiziologjisë, fitoi të drejtën për specializim në Lajpcig dhe në Breslau (Vroclav të Polonisë). Ka dhënë mësim në Universitetin e Tomskit më 1890 dhe në Akademinë Ushtarake të Petrogradit, ku u zgjodh dhe profesor i fiziologjisë. Më 1891 me propozim të Ivan Pavllovit u themelua Instituti për Mjekësinë Eksperimentale, ku u zgjodh drejtor i këtij instituti dhe në këtë detyrë mbeti deri në fund të jetës së tij. Për veprimtarinë eksperimentale më 1904 fitoi çmimin Nobel dhe dy vite më pas u pranua anëtar i Akademisë Ruse të Shkencave. Për zhvillimin e psikologjisë rëndësi të posaçme pati angazhimi studimor i tij për funksionimin e Sistemit Nervor Qendror. Në kuadrin e këtij studimi ai vuri themelet e të mësuarit të thjeshtë, të mësuarit në bazë të refleksit të kushtëzuar. Këtë e paraqiti në veprën e vet "Reflekset e kushtëzuara: gjurmimi i veprimtarisë fiziologjike të cipës së trurit", 1927. Veprat kryesore të tij janë: *"Dvadcatiletnij opit objketivnoga* izučenia *vissej nervnoj delatelnosti (povedenija) životnih"* – (*"Njëzet vjet hulumtime eksperimentale objektive të veprimtarisë së lartë nervore"*), 1923; *"Lekcii o rabote bolšij polusarij golovnoga mozga"* – (*"Leksione mbi veprimtarinë e mirë të hemisferave të trurit"*), 1926.

PAVLLOVIZ/ËM, - MI. m. Emërtim i doktrinës fiziologjike së shkollës refleksologjike të Ivan P. Pavllovit (Ivan P. Pavlov, 1849 – 1936). Sipas tij dhe mendimtarëve të njohur të kësaj shkolle si Ivan M. Seçenov (Ivan M. Seçenov, 1829 – 1905), Vladimir M. Bekterev (Vladimir B. Bekhterev, 1857 – 1927) etj. proceset, gjendjet psikike dhe veprimtaria psikike ka të bëjë me proceset, gjendjet dhe funksionet fiziologjike të sistemit nervor, përkatësisht me veprimtarinë e lartë nervore. Hulumtimet fiziologjike të sistemit nervor mund të shpjegojnë veprimtarinë e gjithëmbarshme të organizmit. Shpjegimin e këtillë kjo shkollë e mbështet kryesisht në metodat hulumtuese të reflekseve të pakushtëzuara, të kushtëzuara dhe në sistemin e reflekseve të rendit të dytë sinjalizues. Teoria mbi të cilën është ngritur Pavllovizmi është teoria e pasqyrimit, sipas së cilës veprimtaria e gjithëmbarshme psikike është pasqyrim i lidhjes së mjedisit të jashtëm me organizmin dhe i mbajtjes së baraspeshimit të brendshëm të tij me anë të sistemit të reflekseve. Pavllovizmi ka ushtruar ndikim të fuqishëm në zhvillimin e psikologjisë në ish Bashkimin Sovjetik si edhe te shqipfolësit, sidomos gjatë gjysmës së parë të shekullit të njëzet. Ndikimi i tij ka qenë i rëndësisë së veçantë për zhvillimin e bihejviorizmit.

PAVOR NOCTURNUS. I ardhur nga latinishtja "frika e natës". Frika e

natës është frikë me intensitet të lartë, me ëndrra tmerruese, me makth etj. karakteristik për fëmijët e moshës 3 – 12 vjeç, por shfaqet edhe te të rriturit. Te fëmijët frika e natës paraqitet në fillim të gjumit, në kohën e parë (rreth 1/3 e kohës fillestare të gjumit). Format e shfaqjes së frikës së natës janë ndër më të ndryshmet: piskama, ngritja nga shtrati, ulja në shtrat për një kohë prej rreth 10 minutash etj. Kjo frikë është e shoqëruar me rrahje të fuqishme të zemrës, me ritëm të shpejtuar të frymëmarrjes, të pulsit, dhe me djersitje. Frika e natës mbetet te 1 % – 3 % e të rriturve.

PAVULLNETSH/ËM, - ME (I, E). mb. Që bëhet pa një motiv dhe pa një qëllim të caktuar. Mbiemri i pavullnetshëm i përket terminologjisë klasike, kur vullneti konsiderohej një prej "shtyllave"përbërëse të jetës dhe aktivitetit psikik të njeriut.

PAZOTËSI, - A. f. Mendim për mungesën e asaj strukture kognitive e motivuese të përgjithshme ose të veçantë, me anën e funksionit të kufizuar të zhvillimit të së cilës njeriu nuk ia del ta kryejë mirë dhe shpejt aktivitetin e tij në një fushëveprim të caktuar, vonohet dhe nuk arrin ta zgjidhë si duhet situatën e caktuar problemore. Këtë kuptim në shqip e hasim në mendimin "Ky është i pazoti në matematikë" në vend të "Ky nuk ka aftësi për matematikë".

PAZHVILLUAR (I, E). mb. Që përcakton ngecjen psikike të njeriut dhe mosndryshimet mirëvajtëse të veprimeve të tij sipas rendit të zhvillimit dhe kohës së normuar të paraqitjes së tyre. Ky term haset në disa togfjalësha kryesorë të terminologjisë së psikologjisë:

a. **Proces psikik i pazhvilluar** – Proces, ritmi i zhvillimit të të cilit, ka mbetur në një shkallë të ulët zhvillimi, përkatësisht prapa normës së zhvillimit normal të përgjithshëm të tij;

b. **Tipar psikik i pazhvilluar** – Aftësi, temperament, shprehi etj. e njeriut dhe e personalitetit të tij që ka mbetur në një shkallë të ulët zhvillimi dhe integrimi, në krahasim me normën e caktuar të zhvillimit dhe të integrimit të atij tipari në organizimin e tërësishëm;

c. **Personalitet i pazhvilluar** – Personalitet me tipare të pazhvilluara dhe me integrim e organizim të pamjaftueshëm të tipareve të përgjithshme në tërësinë psikologjike karakteristike për një njeri të caktuar.

PEÇJAK Vid (Vid PEČJAK). Psikolog slloven. Lindi në Lubjanë më 1929. Profesor i psikologjisë në Departamentin e Psikologjisë të Fakulteti Filozofik të Universitetit të Lubjanës. Ligjërues i psikologjisë në disa universitete të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Australisë. Organizues i anketës ndërkombëtare "*Psikologët e mëdhenj mbi psikologjinë*" – "*Veliki psihologi o psihologiji*" e para këtij lloji me përmasa ndërkombëtare. Në këtë anketë ai u parashtroi pesë pyetje psikologëve të njohur nga të gjitha vendet e botës: 1) Çfarë mendoni për psikologjinë bashkëkohore? 2) Cili do duhej të ishte roli shoqëror i psikologjisë? 3) Ku qëndron kontributi juaj personal, kontributi i bashkëpunëtorëve tuaj, ose ndoshta kontributi i drejtimit tuaj në psikologjinë bashkëkohore? 4) Çfarë mendoni për ardhmërinë e zhvillimit

të psikologjisë? 5) Çfarë mendoni për psikologjinë zbatuese? Ai mori përgjigje nga 77 psikologë të vendeve më të njohura nga këndvështrimi i zhvillimit të psikologjisë. Përgjigjet i përpunoi dhe arriti t`i botonte në veprën "*Psikologët e mëdhenj mbi psikologjinë*" – ("*Veliki psiholozi o psihologiji*"), ku dha një pasqyrë të qartë dhe të rëndësishme për të tashmen dhe të ardhmen e psikologjisë. Ligjëroi lëndën "Histori e psikologjisë me psikologjinë bashkëkohore" në Departamentin e Psikologjisë të Universitetit të Lubjanës. Veprat kryesore të tij janë: *"Psikologjia spozanavanja"* – (*"Psikologjia e njohjes"*), 1975; *"Veliki psiholozi o psihologiji"* – (*"Psikologët e mëdhenj mbi psikologjinë"*), 1983; *"Misliti, delati, ziveti ustvarijalno"* – (*"Mendoni, veproni, jetoni realisht"*), 1987; "*Putevi do Ideja – Primena tehnika stvaralackog misljenja u preduzecama, skolama i drugim sredinama"* – (*"Rrugët deri te idetë – Zbatimi i teknikave të mendimit krijues në sipërmarrje, në shkolla dhe në mjedise të tjera"*), 1989.

PEDAGOGJI, - A. f. Term burimor i ardhur nga greqishtja *paidhos* "fëmijë" dhe *ago* "udhëheq" që ka kuptimin të drejtosh fëmijën (*pedag* është quajtur në Greqinë e Vjetër udhëheqësi dhe kujdestari i fëmijëve). Pedagogjia është disiplinë e grupit të shkencave shoqërore, që merret me studimin e edukatës dhe me arsimimin e fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve. Pedagogjia ka detyra, qëllime, metoda dhe forma organizuese të veçanta, të cilat kanë për qëllim kryesor zhvillimin dhe formimin e personalitetit të shëndoshë dhe të aftë për të vepruar dhe krijuar në mjedisin e këtij personaliteti. Për të kryer detyrat e saj pedagogjia mbështetet në rezultatet hulumtuese të psikologjisë, sidomos të psikologjisë zhvillimore apo gjenetike dhe të psikologjisë pedagogjike. Në shqip termi pedagogji ka përdorim të zakonshëm, por në vendet ku fliten gjuhët anglosaksone termi pedagogji njihet pak.

PEDANTIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga frëngjishtja *pedanterie.* Pedanteria emërton sistemin karakteristik të sjelljeve të njeriut ndaj të tjerëve, ndaj mjedisit të gjerë dhe ndaj vetvetes, të cilin e dallon përpikëria e tepërt dhe organizimi dhe kontrollimi i sjelljeve të hollësishme që herë-herë kalojnë në formalizëm. Në veçantinë e tillë të sjelljes individi pedant gjen mënyrën e shprehjes së krenarisë dhe dijeve që ka ose supozon se i ka.

PEDERASTI, - A. f. Term bu-rimor nga greqishtja *παιδεραστία.* Pederastia është formë e sëmurë e plotësimit të epshit apo shtytësit seksual, duke shfrytëzuar si objekt seksual djemtë e vegjël dhe të rinjtë e të njëjtës gjini. Pederastia shfaqet në raportet seksuale ndërmjet meshkujve.

PEDOCENTRIZ/ËM, - MI. m. Pikëpamje pedagogjike e mbarimit të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe e fillimit të shekullit të njëzet. Sipas pedocentrizmit fëmija me të gjitha nevojat dhe me interesimet e tij duhet të jetë faktor përcaktues i qëllimit, i detyrave, i përmbajtjes, i metodave dhe i formave organizuese të procesit edukativ e arsimor. Pedocentrizmi u përhap sidomos pas publikimit të veprës së autores suedeze E. Kej (E. Key) me titull "Njëqindv **NEFS, - I.** jetëshi i fëmijës", e cila i përket pikëpamjeve negative të pedagogjisë.

PEDOFILI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *pais* ose *παιδο* "fëmijë" dhe *φιλία* "mik, ai që dashuron". Pedofilia me kuptim të përgjithshëm ka emërtuar dashurinë ndaj fëmijëve. Më vonë pedofilia emërtoi dashurinë e bastarduar të plotësimit të epshit, shtytësit, motivit seksual të njeriut të rritur me fëmijë të gjinisë së kundërt ose të së njëjtës gjini. Pedofilia i përket grupit të çrregullimeve të parafilisë. Pedofilia karakterizon më tepër të prapambeturit mendorë, alkoolistët, pleqtë etj. Kryerja e aktit pedofilik konsiderohet akt i dënueshëm. Shih –***PARAFILIA.***

PEDOLOGJI, - A. f. Disiplinë e hershme shkencore që studion zhvillimin fizik e psikik të fëmijëve, si edhe proceset e sjelljet patologjike të tyre. Sipas pedologjisë i tërë procesi edukativ e arsimor duhet të mbështetet në zhvillimin fizik e psikik të fëmijëve. Nën ndikimin e pedologjisë filloi procesi i matjes së ndryshoreve psikologjike, të disa tipareve psikike të fëmijëve dhe diferencimi i fëmijëve në bazë të përmasave dhe nivelit të zhvillimit fizik e psikik të tyre. Pedologjia ka ushtruar ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e psikologjisë së fëmijëve, të anatomisë dhe të fiziologjisë së fëmijëve. Duke mohuar rolin e faktorëve të jashtëm në zhvillimin dhe në formimin e personalitetit dhe ajo është vlerësuar si disiplinë e njëanshme.

PEDOMORFIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga greqishtja *pais* ose *παιδο* "fëmijë" dhe *μορφισμός* "formë". Pedocentrizmi është dukuria e atribuimit në sjelljet e të rriturve të sjelljeve fëmijërore, si edhe shpjegimi i sjelljeve të të rriturve me koncepte apo nocione dhe me lidhje ndërmjet tyre me terma që kanë të bëjnë me sjellje të të vegjëlve.

PEDOMORFOZ/Ë, - A. f. Emërtim i asaj dukurie që ka të bëjë me ruajtjen e atyre karakteristikave në kujtesën e njeriut, të moshës të rinisë së hershme dhe riprodhimi i tyre në sjelljet e të rriturve.

PEMA GJENEALOGJIKE. Origjina dhe zhvillimi i një familjeje të caktuar që nga krijimi deri në degëzimin e saj në shumë familje. Pema gjenealogjike paraqitet me grafik të caktuar, ku dallohet periudha e zhvillimit të asaj familjeje prej familjes burimore dhe zhvillimi i degëve të saj gjatë një periudhe të caktuar kohore.

PENDESË, - A. f. Term i psikologjisë së fesë së krishterë që ka të bëjë me ndëshkimin e e një individi për mëkatin që ka bërë, për të cilin atë e bren ndërgjegjja dhe i rrëfehet meshtarit, apo priftit në kishë. Masa ndëshkimore e caktuar nga ana e meshtarit përjetohet nga ana e të penduarit si një masë qetësuese e ndërgjegjes së tij. Kjo masë ndëshkuese, në varësi nga shkalla e mëkatit, mund të jetë masë ndëshkuese fizike, shpirtërore dhe shpesh masë e ndërlikuar fizike e shpirtërore. Masa e këtillë mund të shpjerë deri në vetëmohim të mirëqenies fizike e shpirtërore të atij që pendohet. Qëllimi i kësaj mase është që besimtarin e krishterë ta bindë për përmbajtjen e sjelljeve dhe mendimeve të tij.

PENDIM, - I. m. Ndjenjë e keqardhjes për një sjellje të gabuar ndaj një individi që lidhet me ndërrimin e qëndrimit për atë sjellje. Pendimi është ndjenjë që lidhet me përjetimin e ndjenjës së fajit. Kjo është ndjenja që i përket vetëvlerësimit të asaj sjelljeje që e ka

kryer vetë njeriu dhe që, pas kryerjes së saj përjeton ndjenjën e keqardhjes për atë që ka bërë. Me rastin e pendimit individi dallon sjelljen e keqe nga vetë bartësi i saj dhe njëkohësisht dallon fajin nga ai që ka bërë faj.

P

PENETRIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *penetratio* "depërtim, futje, përshkim". Ky term përdoret edhe në shqip , sidomos në letërsi dhe në psikologji. Në psikologji emërton konceptin apo nocionin e depërtimit të një ideje, qëndrimi, vlere etj. në "mendjen"e tjetrit, duke kapërcyer pengesa të ndryshme. Penetrimi ose depërtimi i tillë bëhet me qëllim të përkapjes dhe hyrjes thellë në të kuptuarit e një çështje të caktuar etike, ekonomike, personale etj. Në psikologjinë sociale dhe në psikologjinë e personalitetit termi penetrim përdoret më tepër për të emërtuar depërtimin e qëndrimeve dhe rolin e tyre në sjelljet e njeriut.

PENGES/Ë, - A. f. Emërtim i përgjithshëm për gjithçka që e pengon njeriun në rrugën e plotësimit të dëshirës, të motivit, të shtytësit të caktuar. Në literaturën e psikologjisë shpesh përdoret termi profesional "barrierë" për pengesën e paraqitur në angazhimin dhe në veprimtarinë e plotësimit të një motivi, duke shkaktuar vështirësi në zotërimin e asaj pengese. Pengesa ose barriera është vendosur ndërmjet subjektit dhe objektivit të tij, përkatësisht ndërmjet njeriut të uritur dhe ushqimit që gjendet përtej lumit të vërshuar. Pengesat mund të jenë tri llojesh: pengesa fizike (burgu, stuhia, vërshimi etj.), pengesa shoqërore (ligji, parimi e norma morale, statusi shoqëror i njeriut në grupin social të tij etj.) dhe pengesa psikike (aftësia e kufizuar, ndjenja e fajit, mungesa e motivacionit etj.).

PENGESAT E TË MENDUARIT LOGJIK. Faktorë që pengojnë mendimin logjik për çështje të caktuara dhe zhvillimin e drejtë të tij. Faktorët të tillë janë të shumëllojshëm, por më kryesorët janë faktorët formalë dhe faktorët e brendisë së mendimit.

1. **Faktorët formalë** kanë të bëjnë me mënyrën e mendimit dhe shfaqen në disa forma: disocacioni, fluturimi i ideve, ngjitja e mendimit të njeriut për një ide dhe pamundësia e ndarjes nga ajo, përsëritja e shpeshtë e saj etj.
2. **Faktorët e brendisë së mendimit** kanë të bëjnë me të menduarit në bazë të ideve të çrregulluara, sikurse janë ideja e vlerësimit jo real të një çështjeje të caktuar, ose ideja madhore të cilën e pranon si ide të veten dhe beson thellë në të. Ideja relative, gjithashtu është lloj mendimi me përmbajtje të çrregulluar. Shfaqet te ata individë të cilët vendosin në lidhje me veten çdo gjë që ndodh përreth tyre (emisionet e radios, të televizionit, tërmetet etj., që kanë të bëjnë me të dhe me punën e tij). Pengesat e brendisë së mendimit kanë të bëjnë edhe me mendime të dhunshme, nga të cilat njeriu çlirohet me vështirësi.

PENIS, - I. m. Organi mashkullor i riprodhimit dhe i kopulacionit, si edhe i urinimit te sisorët. Funksioni kryesor i penisit është depërtimi i spermës nëpër kanalin e urinës dhe hedhja e tij në traktin e vagjinës.

PENOLOGJI, - A. f. Disiplinë shkencore që merret me çështjet e dënimit të individëve, që me sjelljet e tyre kanë

kryer akte kundërligjore dhe për këtë shkak janë privuar nga jeta e lirë personale. Në kohët më të reja penologjia e ka zmadhuar shtrirjen e saj, duke përfshirë edhe studimin e metodave riedukuese të të dënuarve, me qëllim që risocializimi i tyre t`a bëjë të dënuarin individ të përshtatshëm dhe të dobishëm për veten e tij, si edhe për mjedisin shoqëror. Penologjia ka lidhje me psikologjinë, sepse studion aspektet e ndryshme psikologjike dhe sociale të sanksioneve.

PERCENTIL, - I m. Term i psikometrisë që përcakton përqindjen e një të tëre, të llogaritur sipas bazës së përbashkët 100. Percentili sillet prej 0 – 100. Ai përcakton pozicionin numerik të një arritjeje nën masën e të cilit gjendet përqindja e rasteve të tjera. Kështu, percentili 70 është pozicioni i të dhënave të përftuara nga matja e një ndryshoreje psikologjike nën të cilën gjenden 69 % të rasteve të tjera; percentilli 50 % është vlera e mesores së të dhënave nën të cilën dhe mbi të cilën gjenden 49 % e rasteve të tjera. Percentilat mundësojnë jo vetëm përcaktimin e pozicionit ose të rangut që zënë ndër 100 raste, por edhe krahasimin e një rasti me të tjerët. Rezultat më të lartë ka ai subjekt, i cili ka rangun percentil më të lartë. Në psikometri, e pikërisht në statistikë hasen disa togfjalësha terminologjikë, si:

a. **Rangu percentil** – Pozicioni që zë suksesi i njeriut në një fushëveprimi të caktuar brenda shkallës së ndarë në 100 pjesë të barabarta, nën të cilën gjendet suksesi i të tjerëve i shprehur me përqindje (%); rangu më i lartë është 99 %;

b. **Lakorja percentile** – Paraqitja grafike e përqindjeve të dendurive të vendosura në grupe të posaçme ndaj numrit të përgjithshëm të të dhënave psikologjike.

PERCEPT, - I. m. Term me prejardhje nga latinishtja *percipere* "përkapje, rrokje". Percepti është dukuria, objekti, procesi, situata perceptuese me gjithë përmbajtjen e vet që njeriu i jep objektit të perceptimit gjatë kohës kur ai perceptohet nga ana e tij. Percepti është rezultat i procesit të perceptimit të një dukurie, objekti, situate etj.

PERCEPTIM, - I. m. Procesi dhe rezultati i ndërlikuar i njohjes, me anën e të cilit njeriu bëhet i vetëdijshëm për tërësinë e integruar të ngacmimeve të një dukurie, objekti, procesi etj., që shkaktohet nga ndikimi që këto ushtrojnë drejtpërdrejt në shqisat e njeriut. Ky kuptim i përgjithshëm i termit perceptim përfshin këta përbërës të procesit perceptues: ndikimin fizik të ngacmuesve në shqisa, procesin fiziologjik, neurologjik dhe procesin emocional e motivues, që rezulton me përjetimin e tërësisë nga ana e njeriut të ndikimit të tyre. Kjo tërësi, përkatësisht ky perceptim nuk duhet trajtuar si kopje e trupit ngacmues. Perceptimi konsiderohet se është proces themelor aktiv i njohjes së realitetit, përkatësisht i njohjes së modaliteteve të tij. Është proces aktiv, sepse ka të bëjë me kërkimin, përzgjedhjen e objektit perceptues, përkapjen shqisore të ngacmuesit real, përpunimin e organizimin tërësor të impulsive neurofiziologjike të informacioneve për objektin perceptues dhe shpjegimin e tyre nga ana e njeriut. Për këto shkaqe perceptimi

nuk është vetëm pasqyrim i dukurive, i objekteve, i proceseve dhe i situatave reale, por proces i ndërlikuar dhe i ndërlidhur i faktorëve fizikë, fiziologjikë, neurologjikë e psikikë, për të cilin njeriu bëhet i vetëdijshëm. Perceptimi është produkt përfundimtar i procesit të ndërlikuar fizik, shqisor, neuro-fiziologjik dhe psikik të procesit perceptues. Ky produkt në literaturën e psikologjisë emërtohet me termin percept. Natyra e procesit të perceptimit gjen shprehje te këto shpjegime:

a. **Shpjegimi strukturalist** – Shpjegimi më i vjetër, sipas të cilit perceptimi është sintezë ndijimesh dhe vetëdije për tërësinë e tyre;
b. **Shpjegimi bihejviorist** – Proces i brendshëm hipotetik i njeriut, që lind drejtpërdrejt nga stimujt receptorë të shqisave nën ndikimin e shtytësve, të nevojave dhe të shprehive;
c. **Shpjegimi i drejtpërdrejtë i perceptimit** – Tërësia e perceptimit dhe informacionet që kemi për një perceptim kanë të bëjnë me energjinë fizike të trupit ngacmues të shqisave, dhe jo me funksionin e veçantë të Sistemit Nervor Qendror. Trupi ngacmues në vetveten e tij është tërësi e vetorganizuar, kurse mekanizmat ndijimorë kanë krijuar kodin e marrjes së tij dhe kjo është e mjaftueshme për të pasur perceptim;
d. **Shpjegimi geshtaltist** – Shpjegim që mbështetet në ndërlidhjen vetorganizuese të strukturave të ngacmuesve, duke formuluar ligjet perceptuese si edhe parimin e izomorfizmit, përkatësisht parimin e ekuivalencës ndërmjet strukturave dhe proceseve neurofiziologjike dhe atyre njohëse apo kognitive të vetëdijshme të përvojës së njeriut për objektin perceptues;
e. **Shpjegimi konstruktivist** – Proces aktiv i subjektit, i cili me aktivitetin e tij mendor, kodon shenjat ndijimore dhe, duke interpretuar këto shenja në bazë të përvojës, të dijes që kemi, të strukturave njohëse apo kognitive dhe të motiveve, i jep kuptim shenjave të kodifikuara dhe të sintetizuara si tërësi e veçantë.

PERCEPTIMI BINOKULAR. Perceptimi i njëkohshëm me dy sy, perceptimi normal i dukurive, i objekteve, i situatave etj. Figurat e dy objekteve bien në rrjetën apo në retinën e syrit në vende të ndryshme, por figurat e tyre "shkrihen" në një të përbashkët, duke mundësuar perceptimin e thellësisë së atyre objekteve, proceseve, situatave etj.

PERCEPTIMI I KOHËS. Zgjatja kohore e perceptimit të një dukurie, ngjarjeje, objekti etj., si edhe përjetimi i dallimit kohor të një ndodhie nga tjetra, përkatësisht përjetimi kohor i rendit të ndodhive. Kur koha është e zbrazët vlerësimi i zgjatjes së saj është e mundur të matet objektivisht vetëm brenda 1/3 - ¼ e sekondës. Koha shumë rrallë është e zbrazët. Koha është e mbushur me ndodhi, procese etj. Matja e zgjatjes së kësaj kohe që perceptohet mbështetet në karakterin e ngjarjeve, të ndodhive, të proceseve etj. Në perceptimin e kohëzgjatjes së ndodhive rol të posaçëm luan intensiteti dhe cilësia e ndodhive, e proceseve etj.; kur ndodhitë, ngjarjet, proceset etj. janë interesante për perceptuesin dhe kur shkaktojnë kënaqësi te subjekti, atëherë perceptimi i kohëzgjatjes së tyre është i shkurtër dhe, përkundrazi kur ndodhitë, ngjarjet, proceset etj. janë monotone dhe shkaktojnë

mërzi te subjekti, atëherë kohëzgjatja e tyre është më e madhe se koha reale e zgjatjes së tyre. 90 minuta të zgjatjes së një filmi me përmbajtje interesante dhe me shkallë motivuese të lartë të atij që e sheh këtë film dhe 90 minuta të shikimit të një filmi tjetër me përmbajtje jointeresante janë dy përjetime të ndryshme të kohëzgjatjes për të njëjtin njeri, megjithëse objektivisht rrjedha e kohës në dy rastet është e njëjtë. Përjetimi i kohës së pritjes së një informacioni, një porosie, një urdhri të rëndësishëm etj. është shumë e gjatë. Gjendja shëndetësore ushtron ndikim në përjetim të kohëzgjatjes së një ngjarjeje. Kohëzgjatja e ndërhyrjes kirurgjikale është shumë më e gjatë se kohëzgjatja e njëjtë e të luajturit të një ndeshjeje bilardoje. Perceptimi i kohës mbështetet më shumë në karakterin psikologjik të ndodhive dhe ngjarjeve që e mbushin atë kohë, se në vetë kohëzgjatjen. Perceptimi i tillë i përket kohës psikologjike, përkatësisht perceptimi i saj ka përmasë të theksuar subjektive. Ka situata të posaçme kur njeriu humbet aftësinë e vlerësimit të kohëzgjatjes së një dukurie: në situata të rrezikshme për jetën njeriu humbet aftësinë e vlerësimit të rrjedhjes kohore të asaj situate. Për këtë shkak koha psikologjike, përkatësisht kohëzgjatja e perceptuar është ose më e madhe ose më e vogël nga saktësia objektive e saj, e matur me orë.

PERCEPTIMI I INDIVIDËVE. Formë e perceptimit shoqëror, që ka të bëjë me perceptimin e trupit, të pamjes së jashtme, të sjelljeve të të tjerëve, por edhe me perceptimin e tipareve të personalitetit, të motiveve, të ndjenjave, të synimeve të tij etj. Perceptimi i individëve të tjerë përfshin vlerësimin dhe shpjegimin e strukturave psikologjike të tyre. Ky lloj perceptimi është më i ndërlikuar dhe më i vështirë se perceptimi i trupave fizikë. Në perceptimin e të tjerëve rol të fuqishëm luan përshtypja e parë që lë te perceptuesi kontakti i parë me tjetrin, e pikërisht, shprehja e qartë dhe e fuqishme e emocioneve, afërsia sociale e tij me të tjerët, gatishmëria e bashkëpunimit, sinqeriteti etj. Në këtë proces ushtrojnë ndikim edhe faktorët psikologjikë të atij që percepton. Kjo e vështirëson perceptimin objektiv të individëve të tjerë.

PERCEPTIMI I THELLËSISË. Perceptimi i përmasës së tretë (përpos gjatësisë e gjerësisë), perceptim trupor si një proces i ndërlikuar fizik, shqisor dhe psikologjik dhe ndërlidhës i këtyre faktorëve. Faktorët fizikë të perceptimit të thellësisë janë shenjat e jashtme të objektit perceptues: madhësia e objektit, perspektiva ajrore e të parit, pozicioni i objektit ndër të tjerët në hapësirën e caktuar, qartësia e objektit, maskimi i objektit, drita dhe hija e objektit perceptues. Faktori kryesor shqisor i perceptimit të thellësisë së një objekti është të parit me dy sy, ku rol të rëndësishëm luan të parit me dy sy dhe dispariteti i figurave retinale të atij objekti: figura e retinës së syrit të djathtë rrok njërën pjesë të objektit, kurse figura e retinës së syrit të majtë rrok pjesën tjetër të objektit; kjo ndodh ngaqë syri i djathtë ka largësi të caktuar nga i majti dhe secili sy ka këndin e vet të të parit. Të dy figurat shkrihen në një dhe kjo mundëson dallimin e thellësisë së trupave. Në këtë proces rol të posaçëm luajnë

lëvizjet e kokërdhokut të syve, që mundësohen nga strukturat muskulore të syve. Lëvizja e tyre bën të mundur procesin e konvergimit të syve, përkatësisht drejtimin e të parit të dy syve në një pikë. Kur dy objekte gjenden afër njeri tjetrit këndi i konvergimit është më i madh. Kjo ndodh gjatë shikimit së objekteve në largësi deri 15 – 18 metra, kurse pas kësaj largësie vijat pamore të të dy syve shkojnë paralel. Konvergimi është një nga faktorët e rëndësishëm të perceptimit të thellësisë ose perceptimit tripërmasor. Perceptimi i thellësisë është i mundur edhe në mbështetje të të parit me një sy. Në raste të tilla perceptimi i thellësisë mundësohet nga të gjitha shenjat e përmendura, por këtu rol të veçantë luan akomodimi i lentës së syrit, përkatësisht ndryshimi i formës së lentës së syrit me rastin e të parit të objekteve të largëta dhe të afërta. Akomodimi i lentës së syve mundëson qartësinë e të parit së objekteve, pavarësisht nga ndryshimi i largësisë së një objekti nga perceptuesi i tij.

PERCEPTIMI JASHTËSHQISOR. Perceptim që ka të bëjë me dukuri të çuditshme të disa individëve për të perceptuar dukuritë, objektet, proceset, situatat e caktuara pa ngacmues objektivë dhe duke mos i vënë në funksion shqisat. I këtillë është perceptimi i kutisë së cigareve duke ecur në mesin e njerëzve që nuk pinë duhan, perceptimi i ndjenjave të dikujt kur ai nuk është i pranishëm etj. Perceptimi jashtëshqisor është dukuri psikike e pazakontë për psikologjinë empirike. Studimi i perceptimit jashtëshqisor i përket parapsikologjisë.

PERCEPTIMI PAMOR GIBSON. Pikëpamje teorike mbi njohjen e realitetit. Sipas psikologut amerikan Xhejms XH. Gibson (James J. Gibson, 1904 – 1979) njohja e realitetit, e formave dhe e cilësive objektive bëhet e mundur me marrjen e informacioneve të drejtpërdrejta mbi cilësitë e pandryshueshme të mjedisit ku vepron njeriu. Me këtë supozim teorik Xh. Gibson ka pezulluar supozimet e mundshme për strukturën e brendshme të ndijimeve dhe të kodit të ndijimeve, mbi bazën e të cilave janë ngritur supozime për sistemin e organizimit të ndijimeve dhe për mekanizmat biopsikologjikë të këtij sistemi.

PERCEPTIMI SINKRETIK. Perceptim i padiferencuar objektesh e dukurish që haset te të vegjlit, kur shkrihen në një tërësi perceptive elementet e njohjes së objekteve me ndjenja fëmijërore. Shih – ***MENDIMI SINKRETIK.***

PERCEPTIMI SOCIAL. Perceptimi i individëve, i marrëdhënieve shoqërore ndërmjet tyre dhe i situatave shoqërore, si edhe ndikimi i faktorëve psikologjikë (i emocioneve, i motiveve, i tipareve etj.) në formimin e përfytyrimit dhe të gjykimit vlerësues të tjetrit dhe të sjelljeve të tij, si edhe ndikimi i këtyre faktorëve në ndryshimin e tyre.

PERCEPTIMI SUBLIM. Perceptim i ngacmuesve me intensitet të ulët (nën pragun e ndjeshmërisë dhe me afat shumë të shkurtër ndikues), që nuk janë në gjendje të shkaktojnë përjetim të vetëdijshëm, por ndikimi i tyre dallohet më pas. Ky lloj perceptimi është ende i pasaktësuar, pavarësisht nga rastet e veçanta të përshkruara në jetën e përditshme, siç është rasti

i perceptimit dhe i blerjes së çorapeve të parfumuara nën pragun e ngacmueshmërisë.

PERCEPTIV, - E. mb. Që ka të bëjë me perceptimin, që i përket perceptimit. Në terminologjinë psikologjike termi perceptiv haset në këta togfjalësha psikologjikë:

a. **Cikli perceptiv** – Tërësi e ndërlidhur përbërësish që ka të bëjë me anticipimin e informatave që do të perceptohen. Cikli perceptues përbëhet nga këta përbërës: a) skema kognitive e proceseve psikike që e drejtojnë procesin e perceptimit; b) grupi i informacioneve të klasifikuara dhe c) stimujt aktualë të mjedisit, që ndikojnë në shqisat e perceptuesit. Termi cikli perceptiv i përket psikologjisë kognitive të psikologut amerikan Ulrik R. G. Najser (Ulric R. G. Neisser, 1928);

b. **Faktori perceptiv** – Një ndër faktorët gruporë, apo faktorët parësorë mendorë, që u identifikua në bazë të analizës faktoriale. Faktori perceptiv ose faktori P është aftësi e identifikimit të shpejtë dhe të saktë të formës dhe i dallimit të ndryshimeve të vogla në strukturat e ndërlikuara pamore të objekteve;

c. **Fusha perceptive** – Objekte që perceptohen në një hapësirë të caktuar, duke shfytëzuar në rend të parë shqisën e të parit, si edhe shqisat e tjera. Në fushën perceptive bëjnë pjesë objektet e vështruara me qëllim, si edhe ato që dallohen nga perceptimi joorientues;

d. **Përshtatshmëria perceptuese** – Përgatitja dhe gatishmëria e njeriut për ta perceptuar dukurinë (të zënit e hënës), objektin (kometën), pasojën e ndikimit të një shkaku në ndryshimin e një ndryshoreje psikologjike etj.

e. **Mbrojtja perceptive** – Dukuria e karakterit të censurës së pavetëdijshme, e përqendruar në moslejimin e perceptimit të atyre ngacmuesve që shkaktojnë nervozizëm, ankth, ndjenjën e turpit, të fajit etj. dhe në këtë mënyrë lëndojnë unin e njeriut dhe çojnë në mosnderim të vetvetes;

f. **"Seti" perceptiv** – Term i anglishtes që emërton ndikimin e pritjes së njeriut, të drejtimit të vëmendjes dhe të aktivitetit të tij të çastit në një dukuri të caktuar, si edhe ndikimin e gjendjes aktuale të njeriut në perceptimin e dukurive, të objekteve dhe të situatave të caktuara. Këta janë faktorë psikologjikë, që ndikojnë në përmbajtjen dhe në veçoritë e perceptimit të dukurive, të ngjarjeve, të objekteve etj. Nëse jemi të drejtuar në kuptimin e përmbajtjes së një teksti që lexohet na shpëtojnë gabime ortografike shumë më tepër, se në qoftë se orientohemi në leximin e atij teksti me qëllim konstatimi e korrigjimi të gabimeve ortografike;

g. **Stili perceptiv** – Mënyrë karakteristike e stabilizuar e sjelljeve të një individi në perceptimin e dukurive, ngjarjeve, gjësendeve etj., duke shfrytëzuar funksionimin e modalitetit të caktuar shqisor. Stili perceptiv u dallua në testin Uitkin. Sipas rezultateve të arritura në këtë test dallohen dy tipa stilesh të perceptimit: stili i varur dhe stili i pavarur nga fusha perceptive;

h. **Shndërrimi i perceptimit** – Përmbajtja e perceptuar ka karakter dinamik dhe ndryshon duke u modifikuar në forma të ndryshme. Ky modifikim i atribuohet ndryshimeve fizike të objektit perceptues, shtesës ose

mungesës së ndonjë elementi përbërës dhe shpjegimit të raporteve të reja ndërmjet strukturave përbërëse të objektit perceptues;

i. Të mësuarit perceptiv – Formë e të mësuarit ku të dhënat elementare shqisore grupohen në tërësi të veçanta dhe, duke u kombinuar me informacione të kujtesës, mundësojnë perceptimin dhe njohjen e saktë të mjedisit fizik, biologjik e social dhe përbërësve të tyre. Nëse objekt i leximit të një përmbajtjeje është dallimi, perceptimi i raporteve të caktuara ndërmjet fjalëve, atëherë rezultat i këtij perceptimi është formimi i një ndryshimi progresiv në perceptimin e raporteve ndërmjet fjalëve gjatë procesit të leximit;

j. Theksimi perceptiv – Ndikimi i faktorit shoqëror në ndryshimin perceptiv të një objekti. Personalitetet shkencore, krijuesit e artit, personalitetet politike, ushtarake etj. perceptohen më të bukur, më të gjatë, më të veshur mirë etj., se sa janë objektivisht. Psikologët amerikanë Xherom S. Bruner (Jerome S. Bruner, 1915) dhe Luis Gutman (Louis Guttman, 1916) kanë argumentuar se fëmijët e varfër i kanë perceptuar monedhat metalike prej 5, 10, 15 e 20 cent më të mëdha dhe me vlerë më të madhe se ato monedha që kishin të pasurit (edhe pse me vlerë më të madhe se to).

PERCEPTUALIZ/ËM, - MI. m. Pikëpamje psikologjike mbi rëndësinë parësore të perceptimeve në njohjen e realitetit objektiv. Sipas perceptualizmit vetëm perceptimet e dukurive, të objekteve, të proceseve etj. janë burim i vetëm i dijes dhe i njohjes së realitetit. Realiteti dhe modalitetet e tij, përkatësisht gjësendet dhe cilësitë, dukuritë e ndryshimet, ndërlidhjet e objekteve e të dukurive, si edhe ato ndërmjet cilësive reale janë ashtu si i paraqiten njeriut. Pikëpamja e këtillë ka më tepër karakterin e mendimit të përgjithshëm për realitetin, që është shtrirë në mendimin filozofik se në mendimin psikologjik. Njohja thelbësore e realitetit me të gjitha format dhe ndërlidhjet e tij njihet me anë të mendimit dhe, në këtë njohje, perceptimi luan rolin e tij, por njohja e realitetit është e pamundur të rrëgjohet në perceptime. Perceptualizmi është i pranishëm shumë rrallë në historinë e mendimit psikologjik.

Burimet:

Paul J. Barber & David Legge: "*Perception and Information*" – ("*Perceptimi dhe informimi*"), Methuen, London, 1976.

Nils Birbaumer & Robert F. Schmidt: "*Biologische Psychologie*" – ("*Psikologjia biologjike*"), Berlin, 1990.

Vicky Bruce & Patrick R. Green & Mark A. Georgeson: "*Visuel perception. Physiology, psychology and ecology*" – ("*Perceptimi pamor. Fiziologjia, psikologjia dhe ekologjia*"). Hove East Sussex, UK: Psychology Press, 1996.

James J. Gibson: "*Die Sinne und der Prozes der Wahrnehmung*" – ("*Shqisat dhe procesi i perceptimit*"), Bern, Suttgatrt: Huber, 1973.

Ralph N. Haber & Maurice Hershenson: "*The Psychology of Visual Perception*" – ("*Psikologjia e perceptimit pamor*"), New York: Holt, Rinehart and Winston (botimi i dytë), 1980.

Charles G. Morris & Albert A. Maisto: *"Psikologjia – shkenca e proceseve mendore dhe e sjelljes njerëzore*" (përkthim nga anglishtja), Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë, 2008, fq. 84 – 121.

PERIFERI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *περιφέρεια* "sipërfaqja ose pjesa e jashtme e një organi". Termi ka kuptim të përgjithshëm, por në psikologji

përdoret në raste të veçanta. Në psikofiziologji termi periferi ka kuptimin e neuroneve aferente dhe eferente, që lidhin sipërfaqen e organizmit dhe organet sipërfaqësore të tij me Sistemin Nervor Qendror. Me termin periferi emërtohen edhe proceset psikike më të rëndësishme që janë të lidhura me qendra trunore të larta. Kur përdoret si mbiemër emërton organet periferike të trupit të organizmit dhe funksionet e tyre për të reaguar ndaj ngacmuesve të mjedisit të jashtëm, si edhe me reagimin e shqisave dhe të muskujve ndaj tyre.

PERIFERIA E RRJETËZËS. Periferia e rrjetëzës ose e retinës së syrit është zona pamore më e largët nga gropëza e saj, përkatësisht nga *fovea*. Kufizimi i kësaj zone është i paqartë. Në këtë zonë nuk ka qeliza konike ose kunjëza receptore. Kjo mungesë e kunjëzave shkakton pamjen vetëm bardh e zi. Në këtë zonë, të parit e dukurive (e ylberit, e gjethes së gjelbër, e ngjyrës së kuqe të trëndafilit etj.), jo vetëm që është pamje akromatike, por parja e tyre është në këtë zonë pamje e mjegulluar dhe me nivel të ulët të mprehtësisë.

PERIFERIK, - E. mb. Që i përket periferisë së organizmit, që përcakton organet periferike, strukturën anatomike dhe proceset që zhvillohen kryesisht në periferi të organizmit. Me këtë mbiemër hasen këta togfjalësha të terminologjisë psikologjike e psikofiziologjike:

a. **Disleksioni periferik –** Vështirësi në rinjohjen e fjalëve dhe të kuptimit të tyre. Kjo vështirësi nuk është e lindur, por shkaktohet nga çrregullimet neurofiziologjike dhe nga faktorët psikogjenë;

b. **Nervi periferik** – Neuroni dhe pjesët e tij që shtrihen jashtë zgavrës së kafkës dhe jashtë kolonës vertebrore, duke nervëzuar organet periferike të organizmit. Nervat periferike janë bashkuara në ganglione të posaçme;

c. **Parja periferike** – Pamje e objekteve dhe e cilësive të tyre me anën e skajeve të rrjetëzës apo të retinës së syrit. Parja me skaje të rrjetëzës apo të retinës shkakton mprehtësi të dobët për dallimin e objekteve dhe të cilësive të tyre, por njëkohësisht rrit pragun e ndjeshmërisë së ngacmuesve pamorë me intensitet të ulët;

d. **Sistemi Nervor Periferik** – Pjesë e sistemit nervor që shtrihet jashtë kafkës dhe kolonës vertebrore. Shih – ***SISTEMI NERVOR PERIFERIK***.

PERIFRAZ/Ë, - A. Trup stilistik, me anën e të cilit një individi, por edhe një dukurie, një gjësendi etj., i atribuohet zakonisht tipari karakteristik dhe më i rëndësishëm i pikëpamjes, qëndrimit dhe i sjelljeve të qëndrueshme. Në perifrazë, në vend të emrit të vërtetë, emërtohet tipari kryesor i personalitetit dhe i karakterit të tij. Kështu, mendim perifrazik është shprehja "Luani i Krujës" për Skënderbeun, "Kancelari i Hekurt" për Bismarkun, "Mendjemprehti i teorisë së relativitetit" për Ajnshtajnin etj.

PERIMETËR, - I. m. Instrument i të provuarit të shtrirjes së fushës së të parit dhe të shkallës së ndjeshmërisë së retinës, pra dallimi i gjithë asaj që njeriu sheh me një sy, kur të parit me një sy është i drejtuar në të njëjtën pikë të horizontit.

PERIODIZIMI I ZHVILLIMIT PSIKIK TË NJERIUT. Ndarja e

zhvillimit psikik e fizik të njeriut në periudha të veçanta kohore sipas veçorive të zhvillimit të tij. Procesi i përbashkët i zhvillimit të njeriut ndahet në këto periudha:

1. **Periudha e paralindjes** – Faza e fekondimit të vezës, e krijimit të embrionit dhe e fetusit që zgjat prej 0–280 ditë;
2. **Periudha e paslindjes** – Zhvillimi i fëmijës pas lindjes ndahet në këto faza: faza e të porsalindurit (prej ditës së lindjes së foshnjës dhe prerjes së kërthizës deri në mbarimin e muajit të parë); faza e ushqimit me gji (viti i parë);
3. **Fëmijëria** – Zhvillimi i fëmijës deri në moshën 14 vjeç. Ndahet në këto faza: fëmijëria e hershme (prej 1–7 vjeç), fëmijëria e mesme (prej 7 – 11 vjeç) dhe fëmijëria e vonë (prej 11–14 vjeç).
4. **Rinia** – Zhvillimi i të riut/të resë prej moshës 14-vjeçare deri në moshën 21-vjeçare. Ndahet në dy faza: rinia e hershme (prej 14–16 vjeç) dhe rinia e vonë (prej 16–21 vjeç).
5. **Pjekuria** – Zhvillimi dhe jeta e njeriut prej moshës 21-vjeçare deri në moshën 60-vjeçare.
6. **Pleqëria** – Jeta e njeriut prej moshës 60-vjeçare e tutje. Shih – ***MOSHA E PLEQËRISË***.

PERIPECI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *περιπέτεια* "kthesë". Termi peripecia ka kuptim të përgjithshëm dhe të veçantë. Kuptimi i përgjithshëm ka të bëjë me kthesën vendimtare. Kuptimi i veçantë i përket pengesave të papritura dhe të vështira për t'u kapërcyer që paraqiten gjatë aftësimit për punë, përsosjes arsimore, profesionale e shkencore gjatë procesit të punës etj. dhe shkaktojnë kthesë në veprimtarinë dhe në zhvillimin e njeriut.

PERIUDH/Ë, - A. f. Term i përgjithshëm që në psikologji emërton kohëzgjatjen e një dukurie, gjendjeje, procesi etj. që ka lëvizje ciklike dhe lëvizje rrethore. Në këtë kuptim bëhet fjalë për periudhën e latencës, periudhën e zhvillimit psikoseksual, periudhën e gjumësisë etj.

PERIUDHA E LATENCËS. Koha e qetësimit të fshehtë të funksionit të shtytësit seksual gjatë zhvillimit të furishëm seksual të fëmijës. Termi periudha e latencës haset kryesisht në literaturën e psikanalizës. Sipas këtij burimi periudha e latencës fillon nga përfundimi i vitit të pestë të zhvillimit të fëmijës dhe zgjat deri rreth vitit të dymbëdhjetë të tij, përkatësisht deri në fillim të pubertetit. Gjatë këtyre gjashtë viteve zhvillimore të fëmijës interesimi seksual i saj është dobësuar dhe gati nuk shfaqet fare. Gjatë periudhës latente energjia psikike drejtohet dhe përqendrohet në zhvillimin kognitiv, moral dhe shoqëror. Periudha e latencës përfundon me hyrjen e zhvillimit të fëmijës në fazën e pubertetit, përkatësisht deri rreth vitit të dymbëdhjetë**.**

PERIUDHA INFANTILE. Shtrirja kohore e zhvillimit fizik, social e psikik të foshnjës. Në psikologji kjo është periudha e zhvillimit të foshnjës deri në moshën njëvjeçare. Në terminologjinë juridike kjo është periudha e zhvillimit deri në moshën tetëmbëdhjetëvjeçare, madje edhe deri në moshën njëzetenjëvjeçare.

PERIUDHA KRITIKE. Periudhë e caktuar në pikëpamjen hereditare gjatë

zhvillimit të organizmit të kafshëve dhe të njeriut, kur këto arrijnë pikën më të volitshme të të mësuarit të një modeli sjelljeje, të një procesi psikik etj. Zogjtë e patave një ditë pas lindjes duhet të fillojnë të notojnë, fëmija deri në moshën trevjeçare duhet të fillojë të mësojë të flasë etj. Nëse pas kësaj moshe nuk arrijnë t`i zotërojnë modelet e sjelljeve, atëherë këto modele mësohen me vështirësi të mëdha.

PERIUDHAT E ZHVILLIMIT KOGNITIV. Kohëzgjatja e ndryshimeve kognitive gjatë zhvillimit të fëmijëve që përfshin zhvillimin e proceseve njohëse të fëmijës që zhvillohen mbi bazën vetërregulluese duke u përsosur vazhdimisht, pra duke u bërë gjithnjë e më shumë efikase në njohjen e realitetit objektiv e subjektiv. Periudha e zhvillimit kognitiv i atribuohet pikëpamjes së psikologut zviceran Zhan Pijazhe (Jean Piaget, 1896 – 1980). Sipas tij zhvillimi kognitiv realizohet përmes këtyre katër fazave të kësaj periudhe:

a. **Faza sensomotorike** – Koha e zhvillimit të inteligjencies sensomotorike, që zgjat deri para mbarimit të vitit të dytë të zhvillimit të fëmijës. Kjo është koha e kalimit të fëmijës nga zhvillimi biologjik në zhvillimin psikologjik të tij. Gjatë kësaj kohe te fëmija fillojnë të zhvillohen konceptet e para për hapësirën, kohën etj.;

b. **Faza paraoperacionale** – Koha e zhvillimit të fëmijës ndërmjet njëviti e gjysmë deri rreth vitit të shtatë e të tetë. Gjatë kësaj kohe zhvillohen funksionet semiotike, përkatësisht funksionet simbolike. Përfaqësimin e zhvillimit të mendimit të saj me anë të simboleve të veçanta fëmija është në gjendje ta shfrytëzojë, por gjatë kësaj faze ajo nuk i ka të zhvilluara operacionet e të menduarit;

c. **Faza e operacioneve konkrete** – Koha e shfaqjes së funksioneve të grupimit të objekteve sipas veçorive të përbashkëta, e klasifikimit, e numërimit etj. Kjo fazë zgjat prej moshës shtatë-tetë vjeç deri në moshën njëmbëdhjetë – dymbëdhjetë vjeç. Në këtë fazë shfaqet dukuria e mendimit të konservimit, e mosndryshimit të sasisë, të madhësisë, të numrit etj. të objekteve, pavarësisht nga ndryshimet sipërfaqësore të tyre;

d. **Faza e operacioneve formale të mendimit** – Fazë që karakterizon zhvillimin e mendimit në bazë të emërtimit fjalësor të objekteve, të ngjarjeve etj., duke mos pasur nevojë që fëmija të mendojë vetëm në fushën e konkretes. Kalimi bëhet nga përfytyrimi i objekteve, i dukurive etj. në konceptimin e tyre dhe në shfrytëzimin e emërtimit fjalësor të gjithë asaj që më parë gjendej në fushën konkrete të fëmijës. Kjo është faza e fundit e periudhës së zhvillimit kognitiv, që zgjat prej moshës 11–12 vjeç deri në moshën 15–16 vjeç.

PERLS S. Frederik (Frederick S. PERLS). Psikolog gjerman, i njohur më tepër si Fritz (Fric) Perls. Lindi në Berlin më 1893 dhe vdiq në Çikago. më 1970. U diplomua për mjekësi më 1926. Punoi si mjek në Institutin Ushtarak të Frankfurtit për Lëndime të Trurit. Këtu u njoh me psikologjinë geshtaltiste, me filozofinë ekzistenciale dhe me neofrojdistët Karen Hornei dhe Vilhelm Rajh. U largua nga Gjermania e Adolf Hitlerit duke u vendosur në fillim në Holandë dhe pas

pak kohe në Afrikën e Jugut. Por, në fillim të viteve `30 të shekullit të njëzet u vendos në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe qëndroi më shumë në Esalen në Big Suru të Kalifornisë. U shkollua në kohën e përhapjes së psikanalizës. Libri i Paul Gutmanit e Ralf Heferlineut me titull "*Terapia geshtaltiste*: *shqetësim dhe rritja e personalitetit njerëzor*" i bëri përshtypje të thellë. Mbi përvojën e fituar dhe ndikimin e psikologjisë geshtaltiste u mënjanua nga terapia psikanalitike dhe vuri në zbatim seancat polemizuese me pacientin, formë që ai e quajti mënyra më e mirë e thyerjes së "armaturës psikologjike" dhe e çlirimit të vërtetë të unit të gjallë të njeriut. Konceptoi zbatimin e terapisë geshtaltiste karakteristike dhe themeloi më 1952 Institutin për Terapi Geshtaltiste në Nju Jork, së bashku me bashkëshorten, Laurën. Metodën e kësaj terapie e ka përshkruar dhe shpjeguar në punime dhe në vepra të botuara. Vepra kryesore e Frederik Perls është: *"Gestalt Therapy: Excitement and Growth in the Human Personality"* – (*"Terapia Geshtalt: Shqetësimi dhe rritja epersonalitetit njerëzor"*) (me bashkëpunëtorë), 1951.

PERMISIVITET, - I. m. I ardhur nga latinishtja *permission* "lejim", që përdoret rrallë në shqipe, por haset shpesh në terminologjinë e psikologjisë të personalitetit dhe të psikologjisë zhvillimore. Permisiviteti emërton konceptin e qëndrimit dhe të tiparit të personalitetit që ka të bëjë me raportin tolerant dhe liberal të një individi ndaj bindjes, mendimit, pikëpamjes, qëndrimit, vlerave dhe ndaj sjelljes së dikujt, sidomos ndaj të drejtave dhe lirive të atyre që gjenden në një moshë më të vogël dhe në pozicion shoqëror e profesional më të ulët. Permisiviteti me këtë kuptim nuk nënkupton mungesën e raportit kritik ndaj mendimit, qëndrimit, vlerave etj. të të tjerëve. Permisiviteti në psikologjinë zhvillimore nënkupton lirinë e madhe ndaj kërkesave dhe sjelljeve të lira të fëmijëve, pra qëndrimin dhe sjelljen kundër ndalesave, kufizimeve të mendimit dhe kufizimit të formave të ndryshme të sjelljeve të fëmijës.

PERSEVERANC/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *perseverare* "qëndrueshmëri". Termi perseverancë haset rrallë edhe në terminologjinë e psikologjisë. Perseveranca ka tri kuptime: 1) Kuptimi i parë emërton kuptimin e qëndrueshmërisë, të këmbënguljes, të ngulmit, të synimit etj. të njeriut në pikëpamjen, qëndrimin, synimin etj. dhe në vazhdimin e sjelljeve dhe veprimeve karakteristike të lidhura me ngulmimin e tij, ngulmim i cili çon herë pas here në sjellje të papërgjegjshme. 2) Kuptimi i dytë emërton prirjen e kthimit të herëpashershëm në kujtime dhe në mendime të lidhura me ndjenja të fiksuara, duke mos pasur arsye për t`iu kthyer atyre kujtimeve, mendimeve dhe ndjenjave. Prirja e tillë herë-herë merr përmasa patologjike. 3) Kuptimi i tretë ka të bëjë me përsëritjen e vazhdueshme të fjalëve dhe mendimeve të njëjta pa ndonjë shkas të posaçëm. Perseveranca është njëra ndër simptomat e atyre individëve që kanë shkallë të ulët të inteligjencies.

PERSISTENC/Ë, - A f. Term i ardhur nga latinishtja *persistere* "persistoj", që në shqipe ka domethënien e ngulmimit,

të këmbënguljes, të qëndrueshmërisë. Në psikologji termin persistencë e hasim më tepër në psikologji të personalitetit, të qëndrimeve, sidomos të paragjykimeve. Kështu, thuhet "paragjykimet janë persistuese", d.m.th., janë të qëndrueshme, janë ngulmuese; nuk ndryshojnë lehtë etj."

PERSISTENCA E NDIJIMEVE. Dukuria e ndijimeve, që ka të bëjë me kohëzgjatjen e shkurtër të ndijimeve pas kohës së ndërprerjes së ndikimit të ngacmuesit në shqisat edhe në receptorët përkatës të shqisave. Shkak i dukurisë së persistencës së ndijimeve është përzgjatja e procesit ndijimor të organit të ndijimit edhe pas ndërprerjes së ndikimit të ngacmuesit në këtë organ, pra kjo dukuri ndodh për shkak se aktiviteti neurofiziologjik i aparatit ndijimor shuhet shkallë-shkallë. Shih – ***PASNDIJIMI.***

PERSON, - I. m. I ardhur nga latinishtja *persona* "vetja, individi". Termi individ përdoret në të folurin me kuptim jo fort të përcaktuar. Në shqip termi person ka kuptimin e njeriut të dalluar, të njeriut të fortë. Ky term në teatrin klasik romak ka emërtuar maskën, që aktori e ka vënë në kokë për të shprehur rolin e tij. Në disa disiplina termi person ka kuptime të posaçme. Sipas fesë *person* është individi që ka mend, vetëdije, moral dhe vullnet të lirë. Në disiplinat e shkencave juridike termi person emërton individin, që është bartës i të drejtave dhe detyrimeve qytetare të një vendi. Këtu termi person shpesh përdoret në formë të togfjalëshit. Kështu, togfjalëshi "Persona non grata" ka kuptimin e individit të padëshirueshëm. Në psikologji secili njeri normal ka "maskën"e vet që shfaqet me rolin e tij në mjedisin familjar e shoqëror dhe me rolin e tij dallohet nga të gjithë të tjerët, duke mbrojtur njëkohësisht individualitetin e tij nga ndikimet e ndryshme që vijnë nga jashtë. Por, edhe në kuadrin e psikologjisë termi person emërton edhe kuptime të tjera. Në psikologjinë komplekse të Karl G. Jungut (Carl G. Jung, 1875 – 1961) termi *person* emërton "sistemin e ndërlikuar të marrëdhënieve ndërmjet vetëdijes individuale dhe shoqërore, maskën e përshtatshme, e cila, në njërën anë, është formuar për të lënë përshtypje të caktuar tek të tjerët dhe, në anën tjetër, për ta mbuluar natyrën e vërtetë të personit". Kjo është pamja e jashtme e njeriut, i cili u është drejtuar të tjerëve, mjedisit të tij dhe ka mësuar të dallojë këtë shtresë të jashtme, pra këtë maskë nga përmbajtja e brendshme psikologjike, sociale e morale e tij. Shih – ***INDIVIDI***.

PERSONAL, - E. mb. Që i përket individit, që ka tipare psikologjike karakteristike thelbësore për një individ të veçantë. Me mbiemrin personal janë ndërtuar disa togfjalësha të psikologjisë së personalitetit, të tillë si:

a. **Determinanti personal** – Shkaku kryesor i sjelljes së një individi në një situatë të caktuar ose në situata të njëjta a të ngjashme;

b. **Dispozita personale** – Komponente përbërëse e personalitetit me të cilën përcaktohet konsekuenca e sjelljeve të një individi. Ky term i përket psikologjisë së personalitetit të Gordon V. Olportit (Gorgon W. Allport, 1897 – 1967), sipas të cilit dispozita personale është: "strukturë e përgjithshme neuropsikike (karakteristike për individin),

e aftë që shumë ngacmues t`i bëjë ekuivalentë funksionalë dhe të sjellë e të drejtojë formën (ekuivalente) të përshtatjes së personalitetit stilit të sjelljeve";

c. **Hapësira personale** – Hapësira me kufij dallues ndërmjet një individi dhe individëve të tjerë brenda një mjedisi hapësinor të posaçëm. Kufijtë e këtillë kanë karakter personal, e ndryshojnë prej një individi te tjetri. Ruajtja dhe respektimi i këtyre kufijve nga ana e vet individit është veti e tij. Kjo veti dallohet në reagimin e menjëhershëm të tij sapo individi tjetër të cenojë kufirin apo kufijtë e tillë;

d. **Konstruktet personale** – Entitete të veçanta të sistemit të sjelljeve të një individi. që nënkuptojnë të gjithë përbërësit strukturorë psikologjikë të tij. Ky term haset kryesisht në psikologjinë e psikologut amerikan Xhorxh Keli (Georg Kelly, 1905 – 1966);

e. **Pavetëdija personale** – Përvojë e vetëdijshme e formuar gjatë zhvillimit individual, por ngaqë i është kundërvënë unit të njeriut është bartur në pavetëdijen e njeriut. Struktura e pavetëdijes personale përbëhet nga komplekse dhe nga zhvillimi i pamjaftueshëm ose nga moszhvillimi i aftësive dhe i funksioneve të tyre. Kjo strukturë, megjithatë, është afër vetëdijes dhe formon shtresën sipërfaqësore të personalitetit dhe komunikon lehtë me atë të vetëdijes dhe të pavetëdijes kolektive;

f. **Pavarësia personale** – Sistem tiparesh të sjelljeve personale të lidhura me botëkuptime, pikëpamje, motive etj. të caktuara, që janë karakteristike për një individ. Në këtë rrafsh ka dallime individuale, si edhe dallime brenda psikologjisë së një individi. Kështu emërtohet dallimi midis asaj që individi dëshiron të arrijë në një mjedis dhe asaj që atë dëshirë ai ka arritur ta plotësojë në nivelin e caktuar. Ky dallim në terminologjinë e psikologjisë së personalitetit emërtohet edhe me termin disjunksion personal.

PERSONALITET, - I. m. Një nga termat kyç të psikologjisë, sidomos të psikologjisë së personalitetit. Është tërësi e organizuar tiparesh karakteristike dhe të papërsëritshme të konstruktit trupor, të inteligjencies, të karakterit, të temperamentit, të sistemit të qëndrimeve, të motiveve, të vlerave dhe të sjelljeve relativisht të qëndrueshme dhe konsekuente të një individi, që zhvillohen dhe formohen me veprimtarinë e ndërsjellë të njeriut dhe të faktorëve mjedisorë. Kjo tërësi e tipareve psikologjike është veçori thelbësore e qenies njerëzore, ka komponente të lindura dhe zhvillohet në bashkëveprim me faktorët personalë e social-kulturorë të një mjedisi të caktuar. Një përkufizim i tillë ka qenë i mundur të nxirret nga shumë përkufizime për personalitetin. Nga rreth 50 përkufizime të tilla përmendim tri më të rëndësishmet: 1) Sipas Gordon Olportit (Gordon V. Allport, 1897 – 1967) personaliteti është "organizim dinamik i atyre sistemeve psikofizike përbrenda individit, që përcaktojnë sjelljen karakteristike dhe mënyrën karakteristike të mendimit të tij". 2) Për psikologun amerikan Rajmond B. Katel (Reymond W. Cattell, 1905 – 1998) personaliteti është "tërësia e sjelljeve që na tregon se çfarë do të bënte njeriu kur të gjendej në rrethana të dhëna". 3) Për L. A. Pervinin

personaliteti është "tërësi strukturore dhe dinamike e tipareve të një individi që manifestohet në reagimet karakteristike ndaj situatave". Sipas shkollës psikologjike të Zagrebit "Personaliteti është tërësi gjithëpërfshirëse, integrim tiparesh të një individi në një organizim relativisht të qëndrueshëm dhe unik, që e mbisundon veprimtarinë e tij në mjedisin e ndryshueshëm, e formon dhe e ndryshon këtë veprimtari me ndikimin e kësaj veprimtarie" etj. Nga këto dhe të tjera përkufizime kuptojmë se përkufizimi i personalitetit në psikologji është ndër përkufizimet më të ndërlikuara dhe më të vështira.

Burimet:

William Stern: *"Über psychologie der Individuellen Differencen"* – (*"Psikologjia e dallimeve individuale"*), Berlin, 1900.

Gordon Allport: *"Personality: A Psychological Interpretation"* – (*"Personaliteti: interpretimi psikologjik"*), 1937.

Andras Angyal: *"Foundations for a Science of Personality"* – (*"Bazat e shkencës së personalitetit"*), Oxford University Press, 1941.

Theodor W. Adorno & Frenckel – Brunswik E. & Levinson J. Daniel & Stanford R. Nevit: *"The Authoritarian Personality"* – (*"Personaliteti autoritar"*), New York: Hapre & Row, 1950.

Nikolla Roti: *"Psikologjia e personalitetit"* (përkthim nga serbokroatishtja), Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, Prishtinë, 1966.

Theo Herrmann: *"Lehbuch der empirischen Persönlichkeitsforschung"* – (*"Libër për gjurmimet empirike të personalitetit"*), Göttingen: Hogrefe, 1972.

Sigmund Freud: *"Abris der Psychoanalyse"* – (*"Skica e psikanalizës"*), Frankfurt/M: Fischer, 1975.

John Radford & Richard Kirby: *"The person in Psychology"* – (*"Individi në psikologji"*), "Essential Psychology", Peter Heriot, Methuen, London, 1975.

Calvin S. Hall & Gardner Lindzey: *"Theories of Personality"* – (*"Teoritë për personalitetin"*), Third edition, John Wiley and Sons, New York, 1978.

Ante Fulgosi: *"Psihologija ličnosti"* – (*"Psikologjia e personalitetit"*), Školska knjiga, Zagreb, 1978.

Hans Jürgen Eysenck: *"A model for Personality"* – (*"Modeli i personalitetit"*), Berlin: Springer, 1981.

Walter Mischel: *"Introduction to personality"* – (*"Hyrje në personalitet"*), New York: Holt, Rinehart & Winston, 1981.

Manfred Amelang: *"Differentielle Psychologie und Personlichkeitsforschung"* – (*"Psikologjia diferenciale dhe gjurmimi i personalitetit"*), Mainz: Koohlhammer, 1985.

Lawrence A. Pervin: *"Personlichkeitstheorien"* – (*"Teoritë e personalitetit"*), Munchen: Renhardt, 1987.

Travis Bradberry & Jean Graves: *"The Emotional Intelligence"* – (*"Inteligjencia emocionale"*) (nga përkthimi), Sezam Book, Zrenjanin, 2006.

Lawrence A. Pervin & Oliver P. John: *"Personality"* – (*"Personaliteti"*), John Willey & Sons, Inc. New York – Chichester – Brisbane – Toronto – Singapore, 1997.

Gian Vittorio Caprara & Daniel Cervone: *"Personality – Determinants, Dynamics and Potencials"* – (*"Personaliteti – Përcaktuesit, dinamika dhe potencialet"*), University Press of Cambridge, 2000.

PERSONALITETI ANTISOCIAL. Personalitet me strukturë uniteti të atyre tipareve mbi të cilat zhvillon sjellje agresive, destruktive, dhunime etj. ndaj anëtarëve të tjerë të shoqërisë së një mjedisi të caktuar. Personalitetet e tillë i karakterizon zhvillimi i pamjaftueshëm ose edhe moszhvillimi i ndërgjegjes, mungesa e rregullatorëve të brendshëm moralë (mungesa e parimeve dhe e normave morale – përbërëse të ndërgjegjes), si edhe moszhvillimi i ndjenjës ndaj detyrave

e përgjegjësive shoqërore, mungesa e ndjenjës së fajit dhe e pendimit për të keqen, që me sjelljet e tij i shkakton mjedisit shoqëror. Personalitete antisociale janë: narkomanët, vjedhësit, vrasësit etj. Disa nga sjelljet antisociale fillojnë të zhvillohen që nga fëmijëria, si: arratisja nga familja me ditë të tëra, rrahja me të tjerët, vjedhja etj. Disa nga këto sjellje marrin përmasën e tiparit të sjelljeve edhe në moshën e rritur (asgjësimi i pasurisë, mospasja e ndjenjës së dinjitetit njerëzor, mosangazhimi i mjaftueshëm dhe i duhur në vendin e punës, moskryerja e detyrimeve financiare etj.

PERSONALITETI AUTENTIK. Emërtim i individit të lirë, të natyrshëm dhe krijues, i cili duke zotëruar vështirësi dhe pengesa zhvillimore arrin t`i zhvillojë dispozitat krijuese dhe fuqitë njerëzore. Termi personalitet autentik ose burimor haset në veprat psikologjike të Abraham Maslout (Abraham H. Maslow, 1908 – 1970). Për këtë studiues ky term ka kuptim të njëjtë me termin personaliteti vetaktualizues. Termi *personalitet autentik* haset edhe te Karl R. Roxhers (Carl R. Rogers,1902 – 1987) dhe në disa vepra të Erik Fromit (Erich Fromm, 1900 – 1980), dhe ka kuptim të njëjtë me termin *karakteri produktiv*.

PERSONALITETI AUTONOM. Personalitet i pavarur në zhvillimin e mendimeve të veta, sidomos në marrjen e vendimeve per sjelljet e tij. Ky tip personaliteti nuk ndikohet lehtë nga autoritet e çdo lloj rangu. Ky është një ndër tiparet e personalitetit në psikologjinë humaniste të Abraham H. Maslout (Abraham H. Maslow, 1908 – 1970).

PERSONALITETI AUTORITAR. Individi që mbështetet në autoritetin e pranuar dhe të respektuar, që kërkon dëgjueshmëri nga të nënshtruarit, që shfaq prirjen e nënshtrimit të atij apo atyre që gëzojnë autoritet, që verbërisht u nënshtrohen të tjerëve, që kanë prirjen e ndëshkimit dhe të dënimit të të dobëtve dhe të të nënshtruarve, mostolerimin, destruktivitetin dhe cinizmin. Personaliteti autoritar është integritet qëndrimesh, vlerash, tiparesh dhe sjelljesh antidemokratike. Ky term me kuptimin e mësipërm i atribuohet sociologut gjerman Teodor Adornos (Theodor Adorno, 1903 – 1969). *Personaliteti autoritar* dhe sjelljet e tij maten me shkallën F, përkatësisht me shkallën për matjen e qëndrimeve ndaj ideologjisë fashiste. Kjo shkallë provon nëntë veti sjelljesh karakteristike që shprehin qëndrime të mirëfillta të antisemitizmit, të egocentrizmit dhe të konservatorizmit.

PERSONALITETI I VETAKTUALIZUAR. Individi dhe personaliteti i tij në psikologji, i cili ka arritur t`i realizojë plotësisht fuqitë, kapacitetet dhe aftësitë e tij. Personalitet i vetaktualizuar është ai që ka arritur pjekurinë psikike të plotë dhe që ka arritur të zhvillojë 15 tipare, të tilla si: autonomia e mendimit, freskia e përhershme e përjetimeve, kuptimësia e bërjes humor me qëllim, kreativiteti, nevoja për tërheqje, përjetimi i qartë i gjendjeve kulmore, ndjenja e përbashkësisë dhe identifikimi me njerëzimin, perceptimi objektiv i realitetit, pranimi i vetes dhe i të tjerëve ashtu siç janë, qëndrueshmëria ndaj mospranimit të kulturimit, spontaniteti i sjelljes, përqendrimi në probleme të ndryshme para

përqendrimit në veten e tij, struktura demokratike e karakterit, varësia etike, zhvillimi i raporteve të ngrohta me numrin e vogël të të zgjedhurve.

Burimet*:*

Carl Gustav Jung: *"Psikologjia e së pavetëdijshmes",* Vëllimi 2, Tiranë, 2003.
Kurt Goldstein: *"Der Aufbau des Organismus"*– (*"Struktura e organizmit"*), 1934.
Carl Rogers: *"Person to Person: the Problem of Being Human"* – (*"Personi drejtë personit: problem i të qenit njerëzor"*), New York, 1971.
Abraham H. Maslow: *"Drejt psikologjisë së qenies",* Plejad, Tiranë, 2009.

PERSONALITETI KOMPULSIV. Personalitet me sjellje të çrregulluara, që është karakteristik për individin me tipare të sjelljeve kompulsive, por që këto sjellje kanë marrë karakter të qëndrueshëm. Sjelljet e këtilla nxiten nga tiparet e personalitetit kompulsiv. Të tilla tipare janë: kujdesi i tepruar për pastërti e rregull në veshje e në higjienën trupit, zbatimi i pakontestueshëm i rregullave të mësuara, i normave, i parimeve etj. Në kryerjen e këtyre sjelljeve kompulsive personaliteti kompulsiv shtyhet kryesisht nga frika.

PERSONALITETI MANA. Në psikologjinë analitike të Karl G. Jungut (Carl G. Jung, 1875 – 1998) personifikon njeriun magjik të përsosur dhe të fuqishëm, që ndien në çdo çast fuqinë e ndritur nga brendia e tij. Kjo fuqi ndriçon një individ tjetër, shoqërinë dhe mjedisin e tij. Zakonisht këta janë individë narcizoidë, që besojnë në karizmën e tyre, në fuqinë e tillë të nënshtrimit të quajtur "Mana". Mana është një figurë arketipe, që paraqitet në formën e babait të fuqishëm, të djallit, të mendimtarit të madh etj., të cilën individi e ndien dhe kjo figurë bëhet qendër e botës së brendshme të tij.

PERSONALITETI MULTIPËL. Term i vjetër i psikopatologjisë që emërton atë çrregullim të personalitetit, pra identitetin e personalitetit, kur personaliteti i tij përjetohet i shumëfishtë, përkatësisht kur ai ndahet në dy ose më shumë pjesë të pavarura njëra nga tjetra. Kjo ndarje herë-herë ndodh edhe te njerëzit normalë, sidomos kur një njeri i caktuar përjeton stres të fuqishëm. Ndarja e tillë merr formë patologjike, atëherë kur njeriu nuk është i vetëdijshëm që secila pjesë e ndarë ka ndjenja dhe forma të veçanta të sjelljes.

PERSONALITETI NARCIZOID. Personaliteti që ka si tipar karakteristik të mendimeve dhe të sjelljeve përqendrimin e energjisë psikike në veten e tij, e shumë më pak te të tjerët. Ky tip personaliteti dëshiron të jetë i dashur, por kurrsesi t`i dojë të tjerët. Personaliteti narciztik me shprehje dhe me sjellje ndaj të tjerëve lë përshtypje të njeriut të dashur, të përzemërt, të shoqërueshëm etj., por në thelb është josocial, cinik, i ftohtë etj.

PERSONALITETI NEUROTIK. Personalitet i ngjashëm me karakterin neurotik, madje ka raste kur këto dy terma përdoren në formë sinonimesh. Ndërmjet kuptimit të termit karakter neurotik dhe personalitet neurotik ekzistojnë ndryshime. Personaliteti neurotik i referohet më së shumti mendimeve dhe sjelljeve fëmijërore, duke përdorur herë-herë mekanizmat mbrojtës të personalitetit të tij. Nën ndikimin e prirjes së referimit të sjelljeve fëmijërore personaliteti neurotik nuk është në gjendje ta vlerësojë

realisht situatën familjare, ekonomike, ndërpersonale etj. Në perceptimin e situatave të reja te personaliteti neurotik ushtrojnë ndikim të fuqishëm frika, dëshira fëmijërore, shpresat etj. Nën ndikimin e energjisë së ndjenjave të tilla personaliteti neurotik gati është i pafuqishëm të vendosë për sjelljet e tij, të cilat ai nuk i njeh sa e si duhet.

PERSONALITETI SINDROMATIK. Personalitet, i cili përpos tipareve të përgjithshme, ka edhe disa tipare të tjera sjelljesh të ndërlidhura ndërmjet tyre, të cilat shfaqen në mënyrë karakteristike. I këtillë është personaliteti kompulsiv, objektiv, vetëbesues etj. Kështu, personaliteti kompulsiv është i lidhur me disa sjellje të ndërlidhura që i kryen, edhe pse këto sjellje nuk kanë arsye të kryhen (koprracia, sjellja pedante, përmbajtja e pashmangshme e rregullave dhe e normave të caktuara, përpikëria e tepruar etj).

PERSONALITETI SKIZOID. Çrregullim i përhershëm i personalitetit me këto veçori të proceseve psikike dhe të sjelljeve: besimi i çuditshëm në mendimet magjike, përjetimi jonormal i perceptimit të trupave e dukurive, të foluritt e çuditshëm, humbja e aftësisë së krijimit të marrëdhënieve shoqërore, përqendrimi në vetvete dhe largimi nga më të afërmit, indiferenca ndaj mjedisit dhe ndryshimeve të tij, ndjenjat e ftohta ndaj të tjerëve etj.

PERSONALITETI THEMELOR. Personalitet karakteristik i një mjedisi shoqëror, kulturor dhe ekonomik, si edhe i raporteve karakteristike të tyre, që është tipik për atë mjedis. Strukturën e personalitetit themelor e përbëjnë qëndrimet, vlerat tradicionale, tiparet karakteristike të sjelljeve të një bashkësie shoqërore dhe etnike. Kështu, Shqiptari me besën e tij dallon nga të tjerët, Malazezi me burrërinë ("cojstvo") e vet i përket vetëm mjedisit të tij etj. Këta individë me sjelljet e tyre ndryshojnë nga të tjerët. Personaliteti themelor është rezultat i përvojës së përbashkët të brezave të zhvilluar në truallin e përbashkët të raporteve shoqërore, kulturore dhe ekonomike ndër vite.

PERSONALIZ/ËM, - MI. m. Pikëpamje e përgjithshme që konsideron se personaliteti me integritetin, me konsekuencën e sjelljeve dhe me vlerat e tij karakteristike është konstrukti qendror me të cilin duhet të merret psikologjia dhe prej këtej duhet të fillojë studimi i psikologjisë. Objektivi përfundimtar i psikologjisë është njohja e personalitetit të lirë, e tërësisë biopsikologjike të njeriut konkret dhe të vetëdijshëm. Strukturat dhe funksionet e tjera psikike janë të rendit të dytë. Në literaturën e psikologjisë termi personalizëm haset edhe si sinonim i psikologjisë personalistike.

PERSONAZH, - I m. Individi imagjinar që i përket përmbajtjes së një vepre letrare, romani, fabule etj., që është subjekt përmbajtjesor i asaj vepre. Ky subjekt, pra personazhi në krijimet letrare, kinematografike, muzikore etj. i huazon tiparet emocionale, intelektuale dhe motivuese të njeriut, i cili pasqyrohet në një vepër krijuese. Skënder Bërmema është një nga personazhet në veprën e Ismail Kadares "Koncert në fund të dimrit". Personazhet e këtilla interpretohen në forma të ndryshme, por në thelb pasqyrojnë njeriun, individin e një situate

të caktuar, që përshkruhet e pikturohet në përmbajtjen e një vepre.

PERSONIFIKIM, - I. m. Figurë stilistike që krijohet kur i vishen një gjësendi tipare, veti dhe funksione shpirtërore. Personifikimi është atribuim i cilësive, tipareve dhe i vetive personale një grupi shoqëror, madje edhe një konstrukti abstrakt. Personifikimi është karakteristikë e zhvillimit të mendimit te fëmijët, por karakterizon edhe krijimtarinë letrare, si edhe mendimin psikologjik të shprehur në formën e metaforës, si figurat e karakterit të arketipave në psikologjinë komplekse të Karl G. Jungut (Carl G. Jung 1875 – 1961). Ka raste kur termi *personifikim* haset edhe me kuptimin e mekanizmit mbrojtës, kur një individ i atribuon individit tjetër vlera, ose, madje edhe të meta, për shkak të frustrimit.

PERSONOLOGJI, - A. f. Term i vjetër për psikologjinë e personalitetit, e pikërisht për studimin e personalitetit. Sipas personologjisë të gjitha strukturat, dukuritë, proceset psikike, tiparet dhe karakteristikat e tyre duhet të studiohen duke pasur si koncept themelor personalitetin dhe konceptet e ndryshoreve të tij. Në kohët më të reja psikologjia e personalitetit është stabilizuar si degë e disiplinave psikologjike me përfaqësues eminentë të saj: Henri A. Mar (Henry A. Murray, 1893 – 1988), Gordon V. Olport (Gordon W. Allaport, 1897 – 1967), Erik H. Erikson (Erik H. Erikson, 1902 – 1994), Hans J. Ajzenk (Hans J. Eysenck, 1916 – 1997) etj. Nga të gjithë këta studiues, në literaturën e psikologjisë përmendet më tepër personologjia e Henri A. Marit, e cili e mbështet shpjegimin e dinamikës së personalitetit në 28 motive, duke pohuar se kurrfarë sjellje e njeriut nuk mund të shpjegohet në formë të izoluar, por duhet të niset nga tërësia psikologjike, nga integriteti, uniteti, mospërsëritja dhe veçantia e personalitetit.

Burimet:

John Radford & Richard Kirby: *"The Individ in Psychology"* – (*"Individi në psikologji"*), Methuen, London, 1973.

Gian Vittorio Caprara: *"Personality – Determinants, Dynamics, and Potentials"* – (*"Personaliteti – Përcaktuesi, dinamika dhe mundësitë"*), Cambridge 2000.

Richard Kirby & John Redford: *"Individual Differences"* – (*"Dallimet individuale"*), Methuen, London, 1976.

Reymond B. Cattell: *"The Scientific Analysis of Personality"* – (*"Analiza shkencore e personalitetit"*), Chicago, Illinois, 1966.

C. George Boeree: *"Theories of Personality"* – (*"Teoritë e personalitetit"*), Përkthyer në shqip nga origjinali, Plejad, Tiranë, 2004.

Lawrence A. Pervin & Oliver P. John: *"Personality – Theory and Research"* – ("*Personaliteti – Teoritë dhe gjurmimi"*), 1997.

Hans J. Eysenck: *"The biologycal basis of personality"* – (*"Baza biologjike e personalitetit"*), 1967.

David Peck & David Whitlow: *"Aproaches to Personality Theory"* – (*"Qasje e teorive të personalitetit"*), Methuen, London, 1973.

Nazim Shtino & Anita Pilika: *"Personaliteti dhe çrregullimet e tij"*, Tiranë, 2001.

Arben Hoti: *"Psikologjia e personalitetit"*, Tiranë, 2009.

Lisa Di Plas: *"Psikologjia e personalitetit"*, Tiranë, 2008 (Përkthim nga italishtja).

Pajazit Nushi: *"Psikologjia e përgjithshme II – Njeriu dhe personaliteti i tij në psikologji"*, Prishtinë, 1999.

Emmanuel Mounier: *"Personalizmi"*, (Përkthim), Tiranë, 2000.

PERSPEKTIV/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *perspicere* "shoh", që përdoret edhe në të folurin e zakonshëm. Është

perceptim i një situate dhe i raporteve ndërmjet pjesëve dhe përmasave të tyre nga këndvështrimi i caktuar, duke siguruar qartësinë e duhur të largësisë, të shtrirjes dhe të veçantive të tjera të asaj situate nga ky këndvështrim më i përshtatshëm për individin. Një këndvështrim i tillë siguron edhe dallimin e vëllimit të një objekti. Perspektiva emërton edhe aftësinë e vështrimit të qartë të ndryshimeve të një procesi në të ardhmen, duke e vështruar këtë brenda raporteve reale të zhvillimit të tyre, por duke ruajtur vazhdimisht karakterin individual të këndvështrimit.

PERSPEKTIVA AJRORE. Paqartësi e figurës së objektit që formohet në rrjetëzën ose retinën e syrit për shkak të largësisë së tij nga perceptuesi. Është rezultat i kushteve atmosferike dhe kjo ndikon negativisht në perceptimin e largësisë dhe të thellësisë së objekteve.

PERSPEKTIVA GJATË LËVIZJES. Term i psikologjisë së psikologut amerikan Xhejms Xh. Gibson (James J. Gibson, 1904 – 1980), sipas të cilit, gjatë lëvizjes së njeriut figurat retinore të trupave rreth tij lëvizin njëra pas tjetrës në formë derdhjeje në një shtrat të pandarë. Këto figura lëvizin në përputhje me largësinë e tyre nga perceptuesi. Parja e tyre nga perspektiva e perceptuesit mundëson perceptimin e saktë të përmasave, duke theksuar edhe përmasën e thellësisë së objekteve lëvizorë.

PERSPEKTIVA KOHORE. Vështrim dukurish, procesesh e raportesh nga një largësi kohore e caktuar, duke e perceptuar ngjarjen e caktuar në kuadrin e së kaluarës, të tashmes dhe të së ardhmes.

PERSPEKTIVA VIJORE. Perceptim i pjesëve më të largëta të një objekti si pjesë më të afrueshme të tij, se sa pjesët e afërta të këtij objekti. Është faktor i perceptimit të madhësisë së objekteve, kur këta gjenden në largësi të ndryshme nga perceptuesi.

PERSPEKTIVIZ/ËM, - MI. m. Pikëpamje e përgjithshme e njohjes së dukurive, proceseve, trupave objektivë nga perspektiva e zhvillimit të interesave, motiveve, nevojave dhe të synimeve të njeriut. Vështruar nga ky perspektivizëm njohuritë e njeriut kanë karakter të ndryshueshëm, pra janë relative.

PERSUAZI, - A. f. Term i rrallë edhe në literaturën e psikologjisë, sidomos në atë të gjuhës shqipe. Termi ka ardhur nga latinishtja *persuasion* "bindje". Termi ka kuptim të posaçëm në psikologjinë politike, sociale, religjioze etj. Persuazia në këto disiplina ka kuptimin e komunikimit me dikë, me qëllim të bindjes së tyre për të përvetësuar argumentet e programit të një grupi, partie, sekti religjioz etj., pra me qëllim të organizimit të sjelljeve të tyre sipas përvetësimit të qëndrimeve, të vlerave etj. të atij grupi apo asaj partie politike. Suksesi në ndryshim të qëndrimeve, të bindjeve etj. varet nga saktësia e burimit të argumenteve, nga sistemimi i drejtë i tyre, nga aftësia verbale e paraqitësit të tyre, si edhe nga autoriteti i individit që paraqet kërkesa të caktuara. Në psikologjinë klinike *persuazia* është një tërësi procesesh dhe sjelljesh të drejtuara drejtpërdrejt dikujt, për ta bindur atë për mendime, qëndrime, bindje dhe sjellje të lidhura me to, por që janë të gabuara dhe nga ai kërkohet korrigjimi i tyre. Ky kuptim i termit

persuazi i atribuohet më tepër formave të psikoterapisë.

PERSUAZIBILITET, - I. m. Tipar i personalitetit të individëve që shprehin gatishmërinë për pranimin "pa kushte" të argumenteve, të qëndrimeve, të porosive dhe të vlerave. Proceset njohëse si edhe sjelljet e përgjithshme të këtyre individëve i nënshtrohen lehtë ndikimeve persuazike, pavarësisht nga burimi dhe shkalla e argumentimit real të porosive, qëndrimeve etj. nga të tjerët.

PERVERSION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *perversion* "çoroditje, shtrembërim". Termi perversion ka kuptim të përgjithshëm dhe të veçantë. Kuptimi i përgjithshëm ka të bëjë me procesin e mendimit, të emocioneve dhe me sjelljet çoroditëse e zvetënuese të individit, të cilat shoqëria i dënon. Në psikopatologji dhe në psikiatri termi perversion emërton kuptimin e shtrembërimeve dhe të shmangieve neveritëse të sjelljeve seksuale nga ato normale. Këtu hyjnë format e ndryshme të shmangieve seksuale, që kanë të bëjnë me dhunime seksuale dhe me keqtrajtim seksual të fëmijëve. Shih – ***PARAFILIA.*** Hulumtimit të shkaqeve të formave të ndryshme të perversioneve seksuale i ka kontribuar posaçërisht psikanaliza, sidomos me konceptin e shmangies së libidos nga objekti seksual parësor.

PESIMIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *pessimus* "më i keq", që ka përdorim të gjerë në të folurin e përditshëm dhe në disa disiplina të shkencave shoqërore, sidomos në psikologji. Pesimizmi konsiderohet doktrinë, sipas së cilës dukuritë e gjithësisë janë të këqija dhe të papërmirësueshme. Përmbajtja doktrinore e termit *pesimizëm* manifestohet në mosbesim të theksuar në përfundimin e ndryshimeve, të ngjarjeve, të proceseve etj. Në psikologji, sidomos në psikologjinë e personalitetit, pesimizmi është qëndrim i përgjithshëm dhe tipar i personalitetit, që fillon me vëzhgimin e gjithë asaj që ndodh në mjedisin e gjerë dhe të ngushtë nga këndi i dobësisë, i pashpresës, i së keqes, i zymtësisë, duke pritur vazhdimisht më të keqen nga kjo botë. Qëndrimi dhe tipari i pesimizmit është rezultat i socializimit të njeriut, kurse psikanaliza këtë e vë në kontekstin e frustrimeve të përjetuara gjatë fazës së zhvillimit oral të fëmijës.

PETIT MAL. Term i psikiatrisë i ardhur nga frëngjishtja që në shqip do të thotë sëmundje e vogël, përkatësisht sulm i vogël epileptik. Ky sulm manifestohet me ndërprerje të shkurtra kohore të kontrollit të vetëdijes mbi proceset dhe sjelljet e njeriut. Manifestohet më tepër te fëmijët. Shih – ***EPILEPSIA.***

PËRBËRËSIT E FITIMIT TË DIJEVE. Përbërës, të cilët formojnë një tërësi të pandarë për fitimin e informacioneve dhe të lidhjeve ndërmjet tyre. Komponentë të tillë janë: kodimi i informacioneve në kujtesën afatgjatë të njeriut, lidhja e informacioneve të reja me informacionet tashmë të përpunuara dhe të depozituara në kujtesën e njeriut.

PËRBËRJA KLASORE. Struktura e caktuar e shoqërisë e përbërë nga anëtarët e saj, të cilët u përkasin klasave të ndryshme shoqërore të asaj shoqërie (klasa e mesme, klasa punëtore etj.).

PËRBRENDËSI, - A. f. Përqafimi, pranimi dhe përvetësimi i bindjeve, i normave, i parimeve, i qëndrimeve, i

vlerave etj. të traditës kulturore të një mjedisi nga ana e një individi të atij mjedisi. Përbrendësia është proces dhe rezultat e të mësuarit, i përvetësimit të parimeve, të qëndrimeve, të vlerave etj. dhe përshtatja dhe organizimi i sjelljeve të njeriut sipas tyre. Psikanaliza këtë proces e mbështet në zhvillimin dhe formimin e super egos së një individi, ku rol të rëndësishëm luajnë prindërit dhe edukata familjare, duke përfshirë posaçërisht edukatën morale të familjes dhe të mjedisit të ngushtë e të gjerë, sidomos atë të edukimit shkollor. Në literaturën e psikologjisë dhe të psikanalizës në vend të termit përbrendësi përdoret termi ndërkombëtar internalizim.

PËRBUZ/JE, - JA. f. Ndjenjë e mospërfilljes së qenies njerëzore, e dinjitetit, e veprës dhe e fryteve të punës së tij. Përbuzja shfaqet te njeriu, i cili ka ndjesinë se dikush tjetër, me sjelljet negative ndaj tij e ka nënçmuar tërësinë e personalitetit dhe vlerat njerëzore themelore të tij. Përbuzja gjithmonë është e drejtuar ndaj dikujt ose ndaj një grupi individësh, ndaj qenies njerëzore, dinjitetit dhe vlerave të tyre. Përbuzja ka funksion të rëndësishëm shoqëror: mbron bazën morale e kulturore të një bashkësie të caktuar. Ai që shkel këtë konsiderohet se është përbuzës dhe ka ndjenjën e zhvlerësimit njerëzor. Në Deklaratën Universale për të drejtat e njeriut konsiderohet se njeriu me lindjen e tij gëzon të drejtën që të nderohet dhe të respektohet dinjiteti dhe njerëzishmëria e tij. Përbuzja është shkelje e kësaj të drejte të përgjithshme njerëzore.

PËRCAKTIM, - I. m. Qëndrim konkret i një individi ndaj tjetrit, ndaj të dhënave dhe ndaj raporteve konkrete të një situate. Përcaktimi ka bazë të fuqishme njohëse ose kognitive të përçuar pak nga ndjenjat. Struktura e tij ka të bëjë me idenë e përcaktuar saktësisht të mbështetur në besimin dhe bindjen e tij për saktësinë e saj. Këtu qëndron ndryshimi ndërmjet kuptimit të qëndrimit në tërësi dhe përcaktimit të njeriut ndaj njeriut, objektit dhe situatës konkrete. Njeriu i udhëhequr nga përcaktimet e tij kërkon sjellje të drejtuara dhe të organizuara ndaj një situate konkrete, ndaj ndryshimeve konkrete të asaj situate etj. Pavarësisht nga ndryshimet objektive të një objekti, apo situate ai përcaktohet mendërisht, duke njohur dhe duke pasur besim në njohjen e saj dhe, në varësi nga kjo njohje, ai i modifikon sjelljet e veta ndaj ndryshimeve të objektit dhe të situatës së caktuar.

PËRÇMIM, - I. m. Vlerësim i qëllimshëm mohues i rëndësisë së një vepre dhe i bartësit të saj, vlerësim negativ i rezultatit të punës së tjetrit, i rolit të njeriut në realizimin e një detyre konkrete.

PËRÇMIMI I VLERËS INDIVIDUALE. Ndjenjë e ndërlikuar e drejtuar në vetë subjektin, që ka të bëjë me ndjesinë e pakënaqësisë, të përvuajtjes, të ankthit etj. për veten e tij, ngaqë konsideron se ka mangësi të nivelit të aftësive për realizimin e detyrave dhe kërkesave të një kategorie aktivitetesh të caktuara, të çrregullimit të funksionit të një organi etj. Për këto shkaqe përçmuesi i vlerës individuale e trajton personalitetin e tij herë pas here si personalitet inferior dhe të pavlefshëm. Ky përçmim në disa situata të

posaçme nxit zhvillimin e njeriut dhe bëhet faktor i rëndësishëm i zhvillimit të atyre sjelljeve, me anën e të cilave individi, përçmues i vlerave të tij, orvatet të kompensojë mungesën e funksionimit të një organi, të aftësive të veçanta të tij etj.

PËRÇUESHMËRIA E IMPULSEVE NERVORE NË NEURONE. Gatishmëria e lindur e neuroneve të sistemit nervor për bartjen e impulseve nervore prej një neuroni në neuronin tjetër. Bartja e impulsive nervore karakterizon trupin e neuronit dhe disa pjesë të tij, duke aktivizuar dhe nxitur trupin e neuronit tjetër, për të pranuar impulse nervore dhe duke i bartur këto impulse te trupi i neuroneve të tjera më të afërta me të.

PËRDHUNIM, - I. m. Formë e rëndë e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Përdhunimi është detyrimi që i bëhet dikujt për të vepruar kundër dëshirës, përcaktimit, pikëpamjes, qëndrimit të tij etj. Përdhunimi shfaqet në forma të ndryshme: si detyrim fizik mbi dikë që t`i nënshtrohet kërkesës së dhunuesit, me dhunim psikik duke zhvlerësuar dinjitetin, tiparet e karakterit dhe tërësinë etike të njeriut. Formë e posaçme e përdhunimit është përdhunimi seksual, forma më e përhapur kryesisht në botën rinore.

PËRFAQËSIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *repraesentativus*, që është ngulitur edhe në disa fusha profesionale e shkencore të shqipes. Emërton përfaqësimin e përgjithshëm të arritjeve nga ana e të gjithë subjekteve të një populate, në bazë të përzgjedhjes së bartësve apo subjekteve të një numri të kufizuar të këtyre arritjeve. Ky kuptim ndryshon nga kuptimi i këtij termi në të folurin e përditshëm, kur përfaqësuesi përfaqëson më të mirët në artin filmik, atletikë, në basketboll etj.

PËRFAQËSIMI IKONIK. Përfaqësim psikik i objektit të perceptuar mu në pragun e largimit të tij nga shqisat e njeriut. Figurat, përkatësisht ikonat përfaqësuese zgjasin më shumë se pasndijimet, por ende nuk marrin përmasat e simboleve abstrakte. Këto gjenden në mes të pasndijimeve dhe simboleve konvencionale dhe abstrakte. Sipas teorisë së zhvillimit të mendimit të psikologut zviceran Zhan Pijazhe (Jean Piaget, 1896 – 1980), zhvillimi i përfaqësimit ikonik zgjat gjatë gjithë kohës së fëmijërisë dhe karakterizohet me varfëri detajesh dhe me lidhje të zbehta figurash në një tërësi figurash të kuptueshme.

PËRFAQËSUES. mb. Që përfaqëson dikë tjetër, që vihet në vend të një ose disa individëve etj. Me këtë mbiemër janë ndërtuar këto sintagma të terminologjisë psikometrike:

a. **Kampion përfaqësues** – Grup subjektesh që përfaqësojnë plotësisht të gjithë anëtarët e popullatës, arritjet e të cilit i përfaqëson një grup i vogël i asaj popullate. Forma më objektive e përzgjedhjes së tillë është përzgjedhja e rastësishme;
b. **Test përfaqësues** – Sistem detyrash dhe problemesh që përfaqësojnë thelbin e asaj që provohet me anë të subjektit të caktuar;
c. **Vlerë përfaqësues**e – Vlera e përftuar nga matja e një tipari psikik ose e njërës prej cilësive të saj, që përfaqëson më së miri vlerat individuale të një grupi të madh subjektesh. Vlera e

tillë është vlera e së mesmes aritmetike, pikërisht në raste të posaçme vlera dominuese ose vlera mediale e të dhënave të renditura nga më e madhja te më e vogla.

PËRFORCIM, - I. m. Fjalë e zakonshme në të folurin e përditshëm dhe term i psikologjisë. Në të folurin e përditshëm përforcimi emërton ngritjen e nivelit të energjisë, të qëndrueshmërisë, të rezistencës ndaj ndikimeve të ndryshme etj. Në psikologji përforcimi ka statusin e termit, sepse emërton çdo ngacmues që siguron besueshmërinë se një reagim, një sjellje pozitive do të shfaqet, pra një reagim apo një sjellje negative nuk do të shfaqet ose do të shuhet. Përforcimi është një proces i rëndësishëm gjatë të mësuarit: mësohet për të qenë e qëndrueshme një lloj sjelljeje, një reagim, një veprim. Sjellja, reagimi dhe veprimi përvetësohen dhe bëhen pronë e njeriut, duke e nxitur pozitivisht atë lloj sjelljeje. Termi *përforcim* përdoret më tepër në të mësuarin e reagimit të refleksit të kushtëzuar. Në kontekstin e të mësuarit të refleksit të kushtëzuar përforcimi ka të bëjë me shpërblimin e lidhjes së suksesshme të ngacmuesit të kushtëzuar me një reagim të kushtëzuar. Kjo ndodh atëherë kur pas ngacmuesit të pakushtëzuar shfaqet reagimi pozitiv që ne e shpërblejmë me ushqim, me notë të lartë etj. Përforcimi dhe roli i tij në procesin e kushtëzimit shfaqet edhe në formën negative: pas ngacmuesit të pakushtëzuar pason reagimi të cilin ne e dënojmë, duke shkaktuar te kafsha ngacmim të rrezikshëm dhe të pakënaqshëm elektrik. Ky është përforcimi negativ, në bazë të të cilit reagimi shuhet, eliminohet. Termi përforcim haset në këto togfjalësha psikologjikë:

a. **Përforcim i përfundimit** – Paraqitje e argumenteve shtesë ose të reja në formë gjykimesh, në bazë të të cilave dikujt i shtohet besimi dhe bindja në përfundimin e caktuar;
b. **Përforcim i pjesshëm** – Përforcim vetëm për reagimet e posaçme, pra për reagimet e sakta;
c. **Përforcim i njohurive** – Shtesa e numrit të përsëritjeve ose të riprodhimit të njohurive të një lënde të caktuar, lidhja me argumente të reja etj., me qëllimin për t'i rezistuar procesit natyror të harresës;
d. **Përforcim pozitiv** - Përforcim i një nxitësi me ushqim, ujë, shpërblim etj., menjëherë pas përfundimit të ndikimit të tij në organizëm (të dhënit e ushqimit, të qenit të uritur përforcon reagimin e tij pozitiv në situata të njëjta, p.sh., qeni mëson të kryejë të njëjtat veprime edhe më vonë kur është i uritu**r;**
e. **Përforcim negativ** – Largim i atij ngacmuesi, që rrit shpeshtësinë e paraqitjes së një veprimi të panevojshëm, të padobishëm;
f. **Përforcim i shprehive** – Përsosje e mënyrave të ushtrimit dhe shpërblimi i mënyrave më të suksesshme, të drejtuara në ngritjen e nivelit të përkryer të asaj shprehie.

PËRFORCUESI NEGATIV. Në psikologjinë e të mësuarit emërton atë objekt, dukuri etj. të pakëndshëm, të padëshiruar etj., me largimin ose mënjanimin e të cilit mundësohet përvetësimi i një lloj reagimi, sjelljeje etj. Dhembja, nevrikosja, ligështia e organizmit etj. janë përforcues me ndikim negativ në të mësuarit e reagimit, të

sjelljes tjetër etj. Pengimi i dhembjes, i shpimit të lëkurës, i ngacmuesit elektrik në lëkurë etj. gjatë procesit të zhvillimit e të formimit të reagimeve e sjelljeve të reja merr karakterin e shpërblimit për të përparuar në përvetësimin e reagimeve dhe të sjelljeve të reja.

PËRFUNDIM, - I. m. Formë e të menduarit në psikologjinë kognitive, dije e re, e nxjerrë në formën e gjykimit përfundimtar nga dijet ekzistuese, të cilat përbëjnë premisa të caktuara. Lidhja logjike e premisave, e pikërisht, e gjykimeve siguron nxjerrjen e një përfundimi të vërtetë. Në psikologjinë kognitive dhe në logjikë janë të njohura këto forma të përfundimeve, që në psikologjinë kognitive u provuan për ndikimin e tyre në zgjidhjen e problemeve dhe të situatave problemore:

a. **Përfundimi analogjik** – Përfundim i nxjerrë në bazë të konstatimit të ngjashmërive nga ana e subjektit, përkatësisht në mbështetje të përngjasimit të koncepteve a nocioneve kryesore të premisave të veçanta, që kanë të bëjnë me një grup objektesh, ngjarjesh, situatash etj.;

b. **Përfundimi deduktiv** – Gjykim përfundues i veçantë, i nxjerrë nga lidhja e një gjykimi të përgjithshëm me gjykimin e veçantë. Përfundimi deduktiv mbështetet në operacionet mendore që lidhin të përgjithshmen me të veçantën;

c. **Përfundimi induktiv** – Gjykim përfundimtar i përgjithshëm, i nxjerrë nga lidhja e gjykimeve të veçanta. Mbështetet në procesin e lidhjes së të veçantave me të përgjithshmen: ajo që konsiderohet e vërtetë për secilin anëtar të një klase të caktuar objektesh, ngjarjesh dhe situatash duhet konsideruar e vërtetë edhe për gjithë klasën e caktuar të bimëve, të situatave, të zvarranikëve etj.;

d. **Përfundim statistikor** – Përgjithësim i nxjerrë nga operacionet statistikore të të dhënave individuale për një ndryshore të provuar në një numër të caktuar subjektesh. Në rastet e këtilla zbatohen procedurat e statistikës përshkruese, sidomos të statistikës përmbledhëse.

e. **Përfundimi transduktiv** – Formë e të menduarit të fëmijëve, karakteristike për fazën parakonceptuale të zhvillimit të mendimit të tyre. Këtë formë e karakterizon përfundimi në bazë të ngjashmërisë apo analogjisë që sillet prej të veçantës kah e veçanta për të veçantën, të cilën e ka trajtuar psikologu zviceran Zhan Piazhe (Jean Piaget, 1896 – 1980).

PËRFYTYRIM, - I. m. Përjetim psikik në formë riprodhimi cilësish, objektesh, e dukurish në trajtë figurash mendore të formuara nga perceptimi i dikurshëm i tyre. Përfytyrimet shkaktohen në mungesë të ngacmuesit shqisor (të trupit, të gjësendit, të situatës etj.), por të përjetuar dikur drejtpërdrejt nga ana e njeriut. Bazë e këtij lloj përjetimi është kryesisht kujtesa. Përfytyrimet kanë këto veçori: janë të paqëndrueshme, paraqiten me shumë detaje të humbura, janë shumë më pak të gjalla se perceptimi i përmbajtjes së tyre. Disa prej përfytyrimeve janë produkt i imagjinatës së krijuesit, e pikërisht këto përfytyrime nuk janë pasojë e angazhimit dhe e ndikimit të objekteve, të ngjarjeve dhe të situatave te shqisat e njeriut. Përfytyrimet mund të kenë edhe karakter të përgjithshëm, kur paraqiten

në formën e përfshirjes së disa cilësive të përbashkëta të grupit të objekteve të caktuara. Në këtë rast përfytyrimet i afrohen koncepteve, por ndryshojnë në mënyrë esenciale nga këto forma të mendimit. Në psikologjinë strukturaliste të Vilhelm Vuntit (Wilchelm Wundt, 1832 – 1920) dhe të Eduard B. Tiçenerit (Edward B. Titchener, 1867 – 1927) përfytyrimet, përpos ndijimeve dhe ndjenjave, janë konsideruar përbërës të përjetimeve psikike të ndërlikuara, që nuk mund të zbërthehen në elemente përbërës të tyre.

PËRFYTYRIMI I DHUNSHËM. Fjalë, simbol pamor, melodi etj., që e preokupon njeriun dhe për këtë arsye ai çlirohet me vështirësi nga ky preokupim. Përfytyrime të tilla përjeton një njeri shumë i lodhur nga puna. Këto përfytyrime janë simptoma të psikozës së skizofrenisë.

PËRGJEGJËSI, - A. f. Të qenit e njeriut i vetëdijshëm për të kryer një detyrë dhe vetëdija për rëndësinë e kryerjes së saj, si edhe për pasojat që dalin nga moskryerja, sidomos nga mossuksesi dhe faji i tij për çfarë ai do të përgjigjet para marrësit të asaj detyre (nga familja, bashkësia e gjerë ose e ngushtë nga vetvetja etj.). Përgjegjësia përbëhet nga kuptimi i karakterit të detyrës, i rëndësisë, i rendit dhe i hierarkisë së saj që përçohet me ndjenjë kënaqësie, kur këtë e realizon me sukses, dhe me pakënaqësi kur has në pengesa drejt realizimit të asaj detyre dhe këtë nuk arrin ta realizojë. Përgjegjësia është term i etikës dhe i psikologjisë.

PËRGJEGJSHMËRI, - A. f. Tipar i personalitetit të njeriut që ka të bëjë me vetëdijen e plotë të tij për organizimin dhe drejtimin e sjelljeve në kryerjen e një detyre të besuar, dhe për rrjedhimet e kryerjes ose të moskryerjes së detyrave që ai merr përsipër. Përgjegjshmëria ka karakterin e tiparit, sepse njeriu i gjendur në një situatë ku kërkohet kryerja e detyrave vazhdimisht i kryen ato detyra dhe të tjerët nuk merakosen për kryerjen e asaj detyre. Ky tipar shtrihet prej skajit negativ, në zero e deri në skajin pozitiv, që mund të shkallëzohet numerikisht prej O, +1, +2, +3, +4 e +5, duke përcaktuar me nivelin +5 personalitetin e rritur, të pjekur dhe me shkallën më të lartë të zhvillimit të përgjegjshmërisë. Kjo shkallë përcaktohet në bazë të rezultateve të arritura në shkallën vlerësuese të përgjegjshmërisë.

PËRGJËRIM, - I. m. Lloj ndjenje me strukturë të ndërlikuar që krijohet nga ndërlidhja e ndjenjës së dashurisë, e mallit dhe e nderimit ndaj të tjerëve. Shih – ***ADHURIMI***.

PËRGJITHËSIM, - I. m. Në psikologjinë kognitive është procesi mendor me anën e të cilit të menduarit, duke lidhur elementet kyçe të një klase objektesh, dukurish, situatash etj. formon koncepte dhe nxjerr gjykim të përgjithshëm për të gjithë pjesëtarët e asaj klase. Përgjithësimi zakonisht mbështetet në induksionin mendor të vëzhgimit të një numri të kufizuar gjësendesh, dukurish dhe situatash dhe koncepti e gjykimi i përgjithshëm vlen edhe për të gjithë pjesëtarët e asaj klase. Në psikologji termin *përgjithësim* e hasim te këta togfjalësha terminologjikë:

a. Përgjithësimi empirik – Përgjithësim mendor i lidhjeve dhe i raporteve ndërmjet një grumbulli faktesh dhe

të dhënash të perceptuara, që mund të ketë karakter rregullsie për atë grumbull, por jo për të gjitha llojet e fakteve e të dhënave. Në rast të hulumtimit eksperimental dhe të vëzhgimit josistematik të fakteve dhe të të dhënave që përfaqësojnë gjithë llojin e tyre përgjithësimi empirik mund të marrë statusin e ligjit psikologjik. Shih – ***LIGJET E ASOCIACIONEVE; LIGJI E EFEKTIT; LIGJI I EMERTIT***.

b. **Përgjithësimi i dijes** – Lidhje e tipareve të përgjithshme të dijeve të veçanta në një mendim të përgjithshëm dhe theksimi i rëndësisë për zbatimin e drejtë të tij në rastet e veçanta. Ky përgjithësim është një ndër kushtet e bartjes ose të transferimit në procesin e të mësuarit;

c. **Përgjithësimi i metodave të punës** – Përfundim i përgjithshëm mbi metodat më racionale të punës dhe të të mësuarit. Përgjithësimi i metodave ushtron ndikim pozitiv në përsosjen e metodave të të mësuarit, të të menduarit racional dhe të punës. Përsosja e metodave të të menduarit ndikon pozitivisht në zhvillimin e aftësive kognitive;

d. **Përgjithësimi i ngacmuesve** – Reagim i organizmit ndaj një ngacmuesi të kushtëzuar, ndaj një situate të njëjtë, të përsëritur disa herë dhe, më pas, me paraqitje të situatave të ngjashme ose identike, shfaqet edhe reagimi i mësuar, i përvetësuar më parë;

e. **Përgjithësimi i përgjigjeve** – Prirja e organizmit për të dhënë përgjigje të mësuar me mënyrë e përmbajtje të njëjtë ose të ngjashme, sipas tipit të mësuar më herët. Kjo prirje e përgjigjeve shfaqet nëse ekziston ngjashmëri ndërmjet situatës kur është mësuar përgjigjja dhe situatave të reja;

f. **Përgjithësimi shpjegues** – Shpjegim i një dukurie, i ndryshimeve, i zhvillimit etj., duke u mbështetur në një parim të përgjithshëm shpjegues të klasës së atyre dukurive dhe të kushteve dhe raporteve të njëjta ose të ngjashme të paraqitjes së tyre.

PËRJETIM, - I. m. Term psikologjik burimor që shpreh procesin dhe gjendjen psikike integrale, intelektuale, emotive dhe konotative, e përçuar me përvojën e njeriut, që i është nënshtruar vetëdijes së njeriut dhe kontrollit subjektiv të tij. Përjetimi mund të jetë i thjeshtë, i ndërlikuar dhe shumë i ndërlikuar. Përjetimi i thjeshtë është ndijimi, përjetimi i ndërlikuar është perceptimi dhe përjetimi shumë i ndërlikuar është përjetimi i nostalgjisë, i ndjenjës së bukurisë etj. Për Anri Bergsonin (Henry Bergson, 1859 – 1941) përjetimi është e dhënë themelore e vetëdijes.

PËRJETIMI AHA. Përjetim i veçantë i çastit, kur individi heton raportin kyç të zgjidhjes së një problemi të caktuar. Pas shumë orvatjesh dhe mundimesh për të zgjidhur një situatë problemore, *përjetimi Aha* është një çast te njeriu, ku raportet ndërmjet të dhënave harmonizohen dhe japin zgjidhjen e asaj situate. Përjetimi Aha i përngjet çastit kur shkreptin qielli, dritës së ndezur papritmas dhe njeriu vetvetiu thërret "aha", "gjithsesi", "sigurisht" problemi u zgjidh. Termi i përket shkollës së Virzburgut, përkatësisht studiuesit të kësaj shkolle Karl Ludvig Bylerit (Karl Ludwig Bühler, 1879 – 1963). Ky çast për pikëpamjen e shkollës geshtaltiste është rezultat i

riorganizimit të befasishëm të elementeve përbërës të atij problemi ose asaj situate problemore dhe e zgjidhjes së saj.

PËRJETIMI EMOCIONAL. Përbërës i vetëdijshëm i emocioneve të një individi, karakteri subjektiv i jetës emocionale dhe i formave të saj. Përjetimi emocional ka të bëjë drejtpërdrejt me aftësinë e njeriut për të bërë përshkrimin dhe shpjegimin e një cilësie të caktuar të një emocioni të përjetuar.

PËRJETIMI I VDEKJES. Një ndër termat e rinj të psikologjisë. Ky përjetim ndahet në këto faza: 1) Identifikimi i sëmundjes vdekjeprurëse dhe e gjendjes shokuese për informatën e re, si edhe mohimi i kësaj informate, 2) Në fazën e dytë shfaqet hidhërimi e trishtimi i përçuar me inat ndaj të shëndoshëve rreth tij, 3) Në fazën e tretë shfaqet besimi se me sjelljen e mirë të tij gjendja mund të përmirësohet dhe vdekja mund të shtyhet, 4) Pas fazës së tretë shfaqet gjendja e deprimuar, e pashpresë dhe pohimi se vdekja nuk mund të shtyhet dhe 5) Në fazën e fundit i sëmuri pajtohet me vdekjen dhe kërkon qetësimin e organizmit të tij. Ky mendim përgjithësues i përjetimit të procesit të vdekjes ka edhe ndryshime individuale relativisht të mëdha.

PËRKËDHELJ/E, - A. f. Formë e shfaqjes së dashamirësisë, të dashurisë, të gëzimit dhe të mallëngjimit të një individi ndaj tjetrit. Përkëdhelja shprehet me plotësim dëshirash të veçanta dhe në mënyrë të këndshme, madje edhe jashtë parimeve dhe rregullave të zakonshme familjare dhe shoqërore. Ka karakter individual: nëna e përkëdhel fëmijën e saj, duke e lëmuar dhe kënduar, u rrit me përkëdheljet e prindërve të tij, ia plotësuan ëndrrën e tij në shenjë përkëdhelje etj.

PËRKORËSI, - A. f. Kufizim i vetëdijshëm i njeriut nga ato kënaqësi individuale, që nuk përkojnë me zakonet, me parimet dhe me normat e sjelljeve të përgjithshme, sidomos me ato morale të mjedisit shoqëror. Në marrjen e ushqimit për të plotësuar nevojën biologjike të organizmit familja dhe mjedisi i gjerë i saj ka një masë për marrjen e ushqimit dhe anëtari i saj ka për detyrë t`i përmbahet pak a shumë asaj mase dhe të mos i lërë të tjerët të uritur.

PËRKUFIZIM, - I. m. Pohim me të cilin përcaktohet saktësisht kuptimi i një termi, përmbajtja dhe shtrirja e një koncepti apo nocioni. Një përkufizim i tillë arrihet me anën e proceseve mendore, me të cilat përcaktohet niveli i nocionit më të lartë dhe veçantia e tij. Psikologjia kognitive dallon këto forma të rëndësishme të përkufizimeve:

a. **Përkufizimi formal** – Formë e përkufizimit të koncepteve ku përcaktohen karakteristikat thelbësore të një koncepti, në bazë të të cilave ai koncept apo nocion dallohet nga të gjithë të tjerët. Përkufizimet formale janë të shpeshta në përcaktimin e koncepteve apo nocioneve psikologjike. Në të kundërt, termi i përket terminologjisë së filozofisë, përkatësisht asaj të logjikës.

b. **Përkufizimi real** – Përcaktim i objektivuar i objektit që përkufizohet. Përkufizimi real arrihet duke kuptuar ndërlidhjet e koncepteve apo nocioneve me të cilat përcaktohet saktësisht

përmbajtja e konceptit që përkufizohet. Përkufizimi i tillë është "frustrimi, reagim emocional i njeriut, kur ky pengohet në rrugën e realizimit të qëllimit të tij";

c. **Përkufizimi operacional** – Përcaktim i saktë i përmbajtjes së një koncepti abstrakt të caktuar, që mbështetet në operacionet e formimit të një koncepti apo nocioni, duke marrë për bazë funksionet e konceptit a të nocionit që përkufizohet. I këtillë është përkufizimi "uria është gjendje e organizmit e shkaktuar nga mungesa e lëndëve ushqyese të organizmit". Operacionalizimi i koncepteve apo i nocioneve është i vështirë;

d. **Përkufizimi reduktues** – Përcaktim i paraprijësve dhe i pasojës së një gjendjeje. Përkufizim i tillë është kur pohojmë se "Individi është në gjendje ankthi, nëse sjellja e tij ka dhjetë pikë në testin e ankthit".

e. **Përkufizimi statistikor** – Përkufizim i përmbajtjes së një koncepti apo nocioni, duke u mbështetur në veçoritë e të gjithë pjesëtarëve të një klase objektesh, e pikërisht të përfaqësuesve të përzgjedhur në gjedhen ose modelin e tyre. Ky përkufizim ka vlera të kufizuara.

f. **Përkufizimi omnibus** – Lloj përkufizimi i përmbajtjes së koncepteve apo nocioneve, sipas të cilit në këtë përkufizim duhen futur një nga një të gjithë komponentët përbërës të përmbajtjes së tij. Ky lloj përkufizimi është i pamjaftueshëm dhe nuk sqaron përmbajtjen thelbësore të një koncepti, sepse nuk ka ndarje të vetive thelbësore nga ato jothelbësore.

PËRKUJTIM, - I. m. Ringjallje e qëllimshme e gjurmëve nervore të mbetura në kujtesën e njeriut nga vepra e rëndësishme e një individi. Përkujtimi bëhet për të mbajtur të gjallë dhe për të nderuar veprën dhe bartësin e saj. Rikujtohet vepra e madhe e Skënderbeut në pesëqindvjetorin e vdekjes së tij, rikujtohet në forma të ndryshme njëqind vjetori i Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë me ngritjen e flamurit kombëtar nga Ismail Qemali etj.

PËRLIGJ/JE, - JA. f. Term i përgjithshëm që përdoret në disa disiplina. Ka kuptimin e ligjësimit të një aktiviteti apo veprimtarie për të gjithë ata që jetojnë në një vend. Në psikologji përdoret rrallë dhe me kufizime. Zakonisht, përligjja është paraqitje dhe përshkrim i tipareve të sjelljeve të personalitetit, që arsyeton shkakun dhe rrjedhën e sjelljeve, sjellje që kryhen në përputhje me shkaqet dhe rrethanat e vërteta, në përputhje me motivet e caktuara. Lexuesi i përshkrimit të sjelljeve dhe tipareve të tilla duhet të bindet se në kuadrin e motiveve dhe të rrethanave të caktuara sjelljet e tij kanë mundur të jenë të tilla dhe jo të ndryshme, si edhe në bazë të tyre në të ardhmen mund të parashikohen sjelljet e një individi në situata të ngjashme dhe të njëjta.

PËRMBAJTJ/E, - A. f. Tërësia e elementeve, e funksioneve, e proceseve, që përcaktojnë thelbin e qenies së tyre, duke luajtur rolin parësor të saj ndaj formës së paraqitjes të tyre. Në psikologji termi përmbajtje haset në këta togfjalësha terminologjikë**:**

a. **Përmbajtja e ëndrrave** – Përfytyrimet e larmishme që shfaqen në gjumë dhe asociacioni i çuditshëm i tyre, i nxitur nga dëshirat, shtytësit, idetë e pavetëdijshme, që kanë kuptim të posaçëm;

b. **Përmbajtja e mendimit** – Lënda për të cilën njeriu angazhon proceset mendore të tij. Lëndë e mendimit mund të jetë zgjidhja e një situate problemore, vlerësimi i një gjykimi, zbërthimi i një çështjeje etj., duke e konsideruar dytësore formën e shfaqjes së tyre;

c. **Përmbajtja mendore** – Përjetime të thjeshta (ndijimet), të ndërlikuara (perceptimi) dhe shumë të ndërlikuara (motivet e pavetëdijshme, ndjenjat etj.), që njeriu është në gjendje t`i përshkruajë;

d. **Përmbajtja e përgjigjes në testin Rorshah** – Përgjigjja e të testuarit në bazë të përmbajtjes së perceptimit të figurave të pastrukturuara të testit Rorshah: H "qenie njerëzore", A "kafshë", Bot. "bota bimore", Nat. "natyra", Art. "krijime artistike" etj.

PËRMENDËSH. ndaj. Riprodhim fjalë për fjalë në mënyrë mekanike i përmbajtjes së një lënde mësimore të mësuar, duke mos u mbështetur në kuptimin e atyre fjalëve dhe në kuptimin e mirëfilltë të lidhjeve të tyre. Të mësuarit dhe të mbajturit mend përmendësh është një formë joproduktive e të mësuarit. Kjo formë ka për bazë asociacionet e afërsisë së fjalëve dhe të vazhdimësisë së tyre. Megjithëkëtë, disa emërtime duhen mësuar dhe mbajtur në mend përmendësh, siç është të mësuarit dhe mbajtja mend e rrokjeve, e numrave të njëpasnjëshëm etj.

PËRMIRËSIMI I KUJTESËS. Ngritja e nivelit më të lartë të aftësisë së mbajtjes mend, të njohjes dhe të riprodhimit të përmbajtjeve që mësohen. Kujtesa ka mundësi të përmirësohet duke zhvilluar vetëdijen për metodat më të suksesshme të të mësuarit dhe të mbajtjes mend e riprodhimit të asaj që mësohet, duke lidhur informacionet e reja me informacionet tashmë të përvetësuara, duke shfaqur forma të ndryshme të aktivitetit ndaj mbajtjes mend dhe riprodhimit të përmbajtjeve të ndryshme, duke krijuar lidhje të shumëllojshme ndërmjet informacioneve të mësuara dhe atyre të mësuara më herët etj. Nuk përmirësohen gjurmët nervore te përmirësimi i kujtesës, por kujtesa përmirësohet dhe harresa zbret në nivelin e duhur, duke zbatuar parimet dhe metodat më efikase të të mbajturit mend dhe të të mësuarit.

PËRNGJITJ/E, - A. f. Bashkim i një pjese me tjetrën, lidhje e një organi dhe e funksionit të tij me organin tjetër, bashkim i një fjale me fjalën tjetër dhe përftimi i një fjale të tërësishme kuptimplote, nga të cilat disa janë ngritur në nivelin e termave psikologjike, si: psikonervor, mosbesim, neobihejviorizëm etj.

PËRNGJITJA NERVORE. Bashkim pjesësh nervore dhe formim i gërshetave nervore, duke lidhur në këtë mënyrë pjesën e majtë me pjesën e djathtë të sistemit nervor, të hemisferës së djathtë dhe të hemisferës së majtë.

PËRPARIMI NË TË MËSUAR. Kalimi nga një shkallë e të mësuarit të një përmbajtjeje në shkallën më të lartë, më të përsosur, më të vlefshme etj. të zotërimit të asaj përmbajtjeje. Përparimi gjatë të mësuarit të përmbajtjes së një lënde varet nga shumë faktorë: nga natyra e asaj përmbajtjeje, nga rëndësia e zotërimit të asaj përmbajtjeje për subjektin që mëson, nga fuqia motivuese, aftësitë e tij etj. Që në fillim të

disa përmbajtjeve ritmi i përparimit është shumë i ngadalshëm (fillimi i të mësuarit të gjuhës së huaj); ka përmbajtje fillimi i të cilave është i përshpejtuar, kurse më pas bie interesimi dhe përparimi ndal në të njëjtën pikë ose, madje, mund të bjerë (të mësuarit e termave latinë të anatomisë). Ka përparim me ritëm relativisht të njëjtë gjatë njëfarë kohe (të mësuarit e gramatikës). Në psikologjinë pedagogjike bëhet fjalë për tri lloj përparimesh: përparimi pozitiv, përparimi negativ dhe përparimi me ritëm relativisht të njëjtë. Përparimi në të mësuar ka përmasa individuale.

PËRPESHIM, - I. m. Term statistikor që mund të zëvendësojë termin me prejardhje turke *bazhdarim*. Përpeshimi ka të bëjë më tepër me përcaktimin e vlerës së të dhënave të arritjeve individuale në një test të standardizuar. Në kuptimin e ngushtë përpeshimi është përcaktimi i vlerës së një të dhëne statistikore individuale ndaj vlerës normative, si edhe me kontributin e vlerës individuale ndaj asaj të përgjithshme. Ky term në funksionin e mbiemrit haset në këta togfjalësha terminologjikë:

a. **Koeficienti i përpeshuar** – Përpjestues që tregon vlerën sasiore të një ndryshoreje psikologjike të provuar dhe kontributin individual të saj në përcaktimin e modifikimin e prirjes së asaj ndryshoreje në rezultatin e përgjithshëm;

b. **Mesatarja aritmetike e përpeshuar** – Mesatare që përcaktohet duke shumëzuar vlerën sasiore të veçantë me koeficientin e përpeshuar.

PËRPJEKJ/E, - A. f. Angazhim fizik e psikik për realizimin e një qëllimi të caktuar, e pikërisht për pushtimin dhe zotërimin e tij. Shih – ***ORVATJE.***

PËRPUNIMI I INFORMACIONEVE. Procesi i modifikimit të informacioneve duke lidhur një informacion me një informacion tjetër, duke zbërthyer informacionin e ri, duke lidhur pjesët e tij me informacionin e vjetër dhe duke përftuar në këtë mënyrë informacion të ri. Përpunimi i informacioneve është proces i ndërlikuar, që fillon me marrjen e informacionit, kodimin, vendosjen në kujtesë, gjurmimin e mëvonshëm për gjetjen e saj në kujtesë, dekodimin dhe nxjerrjen, përkatësisht përdorimin e saj. Ky proces fillon me marrjen e informacionit dhe përfundon me përdorimin e atij informacioni në procesin e vendosjes së reagimit kognitiv, veprues etj.

PËRPUNIMI I LËNDËS MËSIMORE. Ngritje e cilësisë së përmbajtjes së një lënde në nivel më të lartë, duke zgjeruar dhe thelluar raportet e informacioneve të asaj lënde, kuptimësinë e lidhjeve mendore të këtyre informacioneve dhe ngulitjen e tyre në kujtesën e atij që mëson. Ka forma të ndryshme të përpunimit të informacioneve, si: përdorimi i fjalorëve profesionalë e teknikë, i teksteve enciklopedike, i risistemimit të informacioneve sipas kritereve të veçanta etj.

PËRPUNIMI I TË DHËNAVE STATISTIKORE. Ngritja e të dhënave statistikore të përftuara nga të provuarit me anë të testit të një ndryshoreje psikologjike në grupin ose gjedhen e caktuar, në nivel më të lartë njohës, duke i bërë këto të dhëna të vlefshme për përshkrimin e prirjes së përgjithshme të të dhënave individuale

dhe për nxjerrjen e përfundimeve për përmasat e ndryshores së testuar.

PËRPUTHJA E DY SHPËRNDARJEVE. Term i statistikës që paraqet procesin e të provuarit të vlerës së të dhënave të përftuara nga matja empirike e një ndryshoreje të një gjedhe dhe shpërndarjen e atyre të dhënave në lidhje me shpërndarjen normale të të dhënave përfaqësuese të të gjithë popullatës. Shkalla e përputhjes së rezultateve shpërndarëse llogaritet në bazë të kuadratit HI.

PËRQENDRIMI I VËMENDJES. Ngulitje e vëmendjes në një objekt ose në një cilësi të tij, si edhe ngulitja e saj në një ide, qëndrim etj. Përqendrimi i vëmendjes është i lidhur me angazhimin e proceseve psikike kognitive, përkatësisht me angazhimin e atyre proceseve psikike, që çojnë në njohjen e saktë të tyre, duke përfshirë edhe lidhjet dhe raportet ndërmjet tyre. Përqendrimi i vëmendjes shkakton qartësinë e madhe të një objekti, të një qëndrimi, të një situate etj., duke i dhënë një "dritë" të fuqishme imponuese objektit perceptues.

PËRQINDJA E ZGJEDHJES SË GJEDHES. Në përcaktimin e raportit ndërmjet numrit të pjesëtarëve të një gjedhe ose një kampioni dhe numrit të përgjithshëm të individëve të atij grupi, nga i cili është bërë përzgjedhja e gjedhes. Zbatohet formula: përqindja e gjedhes "N i gjedhes : N i përgjithshëm i grupit, përkatësisht nëse nga grupi i përgjithshëm prej 26.000 nxënësish është bërë gjedhja prej 0,5 %, gjedhja ka përfshirë 1300 nxënës (1300 : 26 000 "0,05.

PËRSËRITJ/E, - A. f. Thënia ose riprodhimi rishtas i asaj që është mësuar ose ribërja e asaj që është kryer disa herë, me qëllim të ngulitjes në kujtesë të përmbajtjeve të mësuara në formë dije, shprehie e shkathtësie. Në psikologji bëhet fjalë për këto lloj përsëritjesh**:**

a. **Përsëritje mekanike** – Riprodhimi mekanik i lëndës së mësuar sipas renditjes së informacioneve ose të lëvizjes, pa një qëllim të caktuar të atij që e përsërit atë përmbajtje, pra, duke mos u përqendruar në të kuptuarit e informacioneve dhe të lidhjeve ndërmjet tyre;
b. **Përsëritje e qëllimshme** – Thënia disa herë e përmbajtjes së një lënde të caktuar me qëllim të caktuar në mënyrë të saktë. Qëllimi i përsëritjeve të një përmbajtjeje mund të jetë përforcimi ose ngulitja në sistemin nervor të asaj që është mësuar, zgjerimi dhe thellimi i njohurive, marrja në mënyrë sistematike e informacioneve, vënia në pah e një raporti themelor ndërmjet informacioneve (të një parimi, rregulle, ligji), shprehja e kuptueshme, e bukur, e saktë dhe e rrjedhshme e përmbajtjes së mësuar etj. Pa një qëllim të caktuar saktësisht nga ana e atij që e përsërit lëndën nuk mund të ketë përvetësim dhe zotërim të plotë të një lënde;
c. **Përsëritje e përpunuar** – Lidhja e informacioneve të reja të kujtesës afatshkurtër me informacionet e përvetësuara më parë të kujtesës afatgjatë;
d. **Përsëritje produktive** – Përsëritja e përmbajtjes së një lënde, duke iu shmangur riprodhimit identik të informacioneve dhe të lidhjeve ndërmjet tyre, por duke u orvatur të fusë elemente të reja, ndërlidhje të tjera, duke zbatuar forma dhe mjete shprehëse më të përsosura dhe duke organizuar

sistematikisht këtë formë përsëritjesh**.**

PËRSIATJ/E, - A. f. Proces mendor i thelluar për të kuptuar një çështje, për të zgjidhur një problem, madje edhe për të nxjerrë përfundime të reja për raportet objektive dhe për jetën psikike të njeriut (për mendimin, për motivacionin e pavetëdijshëm, për parregullsitë e jetës emocionale të njeriut etj.). Në përsiatje të një çështjeje njeriu e përqendron energjinë e proceseve kognitive në të kuptuarit e thellësive të raporteve thelbësore të një çështjeje, duke u përqendruar në rend të parë në raportet shkak – rrjedhim dhe në parashikimin e zhvillimeve të ardhshme, si edhe në konceptimin e tyre. Kjo e fundit i përket mendimit krijues**.**

PËRSHKRIM, - I. m. Paraqitja me anën e mjeteve e gjuhës dhe e dukurive, e gjësendeve, e cilësive, si edhe e proceseve, tipareve dhe e cilësive të tyre. Përshkrimi realizohet me anë të perceptimit objektiv dhe ai duhet ta pasqyrojë besnikërisht atë që është perceptuar ose perceptohet. Në kuadrin e përshkrimit bën pjesë edhe emërimi dhe shprehja e saktë e asaj që perceptohet. Përshkrimi konsiderohet se është metodë gjurmuese e gjësendeve, e proceseve, e situatave dhe e cilësive të tyre. Ka karakterin e metodës, sepse mbështetet në vëzhgimin sistematik të lëndës që studiohet. Zbatohet sipas një qëllimi të paracaktuar saktësisht të objektit vëzhgues, sipas një sistemi të caktuar të regjistrimit të asaj që vëzhgohet dhe kontrollimit të saktë të kushteve brenda të cilave vëzhgohet dukuria e caktuar. Metoda e përshkrimit zbatohet në disa degë të psikologjisë, sidomos në psikologjinë zhvillimore, posaçërisht në psikologjinë e fëmijëve, në psikologjinë e personalitetit, në psikologjinë pedagogjike etj. Por, psikologjia ka dalë nga faza përshkruese e pjesës më të madhe të lëndës së sa**j.**

PËRSHPEJTIM, - I. m. Procesi i zhvillimit të një dukurie, i funksionit të një organi dhe organizmi, duke shkurtuar ritmin zhvillimor nën ndikimin që ushtrojnë faktorët e caktuar të atij zhvillimi. Ky përshpejtim mund të jetë i barabartë (0, 3, 6 , 9), mund të jetë përshpejtim pozitiv i pabarabartë (0 , 3, 7 , 12, 18) dhe mund të jetë përshpejtim negativ (0, 3, 5, 6). Përshpejtimi përdoret më shumë në psikologjinë e të mësuarit. Kështu, lakorja e të mësuarit të gjuhës së huaj në fillim tregon përshpejtim negativ, në fillim rritet e më pas stabilizohet.

PËRSHPEJTIMI SHKOLLOR. Tërësia e masave të posaçme psikologjike dhe pedagogjike për t`iu dhënë mundësi nxënësve më të suksesshëm për të përparuar ndaj atyre me zhvillim mesatar, duke kaluar dy klasë për një vit dhe duke kryer shkollën më shpejt se të gjithë të tjerët. Kjo vlen për nxënësit me aftësi kognitive të jashtëzakonshme që me shkathtësinë e leximit e të shkrimit, me aftësitë matematikore dhe me sasinë e informacioneve të përgjithshme qëndrojnë mbi të tjerët. Përshpejtimi i këtillë u mundëson nxënësve me zhvillim të aftësive mbimesatare të kryejnë shkollimin më herët se të tjerët dhe këtë e realizojnë me sukses.

PËRSHTATJ/E, - A. f. Term i biologjisë dhe i disa disiplinave të grupit të shkencave shoqërore, por që

përdoret edhe në të folurin e përditshëm. Në biologji përshtatja është emërtim i përbashkët për ndryshimet në strukturë ose në funksionin e një organi, që mundëson zhvillimin më të lehtë të jetës së një qenieje dhe të llojit të saj. Në sociologji përshtatja ka të bëjë me modifikimin e sjelljeve të një individi dhe me zhvillimin e tyre sipas vlerave dhe normave shoqërore të mjedisit shoqëror ku zhvillohet dhe formohet personaliteti. Në psikologji përshtatja është njëra ndër format themelore të jetës psikike të kafshëve dhe të njerëzve. Përshtatja shfaqet në modifikimin e strukturave, të funksioneve organike e psikike dhe të sjelljeve të organizmit, në përputhje me kërkesat relativisht të gjata të mjedisit fizik, biologjik, social dhe psikik të tij, duke i mundësuar organizmit jetën e tij dhe të qenieve që i përkasin një lloji të caktuar. Qeniet e pamundura, për t`iu përshtatur kushteve dhe raporteve të ndryshme të mjedisit të tyre, nuk arrijnë të jetojnë. Përshtatja në psikologjinë e ndijimeve është zvogëlimi i intensitetit të një ngacmuesi pas ndikimit të njëllojshëm dhe të gjatë të tij në shqisën e caktuar. Parfumi shkakton ndijim me intensitet të lartë, por me kalimin e kohës intensiteti i ndijimit zvogëlohet, herë-herë edhe zhduket gradualisht. Në psikologjinë e të mësuarit shfaqet në ndryshimet e rrjedhës së të mësuarit të përmbajtjeve racionale dhe të lëvizjeve, duke harxhuar sa më pak energji psikike. Në psikofiziologji hasen disa lloj përshtatjesh:

a. **Përshtatja në dritë** – Procesi i zvogëlimit të funksioneve të syrit dhe të pjesëve të tij, sidomos i receptorëve të të parit, kur ngrihet niveli i intensitetit të dritës që ndikon në syrin e njeriut. Procesi i përshtatjes së syrit me dritën është i shkurtër; ai zgjat rreth 15 – 60 sekonda. Baza fiziologjike e kësaj dukurie i përket proceseve fotokimike të rrjetëzës ose retinës së syrit dhe ndryshimeve të fotopigmentit rodopsinë;
b. **Përshtatja në errësirë** – Ngritja e nivelit të ndjeshmërisë së fotoreceptorëve, pikërisht e shkopthave kur ulet dukshëm niveli i dritës dhe i ndikimit të saj në syrin e njeriut. Ky proces fillon menjëherë pas ndërprerjes së ndikimit të dritës në syrin e njeriut dhe me këtë rast në fillim nuk shihet asgjë, por gradualisht syri i njeriut vjen duke iu përshtatur errësirës dhe pas rreth dyzet minutash, falë regjenerimit të pigmentit të rodopsinës, syri i përshtatet mjedisit të errët;
c. **Përshtatja e shqisave** – Ndryshimi i ndjeshmërisë së shqisave sipas kushteve të ngacmimeve të ndryshuara. Ndjeshmëria e shqisës së nuhatjes ndryshon në mjedisin e farmacisë pas një qëndrimi relativisht të shkurtër të njeriut në këtë mjedis, të mbushur me erë të rëndë; lëkura i përshtatet lehtë dhe shpejt ndikimit ngacmues të ujit të nxehtë ose të atij të ftohtë.

PËRSHTATJA KROMATIKE. Përshtatje e syrit që ka të bëjë me ndijimin e gjatë të cilësisë së një ngjyre kromatike, kur fillon të zvogëlohet ndijimi i cilësisë së asaj ngjyre, duke anuar kah neutraliteti i asaj ngjyre, pra kah ngjyra akromatike.

PËRSHTIRJ/E, - A. f. Gjësend, ngjarje, njeri etj. ndaj të cilit dikush ka përjetuar më të keqen, i është fyer rëndë sedra dhe tashmë, kur ai shfaqet te tjetri shkakton një ndjenjë të thellë negative

që shoqërohet me disa ndryshime fiziologjike (skuqje të lëkurës së fytyrës, tensionim muskujsh, vjellje etj.), duke shkaktuar, madje, largim sa më të shpejtë nga ai njeri, nga ngjarje etj. Pështirja është shumë e afërt me neverinë, por neveria ka intensitet më të lartë.

PËRSHTYPJ/E, - A. f. Gjurmë e mbetur në sistemin nervor nga përjetimi i ndijimit dhe i ndjenjës së shkaktuar nga ngjarja e dikurshme, që ka ushtruar ndikim në shqisat e njeriut dhe përgjithësisht në psikikën e njeriut. Gjurmët e tilla ruhen për një kohë relativisht të gjatë dhe riaktivizimi i tyre shkakton përtëritjen e asaj përshtypjeje. Shih – ***MBRESË***. Në psikologji bëhet fjalë për përshtypjet ndijimore, kognitive dhe emocionale, por kufiri ndërmjet tyre vihet me vështirësi**.**

PËRTACI, - A. f. Ves i formuar që karakterizon njeriun me mungesë dëshire e gatishmërie për punë, me ngathtësi të angazhimit të tij në veprime të përbashkëta dhe në kryerjen e detyrave personale. Shoqërohet me indiferencë ndaj detyrave, shtyn kryerjen e tyre dhe më në fund as që arrin t`i kryejë ato. Ka karakter të tiparit nëse është ves i qëndrueshëm dhe karakteristik për njeriun e caktuar. Përtacia herë-herë shoqërohet me kënaqësi që përjeton përtaci nga moskryerja e asaj detyre, nga mosangazhimi i duhur etj.

PËRTHITHJ/E-A. f. Veprimi i të thithurit të lëngjeve, të rrezeve etj. nga objektet e caktuara. Ky term haset në këto togfjalësha terminologjikë:

a. **Përthithja e dritës** – Veti e disa objekteve për të përthithur rrezatime të caktuara që është karakteristikë për shumë lëndë. Shkallën e përthithjes së rrezeve të dritës e përcakton përbërja e lëndëve;

b. **Përthithja përzgjedhëse** – Veti e disa lëndëve që të përthithin vetëm rreze me gjatësi valësh të caktuara. Kjo përcakton ngjyrën që do të marrë trupi; ngjyra e tij është ngjyra që rezulton nga bashkimi i rrezeve që nuk janë përthithur. Rrezet e këtilla shkaktojnë ndijimin e ngjyrës së një objekti të caktuar ngaqë syri i njeriut ngacmohet pikërisht nga këto rreze;

c. **Përthithja e zërit** – Thithje e disa valëve ajrore të zërit nga burimi i tij brenda një hapësire të caktuar dhe ndryshimi i cilësisë akustike të kësaj hapësire, duke e bërë zërin më të përshtatshëm për dëgjuesin. Kjo nënkupton shndërrimin e zërit në një lloj tjetër energjie.

PËRTHYERJ/E, – A. f. Ndërrim drejtimi i valëve të ajrit, i lëvizjes së valëve elektromagnetike, i zërit etj. Në këtë kuptim përthyerja e dritës është ndryshim i drejtimit të dritës gjatë kalimit të saj prej një mjedisi të tejdukshëm në një mjedis tjetër të tejdukshëm, por me përbërje dhe me denduri apo elasticitet të ndryshëm.

PËRTHYES, – E. mb. Që përthyen rrezet e dritës, që ka të bëjë me ndërrimin e drejtimit të dritës etj. Këtë kuptim e dallojmë në këto terma:

a. **Faza përthyese** – Kohë shumë e shkurtër që shfaqet prej çastit të ngacmimit të nervit dhe gjatë së cilës ai nuk reagon ndaj ngacmuesit tjetër;

b. **Gabimi përthyes** – Përqendrim jo normal i figurës së një objekti të caktuar në rrjetëzën e syrit. Shkaktohet

nga parregullsia e formës së kokërdhokut të syrit dhe nga parregullsia e funksionimit të disa pjesëve të kokërdhokut të syrit;

c. **Indeksi përthyes** – Treguesi i përthyerjes së rrezes së dritës, kur kjo kalon prej një mjedisi të tejdukshëm në një mjedis tjetër të tejdukshëm.

PËRULËSI, - A. f. Qëndrimi që nënkupton se të tjerët janë më superiorë. Vetia për t'iu bindur e nënshtruar një individi tjetër pa kundërshtim.

PËRVAJTIM, - I. m. Shprehja e dëshpërimit dhe e pikëllimit të një dhimbjeje të madhe me vaj dhe me dënesë. Përvajtimi shfaqet në tepër me rastin e humbjes së më të dashurit në familje.

PËRVOJ/Ë, - A. f. Term i përgjithshëm që gjen përdorim edhe në të folurin e zakonshëm. Në të folurin e përditshëm termi përvojë emërton gjithë atë që njeriu e ka përjetuar dhe e ka grumbulluar spontanisht, gjatë jetës së përditshme mbi bazën njohëse nga kontakti i tij i drejtpërdrejtë me dukuritë, me objektet dhe me proceset e ndryshme. Në psikologji termi përvojë emërton dijen e gjithëmbarshme të njeriut, të fituar jo vetëm gjatë praktikës së tij, por edhe me angazhimin për mbledhjen e grumbullimin e të dhënave dhe fakteve konkrete objektive e subjektive dhe nxjerrjen e mësimeve të vlefshme për njohjen dhe shfrytëzimin racional të atij mësimi. Mbi këtë bazë janë zhvilluar edhe disiplinat e shkencave empirike. Psikologjia është shkencë empirike dhe lënda e psikologjisë është përvoja personale e njeriut dhe studimi i kësaj përvoje. Në psikologjinë kognitive përvoja konsiderohet si tërësi dijesh e sistemuar në kokën e njeriut, e jo si diçka që është jashtë kokës së njeriut.

PËRZEMËRSI, - A. f. Qëndrim i përçuar dhe i gërshetuar dendur me ndjenja dashurie, çiltërsie e ngrohtësie ndaj një individi tjetër. Qëndrimi i tillë merr karakterin e tiparit të sjelljes karakteristike, atëherë kur njeriu afrueshmërinë, dashurinë dhe gëzimin e shfaq pak a shumë ndaj atyre që ai ka kontakt me ta, sidomos ndaj atyre që ai arrin t`i njohë**.**

PËRZGJEDHJA ANAKLITIKE E OBJEKTIT. Term i psikanalizës që emërton dashurinë e njeriut të pjekur, i cili kthehet vazhdimisht në kujtim dhe përjetim të dashurisë ndaj nënës së tij, nga e cila është varur zhvillimi i tij që nga mosha e hershme.

PËRZGJEDHJA DHE PËRSHKALLËZIMI I POHIMEVE Q. Instrument hulumtues dhe vetpërshkrues i personalitetit dhe i tipareve e organizimit të tyre të vetëdijshëm, si edhe i ndryshimeve të tyre në sferën e vetëdijshme të tij. Subjekti provues zgjedh dhe sistemon pohimet prej atyre më karakteristike për subjektin, deri te ato më pak karakteristike për të, ose që nuk kanë të bëjnë me personalitetin e tij. Në literaturën e psikologjisë së personalitetit ky term zëvendësohet me termin asortimenti Q. I përket grupit të teknikave të vlerësimit të personalitetit dhe tipareve e organizimit të tyre. Kjo teknikë ka 50 – 150 pohime, të cilat subjekti ka për detyrë t`i përshkallëzojë këto pohime në 11 kategori, sipas këtij rregulli: në kategorinë e parë hyjnë të gjitha pohimet që i përshkruajnë plotësisht tiparet e personalitetit të tij, në kategorinë e dytë i përtuprovuari zgjedh dhe i vendos ato pohime

që më pak përshkruajnë tiparet, në kategorinë e tretë ato pohime që i takojnë atij edhe më pak dhe kështu me radhë, kurse në 11 kategori vendos ato pohime që nuk i përkasin tipareve të tij. Përshkallëzimi duhet të bëhet sipas kurbës kumbonare, ku në dy skajet e saj vendosen pohimet më të pakta, kurse në mes vendosen pohimet më të shumta. Kjo përzgjedhje dhe përshkallëzim sipas kurbës normale mundëson përpunimin e lehtë statistikor të të dhënave. Këtë teknikë e ka hartuar dhe zbatuar psikologu amerikan V. Stivenson, kurse Karl Roxhersi e ka modifikuar për nevoja psikoterapeutike.

PËRZGJEDHJA NARCIZOIDE E OBJEKTIT TË DASHURISË. Përzgjedhje narciztike e objektit të dashurisë e nxitur nga narcizmi që mbështetet në ngjashmërinë e madhe të partnerit me veten e tij, që ka të bëjë vetëm me modelin e dikurshëm, të tashëm ose të ardhshëm të tij. Këtë dukuri e ka studiuar Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1939). Sipas tij, të rriturit që e zgjedhin partnerin sipas vetes, në realitet e kërkojnë veten e tyre në personalitetin e partnerit të zgjedhur.

PËRZGJEDHJA PROFESIONALE. Veprimtari profesionale që organizohet nga ekspertët e psikologjisë zbatuese ose aplikative, si edhe nga të tjerët, me qëllim të zgjedhjes së kandidatit më të mirë, që i plotëson kushtet parësore dhe dytësore testore për kryerjen me sukses të një pune profesionale të caktuar. Përzgjedhja bëhet në bazë të analizës së kërkesave të punës profesionale, të aftësive intelektuale dhe psikomotorike të kandidatit që i nënshtrohet testimit, intervistës dhe kontrollit mjekësor.

PËRZIERJA E FJALËVE. Në psikopatologji të folurit jonormal, të folurit jokoherent, ku fjalët përzihen me njëra-tjetrën, pa pasur fare kuptim. Dallohet sidomos në format e ndryshme të afazisë, por edhe në disa sëmundje psikike, sidomos te skizofrenikët.

PËRZIERJA E NGJYRAVE. Procesi i përftimit të cilësisë së një ngjyre të re nga përbërja e dy ose e më shumë ngjyrave. Ekzistojnë dy tipa kryesorë të përzierjes së ngjyrave: tipi aditiv dhe tipi superaktiv. Tipi aditiv i përzierjes së ngjyrave ka të bëjë me përzierjen e dritës së projektuar, ku përzierja e dritës së verdhë me të gjelbrën jep përjetimin e ngjyrës akromatike. Tipi superaktiv i përzierjes së ngjyrave është tipi i përzierjes së ngjyrave për pikturim, ku përzierja e ngjyrës së verdhë me ngjyrën e gjelbër jep ngjyrën e gjelbër. Zakonisht termi përzierje e ngjyrave përdoret për të emërtuar tipin aditiv të përzierjes së rrezeve të dritës dhe të projektimit të tyre, kur përftohet ndijimi i posaçëm nga ndikimi i njëkohshëm ose i njëpasnjëshëm i rrezeve të dritës në retinën e syrit. Tipi i veçantë i përzierjes së ngjyrave është tipi retinal i përzierjes së ngjyrave. Ky tip ka të bëjë me përftimin e efekteve të ndijimit të një ngjyre nga rrotullimi me ritëm të ndryshuar i një disku të mbuluar me një letër plastike të një ngjyre të caktuar.

PËRZIERJA E NGJYRAVE ADITIVE. I ardhur nga latinishtja *aditivus* "shtesë". Ky term emërton përzierjen e dritës së projektuar, ku rrezet e së verdhës, të përziera me ato të së gjelbrës japin përjetimin e ngjyrës akromatike, pra të ngjyrës së përhimët

në shkallë të ndryshme, që përcaktohen nga gjatësia e valëve elektromagnetike të së verdhës dhe të së gjelbrës.

PËRROI I NDËRGJEGJES. Vazhdimësia e funksionimit të vetëdijes dhe e përvojës së njeriut. Ky proces dallohet posaçërisht në rrjedhën e mendimeve e të ndjenjave që nga koha kur ato kanë filluar të zhvillohen dhe del në pah renditja zhvillimore e tyre sipas asociacioneve të lira. Kjo do të ishte rrjedhë e jetës subjektive. Rrjedhës së tillë ende i mungon rregullsia gramatikore, kronologjike, logjike etj., por pavarësisht nga kjo mungesë, mendimet dhe ndjenjat e njeriut rrjedhin pandërprerë. Përroi i ndërgjegjes u përdor nga filozofi dhe psikologu amerikan Xhejms Uiliam (James William, 1842 – 1910).

PËSHTJELLIMI MENDOR. Shfaqje e pasistemuar, e paqartë e mendimeve (e ideve, e koncepteve, e gjykimeve etj.) dhe e qëndrimeve për një çështje të caktuar. Është pasojë e disa faktorëve subjektivë: e njohjes sipërfaqësore të asaj çështjeje, e aftësisë së kufizuar për të dalluar thelbësoren. Të qenësishmen, më të rëndësishmen nga të tjerat jothelbësore, të rastësishmet, të parëndësishmet etj.

PIA MATER. I ardhur nga latinishtja që do të thotë "nëna e butë". Me termin *via mater* emërtohet njëra nga tri cipat e trurit, cipa e butë mbështjellëse e trurit dhe e palcës së kurrizit. Kjo cipë është e hollë dhe përçohet me shumë enë të holla të gjakut. Cipa *via mater* është shumë afër indeve dhe u shërben këtyre si mbulesë furnizuese me gjak.

PIERON Anri (Henri PIÉRON). Psikolog francez. Lindi më 1881 dhe vdiq më 1964. Profesor i psikologjisë në "College de France"; personalitet i njohur i zhvillimit të psikologjisë eksperimentale. Ka studiuar mekanizmat neurofiziologjikë dhe me mbrojtjen e doktoratës me temë "Fiziologjia e gjumit" u drejtua më tepër në zhvillimin e psikologjisë së zbatuar në veprimtarinë profesionale, sidomos në zhvillimin e "psikoteknologjisë", e pikërisht në zhvillimin e orientimit profesional të të rinjve. Ka përpunuar dhe zhvilluar ecurinë e hulumtimeve eksperimentale të proceseve psikike, sidomos të ndijimeve. Themelues i dokimologjisë – shkencës mbi vlerësimin. Njëri nga themeluesit dhe drejtor i Institutit për Hulumtimin e Punës dhe të Orientimit Profesional. Më 1940 u zgjodh Kryetar i Shoqatës Franceze për Përparimin e Shkencave, më 1973 Kryetar i Kongresit Ndërkombëtar të Psikologëve i organizuar në Paris dhe Kryetar i Bashkimit Ndërkombëtar për Psikologjinë Shkencore. Redaktor shumëvjeçar i revistës "Année psychologique". Ka ushtruar ndikim në zhvillimin e mendimit psikologjik në shumë vende të Europës. Veprat kryesore të Anri Pieron janë: "*L`évolution de la mémoire*" – ("*Evolucioni i kujtesës*"), 1910; "*Psychologie experimentale*" – ("*Psikologjia eksperimentale*"), 1927. Ka publikuar rreth 500 punime shkencore.

PIETET, - I. m. Term me prejardhje nga latinishtja *pietas*. Emërton respektin dhe nderimin ndaj autoriteteve të rëndësishme në fushëveprime të ndryshme: ndaj shkencëtarëve, shkrimtarëve, strategëve ushtarakë, trimave të dalluar në frontin e lirisë njerëzore e kombëtare etj.

PIGMENTET E TË PARIT. Përbërje specifike biokimike që merr pjesë në procesin e të parit duke përthithur nga drita valët elektromagnetike me gjatësi të ndryshme. Rrezet e dritës kanë receptorët pamorë të të parit (shkopthat dhe kunjëzat) e rrjetëzës ose të retinës së syrit. Pigmente të tilla janë rodopsina, vitamina A etj. Këto pigmente marrin pjesë në fillimin e shndërrimit të energjisë së dritës në proces të zhvillimit të impulseve nervore pamore. Pigmentet e të parit përbëjnë cipën e parë të rrjetëzës apo retinës së syrit.

PIJAZHE Zhan (Jean PIAGET). Psikolog dhe filozof zviceran. Lindur në Noenburg (Zvicër) më 9.08.1896 dhe vdiq në Gjenevë më 16.09.1980. Studioi shkencat biologjike dhe pas mbrojtjes së doktoratës në biologji u mor me psikologji dhe me logjikë. Për nevoja studimore shkoi në Sorbonë, ku mori informacion mbi punimet e Pjer Zhanes, të Alfred Bines dhe të Teodor Simonit. Këtu fillojnë gjurmimet e zhvillimit cilësor të mendjes së fëmijëve, duke u dhënë fëmijëve të moshave të ndryshme detyra dhe problema për zgjidhje dhe duke vëzhguar mënyrën e zgjidhjes së tyre në raport me moshën e tyre. Më 1921–1925 ishte bashkëpunëtor i Eduard Klaparedit gjatë drejtimit të Institutit "Zhan Zhak Ruso. Prej vitit 1929 qe profesor i psikologjisë eksperimentale në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Gjenevë, më pas profesor i psikologjisë gjenetike në Universitetin e Lozanës, lëndë të cilat i dha përsëri edhe në Gjenevë dhe në Paris. Themelues i Qendrës Ndërkombëtare për Epistemologjinë në Gjenevë. Mori pjesë në krijimin e revistës "Arkivi i psikologjisë i revistës zvicerane të psikologjisë" – ("Archives de psychologie i Revue Suisse de Psychologie"). Kryetar i parë i Shoqatës Zvicerane të Psikologëve. U dallua me kontributet e tij empirike në gjurmimin empirik të zhvillimit të mendimit, të gjuhës, të perceptimit etj. Në rezultatet e gjurmimit të mendimit të fëmijëve dalloi këto faza të zhvillimit të mendimit 1) *Faza sensomotorike*, 2) *Faza paraoperacionale*, 3) *Faza operacionale–konkrete* dhe 4) *Faza formale–operacionale.* Grumbulloi rreth vetes shumë studiues të psikologjisë, të logjikës, të matematikës etj., të cilët me rezultatet studimore, sidomos me metodat dhe procedurat gjurmuese themeluan Shkollën Gjenetike Strukturaliste të Gjenevës. Veprat kryesore të tij janë: Botimi i veprave komplete në 10 vëllime më 1975. Nga këto vepra dallojmë: *"La psychologie de l`intelligence"* – (*"Psikologjia e inteligjencies"*), 1947 (përkthyer në shqip, 2004); "*Introduction â l`épistémologie génétique I - III"* – (*"Hyrje në epistemologjinë gjenetike"*), 1950; "*Theorien und Methoden der modernen Erziehung"* – (*"Teoria dhe metodat e edukimit modern"*), 1972; *"Biologie und Erkenntnis"* – (*"Biologjia dhe shkenca"*), 1974; *"Epistémologie des sciences de l`home"* – (*"Epistemologjia shkenca mbi njeriun"*), 1972; *"Structuralisme"* – (*"Strukturalizmi"*), 1968. Në shqip është përkthyer teksti "Mbi pedagogjinë", botuar më 2005.

PIKËLLIM, - I. m. Ndjenjë e ndërlikuar e individit që ka të bëjë me gjendjen e dhimbjes së thellë shpirtërore për humbjen e njeriut më të dashur, dhe që ai vlerëson se e ka humbur përgjithmonë atë. Humbja e tillë përjetohet

gjithmonë kur i pikëlluari vlerëson se rëndësia e asaj që ka humbur është e madhe. Sa më i rëndësishëm të jetë individi, piktura, unaza e humbur etj., aq më intensiv është pikëllimi. Në rastet e këtilla ndjenja e pikëllimit merr përmasa pushtuese të mendimeve dhe të veprimeve të njeriut. Procesi i ndarjes dhe i shkëputjes së njeriut nga vlera e humbur përbën thelbin e pikëllimit. Pas humbjes së vlerave kaq të rëndësishme për një individ të caktuar, dalëngadalë fillon të zhvillohet përshtatja e tij ndaj kushteve dhe rrethanave të reja, si edhe rishikimi i sistemit të vlerave të tij, duke kërkuar vazhdimisht afirmimin e lidhjeve shoqërore të reja.

PIKËPAMJA GJENETIKE. Pikëpamje e psikanalizës, saktësisht e metapsikologjisë për konceptin e progresit, të regresit, të fiksimit dhe për atë të identifikimit, studimi i të cilëve ka të bëjë me qasjen specifike të dukurive psikike dhe formave të ndryshme të sjelljeve te të rriturit, shih – ***PROGRESI; REGRESI; FIKSIMI; IDENTIFIKIMI***. Pikëpamjen gjenetike të qasjes studimore të dukurive dhe sjelljeve të zhvilluara, përkatësisht "të pjekura" te të rriturit e kanë zhvilluar përfaqësuesit eminentë të psikologjisë së egos, Hajnc Hartman (Heinz Hartmann, 1894 – 1970), psikolog amerikan i lindur në Austri dhe psikologu gjerman Ernst Kris (Ernst Kris, 1901 – 1957).

PIKËPAMJA PSIKOLOGJIKE. Vështrim e shqyrtim i një çështjeje psikologjike nga një këndvështrim i caktuar. Strukturën e kësaj pikëpamjeje e përbëjnë sistemi pak a shumë ndërlidhës i koncepteve, gjykimeve dhe i arsyetimeve, i krijuar nga mënyra dhe metoda e përcaktimit të përmbajtjes së saj. E tillë është pikëpamja e psikologjisë humaniste për personalitetin, shpjegimi i emocioneve nga pikëpamja neurofiziologjike, pikëpamja kognitiviste për sjelljet e njeriut etj.

PIKËPAMJET E MOTIVACIONIT. Tërësi koherente shpjegimesh të veçanta të motivacionit për të kuptuar veprimtarinë dhe sjelljet e caktuara njerëzore. Dallohen disa pikëpamje të tilla:

a. **Pikëpamja biologjike** – Shpjegim i veprimtarisë së gjithanshme të njeriut nga nevojat biologjike të përgjithshme dhe të lindura. Pikëpamja biologjike është ndër pikëpamjet më të vjetra.
b. **Pikëpamja bihejvioriste** – Shpjegim i aktivitetit të njeriut në bazë të ngacmimit të jashtëm të shtytësve të lindur të tij. Pikëpamja bihejvioriste është e lidhur kryesisht me themeluesin e bihejviorizmit Xhon B. Uatson (John B. Watson, 1878 – 1958).
c. **Pikëpamja e psikologjisë humaniste** – Shpjegim i veprimtarisë së ndërlikuar të njeriut në bazë të motiveve humaniste dhe të pjekurisë së motiveve. Shih – ***HIERARKIA E MOTIVEVE***. Përfaqësuesi më i njohur i kësaj pikëpamjeje është psikologu amerikan Abraham H. Maslou (Abraham H. Maslow, 1908 – 1870).
d. **Pikëpamja instinktiviste** – Reduktim i veprimtarisë së gjithëmbarshme të njeriut në një numër të caktuar instinktesh. Përfaqësuesi më i njohur i kësaj pikëpamjeje është psikiatri dhe psikologu anglo-amerikan Uiliam Mekdugal (William McDougal, 1871

–1938), i cili, veprimtarinë e gjithëmbarshme dhe të ndërlikuar të njeriut, është orvatur ta shpjegojë në bazë të një numri të kufizuar instinktesh (18 instinkte).

e. Pikëpamja psikanalitike – Shpjegim i aktivitetit të njeriut duke marrë për bazë motivacionin biologjik e të pavetëdijshëm të dy shtytësve kryesorë, të shtytësit të erosit: që është shtytësi i ruajtjes së llojit dhe të shtytësit tanatos, që simbolizon energjinë e shkatërrimit dhe të vdekjes, si edhe kundërshtitë e luftën ndërmjet këtyre shtytësve. Kjo është pikëpamje e Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939).

f. Pikëpamja e vullnetit të lirë – Pikëpamje hipotetike, sipas së cilës motivacioni është i lidhur me vullnetin e lirë të njeriut, i cili është mbisundues i vetvetes dhe si i tillë ai zgjedh vetë përse dhe si do të veprojë në një situatë të caktuar.

PIKËSYNIM, - I. m. Qëllim apo objektiv i identifikuar nga ana e një individi, që shoqërohet me gatishmërinë e angazhimit dhe me veprimet e caktuara për arritjen e zotërimin e tij. Kuptimi i përgjithshëm i këtij termi ka të bëjë me rezultatin përfundimtar të afërt ose të largët që njeriu kërkon ta realizojë me ngulm, pra pika e fundit që njeriu synon ta arrijë me veprimtarinë e vet.

PIKTOFILI, - A. f. Prirje dashurie e atyre që arrijnë shqetësimin, tensionin dhe kënaqësinë seksuale duke vëzhguar piktura e filma erotikë. Çdo skenë filmi erotik zgjon ndjenja seksuale te ata që kanë zhvillim normal, por te piktofilët kjo mënyrë e ngacmimit seksual me anë të pikturave dhe filmave erotikë është tipar relativisht i qëndrueshëm i sjelljeve dhe i jetës seksuale të tyre. Tipat piktofilë zgjedhin para partnerit pikturën apo filmin erotik dhe më pas mund të arrijnë deri në orgazëm me partnerin, nëse këtë nuk e ka arritur gjatë vëzhgimit të pikturave dhe filmave erotikë.

PINEL Filip (Philippe PINEL). Mjek psikiatër francez. Lindi më 1745 dhe vdiq më 1826. I njohur për konstatimin e raportit të keq ndaj të sëmurëve mendorë dhe këmbënguljen e tij për të humanizuar këtë raport. Qysh kur qe emëruar drejtor i një çmendurie, Filip Pineli konstatoi raportin e egër ndaj sëmundjeve mendore, pasi këta keqtrajtoheshin nga kujdestarët, të cilët përdornin mënyra të ndryshme dhune, si: rrahje, lidhje me pranga, punë të rënda fizike jashtë mendjes njerëzore. Me gjithë, kohët e vështira ushtarake, ekonomike dhe politike të Francës së asokohe, kur Filip Pinel këmbëngulte në ndryshimin e raporteve të tilla jonjerëzore, organet e pushtetit të atëhershëm arritën të bëjnë ndryshime në trajtimin fizik, psikik, ushqimor, mjekësor dhe të vendstrehimit për të sëmurët psikikë. Ka qenë konceptues bashkëkohor i asaj kohe për shkaqet e lindjes së sëmundjeve mendore dhe i konceptimit të shërimit moral të tyre. Në bazë të këtyre koncepteve ndryshuan raportet ndaj të sëmurëve psikikë në të mirë të tyre, jo vetëm në Francë, por edhe në Angli, në Gjermani dhe në vende të tjera. Për këtë arsye konsiderohet se është reformues i psikiatrisë në përgjithësi. Pinel arriti të konceptojë klasifikimin origjinal të sëmundjeve shpirtërore në bazë të etiologjisë së këtyre sëmundjeve. Sipas këtij klasifikimi të

sëmundjeve psikike, këto sëmundje kanë këtë ndarje: pireksia, hemoragjia, lezionet organike dhe neurozat. Neurozat nuk janë vetëm çrregullime nervore, por edhe çrregullime morale e psikike. Veprat kryesore të tij janë: *"Nosographie philosophique ou la méthod de l`analyse aplpliquée a la médecine"* – (*"Nosografia filozofike e metodës analitike të zbatuar në mjekësi"*), 1789; *"Traité médico – philosophique sur l`aliénation mentale ou manie"* – (*"Trajtimi mjekësor – filozofik i alienacioinit mendor të manisë"*), 1801.

PIRAMIDA E HENINGUT. Klasifikim i katër llojeve të shijes së lëndëve ushqyese. Në majën e secilës faqe të piramidës gjendet njëra ndër katër shijet: e njelmëta, e tharta, e ëmbla dhe e hidhura. Shijet e tjera ndërmjet këtyre katër shijeve kryesore mund të vendosen në piramidë në bazë të ngjashmërisë dhe të dallimit të tyre nga shijet kryesore. Këtë e ka paraqitur për herë të parë në historinë e psikologjisë psikologu gjerman Hans Hening (Hans Henning, 1885 – 1946). Kjo piramidë ilustrohet nga figura e mëposhtme:



PIROMANI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *πυρο* "zjarr" dhe *μανία* "çmenduri". Piromania është formë e çrregullimit të kontrollit të impulseve të brendshme të njeriut, të nxitura dhe të drejtuara në shkaktimin e zjarrit dhe të përjetimit të kënaqësisë kur ai sheh flakë të madhe. Shkak i kësaj forme të çrregullimit kontrollues të impulseve të brendshme është vetëkënaqësia që përjeton njeriu që i vë zjarrin mullarit të sanës, depos së druve të thatë, magazinës së benzinës etj. Piromani këtë akt nuk e bën për hakmarrje, për ndonjë përfitim material etj., por vetëm për kënaqësi të pashpjegueshme.

PIRSON Karl (Karl PEARSON, 1857 – 1936). Matematikan, statisticien dhe biolog anglez. Profesor i matematikës në Kolegjin Universitar të Londrës. Krijues i paraleles për statistikën zbatuese, më 1901 themeloi revistën "*Biometrica*" – ("*Biometrika*") dhe më pas, më 1925 "*The Annals of Eugenics*" – ("*Eugjenika e kafshëve*"). Në revistën "Biometrica" u botuan vetëm punimet matematiko-statistikore të dukurive biologjike. Metodat dhe procedurat matematike dhe statistike të tij u zbatuan me të madhe në hulumtimet psikologjike, por jo vetëm psikologjike. Në psikologji është i njohur me përcaktimin e llogaritjes së koeficientit të produktit të ndërlidhjes apo korrelacionit, të formulave për përcaktimin e koeficientit të shumëfishtë të korrelacionit, të biserialit të korrelacionit etj. Ka botuar vepra nga matematika e statistika, ndër të cilat më kryesoret janë: *"Mathematical contribution to the theory of evolution"* – (*"Kontributi i matematikës në teorinë e evolucionit"*), 1894 – 1898; "*Tables for statiscians and biometricians"* – (*"Tabelat për statistikanët dhe biometrikanët" 1914.*

PJEKURI, - A. f. Term i biologjisë dhe i psikologjisë biologjike që ka të bëjë me strukturën organike, psikike,

funksionale të një organizmi që ka arritur zhvillimin e plotë. Gjatë procesit të pjekurisë shfaqen ndryshime organike dhe psikike sipas rendit, kohës e formës, duke u kontrolluar nga faktorët e brendshëm, kryesisht nga faktorët organikë. Ndryshimet e lidhura me pjekurinë kanë të bëjnë në radhë të parë me ndryshimet zhvillimore të sistemit nervor. Ndryshimet trupore e psikike të njeriut në moshën e pjekurisë shfaqen gati njësoj te të gjithë dhe përafërsisht në të njëjtën kohë. Në psikologji bëhet fjalë për pjekuri strukturash, funksionesh, tiparesh etj., të tilla si:

a. **Pjekuria emocionale –** Formë e pjekurisë së personalitetit, që ka të bëjë me gatishmërinë e formuar të njeriut për t`i përjetuar, kontrolluar dhe shprehur lirisht ndjenjat e veta me të gjitha format e begatshme të tyre, në shkallën e reagimit emocional të të rriturve në një mjedis kulturor dhe pa rrjedhime të dëmshme për vete dhe për të tjerët. Pjekurinë e tillë e karakterizon zhdukja e formave të reagimit emocional fëmijëror, kontrolli i emocioneve nga vetë njeriu, qëndrueshmëria emocionale, menaxhimi si duhet i gjendjeve emocionale në situata të ndryshme të jetës dhe të aktivitetit të njeriut etj.;

b. **Pjekuria intelektuale –** Shkalla e zhvillimit të strukturave njohëse dhe të proceseve kognitive në nivel të moshës kalendarike të një individi. Kjo shkallë nënkupton zhvillimin e mendimit dhe të proceseve intelektuale jashtë dëshirave, nevojave dhe emocioneve të njeriut. Pjekuria intelektuale është mendim objektiv sipas shkallëve të operacioneve formale të procesit mendor, që i përkasin moshës së caktuar të individit.

c. **Pjekuria e fëmijës për shkollim –** Zhvillimi dhe rritja trupore apo fizike e shëndoshë, pjekuria emocionale, intelektuale dhe shoqërore (pavarësia e fëmijës për t`u gjendur jashtë shtëpisë e familjes, shfaqja e interesimeve për të tjerët dhe për ndryshimet në mjedisin e tij, gatishmëria për bashkëpunim, të kuptuarit e ndryshimeve sasiore, zhvillimi i aftësive për të zbërthyer tërësinë në pjesët e veta etj.;

d. **Pjekuria e personalitetit –** Njeriu i rritur me shkallën e duhur të zhvillimit të tipareve të personalitetit (të identitetit, të integritetit, të unitetit dhe të veçantisë) dhe të harmonisë ndërmjet tyre. Sipas studiuesit amerikan Gordon V. Olport (Gordon W. Allport, 1897 – 1967) pjekuria e personalitetit karakterizohet me këto veti: ndjenjë e zgjeruar për veten, marrëdhënie e ngrohtë me të tjerët, qëndrueshmëri e ndjenjave, kuptim i misionit në mjedisin ku vepron njeriu, kuptim i vetvetes dhe gatishmëri e vetëkritikës dhe e pranimit të kritikës së bashku me sistemin unik të botëkuptimit;

e. **Pjekuria skeletore –** Shkalla e nivelit më të lartë të eshtërimit të kockave të duarve. Kjo shkallë përdoret si përcaktuese më e sigurt e pjekurisë së skeletit.

f. **Pjekuria shoqërore –** Përbërëse e rëndësishme e personalitetit të shëndoshë. Pjekuria shoqërore ka të bëjë me përvetësimin dhe zbatimin e drejtë të parimeve dhe të normave morale të mjedisit ku vepron njeriu, me gatishmërinë e vendosjes së raporteve të shëndosha me të tjerët, me shkallën

e duhur të zhvillimit të inteligjencies shoqërore, me shkallën e lartë të zhvillimit të ndjenjës së përgjegjësisë ndaj detyrave familjare, mjedisore, profesionale etj. Pjekuria shoqërore e personalitetit është e lidhur ngushtë me karakterin dhe me shkallën e zhvillimit kulturor të mjedisit ku zhvillohet dhe formohet njeriu.

PJESA BALLORE E TRURIT. Pjesë e trurit të madh e njohur në anatominë e sistemit nervor me termin latin *lobus frontalis*. Shtrihet nga pjesa e përparme e brazdës ose hullisë qendrore deri te pjesa e sipërme e plasës anësore të trurit. Në pjesën e poshtme të pjesës ballore është e vendosur fusha e qendrave të lëvizjes apo e qendrave motorike. Nga këto qendra impulset nervore shkojnë në muskujt skeletorë që mundësojnë veprimet e lëvizjet e vullnetshme, kurse nën këtë fushë shtrihen qendrat dytësore të lëvizjeve, të cilat me funksionet e tyre i integrojnë këto lëvizje në tërësi lëvizjesh të drejtuara në qëllimin e caktuar të njeriut. Para kësaj fushe shtrihen qendrat nervore që janë bartëse të aktiviteteve të vullnetshme të njeriut. Në pjesën e poshtme të fushës paramotorike shtrihet fusha Brok, ku gjendet qendra e të folurit. Pjesa e përparme e pjesës ballore është e lidhur me formacionin retikular ose rrjetëzen retikulare. Kjo merr pjesë në rregullimin e përgjithshëm të aktivitetit të njeriut, duke ia përshtatur shkallën e aktivitetit qëllimit të caktuar të veprimtarisë së njeriut.

PJESA THEMELORE E TRURIT TË PËRPARMË. Pjesa anësore e hipotalamusit, e cila kontrollon procesin termik të trupit të njeriut dhe procesin e gjumësisë. Të pushuarit e funksionimit të kësaj pjese çon në pagjumësi të plotë të organizmit dhe gjendja e tillë shkakton vdekjen e njeriut brenda pak ditësh.

PJESËT PARIETALE. Pjesë të hemisferave të trurit që shtrihen ndërmjet pjesëve ballore e zverkore mbi pjesën temporale a tëmthore të trurit. Në shqipe pjesët parietale emërtohen me termin pjesët tepore. Kjo pjesë e hemisferave është zonë e posaçme e cipës ose e kores së trurit, që është e zhvilluar në dy pjesë: pjesa e sipërme është bartëse e zonave parësore dhe dytësore të ndijimeve të trupit të njeriut (të ndijimeve të lëkurës – të prekjes, të ftohtit, të nxehjes – dhe të ndijimeve kinestetike); pjesa e poshtme parietale është e formuar nga zona trunore, ku integrohen informacionet e shqisës së të parit, të dëgjimit dhe ato të ndijimeve trupore. Falë funksionit të kësaj zone njeriu është në gjendje të konceptojë të gjithë atë çka ngjet në mjedisin e tij. Në pjesën e fundit të kësaj pjese të trurit, përkatësisht të hemisferës së majtë kryhet analiza e simboleve fjalësore dhe e simboleve të matematikës. Në hemisferën e djathtë të kësaj pjese kryhet perceptimi i hapësirës dhe i raporteve hapësinore, si edhe proceset e kujtesës dhe të planifikimit të pjesëve të lëvizjeve në kuadrin e një veprimtare të tërësishme.

PLACEBO, - JA. f. Term i farmakologjisë me prejardhje nga latinishtja *placeo, ere* "me qenë i këndshëm". Placeboja është preparat farmakologjik pa kurrfarë ndikimi në ndryshimin e gjendjes së pacientit. Përdoret për të

provuar efektin fiziologjik dhe për të ndarë nga efekti fiziologjik efektin psikologjik të pacientit. Përdoret zakonisht për të provuar efektin neutral të këtij ngacmuesi (ujë i zakonshëm), kur subjektet e një grupi janë të bindur se kanë marrë një substancë farmakologjike të vërtetë.

PLAKJ/E, - A. f. Proces ndryshimesh trupore apo fizike dhe psikike me kalimin e kohës, që karakterizohet nga dobësimi gradual i organeve dhe i funksioneve të tyre pas pjekurisë së organizmit. Ky proces është i natyrshëm dhe zhvillohet pavarësisht nga ngjarjet e përjetimet gjatë jetës, pavarësisht nga problemet personale e shoqërore, si edhe nga sëmundjet e çrregullimet e strukturave trupore e psikike. Plakja e njeriut ka karakter progresiv dhe procesi i plakjes është proces i pakthyeshëm biokimik, por shumë i ndërlikuar dhe pjesërisht i njohur.

PLAN, - I. m. Term i përgjithshëm, por me kuptim të veçantë në ekonomi, në metodologji, në psikologji etj. Kuptimi i përgjithshëm i termit plan ka të bëjë me të menduarit paraprak të një aksioni që duhet kryer, me një paraqitje analitike të ecurisë, të mjeteve të realizimit të një detyre të caktuar, të rendit dhe të fazave të parashtruara të një veprimtarie të caktuar, si edhe të elementeve që ndërhyjnë ndërmjet fazave të asaj veprimtarie. Në psikologji termi plan i përket më tepër metodës hulumtuese të një çështjeje apo ndryshoreje psikologjike. Plani i tillë nënkupton pasqyrën sintetizuese, të shkurtër dhe të qartë të këtyre veprimeve: përcaktimin e shkoqitur të çështjes hulumtuese, përshkrimin e shkurtër të saj, përcaktimin e numrit të subjekteve provuese, ndarjen e tyre në grupin eksperimental dhe kontrollues, procedurat hulumtuese që duhet zbatuar gjatë hulumtimit eksperimental të ndryshores psikike të caktuar, analizën e rezultateve pas përfundimit të atij eksperimenti dhe kumtimin e qartë të tyre.

PLANI I PËRFORCIMIT TË NJË SJELLJEJE. Paraqitje me shkrim e orarit dhe e shpeshtësisë së përforcimit të një sjelljeje me anë të shpërblimit, të reagimit pozitiv, ose të dënimit të reagimit negativ, të mënyrës së përforcimit pas dy-, tri-, pesë reagimesh, i shpërblimit ose i ndriçimit të pjesshëm apo të tërësishëm etj. Plani i përforcimit të një sjelljeje, përkatësisht zbatimi i saktë i tij përcakton shpejtësinë e zotërimit të një sjelljeje dhe qëndrueshmërinë e saj në repertorin e sjelljeve të atij organizmi.

PLANI I VËZHGIMIT. Operacionalizimi i veprimeve për vëzhgimin e një dukurie, të një ndryshoreje, të një procesi të caktuar. Plani i vëzhgimit ka këto elemente përbërës: identifikimin e objektit të vëzhgimit, përcaktimin e kohës, të mjeteve dhe të mënyrave të vëzhgimit dhe të shënimit të përcaktuesve të tyre, në bazë të të cilëve duhet të bëhet klasifikimi i të dhënave të përftuara dhe i mënyrës së regjistrimit të tyre.

PLASTICITET, - I. m. Term me përdorim të përgjithshëm, që emërton mundësinë e ndryshimit të një gjendjeje, të nivelit të ndjeshmërisë, të përshtatjes etj. Termi plasticitet ka zënë vend edhe në psikoneurologji, në psikologjinë sociale dhe në psikologjinë pedagogjike. Në psikoneurologji

emërton aftësinë e indit nervor për të marrë funksionin e një indi tjetër nervor, në psikologjinë pedagogjike emërton stilin e të mësuarit dhe përsosjen e tij, kurse në psikologjinë sociale emërton ndryshueshmërinë e rolit të një individi dhe përshtatjen e sjelljeve të tij ndaj situatave dhe raporteve të ndryshuara shoqërore etj.

PLASTICITETI FUNKSIONAL. Aftësia e njeriut për të lëvizur prej një vendi pune në një vend tjetër, duke pasur sukses në këtë zhvendosje. Aksidentet në punë janë shpjeguar dikur me mungesën e faktorit të aftësisë për zhvendosjen nga një vend i punës në vendin tjetër. Rezultatet e analizës faktoriale kanë argumentuar se nuk ekziston faktori aftësi e zhvendosjes së punëtorit në vende të ndryshme të punës.

PLASTICITETI I TRURIT. Term i psikologjisë klasike që emërton aftësinë e ndryshimit të funksioneve të trurit nën ndikimin e të mësuarit dhe përvojës së njeriut. Ky term emërton më tepër kompensimin e funksioneve të pjesëve të cipës apo kores së trurit të madh, të zonave të veçanta (të zonës frontale a ballore, parietale ose tepore dhe të zonës temporale ose tëmthore) pas lindjes së fëmijës, si edhe pas dëmtimit të strukturës dhe të funksionit të ndonjërës nga pjesët, përkatësisht të ndonjërës nga zonat e cipës së trurit të madh.

PLATE, - A. f. Term i marrë nga psikologjia franceze *plateau* që emërton rrafshnaltën, e pikërisht në psikologjinë e të mësuarit emërton pikën kulminante të të mësuarit, kur fillon ngadalësimi ose ndërprerja e përparimit në të mësuarin e një lënde në gjuhë të huaj, të një shprehie etj. Platea shkaktohet nga pamundësia e përparimit të mëtejshëm, nga humbja e interesit për natyrën e asaj lënde, nga rënia e motivacionit për të mësuar etj. Mund të paraqitet me diagram, kur ky merr formë të rrafshët.

PLEGJI, - A. f. Term i psikopatologjisë dhe i neuropsikiatrisë i ardhur në shqip nga latinishtja që emërton kuptimin e sulmit (atakut), që godet kryesisht strukturat nervore të trurit të mesëm, sidomos godet funksionimin e fijeve nervore që lidhin qendrat e trurit të mesëm me muskujt. Goditja e tillë shkakton pamundësinë e zhvillimit dhe të organizimit të sjelljeve të veprimtarisë së vullnetshme të njeriut. Shih – ***PARALIZA.***

PLEQËSI, - A. f. Këshill burrash dhe krerësh të fisit e të fshatit që pleqëronin konflikte të ndryshme ndërmjet individëve, familjeve, fiseve, vëllazërive etj. dhe merrej me vendosjen e masave të veçanta për ruajtjen e rendit e të mirëmbajtjes së marrëdhënieve ndërmjet anëtarëve të fisit, të vëllazërive etj. Vepronte kur marrëdhëniet ekonomike e shoqërore rregulloheshin në bazë të së drejtës zakonore.

PLEQNAR, - I. m. Individ i zgjedhur në institucionin e së drejtës zakonore, në pleqësi që karakterizohej nga tipare të veçanta psikologjike dhe etike. Ndër këto tipare dalloheshin burrëria, mençuria e shkallës së lartë, ndershmëria, njohja e duhur e normave zakonore dhe autoriteti i tij ndër anëtarët e fisit dhe të fshatit. Autoriteti i tillë formohej në themelin e tipareve të lartpërmendura të personalitetit

të pleqnarit. Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit anëtarët e pleqësisë mund të ishin vetëm ata pleq dhe bajraktarë të fiseve shqiptare, të cilët gëzonin famën e burrave të ndershëm, të drejtë dhe trima dhe zotëronin aftësi të veçantë në zbatimin e dispozitave të Kanunit të Lekë Dukagjinit.

PLOGËSHTI- A. f. Mënyrë e posaçme e reagimit dhe e veprimit të caktuar, të cilën e karakterizon vonesa, ngadalësia e lëvizjeve, zvogëlimi i fushës së interesimit të njeriut dhe përpjekja e tij për mosndryshimin e kësaj gjendjeje. Plogështia mund të marrë tiparin e personalitetit, nëse bëhet formë e qëndrueshme e reagimit karakteristik të tij.

PLURALIZ/ËM, - MI. m. Term i ontologjisë, i politikologjisë dhe i sociologjisë me pak shtrirje kuptimore në psikologji, që ka hyrë në shqipe nga latinishtja *pluralis* "shumësi". Termi pluralizëm haset rrallë në psikologji, ku emërton para së gjithash shumësinë e motiveve, të nevojave, të shtytësve etj. Pluralizmi i nevojave në psikologjinë e Abraham H. Maslout (Abraham Maslow, 1908 – 1970) ka të bëjë me shumësinë e nevojave të shfaqura në shkallëzim hierarkik sipas plotësimit të tyre. Shih – ***PSIKOLOGJIA HUMANISTE***. Pluralizmi emërton edhe pritjen e gjurmimit të shkaqeve (jo të një, por të disa shkaqeve) të një dukurie, procesi, situate psikologjike etj.

PLLAKA MAKSVELL. Pllakë e zakonshme e hollë, e rrumbullakët, por e ngjyrosur dhe e shpuar me shumë vrima në largësi të barabarta. Pllaka Maksvell vendoset në një aparat rrotullues; duke u rrotulluar me shpejtësi të madhe hulumtuesi ka mundësi të kontrollojë parimet e përzierjes së ngjyrave. Pllaka mori emrin e fizikanit skocez Xhejms Maksvell (James K. Maxwel, 1831 – 1879).

POLARITET, - I. m. Veçori e një vazhdimësie të një dukurie, procesi etj. që ka dy skaje të kundërta. Në psikologji raport polariteti kemi në shtrirjen e ndjeshmërisë së kundërt: i ngrohtë – i ftohtë, në shtrirjen e tiparit të personalitetit introvert – ekstravert, energjik – i qetë, mbisundues – nënsundues etj.

POLARIZIM, - I. m. Ngritje e shkallës së skajshmërisë së paragjykimeve, të qëndrimeve, të vendimeve etj. të pjesëtarëve të një grupi shoqëror. Kjo është pasojë e diskutimeve të gjata për qëndrimin e caktuar ndaj një çështjeje, kur skajshmëria e atij qëndrimi e shton shkallën e vet duke u bërë edhe më negativ, ose duke marrë përpjesëtim pozitiv të nivelit edhe më të lartë. Polarizimi i tillë është i dallueshëm sidomos në situata të ndryshueshme me rreziqe politike, ekonomike, sociale etj.

POLIANDRI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *poly* "shumë" dhe *andros* "njeri, bashkëshort". Poliandria emërton bashkësinë martesore të formuar nga një grua dhe disa meshkuj dhe është një dukuri e rrallë në botën njerëzore.

POLIDAKTIL, - E. mb. I ardhur nga greqishtja *πολυ* "shumë" dhe *δακτυλία* "gisht", që emërton rastet e jashtëzakonshme të atyre individëve që kanë më shumë gishtërinj të dorës ose të këmbës nga numri i zakonshëm pesë në secilën gjymtyrë.

POLIGAMI, - A. Term me prejardhje nga greqishtja *πολυ* "shumë" dhe *γαμος* "dasmë, martesë". Poligamia është

formë martesore, ku një individ jeton në të njëjtën kohë me disa partnerë të gjinisë së kundërt. Ekziston edhe poligamia vëllazërore, ku të gjithë meshkujt janë vëllezër.

POLIGONI I FREKUENCAVE. Lloj i paraqitjes grafike të shkallës së shpeshtësisë të një vargu të dhënash statistikore të përftuara nga matja e një ndryshoreje te nxënësit, studentët etj. të moshave të ndryshme. Paraqitja grafike e tillë i përngjet një diagrami. Poligoni i frekuencave vizatohet në sistemin koordinativ, ku në abshisë vendoset masa e matjes p.sh., mosha e nxënësve, numri i pikave të fituara në një test etj., kurse në ordinatë numri i subjekteve të provuar. Këtë e ilustron tabela e mëposhtme:



POLIGONI I FREKUENCAVE KUMULATIVE. Paraqitje tabelore e shumës së vlerave numerike brenda një klase të përcaktuar sasiore (e numrit të përgjithshëm të rasteve brenda një klase), e shtuar me shpeshtësinë e vlerës mesatare të klasës poshtë saj. E tillë mund të jetë paraqitja tabelore e vlerave të mëposhtme:

klasa frekuenca frekuenca kumulative

0 - 3	2	2
4 - 7	3	4 (2+2)
8 - 11	5	11 (2+4+5) etj.

POLIGRAFI, - A. f. Emërtim greqisht i aparatit që regjistron në të njëjtën kohë disa ndryshime të organeve në letrën mbështjellëse të rrotullës, e cila rrotullohet me ritëm të njëjtë kohor. Ndryshimet regjistruese të tilla janë: ndryshimet e ritmit të frymëmarrjes, ndryshimet e të rrahurit të zemrës, ndryshimet e presionit të gjakut, ndryshimet e pulsit etj. Poligrafi përdoret në psikologjinë fiziologjike, në psikologjinë klinike, në psikopatologji etj. U shënuan të dhëna të rëndësishme të lidhjeve ndërmjet intensitetit dhe kohëzgjatjes së emocioneve dhe disa ndryshimeve ritmike të funksioneve të disa organeve dhe sistemit të tyre.

POLIOPI, - A. f. Dukuri jonormale në procesin e të parit të një objekti, që karakterizohet nga shfaqja e dy ose më shumë figurave të këtij objekti në rrjetëzën ose retinën e syrit. Poliopia rrjedh nga funksionimi i çrregulluar i pjesëve të syrit, sidomos nga çrregullimi i thyerjes së rrezeve të dritës nëpër korne, bebëz dhe nëpër lentën e syrit.

POLISEMI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *πολύ* "shumë" dhe *συμος* "shenjë". Polisemia është dykuptimësia ose shumëkuptimësia e një fjale. Dukuria e tillë haset edhe në disa terma psikologjikë të gjuhës shqipe, si: ***gjuhë*** (organ shqisor i shijes dhe sistem i artikuluar foljor; ***dhembje*** (lloj i ndijimit të lëkurës dhe vuajtje e atij/asaj që i dhimbset diçka); ***shëmbëllim***

(përngjasim dhe riprodhim i figurës së një trupi të perceptuar më parë).

PONDER, - I. m. Term i statistikës me prejardhje nga latinishtja *pondus* "ngarkesë". Ponderi është ngarkesa relative e "peshës" së një rezultati, e rëndësisë së tij dhe ndikimi i kësaj "peshe", përkatësisht rëndësie në rezultatin e përgjithshëm të matjes së një ndryshoreje. Peshë më të madhe të ndikimit të rezultatit të një testi në rezultatin e dy ose tri testeve të ngjashme mund t`i japim arbitrarisht një testi në mbështetje të një kriteri. Në psikometri sa më e lartë të jetë shmangia standarde e arritjeve të grupit të posaçëm të subjekteve në një test, aq më i madh është kontributi i rezultateve të atij testi në rezultatin e përgjithshëm (në rezultatin bruto) të arritjeve të tyre në dy teste. Ndër disa të mesme aritmetike, e mesmja aritmetike e përftuar nga arritjet e më shumë subjekteve, ose nga matja e disahershme e asaj ndryshoreje ka peshë më të madhe se ajo e përftuar nga arritjet e më pak subjekteve, ose nga numri më i vogël i matjeve të së njëjtës ndryshore. Në statistikën psikologjike dallohen *ponderimi latent* dhe *ponderimi beta*.

PONS, - I. m. Term i anatomisë së sistemit nervor, i ardhur nga latinishtja *pons* "urë" që emërton strukturën nervore që gjendet ndërmjet pjesës vazhduese të palcës së kurrizit dhe trurit të mesëm, shih - *TRURI*. Pjesa e përparme e urës nervore formohet nga bërthama e urës, përkatësisht nga fijezat nervore dhe nga grumbujt e qelizave nervore. Bërthamat nervore kryejnë funksionin e lidhjes së trurit të madh me trurin e vogël dhe një pjesë e kësaj strukture kontrollon kryerjen e veprimeve të vullnetshme të njeriut. Pjesa e poshtme e ponsit, përkatësisht e urës ka disa gërsheta fijezash nervore dhe bërthamash të tyre që janë të lidhura me nervat V, VI, VII e VIII. Emërtohet edhe sipas zbuluesit të saj, anatomistit italian Konstanco Varolius (Constanzo Varolius, 1543 – 1573).

POPULLARITET, - I. m. Fama e një individi në popull, me të cilën shfaqet dashuria dhe qëndrimi pozitiv i të tjerëve ndaj njeriut me popullaritet, ndaj njeriut që ka vlera me rëndësi të përgjithshme për mjedisin ku ai jeton dhe vepron.

POPULLAT/Ë, - A. f. Të gjithë organizmat e një lloji të caktuar qeniesh të gjalla. Në statistikë termi popullatë emërton të gjithë banorët e një fshati, qyteti, vendbanimi etj. që i nënshtrohen një gjurmimi, p.sh., konstatimit të gjatësisë mesatare trupore të banorëve të Deçanit dhe të Dropullit të lindur në vitin 2000. Në këtë rast kemi të bëjmë me popullatë të caktuar dhe të mundshme për matje të gjatësisë trupore. Kjo është formë e mundimshme dhe e kushtueshme për gjurmim. Popullata e qenësishme, por e pacaktueshme është ajo popullatë që ka shtrirje të pakufishme, p.sh., numri i nxënësve shqiptarë në fund të shtatorit të vitit 2012.

POPULLATA PËRFAQËSUESE. Numri i caktuar i subjekteve të një popullate, që zgjidhet sipas një kriteri të caktuar, si: çdo i dhjeti nxënës i klasës VIII të shkollave të Prizrenit, çdo i njëqindti qytetar – pronar i telefonit të këtij qyteti etj. Popullata e tillë mund të jetë e madhe (n >30) ose e vogël

(n<30). Popullata e përzgjedhur duhet të përfaqësojë besnikërisht gjithë popullatën për të pasur vlerë të vërtetë përfundimi, ose përfundimet e nxjerra në mbështetje të gjurmimit të një dukurie tek popullata përfaqësuese**.**

PORIOMANI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *πορεια* "udhëtoj, shkoj" dhe *μανία* "marrëzi". Termi poriomani emërton shtytjen jonormale të një individi për udhëtime të vazhdueshme dhe të panevojshme.

PORTRET, - I. m. I ardhur në shqipe nga frëngjishtja *portrait*. Portreti është paraqitje apo përshkrim besnik dhe i gjallë i një personaliteti të caktuar, me veçori të theksuara trupore e psikike. Përshkrimet e tilla të personaliteteve krijuese, letrare, shkencore, ushtarake etj. mund të shërbejnë si burim i dobishëm e i rëndësishëm, madje edhe si faktor nxitës për studime të veçanta.

PORSALINDUR/A (I, E). mb. Foshnja që nga çasti i lindjes ose nga fillimi i jetës së saj jashtë mitrës së nënës, derisa të fillojë me marrjen e ushqimit nga gjiri. Kjo kohë mund të zgjasë një ose disa ditë. Foshnja e porsalindur mund të jetojë me disa rezerva ushqimore të zhvillimit të saj në periudhën e paralindjes, derisa të fillojë marrjen e ushqimit nga gjiri i nënës. Koha përfundimtare e foshnjës së porsalindur ka karakter individual dhe mund të zgjasë deri në katërmbëdhjetë ditë.

POSTULAT, - I. m. Term i logjikës dhe i psikologjisë kognitive i ardhur nga latinishtja *postulatum*. Postulati është parim mendor që supozohet se është i drejtë, megjithëse nuk nxirret nga faktet empirike dhe nuk argumentohet drejtpërdrejt me anën e tyre.

POSTULATI PSIKOLOGJIK. Parim psikologjik i pranuar si i vërtetë me gjithë karakterin e paargumentuar plotësisht të tij. Ky parim shërben si bazë lidhëse e gjykimeve të tjera nga të cilat nxirret një përfundim i caktuar. Kështu, "ngulitja e gjurmëve" gjatë të mësuarit të njeriut në trurin e tij pranohet e vërtetë, madje mbi këtë bazë nxirren përfundime të tjera, megjithëse "ngulitja e gjurmëve" – siç thuhet në psikologji – pritet të vërtetohet.

POTENCIALI AKSIONAL. Impulse elektrike që shkaktojnë bazën e bartjes së impulseve nervore përgjatë aksonit të qelizës nervore ose të neuronit.

POTENCIALI BIOELEKTRIK. Fuqi apo mundësi elektrike e lëndës së gjallë të organizmave, përkatësisht e qelizave trunore, muskulore, receptore etj. Ky potencial regjistrohet me anë të elektroencefalografit dhe dallohet sidomos me rastin e kontrollit të shkallës së veprimtarisë së një individi, duke përfshirë edhe ndryshimet e këtij potenciali me rastin e përjetimit të tronditjeve të mëdha psikike.

POTENCIALI I MEMBRANËS. Dallimi ndërmjet ngarkesës elektrike të jashtme dhe të brendshme të membranës. Kjo është ngarkesa elektrike prej – 70 mV në brendësi të neuronit. Ky ndryshim i ngarkesës elektrike të membranës së neuroneve ka rëndësi të posaçme, sepse falë këtij ndryshimi të potencialit elektrik të kësaj membrane neuritet ose aksonet e neuronit bartin ngacmimet ose informacionet në strukturat nervore.

POTENCIALI MUSKULOR. Ndryshimi elektronik dhe kimik i fuqisë së membranës së fijeve nervore,

që shkaktohet kur impulset nervore arrijnë në muskuj dhe e ngacmojnë këtë membranë me anën e fijezave të qelizave nervore. Potenciali muskulor ka si karakteristikë ngritjen e aktivitetit të muskujve dhe falë këtij ndryshimi kryhet mbledhja dhe shtrirja e muskujve.

POTENCIALI RECEPTOR. Ndryshimi i fuqisë marrëse të cipës së neuroneve receptorë, kur në këto neurone vepron një ngacmues i caktuar. Këto janë graduale në qelizat receptore, që nuk kanë neurite ose aksone dhe nuk kanë mundësi të prodhojnë potencial veprues. Potenciali receptorik i tyre bartet nëpër rrugët kimiko-elektrike deri te qelizat nervore ose neuronet, që kanë neurite ose aksone dhe këto neurone funksionojnë duke ngritur ose ulur mundësinë e aktivimit të neuroneve me neurite ose me aksone. Ky term zëvendësohet shpesh me termin potencial gjenerator.

POZICION, - I. m. Term i përgjithshëm, që përdoret edhe në të folurin e përditshëm në shqip, duke emërtuar vendin e një objekti, fushën e një ngjarjeje, madje edhe qëndrimin e një individi ndaj ngjarjes, procesit etj. të caktuar. Në psikologji pozicioni emërton vendin e një objekti që perceptohet nga ana e një individi dhe raportin e tij me atë objekt të vendosur në një vend të caktuar. Pozicioni i tillë i një objekti mund të jetë faktor, që shkakton reagim të posaçëm të perceptuesit; mund të emërtohet edhe prirja e mësuar e një individi për të dalluar më mirë dhe më qartë objektet e proceset që gjenden në anën e djathtë të tij. Në psikologjinë e fushave të psikologut amerikan me origjinë gjermane Kurt Levin (Kurt Lewin, 1890 – 1947), termi pozicion ka kuptim të veçantë, sepse emërton fushën e hapësirës jetësore të njeriut, ku ndodh një ngjarje, një proces etj.

POZICIONI SKIZOID – PARANOJAK. Term psikanalitik i psikiatres amerikane Melani Klain (Melanie Klein, 1882 – 1960) që emërton fazën zhvillimore të fëmijës gjatë jetës dhe zhvillimit tetëmbëdhjetëmujor. Gjatë kësaj faze ai vendos kontakt me objektin e pjesshëm, me gjinjtë e nënës. Duke thithur gjinjtë ai projekton shtytjet dhe fantazmat e libidos dhe të agresivitetit, duke i ndarë në fantazma dhe libido të mirë dhe të keq. Këtë ndarje fëmija e përvetëson dhe me këtë ai bën copëtimin e egos. Objektet e këqija shkaktojnë te ai frikë, përndjekje dhe e dërrmojnë atë, kurse objektet e mira shkaktojnë gëzim e hare. Sa më e fuqishme të jetë frika e shkaktuar nga objektet e këqija, aq më shumë zhvillohet te ai prirja kah pozicionit të zhvillimeve skizoide – paranojake. Zhvillimi i këtillë, sipas pikëpamjes së Melani Klain, krijon shtrat të përshtatshëm për çrregullime në formë skizoide ose paranojake. Copëtimi i egos nuk mbetet e tillë, por zvogëlohet gjatë zhvillimit të mëvonshëm të fëmijës.

POZITA SHOQËRORE. Vendi ose pozita e një anëtari të një grupi shoqëror të caktuar në kuadrin e strukturës së atij grupi në një mjedis shoqëror. Pozita e këtillë kërkon kryerjen e detyrave, zgjidhjen e problemave, marrjen e vendimeve etj., rrjedhimisht edhe sjelljet përkatëse të atij anëtari të grupit shoqëror të caktuar. Në një mjedis të zhvilluar anëtari i atij mjedisi mund të ketë dy apo tri pozicione shoqërore.

Burimet:

Albert Bandura: *"Social Learning and Personality Development"* – (*"Të mësuarit shoqëror dhe zhvillimi i personalitetit"*), 1963.
Leon Festinger: *"A Theory of cognitive dissonance"* – (*"Teoria e disonancës kognitive"*), 1957.
Kurt Lewin: *"Field Theory in Social Science"* – (*"Teoria e fushave në shkencat sociale"*), New York, 1951.
William James: *"Psychology"* – (*"Psikologjia"*), New York, 1890.
Edmond Dragoti: *"Psikologjia sociale"*, Tiranë, 1999.
Wilhelm Reich: *"Massenpsychologie des Faschismus"* – (*"Psikologjia masive e fashizmit"*), Kopenhagen – Pragë – Zyrih, 1933.

POZITIV, - E. mb. Që miraton vlerën e efektit të një strukture, të një funksioni organik, social e psikologjik në zhvillimin e një lloj reagimi apo sjelljeje të caktuar. Mbiemri pozitiv haset në disa togfjalësha psikologjikë, si:

a. L**akore pozitive** – Paraqitje grafike e suksesit gjatë njësive kohore të caktuara. Sipas kësaj paraqitjeje përparimi në të zotëruarit e një shprehie në fillim është i ngadalshëm dhe më pas suksesi rritet në shkallë gjithnjë e më të lartë;

b. Ndërlidhje pozitive – Ndërlidhje e ndërsjellë ndërmjet dy dukurive, kur rritja, gjegjësisht zvogëlimi i njërës, tërheq rritjen, gjegjësisht zvogëlimin e tjetrës. Ndërlidhja është pozitive kur numri i shtuar i ushtrimeve të të menduarit të drejtë gjatë zgjidhjes së problemeve rrit cilësinë e mënyrës së të menduarit të drejtë në zgjidhjen e problemeve të reja;

c. Pasfigurë pozitive – Pasfigura e të njëjtës cilësi, si edhe cilësia e ngacmuesit paraprak të shqisës;

d. Përforcim pozitiv – Qëndrueshmëria e pasojës së një reagimi dhe siguria e paraqitjes së atij reagimi kur njeriu gjendet në situata të njëjta ose të ngjashme;

e. Përshtatje pozitive – Ngritje graduale e shkallës së ndjeshmërisë së një shqise, e intensitetit të një tipari të personalitetit etj., sipas shkallës ngacmuese, e pikërisht sipas situatës shoqërore ku gjendet individi;

f. Përvojë pozitive – Tërësi dijesh dhe besim i formuar për dukurinë, objektin, procesin dhe për rëndësinë e tyre, në bazë të përjetimeve të tyre të drejtpërdrejta, duke pohuar rëndësinë dhe vlerën e tyre në të ardhmen e subjektit;

g. Përzgjedhje pozitive – Përzgjedhje ose seleksionim i pjesëtarëve të një kampioni me veti pozitive. Përzgjedhja e tillë do të ishte sikur për dijet matematikore të studentëve të të gjitha fakulteteve të zgjidhnim kampionin e vetëm nga studentët e degës së matematikës dhe të fakultetit teknik;

h. Qëndrim pozitiv – Mbështetës, përkrahës i qëndrimit të një individi ndaj tjetrit;

i. Transferim pozitiv – Bartje e përvojës pozitive nga të ushtruarit e një shprehie në suksesin e shpejtë dhe të dobishëm të procesit të të mësuarit të një shprehie tjetër.

POZITIVIZ/ËM, - MI. m. Term i filozofisë me prejardhje nga latinishtja *positivus* "real, faktik" që emërton atë rrymë filozofike, e cila merr për bazë njohjeje vetë faktet reale dhe njohjen e raporteve reale ndërmjet tyre që i jepen vëzhguesit nga një realitet i tillë. Pozitivizmi mohon rreptësisht çdo lloj mendimi metafizik e religjioz për shkaqet e para të zhvillimit të realitetit. Njohja pozitive e realitetit ka të bëjë me përshkrimin e saktë të të dhënave dhe fakteve shqisore dhe me njohjen e

ligjeve ndërmjet dukurive reale. Vlera e dukurive, kuptimi, rëndësia etj. janë të huaja për pozitivizmim. Pozitivizmi është i lidhur me emrin e mendimtarit sociolog francez August Komt (Auguste Comte, 1798 – 1857), i cili ka qenë nën ndikimin e filozofisë së Fransis Bekonit (Francis Bacon, 1561 – 1626). Sipas tij pozitivizmi është shkalla më e lartë e zhvillimit të mendimit shkencor. Ka ushtruar ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e psikologjisë dhe të metodave hulumtuese të saj.

POZITIVIZMI NË PSIKOLOGJI. Drejtimi filozofik i pozitivizmit ka ushtruar ndikim sidomos në zhvillimin e metodave hulumtuese të psikologjisë, duke përforcuar rolin dhe rëndësinë e metodës së vëzhgimit të dukurive dhe proceseve psikologjike, sidomos të sjelljeve vëzhguese. Ndikimi i tillë u dallua posaçërisht në zhvillimin e bihejviorizmit në psikologji, duke iu kundërvënë njëkohësisht psikanalizës, psikologjisë humaniste dhe psikologjisë ekzistencialiste. U kërkua që psikologjia të jetë më tepër shkencë empirike analitike dhe moniste, se shkencë sintetike e dualiste. Nën ndikimin e pozitivizmit dhe të zhvillimit të bihejviorizmit në psikologji pësoi ndryshim edhe terminologjia e koncepteve mendore; u larguan nga terminologjia e psikologjisë bihejvioriste emërtimet e koncepteve mendore, si: dëshirë, ëndërr, fantazi, mendje, vetëdije etj. Ky pozitivizëm u kritikua ashpër nga zhvillimet metodologjike bashkëkohore të psikologjisë, duke shkaktuar kthimin e termave të koncepteve mendore në psikologji dhe në terminologjinë e saj.

PRAGMATIZ/ËM, - MI. m. Term i filozofisë që ka shtrirje kuptimore edhe në psikologji. Termi rrjedh nga greqishtja *πράγμα* "veprim". Në filozofi pragmatizmi konsiderohet një drejtim, sipas të cilit vlera, rëndësia dhe vërtetësia e një gjykimi, përfundimi etj. kanë të bëjnë me pasojat praktike për njeriun, përkatësisht me dobinë e tyre konkrete për jetën dhe aktivitetin e njeriut. Pragmatizmi ka ushtruar ndikim në zhvillimin e psikologjisë, sidomos të psikologjisë funksionaliste, si edhe në zhvillimin e bihejviorizmit. Në psikologji pragmatizmi ka kuptimin e qëndrimit dhe të vlerës shoqërore kryesore të njeriut. Për njeriun pragmatist vlera më e lartë e njeriut është dobia, pasurimi i njeriut dhe i njerëzimit nga aktiviteti i caktuar dhe nga pasojat e tij, sipas filozofit dhe psikologut amerikan Uiliam Xhejms (William James, 1842 – 1910).

PRAGU ABSOLUT. Caku ose pika kufizuese e energjisë së një ngacmuesi që është në gjendje të shkaktojë ndijim, përkatësisht pika kufizuese nën të cilën energjia e ngacmuesit nuk shkakton ndijim të caktuar, përkatësisht nuk është në gjendje të shkaktojë përjetimin e cilësisë së atij ndijimi. Në literaturën e psikologjisë pragu absolut emërtohet edhe me termin pragu më i ulët, përkatësisht pragu minimal.

PRAGU I DALLIMIT. Pika kufizuese e ndryshimit të vlerës cilësore të një ngacmuesi, rritja minimale e energjisë së të cilit shkakton ndryshim në përjetimin e cilësisë së një ndijimi të caktuar. Mbi këtë pikë cilësia e ndijimit është tjetër, si edhe nën këtë pikë cilësia e ndijimit nuk është e njëjtë me

atë mbi pikën kufizuese. Sa më e lartë të jetë pika kufizuese, përkatësisht pragu absolut dhe ai diferencial, aq më e ulët është shkalla e ndjeshmërisë dhe e kundërta, sa më i ulët të jetë pragu minimal, aq më e lartë është shkalla e ndjeshmërisë.

PRAGU I NDIJIMIT TË TË PREKURIT. Largësia më e vogël ndërmjet dy trupthave receptorë të të prekurit në lëkurë, që mundësojnë ndijimin e njëkohshëm të dy ngacmuesve të lëkurës.

PRAGU I NDJESHMËRISË. Term i përdorur më shpesh në fushën e psikofizikës. Në psikologji pragu i ndjeshmërisë është kufiri i asaj energjie të ngacmuesit prej nga fillon ndjeshmëria shqisore, kurse nën atë prag energjia e ngacmuesit është e pamjaftueshme për të shkaktuar ndjeshmëri, reagim ose efekt të caktuar ndaj energjisë së atij ngacmuesi. Ky është kuptimi kryesor i pragut në psikologji dhe përdorimi më i shpeshtë i këtij termi, i cili në literaturën e psikologjisë haset edhe me emërtimin latin "*limen*". Pragu i ndjeshmërisë shtrihet nga pragu absolut ose minimal deri në pragun përfundimtar ose maksimal. Ka karakter të theksuar individual. Niveli i pragut të ndjeshmërisë mund të matet me njësi fizike, p.sh., me decibel matet pragu i ndjeshmërisë së tingujve. Në psikologjinë fiziologjike dhe në neurofiziologji pragu është energjia më e vogël, energjia minimale e ngacmuesit të jashtëm apo të brendshëm, që është në gjendje të shkaktojë trazim nervor ose impuls nervor, ta vërë në veprim neuronin e caktuar, të shkaktojë tkurrje muskuli ose reagim gjëndrash.

PRAGU I NDJESHMËRISË SË LËKURËS. Term me tri kuptime: 1) Dallimi i njërit gjësend dhe i tjetrit gjësend të mprehtë që ndikon në të njëjtën kohë dhe me të njëjtën energji shtypëse në lëkurë, duke ngacmuar trupthat e ndjeshmërisë së lëkurës; 2) Dallimi ndërmjet shtypjes mekanike intensive të një gjësendi në lëkurën e njeriut dhe shtypjes më pak intensive të të njëjtit gjësend që vepron mbi lëkurën e njeriut herë pas here; 3. Dallimi i ndjeshmërisë së dy ngacmuesve dhe i largësisë së njërit nga tjetri, kur të dy ngacmuesit veprojnë në lëkurën e njeriut dhe ngacmojnë njërën qelizë receptore dhe qelizën tjetër, që gjendet në një largësi të caktuar nga e para.

PRAGU I RIKONJICIONIT. Pika kufizuese e ndjeshmërisë së cilësisë së një ngacmuesi, që është karakteristikë kryesore e atij ngacmuesi. Nën këtë pikë kufizuese energjia e ngacmuesit nuk është në gjendje të shkaktojë njohjen e asaj cilësie, kurse mbi atë pikë ndikuese të energjisë së ngacmuesit subjekti është në gjendje të dallojë karakteristikën e tij. Ngacmuesi pamor i ngjyrës kromatike në fillim shkakton përjetim të ngjyrës, kurse me rritjen e intensitetit të tij arrihet një pikë e ndjeshmërisë dhe e përjetimit të cilësisë së një ngjyre të caktuar kromatike.

PRAGU I VETËDIJES. Term i psikologjisë klasike që paraqet pikën ndarëse të përjetimeve aktuale të një individi, nga përjetimet e dikurshme të tij, nga përvoja dhe nga ndikimet e çastit të dukurive, objekteve dhe të ndryshimeve të tyre në mjedisin e atij individi. Përjetimet aktuale (ndijimet, perceptimet, përfytyrimet etj.) gjenden

mbi pragun më të ulët të vetëdijes së njeriut dhe ai është i përqendruar në përmbajtjen e këtyre përjetimeve, kurse të gjitha të tjerat gjenden nën këtë prag. Ky është kufiri ndarës ndërmjet përmbajtjeve të paravetëdijes dhe përmbajtjeve të vetëdijes. Kuptimi i pragut të vetëdijes është më tepër konstrukt hipotetik. Termi prag i vetëdijes i atribuohet kryesisht pedagogut dhe filozofit gjerman Johan F. Herbart (Johann F. Herbart, 1776 – 1841).

PRAGU MAKSIMAL. Intensiteti më i lartë i ndijimit. Trupi ndikues në receptorët e shqisave të njeriut ose ngacmuesi i tyre mund të ketë intensitet edhe më të lartë, megjithëkëtë intensiteti i ndijimit nuk rritet.

PRAGU MINIMAL. Pika më e ulët e një ngacmuesi që ushtron ndikim në një shqisë të caktuar dhe me nivelin e ulët të intensitetit të tij shkakton ndijim. Shih – ***PRAGU***.

PRAGU PËRFUNDIMTAR I NDIJIMIT. Caku më i lartë i ndjeshmërisë së një shqise të caktuar përtej të cilit ndijimi është i pamundur, pavarësisht nga shtimi i mëtejshëm i intensitetit të atij ngacmuesi. Cakun më të lartë të ndijimit përfundimtar e shkakton intensiteti i lartë i ngacmuesit fizik adekuat për shqisën e caktuar.

PRAKSERNI, - A. f. Term i psikologjisë së personalitetit dhe i pikëpamjes së psikologut amerikan Rejmond B. Katell (Raymond B. Cattell, 1905 – 1998). Praksernia është skaji i atij tipari të personalitetit që shfaqet me mendime, qëndrime dhe me sjellje praktike të organizuara me kujdes ndaj të tjerëve dhe ndaj mjedisit e ndryshimeve të tij. Ky nuk i injoron ndryshimet e realitetit dhe nuk është i dhënë pas mendimeve teorike. Praksernia është poli negativ i shtrirjes së tipareve të personalitetit dhe shënohet me **M -**, përballë tiparit të kundërt, tiparit pozitiv autia **M+**.

PRAKTICIZ/ËM, - MI. m. Zgjidhje çështjesh në bazë të të dhënave praktike e të çastit, duke mos marrë për bazë zhvillimet teorike për atë çështje, përkatësisht duke mos menduar për të ardhmen dhe zhvillimet afatgjata të karakterit teorik të asaj çështjeje. Prakticizmi mbështetet në absolutizimin e praktikës dhe nuk i kontribuon zhvillimit esencial të mendjes dhe mendimit për të vërtetën.

PRAKTIK/Ë, - A. f. Term i ngulitur edhe në shqip i ardhur nga greqishtja *πράξη* "vepër, punë". Praktika është tërësia e veprimeve të njeriut që bëhen me qëllim të caktuar. Kjo është përvoja e grumbulluar e njeriut gjatë jetës së tij mbi përmbajtjen e një veprimtarie të caktuar, të mënyrave të eksekutimit të saktë e të shpejtë të një veprimi etj. Ky term gjen zbatim relativisht të madh në trajtën e mbiemrit. Në këtë cilësi gramatikore janë të formuara disa togfjalësha, si:

1) **Praktikë edukative** – Tërësi veprimesh e sjelljesh të përmbajtjeve me përmasa virtytesh, që mund të përsosen dhe të barten prej një brezi në tjetrin në mënyrë të vetëdijshme;
2) **Mendje praktike** – Mendja mbi sjelljet dhe veprimet etike, të vullnetshme;
3) **Vlera praktike e testeve** – Cilësi e testeve, që të bëjë përcaktimin e saktë të pozicionit të një individi në bazë të suksesit të arritur në zgjidhjen e detyrave dhe të problemave të një testi,

duke u mbështetur në një kriter të caktuar, përkatësisht në bazë të një cilësie të jashtme të pavarur, që matet me një test të caktuar etj.

PRAPAMBETJA MENDORE. Zhvillim mendor i një shkalle të ulët, që ka të bëjë në rend të parë me nivelin e ulët të funksionimit të strukturave të mendjes, të proceseve njohëse apo kognitive, por edhe me pamundësinë e të folurit të artikuluar, të sjelljeve të përshtatura shoqërore dhe të ndjenjave. Prapambetja mendore ka karakter të pakthyeshëm, pra pothuaj nuk ka gjasa të përmirësohet. Shkallën e prapambetjes mendore e përcakton koeficienti i ulët dhe shumë i ulët nënmesatar i zhvillimit të inteligjencies, kur vlera mesatare e zhvillimit të inteligjencies te popullata e një mjedisi të caktuar është 100 (ka shpërndarje pikash të matjes së inteligjencies, që shfaqet në formën kumbonare) dhe me shkallë të shmangies nga kjo mesatare prej 15 pikash matëse nga devijimi standard. Individ me prapambetje mendore konsiderohet ai, i cili ka koeficient të inteligjencies nën 0.7, e pikërisht ata që mezi arrijnë të kenë dy shkallë të shmangies nga mesatarja e gjithë popullatës të atij mjedisi. Individë të tillë ka rreth 2,5 %. Për të gjitha kategoritë e prapambetjes mendore vlen konstatimi se këta individë nuk janë të aftë të kujdesen vetë për jetën e tyre, kanë zhvillim të pamjaftueshëm të inteligjencies dhe të të folurit, nuk mund t`i ndjekin mësimet në shkollë të rregullt etj. Megjithëkëtë, rezultatet bashkëkohore tregojnë se edhe ndërmjet këtyre kategorive ka dallime. Individët me prapambetje mendore të lehtë e me angazhime të mëdha të prindërve mund të kryejnë deri gjashtë vite të shkollimit fillor dhe në moshë të mëvonshme mund të ushtrohen për të kryer punë të lehta. Ata të kategorisë së prapambetjes mendore mesatare mund të shkollohen në shkolla speciale, por shumë prej tyre nuk mund të kujdesen për veten e tyre. Individët me prapambetje të rëndë mendore duhet të vendosen në institucione speciale dhe nën mbikëqyrjen e të tjerëve mund të bëjnë ndonjë punë të thjeshtë. Individët e kategorisë me shkallë shumë të rëndë të prapambetjes mendore nuk mund të aftësohen për jetë të pavarur dhe këta gjatë gjithë jetës së tyre kërkojnë ndihmën e të tjerëve.

PREFERENC/Ë, - A. f. Term i estetikës dhe i psikologjisë, me rrënjë nga latinishtja e re *praeferentia* "çmoj, dua më tepër". Në psikologji preferenca mund të jetë nevojë, qëndrim, shije, vlerë etj., kur subjekti i jep përparësi një dikujt ndaj të tjerëve (objektit, individit, pikturës etj.) dhe shfaq sjellje pozitive ndaj tij. Me rastin e zgjedhjes së njërit objekt ndaj tjetrit, kjo zgjedhje vlerësohet si shenjë e preferencës që ka ai ndaj objektit të përzgjedhur.

PREGNANT, - E. mb. Term i psikologjisë geshtaltiste, që ka ardhur nga gjermanishtja dhe përdoret kryesisht në psikologjinë e perceptimit nga Kurt Kofka (Kurt Koffka, 1886 – 1941), Maks Verthaimer (Max Wertheimer, 1880 – 1943), Volfgang Koler (Wolfgang, Kohler, 1887 – 1967 etj. Mbiemri pregnant emërton prirjen e njeriut për t`i grupuar dhe përkufizuar sa më mirë strukturat perceptive, sipas formës më të dallueshme, më simetrike, më të thjeshtë etj. Kjo prirje emërtohet

si prirje e formës së mirë. Shih – ***PSIKOLOGJIA GESHTALTISTE***.

PREKJ/E, - A. f. Lloj i ndijimeve të lëkurës me anën e të cilave njihet butësia, fortësia, lëmueshmëria, vrazhdësia etj. e trupave që kontaktojnë drejtpërdrejt me lëkurën ose me një pjesë të caktuar të saj, si edhe me ata ngacmues që ushtrojnë ndikim nga afërsia me lëkurën. Këta ngacmues aktivizojnë receptorët e të prekurit, të lidhur me skajet e nervave të veçantë të shtresës së brendshme të lëkurës dhe impulset nervore të tyre barten deri në pjesën parietale ose tepore të cipës ose kores së trurit të madh, ku lind ndijimi i caktuar. Receptorët e të prekurit janë të shpërndarë në lëkurë në mënyrë të pabarabartë. Pjesa e lëkurës së buzëve, të gjuhës, të majës së gishtërinjve, maja e penisit dhe e klitorisit janë shumë më të ndjeshme (largësia ndërmjet receptorëve të të prekurit në këto pjesë është 0.001) se pjesa e lëkurës së shpinës, ku largësia e receptorëve të të prekurit është rreth 6 cm. Prekja është ndër ndijimet më të vjetra, të cilën e ka përmendur edhe Aristoteli qysh para vitit 322 p.e.r. Kohët e fundit konsiderohet se prekja nuk është sistem unik shqisor, por pjesë shqisore e grupit kompleks të shqisave të lëkurës. Ekipi studimor i Qendrës Mjekësore të Universitetit "Kolumbia" nën udhëheqjen e dr. Ellen Lumpkin, kohët e fundit ka zbuluar me anë të teknikës optogjenetike se bartëse të ndijimeve të prekurit janë "Qelizat Merkel" që funksionojnë krah për krah me neuronet e lëkurës.

PREMSI, - A. f. Shkurtesë e termit të anglishtes "Protected emotional sensitivity" – "Ndjeshmëri e ruajtur emocionale". Termi premsi i përket teorisë së personalitetit të Rejmond B. Katelit (Raymond B. Catell, 1905 – 1998) dhe emërton atë skajshmëri pozitive të tiparit burimor të personalitetit, që ka të bëjë me ndjeshmërinë emocionale, me sjellje të çuditshme, me prirjen për të imagjinuar një personalitet të caktuar. Në teorinë e përmendur të personalitetit kjo skajshmëri shënohet me Premsi (I+).

PREPARACION - I. m. Term i përdorur në gjuhën shqipe për të emërtuar përgatitjen për një veprimtari të caktuar. Në psikologjinë kognitive emërton fazën fillestare të mendimit krijues. Kjo fazë përfshin: gatishmërinë për zgjidhjen e problemit, marrjen e informacioneve dhe njohjen e natyrës së një problemi dhe me atë çfarë kërkohet në atë problem, njohjen me një situatë të caktuar problemore etj., mbledhjen e të dhënave më të rëndësishme për çështjen e caktuar problemore që duhet zgjidhur, orvatjet e deritashme dhe rezultatet e arritura duke njohur edhe rrugët e zbatuara për zgjidhjen e asaj situate etj. Pas grumbullimit të këtyre të dhënave dhe ideve të lidhura me çështjen problemore njeriu largon idetë e panevojshme, rrugët e mjetet e pasuksesshme duke përzgjedhur idetë kryesore, e njëkohësisht edhe duke zbuluar orvatje të reja për zgjidhjen e atij problemi, të asaj situate problemore etj.

PRESBIAKUSI, - A. f. Term i psikopatologjisë i ardhur nga greqishtja *πρεβυς* "i moshuar" dhe *ακύσης* "dëgjim", që në kuptimin e përgjithshëm do të thotë *shurdhim pleqërie*. Ky shurdhim në moshën e pleqërisë është zvogëlim i

mprehtësisë së dëgjimit të toneve dhe të zhurmave dhe ka të bëjë me ndryshimin negativ të pragjeve të dëgjimit, ku pragu absolut dhe pragu dallues i toneve dhe i zhurmave pësojnë lëvizje: pragu absolut zbret dhe pragu i dallimit ngrihet. Presbiakusia ka karakter individual dhe është faktor i reagimit të vonuar dhe joadekuat ndaj kërkesave fjalësore, ndaj pyetjeve etj.

PRESBIOFRENI, - A. f. Ndryshim negativ i mendjes në kohën e pleqërisë së njeriut që kuptohet edhe nga zbërthimi i fjalës greke *πρεβυς* "i moshuar" dhe *φρενια* "mendje". Presbiofrenia është formë e senilitetit që karakterizohet nga këto dukuri kryesore: boshllëqet në kujtesën e të moshuarit, zvogëlimi i funksionit të kujtesës për mbajtjen mend të informacioneve të reja, të informacioneve të pleqërisë, ndryshimi i informacioneve të saktësisë së vendit e kohës së ngjarjeve të përjetuara, plotësimi i përmbajtjes së kujtesës me detaje të pa përjetuara etj. Proceset e tjera kognitive, si inteligjencia, procesi i të menduarit, i të folurit, si edhe interesimi për mjedisin dhe ndryshimet e tij, duke përfshirë edhe interesimin për ndryshimet në personalitetin e tij janë ruajtur në mënyrë relative.

PRESBIOPI, - A. f. Çrregullim i të parit të objekteve e dukurive nga ana e të moshuarve. Ky kuptim dallohet edhe në përkthimin e fjalëve greke *πρεβυς* "i moshuar" dhe *οπυς* "shikim". Presbiopia krijohet me kalimin e moshës dhe shkaktohet nga humbja e plasticitetit të lentës dhe nga humbja e shkallës së lartë të aftësisë akomoduese të lentës së syrit. Presbiopia ka mundësi të përmirësohet me bartjen e syzave për shikim nga afër dhe shikim nga larg.

PRESIONI GRUPOR. Shtypja, trusnia, ndikimi që ushtron një grup i caktuar individësh te secili prej anëtarëve të tij për të pranuar qëllimin, detyrat dhe normat e sjelljeve të tyre. Shtypja, trysnia, ndikimi i këtillë ka karakter të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Karakteri i drejtpërdrejtë ka të bëjë me urdhërim, me dënim etj., kurse ndikimi i tërthortë ose jo i drejtpërdrejtë ka të bëjë me bindje, me kërkesë të butë për t`i larguar sjelljet që nuk përkojnë me qëllimin dhe me detyrat e grupit etj.

PRESTIGJ, - I. m. I ardhur nga latinishtja *proestigium* "vlerë, rëndësi". Në psikologji nënkupton një tipar të individit, i cili gëzon autoritet, famë, që nderohet dhe respektohet në mjedisin e tij shoqëror, për të cilin është formuar vetëdija shoqërore për vlerën e posaçme të tij. Është rezultat i aftësive, i punës së frytshme, të ndershme dhe i stilit të sjelljes së tij ndaj të tjerëve. Zakonisht shfaqet me dallimin e individit në një fushëveprim të caktuar, në të cilin afirmohet dhe fiton autoritet. Faktorët që përcaktojnë prestigjin e njeriut kanë të bëjnë me rolin dhe me statusin e tij në një mjedis dhe me shkallën e rëndësisë që ka roli i tij në kryerjen e veprimeve të ndërlikuara të mjedisit ku ai vepron. Individët me prestigj ushtrojnë ndikim të fuqishëm në mendimin, qëndrimet dhe në sjelljet e të tjerëve.

PRETENDIM, - I. m. Term i përdorur edhe në të folurin e rëndomtë, që në gjuhën shqipe ka ardhur nga latinishtja *pretendere* "mëtoj". Lakmi, synim dhe këmbëngulje për të arritur

në një qëllim dhe për ta zotëruar e përvetësuar atë. Pretendimi bazohet në besimin e fortë të njeriut se ai ka të drejtë në të. Pretendimi duhet dalluar nga mbivlerësimi, ngaqë mbivlerësimi mund të arrijë deri në qëndrim mbivlerësues për veten, për vlerën e lartë që mendon se ka, kur të tjerët kanë vlerësim më të saktë për të.

PRIRJE, - A. f. Kusht i fuqishëm anatomik e fiziologjik, i lidhur së pari me strukturën dhe funksionimin e trurit të njeriut dhe me aftësinë e lindur të tij për t`u marrë me një aktivitet të veçantë në mënyrë të suksesshme. Prirja e njeriut zhvillohet paralelisht me arritjen e suksesit të shpejtë dhe të lehtë në një fushëveprim të caktuar. Individi me një prirje të caktuar i zhvillon më shpejt dhe shumë më lehtë aftësitë e tij, në mbështetje të angazhimit dhe të gatishmërisë së tij për të shfrytëzuar kushtet dhe raportet e mjedisit të jashtëm, e madje në rend të parë të edukatës. Ky individ arrin suksese të dukshme në fushëveprimin e tij me angazhim më të vogël se sa individët që nuk kanë prirje. Prirje të këtilla mund të jenë prirja për matematikë, për muzikë, për të pikturuar etj. Për bartësit e prirjeve të këtilla me shkallë të lartë sigurie mund të thuhet se në të ardhmen mund të arrijnë nivel të lartë profesional. Shih – ***DISPOZITA.***

PRITJE, - A. f. Qëndrim me strukturë kognitive, emocionale dhe vepruese që do të mbahet për atë individ, në mbështetje të përvojës së tij, dhe që lidhet me gatishmërinë reaguese të organizmit ndaj asaj që pritet të vijë. Interesimi, vëmendja e drejtuar dhe e përqendruar, tensioni muskulor, gatishmëria e reagimit etj. janë përbërës të asaj që do të ngjasë. Pritja ushtron ndikim në aktivitetin e gjithëmbarshëm të njeriut. Në fushën ndijimore e perceptive të tij pritja mund të ushtrojë ndikim pozitiv, sepse ai e dallon më shpejt dhe më lehtë atë që pret. Pritja mund të ushtrojë ndikim negativ, sepse nën ndikimin e pritjes njeriu mund të gabojë në perceptimin e objektit, mund të zgjedhë gabimisht objektin me cilësi të pritjes e jo me cilësi objektive të tij etj.

PRIZMI I ERËRAVE. Paraqitja e aromave të ndryshme në formë grafike që ka për bazë mendimin hipotetik, sipas të cilit ekzistojnë gjashtë lloje aromash: 1) aroma e luleve; 2) aroma e erëzave, 3) aroma e kalbësirave; 4) aroma e djegieve; 5) aroma e lëngjeve dhe 6) aromat rrëshinore. Këto aroma kryesore ose të "pastra"mund t`i vendosim në këndet e prizmit trefaqësh, siç e tregon figura e mëposhtme:



Të gjitha erërat e tjera janë produkte erërash të kombinuara nga erërat themelore ose të pastra. Erërat e tjera mund të zënë vend nëpër skajet e hapësirës së prizmit. Këtë model e ka paraqitur që nga viti 1916 psikologu gjerman Hans Hening (Hans Henning).

PRIZMI I HENINGUT. Strukturë klasifikuese e aromave sipas majave të një prizmi trefaqësh. Në majën e

secilës faqe të prizmit janë vendosur gjashtë lloj aromash të trupave të ndryshëm: aroma e lules, aroma e lëngut të pemëve, aroma e dyllit, , aroma e kalbësirave dhe aroma e të djegurave. Sipas psikologut gjerman Hans Hening (Hans Henning, 1885 – 1946), çdo aromë tjetër mund të vendoset në prizëm në bazë të ngjashmërisë dhe të dallimeve me aromat kryesore të vendosura në majat e faqeve të prizmit.



PROBABILITET, – I. m. Term i statistikës i ardhur në gjuhën shqipe nga latinishtja *probabilitas* "ka gjasë", që emërton kuptimin e shkallës së treguesit numerik, ku mund të pritet se një dukuri, ngjarje, proces etj. mund të ndodhë rastësisht. Shkalla e probabilitetit sillet prej 0 – 1. Raporti i probabilitetit se ngjarja do të ndodhë përcaktohet sipas formulës 1/N. Kështu, në qoftë se monedhën metalike e hedhim dhe besojmë se do të bjerë faqja e shkruar, kjo mund të ndodhë në raportin ½, sepse N ka vetëm dy mundësi. Pohohet se disa nga ligjet e probabilitetit i ka përcaktuar që nga shekulli XVII matematikani italian, Galileo Galilei (Galileo Galilei, 1546 – 1642) dhe matematikani e fizikanti francez Blez Paskal (1623 – 1662).

PROBABILIZ/ËM, - MI. Term i latinishtes *probabilitas* "mundësi". Ky term ka ardhur në psikologji nga matematika e statistika. Emërton pikëpamjen e përgjithshme me përmasa filozofike, sipas së cilës dukuritë, ngjarjet, proceset etj. mund të parashikohen, por vetëm me një shkallë të lartë të mundësisë apo probabilitetit e jo me siguri të plotë. Kjo pikëpamje mbështetet mbi të vërtetën se dukuritë janë të ndërlikuara dhe se njeriu, për ato dukuri ka informacione e relacione të kufizuara, prandaj gjykimet për tiparet e personalitetit, për vlerat, qëndrimet etj. nuk mund të jenë asnjëherë plotësisht të sigurta.

PROBLEM, - I. m. I ardhur nga greqishtja *πρόβλημα* "detyrë, çështje e pazgjidhur", që në psikologji është një çështje e ndërlikuar teorike ose praktike, e cila kërkon përsiatje për raportet ndërmjet të dhënave dhe mbi marrëdhëniet esenciale ndërmjet tyre, ose përsiatje për të gjetur komponenten që mungon në bazë të relacioneve thelbësore të atyre elementeve që janë dhënë në problem. Në kuptimin e mirëfilltë problemi ka të bëjë me zbulimin e lidhjeve më të rëndësishme ndërmjet atyre të dhënave që nuk janë dhënë konkretisht, por që duhen zbuluar. Problemi i paraqitur kërkon gjithmonë zgjidhje dhe zgjidhja bëhet e mundur në mbështetje të angazhimit të proceseve mendore dhe të formave të ndërlikuara të të mësuarit**.**

PROBLEMA DETOUR. Formë e detyrave testore që hartohen për matjen e inteligjencies së fëmijëve. Problema Detour ka të bëjë me atë lloj situate problemore të krijuar, që kërkon zgjidhje duke u larguar nga qëllimi më i afërt dhe duke synuar qëllime më të largëta për të arritur deri në qëllimin

kryesor: zgjidhjen e situatës problemore konkrete.

PROBLEMET PSIKOLOGJIKE SHKOLLORE. Vështirësi të nxënësve në procesin e zotërimit të përmbajtjeve edukative e mësimore, duke pasur të zhvilluara normalisht si strukturat dhe proceset psikike, ashtu edhe sjelljet e tyre. Të këtilla mund të jenë: vështirësitë në zotërimin e programit të matematikës, të shkrimit e të leximit, të lëndëve të edukatës muzikore, figurative, fizike etj. Zgjidhja e problemeve të tilla është detyrë e psikologut të shkollës.

PROBLEMI I KUTISË. Problem që ka të bëjë me hapjen e një kutie të ndërlikuar dhe të mbyllur në atë mënyrë, që nga subjekti (nga njeriu, por më shpesh nga kafshët e rendeve më të larta) kërkohet të gjejnë mënyrën e hapjes së saj dhe nga ajo të nxjerrin shpërblimin e çmuar. Hapja e kësaj kutie kërkon angazhim produktiv të proceseve mendore, herë-herë kërkohet jo vetëm të hapet kutia, por të tregohet edhe rruga mendore që është ndjekur, derisa është arritur hapja e kutisë dhe marrja prej saj e shpërblimi të çmuar. Kjo kuti ka strukturë tjetër për gjurmimin e mënyrave të zgjidhjes nga ana e kafshëve të rendeve të larta, madje kafsha mund të futet në të dhe të kërkojë dalje për të shuar etjen apo ushqimin e vënë jashtë kutisë të mbyllur me telat gërshetë. Këtë kuti e ka propozuar psikologu amerikan Eduard L. Torndajk (Edward L. Thorndike, 1874 – 1949). Nga ky model psikologu amerikan Burhus F. Skiner (Burhus F. Skinner, 1904 – 1990) ka ndërtuar një model të ngjashëm që quhet kutia e Skinerit.

PROBLEMI I RAPORTIT TRUP–SHPIRT. Problemi themelor dhe më i ndërlikuar i psikologjisë dhe i filozofisë që ka të bëjë me raportin fizik e psikik, e pikërisht me raportin trup- psikikë**.** Ky raport dhe shpjegimi i tij është ndër më të vjetrit që haset në mendimet filozofike të Platonit, Demokritit, Aristotelit etj. Në historinë e qasjes së këtij problemi në psikologji ka zënë vend posaçërisht orvatja për zgjidhjen e sistemuar të tij në paralelizmin psikofizik. Këtë e ka trajtuar posaçërisht mendimtari gjerman, matematicieni dhe filozofi Gotfrid Vilhelm fon Lajbnic (Gottfried Wilhelm von Leibniz, 1646 – 1716). Sipas mendimit të tij proceset trupore, fiziologjike dhe ato psikike rrjedhin pavarësisht njëra nga tjetra, zhvillohen paralel njëri me tjetrin, por janë të pavarur njëri nga tjetri. Për të dyja këto procese vlen e njëjta procedurë. Kjo pikëpamje ka mbisunduar në historinë e mendimit psikologjik për një kohë të gjatë. Rezultatet e gjurmimeve eksperimentale kanë treguar se ky raport është raport shkakor-rrjedhimor. Detyra e psikologjisë është studimi i hollësishëm i këtij raporti. Shih – ***PARALELIZMI PSIKOFIZIK.*** Rene K. Dekarti (Rene K. Dekartes, 1596 – 1650)**,** matematikan dhe fizikan francez "babai i filozofisë së kohës së re" ka menduar se shpirti është substancë jopërmasore, substancë jolëndore dhe e pavarur nga "makina "trup – njeri". Megjithatë, sipas tij, hipofiza është organi qendror i trupit nëpërmjet të cilit ndikohet në shpirtin e njeriut dhe, njëkohësisht, hipofiza është qendra shpirtërore që vë në veprim trupin e njeriut. Pikëpamje të posaçme ka

pasur mendimtari anglez Tomas Hobs (Thomas Hobbes, 1588 – 1679) dhe filozofi holandez Baruh Spinoza (Baruch Spinoza, 1632 – 1677). I pari ka konsideruar se shpirti dhe dukuritë e shpirtit janë produkte mbetës të trupit dhe të proceseve trupore e fiziologjike, kurse Baruh Spinoza ka pasur pikëpamje të ngjashme me Rene Dekartin. U përmendën këta mendimtarë të shquar, sepse pikëpamjet e tyre kanë ushtruar ndikim të fuqishëm në përqendrimin e zgjidhjes së problemit trup–psikikë në hulumtimet psikofiziologjike. Nga ky problem që e ruan ende aktualitetin e vet, sot mund të përgjithësohet mendimi se psikika dhe strukturat e funksionet psikike janë veti të materies së gjallë, të kafshëve dhe të njerëzve. Sa më nivel të lartë të ketë organizmi i tyre në hierarkinë e zhvillimit trupor, sidomos të sistemit nervor, aq më i lartë do të jetë edhe zhvillimi psikik i tyre. Njeriu gjendet në shkallën më të lartë të zhvillimit të sistemit nervor; për këtë shkak edhe strukturat psikike të tij dhe funksionet e tyre janë të nivelit më të lartë dhe më të ndërlikuar. Te njeriu funksionet e proceset psikike në njërën anë pasqyrojnë realitetin me format e ndryshme të tij dhe në anën tjetër psikika e njeriut është aktive dhe rregulluese thelbësore e sjelljeve më të rëndësishme të njeriut dhe e raporteve të tij me mjedisin dhe me format e ndryshueshme të tij. Megjithëkëtë, problemi trup-shpirt ende është problem**.** Lidhur me këtë problem janë dalluar këto pikëpamje teorike: 1) Trupi i njeriut dhe proceset trupore janë shfaqje e shpirtit, e frymës së njeriut. 2) Shpirti e trupi janë dy entitete të ndara, por funksionojnë në ndërveprim ndërmjet tyre. 3) Paralelizmi psikofizik e ka trajtuar këtë raport në kuadrin e dy entiteteve të ndara, por që funksionojnë në lidhje të ngushtë ndërmjet tyre, 4) Vetëm shpirti është parësor, kurse trupi e dukuritë trupore janë shfaqje e tij (idealizmi subjektiv), 5) Vetëm trupi e funksionet e tij ekzistojnë (pikëpamja e materializmit), 6) Trupi e shpirti janë vetëm ide dhe përshtypje shqisore (fenomenizmi), 7) Realiteti trupor dhe mendor janë aspekte themelore të realitetit unik (aspekt i dyfishtë) dhe 8) Dukuritë mendore janë hije e trupit dhe e dukurive trupore. Shpirti dhe trupi ishte dhe mbeti çështje e rrymave të mendjeve njerëzore më të njohura, që i kalon caqet e psikologjisë empirike.

Burimet:

Aristotel: *"Pery psyches"* – (*"Mbi shpirtin"*).
Tommaso d'Aquino: *"Comentaria in Aristotelem"* – (*"Komenti i Aristotelit"*).
Rene Descartes: *"Principia philisophiae"* – (*"Parimet e filozofisë"*), 1664.
Wilhelm Wundt: *"Die Psychologie im Kampf und Dasein"* – (*"Psikologjia në luftë me qenien"*), 1913.
Vojislav Čurčić: *"Dijalog Duše i tela – Psihosomatika"* – (*"Dialogu shpirt–trup – Psikosomatika",* DERETA, Beograd, 2009.
Stevan Cvajg: *"Mjekësia dhe psikika", Mesmer – Beker – Frojd,* Tiranë Argeta – LMG, 2005.
Sandra Amondt & Sam Wang: *"Të fshehtat e trurit – Trupi dhe mendja",* gazeta "Shekulli", Tiranë, 2008.
Alfred Uçi: *"Filozofia e Teodor A. Kavaliotit",* Tiranë, 2004, fq. 267 – 270.
Ibrahim Rugova: *"Vepra e Bogdanit 1675 – 1685",* Prishtinë, 1982.

PROBLEMI RELACIONAL. Problem që në psikologjinë fiziologjike emërton kuptimin e raporteve ndërmjet nevojave, motiveve, shtytjeve, etj.

dhe sjelljeve të ndërlikuara, që kërkojnë gjurmim lidhjes e marrëdhëniesh të gjithanshme.

PROBLEMI TRASHËGIMI – MJEDIS – PSIKIKË. Problem themelor i psikologjisë, në të cilin shtrohet pyetja kryesore: Cili është ndikimi i trashëgimisë biologjike dhe i mjedisit shoqëror në zhvillimin e njeriut dhe të personalitetit të tij? Psikologjia bashkëkohore ka arritur të përjashtojë pikëpamjen e skajshme të mbisundimit të trashëgimisë biologjike në zhvillimin e jetës psikike të njeriut (nativizmin), si edhe atë të ndikimit mbisundues të faktorëve mjedisorë (empirizmin) në zhvillimin e jetës psikike të njeriut. Psikologjia e sotme studion ndikimin e faktorëve të veçantë në zhvillimin e strukturave dhe të proceseve psikike, duke shfrytëzuar metodat dhe procedurat hulumtuese bashkëkohore. Disiplinat e veçanta të psikologjisë, si biopsikologjia, psikologjia zhvillimore, psikologjia kognitive, psikologjia sociale etj. e faktorizojnë çështjen e ndikimit të faktorëve trashëgues dhe të atyre të mjedisit, duke u marrë me matjen e saktë të ndikimeve të tilla dhe duke dhënë përgjigje për strukturat dhe funksionet e veçanta të jetës dhe aktivitetit psikik.

PROCEDUR/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *procedere* "procedoj, eci, shkoj përpara, vazhdoj". Ky term i përket terminologjisë së metodologjisë hulumtuese. Emërton ecurinë, veprimin konkret të gjurmimit në kushte plotësisht të caktuara, si mënyrën e vërtetuar të organizmit, qëllimin e saktësuar, rendin e veprimeve, sidomos saktësinë e kushteve relevante në të cilat realizohet ajo procedurë. Kuptimi i tillë i përngjet kuptimit të metodës, por ndryshon nga kuptimi i termit metodë, ngaqë kjo e fundit ka kuptim shtrirës më të gjerë se procedura.

PROCEDURAT E STRUKTURUARA. Formë e anketës, e intervistës, e vëzhgimit dhe e testit. Në këto metoda e procedura gjurmuese është saktësuar tema, pyetjet dhe radha e paraqitjes së tyre, mënyra e regjistrimit të përgjigjeve, kohëzgjatja e pritjes dhe e marrjes së përgjigjes etj. Këto procedura janë të njëjta për të gjithë subjektet. Ato janë formë e përshtatshme e zbatimit nga ana e të gjithëve, pavarësisht nga profesioni: gazetar, politikan, psikolog etj. dhe janë shumë ekonomike, sepse të dhënat e përftuara mund të përpunohen shpejt dhe lehtë. Këto procedura kanë disa të meta: nuk i përshtaten tipit të secilit subjekt, nuk lejojnë paraqitjen e çështjeve të reja, përgjigjet shpesh janë sipërfaqësore etj. Shih – ***ANKETA; INTERVISTA; SHKALLA E VLERËSIMIT; TESTI.***

PROCEDURAT GJURMUESE TË PSIKOLOGJISË. Procese konkrete të verifikuara për gjurmimin e drejtë dhe objektiv të faktorëve karakteristikë të një dukurie, procesi, sjelljeje etj. Këto përfshijnë përcaktimin e saktë të qëllimit hulumtues dhe të ecurisë në të gjitha fazat hulumtuese. Në procedurat gjurmuese të psikologjisë zakonisht hyjnë: anketa, intervista, shkalla e vlerësimit dhe testi. Secila prej këtyre procedurave përdoret në kushte saktësisht të përcaktuara.

PROCES, - I. m. Term me shkallë të lartë përdorimi në të folurin e përditshëm, por që ka përdorim edhe në psikologji, si edhe në biologji, ekonomi, fiziologji etj. Kuptimi i

përgjithshëm i procesit ka të bëjë me zhvillimin, rrjedhjen, drejtimin e aktivitetit dhe përqendrimin e tij në arritjen e një qëllimi të caktuar dhe pushtimin e tij, pra tërësia e operacioneve që çojnë në një rezultat të caktuar. Në psikologji termi proces emërton zhvillimin e një mendimi, veprimi etj., si: procesi i të mësuarit – angazhimi i perceptimit, i kujtesës, i mendimit dhe i të folurit në përvetësimin e një përmbajtjeje të caktuar. Kuptimi i tillë në psikologjinë kognitive zbërthehet edhe më tej, sepse emërton operacionet e marrjes së informacioneve, të kodimit dhe të shpjegimit të tyre.

PROCESET ATRIBUIVE. Procese të lidhura me perceptime shoqërore. Këto procese kognitive kanë të bëjnë me përshkrimin e sjelljeve dhe të shkaqeve të tyre (të motiveve, nevojave, dëshirave etj.) në bazë të vëzhgimit të veprimtarisë së njeriut. Atribuimi i shkaqeve të sjelljeve të një individi mbështetet në informacionet për sjelljet e jashtme dhe për format e tyre që vëzhgohen nga të tjerët.

PROCESET E KUJTESËS. Kujtesa është proces i ndërlikuar kognitiv i përbërë nga kodimi i informacioneve, nga "të ushqyerit" e informacioneve, përkatësisht nga ruajtja e tyre në trurin e njeriut, nga përzgjedhja e informacioneve dhe riprodhimi i informacioneve të ruajtura. Këto tri procese në terminologjinë e psikologjisë klasike janë quajtur retencion, rekognjicion dhe riprodhim.

a. **Kodimi** – Term i ardhur nga frëngjishtja *code*. Kodimi është shndërrimi ose modifikimi i të dhënave, fizike, kimike, sociale etj. dhe i lidhjeve të tyre në forma psikologjike, në gjurmë nervore, përkatësisht në engrame dhe paraqitje mendore e tyre për të mundësuar ruajtjen e tyre në trurin e njeriut;

b. **Përforcimi** – Ruajtja e formave psikologjike të të dhënave dhe të lidhjeve ndërmjet tyre duke i "ushqyer", pra duke i përforcuar kodet e tyre në bazë të përsëritjeve të atyre kodeve. Përsëritja është forma kryesore e përforcimit të kodeve të kujtesës në trurin e njeriut;

c. **Përgjetja** – Konstatimi i vetëdijshëm i kodit të ruajtur në kujtesë dhe riprodhimi i tij, duke i afruar vetes dhe të tjerëve përmbajtjen e kodit që kërkohet. Riprodhimi i asaj përmbajtjeje është forma objektive e qenësisë së kujtesës dhe e rolit të saj.

PROCESET PSIKIKE. Tërësi e veçantë e jetës psikike, rrjedhje e dukurive të posaçme psikike në baza psikonervore dhe e ndryshimeve të tyre, që karakterizohen me tri veçori kryesore: cilësia zhvillimore, drejtimi i zhvillimit dhe karakteri aktiv i tyre. Psikologjia është përgjithësisht disiplinë shkencore, që merret me studimin e parimeve të përgjithshme të zhvillimit të proceseve psikike. Dallohen tri grupe procesesh psikike: 1) Proceset kognitive që kanë të bëjnë me perceptimin, të mësuarit dhe kujtesën dhe mendimin e të folurit, dhe që janë bartës të njohjes së realitetit; 2) Proceset emocionale që shprehin përjetimin e ndryshimeve të gjendjes së njeriut dhe përjetimin e qëndrimit të tij ndaj dukurive, objekteve, njerëzve, situatave etj. dhe 3) Proceset konotative që kanë të bëjnë me motivet dhe sjelljet e njeriut, kryesisht me veprimet e vullnetshme të tij të drejtuara në një qëllim të parashikuar.

PROCESET PSIKONERVORE. Veprime të posaçme nervore, të cilat karakterizohen, përpos veçorive fiziologjike, edhe me cilësinë e përjetimit të përmbajtjes së tyre nga ana e njeriut. Proceset psikike zhvillohen në bazë të procesit psikonervor, që zhvillohet në strukturat e larta nervore. "Proceset që ngjasin në strukturat e ulëta nervore janë të natyrës fiziologjike dhe kanë mundësi të kalojnë në cilësi të reja, në veprimtari psikonervore, atëherë kur ngrihen në strukturat më të larta nervore, në bazë të proceseve të ndërlikuara të grumbullimit dhe të integrimit të tyre".

PROCESI DYTËSOR. Term i teorisë së psikanalizës që emërton funksionimin e aparatit psikik, përkatësisht të egos së vetëdijshme dhe të paravetëdijshme. Procesi dytësor, sipas themeluesit të psikanalizës Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1938) zhvillohet në egon e vetëdijshme, i cili drejton energjinë e shtytësve dhe impulset e idit sipas parimit të realitetit. Procesi dytësor u zhvillua nga procesi parësor dhe detyra e tij është të drejtojë energjinë e shtytësve të idit, pra procesin parësor, duke marrë për bazë raportin e drejtë ndërmjet egos, idit e super egos. Shih – ***PROCESI PARËSOR.***

PROCESI I FORMIMIT TË SHPREHIVE. Proces psiko-nervor që ka për bazë përsëritjet e organizuara me një sistem të caktuar dhe ligjshmëritë fiziologjike të sistemit nervor mbi zhvillimin e lidhjeve të reja dinamike brenda këtij sistemi, të shqisave e receptorëve të tyre, si edhe të sistemit efektor të organizmit të njeriut. Përsëritja uniforme e një tërësie veprimesh shkakton impulse nervore dhe aktivizimin e qendrave nervore, si edhe lidhjen e neuroneve të veçanta, të cilat, nga përsëritja e veprimeve të njëjta përforcohen dhe veprimtaria e përsëritur bëhet gradualisht më e lehtë, më e shpejtë dhe më e saktë, duke zvogëluar energjinë kontrolluese të vetëdijes së njeriut ndaj veprimeve të tilla. Shih – ***SHPREHIA.***

PROCESI I PUNËS. Proces përmbyllës i veprimeve të ndërlidhura psikofizike të organizuara dhe të drejtuara në një qëllim – në prodhimin e caktuar. Në procesin e punës një veprim zëvendësohet me veprimin tjetër në kohën e duhur dhe ky proces përbën njërin ndër karakteristikat kryesore me karakter të përbashkët të të gjitha llojeve të proceseve të punës. Me studimin e këtij procesi merret psikologjia e punës.

PROCESI I TË PARIT. Procesi i të parit të dukurive, të objekteve, të situatave etj. është ndër proceset fiziologjike dhe psikologjike më të ndërlikuara. Ky proces fillon me ndikimin e dritës në organin e të parit, pra në syrin e njeriut dhe me depërtimin e tyre deri në rrjetën ose retinën e syve, ku reagojnë kunjëzat dhe shkopthat – qelizat receptore të të parit. Në këto qeliza zhvillohet një proces specifik i përpunimit të pigmenteve, proces ky që shkakton impulse nervore, të cilat barten deri në cipën e pjesës oksipitale apo zverkore të zonës së të parit të trurit të madh. Në këtë zonë gjenden qendrat parësore që aktivizohen nga impulset nervore dhe, ku, impulset nervore shndërrohen në ndijime të pacaktuara plotësisht. Ndërkaq, përpunimi i hollësishëm i këtyre impulseve nervore, që janë bartëse të informacioneve, i atribuohet qendrave

dytësore të të parit të cipës ose kores së trurit të madh. Falë këtij procesi të ndërlidhur fizik (rrezet e dritës), funksionit fiziologjik të syrit, lidhjes së këtij funksioni me zhvillimin e impulseve nervore dhe me aktivizimin e qendrave parësore dhe dytësore të cipës së trurit të madh, pikërisht të cipës së pjesës e zonës oksipitale a zverkore të trurit përpunohen impulset nervore. Qendra parësore e të parit kontrollon hyrjen e impulseve nervore në zonën parësore dhe, duke u lidhur me qendrat dytësore, siguron përftimin e të gjitha të dhënave, që përcaktojnë ndijimet dhe perceptimin e dukurive, të gjendjeve, të objekteve, të proceseve dhe të situatave, duke shkaktuar sjellje të posaçme të njeriut ndaj tyre. Ky proces përfshin disa sintagma terminologjike të psikologjisë, të tilla si:

a. Të parët e afërt – Të parët e dukurive, të objekteve, të veprimeve apo të cilësive të tyre që gjenden më pak se 60 cm larg nga shikuesi;

b. Të parët binokular – Të parët me dy sy, kur këta janë të përqendruar në të njëjtin objekt; Prej të parët e një objekti të caktuar me dy sy njeriu e përvetëson figurën e objektit. Figura e secilit sy shkrihet në një figurë të përbashkët. Të parit binokular mundëson perceptimin e thellësisë së trupave në bazë të disparitetit të syve;

c. Të parët qendror – Të parët e objekteve me anën e gropës qendrore të rrjetëzës së syrit, kur objekti dallohet me qartësi dhe me mprehtësi ;

d. **Të parët e largët** – Të parët e objekteve që gjenden më larg se 64 m prej syve të shikuesit;

e. Të parët monokular – Të parët vetëm me një sy mund të ketë karakter të përhershëm ose të përkohshëm. Të parët monokular vështirëson perceptimin e thellësisë së objekteve;

f. Të parët periferik – Të parët e objekteve me pjesën skajore të rrjetëzës së syrit.

g. Fusha e të parit – Objektet e një hapësire të caktuar që njeriu i dallon me anën e shqisës së të parit, brenda çastit më të shkurtër.

h. **Këndi i të parit –** Kënd i formuar nga të parit e disa pikave më të largëta të një objekti të caktuar.

i. Rodopsina e të parit – Purpuri e të parit, fotopigment kromoproteid i syrit. Është i ndjeshëm ndaj dritës dhe gjendet në shkopthat e rrjetëzës së syrit. Kjo substancë kimike shkrihet nën ndikimin e valëve të dobëta të dritës dhe kur thith energji të mjaftueshme drite, atëherë fillon procesi zinxhir i zbërthimit kimik, që aktivizon impulset nervore të shkopthave, të cilët ngacmojnë nervin optik dhe barten në qendrën e të parit të cipës apo kores së trurit të madh, ku zhvillohet ndijimi i dritës së trupave;

j. Qelizat e të parit – Shtresa e kunjëzave dhe shkopthave të syrit përbën qelizat neuroepiteliale fotoreceptorë të të parit, që gjenden në rrjetëzën ose në retinën e syrit. Reagojnë ndaj intensitetit të dritës dhe luajnë rol të rëndësishëm në ndijimin e tonit të ngjyrave dhe të ndriçimit të trupave. Shih – ***KUNJËZAT; SHKOPTHAT.***

k. Shqisa e të parit. Shih – ***SYRI***.

PROCESI I VENDIMARRJES. Proces i veçantë që përbëhet prej disa fazave të ndërlidhura. Në procesin e vendimmarrjes shprehen bindjet, qëndrimet dhe faktorët e tjerë psikologjikë. Në këtë proces mund të zbatohen edhe qasje matematiko-

statistikore, që janë më të sakta, por edhe më të ndërlikuara dhe që zakonisht abstragojnë faktorët subjektivë, duke u mbështetur më tepër në informacione objektive të reja.

PROCESI NERVOR. Ndryshime të përhershme në qeliza dhe në inde nervore.

PROCESI PARËSOR. Term i teorisë së psikanalizës që emërton përmbajtjen dhe funksionimin e idit të pavetëdijshëm, irracional, ku mbisundon parimi i kënaqësisë së shtytësve dhe shkarkimi i energjisë së tyre, pa marrë në konsideratë asnjë faktor tjetër të egos, të super egos, sepse energjia e shtytësit pra duhet plotësuar. Procesi parësor i idit dhe i funksionimit të tij nuk njeh as kohë as hapësirë, ai kërkon vetëm plotësimin e energjisë së vet.

PROCESI SIMBOLIK. Proces i brendshëm që ka të bëjë me përdorimin dhe përpunimin e simboleve. Procesin simbolik e hasim kryesisht gjatë formimit të koncepteve, gjatë zgjidhjes së problemave, gjatë zhvillimit të të folurit, me rastin e përfaqësimit të një situate me anë të simboleve etj. Ky do të ishte kuptimi i termit proces simbolik në psikologjinë kognitiviste. Në psikanalizë ky term ka kuptimin e veprimit me shtytës psikodinamikë, me të cilët rrënohen dëshirat, konfliktet, motivet dhe nevojat e pavetëdijshme. Sipas Karl Jungut procesi simbolik është procesi themelor në art, është procesi i krijimit të miteve, të besimit.

PRODUKTIVITET, - I. m. Term i terminologjisë së ekonomisë që emërton produktin, të mirën lëndore apo shpirtërore të përftuar nga puna e një individi ose e disa individëve. Ky term i përket edhe psikologjisë së punës, përkatësisht asaj industriale. Në këto disiplina emërton veprimet e drejtuara të një punëtori, disa punëtorëve, ose një grupi punëtorësh në shndërrimin e një lënde të papërpunuar në objekt të mirash lëndore ose shpirtërore, duke siguruar për veten e tyre dhe për të tjerët objekte të nevojshme për jetën, punën dhe zhvillimin.

PROFESION, - I. m. Puna e një profesionisti apo zejtari me të cilën ai zhvillon dhe siguron jetën dhe aktivitetin e tij, si edhe të familjes së vet. Profesioni kërkon nivel të ushtrimeve të specializuara për kryerjen si duhet të aktivitetit profesional dhe vazhdimësinë e përsosjes së veprimeve profesionale. Profesionet e zhvilluara kanë kod të veçantë të sjelljeve dhe nuk lejojnë shumë ndërhyrje në aktivitetin profesional. I tillë është profesioni i argjendarit, i dentistit, e xehetarit etj.

PROFILI I PERSONALITETIT. Term që haset shpesh në literaturën e psikologjisë së personalitetit dhe që emërton paraqitjen e përgjithshme dhe të sintetizuar të cilësive dhe të tipareve karakteristike manifestuese të një individi (të aftësive, të psikomotorikës, të tipareve të introversionit etj.), paraqitje në rrafshin pingul të tyre në raport me normat e popullimit të atij mjedisi ku jeton dhe zhvillohet një pjesëtar i caktuar i asaj popullate. Profili i personalitetit mund të paraqitet grafikisht në formë histogrami ose thjesht mund të bëhet në bazë të përshkrimit të cilësive dhe të tipareve pozitive ose negative të tij. Shih – ***PSIKOGRAFIA.***

PROFILI I PROFESIONIT. Tërësia e tipareve dhe e cilësive të një

profesioni apo mjeshtërie, të identifikuara dhe të përshkruara saktësisht. Profili i profesionit përmban këto komponentë kryesorë: natyrën e profesionit, format e organizimit të punës profesionale, kushtet e domosdoshme trupore dhe psikike të atij që do të merret me profesionin e caktuar, kushtet dytësore të atij profesioni dhe kushtet që e pengojnë njeriun për marrjen me atë profesion.

PROGESTERON, - I. Hormon i gjëndrave seksuale i lidhur me trupin e verdhë të organizmit, i njohur me termin latin *corpus luteum* dhe me pjesën e sipërme të hipofizës. Funksioni kryesor i këtij hormoni është përgatitja e mitrës për implantimin e qelizës së vezores së pllenuar, për sekretim me të cilin ushqehen qelizat dhe për përgatitjen e gjoksit të femrës për të prodhuar qumështin e duhur. Sekretimi i progresteronit është nën kontrollin e hormoneve gonadotrope, që prodhohen nga pjesa e sipërme e hipofizës.

PROGNOZ/Ë, - A. m. I ardhur nga greqishtja *πρόγνωση* "parashikim" që parashikon zhvillimin e një dukurie, gjendjeje, procesi etj., në bazë të shenjave të tashme dhe atyre të kaluara. Termi ka ardhur në psikologji nga mjekësia, ku parashikohet zhvillimi i një sëmundjeje në bazë të diagnozës dhe anamnezës. Në psikologji prognoza emërton parashikimin e zhvillimit të mundshëm të një sjelljeje në të ardhmen e një individi të caktuar (suksesi në mësime, në punën profesionale, parashikimin e sjelljeve kriminalistike etj.). Parashikimi ose prognoza në psikologji kryhet në bazë të shfrytëzimit të të dhënave nga historia e individit, nga analiza e anëve të ndryshme të sjelljeve të tanishme, të rezultateve në testin e inteligjencies, në inventarin e personalitetit dhe sintetizmit të këtyre konstatimeve në një gjykim vlerësues. Megjithëkëtë, ekziston mundësia e prognozës së gabuar.

PROGNOZA KLINIKE. Term i psikologjisë klinike që emërton parashikimin e formave të sjelljeve që do të zhvillohen më pas te një individ i caktuar, i sjelljeve problematike, i sjelljeve të suksesshme në shkollë, në profesion etj. Prognoza klinike mbështetet kryesisht në të dhënat dhe faktet idiografike, pikërisht në të dhëna e fakte konkrete e karakteristike, që identifikohen me anën e analizës së hollësishme të atij individi (historia e jetës së një individi, kushtet familjare të tij, rezultatet e testimit psikodiagnostik dhe ato të intervistimit).

PROGNOZA STATISTIKORE. Parashikim i zhvillimit të sjelljeve, të shmangieve nga sjelljet normale, të sukseseve etj., duke shfrytëzuar tabelat statistikore dhe procedurat e statistikës. Tabelat e këtilla përmbajnë norma të përcaktuara në bazë të indikatorëve empirikë, kritikë dhe të rrezikshmërisë objektive. Megjithëkëtë, për saktësinë e parashikimit të sjelljeve është më mirë kombinimi i rezultateve të prognozës klinike me rezultatet e prognozës statistikore.

PROJEKSION, - I. m. Term i ardhur nga latinishtja *projection* "hidhe përpara", që në psikologji ka ardhur nga fizika. Kuptimi themelor i termit projeksion ka të bëjë me paraqitjen e një përmbajtjeje, mendimi, një qëndrimi etj. në formë të qartë, të dallueshme. Në psikologji termi projeksion ka këto kuptime: 1) Në psikanalizë projeksioni

është mekanizëm mbrojtës, me anën e të cilit egoja e njeriut mbrohet nga ndjenjat, si edhe nga energjia e shtytësve të tij në mënyrë të pavetëdijshme, duke ja atribuuar këto ndjenja dhe prirje të tjerëve. Në këtë mënyrë ai mbrohet nga ankthi i tij. Format e skajshme të projeksionit shpien në çrregullime psikike serioze, siç është paranoja. Dëshirat, pikëpamjet, qëndrimet, vlerat e të tjerëve njeriu i shpjegon sipas prirjeve të tij. 2) Në teknikat projektuese projeksioni është interpretim i lëndës së pastrukturuar, i shprehjeve dykuptimëshe etj. sipas dëshirave, interesave, motiveve dhe nevojave e pritjeve personale. 3) Në analizën faktoriale projeksioni është përcaktimi i shkallës së ngarkesës së një procesi me faktor të caktuar. 4) Në psikologjinë fiziologjike termi projeksion emërton bartjen e impulseve nervore nga ana e fijezave nervore, nga një pjesë e trurit në pjesën tjetër të tij, si edhe bartjen e impulseve nervore nga njëra pjesë e kores së trurit të madh në muskuj dhe në gjëndra, si edhe në pjesët ose fushat projektuese të trurit, ku arrijnë ngacmimet nga receptorët e shqisave (impulset receptore të dëgjimit projektohen në pjesën parietale ose tepore të trurit të madh, prandaj kjo pjesë quhet fusha projektuese e dëgjimit). Projeksioni në psikanalizë është mekanizëm mbrojtës i pasuksesshëm i një individi që i atribuon individit tjetër dëshirat e veta të ndaluara nga mjedisi shoqëror. Mbrohet nga dëshira të tilla duke ia hedhur përpara, e pikërisht duke ia projektuar këto dëshira një individi tjetër.

PROJEKTI EKSPERIMENTAL. Parashtrim, shestim**,** plan i diferencuar i planifikimit të hollësishëm të një organizimi gjatë eksperimentit. Ky plan përfshin këto ecuri: përcaktimin e operacionalizimit të ndryshores së pavarur dhe të ndryshores së varur, zgjedhjen e subjekteve, ndarjen e tyre në grupin eksperimental dhe në atë kontrollues ose ndarjen e tyre sipas situatave provuese, përcaktimin e kontrollit të manipulimit me ndryshoret, regjistrimet e ndryshimeve të ndryshores së varur, përcaktimin e procedurave të përpunimit të të dhënave dhe përgjithësimin e konkluzioneve, si dhe kumtimin e tyre.

PROJEKTUES, - E. mb. Që përcakton dy kuptime: 1) Që ka të bëjë me projeksionin, përkatësisht me paraqitjen e dëshirave, të ideve, të motiveve etj. dhe me përcaktimin e karakteristikave të sjelljeve specifike të njeriut dhe të shkaqeve të sjelljeve të këtilla. Mbiemri projektues në një togfjalësh të caktuar mbështetet në hipotezën se te njeriu ekzistojnë faktorë të shtypur, të futur thellë në pavetëdijen e personalitetit dhe këta mund të njihen duke komentuar shprehjet me disa kuptime dhe 2) Që i përket një projekti arkitektonik, të energjisë, hulumtues etj. Mbiemri projektues haset në përbërjen e këtyre togfjalëshave terminologjikë:

a. **Fijeza nervore projektuese** - Fijeza të dala nga qelizat nervore që bartin impulset nervore nga njëra pjesë në pjesën tjetër të cipës së trurit të madh dhe sjellin impulse nervore nga receptorët në qendrat trunore dhe nga qendrat trunore në muskuj;
b. **Fusha projektuese** – Tërësi qendrash të ndijimeve që shtrihen në një fushë të cipës së trurit të madh. Kjo

fushë zakonisht emërton fushat parësore të cipës së trurit të madh;

c. **Hipoteza projektuese –** Term i përdorur që nga viti 1939. U përdor nga Franc Lorens për të emërtuar këtë kuptim: "Çdo personalitet i ballafaquar me ngacmues që kanë përcaktim të pamjaftueshëm, me ngacmues relativisht të pastrukturuar (njolla nga lëngu i ngjyrës së shkrimit, lodra, fjali të pakryera) orvatet ta tejkalojë papërcaktueshmërinë dhe t`i japë kuptim lëndës së dhënë amorfe, duke i dhënë kuptimin e vet "privat" idiosinkretik, përkatësisht duke projektuar në të, sipas rregullit, pikëpamjen e vet për jetën, bindjet, ndjenjat, qëndrimet, idealet dhe nevojat e veta të pavetëdijshme";

d. **Procedura hulumtuese** – Ecuri e verifikuar për studimin e personalitetit, me zbatimin e së cilës pritet të zbulohen dëshirat e fshehta, konfliktet e brendshme, qëndrimet etj. ndaj të tjerëve. Zbatimi i drejtë i procedurave projektuese çon në identifikimin e shkaqeve të sjelljeve karakteristike të një individi. Procedura projektuese ka për bazë lëndën e paformuar, të cilën subjekti duhet ta formojë, duke i dhënë kuptim të caktuar sipas dëshirave, përvojës, komplekseve etj.;

e. **Teknika projektuese –** Tërësi instrumentesh gjurmuese të personalitetit, që kanë për qëllim zbulimin e strukturave të thella të pavetëdijes së personalitetit, që njihen duke kërkuar nga subjekti përgjigje projektive në materialin pa formë, të pastrukturuar, që ai e strukturon, i jep kuptim sipas dëshirave, konflikteve, shtytësve të brendshëm të tij. Ky grup teknikësh përbëhet nga: 1) Testi i njollave i Herman Rorshahut; 2) Testi i fjalive të papërfunduara dhe të pakryera; 3) Testi i vizatimit të figurës së njeriut dhe 4) Psikodrama;

f. **Testi projektues** – Lloj testi i standardizuar i procedurës projektuese, që zakonisht përdoret në psikologjinë klinike. Përbëhet nga paraqitja grafike e situatave të papërcaktuara, të cilat nxisin subjektin për t`i përcaktuar dhe, me këtë rast, këtë e formon duke shprehur dëshirat, motivet, synimet etj. Situatat e këtilla mund të paraqiten në formë figurash të njollave të pikës së ngjyrës së shkrimit, të shpërndarë në anën e djathë dhe të majtë të një faqeje letre shkrimi të thyer në mes të saj, ku është hedhur pika e ngjyrës dhe pas mbylljes së dy faqeve të kësaj letre përftohet një figurë e papërcaktuar, në formë figurash të vizatuara me të meta dhe me zbrazësi që subjekti duhet t`i korrigjojë dhe t`i plotësojë, në formë fjalish të papërfunduara, të pakryera, që subjekti duhet t`i përfundojë, t`i kryejë. Nga interpretimi i figurave, nga korrigjimi i fjalive dhe plotësimi i tyre, sikurse edhe nga korrigjimi e plotësimi i vizatimeve ndriçohet dinamika e personalitetit dhe tiparet karakteristike të tij. Llojet më të njohura të këtij testi janë: testi i psikiatrit zviceran Herman Rorshah (Hermann Rorschach, 1884 – 1922), testi i tematikës aperceptive i psikologut amerikan Sol Rozencvajg (Saul Rosenzeig, 1907), testi i tematikës aperceptive të psikologut amerikan Henri Mareit (Henry Marray, 1893 - 1988) etj.

PROKSIMODISTAL, - E. mb. Term burimor i latinishtes *proximitas* "afërsia". Ky mbiemër haset shpesh në literaturën e psikologjisë, ku përdoret për

të emërtuar atë dukuri, njeri, objekt etj., që gjendet afër; atë që gjendet afër mesit, afër boshtit trupor. Mbiemri proksimodistal gjendet në përbërjen e këtyre togfjalëshave terminologjikë:

a. **Ngacmuesi proksimodistal –** Ngacmuesi fizik, kimik, mekanik etj. që vepron drejtpërdrejt në organet shqisore dhe aktivon receptorët e një shqise të caktuar. Ngacmues proksimodistalë mund të jenë: era e lules, lapsi i prekur, limonada në gojën e njeriut etj.;

b. **Parimi proksimodistal –** Parimi i zhvillimit psikofizik të organizmit, sipas të cilit procesi zhvillimor i organizmit kryhet nga e afërta kah e largëta, nga boshti, qendra e organizmit kah periferia e tij, përkatësisht kah gjymtyrët. Drejtim zhvillimor i tillë është zhvillimi senorik e motorik nga koka e trupi kah duart e këmbët dhe më në fund zhvillohen ndjeshmëria e lëvizjet e kontrolluara nga gishtërinjtë;

c. **Pika proksimodistale e të parit** – Objekti më i afërt i syve, që mund të shihet me qartësinë më të madhe. Këtë e mundëson aftësia e lentës së syrit dhe akomodimi i saj. Mirëpo, objekti më i afërt i të parit të qartë me të dy sytë njëkohësisht i përket pikës proksimodistale të konvergimit të syve;

d. **Receptori proksimodistal** – Organi ndijimor, përkatësisht qeliza organike që kryen funksionin e shndërrimit të energjisë së ngacmuesit të një shqise në impuls nervor. Receptorë proksimodistalë janë receptorët termikë, pra qelizat specifike të lëkurës që shndërrojnë energjinë ngacmuese të trupave të ngrohtë në impulse nervore.

PROMISKUITET, - I. m. Term me prejardhje nga latinishtja *promicuus* "i (e) përzier". Promiskuiteti është mungesë e përzgjedhjes, që kohët e fundit emërton seksualitetin jo përzgjedhës, përkatësisht zëvendësimin e shpeshtë të partnerëve seksualë, duke shfrytëzuar edhe takimet e rastësishme ose rrethanat pak të volitshm**e.**

PROPAGAND/Ë, - A. f. Term i psikologjisë politike, sociale, të tregut etj. i ardhur nga latinishtja *propagare* "zgjeroj" që buron nga viti 1623 në kuadrin e shoqërisë "Kongregacioni i shenjtë i propagandës fide" – ("Sacra congregation de propaganda fide"). Në psikologji dhe në media termi propagandë emërton veprimtarinë e qëllimshme, sistematike dhe të organizuar me qëllim të mbjelljes së një "fare mendore" dhe përhapjes masive të një porosie, qëndrimi, në përmasa sa më të gjera te popullata e një mjedisi për të formuar "një opinion ose një mendim publik" në favor të asaj porosie, atij qëndrimi, asaj gjendjeje, atij motivacioni dhe për të ndryshuar sjelljet e njerëzve të mjedisit të caktuar sipas asaj që propagandohet. Qëllimi i fundit i propagandës është ndryshimi i sjelljeve, përkatësisht i drejtimit të sjelljeve. Për të pasur sukses propaganda duhet të formësohet dhe t`i përshtatet popullatës që i dedikohet dhe situatës shoqërore. Për të kryer rolin e vet propaganda duhet të ketë këto cilësi: të ketë argument bindës, të ketë formulim gjuhësor të qartë dhe stil tërheqës, të ketë theksim grafik të bukur, të zëshëm dhe ritëm përsëritës të dallueshëm, të prekë motivet dhe nevojat më të rëndësishme të popullatës etj. Propaganda mund të jetë ekonomike, politike, ushtarake etj.

PROPRIOCEPSION, - I. m. Term përgjithësues për sistemin e organeve të veshit të brendshëm, përkatësisht të organit vestibular dhe të sistemit të organeve ndijimore kinestetike të muskujve, të eshtrave dhe të kërcejve. Bazën receptore të propriocepsionit e përbëjnë proprioceptorët.

PROPRIOCEPTOR, - I. m. I ardhur nga latinishtja *proprium* "i veti" që emërton receptorët e posaçëm të vendosur në muskuj, në eshtra dhe në kërcej, si edhe në pjesën e veshit të brendshëm, përkatësisht në organin vestibular. Proprioceptorët kryejnë funksionin e marrjes së ngacmimeve, të informacioneve për pozicionin e trupit dhe të pjesëve të tij, për baraspeshën trupore, për tonin e muskujve etj. dhe këto ngacmime shndërrohen në impulse nervore që barten deri në pjesët e posaçme të cipës së trurit të madh, ku lindin ndijimet kinestetike. Me këtë rast njeriu bëhet i vetëdijshëm për pozicionin e tij në hapësirën e caktuar, për ndryshimet e këtij pozicioni dhe të pjesëve të trupit të tij, për baraspeshën trupore, për lëvizjen e trupit dhe të pjesëve të tij, për kërcimin, për rrotullimin e trupit etj.

PROPRIUM, - I. f. Term i psikologjisë së personalitetit, që është përdorur nga psikologu amerikan Gordon V. Olport (Gordon W. Allport, 1897 – 1967). Propriumi është instancë qendrore e personalitetit, që zhvillohet dhe formohet gjatë jetës dhe zhvillimit psikik, shoqëror dhe fizik të njeriut. Kuptimi i propriumit kap tërësinë e përjetimeve të njeriut nga ana e egos së tij. Sipas Gordon Olportit në proprium bashkohen përmbajtjet e vetëdijshme të njeriut për veten e tij, për trupin e vet, për identitetin dhe për synimet e tij. Në proprium hyjnë këto shtatë tipare: konceptimi i trupit të njeriut, i qenies së tij të arsyeshme, njohja dhe sundimi i qëllimeve afatgjata, identiteti i njeriut, respektimi i vetes, karakteristikat e mendimit personal dhe stili kognitiv. Këto tipare kanë kuptimin e përjetimit të ndjenjës së njeriut për unin e vet, perceptimin, mendimin dhe sjelljen e vetëdijshme të tij, kur këto i kryejmë sipas angazhimit të vetëdijshëm, e jo sipas porosisë së tjetrit. Propriumi luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e interesimeve, të vetëdijes, të parashikimit zhvillimor të njeriut etj.

PROSTAGLANDIN/Ë, - A. f. Hormon i prostatës që kryen funksionin e rritjes së shkallës së ndjeshmërisë të mbaresave nervore ndaj histaminës (aminë biogjene që vepron si neurotransmetues në disa rrugë cerebrale, duke marrë pjesë në ndijimin e dhembjes).

PROSTITUCION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *prostitution*. Term i psikopatologjisë sociale, që emërton dukurinë e rëndë sociale, kur femra detyrohet të kryejë raporte seksuale me meshkuj për të siguruar jetesën. Prostitucioni mund të marrë përmasa profesioni. Shfaqet jo vetëm te femrat, por edhe te meshkujt, madje edhe ndërmjet femrave, si edhe ndërmjet meshkujve.

PROSTRACION, - I. m. Term i rrallë i psikologjisë, që ka kuptim të përgjithshëm dhe të veçantë. Kuptimi i përgjithshëm i këtij termi i përket stërlodhjes fizike e psikike të njeriut nga aktiviteti i rëndë dhe i pandërprerë i

tij. Në psikologjinë e punës dhe në atë organizative ka kuptim të veçantë. Kështu ai emërton shkallën më të lartë të lodhjes psikike të njeriut, kur organizmi ka humbur fuqinë e reagimit refleksiv.

PROTANOPI, - A. f. Term i greqishtes i përbërë nga fjalët *πρώτος* "i pari", *a* "mos", *οπσ* "parje". Protanopia është dukuri patologjike e të parit të ngjyrave, që ka të bëjë me humbjen e aftësisë së dallimit të ngjyrës së kuqe (e para ngjyrë e spektrit). Kjo dukuri shkaktohet nga mungesa e pigmenteve në rrjetëzën apo retinën e syrit. Protanopia është njëra formë e dikromatopsisë, kurse forma tjetër është deuteranopia, paaftësia e syrit për të dalluar ngjyrën e gjelbër.

PROTENZI, - A. f. Term i psikologjisë së personalitetit, që i përket teorisë së psikologut amerikan Rajmond B. Katel (Reymond B. Catell, 1905 – 1998). Protenzia është tipar burimor i personalitetit, e pikërisht i skajshmërisë së këtij tipari që përcakton sjelljen karakteristike paranojake. Individët me tiparin e protenzisë shfaqin prirje të hapur të paraqitjes së ideve të ndryshme projektuese. Ky tipar në teorinë e lartpërmendur shënohet me **L+**.

PROTOTAKS, - A. f. Term i psikiatrit amerikan Hari S. Saliven (Harry S. Sullivan, 1892 – 1949) që emërton gjendjen e përjetimit të ngjarjeve, të cilat njeriu nuk arrin t`i dallojë njërën nga tjetra. Gjendja e tillë është karakteristike kryesisht për moshën fëmijërore. Prototaksa paraqitet edhe te të rriturit që vuajnë nga psikozat, përkatësisht te ata që gjenden në gjendje të skajshme psikotike.

PROV/Ë, - A. f. Veprim i organizuar me qëllim të vërtetimit të shkakut të një ndryshimi të dukurisë, të gjendjes, të procesit etj. dhe të lidhjes së tij të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me ndryshimin e caktuar. Organizimi i provës kërkon kontrollimin e saktë të kushteve dhe të lidhjeve ndërmjet kushteve për të vërtetuar saktësisht rolin e një kushti të caktuar dhe përmasat e ndikimit të tij në ndryshimin e dukurisë apo në paraqitjen e gjendjes së ndryshuar të saj.

PROVIM, - I. m. Paraqitje të dhënash, informacionesh e faktesh, si edhe raportesh logjike ndërmjet tyre me qëllim argumentimi, dëshmimi e vërtetimi të një mendimi të caktuar. Objekt provimi mund të jetë matja sasiore e cilësore e njohurive të fituara nga ana e nxënësve ose e studentëve, brenda një lënde të caktuar mësimore-shkencore, matja e vetive, e tipareve psikike, e shkallës së zhvillimit, si edhe e karakteristikave të tyre. Format kryesore të provimit të tillë janë: **hartimi** – përshkrim dhe shpjegim me shkrim i dukurisë, i ndodhisë, i sjelljeve etj., sipas temës së përkufizuar dhe brenda një kohe të caktuar; provim me anë pyetjesh të parashtruara, ku kërkohet përgjigje e saktë dhe e shkurtër e pyetjeve të parashtruara, plotësim të dhënash që mungojnë në përgjigjen e parashtruar, përshkrim raportesh ndërmjet të dhënave sipas kërkesës së parashtruar, provim me anë të testeve etj.

PROVOKIM, - I. m. Term i ardhur në gjuhën shqipe nga latinishtja *provocatio* "ngacmim, nxitje". Provokimi është veprim i qëllimshëm, me të cilin një individ nxitet për t`iu kundërvënë një

ideje, një pikëpamjeje, një vendimi etj. dhe zbatohet në situata provokuese. Në psikologjinë klinike klienti provokohet me fjalë, me pyetje etj., me qëllim të nxjerrjes nga ai të asaj çfarë e mundon (dëshira e shtypur me energjinë nxitëse të sjelljeve të caktuara, motivet, ndjenja e fshehur etj).

PROVUES, - I. m. Individi që provon, që organizon kryerjen e një prove. Provuesi në gjurmimet psikologjike është individi, i cili e ka zotëruar mirë metodologjinë e hulumtimit të dukurive, të proceseve, të sjelljeve etj. të një popullate të caktuar. Në rastet e këtilla kërkohet që provuesi të sigurojë maksimalisht kushtet objektive dhe rezultatet e sakta të çështjes provuese.

PROZOPAGNOZI, - A. f. Term i psikopatologjisë i ardhur nga greqishtja që nënkupton një çrregullim psikik, që ka të bëjë me pamundësinë e njohjes së fytyrës së tjetrit tashmë të njohur dhe të takuar shumë herë më parë. Nga ky çrregullim i ati nuk e njeh fëmijën e tij sipas fytyrës që ai ka. Në rastet e skajshme të këtij çrregullimi njeriu humb aftësinë e njohjes së vetvetes dhe të fytyrës së tij. Prozopagnozia shkaktohet më tepër nga dëmtimi i asaj pjese të cipës së trurit të madh që i përket pjesës parietale ose tepore, ku gjenden qendrat e perceptimeve pamore dhe ku bën pjesë edhe njohja e fytyrave të objekteve të perceptuara.

PSIK/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *ψυχή* "shpirt". Psika është tërësia e dukurive mendore, e proceseve psikike dhe e formave të shprehjes së tyre me anë të sjelljeve të njeriut dhe të kafshëve të rendit më të lartë. Psikës i atribuohet fuqia e kryerjes së funksioneve shpirtërore të që përbëjnë thelbin e jetës. Termi e ka burimin nga mitologjia greke, ku *Psika* ishte një vajzë shumë e bukur e dashuruar në Erosin, por psikologjia bashkëkohore i është larguar përdorimit të këtij termi për shkak të disa kuptimeve të ndryshme. Shih – ***SHPIRTI.***

PSIKANALIZA DHE VETËVRASJA. Zigmund Frojdi e ka shpjeguar vetëvrasjen si formë të ndikimit të shtytësit të agresionit ndaj vetes, të shtytësit të vdekjes në sjelljet e vetëdijshme ose të pavetëdijshme të njeriut. Sipas psikanalizës vetëvrasje kryen ai që paraprakisht ka synuar vrasjen e tjetrit. Për psikanalizën vetëvrasja shkaktohet nga rebelimi i dëshpërimit të fundit të egos ndaj sundimit të pamëshirshëm të super egos.

PSIKIATRIA BIOLOGJIKE. Psikiatria me qasje të veçantë të çrregullimeve dhe sëmundjeve psikike. Qasja e tillë ka të bëjë me trajtimin e çrregullimeve dhe të sëmundjeve psikike duke marrë për bazë anët biologjike e neurofiziologjike të tyre dhe duke u bazuar në përdorimin e barnave farmakologjike për shërimin e tyre.

PSIKIATRIA E KULTURËS. Psikiatria e kulturës është fushë e veçantë e psikiatrisë sociale. Psikiatria e kulturës studion raportin ndërmjet çrregullimeve psikike, sidomos ndërmjet frikës dhe ankthit, në varësi me normat e vlerat kulturore, ku është zhvilluar dhe është formuar personaliteti. Qasja kryesore e psikiatrisë së kulturës është marrja në konsideratë e historisë së klientit në hulumtimin e rrënjëve të çrregullimeve psikike që janë karakteristike për popullsinë e një mjedisi të caktuar social-kulturor.

PSIKIATRIA KRIMINALOGJIKE. Degë e posaçme e psikiatrisë, që merret me përcaktimin e shkallës së përgjegjësisë së atyre që kryejnë vepra kriminale.

PSIKIATRIA SOCIALE. Degë e psikiatrisë që thekson rolin kryesor të faktorëve shoqërorë apo socialë në lindjen dhe zhvillimin e sëmundjeve psikike, duke i konsideruar këta faktorë (familjen, kulturën e mjedisit social, shkollën etj.) shkaqe të rëndësishëm për të kuptuarit e etiologjisë së sëmundjeve psikike dhe të përhapjes së tyre.

PSIKIK/Ë, A f. Nga greqishtja psyche = shpirt. Psikika është term i konceptit përmbledhës për të gjitha llojet e përjetimeve mentale të integruara në organizmin e njeriut dhe të kafshëve dhe manifestimit të tyre me sjellje individuale. Në këtë term përmbledhës mund të hyjnë: proceset, gjendjet psikike, ndërlidhjet funksionale ndërmjet tyre, dallimet karakteristike të tyre te kafshët dhe njerëzit dhe realizimet e tyre në mjedisin ku gjenden dhe veprojnë njerëzit dhe kafshët. Psikika nuk ka përmasë hapësinore, por ka vetëm cilësi kohore. Përmbajtja e përmendur e psikikës mund të jetë e vetëdijshme – përjetim subjektiv i njeriut që vetvëzhgohet nga ai, sjellje e kontrolluar dhe e organizuar nga njeriu. Dukuritë e psikikës mund të jenë edhe të pavetëdijshme. Psikika është produkt i trupit organik të organizuar në nivelin më të lartë të zhvillimit të qenieve njerëzore e atyre të botës shtazore, sidomos atyre të rendit më të lartë me zhvillim të lartë të trurit dhe të cipës së trurit.

PSIKIK, - E. mb. Që ka të bëjë me psikikën: me aparatin psikik, me dukurit, proceset dhe funksionet e integruara, si edhe me shfaqjen e tyre me anë të sjelljeve, reagimeve, veprimeve ndaj objekteve e ngacmuesve të mjedisit të jashtëm, si edhe me sistemin psikik të njeriut – funksione e gjendje komplekse e të ndërlidhura ndërmjet tyre (uni – egoja, komplekset, karakteri, temperamenti, etj.). Psikike mund të cilësohen tipat e individëve me strukturë psikike të ngjashme për një kategori njerëzish, si edhe çrregullimet e proceseve e gjendjeve psikike të njeriut.

PSIKOLEKSIKOLOGJI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *psyche* "shpirt, psikikë", *λεξικό* "fjalor" dhe *lógos* "arsye, shkencë". Disiplinë e re shkencore që merret me studimin psikologjik të fjalëve e të termave dhe të kuptimit të tyre. Në thelb termi *psikoleksikologji* me domethënien e vet e ngre në nivel më të lartë rolin e perceptimit dhe të proceseve njohëse ose kognitive në përcaktimin e zbatueshmërisë së fjalëve dhe të termave gjatë të folurit dhe të shkruarit të tyre. Ky term i ka rrënjët e veta të hershme, por në literaturën e psikologjisë haset rrallë. Filloi të aktualizohet pas përdorimit të "gjuhës" kompjuterike. Për psikoleksikologji filloi të diskutohet për kuptimin e këtij termi pas viteve `70 të shekullit të njëzet, saktësisht pas vitit 1976 kur kanë filluar gjurmimet në përcaktimin e zbatueshmërisë së fjalëve dhe të kuptimit të tyre në gjuhën angleze. Por, termi psikoleksikologji ende nuk ka arritur të bëhet zëri i pandashëm i terminologjisë së psikologjisë bashkëkohore.

Burimet:

George A. Miller & Philip N. Johnson – Laird: "*Language and perception*" – ("*Gjuha dhe perceptimi*"), Cambridge, MA: Harvard University Press, 1976;
John Lyons: "*Semantics*" – ("*Semantika*"), Vol. I and II, Cambridge, MA: Cambridge University Press, 1977.

P

PSIKOLOGU SHKOLLOR. Psikolog profesionalist që merret me psikologjinë zbatuese në zgjidhjen e çështjeve të përshtatjes së nxënësve ndaj kërkesave edukative e arsimore të shkollës dhe si edhe me çështjet e përshtatjes së përmbajtjeve edukative e arsimore të shkollës, moshës, aftësive dhe nevojave të nxënësve. Psikologu i specializuar për çështjet e psikologjisë shkollore merret sidomos me: kontrollin e objektivitetit të matjes së arritjeve të nxënësve në zotërimin e përmbajtjeve mësimore, hartimin e dosjes për secilin nxënës, nxënësit me sjellje jo të rregullta, organizimin racional të veprimtarisë së gjithëmbarshme shkollore, orientimin profesional të nxënësve etj. Aktivitetin e tij e kryen në bashkëpunim me arsimtarët, me nxënësit, me prindërit e nxënësve, me mjekun e shkollës etj.

PSIKOLOGJI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *psyché* "psikika, shpirti" dhe *logos* "shkenca". Psikologjia është shkenca empirike, e cila merret me studimin sistematik të dukurive psikike të njerëzve dhe të kafshëve, të proceseve psikike dhe sjelljeve me tiparet individuale të tyre në bazë të studimit të veprimtarisë, të përvojës dhe të përjetimit të tyre nga ana e njeriut, duke përfshirë edhe lindjen e zhvillimin e tyre. Si e tillë, psikologjia duhet të japë përgjigje për tri pyetjet kryesore: Çfarë është procesi psikik dhe sjellja e caktuar? Si lind e manifestohet procesi psikik dhe sjellja e caktuar? dhe Përse është i tillë procesi psikik dhe sjellja? Shih – ***DETYRAT E PSIKOLOGJISË.*** Sipas strukturës së tij ky term u përdor në teologji dhe në filozofi sipas kuptimit më të vjetër: "Psikologjia është shkenca për shpirtin". Ndaj një përkufizimi të tillë reaguan disa nga mendimtarët, ndër të cilët u dalluan francezët, të cilët qysh nga fundi i shekullit të tetëmbëdhjetë ishin të mendimit se kur flitet për shpirtin, ky përcaktim mund të na shpjerë deri në qëndrimin që "duke folur për psikologjinë do të mendojmë se kjo merret me çështje të ndryshme metafizike, me të cilat psikologjia nuk ka të bëjë". Për këtë shkak këta e përkufizuan psikologjinë mbi bazën e dijeve për botën fizike dhe shpirtërore, të fituar drejtpërdrejt nga perceptimi. Psikologjinë e përkufizuan "dije, që në njërën anë është dije e fizikës dhe, në anën tjetër, dije e psikologjisë". Vilhelm Vunti (Wilhelm Wundt, 1832 – 1920), themeluesi i psikologjisë empirike mbi bazat eksperimentale, e konsideroi psikologjinë si shkencë që merret me studimin e strukturës psikike të veprimtarisë shpirtërore të vetëdijshme, me elementet përbërës të saj" "shkenca mbi proceset dhe dukuritë e vetëdijshme". Vilhelm Vunti në librin e parë "*Bazat e psikologjisë fiziologjike*" – ("*Grunzüge der physiologischen Psychologie*") shkruan: "Librin që ua ofroj publikisht ka për qëllim të shfaqë një fushë të re të shkencës...". Filozofi dhe psikologu amerikan Uiliam Xhejms (William James, 1842 – 1910) e ka konsideruar psikologjinë si shkenca

që meret me funksionet psikike të aktivitetit njerëzor dhe është orvatur të përcaktojë strukturën e këtyre funksioneve. Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1939) e zgjeroi domethënien e psikologjisë, duke pohuar se "psikologjia studion jo vetëm proceset e vetëdijshme, por edhe ato të pavetëdijshme". Deri në mbarim të gjysmës së parë të shekullit të njëzet psikologjia u përkufizua si "shkenca mbi psikikën dhe proceset psikike", megjithëse qysh nga koha e psikologut gjerman Rubert Roraher (1903–1972) psikologjia u përkufizua "Shkenca mbi proceset jetësore subjektive në raport me ligjet objektive". Psikologu amerikan Robert S. Uduorth (Robert S. Woodworth, 1869 – 1862) e përkufizoi psikologjinë si "Shkenca që merret me studimin e aktivitetit të individit – individit si tërësi", ku termin *aktivitet* e konsideron "shprehje të përshtatshme, me të cilën përmblidhet përvoja dhe sjellja e individit". Xhon Uotsoni (John Watson, 1878 – 1958) e konsideron psikologjinë "Shkencë mbi sjelljet, që ka për detyrë të bëjë përshkrimin e thjeshtë të sjelljeve". Në *Fjalorin e Psikologjisë* të Oksfordit - "*Dictionary of Psychology*", të autorit Andrew M. Colman, botuar më 2003, psikologjia përkufizohet: "Studim i natyrës, funksioneve dhe dukurive të sjelljeve dhe të përvojës mendore". Në literaturën angleze të psikologjisë sot psikologjia i jep rëndësi parësore studimit të sjelljes, por të pandarë nga proceset njohëse. Këtë e dallojmë edhe në literaturën shkollore të psikologjisë, si, p,sh., në librin e Terry F. Petijohn "*Psikologjia – një hyrje koncizë*" thuhet: "Psikologjia është shkenca e sjelljes dhe e kognicionit". Secili nga përkufizimet e përmendura ka mangësitë e veta, madje disa nga këto përkufizime janë të njëanshme, duke e vështirësuar përcaktimin gjithëpërfshirës dhe me plot kuptim të psikologjisë.

Psikologjia është shkenca që merret me studimin e proceseve e tipareve psikike në procesin e lindjes, të zhvillimit dhe të manifestimit sjellor të tyre. Shih – ***HISTORIA E PSIKOLOGJISË.***

PSIKOLOGJIA ANALITIKE. Psikologjia që emërton dy kuptime të ndryshme: 1) Qasjen gjurmuese të proceseve psikike dhe të sjelljeve, ku mbizotëron zbërthimi i tyre në përbërës të procesit që gjurmohet apo të sjelljes së tillë; 2) Psikologji analitike quhet sistemi konceptual i psikologjisë psikanalitike dhe i mendimit psikologjik të psikologut zviceran Karl G. Jung (Carl G. Jung, 1875 – 1961). Psikologjia analitike i ka kushtuar kujdes të pakët shtytësit seksual dhe impulseve të tij në zhvillimin psikik të njeriut. Kjo është përqendruar për të pavetëdijshmen kolektive, së cilës i ka dhënë karakter të përgjithshëm, duke u marrë me gjurmimin dhe interpretimin e simboleve, të arketipave dhe strukturave të thella të pavetëdijes kolektive dhe të raportit të saj me pavetëdijen individuale.

PSIKOLOGJIA ASOCIACIONISTE. Një ndër shkollat psikologjike e zhvilluar mbi themelin e asociacionizmit, sipas të cilit proceset psikike dhe sjelljet janë lidhje e elementeve psikike të thjeshta ndërmjet tyre. Psikologjia asociacioniste përfshin psikologjinë strukturaliste të Vilhelm Vuntit (Wilhelm Wunt, 1832 - 1920) dhe të

Eduard B. Tiçenerit (Edward B. Titchener, 1867 – 1927). Sipas cilësisë tërësitë e ndërlikuara psikike formohen nga kombinimi i elementeve të thjeshta psikike të ndijimeve, të përfytyrimeve dhe të ndjenjave elementare, pikërisht të kënaqësisë dhe të pakënaqësisë. Psikologjia strukturaliste zbatoi metodën e vetvëzhgimit ose të introspeksionit klasik. Psikologjia asociacioniste përfshin në strukturën e saj edhe bihejviorizmin e Xhon B. Uotsonit (John B. Watson,1878 – 1958), të Frederik B. Skinerit (Frederick B. Skinner, 1904 – 1990) dhe të bihejvioristëve të tjerë. Këta bihejvioristë shpjeguan sjelljet dhe zhvillimin e tyre në bazë të lidhjeve ndërmjet ngacmuesit dhe reagimit të jashtëm të njohur më shumë me formulën S(timulus) – R(eagim) dhe më pas me formulën S(timulus) – O(rganizëm) – R(eagim).

PSIKOLOGJIA BIOLOGJIKE. Degë e sistemit të shkencave të psikologjisë, që merret me studimin e bazës organike e fiziologjike të proceseve psikike dhe të sjelljeve. Zhvillimi i proceseve psikike dhe i sjelljeve përgjithësisht është i lidhur ngushtësisht me strukturën, morfologjinë dhe funksionimin e sistemit nervor, të sistemit të shqisave dhe me sistemin e gjëndrave me sekrecion të brendshëm, si edhe me ndërlidhjet e tërësishme trupore të tyre. Mbi këtë bazë u zhvillua psikologjia biologjike, e cila sot është diferencuar në psikologjinë fiziologjike, në neuropsikologjinë, në endokrinopsikologjinë etj., që janë fusha të posaçme të psikologjisë biologjike. Në fillim të zhvillimit të psikologjisë biologjike psikologjia u konsiderua degë e biologjisë.

PSIKOLOGJIA E AKTEVE. Shih – ***AKT PSIKOLOGJIA.***

PSIKOLOGJIA E ORGANIZIMIT. Qasja studimore e organizmit në tërësinë e tij duke mos bërë ndarje në trup dhe psikikë. Sipas psikologjisë së organizmit psikologjia duhet afruar me hulumtimet e dukurive, të proceseve psikike e të sjelljeve të njeriut si organizëm unik. Objekti parësor i saj është: njeriu si entitet biologjik unik, hulumtimi i të cilit duhet bërë në mënyrë moniste. Qasje të tillë dallojmë në psikologjinë bihejvioriste dhe në psikologjinë geshtaltiste. Qasje moniste ka edhe modeli i psikologjisë së Kurt Levinit (Kurt Lewin, 1890 – 1947), modeli i Kurt Goldshtajnit (Kurt Goltstein, 1878 – 1965) etj., ku dallohet hedhja poshtë e dualizmit trup-shpirt, dhe dallohet pikërisht përparësia e gjurmimit të tërësisë ndaj gjurmimit të pjesëve të një tërësie.

PSIKOLOGJIA E PERSONALITETIT. Optimizmi është tipar relativisht i qëndrueshëm dhe karakteristikë e sjelljeve të personalitetit dhe e veprimeve të shoqëruara me besimin, bindjen dhe me synimin se çdo veprim i filluar do të përfundojë pozitivisht.

PSIKOLOGJIA E TËRËSISË. Term i konceptit psikologjik i njohur më tepër nga studimet teorike të dukurive e proceseve psikike, si edhe i jetës psikike nga ana e studiuesve gjermanë. Vetë termi ka ardhur nga gjermanishtja *ganzheitspsychologie*. Kjo do të ishte edhe qasje studimore e dukurive dhe e proceseve psikike, sipas së cilës elementet e veçanta psikike (ndijimet, mbajtja mend e një përmbajtjeje të mësuar,

përjetimi i diçkaje të hidhur etj.) mund të kuptohen vetëm në kuadrin e tërësisë së tyre. Psikologjia e tërësisë ishte reagim ndaj psikologjisë asociacioniste dhe asaj strukturaliste, që i shpjegonin dukuritë e proceset, si edhe aktet psikike si shumë kombinuese e ndijimeve, e përfytyrimeve dhe e ndjenjave. Në raport të kundërt me psikologjinë asociacioniste dhe strukturaliste është psikologjia geshtaltiste.

PSIKOLOGJIA EKOLOGJIKE. Disiplinë e re e sistemit të shkencave të psikologjisë, e cila merret me hulumtimin e rrënimit të baraspeshës të sjelljeve të njeriut dhe krizës ekologjike të sotme, që shkaktohet nga asgjësimi i të mirave natyrore, si edhe me hulumtimin e çështjeve psikologjike të mjediseve të urbanizuara dhe ndryshimit të sjelljeve të njeriut nga ndërveprimi individ-mjedis jetësor. Në literaturën e psikologjisë zakonisht merret rëndësia e konceptit sipas Kurt Levin (Kurt Lewin, 1890 – 1947). Shih – ***MJEDISI PSIKOLOGJIK***; ***HAPËSIRA JETËSORE*** Psikologjia ekologjike është term me të cilin emërtohet edhe teoria e Xhon Gibsonit, ku vend qendror ka zënë termi dhe koncepti. Shih – ***PERCEPTIMI I DREJTPËRDREJTË.*** Origjina e psikologjisë ekologjike është e lidhur me psikologun gjerman Vili Helpah (Willy Hellpach, 1877 – 1955), që u interesua për ndikimin e dukurive meteorologjike në psikikën e njeriut, posaçërisht në gjendjen apo humorin e tij. Ndërkaq, në kohët më të vonshme psikologjinë ekologjike e lidhin edhe me emrin e psikologut amerikan me origjinë hungareze Egon Brunsvik (Egon Brunswik, 1903 – 1955), i cili u mor me studimin e raporteve ndërmjet shenjave perceptuese të objekteve, të dukurive, e të proceseve dhe të perceptimit të saktë të tyre.

PSIKOLOGJIA EKSPERIMENTALE. Psikologjia, e cila sistemin e vet shkencor e mbështet kryesisht në rezultatet e metodës eksperimentale laboratorike. Psikologji eksperimentale u quajt psikologjia e shekullit të nëntëmbëdhjetë, e mbështetur në rezultatet e provave psikotike të Ernst Veberit (Ernst Weber, 1795 – 1878), të Gustav Fehnerit (Gustav Fechner, 1801 – 1887), të Herman von Helmholcit (Hermann von Helmholz, 1821 – 1894) etj. Termi psikologji eksperimentale tashmë përdoret me kuptim të gjerë, ku nuk hyjnë vetëm rezultatet e hulumtimeve eksperimentale laboratorike.

PSIKOLOGJIA EKZISTENCIALE. Psikologjia strukturaliste e E. Tiçener dhe e strukturalistëve të tjerë të fillimit të shekullit të njëzet, që ka për objekt studimi në radhë të parë përvojën dhe përpunimin e saj. Pikërisht, objekti i tillë përbën përmbajtjen e brendshme psikike të njeriut, e cila është e pamohueshme, sepse ekzistenca e njeriut mbështetet në përjetimet e tij. Përjetimet e njeriut janë objekt studimi dhe detyrë e psikologjisë. Për këtë qëllim psikologjia ekzistenciale duhet të shfrytëzojë metodën e vetvëzhgimit ose të introspeksionit, me anën e së cilës duhet të analizojë, të klasifikojë dhe të shpjegojë përmbajtjen e vetëdijes (emocionet apo ndjenjat, procesin e mendimit, motivet etj.).

PSIKOLOGJIA EKZISTENCIALISTE. Orientim i psikologjisë sipas të cilit psikologjia duhet të merret me qasje holistike dhe idiografike të

qenies psikologjike të njeriut, e jo me qasje studimore kuantitative që e lënë anash thelbin psikik të njeriut dhe të qenies së tij (identiteti i personalitetit, liria individuale, kuptimi i jetës nga ana e njeriut, shpresa, frika e njeriut etj.). Psikologjia ekzistencialiste përmendet në veprat e Ludvig Binvanger (Ludwig Binwanger, 1881 – 1966), të Medard Bos (Medard Boss, 1903 – 1980), të Erik From (Erich Fromm, 1900 – 1980) etj. Psikologjia ekzistencialiste duhet dalluar nga psikologjia ekzistenciale.

PSIKOLOGJIA EMPIRIKE. Psikologji që merret vetëm me fakte dhe të dhëna dhe me argumentimin konkret të tyre, psikologji që i paraprinë sistemeve dhe teorive. Psikologji e mbështetur në rend të parë në hulumtimin e fakteve dhe të të dhënave që vëzhgohen, mblidhen, renditen. Por, të vetvetishme nuk mund të qëndrojnë; këto duhet t`i nënshtrohen mendjes dhe proceseve mendore, këto klasifikohen dhe përpunohen sipas sistemit të metodave dhe procedurave hulumtuese të psikologjisë. Psikologjia empirike ka filluar të zhvillohet që nga viti 1879 nga ana e Vilhelm Vunt (Wilhelm Wundt, 1832 – 1920), duke u mbështetur në vëzhgimin e organizuar të fakteve e të dhënave sipas metodave dhe procedurave hulumtuese të dukurive e të proceseve psikike dhe të sjelljeve, si edhe duke zbatuar kryesisht metodën e induksionit gjatë procesit të përgjithësimit të tyre. Kuptimi i termit psikologji empirike ndryshon kur bëhet fjalë për psikologjinë e Franc Brentanos (Franz Brentano, 1838 – 1917), që ka të bëjë me hulumtimin e proceseve psikike, duke u bazuar në efektin e drejtpërdrejtë të tyre në aktivitetin e njeriut.

PSIKOLOGJIA FENOMENOLOGJIKE. Disiplinë e psikologjisë që studion përjetimet e njeriut, sjelljet e fituara mbi themelin e përvojës së tij, shkaqet, rrjedhën, mënyrën e organizimit dhe të shfaqjes së tyre në lidhje të ngushtë me përvojën e tij. Psikologjia fenomenologjike nuk merret me studimin e faktorëve biologjikë e socialë të zhvillimit të jetës psikike dhe të formave të shumëllojshme të saj, por vetëm me hulumtimin e përjetimit, me përshkrimin e qartë të një dukurie të caktuar.

PSIKOLOGJIA FETARE. Degë e psikologjisë zbatuese që merret me origjinën e fesë, me rolin e saj në zhvillimin e botëkuptimit, me ndjenjat, përvojën dhe me ritet fetare, e përgjithësisht me zhvillimet e besimit fetar.

PSIKOLOGJIA FILOZOFIKE. Sistem konceptesh klasike për shpirtin, origjinën e shpirtit, të arsyes, të raportit shpirt-trup, të vullnetit etj. Psikologjia filozofike është mbështetur në mendimin deduktiv dhe format e deduktimit të këtij mendimi mbi shpirtin, pavdekshmërinë e tij, mbi format e jetës shpirtërore dhe zhvillimin e tyre etj.

PSIKOLOGJIA FIZIOLOGJIKE. Degë e sistemit të disiplinave të psikologjisë, e cila merret me studimin e bazës fiziologjike të proceseve e sjelljeve psikologjike të organizmit, e saktësisht me hulumtimin e mekanizmave neutralë të proceseve dhe të sjelljeve. Psikologjia fiziologjike është e njohur edhe me emërtimin psikofiziologjia; në anglisht përdoret edhe termi psikobiologjia. Shih – ***FIZIOLOGJIA.***

PSIKOLOGJIA FORENZIKE (KRIMINALISTIKE). Disiplinë e psikologjisë zbatuese ose aplikative që merret me zbatimin e dijeve të psikologjisë në fushën e studimit të forenzikës, si vërtetësia e dëshmive të një dëshmitari ndaj krimit të të pandehurit, besueshmëria e dëshmive dhe e llojeve të ndryshme të tyre që jepen nga ana e dëshmitarëve, sidomos nga ana e atyre që quhen dëshmitarë okularë etj. Psikologjia forenzike merret edhe me hulumtimin e metodave hulumtuese të psikologjisë së marrjes së vendimeve gjyqësore, me kujtesën e faktorit njeri në aksidentet e ndryshme, me çështjen e qëndrueshmërisë emocionale të individit që ka kryer krimin, me synimet e kriminelëve etj. Ndihma e psikologëve forenzikë ndaj procesit objektiv të gjykimit u tregua e dobishme dhe e suksesshme.

PSIKOLOGJIA FUNKSIONALISTE. Psikologjia që merret me studimin e operacioneve mendore, të proceseve psikike dhe me studimin e sjelljeve në orvatjet e organizmit për t`iu përshtatur kërkesave të mjedisit fizik, biologjik e shoqëror. Përfaqësuesit më të njohur të psikologjisë funksionaliste janë: Xhon Dju (John Dewey, 1859 – 1952), Xhejms Uliam (James William, 1842 – 1910), Xhejms Enxhëll (James Angell, 1869 – 1949), Xhorxh Mid (George Mead, 1863 – 1931, Eduard Torndajk (Edward Thorndike, 1874 – 1949), Robert Uduorth (Robert Woodvorth, 1869 – 1962) etj. Sipas tyre të gjitha aktet psikike kanë vlera adaptuese; edhe sikur të mos kishte qenë roli i tillë funksional do të mjaftonin instinktet dhe shprehitë për t'u gjendur me sukses në mjedisin e caktuar.

PSIKOLOGJIA FUQIMORE. Doktrinë e psikologjisë, sipas së cilës psikika e njeriut përbëhet nga fuqitë shpirtërore të veçanta prej të cilave buron veprimtaria e caktuar psikike. Psikologjia fuqimore kishte për detyrë të studionte fuqinë e mendjes, të intelektit, të arsyes, të vullnetit dhe t`i shpjegonte proceset psikike me disa fuqi ose, siç është quajtur atëherë, me disa fakultete (fuqi) psikike, të pavarura (latinisht *facultas* "fuqi"), shih – ***FAKULTETET PSIKIKE***. Këto fuqi a fakultete me zhvillimin e tyre bënë që individi të kishte sukses në fushëveprimin e tij (matematikani të kishte sukses në fushën e zgjidhjes së problemave matematikore, sepse zotëronte fuqi psikike të matematikës, fuqi të cilën e kishte ushtruar. Individi që ka kujtesë të fuqishme mban mend, riprodhon dhe i percepton njësoj datat historike, vargjet e poezisë, formulat kimike etj.). Hasan Tahsini ishte ithtar i psikologjisë fuqimore, i psikologjisë së fakulteteve.

PSIKOLOGJIA GESHTALTISTE. Drejtim psikologjik dhe shkollë e psikologjisë që për pikënisje thelbësore të trajtimit të dukurive, proceseve, sjelljeve etj. psikike ka tërësinë, që është diçka më shumë se shuma e elementeve përbërës të saj; tërësia përcakton kuptimin dhe rëndësinë e elementeve të saj. Një melodi mund të luhet me instrumente muzikore të ndryshme, por tërësia e saj nuk ndryshon; reagimi i një individi ndaj një situate është reagim ndaj tërësisë së asaj situate e jo ndaj një ose disa elementeve të saj; të mësuarit është riorganizim i gjithë përvojës së tërësishme të njeriut etj. Koncepti themelor i psikologjisë

geshtaltiste është përputhshmëria e proceseve neurofiziologjike me përvojën psikologjike të njeriut, përkatësisht përvoja e njeriut organizohet sikurse proceset nervore në trurin e njeriut. Shih – ***PARIMI I IZOMORFIZMIT.*** Themelues të këtij drejtimi psikologjik janë psikologët: Kristian fon Erenfels (Christian von Erenfels, (1859 – 1916), Kurt Kofka (Kurt Koffka, 1886 – 1941), Volfgang Koler (Wolgang Kohler, 1887 – 1967), Maks Vertaimer (Max Wertheimer, 1880 – 1043), Kurt Levin (Kurt Lewin, 1890 – 1947), kurse në Shtetet e Bashkuara të Amerikës u dallua neurologu dhe psikiatri me origjinë gjermane Kurt Goldshtajn (Kurt Goldshtein, 1878 – 1965), i cili mbështeti teorinë holistike të organizmit të njeriut. Rrënjët e vërteta të qasjes së tërësisë si cilësi e posaçme i hasim më herët te mendimtarët: poeti gjerman Johan V. Gëte (Johann W. von Goethe, 1749 – 1832), dhe filozofi dhe psikologu gjerman Ernst Mah (Ernst Mach, 1838 – 1916). Për këtë shkollë psikologjike lëndë e psikologjisë janë dukuritë, proceset dhe veprimet psikologjike të tërësishme që mbështeten në fakte objektive dhe subjektive. Parimet e qasjes së hulumtimit të lëndës së psikologjisë janë: parimi holistik dhe molar. Metodat e parapëlqyera hulumtuese të tërësisë së proceseve dhe veprimeve psikologjike janë: metoda fenomenologjike, metoda e eksperimentit, vëzhgimi i drejtpërdrejtë i përjetimit dhe përshkrimi i saktë i tyre. Sipas këtyre parimeve dhe metodave hulumtuese shkolla geshtaltiste me gjithë programin e saj lindi dhe u zhvillua si drejtim i kundërt i psikologjisë strukturaliste të Vilhelm M. Vuntit (Wilhelm M. Wundt, !832 – 1920) dhe Eduard Tiçener (Edward B. Titchener, 1867 – 1927). Ky drejtim geshtaltist në gjuhën shqipe është përmendur në shkrime të pakta, kryesisht në tekste shkollore.

PSIKOLOGJIA GJENETIKE. Term i qëndrueshëm i psikologjisë zhvillimore, e cila merret me studimin e zhvillimit të jetës psikike dhe të formave të saj, si edhe me studimin krahasues të dukurive, të proceseve dhe të sjelljeve. Shih – ***PSIKOLOGJIA ZHVILLIMORE.***

PSIKOLOGJIA HORMIKE. Rrymë psikologjike që është marrë me përshkrimin dhe, më tepër me shpjegimin e veprimeve të shkaktuara nga nevojat biologjike të organizmit të njeriut. Sipas kësaj rryme instiktet janë baza motivuese e veprimtarisë së njeriut, e drejtuar në një objektiv të caktuar. Instiktet përbëjnë konceptin kryesor dhe shtyllën e gjithë psikologjisë hormike. Proceset kognitive (perceptimi, kujtesa, mendimi e të folurit) janë procese dytësore dhe të varura nga nevojat biologjike të natyrës instiktive. Themelues i kësaj rryme psikologjike ka qenë antropologu dhe psikologu anglez, Uiliam MekDugal (William McDougal, 1871 – 1939), kundërshtar i madh i bihejviorizmit dhe një ndër themeluesit e psikologjisë sociale. Pamundësia e përcaktimit të saktë të kuptimit të termit instinkt dhe mospërcaktimi i saktë i numrit të instinkteve kanë shkaktuar dyshime të mëdha në vlerën shkencore të kësaj rryme. Megjithëkëtë, psikanaliza, psikodinamika dhe psikologjia humaniste ka gjasë të jenë frymëzuar nga pikëpamja e psikologjisë hormike.

PSIKOLOGJIA HUMANISTE. Fuqia e tretë psikologjike pas psikanalizës dhe bihejviorizmit, që u zhvillua në lëvizjen dhe drejtimin psikologjik nga vitet `60 të shekullit të njëzet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Themelues i kësaj lëvizjeje dhe rryme psikologjike ka qenë Abraham Maslou (Abraham Maslow, 1908 – 1970), kurse përfaqësuesit më eminentë të saj ishin: Karl Roxhers (Carl Rogers, 1902 – 1987), Erik From (Erich Fromm, 1900 – 1980), Gordon Olport (Gordon Allport, 1897 – 1967), Sharlot Byler (Charllotte Buhler, 1893 – 1974) etj. Pikëpamja e psikologjisë humaniste është: njeriu duhet qasur si qenie kreative, përgjegjëse për fatin e zhvillimit të tij, sepse njeriu ka të tillë fuqi njerëzore që me veprimtarinë e tij mund t`i zhvillojë këto fuqi potenciale; ai ka nevojë për vetaktualizim. Secilit i duhet mundësuar zhvillimi i fuqive potenciale psikologjike, karakteristike për gjininë njerëzore. Detyra e psikologjisë nuk është shpjegimi i natyrës së shtytësve (i energjisë, i shmangieve të zhvillimit të shtytësve etj.) siç vepron psikanaliza dhe as shpjegimi i aktivitetit të tij sipas formulës S – R, siç vepron bihejviorizmi, por studimi dhe realizimi i kushteve dhe i raporteve që çojnë në vetaktualizim. Njeriu lind me natyrë njerëzore të mirë ose neutrale, metodat e hulumtimit të tij duhet të drejtohen në gjurmimin e vlerave, idealeve, të identitetit, të lirisë njerëzore, të vetaktualizimit të tij. Njeriu dhe studimi për të duhet parë nga këndvështrimi holistik, duke u përqendruar në nevojat, interesat e dëshirat aktuale të tij, si edhe në plotësimin e tyre.

PSIKOLOGJIA INDIVIDUALE. Psikologjia e dallimeve individuale ose psikologjia diferenciale në fillim të përdorimit të këtij termi, që u zhvillua nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë e fillimi i shekullit të njëzet nga ana e psikologut gjerman Vilhelm L. Shtern (Wilhelm Stern, 1871 – 1982). Sot, termi psikologjia individuale, emërton psikologjinë e psikiatrit austriak Alfred Adler (Alfred Adler, 1870 – 1937). Konceptet kryesore të psikologjisë individuale të A. Adlerit janë: synimi për mbisundim apo superioritet, ndjenja e inferioritetit, dhe zotërimi i saj, stili i jetës së individit, kompensimi dhe interesi shoqëror për zhvillimin e tij. Sipas psikologjisë individuale të Alfred Adlerit jeta e njeriut është një proces i qëllimshëm. Njeriu duke u mbështetur në strukturën psikike të tij përpiqet ta realizojë synimin karakteristik të tij - synimin për mbisundim dhe fitimin e rëndësisë shoqërore të tij. Gjatë realizimit të këtij synimi njeriut i paraqiten herë pas here pengesa të shumëllojshme, duke shkaktuar te ai zhvillimin e një ndjenje me vlerë më të ulët, pra të ndjenjës së inferioritetit. Këto pengesa përforcojnë përpjekjet për kompensimin e mungesave të tij. Synimi për kompensimin e të metave shkakton zhvillimin e strategjisë së jetës dhe zhvillimin e mëtejshëm të saj. Strategjia e këtillë mund të jetë pozitive, siç janë: përkushtimi ndaj artit, edukatës, shkencës, teknikës etj., por mund të jetë edhe negative, si: inati, mania e madhësisë, tërheqja në vetvete etj. Në gjuhën shqipe janë përkthyer këto vepra të A. Adlerit: "*Ç`kuptim mund të ketë jeta*", 2003; "*Shkenca e të jetuarit*", 2009; "*Të kuptosh natyrën e*

njeriut", 2010 dhe "*Psikologjia individuale – Praktika dhe teoria*", 2011.

PSIKOLOGJIA KOGNITIVE. Degë e psikologjisë që emërton qasjen e përgjithshme të psikologjisë, që është e drejtuar në hulumtimin e proceseve kognitive për t`i kuptuar dhe shpjeguar të gjitha proceset psikike, si edhe sjelljet e njeriut. Psikologjia kognitive deri nga gjysma e dytë e shekullit njëzet është konsideruar më shumë drejtim psikologjik, ku theksohet rëndësia e njohjes së strukturave dhe funksioneve psikike për shpjegimin e të gjitha llojeve të sjelljeve të njeriut. Kjo degë e psikologjisë lindi si reagim ndaj psikologjisë bihejvioriste. Psikologjia kognitive, në kundërshtim me psikologjinë bihejvioriste, kërkon shpjegimin e sjelljeve të njeriut, duke marrë në konsideratë rolin e proceseve njohëse, e pikërisht duke kërkuar identifikimin e shkaqeve të sjelljeve të caktuara, ku përfshihen edhe proceset emocionale, motivuese dhe çrregullimet e sjelljeve të njeriut.

PSIKOLOGJIA KOMUNALE. Fushë bashkëkohore e psikologjisë zbatuese, që merret me marrjen e atyre masave sociale dhe psikologjike që ndihmojnë zgjidhjen e çështjeve problemore të individëve të bashkësisë komunale, përshtatjen e tyre ndaj kërkesave të atij mjedisi dhe mbajtjen e tyre në mjedisin e caktuar komunal, përkatësisht mos largimin e tyre nga mjedisi, për shkak të situatave problemore sociale, ekonomike dhe psiko-sociale. Psikologjia komunale ka lidhje të ngushtë sidomos me psikologjinë klinike. Në mjediset shqiptare ende nuk është zhvilluar.

PSIKOLOGJIA KRAHASUESE. Degë e sistemit të disiplinave psikologjike, e cila studion sjelljet e llojeve të ndryshme të kafshëve, me qëllim të krahasimit të tyre, duke synuar identifikimin e ngjashmërive dhe të dallimeve ndërmjet tyre. Psikologjia krahasuese shfrytëzon rezultatet e hulumtimeve biologjike, etiologjike, , gjenetike, fiziologjike, të evolucionit të botës shtazore etj. Kjo disiplinë mbështetet sidomos në ngjashmërinë dhe dallimet e procesit të të mësuarit nga ana e llojeve dhe e niveleve të ndryshme zhvillimore të botës së kafshëve. Në literaturën e psikologjisë hasim në zgjerimin e kuptimit të termit psikologji komparative ose krahasuese, sepse kjo disiplinë merret edhe me krahasimin e sjelljeve të njerëzve të mjediseve kulturore dhe historike të ndryshme.

PSIKOLOGJIA KRIMINALOGJIKE. Shkenca që merret me studimin sistematik të motiveve, të aftësive dhe të tipareve individuale të kriminelëve. Psikologjia kriminalogjike merret me studimin e çështjeve themelore të tilla, si: besueshmëria e llojeve të ndryshme të argumenteve për sjelljet, situatën dhe për rrethanat e kryerjes së krimeve, besueshmëria e atyre që argumentojnë në procesin e gjykimit të bartësve të krimeve, psikologjia e marrjes së vendimeve etj. Në literaturën e psikologjisë bëhen dallime në kuptimin e termave. Shih – ***PSIKOLOGJIA FORENZIKE; PSIKOLOGJIA JURIDIKE.***

PSIKOLOGJIA KULTURORE. Degë aplikative e psikologjisë që merret me studimin e zbatimit të metodave, të njohurive dhe të rezultateve

psikologjike në lëmi të ndryshme të kulturës, lidhshmërinë ndërmjet akteve e krijimeve kulturore dhe sjelljeve të njeriut, si edhe varësinë e dukurive kulturore nga proceset psikike dhe sjelljet e njeriut. Psikologjia e kulturës filloi të zhvillohet nën ndikimin e pikëpamjeve të psikologut gjerman Georg Kershenshtajner (Georg Kerschenschtajner, 1854 – 1932) dhe të filozofit e psikologut gjerman Vilhelm Diltaj (Wilhelm Dilthey, 1833 – 1911). Sipas pikëpamjeve të këtyre mendimtarëve të kuptuarit dhe interpretimi i të mirave kulturore përbën bazën metodologjike të njohjeve dhe të shfaqjeve shpirtërore të njeriut.

PSIKOLOGJIA MATEMATIKE. Orvatje e reduktimit të lëndës së psikologjisë vetëm në kuadrin e matjeve numerike të ndryshoreve psikologjike dhe të veprimit me numra, si edhe me relacionet e numrave. Disa nga ndryshoret psikologjike kanë mundësi të hyjnë në qarkun e psikologjisë matematike (në psikofizikë, në përpunimin e informacioneve të kujtesës, në teorinë e të mësuarit etj.) dhe hipotezat e teoritë e tyre të verifikohen matematikisht, por jo dhe ndryshoret në psikologjinë sociale, klinike, në psikologjinë e personalitetit etj. Shih – ***PSIKOMETRIA.***

PSIKOLOGJIA MOLEKULARE. Qasja studimore e njësive elementare të dukurive e proceseve psikologjike, si edhe elementet e sjelljeve të njeriut dhe të aktivitetit të kafshëve. Një qasje e tillë ka filluar me psikologjinë strukturaliste të Eduard B. Tiçener (Edward B. Titchener, 1867 – 1927) dhe ka marrë formën e vet karakteristike në studimet e Xhon Uatsonit (John B. Watson, 1878 – 1958), të Burhus F. Skinerit (Burhus. F. Skinner, 1904 – 1990), Klark L. Halit (Clark L. Hal, 1884 – 1952). etj. Qasja molekulare siguron përshkrim më të hollësishëm dhe shpjegim objektiv, por nëse nuk humb kuptimi i përgjithshëm i akteve psikologjike.

PSIKOLOGJIA NDËRPERSONALE. Degëzim i psikologjisë humaniste, rrënjët e së cilës burojnë që nga religjionet e lindjes. Kjo psikologji ka si lëndë studimi përvojën transshedentale të lidhur me termat e koncepteve mistike, me gjendjen e ndërmjetme të njeriut, me format psikike të ngjashme me format e pavetëdijshme etj. Themelues i këtij degëzimi të psikologjisë humaniste është Abraham Maslou (Abraham Maslow, 1908 – 1970) dhe bashkëpunëtorë të tjerë.

PSIKOLOGJIA NË STRUKTURËN E DISIPLINAVE SHKENCORE. Psikologjia zakonisht renditet në grupin e shkencave shoqërore, sepse ka një sistem koherent dhe të qëndrueshëm të koncepteve dhe ndërlidhjeve të tyre për proceset e gjendjet psikike, për sjelljet dhe karakteristikat individuale të tyre, tashmë të verifikuara dhe të kumtuara me gjuhën shkencore të saj. Megjithëkëtë, ka qëndrime sipas të cilave psikologjia shtrihet vertikalisht dhe horizontalisht ndërmjet disiplinave të shkencave natyrore (biologjia, fiziologjia, fizika etj.) dhe atyre të shkencave shoqërore (antropologjia, drejtësia, sociologjia etj., (shtrirja horizontale) dhe filozofisë (logjikës, etikës, estetikës) dhe disiplinave të shkencave zbatuese ose aplikative (shkencave mjekësore dhe teknike). Psikologjia sociale bën pjesë në grupin e

shkencave sociale, psikologjia fiziologjike bën pjesë në grupin e shkencave natyrore, psikologjia klinike zë vend të posaçëm në grupin e disiplinave zbatuese etj. Qëndrimi për këtë pozicion karakteristik të psikologjisë shpjegohet me faktin se psikologjia merr nga këto disiplina të ndryshme shkencore dhe u jep këtyre fakte, koncepte e ndërlidhje logjike në formë përgjithësimesh të ndryshme (rregullash, ligjesh, teoremash, teorish etj.).

PSIKOLOGJIA OBJEKTIVE. Drejtim psikologjik ose shkollë psikologjike, që për objekt studimi ka shfaqjen e jashtme të gjendjes, të dukurive, të proceseve psikike, që i nënshtrohen vëzhgimit, matjes, vlerësimit dhe regjistrimit të tyre nga ana e të tjerëve. Në psikologjinë objektive legjitime janë vetëm ato shkolla dhe drejtime që u qasen hulumtimeve të dukurive, proceseve, strukturave dhe funksioneve të tyre me metodën e vëzhgimit dhe me format e ndryshme të kësaj metode, duke i zbatuar këto në kushte dhe rrethana fizike dhe duke përjashtuar të gjitha të dhënat e përftuara me anë të vetvëzhgimit, të tilla si: refleksologjizmi, bihejviorizmi, neobihejviorizmi etj. Në këto shkolla dhe drejtime lëvizjet, reflekset dhe sjelljet përcaktohen saktësisht nga këndvështrimi i cilësisë, i zgjatjes kohore, i shkallës së intensitetit etj. dhe emërtohen kryesisht me terma të disiplinave të biologjisë, të fizikës, të fiziologjisë, por shpesh edhe të psikiatrisë.

PSIKOLOGJIA ORGANIZATIVE. Term që emërton psikologjinë industriale duke zgjeruar kuptimin e saj me gjurmimin e strukturës dhe të organizatës së punës. Psikologjia organizative merret me studimin e sjelljeve të punëtorit të një organizate industriale, ku veprojnë grupet punuese me strukturë, me drejtim dhe me dinamizëm hierarkik të posaçëm. Ajo merret edhe me gjurmimin e përshtatjes së kulturës së punës të organizatës punuese dhe kërkesave bashkëkohore të zhvillimit të degëve të ndryshme të industrisë. Për këto arsye psikologjia organizative studion dhe çështjen e qëndrimeve e të vlerave dhe ndryshimin e tyre te punëtorët, si edhe merret me organizimin e formave të ndryshme të zhvillimit arsimor të punëtorëve.

PSIKOLOGJIA PEDAGOGJIKE. Njëra ndër disiplinat zbatuese të psikologjisë, që, në kuptimin e gjerë të termit merret me studimin e aspekteve psikologjike të edukatës dhe të arsimit. Në kuptimin e ngushtë psikologjia pedagogjike merret me studimin e natyrës së njeriut dhe me ndryshimin progresiv të tij, përkatësisht me ndryshimin e qëndrueshëm dhe progresiv të sjelljeve dhe të veprimtarisë së njeriut nën ndikimin sistematik të procesit të të mësuarit. Detyrat kryesore të psikologjisë pedagogjike janë: njohja e proceseve, e vetive, e tipareve dhe e përmasave zhvillimore të tyre, si edhe ndryshimi paravajtës dhe i qëndrueshëm i tyre nën ndikimin që ushtron procesi sistematik i të mësuarit, si edhe ndikimi i faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm në zhvillimin e personalitetit. Nga këto detyra psikologjia pedagogjike "nxjerr parime psikologjike të nevojshme për studimin e problematikës së edukatës". Strukturën bazë të psikologjisë pedagogjike e përbëjnë: zbatimi racional i parimeve dhe i metodave të të mësuarit në përgjithësi, të

mësuarit dhe të nxënit e përmbajtjeve të lëndëve shkollore, zhvillimi i programeve shkollore (kurrikulave), proceset e socializimit dhe integrimi i tyre në sistemin e integruar funksional të proceseve njohëse apo kognitive, përsosjen e procesit të mësimdhënies dhe trajnimin e arsimtarëve etj. Në shqip psikologjia pedagogjike është emërtuar me termin psikologji edukuese.

Burimet:

Robert Stammers & John Patrick: *"The Psychology of training"* – (*"Psikologjia e trajnimit"*), Methuen, London 1975.

Bardhyl Musai: *"Psikologji edukimi"*, Tiranë, 1999.

Alfred Lorenzer: *"Zur Begrundung einer Materialistischen Sozialisationstheorie"* – (*"Bazat e teorisë së socializimit materialist"*), London, 1972.

Borislav Stevanović: *"Pedagoška psihologija"*– (*"Psikologjia pedagogjike"*), Beograd, 1968.

James Deese & Stewart H. Hulse: "*The Psychology of Learning"* – (*"Psikologjia e të mësuarit"*), Third Edition, International Student Edition, McGRAW – HILL BOOK COMPANY, 1967.

PSIKOLOGJIA PENOLOGJIKE. Degë e psikologjisë zbatuese që merret me studimin e ndikimit të masave edukuese dhe përmirësuese të atyre, që më parë, kanë kryer akte sjelljesh të dëmshme për mjedisin shoqëror dhe për zhvillimin e tij. Psikologjia penologjike merret posaçërisht me tiparet e personalitetit penologjik dhe me studimin e ndikimit të masave psikologjike, sociale dhe pedagogjike në risocializimin e delikuentëve. Sot konsiderohet se psikologjia penologjike është degë e psikologjisë forenzike.

PSIKOLOGJIA PERSONALISTIKE. Orientim psikologjik, sipas të cilit parimet e psikologjisë së përgjithshme dhe të zhvillimit të saj kanë kuptim vetëm në qoftë se këto parime nxirren nga jeta personale e njeriut dhe përvoja konkrete e tij. Parimet e ligjet e përgjithshme të dukurive e proceseve psikike të ndara nga vetë bartësi i tyre, e pikërisht nga personaliteti nuk mund të kenë kuptim të rëndësishëm për mendimin shkencor të psikologjisë. Lënda e psikologjisë personalistike është njohja e objektivave jetësore të njeriut, e synimeve, e botëkuptimit etj. të tij, por jo edhe njohja e parimeve dhe e ligjeve për kujtesën, mendimin, emocionet etj., nëse këta nuk janë të izoluar, por këta duhen trajtuar në lidhje të drejtpërdrejtë me njeriun konkret dhe me përvojën e tij. Kurrfarë sjellje e personalitetit dhe asnjë dukuri dhe proces psikik nuk mund të kuptohen, po qe se nuk merret në konsideratë personaliteti si tërësi e organizuar dhe e qëndrueshme.

PSIKOLOGJIA RACIONALE. Psikologji e mbështetur në mendimin racional, që ka të bëjë me psikologjinë e mbështetur në metafizikë dhe e dalë nga racionalizmi në filozofi. Psikologjia racionale shfrytëzon të dhënat e përftuara nga vetvëzhgimi, por këto i shtie në përdorim në kuadrin e mendimit deduktiv dhe të shprehjeve filozofike. Psikologjia racionale i kundërvihet psikologjisë empirike me përmbajtjen e saj, sidomos me metodën e mbledhjes dhe të përpunimit të të dhënave. Për psikologjinë racionaliste çështja kryesore është studimi i thelbit të shpirtit.

PSIKOLOGJIA S – R. Psikologjia që ka për qëllim të vetëm studimor njohjen e lidhjes ndërmjet ngacmuesve dhe reagimeve dhe raporteve funksionale ndërmjet tyre, raporte, të

cilat i konsiderojnë në themel të sjelljeve, me studimin e të cilave duhet të merret psikologjia. Qasja e studimeve psikologjike në bazë të formulës S(timul) – R(eagim) i atribuohet psikologjisë bihejvioriste të tipit të Xhon B. Uotsonit (John B. Watson, 1878 – 1958). Edhe vet neobihejvioristët e tipit të psikologëve Eduard K. Tolman (Edward Ch. Tolman, 1886 – 1996), Klark L. Hol (Clark L. Hull, 1884 – 1952) etj. kanë bërë ndryshime në këtë qasje të psikologjisë klasike.

PSIKOLOGJIA – SHKENCË EMPIRIKE-EKSPERIMENTALE. Tërësi koherente e sistemit të koncepteve psikologjike dhe e ndërlidhjeve ndërmjet tyre, në formën e teorive mbi proceset psikike dhe mbi sjelljet e njeriut dhe të veprimeve të kafshëve, si edhe mbi gjenezën ontogjenetike dhe filogjenetike të tyre. Ky sistem konceptesh psikologjike e ndërlidhjesh midis tyre ka unitet hulumtues të argumentuar dhe shprehje terminologjike të veçanta. Është fryt i aktivitetit gjurmues eksperimental dhe rezultatet e përftuara nga organizimi metodik i gjurmimit të tyre janë sistematizuar e kumtuar dhe, si të tilla, mund të verifikohen dhe të publikohen në vepra dhe revista shkencore të psikologjisë. Korrigjimet, plotësimet dhe zbulimet e reja të proceseve psikike dhe të sjelljeve janë tipare të përhershme të aktivitetit shkencor individual, kolektiv dhe të institucioneve shkencore të psikologjisë. Psikologjia empirike u zhvillua mbi arritjet e disa disiplinave të shkencave natyrore dhe të metodës eksperimentale, si edhe mbi përsiatjet teorike për jetën dhe dukuritë psikike. Shih – ***HISTORIA E PSIKOLOGJISË.***

Burimet:

Aleksandër Kocani: *"Historia e shkencave",* Tiranë, 1998.

Maurice Reuchlin: *"Historia e psikologjisë",* Tiranë, 1999.

Detlev von Uslar: *"Psychologie und Welt"* – (*"Psikologjia dhe bota"*), Stuttgart, Berlin, Koln, Mainz, 1972.

John M. Darley & Sam Glucksberg & Ronald A. Kinchla: *"Psicologia 1"* – (*"Psikologjia 1"*), Bologna, Italia, 1993 (fq. 13 – 50).

Spencer A. Rathus: *"Essentials of Psychology"* – (*"Themelet e psikologjisë"*), 1997, fq. 1 – 26.

Erion Kristo: *"Arti i ri i të menduarit – Psikologjia dhe metodologjia e studimit",* Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 2004, fq. 135 – 162.

*"ALBANIA – Kopshta e shkencës", v*ëll. A, I (mars 1897 – prill 1898, fq. A. 153).

PSIKOLOGJIA SOCIALE. Njëra nga disiplinat fondamentale të psikologjisë bashkëkohore, që merret me studimin e sjelljeve të njeriut në kuadrin e rrjedhave shoqërore dhe të ndërveprimit të njeriut me mjedisin shoqëror të tij. Kjo disiplinë merret edhe me njohjen e natyrës dhe të shkaqeve të mendimeve, të ndjenjave dhe të sjelljeve të individit në situatat shoqërore. Psikologu amerikan Gordon V. Olport (Gordon W. Allport, 1897 – 1967) e ka përkufizuar në këtë mënyrë lëndën e psikologjisë sociale: "Të kuptuarit dhe shpjegimi i ndikimit të vërtetë të pranisë së përfytyrimit të një individi tjetër ose informacionit për të në mendimin, në emocionet dhe në sjelljet e individit". Çështjet më të rëndësishme studimore të psikologjisë sociale janë: ndërveprimi social, perceptimi social, qëndrimet, socializimi etj. U zhvillua në raport me zhvillimin e disa degëve të psikologjisë (të psikologjisë së përgjithshme, zhvillimore, klinike etj.)

dhe të antropologjisë kulturore, të kulturologjisë, të sociologjisë, të shkencave politike etj. Shfrytëzon metodat dhe procedurat e posaçme gjurmuese, si: vëzhgimin e kontrolluar të sjelljeve, të grupeve shoqërore në terren, metodën e eksperimentit, e pjesërisht, anketën, testin sociometrik etj.

PSIKOLOGJIA SPEKULATIVE. Emërtim i psikologjisë klasike joshkencore, si pjesë e metafizikës, që si lëndë studimore ka pasur pavdekshmërinë e shpirtit dhe cilësitë e këtij shpirti! Nuk ka të bëjë as me njohjen ndijimore apo shqisore, as me një përvojë të tillë, sepse nuk mbështetet në të dhënat, në faktet shkencore, por me ato jashtë shqisave. Ka zbatuar metodat e deduktimit hipotetik në konceptin teorik të origjinës së arsyes, të shpirtit, të vullnetit, sidomos për shpjegimin e marrëdhënieve trup – shpirt etj.

PSIKOLOGJIA STRUKTURALISTE. Psikologjia e Vilhelm Vuntit dhe Eduard Tiçenerit. Ky i fundit botoi regjistrin prej 44.000 elementesh psikike që shkaktoi protestë e përplasje të mëdha, duke i dhënë shkas tejkalimit të thjeshtësisë në përfilljen e proceseve psikike. Thjeshtësimi dhe programi i ngushtë i psikologjisë strukturaliste bënë që kjo psikologji të ketë statusin e historisë së psikologjisë. U zhduk nga skena e psikologjisë qysh nga viti 1927. Shih – ***STRUKTURALIZMI.***

PSIKOLOGJIA SUBJEKTIVISTE. Pikëpamje e të gjitha drejtimeve dhe shkollave psikologjike që theksojnë rëndësinë e madhe të botës psikike të brendshme të njeriut dhe përjetimeve e formave të ndryshme të tyre. Karakteristikë e përbashkët e këtyre pikëpamjeve është që, sjelljet e jashtme të njeriut janë të pamjaftueshme për të njohur e kuptuar proceset psikike, format dhe funksionet e proceseve kognitive, emocionale dhe motivuese. Psikologjisë subjektive i përkasin shkolla humaniste, introspektive, psikanalitike, strukturaliste etj.

PSIKOLOGJIA SHËNDETËSORE. Degë relativisht e re e sistemit të shkencave të psikologjisë që merret me gjurmimin e aspekteve psiko-sociale të shëndetit dhe të sëmundjeve të njeriut, si edhe me raportin ndërmjet tyre. Zbaton metodat, procedurat dhe teknikat psikoterapeutike të psikologjisë, duke i mbështetur këto në humanizimin e raporteve ndërmjet të sëmurit dhe personelit mjekësor dhe shërues. Fushat më të rëndësishme studiuese të psikologjisë shëndetësore janë: gjurmimi i ndikimit të përjetimeve stresante në shëndetin mendor dhe rrjedha dhe zhvillimi i proceseve psikike, të lidhura me përjetimin e gjendjes stresante, të ankthit, të frikës, të çrregullimeve psikosomatike etj.

PSIKOLOGJIA SHKOLLORE. Nëndegë e psikologjisë pedagogjike ose edukuese që merret me gjurmimin e aspekteve të procesit edukativ e arsimor në shkollë. Ka karakterin e psikologjisë zbatuese dhe kontribuon në zbatimin e rregullave dhe të parimeve të psikologjisë së aftësive, të motivacionit dhe të të mësuarit e kujtesës në zotërimin e përmbajtjeve të lëndëve mësimore nga ana e nxënësve dhe e studentëve duke u marrë edhe me çështjet e dokimologjisë etj.

Burimet:

Edwin G. Boring: *"A History of Experimental Psychology"* – (*"Historia e psikologjisë eksperimentale"*), Century, 1929.

John C. Flügel: *"A Hundred Years of Psychology, 1833 – 1933"* – (*"Njëqind vitet e psikologjisë, 1833 – 1933"*), Macmillan, 1933.
Robert S. Woodwoth: *"Contemporary Schools of Psychology"* – (*"Shkollat bashkëkohore të psikologjisë"*), Great Britain, 1965.
Gardenr Murphy: *"Historical Introduction to Modern Psychology"* – (*"Hyrje në historinë e psikologjisë bashkëkohore"*), Kondon, 1957. (*Pjesa e tretë: Sistemet psikologjike bashkëkohore* fq. 204 – 264).
Peter Senge & Nelda Cambron–McCabe & Timothy Lucas & Bryan Smith & Janis Dutton & Art Kleiner: *"Shkollat e të nxënit"*, Tiranë, 2006.
Erik H. Erikson: *"Childhood and Society"* – (*"Mituria dhe shoqëria"*), New York: Norton, 1963.
Howard Gardner: *"Developmental Psychology"* – (*"Psikologjia zhvillimore"*), *Boston: Little, Brown and Co., 1982.*
Žarko Korač: *"Škole i sistemi u Psihologiji"* – (*"Shkollat dhe sistemet në psikologji"*), Beograd, 2008.
Gillian Butler & Freda McManus: *"PSIKOLOGJIA – një hyrje e shkurtër"*, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, Tiranë, 2007.
Liljana Reçka: *"Psikologjia zhvillimore"*, Tiranë, 2005.
Pajazit Nushi: *"Të nxënit e lëndëve shkollore dhe zotërimi i tyre"*, Prishtinë, 1997.

PSIKOLOGJIA TEORIKE. Zhvillimi i atyre disiplinave bazë, që synojnë shpjegimet fondamentale të jetës, të dukurive e proceseve psikike dhe aspekteve të sjelljeve. Në këto disiplina bëhet fjalë më tepër për sistemin e koncepteve dhe të raporteve koherente ndërmjet tyre, që kanë të bëjnë me parimet, ligjet, teoritë dhe me sistemin e teorive për jetën, dukuritë, proceset psikike dhe sjelljet. Të këtilla janë: psikologjia e përgjithshme ose hyrje në psikologji, psikologjia e personalitetit, psikologjia fiziologjike, psikologjia sociale, psikologjia kognitive, psikologjia zhvillimore a gjenetike, psikopatologjia dhe zoopsikologjia.

PSIKOLOGJIA TOPOLOGJIKE. Psikologji e mbështetur në parimet dhe në ligjet e psikologjisë geshtaltiste. Sipas psikologjisë së fushave analiza e proceseve psikologjike të hapësirës jetësore të njeriut është e ngjashme ose analoge me analizën e fushave tërheqëse të fizikës. Bota e brendshme psikologjike e njeriut përshkruhet dhe analizohet si fushë tërheqëse. Proceset psikike dhe sjelljet e njeriut shpjegohen në bazë të ndikimit të fuqive tërheqëse të një fushe të caktuar jetësore të njeriut dhe pjesës tjetër të saj, që qëndron në raport tërheqës dhe dinamik me atë të parën. Sjelljet e njeriut në hapësirën e caktuar shkaktohen nga fuqitë që dalin nga raportet ndërmjet fushave tërheqëse të njeriut. Kështu, lëvizjet e njeriut zhvillohen nga kufizimi i fushave psikologjike që tërheqin dhe refuzojnë organizmin. Disa fusha kanë valencë pozitive, tërheqëse, kurse të tjerat kanë valencë negative, refuzuese dhe njeriu i ndodhur në mes tyre vendos si të sillet dhe si të veprojë. Psikologjia topologjike apo e fushave u emërtua nga psikologu gjerman Kurt Levin (Kurt Lewin, 1890 – 1947).

Burimet:

Kurt Lewin: *"Principles of topological psychology"* – (*"Parimet e psikologjisë topologjike"*), 1936.
Kurt Lewin: *"Fields theory in social sciences"* – (*"Teoria e fushave në shkencat shoqërore"*), Cartwright, 1951.

PSIKOLOGJIA THELLËSORE. Term përmbledhës për pikëpamjet e psikiatrit zviceran Eugen Blojler (Eugen Bleuler, 1857 – 1939) deri në fund të konceptimit të psikanalizës së

Zigmund Frojdit (1856 – 1939). Në kuadrin e kësaj shtrirjeje të psikologjisë thellësore mbiemri thellësor përcakton përmbajtjen topologjike dhe atë gjenetike: përmbajtja topologjike ka të bëjë me shtresimin shpirtëror prej të pavetëdijshmes deri në shtresën e zhvilluar të vetëdijes së njeriut, e pikërisht të pavetëdijshmes, të paravetëdijshmes dhe të vetëdijshmes, rrjedhimisht prej ezirit, egos deri në super ego. Përmbajtja gjenetike ka të bëjë me modelin biografik të zhvillimit psikik, nga rëndësia e përjetimeve fëmijërore deri në rolin e rëndësinë e tyre për zhvillimin dhe organizimin e sjelljeve të njeriut në moshën e rritur. Psikologjia thellësore e këtillë shpjegon dukuritë, proceset psikike dhe sjelljet e njeriut, si edhe personalitetin e tij me proceset mbisunduese të pavetëdijshme dhe me përcaktimin psikik, rrjedhimisht me shpjegimin e dukurive psikike, duke u mbështetur në shkaqet e tyre, përkatësisht në ndryshimet psikike paraprijëse.

Burimet:

Leonard Prifti: *"Psikanaliza sot: Psikologjia e thellësive",* Shtëpia Botuese UEGEN, Tiranë 2006.

Maria Fürst: *"Psychologie" (Einschliesslich Entwicklungpsychologie und Erzihungslechre)* – (*"Psikologjia" (Psikologjia zhvillimore dhe të mësuarit e edukatës)),* Wien, 1991, fq. 136 – 151.

Janez Musek & Vid Pečjak: *"Psihologija",* E D U C Y, Ljubljana, 2001, fq. 228 – 230.

Çarls Brener: *"Themelet e psikanalizës"* (botim i ripunuar dhe i zgjeruar), UFO PRESS, Tiranë, maj 2008.

PSIKOLOGJIA VEKTORIALE. Psikologji që përbëhet nga psikologjia e motivacionit dhe ajo e personalitetit, duke përfshirë edhe raportet ndërmjet tyre. I përket psikologjisë së fushave ose psikologjisë topologjike. Ka të bëjë me paraqitjen sistematike të fuqive motivuese të njeriut. Përfaqësuesi i saj është psikologu amerikan me prejardhje gjermane Kurt Levin (Kurt Lewin, 1890 – 1947). Sipas tij lënda e psikologjisë vektoriale është sjellja e njeriut, që përcaktohet nga veçoritë e fushës jetësore të njeriut me valencat pozitive apo negative të saj dhe sjellja e personalitetit të caktuar. Si njëra veçori ashtu edhe tjetra mund të paraqiten në formën vektoriale. Në kuadrin e këtij raporti dallohet fusha e veprimtarisë së njeriut, e faktorëve të lidhur me të dhe e rolit të përvojës në zhvillimin dhe organizimin e sjelljeve.

PSIKOLOGJIA ZHVILLIMORE. Njëra ndër disiplinat e rëndësishme të sistemit të disiplinave të psikologjisë. Psikologjia zhvillimore merret me hulumtimin e zhvillimit të proceseve psikike, të sjelljeve të njeriut dhe të ndryshimeve progresive të tyre nga lindja deri në pleqëri dhe në vdekje. Kjo psikologji hulumton faktorët biologjikë, socialë e personalë dhe rolin e ndikimit ndërlidhës të tyre në procesin e tillë të zhvillimit, duke përfshirë zhvillimin filogjenetik – zhvillimin e formave elementare të jetës psikike të njeriut primitiv deri te format e ndërlikuara të jetës psikike të njeriut të sotëm, si edhe zhvillimin ontogjenetik – zhvillimin e jetës psikike nga faza embrionale deri në pleqëri dhe në vdekje. Deri vonë u quajt psikologjia e fëmijëve, madje edhe sot në gjuhën shqipe bëhet fjalë për psikologji të fëmijëve, e cila ka shtrirje më të ngushtë se kuptimi i psikologjisë zhvillimore, sepse kjo e fundit përfshin psikologjinë e fëmijëve, të moshës së pubertetit, psikologjinë e moshës rinore, të

moshës së pjekurisë dhe psikologjinë e moshës së pleqërisë. Bazat e psikologjisë zhvillimore i ka hedhur evolucionisti i njohur Çarls Darvin (Charles Darwin, 1809 – 1882).

PSIKOTERAPI, -a. Emërtimi i përbashkët i teknikave dhe procedurave kryesisht fjalësore, që organizohen ndërmjet psikoterapistit me qëllim të largimit të formave të ndryshme të çrregullimeve të mendimit, ndjenjave dhe sjelljeve me origjinë psikogjene. Zbatimi i tyre synon cytjen e zhvillimit pozitiv të personalitetit. Format e psikoterapisë zakonisht ndahen në tri grupe: psikanalitike, të drejtuara në klientin dhe psikoterapia bihejviorale.

PSIKOTERAPIA EKZISTENCIALISTE. Psikoterapi që hulumton mjekimin, mënyrën se si pacientët e përjetojnë mjedisin, identitetin dhe unitetin e personalitetit të tyre, duke u mbështetur në metodën e barabartë të bashkëbisedimit ndërmjet psikoterapistit dhe pacientit. Psikoterapia ekzistencialiste ka për qëllim kryesor të çlirohet nga ankthi dhe frika e rremë, nga përvoja mbi karakterin jo autentik të personalitetit të tij, duke u ballafaquar me çështjet e lirisë e të përgjegjësisë dhe të arrijë plotësisht të drejtat e liritë, si edhe karakterin autentik të personalitetit të tij. Qëllimi kryesor i terapisë ekzistencialiste është që individi, duke analizuar ekzistencën e tij si edhe të të tjerëve, të ndryshojë pikëpamjen, vlerat dhe kuptimin e jetës personale.

Burimet:

Albert Bandura: *"Self efficacy: Towards a unifying theory of behavioral change"* – (*"Efikasiteti vetjak: Drejt një teorie të unifikuar të ndryshimeve bihejviorale"*), Psychological review, 1977, 84. 191 – 215.

S. Bloch*: "What is psychotherapy?"* – (*"Çfarë është psikoterapia"*), Oxford, 1982.

S. Bloch*: "An introduction to the psychotherapies"* – (*"Hyrje në psikoterapi"*), Oxford, 1979.

Sigmund Freud*: "Hyrje në psikanalizë",* Tiranë, 2004.

Slavoljub Radonjic: *"Terapeutski principi i metode bihejvioralne terapije"* – (*"Parimet e metodat terapeutike të terapisë bihejviorale"*), Bihejvior psikoterapija, Avalske sveske, 1/78.

PSIKOTERAPIA FILOZOFIKE. Zbatim i psikoterapisë në ndryshimin e pikëpamjeve filozofike të klientit dhe të ndikimit të tyre në sjelljet e çrregulluara të tij ndaj të tjerëve dhe ndaj gjithësisë e dukurive të saj. Qëllimi kryesor i psikoterapisë filozofike është ndryshimi i mendimeve filozofike të tij në drejtim të argumentimit konkret e objektiv dhe, rrjedhimisht, edhe ndryshimin e sjelljeve të klientit ndaj realitetit, objekteve, dukurive dhe proceseve objektive reale të situatave të ndryshme të njeriut. Premisa të psikologjisë filozofike ka psikoterapia e Karl Roxhersit dhe logoterapia e psikiatrit austriak Viktor E. Franklin (Viktor E. Frankl, 1905 – 1997).

PSIKOTERAPIA GRUPORE. Forma psikoterapeutike që realizohen në prani të grupeve të përbëra nga individë që vuajnë kryesisht nga problemet e njëjta ose të ngjashme. Psikoterapia grupore është veprim i organizuar psikoterapeutik që organizohet nën drejtimin e një psikoterapeuti ose psikoterapeute dhe në prani të të gjithë anëtarëve të atij grupi (narkomanë, neurotikë, psikosomatikë etj.). Specialistët që udhëheqin psikoterapinë grupore shfrytëzojnë lidhjet shoqërore ndërmjet anëtarëve dhe klimën psikologjike të përbashkët

për të modifikuar pikëpamjet, qëndrimet dhe sjelljet e tyre.

PSIKOTERAPIA KOGNITIVE. Formë e terapisë psikologjike, sipas së cilës për njohjen e çrregullimeve të sjelljeve të njeriut, sidomos të shkaqeve të këtyre çrregullimeve, duhen njohur bindjet, mënyra e perceptimit dhe e shpjegimit të dukurive, objekteve, proceseve fizike, sociale, mjedisore, si edhe vetja dhe raportet me të tjerët. Esenca e psikoterapisë kognitive është ndërhyrja e psikoterapeutit për t'ia ndryshuar bindjet, qëndrimet, e pikërisht gjithë strukturën e skemës njohëse të klientit, në drejtim të perceptimit real të gjithë asaj që e rrethon. Kjo formë e psikoterapisë është e lidhur me psikiatrin amerikan Aron T. Bek (Aron T. Beck, 1921).

PSIKOTERAPIA ROXHERS. Lloj karakteristik i psikoterapisë, që ka të bëjë me rolin këshillues të psikoterapeutit, përkatësisht me rolin drejtues të nxitjes në krijimin e klimës së ngrohtë për pacientin dhe lirinë e pakufizuar të tij për shfaqjen e përmbajtjeve të rëndësishme nga përvoja dhe jeta e tij, me nismën e dialogut me pacientin, me trimërinë e tij për të interpretuar sa më qartë përmbajtjet e përgjigjeve nga përvoja etj. Në këtë lloj psikoterapie qendër e psikoterapisë nuk është psikoterapeuti me autoritetin e tij, por vetë pacienti, të cilin e ndihmon për të fituar një pasqyrë sa më të qartë në pjesët e panjohura të unit të vet. Kjo lloj psikoterapie u quajt psikoterapi e drejtuar në pacientin e caktuar. E zbatoi psikologu amerikan Karl R. Roxhers (Carl R. Rogers, 1902 – 1987)**.** "Psikoterapisti nuk e shëron klientin, por e shpie të shërohet vet".

PSIKOZA FUNKSIONALE. Psikoza maniako-depresive, e skizofrenisë dhe paranoja. Këto psikoza dikur përbënin grupin e psikozave që janë trajtuar si psikoza të faktorëve psikogjenë. Por, sot termi psikozë funksionale i përket së kaluarës, sepse është konstatuar se edhe psikozat e përmendura janë të lidhura me faktorë biokimikë e fiziologjikë.

PSIKOZA ORGANIKE. Çrregullim serioz psikik i shkaktuar nga të metat strukturore ose funksionale të sistemit nervor, përkatësisht të një pjese të tij. Term i vjetër, i cili nuk është përfshirë në pjesën IV të DSM.

PSIKOZA SENILE. Ndryshime negative të strukturave psikike dhe të funksioneve të tyre, që karakterizojnë një individ në moshën e pleqërisë. Ndër ndryshimet e tilla dallohen: rrënimi i të mbajturit mend dhe i riprodhimit të informacioneve, sidomos të informacioneve në lidhje me më të rejat ndërmjet tyre, rritja e shkallës së ngacmueshmërisë, ndryshime të mëdha të zotërimeve psikike, e pikërisht i humorit, si dhe kokëfortësia. Këto psikoza kanë karakter individual dhe shkaktohen nga rrënimi i indeve nervore.

PSHERËTIM/Ë, - A. f. Formë e shprehjes neurofiziologjike të gjendjeve të posaçme emocionale të njeriut, të cilat shoqërohen me marrje frymë thellë dhe lëshim të saj të fuqishëm nga organet e frymëmarrjes. Ky ndryshim i intensitetit të frymëmarrjes ndodh në rastet e përjetimit të një brenge, të përkujtimit mallëngjyes të një miku apo shoku, të përjetimit të mërzisë, duke ditur ose mos ditur shkaqet e mërzisë etj. Psherëtima shtrihet prej përjetimit

të emocioneve të caktuara, vlerësimit të shkaqeve të përjetimit të tyre, që janë të pandashme nga ndryshimet e intensitetit të frymëmarrjes, gjithsesi të përcjella edhe me ndryshime fiziologjike të tjera, në rend të parë me reagim të refleksit psikogalvan. Psherëtima nuk është bërë ende term standard në terminologjinë e psikologjisë.

PUÇËRZAT E RUFINIT. Fundi i fijezave nervore të shpërndara në indin e nënlëkurës në formë të rrjetëzës së ndërlikuar, që besohet se janë ndërmjetësuese në reagimin e organizmit ndaj ngacmuesve të vakët, të ngrohtë ose të nxehtë. U emërtuan sipas studiuesit italian të anatomisë Anxhelo Rufini (Angelo Ruffini, 1864 – 1929).

PUÇËRZAT KRAUZE. Organe receptore të lëkurës, që besohet se janë të lidhura me ndijimet mekanike të lëkurës. Këtyre puçërzave u është atribuuar deri nga mbarimi i gjysmës së pare të shekullit të njëzet roli i receptorëve të temperaturës. Këto puçërza kanë shpërndarje josimetrike në lëkurë dhe zakonisht janë të vendosura ndërmjet mbështjellësve të muskujve të gjatë e të thatë dhe membranës së lëngshme të lëkurës. U quajtën kështu nga zbuluesi i tyre anatomo-patologu gjerman Vilhelm Krauze (Wilchelm Krause, 1833 – 1910).

PUÇËRRZAT PAÇIN. Lloj receptorësh të të prekurit, që gjenden në thellësinë e indeve dhjamore të lëkurës. Këto puçërrza reagojnë ndaj shtypjes së asaj pjese të lëkurës, ku vepron një ngacmues i fuqishëm fizik, si edhe dridhjet me dendësi të lartë. U emërtuan sipas zbuluesit të tyre, anatomo-patologut italian Filipo Paçini (Filipo Pacini, 1812 – 1883).

PUNA STATIKE. Lloj i veprimtarisë së punës së njeriut që realizohet nga ana e tij, duke mbajtur në pozicion të njëjtë zakonisht duart apo këmbët dhe herë-herë të dy gjymtyrët në pozicion të njëjtë. Punë statike është mbajtja e trupit me peshë të lartë në një pozicion të caktuar, rezistenca e njeriut ndaj një fuqie sulmuese etj. Në rastet e tilla kontraktimi i muskujve është në gjendje të përhershme. Puna statike kërkon energji shumë më të vogël nga puna dinamike, por është më e mundimshme për njeriun.

PUSHIM, i m. Ndërprerja e veprimtarisë, e punës fizike ose e punës mendore me qëllim të kompresimit të energjisë së organizmit gjatë punës. Pushim është procesi më efikas i asgjësimit të lodhjes, koha e përmirësimit të organizmit nga lodhja. Pushimin duhet marrur para lodhjes; më efikas është pushmi aktiv me pauza se pushimi i njëhershëm i gjatë.

PUSHIMI AKTIV. Zëvendësim i veprimtarisë së punës së gjatë e të mundimshme me një aktivitet tjetër më të lehtë dhe të këndshëm, me qëllim këndelljen e organizmit. Pushimi aktiv realizo-het me anë të shëtitjeve nëpër lulishte, me ushtrime trupore të lehta, me not, sport etj.

PUSHTIMI nga ankthi. Ngarkesa e madhe e individit, që ka të bëjë me gjendjen psikike për të ardhmen e ngarkuar me halle të përballimit të ngjarjeve negative. Kjo gjendje mund të zgjatë relativisht shumë kohë. Shoqërohet me jo gatishmëri për t'i kontrolluar sjelljet, duke besuar se shumë stimuj shoqëror kanë vazhdimisht përmasë kërcënuese.

Q

Q Shkurtesë për dy terma të koncepteve psikometrike: shmangia kuartile dhe shkurtesa Q_1, shkurtesa Q_2, shkurtesa Q_3 për çerekun ose kuartilin e parë, të dytë dhe të tretë të një tërësie.

QARKU PAPEZ. Strukturë nervore e ndërlikuar që përbëhet nga pjesa e përparme e talamusit, nga hipokampusi, pjesët mamilare, nga korteksi (cipa e trurit) cingular dhe nga fijezat nervore lidhëse të këtyre pjesëve. Qarku i tillë nervor i përket strukturës limbike të trurit, përkatësisht pjesës së brendshme të mesit të secilës hemisferë. Konsiderohet se qarku nervor Papez është bartës rregullues i sjelljeve dhe i emocioneve të njeriut. Këtë qark e ka zbuluar neuroanatomisti amerikan Xhejms V. Papez (James W. Papez, 1883 – 1958). Qarku Papez përmendet që nga viti 1837. Prej kësaj kohe daton teoria Papez e emocioneve, kur u përmend roli i hipotalamusit dhe roli integrues i korteksit në zhvillimin e proceseve emocionale.

QARTË (I, E). mb. Që dallohet, që shquhet mirë e lehtë nga të tjerët, që kuptohet mirë. I qartë mund të jetë ndijimi, perceptimi, përfytyrimi, mendimi etj. Në psikologji hasen këto sintagma terminologjike:

a. **Ndijimi i qartë** – Ndijim që karakterizohet me dallueshmëri, me kuptueshmëri dhe me intensitet më të madh të perceptimeve të cilësive të një dukurie a një trupi që ushtron ndikim në shqisën e njeriut;

b. **Perceptimi i qartë** – Perceptim që karakterizohet me dallimin dhe me kuptimin më të plotë të një dukurie a objekti që perceptohet. Shkaktohet nga faktorët e jashtëm dhe nga faktorët e brendshëm, si detyra, përvoja, rëndësia etj.;

c. **Përfytyrimi i qartë** – Figura e riprodhuar e trupit që është perceptuar dhe ka veçori parësore e dytësore të ruajtura në kujtesën e njeriut.

QASJA IDIOGRAFIKE. I ardhur nga greqishtja *ιδιό* "i veçantë" dhe *γραφος* "shkruaj". Qasje studimore e veçantë e lidhur me hulumtimin konkret individual, unik dhe të papërsëritshëm. Në psikologji qasja e këtillë ka ardhur nga filozofi gjerman Vilhelm Vindelbant (Wilhelm Windelband, 1848 – 1915).

Q

Qasjen idiografike e ka parapëlqyer sidomos psikologu amerikan Gordon Olport (Gordon Allport, 1897 – 1967), duke rikujtuar se secili ka histori të veçantë, kushte zhvillimi e formimi të posaçme dhe forma sjelljesh individuale, dhe rrjedhimisht, studiuesi i personalitetit duhet t`i zotërojë metodat dhe procedurat e hulumtimit individual, si dokumentet personale, fletëpalosjen individuale, intervistën, shkallën e vetëvlerësimit, përzgjedhjen Q etj.

QASJA NOMOTETIKE. Qasje e hulumtimit të dukurive psikike me qëllim të konstatimit të cilësive dhe të raporteve gjithëpërfshirëse dhe të përbashkëta ndërmjet tyre dhe zbulimin e identifikimin e parimeve dhe të ligjeve të zhvillimit të tyre. Nomotetik e ka prejardhjen nga greqishtja *nomothetikos* "i ligjshëm". Qasja nomotetike ose nomologjike abstragon, lë anash cilësitë e veçanta, individuale të dukurive dhe të proceseve që hulumtohen. Qasja nomotetike e hulumtimeve psikologjike është theksuar sidomos në studimet e psikologjisë së përgjithshme dhe të psikologjisë së personalitetit. Këtë qasje e ka parapëlqyer sidomos psikologu amerikan Gordon V. Olport (Gordon W. Allport, 1897 – 1967), sipas të cilit personaliteti duhet shpjeguar në bazë të parimeve dhe të ligjeve të zhvillimit të ndryshoreve të përgjithshme të tij.

QASJA PERSONALE. Qasje karakteristike e studimit të dukurive, të proceseve dhe të formave të sjelljeve duke u nisur nga bartësit konkretë të tyre, përkatësisht nga personaliteti konkret, që është tërësi e qenies biopsikike integrale, unike e papërsëritshme dhe e veçantë. Qasja personale nënkupton zhvillimin psikik të njeriut në personalitetin e tij, duke u mbështetur në aktivitetin e tij personal të përzgjedhjes së faktorëve ndikues në zhvillimin e tij. Nismëtar i zhvillimit të kësaj qasjeje dhe i psikologjisë personale është psikologu gjerman Vilhelm Stern (William L. Stern, 1871 – 1938). Kjo qasje ndikoi më vonë në zhvillimin e psikologjisë së personalitetit – degë e sistemit të shkencave të psikologjisë.

QELIZ/Ë, - A. f. Njësia bazë strukturore dhe dinamike e organizmit të gjallë. Përbëhet prej bërthamës, protoplazmës, kromozomeve të mbështjella me cipë të posaçme. Organizmi i gjallesave të kafshëve, sidomos organizmi i njeriut, është i ndërtuar nga bilionë qelizash me funksione të specializuara. Qeliza ka aftësi të këmbimit të lëndëve. Bashkimi i qelizave të njëllojta në strukturë të përbashkët organike përbëjnë indin, qelizat e të cilit kryejnë funksion të përbashkët. Disa lloj qelizash kanë funksion të rëndësishëm për veprimtarinë e gjithëmbarshme të organizmit të qenieve të gjalla, për proceset psikike dhe sjelljet e njeriut.

QELIZAT DRIDHËSE VESTIBULARE. Qeliza receptore që gjenden të shtrira në hyrje të secilit kanal gjysmërrethor të aparatit vestibular. Këto qeliza regjistrojnë lëvizjet dhe ndryshimet e baraspeshës së trupit të njeriut. Kanë një gërshetë fijezash nervore të zhytura në masën xhelatinoze. Lëvizja e kokës shkakton lëvizjen valore të lëngut në kanalet gjysmërrethore. Valët e këtilla vënë në lëvizje masën xhelatinoze, kurse kjo shkakton lakimin e fijezave nervore. Kjo

lëvizje e gërshetave të fijezave nervore bart impulset nervore në tru dhe në drejtim të lukthit.

QELIZAT NERVORE. Në anatominë e sistemit nervor janë përbërëse themelore të sistemit nervor. Përbëhen nga trupi qelizor si të gjitha qelizat e tjera. Krahas trupit kanë edhe dendrite dhe neuritin ose aksonin, që kanë vendndodhje të ndryshme dhe kryejnë funksione të posaçme. Këto lidhin sistemin nervor me organet shqisore, me muskujt dhe me gjëndrat, si edhe me qeliza të tjera nervore. Shih – ***NEURONI.*** Në psikofiziologji dallohen disa lloje qelizash të rëndësishme për proceset psikike dhe për sjelljet e qenieve të gjalla (të kafshëve dhe të njeriut):

a. **Qelizat e Becit** – Qeliza nervore ose neurone të mëdha me trup qelizor, që ka formë piramidale. Këto gjenden në pjesën ballore të cipës së trurit të madh dhe në cipën motorike të saj. Neuritet e qelizave të Becit përbëjnë rrugën piramidale. Nga qelizat e Becit nisen fijet nervore, që bartin impulse nervore deri në muskuj skeletorë. Qelizat e Becit marrin pjesë në veprimtarinë e vullnetshme të njeriut. U emërtuan sipas anatomistit rus Vladimir Bec (Vladimir Betz, 1834 – 1894);

b. **Qelizat e Purkinit** – Qeliza nervore të mëdha, që gjenden në shtresën e dytë të cipës së trurit të vogël duke u shtrirë deri në bërthamat e thella. Kanë formë të degëzuar dhe këtu, neuritet e saj ndërtojnë rrugët eferente të trurit të vogël;

c. **Qelizat bipolare** – Qeliza nervore me dy pole, që takohen në rrjetëzën a në retinën e syrit. Këto bartin impulse të shkaktuara nga ndryshimet në qelizat receptore të të parit dhe fijet nervore të tyre lidhin qelizat ganglionare të rrjetëzës ose retinës së syrit;

d. **Qelizat gliale –** qeliza përbërëse të sistemit nervor që kryejnë këto funksione: bëjnë mielimizimin e aksoneve të neuroneve të trurit, luajnë rol të veçantë në metabolizmin e sistemit nervor dhe janë mbështetëse;

e. **Qelizat kromafine –** Qeliza nervore që gjenden në trupat karotidë dhe në pjesët modulare të gjëndrës mbiveshkore;

f. **Qelizat multipolare** – Qeliza nervore që në trupin e tyre kanë më shumë se dy pjesë vazhduese. Njëra nga pjesët është neuriti ose aksoni, kurse pjesa tjetër është degëzim i dentriteve. Dallohen disa lloje qelizash të tilla, si: qeliza multipolare me formë piramidale, me formë yjesh, grimcash, etj. Qelizat multipolare përbëjnë lëndën e përhimët të qendrave nervore;

g. **Qelizat receptore** – Qeliza shqisore të specializuara për marrjen e energjisë mekanike, optike, të shijes etj. të trupave ngacmues të shqisave të caktuara dhe shndërrimi i kësaj energjie në impulse të veçanta nervore;

h. **Qelizat Shvan –** Qeliza që formojnë këllëfin mielinik që vesh neuritet ose aksonet e qelizave nervore. Emërtohen sipas zbuluesit të tyre, anatomistit gjerman Teodor Shvan (Theodor Schwann, 1810 – 1882).

i. **Qelizat Renshau –** qeliza me strukturë e morfologji të posaçme. Qeliza e Renshau është neuron me neurit të shkurtër që kryen funksionin e frenimit të neuronit motorik, duke shkaktuar sinapsë kthyese në veten e saj. Në këtë mënyrë qeliza Renshau bëhet pengesë për aktivizimin e qelizës

motorike, që bart impulsin nervor deri në muskul. Në këtë mënyrë pengohet kontraktimi i tepërt i muskulit. Mori emrin e zbuluesit të saj, neurologut amerikan Birsei Renshau (Birdsey, Renshaw, 1911 – 1941).

QELIZAT NERVORE MULTIPOLARE. Në anatominë e sistemit nervor janë qeliza nervore me dy e më shumë degëzime, që përbëjnë grupin e qelizave nervore kryesore të sistemit nervor. Qelizat nervore multipolare ose shumëpolëshe janë disa llojesh: qeliza piramidale, në formë yjesh, granatash etj. Ndër këto qeliza dallohen qelizat nervore multipolare të formës së piramidës.

QENDRAT E LARTA NERVORE. Qendra të trurit të madh që kanë të bëjnë me llojet e ndërlikuara të jetës dhe të veprimtarisë psikike të njeriut, sidomos me zhvillimin e proceseve kognitive. Bartëse e qendrave nervore të larta është cipa ose korja e trurit të madh si tërësi, ngaqë lindja dhe zhvillimi i proceseve të ndërlikuara shtrihet pak a shumë në të gjithë cipën e trurit të madh. Megjithëkëtë, në cipën e trurit të madh dallohen tri lëmi të gjera: 1) Lëmi e qendrave ndijimore a sensorike; 2) Lëmi e qendrave lëvizore a motorike dhe 3) Lëmi e qendrave lidhëse apo asociative. Funksionin e tyre e kryejnë qelizat nervore dhe pjesët e ndërlidhura të tyre, duke mundësuar zhvillimin e formave të ndërlikuara të jetës dhe të veprimtarisë psikike të njeriut.

QENDRAT NERVORE. Pjesë të sistemit nervor që i përkasin trurit të madh dhe formohen nga grumbuj qelizash nervore të ndërlidhura që kryejnë funksion të përbashkët, sidomos në zhvillimin e proceseve të ndërlikuara kognitive. Këto qendra përbëhen nga pjesët e cipës apo kores së trurit të madh. Në kuptimin e ngushtë qendra trunore duhet kuptuar si pjesë e trurit ku impulset nervore shndërrohen në procese të ndërlikuara psikike, siç janë proceset intelektuale ose kognitive. Qendrat nervore nuk janë pjesë të ngushta dhe të vogla të trurit, por pjesë të ndërlidhura në mënyrë funksionale ndërmjet tyre. Sipas funksioneve që kryejnë, dallohen këto lloj qendrash nervore:

a. **Qendrat nervore asociative** – Qendra ndërlidhëse të cipës a kores së trurit të madh. Me këtë term herë emërtohen fushat e shkallës së tretë dhe herë emërtohen bashkërisht fushat e shkallës së tretë dhe ato të dytë. Fijezat nervore të këtyre qendrave bëjnë lidhjen e pjesëve të ndryshme të cipës së trurit të madh;
b. **Qendrat nervore motorike** – Qendra që përbëjnë zonën motorike të cipës së trurit të madh. Janë rregullatore të lëvizjeve të trupit e të pjesëve të ndryshme të tij. Fijezat e qelizave nervore të këtyre qendrave bartin impulse nervore nga qendrat motorike në muskuj dhe në gjëndra. Qendrat motorike të cipës së trurit të madh janë të përfshira në kryerjen e funksioneve të veprimtarisë së vullnetshme të njeriut;
c. **Qendrat sensorike** – Qendra ndijimore të cipës së trurit të madh që kryejnë funksionin e ndijimeve dhe të perceptimeve. Në to përfundojnë fijezat e nervave prurës, që bartin impulse nervore nga receptorët e shqisave në qendrat përkatëse dhe pikërisht këtu, impulset nervore shndërrohen në ndijime dhe perceptime të caktuara;

d. **Qendra hipotalamike** – Qendër ndërgungore me funksione të ndërlikuara që luan rol të rëndësishëm në jetën emocionale dhe ndijimore të njeriut;

e. **Qendra e Brokut** – Fushë në cipën apo koren e trurit të madh që zakonisht gjendet në pjesën e poshtme të brazdës ballore të hemisferës së majtë të trurit (rrallë haset edhe në pjesën e djathtë të hemisferës). Kryen funksionin e artikulimit të fjalëve dhe të të folurit. Çrregullimi i funksionit të kësaj qendre shkakton pamundësinë e të folurit, megjithëse lëvizja e gjuhës dhe e buzëve është e padëmtuar dhe të kuptuarit e fjalëve është aftësi relativisht e ruajtur. Mori emrin e zbuluesit të saj, fiziologut dhe kirurgut francez Paul Broka (Paul Broca, 1824 – 1880);

f. **Qendra e Vernikut** – Fushë nervore në cipën apo koren e trurit të madh që gjendet në pjesën tëmthore të hemisferës së trurit të djathë (te pjesa më e madhe e njerëzve). Kjo fushë kryen funksionin e të kuptuarit të procesit të të folurit. Çrregullimi i funksionit të kësaj fushe shkakton pamundësinë e të kuptuarit të të folurit, megjithëse ruhet ndjeshmëria e dëgjimit. U quajt kështu sipas zbuluesit të saj, neurologut gjerman Karl Vernik (Carl Wernicke, 1848 – 1905).

QENDRAT NERVORE TË NËNCIPËS. Qendra nervore që gjenden në thellësinë e trurit, struktura nervore të përbëra nga indet nervore të zhvilluara në cipën e trurit të madh. Në këto qendra pasqyrohet gjendja e përgjithshme e organizmit dhe e funksioneve të organeve të tij, duke përfshirë edhe lëvizjet refleksive. Qendrat nervore të nëncipës janë të lidhura me funksionin e sistemit nervor autonom ose vegjetativ**.**

QENIA PSIKIKE. Ekzistenca e jetës psikike, e dukurive, proceseve dhe e tipareve psikike të organizuara në qenien e organizmit të gjallë. Qenia psikike e njeriut është tërësia e proceseve psikike dhe e sjelljeve karakteristike, si edhe e tipareve të veçanta të integruara dhe të organizuara në shkallën më të lartë në qenien njerëzore, pikërisht në njeriun e gjallë, në njeriun konkret.

QESKA E VESTIBULIT. Njëra nga dy qeskat e organit vestibular, e emërtuar *sakulus*. Shih – ***VESTIBULI.***

QESHJ/E, - A. f. Dukuria e shprehjes së ndjenjave të njeriut ndaj një situate komike, kur ai përjeton gëzim, hare, kënaqësi etj., dhe që shoqërohet me lëvizje karakteristike të buzëve, të gojës, të syve, të muskujve të fytyrës, madje, në raste të veçanta, edhe prej lotëve. Qeshja karakterizon botën njerëzore dhe ka karakter shoqëror (të njëjtat situata nuk shkaktojnë qeshje në të gjitha mjediset shoqërore). Qeshjen e shkakton asociacioni i çuditshëm, i papritur, i pazakonshëm i përfytyrimeve, i formave të mendimit për situatën e çuditshme të një individi tjetër, ose të vetën, duke mos prekur dhe rrezikuar vlerat subjektive. Qeshja mund të shkaktohet nga raporti, situata simpatike, por edhe nga ajo josimpatike. Qeshja nën buzë, në vetvete, në shumë mjedise shoqërore është formë e shfaqjes së urrejtjes ndaj tjetrit.

QETËSUES, – I. m. Përbërje biokimike të veçanta, barna ose medikamente me efekt terapeutik, që shërbejnë për qetësimin e organizmit, kur ky është i shqetësuar dhe ka simptoma

çrregullimi të ndonjë sistemi organesh dhe proceseve fiziologjike të tij. për organizmin Për një individ me shqetësime psikofizike vetëm mjeku specialist mund të caktojë llojin e qetësuesit për atë organizëm, duke dhënë këshilla që pacienti duhet t'i zbatojë rreptësisht. Ndër llojet e ndryshme të qetësuesve dallojmë qetësuesit e ankthit: alprazolam, klorazepat, oksazepam etj.

QËLLIM, - I. m. Gjendja, objekti që njeriu synon ta arrijë me veprimtarinë e tij, drejt të cilit e shtyn dëshira, motivi, nevoja, shtytësi i caktuar. Te njeriu shfaqet në formën e konceptit, përfytyrimit të shoqëruar me veprimtari përfundimtare për ta zotëruar atë. Qëllimi ose caku mund të ketë karakter fizik, psikik dhe shoqëror. Qëllimi dhe e tërë dija e veprimtaria drejt tij përbën pikënisjen e veprimtarisë së vullnetshme. Këtë psikologu gjerman Vilhelm Vunt (Wilhelm Wundt, 1832 – 1920) e ka quajtur "përfytyrim anticipues". Në arritjen e qëllimit njeriu zgjedh rrugën dhe mjetet nëpër të cilat ai do të kalojë, duke përdorur mjete të veçanta për ta zotëruar gjësendin, apo situatën e përfytyruar më parë. Me realizim të qëllimit pushon së vepruari përkohësisht dëshira, motivi, nevoja, shtytësi. Njeriu është i vetëdijshëm për qëllimin e aktivitetit të tij. Ka raste kur njeriu është i pavetëdijshëm për qëllimin e aktivitetit të vet. Psikanaliza ka identifikuar disa qëllime të karakterit të pavetëdijshëm, si: qëllimi agresiv, narcizoid, seksual etj. Qëllimi mund të jetë afatshkurtër dhe afatgjatë. Qëllim afatshkurtër është blerja e rrobave të stinës, marrja pjesë si spektator në pjesën teatrale "Edipi" etj., kurse qëllim afatgjatë është përfundimi me sukses të lartë i studimeve, arritja në kulm e krijimtarisë filmike etj. Për nga struktura e tyre qëllimi mund të jetë konkret, abstrakt, i parealizueshëm etj.

QËNDRIM, - I. m. Term psikologjik, megjithëse i ardhur nga biologjia dhe mjekësia. Në psikologji qëndrimi është strukturë dinamike e personalitetit e formuar gjatë përvojës si gatishmëri dhe prirje relativisht e qëndrueshme e individit për të menduar, përjetuar dhe vepruar pozitivisht ose negativisht ndaj një individi të caktuar, ndaj një objekti, situate dhe bartësve të saj. Qëndrimi pozitiv ndikon në sjelljet përkrahëse, ndihmëse ndaj tij. I tillë mund të jetë qëndrimi pozitiv ndaj shokut të ngushtë, ndaj mikut etj. Qëndrimi negativ ndikon në largimin nga ai objekt, në pengimin e zhvillimit të tij, madje edhe në sulmin ndaj tij. I tillë mund të jetë qëndrimi ndaj agresorit, keqbërësit etj. Struktura e qëndrimeve është e ndërlikuar; përbëhet nga komponentët kognitivë, emocionalë dhe veprues, përkatësisht nga ndërlidhja e tyre. Dija dhe përvoja për objektin e një qëndrimi ndikon në perceptimin e tij, në përcaktimin e rëndësisë dhe vlerës së tij, si edhe në bindjen e njeriut për objektin e qëndrimit dhe raportin ndaj tij dhe objekteve të tjerë. Veçoritë kryesore të qëndrimeve: qëndrimet janë të formuara gjatë jetës dhe përvojës së njeriut, këto kanë karakter aktiv, janë të qëndrueshme dhe ndryshojnë me vështirësi. Qëndrimet mund të kenë karakter të përgjithshëm shoqëror (nderimi i dinjitetit, i lirisë dhe i të drejtave të njeriut, i raporteve demokratike, i mirëqenies kombëtare etj.) dhe personal (qëndrimi ndaj

nënës, ndaj një aktori të artit filmik, ndaj një basketbollisti të njohur, ndaj zezakëve etj.). Qëndrimi zakonisht shoqërohet me qëndrimet e tjera, duke formuar organizmin e qëndrimeve unike ndaj klasës së caktuar të objekteve, ndaj pjesëtarëve të një partie, të një race etj. Në këtë mënyrë formohet baza e njohjes dhe e reagimeve ndaj një klase, kategorie objektesh të mjedisit të ngushtë dhe të gjerë. Sot në psikologjinë sociale, në psikologjinë e personalitetit dhe në psikologjinë politike i kushtohet rëndësi e posaçme gjurmimit të formimit, ndryshimit të qëndrimeve dhe intensitetit të tyre.

QËNDRIMI RELIGJIOZ. Gatishmëria e njeriut për të reaguar pozitivisht ndaj dukurive, ndaj qenieve të pacaktuara dhe ndaj riteve fetare që mbështetet në besimin e thellë të tij në Perëndi.

QËNDRIMI ROMANTIK. Qëndrim ëndërrues ndaj jetës, raporteve shoqërore, veprimeve etj., në të cilat theksohen ndjenjat dhe format e ndryshme të imagjinatës të së kaluarës që sublimohen në ideale të veçanta. Qëndrimi romantik gjen shprehje në krijimtarinë figurative, letrare, muzikore etj.

Burimet:

Ben Reich & Christine Adcock: *"Values, Attitudes and Behaviour Change*" – (*"Vlerat, qëndrimet dhe ndryshimi i sjelljeve"*), Methuen, London, 1976 (fq. 25 – 122);

David Katz: "*The functional approach to the study of attitudes"- "Qasje funksionale e studimit të qëndrimeve"*. Public Opinion Quarterly 24, 1960 (fq. 163 – 204);

Burrhus F. Skinner: "*Science and Human Behaviour*" – *"Shkenca dhe sjellja njerëzore"* MecMillan, New York, 1953;

Edmond Dragoti: *"Psikologjia Sociale*", Shtëpia Botuese "Libri Universitar", Tiranë, 1999 (fq.155 – 186).

QËNDRUESHMËRI, - A. m. Veçori e mosndryshimit relativ të disa përmbajtjeve, të proceseve dhe tipareve psikike të personalitetit. Në kuptimin e përgjithshëm term i ardhur nga latinishtja *stabilitas* "qëndrueshmëri" dhe me kuptim të posaçëm në psikologji, si edhe në fizikë, gjenetikë, statistikë etj. Në psikologji termi qëndrueshmëri përdoret në psikologjinë e personalitetit për të emërtuar ato tipare të sjelljes, që nuk pësojnë ndryshime të mëdha emocionale, sidomos jo përtej masës. Hasen disa lloj qëndrueshmërish:

a. **Qëndrueshmëria e matjeve psikologjike** – Koeficienti i ndërlidhjes apo korrelacionit ndërmjet vargut të të dhënave të përftuara nga dy a tri matje të një ndryshoreje psikologjike me të njëjtët subjekte dhe në të njëjtat kushte me zgjatje kohore ndërmjet testimit të parë e të dytë prej disa muajsh (tre – pesë);

b. **Qëndrueshmëria e perceptimeve** – Mosndryshimi i perceptimit të një objekti, ndonëse ndryshon pak një cilësi ose disa sosh të atij objekti. Qëndrueshmëria e perceptimeve bën që perceptimi të mos përputhet plotësisht me karakteristikat e objektit perceptues. Kjo ushtron ndikim pozitiv në organizimin e sjelljeve të tij ndaj objektit ose situatës që perceptohet. Qëndrueshmëria e perceptimeve shfaqet në tri forma: qëndrueshmëria e formës – rrethi i perceptuar anash i përngjet elipsit, por, megjithëkëtë njeriu reagon ndaj tij sipas formës perceptuese e jo sipas formës eliptike të tij. Qëndrueshmëria e madhësisë së objektit perceptues ka të bëjë me

faktin se figura e madhësisë së objektit në rrjetëzën a retinën e njeriut ndryshon sipas largësisë së njeriut nga objekti perceptues (madhësia e shtyllave të telefonit duket se ndryshon nga largësia e tyre prej perceptueset, por njeriu këto i percepton në formën e madhësisë së pandryshuar). Qëndrueshmëria e shkallës së ndriçimit të një objekti. Një copë thëngjill e perceptuar në dritën e diellit dhe në errësirë e ndryshon shkallën e ndriçimit së tij, por këtë njeriu e percepton të pandryshuar. Shih – ***PERCEPTIMI***.

c. **Qëndrueshmëria e qëndrimeve** – Ruajtja e qëndrimit të formuar në formë relativisht të pandryshueshme për një kohë të gjatë. Nën ndikimin që ushtron dukuria e mosndryshueshmërisë së qëndrimeve njeriu braktis dukuritë, objektet, situatat etj. që argumentojnë të kundërtën e qëndrimit të tij;

d. **Qëndrueshmëria e testit** – Qëndrueshmëri që arrihet duke përftuar të njëjtat rezultate ose rezultate shumë të ngjashme nga zbatimi i të njëjtit test te grupi i njëjtë i subjekteve dhe në kushte të njëjta të përsëritjes së tij. Në rastet e këtilla shfrytëzohet koeficienti i ndërlidhjes apo korrelacionit dhe sa më i lartë të jetë ky koeficient, aq më e madhe është qëndrueshmëria e testit**;**

e. **Qëndrueshmëria e vëmendjes** – Moslëvizja, moslargimi i vëmendjes prej objektit në të cilin ajo është përqendruar në objektin tjetër. Kjo varet nga disa faktorë të jashtëm apo objektivë, si edhe nga faktorë të tjerë subjektivë;

f. **Qëndrueshmëria emocionale** – Gjendja e njeriut me reagime dhe me sjellje emocionale të përshtatshme me situatat e me ngacmuesit, që manifestohet në mënyrë konsekuente në kuadrin e kritereve shoqërore të mjedisit ku ai përjeton emocionet. Qëndrueshmëria emocionale është e pandarë nga pjekuria emocionale e individit. Qëndrueshmëria emocionale ka të bëjë me kontrollin e intensitetit, me zgjatjen kohore dhe me shkakun e emocioneve, me qëllim të pengimit të ndikimit negativ të tyre në çrregullimin e dukurive organike dhe në sjelljet e njeriut. Kontrolli i tyre arrihet në forma të ndryshme, si: duke u shmangur nga situatat që shkaktojnë dëshpërim, mërzi, trishtim dhe xhelozi të madhe.

QORTIM, - I. m. Vërejtja që i bëhet një individi për punën e dobët, për rezultatet e ulëta të punës profesionale të tij, për sasinë e pamjaftueshme të efektit ose për cilësinë e dobët të punës së vet etj. Qortimi ka karakter nxitës për një angazhim më të madh, më racional etj. të një veprimtarie të caktuar, të sjelljeve të posaçme etj. Efekti i qortimit, si faktor nxitës në shtimin e produktivitetit të punës, në përmirësimin e rezultateve të punës, varet edhe nga tiparet e personalitetit.

QYTETËRIM, - I. m. Term i kulturologjisë dhe i sociologjisë që përkon edhe me përbërës psikikë dhe si i tillë përdoret në një pjesë të psikologjisë sociale. Këtu qytetërimi është përvetësimi i motiveve humane për sjellje të holla, subtile dhe të qëndrueshme tradicionalisht në një mjedis kulturor. Qytetërimi, si term dhe koncept është më i ngushtë në raport me konceptin dhe termin kulturë.

R

R – shkurtesë për faktorin e përgjithshëm të rezonimit.

R – shkurtesë për reagim.

r – shkurtesë për koeficientin e ndërlidhjes ose të korrelacionit.

RAC/Ë, - A. f. I ardhur në shqip nga latinishtja *ratio* "lloj" ose nga *radix* "rrënjë". Raca emërton veti e tipare antropologjike, biologjike dhe morfologjike të trashëguara, karakteristike për një grup të madh popujsh, sipas të cilave popujt dallohen nga njëri-tjetri sipas ngjyrës së lëkurës, strukturës së flokëve dhe ngjyrës së tyre, gjatësisë së trupit, tipareve të fytyrës dhe vendit ku jetojnë, pavarësisht nga gjuhët e ndryshme që flasin, nga përkatësia kombëtare dhe fetare. Kuptimi i termit racë në psikologjinë sociale është ende i papërcaktuar saktësisht, që shihet në klasifikimin e shumëllojshëm të racave (ka ndarje në tri-, pesë-, gjashtë-, madje edhe në nëntëmbëdhjetë racash). Në pikëpamjen e dallimeve psikike të pjesëtarëve të racave të ndryshme çështja është shumë më e komplikuar dhe nuk ka të dhëna e fakte empirike të verifikuara. Diskutimet lidhur me çështjen e ekzistencës së dallimeve psikike të kushtëzuara nga dallimet antropologjike, biologjike e morfologjike të njerëzve të racave të ndryshme, ende nuk kanë dhënë përgjigje ndaj pyetjeve: Çfarë janë këto dallime psikike dhe çfarë mase psikometrike kanë. Ndikimet ideologjike gjatë periudhave të caktuara kohore kanë qenë të mëdha dhe kanë prodhuar pikëpamje të ndryshme jonjerëzore, si albanofobia, antisemitizmi etj.

RACIAL, - E. mb. Që përcakton përkatësinë raciale të një individi, atë që ka të bëjë me një racë të caktuar. Ky mbiemër haset në këta terma sintagmë të psikologjisë:

a. **Antipatia raciale** – Mosdurim, neveri ose refuzim i një individi ndaj një individi tjetër të një race të veçantë, ndaj pikëpamjes së një individi tjetër që i nuk i përket racës së tij;

b. **Paragjykimi racial** – Lloj i qëndrimit intensiv pa bazë argumentuese dhe me përmbajtje negative ndaj një race të caktuar dhe anëtarëve të asaj race. Ushtron ndikim të fuqishëm negativ (të urryer dhe armiqësor) ndaj sjelljeve

të pjesëtarëve të një race tjetër. Paragjykimi i tillë është antinjerëzor dhe i ndaluar nga OKB me Deklaratën për Racën dhe Paragjykimet Raciale, të miratuar më 27 nëntor 1978 në Paris, në Sesionin e Konferencës së Përgjithshme të OKB-së për Arsim, Shkencë dhe Kulturë;

c. Tipare raciale – Cilësi të qëndrueshme antropometrike dhe biologjike të grupeve të mëdha njerëzore, që janë karakteristike për pjesëtarët e një race të caktuar (ngjyra e lëkurës, e flokëve, gjatësia e trupit, forma e fytyrës, e kafkës etj.).

RACIONAL, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *ratio* " mendje, arsye". Që përcakton atë që i përket mendjes ose arsyes, që mbështetet në mendje , përkatësisht në arsye, që argumentohet me fakte bindëse, që i përket asaj që është kognitive (procesit të mendimit) e jo asaj që është emocionale.

RACIONALIZ/ËM, - MI. m. Në terminologjinë e filozofisë emërton konceptin kryesor të doktrinës filozofike, sipas së cilës e vërteta përfundimtare mund të njihet vetëm me anë të mendjes dhe të mendimit. Burim i dijes dhe kriter i së vërtetës është mendja dhe mendimi njerëzor. Kjo doktrinë, e njohur që nga mendimet e filozofisë së vjetër greke (Platoni, Aristoteli dhe e shtrirë më vonë në mendimet filozofike të Dekartit, Lajbnicit, Spinozës dhe pjesërisht edhe të lingistit e psikologut Avram N. Çomski (Avram N. Chomsky, 1928), i cili ka ndikuar në zhvillimin e psikologjisë së personalitetit, sidomos të psikologjisë kognitive. Mbi këtë doktrinë psikologët Alfred Adler (Alfred Adler, 1870 – 1937), Flojd Olport, (Floyd Allport, 1864 – 1915) dhe Abraham Maslou (Abraham Maslow, 1908 – 1970) zhvilluan sistemin e mendimeve psikologjike për personalitetin dhe zhvillimin e tij.

RACIONALIZIM, - I. m. Mekanizëm mbrojtës i pasuksesshëm që kërkon shkaqet e mossuksesit të një individi në studime, në punë dhe te të tjerët, duke arsyetuar mossuksesin e tij me motive të tjera, shpesh të rangut më të ulët, por të pranishëm në mjedisin shoqëror. Në psikologjinë dinamike ka dy kuptime: 1) Qartësim i një situate të ndërlikuar, shndërrim i një përmbajtjeje konfuze në përmbajtje të qartë dhe 2) Ekonomizimi i një veprimtarie, përmirësimi i cilësisë së efektit të një pune, duke përfshirë edhe organizimin e drejtë të punës dhe përsosjen e mënyrave të asaj pune. Ky kuptim i përket më tepër ekonomisë, por edhe psikologjisë së punës, si edhe asaj të të mësuarit (Të mësuarit është formë pune). Në psikanalizë termi racionalizim emërton mekanizmin mbrojtës me anën e të cilit individi fsheh motivet, sjelljet, ndjenjat etj., duke kërkuar e duke dhënë arsyetime të veçanta për idetë dhe sjelljet e tij të papranueshme për mjedisin e tij. Mossuksesi në një fushëveprim mbulohet, fshihet me një arsyetim të pranueshëm për mjedisin shoqëror, me qëllim të largimit nga turpi dhe nga cenimi i ndjenjës së inferioritetit. Sipas kuptimit të dytë termin racionalizim e hasim në këta togfjalësha terminologjikë të psikologjisë:

a. Racionalizimi i përmbajtjes së mësimit – Të dhënit kuptim në mënyrë të plotë një përmbajtjeje të caktuar mësimore, klasifikimi i fakteve parësore, sistemimi i tyre, identifikimi i

lidhjeve thelbësore ndërmjet tyre etj. dhe angazhimi i plotë i atij që mëson në përvetësimin e përmbajtjeve të tilla kuptimore;

b. **Racionalizimi i mbajtjes mend të një lënde të mësuar** – Konsultimi i pjesëve të paqarta i lëndës së mësuar duke u dhënë kuptim atyre, duke i shndërruar në informacione të qarta dhe duke krijuar lidhje racionale ndërmjet tyre, duke ndryshuar vendin e lidhjet, duke bërë zëvendësimin e informacioneve të paqarta të kujtesës me informacione të duhura etj.;

c. **Racionalizimi i metodave të të mësuarit** – Përcaktimi dhe zbatimi i metodave më të drejta në përvetësimin e përmbajtjeve mësimore, duke zbatuar sidomos metodën e të mësuarit në bazë të zgjidhjes së problemeve dhe të situatave problemore. Ushtron ndikim pozitiv në përsosjen e vazhdueshme të mënyrave të të mësuarit aktiv**.**

RACIZ/ËM, - MI. m. Teori negative që konsideron se raca është përcaktuesja kryesore e qenies së njeriut dhe e vlerave njerëzore të tij. Për këtë shkak duhet bërë dallim midis racave të njerëzve, kombeve, madje edhe midis religjioneve të tyre. Kjo mbron pabarazinë shoqërore, kombëtare, fetare etj., në bazë të pikënisjes së gabuar se ka "raca të larta" dhe "raca të ulëta", popuj e kombe të lartë e të ulët, religjione prestigjioze e joprestigjioze etj. Pjesëtarët e racave, të kombeve, të religjioneve etj. të larta janë të privilegjuar dhe kanë të drejta e liri të veçanta. Nga racistët është konsideruar se: Raca ariane e gjermanëve është racë e komb mbi të gjitha racat e tjera dhe mbi të gjitha kombet! Pjesëtarët e disa racave, kombeve dhe feve janë më inteligjentë se të tjerët etj. Pohime të tilla kanë karakterin e gjykimeve negative të fuqishme që marrin përmasa paragjykimesh, që shkaktojnë diskriminim të drejtuar kundër një grupi të caktuar racor.

RADIASTEZION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *radiare* "rrezatim" dhe nga greqishtja αναισθησία "ndijim". Term me kuptim hipotetik që emërton aftësinë e disa individëve, të cilët me mjete të thjeshta përcaktojnë zonën e ngushtë ku gjendet burimi nëntokësor i ujit, i mineraleve, madje edhe i burimit patogjen të disa çrregullimeve apo sëmundjeve. Për këtë aftësi të karakterit parapsikologjik nuk ka argumente provuese.

RADIKALIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *radix* "rrënjë". I përket më tepër politikologjisë, sociologjisë, shkencave juridike etj., por ka edhe kuptim psikologjik. Radikalizmi është ajo pikëpamje, sipas së cilës kërkohen ndryshime rrënjësore shoqërore dhe ndryshime skajore të raporteve politike, ekonomike dhe shoqërore. Këto ndryshime prekin fushën e motivacionit, të proceseve kognitive, emocionale dhe sjelljeve të lidhura me kërkesa të tilla.

RADIKS, - I. m. Në anatomi i ardhur nga latinishtja *radix* "rrënjë". Me këtë term emërtohet rrënja e nervit, e gërshetës së fijezave nervore, të cilat degëzohen në gjithë sistemin nervor**.**

RADONJIQ Sllavoljub (Slavoljub RADONJIĆ). Lindi në Beograd më 1929. Pas fillimit të studimeve për filozofi i transferoi ato për psikologji në Katedrën e Psikologjisë Eksperimentale të Fakultetit Filozofik të

Universitetit të Beogradit, ku i përfundoi me rezultate të shkëlqyera më 1954 dhe më pas u doktorua për psikologji. Bir i një familjeje intelektuale të Beogradit, njohës i disa gjuhëve të huaja dhe intelektual i mirëfilltë. Asistent, docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar i psikologjisë së përgjithshme në Departamentin e Psikologjisë të Fakultetit Filozofik të Beogradit. U mor më tepër me çështjet teorike të psikologjisë, sidomos me të mësuarit dhe çështjen e biofidbekut. Ka dhënë mësim për studiuesit e psikologjisë të të gjitha niveleve të psikologjisë së përgjithshme, duke u përqendruar më tepër në proceset e larta psikike, si edhe në rolin e të mësuarit në zhvillimin e tyre. Me veprat origjinale dhe me përkthimet e disa veprave apo pjesëve të tyre nga anglishtja ka kontribuar në përhapjen dhe zhvillimin e mendimit psikologjik bashkëkohor në vendet e ish Federatës Jugosllave, duke përfshirë edhe zhvillimin e mendimit psikologjik ndër Shqiptarët e Kosovës. Veprat kryesore të tij janë: *"Transfer učenja"* – (*"Transferimi i të mësuarit"*), 1959; "*Uvod u psihologiju" – Struktura psihologije kao nauke"* – (*"Hyrje në psikologji – Struktura e psikologjisë si shkencë"*), 1968 (ribotuar disa herë); *"Psihologija učenja"* – (*"Psikologjia e të mësuarit"*), 1985.

RADHITJE, - A. f. Term i përgjithshëm që në psikometri ka kuptim të posaçëm. Radhitja emërton konceptin e renditjes së të dhënave dhe vlerave sasiore psikologjike për ndryshoren e matur, si: të dhënat e përftuara nga matja e intensitetit të një ndijimi, të shkallës së zhvillimit të inteligjencies së një grupi të caktuar njerëzish etj. Në raste të tilla bëhet fjalë për të dhënat e një numri të vogël subjektesh (> 30), duke filluar radhitjen nga vlera sasiore më e ulët dhe duke përfunduar në vlerën sasiore më të lartë.

RAJZES–KLAJN Melani (Melanie REIZES–KLEIN). Psikologe austriake. Lindi në Vjenë më 30.03.1882 dhe vdiq në Londër më 22.09.1960. Udhëheqëse ideore e brezit të dytë të psikanalizës, prijëse e klajnizmit. Ka dhënë kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e psikanalizës në Britaninë e Madhe. Ka konceptuar një teknikë të posaçme të psikanalizës së fëmijëve dhe të analizës didaktike, ku psikoterapeuti nuk duhet të luajë rolin e didaktikut, por duhet të krijojë një klimë dhe një atmosferë të lirisë së plotë të shfaqjes së nevojave të fëmijëve. Më 1910 e tërë familja u detyrua të vendoset në Budapest, ku Melania gjeti veprat e Zigmund Frojdit dhe iu nënshtrua psikanalizës nga Shandor Ferenzi. Zigmund Frojdin e njohu më 1918. U detyrua të emigrojë në Londër më 1926 dhe u bë anëtare e Shoqatës Psikanalitike të Britanisë – "British Psychoanalytical Society", duke zhvilluar veprimtari praktike në zbatimin e psikanalizës në shërimin e fëmijëve me sjellje problematike. Nga këtu mblodhi lëndë të rëndësishme për studimin psikanalitik të fëmijëve. Sipas rezultateve të arritura argumentoi se procesi zhvillimor psikik te fëmijët nuk përputhet me konceptin zhvillimor psikanalitik të zhvillimit të fëmijëve. Kjo mospërputhje dallohet sidomos në kumtesën e saj të mbajtur në Kongresin X të Psikanalizës në Insburk "Fazat e hershme të konfliktit të Edipit", ku theksoi zhvillimin e

formave paragjenitale të Kompleksit të Edipit. Sipas saj "fëmija i vogël mund ta shijojë kënaqësinë e plotë vetëm nëse ka aftësi të zhvilluar për dashuri: kënaqësia është themeli i falënderimit. Frojdi mirëqenien e fëmijës nga të ushqyerit me gji e ka përshkruar si shtesë të kënaqësisë seksuale. "Sipas këndvështrimit tim (P.N.) kjo përvojë nuk është vetëm bazë e kënaqësisë seksuale, por edhe baza e të gjithë fatit të mëvonshëm, duke mundësuar ndjenjën e bashkimit me individin tjetër". Veprat kryesore të saj janë: *"The psychoanalysis of Children"* – (*"Psikanaliza e fëmijëve"),* 1932; "*Contributions to Psychoanalysis'* – (*"Kontribute në psikanalizë"*), 1947; "*Developpments de la psychoanalyse"* – (*"Zhvillimi i psikanalizës"),* 1952.

RANG, - U. m. Në statistikë i ardhur nga frëngjishtja *rang* "rend, pozicion". Rangu është pozita që zë një vlerë në një rend vlerash të renditura nga vlera më e lartë në vlerën më të ulët ose përkundrazi, nga vlera më e ulët në vlerën më të lartë të zhvillimit të një tipari të caktuar të personalitetit etj. Ky rend tregon se vlerat janë radhitur sipas madhësisë, por nuk tregon sa është dallimi statistikor ndërmjet syresh. Zbatohet për nevoja të ranxhimit të vlerave, ku vlera më e lartë statistikore e përftuar nga matja e një tipari zë vendin e parë, kurse ajo më e ulëta zë vendin e fundit dhe vlerat e tjera renditen sipas madhësisë së tyre. Ranxhimi mund të jetë dy llojesh:

a. **Ranxhimi i rëndomtë** – Vendi që zë vlera e caktuar (intensiteti i ndijimit, shkalla e zhvillimit të inteligjencies etj.) sipas përcaktimit sasior të tyre, prej vlerës më të madhe te vlera më e vogël dhe përkundrazi. Ky lloj ranxhimi mundëson njohjen e vendit të secilës vlerë brenda një numri të vogël vlerash të përftuara nga matja e një tipari, sjelljeje etj.;

b. **Ranxhimi percentil** – Rendi i suksesit të një individi të caktuar, që përcaktohet duke pjesëtuar dendësinë e përgjithshme kumulative me numrin e përgjithshëm të rasteve të vlerave individuale dhe duke shumëzuar rezultatin me 100. Ranxhimi percentil mundëson krahasimin e saktë, përkatësisht dallimin numerik të saktë ndërmjet vlerave numerike individuale.

RANK Oto (Otto RANK). Psikanalist austriak. Lindi në Leopoldshtadt (rrethinë e Vjenës) më 1884 dhe vdiq në Nju Jork më 1939 (disa javë pas vdekjes së Zigmund Frojdit). Kreu studimet e larta dhe doktoratën, duke u bërë një ndër psikanalistët më të arsimuar dhe nga më të besuarit e Zigmund Frojdit. Një ndër themeluesit e Qendrës së Botimeve Psikanalitike – "Internationaler Psychoanalityscher Verlag", të cilën e udhëhoqi deri më 1924. Me gjithë pikëpamjet e kundërta me Zigmund Frojdin ai mbeti një frojdist i pathyeshëm. Për të psikologjia ishte psikanaliza. Oto Rank më 1926 themeloi teorinë e terapisë aktive, duke u përqendruar më shumë në gjendjen e tashme të pacientit se në të kaluarën e tij. Ky ishte një prej dallimeve ndaj pikëpamjes së Zigmund Frojdit. Dallimi tjetër ishte se Oto Ranku ankthin dhe traumat i shpjegoi mbi bazën e traumës së lindjes, e jo duke kaluar nëpër fazën e Edipit dhe atë të incestit. Psikanalizën e shpjegoi mbi bazën metapsikologjike, por jo të tipit të Zigmund Frojdit. Madje edhe psikologjia

e tij përfaqësonte ideologji kulmore. Veprat kryesore të Oto Rankut janë: *"Das trauma der Geburt"* – (*"Trauma e lindjes"*), 1924; *"Sexualitet und Schuldgefühl"* – (*"Seksualiteti dhe ndjenja e fajit"*), *1926; Technik der Psychoanalyse"* – (*"Teknika e psikanalizës I - III"*), 1926, 1931 dhe 193*6; "Seelenglaube und Psychology"* – (*"Besimi në shpirt dhe psikologjia"*), 1931 etj.

RAPORTI I OBJEKTIVUAR. Marrëdhënie ose raport kryesor i objektivuar është raporti fëmijë – nënë. Këtij raporti psikanaliza i kushton kujdes të posaçëm, e që sipas Zigmund Frojdit është themeli i zhvillimit të raporteve të mëvonshme sociale të njeriut. Frojdi ka vërejtur rëndësinë e përjetimit të hershëm të shtytësve nga ana e fëmijës dhe të perceptimit të energjisë së shtytësve nga ana e tij. Psikanalistët e mëvonshëm, sidomos Melani Klain (Melanie Klein, 1882 – 1960) kanë theksuar rëndësinë e lëvizjes së energjisë së shtytësve nga thellësia intrapsikike drejt objektit të jashtëm. Nga ky raport zhvillohen lidhjet emocionale dhe shoqërore ndërmjet një individi të caktuar dhe të tjerëve, si edhe ndaj gjësendeve. Lidhjet emocionale dhe shoqërore shfaqen edhe si baraspeshë e dashurisë së njeriut ndaj vetes së tij.

RAPORTI KRITIK. Qëndrueshmëri e caktuar në kushte dhe në rrethana të veçanta. Në psikometri raporti kritik përcaktohet sipas raportit të vlerës së caktuar statistikore dhe gabimit standard.

RAST, - I. m. Dukuria, ngjarja, veprimi, tipari etj. i paraqitur një ose disa herë në kushte e rrethana të parapara dhe të jashtëzakonshme. Rast emërtohet edhe individi i jashtëzakonshëm, që kërkon trajtim psikologjik (rasti i Albertit të vogël, i Hansit të vogël në psikanalizë). Prandaj, rasti është fakt, çështje që kërkon gjurmim. Në fushën e gjurmimit rasti është njësi e zgjedhur për gjurmim, sepse ka dhe shkakun e vet.

RASTIT (I, E). mb. Që i përket rastit, që ndodh papritmas, rastësisht, pa dëshirën dhe vullnetin e gjurmuesit etj., si gabimi i rastit ose i rastësishëm. Me këtë mbiemër hasim disa sintagma terminologjike në psikologji:

a. **Dallimi i rastit** – Çfarëdo dallim statistikor ndërmjet dy masave, rezultateve etj. që konsiderohet se është produkt i faktorëve të rastësishëm, dallim që nuk buron nga ndikimi i rëndësishëm i një faktori, i një dukurie, i një veprimi etj.;

b. **Gabimi i rastit** – Lloj gabimi statistikor i paraparë. Gabimi i rastit dallohet nga shmangia e nivelit të lartë të një rezultati apo të një arritjeje nga rezultati i vërtetë. Ky mund të jetë gabim në drejtimin pozitiv (shumë i lartë) ose negativ (shumë i ulët). Në numrin e madh të rasteve të provuara gabimi i tillë neutralizohet dhe përftohet vlera mesatare që pasqyron saktësisht arritjet e grupit të madh të subjekteve të provuara;

c. **Kampioni (gjedhja) e rastit** – Përzgjedhja e atillë e gjedhes, e kampionit, e grupit përfaqësues të një popullate, ku secili anëtar ka mundësi të barabarta dhe të njëjta të bëhet anëtar i asaj gjedhe, i atij kampioni (çdo i treti në radhë, nxjerrja e numrave symbyllazi nga një lodër ose "tupan" i mbushur me numra çift e tek që përfaqësojnë të gjithë anëtarët e atij kampioni etj.).

d. **Të mësuarit e rastit** – Përvetësimi i interesave, qëndrimeve, paragjykimeve, vlerave etj. në mënyrë të rastësishme, në mënyrë të paqëllimshme gjatë përvojës së njeriut dhe në mënyrë jo sistematike. Të mësuarit e rastit është të mësuar joinstitucional dhe jo i organizuar. Ndodh që njëherë të përjetojmë një të papritur dhe këtë e mbajmë mend, ndoshta gjithë jetën, pavarësisht nga fakti që atë të papritur dhe mbajtjen mend të saj nuk e dëshirojmë.

REAGIM, - I. m. Term me përdorim të përgjithshëm i ardhur nga latinishtja *reaction* "kundërveprim". Me këtë kuptim zakonisht përdoret në psikologji. Termi reagim gjendet zakonisht në kuadrin e një sintagme psikologjike, kur merr kuptim specifik, si reagim motorik (lëvizja specifike kundërvepruese e një organi ndaj një stimulimi), reagimi fjalësor (përgjigjja me fjalë ndaj një pyetjeje) etj. Shih – ***KUNDËRVEPRIMI***.

REAGIMI ALARMUES. Faza e parë e sindromës së përgjithshme adaptuese të organizmit, që vihet në veprim nga ndikimi i stresit fizik, fiziologjik e psikologjik. Stresantët e tillë aktivizojnë pjesën simpatike të sistemit nervor autonom.

REAGIMI ANKTHOR. Reagim neurotik i individit ndaj situatave të stresit. Struktura e këtij reagimi ka frikën, trishtimin, ndjenjën e rrezikut, të pafuqisë së njeriut, i cili pret një fatkeqësi të supozuar. Kjo formë ankthore është e lidhur me ndryshime fiziologjike, si dridhja, të marrët mend, aritmia e të rrahurit të zemrës etj**.**

Burimi:

Søren Kierkegaard: *"Koncepti i ankthit,* Tiranë, 2002.
Pencer A. Rathus: *"Temelji Psihologije",* Zagreb, 2001, fq. 549 – 554.
Ylli Pango: *"Psikoterapi",* Tiranë, 2004, fq. 15 – 133.
Charles G. Morris & Albert A. Maisto: *"Psikologjia – shkenca e proceseve mendore dhe e sjelljes njerëzore",* Tiranë 2008, fq. 427 – 430.
Stanley Schachter: *"The Psychology of Affiliation' – ("Psikologjia e afilacionit"),* Standford. California, 1959.
Sigmund Freud: *"Psikoanaliza e histerisë dhe e ankthit",* Tiranë, 2007.
Gordana Stanovska & Myqereme Rusi: *"Psikologjia mjekësore",* Skopje – Shkup, 2001, fq. 60 – 61.
Sadik H. Lala: *"Psikopatologji",* Tiranë, 2013, fq. 129 – 137.

REAGIMI I KUSHTËZUAR. Reagim ndaj dritës elektrike, ngjyrës, tingullit etj. i mësuar nga ana e organizmit pas disa përsëritjeve të lidhjes dritë elektrike-ushqim. Pas përsëritjeve të lidhjes së faktorit neutral (të dritës, ngjyrës, tingullit etj.) organizmi fillon t`i aktivizojë gjëndrat jargore sapo t`i ekspozohet dritës, pavarësisht nëse ushqimi pason pas dritës elektrike, ngjyrës, tingullit etj. Kjo është lidhje e re, reagim i ri, që përpara nuk është gjendur në reagimet e organizmit dhe luan rol të rëndësishëm në përshtatjen apo në adaptimin e organizmit ndaj ndryshimeve të faktorëve mjedisorë. Rezultatet e disa hulumtimeve kanë treguar se reagimi i kushtëzuar nuk është plotësisht i njëjtë me reagimin e organizmit ndaj ngacmuesit të pakushtëzuar (ndaj ushqimit, pastrimit, të organizmit etj.), por ky reagim është disi i modifikuar.

REAGIMI I PAKUSHTËZUAR. Reagim i natyrshëm i organizmit ndaj një lloji të caktuar të ngacmuesit natyror, ngacmuesit të pakushtëzuar: reagimi i tillë ndodh në një organizëm sa herë që vepron një ngacmues i pakushtëzuar si: ushqimi në gojën e organizmit të qenit shkakton reagimin jargor të tij.

REAGIMI IMPLICIT. Reagimi hipotetik i brendshëm i organizmit gjatë një procesi psikik, por i padukshëm nga të tjerët; gjatë të menduarit kemi lëvizje të brendshme të organeve të të folurit, proceset emocionale kryhen në mbështetje të proceseve fiziologjike të gjëndrave me tajitje të brendshme dhe të muskujve që nuk dallohen nga të tjerët etj.

REAGIMI NDAJ STRESIT AKUT. Çrregullim i përjetimeve dhe i sjelljeve të njeriut normal, reagim ndaj situatave të papritura keqbërëse, si fatkeqësia në komunikacion, vdekja e papritur e prindit, e të afërmit, vërshimi i madh etj. Ky reagim ka fazat e veta: reagim pas disa çastesh, orësh, ditësh etj. duke u manifestuar me sjellje çorientuese, me shpërqendrim të vëmendjes, humbje të përkohshme të të menduarit normal dhe të kontrollit të sjelljeve. Pas kësaj faze pason faza e panikut dhe e arratisjes, e shoqëruar me përshpejtim të frymëmarrjes, përshpejtim të qarkullimit të gjakut, me djersitje etj. Këto simptoma zakonisht zhduken pas disa ditësh e jo më shumë se një muaj.

REAGIMI PARAPRIJËS. Reagimi ndaj një ngacmuesi që pritet para se ai të shfaqet, para se ai të ndikojë te shqisat e njeriut. I tillë është reagimi paraprijës i hedhjes së hapave të parë në atletikë, para se të jepet shenja e fillimit të vrapimit etj**.**

REAKTIV, - E. mb. Që i përket një veprimi, që karakterizon një sjellje, e cila emërton atë lloj veprimi që nuk shkaktohet nga një motiv i brendshëm, por zhvillohet si përgjigje ndaj një ngacmuesi, përkatësisht ndaj sjelljeve të një ngacmuesi tjetër. Ky mbiemër haset te këto sintagma psikologjike:

a. **Depresioni reaktiv –** Depresion i shkaktuar drejtpërdrejt nga një ngjarje e rëndë e jetës së njeriut. Ngjarje që shkaktojnë depresion reaktiv mund të jenë: sëmundja e rëndë, vdekja e bashkëshortes, e nënës, humbja e gjithë pasurisë etj.;

b. **Formacioni reaktiv –** Mekanizëm mbrojtës që ka të bëjë me qëndrimet, tiparet, vlerat personale të murosura, të cilat i kundërvihen, pengojnë shfaqjen e një dëshire, shtytësi të shtypur në sferën e pavetëdijes së njeriut. Kështu, tipari i pastërtisë së tepruar është kundërvënie, përkatësisht mbrojtje ndaj impulseve të pavetëdijshëm të ndotësisë. Formacioni reaktiv në ndryshim nga shtypja e dëshirave, e ndjenjave etj., shpie në ndryshime sjelljesh të përhershme;

c. **Inhibimi reaktiv –** Frenimi i veprimtarisë si kundërpërgjigje ndaj punës së tepërt e të lodhshme. Një frenim i këtillë është i pranishëm sidomos gjatë të mësuarit të përqendruar për njëfarë kohe (kur nxënësi a studenti mëson ditë e natë para provimit, ngaqë këtë nuk e ka bërë çdo ditë gjatë vitit shkollor. Termi inhibicion reaktiv i përket teorisë së të mësuarit të psikologut amerikan Klark I. Hulit (Clark I. Hull, 1884 – 1952);

d. **Neuroza reaktive –** Çrregullim relativisht i qëndrueshëm i procesit emocional që shfaqet kryesisht me ankth, me drojë të madhe, me frikë etj. Neuroza e tillë është reagim, përgjigje e lindur ndaj përjetimit të një situate stresante. Kjo neurozë mund të zhduket vetvetiu, përpos rasteve të rënda;

e. **Psikoza reaktive** – Çrregullim i rëndë shpirtëror me kohëzgjatje të paparashikuar që lind si rezultat i shtypjes së rëndë e me kohëzgjatje të tepërt të kërkesave të mjedisit shoqëror, të përjetimit të një situate të rëndë stresante dhe të papritur, si: dhunimi seksual nga një i afërm i familjes, tortura, lindja e fëmijës nga nëna me babë të huaj etj. Psikoza reaktive gjendet në skajin e kundërt të psikozës endogjene;

f. **Tipi reaktiv –** Tip i njeriut, të cilin e karakterizon mbisundimi ose zotërimi e sjelljeve si reagim ndaj sjelljeve të të tjerëve. Për tipin reaktiv parësor është reagimi ndaj ngacmuesve të jashtëm, sidomos ndaj atyre sjelljeve të të tjerëve që prekin, ngacmojnë e kanë lidhje me personalitetin e tij.

REAL, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *res* "sendor, gjësend". Përcakton të gjitha gjësendet, dukuritë e raportet që janë lëndore, të njëmendta, që ekzistojnë jashtë njeriut në mjedisin e ngushtë e të gjerë fizik, biologjik, shoqëror dhe psikik. Përcakton vetëm ato që nuk gjenden në mendime, në imagjinatë dhe në teorinë e njëmendësuar.

REALITET, - I. m. Tërësia, universi i gjithë asaj që ekziston në hapësirë dhe në kohë dhe që mund të vëzhgohet, madje edhe të maten aspektet e një strukture fizike, biologjike, shoqërore dhe psikike të secilës pjesë të këtij universi. Njeriu është në raport të vazhdueshëm me realitetin e tillë. Humbja e këtij raporti nga ana e njeriut është simptomë kryesore e sëmundjeve dhe e çrregullimeve të rënda psikike, në rend të parë kjo është simptomë e skizofrenisë. Në psikologji theksohet realiteti subjektiv i këtij universi, por bëhet dallimi ndërmjet realitetit objektiv dhe realitetit subjektiv:

a. **Realiteti objektiv** – Tërësia e gjësendeve dhe e dukurive, të njohura e të panjohura, si edhe uniteti i tyre që janë objekt i praktikës njerëzore dhe ekzistojnë jashtë njeriut dhe pavarësisht nga vetëdija e tij;

b. **Realiteti subjektiv** – Tërësia e të gjitha formave të psikikës së njeriut (e dukurive, e proceseve, e motiveve dhe e sjelljeve të njeriut). Nga realiteti subjektiv duhet dalluar realiteti psikik që ka kuptim më të gjerë, sepse përfshin të gjitha format e zhvillimeve psikike te njerëzit dhe te kafshët.

REALIZ/ËM, - MI. m. Term që përdoret në të folurit e përditshëm, në filozofi, në sociologji, në psikologji etj. Në të folurit e përditshëm ka kuptimin e karakteristikës së mendimit dhe të folurit të njeriut të kthjellët nga mendja, me qëndrim real ndaj objekteve, dukurive, proceseve e raporteve objektive të mjedisit të tij, ndaj të tjerëve dhe ndaj vetes dhe sjelljeve të tij. Në filozofi, në teorinë e njohjes realizmi është pikëpamje filozofike, sipas së cilës bota e jashtme është qenie, realitet që ekziston i pavarur nga njeriu, pjesë e të cilit është edhe ai vetë, dhe nga dija e tij, nga perceptimi dhe nga mendja e njeriut. Përmbajtja e mendjes së njeriut është pasqyrim i realitetit, përkatësisht konceptet abstrakte kanë ekzistencë, sepse kanë lidhje të

drejtpërdrejtë me ekzistencën reale. Në psikologji termi realizëm lidhet më tepër me psikologjinë e njohjes së realitetit nga ana e fëmijës dhe e zhvillimit mendor të tij. Këtu termi realizëm përdoret për të emërtuar mendimin karakteristik të fëmijëve, për t`i dhënë dukurive e proceseve psikike karakter real. Karakterizon fëmijët e moshës parashkollore e deri rreth moshës gjashtë vjeç.

REALIZIM, - I. m. Akt veprues, sjellje e njeriut me të cilën dëshira, ideja, ideali, përfytyrimi, synimi, shpresa, vendimi etj. shndërrohen në realitet. Këto sjellje të njeriut me synim të posaçëm parashikues janë sjellje të vullnetshme të tij.

REBELIM, - I. m. Në sociologjinë dhe psikologjinë sociale emërton konceptin e sjelljeve të një grupi njerëzish që përcaktohen t`i kundërvihen synimeve të zhvillimeve ekonomike, juridike, kulturore, shoqërore etj., duke kërkuar formimin e qëndrimeve dhe të sjelljeve të kundërta, kundër rrugëve dhe mjeteve të miratuara për realizimin e tyre.

RECEPTIV, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *recipere* "marr", por me përdorim relativisht të madh në literaturën e psikologjisë. Me këtë mbiemër emërtohet karakteristika e atij individi, i cili ka aftësinë për të pranuar (marrë) energjinë e trupit ndikues në shqisa dhe për ta shndërruar këtë në impuls nervor, duke shkaktuar ndjijimin specifik të këtij ndikuesi.

RECEPTOR, - I. m. Në anatomi i ardhur nga latinishtja *receptor* "marrës, grumbullues". Receptorët janë qeliza nervore ose pjesë të specializuara të tyre për marrjen e energjisë së ngacmuesit të shqisave dhe shndërrimit të saj në impuls nervor, që me anën e pjesëve skajore të nervit prurës i bartin këto impulse deri në qendrat nervore të cipës së trurit të madh. Ky është funksion i përgjithshëm i qelizës nervore receptore. Në këtë grup qelizash hyjnë qelizat specifike të organeve shqisore të periferisë së organizmit (konet dhe shkopthat në retinën e syrit, qelizat dridhëse në organin e Kortit, puprritë në gjuhë etj., qelizat proprioreceptore të ngacmuesve të brendshëm, si receptorët kinestetikë, qelizat dridhëse në kanalet gjysmëharkorë të veshit të brendshëm etj. Qelizat e tilla dhe pjesët e tyre janë specializuar gjatë zhvillimit evolutiv për funksionet specifike të tyre**.**

RECEPTORËT ALFA. Lloj receptorësh që funksionojnë nën ndikimin e adrenalinës. Receptorët alfa janë lloj molekulash të karakterit të receptorëve kimikë në cipën e qelizave nervore dhe të qelizave të muskujve, të cilët, gjatë veprimit të noradrenalinës mundësojnë bartjen e impulseve nervore nga një qelizë nervore në tjetrën ose nga qelizat nervore në qeliza të muskujve.

RECEPTORËT BETA. Receptorë në cipën e qelizave trunore dhe të qelizave muskulore. Ngacmimi i tyre shkakton kontraktimin e ngritur të muskulit të zemrës dhe relaksimin e muskujve skeletorë. Funksioni i tyre ndaj ngacmuesve dallohet sidomos në bronket dhe në organet e sistemit të tretjes së ushqimit.

RECEPTORËT MEKANIKË. Receptorë që energjinë mekanike që ndikon

në shqisat e njeriut e shndërrojnë në impulse nervore. Në grupin e receptorëve mekanikë hyjnë: receptorët e dëgjimit, të të prekurit, proprioreceptorët e vendosur në muskuj, në eshtra dhe në kërcinj dhe receptorët e qarkullimit të gjakut nëpër arterie.

RECEPTORËT OLFAKTORË. Tërësi nervash boshtorë që gjenden në epitelin e pjesës së sipërme të hundës dhe që pjesët e tyre i mbulon cipa e brendshme e hundës.

RECEPTORËT OPIATË. Sot bëhet fjalë edhe për receptorë të posaçëm të opiateve, që konsiderohet se janë tri llojesh: receptorët *mi*, *delta* dhe *kappa*. Këta gjenden në pjesët pas-sinaptike të trurit, si në amigdala anterior, hipotalamus dhe në pjesët qendrore të përhimëta të trurit.

RECEPTORËT TAKTILË. Receptorët e të prekurit, receptorë që reagojnë ndaj trupave të ngurtë, të lëngët dhe flurorë kur këta ndikojnë në lëkurën e njeriut, përkatësisht në një pjesë të saj. Receptorët taktilë përbëjnë grupin e qelizave të ndjeshme, të vendosura në shtresën e jashtme të lëkurës së njeriut. Këta janë disa llojesh: puçërrzat Majsner, mbaresat e nervave të lirë, nyjat e rrënjëve të qimeve të lëkurës, pllakat e qelizave Merkel etj. Këta receptorë janë të shpërndarë dhe të përqendruar në forma me dendësi të ndryshme në pjesët e lëkurës. Më të dendur janë në majat e gishtërinjve, në buzë, në majën e gjuhës etj.

RECESIV, - E. mb. Që përcakton atë strukturë apo funksion që është i përmbajtur, që nuk arrin të vijë në shprehje, sepse nuk është strukturë apo funksion mbisundues ose dominues. Termi i përket më tepër gjenetikës, por ka përdorim edhe në psikologjinë zhvillimore. Në togfjalëshin gjeni recesiv ka kuptim të veçantë: gjeni recesiv – gjen në çiftin e gjeneve që nuk arrin të bëhet gjen aktiv nga prania dhe funksioni mbisundues në çiftin hererozigotë. Kjo ndodh ngaqë struktura dhe funksioni i këtij gjeni mbulohet me gjenin dominues. Nga çifti dominues i gjenit shfaqet tipari i organizmit, që i përket atij gjeni. Nëse bashkohen gjenet e njëjta të dy prindërve me sy me ngjyrë të kaltër, atëherë edhe pasardhësi i tyre, pavarësisht se dy prindërit i përkasin racës së bardhë ose racës së zezë, do të ketë sy të kaltër.

RECIDIVIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *recidivus* "që shfaqet rishtas, që kthehet në gjendjen e vjetër". Ky term i përket më tepër mjekësisë dhe psikiatrisë për të emërtuar çrregullimin fiziologjik a psikiatrik që shfaqet përsëri pas shërimit të atij çrregullimi dhe sëmundjeje. Recidivizmi me kuptim të tillë përdoret edhe në psikologjinë forenzike, kur i dënuari ka kryer me muaj a me vite burg, pas lirimit nga burgu përsërit sjelljet e krimit për të cilat më parë ka qenë dënuar.

RECIPROCITET, - I. m. Raport marrëdhëniesh ndërmjet dy dukurive, çështjeve, qëndrimeve, trupave etj., ku elementet e tyre veprojnë në koordinim të kundërt njëri me tjetrin. Në psikofizikë kohëzgjatja dhe intensiteti i një ngacmuesi në shqisën e caktuar janë në raport reciprok me njeri-tjetrin dhe çojnë në procesin e ndijimit. Në psikologjinë kognitive dhe në pikëpamjen e zhvillimit të vlerave etike

të psikologut zviceran Zhan Pijazhes (Jean Piaget, 1896 – 1980) reciprociteti ka këtë kuptim: një faktor mund të eliminohet ose të kontrollohet me qëllim të gjurmimit të tjetrit, më pas mund të kthehet prapë. Ky proces paraqitet pas fazës formale-operacionale. Në zhvillimin e vlerave morale, këto mund të zhvillohen në raportin reciprok të tipit "ti mua, unë ty". Termi reciprocitet, duke ruajtur kuptimin themelor, në teorinë e zhvillimit të qëndrimeve dhe të ndryshimit të tyre merr konotacion të posaçëm: njeriu përpiqet t'i zgjidhë qëndrimet e kundërta duke i lidhur ato ndërmjet tyre dhe duke vendosur baraspeshë ndërmjet syresh. Kjo është teoria e psikologut amerikan me origjinë austriake Fric Hajderit (Fitz Heider, 1896 – 1998).

RECIPROK, - E. mb. Që tregon raportin e ndërsjellë ndërmjet dy dukurive, dy trupave, dy veprimeve etj., ku elementet e njërit trup, veprim apo dukuri veprojnë në drejtim të kundërt ndaj elementeve të trupit, veprimit apo dukurisë tjetër.

RECITIM, - I. m. Term i ngulitur edhe në stilistikën e shqipes, i ardhur nga latinishtja *recitare* "lexoj". Recitimi emërton kuptimin me zë të një vjershe, të përmbajtjes së një proze, të një liste rrokjesh për gjurmimin e mbajtjes mend të tyre etj. Recitimi ka kuptimin e të thënies me zë të përmbajtjes së tyre përmendësh.

REDUKSIONIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *reduction* "kthim në fillim, duke filluar nga fillimi". Reduksionizmi është pikëpamje e përgjithshme, sipas së cilës për njohjen e formave të ndërlikuara të proceseve, të sjelljeve, të rregullsive, të ligjshmërisë së tyre etj., këto duhen shndërruar në forma më të thjeshta të niveleve më të ulëta. Reduksionizmi ka gjetur zbatim edhe në psikologji. Sipas reduksionizmit dukuritë psikike, proceset e ndërlikuara psikike dhe sjelljet e tilla mund të njihen duke i zbërthyer në njësi më të thjeshta, përkatësisht duke i rrëgjuar konceptet psikike në koncepte elementare të psikologjisë. Kështu, psikologjia strukturaliste i ka rrëgjuar proceset e ndërlikuara psikike në ndërlidhje të tre elementeve: të ndijimeve, të ndjenjave dhe të përfytyrimeve. Refleksologjia i ka rrëgjuar veprimet dhe sjelljet e ndërlikuara në reflekse të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara. Reduktimi i motiveve është shpjegimi i motiveve dhe i intensitetit të tyre në bazë të aktivitetit të indeve të organeve të organizmit etj.

REDUKSIONIZMI PSIKOLOGJIK. Shpjegim i dukurive, i proceseve, i strukturave psikike e funksionimi i tyre në bazë të pohimeve ose parimeve themelore të proceseve psikike dhe të sjelljeve. Në fillim të zhvillimit të psikologjisë proceset psikike, strukturat dhe funksioni i tyre u shpjeguan në bazë të rregullsive dhe ligjeve të dukurive dhe proceseve fiziologjike. Ky reduktim ka të bëjë me problemin e raportit ndërmjet dukurive psikike me ato fiziologjike. Ky lloj reduksionizmi përforcoi mendimin dhe qëndrimin për ekzistencën e aktivitetit psikik në bazë të lidhjes së tij me atë të trurit. Sipas këtij reduksionizmi vetëm shpjegimet fiziologjike janë të vlefshme për njohjen e jetës psikike dhe të dukurive të saj. Më pas reduksionizmi u mor me njohjen dhe me shpjegimin e nivelit

më të thjeshtë dhe më të ulët të veprimeve të organizmit për të kuptuar dhe shpjeguar ato më të ndërlikuarat. Harresa shpjegohej me asgjësim ose "fshirje" të gjurmëve në trurin e njeriut. Rrjedhimisht edhe psikologjia dhe lënda e studimit të saj reduktohet në fiziologji, në biokimi, në fizikë dhe në kimi. Por, një shpjegim i tillë është i pamundur. Pamundësia e shpjegimit të tillë dallohet sidomos në lëndën e psikologjisë sociale dhe në atë të psikologjisë së tipareve të personalitetit, të zhvillimit dhe organizimit të tyre, që nuk kanë të bëjnë me procese dhe me funksione fiziologjike**.**

REDUNANC/Ë, - A. f. Në teorinë e informatikës dhe të psikolinguistikës i ardhur nga latinishtja *redunatio* "shumicë". Emërton raportin ndërmjet numrit të shenjave, të fjalëve etj. dhe numrit të informacionit apo të porosisë që mbajnë dhe bartin ato shenja, ato sinjale nga një vend në vendin tjetër. Sa më shumë shenja ka një porosi që bartet prej një vendi në tjetrin, prej një individi te tjetri, aq më e vogël është redunanca. Shenjat, fjalët, sinjalet etj. janë bartëse të informacionit. Ka raste kur të shkruarit e një informacioni, të një porosie etj. është i rrëgjuar në një numër të vogël shenjash për shkak të rregullave gramatikore, ortografike, sintaktike etj.; në tastet e tilla redunanca është më e madhe. Tepria e shenjave, e fjalëve, e sinonimeve etj. përballë numrit të informacionit që bartet nga ana e tyre mundëson sqarimin shkoqitjen e një informacioni nga tjetri. Kjo është pasuri e një gjuhe. Kështu, redunanca e gjuhës angleze është 75 %, d.m.th., kjo gjuhë ka 25 % shenja, fjalë, sinjale etj. më tepër se numri i informacioneve që bartin ato shenja (shumë prej shenjave mund të mos përdoren dhe informacioni të jetë i plotë, informacion i kuptueshëm, që bartet në kanalin e komunikimit në këtë gjuhë). Gjuha shqipe ka më pak redunancë, por gjithsesi numri i redunancave është më i madh se numri i informacioneve, i porosive që bartin ato. Këto raporte në shqip duhen studiuar.

REFERENC/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *refere* "bart prapa". Burim mbështetës i theksuar në gjurmime psikologjike, e përgjithësisht në gjurmime shkencore. Referencat e tilla kanë vlerë teorike dhe praktike; mund ta drejtojnë veprimtarinë e gjurmuesit në një qëllim ose objektiv të posaçëm gjurmues, mund të përforcojnë rezultatet e një gjurmimi duke u thirrur në një pikëreferimi të caktuar. Pikëreferimi mund të jetë një koncept me termin e vet. Ka raste kur i referohemi një qarku të gjerë qëndrimesh, standardesh, vlerësimesh etj.

REFLEKS, - I. m. Formë e reagimit të thjeshtë dhe të lindur ndaj ngacmuesve që ushtrojnë ndikim në organizëm ose në një organ të tij. Termi refleks është ngulitur në gjuhën shqipe, i ardhur nga latinishtja *refektio* "kthej". Ky reagim lind kur ngacmimi nervor shtrihet prej receptorëve deri në efektor, përkatësisht deri në muskuj dhe gjëndra, nëpërmjet rrugëve neurale që janë të trashëguara dhe karakterizojnë llojin e caktuar të kafshëve. Baza organike e reflekseve është e përbërë nga strukturat nervore dhe rrugët nervore të trashëguara. Me anë të reagimeve refleksive kryhen proceset rregulluese

të baraspeshimit fiziologjik brenda organizmit. Reflekset janë forma mbisunduese të reagimeve te kafshët e nivelit të ulët evolutiv, kurse te kafshët e nivelit më të lartë mbisundojnë forma sjelljesh dhe veprimesh më të ndërlikuara që përvetësohen gjatë jetës, përvojës dhe dijeve. Refleksi te njeriu është forma më e ulët e reagimit të pavetëdijshëm të organizmit të gjallë ose i një organi të tij ndaj një ngacmuesi të jashtëm. Për të kuptuar zhvillimin e sjelljeve dhe të veprimeve të shumëllojshme dhe të ndërlikuara të njeriut duhen njohur reagimet refleksive dhe raporti i tyre me sjelljet e tjera.

REFLEKSI I KUSHTËZUAR. Term i shkollës fiziologjike ruse të Vlladimir Behterevit (Vladimir Behterev, 1857 – 1927) dhe Ivan P. Pavllovit (Ivan P. Pavlov, 1649 – 1836). Refleksi i kushtëzuar është reagim i kushtëzuar, sipas tipit të reagimit të kushtëzuar. Shih – ***REAGIMI I KUSHTËZUAR***. Sot termi refleks i kushtëzuar është zëvendësuar me termin reagim i kushtëzuar.

REFLEKSI MORO. Veprim refleksiv por i ndërlikuar. Refleksi Moro shfaqet me dridhje të organizmit të foshnjës kur atë e lëshojmë nga lart poshtë. Me këtë rast te foshnja shfaqet refleksi i shtrirjes së duarve me shuplaka të hapura dhe me gishtërinj të shtrirë, dhe më pas duart i mbledh në formë të përqafimit. Refleksi Moro shfaqet brenda dy muajve dhe më pas zhduket. Është pasojë e reliktit të njerëzve majmunë që kapeshin pas degëve të drunjve. U zbulua nga pediatri austriak Ernst Moro, 1874 – 1951).

REFLEKSI PATELAR. I ardhur nga latinishtja *patella* "kockë e kupës së gjurit, patelë". Refleksi patelar është reagim i posaçëm dhe automatik i pjesës poshtë gjurit, dridhje dhe shtyrje përpara e kësaj pjese, kur gashtellës i bihet me çekiç gome. Refleksi patelar është refleks kryesor në vëzhgimet mjekësore të zhvillimeve neurologjike të fëmijëve. Refleksin patelar e ka hulumtuar psikologu amerikan Edvin Tvitmejer (Edwin B. Twitmeyer, 1873 – 1943) lidhur me gjurmimin e refleksit të kushtëzuar.

REFLEKSI PLANTAR. I ardhur nga latinishtja *plantaris* "tabanor, i tabanit të këmbës" dhe *reflexus* "reflektim, jehonë". Refleksi plantar është reagimi i i lindur i fëmijës që shfaqet pas një viti e më tej. Ky refleks shfaqet me tërheqjen poshtë të gishtërinjve të këmbës kur nën tabanin e këmbës tërheqim një copëz pëlhurë, një laps etj. Reagimi i tillë është shenjë e mielinizimit të rregullt dhe përfundimtar të rrugëve nervore prej kokës deri në fund të këmbëve.

REFLEKSI STATIK. Reagim refleksiv ndaj ndryshimit të vendndodhjes së trupit. Ky reagim ka të bëjë me mbajtjen drejtë të trupit të njeriut në gjendje normale fiziologjike e psikike dhe shërben për ta drejtuar atë. Kur ky reagim e kthen trupin e njeriut në pozicionin normal emërtohet refleks korrigjues.

REFLEKSION, - I. m. Term me kuptim të përgjithshëm dhe të veçantë. Kuptimi i përgjithshëm ka të bëjë me përsiatjen e njeriut mbi përvojën e tij për një ngjarje, objektiv, situatë etj. dhe për rëndësinë e vlerën e saj. Në psikologji emërton tiparin e personalitetit që shfaqet në përmbajtjen e reagimit

të menjëhershëm ndaj një problemi, duke menduar thellë për mënyrën e zgjidhjes, për efektet e zgjidhjes etj. Ky është proces subjektiv i njohjes së proceseve psikike dhe sjelljeve të vetëdijshme të njeriut. Në literaturën e psikologjisë haset edhe sinonimi i vetvëzhgimit. Shih – ***PËRSIATJE.***

REFLEKSIONI I NDJENJAVE. Formë e terapisë jodirektive që është teknikë terapeutike, e cila ka të bëjë me përsëritje mendimesh e shprehjesh të tyre nga ana e pacientit, duke vënë theksin posaçërisht në anët emocionale të tyre.

REFLEKSIVITET – IMPULSIVITET. Term i psikologjisë kognitive që ka kuptimin e përmasës së stilit kognitiv, sipas të cilit disa tipa njerëzish priren që, kur gjenden në një situatë problemore disa prej tyre nuk reagojnë menjëherë ndaj asaj që kërkohet, por mendojnë, thellohen në mendime për natyrën e problemit dhe për atë çfarë kërkohet në atë problem etj. Disa të tjerë janë impulsivë, e reagojnë menjëherë ndaj situatës problemore.

REFLEKSOLOGJI, - A. f. I ardhur nga latinishtja *reflexio* "kthim" dhe *logos* "mendim, fjalë". Doktrinë e psikologjisë sipas së cilës veprimtaria e gjithëmbarshme psikike duhet të studiohet objektivisht në bazë të vëzhgimit sistematik hulumtues të veprimeve të kafshëve dhe të sjelljeve të njerëzve, duke u mbështetur në mekanizmin e formimit të reflekseve të kushtëzuara dhe lidhjeve të shumëllojshme të tyre. Baza e kësaj doktrine është rrëgjimi ose reduktimi i aktivitetit të gjithëmbarshëm në harkun refleksiv, ku pjesa dërrmuese e tij është rruga aferente - eferente. Kjo doktrinë mekanike i ka mohuar tërësisht përjetimet e brendshme të njeriut (procesin e mendimit, të emocioneve, të motiveve etj.) dhe u shfrytëzua shumë nga rryma e shkolla bihejvioriste. Termi refleksologji u përdor për herë të parë nga vazhduesi i studimeve të shkollës fiziologjike ruse Vladimir M. Behteriev (Vladimir M. Behteriev, 1857 – 1927), fiziolog dhe neurolog rus. I ka kontribuar zhvillimit të psikologjisë në dekadat e para të shekullit të njëzet. Edhe psikologu francez Teodil Ribo (Theodule A. Ribot, 1839 – 1916) ka konsideruar "refleksi është baza e aktivitetit psikik". Kjo doktrinë më vonë u kritikua dhe tashmë përmendet si doktrinë që i përket së kaluarës.

REGRES, - I. m. I ardhur nga latinishtja *regressio* "kthim prapa, prapavajtje, zmbrapsje, (e kundërta e progresit)". Në kuptimin e përgjithshëm ka të bëjë me atë lloj lëvizje që e kthen prapa zhvillimin, që kthehet në fazat e hershme të zhvillimit, përkatësisht kur i rrituri shfaq sjellje të fazës së fëmijërisë së tij, si të qarit, kur njeriu has në pengesë të fuqishme, që vështirë të zotërohet. Një kuptim i tillë i termit regres i jep regresit karakterin e mekanizmit mbrojtës. Termi regres është përdorur shumë në psikanalizë. Në psikanalizë termi regres emërton tërheqjen e libidos së njeriut të rritur, në qëllimin apo objektivin e fazave më të hershme të zhvillimit psikoseksual të tij. "Sa më të fuqishme të jenë pengesat që has njeriu, aq më shumë bëhet i paaftë për t`i zotëruar ato" dhe, për këtë, ai tërhiqet dhe kthehet në një fazë më të hershme të zhvillimit. Në statistikë termi regres ka kuptimin e

kthimit të një vlere statistikore të një ndryshoreje në të mesme aritmetike. Kjo ndodh në rastet kur raporti ndërmjet dy ndryshoreve zvogëlohet, kur koeficienti i ndërlidhjes ose i korrelacionit ndërmjet dy ndryshoreve vjen duke u zvogëluar. Në psikologji hasen këto lloj regresesh:

a. **Regresi i kujtesës** – Humbje e aftësisë së të mbajturit mend, të rinjohjes dhe riprodhimit të asaj që njeriu e ka përjetuar nga e kaluara jo e largët dhe ruajtja e asaj, që ai e ka përjetuar nga e kaluara e hershme të tij. Shfaqet në moshën e thyer të njeriut;

b. **Regresi i lëvizjeve të syrit** – Koha e kthimit prapa të lëvizjeve të syrit gjatë leximit të një teksti. Lëvizjet e tilla bëhen me qëllim të perceptimit të drejtë të fjalëve të shkruara; këto shfaqen më shpesh te lexuesit e paushtruar;

c. **Regresi i mendimit** – Kthimi prapa i mendimit prej përfundimit të miratuar në të provuarin e premisave nga të cilat është nxjerrë përfundimi;

d. **Regresi i sjelljeve** – Paraqitje e formave më të ulëta, më primitive të sjelljeve, nga ato që janë më të pjekura dhe më të kultivuara;

e. **Regresi i shprehive** – Dobësim i bashkërenditjes, i lidhjes së lëvizjeve dhe rënia e saktësisë, e shpejtësisë së ekzekutimit të tyre në shkallë më të ulë**t.**

REGRESION, - I. m. Mekanizëm mbrojtës i suksesshëm që i kthen, i zmbraps sjelljet e një të rrituri në sjellje fëmijësh: p.sh., një grua në moshë qan jo prej pikëllimit, por nga përjetimi i frustrimit me qëllim të përforcimit të egos së saj.

REGJIMI I PUNËS. Sistem rregullash të veprimeve bashkërenditëse të punës së një grupi punëtorësh. Përmbajtja dhe rendi i këtij sistemi, si edhe zbatimi i plotë i regjimit të punës të konceptuar në këtë sistem i kontribuon mirëvajtjes së punës dhe shtimit të produktivitetit të saj. Përvetësimi i këtij sistemi dhe, sidomos, zbatimi i tij,është i lidhur ngushtë me motivacionin për punë.

REGJION, - I. m. Term i gjeografisë që e hasim edhe në teorinë topologjike të psikologjisë së Kurt Levinit (Kurt Lewin, 1890 – 1947), psikologut gjerman që jetoi në SHBA, i cili me termin regjion emërtoi fushën hapësinore të kufizuar të jetës së njeriut ku vijnë në shprehje të gjitha mendimet, ndjenjat, motivet, synimet dhe sjelljet e tij. Janë diferencuar këto lloje regjionesh:

a. **Regjioni i brendshëm** – Tërësia e "botës së brendshme" të njeriut. Përfytyrimet, përjetimet, përjetimet emocionale, përmbajtjet e kujtesës, mendimi dhe format e përmbajtjet e tij, motivet, nevojat dhe sjelljet e njeriut të rrethuara me regjionin perceptiv - motorik;

b. **Regjioni perceptiv -motorik** – Rruga përmes së cilës kalon lidhja e botës së brendshme të njeriut me mjedisin apo hapësirën jetësore të tij. Regjioni perceptiv-motorik e rrethon plotësisht regjionin e brendshëm të njeriut;

c. **Regjionet personale** – Regjione me përmbajtje interesimesh, motivesh, nevojash, vlerash etj. të një individi të caktuar që jeton dhe vepron në një hapësirë jetësore, e cila është e interesuar pak ose nuk është e interesuar fare për strukturat psikike personale dhe për funksionet e tyre, sepse ka përkufizimet e veta kulturore, morale etj.

REGJIONET E HAPËSIRËS JETËSORE. Të gjitha format e sjelljeve, përfshirë edhe format potenciale të tyre, që njeriu mund t`i ekzekutojë dhe mund t`i paramendojë në një hapësirë të caktuar. Disa nga regjionet e tilla të njeriut janë pozitive, disa negative, por ka edhe të paanshme për nga vlera e tyre. Të gjithë cepat e regjionit të hapësirës jetësore nuk janë njësoj të përshtatshme dhe të vlefshme për secilin prej pjesëtarëve të një regjioni të caktuar.

REGJISTRIMI I TË DHËNAVE. Shënim i përpiktë dhe sistematik i të dhënave të përftuara nga matja e ndryshoreve psikike që hulumtohen. Regjistri i tillë përfshin këto elemente të dhënash: kohëzgjatja, intensiteti, kushtet e paraqitjes dhe rrethanat e zhvillimit të procesit të gjurmimit të ndryshoreve. Për gjurmime të veçanta, ku numri i të dhënave është i madh dhe mënyra e regjistrimit duhet të jetë e shpejtë dhe e saktë, sot zbatohen forma të ndryshme regjistrimesh të të dhënave me aparate të posaçm**e.**

REHABILITIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *re* "prapa" dhe *habilitas* "përshtatshmëri". Rehabilitimi është rikthim i organizmit, i një organi apo sistemi organesh në gjendje të rregullt funksionimi. Ky term ka zbatim të gjerë. Në psikologji përdoret më shpesh me kuptimin e rikthimit në gjendje të rregullt funksionale dhe më pak zbatohet kuptimi i termit rehabilitim, rikthim në gjendjen e mëparshm**e.**

REINKARNACION, - I. m. I ardhur nga latinishtja që i përket spiritualizmit, por ka kuptim psikologjik. Reinkarnacioni është besimi dhe bindja e disa njerëzve, sipas të cilëve shpirti i njeriut pas vdekjes qëndron një kohë në botën tjetër dhe pastaj zbret në tokë. Këtu bashkohet me një trup tjetër njeriu.

REKLAMIM, - I. m. Mjeshtri e rritjes së konsumatorëve të një malli, procesi i shtimit të numrit të konsumatorëve të një lloji malli. Nxit aktivitetin e njeriut të drejtuar dhe të organizuar në blerjen e një lloji të caktuar të artikujve ushqimorë, të mobilieve, të veshmbathjes etj. Kjo prek fushën e ndjenjave, të qëndrimeve dhe të sjelljeve pozitive ndaj llojit të caktuar të mallrave. Për këtë shkak reklamimi nuk është vetëm koncept ekonomik, ndoshta ky është më pak ekonomik se psikologjik, sepse reklamimi synon njohjen e mallit dhe të cilësive të mira e tërheqëse të tij, tërheqjen e njeriut dhe sjelljen pozitive ndaj tij, e pikërisht blerjen e atij malli.

RELACION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *relatio* "lidhor", që ka lidhje apo kushtëzohet nga tjetri, që ka të bëjë me diçka tjetër, që ekziston ndërlidhja ndërmjet dukurive, kushteve, ngjarjeve etj., ku dukuria paraprake është kusht i lindjes, i shfaqjes së dukurisë pas saj, ku ndryshimi i së parës shkakton ndryshimin e dukurisë që rrjedh pas saj**.**

RELACIONAL, - E. mb. Që i përket relacionit, marrëdhënies, raportit ose raporteve. Termi relacional emërton më tepër të kuptuarit e ndërlidhjeve ndërmjet faktorëve, kushteve, informatave etj.

RELACIONI FUNKSIONAL. Raporti ndërmjet dy ndryshoreve, sipas të cilit ndryshimet e një ndryshoreje shkaktojnë ndryshime në ndryshoren tjetër.

RELAKSIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *relaxati* "çlodhje". Procesi i lëshimit të lirë të muskujve të organizmit që qetësohet, të çliruarit nga tonusi i muskujve të shtrënguar, të shkaktuar nga puna e njëtrajtshme, si edhe të çliruarit e njeriut nga ngarkesa emocionale e fuqishme (përpos gjendjes së kënaqësisë). Relaksimi është aktiv, kur individi i lodhur shtrihet në krevat dhe shtriq muskujt e gishtërinjve, të duarve dhe të këmbëve, si edhe muskujt e qafës. Termi është i lidhur më tepër me psikologjinë e punës dhe me psikologjinë e sportit, ku relaksimi zbatohet me qëllim të çlodhjes së organizmit.

RELATIV, - E. mb. Që përcakton atë që nuk ka vlerë absolute, por vlerë të paqëndrueshme, sepse është i varur nga kushtet, proceset, raportet e tjera. Ky mbiemër përdoret për të emërtuar rëndësinë dhe vlerën e një dukurie, gjendjeje, procesi etj., në bazë të njohjes së lidhjeve ose raporteve të tyre me dukuritë, gjendjet dhe proceset e tjera. Mbiemri relativ përdoret për të emërtuar edhe diçka që është jo e plotë, e pjesshme (përgjigje relative). Kuptimi i përgjithshëm i këtij mbiemri ka të bëjë me njohjen e cilësisë së një dukurie dhe procesi vetëm në raport me dukurinë e procesin tjetër.

RELATIVIZMI KULTUROR. Relativizmi kulturor emërton konceptin e vlerësimit të normave, të standardeve, të sjelljeve dhe të mendimeve kulturore, varësisht ku ato norma e standarde janë zhvilluar dhe formuar. Sipas pikëpamjes së relativizmit kulturor zakonet dhe tradita kulturore e një mjedisi nuk mund të vlerësohen, duke krahasuar ato zakone dhe traditën e tyre me zakonet dhe traditën kulturore të një mjedisi tjetër, por vetëm me shkallët e zhvillimit të tyre në atë mjedis. Si e tillë kultura ushtron ndikim thelbësor në formimin e disa formave të sjelljes së njeriut, si: manifestimi i frikës, i durimit, i tolerancës fetare etj. Konsiderohet se termi i konceptit relativizëm kulturor e ka futur në terminologjinë e psikologjisë Rut Benedikt (Ruth Benedict, 1887 – 1948), etnologe dhe antropologe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Individin duhet ta kuptojmë ashtu si ai jeton në kulturën e tij, si edhe kulturën ashtu si ajo jeton në individin".

RELEVANCA HEDONISTE. Dukuria e perceptimit dhe e vlerësimit të sjelljes së një individi në varësi nga ndikimi i asaj sjelljeje në personalitetin tonë: nëse ka goditur personalitetin tonë, atëherë këtë e perceptojmë dhe e vlerësojmë negativisht, duke kërkuar dënim të asaj sjelljeje, nëse sjellja e tij nuk ka të bëjë me ne, atëherë këtë e perceptojmë dhe e vlerësojmë të parëndësishme. Kur jemi pjesëmarrës në këtë sjellje, këtë e perceptojmë dhe e vlerësojmë zakonisht të parëndësishme.

RELIABILITET, - I. m. Në literaturën psikologjike, sidomos në procesin e standardizimit të testeve, reliabiliteti ose besueshmëria e një instrumenti matës psikologjik (i testit, i pyetësorit, i shkallës së vlerësimit etj.), është cilësi metrike, zbatim i së cilës në matjen e një ndryshoreje psikologjike çon vazhdimisht në rezultate të përafërta, përkatësisht shumë të ngjashme. Shih ***– KARAKTERISTIKAT METRIKE TË TESTIT.***

RELIGJION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *religio* "besim". Sistem besimesh, konceptesh, përfytyrimesh me fuqi të mbinatyrshme në krijimin e në zhvillimin e natyrës, të shoqërisë, të dukurive dhe të raporteve të shumëllojshme ndërmjet syresh. Qendra kryesore e këtij sistemi është qenia kulmore, hyjnore – Perëndia. Njohja e sistemit të tillë të njeriut konsiderohet se mundëson të kuptuarit e disa lloj sjelljesh të njeriut dhe të motiveve të tyre. Përbërëse e rëndësishme e këtij sistemi është besimi i fuqishëm në Perëndi, që mundëson ekzistencën e shpirtit, zhvillimin dhe përsosjen, si edhe pavdekshmërinë e tij, madje edhe pas vdekjes së njeriut. Shkalla më e lartë e zhvillimit të religjionit është religjioni monoteist – besimi në një Perëndi. Ky besim buron nga zhvillimi i animizmit, i magjizmit dhe i totemizmit i botës njerëzore, që arriti të ngrihet mbi besimin në shumë Perëndi**.**

RELIGJIOZ, - E. mb. Që i përket besimit ose fesë, që është i lidhur, që ka të bëjë me fenë.

RELIGJIOZITET, - I. m. Term përmbledhës për interesim, pjesëmarrje, shkallë të lartë të besimit dhe vazhdimësisë së pjesëmarrjes në rite fetare. Tërësi e ndërlikuar qëndrimesh, pikëpamjesh, ndjenjash dhe veprimesh fetare, me të cilat njeriu plotëson nevojën e mësuar për të besuar në diçka të mbinatyrshme**.**

REMINISHENC/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *reminisctentia* "rikujtim i paqartë". Termi reminishencë ka dy kuptime: 1) Emërton dukurinë e shfaqjes së kujtimeve, të informacioneve, të cilat njeriut i janë dukur të harruara, sepse këto kanë kaluar pragun e vetëdijes, janë vendosur në përmbajtje të pavetëdijshme dhe nuk kanë shkak të posaçëm të shfaqjes së tyre (në momentin e shfaqjes njeriu as që i kërkon këto). Reminishenca karakterizohet me mbajtjen mend dhe riprodhimin e informacioneve të caktuara për një përvojë, shumë kohë pas përjetimit të saj, se menjëherë pas përjetimit të drejtpërdrejtë; 2) Ringjallje e një përvoje pa dijeni për origjinën e saj, duke mos ditur se ajo është e kujtuar e së kaluarës së njeriut.

REMISION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *remissio* "kthim". Në psikologjinë klinike dhe në psikiatri emërton dukurinë e përjetimit të humbjes së simptomave të një çrregullimi apo sëmundjeje psikike. Është faza kur subjekti i sëmurë raporton se e ndien veten mirë si para shfaqjes së sëmundjes psikike. Remisioni është përjetim subjektiv i përjetimit të gjendjes së mirë psikike. Megjithëkëtë, supozohet se sëmundja nuk është shërua**r.**

RENIN/Ë, - A. m. Hormon i veshkës që krijohet dhe rrjedh nën ndikimin e ngacmuesit të pjesës simpatike të sistemit nervor autonom ose vegjetativ. Ky hormon ka kryesisht funksion fiziologjik. Shkaktohet në rend të parë nga mungesa e rrjedhjes së mjaftueshme të gjakut në veshkë. Renina me proceset e saj shkakton etje, e cila ngacmon pjesën e cipës adrenale të trurit të madh dhe, më në fund, mbajtjen e natriumit. Ka lidhje me ndryshimin e gjendjes emocionale të njeriut.

REOBAZ/Ë, - A. f. Term i psikologjisë fiziologjike, i pjesës së neuropsikologjisë. Emërton intensitetin e shkallës më të ulët elektrofiziologjik, që është në gjendje të vërë në veprim qelizën

nervore. Intensiteti i shkaktuar në këtë mënyrë duhet të zgjatë një kohë të caktuar. Intensiteti i ngacmimit të qelizës nervore nuk ndryshon as me zgjatje kohore me intensitet të njëjtë, përveç rasteve të posaçme.

REPERTOR, - I. m. Term që hyri në përdorim psikologjik kryesisht në psikologjinë bihejvioriste. Emërton pasqyrimin e plotë të sjelljeve të një organizmi në një situatë gjurmuese, duke përfshirë shpesh edhe mundësinë e paraqitjes së një sjelljeje që gjurmuesi mendon se ka bazë potenciale për paraqitjen e saj.

REPETICION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *repetitorium*, që haset shpesh edhe në gjuhën shqipe, shih – ***P RS RITJA.*** Termi repeticion ka kuptimin e përsëritjes aktive të përmbajtjes së një teksti prozaik ose poetik me qëllim të të kuptuarit të raporteve ndërmjet të dhënave e informacioneve të brendshme të atij teksti, duke synuar mbajtjen mend dhe riprodhimin e saktë të tij. Në tekstet pedagogjike shpesh përdoret thënia latine "Repetitio Mater Studiorums" – "Përsëritja është mëma e dijes". Kjo thënie e vjetër ka kuptim psikologjik vetëm në kuptimin e përsëritjeve aktive**.**

REPLIKIM, - I. m. Term që haset më tepër në të folurin e përditshëm dhe më pak në psikologji. Në psikologji ka kuptimin e eksperimentit psikologjik të veçantë. Ka të bëjë me përsëritjen e eksperimentit, duke iu kundërvënë eksperimentit të mëparshëm dhe rezultateve të tij me qëllim të vërtetimit të atyre rezultateve.

REPRESION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *repressio* "shtypje, ndrydhje". Në psikologji është një ndër mekanizmat mbrojtës me anën e të cilit egoja e njeriut mbrohet nga dëshirat, idetë, impulset, motivet dhe kujtimet e papranueshme për mjedisin shoqëror. Lejimi i shfaqjes së tyre në mjedisin e njeriut shkakton ankth, ndjenjën e fajit dhe atë të turpit. Për të mos ardhur deri në këtë gjendje represioni i shtyp dëshirat, motivet, kujtimet etj. duke mos lejuar që këta të depërtojnë nga përmbajtja e pavetëdijshme në atë të vetëdijshme. Shih – ***MEKANIZMAT MBROJTËS.***

REPUTACION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *reputare*. Emërton konceptin e përgjithshëm për vlerat e një individi, për famën që ai gëzon në mjedisin e tij shoqëror, e formuar në bazë të vlerësimit të të mirave të tij dhe gatishmërisë së vazhdueshme për të afruar të mira për të tjerët.

RESPEKT, - I. m. Term i të folurës së përditshme ose kolokviale, por edhe i terminologjisë së etikës dhe i psikologjisë, i ardhur nga latinishtja *respectus* "nderim". Në psikologji emërton ndjenjën e nderimit që një individ i bën tjetrit, për meritat dhe vlerat, për të cilin beson thellë se ka tipare të larta të karakterit të tij. Respekti ka edhe tipare të qëndrimit, kur nën ndikimin e tij njeriu shpreh sjellje nderimi e mirënjohjeje të posaçme ndaj individit të respektuar.

RESPONDENT, - I. m. I ardhur nga latinishtja *respondens*, që haset shpesh në psikologji. Me termin respondent emërtohen dy kuptime: 1) Subjekti provues, individi, i cili jep përgjigje në pyetësor, pikërisht organizmi reagues ndaj ngacmuesit të caktuar; 2) Reagim,

lloj veprimi a sjellje e përforcuar e organizmit ndaj një ngacmuesi karakteristik të mjedisit të jashtëm. Kështu është emërtuar reagimi apo sjellja e formuar e organizmit ndaj ngacmuesit të jashtëm në teorinë e psikologut amerikan Burhus F. Skiner (Burhus F. Skinner, 1904 – 1990).

RETENC/Ë, - A. f. Në kuptimin e përgjithshëm ka të bëjë me procesin e ruajtjes së një cilësie në një trup. Në psikologji më tepër i përket psikologjisë së kujtesës i ardhur nga latinishtja *retention* "ruaj". Emërton konceptin hipotetik të ruajtjes së gjurmëve që kanë mbetur nga përvoja, sidomos nga të mësuarit e një lënde të caktuar, nga të mësuarit e informacioneve, të dhënave, të raporteve etj. Këto gjurmë mbeten në trurin e njeriut prej momentit fillestar të të mësuarit të një përmbajtjeje deri në momentin e mëvonshëm të kërkimit të kujtimit dhe riprodhimit të saj. Gjurmët e tilla shprehen me reagimet e njeriut në përputhje me atë që ka përjetuar më herët,me përvojën e mëhershme, me përmbajtjen e përvetësuar nga të mësuarit e dikurshëm. Supozohet se këto ndryshime nervore janë ndryshime plastike nervore që ruhen në trurin e njeriut. Gjithsesi, ndryshimet e tilla kanë të bëjnë me strukturën e qelizave nervore të cipës së trurit të madh dhe të lidhjeve ndërmjet syresh. Por, këto ndryshime nuk mund të vërehen drejtpërdrejt*ë* dhe as nuk mund të maten.

RETIN/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *retina* "rrjetëz". Retina ose rrjetëza e syrit në anatominë e syrit është cipa e brendshme e syrit. Kjo cipë e ndërlikuar përbëhet nga 10 cipa. Është e ndarë në tri shtresa kryesore në shtresën e ganglioneve – qelizore, në shtresën e qelizave bipolare dhe në shtresën fotoreceptore. Nga këto shtresa, ajo e fundit është shtresa kryesore dhe, nga të cilat ajo e shkopthave dhe e kunjëzave kryen funksionin më të rëndësishëm në procesin e të parit. Kjo shtresë ka 115 milionë shkoptha dhe 6 milionë kunjëza. Kunjëzat kryejnë funksionin e të parit të ngjyrave dhe të hollësive perceptive. Kunjëzat gjenden në gropëzën fovein dhe shtrihet gjithnjë e më pak prej gropëzës kah periferia e syrit. Shkopthat janë të shpërndarë jashtë gropëzës dhe numri i tyre rritet proporcionalisht kah periferia e syrit. Retina është formacion i veçantë nervor i përbërë nga rrjetëza e dendur e pjesëve skajore të nervit pamor. Në retinë bie figura e objektit që përftohet në bazë të thyerjes së rrezeve të dritës nga brisi dhe thjerrëza. Kjo është figura besnike e ngacmuesit të jashtëm e riprodhuar në retinë, por e zvogëluar, e kthyer mbrapsht dhe njëdimensionale. Kjo ushtron ndikim në shkoptha dhe në kunjëza, që janë të lidhur me pjesët skajore të nervit të të parit dhe këtu ndikimi i saj shndërrohet në impuls nervor, që bartet në qendrën pamore apo optike të cipës së trurit të madh. Këtu procesi neurologjik shndërrohet në atë psikonervor, përkatësisht në ndijim pamor. Shih – ***SYRI.***

RETINAL, - I. m. Lloj i pigmentit të retinës, molekulë e vogël e përftuar nga vitamina A. Nga kjo molekulë lind purpuri i të parit – rodopsina. Mungesa e rodopsinës shkakton verbimin e natës. Për shkak të mungesës së saj njeriu nuk është në gjendje të shohë në errësirë.

RETINOR, - E. mb. Që i përket retinës, që ka të bëjë me retinën e syrit. Ky mbiemër është pjesë përbërëse e sintagmave të mëposhtme:

a) **Denzitometria retinore** – Teknikë e matjes së sasisë së dritës që thithet ose absorbohet nga shkopthat e retinës. Sipas kësaj teknike rrezet e dritës kalojnë nëpër retinë dy herë dhe shkopthat thithin sasinë e rrezeve të dritës, e cila nuk shfaqet në matjen përfundimtare;

b) **Dispariteti retinor –** Figurat e objekteve të retinës së syrit të djathtë e të majtë janë të ndryshme, por këto në mbështetje neurale japin një figurë. Figura e tillë, e përftuar nga bashkimi i pjesës së parë me retinën e syrit të djathtë dhe pjesës së parë me retinën e syrit të majtë mundësojnë perceptimin e thellësisë së trupave;

c) **Fusha retinore** – Fusha e receptorëve ose e fotoreceptorëve të syrit, pikërisht fusha e shkopthave dhe e kunjëzave, që janë ngacmuar nga ngacmuesit e ndryshëm, të cilët kufizojnë fushën fotoreceptore të retinës së syrit;

d) **Zona retinore** – Zona të gatshme për të reaguar ndaj ngjyrave. Syri normal i njeriut i dallon të gjitha ngjyrat falë gropëzës ose fovesë së retinës, ku gjenden kunjëzat. Rreth gropëzës së retinës është zona e dallimit të ngjyrës së kaltër, të verdhë dhe atyre akromatike (bardhë e zi), ngjyra parësore e kuqe dhe e gjelbër perceptohen si ngjyra të zeza, kurse nuancat e tjera të ngjyrës së kuqe e të verdhë perceptohen me një shtresë të lehtë të ngjyrës së kaltër e të verdhë. Në periferi të rrjetëzës së syrit ku gjenden vetëm shkopthat, dallohen vetëm e bardha dhe e zeza me të gjitha nuancat e tyre.

RETROAKTIV, - E. mb. Term që haset në shprehje psikologjike në disa gjuhë e që ka ardhur në shqip nga përkthimi i librave psikologjikë nga gjuhët e tjera. E ka prejardhjen nga latinishtja *retro* "nga prapa, prapaveprues, që ka fuqi prapavepruese", ose "që ka fuqi kthimi nga pas". Ky mbiemër përmendet kryesisht në psikologjinë e kujtesës dhe të harresës. Bëhet fjalë për ndikimin që ushtron të mësuarit aktual të informacioneve dhe lidhjeve të tyre në informacionet e mësuara më herët. Me këtë mbiemër janë ndërtuar këto sintagma terminologjike të psikologjisë:

a. **Asociacioni retroaktiv** – Lidhja ndërmjet informacioneve apo të dhënave të tjera që mësohe**n** njëherazi me ato të mësuara paraprakisht;

b. **Lehtësimi retroaktiv** – Përforcim i lidhjes ndërmjet një ngacmuesi të organizmit dhe reagimit të organizmit ndaj atij ngacmuesi me anë të formimit të lidhjeve të reja ndërmjet tyre;

c. **Inhibimi retroaktiv** – Ndikim prapavajtës i të mësuarit të një përmbajtjeje të re në keqësimin e mbajtjes mend dhe riprodhimit të përmbajtjes së mësuar para saj. Përmbajtjet e mësuara më herët nuk kujtohen nga të mësuarit e përmbajtjeve të tashme. Kjo ndodh sidomos kur dy përmbajtje janë të ngjashme: të mësuarit e frëngjishtes ndikon negativisht në mbajtjen mend të italishtes së mësuar më herët; kjo lëndë harrohet më shpejt dhe më lehtë. Në literaturën e psikologjisë njihet edhe me termin interferencë retroaktive.

RETROGRAD, - E. mb. Që ka të bëjë me përvojën e së kaluarës, që u përket ngjarjeve të kaluara të përjetuara nga ana e njeriut. I ardhur nga latinishtja *retrogradus*.

RETROSPEKCION, - I. m. Shikim prapa, përkthim nga latinishtja *retrospettivo* = *prapavështrim*. Metodë e vëzhgimit sistematik të përjetimeve (të ngjarjeve, të situatave etj.) të veta nga ana e një subjekti të caktuar dhe e përshkrimit të tyre nga ana e tij. Disa nga strukturalistët në psikologji argumentojnë se retrospekcioni duhet dalluar nga introspeksioni, kurse disa të tjerë argumentojnë njësimin ndërmjet kuptimit të këtyre dy termave. Megjithëkëtë, në literaturën e psikologjisë bëhet dallimi në kuptimin e termave retrospekcion e introspekcion.

REVERSIBILITET, - I. m. I ardhur nga latinishtja *reversibilitas* "kthyeshmëri, që përpos matematikës, u bë term i psikologjisë. Në fillim termi reversibilitet ka emërtuar atë karakteristikë të transformimeve matematike që mund të përmbysen dhe të kthehen në pikën fillestare të tyre. Në psikologji termi reversibilitet është përdorur nga psikologu zviceran Zhan Pijazhe (Jean Piaget, 1896 – 1980) duke i dhënë kuptim të një tipari të rëndësishëm të inteligjencies, që shfaqet në aftësinë e individit për të grupuar figura, objekte, të dhëna etj. Është tipar që formohet me zhvillimin e strukturave të inteligjencies.

REVERSIBIMI I NGACMIMIT NERVOR. Ngacmim nervor i kthyer prapa në formë rrethore. Është dukuri nervore që shfaqet në paraqitjen e lëvizjeve të impulseve nervore në formë rrethore në grumbullin e qelizave nervore me lidhje të tillë ndërmjet tyre, që mundësojnë lëvizjen e impulseve nervore prej një qelize në qelizat e tjera nervore dhe kthimin e kësaj lëvizjeje të impulseve nervore në qelizën prej së cilës është nisur lëvizja e tyre. Lëvizjet e tilla nervore kanë rëndësi të madhe për funksionimin e gjithë sistemit nervor. Rezultatet e disa hulumtimeve kanë treguar se lëvizjet e tilla të impulseve nervore përbëjnë bazën e kujtesës afatshkurtër.

REVISTAT PSIKOLOGJIKE. Lloj publikimi profesional-shkencor që i kushtohet çështjeve të psikologjisë. Ka karakter periodik. Në revistën psikologjike botohen trajtesa dhe punime përmbajtjesh të ndryshme nga dega e psikologjisë, së cilës i është përcaktuar fizionomia e asaj reviste. Punimet e tilla mund të jenë nga psikologjia teorike dhe nga dega e caktuar e psikologjisë zbatuese. Kriter themelor i botimit të punimeve në revistat psikologjike duhet të jetë kumtimi i qartë, i shkoqitur dhe i kuptueshëm i rezultateve të gjurmimeve, ku janë zbatuar me përpikëri metodat dhe procedurat hulumtuese dhe kanë vlerë të posaçme shkencore. Krahas punimeve profesionale dhe shkencore në revistat psikologjike mund të botohen vështrime të botimeve psikologjike, tekste recensuese, kritika etj. Ndër më të njohurat janë: "Journal of Experimental Psychology" ("Revista e psikologjisë eksperimentale"), "European Psychologist" (Psikologu europian"), "Journal of Personality" ("Revista për personalitetit") etj. Përmbajtjet e revistave psikologjike janë një nga burimet e shqyrtimeve për zhvillim të mendimit psikologjik të një vendi. Deri tani në

shqip trajtesat dhe punimet psikologjike janë botuar zakonisht në revista pedagogjike, mjekësore, të shkencave sociale etj.

REVOLT/Ë, - A. f. I ardhur nga frëngjishtja *revolte*. Revolta është reagim i nxitur nga pakënaqësia dhe zemërimi që shpërthen me forcë kundër atij që ka shkaktuar një reagim të tillë.

REZENJIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *resignatis* "dorëzim, pajtim". Tërheqje nga qëndrimi i mëparshëm, nga sjellja e mëhershme dhe pajtim me fatin, duke mos pasur të qartë pasojat e kësaj tërheqjeje të individit nga qëndrimet, sjelljet, madje edhe nga lufta e mëparshme. Ky term haset në teorinë e psikologjisë së personalitetit të psikanalistes me origjinë gjermane Karen Hornei (Karen Horney, 1885 – 1952), që u mor me studime në SHBA. Në teorinë e saj hasen këta tipa rezenjimesh:

a. **Rezenjimi dinamik** – Tërheqje e vetëdijshme e individit nga interesi, qëllimi i tij duke mos parë momentalisht dobi nga qëndrimi dhe nga sjellja e pandryshuar;
b. **Rezenjimi neurotik** – Tërheqje nga konflikti me sjellje neurotike, me revoltë të atij ose asaj që tërhiqet nga ai konflikt. Shfaqet me mungesë të çfarëdolloj nisme për pjesëmarrje në ndonjë vendim për ndonjë ndryshim etj.;
c. **Rezenjimi persistent** – Tërheqje në pasivitet, mosmarrje pjesë me vetëdije e një individi në zgjidhjen e konflikteve të vogla ose të mëdha, por të rëndësishme për jetën e tij dhe të të tjerëve në mjedisin e ngushtë dhe të gjerë.

REZONANC/Ë, - A. f. Term i fizikës që ka edhe kuptim psikologjik të rëndësishëm, sidomos për ndijimet dëgjimore. E ka prejardhjen nga latinishtja *resonare* "jehoj". Rezonanca është dukuri fizike të cilën e karakterizon përforcimi i tingullit të caktuar nga induktimi i valëve të ajrit me intensitet që i përgjigjet intensitetit të një sistemi tjetër valor. Në këtë dukuri mbështetet njëra nga teoritë e dëgjimit të tingujve. Në disa tekste të psikologjisë humaniste termi rezonancë ka kuptimin e përputhjes emocionale të dy a më shumë individëve për një situatë të caktuar.

REZON/Ë, - I. m. Term që haset në të folurin e zakonshëm dhe në shqip ka ardhur nga frëngjishtja *rajson* "mendje, arsye". Shih – ***ARSYE.***

REZONIM, - I. m. Të menduarit logjik dhe koherent në procesin e zgjidhjes së problemave në bazë të argumentimit bindës të lidhjeve ndërmjet gjykimeve, nga të cilat rrjedh gjykimi përfundimtar. Rezonimi shfaqet në procesin e zgjidhjes së problemave, ku provohet sistematikisht vërtetësia e gjykimeve paraprake nga të cilat nxirret zgjidhja e problemit, e pikërisht përfundohet në gjykim të përgjithshëm.

REZULTAT, - I. m. Term i përdorshëm në disa fusha profesionale e shkencore. Emërton dy kuptime: 1) Rrjedhimin ose pasojën e një shkaku të një veprimi, të efektit të punës së caktuar, arritjen e individit në një shkallë të caktuar suksesi dhe 2) Bilancin përfundimtar të të mësuarit, që përcaktohet me shkallën vlerësuese të zotërimit të një përmbajtjeje, si edhe të dhënat e përftuara nga një eksperiment i caktuar.

REZULTATET E DERIVUARA. Shndërrimi i rezultateve bruto në një lloj të caktuar rezultatesh, përkatësisht shndërrimi tyre në raport me normën e përftuar në bazë të testit të bazhdaruar. Forma më e përshtatshme dhe më shumë e shfrytëzuar e derivimit të rezultateve është shkalla e centileve, e decileve dhe ajo e percentileve. Në shkallën e centileve vlera e centilit përcaktohet me përqindjen e arritjeve të subjekteve. Kështu, kur themi 1 % e subjekteve më të dobët, këta i përkasin centilit 1, ata me rezultat mbi rezultatin e më të dobëtëve i përkasin centilit 2, e kështu me radhë.

REZULTATI BRUTO. Numri i përgjithshëm i pikave të fituara në zgjidhjen e detyrave dhe të problemave të një testi. Rezultati bruto nuk jep pasqyrë të vlerës së tij ndaj vlerës së normuar, p. sh., ndaj rezultatit të një testi të bazhdaruar. Për këtë shkak duhet shndërruar ky rezultat në atë të derivuar.

REZULTATI C. Përfundim i arritur në një test nga ana e një subjekti, që shprehet me një njësi të së ashtuquajturës ***SHKALLA C*** – shih**.**

REZULTATI KOHOR. Rezultat i arritur i një subjekti në një test të caktuar, që tregon kryerjen në një kohë të caktuar të detyrave, zgjidhjen e parashikuar me kohë të problemave testore etj.

REZULTATI KRITIK. Rezultat kufitar ndërmjet atij që kënaq dhe që nuk kënaq një kriter, si minimum i domosdoshëm i pikëve për të kualifikuar një subjekt të aftë apo të paaftë për detyrën me shkrim. Numri më i vogël i pikave të arritura në një test përzgjedhës për një profesion të caktuar etj. Në psikometri kërkohet që rezultati kritik të përcaktohet nga rezultatet e skajshme.

REZULTATI T. Rezultati i një subjekti të testuar i shprehur në njësi të shkallës T. Shih – ***SHKALLA T.***

REZULTATI TESTOR. Numri i pikave të fituara të një subjekti në një test. I tillë mund të jetë rezultati bruto dhe rezultati i derivuar i atij subjekti në testin e caktuar për fitim të së drejtës për të vazhduar studimet, për përzgjedhje të profesionit, për të vazhduar garën për shkallë më të lartë të zhvillimit të aftësisë fjalësore, matematike, muzikore etj.

REXHA ZEKERIA. Filozof shqiptar. Lindi në Gjakovë më 12.05.1910 dhe vdiq në Tiranë më 22.02.1972). Kreu studimet për filozofi në Fakultetin Filozofik të Tuluzit në Francë, por atje nuk arriti të diplomohet. U diplomua për filozofi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit më 1947, kurse më vonë u diplomua po në këtë fakultet edhe për romanistikë. Nga viti 1947 ka dhënë mësim në Gjimnazin e Prishtinës në lëndën e filozofisë dhe të psikologjisë në gjuhën shqipe deri më 1958, kur u largua nga Prishtina e Kosova dhe u vendos në Tiranë. Në Shqipëri u angazhua në mësimdhënien e filozofisë e të psikologjisë në Berat, më pas punoi si bashkëpunëtor shkencor në Institutin e Historisë dhe të Gjuhësisë në Tiranë. Në historinë e mendimit psikologjik shqiptar në Kosovë la gjurmë në organizimin dhe zhvillimin e lëndës së psikologjisë në Gjimnazin e Prishtinës, pjesërisht edhe në Normalen e Prishtinës. U mor më tepër me

çështjet e organizimit dhe të zhvillimit të arsimit dhe të shkollave në Kosovë, posaçërisht në zhvillimin e institucioneve shkollore në gjuhën shqipe. Ishte drejtor i Shkollës Normale shqipe në Gjakovë në vitin 1942, kurse pas përfundimit të Luftës II Botërore, në fund të vitit 1945 ka ushtruar detyrën e të besuarit për Arsim e Kulturë në Këshillin e Kosovës. I shtyrë nga nevojat imediate të asaj kohe u angazhua kryesisht në vënien e themeleve të para zhvillimit të arsimit e shkollës shqipe në Kosovë, duke bashkëpunuar njëkohësisht në konceptimin dhe botimin e librave shqip për nevoja shkollore, si edhe në zhvillimin e kulturës së gjuhës shqipe, të mbledhjes së folklorit në trevat e Kosovës, në zhvillimin e krijimtarisë letrare në kuadrin e të vetmes revistë letrare "Jeta e Re", duke qenë dhe drejtor i parë i saj. Është i njohur si konceptues i shkurtimit të përmbajtjes së lëndës së psikologjisë më 1950 nga Libri i N. Kornillovit "Psikologjia", të përkthyer nga rusishtja në shqip në Tiranën e pas Luftës II Botërore. Mësimdhënësi i parë i lëndës së psikologjisë në gjuhën shqipe në vitet e para të Kosovës së pas Luftës II Botërore.

REXHEPAGIQ Jashar. Lindi më 16 janar 1929 në Plavë, ku kreu shkolën fillore, ndërsa gjimnazin në Beran dhe në Pejë. Studioi në Fakultetin Filozofik të Zagrebit, ku diplomoi në vitin 1953 dhe mori titullin profesor i shkencave pedagogjike. Gradën doktor shkence e mori në vitin 1965 në Fakultetin Filozofik të Zagrebit, ku mbrojti me sukses tezën "Zhvillimi i shkollave dhe i arsimit të shqiptarëve në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918".Ushtroi detyra të ndryshme në institucione arsmore dhe shkencore. Në institucione arsimore të nivelit të mesëm dhe të lartë ka dhënë edhe lëndën e psikologjisë. Ka botuar vepra pedagogjike si edhe artikuj e vështrime nga psikologjia.

Artikuj nga psikologjia:

Psikologjia dhe zhdukja e pasioneve negative, Përparimi, Prishtinë, 1956, nr. 11 – 12,fq.691 -697.

Problem periodizacije dečjeg psihofizičkog razvitka, - "Problemi i periodizimit të zhvillimit psikofizik të fëmijës" Zbornik radova nastavnika VPŠ u Prištini, Priština, 1960, br. 55-72. *Metodika e studimit psiqik të nxanësve*, Buletini i Entit për përparimin e shkollave të KAKM, Prishtinë, 1960, Nr. 4. *Pedagogjia e psikologjia*, kumtesë në këshillimin shkencor: Pozita e shkencave shoqërore në Kosovë, mbajtur më 20 nëntor 1997. në lib.: Pozita e shkencave shoqërore në Kosovë, Prishtinë, ASHAK, 2001, f. 53-60.

"Teorijsko – metodološki pristup psihološkom i pedagoškom aspektu etnoloških proučavanja na Kosovu" – "Qasje teoriko – metodologjike e aspektit psikologjik e pedagogjik të hulumtimeve etnologjike në Kosovë", saopštenje na naučnom skupu Odeljenja društvenih nauka ANUK, u Prištini , 17. Novembra 1989.

RËNDËSIA E KOEFICIENTIT TË NDËRLIDHJES. Dallimi i koeficientit të ndërlidhjes të të dhënave të një gjurmimi empirik nga hipoteza me vlerë zero. Për këtë qëllim mund të shfrytëzohet (kur kemi të bëjmë kryesisht me një kampion përmasash të vogla) formula e gabimit standard të koeficientit të ndërlidhjes:

$$t = r\sqrt{\frac{N-2}{1-r^2}}$$

Në këtë formulë N është numri i rasteve të një kampioni, r është koeficienti i korrelacionit. Në tabelat statistikore që tregojnë vlerën e testit t konstatojmë se, a ka rëndësi dallimi i koeficientit të ndërlidhjes në rastin N – 2 nga hipoteza zero dhe sa është ky dallim.

RËNDËSIA STATISTIKORE. Formë e argumentimit të qenies së një ndryshoreje, të përmasave të saj dhe të argumentimit të probabilitetit, se një dukuri psikike e identifikuar në një kampion, gjedhe ose mostër paraqitet në popullatën, që përfaqësohet nga ai kampion në një përmasë që është më e vogël se 5 % e rasteve të gjithë popullimit. Rëndësi statistikore mund të kenë treguesit e shkallës së ndërlidhjes të dy a më shumë ndryshoreve, krahasimi i shpërndarjes së të dhënave të një gjurmimi empirik me shpërndarjen teorike etj.

RËNKIM, - I. m. Komponent përbërës dhe shprehje specifike e dhembjes, e hidhërimit, e zemërimit etj. me zë tingëllues të përvuajtur të një individi për humbjen e pazëvendësueshme të të dashurit të vet, të veprës me vlerë të madhe etj.

RIAFTËSIM, - I. m. Aftësim i ripërtërirë i një individi që merret me një veprimtari profesionale të caktuar, për kryerjen me sukses të së cilës nevojitet përsosja e asaj veprimtarie. Riaftësimi organizohet sipas qëllimit, parimeve, metodave, mjeteve dhe formave të posaçme.

RIATRIBUIM, - I. m. Teknikë psikoterapeutike që ka të bëjë me trajnim pacientësh që vuajnë nga mendimet dhe sjelljet depresive. Trajnimi ka për qëllim zbutjen, lehtësimin e përjetimit të ndjenjës së fajësisë, kur pacientit i atribuohen pa të drejtë ndodhitë joreale.

RIBO Teodil-Armand (Théodyle-Armand RIBOT). Psikolog dhe filozof francez. Lindi në Guingamp më 1839 dhe vdiq në Paris më 1916. Ka studiuar për filozofi, ku u diplomua dhe shërbeu si profesor në shkollën e mesme për filozofi dhe psikologji. Por, më pas u mor vetëm me psikologji. Mbrojti doktoratën për psikologji me tezën "Trashëgimia psikologjike", 1873. Nga viti 1885 ka dhënë mësim në Universitetin e Sorbonës në lëndën e psikologjisë eksperimentale. Teodil Armand Ribo ka qenë drejtor i katedrës për psikologji eksperimentale dhe krahasuese, që me krijimin e kësaj katedre në kolegjin francez "Kolezh de Fransu". Përkrahës i metodës së vetëvëzhgimit ose introspeksionit. Në psikologji ka mbetur i njohur më tepër me Ligjin e Ribos. Sipas këtij ligji zhvillimi (ndërtimi) i kujtesës shkon nga mbajtja mend e më të vjetrave kah të rejave; mbahen në mend e riprodhohen më parë të dhënat, faktet, afektet, komplekset e përjetuara më herët se ato që janë përjetuar më vonë. Po kështu, më lehtë dobësohen e më parë humbin e zhduken nga kujtesa jonë të dhënat, faktet, afektet, komplekset më të reja e më pas ato të vjetrat. Në përgjithësi përjetimet e hershme të moshës fëmijërore e rinore ruhen dhe përforcohen dhe këto kanë mundësi të zhduken të fundit, kurse ato që janë përjetuar në moshën e pjekurisë, sidomos ato të moshës së pleqërisë,

dobësohen dhe zhduken të parat nga kujtesa. Veprat kryesore të tij janë: "*La psyhologie anglaise contemporalne" – ("Psikologjia angleze bashkëkohore"),* 1870; *"La psychologie allemande contemporalne" – ("Psikologjia gjermane bashkëkohore"),* 1881; *"Les maladies memoire" – ("Sëmundjet e kujtesës"),* 1881; "*Les maladies de la volunté" – ("Sëmundjet e vullnetit"),* 1883; *"Les maladies de la personnalité" – ("Sëmundjet e personalitetit"),* 1885; *"La psychologie de l`attention" – ("Psikologjia e vëmendjes"),* 1888 etj.

RIBOZOMË, - A. f. Term i biologjisë që emërton qelizat e imëta në citoplazmën e të të gjitha qelizave, që janë themeli i kodit gjenetik për sintetizimin e proteinave.

RIGOROZITET, - I. m. I ardhur nga latinishtja *rigorosus* "i ashpër". Qëndrim për mënyrën e mendimit dhe të veprimit të njeriut, sipas të cilit ai u përmbahet me përpikëri rregullave, normave etj. duke mos lejuar shmangien prej tyre. Rigoroziteti nuk lejon sjellje bamirësie, ndikim të dhembshurisë në mendim dhe veprim, dhe as ndikim motivesh të posaçme lehtësuese.

RIGJIDITET, - I. m. I ardhur nga latinishtja dhe *rigides* "ngurtësi, shtangësi". I ardhur nga fiziologjia në psikologjinë fiziologjike, ku ka emërtuar kontraktimin e fuqishëm të muskujve, gjendjen e tkurrur të muskujve, sikurse është rasti i cenimeve nervore ekstrapiramidale të muskujve. Rigjiditeti është element përbërës i katatonisë. Ky kuptim i termit shtrihet edhe në tiparet e personalitetit, duke emërtuar ngurtësi në përshtatjen perceptive, emocionale dhe shoqërore të individëve të caktuar. Ka qëndrime e shprehi që tashmë kanë humbur vlerën e tyre në sjelljen e gjithëmbarshme, por njeriu iu përmbahet në aktivitetin e tij. Rigjiditeti shfaqet në këto forma:

a. **Rigjiditeti hipnotik** – Tkurrje e fuqishme muskujsh me kohëzgjatje të caktuar që shkaktohet nga hipnoza;
b. **Rigjiditeti mendor** – Ngurtësia e të menduarit ndryshe nga e kaluara. Shfaqet edhe atëherë kur kanë ndryshuar kushtet dhe raportet objektive për objektin e mendimit;
c. **Rigjiditeti emocional** – Ngurtësia e reagimit emocional ndaj objekteve, situatave etj. të caktuara, pavarësisht se vlera dhe rëndësia e tyre për atë njeri kanë ndryshuar;
d. **Rigjiditeti i sjelljeve** - Pamundësia e njeriut për t`i ndryshuar disa forma të sjelljeve të tij, madje edhe shpreh shkathtësi, pavarësisht nga ndryshimi i rrethanave dhe raporteve të ndryshuara në mjedisin jetësor të tij.

RIHTER Horst-Eberhard (Horst-Eberhard RICHTER). Mjek psikiatër dhe psikanalist. Lindi në Berlin më 28.04.1923 dhe vdiq në Gießen më 19 dhjetor 2011. U dallua me rezultatet e studimeve të tij që kishin të bënin me lidhjen e neurozave me patologjinë e rendit të familjes. Sipas rezultateve të analizës së këtij raporti Horst Eberhard Rihteri arriti në përfundimin se kultura familjare dhe shthurja e rendit dhe e raporteve familjare është ndër shkaqet e neurozave. Ai u mor edhe me studimin e dukurive shoqërore, posaçërisht me motivet e sjelljeve politike, ku motivet e pavetëdijshme i nxori nga të qenit i vetëdijshëm i njeriut për paqe dhe siguri. Veprat kryesore të

tij janë: *"Eltern, Kind, Neurose"* – (*"Prindërit, fëmijët, neurozat"*), 1963; *"Patient Familie"* – (*"Familja paciente"*), 1970; *"Der Gotteskomplex"* – (*"Kompleksi i Zotit"*), 1979; *"Zur Psychologie des Friedens"* – (*"Psikologjia e paqes"*), 1982.

RI-INTEGRIM, - I. m. Term me kuptim të përgjithshëm që përdoret rrallë në psikologji. Bashkimi i pjesëve, i elementeve përbërës të një trupi, të një përmbajtjeje etj. në një tërësi. Në psikologji ka kuptimin e aftësisë së individit që të reagojë ndaj një ane apo elementi të një ngacmuesi, kur ai është mësuar të reagojë ndaj tërësisë ku merr pjesë edhe ai element i atij ngacmuesi. Kështu, aftësia ri-integruese e kujtesës ka të bëjë me të kujtuarit e shumë detajeve të një përmbajtjeje të tërësishme, kur individin e ngacmon vetëm një detaj i asaj tërësie.

RIKONSTRUKTIM, - I. m. Term me origjinë latine, por në psikologji ka hyrë nga frëngjishtja *reconstruction* "rindërtim". Në psikologji ka kuptimin e rivënies së strukturës së të dhënave psikologjike sipas skemës së gjendjes së tyre të mësuar dikur. Me këtë term në psikoterapi kuptohet rivendosja e sjelljeve jo të integruara sipas rendit të dikurshëm integrues të tyre. Ky është kuptimi psiko-terapeutik i këtij termi, ku pacienti duhet bërë i vetëdijshëm për vlerësimin e gabuar të sjelljeve të tij ndaj vetes, e pikërisht duhet detyruar t`i zëvendësojë sjelljet e tilla me sjellje normale. U zhvillua sidomos nga psikologu amerikan Albert Elis (Albert Ellis, 1913). Në psikologji emërton metodën provuese të kujtesës, sipas së cilës gjurmohet aftësia e kujtesës së një individi, duke kërkuar nga ai që ta rikthejë rendin e të dhënave të përziera (të rrokjeve, të fjalëve të një gjuhe të huaj, të numrave etj.) në rendin burimor të mësuar më parë. U zbatua sidomos nga studiuesi gjerman Herman fon Ebinghauz (Herman von Ebbinghaus (1880 – 1909). Rikonstruktimi në psikanalizë nënkupton procedurën e interpretimit të të dhënave biografike të një individi, me qëllim të njohjes së sjelljeve të tashme të tij. Zbatohet më tepër te pacientët me sjellje të çrregulluar, me qëllim identifikimin e fazës zhvillimore prej nga ka buruar shkaku i asaj sjellje**.**

RIKONJICION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *re* "prapa" dhe *kognitio* "njohje". Përdoret më shumë në psikologjinë kognitive. Rikonjicioni është të qenit i vetëdijshëm se një objekt i parë më herët, një ngjarje, një përmbajtje etj. e mësuar dikur është përjetuar. Shih **- *RINJOHJA*.**

RIKUJTIM, - I. f. Të sjellët përsëri në mend të informacioneve, të përvojës së kaluar, të të dhënave etj., të mësuara a të përjetuara dikur.

RIM/Ë,- A. f. I ardhur nga frëngjishtja *rime*. Në stilistikë ka të bëjë me barazinë e plotë të rrokjeve fundore të një fjale me ato të një fjale tjetër, duke filluar nga zanorja e theksuar. Lehtëson të mbajturit mend të lëndës.

RINENCEFALON, - I. m. I ardhur nga latinishtja *rhinencephalon* që i përket pjesës nervore të trurit të nuhatjes ose olfaktorik. Kjo pjesë shtrihet në bulbin nuhator, traktin nuhator, fushën e veçantë në formë dardhe të trurit, disa pjesë të cipës dardhore dhe disa pjesë të kompleksit amigdaloid. Kryen funksionin e marrjes dhe të

përpunimit të të dhënave, të informacioneve nuhatëse. Te disa kafshë kjo pjesë luan rol të rëndësishëm në drejtimin dhe organizimin e veprimeve të tyre (macja, qeni, dhelpra etj.). Disa rezultate të gjurmimit të kësaj pjese të cipës së trurit marrin pjesë edhe në zhvillimin e kujtesës eksplicite dhe të proceseve të saj.

RINJOHJE, - A. f. Proces i kujtesës që ka të bëjë me mbresën e individit dhe me besimin e tij se dukuria, objekti, individi etj., me të cilin takohet është i njohur, se me të nuk takohet për herë të parë. Subjekti përjeton ndjenjën e diçkaje të njohur, megjithëse herëherë nuk i kujtohen të dhënat e hollësishme (nuk i kujtohet koha, vendi, rasti i takimit etj.). Me anë të rinjohjes njeriu njeh se përmbajtja e një përfytyrimi, nocioni etj. të tashëm është i njëjtë me atë të kaluarën. Rinjohja nuk përfshin riprodhimin e përmbajtjes së caktua**r.**

RIPARIM, - I. m. Përmirësimi i sjelljeve të çrregulluara. Riparimi në psikanalizë ka kuptimin e zbutjes së fajit me anë të angazhimit të njeriut në kryerjen e sjelljeve të dobishme për vete dhe për të tjerët. Psikanalistja austriake Melani Klajn (Melanie Klein, 1882 – 1960), në veprat e veta riparimin e konsideron mekanizëm mbrojtës për zgjidhjen e raportit ndërmjet ndjenjave ambivalente ndaj një individi, objekti, situate etj.

RIPRODHIM, - I. m. Proces i kujtesës që ka të bëjë me ringjalljen e mbresave të asaj që është mësuar dhe me përsëritjen e saj me gojë, me shkrim, me lëvizje etj. Kopja e riprodhimit të lëndës së mësuar kryesisht nuk përputhet plotësisht me lëndën origjinale të mësuar dikur. Riprodhimi është edhe metodë e gjurmimit të kujtesës, përcaktimi i cilësisë dhe i sasisë së lëndës së mbajtur mend nga të mësuarit e saj dikur, në bazë të riprodhimit të saj pas një pauze të caktuar (pas tri orësh, një dite, një jave).

RIPRODHUES, - E. mb. Që ka të bëjë me riprodhimin, që i përket riprodhimit.

RISOCIALIZIM, - I. m. Ndryshim kahesh të bindjeve, qëndrimeve, sjelljeve etj. përmes të cilit pjesëtari i një mjedisi të caktuar shoqëror fillon përshtatjen e tij ndaj kërkesave shoqërore aktuale. Risocializimi është proces institucional. Forma më e njohur e këtij procesi është burgu (përpos konvikteve, ushtrisë etj.) dhe aktivitetet shoqërore e edukative që zhvillohen në kuadrin e kohës së caktuar. Aktiviteti i risocializimit ka për qëllim kryesor konvergimin e këshillave, të ligjëratave, të porosive etj. në të mësuarit dhe përvetësimin e qëndrimeve, të roleve, të vlerave të tjera nga ato që individi i ka pasur.

RIT, - I. m. I ardhur nga latinishtja *ritus*. Tërësi zakonesh e një bashkësie njerëzish që kryhen nga ana e tyre sipas një rregulli të ngulitur nga tradita. Këto rite kryhen dhe përsëriten sipas një rendi kohor të caktuar. Kryesisht kanë karakter fetar. U jepen kuptime të posaçme në raste të caktuara.

RIT/ËM,- MI. m. I ardhur nga greqishtja *ρύθμιση*. Lëvizje e njëtrajtshme; paraqitje e fjalëve, e lëvizjeve, e tingujve etj. dhe përsëritje e tyre me pushime të njëjta kohore. Ushtron ndikim në zhvillimin e saktësisë së

ekzekutimit të lëvizjeve dhe të përsëritjeve të tyre sipas pushimeve të njëjta kohore. Ritmi konsiderohet se është mjet mnemoteknik.

RITMET BIOLOGJIKE. Zëvendësime periodike të proceseve biologjike me intervale kohore të gjata dhe të shkurtra: ritmi i rrahjes së zemrës është zëvendësim kohor i shkurtër disa sekondash, ritmi i gjendjes së zgjuar dhe asaj të gjumit është ditor, i menstruacioneve etj. Ritmet biologjike janë ritme të lindura.

RITMI BERGER. Valët Alfa të trurit që karakterizojnë gjendjen e zgjuar dhe të qetë të njeriut. Shih – ***VALËT ALFA.***

RITUAL, - I. m. Sistem ritesh, veprimesh të njëllojta të banorëve të një vendi që bëhen nga tradita dhe janë të lidhura me raste të veçanta. Të tilla mund të jenë ritet e lindjes, të martesës, të vdekjes etj. Këto kryhen në besim të së mirës së një individi, kolektivi, përkatësisht për t`iu larguar të këqijave. Te ata që vuajnë nga simptomat e neurozës së ankthit dallohen sjelljet e paqëllimshme që përsëriten pa kontroll të vetëdijes. Rituali në psikanalizë është veprimtari stereotipe e dalluar sidomos te neurotikët ; ka bazë irracionale dhe kryhet pa qëllim të qartë. Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1939) ka zbuluar ngjashmëri ndërmjet riteve te neurotikët dhe te ritet fetare.

RITUALET KOMPULSIVE. Veprime kompulsive që marrin formën e ritualit që përsëritet gjithmonë me një rend të pandryshuar brenda intervaleve të caktuara kohore. Bindja e thellë në rendin ritual të sjelljeve u shkakton të tjerëve pakënaqësi e pengesa të ndryshme, kurse kërkesa e tyre për ndërprerje të ritualeve kompulsive shkakton reagim të pakëndshëm.

RITUALI RELIGJIOZ. Tërësi sjelljesh e veprimesh stereotipe që kryhen nga ana e njeriut religjioz me qëllim të plotësimit të kërkesave dhe detyrimeve fetare. Kryhen me qëllim të largimit të njeriut dhe të mjedisit të tij nga e keqja. Në psikanalizë rituali religjioz është përsëritje sjelljesh të njëjta në formë të vazhdueshme. Shkaku i tyre sipas Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) është i karakterit irracional.

RITUALIZIM, - I. m. Veprimi i kryerjes së riteve në mënyrë stereotipe. Ky term haset në teorinë e personalitetit të Erik Eriksonit (Erik H. Erikson, 1902 – 1994), psikanalist me origjinë gjermane që migroi në SHBA. Me këtë term emërton format e zhvilluara të mendimit dhe sjelljeve stereotipe të fituara gjatë përvojës së njeriut dhe komunikimit të tij me të tjerët në një mjedis të caktuar kulturor. Shfaqet në secilën nga tetë shkallët e zhvillimit të personalitetit.

RIVALITET, - I. m. I ardhur nga latinishtja *rivalitas* "kundërshtar". Prirje e njeriut për t'ia kaluar tjetrit ose për të bërë atë që bën tjetri në një fushëveprim, në të cilin marrin pjesë dy a më shumë veta me qëllim garues. Me këtë kuptim hasen këto rivalitete:

a) **Rivaliteti i lakmisë** - Gjendje e nderë dhe përpjekja për të marrë atë që ka tjetri, për të fituar sikurse tjetri;
b) **Rivaliteti i xhelozisë** - Përpjekja për të qenë sikurse tjetri ose mbi të.

Është e motivuar nga frika e humbjes së dashurisë ose të nderimit të tjetrit.

ROBËRI, - A. f. Gjendje e ndrydhur fizike, psikike dhe morale e njeriut, që e përdor këtë ndrydhje si mjet dhe formë për mbajtjen e tjetrit nën zgjedhën a sundimin e tyre.

ROBOT, - I. m. I ardhur nga çekishtja *robota* "punë e rëndë". Aparat automatik që kryen disa veprime të ngjashme me ato të njerëzve. Konstruktime të çuditshme që në disa vende pune të prodhimtarisë industriale zënë vend të rëndësishëm, sepse kryejnë disa punë të programuara në kushte dhe në raporte të rënda klimatike. Robotët u krijuan me ndërlidhje dijesh nga fizika, matematika, shkencat kompjuterike dhe psikologjia**.**

RODOPSIN/Ë, - A. f. Fotopigment që shpërbëhet nën ndikimin e dritës, duke formuar në këtë mënyrë pigment të posaçëm. Me këtë shpërbërje dhe ndërtim të substancës biokimike të veçantë fillon procesi neuro-fiziologjik nga periferia e syrit të njeriut deri në qendrat e të parit të cipës a kores së trurit të madh. Pigmenti i tillë i formuar në shkopthat e retinës a të rrjetëzës së syrit quhet rodopsinë – aldehid i vitaminës A dhe aktivizohet duke absorbuar valët elektromagnetike deri rreth 500 nanometër. Në kunjëzat e retinës ka pigmente të tjera, por ende me strukturë të panjohur plotësisht. Konsiderohet se pigmentet e kunjëzave reagojnë ndaj valëve elektromagnetike prej 450 – 570 nanometër.

ROL, - I. m. I ardhur nga frëngjishtja që u përdor në fillim për të emërtuar aktivitetin e paraparë, të shkruar të aktorit në letër prej nga duhej ta mësojë dhe ta luajnë në binën teatrale. Së këndejmi u bart në psikologjinë e personalitetit dhe në psikologjinë sociale duke emërtuar sjelljet obliguese, detyrat dhe të drejtat që duhet të plotësojë individi në vendin e punës, në mjedisin e caktuar familjar, shoqëror etj., si edhe ndaj vetes së tij. Këtë e presin të tjerët nga individi që ka një status të veçantë, që zë vend të caktuar në hierarkinë profesionale, shkencore, shoqërore etj. Me termin role emërtohen më tepër sjelljet e normuara, si, p.sh., si duhet të sillet babai ndaj fëmijës së tij. Roli me këtë kuptim është rezultat i të mësuarit dhe, si i tillë është përvetësuar nga çdo individ. Rolet e njeriut mund të jenë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Njeriu që ka një pozicion të caktuar në shoqëri duhet të ketë edhe rol të veçantë. Këtë kuptim përcaktues termi e ruan në shprehje të veçanta terminologjike të psikologjisë, si:

a. **Roli difuz** – Rol i papërcaktuar qëndrimesh dhe sjelljesh i një adoleshenti që manifestohet në modelin e luhatjes së qëndrimeve dhe sjelljeve të tij ndërmjet qëndrimeve dhe sjelljeve të të rriturit dhe atij ende të parritur. Është term i teorisë së personalitetit të Erik H. Eriksonit (Erik H. Erikson, 1902 – 1994);

b. **Roli i dhënë** – Roli i përcaktuar me lindjen e individit, si p.sh., roli i femrës, i mashkullit, i të riut, i plakut etj.;

c. **Roli i gënjeshtërt** – Roli i sjelljeve të një individi, i cili me sjellje të rrema orvatet t`i shmanget së vërtetës, sipas së cilës ai ka kryer një akt të zymtë që prek nderin e tij dhe të familjes. Ndër sjelljet e rreme në literaturën e psikologjisë përmenden sjelljet e ndarjes

së bashkëshortëve, kur këta sillen sikur të mos u ketë ndodhur asgjë.

d. **Roli grupor** – Rol që emërton konceptin e rolit të një pjesëtari të grupit të individëve edhe më të vogël brenda grupit më të madh. Roli grupor është tërësi veprimesh e sjelljesh të të drejtave dhe detyrimeve ndaj grupit shoqëror. Term i psikologjisë sociale i përdorur në fillim nga sociologu amerikan Robert King Merton (Robert King Merton, 1910 -);

e. **Roli gjinor** – Qëndrime, sjellje dhe vlera personale që manifestojnë përkatësinë e një individi të gjinisë femërore ose mashkullore. Këto tipare njëkohësisht janë tipare emërtuese të identitetit gjinor të një individi në çdo moment të jetës së tij. Të tilla janë rolet specifike të femrës ose të mashkullit, si: mënyra e të menduarit, përjetimi dhe reagimi emocional, si edhe mënyra e veprimit të mashkullit dhe femrës në një situatë të caktuar shoqërore;

f. **Roli kognitiv i syve** – Të parit me anë të syve luan rol të madh dhe të rëndësishëm në njohjen e trupave, të dukurive reale dhe të ndryshimeve të tyre, përkatësisht në zhvillimin e përgjithshëm psikik të individit. Besohet se njeriu me anë të syrit, e pikërisht me anë të procesit të të parit me to, merr më shumë se 90 % të informacioneve rreth botës së jashtme. Pjesa dërmuese e këtyre informacioneve ka të bëjë me njohjen e dritës dhe të ndryshimeve të saj në mjedisin e njeriut, me karakteristikat e sipërfaqes së objekteve, me cilësitë e ngjyrave kromatike dhe akromatike, me dallimin e madhësisë dhe të formës së objekteve, me vendndodhjen e trupave në natyrë, me ndryshimin e saj, me lëvizjen e tyre, me hollësitë strukturore të objekteve dhe dukurive pamore etj.

g. **Roli reciprok** – Roli i përcaktuar me raportin shumëfishor ndërmjet dy individëve, që me qëndrimet dhe sjelljet e veta e zëvendësojnë njëri-tjetrin, si roli në raportin bashkëshort – bashkëshorte, nënë–bijë, mësues–nxënës etj.

h. **Rolet komplementare** – Rolet e dy individëve ngushtësisht të lidhur njeri me tjetrin bashkëshorti e bashkëshortja, prindërit e fëmijët e tyre, psikanalisti e klienti etj.

i. **Rolet konfliktuoze** – Rolet e ndryshme të njeriut në zgjidhjen e një situate problemore. Rastet e roleve konfliktuale kanë të bëjnë me praninë e dy a tri roleve të një individi sipas statusit shoqëror që ka dhe njëkohësisht këto role janë në raport të kundërt me njëri tjetrin. Plotësimi i një roli e vështirëson ose e pengon plotësimin e rolit tjetër. Të tilla janë rolet e gruas që duhet t`i plotësojë detyrat ndaj bashkëshortit, ndaj nënës dhe detyrat e profesionit të mësuesit. Konflikti brenda një roli ka të bëjë me sjelljet e pritura nga të tjerët dhe me kuptimësinë e atij roli nga ana e vetë individit. Kështu, nëna duhet ta luajë rolin e saj ndaj fëmijës dhe të tjerët presin ta dënojë fëmijën e saj, por kjo këtë nuk pranon ta bëjë, pavarësisht se e di që të tjerët e presin këtë nga ajo. Situatat e tilla e vështirësojnë shumë procesin e të mësuarit të roleve nga ana e fëmijëve.

j. **Rolet reciproke** – Marrëdhënie të pandashme ndërmjet burrit e gruas, përkatësisht ndërmjet bashkëshortit dhe bashkëshortes, ndërmjet mësuesit e nxënësit, nënës e bijës së saj etj.

ROMANI PSIKOLOGJIK. Lloj i krijimtarisë letrare, përmbajtja e së cilës ka

të bëjë me çështje psikologjike, duke i dhënë rëndësi të posaçme psikologjisë së personalitetit (motivet psikologjike, me përshkrim ndjenjash, tiparesh dhe veçorish të karakterit të subjekteve (të personazheve të atij romani). Romani psikologjik përmban vështrime, përsiatje të autorit, i cili i kthehet brendësisë së personalitetit kur ai evokon "përfytyrime, ndijime, atmosferë mentale". Studiuesi i romanit psikologjik Leon Edel përmend faktin e përshkrimit dhe të shpjegimit të rrjedhës së vetëdijes" (term i konceptit të Uiljam Xhejmsit) në romanin psikologjik. Autorë të spikatur të romanit psikologjik janë Shekspiri, Dostojevski, Fokneri, Vulfin, Xhojsi, Prusti etj. Romane me përmasa të dallueshme psikologjike janë: "Idioti", "Krim dhe ndëshkim" i Fjodor M. Dostojevskit, "Ese" e Vulfit, "Të mjerët" e Hygosë, "Afërdita" e Sterjo Spasses, "Hamleti princ i vështirë" i Ismail Kadares, "Një dashuri dhe shtatë faje" e Rexhep Qoses, "Të jetosh në ishull" e Ben Blushit, "Kthinat e Kujtesës" e Arta Markut, Tiranë 2014, etj.

ROMANTIK, - E. mb. I ardhur nga frëngjishtja *romantique*. Përcakton atë që ka të bëjë me periudhën e romantizmit në krijimtarinë artistike, që ngjall ëndrra, ndjenja e shpresa.

RORSHAH Herman (Hermann RORSCHACH). Mjek psikiatër dhe psikolog zviceran. Lindi në Zyrih më 1884 dhe vdiq në Herisau më 1922. Pas përfundimit me sukses të studimeve për mjekësi u specializua për psikiatri pranë psikiatrit të njohur zviceran Eugen Blojler në Zyrih, ku u interesua për psikanalizën dhe përvetësoi me kujdes ligjëratat psikanalitike, sidomos ato nga studimet e Karl Jungut në klinikën Burghelci. Asistent, mjek, ndihmësdrejtor dhe drejtor i spitaleve të sëmundjeve mendore në Zvicër, duke qëndruar në Bern gjatë viteve 1915–1922 dhe në Herisau të kantonit Apencel. Ishte i entuziazmuar me pikëpamjet e Zigmund Frojdit. Më 1939 krijoi Shoqatën Zvicerane për Psikanalizën, ku pohohet se ka luajtur rol të rëndësishëm në përhapjen e ideve psikanalitike. Adhuronte pikturën, duke u marrë edhe vetë me të; e për këtë shkak qe i interesuar për vizatimet e të sëmurëve psikikë. Nga këto vizatime konstatoi se të sëmurët psikikë e ndryshojnë perceptimin pamor, e, në përputhje me këtë më 1918 hartoi Testin Rorshah, ose testin e pikave të ngjyrës së shkrimit të përhapur në dy faqet e një letre shkrimi të thyer në mes, prej nga pika e ngjyrës e hedhur në mesin e kësaj thyerjeje pas bashkimit të të dy faqeve shpërndahet njësoj dhe me të njëjtën formë në dy faqet e kësaj letre. I testuari duhej ta interpretonte këtë figurë dhe sipas procedurave standard jepej diagnoza për strukturën e personalitetit të tij, duke përfshirë natyrisht edhe përcaktimin e simptomave të sëmundjes psikike. Testi Rorshah përbëhet prej dhjetë figurash, nga të cilat gjashtë ishin bardh e zi dhe katër të tjera me ngjyra kromatike. Ky test u tregua i përshtatshëm për diagnostikimin e sëmundjeve psikike dhe u përhap shpejt, duke u bërë sot një ndër testet e njohura psikologjike. Vdiq i ri duke mos arritur t`i mbushë të tridhjetat. Veprat kryesore të tij janë: "*Psychodiagnostic. Méthode et résultants d`une expérience diagnostique de*

perception, interpretation libre des forms fortuites" – (*"Psikodiagnistika. Metodat dhe rezultatet e përvojës diagnostikuese të perceptimit, interpretimit libror të formës"*), Bern, 1921; *"Reflexhalluzinationen und Symboli"* – (*"Halucinacionet refleksive dhe simbolika"*), 1912; *"Analyse einer schizophrenene Zeichnung"* – (*"Analiza e simptomave të skizofrenisë"*), 1913.

ROXHERS Karl (Carl ROGERS). Psikolog amerikan. Lindi në Çikago më 1902 dhe vdiq në San Diego (Kaliforni) më 1987. Studimet e psikologjisë i filloi pas dy vjetësh studimesh në një institucion fetar të Unionit në Nju Jork, ku i ndërpreu me motivin se i përkisnin një doktrine të kufizuar. Më 1926 u regjistrua për psikologji në kolegjin universitar të mësuesve të Universitetit të Kolumbias. Pas katër vitesh studimesh mbrojti magjistraturën dhe më 1931 u doktorua për psikologjinë e fëmijëve. Veprimtarinë e tij psikologjike e filloi në një institucion për ndalimin e fëmijëve në Rosheter të Nju Jorkut, ku punoi me fëmijë problematikë, pra me delikuentët. Më 1940 i ofruan vendin e profesorit të psikologjisë në Universitetin Shtetëror të Ohajos (Oiho), pas botimit të veprës së tij "Qasje klinike për fëmijët problematikë". Më pas punoi dymbëdhjetë vjet në Universitetin e Çikagos, ku themeloi qendrën për këshillim. Veprimtaria profesionale i përket më tepër psikoterapisë, e emërtuar me termin "terapia me klientin në qendër." Falë suksesit në këtë veprimtari arriti të japë mësim në Universitetin e Stanfordit gjatë viteve 1962–1963. Koncepti themelor i tij për klientin ishte: "Personaliteti duhet pranuar në tërësinë e tij dhe psikoterapeuti duhet të komunikojë me klientin që zhvillon lidhje sociale e psikologjike sa më të ngushtë. Klienti në sjelljet e terapeutit duhet ta shohë veten si në pasqyrë. Terapeuti e inkurajon klientin për të marrë përgjegjësi mbi vete". Pas vitit 1963 kaloi me punë në Institutin Perëndimor për Shkenca Bihejviorale – "Western Behavioral Sciences Institute" dhe më pas në Kaliforni, ku qëndroi deri në fund të jetës. Sipas tij "Karakteristika themelore e trurit njerëzor është krijimi i pandërprerë i konceptit për vete, që vazhdon madje edhe në sëmundjen e tmerrshme neurologjike". Ai qe i mendimit se njerëzit duhet ta shohin veten e tyre si proces të pandërprerë e jo si entitet të fiksuar. Veprat kryesore të tij janë: *"The Clinical Treatment of the Problem Child"* – (*"Trajtimi klinik i fëmijëve problemorë"*), 1939; *"Counseling and Psychotherapy"* – (*"Këshillimi dhe psikotera*pia"), 1942*; "Client Center Therapy: its Current Practice, Implications and Theory"* – (*"Terapia e përqendruar në klientin: praktika aktuale, zbatimi dhe teoria"*), 1951; *"Psychotherapy and Personality Change"* – (*"Psikoterapia dhe ndryshimi i personalitetit"*), 1954 etj.

RUAJTURIT E LËNDËS SË MËSUAR (TË). Proces i kujtesës që ka të bëjë me mbajtjen mend në mënyrë sasiore e cilësore të përmbajtjeve të mësuara dhe të zotëruara. Përsëritjet e organizuara sistematikisht nga ana e atij që mëson është forma më e suksesshme e të ruajturit në kujtesë të këtyre përmbajtjeve. Shih – ***RETENCIONI.***

RUBEOL/Ë, - A. f. Term i patologjisë fiziologjike i ardhur nga latinishtja me të njëjtin emërtim. Rubeola është

sëmundje, e cila mund të jetë e rrezikshme sidomos për gruan me embrion prej tre muajsh, që mund të shkaktojë në procesin e zhvillimit të embrionit edhe zhvillim të ngadalshëm psikik (krahas kataraktës, sëmundjes së zemrës dhe humbjes së aftësisë së dëgjimit). Rreziku më i madh për embrionin është zhvillimi i tij në muajin e parë të zhvillimit, kurse pas fazës së fetusit (pas tremuajsh) nuk ka më rrezik për zhvillimin e embrionit.

RUBINSHTAJN Leonidoviç Sergej (Leonidovic Sergej RUBINŠTEJN). Psikolog dhe filozof rus. Lindi në Odesë më 6.06.1889 dhe vdiq në Moskë më 11.01.1960. Gjatë viteve 1932–1942 qe drejtor i Katedrës së Psikologjisë në Institutin Shtetëror të Pedagogjisë në Leningrad, prej viteve 1942–1950 drejtor i Katedrës së Psikologjisë të Universitetit të Moskës, më pas prej drejtor i Institutit Psikologjik të Akademisë së Shkencave Pedagogjike dhe prej vitit 1945 drejtor i Departamentit të Psikologjisë në Institutin e Filozofisë. U angazhua më tepër në trajtimet teorike të çështjeve të psikologjisë, sidomos të procesit të mendimit, që është "preokupim i përhershëm" i Sergej Leonidoviç Rubinshtajnit. Pohohet se me këtë vepër fitoi famë të madhe, e ndërkohë u kritikua ashpër nga sistemi sovjetik në fund të viteve dyzet të shekullit të njëzet. Pikëpamjet e tij për personalitetin ai i shprehu në veprën "Qenia dhe njohja", ku sundojnë proceset psikike determinante dhe ku, më në fund "ekziston vullneti i personalitetit dhe synimet e tij, që del nga idetë autonome dhe nga fryma e përgjithshme e personalitetit". Veprat kryesore të tij janë: *"Osnovi psihologiii"* – (*"Bazat e psikologjisë"*), 1935; *"Bitie i soznannie"* – (*"Qenia dhe njohja"*), 1957; *"Prinicipi i puti razvitiji psihologii"* – (*"Parimet dhe rrugët e zhvillimit të psikologjisë"*), 1959; *"Problemi obšej psihologii"* – (*"Problemet e psikologjisë së përgjithshme"*), 1973.

RUDIMENT, - I. m. I ardhur në psikologji nga biologjia dhe me prejardhje gjuhësore nga latinishtja *rudimentum* "diçka e pazhvilluar". Fillesë e zhvillimit të një dukurie, organi, mësimi etj. funksioni i së cilës ndërkohë është ndërprerë. Në biologji emërton organin e pazhvilluar të disa organizmave, të cilët gjatë zhvillimit evolutiv të llojeve të caktuara të organizmave dhe bartësve të tyre kanë humbur funksionin e vet.

RUSI Myqereme. Psikologe shqiptare. Lindi në Tetovë më 25.05.1958. Kreu studimet për psikologji në Fakultetin e Filozofisë të Universitetit "Kiril i Metodij" të Shkupit më 1982. Më 1995 mbrojti magjistraturën për psikologji dhe më 1997 mbrojti me sukses tezën e doktoratës "Ankthi dhe ndikimi i tij në shpejtësinë e të menduarit te nxënësit shqiptarë" në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës. Nga viti 2013 profesor ordinar i psikologjisë për lëndën "Hyrje në psikologji" në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Arteve në Universitetin Shtetëror të Tetovës. Në vitet 1983–1984 psikologe klinike në Qendrën Mjekësore "Dr. Jeremije Zherajiq" në Ferizaj, pedagoge e psikologjisë së përgjithshme në Gjimnazin e Tetovës dhe e psikologjisë mjekësore në shkollën e mesme mjekësore "Nikola Shtejn" të Tetovës, ku ka ushtruar edhe

detyrën e psikologes së shkollës (1985 – 1993). Që nga viti 1994 u emërua asistente e, më pas profesoreshë, shefe e katedrës së psikologjisë dhe dekane e Fakultetit Filozofik të Universitetit Shtetëror të Tetovës; pedagoge e psikologjisë pedagogjike në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës nga viti 1999. Merret me gjurmimin e aftësive dhe me psikologjinë e personalitetit. Nga këto fusha studimore ka paraqitur trajtesa në konferenca e simpoziume shkencore ndërkombëtare në Romë, Nikozi, Stara Zagora (Bullgari), Shibenik (Kroaci), Ohër, Edrene (Turqi) dhe në Tetovë. Ka botuar vepra dhe artikuj në revista profesionale dhe shkencore. Veprat kryesore të saj janë: *"Metodika e edukimit parashkollor*", 1999; *"Psikologjia mjekësore"* (bashkautore), 2011.

RUTIN/Ë, - A. f. I ardhur nga frëngjishtja *routine* "përditshmëri e njëjtë". Formë e sjelljeve stereotipe të njeriut, e formuar për punë të posaçme, përkatësisht për realizimin e detyrave të punëve të posaçme. Rutina është përvojë me shkallë relativisht të automatizuar të lëvizjeve në punën e tij, me shkallë interesimi të ngushtë jashtë sferës së rutinës dhe me angazhim të zvogëluar të proceseve mendore. Në literaturën e psikologjisë me termin rutinë emërtohen edhe sjelljet e përsëritura çdo ditë, në kohë kryesisht të njëjtë, si pastrimi i trupit në mëngjes, të veshurit me rroba të përshtatshme e të bukura etj.

RR

RRAHJA E MENDIMEVE. Shprehje popullore e gjuhës shqipe që ka të bëjë me një bashkëbisedim të organizuar ndërmjet dy a disa individësh, që orvaten të prodhojnë ide, me të cilat mund të hapin rrugën e zgjidhjes së një çështjeje, apo të një situate problemore. Idetë e prodhuara vështrohen dhe vlerësohen, duke bërë zgjedhjen e atyre që i përkasin strategjisë së zgjidhjes së një çështjeje apo ndonjë problemi të caktuar.

RRASKAPITJ/E, - A. f. Gjendje e një lodhjeje të tejskajshme të njeriut, gjatë së cilës ai nuk ka energji dhe as motivacion për kurrfarë aktiviteti fizik e intelektual. Një gjendje e tillë është labërgim neuromuskular dhe përtesë e madhe për çdo lloj veprimtarie. Shkaktohet nga një punë e gjatë e intensive monotone, nga lodhje e madhe e organizmit të njeriut. Karakterizohet me disa ndryshime fiziologjike dhe psikike, si: ndryshime negative në funksionimin e qendrave nervore dhe të sinapseve neuromuskulare, përqendrim i acidit të qumështit në indet e organizmit, çrregullim i madh i lëvizjeve të trupit dhe të gjymtyrëve të tij, rënie e produktivitetit të punës, dobësim i cilësisë së saj, rënie e interesimit për atë punë, shpërqendrim i vëmendjes, humbje e motivacionit, pakënaqësi etj. Shih – ***MOLISJA.***

RRAVGIM, - I. m. Paqartësi e figurave të objekteve kur rrezet e dritës së tyre që kalojnë nëpër thjerrëza ose trupa të tejdukshëm nuk takohen ose nuk konvergohen në një pikë. Në psikologji hasen disa lloj rravgimesh:

a. **Rravgim i ngjyrave** – Rravgim i ngjyrave kromatike (e gjelbër, e kaltër, e kuqe, e verdhë, bashkë me nuancat e tyre); mosarritje e rrezeve të ngjyrosura në pikën e ngjyrës së bardhë, kur rrezet e dritës së bardhë kalojnë nëpër thjerrëzën e syrit;
b. **Rravgim mendor** – Shmangie e përkohshme e zhvillimit të proceseve psikike dhe e sjelljeve nga zhvillimi normal i tyre;
c. **Rravgim seksual** – Shmangie e shtytësit seksual nga realizimi normal i energjisë së tij;
d. **Rravgim sferik** – Përhapje e shtrembëruar e rrezeve të dritës në retinën e

syrit të njeriut. Shkaktohet nga thjerrëza në formë sferike.

RREGULL, - I. m. Term i formalizuar për karakteristikat e marrëdhënieve kryesore, parësore dhe të qëndrueshme të koncepteve dhe të ndërlidhjeve koherente të tyre. Konceptet përkufizohen sipas një rregulli dhe njohja e përmbajtjes së tyre nënkupton edhe rregullin e përcaktimit dhe të përkufizimit të përmbajtjes së një koncepti të caktuar. Shërben si mbështetje apo si normë për njohjen e zhvillimit të një dukurie, procesi, sjelljeje etj.

RREGULLAT E SHPREHJES SË EMOCIONEVE. Forma normash të qëndrueshme të natyrës social-kulturore, sipas të cilave pjesëtari i një mjedisi të caktuar shoqëror orvatet t`i shfaqë emocionet e veta sipas "shtratit" të këtyre rregullave. Këto përfshijnë mënyrën, kohën dhe intensitetin e shprehjes së emocioneve para të tjerëve. Mjediset shoqërore kanë përcaktuar në formë të pashkruar përshtatshmërinë e shprehjes së emocioneve të ndryshme. Këto rregulla ndryshojnë nga një mjedis shoqëror e kulturor në një tjetër mjedis shoqëror e kulturor, madje ka raste kur edhe përbrenda një mjedisi vërehen ndryshime të tyre. Shqiptarët e viseve të ndryshme e shprehin pikëllimin në forma të ndryshme.

RREKJ/E, - A. f. Qëndrueshmëri e njeriut, i cili me ngulm orvatet për të arritur në cakun, qëllimin apo objektivin që i paraprin. Emërton në thelb nënshtrimin e proceseve psikike dhe të sjelljeve të njeriut një qëllimi të përfytyruar dhe të përmendur, nga i cili ai nuk ndahet, derisa t`a realizojë duke pasur parasysh edhe pengesat fizike, shoqërore e morale dhe domosdoshmërinë e zotërimit të tyre për të arritur në atë qëllim.

RRETHI I NGJYRAVE. Paraqitje grafike e renditjes së cilësisë së ngjyrave kromatike sipas gjatësisë së valëve elektromagnetike të tyre dhe ngopjes së tyre. Qendra e rrethit përfaqëson ngjyrën plotësisht të pangopur me nuanca kromatike dhe kjo është e zeza. Sa më larg të jenë ngjyrat kromatike nga e zeza aq më të ngopura janë ato me valë elektromagnetike me gjatësi të caktuara, përkatësisht këto janë aq më të pastra ose tonaliteti (cilësia) i tyre është më i lartë. Në këtë rreth ngjyrat janë të renditura sipas gjatësisë së valëve elektromagnetike, prej atyre me valë më të shkurtra deri te ngjyrat me valë elektromagnetike më të gjata, duke zënë këto vende në rrethin e ngjyrave: ngjyra e kaltër me gjatësi valësh prej reth 480 – 480 ose e matur me njësinë e nanometrit prej ~ 560 – 490 nm, , ngjyra e gjelbër – e kaltër 490, e kaltra – e gjelbra 495, e gjelbra 510, e verdha – e gjelbra 560, e verdha 580 ose prej rreth 590 – 560 nm, ngjyra portokalli 500 ose ~ 635 – 590 nm dhe ngjyra e kuqe me gjatësi valësh elektromagnetike prej rreth 700 milimikronësh ose prej ~ 700 – 635 nm. Shih – ***NGJYRAT KROMATIKE.*** Hapësira e rrethit të ngjyrave mbi 700 deri në 380 milimikronësh i përket ngjyrave jospektrale ose ngjyrave me nuancë të kuqe të purpurt, deri te ngjyra e kaltër e mbyllur – e purpurt, që janë gati të padallueshme për syrin e njeriut. Rrethin e ngjyrave e ilustron paraqitja e mëposhtme e tij:



Paraqitja grafike e rrethit të ngjyrave

RRETHI I VJENËS. Rrethi ose qarku i dijetarëve të Vjenës është i njohur për rolin e tyre në zhvillimin e mendimin filozofik, si edhe ndikimin që ushtruan në zhvillimin empirik të psikologjisë, posaçërisht në zhvillimin e metodave gjurmuese të psikologjisë, sidomos të metodave gjurmuese të procesit të mendimit. Këtë rreth e përbënin disa mendimtarë të njohur austriakë, si Rudolf Karnap (Rudolph Carnap, 1891 – 1970), Hans Rajhenbah (Hans Reichenbach, 1891 – 1953), Herbert Fajg (Herbert Feigl, 1902), etj. Me fillimin e Luftës II Botërore këta u detyruan të vazhdojnë veprimtarinë e tyre në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

RRETHI LAKONIAN SHQIPTAR. Institucion psikanalitik shqiptar me seli në Tiranë. U themelua më 2008. Vepron kryesisht mbi parimet e psikanalistit francez Zhak Lakon (Jasques Lacan, 1901 - 1981). Organizon seminare dhe mbajtje ligjëratash profesionale nga studiuesit e njohur të psikëanalizës të vendit dhe të jashtëm. Veprimtarinë e vet e shtrin ndër shqiptarët e Shqipërisë, të Kosovës, etj. Rrethi Lakonian udhëhiqet nga psikanalistja Jolka Nathanail - Peuotet

RREZATIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *in* "në" dhe *radius* "rreze". Term i fizikës që emërton konceptin e burimit dhe të përhapjes së një forme të caktuar të energjisë nëpër një lëndë apo në një hapësirë të caktuar. Në kuptimin e përgjithshëm është shtrirja e dritës, e impulsit nervor etj. nga pika qendrore e burimit të këtyre ngacmuesve kah pjesët anësore dhe pjesët e tjera. Në psikofiziologji emërton konceptin e rrezatimit neural, përkatësisht përhapjen e ngacmueshmërisë neurale. Në psikologji hasen këto lloj rrezatimesh:

a. **Rrezatimi neurofiziologjik** – Rrezatim që ka të bëjë me përhapjen e impulsit nervor të shkaktuar nga ngacmuesi me intensitet të lartë nga një qelizë nervore në vargun e gjerë të qelizave nervore. Përhapja dhe shtrirja e tillë e impulsit nervor i përket rasteve të veçanta, kur intensiteti i ngacmuesit është i lartë, përndryshe përhapja e tillë nuk ndodh në rastet e zakonshme të ngacmimit të qelizave nervore. Rrezatimi neurofiziologjik ka edhe kuptimin e zgjerimit të shtrirjes së efekteve të veprimtarisë së një qendre nervore në qendrat e tjera nervore. Shtrirja e efekteve të tilla mund të jetë pozitive ose negative, përkatësisht nxitje e veprimtarisë së qendrave të tjera nervore dhe frenim i qendrave të tjera nervore.
b. **Rrezatimi i dhembjes** – Rrezatim që ka të bëjë me përhapjen a shtrirjen e ndijimit të dhembjeve jashtë një organi të caktuar;
c. **Rrezatimi perceptiv** – Rrezatim që ka të bëjë me dukurinë e perceptimit të madhësisë më të madhe të trupave nga madhësia reale e tyre, kur këta janë të vendosur në një sipërfaqe të errët;

d. **Rrezatimi refleksiv** – Rrezatim që ka të bëjë me rrezatimin refleksiv që i përket terminologjisë së shkollës së Ivan Pavllovit (Ivan Pavlov, 1849 – 1936). Dukuria e përhapjes së reagimit refleksiv të mësuar sipas formës së refleksit të kushtëzuar në ngacmues të ngjashëm me ngacmuesin artificial. Sipas Ivan Pavllovit kjo dukuri mund të shpjegohet me rrezatim të impulsive nervore të cipës ose kores së trurit të madh.

RREZET E VALËVE ELEKTROMAGNETIKE. Rrymë valësh të dritës që burojnë nga një trup dhe përhapen në një drejtim të caktuar. Syri i njeriut dallon vetëm një pjesë të këtyre rrezeve, që shtrihen prej 380 – 700 milimikronësh. Nën këtë kufi dhe mbi kufirin prej 700 milimikronësh syri i njeriut nuk është në gjendje t`i dallojë. Të tilla janë rrezet dyfaqëshe: infra të kuqe dhe ultravjollcë.

a. **Rrezet infra të kuqe** – Rreze me gjatësi valësh 700 milimikronësh, që nuk kanë aftësi të ngacmojnë syrin e njeriut dhe në lëkurën e njeriut shkaktojnë nxehtësi të shkallës së lartë dhe ndryshime pigmenti;

b. **Rrezet ultravjollcë** – Rrymë valësh elektromagnetike me dendësi më të madhe se ato të rrezeve të dritës. Këto rreze kanë aftësi të lartë përshkuese. Shih – ***RRETHI I NGJYRAVE.***

RREZET INFRA. Infra rrjedh nga latinishtja dhe ka kuptimin "nën". Përdoret shpesh në optikë dhe në psikologjinë fiziologjike për të emërtuar rrezet e dritës me gjatësi valësh mbi 700 milimikronë, që formojnë ngjyrën e kuqe të ndezur. Mbi gjatësitë e valëve elektromagnetike prej 700 milimikronësh syri i njeriut nuk është në gjendje të reagojë.

RRËMUJ/Ë, - A. f. Term që emërton konceptin e sjelljeve arrogante, destruktive, dhunuese, etj. të një grupi njerëzish. Motivet e sjelljeve të tilla janë kryesisht motive të pavetëdijshme me bazë shtytëse emocionale të fuqishme. Rrëmujë mund të shkaktojë grupi i simpatizantëve të një ekipi basketbolli, futbolli etj., kur këta, nën ndikimin e fuqisë së tillë motivuese, nuk përjashtojnë as sjelljet shkatërruese të çdo gjëje që gjendet para tyre.

RRËQETHJ/E, - A f. Puprri e përkohshme dhe e shpejtë e lëkurës dhe e muskujve të njeriut, që shkaktohet nga ndijimi i ftohtësisë së trupave flurorë, të lëngët ose të ngurtë që ndikojnë në lëkurë. Rrëqethja është njëra nga format e shfaqjes së disa llojeve të emocioneve të papritura negative, si rrëqethje e shkaktuar nga frika e pikëllimi i madh.

RRITJ/E, - A. f. Proces që ka të bëjë me rritjen e numrit të përgjithshëm të qelizave, si edhe me rritjen e përmasave të tyre. Manifestohet me zmadhimin shkallë-shkallë të organizmit, të madhësisë, të peshës, të vëllimit të organeve, të shoqëruara rregullisht me zhvillimin e funksioneve të tyre dhe me sjellje të posaçme. Rritja te njeriu fillon prej mbarsjes së qelizave dhe zgjat kryesisht deri në fund të moshës 21 vjeç. Është rrjedhim i shtimit të qelizave dhe zmadhimit të tyre në organizëm. Një rritje dhe zhvillim i tillë është argument i fuqishëm, pasi fëmija nuk është individ i rritur në miniaturë, por ka organizëm biologjik dhe zhvillim psikik të ndryshëm nga i rrituri. Hasen disa forma të rritjes:

a. **Rritja anatomike** – Rritja e madhësisë, e formës dhe e organeve gjatë viteve të zhvillimit të organizmit. Rritja anatomike është rritja trupore e njeriut e vlerësuar sipas zhvillimit të skeletit dhe përforcimit të eshtrave. Për caktimin e saktë të indeksit të rritjes anatomike shfrytëzohet më tepër shkalla e përforcimit të eshtrave të shuplakës së dorës.

b. **Rritja diferenciale** – Rritja dhe përsosja e funksioneve të pjesëve të një sistemi të organizmit (në anatomi) dhe vlerësimi i shkallës së zhvillimit të funksioneve të strukturave psikike, që nuk kanë të bëjnë me zhvillim madhësish, por me nivel më të zhvilluar të aftësive të konceptimit të dukurive, objekteve, situatave etj.

c. **Rritja fiziologjike** – Ndryshim paravajtës i funksionit të organeve dhe të organizmit gjatë moshës kalendarike të organizmit; mosha kalendarike e një individi të caktuar sipas ndryshimeve fiziologjike e psikologjike; mosha e llogaritur prej ditës së lindjes deri në ditën kur flitet për të. Për fëmijën e moshës deri në 3 vjeç rritja fiziologjike llogaritet me muaj; për fëmijën e rritur prej moshës 4-vjeçare deri në moshën 12 – 14-vjeçare mosha llogaritet me vite dhe me muaj, kurse për atë të moshës pas adoleshente mosha llogaritet kryesisht vetëm me vite.

d. **Rritja horizontale** – Ritje e numrit të funksioneve në kuadrin e një sistemi veprimesh që mund të kryhen brenda shfrytëzimit të të njëjtit nivel të zhvillimit të organeve dhe të strukturave psikike, siç është sistemi i zhvillimit intelektual, shqisor dhe motorik (i shkathtësive dhe i shprehive).

e. **Rritja e nevojave** – Shtimi i numrit të nevojave të shkallës më të lartë të njeriut dhe zhvillimi i funksioneve të tyre, si: nevoja për bukuri, drejtësi, nder, rend dhe vetaktualizim. Zhvillimit të këtyre nevojave dhe rritjes së numrit të tyre i paraprin plotësimi i nevojave themelore të njeriut, pa plotësimin e të cilave shtimi i nevojave të reja është i pamundur. Ky term i përket teorisë së zhvillimit të personalitetit të psikologut amerikan Abraham H. Masllout (Abraham H. Maslow, 1908 – 1970).

f. **Rritja psikike** – Ndryshim paravajtës i strukturave psikike, i proceseve, i sjelljeve dhe i tipareve psikike, si p,sh., rritja e kapaciteteve kognitive te fëmija.

RRJEDHSHMËRIA VERBALE. Një ndër faktorët e aftësive parësore mendore, që në sistemin e këtyre aftësive shënohet me shkronjën W. Rrjedhshmëria e të folurit ka të bëjë me shprehje a të folur të drejtë dhe sistematik, si edhe me gjetjen e shpejtë dhe të lehtë të fjalëve e fjalive dhe ndërlidhjeve të tyre që shprehin qartë, saktë e në mënyrë të shkoqitur mendimet. Shih – ***AFTËSITË PARËSORE.***

RRJETËZA E SYRIT. Shtresa më e thellë e pjesës fundore të syrit, bartëse e fotoreceptorëve. Shih – ***RETINA.***

RRJETËZA TRUNORE. Formim i veçantë në trajtë rrjete i lëndës nervore të trungut të trurit, që shtrihet prej pjesëz vazhduese të palcës kurrizore deri në pjesën e përparme të trurit ballor. Kjo është një rrjetëz e dendur nervore që përbëhet nga qelizat nervore dhe pjesët e tyre, të cilat i japin ngjyrë të përhimët kësaj rrjetëze, duke formuar një tërësi të ndërlikuar lidhjesh të qelizave nervore që kanë kontakte të panumërta ndërmjet tyre. Është bartëse e strukturave dhe funksioneve të ndërlikuara psikike,

siç janë: orientimi pamor e dëgjimor i njeriut në hapësirë, proceset e ndërlikuara mendore, vëmendja, veprimtaria e vullnetshme e njeriut, nxitja dhe kontrollimi i lëvizjeve të automatizuara (shprehitë e shkathtësitë) etj. Shih – ***FORMACIONI RETIKULAR.***

RROKJ/E, - A. f. Dy a tre tinguj të kombinuar që shqiptohen me një nxjerrje fryme të njeriut dhe nuk kanë kuptim. Në psikologji përdoren për të gjurmuar të mbajturit mend. Për këtë qëllim në psikologji përdoren më tepër rrokjet e përbëra nga një zanore në mes dhe dy bashkëtingëllore, si: cas, den, kig, nom, xët etj.

RROKJA E TRUPAVE. Formë e mësuar e përdorimit të gishtërinjve dhe duarve për rrokjen e qëllimshme të trupave dhe për përdorimin e tyre. Zhvillohet mbi refleksin e lindur të të porsalindurit, që humb pas disa muajsh të zhvillimit të foshnjës. Besohet se në sajë të zhvillimit të ecjes vertikale, të duarve dhe të gishtërinjve njeriu u bë njeri në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Rrokja e trupave te fëmija zhvillohet shkallë-shkallë: në fillim të zhvillimit ai e rrok objektin me gjithë shuplakën e dorës; pas moshës njëvjeçare objektet i rrok me gishtërinj, duke e ndarë gishtin e madh nga të tjerët dhe duke i përdorur gjithnjë e më tepër majat e gishtërinjve për rrokjen e objekteve.

RROTA E AKTIVITETIT. Trup rrotullues në formë lodre a tupani, i përbërë nga xhami special (nga brenda-jashtë nuk shihet) dhe nga telat e shkallëzuar, ku vendoset kavja, e pikërisht miu. Miu i uritur ngjitet shkallëve me tel duke vënë në rrotullim rrotën e këtij "tupani", e cila me anë të një instrumenti të veçantë mat dhe regjistron numrin e rrotullimeve. Përdoret për të matur fuqinë e nevojës për etje, seks, ushqim etj.

RROTULLUESI I NGJYRAVE. Sipërfaqe rrethore e një trupi në formë disku, në të cilën renditen ngjyrat sipas rendit të tonit dhe ngopjes së tyre. Përdoret për gjurmimin e proceseve psikofiziologjike të të parit të ngjyrave në kushte të posaçme. Shih – ***RRETHI I NGJYRAVE.***

RRUGËT NERVORE. Rrugë nervore që drejtojnë impulset e veçanta në sistemin nervor. Këto janë rrugë nervash dhe zgjatimesh të tyre që lidhin trurin me organet e trupit. Nëpërmes tyre barten impulse nervore në qendra të caktuara të trurit dhe prej tyre në muskuj dhe në gjëndra. Në psikologjinë fiziologjike dallohen këto lloj rrugësh nervore:

a. **Rrugët nervore të lëvizjeve** – Bartje e impulseve nervore me anë të nervave nxjerrës prej qendrave lëvizore a motorike të cipës së trurit të ardhur përmes palcës kurrizore dhe nervave shpinorë deri në muskuj dhe në gjëndra. Rruga kryesore e këtyre nervave është rruga piramidale;

b. **Rruga nervore e ndijimeve** – Drejtim i bartjes së impulseve nervore me anë të nervave prurës nga organet e veçanta dhe nga receptorët e shqisave deri në qendrat e cipës së trurit të madh. Këto përfshijnë ngacmimin e neuriteve, lidhjet e tyre me nyjat nervore të shpinës, neuritet e të cilave hyjnë në palcën e kurrizit, ku gjenden tufa fijezash nervore që lidhen me talamusin. Prej këndej fillon neuriti tjetër që përcjell impulsin nervor deri

në qendrën përkatëse, ku zhvillohet aktiviteti psikonervor;

c. **Rruga nervore piramidale** – Rrugë fijezash nervore që nisen nga qelizat e Becit dhe vazhdojnë rrugën poshtë palcës kurrizore deri në muskuj. Fijezat nervore të kësaj rruge kontrollojnë lëvizjet e vullnetshme.

"RRUSHI I THARTË". Mekanizëm mbrojtës i pasuksesshëm i emërtuar sipas Ezopit. Sipas këtij mekanizmi mossuksesin në arritjen e një qëllimi të caktuar njeriun e arsyeton duke ja zvogëluar vlerën objektive këtij qëllimi dhe duke e lënë atë mënjanë, sepse i ka vënë vetes një qëllim më të lartë.

RRYMA PSIKOLOGJIKE. Lëvizje e përgjithshme mendore e sistemuar në formën e teorisë psikologjike të përgjithshme, e cila orvatet t`i shpjegojë proceset psikike, sjelljet dhe ndryshimet individuale nga një këndvështrim i posaçëm. Ky është sistem relativisht integrues dhe koherent i koncepteve për lëndën e metodat e psikologjisë dhe kuptimësinë e veçantë të fakteve psikike, për sjelljet dhe ndërlidhjet e tyre, si edhe për interpretimin e tyre. Në këtë pikëpamje dallohet pak nga shkolla psikologjike, e cila nënkupton karakterin institucional të zhvillimit të mendimit psikologjik. Shih – ***SHKOLLA PSIKOLOGJIKE.***

RRYMIMI I VETËDIJES - i m. Rrjedh e vetëdijes. Term i konceptit të psikologjisë së Uiliam Xhejmsit ("The Stream of Consciousness"). Sipas tij vetëdija nuk është shtresë statike e përvojës episodike apo mozaik pjesësh të palidhura, por lum rrjedhës i vazhdueshëm i mendimeve, i përjetimeve etj. Kjo rrjedh ka fazat e veta, si "para dhe pas kësaj ndjeshmërie", "përjetimi", "përvoje", "mendimi" etj. Në këtë rrjedhë ka indentifikuar gjendjet substantive dhe transitive të vetëdijes së njeriut

Burimi:

"*The Principles of Psychology*", Vëllimi I, London: Macmillan and Co., 1890.

S

S "Shkurtesë për aftësinë spaciale (hapësinore) në Teorinë e Leon L. Terstonit (Lewis L. Thurstone, 1887 – 1956)**.**

S "Shkurtesë për subjektin".

S "Shkurtesë për stimuluesin, apo ngacmuesin (sidomos në formulën S – R).

S "Faktori special në teorinë e Çarls E. Spirman (Charles L. Speraman, 1863 – 1974)".

SABOTIM, - I. m. Term i të folurës së përditshme dhe shprehje teknike në psikologjinë e punës i ardhur nga frëngjishtja *sabotage*. Emërton dëmtimin e qëllimshëm dhe në mënyrë të fshehtë të mjeteve të punës, të prodhimit, të pronës etj. Shkaktohet nga ana e një individi ose një grupi punëtorësh për të penguar procesin e punës dhe për të futur çrregullim në punishte, në fabrikë, në shkollë etj. Sabotimi pengon mirëvajtjen e punës dhe në kushte të zakonshme shfrytëzohet më tepër në situata krizash ekonomike, sociale etj. për t`i sjellë dëm punës. Realizohet në forma të ndryshme si: prishja e mjeteve të punës, e makinave, pakujdesia në paketimin e produkteve etj.

SADIZ/ËM, - MI. m. Formë e shëmtuar e plotësimit të shtytjes dhe motivit seksual, formë e shmangies seksuale, kur një individ "kryen aktin seksual duke poshtëruar, dënuar e munduar me gjithë çfarë është e mundur një individ tjetër". Ka raste kur kjo shmangie është e domosdoshme për të arritur në kënaqësinë seksuale, duke i shkaktuar dhembje partnerit tjetër. Në raste të tilla sadizmi i përket kategorisë së parafilive. Termi sadizëm ka shtrirë kuptimin e tij edhe në fusha të tjera të jetës dhe aktivitetit të njeriut, siç është sjellja e vrazhdë e njeriut ndaj tjetrit duke i shkaktuar dhembje e vuajtje. Fjalën sadizëm e përdori shkrimtari francez Komte D. F. dë Sade (Comte D. F. de Sade, 1740 – 1814), por u konsolidua si term nga markezi dë Sade, prej nga u quajt sadizëm**.**

SADIZMI NË PSIKANALIZË. Prirje e hapur dhe relativisht e qëndrueshme e një individi për t`i shkaktuar dëm, dhembje fizike e shpirtërore një individi tjetër dhe që përjeton kënaqësi gjatë nënshtrimit dhe vuajtjeve të tjetrit. Sipas Zigmund Frojdit

(Sigmund Freud, 1856 – 1939) sadizmi është përbërës i shtytjes seksuale agresive, që ka marrë formë të pavarur e të tepruar, duke e vendosur atë në vend të parë". Në shqyrtimet e mëvonshme Frojdi ka shpjeguar se sadizmi ka ardhur nga mazohizmi, që te njeriu lind para sadizmit. Psikanalisti social Erik From (Erich Fromm, 1900 – 1980) i ka dhënë kuptim më të gjerë këtij termi. Sipas tij viktimizimi seksual është formë e pushtimit të plotë të tjetrit dhe jo qëllim për vete dhe në vetvete. Një sadizëm i tillë zhvillohet nga paaftësia e njeriut për t`i dashur të tjerët.

SADIZMI ORAL. Veprim agresiv gojor, kur bëhen orvatje për t`i sjellë objektit të libidos dhembje e lëndim. Sipas psikanalistes austriake Melani Klajn (Melanie Kleine, 1882 – 1960) sadizmi oral arrin kulmin e vet në fazën orale të zhvillimit psikoseksual.

SADOMAZOHIZ/ËM, - MI. m. Sjellje agresive të drejtuara ndaj vetes dhe njëkohësisht edhe ndaj të tjerëve. Është dukuri e rrallë, së cilës Zigmund Frojdi dhe Erik Fromi i kanë kushtuar kujdes të posaçëm në përshkrimin e saj. Sipas Zigmund Frojdit "Sadisti është njëkohësisht sadomazohist, megjithëse ana aktive dhe pasive e perversionit të tij mund të jetë e shprehur me fuqi më të madhe dhe të përfaqësojë kryesisht veprimtarinë seksuale të tij". Ndërkaq, për Erik Fromin sadomazohizmi është raport joproduktiv ndaj botës, por jo perversion seksual. Sipas tij sadomazohizmi është largim nga ndjenja e padurueshme e të lënit pas dore dhe e vetmisë.

SAGJITAL, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *sagittalis* "shigjetor" dhe i përdorur kryesisht në psikologjinë fiziologjike. Me këtë emërtohet cilësia e gypit në formë shigjete që bashkon bazën e eshtrave të kokës, pra plasa që e ndan trupin vertikalisht në dy pjesë të barabarta e simetrike (ana e djathtë dhe e majtë e trupit, truri i ndarë në dy pjesë, siç është plasa longitudinale që ndan trurin në dy hemisfera).

SAIZOTOMI, - A. f. Faktori A i tipareve negative të personalitetit të tilla si: sjelljet e ftohta, të përmbajtura që nuk shprehin gatishmëri për bashkëpunim, besueshmëri dhe sjellje rigide të personalitetit. Shënohet me termin "Saizotomia A – ". Termi i përket teorisë së personalitetit të Rajmond B. Katelit (Reymond B. Cattell, 1905 – 1998).

SAKRIFIC/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *cacrificium* "flijim". Sakrifica është të bërit theror, vetëmohimi me dashje i njeriut për hir të një qëllimi më të lartë, më bujar, më fisnik. Kjo ka të bëjë me procesin e nënshtrimit të bindjeve, të pikëpamjeve, të qëndrimeve personale mendimeve të të tjerëve, të cilët mund të jenë autoritete ekonomike, fetare, politike etj. Në psikologjinë eksperimentale sakrifica është mundimi deri në asgjësim të qenies së eksperimentimit (të minjve, të qenve etj.), me qëllim të përcaktimit të shkallës së durimit pa oksigjen, pa ujë, pa ushqim etj. Sakrifica në fenë e krishterë është "vuajtja e Krishtit si dhuratë e Zotit për shpëtimin e njerëzimit". Rrjedhimisht me këtë, në fenë e krishterë sakrifica kuptohet si nënshtrim i besimtarëve, i ndjenjave, i mendimeve dhe i sjelljeve të tyre kërkesave të të parit të fesë katolike. Kjo sakrificë, ky nënshtrim i atribuohet posaçërisht

priftërinjve, famullitarëve, ipeshkvijve etj.

SAKRIFIKIM, - I. m. Heqje dorë me vetëdashje nga të mirat, nga përfitimet vetjake, nga plotësimi i dëshirave, i interesave, nga realizimi i synimeve për të mirën e të tjerëve, për të mirën e përgjithshme të shoqërisë. Emërton edhe kuptimin e konceptit të flijimit të qëllimshëm të njeriut për hir të interesit të përgjithshëm familjar, kombëtar e mbarënjerëzor.

SAKRUM, - I. m. Term i anatomisë, që përdoret më tepër në psikologjinë fiziologjike dhe ka ardhur nga latinishtja *sacralis* "kërbishtor". Emërton ashtin në formë trekëndore të pjesës së poshtme të kolonës vertebrore, duke lidhur pjesët e shpinës ndërmjet tyre.

SAKTËSI, - A. f. Veçori e organizimit të sjelljeve sipas rendit e përpikërisë kohore, hapësinore, morale etj., duke iu përmbajtur vazhdimisht rendit dhe marrëveshjes me të tjerët. Kur kjo mënyrë e sjelljeve merr karakter të përgjithshëm dhe të qëndrueshëm, atëherë saktësia merr përmasën e tiparit të personalitetit. Saktësia është rezultat i procesit të të mësuarit.

SAKUL, - I. m. Në anatominë e veshit i ardhur nga latinishtja *sacculus* "qeskë". Sakuli është qeska më e vogël ndër dy të tilla që gjenden në veshin e brendshëm. Ka formë të rrumbullakët dhe në fund të tij gjenden receptorët, që reagojnë ndaj ndryshimit të vendndodhjes së trupit në hapësirë dhe të pjesëve të tij. Këtë funksion e kryen së bashku me qeskën tjetër pak më të madhe, utrikulin dhe me pjesët e tjera të veshit të brendshëm, me receptorët e tyre, si edhe me qendrën e trurit për ekuilibrim të trupit dhe të pjesëve të tij. Shih – ***UTRIKULI.***

SALIVACION, - I. m. I ardhur në psikologji nga anglishtja që emërton prodhimin e jargëve pështymore dhe lagien e gojës dhe të buzëve me pështymë. Termi i përket fiziologjisë, por ka edhe përmasë domethënëse për psikologjinë e frikës. Nën ndikimin e frikës që përjeton njeriu dallohet mungesa e pështymës në buzë dhe në gojë. "Buzët e thata" është shenjë e sigurt e përjetimit të frikës nga ana e një njeriu të caktuar.

SALIVEN Hari Stek (Harry Stack SULLIVAN). Mjek psikiatër amerikan, neopsikanalist. Lindi në Noriç (Norwich) në Nju Jork më 1892 dhe vdiq në Paris më 1949. Ishte kundërshtar i pikëpamjeve të Zigmund Frojdit, por nuk u nda nga koncepti i pavetëdijeshmërisë, i mekanizmave mbrojtës dhe i rolit të interpretimit të ëndrrave, kurse disa koncepteve të tjera psikanalitike ja ka ndryshuar kuptimin e tyre. Përpos kësaj Hari Saliven është hartues i konceptit *selfsystem* – "*sistemi i unit*" dhe përgjithësisht i konceptit të psikiatrisë ndërpersonale, duke theksuar rolin e faktorëve të mjedisit shoqëror në zhvillimin dhe formimin e personalitetit. Sipas tij njeriu ka vetëm dy lloje nevojash: nevojën e sigurimit dhe atë të kënaqësisë; konflikti ndërmjet këtyre nevojave shkakton problem emocional dhe, lidhur me të, edhe sjellje të papërshtatshme. "Nuk ka personalitet të pavarur nga shoqëria". Nga raporti individ–shoqëri zhvillohet personaliteti i shëndoshë ose i sëmurë. Zhvillimi i këtij raporti fillon që nga koha e paralindjes dhe

vazhdon me varësinë e fëmijës nga e ëma; raporti nënë–fëmijë është raporti bazë mbi të cilin zhvillohen format e tjera të raporteve shoqërore te njeriu. Kësaj pikëpamjeje të tij për zhvillimin e personalitetit i ka dhënë termin "*sistemi i unit*". Veprat kryesore të tij janë: *"Conceptions of Modern Psychiatry"* – (*"Botëkuptimi i psikiatrisë moderne"*), 1947; "*The Interpersonal Theory of Psychiatry"* – (*"Teoria ndërpersonale në psikatri"*), 1953; *"Freud and Americans 1917 – 1985"* – (*"Frojdi dhe amerikanët"*), 1995;

SANATORIUM, - I. m. Ente shëndetësore që në fillim ishin ndërtuar për sëmundje të rënda e të specializuara për sëmundje të veçanta, siç ishte tuberkulozi në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Më vonë me termin sanatorium (në vendet anglo-saksone) u emërtuan shtëpitë e të moshuarve. Në mjediset shqiptare sanatoriumi emërton kryesisht entet shëndetësore për sëmundjet e mushkërive, që ndërtohen në vende me ajër të pastër.

SANGUIN. asnj. Që i përket tipit sanguin të temperamentit të njeriut, i emërtuar me fjalën greke *σανγυης* "gjak". Ky temperament karakterizohet nga këto cilësi: i shpejtë ndaj ngacmuesve, me intensitet të dobët të emocioneve që nuk zgjasin shumë, me prirje kah haresë, kalimi i shpejtë nga predispozita negative në atë pozitive, orientim optimist në jetë etj. Tipi sanguin është emërtim i klasifikimit klasik të temperamentit në bazë të mbisundimit të lëngjeve në organizmin e njeriut. Këtë klasifikim e ka bërë mjeku grek Hipokrati (Hippocrates, rreth viteve 460 – 377 p.e.r.) dhe mjeku e filozofi grek Galen (Galen, 122 – rreth 199). Shih – ***TEMPERAMENTI.***

SAPOLINDUR (I, E). mb. Që përcakton kohën gjatë së cilës prej lindjes organizmi i fëmijës mund të jetojë me rezerva ushqimore të fazës së paralindjes. Kjo fazë mund të zgjasë disa ditë. Kur fëmija i porsalindur fillon të ushqehet me qumështin e gjirit të nënës, atëherë ai quhet foshnje.

SARKAZ/ËM, - MA. f. Term i letërsisë me përmasë të caktuar psikologjike i ardhur nga greqishtja *σαρκασμός*. Është shprehje ironike me të cilën shprehet hidhërimi, përbuzja, urrejtja etj. në përmbajtjen e mendimit të shfaqur në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, madje edhe në porosinë e drejtuar tjetrit. Konsiderohet mjet i fuqishëm i demaskimit të kundërshtarit.

SASI, - A. f. Aspekti sasior i një dukurie, gjendjeje, procesi psikik etj. Sasia ka të bëjë me përcaktimin e sasisë së vlerave, të nivelit të intensitetit të një ndijimi, me shtrirjen kohore të një procesi, me shkallën e zhvillimit të aftësive etj. Matjet në psikologji janë të mundshme vetëm në mbështetje të përcaktimit numerik të ndryshoreve psikologjike që janë provuar.

SASIOR, - E. mb. Që përcakton aspektin numerik të proceseve psikike dhe të sjelljeve; që ka të bëjë me sasinë e tyre, si: koha e zgjatjes së një reagimi, intensiteti i ngacmuesit të receptorëve të dëgjimit, shkalla e zhvillimit të inteligjencës etj. Matjet sasiore kanë ushtruar ndikim të fuqishëm në zhvillimin e psikologjisë eksperimentale.

SATIR/Ë, - A. f. Term i letërsisë me përbërës përmbajtjesorë psikikë, i ardhur nga latinishtja *satura*. Emërton përqeshjen dhe qortimin e përmbajtjes së shprehjeve dhe të sjelljeve të

padëshirueshme, të cilat konsiderohen se janë të meta shoqërore dhe individuale. Shfaqen me mprehtësi mendore e shprehje thumbuese.

SATIRIAZ/Ë, - A. Term i psikopatologjisë i ardhur nga greqishtja *σάτυρας*, sipas mitologjisë greke "djall i pyjeve". Emërton konceptin e zmadhuar të shtytjes dhe motivit seksual te meshkujt, e pikërisht konceptin e pangopshmërisë seksuale të disa meshkujve. Kjo dukuri erotike te meshkujt e caktuar ka karakter të qëndrueshëm. Çon në stabilizim të rrallë të jetës bashkëshortore; kërkohet ndërrim i shpeshtë i partnerit seksual. Kjo dukuri me të njëjtën përmbajtje shfaqet edhe te disa femra, por me termin nimfomani.

SATURIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *saturati* "ngopje" që i përket konceptit të pastërtisë së një ngjyre. Ngjyrat me shkallë të lartë saturimi janë ngjyra kromatike të gjalla, të fuqishme; këto largohen shumë nga e zeza. Ngjyrat me shkallë të ulët saturimi duken të papastra, të përziera me të zezën. Në psikometri termi saturim përdoret në analizën faktoriale dhe emërton koeficientin e ndërlidhjes ose të korrelacionit të një faktori me një faktor tjetër në një test të dhënë.

SAVANT, - I. m. Emërtim francez për ata individë, të cilët janë tepër të aftë, të jashtëzakonshëm, të shkathët mendërisht në një fushë të posaçme të diturisë, kurse në fusha të tjera janë të kufizuar. Savantët janë ata individë, të cilët brenda një kohe të shkurtër janë në gjendje të caktojnë saktësisht se cila ditë është 19 marsi i vitit 2020. Mjafton ta dëgjojnë një herë një kompozim dhe e interpretojnë me përpikërinë më të madhe pa nota; për një kohë shumë të shkurtër janë në gjendje të llogarisin dy numra katër-, pesë- e gjashtëshifrorë etj. Natyra psikike e aftësive të tilla kërkon metoda hulumtuese të veçanta, që psikologjisë së sotme i mungojn**ë.**

SEÇENOV Mihajloviç Ivan (Mikhaylovich Ivan SECHENOV). Fiziolog rus me ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e neuropsikologjisë. Lindi më 1829 dhe vdiq më 1905. Kreu studimet e mjekësisë në Fakultetin e Moskës dhe më pas ka punuar në laboratorin eksperimental të Herman Helmholcit, por teknikën e hulumtimeve eksperimentale e mësoi duke punuar në laboratorin e fiziologut të njohur francez Klod Bernar. U doktorua më 1860 në fiziologji pas mbrojtjes me sukses të tezës mbi fiziologjinë e dehjes së njeriut nga alkooli. Profesor i fiziologjisë në Akademinë Mjekësore – Kirurgjike të Universitetit të Petrogradit, të Odesës dhe të Moskës. Konsiderohet "babai i fiziologjisë ruse", nga shkolla e tij u zhvillua dhe u afirmua fiziologu Ivan Petroviç Pavllovi dhe neurologu e psikiatri Vladimir Mihajloviç Behterievi. Rezultatet e hulumtimit të fiziologjisë së sistemit nervor të njeriut treguan ekzistencën e qendrave frenuese të trurit. Organizmi i njeriut funksionon falë funksionimit të qendrave nxitëse dhe qendrave frenuese. Baraspesha funksionale e organizmit të njeriut mbështetet në drejtpeshimin funksional të qendrave nxitëse dhe frenuese të trurit. Ky ishte një nga zbulimet e rëndësishme – shkas i propozimit të Ivan Seçenovit për çmimin Nobel, që kurrë nuk e

mori. Në historinë e psikologjisë mbeti i njohur me rezultatet e gjurmimit të reflekseve dhe të lidhjeve e ndërlidhjeve të tyre me veprimet e me sjelljet e njeriut. Sipas tij sjelljet janë baza e psikikës së njeriut, sepse psikika nuk ka bazë të qenies së saj të pavarur; kjo nuk ekziston si entitet i veçantë, por për natyrën e proceseve psikike dhe të vetive karakteristike psikike gjykojmë në bazë të sjelljeve që shfaqen objektivisht. Sjelljet e këtilla duhet të jenë objekt i studimit të psikologjisë. Kjo qasje e re studimit të proceseve dhe vetive psikike ishte kundërqasje mendore e psikologjisë strukturaliste e introspektive, që në Europën e viteve të fundit të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe në fillim të shekullit të njëzet, së bashku me psikanalizën, u bë qasje mendore mbisunduese e atyre viteve. Mbi këtë bazë pohojmë se shkolla fiziologjike ruse e Seçenovit, e Pavllovit dhe e Behterievit ka qenë paraprijëse e zhvillimit të drejtimit dhe të shkollës bihejvioriste, që lindi dhe u zhvillua në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Veprat kryesore të tij janë: "*Refleksi golovnog mozga*" – (*"Reflekset e trurit të madh"*), 1863; *"Elementi misli"* – (*"Elementet e mendimit"*), 1878.

S

SEDATIV, - Ë. Grup substancash psikofarmakologjike, marrja e të cilave shkakton uljen e funksionit të sistemit nervor qendror, duke manifestuar ulje të shkallës së veprimtarisë ndijimore e motorike dhe gjumë të lehtë. Grupit të sedativëve u përkasin këto substanca kryesore: barbituratet, klorhidratet etj. Cilësi e përbashkët e këtyre substancave është ndikimi i tyre në qetësimin e organizmit.

SED/ËR, - RA. f. Ndjenja e nderimit dhe e respektimit të shoqëruar me dashuri të virtyteve, të vlerave njerëzore të një individi. Sedra përjetohet për shkak të virtyteve, të cilat ai i vlerëson në shkallë të lartë. Kuptimi i sedrës shtrihet ndaj vlerave etike, profesionale, personale që ai i ka, apo që mendon se i ka duke bërë orvatje të vazhdueshme për të mos cenuar këto vlera. E tillë është vlera e dinjitetit njerëzor, e ndershmërisë etj. Një ndjenjë e tillë lidhet ngushtë me angazhimin për t`u ruajtur nga padrejtësia, e pandershmja, duke kultivuar vlerat apo virtytet që ai i ka dhe i vlerëson pozitivisht në shkallë të lartë. Kjo ndjenjë zhvillohet dhe formohet me thellimin e nderimit të prindërve ndaj fëmijës së tyre, sepse ai fillon ta çmojë rëndësinë e vetes dhe të qenies së vlefshme të tij.

SEGREGACION, - I. m. Term i psikologjisë sociale i ardhur nga latinishtja *segregare* "ndaj nga tërësia". Segregacioni është qëndrim i rrënjosur i një grupi individësh që dallohen nga të tjerët për nga ngjyra e lëkurës, përkatësia etnike, fetare etj., që ushtrojnë ndikim të drejtpërdrejtë në nxitjen, organizimin dhe drejtimin e sjelljeve negative ndaj tyre. Mbështetet në ndjenjën e mbivlerësimit të një grupi ndaj një grupi tjetër. Shfaqet në privilegjet e formuara për vendbanim, institucione të veçanta shoqërore, kulturore, arsimore etj. të një grupi nga grupi tjetër etnik, fetar, racor etj., me territor të ndarë, me standard jetësor dhe zakone të posaçme. Segregacioni i njohur është ai i Republikës Jugafrikane, ku zezakët kanë përjetuar shkelje të rënda njerëzore. Termi segregacion

e ka ruajtur kuptimin e vet edhe në psikologjinë geshtaltiste. Këtu segregacioni nënkupton ndarjen fenomenologjike të një figure nga sfondi i saj, duke e perceptuar këtë si diçka të tërësishme dhe të organizuar.

SELIGMAN Martin (Martin SELIGMAN). Psikolog amerikan. Lindi në Nju Jork më 1942. Studioi në Akademinë "Albany" të Nju Jorkut. Pas përfundimit të studimeve në Universitetin Princeton mori falënderimin më të lartë më 1964. U doktorua në psikologji në Universitetin e Pensilvanisë, ku punon prej vitit 1964. Kryetar i Shoqatës Amerikane të Psikologëve nga viti 1998. Themelues i lëvizjes "Psikologjia pozitive". Sipas tij, jeta e vërtetë e njeriut është jeta e synimeve për ndryshime dhe aftësia jonë për të reaguar ndaj tyre. Prandaj, njeriu duhet të jetë i gatshëm t`i përgjigjet situatës së shkaktuar me sjellje të përshtatshme. Vetë njeriu duhet të marrë mbi vete përgjegjësinë e mendjes së tij. Ka botuar dyqind artikuj shkencorë nga fusha e psikologjisë. Veprat kryesore të tij janë: "*Learned Optimism*" – (*"Optimizmi i mësuar"*), 1991; *"Çfarë mund të ndryshojmë dhe çfarë nuk mund të ndryshojmë",* 1993, "*The Optimistic Child*" – ("*Fëmija optimist"*), 1995 etj.

SEKONDAR, - E. mb. Term që ka depërtuar në shqip nga latinishtja *secundariuis* "dytësor". Në literaturën e psikologjisë përdoret me kuptimin i dyti sipas rendit, sipas rangut të rëndësisë, i varur nga tjetri.

SEKRETIM, - I. m. Në anatominë e fiziologjisë dhe të psikologjisë fiziologjike i ardhur nga latinishtja *secretion* "sekretim, tajitje", që ka të bëjë me prodhimin e gjëndrave të organizmit. Ky term përdoret më tepër për të emërtuar hormone të gjëndrave me sekretim të brendshëm, përkatësisht të atyre substancave aktive biokimike që luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin funksional të organizmit . Shih – ***GJËNDRAT ME SEKRETIM TË BRENDSHËM.***

SEKS, - I. m. I ardhur nga latinishtja *sex*. Është ngulitur edhe në të folurin e përditshëm. Emërton konceptin e tërësisë së veçorive organike, fiziologjike e psikike parësore e dytësore që karakterizojnë mashkullin dhe femrën e që, në bazë të të cilave mashkulli ndryshon nga femra. Funksioni i përbashkët dhe specifik i secilit qëndron në riprodhimin e një lloji të caktuar të organizmave. Në psikanalizë termi seks ka kuptim të gjerë. Kështu krahas funksionit gjenital dhe riprodhues, seksi emërton shtytësin seksual me anën shqisore dhe trupore dhe strukturën emocionale të dashurisë. Është termi kryesor i psikanalizës së tipit të Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939).

SEKSIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga fjala seks që emërton qëndrimin negativ, madje edhe paragjykimin e një gjinie ndaj pjesëtarëve të një gjinie tjetër. Zakonisht, fjala është për qëndrime negative, për paragjykime dhe sjellje të lidhura me to, të drejtuara dhe të përqendruara te pjesëtarët e gjinisë femërore. Seksizmi shfaqet në nënçmimin e vlerave të femrave, duke iu kufizuar të drejtën për të qenë të zgjedhura në forume ekonomike, financiare, politike, shoqërore etj. Pabarazia e gjinive është veprimtari

dënuese. Angazhimi për ruajtjen dhe respektimin e dinjitetit njerëzor, pavarësisht nga gjinia përkatëse, është ndër të drejtat themelore të njeriut.

SEKSUAL, - E. mb. Që i përket seksit, që ka të bëjë me seks, që ka kuptim të përgjithshëm seksual dhe kuptim psikanalitik. Me këtë mbiemër janë formuar termat togfjalësh:

a. **Anomalitë seksuale** – Çrregullim në format e veprimeve për plotësimin e shtytësit dhe motivit seksual duke ndryshuar objektin, qëllimin dhe sjelljet seksuale;

b. **Çrregullimet seksuale –** Forma sjelljesh jonormale të raporteve seksuale. Objekti seksual, qëllimi dhe fuqia e shtytjes seksuale e shoqëruar me sjellje jonormale të raporteve seksuale ndërmjet femrës e mashkullit. Çrregullimet e tilla ndahen në tri grupe kryesore: parafilitë, çrregullimet e funksionit psikoseksual dhe çrregullimet e identitetit të përkatësisë seksuale;

c. **Disfunksionet seksuale –** Çrregullime raportesh psikoseksuale që nuk kanë bazë organike dhe manifestohen me ngacmime me shkallë të ulët seksuale të një femre apo një mashkulli, me mungesë dëshire për marrëdhënie seksuale etj.;

d. **Identiteti seksual –** Të qenit i vetëdijshëm i një individi për rolin e vet seksual, pikërisht përjetimi i rolit seksual si rol i vetë individit; ka individë që nuk e kanë të qartë identitetin seksual të tyre (janë të vetëdijshëm për përkatësinë gjinore organike e fiziologjike, por dëshirojnë rol seksual të gjinisë tjetër;

e. **Motivet seksuale** – Motiv biologjik karakteristik për njerëzit. Mënyrat e realizimit të tij, sjelljet e nxitura nga motivi seksual (që nxit, drejton dhe organizon sjelljet drejt partnerit të gjinisë së kundërt) mësohen dhe ndryshojnë prej një mjedisi në një mjedis tjetër kulturor;

f. **Objekti seksual** – Individi i gjinisë së kundërt, i të njëjtës gjini, gjësend etj., në të cilin është drejtuar aktiviteti seksual dhe sjelljet e posaçme të këtij aktiviteti;

g. **Qëllimi seksual** – Synimi dhe dëshira seksuale me energjinë e tyre që shkaktohet nga tensioni i organizmit dhe nevoja e çlirimit të energjisë së dëshirës, motivit dhe synimit, duke kryer aktin e raportit seksual me partnerin e caktuar, pra arritja e orgazmës;

h. **Roli seksual** – Besimi, bindja, qëndrimi, vlera dhe sjelljet e lidhura me to, që përcaktohen nga mjedisi shoqëror; pjesëtari i këtij mjedisi kulturor pritet t`i përmbahet rolit të caktuar. Në mjediset shqiptare mashkulli pritet të jetë burrëror, i interesuar dhe i angazhuar në punë më të rënda, kurse nga femra pritet të jetë e qetë, e butë, e kujdesshme, shtëpiake dobiprurëse, nënë e mirë etj.

i. **Shtytësi seksual** – Prirje e lindur biologjike, e shkaktuar nga disa ndryshime fiziologjike të organizmit dhe e drejtuar në kërkim të objektit seksual dhe në realizimin e aktit seksual. Në psikanalizë shtytësi seksual ka kuptim të veçantë me rëndësi të madhe për shpjegimin e aktivitetit të gjithëmbarshëm të njeriut, duke përfshirë edhe çrregullimet neurotike. Shtytësi seksual ka burimin, fuqinë, objektin dhe qëllimin e vet;

j. **Trauma seksuale** – Term i psikanalizës që emërton kujtimet e dhembshme

të sulmeve seksuale të të rriturve (të prindërve, të të afërmve, të kujdestarëve, të miqve etj.) ndaj një individi të moshës fëmijërore. Këto viktima vuajnë shumë kohë nga trauma psikike**.**

SEKSUALITETI INFANTIL. Në teorinë psikanalitike të Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1836 – 1939) seksualiteti infantil shtrihet në fazën e seksualitetit oral, anal, falus deri në fazën e zhvillimit të gjenitaleve të hershme.

SEKULAR, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *secularis* "profane", që i përket botës laike, që është jashtë sferës së besimit fetar. Ky mbiemër buron që nga koha e Reformacionit gjerman, kur ka filluar shpronësimi i kishave në të mirë të pushtetit laik. Sekular mund të cilësohet individi fetar, i cili ka hequr dorë nga bindjet, pikëpamja dhe qëndrimet fetare. Një proces i tillë është gjurmuar pak në psikologjinë e fesë.

SELEKSIONIM, - I. m. Term i përgjithshëm që përdoret në disa disiplina shkencore, si edhe në të folurin e përditshëm në shqip, por i ardhur nga latinishtja *selectio* "përzgjedhje". Në psikologji përdoret më tepër në përzgjedhjen profesionale – zgjedhja e kandidatëve, të cilët në nivelin më të lartë cilësor i plotësojnë kriteret psikologjike dhe shëndetësore për të kryer me sukses punët e lidhura me një profesion të caktuar. Shih – ***PËRZGJEDHJA PROFESIONALE.***

SELEKSIONIMI PROFESIONAL. Proces psikologjik e mjekësor i organizuar nga ekspertët me qëllim të përzgjedhjes së kandidatit më të suksesshëm, i cili i plotëson kriteret testore për kryerjen me sukses të plotë të detyrave që i kërkon vendi i caktuar i punës. Shih –***PËRZGJEDHJA PROFESIONALE.***

SEMANTIK/Ë, - A. f. Term i gjuhësisë dhe i filozofisë së gjuhës që përdoret për të emërtuar studimin e kuptimit të shenjave në përgjithësi, në rend të parë studimin në raport me emërtimin dhe zhvillimin e tyre. Në terminologji ka hyrë nga greqishtja *σημασιολογία* "kuptimor". Ka përmasë domethënëse psikologjike, para së gjithash për shkak të kuptimit denotativ dhe konotativ të fjalëve. Në psikologji përdoret kryesisht në formën e mbiemrit, si afazi semantike, kujtesë semantike, terapi semantike etj.

SEMANTIKA GJENERATIVE. Qasje e atillë e gjurmimit të gjuhëve që është e drejtuar në zhvillimin e gramatikës që gjeneralizon kuptimin e thellë të fjalisë dhe orvatet për të shndërruar kuptimin e thellë në fjali reale.

SEMIOTIK/Ë, - A. f. Disiplinë shkencore, e cila merret me studimin e shenjave komunikuese, me llojet dhe me funksionet e sistemit të këtyre shenjave. Dallojmë semiotikën e sistemit të shenjave komunikuese njerëzore, që kanë kryesisht karakter gjuhësor, siç është fjala, por edhe figura, gjesti etj. Këta shenja dhe kuptimi i tyre kërkojnë angazhim të proceseve kognitive. Sjelljet e njerëzve nxiten, organizohen dhe drejtohen sipas shenjave të caktuara. Shenjat komunikuese të kafshëve janë jofjalësore dhe karakterizojnë llojin e caktuar të tyre. Çarls Moris konsiderohet se është themelues i semiotikës, kurse me studimin e gjerë

dhe të thellë të saj u mor linguisti amerikan me origjinë hungareze Tomas A. Sebeok (Thomas A. Sebeok).

SENESCENCI, - A. f. I ardhur në terminologjinë shqipe të psikologjisë nga latinishtja *senex* "plak". Periudha kohore e ndryshimeve fizike e psikike e lidhur me kohën e pleqërisë, përkatësisht me fillimin e moshës 65-vjeçare. Sot emërtohet me termin faza e tretë e jetës së njeriut.

SENILITET, - I. m. I ardhur nga latinishtja *senilis* "i pleqërisë". Tërësi ndryshimesh organike, fiziologjike, morfologjike dhe psikike të lidhura me dobësimin fizik e psikik, që manifestohen në radhë të parë me format e dobësuara të aftësive mendore, të ndjenjave dhe të sjelljeve të njeriut. Këto ndryshime kanë karakter relativisht të përbashkët, por me ndryshime individuale. Sot bëhet dallimi i moshës parasenile dhe senile. Fillimi i senilitetit është i lidhur me moshën pas të gjashtëdhjetave.

SENSACION, - I. m. E dhëna shqisore dhe përjetimi elementar psikik i saj nga ana e njeriut. Term i përdorur shpesh në literaturën e psikologjisë, sidomos të asaj klasike, i ardhur nga latinishtja *sensatio* "mbresë", *santire* "ndijim". Në psikologjinë strukturaliste të tipit të psikologut gjerman Eduard V. Tiçener (Edward W. Titchener, 1867 – 1927) sensacioni, ndjenjat dhe përfytyrimet janë tri elementet e vetëdijes. Shih ***- NDIJIM****I*. Ky term përdoret edhe në të folurin e përditshëm dhe emërton lajmin, informacionin e papritur, që habit individin dhe bën jehonë.

SENSACIONAL, - E. mb. Që shkakton ndijim të thellë, i cili për një kohë të caktuar mbisundon proceset mendore, emocionale dhe sjelljet e njeriut. Ka për bazë kontrastin ndërmjet dukurisë së paralajmëruar dhe përvojës së atëhershme dhe befasisë së paraqitjes së një cilësie tjetër nga ajo që pritej.

SENSIBILIZIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja që në shqip ka kuptimin e ndjeshmërisë. Sipas kuptimit të përgjithshëm që përdoret më tepër në të folurën e përditshme emërton ngritjen e ndjeshmërisë në kuadrin e një lloji të caktuar ndijimesh, përshtatjen e tyre ndaj situatave ngacmuese me intensitet të ulët. Sensibilizimi ka të bëjë edhe me rritjen e ndjeshmërisë së ndjenjave ndaj një objekti, si rritja e ndjeshmërisë së nënës ndaj sjelljeve të të tjerëve të drejtuara ndaj fëmijës së saj. Kuptimi i veçantë ka të bëjë me rritjen e shkallës së ndjeshmërisë të një fushe të veçantë ndijimi, për shkak të disa ndryshimeve organike (ndjeshmëria e lartë e gruas shtatzënë ndaj shijes së ushqimeve të ndryshme), si edhe për shkak të ndikimit që ushtron një ngacmues në shqisën adekuate dhe ngritja e shkallës së ndjeshmërisë në shqisën tjetër**.**

SENSITIM, - I. m. Një nga format më të thjeshta të të mësuarit të reagimeve ndaj ngacmuesve të shqisave që paraqesin rrezik për organizmin. Shfaqet me rritjen e shkallës së ndjeshmërisë shqisore ndaj atyre ngacmuesve, që përsëriten disa herë dhe kanë intensitet relativisht të lartë duke rrezikuar jetën e organizmit. Pas rasteve të tilla organizmi fillon të mësohet duke reaguar edhe ndaj ngacmuesve të tillë, por me intensitet të ulët. Format e tilla të të mësuarit kanë si funksion përshtatjen

e organizmit ndaj ngacmuesve të rrezikshëm.

SENSITIVIZ/ËM, - MI. m. Shfaqje e gatishmërisë së reagimit me ankth ndaj situatave të ndryshme, që nuk japin shkas për të reaguar me ankth. Sensitivizmi është zhvilluar dhe formuar në formën e një prirjeje reaguese, ngaqë janë përjetuar shpesh situata me frikë gjatë procesit të zhvillimit të personalitetit të njeriut. Kuptimi i tillë ka të bëjë edhe me pamundësinë e njeriut për t`i dalluar situatat e sigurta për jetë dhe veprim nga ato të rrezikshmet.

SENSOMOTORIK, - E. mb. Ndijim dhe perceptim i objekteve, dukurive dhe situatave, të shoqëruara me veprimtari të veçantë të njeriut ndaj tyre. Kësaj veprimtarie i paraprin ndijimi i caktuar pamor, dëgjimor, i lëkurës etj. Baza fiziologjike e veprimtarisë së tillë ka të bëjë me mekanizmin aferent dhe eferent nervor. Në psikologjinë e psikologut zviceran Zhan Pijazhe (Jean Piaget 1896 – 1980) mbiemri sensomotorik ka të bëjë me fazën e zhvillimit më të hershëm kognitiv të foshnjës.

SENSORIUM, - I. m. Term i psikologjisë klasike që emërton qendrat, apo fushat e qendrave të cipës së trurit të madh, ku kanë arritur impulset nervore nga shqisat dhe receptorët e tyre dhe këto impulse janë përpunuar e janë shndërruar në ndijime dhe perceptime.

SENSUALIZ/ËM, - MI. m. Drejtim filozofik i teorisë së njohjes së realitetit, sipas të cilit tërë dija dhe sistemi i saj ka për burim të vetin përvojën shqisore të njeriut. Njohja e gjithëmbarshme e njeriut rrjedh nga ndijimet dhe nga cilësitë sasiore e cilësore të tyre dhe se, ajo që është jashtë njohjes shqisore nuk mund të jetë lëndë e njohjes. Përfaqësuesit më të njohur të sensualizmit kanë qenë Kondiaku, Loku etj. Në psikologji njihet thënia e Xhon Lokut "Asgjë nuk gjendet në mendje pa qenë më parë në shqisa". Ky pohim i përgjithshëm ka ushtruar ndikim të fuqishëm në zhvillimin e psikologjisë asocacioniste.

SENTENC/Ë, - A. f. I ardhur në shqip nga latinishtja *sententia* "fjalë e urtë". Sentenca është shprehje koncize, e shkurtër dhe e qartë e përvojës për një të vërtetë jetësore dhe zhvillimin e njeriut, pikërisht për gjendjen e tij në një situatë të vështirë jetësore. Të tilla janë shprehjet në shqip: "Bukuria shkëlqen", "Dija s`ka fund", "Nga e keqja del e mira dhe nga e mira del e keqja…" etj.

SENTIMENT, - I. m. I ardhur nga latinishtja *santire* "ndiej". Termi sentiment sot po merr kuptim më të gjerë. Është strukturë psikike e ndërlikuar dhe e formuar e njeriut, e formuar nga një varg ndjenjash, qëndrimesh dhe vlerash dhe e drejtuar në një objekt të caktuar. Sentimente janë: atdheu, mësuesi, nëna, vendlindja, madje edhe vetvetja. Sipas kuptimit të mësipërm patriotizmi si sentiment manifestohet me dashuri ndaj atdheut, me gatishmëri për t`u sakrifikuar për të mirën e tij dhe me urrejtje ndaj atij që e cenon dhe e rrezikon. Termi sentiment me kuptimin e mësipërm është përdorur në fillim nga psikologu me origjinë daneze Vilhelm MekDugal Wilhelm MecDougall). Psikologu amerikan Rejmond B. Katel (Rejmond B. Catell, 1905 – 1998) në teorinë e vet të personalitetit sentimentin e ka

përkufizuar: "Strukturë kryesore tiparesh dinamike e formuar nga ana e personalitetit, që i shtyn pronarët e saj ta drejtojnë vëmendjen në disa objekte ose klasa objektesh, duke pasur ndjenja dhe duke reaguar në mënyrë të caktuar ndaj tyre". Sentimentet luajnë rol të rëndësishëm në jetën dhe veprimtarinë e gjithëmbarshme të njeriut**.**

SENTIMENTALITET, - I. m. I ardhur nga frëngjishtja *sentimental* "ndjeshmëri", që ka të bëjë me shkallën e lartë të ndjeshmërisë emocionale të njeriut, që shfaqet në trajtë prirjeje me emocione romantike dhe periferike të herëpashershme ndaj situatave shoqërore të ndryshme. Prirja e tillë herë-herë mund të jetë edhe prirje sentimentale e pasinqertë.

SENTIMENTI I UNIT. Strukturë e ndërlikuar ndjenjash, qëndrimesh dhe veprimesh, e formuar në formë prirjeje të qëndrueshme për të reaguar pozitivisht ndaj vetes. Shfaqet në reagimet e zakonshme të shfaqjes pozitive të vetes ndaj të tjerëve, por edhe ndaj unit. Sentimenti i unit ose vetsentimenti konsiderohet ndër sentimentet mbisunduese të sjelljeve të njeriut. Ky është faktor mbrojtës i shëndetit fizik e psikik, i integritetit të interesave, të qëndrimeve e të motiveve të personalitetit. I përket teorisë së personalitetit të Rejmond B. Katelit, prej nga ka hyrë dhe është stabilizuar në terminologjinë e psikologjisë.

SEPTUM, - I. m. Pjesë e sistemit nervor limbik e vendosur në pjesën e sipërme të talamusit, e emërtuar me termin latin *septum* "ndarës". Termi i përket psikologjisë fiziologjike dhe përdoret më shumë në trajtën *septum pellucidum*, që përbën një grumbull qelizash nervore, të cilat marrin pjesë në rregullimin e gjendjes emocionale dhe në pengimin e reagimeve stereotipe agresive të njeriut.

SERIOZITET, - I. m. Term i të folurës së përditshme, por i përdorur edhe në psikologji; ka ardhur nga latinishtja *serius*. Serioziteti është tipar i përgjithshëm i sjelljeve të njeriut, që shfaqet me angazhimin e njëmendët të tij në kryerjen e detyrës, në zgjidhjen e shpejtë e të drejtë të një situate problemore dhe të sjelljeve të organizuara mbi bazën e zgjidhjes së asaj situate problemore.

SEROTONIN/Ë, - A. f. Neurotransmetues i formuar nga grupi i qelizave nervore që përbëjnë bërthamat e qelizave lidhore të vendosura në trungun nervor dhe që luajnë rol të rëndësishëm në përçimin e impulseve nervore. Degët e këtyre qelizave përfundojnë në hipotalamus dhe në pjesët e tjera të sistemit limbik, në cipën e trurit të madh dhe të vogël dhe në palcën kurrizore. Serotonina merr pjesë në rregullimin e gjumit, të ritmit të lëvizjeve dhe të shprehive. Sekretimi i serotoninës në sasi të pamjaftueshme shkakton çrregullimin e përjetimeve emocionale dhe shfaqet më tepër në çrregullimin e humorit, të gjumit dhe të ndjenjës së mundimit të organizmit. Ka medikamente që rregullojnë baraspeshën midis sasisë dhe funksionimit të serotoninës mbi bazën e shtimit ose të pakësimit të saj në gjak.

SERVIL, - E. mb. Që emërton cilësinë e qëndrimit dhe të sjelljes përulëse e lajkatare të një individi ndaj një individi tjetër, i cili gjendet në një pozitë më të lartë ekonomike, politike, shoqërore,

ushtarake etj., me qëllim përfitimesh vetjake (financiare, të përparimit në detyrën profesionale, në marrjen e gradës artistike, shkencore, ushtarake më të lartë etj.). Sjelljet e tilla marrin karakterin e qëndrimit, madje edhe të tiparit, po qe se stabilizohen në sjelljet ndaj "më të mëdhenjve".

SERVILIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga rrënja e fjalës latine *servilis* që emërton qëndrimin dhe sjelljen e lidhur me të, që shfaqet në përuljen e tij ndaj tjetrit, me lajka, ledhatime etj., kryesisht ndaj prijësve të veprimtarisë profesionale, politike etj. Ky qëndrim merr përmasën e një tipari të qëndrueshëm në sjelljet e personalitetit kur ky bëhet gati i zakonshëm në sjelljet ndaj një individi tjetër, sidomos ndaj individëve të tjerë superiorë. Zhvillohet dhe nga përfitimet materiale, të një pozite më të lartë në hierarkinë shoqërore, politike etj.

SET, - I. m. I ardhur nga anglishtja, që është bërë pjesë e terminologjisë psikologjike të ndërkombëtarizuar. Ka dy kuptime: 1) Strukturë psikike me funksion reagimin gati të njëjtë të një individi ndaj klasës së objekteve që kanë cilësi të përbashkëta, ndonëse ata kanë edhe ndryshime, por këto ndryshime nuk vërehen edhe atëherë kur duhen vënë re; 2) Emërton drejtimin, gatishmërinë, gjendjen, e pritjes së përkohshme paraprake të individit për perceptimin e një dukurie, objekti, situate etj. dhe ndikimin e tyre në perceptimin, në vlerësimin, madje edhe në sjelljet e tij ndaj asaj që do të shfaqet në fushën e të parit, të dëgjuarit etj. Gatishmëria e ushtarit në pyll në pritje të armikut ndikon në perceptimin, madje të gabuar të hapave të oficerit të kufirit, që ushtari i percepton si hapa të armikut, pritja e një ngacmuesi përshpejton reagimin motorik të pritësit ndaj tij etj.

SETI MENDOR. I ardhur nga anglishtja. Ka hyrë vonë në psikologji si gatishmëri e formuar e njeriut për t`iu qasur zgjidhjes së problemeve, duke shfrytëzuar përvojën e suksesshme të zgjidhjes së problemeve të ngjashme që ai i ka zgjidhur më herët.

SËMUNDJ/E, - A. f. Term mjekësor që emërton gjendjen jonormale të organizmit dhe ka të bëjë me çrregullimin e funksioneve jetësore të qenieve të gjalla. Në gjendjen e sëmurë organizmi reagon me çrregullim sjelljesh e veprimesh ndaj ngacmuesve që ushtrojnë ndikim të dëmshëm fizik, kimik, biologjik dhe psikik në organizëm ose në ndonjë organ apo sistem organesh. Sëmundja është pasojë e faktorëve ekzogjenë dhe indogjenë. Këta rrezikojnë aftësitë dhe funksionet biologjike dhe psikike. Termi u përdor nga mjekët dhe përdorimi i tij daton që nga shekulli XV, kur filluan të bëhen orvatje për dallimin e gjendjes së sëmurë të organizmit nga gjendja e funksionimit normal të tij, duke gjurmuar edhe shkaqet e gjendjeve të sëmura. Për kuptimin e termit sëmundje është me rëndësi përbërësja e etiologjisë së sëmundjes. Përdorimi i këtij termi u shtri edhe në psikologjinë shëndetësore dhe në psikopatologji.

SËMUNDJA ALZAIMER. Sëmundje e rëndë psikike me zhvillim progresiv, pasojë e atrofizimit të qelizave nervore të cipës së trurit të madh dhe të ndërlidhjeve të tyre, që shfaqet te njeriu zakonisht pas moshës pesëdhjetëvjeçare.

Simptomat kryesore të shfaqjes së kësaj sëmundjeje janë: humbja graduale e lidhjes me realitetin dhe ndryshimet e tij, vështirësi në të folur dhe çrregullime të strukturave dhe funksioneve kogntive, sidomos çrregullime të mëdha në proceset e kujtesës. Këto çrregullime janë pasojë e atrofizimit të cipës së trurit të madh, duke prekur sidomos strukturën e qelizave dhe të indeve nervore të qendrave njohëse të realitetit. Sëmundja Alzaimer ka bazë trashëgimie; kur dy prindërit kanë vuajtur nga kjo sëmundje rreth 90 % të pasardhësve të tyre vuajnë nga kjo sëmundje dhe, kur vetëm njëri prind ka pasur këtë sëmundje besohet se 60 % e pasardhësve do të vuajnë sëmundjen Alzaimer. U identifikua për herë të parë në formën më të saktë nga neurologu gjerman Aloj Alzaimer (Alois Alzheimer, 1864 – 1915). Shërimi i saj deri më sot është gati i pamundur, nuk ka medikament shërues për të.

S

SËMUNDJA BINSVANGER. Formë e sëmundjes progresive të rënies së strukturave e funksioneve psikike, në rend të parë të proceseve intelektuale dhe të sjelljeve të lidhura me funksionimin e strukturave të disa pjesëve të trurit. Shfaqet me zhbërjen e mielizimit të cipës së pjesës temporale dhe asaj tëmthore ose oksipitale. Mori emërtimin e mjekut zviceran Oto Binsvanger (Otto Binswanger, 1852 – 1929).

SËMUNDJA E PARKINSONIT. Shih – ***PARKINSONIZMI.***

SËMUNDJA KROJCFELD – JAKOB. Sëmundje neurologjike që ka këto simptoma psikologjike: demencën progresive, çrregullimin e të parit, paralizën e gjymtyrëve dhe qëndrimin jonormal të trupit. Kjo sëmundje shkaktohet nga disa organizma që i përngjajnë viruseve dhe nuk kanë acide nukleike. Sëmundja u quajt sipas zbuluesve të saj, neurologëve gjermanë: H. Krojcfeld (H. Creutzfeldt, 1885 – 1964) dhe A. Jakob (A. Jakob, 1884 – 1931).

SËMUNDJA KRONIKE. Sëmundje që zgjat shumë kohë dhe simptomat e së cilës ndryshojnë me ngadalësi gjatë një faze kohore. Sëmundjet e tilla mund të jenë sëmundje organike dhe sëmundje psikike, shpeshherë të pandara njëra nga tjetra.

SËMUNDJA LITËL. Paraliza cerebrale e fëmijëve. Simptomat kryesore të kësaj sëmundje janë të lidhur me ngërçe muskulore e nyjash të tyre dhe me humbje të aftësisë së koordinimit të lëvizjeve të trupit dhe të gjymtyrëve të tij. Shkaktohet nga lëndimet e embrionit nga helmimi i nënës me pije alkoolike dhe me marrje drogash, nga procesi i pakryer i mielinizimit të neuroneve dhe rrugëve nervore piramidale. U zbulua më 1861 nga kirurgu – ortopedik anglez Uiliam Xh. Litël (William J. Litl).

SËMUNDJA NERVORE. Çrregullim organik i sistemit nervor që shkakton çrregullime psikike me intensitet dhe me kohëzgjatje të ndryshme.

SËMUNDJA PIK. Sëmundje e rëndë paravajtëse e rrënimit të proceseve intelektuale dhe emocionale, si edhe e funksionit të tyre. Fillon rreth moshës gjashtëdhjetë vjeçare dhe pas rreth dhjetë vjetëve të zhvillimit të kësaj sëmundje shfaqen shenja të shthurjes

së proceseve emocionale dhe njëkohësisht edhe të proceseve intelektuale. Në fillim kujtesa dhe proceset e saj ruhen relativisht, por më pas shfaqet rrënimi intensiv edhe i kujtesës. Sëmundja Pik është pasojë e degjenerimit neural të zonave të pjesës ballore dhe tëmthore të trurit. Besohet se kjo sëmundje është e trashëguar. U përshkrua për herë të parë më 1892 nga ana e mjekut çek Arnold Pik (Arnold Pick, 1851 – 1924).

SËMUNDJET E SISTEMIT NERVOR. Çrregullimi i strukturave dhe i funksioneve të tyre në Sistemin Nervor Qendror dhe atë periferik. Disa sëmundje të tilla kanë të bëjnë drejtpërdrejt me çrregullim të proceseve psikike dhe me çrregullim të lidhjeve ndërmjet tyre. Shumë sëmundje të sistemit nervor godasin keq në formë jo të drejtpërdrejtë çrregullimet e proceseve psikike dhe sjelljet e njeriut. Ndër sëmundjet e sistemit nervor me ndikim në proceset psikike dhe në sjelljet e njeriut dallohen: atrofia neuropatologjike e muskujve, encefaliti, idiotizmi, meningjiti, paraliza etj.

SËMUNDJET E SHQISAVE. Çrregullim i përkohshëm apo i përhershëm, i lehtë apo i rëndë, i pjesshëm apo i tërësishëm i organit shqisor dhe ndijor, si edhe i funksioneve të tyre. Çrregullimet e tilla ndikojnë drejtpërdrejt në proceset e njohjes së trupave, të gjendjeve, si edhe të cilësive të tyre. Në këtë pikëpamje dallohen sëmundjet e shqisës së të parit dhe të të dëgjuarit.

SËMUNDJET ENDOKRINE. Sëmundje në të cilat përfshihet gusha, kretinizmi, miksedema, sëmundjet e hipofizës, të gjëndrave mbiveshkore, të pankreasit, të gjëndrave tiroide dhe paratiroide dhe sëmundjet e gjëndrave seksuale. Funksioni i tepruar ose i zvogëluar i këtyre gjëndrave ushtron ndikim negativ edhe në zhvillimin intelektual, emocional dhe të sjelljeve të njeriut.

SËMUNDJET PSIKIKE. Çrregullime procesesh intelektuale, emocionale dhe të sjelljeve, si edhe të lidhjeve ndërmjet tyre. Në grupin e sëmundjeve psikike bëjnë pjesë: prapambetja mendore, psikozat etj. Shumë specialistë i konsiderojnë edhe neurozat sëmundje psikike. Karakterizohen me rënien e aftësive, të kapaciteteve dhe të funksioneve të tyre në përballimin e nevojave të jetës së përditshme.

SËMUNDJET PSIKOSOMATIKE. Sëmundje që kanë burim psikogjen, të cilat shkaktohen ose përshpejtohen nga faktorët psikikë, në radhë të parë nga ndikimet negative që ushtrojnë këto çrregullime: ankthi, frika, stresi etj. Në këtë grup sëmundjesh hyjnë: astma, rritja e presionit të gjakut, gastriti etj.

SËNDISJ/E, - A. f. Shqetësim emocional i njeriut pa ndonjë shkak të rëndësishëm për një shqetësim të tillë. Njeriu përjeton mërzi dhe brengosje pa pasur shkak të posaçëm për përjetim të tillë të këtyre emocioneve dhe të reagimeve të lidhura me to. Sëndisja herë-herë përjetohet lehtë, por jo gjithmonë.

SFID/Ë, - A. f. Në psikologji nënkupton qëndrimin këmbëngulës të njeriut për të përballuar në çfarëdo forme pengesën që i bëhet nga ana e kundërshtarit, duke mos marrë shpesh

në konsideratë fuqinë, madhësinë e pengesës objektive, lëndore apo mendore që i bëhet nga ana e kundërshtarit.

SFILITJ/E, - A. f. Rraskapitje trupore dhe psikike nga puna e rëndë, monotone dhe e mundimshme, e shoqëruar zakonisht me pakënaqësi dhe me vuajtje shpirtërore. Sfilitja është gjendje e shkaktuar kryesisht nga pakësimi gjithnjë e më shumë i lëndëve ushqimore rezervë të organizmit. Por, ky nuk është shkak i vetëm i gjendjes sfilitëse. Psikologjia e punës është në gjurmë të shkaqeve të tjera.

SFOND, - I. m. Në psikologji emërton tablonë mbi të cilën është vendosur figura, piktura e një objekti të caktuar. Sfondi mund të jetë sipërfaqja mbi të cilën shtrihet trupi perceptues ose figura e tij. Raporti sfond-figurë, fushë e prapme-objekt etj. ka rëndësi të posaçme në procesin e perceptimit; nga ky raport varet qartësia e perceptimit të trupit, të dukurisë etj. Ky raport ruhet shumë në skenat e teatrove. Sa më madh të jetë kontrasti ndërmjet sfondit dhe objektit perceptues, aq më i qartë dhe i shkoqitur është perceptimi i asaj figure, portreti, trupi etj. Shih – ***PARIMET E PSIKOLOGJISËGESHTALTISTE.***

SIFILIZ, - I. m. Sëmundje ngjitëse veneriane e shkaktuar nga spiroketa e zbehtë, e njohur me termin latin *treponema pallidum*. Bartet me anën e zbrazëtirave të lëkurës, më shpesh me anë të membranës mukoze gjatë raporteve seksuale. Godet sidomos enët e gjakut, sistemin nervor dhe zemrën. Për shkak të ndikimit që ushtron në strukturën dhe në funksionin e sistemit nervor shfaqen edhe çrregullime të rënda psikike, sidomos kur sifilizi zhvillohet në fazën metafazore.

SIGM/Ë, - A. f. Shkronjë e alfabetit grek që në psikometri shënohet me E**.** Kjo shenjë emërton shumën e përgjithshme të të gjitha vlerave numerike. Pra, kjo shumë shënohet sigma, por nuk lexohet sigma, lexohet vetëm shuma. Leximi sigma është rezervuar për të emërtuar shmangien nga vlera standard (shmangien kuadratike ose standarde).

SIGURI, - A. f. Gjendje psikike e të qenit pa mëdyshje të një individi, e besimit dhe e bindjes në vërtetësinë e një gjykimi, rezultati etj., në zgjidhjen e drejtë të një çështjeje, në realizimin e interesave, të synimeve etj., duke qenë ai i vetëdijshëm se për këtë nuk i kërcënohet ndonjë rrezik.

SIGURIA E TESTIT. Cilësi metrike e testit që ka të bëjë me konsekuencën e matjes së një ndryshoreje, kur matjet e asaj ndryshoreje me anë të një testi, te të njëjtët subjekte dhe në kushte të njëjta ose të ngjashme jep rezultate identike ose shumë të ngjashme. Ky kuptim i termit togfjalësh siguri e testeve ka të bëjë me të gjitha instrumentet matëse në psikologji. Në psikometri cilësia e sigurisë së një instrumenti emërtohet shpesh me termin *reliabilitet*.

SIGURIA EMOCIONALE. Gjendje e qëndrueshmërisë emocionale të njeriut që shfaqet kur ai vlerëson se nuk i kanoset rrezik për përjetimin e ndjenjave, për plotësimin e dëshirave, të motiveve, të nevojave etj. Siguria emocionale shfaqet edhe atëherë kur njeriu ballafaqohet me pengesa serioze,

sepse ky di t`i kontrollojë emocionet e veta dhe shkallën e manifestimit të tyre.

SIKLET, - I. m. I ardhur nga arabishtja *thiklet* "mundim" i ndërlikuar shpirtëror dhe fizik. Në psikologjinë popullore fjala siklet në shqip ka përdorim të shpeshtë.

SIMBIOZ/Ë, - A. f. Term i biologjisë që përdoret edhe në psikologji, i ardhur nga greqishtja *συμβίωση* "të jetuarit bashkë". Në psikologji emërton bashkëveprimin e ngushtë ndërmjet subjektit dhe objektit, ku subjekti shpesh është i varur nga objekti. Në psikologjinë zhvillimore emërton lidhjen e ngushtë ndërmjet të porsalindurit dhe nënës. Kjo lidhje konsiderohet lidhje me rëndësi të jashtëzakonshme për zhvillimin emocional të fëmijës dhe reflektohet pozitivisht edhe në sjelljet e nënës. Por, kjo lidhje mund të bëhet e dëmshme nëse nuk ndryshohet dhe nuk dobësohet me rritjen dhe me pjekurinë e fëmijës.

SIMBOL, - I. m. Çfarëdo shenje (gjest, fjalë etj.) që përfaqëson, shënjon ose tregon diçka tjetër; i ardhur nga greqishtja *σύμβολο*. Simboli emërton veçoritë kryesore, thelbësore dhe të përgjithshme të një objekti ose të një grupi objektesh; ai emërton një koncept dhe është rezultat i marrëveshjes ndërmjet atyre që e flasin një gjuhë, që merren me një disiplinë shkencore apo artistike. Simbolet përçojnë gjithë kulturën e secilit mjedis.

SIMBOLI NË PSIKANALIZË. Mjete të përhershme dhe të përgjithshme, të vetëdijshme, me të cilat shfaqen dëshirat, idetë, mendimet, përfytyrimet, ndjenjat e pavetëdijshme. Sipas themeluesit të psikanalizës simbolet janë: "Raport i përhershëm ndërmjet elementeve të ëndrrës dhe përkthimit të tyre. Këtë përkthim e quajmë simbolik, kurse vetë elementin e ëndrrës e quajmë simbol të mendimit të pavetëdijshëm të ëndrrës". Karl G. Jung (Carl G. Jung, 1875 – 1998) konsideron se simboli për njeriun është zëvendësim i asaj që është abstrakte. Kështu përfytyrimi i pëllumbit, i fluturës etj. është simbol i shenjtorit, i idesë së arketipit, i shpirtit etj.

SIMBOLIKA E ËNDRRAVE. Përmbajtja thelbësore e ëndrrave përcaktohet me simbole të veçanta, që zëvendësojnë objektin, dëshirën, shtrëngimin e një individi të caktuar. Psikanaliza ka bërë disa përgjithësime të kuptimit të këtyre simboleve ëndërrore. Sipas psikanalizës simbolet e ëndrrave janë të lidhura më së tepërmi me dëshira të ndaluara seksuale. Ndër përgjithësimet e tilla janë edhe këto: objektet e gjatë (lapsi, shpata, pushka etj.) që simbolizojnë në ëndërr organin seksual mashkullor, kurse objektet e shtrirë në gjerësi, (kutia e shkrepëses, tuneli, tavolina etj. janë simbole ëndërrore që zëvendësojnë organin seksual femëror. Përgjithësimi i tillë i simboleve mbështetet në disa elemente të përbashkëta të tyre, si edhe në mekanizmin e ngjeshjes dhe të reduktimit të simboleve. Këto elemente mund të jenë të karakterit fizik, gjuhësor, funksional etj. Por, njohja më e saktë e kuptimit të këtyre simboleve duhet kërkuar në jetën dhe veprimtarinë mbisunduese të individit.

SIMBOLIZ/ËM, - MI. m. Term që haset më tepër në art, ku emërton shprehjen e emocioneve me anë

të simboleve, e pikërisht me anë të figurave, notave e toneve muzikore, si edhe me anë të vallëzimit. Ka shprehje metaforike që me simbolizëm tregojnë mprehtësinë e mendimit, saktësinë e lëvizjeve etj. E tillë është metafora "Mendja e tij është si thika e mprehtë", "Duart e tij janë si makina"etj.

SIMETRI, - A. f. Term i përgjithshëm i ardhur në shqip nga greqishtja *συμμετρία*. Emërton përbërjen e komponentëve të një tërësie, në përputhje të plotë harmonike në mes tyre, nga pikëpamja e madhësisë, e formës brenda një rrafshi. Simetria në psikologji është prirje e grupimit të komponentëve ngacmuese që japin një tërësi harmonike e jo tërësi joharmonike në perceptimin e saj. Shih – ***PARIMET E PSIKOLOGJISË GESHTALTISTE.***

SIMON Teodor (Theodoré SIMON). Mjek psikiatër francez. Lindi më 1872 dhe vdiq më 1961. U doktorua në psikologji me mbrojtjen e tezës "Mbi ndërlidhjen e zhvillimit fizik me kapacitetet intelektuale". Në psikologji emri i tij lakohet sa herë që përmendet testi i shkallës së inteligjencës Bine–Simon. Për përcaktimin e kësaj shkalle ka merita edhe bashkëpunëtori i Alfred Bines – Teodor Simon, i cili ofroi të dhënat për sjelljet e fëmijëve jonormalë, që i identifikoi dhe mblodhi nga veprimtaria e tij në spitalin e së Shenjtës Mari në Paris. Ai vijoi veprimtarinë psikologjike të matjes së zhvillimit të inteligjencës së fëmijëve dhe për këtë qëllim edhe bëri standardizimin e testeve, por nuk la pas ndonjë vepër psikologjike të njohur.

SIMPATI, - A. f. Fjalë e ngulitur në shqip dhe term i psikologjisë i ardhur nga greqishtja *syn* "me" dhe *pathos* "dhembje". Simpatia është ndjenjë pëlqimi dhe mirëdashjeje e orientuar ndaj një ose disa individëve. Shfaqet në prirjen e njeriut për të përjetuar ndjenjat e njëjta (frikën, gëzimin, pikëllimin etj.) me tjetrin ose me të tjerët. Kjo ndjenjë shpesh është e dyanshme dhe për këtë dy individët nxiten nga simpatia për të pasur kontakte dhe marrëdhënie të shpeshta. Simpatia ndaj tjetrit mbështetet në qëndrime, tipare personale dhe në vlera shoqërore të ngjashme, madje edhe në karakterin komplementar të nevojave të tyre. Shkalla e zhvillimit të simpatisë është e lidhur me ngjashmërinë e temperamentit, të karakterit, të motiveve etj. të dy ose më shumë individëve.

SIMPTOM/Ë, - A. f. Term i mjekësisë, i psikologjisë dhe i psikoterapisë i ardhur nga greqishtja *συμπάθεια* "shenjë". Simptoma është ndryshim karakteristik i zhvillimit organik, fiziologjik dhe psikik që paralajmëron zhvillimin patologjik të një funksioni apo procesi. Një ndryshim i tillë është shenjë e një çrregullimi në zhvillimin e proceseve psikike dhe në sjelljet e njeriut, që manifestohet me lodhje të shpejtë, me dobësim dhe me humbje gjithnjë e më të madhe të energjisë psikike për zotërimin e asaj shenje.

SIMPTOMA NEGATIVE. Rënie e funksioneve të proceseve psikike dhe çrregullim i sjelljeve që hasen më tepër në sëmundjen e skizofrenisë. Ndër simptomat e tilla të skizofrenisë dallohen: mungesë dëshire për të jetuar, mungesë e ndjenjës së kënaqësisë, tërheqje nga marrëdhëniet shoqërore me të folur të pakuptueshëm dhe me mendime irracionale, sikurse edhe

me halucinacione dëgjimore etj. Këto simptoma janë shenja të shkallës së parë të skizofrenisë, të cilat janë përpunuar hollësisht në psikiatri dhe në psikopatologji.

SIMPTOMA NË BIHEJVIORIZËM. Simptomë që emërton vet sëmundjen dhe jo shenjën e sëmundjes, përkatësisht shenjën e gjendjes patologjike psikike. Për bihejvioristët simptoma është sjellje e mësuar gabimisht dhe ndryshimi i kësaj sjelljeje çon në eliminim të sjelljeve të këqija, përkatësisht në eliminim të simptomave ose të një sëmundjeje të caktuar psikike.

SIMPTOMA NË PSIKANALIZË. Formë e sjelljes që rezulton nga konflikti ndërmjet mbrojtjes së egos dhe zmbrapsjes së energjisë së shtytësve të pavetëdijshëm. Ky do të ishte kuptimi i termit simptomë sipas Zigmund Frojdit, themeluesit të psikanalizës. Për Karl Jungun simptoma mund të jetë shenjë e dobishme për zhvillimin psikik, sepse paralajmëron që egoja e njeriut ka arritur në një shkallë kur nuk është në gjendje të vendosë se çfarë të bëjë dhe kjo tregon se në jetën psikike të atij njeriu duhet ndryshuar diçka.

SIMULATOR, - I. m. Instrument teknik i formuar me qëllim të ushtruarit e kandidatëve në kryerjen me sukses të një profesioni të ndërlikuar dhe të rrezikshëm, si: drejtimi e aeroplanit, i automobilit, i anijes, i nëndetëses etj. Simulatori është imitues i funksionimit real të aparateve të shtrenjta. Zotërimi i programit të aftësimit të pilotëve bëhet me anë të simulatorëve dhe procesi i zotërimit të profesioneve të përmendura me anë të simulatorëve mbështetet në parimet e transferimit pozitiv të të mësuarit.

SIMULIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *simulation* "të shtirur". Të shtirurit e një individi me qëllim mashtrimi. Gënjeshtër e qëllimshme që bëhet për ta vënë individin tjetër në një situatë që t`u besojë sjelljeve me të cilat ai synon të shfaqë gjendjen e tij, ndryshe nga ajo që është e vërtetë, imitim i sjelljeve të të sëmurit; fsheh çrregullimet psikike të caktuara, shfaq mungesën e gatishmërisë për të kryer detyrën, mosangazhimin e mjaftueshëm për të mësuar si duhet dhe sa nevojitet përmbajtjet e një lënde mësimore etj. Gënjeshtra e tillë bëhet me qëllim përfitimi të ndonjë privilegji, të largimit nga pasojat negative etj.

SIMULTAN, - E. mb. Që është i (e) njëkohshëm. Ky term haset më tepër në psikologjinë fiziologjike. Shih – ***KONTRASTI SIMULTAN.***

SINAPS/Ë, - A. f. Term i anatomisë së sistemit nervor i ardhur nga greqishtja *synapsis* "lidhje, pikë takimi e kontakti ndërmjet aksonës së një neuroni me një pjesë të trupit të neuronit tjetër, pikërisht me cipën e dendriteve të neuroneve të tjerë. Në sinaps zhvillohet bartja e impulseve nervore nga një qelizë nervore në tjetrën dhe më tepër bartja e tyre bëhet me anën e ndërmjetësuesve, përkatësisht të neurotransmetuesve. Dallohen disa lloj sinapsesh. Sipas transmetuesve u identifikuan këto sinapsa kryesore: sinapsa adrenenergjike e rolit të noradrenalinës, sinapsa dopaminenergjike e rolit të dopaminës etj. Qeliza nervore dhe sinapsa paraqitet në figurën e mëposhtme:



SINAPSA FRENUESE. Sinapsa ndërmjet dy neuroneve ose qelizave nervore, ku fuqia apo potenciali i qetësisë së cipës pas-sinaptike bëhet negative, për shkak të aktivizimit të pjesës parasimpatike.

SINAPSA NXITËSE. Lidhja specifike ndërmjet dy qelizave nervore apo neuroneve, kur fuqia reaguese e cipës pas-sinaptike bëhet me energji pozitive, që rrjedh nga aktiviteti i pjesës parasinaptike.

SINDROM/Ë, - A. f. Term i mjekësisë dhe i psikologjisë klinike i ardhur nga greqishtja *syndrome* "ndërveprim, merr pjesë në proces zhvillimi". Sindroma është bashkim simptomash e tiparesh të çrregullimeve karakteristike dhe paraqitje e përbashkët e tyre në kuadrin e një tërësie sjelljesh. Ky bashkim konsiderohet se është tërësi të dhënash pikëmbështetëse për ndonjë dyshim, përkatësisht për ndonjë sëmundje, për një gjendje psikike të çrregulluar, që kërkon trajtim të caktuar.

SINDROMA ALKOOLIKE E FETUSIT. Grup shenjash karakteristike çrregulluese të aktivitetit të fëmijëve, të shkaktuar nga nëna, e cila ka pirë, ka marrë alkool gjatë shtatzënisë. Sindroma alkoolike e njohur me shkurtesën FAS ka këto shfaqje organike dhe psikike: deformim të fytyrës, çrregullim të funksionimit të zemrës (kufizim i funksionimit të zemrës, aritmi, përshpejtim të të rrahurit të herë-pashershëm të zemrës etj.), zhvillim të kufizuar të proceseve kognitive dhe të aftësive njohëse etj.

SINDROMA BALINT. Çrregullim neurologjik që shfaqet me çrregullim të perceptimit. Strukturën e sindromës Balint e shkaktojnë këto çrregullime: pamundësia e emërtimit të objekteve të shfaqura, pamundësia e rinjohjes së formave të objekteve dhe pamundësia e njohjes së kuptimit të përgjithshëm të një skene të përbashkët objektesh, pavarësisht nga aftësia e padëmtuar e njohjes së secilit objekt përbërës të asaj skene. Këtë e ka përshkruar neurologu hungarez Rudolf Balint (Rudolph Balint, 1874 – 1934).

SINDROMA "ÇERDHJA E ZBRAZËT". Gjendje emocionale depresive e shoqëruar me humbjen e kuptimit për jetën e mëtejme, kur anëtari më i ri i familjes, sidomos fëmija, përcillet në jetën e mëtejshme dhe prindi mbetet i vetmuar.

SINDROMA DAKOSTA. Shih – ***ÇRREGULLIMI PASTRAUMATIK.***

SINDROMA DAUN. Tërësi simptomash fizike dhe psikike që u përshkruan hollësisht nga mjeku britanik Xhon L. Daun në vitin 1866. Sindroma Daun është çrregullim mendor me simptoma parësore të vonesës mendore të individit dhe me këto çrregullime fizike kryesore: ashti i kokës i sheshtë, gishtërinj të hapur, lëkurë me puçrra të mëdha etj. Është çrregullim i rrallë dhe, sipas disa të dhënave statistikore, ky çrregullim paraqitet në raportin 1 : 700, që do të thotë se në 700 të porsalindur njëri shfaq Sindromën Daun. Pohohet se faktor kritik i shfaqjes së kësaj sindrome është mosha e rritur e mëmës.

SINDROMA DE KLERAMBO. Psikozë pasionante, por e emërtuar sipas zbuluesit të kësaj psikoze. Sindroma De Klerambo është dukuri psikike e rrallë që shfaqet në ato raste kur një individ e adhuron jashtëzakonisht tjetrin që është bartës i një qëndrimi apo pikëpamjeje të caktuar. Shkaku i këtij adhurimi dhe admirimi është përmbajtja dhe rëndësia që i jep individi tjetër bartësit herë-herë edhe të panjohur për të. Sindroma De Klerambo i përket dukurive të deluzioneve**.**

SINDROMA E DORËS SË HUAJ. Çrregullim neuromuskular gjatë të cilit njeriu me dorë funksionale të rregullt përjeton dukurinë e aktivitetit të dorës së tij sipas një urdhri të huaj për të, thuajse ajo është dorë e huaj e jo e tij. Është pasojë e dëmtimit të pjesëve të mesme të pjesës së përparme të trurit të njeriut.

SINDROMA E KAMPEVE TË PËRQENDRIMIT. Formë e çrregullimit stresant që ka të bëjë me ndjenjën e fuqishme të fajit me shkak të pacaktuar. Të tillë ishin kampi shqiptar i Dubravës i vitit 1989 – 1999, i Spaçit, i Goli Otokut etj. i gjysmës së dytë të shekullit të njëzet në Shqipëri dhe në Jugosllavi.

SINDROMA E KORSAKUT. Sindromë që i përket psikozave organike. Rezulton nga mungesa e vitaminës B1, infeksioni, tepria e marrjes së alkoolit, helmimi etj. Godet keq bazën neurofiziologjike të kujtesës afatshkurtër dhe afatgjatë. Shih – ***SINDROMA KORSAKOV.***

SINDROMA E PËRDHUNIMIT SEKSUAL. Ndjenjë e ndërlikuar e zymtë e viktimizimit të grave të përdhunuara seksualisht nga agresorët gjatë zhvillimit të operacioneve të luftës në Kosovën e viteve 1989 – 1999. Këto kanë përjetim se janë: "femra të vdekura në mesin e të gjallëve". Të përdhunuarat jetojnë me ngarkesa emocionale, me shpresa shumë të kufizuara për jetën, me ndjenjën e përhershme të hidhërimit, zemërimit, pikëllimit, me mbyllje në vetmi dhe me humbje të interesit për ta jetuar jetën në mënyrë cilësore. Në mjediset shqiptare të kultit të nderit përdhunimi vlerësohet akti më i ndyrë me pasoja shumë të rënda fizike, shoqërore, psikike dhe morale. Në mjediset e tilla jeta e femrës me nder të njollosur është jetë e pavlerë. Në Luftën e Kosovës të viteve 1989 – 1999 ka pasur raste të vetëflijimit të të rejave pas përdhunimit seksual nga ana e ushtarëve, e policëve dhe e paramilitarëve serbë, të arratisjes nga vendbanimi dhe të emigrimit, raste të ndërprerjes së marrëdhënieve bashkëshortore, raste të heshtjes ndaj përdhunimit dhe fare pak raste të denoncimit të përdhunimit. Këto janë rezultatet e gjurmimit të kësaj dukurie, nga autori i këtij leksikoni, psikologu Pajazit Nushi, lindur më 1933**.**

SINDROMA E PËRSHTATJES SË PËRGJITHSHME. Sindroma e njohur e përshtatjes së organizmit dhe e reagimeve të individit gjatë përjetimit të gjendjes stresante nga ana e tij. Tri faza të përbashkëta që karakterizojnë këtë simptomë janë: reagimi alarmues, qëndrueshmëria dhe rraskapitja e organizmit. Shih – ***STRESI.*** Këtë sindromë e ka gjurmuar endokrinologu kanadez me prejardhje austriake Hans Seli (Hans Seye, 1907 – 1982).

SINDROMA GAS. Sindromë e përgjithshme përshtatëse që emërton gjendjen e përgjithshme biologjike të përshtatjes së organizmit në stres dhe në situatë stresi. I ardhur nga anglishtja në psikologjinë shëndetësore dhe atë klinike, që formohet nga bashkimi i shkronjave të para të fjalëve: G(eneral) – i përgjithshëm, A(daptation) – përshtatës, S(yndrome) – sindromë. Kjo sindromë e përgjithshme e organizmit të njeriut ka të bëjë me përshtatjen trupore, fiziologjike dhe psikike të gjendjes së stresit, shih – ***STRESI.*** Ka tri faza: 1) Fazën alarmuese me nënfazat përkatëse; 2) Fazën e shokut dhe 3) Fazën e kundërt të shokut. Gjatë fazës alarmuese individi merr informacion për stresin dhe njëkohësisht orvatet t`i mobilizojë të gjitha energjitë fizike e psikike për t`ia kundërvënë ndikimit të stresit në organizmin e tij. Në fazën e shokut (që ndahet me vështirësi nga faza e alarmit) organizmi i kundërvihet stresit dhe me këtë rast bie temperatura e organizmit, shfaqen ndryshime në presionin e gjakut, lëngu qelizor fillon të humbasë, dobësohet tonusi i muskujve etj. Faza e tretë është faza më e rrezikshme, sepse nga stresi i fuqishëm organizmi i njeriut mbërrin në gjendje pamundësie për të qëndruar nga shpenzimi i energjisë fiziologjike e psikologjike. Nëse në këtë fazë organizmi detyrohet të reagojë me shok, atëherë njeriu i afrohet vdekjes. Ky përshkrim i atribuohet fizikanit dhe endokrinologut kanadez të lindur në Austri Hans Seli (Hans Selye, 1907 – 1982).

SINDROMA HERLER. Sindromë e rëndë e zhvillimit të kufizuar psikik të njeriut, që shoqërohet me disa ndryshime fizike, sidomos të dukshme në fytyrën e atij që vuan nga kjo sindromë (hunda e gjerë në formë gati të rrafshuar me fytyrën, sy të gjerë, veshë të zhvilluar nga fundi i kokës). Boshti kurrizor i të sëmurit me sindromën Herler është i kërrusur. Proceset psikike dhe sjelljet e tij kanë shkallë të ulët zhvillimi. Sindroma Herler ka bazë trashëgimie.

SINDROMA KLAJN – LEVIN. Tërësi simptomash që karakterizojnë çrregullimin e gjumit (përgjumje e papërballueshme) dhe proceset e vullnetit të çrregulluar. Për sindromën Klajn – Levin kanë shkruar psikiatri gjerman Vili Klajn (Willi Klleine, 1920) dhe neurologu i Shteteve të Bashkuara të Amerikës me origjinë ruse Maks Levin (Max Levin, 1901).

SINDROMA KLIVER – BJUS. Sindromë e ndërlikuar, ku dallohen struktura të agnozisë pamore, të ndryshimeve të thella në jetën emocionale dhe në aktivitetin seksual të nivelit të lartë me ndërlidhjet ndërmjet këtyre strukturave. Sindroma është e lidhur me disa çrregullime në funksionin e bërthamës amigdala dhe me një pjesë të cipës së trurit të madh. Termi i kësaj sindrome është i lidhur me zbuluesit e tij: me emrin e neurologut amerikan me prejardhje gjermane Hajnrih Klyver (Heinrich Kluver, 1898 – 1979) dhe me emrin e neurologut amerikan Pol K. Bjusi (Paul C. Bucy, 1904).

SINDROMA KORSAKOV. Sindromë që haset shpesh te alkoolistët kronikë. Manifestohet me humbje të kujtesës për atë çfarë i ka ndodhur kohët e fundit pacientit me sindromën Korsakov, kurse ngjarjet e së kaluarës së largët

i mban mend shumë mirë. Te ata që vuajnë nga kjo sindromë është konstatuar çrregullim i strukturave nervore të hipokampusit – bartëse e mbajtjes në mend të ngjarjeve. Sindroma Korsakov u zbulua nga mjeku rus Sergej Sergejeviç Korsakov (Sergej Sergeievich Korsakoff, 1854 – 1900).

SINDROMA KULTURORE. Tërësi e ndërlikuar e proceseve psikike, e sjelljeve dhe e gjendjeve psikopatologjike e psikiatrike të individëve të një lokacioni, që është karakteristike për kulturën e një mjedisi. Në studimet e sindromës kulturore përmenden disa forma: frika magjike, *koro* – frika e meshkujve të Azisë Juglindore se organi mashkullor i tyre do të tërhiqet në brendësi të barkut dhe do të shkaktojë vdekjen; sindroma *eskim piblokto* – pushtim i njeriut nga djajtë; *hiva itk* – zemra e plasur etj.

SINDROMA NDARËSE. Sindromë neurologjike që shfaqet me pengesa në bartjen e informacioneve nga një pjesë e trurit në pjesën tjetër të tij. Dallohet posaçërisht në funksionimin e "trupit të përflakur" (*corpus callosum*) të trurit në rastet e afazisë, të amnezisë dhe të apraksionit. Këto janë çrregullime të aftësisë së të folurit (afazi), të humbjes së pjesshme apo të plotë të kujtesës (amnezi) dhe të humbjes së pjesshme apo të plotë të aftësisë së kryerjes së lëvizjeve të një veprimi të vullnetshëm (apraksi). Çrregullimet e tilla shkaktohen nga pengesa komunikuese nervore ndërmjet rrugëve të qendrave nervore. Këtë sindromë e ka zbuluar neurologu amerikan Norman Geshvind (Norman Geschwind, 1926 – 1984).

SINDROMA ORGANIKE MENDORE. Emërtim përgjithësues për delirin, demencën dhe sindromën organike të sjelljeve të personalitetit. Secili prej këtyre emërtimeve shfaq simptomat e tij, por etiologjia e çrregullimeve të këtilla kërkon hulumtim, sepse nuk ka të bëjë me çrregullimin organik-mendor, për të cilin dihet shkaku i çrregullimit.

SINDROMA PREDER–VILI. Sindroma e prapambetjes mendore e trupore apo fizike të fëmijëve. Këtë e karakterizojnë këto veçori psikike e trupore apo fizike: prapambetja e zhvillimit mendor, që shtrihet nga shkalla e ulët deri në shkallën e lartë të prapambetjes mendore, trupi i shkurtër me trashësi mbimesatare me organe gjenitale gati të pazhvilluara dhe me apetit të shkallës së lartë. Kjo sindromë u identifikua nga dy mjekë fëmijësh, përkatësisht nga pediatrit zviceranë Andrea Preder (Andrea Preder, 1960) dhe Vili H. (Willi H., rreth vitit 1960).

SINDROMIA RET. Çrregullim i zhvillimit të organizmit pas moshës gjashtëmujore. Ky çrregullim ka këto karakteristika: zhvillimi i përgjithshëm i foshnjës është plotësisht normal deri në moshën gjashtëmuajshe; më pas humbin shkallë-shkallë lëvizjet e duarve drejtuar një objekti të caktuar, shfaqen forma të çrregullta të zhvillimit të formës së kokës dhe trupit, prapambetje e madhe e zhvillimit të të folurit. Kjo sindromë i atribuohet neurologut austriak Andreas Ret (Andreas Rett, 1960).

SINDROMA STENDAL. Tërësi e ndërlidhur simptomash që shfaqet me

gjendjen e njeriut të zhytur në përjetimin e thellë të bukurisë së krijimeve artistike. Gjendja e këtillë ka këto simptoma kryesore: ndjenjën e humbjes së aftësisë së orientimit hapësinor e kohor dhe, lidhur me këtë, humbjen e vetëdijes së tij. U emërtua sipas krijuesit të njohur Stendal, i cili e ka përshkruar për herë të parë këtë gjendje me rastin e vizitës së tij në një kishë në Firence (Itali), ku i lanë mbresa të thella ikonat me një bukuri të jashtëzakonshme. Përshkrimin e gjerë të tij e ka përfunduar me fjalët "Eci me frikë se do të rrëzohem".

S

SINDROMA TURET. Formë e çrregullimit neurologjik që shfaqet me lëvizje të pavullnetshme të muskujve, me vokalizim të papërshtatshëm të fjalëve dhe me aftësi të kufizuara të kontrollit të lëvizjeve dhe të të folurit të fjalëve. U përshkrua për herë të parë nga psikiatri francez Zhorzh Zhil de la Turet (Georges Gilles de la Tourette, 1857 – 1904).

SINDROMA TURNER. Çrregullim gjenetik që paraqitet te foshnjat femra dhe ka të bëjë vetëm me një X në vend të (dy ikseve) XX të çiftit nervor të 23-të. Ky çrregullim gjenetik hyn në grupin e çrregullimeve të ndryshimit të vendeve të kromozomeve, përkatësisht në grupin e translokacionit të kromozomeve. Ka pasoja psikike të rënda: çrregullim të proceseve intelektuale apo kognitive, paqëndrueshmëri të gjendjes emocionale dhe disa çrregullime të tipareve të personalitetit dhe të unitetit të tyre. U përshkrua për herë të parë nga ana e fizikanit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës Henri H. Turner (Henry H. Turner, 1892 – 1970).

SINDROMA VIL. Mungesë e një gjeni në kromozonin e shtatë dhe e acidit dezoksiribonukleik përreth kromozomit të shtatë. Ka pasoja fiziologjike dhe psikologjike. Ndër pasojat fiziologjike dallohet çrregullimi metabolik i kalciumit, dëmtimi i qarkullimit të gjakut dhe i funksionimit të zemrës etj. Ka edhe pasoja në zhvillimin psikik, që shfaqen në shkallën e ulët të zhvillimit kognitiv. Megjithëkëtë, fëmijët që vuajnë nga sindroma Vil kanë të zhvilluar aftësitë fjalësore ose verbale, janë të shoqërueshëm dhe shfaqin prirje miqësore me të tjerët.

SINERGJI, - A. f. Term i fiziologjisë, i psikologjisë fiziologjike dhe i psikologjisë së punës, i ardhur nga greqishtja *συνεργία*. Emërton bashkëveprimin e funksionimit të disa organeve të trupit, sidomos të muskujve, për një veprim të vullnetshëm. Në psikologjinë e punës ky term emërton ndryshimet e përbashkëta në sistemin e organeve të frymëmarrjes, të organeve kardiovaskulare, të tretjes së ushqimeve, të rregullimit termodinamik etj. gjatë punës në fushën e makinerisë, të ndërtimtarisë, gjatë veprimtarisë intelektuale etj.

SINESTEZI, - A. f. Term psikologjik i ardhur nga greqishtja *συναίσθηση* "bashkëndijim". Sinestezia është përjetim i ndijimit në dy fusha ndijimi, megjithëse ngacmuesi ushtron ndikim vetëm në një shqisë. Një ndijim i tillë është përjetimi i ngrohtësisë, kur në syrin e njeriut vepron ngacmuesi me ngjyrë të kuqe. Në shqip kemi shprehje me kuptim të ngjashëm me sinestezi, të tilla si: "Përqafim i ftohtë", "E vërtetë e hidhur", "Ton i thellë" etj. Disa të rinj tingujt e një kompozicioni

i përjetojnë në ngjyra të ndryshme. Dukuria e këtillë është e vetvetishme. Besohet se është rezultat i përkimit funksional të qendrave ndijimore.

SINKINEZ/Ë, - A. f. Term i përdorur rrallë në psikologji dhe i ardhur nga greqishtja *συγκίνηση*. Emërton dukurinë e shfaqjes së lëvizjes automatike të një apo disa organeve të trupit, bashkë me lëvizjet e aktit të vullnetshëm të një organi tjetër. E këtillë është lëvizja e pavullnetshme e muskujve të dorës së shëndoshë; kur njeriu orvatet ta vërë në lëvizje muskulin e paralizuar të dorës tjetër. Shkaktohet kryesisht nga lëndimi i rrugëve nervore piramidale.

SINKOP, - I. m. Term i patologjisë që emërton aktivitetin e dobët të zemrës së njeriut, që shpie në humbje të kontrollit të vetëdijes mbi sjelljet dhe përgjithësisht mbi reagimet e njeriut. Shkaktohet shpesh nga përjetimi i frikës dhe i shpeshtësisë së shfaqjes së saj.

SINKRETIZ/ËM, - MI. m. Term gjuhësor, psikologjik e sociologjik i ardhur nga greqishtja *συγκρητισμός* "bashkim". Sinkretizmi është dukuri e bashkimit të elementeve të ndryshëm në një tërësi kuptimore, e cila i përngjet tërësisë, por lidhja e elementeve përbërës është jokoherente, madje mund të ketë përbrenda kësaj lidhjeje edhe elemente të kundërta. Në fillim ka emërtuar tërësi këngësh, magjish e vallesh të bashkësive primitive, kur elementet e tyre nuk ndaheshin nga pjesëtarët e kolektiveve që merrnin pjesë në atë manifestim.

SINONIME PSIKOLOGJIKE. Terma të gjuhësisë që kanë kuptim psikologjik; termi sinonim ka ardhur nga greqishtja *συνώνυμος* "me të njëjtin emër". Këto janë fjalë apo terma që shprehin të njëjtin kuptim, përkatësisht terma që emërtojnë të njëjtin koncept, por ndryshojnë njëri nga tjetri nga përbërja tingullore dhe nga mënyra e të shkruarit të tyre. Të tillë janë: *shqisë* "ndijë", *emocion* "ndjenjë", *mësoj* "nxë", *orvatje* "përpjekje", *eksperiencë* "përvojë" etj.

SINTEZ/Ë, - A. f. Term i logjikës dhe i psikologjisë i ardhur nga greqishtja *σύνθεση* "lidhje". Sinteza është bashkim elementesh në një tërësi integrale. Tërësia e këtillë tregon se ka cilësi të përbashkëta, të cilat nuk do t`i kishin domosdoshmërisht pjesët apo elementet nga të cilët është krijuar ajo tërësi. Si ecuri mendore dhe praktike sinteza vjen pas ndarjes, pas analizës së pjesëve përbërëse të saj. Kjo tregon mënyrën e lartë të të menduarit të njeriut, nga i cili rezulton njohje më e gjerë dhe më e thellë e realitetit dhe e dukurive të tij**.**

SINTEZA KREATIVE. Tërësi e formuar me sintezë psikike (operacion i mendimit), e cila është rezultat i ri, që e tejkalon shumën e elementeve, nga të cilët është formuar kjo tërësi. Cilësitë e kësaj tërësie janë thellësisht të tjera nga komponentët përbërës, kur këta vëzhgohen të pavarur njëri nga tjetri. Termi i përket psikologjisë së psikologut gjerman Vilhelm M. Vunt (Wilhelm M. Wundt, 1832 – 1920**).**

SINTONI, - A. f. Term që sot i përket më tepër psikologjisë ambientale, i ardhur nga greqishtja *σύντονος* "i harmonizuar". Termi sintoni u përdor në fillim nga psikiatri zviceran Eugen Blojer (Eugen Bleuer, 1857 – 1939) në

përcaktimin e tipit të personalitetit te i cili mbisundon harmonia mendore me mjedisin e saj, si edhe me ndryshimet e këtij mjedisi. Harmonia e këtillë shfaqet kryesisht në reagimet emocionale dhe në përjetimin e brendshëm të tyre nga ana e njeriut. Sot, ka psikiatër që besojnë se harmonia e këtillë mund të jetë simptomë e prirjes së çrregulluar dyskajore ose bipolare të manisë depresive. Në psikopatologji dhe në psikiatri po përdoret gjithnjë e më pak.

SINJAL, - I. m. Term i teorisë së informacioneve dhe i kibernetikës i ardhur nga latinishtja *signum* "shenjë". Në psikologji emërton shenjën e një objekti (shputa e këmbës në zall ose rërë është shenjë se aty ka kaluar një njeri, emërton edhe shenjën paralajmëruese të një ngjarjeje që do të zhvillohet (tymi i një oxhaku është shenjë e zjarrit që do të ndizet nga brenda oxhakut), karrigia e mbuluar me peshqir e vendosur para derës së shtëpisë të një Shqiptari është shenjë se aty pranojnë ngushëllime për vdekjen e një të afërmi të tyre etj. Në rastet e tilla shenja është përfaqësuese e një objekti, dukurie etj. Ndërmjet shenjës dhe objektit që përfaqësohet nga shenja e caktuar ekziston një lidhje e ngushtë. Shih – ***SHENJA.***

SINJALET E RENDIT TË DYTË. Term i fiziologut rus Ivan P. Pavllov (Ivan P. Pavlov, 1849 – 1936). Fjalë të dëgjuara ose të shkruara në shqip nga ata që komunikojnë në gjuhën shqipe. Këto janë sinjale të rendit të lartë, që në thelb ndryshojnë nga sinjalet e rendit natyror, që i përkasin rendit të parë. Sinjalet e rendit të dytë i përkasin vetëm sistemit sinjalizues njerëzor, që mundëson zhvillimin e mendimit konceptual dhe komunikimin fjalësor ndërmjet njerëzve.

SINJALET E RENDIT TË PARË. Sinjale konkrete të mjedisit të jashtëm (aroma, drita, prekja e lëkurës, rryma elektrike, shija, temperatura etj.) Fiziologu rus Ivan P. Pavllov i ka shfrytëzuar këta ngacmues në procesin e formimit të reflekseve të kushtëzuara. Njerëzit dhe kafshët e njohin botën e jashtme me anë të informacioneve të marra nga sinjalet e rendit të parë. Këto sinjale janë përbërës të sistemit sinjalizues të ngacmuesve të kushtëzuar. Këto sinjale së bashku me ata të rendit të dytë formojnë sistemin sinjalizues.

SISTEMATIK/Ë, - A. f. Renditje faktesh, konceptesh, të dhënash etj. sipas një parimi, duke zbatuar saktësisht parimin ndarës të tyre. Mbështetet në klasifikimin e fakteve, të koncepteve, të të dhënave etj., duke krijuar në këtë mënyrë rend, pasqyrë dhe rregullsi në gjurmimin e tyre. E tillë është sistematika e ndijimeve, sistematike e motiveve, sistematika e teorive psikologjike të personalitetit etj.

SISTEM, - I. m. Term i familjarizuar në të folurit e përgjithshëm në gjuhën shqipe, i ardhur nga greqishtja *σύστημα* "përbërje, tërësi, renditje". Ka zënë vend në terminologjinë e disa disiplinave si në grupin e shkencave natyrore, ashtu edhe në atë të shkencave shoqërore, si: në astronomi, filozofi, gjuhësi, kulturologji, në sociologji etj. Në psikologji termi sistem emërton konceptin abstrakt të një tërësie përbërëse koherente, ku vendndodhja e secilit përbërës përcaktohet në kuadrin

e funksionit të tërësisë dhe ndaj funksionit të përbërësve të tjerë të kësaj tërësie. Sisteme të tilla janë: sistemi kognitiv, motivues, nervor, sistemi i vlerave etj.

SISTEMI BINAR. I ardhur nga latinishtja *bini* "dy, çift". Sistem klasifikues i koncepteve që njeh vetëm dy vlera sasiore: 1 dhe 0. Me një sistem të tillë emërtohen edhe vendndodhjet semantike dydrejtimëshe. Vendndodhje të tilla janë: Djathtas – majtas, femërore – mashkullore, lart – poshtë etj. Pozicionet e këtilla të vlerave karakterizojnë përgjithësisht mentalitetin e fazës fillestare të zhvillimit të mendjes njerëzore. Këtë e ka zbuluar antropologu francez Klod Levi – Shtraus (Claude Levi – Strausse, 1908 – 2009). Ky nivel zhvillimi dallohet në besëtytni, në legjenda, në mite etj.

SISTEMI GEZEL I ZHVILLIMIT TË FOSHNJËS. Sistem apo rend i zhvillimit psikik të fëmijëve në fushën motorike, përshtatëse, gjuhësore dhe të sjelljeve personale e shoqërore. Këtë sistem të zhvillimit të fëmijëve deri në moshën parashkollore e zhvilloi pediatri dhe psikologu amerikan Arnold L. Gezel (Arnold, L. Gesell, 1880 – 1961), së bashku me bashkëpunëtorët. Ky rend i zhvillimit të fëmijëve është rendi i parë i normuar në bazë të vëzhgimit sistematik të fëmijëve pa tërhequr vëmendjen e tyre. Sipas Arnold Gezelit rendi i zhvillimit të disa proceseve dhe sjelljeve të fëmijëve kishte karakter gjenetik të përgjithshëm. Shih ***– TESTI GEZEL.***

SISTEMI I ANALIZËS SË PUNËS. Term i psikologjisë së punës që emërton metodat sistemore, me anën e të cilave identifikohen aftësitë dhe shkalla e zhvillimit të tyre, njohuritë dhe shkathtësitë e shprehitë e nevojshme për një vend pune. Identifikimi i tyre përbëhet nga një seri testesh të hartuara pikërisht për vende pune profesionale, sidomos për ato të nivelit zhvillimor të lartë (industria e armëve nukleare, pilotët e aeroplanit, sistemi sinjalizues elektrik etj.).

SISTEMI I DISIPLINAVE TË PSIKOLOGJISË. Tërësi e ndërlidhur dhe unike e degëve të psikologjisë. Duke pasur në mend strukturën e këtyre degëve, sistemit të disiplinave të psikologjisë u bëhet ndarje sipas parimeve të ndryshme. Parimi më i shpeshtë i kësaj ndarjeje është klasifikimi i disiplinave të psikologjisë në dy grupe të ndërlidhura: 1) Grupi i disiplinave teorike dhe 2) Grupi i disiplinave zbatuese ose aplikative. Grupin e disiplinave teorike e përbëjnë këto degë të psikologjisë:

PSIKOLOGJIA E PËRGJITHSHME;
PSIKOLOGJIA FIZIOLOGJIKE;
PSIKOMETRIA;
PSIKOLOGJIA E PERSONALITETIT;
PSIKOLOGJIA ZHVILLIMORE – shih etj. Disiplinat e psikologjisë zbatuese janë:
PSIKOLOGJIA FORENZIKE;
PSIKOLOGJIA KLINIKE;
PSIKOLOGJIA PEDAGOGJIKE;
PSIKOLOGJIA E PUNËS;
PSIKOLOGJIA ORGANIZATIVE – shih etj.

SISTEMI I NGJYRAVE DIN. Sistem i klasifikimit të ngjyrave në optikë, sidomos në vendet e Europës. Klasifikimi i ngjyrave sipas sistemit Din është kryer në bazë të tri tipareve të tyre: cilësisë, ndriçimit dhe mbingopjes.

SISTEMI I NGJYRAVE MANSEL. Sistem i veçantë ngjyrash të përzgjedhura dhe të renditura sipas tri cilësive të tyre: sipas nuancave, ngopjes dhe ndriçimit. Mostrat shërbejnë për të krahasuar përjetimin psikologjik të ngjyrës sipas ngacmuesit fizik të ngjyrës. Këtë sistem e ka zbuluar piktori amerikan Albert H. Mansel (Albert H. Munsell, 1858 – 1918).

SISTEMI I VLERAVE. Strukturë pak a shumë e organizuar dhe koherente e vlerave të ndërlidhura të një mjedisi kulturor të caktuar, të cilat kanë karakter hierarkik. Mund të jetë sistem i pranuar dhe i rregulluar me pjesëmarrje të vetëdijshme të anëtarëve të atij mjedisi, ose sistem vlerash i një mjedisi të caktuar, ku anëtarët e tij veprojnë sipas disa vlerave, por nuk janë të vetëdijshëm plotësisht përse sjelljet organizohen dhe drejtohen sipas atyre vlerave. Sistemi i vlerave mund të jetë individual ose i përbashkët për mjedisin shoqëror. Në mjedisin shqiptar ka mbetur e njohur vlera e besës, e mikpritjes, e tolerancës fetare etj. Sistemi i vlerave ka karakter evolutiv.

SISTEMI KONCEPTUAL. Strukturë e ndërlidhur konceptuale që karakterizon në rend të parë teoritë shkencore. Në studimet e psikologut amerikan O. J. Harvi (O. J. Harvey, 1927) sistemi konceptual emërton strukturën e proceseve psikike, që janë bazë e bindjeve të njeriut. Këtë strukturë sistematike e përbëjnë katër nënsisteme: nënsistemi konkret, abstrakt, integral dhe nënsistemi i vetëbesimit, i motivacionit të brendshëm dhe i fleksibilitetit të pikëpamjeve.

SISTEMI NERVOR. Organizim i veçantë dhe i tërësishëm qelizash e neuroglish nervore (element përbërës i indeve nervore), që së bashku me sistemin e gjëndrave me sekrecion të brendshëm rregullojnë proceset, funksionet e brendshme të organeve të trupit, lidhin dhe koordinojnë aktivitetin e brendshëm të tyre, si edhe kryejnë ndërlidhjen e trupit të njeriut me botën e jashtme. Sistemi nervor është baza biologjike e proceseve psikike dhe e sjelljeve të gjithanshme të njeriut dhe qenieve të tjera të gjalla. Përbëhet nga Sistemi Nervor Qendror dhe Sistemi Nervor Periferik. Sistemi Nervor Qendror është i përbërë nga truri dhe nga palca e kurrizit. Shih – ***TRURI; PALCA KURRIZORE***. Pjesa periferike e sistemit nervor është e përbërë nga tubtha fijesh nervore, që lidhin Sistemin Nervor Qendror me shqisa, muskuj dhe me gjëndra. Këtë pjesë të Sistemit Nervor Qendror e përbëjnë edhe disa bashkësi qelizash nervore, që janë të vendosura jashtë Sistemit Nervor Qendror. Në sistemin nervor periferik dallojmë sistemin nervor trupor ose somatik dhe sistemin nervor autonom ose vegjetativ. Sistemi nervor trupor apo somatik është i lidhur me shqisa dhe me muskuj. Funksioni i tij ka të bëjë me marrjen e informacioneve nga jashtë dhe me reagimin ndaj tyre. Sistemi nervor autonom ose vegjetativ është rregullator i proceseve jetësore që zhvillohen brenda organizmit (të organeve të tretjes së ushqimit, të frymëmarrjes, të gjëndrave me sekrecion të brendshëm, të jashtëm etj.). Sistemi nervor autonom ose vegjetativ përbëhet nga pjesa simpatike dhe parasimpatike që kryejnë funksione të kundërta duke funksionuar si një e tërë. Shih – ***SISTEMI NERVOR VEGJETATIV***.

SISTEMI NERVOR AUTONOM. Pjesë përbërëse e sistemit nervor që rregullon, drejton dhe kontrollon aktivitetin e organeve të brendshme të organizmit, si: aktivitetin e zemrës, të organeve të frymëmarrjes, të tretjes së ushqimeve etj. Përbëhet nga sistemi nervor simpatik dhe parasimpatik. Sistemi nervor simpatik përbëhet nga nyjat nervore që shtrihen përgjatë palcës së kurrizit dhe nga disa qendra vegjetative të trurit dhe të palcës së kurrizit. Sistemi nervor parasimpatik përbëhet prej bërthamave të nervave të trurit të mesëm dhe të trurit të zgjatur. Është rregullues i aktivitetit të shpejtuar të zemrës, të rritjes së presionit të gjakut, i përshpejtimit të marrjes frymë, i funksioneve të organeve tretëse, i zgjerimit të bebes së syrit etj. Sistemi nervor parasimpatik kryen funksione të kundërta me ato të sistemit nervor simpatik. Funksioni i përbashkët i tyre është funksion antagonist: sistemi nervor simpatik rregullon procesin e harxhimit të energjisë së organeve trupore, ndërsa ai parasimpatik është rregullues i procesit të kundërt – i krijimit të energjisë së tyre. Sistemin nervor autonom e vënë në veprim qendrat nervore të palcës së kurrizit, të trungut nervor dhe të hipotalamusit. Sistemi nervor autonom luan rol të rëndësishëm në jetën psikike të njeriut, sidomos në zhvillimin e proceseve emocionale dhe motivuese. Emocionet me intensitet të lartë, afektet dhe streset shoqërohen me aktivitet të sistemit nervor simpatik. Sistemi nervor autonom emërtohet edhe me termin sistemi nervor vegjetativ.

SISTEMI NERVOR CEREBROSPINAL. Sistemi nervor i trupit, i njohur edhe me emërtimin sistemi nervor qendror. Përbëhet nga sistemi nervor qendror (shtylla a trungu i trurit dhe truri, nga palca e kurrizit, truri i vogël ose truthi, truri i ndërmjetëm dhe nga sistemi nervor periferik (nga nervat kafkorë dhe nervat kurrizorë e pjesët e tyre). Sistemi nervor cerebrospinal është rregullues i raporteve ndërmjet organizmit dhe mjedisit të jashtëm. Këtë funksion të rëndësishëm e kryen me anën e organeve shqisore dhe neuroneve qendërprurëse ose aferente, që i marrin të dhënat nga mjedisi i jashtëm dhe me anën e neuroneve qendërnxjerrëse apo eferente dhe të lidhjes së tyre me muskuj, të cilët bëjnë të mundur njohjen e ndryshimeve të jashtme dhe reagimin e organizmit ndaj këtyre ndryshimeve. Secila nga pjesët e përmendura kryen funksione të veçanta. Palca – merr informacione nga lëkura dhe muskujt dhe dërgon informacione përgjegjëse për aktet lëvizore. Në shtyllën e trurit janë të përqendruara bërthamat e shumicës së nervave të kafkës, kjo njëkohësisht merr informacione nga lëkura dhe muskujt e qafës e të kokës dhe kontrollon lëvizjet e tyre. Truri i vogël ose truthi kryen funksionin e modifikimit të lëvizjeve të trupit dhe pjesëve të tij dhe kontrollon lëvizjet e organizmit. Në trurin e ndërmjetëm gjenden talamusi, hipotalamusi, nëntalamusi dhe epitalamusi. Këto struktura përbëjnë një zonë kyçe, nëpër të cilat kalojnë informacionet e ndijimeve dhe ato të lëvizjeve, duke u lokalizuar në qendra të rëndësishme integruese. Sistemi nervor cerebrospinal përbëhet preh dy hemisferave ose gjysmërruzujve të veshur me cipën apo koren e trurit.

Ndahet në katër pjesë të njohura me termin lobe apo zona. Këto pjesë janë: lobi, përkatësisht zona ballore apo frontale, tëmthore ose temporale, paretale ose tepore dhe zona oksipitale ose zverkore. Këto zona kryejnë funksione të rëndësishme të jetës, aktivitetit psikik dhe integrimit të tyre.

SISTEMI NERVOR LIMBIK. Pjesë e sistemit nervor që përbëhet nga amigdala, bërthamat e përparme të talamusit, forniksi, girus cinguli dhe hipotalamusi. Të gjitha këto pjesë janë të lidhura ngushtësisht ndërmjet tyre, me masën ose formacionin retikular dhe me pjesët e përparme të cipës së trurit të madh. Kjo është ndërlidhje e ndërlikuar neuronesh dhe pjesësh të tyre. Ky sistem merr pjesë në rregullimin e funksioneve të ndërlikuara psikike, si: veprimet instinktive, është rregullator i përjetimeve emocionale dhe sjelljeve të njeriut. Sistemi nervor limbik, bashkërisht me masën apo formacionin retikular merr pjesë në rregullimin e gjendjes zgjuar dhe në atë të gjumit. Nga ky sistem dallohet roli i rëndësishëm i hipotalamusit në zhvillimin e proceseve të kujtesës**.**

SISTEMI NERVOR PERIFERIK. Pjesë e sistemit nervor që gjendet jashtë sistemit nervor cerebrospinal apo qendror. Përbëhet nga tuba fijezash nervore që lidhin sistemin e mesëm nervor me organet shqisore, me muskujt dhe me gjëndrat. Pjesa tjetër e sistemit nervor periferik formohet nga disa grupe të vogla qelizash nervore jashtë Sistemit Nervor Qendror. Përbrenda këtij sistemi gjendet Sistemi Nervor Autonom. Shih – ***SISTEMI NERVOR AUTONOM.***

SISTEMI NERVOR QENDROR. Pjesë e sistemit nervor i përbërë nga truri, palca kurrizore dhe rrugët nervore të trurit dhe ato të palcës kurrizore. Kryen funksionet e integrimit dhe të koordinimit të proceseve psikike dhe të sjelljeve: merr informacione nga mjedisi i jashtëm me anë të funksionimit të shqisave. Këto informacione, i ruan, i përpunon dhe i integron në proceset psikike të kujtesës, të mendimit, kontrollon sjelljet emocionale, sistemin motivues dhe rregullon sjelljet adaptuese të njeriut. Shih – ***SISTEMI NERVOR CEREBROSPINAL.***

SISTEMI NERVOR SOMATIK. Pjesë e sistemit periferik të trupit të organizmit, që është i formuar nga neuronet ndijore dhe lëvizore. Kryen funksionet e bartjes së impulseve nervore nga organet shqisore në qendrat e trurit dhe nga këto në muskuj, duke mundësuar në këtë mënyrë reagimin e njeriut ndaj ngacmuesve të shqisave, përkatësisht duke mundësuar lëvizjet e vullnetshme të muskulaturës dhe të skeletit të trupit. Kontrollon përgjithësisht muskujt skeletikë.

Burimet:

Neil R. Carlson: *"Physiology of Behavior"* – (*"Fiziologjia e sjelljes"*), Boston – London – Toronto – Tokyo – Singapore, 2001.

A.P. Luria: *"Osnovii Nejropsihologii"* – (*"Bazat e neuropsikologjisë"*), Moskva, 1973.

John Blendell: *"Physiological Psychology"* – (*"Psikologjia fiziologjike"*), Methuen, London, 1975.

Tony Buzan: *"Brain Child"* – (*"Truri i fëmijës"*), 2003.

Ethem Ruka: "*Fiziologjia e gjallesave shtazore"*, shblu, Tiranë, 1998.

SISTEMI NERVOR VEGJETATIV. Pjesë përbërëse e sistemit nervor.

Funksioni kryesor i këtij sistemi është zhvillimi dhe rregullimi i aktivitetit të organeve të brendshme të trupit. Shih – ***SISTEMI NERVOR AUTONOM.***

SISTEMI NJERI – MAKINA. Term i psikologjisë së punës që paraqet tërësinë e përbashkët të raportit ndërmjet aktivitetit të punës profesionale dhe makinës së drejtuar në prodhimin e një produkti të caktuar. I tillë mund të jetë raporti njeri (punëtor) operator - automobil, mekanik – motor, pilot - aeroplan etj. Ky raport është i ndryshëm në sistemin e punës manuale, gjysmë të automatizuar, të automatizuar dhe të mekanizuar. Në sistemin e punës së automatizuar njeriu është mbikëqyrës i procesit të veprimit profesional me makinë; në sistemin e mekanizuar makina është burim i energjisë, kurse njeriu këtë e drejton dhe e mbikëqyr, kurse në sistemin e punës së dorës ose sistemin manual njeriu i kryen të gjitha funksionet me mjetet e punës. Në sistemin njeri – makinë punëtori duhet ta njohë mirë makinën dhe funksionin e saj, kurse makina e punës duhet t`i përshtatet aftësive perceptuese, njohëse dhe motorike të punëtorit.

SISTEMI SHQISOR. Sistem i ndërlikuar shqisor apo ndijimor i përbërë nga shqisat, rrugët nervore aferente dhe zonave sensorike të cipës apo kores së trurit të madh. Ndijimet dhe perceptimet e dukurive, të proceseve, të trupave etj., përkatësisht njohja e tyre është e mundur vetëm me funksionimin e rregullt të tërësisë së këtij sistemi. Ky sistem gjatë zhvillimit të njeriut është specializuar për marrjen, përpunimin, analizën dhe sintezën e ngacmuesve që veprojnë drejtpërdrejt në sistemin e këtyre shqisave. Sistemin shqisor e përbëjnë shqisat e periferisë së organizmit, shqisa e baraspeshimit dhe shqisat e brendshme të organizmit. Shih –

NDIJIMET EKSTERORECEPTIVE;
NDIJIMET INTERORECEPTIVE;
NDIJIMET PROPIORECEPTIVE.

SITUACIONALIZ/ËM, - MI. m. Emërtim i disa pikëpamjeve psikologjike, sipas të cilave karakterin e gjithëmbarshëm të veprimtarisë së njeriut e përcakton situata ku ai gjendet, përkatësisht situata e mjedisit natyror, shoqëror e psikik të njeriut. Vështirë se mund të interpretohen reagimet dhe sjelljet e organizmit, nëse nuk merret në konsideratë situata e caktuar. Për këtë shkak sot bëhet fjalë kryesisht për qasje të përgjithshme psikologjike, duke marrë në shqyrtim situatën si edhe rëndësinë e interesave, të motiveve, të përvojës, si edhe fleksibilitetin e reagimeve dhe të sjelljeve sipas vlerësimit individual të asaj situate nga ana e njeriu**t.**

SITUAT/Ë, - A. f. Pozicioni i njeriut, gjendja në një mjedis të caktuar, e shkaktuar nga kushtet, rrethanat e raportet ndërmjet të tjerëve, ku zhvillohet një marrëveshje, një konflikt etj. Përcaktimi i saktë i situatës ka rëndësi të veçantë: sipas përcaktimit të situatës dhe rëndësisë së saj njeriu merr vendim për zgjedhjen e sjelljeve, organizimin dhe bashkërenditjen e sjelljeve të veta.

SITUS INVERSUS. Term i anatomisë që në shqip emërtohet me fjalët vendosje e kundërt e organeve. Përdoret

kryesisht në psikologjinë fiziologjike për të emërtuar në rend të parë zhvendosjen e funksionit të perceptimit hapësinor nga hemisfera e djathtë në hemisferën e majtë të trurit dhe funksionin e të folurit nga hemisfera e majtë në hemisferën e djathtë.

SJELLJ/E, - A. f. Reagime të organizmit ndaj ngacmuesve të drejtpërdrejtë ose të ndërmjetëm ku hyjnë: lëvizjet e organizmit, operacionet, proceset, reagimet ndaj ngacmuesve, reflekset, shkathtësitë, shprehitë, veprimet e vullnetshme dhe veprimet e pavullnetshme. Këto kanë mundësi të vëzhgohen, të regjistrohen dhe të maten objektivisht. Ky term do të shprehte gjithë ata që konsiderojnë psikologjinë disiplinë shkencore që studion sjelljet dhe që e dëgjojnë gjithë lëndën e saj në formulën S(timul) – R(eagim). Përkufizimi i këtillë kënaq përfaqësuesit e bihejviorizmit, por mohon kompleksin e proceseve mendore, përkatësisht proceset e mendjes, si edhe proceset fiziologjike dhe neurologjike të tyre. Psikologjia e sotme me termin sjellje mbulon kuptimin e proceseve psikike dhe të të gjitha llojeve të aktivitetit, duke përfshirë edhe veprimtarinë e neurokorteksit, përkatësisht të cipës së trurit të madh. Me anën e tyre njeriu vepron mbi mjedisin dhe ndryshimet e tij, shkakton ndryshime pozitive të këtij mjedisi ose shmang ndikimet e tij të papëlqyeshme. Në shqip dallohen sjelljet pozitive dhe negative. Këto çojnë në përfundim me konotacion moral, duke e konsideruar sjelljen veprimtari të posaçme dhe të mësua**r.** Termi sjellje ka zbatim të gjerë në literaturën e psikologjisë, si edhe në të folurin e përditshëm, përkatësisht atë kolokfial.

SJELLJA ADAPTUESE. Sjellje e drejtuar në përshtatjen e aktivitetit të organizmit ndaj kërkesave fizike e biologjike të mjedisit të organizmave, sidomos të kërkesave shoqërore dhe morale të organizmit të njeriut ndaj mjedisit të caktuar dhe ndryshimeve të tij. Në teorinë evolutive të Çarls Darvinit (Charles Darwin, 1809 – 1882) sjelljet adaptuese kanë zënë vend të rëndësishëm në zhvillimin evolutiv të qenieve të gjalla.

SJELLJA ALTRUISTE. Motivim dhe organizim i sjelljeve të njeriut të drejtuara në ndihmën, përparimin dhe përgjithësisht në dobiprurjen e tjetrit, madje, duke qenë edhe në dëm të altruistit dhe herë-herë edhe në sakrifikim të tij për të mirën e tjetrit ose të të tjerëve. Sjelljet altruiste janë produkt i të mësuarit dhe burojnë nga ndjenjat njerëzore të ndërlidhjeve të tyre, që për bazë kanë dashurinë, miqësinë, simpatinë dhe shoqërizimin njerëzor**.**

SJELLJA ANTISHOQËRORE. Keqtrajtimi i të tjerëve, përdhunimi seksual, sjelljet kundravajtëse, dhuna në shkolla etj., që bien ndesh me normat dhe me standardet shoqërore dhe morale të mjedisit të caktuar, duke rrezikuar dhe prishur bashkëjetesën paqësore. Disa nga format e sjelljeve antishoqërore shfaqen që në moshën e fëmijërisë, të rinisë dhe në atë të pjekurisë. Janë rezultat i socializmit të paorganizuar social, i edukatës së mangët familjare etj.

SJELLJA ASERTE. I ardhur nga latinishtja *asertorius* "pohues". Formë e sjelljes së njeriut e zhvilluar mbi bazën e motivit të agresivitetit. Sjellja aserte shfaqet në veprimtarinë e besimit të

theksuar në veten e tij, në mbrojtjen me ngulm të interesave, të synimeve dhe të qëllimeve të veta. Në mjedisin tonë karakterizon më tepër sjelljet e meshkujve. Konsiderohet formë e sjelljeve të çrregulluara**.**

SJELLJA AUTOMATIKE. Sjellje motorike dhe verbale e paqëllimshme, e pavetëdijshme, që karakterizon më tepër epilepsinë, skizofreninë dhe narkolepsinë. Manifestohet në forma të ndryshme, si: ngritja nga shtrati në gjumë e sipër, biseda me zë të lartë etj. Sjelljet automatike janë shpesh reagime ndaj situatave stresante dhe traumatike**.**

SJELLJA AVERSIVE. Emërtim i përgjithshëm i sjelljeve që kanë të bëjnë me raportin njeri – objekt aversiv. Sjellja e tillë është largimi, ikja nga objekti aversiv dhe nga kushtet e raportet e shfaqjes së tij, si edhe sjellja e dënimit të vetes me objektin aversiv.

SJELLJA BIOSOCIALE. Sjellje e ndërlidhur dhe e zhvilluar falë bashkëveprimit të faktorëve biologjikë dhe atyre shoqërorë gjatë procesit të socializimit dhe edukimit të njeriut. Shtytësi seksual ka bazë biologjike, por format e sjelljeve për plotësimin e këtij shtytësi janë ndër më të ndryshmet në mjedise të ndryshme shoqërore dhe kulturore. Të gjithë kanë nevojë për ushqim, por sjelljet dhe format e tyre për plotësimin e urisë ndryshojnë prej një mjedisi shoqëror e kulturor në një mjedis tjetër.

SJELLJA E SHËNDETSHME. Të gjitha sjelljet dhe veprimet e njeriut për ta mbrojtur gjendjen e mirë fizike e psikike të tij, duke kërkuar që në zanafillën e një sëmundjeje ndihmë mjekësore. Në këtë aspekt rol të rëndësishëm luajnë informacionet dhe përgjithësisht dijet nga psikologjia (angazhimi në lojëra sportive, ushqimi i rregullt, mënjanimi i shprehive negative (të pirit e duhanit, marrja e drogave), kontrolli sistematik mjekësor etj., perceptimi real i ndryshimeve shëndetësore, besimi ndaj personelit mjekësor etj.

Burimet:

Jean Menechal: *"Hyrje në psikopatologji",* Tiranë, 2005.

Staniša Nikolić & Eduard Klain & Vesna Vidović*: "Osnove Medicinske Psihologije"* – (*"Bazat e psikologjisë mjekësore"*), Zagreb, 1990.

Karen Horney: *"The Neurotic Personality of Our Time"* – (*"Personaliteti neurotik i kohës sonë"*), New York, 1937.

Gordana Stankovska & Myqereme Rusi: "*Psikologjia mjekësore*", Skopje - Shkup, 2011.

SJELLJA IMPULSIVE. Sjellje e vrullshme e shkaktuar nga faktorët e brendshëm, e cila shoqërohet me emocione intensive.

SJELLJA MASIVE. Sjellje gati e njëjtë e një numri të madh të qytetarëve të një vendi. E tillë është veshja shumë e ngjashme ose e njëjtë e të rinjve të një vendi, rregullimi i flokëve sipas një modeli te pjesa dërrmuese e të rejave, sjellja pozitive e të rinjve ndaj një stili muzikor etj. Sjellja masive realizohet nën ndikimin e institucioneve të fuqishme shoqërore, siç është televizioni etj.

SJELLJA ME DREJTIM QËLLIMOR. Sjellje të motivuara nga dëshira, nga energjia e shtytësve etj. dhe të drejtuara në një qëllim të caktuar dhe arritjen e këtij qëllimi nga ana e njeriut. Qëllimi mund të jetë fizik, biologjik

e shoqëror. Sjellja e tillë karakterizon veprimet e vullnetshme të njeriut.

SJELLJA PROBLEMATIKE. Sjellja e njeriut që ka bazë sociale e psikologjike dhe që mund të shkaktojë problem psikologjik. Ndër sjelljet problematike dallohen: sjelljet antishoqërore, destruktive, shumë të papërshtatshme, shkatërruese etj. Secila nga llojet e përmendura të sjelljeve ka motivet e veta dhe njëkohësisht këto sjellje kanë karakter të theksuar individual.

SJELLJA STEREOTIPE. Sjellje të njëjta të disa individëve, të cilët nuk i ndryshojnë këto sjellje ndaj grupit të anëtarëve të tjerë, pavarësisht nga ndryshimet sociale, ekonomike e shoqërore. Këta nuk tregojnë gatishmëri për të modifikuar sjelljet e fituara qysh në fëmijëri.

SJELLJA VERBALE. Sjellje me fjalë (verbale) e njerëzve, që ka të bëjë kryesisht me reagim të tyre ndaj fjalëve dhe situatave të formuluara me fjalë, si edhe me aktivizim të proceseve të kujtesës ndaj fjalëve të lidhura me lëndën e mbajtur mend nga ana e njeriut dhe me riprodhimin e duhur të saj në situatat e veçanta fjalësore. Ky term është përdorur më tepër nga ana e bihejvioristëve. Në shqip përdoret rrallë dhe kjo ndodh nën ndikimin e teksteve të psikologjisë bihejvioriste.

SJELLJA ZAKONORE. Sjellje të pashkruara që janë rrënjosur gjatë zbatimit të tyre për një kohë të gjatë në procesin e rregullimit të marrëdhënieve ndërmjet anëtarëve të një mjedisi të gjerë shoqëror. Sjelljet zakonore kishin karakter kazual në kuptimin e rastësishëm të tyre, por që shkaktonin dëm të njerës palë dhe kërkonin të zgjidhen për të qetësuar të dy palët. Këto sjellje janë sjellje që kanë të bëjnë me shkallën e zhvillimit të ndërgjegjes dhe i përkisnin strukturës së ndërgjegjes, por u zhvilluan para parimeve dhe normave morale. Këto i përkisnin të drejtës zakonore dhe ishin të detyrueshme për t`u zbatuar. U zhvilluan në periudhën e gjatë të zhvillimit të shoqërisë, kur kjo ishte ende e paorganizuar, shumë larg periudhës së zhvillimit të organeve dhe institucioneve juridike të shtetit.

SJELLJA ZAKONORE NDËR SHQIPTARËT. Sjelljet zakonore janë karakteristike edhe për zhvillimin e shoqërisë ilire e arbërore, sidomos të zonave malore e të bjeshkëve. Këto ishin sjellje të pashkruara të mjediseve ilire e arbërore, të organizuara sipas rendit fisnor shumë kohë para zhvillimit të parimeve dhe normave të së drejtës zakonore. U zhvilluan për një kohë të gjatë pas përsëritjeve të shumta të tyre, të marrëdhënieve ndërmjet anëtarëve të fiseve dhe ndërmjet fiseve. Nga këto sjellje e rregulla të tyre, si edhe nga zhvillimi i të drejtës zakonore ka buruar e drejta kanunore e Shqiptarëve. Në këtë fushë ka mbetur i njohur Kanuni i Lekë Dukagjinit.

Burimet:

Neil R. Carlson & William Buskist & G Neil Martin: *"Psychology the Science of Behavior"* – (*"Psikologjia shkenca për sjelljen"*), 1997.

John Watson: *"Behaviorism"* – (*"Bihejviorizmi"*), 1925.

Carole Wade & Carol Tavris: *"Psychology"* – (*"Psikologjia"*), 1979, fq. 68 – 95.

Neki Juniku: *"Modifikimi i sjelljes në shkollë"*, Prishtinë, 1997.

Robert Serpell: *"Culture`s Influence on Behaviour"* – (*"Ndikimi i kulturës në sjellje"*), Methuen, London 1976.

Albert Bandura: *"Principles of Behavior Modification"* – (*"Parimet e modifikimit të sjelljes"*) 1967.
Ismet Elezi: *"Njohuri për të drejtën zakonore mbarëshqiptare",* Prishtinë, 2003.

SJELLJET TERRITORIALE. I ardhur nga latinishtja *territorium* "hapësira e një vendi me kufij të caktuar". Sjelljet territoriale janë lloj sjelljesh të lidhura me një hapësirë të kufizuar, të cilën një qenie e caktuar e konsideron të vetën dhe e kryen këtë sjellje për mbrojtjen e saj. Sjelljet e këtilla dallohen sidomos te disa kafshë të egra si te ariu, dhelpra, ujku etj., si edhe te disa kafshë shtëpiake, siç është qeni. Konsiderohen sjellje të lindura dhe universale për llojin e caktuar të kafshëve. Sjelljet territoriale karakterizojnë edhe gjininë njerëzore; edhe njerëzit hapësirën e tyre (shtëpinë, arën etj.) e kufizojnë, e zhvillojnë dhe e ruajnë nga dëmet. Në një hapësirë të kufizuar me mur, me rrjetë hekuri etj. njerëzit e ndiejnë veten më të sigurt dhe më të rehatshëm.

SKAJET NERVORE. Mbaresa ose pjesë përfunduese të fijeve nervore.

SKALIM, - I. m. Procesi i veprimit të profesionalistëve në hartimin e testit për matje, vlerësim të qëndrimeve, të metodave, të procedurave gjurmuese e matëse, si edhe interpretimin e rezultateve të arritura me zbatimin e metodave dhe procedurave matëse.

SKALITJ/E, - A. f. Term i ardhur nga estetika në psikologji. Përdoret rrallë për të emërtuar përshkrimin dhe shpjegimin e hollësishëm dhe të bukur të koncepteve të posaçme, si: pamja serioze e Skënderbeut, qëndrimi besnik i malësorit, tiparet e dashurisë së nënës ndaj fëmijëve të saj etj. Skalitet një ndjenjë, qëndrim, tipar i sjelljes etj. me qëllim të theksimit dhe të qëndrueshmërisë së tyre në sjelljet e njeriut.

SKANDAL, - I. mb. Që cilëson sjelljet e turpshme të njeriut në një situatë të caktuar dhe që ka ardhur nga greqishtja *σκανδβων*. Sjelljet skandal ose skandaloze janë ato që nuk kanë të bëjnë me parime e me norma morale, dhe as me përcaktimet ligjore të sjelljeve të njeriut në situate të tilla.

SKELET, - I. m. Term i anatomisë i ardhur nga greqishtja *σκελετός* që emërton tërësinë e fortë organike eshtërore të njeriut, që është mbështetëse kryesore e të gjitha organeve të trupit të tij. Përbëhet nga shtylla kurrizore, kafka, brinjët, dërrasa e kraharorit, gjymtyrët e sipërme, brezi pelvik dhe gjymtyrët e poshtme. Skeleti është tërësi e formuar prej 206 eshtrave të trupit të njeriut.

SKEM/Ë, - A. f. Paraqitje rregullash, modelesh e drejtimesh njohëse kryesore të një procesi, veprimtarie, sipas së cilës njeriu organizon zhvillimin e veprimtarive të ndërlikuara. Në psikologjinë kognitive është paraqitje e thjeshtëzuar, strukturë mendore, model i qasjes së zhvillimit të procesit të mendimit përgjatë orvatjeve të zgjidhjes së një çështjeje apo problemi matematik, politik, shoqëror etj. Për psikologun anglez Frederik Bartlet (Frederic Bartlett, 1886 – 19690) skema është rrjet i përpunuar i strukturave abstrakte mendore që përfaqësojnë një kuptim të caktuar.

SKEMA AKSIONALE. Strukturat e periudhës sensomotorike të zhvillimit kognitiv të fëmijëve, paraprijëse të formimit të koncepteve. Shfaqet në

gatishmërinë aksionale të diferencimit dhe të integrimit të aksioneve, si edhe të bartjes së asaj përvoje nga një situatë në një situatë tjetër.

SKEMA SHOQËRORE. Harta mendore, modele kognitive të interpretimit të ngjarjeve shoqërore dhe të raporteve të caktuara. Këto përjashtojnë sjelljet individuale sipas motiveve, nevojave e qëndrimeve dhe për këtë arsye skemat shoqërore kanë karakter konstruktiv. Ndihmojnë përzgjedhjen e sjelljeve dhe ruajtjen e më të mirave në kujtesën e njeriut, duke paraqitur njëkohësisht drejtimin e procesit të zhvillimit të këtyre sjelljeve.

SKEMATIZIM, - I. m. Paraqitje e të dhënave psikologjike për kujtesën, mendimin etj. të reduktuara në ato kryesoret, duke mënjanuar të dhënat periferike dhe duke hartuar një pasqyrë të qartë e konkrete të të dhënave themelore të një situate të mbajtur mend dhe për gjurmimin e raporteve thelbësore ndërmjet tyre me anë të proceseve mendore.

SKEPTICIZ/ËM, - MI. m. Pikëpamje e përgjithshme për pamundësinë e njohjes së të vërtetës, që rrjedh nga mungesa e kriterit të saktë, sipas të cilit përcaktohet mendimi i vërtetë. Termi ka ardhur nga greqishtja *σκέψη* "dyshim". Thelbi psikologjik i skepticizmit i përket ndjenjës intelektuale të dyshimit dhe të asaj të pasigurisë së njohjes së realitetit, duke përfshirë edhe dyshimin në atë që është tashmë e njohur. Skepticizmi ka histori të lashtë dhe është i lidhur me mendimtarin Pirro të Greqisë Antike.

SKINER Frederik Berrhus (Burrhus Frederic SKINER). Psikolog amerikan, bijejviorist. Lindi në Pensilvani më 1904 dhe vdiq në Masaçuset më 1990. Studioi letërsi e më pas psikologji në Universitetin e Harvardit, ku pas përfundimit me sukses të studimeve për psikologji vazhdoi veprimtarinë gjurmuese dhe kreu magjistraturën dhe doktoraturën. U zgjodh profesor i psikologjisë në Universitetin e Minesotos dhe këtu punoi në vitet 1937–1945, më pas në vitet 1945–1948 në Universitetin Indiana dhe deri sa doli në pension qe profesor i psikologjisë dhe studiues eksperimental i sjelljeve në Universitetin e Harvardit ku mori thirrjen e nderit "Edgar Pirs" si profesor i psikologjisë. Ithtar i madh i bihejviorizmit, por në ndryshim nga themeluesi i bihejviorizmit Xhon Uotson, Skiner Berhus qe i prerë në qëndrimin se "Psikologjia nuk duhet të merret me shpjegimin e asaj çfarë ndodh në organizëm, madje edhe në qoftë se ka të bëjë me procese fiziologjike të thjeshta, por duhet të merret me hulumtimin dhe përshkrimin vetëm të marrëdhënieve të organizmit me mjedisin e jashtëm, duke u përkufizuar në përshkrimin e pastër dhe duke u larguar nga çfarëdo lloj interpretimi, ose duke u përmbajtur nga të shtuarit e çfarëdolloj fakti të vërtetuar". Për Skiner Berrhusin sjelljet janë rreptësisht të përcaktuara. Konceptet e reja bihejvioriste të tij u mbështetën kryesisht në refleksin veprues. Zhvilloi një teknikë të përsosur të gjurmimit shkencor të sjelljeve dhe të modelimit të tyre, duke ndikuar shumë në zhvillimin e psikologjisë objektive. Veprat kryesore të tij janë: "*The Behavior of Organism*" – ("*Sjellja e organizmave*"), 1938; *"Science and Human Behavior"* –

(*"Shkenca dhe sjellja njerëzore"*), 1947; "*Verbal behavior*" – ("*Sjellja verbale*"), 1959; *"Beyond Freedom and Dignity"* – (*"Përtej lirisë dhe dinjitetit"*), 1971; *"About Behaviorism"* – (*"Rreth bihejviorizmit"*), 1979 etj.

SKIZOFRENI, - A. f. Term i psikiatrisë dhe i psikopatologjisë i ardhur nga greqishtja *σχιζο* "çaj" dhe *φρενής* "mendje" që përfaqëson psikozën më të rëndë të çrregullimeve mendore të njeriut. Simptomat kryesore të skizofrenisë janë: çrregullimet e mendimit, të të folurit, të sjelljeve dhe të raporteve ndërmjet tyre, çarjet ndërmjet proceseve të mendimit dhe përjetimeve emocionale, shfaqjet e halucinacioneve, shmangia nga raportet shoqërore dhe përgjithësisht plasaritja ndërmjet proceseve psikike, bashkërenditjes dhe unitetit funksional të tyre. Përgjithësisht skizofrenia ka të bëjë me çrregullime të rënda kognitive, emocionale dhe të sjelljeve të njeriut, duke përfshirë sidomos veprimet e çrregullta të vullnetshme. Identifikimi i mirëfilltë i kësaj sëmundjeje psikike kërkon paraqitjeje të simptomave të përmendura në një vazhdimësi prej së paku gjashtë muajsh. Termin skizofreni me kuptimin e përmendur e ka përdorur psikiatri zviceran Eugen Blojler (Eugen Bleuler, 1857 – 1939). Shkaqet e plota të skizofrenisë janë ende të panjohura. Dallohen disa lloje skizofrenish, si: skizofrenia hebefrenike, katonike dhe skizofrenia paranoike.

SKIZOFRENIA HEBEFRENIKE. Skizofrenia e moshës së pjekurisë që zakonisht shfaqet rreth moshës 15 – 20 vjeç e që ka këto veçori kryesore: çrregullime të procesit të emocioneve dhe përjetimit të tyre me intensitet të lartë, agresivitet dhe përjetime halucinative.

SKIZOFRENIA KATONIKE. Çrregullim i madh i aftësive të lëvizjeve i shfaqur në dy forma: frenim i madh lëvizjesh (negativizëm, katalepsi etj.) dhe shqetësim motorik i tepruar.

SKIZOFRENIA NË PSIKANALIZË. Skizofreni e trajtuar si kthesë prapa e zhvillimit të njeriut të pjekur. Kjo kthesë lidhet me kthim zhvillimor në fazën e narcizmit, ku rrënohet struktura e egos dhe depersonalizimi i njeriut me ide fikse të madhështisë, të halucinacioneve, të ideve sumanute, me ëndrra të çuditshme etj. Ai që vuan nga skizofrenia tërhiqet nga mjedisi e bota e jashtme dhe mbyllet pothuajse krejtësisht në veten e tij; humb çfarëdo lidhje me dukuritë mjedisore të tij. Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1939) procesin e zhvillimit të skizofrenisë e ka ndarë në dy faza kryesore: 1) Faza e rrënimit të egos dhe 2) Faza e mbisundimit të halucinacioneve dhe e regresit të thellë motorik.

SKIZOFRENIA PARANOIDE. Skizofreni me tipare të mendimit të çrregulluar, si në pikëpamje të zhvillimit të proceseve mendore, ashtu edhe me çrregullime përmbajtjesore të këtyre proceseve, ku mbisundojnë halucinacionet, shkëputjet mendore me realitetin dhe ndjenja e përndjekjes.

SKIZOFRENIA SIMPLEKSE. Term i psikiatrisë bashkëkohore dhe i psikopatologjisë, i ardhur nga greqishtja *shizo* "çaj", *phreno* "mendje"dhe fjala latine *simplex* "i, e thjeshtë". Është lloj i skizofrenisë që karakterizohet me

apati, humbje të lidhjeve me realitetin dhe me ndryshime të mjedisit të tij, indiferencë emocionale jashtëzakonisht të madhe dhe me vështirësi të mëdha komunikuese me të tjerët.

SKLER/Ë, - A. f. E bardha e syrit, shtresë e brendshme fijezore e cipës së jashtme të kokërdhokut të syrit, që e mbështjell atë. Sklera është e patejdukshme. Termi ka ardhur nga greqishtja *σκληρός* "e fortë". Kjo pjesë e syrit emërtohet edhe me termin mbështjellës sklerotik. Shih – ***SYRI.***

SKLEROIRIT, - I. m. Pezmatim i sklerës dhe i cipës së ylberthit të syrit. Emërtohet edhe me termin skleritis, që ka prejardhje nga fjala bazë e greqishtes *skleros* "i, e fortë".

SKLEROZ/Ë, - A. f. Term i patologjisë së përgjithshme, i psikiatrisë dhe i psikopatologjisë, i ardhur nga greqishtja *skleros* "i, e fortë" që ka të bëjë me shtrëngimin patologjik të indeve të organeve të ndryshme të trupit të njeriut. Për pasojë haset arteroskleroza, arteroskleroza cerebrale, arteroskleroza e shumëfishtë ose multiple etj. Skleroza e shumëfishtë ka të bëjë me dukuritë psikologjike patologjike.

SKLEROZA MULTIPLE. Sklerozë shumëshkakore ende e paidentifikuar plotësisht. Ka të bëjë me ngurtësimin e indeve nervore të trurit dhe të palcës kurrizore. Ka zhvillim kryesisht progresiv, ndonëse me ritëm jo të ndryshueshëm. Shfaqet me rrënim të proceseve mendore dhe me çrregullime emocionale.

SKOFI, - A. f. Tërësi tiparesh të mira, pozitive, të organizuara fortësisht në strukturën dhe unitetin e personalitetit. Ky organizim tiparesh shfaqet me sjellje karakteristike, si: butësi e urtësi në marrëdhënie me të tjerët, kujdes i veçantë ndaj tjetrit. Dallohet me qëndrueshmëri të stabilizuar në sjelljet e njeriut. Është tërësi tiparesh e mësuar gjatë socializimit dhe edukimit të fëmij**ës.**

SKOPOFILI, - A. f. Përjetim i kënaqësisë seksuale duke parë e vëzhguar sjellje partnerësh në dashuri të thellë, duke dashur të shohë fotografi femrash lakuriqe, filma erotikë etj. Numri i njerëzve të këtillë është relativisht i madh, por me ndryshime mjedisesh kulturore dhe fetare, si edhe me ndryshime individuale të individëve të mjediseve të ndryshme kulturore e shoqërore.

SKOR, - I. m. Term i anglishtes që ka hyrë në përdorim sidomos në psikometri. Skor emërton vlerën sasiore të një rezultati të arritur nga ana e një individi, ose vlerën e përgjithshme sasiore të matjes së një ndryshoreje të një grupi homogjen të individëve. Shih – ***ARRITJE.***

SKRUPULL, - I. m. Fjalë e të folmes popullore shqipe që merr statusin e termit, duke emërtuar konceptin e përmbajtjes së shprehjes, të sjelljes ndaj tjetrit, sepse ka konsideratë ndaj tij, ndaj dinjitetit njerëzor dhe fytyrës morale të tij, që druan se prek për të keq dhe lëndon karakterin dhe personalitetin e tjetrit. Merr statusin e termit të psikologjisë sociale dhe asaj etike, nëse është ngulitur si qëndrim i sjelljeve të gjithëmbarshme të njeriut.

SKUTHËRI, - A. f. Tërësi qëndrimesh e sjelljesh të nxitura dhe të drejtuara në mjegullimin, në fshehjen e qëllimshme të synimeve dhe të qëllimeve objektive të tij. Skuthëria bëhet me

qëllime përfitimesh vetjake të ndryshme. Kur qëllimet e këtilla marrin përmasa të qëndrueshme në sjelljen e njeriut, atëherë skuthëria ka përmasën e tiparit të sjelljeve të tij.

SMIR/Ë, - A. f. Keqdashje e një individi ndaj një tjetri që shkaktohet nga lakmia e tepërt e shoqëruar me pakënaqësi, pasi tjetri ka atë të cilën dëshiron ta ketë edhe vetë ky. Smira është ndjenjë e ndërlikuar që zhvillohet gjatë socializimit të njeriut dhe shpesh ka përmasa motivuese të veprimtarisë ndaj individit tjetër, i cili në mëvetësinë e tij ka atë që ky dëshiron ta ketë, është pronar i asaj që tjetri lakmon ta ketë, por që këtë mezi ose kurrsesi nuk arrin ta përvetësojë.

SNOBIZ/ËM, - MI. m. Term i psikologjisë shoqërore i ardhur nga anglishtja dhe i shtrirë në disa gjuhë. Snobizmi është cilësi sjelljesh imituese të mënyrës së jetesës, të modës, të stilit etj. të atyre që mendohet se gjenden në një shkallë më të lartë shoqërore, në një klasë fisnikësh të zgjedhur. Tipar sjelljeje i atij që i jep rëndësi vetes, që imiton të zotin pa pasur kurrfarë mbështetje për të.

SOCIABILITET, - I. m. Dëshira motivuese e njeriut për të lidhur shoqëri me të tjerët. Manifestohet me ndjenja pozitive dhe veprime të nxitura nga motivet shoqërore, të organizuara dhe të drejtuara kah bashkëveprimi me të tjerët. Shkalla e zhvillimit të sociabilitetit matet me zbatimin e testit sociometrik.

SOCIALDARVINIZ/ËM, - MI. m. Teori e shpjegimit të zhvillimeve shoqërore sipas modelit të teorisë së evolucionit të Çarls Darvinit (Charles Darwin, 1809 – 1882). Shoqëria dhe zhvillimet e saj mbështeten në parimin e konkurrencës dhe të konflikteve, përkatësisht të luftës për ekzistencë. Më të aftit, më të fortët që arrijnë të përballojnë konkurrencën dhe konfliktet mbijetojnë, të tjerët eliminohen. Përfaqësuesi më i njohur i kësaj pikëpamjeje ishte Berbet Spenseri (Herbert Spencer, 1820 – 1903). Kjo teori nuk ka arritur t`i përballojë kritikat argumentuese.

SOCIALIZ/IM, - MI. m. Term i disiplinave humaniste. Në psikologjinë sociale socializimi është proces i formimit të qenies njerëzore nën ndikimin që ushtrojnë faktorët e mjedisit shoqëror. Ky është në rend të parë proces i shndërrimit të fëmijës nga qenia biologjike e papjekur në personalitet të pjekur shoqëror, kulturor e moral. Është proces i ndërlikuar dhe afatgjatë, që ka të bëjë me format e ndryshme të të mësuarit, me burime të ndryshme të ndikimeve shoqërore, ku individi në ndërveprim me mjedisin shoqëror mëson dhe përvetëson format e ndryshme të përjetimeve psikike dhe sjelljet e duhura. Socializimi i përket fitimit të përvojës jetësore (të dijeve, shprehjes së mendimeve me anë të simboleve, të përftimit të vlerave shoqërore, të zhvillimit të qëndrimeve, të sjelljeve me të cilat njeriu i përshtatet mjedisit shoqëror, kërkesave e nevojave zhvillimore të tij dhe angazhimit në ndryshimin e tij. Në procesin e socializimit individi mund të përvetësojë edhe trajta sjelljesh të padëshirueshme (sjellje delikuente, jokulturore, të pamoralshme etj.), por me anë të socializimit i zhvillon edhe aftësitë specifike individuale të tij, në bazë të të cilave ai ndryshon nga

të gjithë të tjerët. Socializimi është proces dhe rezultat i shndërrimit të qenies njerëzore nga ajo biologjike dhe e pafuqishme, por me potencial të jashtëzakonshëm zhvillimor në qenien shoqërore.

SOCIALIZIM I MOTIVEVE. Term i konceptit shoqërizim i motiveve, përkatësisht ndryshim pozitiv i formave dhe i mjeteve të plotësimit të motiveve. Shih – ***SHOQËRIZIMI I MOTIVEVE.***

SOCIOBIOLOGJI, - A. f. Studim i bazës biologjike të sjelljeve shoqërore e kulturore të njeriut, përkatësisht ndërmjet gjenetikës dhe sjelljeve të njeriut. Kjo disiplinë e ka zgjeruar fushën gjurmuese dhe tashmë merret me studimin e bazës biologjike të zhvillimit të proceseve psikike, të veprimeve të kafshëve dhe të sjelljeve shoqërore të njeriut. Filloi zhvillimin e saj në shekullin e njëzet nën ndikimin e pikëpamjeve për evolucionin e qenieve të gjalla të Çarls Darvinit (Charles Darwin, 1809 – 1882). Agresiviteti i njeriut, sjellja altruiste, seksuale etj. e kanë bazën biologjike të zhvillimit të tyre, pra këto nuk janë vetëm produkt i të mësuarit. Çështja e integrimit të faktorëve biologjikë në shpjegimin e sjelljeve të njeriut mbetet aktuale edhe në ditët e sotme.

SOCIOCENTRIZ/ËM, - MI. m. Kompozitë terminologjike e ardhur nga latinishtja *societas* "shoqëri" dhe *centrum* "qendror". Sociocentrizmi është përfillje e grupit shoqëror dhe e sjelljeve grupore të këtij grupi si kriter dhe si qëndrim për përfaqësimin ideal të mendimit dhe sjelljeve të tij. Ky kriter dhe qëndrim është i vlefshëm për të vlerësuar grupet e tjera dhe sjelljet e tyre.

SOCIODRAM/Ë, - A. f. Term bashkëngjitës i fjalëve latine *socius* "shok" dhe *drama* "veprim". Sociodrama është metodë psiko-terapeutike dhe gjurmuese e dinamikës së marrëdhënieve ndërmjet anëtarëve të një grupi social dhe të zgjidhjes së konflikteve ndërmjet tyre dhe grupeve sociale. Zbatohet duke luajtur rolin në mënyrë dramatike në kuadrin e një grupi shoqëror të caktuar. Si metodë psiko-terapeutike zbatohet me qëllim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe konflikteve ndërmjet grupeve shoqërore në institucione të ndryshme shoqërore, ekonomike dhe politike.

SOCIOGRAM, - I. m. Paraqitje grafike e strukturës së ndërveprimit ndërmjet anëtarëve të një grupi shoqëror. Në këtë paraqitje shfrytëzohen shenjat grafike në formë shigjetash dhe rrethorësh të vegjël. Shigjetat tregojnë drejtimin tërheqës ose refuzues të marrëdhënieve të një anëtari të atij grupi me anëtarin tjetër të shënjuar me shenjën O. Këtë e ilustron sociogrami i mëposhtëm:



Burimet:

David G. Myers: *"Socialpsikologjia",* Shtëpia Botuese UEGEN, Tiranë, 2003.
Henri Valon: *"L`Etude psychologique et sociologique de l`efeant"* – (*"Studime psikologjike dhe sociologjike të fëmijëve"*), ENFANCE, 3 – 4, 1959.
Albert Bandura: *"The rRole of Modeling Processes in Personality Development"* – (*"Roli i procesit të të mësuarit sipas modelit në zhvillimin e personalitetit"*), Hartup, W. W. and Smerthergill, N. L.: *The Young Child:* Review of Research.
Ylli Pango: *"Psikologjia sociale",* Biblioteka Universale, Korbi.
Edmond Dragoti: *"Psikologjia sociale",* Shtëpia botuese "Libri Universitar", Tiranë, 1999.

SOCIOGJENEZ/Ë, - A. f. I ardhur nga fjalët e përngjitura latine *societas* "shoqëri" dhe *genesis* "lindje, zhvillim". Shpjegim i sjelljeve shoqërore në bazë të prejardhjes dhe zhvillimit të tyre duke përfshirë rolin e përvojës dhe bartjen e saj prej një brezi në brezin tjetër. Sot përdoret më tepër për të emërtuar prejardhjen apo gjenezën e sjelljeve delikuente, madje edhe të atyre kriminogjene**.**

Burimet:

Max Weber*: "Gesammelte Aufsatze zur Wisenschaftsgeschichte"* – (*"Bazat e tërësishme të shkencave historike"*), Munchen, 1924.
Max Weber: *"Mbi disa kategori të sociologjisë kuptimore"* – ("*Nocionet sociologjike themelore"*), Tiranë, 2010.
Albert Bandura: *"Social Learning Theory"* – (*"Teoria e të mësuarit social"*), New York, 1977.
Edmond Dragoti: *"Psikologjia sociale",* Tiranë, 1999.

SOCIOLOGJI, - A. f. I ardhur nga latinishtja *socius* "fis, shoqëri". Sociologjia është disiplinë e përgjithshme shkencore, që merret me studimin e origjinës, të historisë së shoqërisë njerëzore dhe të zhvillimit të dukurive, të dinamikës, të strukturave shoqërore, si edhe me njohjen e rregullsisve dhe të ligjeve të ekzistencës dhe të zhvillimit të proceseve të tyre. Sociologjia ka lidhje të ngushtë me psikologjinë sociale, e cila gjurmon në rend të parë sjelljet shoqërore individuale në bazë të interesimeve, të nevojave, të qëndrimeve, të tipareve të personalitetit dhe përjetimet subjektive të dukurive shoqërore (të marrëdhënieve, të situatave shoqërore etj.), si edhe reflektimin e tyre në proceset psikike dhe në sjelljet e individit**.**

SOCIOLOGJIA E PERSONALITETIT. Disiplinë e veçantë e sociologjisë që studion rolin dhe rëndësinë e faktorëve socialë dhe të proceseve sociale në zhvillimin dhe formimin e personalitetit. Në këtë kuadër sociologjia e personalitetit konsideron se personaliteti i integruar dhe veçantia e tij është produkt i ndikimit të faktorëve dhe proceseve sociologjike, por edhe subjekt veprues në zhvillimin e tyre. Shih – ***PSIKOLOGJIA E PERSONALITETIT.***

SOCIOLOGJIA E PSIKOLOGJIZUAR. Pjesë e sociologjisë që mbështet përshkrimin dhe shpjegimin e zhvillimit të shoqërisë, të raporteve dhe formave të saj, si edhe reduktimin e tyre në pasqyrimin e strukturave psikike, të dëshirave, të motiveve dhe të nevojave etj. Shih – ***PSIKOLOGJIA SOCIALE.***

SOCIOLOGJIA PSIKANALITIKE. Pikëpamje e përgjithshme sociologjike e mbështetur në psikanalizë dhe në rezultatet e gjurmimit të zhvillimit të sjelljeve shoqërore mbi shtytësit biologjikë, sidomos mbi rolin e shtytësit seksual në zhvillimin e sjelljeve shoqërore. Ky term është i lidhur

kryesisht me mësimet e themeluesit të psikanalizës Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939**).**

SOCIOLOGJIZ/ËM, - MI. m. Pikëpamje e përgjithshme mbi rolin parësor të strukturave, të dukurive dhe marrëdhënieve shoqërore në zhvillimin e njeriut dhe në organizimin e drejtimin e sjelljeve të tij ndaj objektivave të caktuara. Sipas sociologjizmit të gjitha dukuritë, proceset psikike dhe sjelljet e formuara të njeriut janë produkt i mjedisit shoqëror dhe duhet të shpjegohen në bazë të arritjeve sociologjike. Është formë e redukcionizmit të llojeve të ndryshme të interesimeve, të motiveve, të nevojave, të tipareve të personalitetit etj. në faktorë shoqërorë dhe në rolin vendimtar të tyre në zhvillimin dhe formimin psikologjik të njeriut. Ndër të njohurit e redukcionizmit të tillë janë: Xhon Uotson, Burhus Skiner, Albert Bandura, Erik From dhe Karen Hornaj.

SOCIOMETRI, - A. f. I ardhur nga latinishtja *socius* "shok" dhe *metron* "masë" që ka të bëjë me matjen e sjelljeve shoqërore. Sociometria është matje e dinamikës dhe e marrëdhënieve shoqërore ndërmjet anëtarëve të një grupi shoqëror. Kuptimi i ngushtë i saj është përshkrim, matje, analizë dhe shpjegim i sjelljeve të anëtarëve të një grupi shoqëror të vogël të shprehura në marrëdhënie ndërmjet tyre. Me këtë kuptim sot konsiderohet term emërtues i metodës dhe teorisë sociometrike. Instrumenti kryesor i matjes së marrëdhënieve shoqërore, të shkallës së afërsisë dhe të distancës shoqërore të njërit ndaj tjetrit është testi sociometrik. Themelues i sociometrisë është psikiatri amerikan me prejardhje austriake Xhejkob L. Moreno (1890 – 19 74), që pretendonte ta ngrinte sociometrinë në shkallën e një disipline shkencore të posaçme.

SOCIOPAT, - I. m. Në psikiatri i ardhur nga latinishtja *societas* "shoqëri" dhe *αίσθηση* "vuajtje". Term relativisht i ri për personalitetin psikopat që është tip personaliteti që shfaq çrregullime të ndryshme sjelljesh në marrëdhëniet shoqërore (tipi jo i shoqërueshëm, antishoqëror etj.). Karakterizohet nga mungesa e ndjenjës së përgjegjësisë ndaj një individi tjetër, nga mungesa e fajit, e aftësisë dhe e gatishmërisë së komunikimit me të tjerët, e aq më pak e organizimit të sjelljeve shoqërore etj.

SOCIOTERAPI, - A. f. Formë e veçantë e terapisë që synon faktorët shoqërorë dhe shfrytëzimin e formave të ndryshme të krijimit të kontakteve shoqërore. E tillë është psikodrama, ku zhvillohen situata me lidhje shoqërore të reja dhe në të cilat komunikohet lirisht, sipas rolit të secilit individ në zhvillimin e sjelljeve të veçanta shoqërore. Në këtë formë të terapisë grupore theksohen më pak faktorët e brendshëm psikikë të pacientit për t`i lënë hapësirë të pakufizuar lidhjeve dhe marrëdhënieve ndërmjet anëtarëve të një grupi të caktuar. Lindi nga zhvillimi i psikiatrisë sociale dhe i psikologjisë sociale.

SODITJ/E, - A. f. Vështrim i qëllimshëm dhe me vëmendje të përqendruar në dukurinë, fjalën, pikturën etj. Me anë të soditjes zhvillohet procesi elementar i njohjes objektive të realitetit, të dukurive dhe objekteve, si edhe të ndryshimeve të tij. Kjo njohje ka të bëjë me përfitimin e të dhënave "të thjeshta shqisore", të cilave nje-

riu u jep kuptim. E tillë është soditja e majës së bjeshkëve të Shkëlzenit, e burimit të lumit Valbona, e ylberit etj.

SODOMI, - A. f. Perversitet seksual që shfaqet me sjellje të individëve që kryejnë aktin seksual me kafshë, sidomos me kafshë shtëpiake. Sodomia shkaktohet nga shqetësimet e thella seksuale, nga mungesa e partnerit të gjinisë femërore, nga çrregullimet hormonale e psikike etj. U konstatua sidomos te çobanët e bjeshkëve të larta të izoluara, ku këta kalojnë një pjesë të mirë të kohës pa pjesëtarë të familjes dhe pa grupe shoqërimi. U emërtua sipas qytetit Sodom, i i cili u zbraz nga banorët sodomikë.

SOFISTIK/Ë, - A. f. Term i përgjithshëm i ardhur nga greqishtja *όφις* "mjeshtër shkathtësie". Nënkupton zbatimin e qëllimshëm të "argumentit" në mënyrë të gabuar nga një individ, për të vënë në dyshim dhe në gabim individin tjetër, përkatësisht për ta gënjyer atë ose mjedisin e tij. Sofistika gjendet e shprehur më tepër në format silogjistike të të përfunduarit, duke keqpërdorur shprehjen e koncepteve dhe atë të gjykimeve.

SOLIDARIZIM, - I. m. Term i psikologjisë sociale i ardhur nga latinishtja *solidarism* "përbashkësi" që nënkupton gatishmërinë e përbashkët, përkrahjen dhe ndihmënn reciproke për të kryer një detyrë të përbashkët, një marrëveshje etj. Kjo gatishmëri zhvillohet mbi bazën e vetëdijes për nevojën, rëndësinë, interesin dhe përgjegjësinë reciproke në kryerjen e detyrave grupore. Solidariteti ka të bëjë drejtpërdrejt me kohezionin shoqëror dhe rëndësinë e zhvillimit të tij. Mbi këtë bazë u bënë përpjekje për shpjegimin e pajtimit të sjelljeve kundërshtuese ndërmjet individëve dhe grupeve të tyre.

SOLIPSIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *solus* "i vetëm" dhe *ipse* "vet" që në filozofi ka kuptim psikologjik. Solipsizmi është emërtim i qëndrimit të gabuar, sipas të cilit përvoja individuale është e vetmja së cilës njeriu mund t`i besojë. Bota e jashtme me të gjitha dukuritë e saj është vetëm përvojë e unit të njeriut, përkatësisht objekt i vetëdijes së njeriut**,** përkatësisht ajo që është fituar me anë të mendjes dhe të arsyes. Asgjë nuk ekziston përveç gjendjes dhe proceseve subjektive.

SOMATIK, - E. mb. Që i përket trupit, që është trupor dhe që vjen nga greqishtja *σωματικός* "trupor". Përcakton qelizat trupore të trupit të njeriut, krahas atyre riprodhuese. Mbiemri somatik qëndron përballë mbiemrit psikik, mendor si mbiemri fizik që nuk ka të bëjë me atë psikik e shoqëror. Raporti somatik – psikik, përkatësisht trupor – psikik apo mendor është ndër raportet më të ndërlikuara në teorinë e njohjes së realitetit.

SOMATIZIM, - I. m. Çrregullim fiziologjik trupor që karakterizohet nga shndërrimi i çrregullimeve psikike, në rend të parë, i përjetimeve emocionale në dhembje trupore. Të tilla janë ankesat për dhembje të duarve, të këmbëve, të kokës, të organeve të frymëmarrjes, të tretjes së ushqimit etj. Përjetimi i dhembjeve të tilla nuk ka bazë organike e fiziologjike, e pikërisht nuk dallohen simptoma të patologjisë organike. Megjithëkëtë, individët e somatizuar janë të preokupuar me gjendjen e tyre shëndetësore të karakterit fizik.

SOMATOTONI, - A. f. Kategori konceptuale e tipologjisë konstitucionale të strukturës së personalitetit (të temperamentit), sipas së cilës tiparet e personalitetit përcaktohen nga struktura e trupit të njeriut. Somatotonia është tipi i personalitetit me trup të zhvilluar me këto tipare karakteristike: aktiv, me prirje mbisunduese, me energji, me mungesë ndjenjash për të tjerët etj.

SOMATOTROPIN/Ë, - A. f. Hormon i rritjes së trupit që sekretohet nga pjesa e përparme e hipofizës. Zvogëlimi i sasisë së sekretuar të këtij hormoni shkakton pamundësinë e rritjes së duhur, ose sekretimi i një sasie të madhe somatotropine shkakton rritje të jashtëzakonshme të organizmit. Shih – ***AKROMEGALIA*.**

SOMNAMBULIZ/ËM, - MI. m. Term i psikiatrisë dhe i psikologjisë klinike me prejardhje nga latinishtja *somuns* "gjumë" dhe *ambulare* "shëtis", që ka kuptimin e shëtitjes, të ecjes së njeriut gjatë kohës kur ai fle. Somnambulizmi është formë e çrregullimit të lëvizjeve dhe e tërësisë së tyre që shfaqet në fazën e gjumit të njohur me shkurtesën NREM, përkatësisht jo REM ose fazë e gjumit të thellë, të cilën e karakterizon aktiviteti i valëve delta të trurit, qetësimi i lëvizjeve të syve, ritmi i rregullt i zemrës, frymëmarrja dhe niveli i ulët metabolik i organizmit. Njeriu në gjendje somnambulike ngrihet nga krevati, vishet me rrobat e ditës, del jashtë, shëtit në dritën e hënës dhe mund të zgjohet, po qe se ndodhet pranë dritës së fortë të reflektorëve, kur në ecje e sipër futet në ujë, kur dëgjon ndonjë zë të lartë etj., ose pas shëtitjes mund të kthehet në krevat dhe të vazhdojë fjetjen pas heqjes së rrobave. Pas zgjimit nuk i kujtohen aktivitete të tilla**.**

SOMNILOKUVI, - A. f. Term i ardhur nga përngjitja e fjalëve latinisht *somuns* "gjumë" dhe *lokui* "flas" që emërton dukurinë e të folurit në gjumë. Është dukuri e rrallë e të folurit të çrregullt me shfaqje të ëndrrave.

SOMNOLENC/Ë, - A. f. Gjendje e përgjumësisë së njeriut, që zgjat relativisht shumë kohë. Ka karakter patologjik dhe ka prirje për gjumë, pra priret nga dëshira e sëmurë për gjumë disaditor. Është pasojë e sëmundjes së mëlçisë, e tumorit, e sëmundjes së veshkave, por mund të shkaktohet edhe nga faktorët psikogjenë, si gjendja depresive, lodhja e madhe etj.

SOND/Ë, - A. f. Term që ka hyrë në psikologji nga mjekësia; i ardhur nga frëngjishtja *sonder* "kërkoj". Sonda është kampion ose gjedhe e përzgjedhur nga një popullatë, që shërben për një gjurmim të caktuar në psikologji; zbatohet në gjurmime eksperimentale të psikologjisë. Kështu, subjekteve u jepet të mësojnë për të mbajtur mend këtë radhë shkronjash: T, C, U, N, G, Dh, E, Z, M, P dhe pas përvetësimit të pagabueshëm të këtyre shkronjave nga subjekti kërkohet të riprodhojë se cila shkronjë ishte para shkronjës G ose pas kësaj shkronje.

SONDAZH, - I. m. Veprim paraprak i gjurmimit të një ndryshoreje psikike, që kryhet me qëllim të përgatitjes së plotë për gjurmimin kryesor të asaj ndryshoreje (të qëndrimeve, të synimeve etj.). Në këtë fazë vërtetohet ecuria, instrumentet e gjurmimit, rendi i zbatimit të tyre etj. Zbatohet më

tepër kur kemi të bëjmë me hulumtim temash komplekse, si: sjelljet e institucionalizuara, përplasje qëndrimesh politike, tensionesh shoqërore etj.

SONDI Leopold (Leopold SZONDI). Psikiatër dhe psikanalist zviceran me origjinë hebraike. Lindi në Njitri (Nitra) të Sllovakisë më 1893 dhe vdiq në Cyrih më 1986. U doktorua në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Budapestit. Në qershor 1944 u detyrua ta ndërpresë punën, pasi u burgos dhe e dërgua në kampin e përqendrimit nazist Bargen–Belzen (Bergen-Belsen). Në dhjetor 1944 u vendos në Zvicër, ku zhvilloi aktivitetin profesional ku dhe ngriti "Institutin Sondi" në Cyrih. Ishte nën ndikimin e fuqishëm të mësimeve të Zigmund Frojdit, të shkollës psikiatrike gjermane dhe të mësimeve nga gjenetika. Në zhvillimin e psikologjisë mbeti i njohur më tepër me konceptin e *Analizës së fatit – Schicksalsanalysse*. Kjo qasje psikanalitike ka të bëjë më tepër me analizën gjenealogjike të mbështetur në të pavetëdijshmen familjare. Sipas tij e pavetëdijshmja familjare me kodin e vet gjenetik është bazë e përzgjedhjes së profesionit. Afiniteti profesional mbështetet në shtytës siç e shpjegon dhe psikanaliza. Mbi këtë bazë ai hartoi një test të përbërë prej 80 fotografish të të sëmurëve mendorë. Me anën e zbatimit të këtij testi u orvat të nxjerrë nga personaliteti ndjenjën më të thellë, të fshehur në pavetëdijen e pacientit, duke analizuar posaçërisht reagimet emocionale në relacionin simpati-armiqësi. Këtë test e bëri të njohur dhe të famshëm përtej kufijve të Zvicrës. Në vitet e fundit të jetës ishte i mendimit se psikologjia duhet të merret më tepër me studimin e përmbajtjeve të pavetëdijshme. Por, sipas tij thelbësore dhe e dobishme do të ishte sikur psikologët të merreshin me të dy fushat. Veprat kryesore të tij janë: *"Schicksalsanalyse"* – (*"Analiza e fatit"*), 1944 *"Experimentelle Triebdiagnostik"* – (*"Diangostika eksperimentale e shtytësve"*), 1947.

SOPOR, - I. m. Term i psikiatrisë, i psikopatologjisë dhe i psikologjisë klinike, i ardhur nga latinishtja *sopor* "gjumë i thellë". Emërton formën e rëndë të çrregullimit të funksionit të vetëdijes, që manifestohet në rend të parë me pamundësinë e perceptimit dhe të të menduarit. Prej kësaj gjendjeje njeriu mund të dalë nga ngacmuesit shumë intensivë, si: të rrahurit e fytyrës me shuplakë, të lagurit me ujë të ftohtë, shpimi me gjilpërë etj. Pas kalimit të kësaj gjendjeje atij nuk i kujtohet gjendja paraprake dhe as ngacmuesit e ndryshimit të saj.

SOPORIFIK, - U. m. Medikament apo bar, marrja e të cilit shkakton përgjumësi. Zakonisht bëhet fjalë për barbituratet dhe narkotikët. Kuptimi i këtij termi shtrihet edhe në të folurin jointeresant, të përsëritur dhe të gjatë që i vë në gjumë të tjerët (në të folurin e përditshëm).

S – O – R. Formulë që vjen nga shkurtesat: S(timul) – O(rganizëm) dhe R(eagim). Modifikim i formulës së bihejviorizmit të hershëm S(timul) – R(eagim), duke përfshirë edhe rolin e faktorit të organizmit në kuptimin e gjerë të tij, për shpjegimin e proceseve psikike dhe të sjelljeve.

SPASTICIZ/ËM, - MI. Në patologji i ardhur nga latinishtja *spasmodicus*

"i spazmave, ngërç". Spasticizmi është term përmbledhës për forma të ndryshme të çrregullimit të lëvizjes së muskujve, të ngërçit dhe të paralizës së tyre. Ndër to dallohet forma e paralizës cerebrale. Shfaqet me zvogëlim të jashtëzakonshëm të kontrollit të lëvizjeve të vullnetshme dhe me paralizë të muskujve të gjymtyrëve, të syve dhe të gjuhës. Lidhet shpesh me dëmtimin e neuroneve të qendrave motorike të cipës së trurit të madh.

SPAZ/ËM, - MA. m. Ngërç i papritur i muskujve skeletorë dhe i organeve të brendshme ose i muskujve visceralë. Spazma mund të jetë klonike dhe tonike. Spazma klonike ka të bëjë me zëvendësim të kontraktit muskulor me atë relaksues, kurse ajo tonike i përket kontraktimit të përhershëm të muskulaturës.

SPECIFIK, - E. mb. I ardhur nga latinishtja *species* "lloj, (i, e) veçantë" që përcakton tërësinë e veçorive përcaktuese të një dukurie, gjendjeje, objekti etj. Në psikologji emërtohet subjekti karakteristik, në analizën faktoriale përcaktohet faktori i pavarur, që nuk lidhet me të tjerët.

SPEKT/ËR, - RI. m. Term i fizikës me shtrirje përdoruese edhe në psikologji, i ardhur nga latinishtja *spectrum*. Ka kuptim të përgjithshëm sipas emërtimit "spektër veprimi". Në psikofizikë ka gjetur përdorim më tepër në emërtimin e ndijimeve pamore dhe dëgjimore të shkaktuara nga ngacmuesit fizikë. Kështu spektri akustik i dëgjimit shtrihet prej tingullit më të ulët (rreth 16 – 20 Hz) deri në atë më të lartë (rreth 20.000 Hz), i pranuar për veshin e njeriut; spektri i ngjyrave është brez ngjyrash i përbërë nga zbërthimi i ngjyrës së bardhë, kur kjo kalon nëpër prizmin optik dhe përftohet brezi i përbërë i ngjyrave; vjollcë, blu, e kaltër, e gjelbër, e portokallinjtë, e deri në ngjyrën e kuqe. Secila nga ngjyrat e përmendura ka gjatësi të caktuar të valëve elektromagnetike prej rreth 380 – 740 nm.

SPEKTRI AUDITIV. Fusha e shtrirjes së dëgjueshmërisë së zërave nga ana e njeriut. Fusha dëgjimore ose spektri auditiv normal i njeriut shtrihet prej rreth 20 Hz deri në 20.000 Hz.

SPEKTROGRAF, - I. m. Instrument i paraqitjes pamore të tri cilësive të zërit; të kohës së zgjatjes të frekuencave dhe të intensitetit të zërit. Në psikologji përdoret më tepër për të provuar perceptimin e të folurit me zë**.**

SPEKTROSKOP, - I. m. Instrument i zbërthimit të dritës në përbërës të saj nga valët elektromagnetike me gjatësi të caktuar. Ky instrument përbëhet kryesisht nga prizma optike.

SPENSER Herbert (Herbert SPENCER). Filozof dhe sociolog anglez me ndikim në zhvillimin e psikologjisë së shekullit të nëntëmbëdhjetë. Lindi në Derby më 27.04.1820 dhe vdiq në Brighton (Sussex) më 8.12.1903. Pikëpamjet e tij për zhvillimin e qenieve i ka mbështetur në zhvillimin evolutiv të tyre, madje këtë e ka theksuar para Çarls Darvinit. Duke u nisur nga ky qëndrim i përgjithshëm ai përcaktoi edhe detyrën e filozofisë: zbulimin e ligjeve gjithëpërfshirëse të zhvillimit të gjithësisë. Zhvillimin evolutiv të shoqërisë e krahasonte me zhvillimin evolutiv të organizmit të njeriut, ku mbisundon parimi zhvillimor që

kryhet brenda dy proceseve: Procesit të diferencimit dhe procesit të integrimit. Këtij parimi dhe këtyre proceseve i nënshtrohet i tërë zhvillimi organik, social dhe psikik. Proceset psikike i nënshtrohen përshtatjes së kushteve, rrethanave dhe raporteve të mjedisit dhe ky proces po ashtu ka të bëjë me ligjin e ruajtjes së materies dhe të energjisë, sipas të cilit asgjë nuk humbet e zhduket, por shndërrohet nga një energji në tjetrën. Proceset psikike zhvillohen nga diferencimi dhe integrimi i brendshëm, duke pasuar zhvillimet gjithnjë e më të ndërlikuara të tyre. Një zhvillim i tillë udhëhiqet nga sistemi nervor. Sipas tij ashtu si zhvillimi i organizmit dhe ai i psikikës kryesohet nga sistemi nervor, ashtu edhe zhvillimi i klasave më të ulëta shoqërore drejtohet nga klasa më e lartë e tyre. Veprat kryesore të tij janë: "*Social Statics*" – (*"Statika Sociale"*), 1850; "*First Principles*" – (*"Parimet e para"*), 1862; *"Principles of Biology"* – (*"Parimet e biologjisë"*), 1864 – 1867; *"Principles of Psychology"* – (*"Parimet e psikologjisë"*), 1872; "*The Stady of Siciology*" – (*"Studimi i sociologjisë"*), 1873; "*Principles of Sociology*" – ("*Parimet e sociologjisë*)", 1876 – 1896; "*Principles of Ethic*" – ("*Parimet e etikës*"), 1879 – 1893; *"Man versus State"* – (*"Njeriu kundër shtetit"*), 1884.

SPERM/Ë, - A. f. Term i embriologjisë i ardhur nga greqishtja *σπέρμα* "farë" që përfaqëson një varg qelizash mashkullore seksuale, që zhvillohen në lëngun seminal dhe përmbajnë spermatozoide. Te qeniet e ndryshme të gjalla ka përbërje, formë dhe vitalitet të ndryshuar. Përbëhet nga koka, qafa dhe bishti i gjatë.

SPERMATOGJENEZ/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *σπερμα* "farë" dhe *τογόνος* "lindje". Procesi i zhvillimit dhe i formimit të spermatozoidëve, farës së qelizave seksuale mashkullore.

SPIKATJ/E, - A. f. Orvatje e qëllimshme e njeriut për të bërë dallimin, për ta shkoqitur, shquar dhe theksuar objektin, qëndrimin, sjelljen etj. e një individi nga të tjerët në një grup social, në një mjedis shoqëror, në një mjedis punëtorësh të një sektori sekret etj. Në psikologjinë e emocioneve spikat burrëria, guximi, trimëria etj., ose frika, pabesia, tinëzia etj.

S

SPINA BIFIDA. Term i patologjisë i ardhur nga latinishtja *spina bifida*. Ka kuptimin e zhvillimit me të meta të kanalit të shpinës, përkatësisht të shtyllës kurrizore. Kjo e metë zakonisht shfaqet me mbyllje të pjesshme ose të plotë të shtyllës kurrizore, me rastin e së cilës zmadhohet sasia e lëngut trunor në kafkë. Ka disa pasoja, nga të cilat dallohet pengesa në ecje dhe në kontrollin e lëvizjeve të këmbës, që mund të përfundojë në paralizë muskulore të këmbëve.

SPINAL, - E. mb. E shtyllës kurrizore, që ka të bëjë me shtyllën kurrizore, që përcakton atë që i përket shtyllës kurrizore: ganglionet spinale ose të shtyllës së kurrizit, nervat spinale etj. Shih – ***SHTYLLA KURRIZORE.***

SPIRITIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *spiritus* "frymë, shpirt". Besimi në shpirtra, besimi se matanë varrit ekziston një botë shpirtrash dhe besimi në mundësinë e komunikimit të njerëzve të gjallë me shpirtra të vdekur, duke shfrytëzuar ndërmjetës. E tillë është vetëm fryma me të cilën ka

të bëjë njeriu. Gjuhëtari shqiptar Selman Riza ishte i mendimit se fryma e njeriut është mendja dhe shpirti i tij. Besimi i tillë ka marrë karakterin e një doktrine, qysh kur këtë e themeloi mendimtari Alan Kardek (Allan Kardec, 1857 – 1909).

SPIRMAN Çarls (Charles SPEARMAN). Psikolog dhe psikometrist anglez. Lindi në Londër më 1863 dhe vdiq më 1945, po në Londër. Ka shërbyer si oficer në ushtrinë britanike. Më pas, në moshën 34-vjeçare, ndoqi mësimet e Vilhelm Vuntit në Lajpcig dhe më 1904 mbrojti doktoratën pranë tij me temë "Mbi perceptimin special". Më pas ndoqi me kujdes zhvillimin e gjurmimeve dhe të rezultateve hulumtuese të shkollës së Virzburgut për mendimet dhe shkollën e Berlinit për perceptimin, por nuk la pas as studimet e filozofisë. Nga viti 1911 punoi si profesor i psikologjisë në kolegjin universitar. U mor me studimin e aftësive dhe me përsosjen e metodave psikometrike të zbatuara në gjurmimin e strukturës së aftësive dhe matjen e zhvillimit të tyre. Është e njohur formula Spirman e korrelacionit. Nga rezultatet e gjurmimeve konceptoi teorinë e njohur bifaktoriale të inteligjencës, rrjedhimisht identifikoi faktorin e përgjithshëm (*faktorin e përgjithshëm g*) (gjeneral) të inteligjencës dhe faktorët specialë (*faktorët s*). Këtë e publikoi në fillim në revistën "The American Journal of Psychology", 1904. Veprat kryesore të tij janë: "*The abilities of man: Their Nature and Measurement*" – (*"Aftësitë e njeriut: Natyra dhe matja e tyre"*), 1927; "The Theory of Two Factors" – ("*Teoria e dy faktorëve*"), Psych. Rev. 1914, 21, 101 - 115; *"Creative mind"* – (*"Mendimi kreativ"*), 1930 etj.

SPITALI SALPETRIER Spital i njohur në Paris, prej nga doli edhe termi i shkollës psikiatrike dhe psikopatologjike të Parisit, që nga shekulli i nëntëmbëdhjetë. u bë I famshëm me punimet dhe me mënyrën e të menduarit për hipnozën dhe për histerinë nga ana e studiuesve francezë: psikiatrit Filip Pinel (Philippe Pinel, 1745- 1826), neurologut Zhan Maren Sharkot (Jean Martin Charcot, 1825 – 1893) dhe psikiatrit Pjer M. Feliks Zhanet (Pierre M. Felix Janet, 1859 – 1947). Pikëpamja e përgjithshme e kësaj shkolle për çrregullimet dhe sëmundjet psikopatologjike mbështetet në parimet neurologjike të këtyre çrregullimeve dhe sëmundjeve psikike. Më vonë u ndeshën edhe çrregullime e sëmundje psikike pa bazë neurologjike.

SPONTANITETI PSIKIK. Veprimtari e vetvetishme, e paqëllimshme dhe e paorganizuar. E tillë është veprimtaria e papërgatitur fare nga ana e një subjekti të caktuar, por e shfaqur papritmas, duke mos pasur shkak të posaçëm të paraqitjes dhe të zhvillimit të saj. Psikanaliza pohon të kundërtën: nuk ka asnjë proces psikik, asnjë sjellje, asnjë veprim që nuk është i shkaktuar nga një shtytës, nga një motiv. Ky duhet gjurmuar dhe duhet identifikuar për të mundësuar e shpjeguar sjelljet dhe veprimet e njeriut. Shih – ***MOTIVACIONI I PAVETËDIJSHËM.***

S Q 3 R. Formulë empirike e të mësuarit të suksesshëm, e formuar nga shkronjat e para të fjalëve në anglisht: S(urvey) "vështroj", Q(uestion) "pyetje", R(ead) "lexoj", R(epite) "përsëris", R(eview) "rishikoj". Sipas kësaj formule, lënda që duhet mësuar

vështrohet së pari duke u lexuar me përpikëri për t`u fituar pasqyra e qartë e përmbajtjes së saj dhe e asaj që është thelbësore në përmbajtjen e tillë; më pas hartohen pyetjet që kërkojnë përgjigje të saktë. Mandej, lënda lexohet rishtas me qëllim që të jepet përgjigje për pyetjet e parashtruara, pa humbur qëllimin kryesor: lënda lexohet me qëllim të përvetësimit të saj, pastaj lënda përsëritet me zë pjesë–pjesë dhe më në fund riprodhohet e tëra me zë. Studiuesi i psikologjisë së të mësuarit, psikologu amerikan Eduard S. Robinson (Edward S. Robinson, 1910 – 1930) kësaj formule i ka dhënë karakterin e metodës sistemore të të mësuarit të suksesshëm.

SQARIM, - I. m. Veprim i organizuar dhe i qëllimshëm intelektuaL, i cili kryhet për njohjen e plotë dhe shpjegimin e hollësishëm të përmbajtjes së një çështjeje të mësuar, të përbërësve, sidomos të lidhjeve ndërmjet përbërësve të asaj çështjeje.

SQIM/Ë, - A. f. Qëndrim dhe prirje e formuar gjatë socializimit, që ka të bëjë me vlerësimin e tepruar të vetes dhe të tipareve të tij, duke bërë përpjekje të qëndrueshme për t`u shfaqur me sjellje, me pikëpamje e me qëndrim mbi të tjerët. Sqima ka përmasë motivuese, sepse e nxit nga brenda njeriun për të ndërmarrë veprime të dallueshme nga të tjerët. Sqima mbështetet në vlerat që ai beson se i ka, kurse në realitet ato janë vlera të supozuara dhe, si të tilla, këto vlera janë të njohura për mjedisin shoqëror. Sqima është term që haset rrallë në tekstet psikologjike.

STABILIMET/ËR, - RI. m. Instrument për matjen e qëndrueshmërisë organike të organizmit, i përdorur kryesisht te njeriu. Përdoret duke matur lëkundjet e organizmit, derisa ai rri plotësisht i shtrirë, i qetë e me sy të mbyllur. Në rastet e tilla stabilimetri mat numrin e lëkundjeve të organizmit.

STANDARD, - I. m. I ardhur në shqip nga anglishtja *standard* "masë e verifikuar, e pranuar nga mjedisi shoqëror". Në bazë të standardit krahasohet dhe vlerësohet cilësia e një pune, sjelljeje, e përvetësimit të dijeve etj. Duke u nisur nga standardi pritet shfaqja e një veprimi, e një sjelljeje në kohën e caktuar.

STANDARDIZIM, - I. m. Procesi dhe procedurat e zbatuara të përcaktimit dhe të zbatimit të standardeve të përkufizuara në një fushëveprim të caktuar. Termi standardizim nënkupton tërësinë e përcaktimeve të detyrave, të mënyrave, të teknikave të vlerësimit, të metodave të evoluimit dhe të interpretimit të rezultateve. Përdoret më tepër në procesin e krijimit të testeve të vlefshëm dhe të sigurt.

STANDARDIZIMI I TESTEVE. Procesi i përcaktimit të detyrave dhe problemave testore, i mënyrës së dhënies dhe zbatimit të testeve, përcaktimi i vlerësimit, i evoluimit të rezultateve dhe i interpretimit të tyre. Standardizimi i testeve kërkon njohuri të gjera dhe të thella psikologjike e psikometrike dhe një përvojë të duhur.

STATISTIK/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja që ka përdorim të përgjithshëm dhe të veçantë. Në të folurin e përditshëm statistika ka kuptimin e paraqitjes së rezultateve të matjes së një dukurie, ndryshoreje etj. Termi

statistikë përdoret më shumë me kuptimin e veçantë. Emërton atë degë të matematikës (në disa vende e konsiderojnë disiplinë të veçantë shkencore), që merret me studimin e anës sasiore të dukurive masive dhe të raporteve ndërmjet tyre, duke mbledhur, përpunuar dhe paraqitur të dhënat numerike me anë të numrave. Statistika ka metodologji të përpunuar dhe gjurmimet masive janë të pamundshme pa zbatimin e saj.

STATISTIKA INDUKTIVE. Procedura statistikore dhe procesi i të menduarit induktiv me anën e të cilit hulumtuesi nxjerr gjykimin përfundimtar ose konkluzionin, duke konstatuar raportet thelbësore të të dhënave të një grupi subjektesh, duke përgjithësuar mendimin për të gjithë subjektet e asaj klase, të atij grupi, të asaj kategorie etj.

STATISTIKA INFERENCIALE. Term me origjinë latine që emërton atë degë të statistikës, e cila merret me përcaktimin e shkallës së besueshmërisë, sipas së cilës konkluzioni i arritur nga të provuarit e gjedhes së subjekteve të caktuara ka vlerë për gjithë popullatën, nga e cila janë përzgjedhur përfaqësuesit gruporë të asaj popullate.

STATISTIKA PARAMETRIKE. Pjesë e statistikës, e cila mbështetet në shpërndarjen e të dhënave nga matja e një ndryshoreje psikologjike, kur ato të dhëna janë të shpërndara në formë të lakores normale kumbonare. Metodat dhe teknikat e statistikës parametrike që zbatohen, kur janë të shpërndara në formën kumbonare, kërkojnë që: anëtarët e modelit të përzgjedhur të jenë të përzgjedhur në mënyrë objektive, të pavarur nga asnjë kusht, të kenë të njëjtin raport të njohur të variancës dhe të dhënat të jenë të atilla që të mundësojnë zbatimin e operacioneve matematikore. Në metodat dhe teknikat e statistikës parametrike hyjnë analiza e variancës, analiza regresive, analiza kanonike etj. Mbi rezultatet e arritura nga zbatimi i metodave dhe teknikave të statistikës parametrike mund të nxirren përfundime me shkallë të lartë besueshmërie për të gjithë popullatën e caktuar. Me këtë rast mesatarja aritmetike dhe shmangia standard janë parametra që kryesisht karakterizojnë popullatën e tërësishme.

STATISTIKA PËRSHKRIMORE. Pjesë e statistikës, e cila shërben për përshkrimin sasior të një dukurie psikike të matur. Statistika, sidomos ajo përshkrimore, zbatohet në përgjithësi më tepër në matjen e dukurive brenda gjedhes ose kampionit, duke synuar të paraqesë saktësisht gjendjen e saktë sasiore të një ndryshoreje psikologjike, të matur te pjesëtarët e atij kampioni. Sa më i madh të jetë kampioni, aq më të besueshme janë edhe vlerat numerike që duhet të përfaqësojnë gjithë popullatën. Në statistikën përshkruese bëjnë pjesë këto procedura statistikore: mbarështrimi i vlerave statistikore, klasifikimi i tyre, mesatarja aritmetike, mesorja, modi, shmangia mesatare, shmangia kuadratike etj. Por, në psikologji, rrallë mund të matet ndryshorja psikologjike te të gjithë anëtarët e popullatës. Për këtë shkak duhen zbatuar procedurat e statistikës shpjeguese.

STATISTIKA PSIKOLOGJIKE. Metodologji me anën e së cilës maten funksionet psikike, strukturat dhe proceset e tyre, si edhe ndryshoret

gjurmuese me qëllim të vlerësimit të përmasave zhvillimore e funksionale të tyre, si edhe të karakteristikave sasiore dhe të raporteve ndërmjet tyre. Të këtilla janë më shpesh matja e shtrirjes dhe e intensitetit të një ndryshoreje, e dendurisë sasiore të paraqitjes së cilësive të ndryshoreve etj. Shih - ***PSIKOMETRIA.*** Statistika psikologjike mund të jetë përshkruese apo deskriptive dhe konkluduese ose inferenciale. Statistika përshkruese ka të bëjë me përcaktimin e vlerës së mesme të rezultateve të një kampioni ose grupi përfaqësues, si edhe të shkallës së shmangies së vlerave sasiore individuale nga vlera e mesme. Statistika inferenciale merret me nxjerrjen e atyre përfundimeve nga matja e ndryshoreve në një kampion ose gjedhe që kanë vlerë për të gjithë popullatën (shpesh të pamundur për ta matur të gjithë ndryshoren provuese). Këtu bëjnë pjesë metoda e gabimit standard, momenti kritik, hipoteza fillestare dhe vërtetimi ose mosvërtetimi i saj. Në statistikën psikologjike zbatohet edhe statistika parametrike dhe ajo joparametrike, Statistika parametrike ka të bëjë me operacionet matematikore dhe me zbatimin e dendësive të tyre që kanë shpërndarje normale. Statistika joparametrike ka të bëjë me studimin e përmasave sasiore të një ndryshoreje psikologjike, e cila ka përmasa të dendësive të shpërndara jo sipas ligjeve të shpërndarjes normale.

STATUSI SHOQËROR. Shkalla e prestigjit që gëzon individi i një anëtari të grupit shoqëror, të fituar në bazë të angazhimit, të fitimit të të drejtave nga pozita që ai anëtar zë në strukturën e atij grupi shoqëror.

STENIK, - E. mb. I ardhur nga greqishtja *στενός* "forcë" që përcakton rolin e forcës mobilizuese dhe ndikimin e disa ndjenjave që shfaqen në kushte të veçanta të zhvillimit të veprimtarisë së njeriut. E tillë është ndjenja e suksesit të arritur, e cila e shtyn individin të punojë edhe më intensivisht për të arritur suksese edhe më të mëdha.

STEREOAGNOZI, - A. f. Verbim taktil, verbim i lëkurës që shfaqet me humbjen e aftësisë së njohjes të trupave, të formës, të madhësisë dhe të gjendjes së tyre me anë të lëkurës. Stereoskopia në shumë raste plotësohet me aftësinë e të parit. Është gjendje patologjike që shkaktohet nga dëmtimi cerebrospinal.

STEROIDET. m. Substanca hormonale e gjëndrave seksuale dhe e atyre mbiveshkore që shkrihen në yndyra. Qelizat nervore të lidhura me receptorë i absorbojnë lehtë dhe shpejt këto substanca. Këto substanca kryejnë funksionin e zhvillimit të strukturës muskulore të organizmit, e cila ka mundësi të zhvillohet me marrjen e asteroideve artificialë, duke mos keqpërdorur përdorimin e tyre.

STEREOSKOP, - I. m. Aparat pamor në të cilin figura e sendit të paraqitur në të duket në trajtë reliefi në kushte të posaçme. Stereoskopi ka dy qelqe me thjerrëza specifike nga një për secilin sy, që mund të lëvizin në drejtim përpara-mbrapa. Kur figura e njërit sy përputhet me figurën e syrit tjetër, atëherë perceptohet thellësia e trupit të paraqitur në formë figure. Kjo ndodh atëherë, kur dy okularë janë të larguar njëri nga tjetri saç është largësia e njërit sy nga syri tjetër.

STEREOTIPI, - A. f. I ardhur nga përngjitja e fjalëve në greqisht *στερεό* "i (e) fortë, i ashpër" dhe *τυπος* "vulë". Stereotipia është term përmbledhës për një tërësi përfytyrimesh e qëndrimesh të thjeshta, për sjellje relativisht të pandryshueshme të njeriut ndaj pjesëtarëve të një grupi tjetër etnik, fetar e shoqëror, të formuar gjatë socializimit të njeriut, sidomos në edukatën familjare autoritative. Stereotipitë janë zhvilluar në bazë të mendimit dhe përvojës jokritike, si edhe të bindjes negative të përgjithësuar. Të tilla janë mendimet e përgjithësuara: "Gruaja e fut burrin në shishe", "Burrat janë të fuqishëm dhe të vrazhdë" etj. Kur përfytyrimet, qëndrimet dhe sjelljet stereotipe janë të përqendruara dhe të drejtuara ndaj një grupi të caktuar etnik, fetar, racor etj., atëherë këto i përngjajnë shumë paragjykimeve. Stereotipet shtrembërojnë perceptimin dhe pengojnë vlerësimin real të pjesëtarëve të grupeve dhe të sjelljeve të tyre.

S

STEVANOVIQ Borisllav (Borislav STEVANIVIĆ). Psikolog jugosllav. Lindi më 1891 dhe vdiq më 1971. Studioi dhe përfundoi studimet për psikologji në Universitetin e Kembrixhit në Londër. Ka shërbyer si financier i Oborrit Mbretëror të Serbisë. U doktorua me mbrojtjen e suksesshme të tezës "An Experimental Study of the Mental Processes Involved in Jugemend" – "Studim eksperimental i procesit të formimit të koncepteve", 1926. Ka qenë themelues i Seminarit të Psikologjisë Eksperimentale në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit, që më vonë, më 1950, u shndërrua në degë të psikologjisë, ku kryen studimet e psikologjisë disa shqiptarë nga Kosova. Ka pasur një kulturë të lartë të psikologjisë eksperimentale të drejtimit të Britanisë së Madhe (ka mbrojtur doktoratën te Çarls Spirman). Drejtoi veprimtarinë studimore për përshtatjen e shkallës Bine – Simon të fëmijëve të kombësisë serbe. Ky studim u botua me titullin "Rishikimi beogradas i shkallës Bine – Simon" – ("Beogradska revizija Bine – Simonove skale"). Akademik i Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve. Ka qenë ndër 215 "kapllarët" e ushtrisë serbe që kaluan nëpër tokat shqiptare pas vitit 1913 duke mbetur të njohur me "trazirën" e madhe ndaj popullsisë shqiptare. Veprat kryesore të tij janë: *"Beogradska revizija Bine – Simonove skale"* – (*"Rishikimi beogradas i shkallës Bine – Simon"*), Beograd, 1934; *"Merenje inteligencije"* – (*"Matja e inteligjencës"*), Beograd, 1937*; "Socijalna kulturno – sredina i umna obdarenost u odredjivanju doba uzrelosti"* – (*"Mjedisi social- kulturor dhe dhuntia natyrore në përcaktimin e kohës së pjekurisë mendore"*), Beograd, 1940; "*Ucenje i pamcenje"* – (*"Të mësuarit dhe kujtesa"*), Kragujevac, 1953 (u përkthye në gjuhën shqipe më 1964); *Pedagoska psihologija"* – (*"Psikologjia pedagogjike"*), Beograd, 1955 (u përkthye në gjuhën shqipe më 1957).

STËRMUNDIM, - I. m. Lodhje fizike dhe mendore ose e kombinuar përtej mase, gjendje në prag të shterimit të fuqisë fizike të muskujve të organizmit të njeriut në një punë të gjatë që kërkon energji fizike apo trupore. Stërlodhja mendore është stërlodhje subjektive, më tepër ndjenjë e pamundësisë për të vazhduar më tutje angazhimin në të mësuar, në zgjidhje të situatave

mendore, në shkrime imagjinuese etj. Shih – ***RRASKAPITJA.***

STËRVITJ/E, - A. f. Tërësi ushtrimesh të organizuara me plan, që kryhen sipas udhëzimeve të posaçme nga ana e individëve dhe nën udhëheqjen e një eksperti për veprimtari të caktuara. Këto kanë për qëllim përvetësimin e shprehive të ndryshme në fushën profesionale të punës, të sportit, të shërbimit ushtarak etj. Termi përdoret më tepër për të emërtuar formimin e shprehive. Të tilla janë: shprehia e të folurit të një gjuhe të huaj, e përdorimit të saktë të mitralozit, e të shkruarit në kompjuter etj. Stërvitjet janë kusht i domosdoshëm për formimin e shprehive, për zhvillimin e shkathtësive e të disa cilësive të trupit, të disa proceseve psikike (motorike, intelektuale, perceptive dhe vetive psikike). Bazë e ushtrimeve janë përsëritjet e veprimeve, të cilat nuk duhet të jenë shumë të shpeshta dhe as shumë të rralla, por duhet të organizohen me pauza të përcaktuara kohore dhe me shkallën optimale të shpeshtësisë së përsëritjeve. Organizohen deri në shkallën e përvetësimit të plotë të një shprehie dhe të ekzekutimit të pagabueshëm të saj.

STËRVITJA E KUJTESËS. Zhvillimi i aftësisë së të mbajturit mend, të rinjohjes dhe të riprodhimit të përmbajtjeve që mësohen në bazë të përgjithësimit të diturisë e të përvojës për metodat, kushtet, parimet e për rregullat më produktive në të mësuarit dhe në të mbajturit mend sa më mirë, sa më gjatë dhe sa më lehtë. "Kujtesa nuk ushtrohet si organ, por ushtrohen veprimet e të mësuarit, për të mbajtur mend më lehtë dhe për një kohë të gjatë atë që mësohet".

STËRVITJA E TË MENDUARIT. Zhvillimi i procesit të mendimit në bazë të përsosjes së mënyrave, se si të mendohet logjikisht e drejt dhe bartja e mendimeve, e parimeve dhe e përvojës së përgjithësuar së të menduarit logjik e të drejtë prej një fushëveprimi në fushëveprimin tjetër, duke e ngritur gjithnjë në nivel më të lartë të menduarit si procesi më i lartë intelektual. Mënyrat, parimet dhe përvoja e tillë ka të bëjë me zhvillimin e interesimeve, të qëndrimeve, të synimeve, ku duhen gjurmuar gjithnjë lidhjet dhe raportet ndërmjet të dhënave, duke dalluar ato parësore prej atyre dytësore e të parëndësishme, si edhe verifikimin e pohimeve ose të mohimeve me argumente bindëse.

STËRVITJA E TË PERCEPTUARIT. Zhvillimi i procesit të vëzhgimit të objekteve, të dukurive, të raporteve etj. në bazë të përvetësimit të metodave dhe të parimeve të përvojës, se si duhet vëzhguar për ta rrokur, për ta njohur dhe për ta perceptuar sa më mirë dhe sa më shpejt objektin, dukurinë etj. dhe në bazë të bartjes dhe zbatimit të tyre në perceptimin e objekteve dhe të dukurive të tjera.

STIGM/Ë, - A. f. Fjalë e terminologjizuar e greqishtes *στίγμα* "damkë, njollë, shenjë". Stigma është shenja e pazakonshme morfologjike e trupit, zakonisht e lëkurës, por jo vetëm e saj. Stigma ose shenja të tilla trupore mund të jenë: albinizmi, deformimi i buzëve, i formës së kokës, i syve etj. Shenjat e këtilla janë simptoma të një gjendjeje degjeneruese të indeve, por të parrezikshme. Disa prej tyre janë të lidhura me simptomat e ndonjë çrregullimi psikik. Kohët e fundit është

zgjeruar kuptimi i stigmave, përkatësisht e shenjave të tilla, duke shtrirë kuptimin e vet edhe në fushën sociale e morale. Ata që marrin damkë, stigmë ose shenja morale (droga, krimi, prostitucioni etj.) pësojnë efekte sociale negative në mjedisin e tyre kulturor.

STIGMATIZ/ËM, - MI. m. Damkosja e hapët që i bëhet njeriut nga ana e të tjerëve, të cilët, në bazë të një shenje deformimi fizik ose të sjelljes amorale, kanë qëndrim të përgjithshëm degjenerues për atë njeri.

STIL, - I. m. Term i teorisë së letërsisë, që ka shtrirje kuptimore në psikologji dhe është i ardhur nga latinishtja *style* "shkop i vogël me majë të mprehtë". Stili në psikologji është veçantia e sjelljeve, e mënyrave dhe e mjeteve që njeriu përdor gjatë punës në fushëveprimin profesional të tij (në të folur, në sjellje, në të shkruar etj.).

STILI I JETËS. Sjellje karakteristike, relativisht e qëndrueshme e një individi. Këtë e përbëjnë interesimet individuale, motivet, qëndrimet, vlerat karakteristike të një individi. Termi stili i jetës i përket psikologjisë individuale të psikiatrit austriak Alfred Adler (Alfred Adler, 1870 – 1937).

STILI KOGNITIV. Mënyrë e posaçme e qasjes së problemeve dhe zgjidhjes së tyre nga ana e secilit individ. Disa individë i qasen sistematikisht perceptimit të drejtë dhe zgjidhjes së problemeve, disa i qasen zgjidhjes në mënyrë analitike, të tjerët në mënyrë sintetike; disa janë të ngadalshëm në procesin e kuptimit të problemeve e zgjidhjes së tyre, disa janë të shpejtë etj. Në këtë pikëpamje kemi mënyra të ndryshme individuale të angazhimit të proceseve kognitive dhe të organizimit të sjelljeve personale në perceptimin, në trajtimin e çështjeve problemore dhe në zgjidhjen e tyre. Dallimet e tilla kanë karakter individual në mjedisin kulturor të një bashkësie; ato janë të dukshme te pjesëtarët e gjinive, të moshave të ndryshme, si edhe ndërmjet anëtarëve të shoqatave profesionale.

STIMUL, - I. m. Term i stabilizuar në tekstet e psikologjisë në gjuhët anglosaksone që ka prejardhje nga e njëjta fjalë latine, që në gjuhën tonë shqiptohet nxitës. Stimuli ka kuptimin e shtrirë gjerësisht në psikofizikë, në psikologjinë e personalitetit, të punës, të sportit etj. Emërton çdo objekt, energji ndikuese të tij në shqisa, fjalë, ngjarje, situata, ndryshim të situatës etj. që nxit sjelljen e organizmit, ndryshon reagimin e tij, që vë në veprim receptorët e shqisave etj. Stimujt mund të jenë të brendshëm dhe të jashtëm, por karakteristika thelbësore e tyre është efekti që këta shkaktojnë në organizëm, në shqisa, në gjymtyrë etj. të tij. Shih – ***NXITËSI.***

STIMULANT, - I. m. Droga në forma dhe struktura të ndryshme, të cilët ngacmojnë dhe nxisin aktivitetin e sistemit nervor simpatik, duke zhvilluar energji të jashtëzakonshme, të shoqëruar me ndjenjën e optimizmit të pamasë.

STIMULIM, - I. m. Nxitja e aktivitetit të caktuar të organizmit, fuqizimi i këtij aktiviteti, ndryshimi i drejtimit të tij etj. i shkaktuar nga nxitësit biologjikë, fizikë, shoqërorë etj. Në fillim të zhvillimit të psikologjisë empirike termi stimul u përdor për të emërtuar ndikimin që ushtron forma e caktuar e

energjisë fizike, e ndryshimit të mjaftueshëm të intensitetit të saj, si edhe ndryshimi i llojit të kësaj energjie në reagimin receptor të një shqise të caktuar. Për këtë shkak bëhet fjalë për stimujt përkatës e jopërkatës. Stimuj përkatës janë të gjithë ata, që shkaktojnë reagim vetëm të një shqise të caktuar (drita për syrin, zëri për veshin, energjia termike e trupit për lëkurën etj.). Stimuj jopërkatës janë të gjithë ata trupa, energjia fizike e të cilëve shkakton ndijim te shqisa jopërkatëse. Stimulimi shoqëror është sjellje ndikuese e një anëtari të grupit shoqëror në zhvillimin e sjelljes së një individi tjetër ose në ndryshim të saj**.**

STRABIZ/ËM, - MI. m. Term i anatomisë së syrit dhe i psikologjisë fiziologjike i ardhur nga greqishtja *στραβισμός* "vëngëri". Strabizmi është çrregullim i lëvizjeve të syrit. Shih – ***VËNGËRIA*.**

STRATEGJI, - A. f. Term i prejardhur nga greqishtja që u përdor në lëvizjet ushtarake dhe shtriu kuptimin e vet edhe në psikologji. Strategjia është plani i hartuar me qëllim të caktuar, sipas të cilit mendja e njeriut vepron drejt zgjidhjes së një problemi apo situate problemore. Ky term u përdor edhe në veprat e Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) për të emërtuar procesin e pavetëdijshëm të të kaluarit me dinakëri të energjisë së shtytësve të idit mbi atë të egos**.**

STRATEGJIA E MBIZOTËRIMIT. Udhërrëfyes i zotërimit të vetëdijshëm të frikës dhe ngarkesave psikike të jetës së përditshme, që shfaqen sidomos me rastin e ballafaqimit me pengesa fizike, shoqërore e psikike gjatë synimit të arritjes në një qëllim apo objektiv. Termi përdoret më shumë për zotërimin e ankthit, duke u angazhuar me gjetjen e formave dhe mjeteve të sjelljeve për t`iu kundërvënë pengesave. Kështu, studenti i frikësuar nga provimi mëson shumë për të mos përjetuar ankth gjatë përgjigjeve në pyetjet provuese.

STRATEGJIA E REAGIMEVE TË PAPAJTUESHME. Teknikë e luftimit të sjelljeve agresive. Ky term u përdor në literaturën e re të psikologjisë e të psikoterapisë. Kjo strategji ka të bëjë me ekspozimin e njeriut ndaj dy ngacmuesve që shkaktojnë ndjenja të kundërta: ndjenja e dashurisë seksuale dhe ajo e humorit ushtrojnë ndikim në procesin e frenimit dhe të luftimit të sjelljeve agresive, përshkrimi i konfliktit ndërmjet dy individëve në mënyrë komike etj.

STRATIFIKIM, - I. m. Term që ka për bazë fjalën latine *stratum* "shtresë". Stratifikimi ka të bëjë me përzgjedhjen e kampionit ose gjedhes së popullatës të shtresave të ndryshme në atë mënyrë që përzgjedhja e kampionit të jetë përfaqësuese e shtresave të popullatës. Kështu, studentët me arritje pozitive mund të jenë me arritje të kënaqshme, të mirë, shumë të mirë dhe shkëlqyeshëm. Kampioni gjurmues në psikometri duhet të ketë përfaqësues të barabartë të të gjithë këtyre studentëve me arritje të ndryshme në zotërimin e lëndëve studimore.

STRATUM, - I. m. Grupe shtresash të ndryshme të ndara nga masa statistikore. Këto mund të jenë dy ose më shumë, si: femra – meshkuj, të dobët – të mirë – shumë të mirë, jo të ngathët – pak të ngathët, të ngathët, shumë të

ngathët etj. Numrin e shtresave apo stratumeve e përbën natyra e çështjes studimore dhe qëllimi i studiuesit.

STRES, - I. m. I ardhur nga anglishtja *stress* e i ngulitur në gjuhën e veprave psikologjike. Stresi është reagimi i organizmit ndaj situatave ngacmuese të rrezikshme e tensionuese, që kërkojnë më tepër angazhim përshtatës për të mundësuar që organizmi të kryejë normalisht proceset e veta fiziologjike dhe psikologjike. Me këtë kuptim të stresit janë përfshirë ngacmuesit e rinj dhe jo të zakonshëm (alarmues), rraskapitja e organizmit për t`iu përshtatur situatës së re të tensionuar, ku janë thyer e shfuqizuar mekanizmat mbrojtës të organizmit dhe çrregullimi i funksioneve të organizmit dhe i sjelljeve të tij. Termi stres ka kuptimin e ngacmuesit, të reagimit dhe të pasojave të tij. Studiuesi më i njohur i stresit, i shkaktarëve, i natyrës së përjetimit psikik dhe i ndryshimeve fiziologjike e i sjelljeve të njeriut ka qenë endokrinologu kanadez Hans Seli (Hans Selye, 1907 – 1982).

STRESI AKULTUROR. Vështirësi psikike e shoqërore e shumë emigrantëve, të cilët me mund e përpjekje arrijnë t`i përshtaten kërkesave kulturore të mjedisit të ri. Disa nga emigrantët përjetojnë forma të ndryshme të stresit në procesin e përshtatjes së tyre ndaj modeleve të sjelljeve kulturore të një mjedisi të ri.

STRESI PSIKOLOGJIK. Shfaqje e gjendjes stresante te njeriu me frikë, zemërim, me ndjenjë të pafuqisë për ta zotëruar ngacmuesin e rrezikshëm e dëmprurës. Pasoja më e rëndë e stresit psikologjik është pamundësia e kontrollimit të frikës. Individi i rritur, i cili është mësuar t`i zotërojë situatat e rënda jetësore të karakterit traumatik më lehtë përballon situatat stresante, sidomos kur ka ndihmën e mjedisit të ngushtë shoqëror. Ky individ i përdor mekanizmat mbrojtës për të vënë organizmin psikik të tij në gjendje të funksionimit normal. Por, kjo nuk ndodh me të rinjtë. Te këta gjendja e tyre mund të paraqitet në tri forma të ndara sipas intensitetit të durimit të situatës së rëndë ngacmuese: 1) Gjendja e durimit ose e tolerancës të ngacmuesit dëmprurës e të rrezikshëm; 2) Angazhimi për ta frenuar dhe penguar ndikimin e tij, përkatësisht për ta zotëruar ngacmuesin me sjellje të posaçme dhe 3) Tërheqja nga zotërimi i ngacmuesit ose i situatës stresante dhe nënshtrimi i qetë i njeriut ndaj asaj situate. Ndikimi i vazhdueshëm i situatave stresante shkakton çrregullim sjelljesh, madje edhe sëmundje psikike.

STRESOR, - I. m. Grup faktorësh biologjikë, psikologjikë dhe shoqërorë, që me ndikimin e tyre në individin e caktuar çrregullojnë zhvillimin e baraspeshuar trupor, psikik e shoqëror të personalitetit, përkatësisht të integritetit të tij. Në grupin e stresorëve biologjikë hyjnë: kanceri, leucemia, sida etj., në atë psiko-socialë bëjnë pjesë: të gjithë ata faktorë dhe situata që i rrezikojnë ekzistencën materiale, nderin e famën e njeriut (burgimi, humbja e vendit të punës, konfliktet e rënda me udhëheqësin, përdhunimi, ndarja e bashkëshortëve, sidomos kur këta kanë fëmijë, migrimi i detyruar etj). Stresorët mund të jenë afatshkurtër dhe afatgjatë, me intensitet të ulët, të mesëm dhe të lartë etj.

Burimet:

Theodori Karaj: *"Psikologjia e stresit",* Tiranë, 2005.

Jasenka Predrag: *"Stres, trauma, oporavak"* – (*"Stresi, trauma dhe përmirësimi"*), Zagreb, 1996.

Peter Tyrer: *"Si ta përballojmë stresin",* Tiranë, 2000.

Shoqata Shqiptare e Psikiatrisë: *"Probleme të stresit pas traumës,* Tiranë, 1999.

Tom Trauer: *"Të përballosh stresin",* Tiranë 1997.

UNICEF – Fondi i Kombeve të Bashkuara për fëmijët*: "Ndihma për fëmijët në përballimin e streseve të luftës",* Atar Roto Press, Zvicër, qershor 1999.

Xhafer Ismaili: *"Në kërkim të njohjes dhe përballimit të stresit",* Prishtinë, 2006.

STRIA TERMINALIS. Në anatomi i ardhur nga latinishtja që emërton rrugën e gërshetës së fijeve nervore që kalon prej amigdalës së mesme dhe fushave të qendrave nervore të pjesës ballore të trurit të madh, duke përfshirë edhe zonën e mesme paraoptike, e cila është kryesisht bartëse e sjelljes seksuale të meshkujve.

STROBOSKOP, - I. m. I ardhur nga greqishtja *στροβες* "vorbull" dhe *σκοπεως* "vështroj". Stroboskopi është instrument me të cilin projektohen figurat e njëpasnjëshme me ritëm të njëjtë për të përftuar përjetimin e lëvizjeve të tyre. Kinoprojektori është një stroboskop i rëndomtë, që në pëlhurën e kinemave paraqiten figurat në lëvizje. Në gjurmimet psikologjike shërben për të njohur hollësisht perceptimin e lëvizjeve. Shpesh emërtohet edhe me termin efekti stroboskop.

STRUKTUR/Ë, - A. f. Term i ardhur nga latinishtja *structura*. Struktura është përbërja tërësore e formuar nga elementet e saj të organizuara dhe të stabilizuara në atë tërësi. Tërësia është thelbësore dhe nga kjo analizohet aspekti i caktuar ose përbërësit e saj. Tërësia është entitet i posaçëm që nuk formohet vetëm nga përbërësit, pavarësisht nga fakti se për strukturën flitet vetëm kur kemi të bëjmë me një tërësi. Termi ka përdorim të theksuar në psikologji**.**

STRUKTURA E ËNDRRËS. Sipas teorisë psikanalitike ëndrrat kanë përmbajtje strukturore të përgjithshme dhe formohen prej dy shtresash: shtresa manifestuese e ëndrrës dhe shtresa latente e ëndrrës. Shtresa manifestuese formohet nga ajo që i kujtohet ëndërruesit dhe kjo shtresë përbën sipërfaqen e ëndrrës, kurse shtresa latente është shtresa e thellë e përmbajtjes së pavetëdijshme të saj. Thelbin e kuptimësisë së ëndrrës e përbën përmbajtja e thellë e saj. Deri në njohjen e kësaj përmbajtjeje nevojitet interpretim i ëndrrës, në mënyrë që subjekti të bëhet i vetëdijshëm për të dhe të çlirohet nga shtytja drejt saj dhe sjelljet e pakuptimta të tij.

STRUKTURA E INTELIGJENCËS. Faktorët përbërës të inteligjencës apo struktura e inteligjencës filluan të identifikohen pas zbatimit të metodave psikometrike të inteligjencës. Por, edhe këtu vërehen ndryshime në rezultatet e hulumtimeve të saj. Psikologu francez Alfred Bine (Alfred Binet, 1857 – 1911) qysh më 1904 ka pohuar se inteligjenca përbëhet nga disa faktorë të lidhur ndërmjet tyre. Pas A. Bines, studiuesit e strukturës së inteligjencës kanë vërtetuar se ajo përbëhet prej shumë faktorësh. Lidhur me ndryshimet e

pikëpamjeve ekzistojnë këto pikëpamje teorike për strukturën e inteligjencës: a) Teoria dyfaktoriale e inteligjencës e psikometristit dhe psikologut anglez Çarls E. Spirmanit (Charles E. Spearman, 1863 – 1945), i cili zbatoi metodën e analizës faktoriale në hulumtimin e strukturës së inteligjencës. Sipas kësaj teorie strukturën e inteligjencës e përbën faktori i përgjithshëm, përkatësisht faktori G (general – i përgjithshëm) dhe faktorët S (specialë), shih – ***TEORIA DYFAKTORIALE E INTELIGJENCËS*****;** b) Teoria e faktorëve gruporë e Luis L. Terstonit (Louis L. Thurstone, 1887 – 1995). Kjo teori e shpjegon strukturën e inteligjencës në bazë të shtatë faktorëve të veçantë, shih – ***TEORIA E FAKTORËVE GRUPORË*****;** c) Teoria e Rajmond B. Katellit (Raymond B. Cattell, 1905 – 1998). Kjo teori e shpjegon strukturën e inteligjencës duke identifikuar dy faktorë të përgjithshëm: faktorin e inteligjencës së kristalizuar dhe faktorin e inteligjencës fluide, shih – ***INTELIGJENCA E KRISTALIZUAR; INTELIGJENCA FLUIDE;*** ç) Teoria e modelit morfologjik të inteligjencës. Kjo është pikëpamje teorike e psikologut amerikan Xhoi P. Gilford (Joy P. Guilford, 1897 – 1987) që shpjegon strukturën e inteligjencës në bazë të 120 faktorëve të pavarur të inteligjencës, shih – ***TEORIA MORFOLOGJIKE E INTELIGJENCËS;*** d) Modeli hierarkik i strukturës së inteligjencës e shpjegon strukturën dhe organizimin e inteligjencës në bazë të katër niveleve hierarkike të faktorëve të inteligjencës. Një model i tillë është identifikuar nga psikologu britanik Filip Vernon (Philip Vernon, 1905 – 1987). Shih – ***MODELI HIERARKIK I STRUKTURËS SË INTELIGJENCËS.***

STRUKTURA E PERSONALITETIT. Përbërësit psikologjikë të personalitetit. Sipas teorive psikologjike të personalitetit dallojmë këto struktura të personalitetit: 1) Struktura e idit, egoja dhe superegoja e personalitetit. Përfaqësuesi eminent i kësaj pikëpamjeje është Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1939). 2) Sipas Karl Jungut, psiklanalistit zviceran Karl G. Jung (Carl G. Jung, 1875 – 1961) personaliteti është i përbërë nga uni, e pavetëdijshmja individuale dhe e pavetëdijshmja kolektive. 3) Personaliteti përbëhet nga 16 faktorë. Kjo është pikëpamja e Rajmond B. Katelit (Reymond B. Catell, 1905 – 1998). 4) Faktorët hierarkikë të personalitetit (nevojat fiziologjike, nevoja e sigurisë, e përkatësisë së një bashkësie dhe e dashurisë, e nderimit dhe nevoja e vetaktualizimit). Kjo është pikëpamja e psikologut amerikan Abraham H. Maslou (Abraham H. Maslow, 1908 – 1970). 5) Tiparet e personalitetit – përbërës psikologjikë të personalitetit. Përfaqësuesi i kësaj pikëpamjeje është psikologu amerikan Gordon V. Oloport (Gordon W. Allport, 1897 – 1967)**.**

STRUKTURA FAKTORIALE. Raporti numerik i përftuar ndërmjet ndryshoreve të provuara dhe faktorëve të identifikuar.

STRUKTURA KOGNITIVE. Strukturë që emërton konceptin hipotetik të bazës neuropsikike dhe të organizimit të saj në kuadrin e proceseve dhe

të sjelljeve të njeriut. Sipas psikologut amerikan me origjinë gjermane Kurt Levin (Kurt Lewin, 1841 – 1931) strukturën kognitive të njeriut e përbën organizimi karakteristik i përjetimeve subjektive të botës fizike e shoqërore, si një tërësi faktesh me organizim hierarkik dhe me renditje të koncepteve, të bindjeve, të pritjeve dhe të qëndrimeve. Kjo strukturë përcakton sjelljen dhe mendimin e individit, e pikërisht strukturën kognitive të tij.

STRUKTURA NERVORE PIRAMIDALE. Gërshetë fijesh nervore të ndërlidhura në formën e piramidës që bartin impulse nervore nga muskujt rrethorë. Kjo gërshetë fijezash nervore përbën bazën nervore të veprimeve të vullnetshme. Një gërshetë e tillë formohet nga neuritet e qelizave të fushës motorike të cipës së trurit të zonës ballore. Një pjesë e këtyre fijeve nervore përfundon në bërthamën e qelizave të palcës kurrizore dhe nëpërmjet kësaj rruge impulset nervore barten në muskujt e fytyrës, të gjuhës dhe të grykës. Fijet e tjera të kësaj gërshete shkojnë në palcën e kurrizit, duke përfunduar në brinjët e përparme të palcës kurrizore. Këto fijeza bartin impulset nervore nga qendrat e trurit në muskujt skeletorë.

STRUKTURA STRIARE. Në anatominë e sistemit nervor dhe në psikologjinë fiziologjike, që në latinisht emërtohet *corpus striatum* strukturën striare e përbëjnë tre grumbuj qelizash nervore të pjesës së përparme të trurit të madh. Në këtë pjesë përfundojnë fijezat nervore, të cilat sjellin impulse nga cipa apo korja e trurit të madh, nga talamusi dhe substanca e zezë që gjenden në trurin e mesëm. Lëndimi dhe dëmtimi i kësaj gërshete shkakton çrregullime në motorikën e njeriut, përkatësisht çrregullime të shprehive dhe shkathtësive. Kjo tregon se struktura striare luan rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe formimin e shprehive e të shkathtësive.

STRUKTURALIZ/ËM, - MI. m. Drejtim dhe metodë gjurmuese antropologjike, gjuhësore, psikologjike e sociologjike. Edhe në psikologji ka ardhur nga gjuhësia. E përbashkëta kuptimore e strukturalizmit është qasja e një entiteti, duke e zbërthyer atë në elementet, përbërëset e tij. Në psikologji strukturalizmi është i lidhur me gjurmimet e psikologut gjerman Vilhelm Vunt (Wilhelm Wundt, 1832 – 1920), sidomos me qasjen studimore të proceseve të vetëdijshme nga ana e psikologut amerikan me prejardhje angleze Eduard B. Tiçener (Edwar. B. Titschener, 1867 – 1927). Këta sipas qasjes gjurmuese introspektive dhe eksperimentale të subjekteve provues kishin ardhur në përfundim se tërësia psikike është e formuar prej elementeve që nuk mund të ndahen më tutje dhe nga kombinimi i tyre. Këta elemente ishin: ndijimet, përfytyrimet dhe ndjenjat, përkatësisht kënaqësia dhe pakënaqësia. Këta elemente të pandashëm kanë cilësinë, intensitetin dhe kohëzgjatjen e tyre. Kjo qasje e gjurmimeve psikologjike u kundërshtua shumë pothuaj nga të gjitha drejtimet e shkollat psikologjike. Perceptimi nuk është shumë e ndijimeve, por cilësi e posaçme, perceptimi i fjalisë nuk është shumë kuptimore e fjalëve përbërëse të saj, perceptimi i raporteve shoqërore është tërësi marrëdhëniesh të veçanta. Psikologu zviceran Zhan

Piazhe (Jean Piaget, 1896 – 1980) strukturalizmin e ka konsideruar metodë hulumtuese. Sot kjo qasje dhe rezultatet e saj i përkasin historisë së psikologjisë.

STUDIMI I RASTIT. Term i përdorur më tepër në psikologjinë klinike, në psikiatri, në psikologjinë zhvillimore etj. i ardhur nga psikanaliza. Emërton metodën gjurmuese të zhvillimit psikik të një individi me qëllim të përftimit të pasqyrës së qartë të historisë individuale dhe të shfrytëzimit të saj për njohjen e zhvillimit të sjelljeve të veçanta, sidomos për shërimin e sjelljeve të çrregullta. Mbështetet në parimin e rëndësisë së madhe të përjetimeve dhe ngjarjeve individuale të moshës së fëmijërisë në zhvillimin psikologjik të individit në moshën e pjekurisë. Shih – ***HISTORIA E RASTIT.***

STUDIMI PILOT. Term i futur edhe në shqip nga anglishtja që përdoret në gjurmimet psikologjike, sidomos të psikologjisë sociale. Emërton aktin e të provuarit paraprak të modelit studimor në një kampion ose gjedhe të vogël nga popullata e saj. Ndihmon në përsosjen e metodave dhe të procedurave hulumtuese, si edhe të formave organizuese të hulumtimit kryesor.

STUDIMI PSIKOLOGJIK. Punim shkencor kushtuar një çështjeje psikologjike. Studimi psikologjik përfshin përkufizimin e qartë të temës, përcaktimin e metodave e procedurave gjurmuese, bashkërenditjen e veprimeve gjatë zbatimit të këtyre metodave e procedurave, nxjerrjen e rezultateve dhe përfundimin, si edhe kumtimin e zbërthyer qartësisht të rezultateve gjurmuese. Studimi i këtillë është studimi që i nënshtrohet rreptësisht kontrollit të faktorëve dhe rregullsive studimore. Kur studimi psikologjik ka të bëjë me një çështje të psikologjisë zhvillimore, atëherë ky studim mund të jetë studim horizontal dhe vertikal. Studimi horizontal ka të bëjë me gjurmimin e një ndryshoreje të një niveli zhvillimor përbrenda grupmoshës së njëjtë të disa individëve. Studimi gjatësor, vertikal ose longitudinal është studim i një ndryshoreje të një individi ose disa të tjerëve gjatë ndryshimeve moshore të tyre. Të këtilla mund të jenë çështjet studimore të zhvillimit të aftësive, të rritjes së organizmit gjatë zhvillimit moshor etj., si edhe për të përcaktuar prirjet e zhvillimit të tyre. Studime psikologjike mund jenë studimet e birësimit, studimet me binjakët dhe studimet mbi familjet – studim i fëmijëve të ndarë nga prindërit, i binjakëve monozigotë ose bizigotë të ndarë njëri nga tjetri, që zhvillohen në mjedise të ndryshme kulturore për të studiuar rolin e trashëgimisë dhe të mjedisit në zhvillimin e sjelljeve të tyr**e.**

STUDIMOR, - E. mb. Që përcakton përpjekjet sistematike e organizuese të një gjurmuesi a të një ekipi gjurmuesish, që kanë të bëjnë me studimin sistematik e shkencor të problemeve të ndryshme teorike e praktike, si identifikimin e fakteve dhe raporteve të reja ndërmjet tyre apo të një parimi të verifikuar plotësisht dhe të qartë e të shkoqitur në pikëpamjen e gjuhës shkencore. Studimore mund të jenë punimet gjurmuese nga psikologjia pedagogjike, e personalitetit, psikologjia zhvillimore etj.

STUPOR, - I. m. Term i psikiatrisë dhe i psikologjisë klinike i ardhur nga latinishtja *stuporis* "shtangie". Gjendje letargjike, psikike, e çrregulluar e individit deri në atë masë sa ai nuk është në gjendje të reagojë ndaj ngacmuesve, duke mos pasur përkohësisht orientim kohor dhe hapësinor. Individi në gjendje stupori i ka të kufizuara funksionet e proceseve kognitive, emocionale dhe motivuese. Shfaqet te disa të sëmurë psikikë (depresion i thellë, skizofreni katatonike, epilepsi). Në shumë raste stupori është dalluar dëmtimi i rrjetës retikulare, i pjesës së majtë të trurit etj.

SUBJEKT, - I. m. Term i disa disiplinave shkencore (i filozofisë, i gjuhësisë, i shkencave juridike etj.) i ardhur nga latinishtja *subjectus* "nënshtroj". Në psikologji është term standard i individit që është bartës i jetës psikike dhe objekt i hulumtimit të një procesi apo forme të sjelljes, i një tipari, gjendjeje psikike etj., i aftë për t`iu nënshtruar vëzhgimeve e studimeve kërkimore. Me termin subjekt emërtohet individi që i nënshtrohet vëzhgimit, eksperimentimit etj. nga ana e të tjerëve, pra pjesëmarrësi kryesor në një gjurmim shkencor.

SUBJEKTIV, - E. mb. Ajo që i përket një subjekti, që ka të bëjë me një subjekt të caktuar, që është cilësi e atij subjekti. Subjektive është jeta private e një individi, jeta psikike e brendshme e njeriut, që nuk i nënshtrohet vëzhgimit nga ana e të tjerëve, që nuk kumtohet për të tjerët, që nuk i nënshtrohet vëzhgimeve e matjeve objektive kontrolluese. Subjektiv mund të jetë individi, i cili u nënshtrohet dëshirave, interesave e synimeve të tij jo-objektive. I këtillë mund të jetë përjetimi i disa përvojave të frikës dhe të ankthit. Frika dhe ankthi kanë karakter të ngushtë subjektiv, përkatësisht individual, sidomos në format e sjelljeve.

SUBJEKTIVIZ/ËM, - MI. m. Term i filozofisë, e pikërisht i degëve të saj, si etika, estetika, logjika etj. Sipas kësaj pikëpamjeje të përgjithshme botën lëndore e përbëjnë përfytyrimet dhe mendimet e njeriut, kurse vlerat etike dhe estetike janë subjektive. Ky term shpesh ka kuptimin e prirjes së një individi, sipas së cilës pikëpamjen, qëndrimet, vlerat etj. të tij i konsideron të përgjithshme dhe që i vlerëson sjelljet e të tjerëve sipas kriterit të tij personal (jo nga kushtet reale).

SUBKORTEKS, - I. m. Masa e trurit që gjendet nën cipën e trurit të madh, përkatësisht nën korteks dhe nuk i nënshtrohet kontrollit nga ana e korteksit. Këtë e përbëjnë strukturat e substancës së bardhë të trurit, që kryejnë funksionet e tyre organike të pakontrolluara nga cipa e trurit të madh.

SUBLIMIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *sublimation* "fisnikërim". Ka kuptim të përgjithshëm dhe të veçantë. Kuptimi i përgjithshëm ka të bëjë me ridrejtimin e veprimtarisë së njeriut prej synimeve të papranueshme nga mjedisi shoqëror (synimeve agresive, seksuale etj.) në ato që i vlerëson pozitivisht dhe i pranon mjedisi shoqëror. Kuptimi i veçantë ka të bëjë me zëvendësimin e një qëllimi e prirjeje me një tjetër qëllim a prirje të një shkalle më të lartë në vlerësimet shoqërore. I tillë është sublimimi i energjisë agresive në angazhimin e asaj energjie në përshkrime

dhe shpjegime të letrarizuara. Në këtë pikëpamje sublimimi është mekanizëm mbrojtës i njeriut, i përcaktuar nga përfaqësuesit e psikanalizës. Këta konsiderojnë se vlerat artistike, etike, kulturore etj. janë shndërrim i energjisë së shtytësve, në rend të parë i shtytësit seksual dhe atij agresiv në përsosjen e sjelljeve morale dhe arritjen e qëllimeve më të larta njerëzore.

SUBMISIVITET, - I. m. Gatishmëri e disa individëve për t`iu nënshtruar atij që është mbisundues, punëdhënës, udhëheqës etj., për të pranuar pa bërë zë mendimet, ëndërrimet, udhëzimet e tjetrit, që gjendet në shkallën më të lartë të hierarkisë familjare, farefisnore, shoqërore etj. Submisiviteti manifestohet në forma objektive duke lëvizur kokën poshtë-lart, duke ulur shikimin e tij poshtë etj. Ky manifestim ndryshon nga një mjedis në mjedisin tjetër kulturor.

SUBSTANCA E ZEZË. Term i anatomisë i përdorur në psikologji e fiziologji edhe me termin latin *substantia nigra*. Kjo është substancë nervore, pigmentuese, e përhirtë - e zezë e trurit të mesëm e lidhur me tri grumbuj qelizash nervore të pjesës së përparme të trurit. Këto së bashku janë të lidhura në formë rrethi, janë bartëse të motorikës dhe kontrollojnë sistemin e lëvizjeve të njeriut.

SUBSTANCA PSIKOAKTIVE. Heroina, kokaina dhe marijuhana. Këto kanë përbërje biokimike me veti nxitëse të funksionimit të sistemit nervor dhe me pasoja të dallueshme ndryshimesh në perceptimin e objekteve dhe të dukurive e të ndryshimeve të tyre, me ndryshim në sferën emocionale dhe në sjelljet e njeriut ndaj vetes, të tjerëve dhe të ndryshimeve të përgjithshme të mjedisit të tij.

SUBTALAMUS, - I. m. Pjesë e rëndësishme e talamusit, përkatësisht bërthama e qelizave nervore të pjesës nëntalamusore e lidhur me tri grumbujt e qelizave nervore të pjesës së trurit të përparmë (bartëse e kontrolluese të motorikës), me pjesët e gërshetës së fijezave nervore që bartin impulse nervore nga receptorët në talamus. Kjo pjesë e talamusit formohet edhe prej fijezave nervore që bartin impulse nervore nga truri i vogël në talamus dhe, po ashtu, është e lidhur me pjesët bërthamore të masës së zezë dhe të kuqe të trurit të mesëm.

SUBTEST, - I. m. Nëntest i formuar nga detyrat, problemat e pyetjet, që janë të lidhura ngushtë me ndryshoren kryesore që matet me anë të testit kryesor. Përmbajtja e subtesteve është e atillë që synon njohjen e njërës anë të zhvillimit të ndryshores, të një përbërësi të saj që duhet matur dhe vlerësuar. Detyrat e subtestit janë të veçanta dhe jepen në mënyrë të posaçme, por rezultatet e arritura përfshihen në rezultatin e përbashkët.

SUBVOKALIZ/IM, - MI. m. Të folur i pazëshëm i një individi. Të folurit e këtillë dallohet në lëvizjet e buzëve, të gjuhës, të nofullave dhe besohet që proceset mendore nuk mund të vëzhgohen dhe as të regjistrohen me aparate të ndjeshme, madje edhe të përsosura.

SUGJERIM, - I. m. Term i të folurit kryesisht të përditshëm i ardhur nga fjala latine *suggerere* "këshilloj". Sugjerimi është mendim, qëndrim dhe herë-herë edhe udhëzim që i jepet një

individi se si të sillet e të veprojë në situata të ndërlikuara, si t`i qaset zgjidhjes së një çështjeje, si ta zgjidhë një situatë problemore etj. Ky mendim, qëndrim, udhëzim etj. ka karakterin e ngacmuesit, të nxitësit për ndryshim të qëndrimit ose sjelljeve. Nuk ka karakter të detyrueshëm, pra këtë tjetri mund ta marrë në konsideratë, por jo detyrimisht. Zbatohet në një aktivitet propagandues politik, tregtar etj. madje, edhe si mjet ndikimi që individi tjetër nuk duhet ta marrë në formë kritike. Sugjerimi ka gjetur zbatim në disa forma të terapisë.

SUGJESTIBILITET, - I. m. Tipar i personalitetit, i cili gati në mënyrë të përhershme dhe të qëndrueshme tregon gatishmëri për t`i ndryshuar qëndrimet dhe sjelljet e tij sipas sugjerimeve të të tjerëve, sidomos të atyre që kanë autoritet në një fushëveprim të caktuar. Sugjestibiliteti është pranimi jokritik gati i përhershëm i mendimit të tjetrit, i qëndrimit të të tjerëve etj. Ky tipar manifestohet sidomos te ata që e kanë pak të zhvilluar unin personal dhe në disa situata të jashtëzakonshme, si p.sh., pas lirimit nga burgimi, pas përjetimit të gjendjes stresante etj.

SUICIDOMANI, - A. f. Term i kriminologjisë, i psikiatrisë e i psikologjisë i formuar nga përngjitja e dy fjalëve latine *suicidium* "vetëvrasje" dhe *mania* "marrëzi". Suicidomania është dëshirë e vazhdueshme për kryerjen e aktit të vetëvrasjes. Kjo dëshirë haset më tepër te ata që vuajnë nga psikoza e skizofrenisë dhe nga një shkallë e lartë deprimimi. Shih – ***VETËVRASJA.***

SUKSES, - I. m. Arritja e individit në cak të paramenduar si rezultat i veprimtarisë së vullnetshme të tij, që shkakton kënaqësi, gëzim e krenari, shpesh edhe ndjenjë të harresës intensive (amalgamë) e ndjenjës së kënaqësisë, të gëzimit dhe të krenarisë. Konsiderohet faktor nxitës i aktivitetit më të lartë, më fisnik nga ana e atij që realizon qëllimin e tij.

SULKUS, - I. m. Term i anatomisë dhe i psikologjisë fiziologjike i stabilizuar në terminologjinë e sistemit nervor. Emërton brazdën, çarjen e një organi. Në psikologjinë fiziologjike zakonisht emërton brazdën qendrore të njohur me termin brazda e Rolandit, që gjendet në mesin e dy hemisferave, si edhe brazdën anësore, ndarëse e pjesës parietale ose tepore nga ajo temporale ose tëmthore e trurit, e njohur me termin latin *sulkus lateralis* ose *brazda e Selvisë.*

SULMET PANIKE. Sulme të papritura të frikës intensive dhe të tmerrit që kanë një kohëzgjatje shumë të shkurtër dhe manifestohen me këto simptoma karakteristike: frikë nga vdekja, nga çmenduria, dridhje gjymtyrësh, djersitje, përshpejtim i rrahjes së pulsit, ritëm i çrregulluar i frymëmarrjes etj. Sulmet panike shfaqen kryesisht te ata që vuajnë nga çrregullimet ankthore. Këto sulme ndryshojnë nga çrregullimet panike, sepse janë shumë të rralla.

SUPER EGOJA. asnj. Term i psikanalizës, përbërës i modelit trishtresor të psikikës së njeriut. Super egoja emërton shtresën e tretë psikike të personalitetit, shtresën morale dhe shoqërore të tij, që i imponohet sjelljeve të tij. Përmbajtja e kësaj shtrese është formuar nga përvetësimi i parimeve dhe i normave morale, që drejtojnë sjelljet e

njeriut në plotësimin e nevojave biologjike (të shtytësve), shoqërore dhe psikologjike në objektiva të mundshëm dhe të lejuar nga mjedisi shoqëror e kulturor i tij. Tri janë funksionet e super egos: vetëvëzhgimi, funksioni i ndërgjegjes dhe ai i egos ideale. Super egoja zhvillohet dhe formohet me anë të identifikimit të fëmijës me prindërit dhe me të mëdhenjtë nga të cilët i merr dhe i përvetëson parimet dhe normat e sjelljeve të tij. Sipas themeluesit të psikanalizës Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) super egoja luan rolin e "gjykatësit" të brendshëm, i cili vlerëson sjelljet, duke i dënuar ato të pamoralshmet dhe duke përkrahur e lëvduar të moralshmet. Sipas tij super egoja është pjesë e egos, por me funksione të ndryshuara nga ato të egos. Super egoja është struktura më e re gjenetike e personalitetit. Shih – ***TEORIA PSIKANALITIKE E PERSONALITETIT.***

S

SUPERSTRUKTUR/Ë, - A. f. Tërësia e institucioneve shoqërore të zhvilluara mbi themelin e zhvillimeve ekonomike. Në psikologji u përdor më tepër në psikologjinë sociale të zhvillimeve shoqërore moniste. Ka emërtuar besimin, bindjet, qëndrimet, vlerat etj. e institucioneve shoqërore të krijimtarisë artistike, të arsimit, kulturës, shkencës etj.

SUPOZIM, - I. m. Të marrit me mend si të vërtetë, të besuarit në një pikënisje, saktësia e së cilës duhet të vërtetohet. Ky është kuptimi i përgjithshëm i termit supozim. Në psikologjinë kognitive ka kuptim të veçantë. Këtu supozimi është aksiomë e përgjithshme që pranohet, por rrjedhimet e saj duhet të identifikohen dhe me këtë rast mund të flitet për vërtetësinë e atij supozimi. Por, supozimi nuk mund të vërtetohet në mënyrë argumentuese me metoda e procedura të psikologjisë empirike. Në rastet e këtilla supozimi merr statusin e hipotezës**.**

SUPSTITUCION, - I. m. Term i anglishtes *substitution* "zëvendësim, që po depërton edhe në përkthimin e teksteve në gjuhë të tjera, madje edhe në gjuhën shqipe. Shih – ***ZËVENDËSIMI I QËLLIMIT.***

SYNIM, - I. m. Gjendje psikike e brendshme dhe proces karakteristik i angazhimit konvergues të përfytyrimit të qëllimit, të përjetimit emocional dhe të veprimit të njeriut në qëllimin apo objektivin e caktuar. Gjendja e këtillë ka kuptimin e gatishmërisë së energjisë së brendshme të organizmit për të arritur në qëllimin ose objektivin e caktuar. Kjo ka përmasën e një procesi, ngaqë ka të bëjë me përcaktimin e njeriut për të arritur dhe pushtuar qëllimin ose objektivin e përmendur, duke drejtuar dhe organizuar veprimtarinë e tij në atë qëllim të qartë, të përqendruar në përfytyrimin e tij dhe të shoqëruar me gatishmëri të veprimit. Synimi ka përmbajtje integrale kognitive, emocionale dhe të veprimeve të vullnetshme. Shih – ***PRIRJA.***

SYNIMET VETËBURIMORE. Aspirata, dëshira, interesa, qëllime, qëndrime, synime thelbësore për individualitetin e një personaliteti. Kjo tërësi e ndërlikuar strukturash psikike i jep personalitetit karakter unik dhe të veçantë. Këto e pushtojnë plotësisht personalitetin dhe veprimtarinë e tij. Tërësia e tillë unike dhe e veçantë është

tregues kryesor i pjekurisë së personalitetit dhe i shkallës së lartë të zhvillimit të vetëdijes për individualitetin e personalitetit të një individi të caktuar.

SYNIMI NË PËRSOSMËRI. Synim i mbështetur në nevojën, përkatësisht në shtytësin themelor të lindur të njeriut për zhvillim të plotë të tij. Buron nga ndjenja e papërsosshmërisë, që e shtyn njeriun vazhdimisht në drejtim të zhvillimit sa më të lartë, sa më të përsosur dhe sa më superior dhe të sigurt drejt fitores. Ky synim konsiderohet se është fuqi dinamike e njeriut që e shtyn realizimin e mundësive të vetes në procesin dhe mënyrën sa më cilësore të zhvillimit. Si fuqi shtytëse e tillë kjo nuk pushon së vepruari në vetë njeriun, madje duke u shtrirë në dy drejtime: në drejtimin pozitiv dhe në atë negativ. Drejtimin e veprimtarisë së këtij shtytësi e përcakton vetë individi. Njeriu i shëndoshë, i arsyeshëm dhe me ndjenja shoqërore fuqinë e këtij shtytësi e drejton në varësi me parimet dhe me normat e përgjithshme të zhvillimit të shoqërisë, kurse tipat neurotikë dhe joshoqërorë këtë orvaten ta zhvillojnë jashtë drejtimit të zhvillimit të mjedisit shoqëror. Ky term buron nga psikologjia individuale e Alfred Adlerit (Alfred Adler, 1870 – 1937).

Burimet:

Alfred Adler*: "Psikologjia individuale – Praktika dhe teoria",* UEGEN, Tiranë, 2011.

Alfred Adler: *"Të kuptosh natyrën e njeriut",* Tiranë, 2010.

Alfred Adler: *"Shkenca e të jetuarit",* Tiranë, 2009.

Alfred Adler: *"Ç`kuptim mund të ketë jeta",* Tiranë, 2003.

SYNIMI PËR FUQI. Synim i të gjithëve, lakmi dhe insistim i tyre për të pasur të zhvilluar ndjenjën e sigurisë jetësore, për të fituar fuqi mbi të tjerët, për t`i sunduar të tjerët. Mjeku, oficeri, politikani etj. orvatet ta plotësojë këtë synim, duke respektuar parimet e normat shoqërore të mjedisit të ngushtë dhe të gjerë shoqëror e profesional. Ky synim mund të jetë i vetëdijshëm ose i pavetëdijshëm dhe te njerëzit normalë ka karakterin e tiparit të posaçëm. Ndërkaq, individi nevrik, individët me sjellje shmangëse seksuale etj. këtë synim orvaten ta plotësojnë edhe duke rënë në konflikt me mjedisin e tyre. Mjedisi konkurrent është faktor shtytës i zhvillimit të synimit për fuqi, për pushtet të njeriut mbi të tjerët. Në zhvillimin e synimit për fuqi ushtron ndikim edhe ndjenja e vlerës më të ulët. Synimi për fuqi është term i psikologjisë individuale të Alfred Adlerit (Alfred Adler, 1870 – 1937). Shih – ***NDJENJA E VLERËS MË TË VOGËL.***

SY, - RI. m. Organ shqisor i ndërlikuar i të parit të objekteve, të dukurive dhe të cilësive të tyre. Në pikëpamjen anatomike syri përbëhet nga kokërdhoku, nervi i të parit me pjesët e veta dhe nga organet aksesore, që e bëjnë të mundshme lëvizjen e syrit dhe mbrojtjen e tij nga rreziqet e ndryshme. Këto janë struktura të ndërlidhura ngushtë ndërmjet tyre, ku bëhet e mundur që energjia e pjesës pamore të shndërrohet në impulse nervore dhe bartja e tyre në qendrën pamore të cipës së trurit të madh shkakton ndijimin e të parit. Kokërdhoku i syrit ka formën e rrumbullakët me diametër prej rreth 24 mm, i vendosur në zgavrën e majtë dhe të djathtë të eshtrave të fytyrës së pjesës së sipërme të

saj. Përbëhet nga tri cipa: nga cipa e jashtme e tejdukshme e quajtur brisë ose kornea dhe nga pjesa tjetër e patejdukshme e të bardhës së syrit (sclera). Sklera në pjesën e përparme është e tejdukshme dhe formon kornenë; nga cipa e mesme, ku dallohet cipa enore (koroidja), pjesa ciliare dhe ylberthi (irida në mesin e së cilës gjendet bebja e syrit (pupilla); nga cipa e tretë, cipa e brendshme që quhet rrjetëz (retinë), bartëse e shtrirjes së nervit pamor ose optik. Kjo cipë përbëhet nga shtresa e kunjëzave dhe e shkopthave, ku shkaktohet rizhvillimi pigmentor prej nga fillon shndërrimi i energjisë në impulse nervore të fijezave të nervit pamor. Në fundin e syrit gjendet njolla e bardhë e rrumbullakët, nga e cila del nervi prej rrjetëzës ose retinës së syrit. Ky vend quhet njollë e verbët, e pandjeshme për rrezet e dritës. Në pjesën anësore të brendshme të bebes së syrit gjendet njolla e verdhë dhe gropëza e saj e njohur me termin gropa qendrore, e ndjeshme ndaj ngacmimeve pamore. Nervi pamor del nga kokërdhoku i syrit në pjesën e prapme të tij, kurse një pjesë e fijezave të tij kryqëzohen në të ashtuquajturën kryqëzim pamor dhe prej këndej rrugët pamore vazhdojnë deri në qendrën dytësore e parësore të të parit. Bërthama e kokërdhokut përbëhet nga trupi qelqor, nga kristalini dhe nga lëngu ujor. Njeriu, si edhe shumë kafshë, kanë nga dy sy; secili prej tyre e sheh të njëjtin objekt nga këndet e ndryshme, por në qendrën e të parit përftohet figura e përbashkët e objektit. Shih – ***TË PARIT.*** Strukturën e syrit e dallojmë në figurën e mëposhtme:



SYRI MBIZOTËRUES. Njëri sy i njeriut, i cili gjithmonë e fokuson më mirë një objekt nga syri tjetër. Ky sy mbisundues e drejton syrin tjetër se ku duhet ta fokusojë objektin që perceptohet.

SH

SHANS, - I. m. Mundësia e paraqitjes së njërës nga rastet sipas teorisë së probabilitetit. Një rast i tillë mund të paraqitet ngaqë shkaktohet nga një numër i madh faktorësh dhe nga kombinimi i tyre.

SHANTAZH, - I. m. I ardhur nga frëngjishtja *chantage*. Zbatimi i formave të ndryshme të presioneve psikike të një individi, për ta detyruar një individ tjetër të veprojë kundër bindjeve, interesave, qëndrimeve dhe përcaktimeve të tij, me qëllim të plotësimit të kërkesave, interesave e qëndrimeve të veta.

SHARKO Zhan-Martin (Jean-Martin CHARCOT). Neuropsikiatër francez, themelues i neurologjisë moderne. Lindi në Paris më 1825 dhe vdiq më 1893. Me emrin e tij janë të lidhura konceptet themelore të shërimit të sëmundjeve psikike: histeria, hipnoza, neuroza. Gjendjen histerike të grave e ka përshkruar shumë bukur në shkrimet e revistës "Orët e së martës". Rezultatet e hulumtimit të tij treguan se paraliza histerike nuk është pasojë e çrregullimeve të trurit, por paraliza histerike shkaktohet nga shoku emocional. Emri i Zhan Martin Sharkos konsiderohet i lidhur ngushtë edhe me fillesat e zhvillimit të psikanalizës. Pranë tij mësuan Pjer Zhanet, Zigmund Frojd dhe Alfred Bine; njihet ndikimi i tij në formimin e Zigmund Frojdit të ri. Është themelues i katedrës së parë të neurologjisë në Spitalin Salpetrier të Parisit. Më 1873 anëtar i Akademisë Kombëtare të Mjekësisë, kurse më 1883 anëtar i Akademisë Franceze të Shkencave. Nën udhëheqjen e tij Spitali Salpetrier u bë qendër europiane e neurologjisë, e psikiatrisë, e psikopatologjisë dhe e psikologjisë. Vepra kryesore e tij është: *"Leçons sur les maladies du systéme nerveux faites ā al Salpètrière"* – (*"Leksione për sëmundjet e sistemit nervor të shfaqura në Salpetrier"*), botur në 3 vëllime, 1872 – 1887.

SHARLATAN, - I. m. Mashtrues i paturpshëm, i cili paraqitet si njohës i mirë i një çështjeje, kurse në të vërtetë është i paditur dhe i paaftë.

SHARRËZ, - A. f. Tkurrje e muskujve të trupit që shoqërohet me të dridhura të forta të trupit. Shkaktohet nga infektimi dhe mungesa e kalciumit, e vitaminës D etj.

SHASTISJ/E, - A. f. Humbje e pjesshme e kontrollit të mendjes mbi proceset psikike dhe sjelljet e njeriut, që shkaktohet nga ngacmuesit e papritur dhe të fuqishëm mbi organizmin e tij. Shastisja është ndryshim i baraspeshës ndërmjet mendjes dhe proceseve mendore e proceseve emocionale të njeriut, me pasoja në kontrollin e pamjaftueshëm të sjelljeve ndaj ngacmuesve – shkaktarë të një gjendjeje të tillë. Në rastet e posaçme shastisja merr përmasat e gjendjes afektive.

SHELDON Uiliam (William SHELDON). Mjek dhe psikolog amerikan. Lindi më 1889 dhe vdiq më 1977. Profesor në disa universiteteve të njohura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si: në Çikago, Kaliforni, Harvard e Kolumbi. Drejtor i Qendrës Biologjike Humaniste në Kembrixh (Masaçusets). Në psikologji u bë i njohur me tipologjinë e njohur me termin tipologji konstitucionale, ose somatotipologjia, ku bëri ndarjen e tipave konstitucionalë në tipin endomorf, mezomorf dhe ektomorf. Për tipin endomorf përcaktoi mbisundimin e organeve të tretjes – prirjen e reagimit emocional, për tipin mezomorf përcaktoi mbisundimin e muskujve skeletorë dhe të skeletit – prirjen e aktivitetit intensiv dhe të garimit dhe për tipin ektomorf përcaktoi mbisundimin e sistemit nervor dhe të ndjeshmërisë së lëkurës – angazhimin mbisundues në proceset e përsiatjes dhe të tërheqjes nga mjedisi shoqëror. Veprat kryesore të tij janë: *"Morphologic type and mental ability"* – (*"Tipat morfologjikë dhe aftësitë mendore",* 1926; "*The varieties of human phisique. An introduction to constitutional psychologie" – "Variacionet e psikikës njerëzore. Hyrje në psikologjinë konstitucionale",* (me bashkëpunëtorë, 1940); *"Atlas of men"* – (*"Atlasi mbi njeriun"*), (me bashkëpunëtorë, 1952) etj.

SHEND, - I. m. Gjendje emocionale, të cilën e karakterizon përjetimi i thellë i gëzimit, i haresë i përçuar me qëndrim optimist ndaj një situate të krijuar. Shkaktohet nga suksesi i nivelit të lartë të njeriut. Shendi ushtron ndikim pozitiv në angazhimin e njeriut për aktivitete të suksesshme.

SHENJ/Ë, - A. f. Ngacmues, tregues i nevojës së ndryshimit të sjelljes së njeriut; mjet komunikimi me të tjerët që është bartës i një kuptimi të caktuar. Shenja të tilla mund të jenë lëvizja me kokë, me sy, me duar etj., ku në situata të caktuara secila prej tyre ka kuptim të caktuar. Domethënia e tyre është përcaktuar në bazë të marrëveshjes së pashkruar ndërmjet anëtarëve të një bashkësie të caktuar, të një mjedisi të caktuar dhe zbatohet si formë e veçantë komunikimi ndërmjet tyre. Disa nga shenjat fiziologjike të përkohshme si: skuqja e fytyrës, dridhja e pakontrolluar e duarve, ulja e kokës etj., shprehin ndjenjën e turpit, të frikës së madhe etj. Disa shenja të tjera shprehin pohimin ose mohimin e mendimit, të qëndrimit (lëvizja e kokës poshtë-lart shpreh miratimin e mendimit e të qëndrimit, kurse lëvizja e kokës majtas-djathtas shpreh mospajtimin me mendimin e me qëndrimin e shprehur. Por, domethënia e këtillë nuk është e njëjtë për mjediset shoqërore e kulturore të mjediseve të tjera. Disa shenja tregojnë fillimin e aktivitetit të caktuar nga ana e individëve; lëvizja e caktuar e duarve të dirigjentit të korit tregon

fillimin e ekzekutimit të kompozimit, të operetës etj. Disa shenja (emblema, flamuri, shenjat e komunikimit, etj.) përfaqësojnë diçka tjetër, që nuk është në lidhje natyrore me kuptimin e tyre. Këto shenja bartin informacion, porosi (mesazh) për individët e tjerë të atij mjedisi dhe ndikojnë në jetën e njeriut.

SHENJAT BINAURALE. Shprehje e përbërë nga dy fjalë latinisht *bini* "dy" dhe *aures* "veshë". Shenjat binaurale i përkasin atij grupi shenjash, përcaktimin e burimit gjë që na e mundëson dëgjimi i njëkohshëm me të dy veshët, duke vlerësuar nga cili drejtim vijnë tingujt e burimit të caktuar. Përcaktimin e lehtë të drejtimit të burimit të tingujve na mundëson edhe lëvizja e kokës. Shih - ***LOKALIZIMI I TINGUJVE NË HAPËSIRË.***

SHENJAT BINOKULARE. Shenja që ndihmojnë perceptimin e thellësisë së një objekti me anë të të parit të tij me të dy sytë. Konvergimi i i syve dhe divergimi i tyre me rastin e të parit afër dhe larg janë shenjat më të rëndësishme të perceptimit të thellësisë së një objekti.

SHENJAT GESHTALTE. Struktura të organizuara me raporte të posaçme në tërësi të posaçme, të cilat i japin kuptim asaj tërësie, situate, procesi etj. Shenjat e një tërësie të këtillë sajojnë cilësinë perceptuese të quajtur geshtalt. Geshtalti tregon përmbajtjen kuptimore të asaj tërësie duke mundësuar edhe parashikimin e pasojave që mund të ketë ajo situate e një tërësie të këtillë. Shih - ***GESHTALTI.***

SHENJAT MONOKULARE. Shenjat që mundësojnë perceptimin e thellësisë së një objekti me anë të të parit të tij me një sy (afërsia e objektit, madhësia, maskimi, vija konvergjente e të parit, drita dhe hija e objektit).

Burimet:

Gordon Allport: *"Personality: a psychological interpretation"* – (*"Personaliteti: interpretimi psikologjik"*), New York, Holt, 1961.
Ivan Ivić: *"Čovek kao animal symbolicum"* – (*"Njeriu si kafshë symbolike"*), Beograd, 1978.
Nikola Rot: *"Znakovi i značenja'* – (*"Shenjat dhe kuptimet"*), Beograd, 1982.
Wilhelm Wundt: *"Sprachgeschichte und Sprachpsychologie* – (*"Historia e gjuhës dhe psikologjia e gjuhës"*), Leipzig, 1901.

SHENJAT OKULOMOTORIKE. Vendndodhja e syve, e muskujve të syve dhe e atyre muskujve që aktivizohen nga ndryshimet e lentës së syrit. Shenja të tilla mundësojnë perceptimin e thellësisë së trupave dhe janë të lidhur me përshtatjen dhe konvergimin e të parit të objekteve.

SHERINGTON Çarls (Charles SHERINGTON). Neurofiziolog anglez. Lindi më 1857 dhe vdiq më 1952. Rezultatet e gjurmimit të sistemit nervor nga ana e tij dhe e bashkëpunëtorëve kanë ushtruar ndikim të fuqishëm në konceptimin e funksionit dhe të rolit të sistemit nervor për zhvillimin e përgjithshëm të njeriut, sidomos për zhvillimin e proceseve psikike dhe të sjelljeve të njeriut. Në gjurmimet e tij u përqendrua në analizën e reagimeve refleksive, në rolin e qendrave të larta nervore në zhvillimin e tyre, si edhe në ndërvarësinë funksionale të sistemeve refleksive. Pohohet se konceptet dhe termat e tyre të sumacionit nervor dhe të inhibimit nervor u përcaktuan prej tij. Koncepti i mënyrës së hulumtimit të reflekseve dhe të lidhjeve funksionale ndërmjet

reagimeve reflektive të funksionit të qendrave të larta nervore kanë ushtruar ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e psikologjisë dhe të psikologjisë fiziologjike. Vepra kryesore të Charles Sherington janë: *"The integrative Action of the Nervous System"* – (*"Aktiviteti integrues i sistemit nervor"*), 1906.

SHESTIM, - I. m. Procesi i hartimit të një plani të caktuar që synon realizimin e një vepre sipas përcaktimit të një qëllimi apo objektivi të caktuar saktësisht. Në procesin e shestimit vjen në shprehje mendimi abstrakt dhe krijues. Shestimi është faktor paraprijës në krijimet arkitektonike, të pikturës, letrare etj.

SH

SHËMBËLLIM, - I. m. Figurë e krijuar në bazë të ndikimit të drejtpërdrejtë të trupave në shqisat e njeriut, të përvojës që ka njeriu për të, si edhe për lidhjet e tij më të tjerët. Ndryshon nga përfytyrimet, sepse këto janë riprodhim i figurës së një trupi, që ka ndikuar dikur në shqisat e njeriut, pasqyrim i dikurshëm i tij në vetëdijen e njeriut, kurse shëmbëllimi është ndërlidhur me përfytyrime, me asociacionin e tyre dhe më përvojën e njeriut për këtë tërësi psikologjike. Kjo është një tërësi e ndërlidhur përbërësish objektivë dhe subjektivë. I tillë është shëmbëllimi i malësorit, i pushimeve verore në bregun e Adriatikut të Jugut, i thesit të farës së grurit të mirë etj.

SHËMTIR/Ë, - A. f. Individi, objekti, vepra etj. e shëmtuar që shkakton gjendjen emocionale të pakënaqësisë, të largimit, madje edhe të neverisë ndaj saj. Shkaktohet nga vlerësimi i një objekti, i një vepre etj. të shëmtuar.

SHËMTUAR (I, E). mb. Që përcakton objektet dhe dukuritë negative për njeriun, që refuzojnë, që e largojnë atë nga një objekt dhe nga një dukuri jo e bukur, e papëlqyeshme, e zymtë, pa gjallëri etj., e zhvilluar mbi bazën e ndijimit të së keqes, të së mërzitshmes, herë-herë edhe të gërdisë së njeriut ndaj ditëve të stinës së pranverës me mjegull, me shi dhe të ftohtë, ndaj një individi me pamje jo të bukur, të mërzitshme, të zymtë, të ftohtë etj. Përjetimi i së shëmtuarës ndodh atëherë, kur një melodi, panorama e një pylli e parë nga larg, një pikturë etj. janë ngacmues joharmonikë, me raporte komponentësh të deformuar ndërmjet tyre etj. Ndaj këtyre ngacmuesve njeriu reagon negativisht, me pakënaqësi, me dhembshuri, që e shtyjnë atë të largohet nga objektet e këtilla.

SHËNDET, - I. m. Gjendje e mirë, normale organike, funksionale dhe psikike e individit që ka karakter relativisht të qëndrueshëm për një kohë të gjatë. Gjendja e shëndoshë manifestohet në forma të ndryshme të veprimtarisë normale të njeriut, ku ai arrin rezultate pozitive në fushëveprimet e ndryshme, që paraqesin vlera të rëndësishme për jetën e njeriut, të familjes dhe të mjedisit të ngushtë dhe të gjerë të tij.

SHËNDETI MENDOR. Tërësia e strukturave dhe e funksioneve psikike që zhvillohen normalisht në procesin e përgjithshëm të jetës dhe të aktivitetit të njeriut. Në shëndetin mental hyjnë zhvillimet normale të proceseve psikike dhe të sjelljeve të njeriut, të cilat njeriu normal është në gjendje t`i kontrollojë dhe t`i modifikojë. Pikërisht me studimin e proceseve psikike dhe të sjelljeve normale merret psikologjia dhe disa degë të posaçme

të saj, në ndryshim nga psikopatologjia që merret me studimin e çrregullimeve të funksioneve mentale dhe nga psikiatria që studion sëmundjet mentale dhe mundësinë e mjekimit dhe të shërimit të tyre. Profili i shëndetit të mirë mental dallohet sipas shkallës së zhvillimit të këtyre komponentëve: mirëqenia emocionale me përmasën e duhur të kënaqësisë dhe të stimulimit të përjetimit të saj, shkalla e arritjes së sukseseve në aktivitetin e përditshëm dhe në atë profesional, aftësia e pavarur e individit për të përcaktuar qëndrimet dhe sjelljet e veta, duke qenë i gatshëm për të refuzuar ndikimin e të tjerëve, aftësia e përcaktimit të qartë të qëllimeve të veprimtarisë, e shoqëruar me aspiratën e zhvilluar për zotërimin e tyre dhe aftësinë e baraspeshës së individit për të zhvilluar dhe kontrolluar tërësinë e integruar të proceseve psikike dhe të sjelljeve të veta. Në mjediset shqipfolëse përdoret më tepër termi shëndet mendor.

SHËRIM, - I. m. Procesi profesional i mënjanimit të shkaktarëve të sëmundjes organike psikike dhe rivendosja e shëndetit të mirë organik apo psikik te një individ i caktuar**.**

SHFAJËSIM, - I. m. Çlirimi i individit nga ndjenja e fajit dhe nga dënimi, duke argumentuar motivin, qëllimin, rrugën dhe mjetet e drejta të zbatimit gjatë veprimtarisë së tij.

SHFAQJA E DUKURIVE PSIKIKE. Sjelljet dhe veprimet objektive të një individi, procesi, vetitë dhe veçoritë psikike të këtyre sjelljeve, të cilat njeriu i shfaq. Ato janë të dallueshme dhe të vazhdueshme për të tjerët (aftësia shfaqet në zgjidhjen e suksesshme të problemeve, kujtesa shfaqet me riprodhimin e lëndës së mësuar, vullneti shfaqet me veprimet e vetëdijshme të individit për realizimin e qëllimeve të caktuara etj.).

SHFRENUAR (I, E). mb. Që përcakton një personalitet të papërmbajtur, të cilin e karakterizon tipari relativisht i qëndrueshëm dhe i përhershëm i mospërmbajtjes së dëshirave, të ndjenjave, të shumë mendimeve etj., të tij në mjedisin ku gjendet.

SHIJE, - A. f. Në fillim të përdorimit të këtij termi shija ka emërtuar procesin e ndijimit të një cilësie të trupave, por në gjuhën shqipe haset rrallë kuptimi i tillë i termit shije. Në këtë kuptim thuhet: ”Ai kishte shije për t`u veshur si duhet”, “Ajo e kishte rregulluar me shije kopshtin e shtëpisë së saj”, “Ka shije për të zgjedhur fjalët” etj. Por, kuptimi i tillë ka gjasa është ngushtuar shpejt, duke u përqendruar në shijen e ushqimit e të pijeve, në shqisën e të shijuarit dhe në ndijimin e të shijuarit.

SHIJA ESTETIKE. Term i pjesshëm i huazuar nga shija ndijimore e ushqimeve, e pijeve etj., por në estetikë ka kuptim tjetër me përmasë të theksuar psikologjike. Shija estetike është shija për të bukurën që ka të bëjë me aftësinë e mprehtë të ndjesisë së njeriut për ta dalluar të bukurën, të hijshmen, qejfleshën nga e shëmtuara, të pahijshmen, në gjësendet e natyrës, në produktet e njeriut dhe para së gjithash në krijimet artistike, për të kuptuar dhe vlerësuar të bukurën, duke ndjerë njëkohësisht kënaqësi, “lezet” të posaçëm në të bukurën. Të tilla janë shprehjet “fjalë, fytyrë, sjellje e bukur etj.”. Në këtë kuptim shija estetike

është koncept apo nocion i ndërlikuar, sepse përjetimi i shijes estetike ka të bëjë me njohjen shqisore, racionale dhe me procesin e ndjenjës së veçantë. Shija estetike nuk është e vetvetishme; ajo ka strukturë psikologjike të ndërlikuar me përmasa individuale, por shkaktohet nga kushtet, rrethanat dhe nga raportet objektive, ku zhvillohet dhe formohet njeriu me identitetin, integritetin dhe veçantinë e personalitetit të tij. Përjashtim nga zhvillimi e kultivimi i tillë i shijes estetike bëjnë ata individë që lindin me dispozita dhe me talent të veçantë për krijimtarinë e së bukurës në poezi, në muzikë, në pikturë etj. Çështja e shijes estetike është ndër më të diskutueshmet në estetikë dhe në psikologjinë e së bukurës.

SH

SHIJA NDIJIMORE. Shija e ushqimeve dhe e pijeve me të cilat njeriu shuan etjen dhe urinë dhe informacionet që ai i merr nga shkrirja kimike e ngacmuese e tyre në puprritë e gjuhës, në receptorët e gjuhës dhe në mbështjellësin e brendshëm të fytit. Baza anatomike dhe fiziologjike e shqisës së shijes është e formuar nga puprritë e të shijuarit, receptorët e shijes të lidhura me mbaresat e nervit VII dhe IX kafkor, që bartin impulse nervore përmes palcës kurrizore dhe të talamusit në qendrën e shijes së cipës së trurit të madh. Dallohen katër lloje shijesh kryesore: 1) Shija e ëmbël (karbohidratet, sheqeri, mjalti); 2) Shija e hidhur (pelini), 3) Shija e njelmët (kripa) dhe 4) Shija e thartë (uthulla). Sipërfaqja e gjuhës është bartëse kryesore e llojeve të përmendura të shijeve. Receptorët e këtyre shijeve në formën më të vrazhdë gjenden në këto pjesë të gjuhës: për shijen e ëmbël - në majë të gjuhës dhe në pjesët e përparme të saj, për të hidhurën – në pjesën e fundit të gjuhës, për të njelmëtën – në pjesën e përparme dhe në mes të sipërfaqes së gjuhës dhe për shijen e thartë – në anën e majtë dhe të djathtë të gjuhës. Në përjetimin e ndijimit të shijes ushtron ndikim shqisa e të nuhaturit.

SHIKIM, - I. m. Proces i ndërlikuar fiziologjik dhe psikologjik, të cilin e karakterizon drejtimi i syve në një shënjestër të caktuar me qëllim të vështrimit të tij. Shkaktohet nga faktorët e brendshëm e të jashtëm. Disa nga faktorët e brendshëm (interesimi, pakënaqësia, përvoja etj.) i japin shikimit të individit një veçori të theksuar psikologjike, të cilën e konstatojmë në togfjalëshat: shikimi i thellë, shikim i vrazhdë, shikim i ftohtë etj.

SHKAKËSIA MEKANIKE. Në teorinë e zhvillimit mendor të fëmijëve të Zhan Piazhes (Jean Piaget, 1896 – 1980) është fazë e zhvillimit mendor që karakterizon moshën e fëmijës për të kuptuar një varg lidhjesh ndërmjet trupave dhe që fëmija vlerëson se një trup është shkak i lëvizjes së trupit tjetër. Kështu, kur një top loje gjatë lëvizjes i bie topit tjetër, topi i parë është shkak i lëvizjes së topit të dytë.

SHKALL/Ë, - A. f. Term që haset shpesh në literaturën e psikologjisë si edhe në krijimet letrare në gjuhën shqipe, sidomos në gjuhën angleze. Në psikologji me termin shkallë emërtohet instrumenti klasifikues, sistemi i përkufizuar i vlerave dhe renditja e tyre sipas një parimi që mundëson vendosjen e një dukurie, intensiteti të një ndryshoreje, vlere etj. në vendin e merituar ose vendosjen e rezultateve

të arritura në një varg arritjesh paravajtëse apo progresive. Shkalla ka karakter matës, përkatësisht me anën e saj përcaktohet saktësisht rendi i vlerave, dallimi i një pike vlerësuese nga pika tjetër dhe përmasa e këtij dallimi në madhësitë e përkufizuara.

SHKALLA A – S. Shkurtesë për shkallën e antisemitizmit (e ardhur nga anglishtja *antisemitism scala*). Shkalla A – S mat mosdurimin dhe armiqësinë ndaj hebrenjve, që shprehen me qëndrime negative ndaj tyre. Kjo shkallë përbëhet nga pesë nënshkallë me 52 pohime negative për hebrenjtë. Nënshkalla e parë përmban pohimin se hebrenjtë janë: agresivë, hedonistë, mendjemëdhenj, të papastër etj. Shkalla e dytë përmban pohimin: hebrenjtë janë të rrezikshëm, të prirë për revolucion, të vrazhdë etj. Shkalla e tretë përbëhet nga pohimet që kanë të bëjnë me qëndrimin se ndaj hebrenjve duhet zhvilluar diskriminim; Shkalla e katërt përmban pohimin: hebrenjtë ndahen shumë nga mjedisi shoqëror dhe nënshkalla e pestë përmban pohimin se hebrenjtë depërtojnë deri në nivele të larta ekonomike, shoqërore etj. U hartua nga filozofi, psikologu dhe sociologu gjerman Teodor V. Adorno (Theodor W. Adorno, 1903 – 1969).

SHKALLA ADITIVE. Vlerat numerike të disa matjeve të një ndryshoreje psikologjike të paraqitura në shtylla, ku vlera numerike e ndryshores së tretë është shuma e vlerës numerike të ndryshores së parë me të dytën, vlera numerike e ndryshores së katërt është shuma e vlerës numerike të ndryshores së parë me të dytën dhe me të tretën, e kështu me radhë.

SHKALLA BEJLI E ZHVILLIMIT TË FËMIJËS. Shkallë vlerësuese e zhvillimit të fëmijëve të moshës shumë të re, përkatësisht të moshës prej ditës së lindjes deri në mbarim të muajit 42. Shkalla Bejli është formuar nga reagimet e foshnjave ndaj ngacmuesve me lëvizje, vëmendje, drejtim të kokës e të trupit, eventualisht edhe të pjesëve të tij, si edhe me reagim emocional ndaj ngacmuesve. U hartua nga psikologu amerikan i psikologjisë fëmijërore Nensi Bejli (Nancy Bayes, 1899 -).

SHKALLA BINE–SIMON PËR MATJEN E INTELIGJENCËS. Testi i parë i ndërlikuar për matjen e shkallës së zhvillimit të inteligjencës. Me anë e tij provohet dhe vlerësohet shkalla e zhvillimit të aftësisë së përgjithshme mendore ose inteligjenca, gjegjësisht faktori i përgjithshëm, faktori gjeneral (Gj) ose, sipas Alfred Bine totali i inteligjencës përbën tërësinë e normuar moshore të matjes së inteligjencës të fëmijëve të moshës shkollore. Testi i tillë u hartua nga ana e Alfred Bines (Alfred Binet, 1857 – 1910) dhe Teodor Simonit (Theodore Simon, 1873 – 1961). Testi i tillë shënoi fillimin e lëvizjes së organizuar për zhvillimin e psikologjisë zbatuese ose aplikative dhe të psikometrisë. Mbështetet në përcaktimin e Bines për karakterin sintetik dhe unitetin psikik të njeriut dhe të aftësive të tij, që përbëhen prej këtyre komponentëve të inteligjencës (kuptimi, drejtimi, zbulimi dhe vetëkritika), në mundësinë e matjes së inteligjencës dhe në përcaktimin e shkallës së zhvillimit të saj te njeriu, gjegjësisht te fëmija i caktuar me anën e përcaktimit të moshës mendore të tij. Shkalla Bine–Simon për matjen e inteligjencës

është rezultat i punës eksperimentale dhe psikometrike të dy bashkëpunëtorëve të përmendur. Këtë punë e kryen sipas kërkesës së Ministrisë së Arsimit të Francës për nevoja praktike të procesit edukativo - arsimor: për ndarjen e fëmijëve, të cilët nuk ishin në gjendje të përvetësonin me sukses programin mësimor të shkollës fillore krahasuar me të tjerët. Kësaj kërkese i janë përgjigjur me sukses Alfred Bine dhe Teodor Simoni. Me këtë shkalë maten ndryshimet individuale ndërmjet fëmijëve me shkallë të ndryshme të zhvillimit të aftësive të tyre, duke përfshirë edhe dallimin ndërmjet të aftëve dhe të prapambeturve nga pikëpamja mendore. Shkalla Bine – Simon për matjen e inteligjencës vlerësohet si njëra ndër zbulimet më të rëndësishme në historinë e psikologjisë. Më 1908 realizuan ndryshimin dhe plotësimin e saj, kurse më 1911 revizionin e tërësishëm të kësaj shkalle. E njëjta është përshtatur nga Levis M. Terman (Lewis M. Terman, 1846 – 1908) në SHBA, nga Eduard Klapared (Edouard Claparedo, 1873 – 1940) në Zcvicër, nga Uiliam Shtern (William Stern, 1871 – 1938) në Gjermani, Siril Bert (Cyril Burt, 1883 – 1971) në Angli etj. Rrjedhimisht me pikëpamjen e Alfred Bines për karakterin e ndërlikuar të "totalit të inteligjencës" ai hartoi një varg detyrash dhe problemash të shumëllojshme, zgjidhja me sukses e të cilave tregon rezultatin e përgjithshëm të zhvillimit të inteligjencës, dhe jo vetëm shkallën e zhvillimit të një komponenteje ose të një "fuqie"psikike" (p.sh., të kujtesës). Kjo shkallë mat zhvillimin e inteligjencës së fëmijëve të moshës 3 – 15-vjeçare dhe atë të të rriturve. Detyrat dhe problemat janë ndarë sipas moshës së fëmijës. Për secilin vit të moshës së fëmijës janë përcaktuar 5 detyra e problema, të cilat në studimin paraprak i kanë zgjidhur me sukses 75 % e fëmijëve të provuar. Shih - ***SHKALLA STANFORD – BINE.***

Burimet:

Alfred Binet & Theodore Simon: *"La Mesure – du developpement de I`intelligence chez les jeunes enfants"* – ("Matja – Zhvillimi i inteligjencës te fëmijët e vegjël", A. Colin – Bourrelier, Paris, 1905.

Alfred Binet & Theodore Simon*: "Testet – Inteligjenca e fëmijëve",* Tiranë, 1998 (botimi i dytë Tiranë, 2002).

Joy P. Guilford: *"The Structure of Intellect"* – (*"Struktura e intelektit"*), Psych. Bullet. Nr. 4. V. 53. 1955.

Luis M. Terman & Maud A. Merrill: *"Stanford – Binet Manuel for the Third Revision"* – (*"Doracaku i rishikimit të tretë të shkallës Stanford – Bine"*), Boston, 1960.

Sotir Temo: *"Psikologjia e aftësive – A është i aftë fëmija juaj? Përse është i aftë?",* Korçë, 2002.

Pajazit Nushi: *"Psikologjia e Përgjithshme 1",* Prishtinë, 2002, fq. 406 – 438.

Ylli Pango*: "Psikologjia e aftësive matematike",* Shkenca dhe Jeta. Nr. 4, Tiranë, 1986.

SHKALLA BOGARDUS. Shkallë që mat nivelin e gatishmërisë të një individi për të pranuar afërsinë dhe distancën shoqërore të tij ndaj individëve të tjerë të një etnie, feje, gjinie, kombi e të një race tjetër. Kjo shkallë mbështetet në parimin e gradualizimit brenda kufijve: "e pranoj për bashkëshort (pavarësisht nga përkatësia etnike, kombëtare e racore)", ose "këta duhen dëbuar nga fshati, rruga, qyteti dhe nga vendi im". Shkalla u hartua nga sociologu amerikan Emori S. Bogardus (Emory S. Bogardus, 1882 – 1973). Kjo shkallë emërtohet edhe me termin shkalla e distancës sociale.

SHKALLA C. Shkallë matëse e rezultateve të arritura nga ana e një individi. Shkalla C përftohet me anë të bazhdarimit të një testi, duke shndërruar shmangien standard mbi bazën e shpërndarjes normale të të dhënave. Shkalla C ka 11 klasa të dhënash; fillon prej 0 dhe përfundon në nivelin më të lartë, përkatësisht në nivelin 10, duke u shtrirë prej vlerës 2.75 të shmangies standarde nën vlerën e së mesmes aritmetike dhe arrin deri në 2.75 mbi vlerën e së mesmes aritmetike.

SHKALLA E ANKTHIT MANIFESTUES. Shkallë që merret me matjen e nivelit të ankthit të pavetëdijshëm. Përbëhet nga përshkrimi i disa simptomave të ankthit dhe nga subjekti kërkohet të përcaktohet cilat nga ato simptoma janë karakteristike për veten e tij. Në mbështetje të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave përcaktohet niveli i ankthit të pavetëdijshëm të një subjekti.

SHKALLA E ETNOCENTRIZMIT. Shkallë e hartuar me qëllim matjen e qëndrimeve të mbivlerësuara për përkatësinë etnike të vetë subjektit dhe përcaktimin e nivelit të nënvlerësimit të etnive të tjera, përkatësisht të anëtarëve të etnive kufitare, si edhe të atyre që i përkasin pakicave apo minoriteteve të etnive të tjera. Përbëhet nga tri nënshkallë: 1) Nënshkalla e parë që gjurmon paragjykimet dhe sjelljet stereotipike ndaj zezakëve; 2) Nënshkalla e dytë që gjurmon paragjykimet sjelljet stereotipike ndaj popujve të tjerë, ndaj pakicave dhe ndaj të huajve në një vend dhe 3) Nënshkalla e tretë që përbëhet nga pohimet për idealizimin e virtyteve dhe tipareve pozitive etnike të vetë individit. Në mbështetje të rezultateve të përftuara nga përpunimi i të dhënave nga zbatimi i kësaj shkalle përcaktohet niveli i etnocentrizmit të një subjekti. Shkalla u hartua nga Teodor V. Adorno me bashkëpunëtorë.

SHKALLA E GJURMIMIT TË NDRYSHIMEVE TË BOTËKUPTIMIT. Shkalla e matjes dhe e vlerësimit të botëkuptimit të vetë njeriut dhe kënaqësisë së subjektit me këtë botëkuptim. Nga subjekti kërkohet që në këtë instrument ta përcaktojë vetë mënyrën më të mirë dhe më të keqe të jetesës së tij. Këtë e bën duke përzgjedhur pikën e shkallës ndër dhjetë nivele. Këtë pozicion mund ta krahasojë me atë para një-, dy-, apo tri viteve, duke u bërë i vetëdijshëm për evoluimin e botëkuptimit të tij.

SHKALLA E MAKIAVELIZMIT. Shkallë që mat tiparin e njeriut me sjellje të organizuara dhe të drejtuara vetëm në dobi të tij dhe të rrethit të tij më të ngushtë, që u hartua mbi parimin "qëllimi arsyeton mjetin". Përbëhet nga pohimet e shkruara që i afrohen subjektit për të përcaktuar tiparin e vet, se në ç`masë qëllimi arsyeton mjetin, duke përfshirë edhe manipulimin e padrejtë me të tjerët. U hartua nga psikologët amerikanë Rikard Kristi (Richard Christiie, 1918 – 1992) dhe nga Florenc Geis (Florence L. Geis, 1933 – 1992). Mori emërtimin nga mendimtari italian Nikola Makiaveli (Niccolo Meciawelli, 1469 – 1527**).**

SHKALLA E RANXHIMEVE. Shkallë që i përket shkallëve ordinare. Ka të bëjë me renditjen e të dhënave sipas një parimi, ku mbeten të panjohura dallimet ndërmjet përbërësve të ranxhuar. E këtillë është shkalla e

ranxhimit të nxënësve sipas suksesit të arritur të secilit në fund të vitit shkollor etj. Shkalla e ranxhimeve nuk është e saktë, sepse e njëjta notë e arritur nga disa nxënës nuk tregon se këta kanë dije të njëjta dhe dallimi ndërmjet notës 2 e 3 është më i madh se ndërmjet notës 4 e 5.

SHKALLA E STUDIMIT TË VLERAVE. Shkallë e hartuar për matjen e nivelit të zhvillimit të vlerave, duke u mbështetur në gjashtë vlerat e sistemit konceptual të mendimtarit gjerman Eduard Shpranger (Eduard Spranger, 1882 – 1963). Gjurmuesit Gordon V. Olport (Gordon W. Allport, 1897 – 1967), Filip Vernon (Philip Vernon, 1905 – 1987) dhe Gardner Lindzi (Gardner Linzey, 1920) hartuan shkallën e vlerave personale, duke u nisur nga bindja se personaliteti njihet mirë, nëse provohet ardhmëria e tij. Kjo shkallë përbëhet nga 45 detyra dhe subjekti duhet të bëjë përzgjedhjen e orientimit të vlerave të tij sipas sistemit të vlerave ekonomike, estetike, politike, shoqërore religjioze dhe teorike. Mbi bazën numerike të pikave të fituara për këto orientime të vlerave të subjektit përcaktohet edhe psikografi i vlerave të subjekteve.

SHKALLA E VAZHDIMËSISË. Kjo është shkallë matëse e vazhdimësisë së ndryshimeve të një ndryshoreje psikologjike, ku ndryshimet e pandërprera maten me njësi vlerash diskrete. Shkalla e vazhdimësisë mat ndryshoret, kur këto pësojnë ndryshime të mëdha ose të vogla brenda një intervali kohor të caktuar.

SHKALLA E VETËVLERËSIMIT. Shkallë e përbërë nga 29 çifte pohimesh, ku subjekti duhet të bëjë përzgjedhjen e atyre që beson se karakterizojnë veten e tij. Në njërin çift përcaktohet sjellja e shkaktuar nga fati, rrethanat e subjektit, kurse çifti tjetër përcakton sjelljet e subjektit, që ai ia atribuon aftësive dhe energjisë motivuese të tij. Sipas përcaktimeve të shënuara në këtë instrument matës (zakonisht pyetësori) identifikohet niveli i njohjes së sjelljeve të subjektit nga ana e tij. U hartua nga psikologu amerikan Xhulian B. Roter (Julian B. Rotter, 1916).

SHKALLA E VLERËSIMIT. Shkalla numerike e matjes së vlerës së qëndrimeve dhe e nivelit të zhvillimit të tyre. Shkalla e vlerësimit të qëndrimeve të një subjekti përcaktohet në bazë të vlerësimit që i bëjnë përgjigjeve disa vlerësues. Me këtë shkallë maten qëndrime të ndryshme, si: qëndrimi ndaj abortit, aparteidit, dënimit me vdekje, ndaj homoseksualizmit etj.

SHKALLA E ZBULIMIT TË GËNJESHTRAVE. Një nga nënshkallët e Inventarit Multifazor të Minesotos për Personalitetin (MMPI). Kjo nënshkallë përbëhet nga njësi testore të hartuara në atë mënyrë që të arrihet në zbulimin e orvatjeve të personalitetit, për ta paraqitur të gënjeshtërt personalitetin e tyre pozitiv, kurse në të vërtetë ai me këtë pohon të pavërteta.

SHKALLA E ZHVILLIMIT TË ASPIRATAVE. Masë e brendshme e njeriut, sipas së cilës ai vlerëson shkallën e arritjes së suksesit në një fushë të veprimtarisë, sidomos të veprimtarisë krijuese të tij. Kjo shkallë apo nivel i zhvillimit të aspiratës është pika më e lartë e suksesit që pret një individ për

të arritur në një fushëveprimi të posaçëm. Ky individ synon të përcaktojë pikën më të lartë të shkallës së aspiratës, duke marrë për bazë përvojën dhe besimin në aftësitë e veta. Niveli i zhvillimit të aspiratës matet duke u mbështetur në krahasimin e suksesit që ai pret dhe çfarë ai ka arritur konkretisht në fushëveprimin e tij. Suksesi real e ngre nivelin e aspiratës, kurse seria e mossuksesit e ul këtë nivel. Shkalla e zhvillimit të aspiratës ka fuqi të madhe motivuese.

SHKALLA F. Shkalla standard e hulumtimit të tipareve të personalitetit që i pranojnë qëndrimet e ideologjisë jodemokratike dhe antidemokratike. Shkalla F mat nivelin e autoritetit të një individi ndaj një sistemi ideologjik ose ndaj një politike të caktuar antidemokratike. Shkalla F përbëhet prej 38 pohimeve të grupuara në 8 nënshkallë. Hartues i shkallës F ka qenë filozofi, sociologu dhe psikologu gjerman Teodor Adorno (Theodor Adorno, 1903 – 1969). Kjo shkallë u hartua si fillim për të matur qëndrimet ndaj fashizmit dhe prej këtyre mori emërtimin shkalla – F.

SHKALLA GRAFIKE. Shkallë e përbërë nga shtrirja vizore apo grafike e ndarë në vijëza të shkurtra vertikale largësish të barabarta (prej 4 – 14 cm), përkatësisht në 5 – 7 pjesë, që emërtojnë intensitetin e një dukurie, qëndrimi, tipari etj. prej nivelit më të ulët deri në atë më të lartin. Vlerësuesi ka për detyrë të përcaktojë vendin a vendndodhjen e përfaqësimit të dukurisë, të qëndrimit, të tiparit në shtrirjen vertikale, prej nivelit minimal të anës së majtë deri në atë maksimal të skajit të djathë në fund të kësaj vize. Sa më larg nivelit minimal përcaktohet vlerësuesi, aq më të zhvilluar e ka dukurinë, qëndrimin apo tiparin e personalitetit të provuar.

SHKALLA I – E. Shkalla introversion dhe ekstraversion që mat shkallën e shtrirjes së një tipi të personalitetit në kuadrin intraversion dhe ekstraversion, duke përcaktuar në këtë mënyrë pozicionin e atij personaliteti në shtrirjen introversion–ekstraversion. Shkalla I – E është marrë nga struktura e ***INVENTARIT MULTIFAZOR I MINESOTOS PËR PERSONALITETIT*** **I** – shih.

SHKALLA KLINIKE. Shkalla klinike emërton sistemin e pyetjeve dhe të detyrave të atyre testeve, të cilët masin nivelin e pranisë së tipave të veçantë të sjelljeve jonormale.

SHKALLA MAH. Shkalla gjurmuese e stileve të sjelljes ndërmjet individëve. Kjo shkallë përbëhet nga një varg pohimesh që shpjegojnë se si duhet sjellë me njerëzit për t`i manipuluar ata me sukses. Nga subjektet provues kërkohet që të japin pëlqimin ose mospëlqimin dhe, në bazë të shumës së pikëve pohuese ose mohuese përcaktohet stili i manipulimit me ata njerëz. Shkalla Mah është hartuar nga psikologu amerikan Riçard Kristi (Richard Christie, 1818 – 1922). Shih - ***MAKIAVELIZMI.***

SHKALLA MASHKULL – FEMËR. Instrument psikologjik për matje të tipareve gjinore të njeriut. Shkalla ka karakter shtrirës bipolar. Përbëhet nga pohimet antropologjike që janë tipare karakteristike të organizmit dhe të sjelljeve të gjinisë mashkullore dhe të asaj femërore të mjedisit shoqëror e kulturor të tij. Nga subjekti që i nënshtrohet testimit të këtillë kërkohet të

përgjigjet me cilat pohime pajtohet dhe me cilat nuk pajtohet. Numri më i madh i pohimeve për trupin mashkullor dhe sjelljet mashkullore që anojnë në krahun mashkullor tregon vlerësimin për përkatësinë gjinore të subjektit, ndërkaq kur numri më i madh i përgjigjeve i përket anës femërore, subjekti, pavarësisht cilës gjini antropologjike i takon, i përket gjinisë me sjellje femërore. Kjo shkallë zakonisht paraqitet në literaturën e psikologjisë me shkurtesën shkalla - MF.

SHKALLA NOMINALE. I ardhur nga latinishtja *nomen* "emër". Shkallë e përcaktimit të përkatësisë së një individi, të një vetie psikike, të intensitetit të zhvillimit të një cilësie etj., të një klase të caktuar, por të përkufizuar saktësisht. Shkalla nominale është shkalla më e thjeshtë dhe më e vrazhdë e përcaktimit të përkatësisë së individëve, të vetive, të cilësisë së të dhënave të një ndryshoreje etj., që ka të bëjë me përkufizimin e klasës së caktuar dhe me vendosjen e secilit individ, të secilës së dhënë në klasën përkatëse. Shkalla nominale jep vetëm klasifikimin, ndarjen e të dhënave individuale në klasa të kufizuara saktësisht, duke mundësuar operacionet statistikore të thjeshta (sasinë e të dhënave të përftuara nga matja e tyre në klasa të ndara sipas kritereve të caktuara). Secila e dhënë mund t`i përkasë vetëm një klase. Zbatimi i shkallës nominale në përpunimin e të dhënave bëhet e mundshme duke bërë ndarjen e të dhënave sipas emrit të klasës së caktuar (m = mashkull, f = femër), por jo sipas raporteve sasiore ndërmjet tyre.

SHKALLA NUMERIKE. Lloj i shkallës matëse të qëndrimeve, tipareve etj. që përbëhet nga një varg numerik i shtrirë prej nivelit më të ulët (nivelit 0) deri në nivelin më të lartë (niveli 10). Detyra e subjektit është të përcaktohet cilës vlerë numerike i përket intensiteti, ngopja e qëndrimit të caktuar ndaj një grupi, partie, sekti etj. të një individi ndaj tyre.

SHKALLA ORDINARE. Shkallë matëse e madhësisë së qëndrimeve, të interesave, të vlerave etj. Shkalla ordinare është ndër instrumentet matës më të thjeshtë. Kjo shkallë tregon vetëm se cila madhësi është më e madhe, e cila madhësi është më e vogël, por nuk paraqet në mënyrë specifike largësinë e saktë të një njësie nga një tjetër.

SHKALLA PËR MATJEN E INTELIGJENCËS VEKSLER – BELVI. Tërësi testesh për matjen e aftësive verbale dhe të aftësive joverbale të inteligjencës. Njihet me shkurtesën WAIS. Mbështetet në konceptin e testit Bine – Simon. Shkalla Veksler – Belvi ka dy forma kryesore: shkallën për matjen e inteligjencës së të rriturve dhe shkallën për matjen e inteligjencës së fëmijëve. E para përbëhet prej testesh të formuluara me fjalë (shkalla e përgjithshme e informimit, fjalori, detyrat aritmetike, detyrat e të kuptuarit të situatave, të ngjashmërive etj.) dhe prej pesë testesh joverbale (plotësim figurash, përputhje kockash të formës kubike, orientimi hapësinor etj.). Ka formën 1 e 2 të saj. U hartua nga psikologu amerikan Dejvid Veksler (Dawid Wecksler, 1896 – 191981) dhe u botua për herë të parë më 1929.

Burimet*:*

David Wecksler: *"The Measurement of Adult Intelligence"* – (*"Matja e inteligjencës së të rriturve"),* Baltimor, 1939.

David Wecksler: *"Wecksler Adult Intelligence Scale"* – (*"Shkalla Ueksler e inteligjencës së të rriturve"*), New York, 1955.
Pajazit Nushi: *"Inteligjenca dhe masa e zhvillimit të saj te Shqiptarët e moshës madhore"*, Prishtinë, 2008.

SHKALLA PËRSHKRUESE. Lloj i shkallës matëse që karakterizohet me përcaktime të sjelljeve të shkallëzuara në mënyrë cilësore, si: jashtëzakonisht dorëlirë, dorëlirë, as dorëlirë as doreshtrënguar, dorë shtrëngues dhe jashtëzakonisht doreshtrënguar. Nga subjekti kërkohet të përcaktojë sjelljen e një individi tjetër a të individëve të tjerë, në mbështetje të dijeve që ka ai për të tjerët.

SHKALLA RACIO. Shkallë matëse më e përsosura, e njohur edhe me termin shkalla absolute. Shkalla Racio ka pika, proporcione me largësi saktësisht të ndara njëra prej tjetrës, që mundëson që të dimë nëse një ndijim jo vetëm është më i madh ose më i vogël, por për sa njësi matëse ai është më i madh ose më i vogël, duke filluar nga pika 0. Shkalla Racio është metri, grami, termometri etj. Kështu, kur themi një gjësend është i rëndë 20 gr. Kuptojmë se ai është dy herë më i rëndë se gjësendi tjetër me peshë prej 10 gr. Në psikologji shkallët e këtilla matëse janë të rralla, përkatësisht këto i hasim pjesërisht në psikofizikë, por jo edhe në matjen e aftësive, të tipareve të individualitetit etj.

SHKALLA STANFORD-BINE. Test i Universitetit të Stanfordit në SHBA, i përshtatur nga psikologët francezë Alfred Bine (Alfred Binet, 1857 – 1911 e Teodor Simoni (Theodore Simone, 1873 – 1918), nga psikologu amerikan Luis M. Terman (Louis M. Terman, 1877 – 1956) dhe kolegë të tij për matjen e inteligjencës së banorëve të mjedisit kulturor e gjuhësor të SHBA-s. Përshtatja e tij u bë më 1916 dhe në thelb më tepër është hartim origjinal se përshtatje e shkallës Bine – Simon. Kjo shkallë pësoi ndryshime edhe më të mëdha më 1937, më 1960 dhe më 1986. Më 2003 u publikua botimi i pestë i kësaj shkalle. Shih - ***SHKALLA E MATJES S INTELIGJENCËS BINE – SIMON.***

SHKALLA T. Shkalla e përftuar nga shndërrimi i shmangies në bazë të shpërndarjes së arritjeve sipas formës normale të tyre. Mesatarja aritmetike e rezultateve të përgjithshme ose e rezultateve bruto është vlera T 50, kurse njësia e shkallës T është një e dhjeta e shmangies standard ose shmangies kuadratike të rezultateve të përgjithshme ose e rezultateve bruto. Kjo shkallë shtrihet prej 0 (pesë njësi të shmangies standard nën mesataren aritmetike) deri në 100 (pesë njësi të shmangies standard mbi mesataren aritmetike). Përcaktimi i vlerave individuale me anë të shkallës T është e mundur kur shpërndarja e të dhënave përputhet me normalen e shpërndarjes së tyre dhe në bazë të proporcioneve kumulative të arritjeve në test. Kjo është shkalla më e sigurt e bazhdarimit të testeve.

SHKALLA TYMPANI. Term i anatomisë së veshit i ardhur nga latinishtja. Pjesë e kanalit spiral të kërmillit të veshit. Shih - ***KËRMILLI I VESHIT.***

SHKALLA VESTIBULARE. Në anatominë e veshit njihet me termin latin *scala vestibule*. Emërton një nga tri kanalet e labirintit, që është i mbushur

me lëng të posaçëm dhe përçon dridhjet ose vibrimet nga yzengjia, që është një ndër eshtrat e veshit të mesëm në organin e Kortit, ku dridhjet shndërrohen në impulse nervore.

Burimet:

Robert S. Woodworth: *"Experimental Psychology"* – (*"Psikologjia eksperimentale"*), Columbia University, 1938 (kapitulli VII).

Chales E. Osgood: *"Method and Theory in Experimental Psychology"* – (*"Metoda dhe teoria në psikologjinë eksperimentale"*), Oxford University, New York, 1953.

Edward Ch. Tolman: *"Purposive behavior in animals and men"* – (*"Qëllimi i sjelljeve te kafshët dhe njeriu"*), Apleton – Century – Crofts, New York, 1932.

Ethem Ruka: *"Fiziologjia e gjallesave shtazore"*, shblu, Tiranë, 1998.

SHKALLA VESTIBULI. Term i anatomisë së veshit i përdorur në psikologjinë fiziologjike me të njëjtin emërtim *scala vestibule*. Pjesë e kanalit spiral të kërmillit të veshit të brendshëm. Kështu emërtohet njëri nga tri gypat gjysmë harkor të ndërlidhur, që së bashku formojnë kërmillin. Shkalla vestibuli ndahet nga shkalla e dytë, shkalla media me anë të cipës vestibulare. Shih - ***KËRMILLI I VESHIT.***

SHKALLËT BIPOLARE. Shkallë që shërbejnë për përshkrimin identifikues të tipareve të personalitetit dhe matjen e shkallës së zhvillimit të atyre tipareve që kanë shtrirje ndërmjet dy poleve: prej atij negativ -1 nëpërmjet pikës asnjanëse O deri në skajin fundor të polit pozitiv +1. Pika asnjanëse ose neutral[e, përkatësisht ajo që gjendet ndërmjet – 1 dhe +1 edhe pse shënohet me O nuk përputhet me pikën zero të zhvillimit të atij tipari, por është pikë cilësore asnjanëse.

SHKALLËT E MATJES SË QËNDRIMEVE. Emërtim i instrumenteve psikologjike të hartuara për matjen e valencës pozitive ose negative të një qëndrimi. Këto instrumente përbëhen nga një varg i vogël pohimesh dhe mohimesh të renditura sipas intensitetit të tyre. Nga subjektet kërkohet të përcaktojnë për pëlqimin ose mospëlqimin e atij qëndrimi, si edhe për nivelin ose shkallën e pëlqimit, përkatësisht të mospëlqimit të atij qëndrimi. Në bazë të përgjigjeve përcaktohet qëndrimi i individit ndaj objektit provues të qëndrimeve dhe shkalla e besimit dhe e bindjes për atë qëndrim. Në psikologji bëhet fjalë për tri lloje shkallësh të matjes së qëndrimeve.

a. **Shkalla Gutman** – Shkallë njëpërmasore e matjes së qëndrimeve, me anën e së cilës përcaktohet një aspekt i raportit ndaj objektit të qëndrimit. Te kjo shkallë shkallëzohen ose ranxhohen përgjigjet sipas intensitetit të gatishmërisë ose prirjes së reagimit dhe nga subjekti kërkohet të vendoset për njërën nga përgjigjet e dhëna. Përgjigja e dhënë nënkupton edhe pranimin e përgjigjeve paraprake me intensitet më të ulët. Për këtë shkak shkalla Gutman quhet edhe shkalla kumulative. U hartua nga psikologu amerikan Luis H. Gutman (Louis H. Guttman, 1916 – 1987);

b. **Shkalla e Likertit** – Shkallë që përbëhet nga 15 – 20 pohime që shprehin qëndrim pozitiv ose negativ ndaj një objekti të caktuar. Nga subjektet kërkohet që ndaj secilit pohim të shprehin shkallën ose nivelin e besimit dhe të bindjes, duke filluar nga 1 – 5, si: 1 = pajtohem plotësisht, 2 = pajtohem, 3

= nuk mund të vendos, 4 = nuk pajtohem dhe 5 = nuk pajtohem kurrsesi. Qëndrimi i subjektit përcaktohet duke mbledhur përgjigjet prej 5 – 1 për qëndrimin pozitiv dhe ato prej 1 – 5 për qëndrimin negativ. Vlera e përgjithshme e qëndrimit të një individi përftohet duke mbledhur vlerat individuale të secilit pohim apo mohim. Më pas llogaritet interkorrelacioni ndërmjet të gjitha përgjigjeve pozitive dhe rezultatit të përgjithshëm. Ato pohime apo përgjigje që kanë shkallë të lartë të korrelacionit me rezultatin e përgjithshëm tregojnë për qëndrimin e caktuar dhe bëjnë më së miri dallimin ndërmjet subjekteve për qëndrimin që matet. Rezultatet e përftuara janë të përshtatshme për analizën faktoriale. U hartua nga psikologu amerikan Rensis Likert (Rensis Likert, 1903 – 1981);

c. **Shkalla Therston** – Shkallë që mat qëndrimet e ndryshme ndaj demokracisë, religjionit, racizmit etj. Në këtë shkallë pohimet janë të graduara dhe të larguara njëra nga tjetra me largësi vlerësuese të njëjtë të përcaktuar nga një numër vlerësuesish. Kjo shkallë përbëhet nga një numër relativisht i madh (rreth 20 njësi) pohimesh të përzgjedhura nga një sasi e madhe qëndrimesh të shumë subjekteve, që përfaqësojnë nuancat dalluese të atij qëndrimi. Pranimi i njërës përgjigje apo pohim tregon pikën e saktë numerike të qëndrimit pozitiv, përkatësisht të refuzimit të atij qëndrimi ose të qëndrimit negativ. Shkalla e intensitetit të një qëndrimi sillet prej pikës fillestare 1 – 11, pika e fundit e përmbajtjes dhe e intensitetit të atij qëndrimi. Shkallën vlerësuese e përcaktojnë personat e vlerësimit. Vlera e përgjithshme e një qëndrimi përcaktohet duke mbledhur vlerat individuale me të cilat subjekti pajtohet. Shkalla Therston është e ndërlikuar. Quhet shkalla e intervaleve të njëjta, por është vështirë të përcaktohet intensiteti vlerësues i njëjtë ndërmjet shkallës 1 – 2 dhe asaj 10 – 11. U quajt sipas hartuesit të saj, psikologut amerikan Luis L. Therston (Louis L. Thurstone, 1887 – 1955).

Burimi:

Gordon Allport: *"The Natyre of Prejudice"* – (*"Natyra e paragjykimeve"),* 1954.

Ben Reich & Christine Adcock: *"Values, Attitudes and Behavior Change"* – (*"Vlerat, qëndrimet dhe ndryshimi i sjelljeve"*), Methuen, London, 1976.

Kevin Veldal*: "Social Behavior* – (*"Sjellja shoqërore"),* Methuen, London, 1975.

Edmond Dragoti: *"Psikologjia sociale"* Tiranë, 1999, fq. 153 – 285.

Martha Cottam & Beth Dietz–Uhler & Elena Mastors & Thomas Preston: *"Introduction to Political Psychology"* – (*"Hyrje në psikologjinë politike"*), 2009, fq. 37 – 61.

Robert Serpell: *"Culture`s Influence on Behaviour"* – (*"Ndikimi i kulturës në sjellje"*), Methuen, London 1976.

SHKALLËT E QËNDRIMEVE. Instrument psikologjik që nxit shfaqjen e qëndrimit ndaj një institucioni ekonomik, politik e shoqëror, ndaj lëvizjeve politike, ndaj një personaliteti të caktuar etj. Zbatimi i drejtë i këtij instrumenti kërkon nga subjekti që provohet të përcaktojë vendndodhjen e qëndrimit të tij pozitiv ose negativ ndaj objektit që shpreh qëndrimin e tij. Kur shkalla e këtillë është e standardizuar subjekti përcakton saktësisht vendndodhjen e tij, përkatësisht të qëndrimit ndaj objektit ku provohet qëndrimi i subjektit. Të këtilla janë shkalla e Gutmanit, e Likertit dhe shkalla e Therstonit**.**

SHKALLËT E PJEKURISË SHOQËRORE. Shkallët e vlerësimit e të përvetësimit të sjelljeve, të shkathtësive, shprehive dhe të arritjes së pavarësisë së fëmijëve të moshave të ndryshme. Më e njohura është shkalla Dall, që përfshin disa shkathtësi, si: të pastruarit e duarve, të faqeve, të trupit, të ushqyerit e pavarur dhe sipas orarit të caktuar, të veshurit e duhur me kohë, të kryerit e disa detyrave të shtëpisë, të fqinjëve etj. Shkalla Dall nuk është kompetente për matjen e pjekurisë shoqërore të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Për vlerësimin e këtyre fëmijëve shfrytëzohen shkallë të tjera.

SH

SHKALLËT E TË MËSUARIT. Të mësuarit e përmbajtjes së një lënde me qëllim të zotërimit të plotë të saj. Ky proces kalon nëpër disa shkallë: 1) Shkalla e gjurmëve nervore të asaj që mësohet, 2) Rinjohja, 3) Riprodhimi i pavarur dhe 4) Shkalla e riprodhimit automatik të përmbajtjes së zotëruar. Në shkallën e parë të të mësuarit gjenden ato përmbajtje të cilat mezi njihen nga individi, kur ballafaqohemi edhe një herë me to. Ndërkaq, kjo shkallë e të mësuarit të përmbajtjeve nuk është padijeni e tyre, sepse ai që i rimëson këto përmbajtje ka përshtypjen se nuk janë krejtësisht të panjohura. Madje, po qe se rishtas mësohen të njëjtat gjëra, nevojitet kohë më e shkurtër dhe më pak përsëritje se të mësuarit e të njëjtave përmbajtje, me të cilat ballafaqohen për herë të parë. Harresa në këtë shkallë të të mësuarit është shumë e fuqishme. Në shkallën e rinjohjes së përmbajtjeve të mësuara hasen dije që, kur ballafaqohemi rishtas me to, jemi plotësisht të sigurt se janë të njohura për ne, por nuk jemi në gjendje t`i riprodhojmë. Efekti i harresës është i nivelit të lartë. Në shkallën e riprodhimit të pavarur gjenden ato përmbajtje të lëndëve mësimore nga shkencat natyrore-teknike, shoqërore, të artit etj., që mund t`i përsërisim në mënyrë krejtësisht të pavarur në çdo situatë, sa herë që të jetë nevoja, duke qenë plotësisht të vetëdijshëm se përmbajtjet e tyre janë zotëruar plotësisht nga ana jonë. Harresa ushtron ndikim të kufizuar në zhdukjen e gjurmëve nervore për këto përmbajtje. Shkalla më e lartë e të mësuarit të përmbajtjeve mësimore është niveli i riprodhimit gati automatik të tyre, duke harxhuar energji mendore të pakët dhe me një kontroll minimal të vetëdijshëm gjatë riprodhimit të tyre. Në këtë nivel të të mësuarit zakonisht gjenden shprehitë. Shkallën e të mësuarit, të përvetësimit dhe të zotërimit të përmbajtjeve mësimore e përcakton individi (nxënësi, studenti etj.) në mbështetje të synimit, të angazhimit, të numrit të përsëritjeve të atyre përmbajtjeve dhe të mënyrave të të mësuarit (të mësuarit relacional, në formën e zgjidhjes së problemave si mënyra më produktive e të mësuarit).

Burimet:

Vernon Gregg: "*Human Memory" – ("Kujtesa njerëzore*"), Methuen, London 1975, "*Essential Psychology*", Edited by Peter Herriot.

Robert Stammers & John Patrick: "*The Psychology of Training" – ("Psikologjia e stërvitjes"*), Methuen, London 1975, "*Essential Psychology*", Edited by Peter Herriot.

Ivan Furlan: "*Primijenjena psihologija učenja" – ("Zbatueshmëria e psikologjisë së të mësuarit*"), Školska Knjiga, Zagreb 1984.

Bardhyl Musai: *"Psikologji edukimi – Zhvillimi, të nxënët, mësimdhënia"*, Tiranë 1999.

Dtv: *"Atlas Psychologie"* – (*"Atlas i psikologjisë"*), Band 2, München 1997.

Pajazit Nushi: *"Të nxënit e lëndëve mësimore dhe zotërimi i tyre"*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, Prishtinë, 1997.

SHKALLËT MATËSE NË PSIKOLOGJI. Shkallë që përdoren për të matur numerikisht nivelin e pranisë dhe të zhvillimit të qëndrimeve, të interesimeve, të tipareve të personalitetit etj. Hartimi i tyre i nënshtrohet këtyre rregullave: përcaktimit të identitetit psikologjik të subjektit, vërtetimit të rendit të paraqitjes së strukturave psikologjike në sjelljet e njeriut, përcaktimit të dallimeve psikologjike dhe përmasave të këtyre dallimeve. Për këtë qëllim shërbejnë: 1) shkalla nominale – ka dy klasë mashkull–femër pa ndarje ndërmjet tyre. Shih - ***SHKALLA MASHKULL – FEMËR***; 2) Shkalla urdhëruese – shkallë e formuar në bazë të cilësive sasiore të renditura pa ndonjë kriter dhe përdoret për të konstatuar vendndodhjen ose rangun që zë një subjekt në grupin e subjekteve të tjerë; 3) Shkalla e intervaleve – shkalla shtrirëse me numërim të njëjtë të largësisë së njërës njësi nga tjera. E këtillë është shkalla e metrit që fillon nga zeroja. Detyra e subjektit vlerësues është të përcaktojë vendin ose pozicionin e zhvillimit të një qëndrimi, tipari etj.

SHKALLËT ZHVILLIMORE. Shkallët ose nivelet e zhvillimit të jetës psikike të caktuara me rritjen e organizmit të njeriut. Në psikologjinë zhvillimore këto shkallë apo nivele njihen më tepër me termin periudha të zhvillimit të jetës psikike. Këto shkallë apo periudha sot ndahen sipas këtij sistemi: periudha e foshnjërisë – nga lindja deri në përfundim të vitit të parë; fëmijëria e hershme – prej mbarimit të vitit të parë deri në përfundim të vitit të gjashtë; fëmijëria e moshës së mesme – prej fillimit të vitit të shtatë deri në moshën dhjetëvjeçare; fëmijëria e vonshme – prej moshës dhjetëvjeçare deri në moshën dymbëdhjetëvjeçare; periudha e adoleshencës – prej moshës dymbëdhjetëvjeçare deri në moshën njëzetenjëvjeçare; pjekuria – prej moshës njëzetenjë deri në moshën gjashtëdhjetepesëvjeçare dhe periudha e pleqërisë – pas moshës gjashtëdhjetepesë vjeçare. Kjo ndarje e zhvillimit të jetës psikike ndryshon nga ajo para një gjysmë shekulli. Shih ***- PERIODIZIMI I ZHVILLIMIT PSIKIK TË NJERIUT.***

Burimet:

Erik H. Erikson*: "Childhood and Society" – "Fëmijëria dhe shoqëria",* New York: Norton, 1963.

William Th. Preyer: *"Die Seele des Kindes.Beobachtungen uber die geistige Entwicklung des Menschen in den ersten Lebensjahren" – ("Shpirti i fëmijës. Vështrim mbi zhvillimin shpirtëror të njeriut në vitin e parë të jetës")*, Leipzig: Grieben, 1882.

Karl Bühler*: "Die geistige Entvicklung des Kindes" – ("Zhvillimi shpirtëror i fëmijës"),* Jena: Fischer Conzen, Peter, 1918.

William Stern: *"Psychologie der frühen Kindheit bis zum sechsten Lebensjahr" – ("Psikologjia e fëmijërisë së hershme deri në vitin e gjashtë të jetës"),* Leipzig: Quelle & Meyer, 1914.

Dietrich Tiedemann*: "Beobachtungen über die Enticklung derSeelenfahingkeiten bei Kindern" – ("Vështrim mbi zhvillimin e aftësive shpirtërore të fëmijëve"),* Herausgegeben von Chr. Ufer. Altenburg: Bonde, 1897.

Elisabeth Wiesbauer: *"Das kind als objekt der Wissenschaft: Medicinische und psychologische Kinderforschung an der Wiener Universität 1800 – 1014" – ("Fëmija si objekt i gjurmimit shkencor: gjurmime mjekësore dhe psikologjike të fëmijëve në Universitetin e Vjenës 1800 – 1914"*), Wien: Löcker, 1981.

Stanley G. Hall: *"Adolescence. Its Psychology and its Relation to Physiology, Anthropology, Sociology, Sex, Crime, Religion and Education"* – (*"Adoleshenca. Psikologjia dhe relacioni i saj me fiziologji, antropologji, sociologji, seks, krim, religjon dhe edukatë"*), New York, Appleton, 1904.
Jean Piaget: *"La Psychologie de L`intelligence"* – (*"Psikologjia e inteligjencës"*), 1947.
Jonas Langer*: "Theories od Dewelopment"* – (*"Teoritë e zhvillimit"*), 1969.
Jean Piaget*: "Pedagogjia",* Instituti i Kurrikulave dhe i Standardeve, Tiranë, 2005, fq. 21; 145 – 155.
Remo H. Lango: *"Vitet e foshnjërisë – Zhvillimi i fëmijërisë së hershme i parë nga këndvështrimi biologjik"*. UEGEN, Tiranë, 2000.
Lawrence Kohlberg: *"Moral Development and Behavior"* – (*"Zhvillimi moral dhe sjellja"*), New York: Halt Rinehatr and Winston CBS College Publish, 1976.
Gordon Allport: *"Pattern and Growth in Personality"* – (*"Përbërja dhe zhvillimi i personalitetit"*), 1961.
Ross Vasta & Marshall M. Haith & Scott A. Miller: *"Psikologjia e fëmijës – Shkenca moderne",* Shtëpia botuese UEGEN, Tiranë, 2007.
Liljana Reçka*: "Psikologjia e zhvillimit",* shblu, Tiranë, 2005.
Vera Smilaniq & Ivan Toliçiç*: "Psikologjia fëmijërore",* Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, 1976.
Dava Përlala*: "Të mësuarit dhe zhvillimi psikik i fëmijës 6–7 vjeç",* Camaj–Pipa, Shkodër, 2001.

SH

SHKALLËZIMI KRUSHKALL – SHEPARD. Procedurë psikometrike për vlerësimin e përmasave psikologjike të ngacmuesve që ndikojnë në shqisat e njeriut. Sipas kësaj procedure nga subjektet kërkohet të vlerësojnë ngjashmërinë e ngacmuesve të ndryshëm dhe më pas rezultatet analizohen me qëllim të përcaktimit të atyre dimensioneve psikologjike, të shkaktuara nga këta ngacmues që janë të dobishëm për vlerësim objektiv. Këtë procedurë e ka zhvilluar statisticieni amerikan Uilijam H. Krushkall (William H. Krushkall, 1919) dhe psikologu amerikan Shepard R. Njulend, Shepard R. Newland, 1929) duke hulumtuar kryesisht në mënyrë të veçantë nga njeri-tjetri.

SHKAQET E PRAPAMBETJES MENDORE. Shkaqet e prapambetjes mendore janë pak të njohura. Te shumica e njerëzve prapambetja mendore është pasojë e dëmtimit të trurit. Kjo është evidente te 25 % e atyre që i përkasin kategorisë së rëndë dhe shumë të rëndë të prapambetjes mendore. Ka gjasa se dhe te ata të kategorisë së lehtë dhe mesatare të prapambetjes mendore shkak i një gjendjeje të tillë është dëmtimi i trurit, por dëmtimi i tillë nuk vërtetohet në aparatet speciale të hulumtimit të trurit. Baza e përgjithshme e prapambetjes mendore është e lidhur me disa anomali të gjeneve dhe të kromozomeve të tyre. Në mjediset familjare me ftohtësi raportesh emocionale dhe me moskujdes ngacmues për zhvillimin e pasardhësve mund të shkaktohet prapambetje e lehtë mendore e fëmijëve të këtyre familjeve. Me angazhim sistematik dhe të kujdesshëm të prindërve prapambetja mendore mund të zbutet, por, fatkeqësisht, nuk mund të eliminohet.

SHKATHTËSI, - A. f. Kryerje e shpejtë, e lehtë, e saktë dhe e zhdërvjellët e një veprimtarie të ndërlikuar. Shkathtësia është rezultat i të mësuarit, e pikërisht i ushtrimeve të organizuara. Shkathtësia është gjithmonë rrjedhje e organizuar veprimesh verbale, simbolike dhe motorike e drejtuar në një

qëllim të përcaktuar saktësisht. Në strukturën e saj dallohet ana kognitive dhe psikomotorike. Kuptimi kognitiv ka të bëjë me aftësi të zhvilluar në të kuptuarit e lehtë dhe të shpejtë të një çështjeje, në shfrytëzimin e duhur të informacioneve dhe në gjetjen e lehtë të raporteve ndërmjet tyre për zgjidhjen e saj. Për këtë shkak shkathtësia ka përmasa të theksueshme të zhdërvjelltësisë së njeriut, kur ai gjendet në një situatë problemore. Kuptimi psikomotorik ka të bëjë me gatishmërinë e zhvilluar në nivel parashprehimor për të koordinuar lehtë dhe shpejt lëvizjet që i kontribuojnë arritjes në një qëllim të caktuar. I tillë është të drejtuarit e automobilit, të biçikletës, të luajturit bilardo etj. Në rastet e këtilla theksohet ana motorike e shkathtësisë, kurse në rastin e shkathtësive kognitive theksohet më tepër ana simbolike dhe verbale, ndonëse të dy anët janë të pandashme dhe përbëjnë një tërësi aktiviteti të stërvitur.

SHKOLL/Ë, - A. f. Institucion edukativ e arsimor, në të cilin organizohet veprimtaria e edukimit dhe e arsimimit të brezit të ri, sipas një plani dhe programi të caktuar në bazë të bashkëveprimit të arsimtarëve dhe nxënësve. Shkollat dallohen sipas nivelit të edukimit dhe arsimimit të nxënësve dhe sipas tipit të përgatitjes së specialistëve për nevojat e zhvillimit ekonomik e shoqëror. Shkolla është institucion i rëndësishëm i socializimit sistematik dhe me plan të nxënësve. Kjo me veprimtarinë e gjithëmbarshme të saj ushtron ndikim në formimin e dijeve e të shkathtësive, si edhe të sistemimit të tyre dhe, njëkohësisht, në zhvillimin e strukturave dhe të funksioneve psikike të tyre, në zhvillimin e proceseve psikike dhe në formimin e qëndrimeve dhe të sjelljeve intelektuale, morale dhe estetike të nxënësve. Roli i rëndësishëm i personalitetit të arsimtarit dallohet sidomos kur ai arrin të bëhet model i identifikimit të nxënësve me personalitetin e tij.

SHKOLLA BRITANIKE E PSIKANALIZËS. Shkollë e mendimit psikanalitik e themeluar nga Alfred E. Xhonsi (Alfred E. Jones, 1879 – 1958) dhe ku bënin pjesë psikanalistët: Ronald Freben (Roland Fairbarn, 1889 – 1964), Hari Gantrib (Harry Guntrib, 1901 – 1975), Donald Uinikot (Donald Winnicott, 1896 – 1071), Mihael Balint (Michael Balint, 1896 – 1970), Xhon Bolbi, John Bowlby, 1907 – 1990) etj. Kjo shkollë kishte pikëpamje të tjera nga pikëpamja e psikanalistes angleze Melani Klajn (Melanie Klein, 1882 – 1960) dhe shërbeu për të bërë ndarjen nga kontributi psikanalist i shkollës psikanalitike amerikane, franceze, gjermane etj. Theksohet angazhimi i tyre në raportin e objektit, në rëndësinë e raportit nënë–fëmijë për zhvillimin psikik dhe në rëndësinë e faktorëve të jashtëm për të kuptuar zhvillimin psikik të individit.

SHKOLLA E BERLINIT. Shkollë për zhvillimin e pikëpamjeve geshtaltiste në kuadrin e Universitetit të Berlinit në fillim të shekullit të njëzet. Kjo shkollë ishte një institucion gjurmimesh psikologjike me revistën "Forschungenpsychologie", organ zyrtar profesional dhe shkencor i kësaj shkolle. Botoi 22 numra, derisa regjimi nazist më 1938 e ndaloi botimin e saj. Në këtë institut kanë kryer gjurmime

themeluesit e shkollës geshtaltiste: Maks Verthaimer (Max Wertheimer, 1880 – 1943), Kurt Kofka (Kurt Koffka, 1886 –1984), Volfganag Këler (Wolfgang Köhler, 1887 – 1967), Kurt Levin (Kurt Lewin, 1890 – 1947) dhe Volfgang Mecger (Wolfgang Metzger, 1899 – 1979). Pas vitit 1938 të gjithë këta psikologë emigruan në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke mbetur bashkëpunëtorë të ngushtë gjatë gjithë jetës dhe aktivitetit të tyre.

SHKOLLA E MARBURGUT. Shkollë psikologjike e Universitetit të Marburgut në Gjermani. Përfaqësuesit e kësaj shkolle u morën me gjurmimin e procesit të mendimit, duke zbatuar metodën e vetëvëzhgimit eksperimental. Në këtë shkollë kanë eksperimentuar disa psikologë, ndër të cilët edhe psikologu Karl Marbe.

SHKOLLA E PSIKOLOGJISË SHPIRTËRORE. Shkollë psikologjike e drejtimit filozofik me metoda të veçanta që ka si lëndë të vetën studimin e proceseve psikike dhe të personalitetit, të lidhura me dukuritë kulturore dhe historike. Të këtilla janë: dëshirat, idealet, emocionet estetike dhe përjetimi i tyre, orientimet vlerësuese të njeriut, përjetimet mistike etj. Këto dukuri mund të studiohen me anën e të kuptuarit të tyre, duke pasur për bazë qasjen idiografike dhe holistike të tyre.

SHKOLLA E VYRZBURGUT. Grupi i hulumtuesve të proceseve të larta psikike, sidomos i procesit të mendimit, të organizuar në Universitetin e Virzburgut të Gjermanisë. Ndër më të njohurit e kësaj shkolle janë: Osvald Kylpe (Oswald Külpe, 1862 – 1915), Karl Byler (Carl Bühler, 1869 – 1941) dhe Narcis Ah (Narziss Ach, 1871 – 1946). Sipas pikëpamjeve të kësaj shkolle proceset e larta psikike nuk mund të reduktohen në ndijime, ndjenja dhe në përfytyrime. Këta psikologë zbatuan metodën e vetëvëzhgimit eksperimental sistematik dhe, në bazë të rezultateve të arritura, konstatuan se ekziston "mendimi i pastër" pa përfyrime dhe pa ndijime, përcaktuan "prirjen përcaktuese" në zgjidhjen e problemeve, që nuk ka të bëjë me ndijime dhe as me ndjenja e përfytyrime, rolin e "qëndrimit mendor" në zgjidhjen e problemeve, rëndësinë e "gjendjes së vetëdijshme" dhe rolin e "detyrës" në procesin e gjykimeve vlerësuese.

SHKOLLA E ZYRIHUT. Sistemi konceptual i pikëpamjeve dhe i qëndrimeve psikologjike të psikanalistit zviceran Karl Gustav Jung (Carl Gustav Jung, 1875 – 1961) dhe i ithtarëve të këtij sistemi. Mori emrin shkolla e Zyrihut, sepse u themelua në qytetin e njohur të Zvicrës – në Cyrih. Në psikologji është e njohur edhe me termin shkolla e psikologjisë analitike ose e psikologjisë komplekse**.**

SHKOLLAT PSIKOLOGJIKE. Tërësi pikëpamjesh, sistemesh dhe qëndrimesh konceptuale të përgjithshme, karakteristike për lëndën e psikologjisë, për metodat e studimit të saj dhe për fushat e interesit studimor të jetës psikike, të dukurive dhe proceseve psikike, si edhe për sjelljet. I përkasin grupit të psikologëve të pikëpamjeve, të metodave dhe të zgjidhjeve të çështjeve kyçe të psikologjisë. Shkollat e tilla kanë përmasa institucionale dhe për këtë shkak disa studies largohen nga përdorimi i termit

shkollë psikologjike, duke përdorur termin orientim psikologjik. Gjatë zhvillimit historik të sistemeve të tilla u dalluan këto shkolla ose orientime psikologjike: shkolla e strukturalizmit, shkolla e funksionalizmit, shkolla e psikanalizës, shkolla e bihejviorizmit, shkolla e geshtaltizmit, shkolla e psikologjisë humaniste dhe shkolla cognitive. Secila nga këto shkolla psikologjike ka sistemin e vet konceptual të lëndës së psikologjisë, të metodave, të postulateve dhe të koncepteve kyç me termat e tyre.

Burimet:

Robert S. Woodworth: *"Contemporary Schools of Psychology"* – (*"Shkollat bashkëkohore të psikologjisë"),* METHUEN & CO LTD I I New Fetter Lane London EC 4.

Vladimir M. Behteriev: *"Objektive Psychologie; oder, Psychoreflexologie: die Lehre von den Assoziationsreflexen"* – (*"Psikologjia objektive; ose, Psikorefleksologjia: të mësuarit mbi asociacionreflekset*"), Leipzig, 1913.

Jozef Breuer & Sigmund Freud: *"Studien über Hysterie"* – (*"Studime mbi histerinë*"), Leipzig - Wienna: Franz Deuticke, 1895.

William James: "*Principles of Psychology"* – ("*Parimet e psikologjisë*"), New York, 1890.

Edward B. Titchener: *"Systematic Psychology"* – (*"Psikologjia sistematike"*), New York: The Macmilan Co. 1929.

Zigmund Frojd: *"Pesë leksione mbi psikanalizën"*, Tiranë, 1938.

Zigmund Frojd: *"Interpretimi i ëndrrave"*, Tiranë, 2010 etj.

Wolfgang Köhler: *"Gestalt Psychology"* – (*"Psikologjia geshtaltiste"*), New York, 1929.

Janet Piaget: *"The Construction of Reality in the Child"* – (*"Ndërtimi i realitetit te fëmijët"*), New York, 1937.

Charles Spearman*: "The Nature of Intelligence and the Principles of Cognition"* – (*"Natyra e inteligjencës dhe parimet e kognicionit*"), London: Macmillan & Co. Ltd. 1923.

SHKOPTHAT DHE KUNJËZAT. Shkopthat dhe kunjëzat janë receptorë të të parit, të cilët përbëjnë njërën nga shtresat e rëndësishme të rrjetëzës ose të retinës së syrit. Shkopthat dhe kunjëzat e shndërrojnë energjinë e dritës në energji elektrike. Shkopthat janë receptorë akromatikë, receptorë të posaçëm të të parit në dritë të zbehtë dhe në errësirë, si edhe të të parit të ngjyrave akromatike. Janë të gjatë dhe kanë formë shkopthash. Retina e syrit të njeriut ka rreth 130 milionë shkoptha dhe pjesa më e madhe e tyre gjendet në periferi të rrjetëzës apo retinës së syrit, në gropën qendrore të rrjetëzës (*fovea centralis*) nuk gjenden. Shkopthat kanë vetëm një fotopigment – rodopsinën, që reagon me të gjitha valët e dritës.

SHKRIMET E PARA SHQIPE TË PSIKOLOGJISË. Shkrimet e para shqipe nga shkenca e psikologjisë empirike janë shfaqur vonë. Ishin të lidhura ngushtësisht me filozofinë dhe pedagogjinë, ku u shfrytëzuan rezultatet e arritura në vende të tjera në gjurmimin empirik të proceseve psikike dhe të sjelljeve. Këto shkrime të autorëve me origjinë shqiptare, së pari u paraqitën në vendet emigruese të tyre ose të paraardhësve, natyrisht në gjuhën e vendeve ku këta ishin afirmuar. Arbëreshi Italian, mjeku Gabriele Bukola, u dallua me shkrimet e para në psikologjinë eksperimentale. Botoi në italisht më 1879 punimin "Doktrina e trashëgimisë dhe fenomenet psikologjike". Hasan Tahsini botoi më 1894 traktatin e parë psikologjik "Psikologji ose "Ilim Ruh" – "Psikologji ose "dituri mbi shpirtin", duke vështruar lëndën e psikologjisë më tepër nga

këndvështrimi filozofik. Gaspër Beltoja në librin e tij me karakter pedagogjik "Pedagogji theorike" më tepër ka trajtuar proceset psikike. Më 1923 u botua në Tiranë përkthimi nga frëngjishtja i librit të mjekut, psikologut dhe sociologut Dr. Gustav Lë Bon "*Psikologjia e edukatës*". Iliaz A. Korça më 1924 botoi në Shkodër shkrimin "Psikologjië. Form` e pare". Më 1933 u botua nga gjuhëtari Aleksandër Xhuvani vepra "*Fillime të pedagogji. Pjes` e parë.* "Psikologji e shtime në punë t` edukatës" për shkollat normale e për mësuesit e filloreve, që u përdor si tekst shkollor deri nga fundi i Luftës II Botërore.

Burimet:

Nuri Abdiu: *"Kontribute themelore në historinë e mendimit psikologjik shqiptar (deri më 1939)",* Tiranë, 2003.

Alfred Uçi: *"Filozofia e Teodor Anastas Kavaljotit",* Tiranë, 2004.

SHKRUARIT E AUTOMATIZUAR (TË). Procesi i të shkruarit gjatë të cilit vëmendja e atij që shkruan është e përqendruar në përmbajtjen e asaj që shkruan e jo në aktin e të shkruarit qartë, bukur, lexueshëm etj. Të shkruarit e automatizuar është rezultat i ushtrimeve të shumta dhe i përvojës së fituar gjatë këtij procesi.

SHMANGIA KUARTILE. Term i psikometrisë që ka të bëjë me përcaktimin e shmangies së vlerës së mesme nga numri i të dhënave numerike që janë rreshtuar sipas madhësisë së tyre. Shmangia kuartile përcaktohet si ndryshim i përgjysmuar, duke llogaritur dallimin sasior ndërmjet kuartilit të parë dhe të tretë.

SHMANGIA MESATARE. Masë statistikore e përcaktimit të shkallës së homogjenitetit ose të heterogjenitetit të vlerave statistikore të anëtarëve të një popullate ose të kampionit të tyre, te të cilët është vlerësuar numerikisht vlera mesatare e zhvillimit të një ndryshoreje të caktuar. Llogaritet sipas formulës:

Sh M. $= \frac{\sum dM}{N} \left(\sum [dM) \right]$ = ndryshimi sasior ndërmjet vlerave (vlerës) mesatare, gjegjëset e mesatares aritmetike dhe secilës vlerë sasiore individuale; N = numri i përgjithshëm i subjekteve të provuara).

SHMANGIA MESATARE KUADRATIKE. Masë statistikore e ndryshueshmërisë së vlerave sasiore individuale nga vlera mesatare e tyre. Llogaritet sipas formulës: Sh. K.

$$\delta = \frac{\sum d^2}{N(\sum d^2)}$$

Në këtë formulë shenja (sigma) emërton shumën e ndryshimeve të vlerave sasiore individuale nga vlera mesatare e ngritur në katror; N është numri i përgjithshëm i subjekteve të provuara. Shmangia mesatare kuadratike zbatohet më tepër se shmangia mesatare, për shkak të saktësisë më të madhe.

SHMANGIA STANDARDE. Masë statistikore që tregon si dhe sa të dendura janë të shpërndara vlerat numerike rreth mesatares aritmetike krahasuar me shpërndarjen normale të tyre duke marrë për bazë shpërndarjen sipas kurbës së Karl F. Gausit (Karl F. Gausit, 1777 – 1855), matematikanit

gjerman. Kur kemi të bëjmë me shumë raste, atëherë zbatohet formula:

$$\sigma = \sqrt{\frac{(X-M)^2}{N}}$$

dhe kur kemi të bëjmë me pak raste, atëherë zbatohet formula: $\sigma = \sqrt{\frac{(X-M)^2}{N-1}}$. Këtë e ilustron paraqitja grafike e mëposhtme:



SHOKU. asnj. I ardhur nga frëngjishtja *choc* "goditje". Shoku është emërtim i goditjes, i sulmit të papritur psikofizik; gjendje akute organike dhe psikike e një individi të lënduar, të brengosur, ose që ka pësuar tronditje të thellë e të papritur shpirtërore. Këtë gjendje e shkakton ndërprerja e furnizimit me oksigjen të indeve të organizmit (sidomos të indeve nervore), pasojë e goditjes, e përplasjes së organizmit me situatën e papritur. Në këtë rast kemi humbjen e pjesshme të vetëdijes ose zvogëlimin në masën minimale të saj për kohë të caktuar. Gjendja e shokut është çrregullim i përkohshëm i funksionimit psikofizik të organizmit. Manifestohet me çrregullim të të rrahurit të zemrës, me vështirësi të procesit të perceptimit, të mendimit, me djersitje, dridhje të gjymtyrëve e të trupit dhe me ndryshime në funksionin e sistemit nervor autonom. Shoku është faza e parë e sindromës së përgjithshme të përshtatjes së organizmit.

SHOKU EMOCIONAL. Gjendje emocionale me intensitet të lartë të përjetimit të saj, kur një individ reagon ndaj një situate të papritur me emocione me një intensitet të skajshëm, me humbje të kontrollit të emocioneve, "marrje" duarsh, shpesh edhe me humbje të vetëdijes. Shoku emocional zakonisht përjetohet nga vdekja e papritur e më të dashurve, nga situatat stresuese të marrjes flakë të shtëpisë, të vërshimeve të mëdha, të tërmetit etj.

SHOKU I SË ARDHMES. Tronditje, goditje psikofizike e njeriut bashkëkohor, sidomos e njeriut të së ardhmes, i cili goditet me informacionesh ndryshimesh ekonomike, politike e shoqërore të dendura, ndaj të cilave ai nuk ka kapacitete të mjaftueshme mendore dhe organike për t`i njohur dhe asimiluar në trurin e tij. Shoku i së ardhmes është karakteristik më tepër për individët e vendeve industriale dhe pasindustriale. Ndaj të tilla sulmeve të këtyre informacioneve njeriu reagon duke qëndruar indiferent, duke mohuar me agresivitet dhe duke qëndruar në shkallën e sjelljeve rinore e fëmijërore. Këtë lloj shoku e ka emërtuar shok ardhmërie gazetari amerikan Alan Tofler (Alan Toffler, 1928).

SHOKU KULTUROR. Term me konotacion të theksuar psikologjik që ka të bëjë me përjetimin e çrregullimeve emocionale, mendore dhe sociale të atij individi, i cili ndërron mjedisin e tij

dhe vendoset në një mjedis tjetër kulturor, që ka sistem normash, parimesh dhe standardesh krejtësisht të ndryshme. Shqiptari që emigron në Shtetet e Bashkuara të Amerikës përjeton befasi të çuditshme për të, ai e ndien veten të humbur, të vetmuar, me vështirësi të theksuara të përshtatjes së tij këtij mjedisi të ri, ku ai është i juaj dhe ku koha dhe shfrytëzimi i saj në punë çmohet shumë më tepër se vizitat e miqve, bisedat e gjata ndërmjet shokëve e miqve, se fitimi nga puna e vetë njeriut është vlerë mbi të gjitha të tjerat etj.

SHOKU TRAUMATIK. Tronditje e fuqishme e organizmit nga rryma elektrike, e cila është në gjendje të shkaktojë gjendje spazme të qëndrueshme të një muskuli. Gjendjet e këtilla shkaktohen artificialisht te kafshët për qëllime studimore.

SHOQËRIMI I PËRFYTYRIMEVE. Vetia e lidhjes së përfytyrimeve, e cila paraqitet në tërheqjen e një përfytyrimi nga përfytyrimi paraprak. (Përfytyrimi i oborrit të bibliotekës tërheq përfytyrimin e ndërtesës së bibliotekës, përfytyrimi i trëndafilit tërheq paraqitjen e përfytyrimit të lulishtes së shkollës në stinën e pranverës, përfytyrimi i plakut të shtyrë në moshë tërheq përfytyrimin e djalit të tij të ri etj.). Mosshkëputja e një përfytyrimi nga përfytyrimi tjetër dhe lidhja e renditja e tyre realizohen sipas disa parimeve.

SHOQËRIZIMI. m. Proces i shndërrimit të një individi në personalitet shoqëror. Është proces i ndërlikuar që ka të bëjë me përshtatjen e bazës biofiziologjike të tij ndaj kërkesave dhe raporteve të caktuara shoqërore, sikurse edhe me formimin e bazës shoqërore (të organeve shoqërore) të individit për përfshirjen e tij të suksesshme në veprimtarinë e gjithëmbarshme shoqërore, ekonomike e kulturore të mjedisit ku zhvillohet dhe vepron ky individ. Shoqërizimi i tij fillon qysh në fëmijërinë e hershme, qysh kur fëmija dallon veten nga prindërit dhe nga të tjerët dhe zgjat deri në moshën e pjekurisë dhe pas saj. Bazën e tij e përbën të mësuarit, që realizohet në procesin e plotësimit të dëshirave, të interesave, të motiveve, të nevojave etj., të ndikimit që ushtron në të sistemi i vlerave të një shoqërie të caktuar (edukata, arsimi, kultura etj.) dhe të veprimtarisë së vetë njeriut.

SHOQËRIZIMI I PROCESEVE PSIKIKE. Modifikim i proceseve psikike nën ndikimin e faktorëve dhe raporteve shoqërore të mjedisit të caktuar, ku zhvillohet e formohet personaliteti. Në këtë kuptim flitet për shoqërizimin e këtyre proceseve psikike: a) Shoqërizimi i kujtesës - formësimi i lëndës së mbajtur mend në përputhje me nevojat e me përvojën shoqërore dhe riprodhimi i saj sipas veçorive kulturore të një mjedisi të caktuar; b) Shoqërizimi i motiveve - shndërrimi i formave dhe i mjeteve të plotësimit të motiveve, sidomos i atyre biologjike, sipas modeleve shoqërore të mjedisit të caktuar, përcaktimi i shfaqjes së nevojave, i mënyrës dhe i mjeteve të plotësimit të tyre; c. Shoqërizimi i ndjenjave - përcaktimi i situatave që shkaktojnë ndjenja, me përjetimin karakteristik të intensitetit e të shfaqjes së ndjenjave nga ana e njeriut. Shoqërizimi i perceptimeve - të dhënët kuptim asaj që perceptohet sipas interesimeve, qëndrimeve, stereotipeve, shprehive shoqërore etj. të një mjedisi të caktuar

dhe vartësia e perceptimeve nga vlerësimi shoqëror i objekteve dhe i dukurive, sikurse edhe nga rëndësia që i jep rrethi shoqëror asaj që perceptohet.

SHOVINIZ/ËM, – MI. m. I ardhur nga frëngjishtja *chauvinism*. Lloj qëndrimi intensiv, negativ, i skajshëm ndaj një kombi tjetër dhe ndaj pjesëtarëve të tij. Karakterizohet nga përçmimi dhe urrejtja e tij, nxitja e grindjeve dhe e armiqësisë ndaj të individëve të tjerë me përkatësi kombëtare të ndryshme, sjellja e vrazhdë, pengimi i zhvillimit ekonomik, arsimor, kulturor etj. Hyjnizimi dhe zmadhimi i vlerave të kombit të tij, të cilin e konsideron superior. Të tilla i konsideron edhe tiparet e pjesëtarëve të kombit të vet, kurse të gjithë të tjerët janë inferiorë dhe sjelljet ndaj të tjerëve janë sjellje nënçmuese, urrejtjeje dhe armiqësie.

SHPËRNDARJA E PËRGJITHSHME E TË DHËNAVE. Treguese e shtrirjes së përgjithshme të të dhënave që llogaritet duke zbritur nga vlera më e lartë sasiore vlerën më të ulët dhe kësaj shume duke i shtuar 1. Përdoret rrallë për shkak të pasigurisë së saj, por jep kuptimin e parë brenda të cilit gjurmuesi mund të përcaktojë operacionet statistikore të duhura.

SHPËRNDARJA E TË DHËNAVE POASON. Formë e shpërndarjes së atyre të dhënave të përftuara nga matja e një ndryshoreje që shfaqet në një sasi të vogël, përkatësisht në sasi prej nën 10 % të të gjitha rasteve. Probabiliteti i shfaqjes së rasteve të këtilla është shumë i vogël, përkatësisht nën 10 %. Në psikometri ka raste të rralla të shpërndarjes së vlerave të tilla. Shpërndarja Poason është rezultat i gjurmimeve të matematikanit francez Simeon D. Poason (Simeon D. Poisson, 1781 – 1840).

SHPËRNDARJA E TË DHËNAVE POLIMODALE. Formë e shpërndarjes së parregullt (jokumbonare) që formohet nga raporti i të dhënave me shpeshtësi ose dendësi të një niveli të lartë ndaj të dhënave me shpeshtësi të nivelit të ulët. Shpërndarjen polimodale e ilustron grafiku i mëposhtëm:



SHPËRNDARJA E TË DHËNAVE STATISTIKORE. Shkalla dalluese e të dhënave statistikore të një dukurie të matur psikike te subjektet e ndryshme, ose dallimi i saj nga vlera mesatare e tyre. Shkalla e shpërndarjes së tillë të të dhënave statistikore vlerësohet në bazë të shmangies mesatare, shmangies mesatare kuadratike etj.

SHPËRNDARJA E TË DHËNAVE U. Formë e shpërndarjes së të dhënave ku sasia e të dhënave të skajshme ka shkallë të lartë shpeshtësie në të dy anët e tyre, përkatësisht në njërën anë ka shkallë tepër të ulët të shpeshtësisë, kurse në anën tjetër ka shkallë tepër të lartë të shpeshtësisë së të dhënave, duke pasur njëkohësisht shkallë të ulët të të dhënave të grumbulluara rreth së mesmes aritmetike. Paraqitja grafike e tyre në formën e lakores i përngjet shumë shkronjës U. Forma e këtillë e shpërndarjes zakonisht përftohet kur kemi të bëjmë me ndryshore

diotomike, ku, me këtë rast qëndrimet ndaj të njëjtit objekt janë të polarizuara skajshmërisht.

SHPËRNDARJA NORMALE. Shpërndarja ose distribucioni i vlerave, i të dhënave të përftuara ose të pritura nga matja e një ndryshoreje psikologjike, kur këto janë të grupuara rreth vlerës së mesme të tyre, duke u shfaqur grafikisht në formën e kumbonares së matematikanit gjerman Karl F. Gaus (Carl F. Gauss, 1777 – 1855). Shpërndarja e vlerave individuale ose e të dhënave të përftuara nga matja e një ndryshoreje shtrihet prej - ∞ deri në + ∞ . Kjo shpërndarje është e lidhur drejtpërdrejt me faktorin konstant ose sistematik të ndryshores që provohet. Por, në përcaktimin e shpërndarjes së vlerave ose të të dhënave individuale ndikojnë edhe disa faktorë të rastësishëm ose josistematikë, duke ndryshuar shpërndarjen e vlerave individuale ose të të dhënave. Ndikimi i këtyre faktorëve është i lidhur me ndryshimet jokonstante të organizmit të subjekteve gjatë procesit provues, me ndikimin e faktorëve josistematikë të jashtëm, si edhe nga gabimet e mundshme gjatë procesit të matjes së ndryshores te subjektet individuale. Shpërndarja normale e vlerave individuale rreth vlerës së mesme të tyre është dukuri e rrallë meqë ndikojnë faktorët josistematikë që duhen eliminuar gjatë procesit të të provuarit të një ndryshoreje të caktuar. Por, shpërndarja normale ka rëndësi të madhe në hulumtimet psikologjike; testimi i saktë psikologjik mbështetet në vlerën mesatare të përftuar nga matja e ndryshores në popullimin e caktuar. Shpërndarjen normale të vlerave individuale e paraqesim në figurën e mëposhtme:



SHPËRNDARJA T. Lloj i ndarjes së masave të përftuara nga llogaritjet statistikore sipas vlerave t. Shpërndarja e masave sipas distribucionit t është koncept teorik i statistikës, që në përmbajtjen kuptimore është më i gjerë se koncepti i shpërndarjes simetrike të të dhënave; sa më i vogël, sa më e ngushtë të jetë gjedhja ose kampioni, aq më i gjerë është distribucioni t përballë distribucionit normal. Në bazë të distribucionit t përcaktohet në mënyrë statistikore rëndësia e dallimeve statistikore ndërmjet dy masave statistikore (ndërmjet dy të mesmeve aritmetike, ndërmjet shmangies kuadratike etj.).

SHPËRTHIM I RRITJES SË ORGANIZMIT. Përshpejtim i zhvillimit natyror organik e fiziologjik të organizmit, që shfaqet në rritjen e lartësisë së shtatit dhe në shtimin e peshës së organizmit. Zhvillimi i tillë i përshpejtuar realizohet gjatë moshës së pubertetit të femrave dhe të meshkujve.

SHPIFJE, - **A.** f. Trillime të pavërteta që krijohen me qëllim të dëmtimit të individit, duke përlyer nderin, famën dhe besimin që ai gëzon te të tjerët. Shpifja e trilluar ose e bartur te të

tjerët bëhet për qëllime të posaçme e më tepër për përfitime morale e materiale.

SHPIKJE, - A. f. Zbulim, zgjidhje e re e një detyre ose e një problemi ekonomik, matematikor, teknik apo teknologjik, e cila zbatohet në procesin e prodhimit të të mirave materiale dhe i kontribuon zhvillimit të ekonomisë, arsimit, kulturës etj. Është fryt i mendimit krijues.

SHPIN/Ë, - **A.** f. Pjesa e prapme e trupit të njeriut, e cila shtrihet prej qafës e supeve deri në mesin e trupit dhe prej anës së majtë të kësaj pjese deri në anën e djathtë. Përbëhet nga muskujt e ndryshëm (për nga forma, përmbajtja dhe shtrirja). Muskujt sipërfaqësorë dhe në thellësi të shpinës shtrihen për së gjëri prej njërës shpatull në tjetrën dhe për së gjati prej protuberancës anësore të jashtme deri në koksigj. Kjo pjesë e trupit mbulohet me lëkurë, e cila është më pak e ndjeshme ndaj trupave.

SHPIRT, - I. m. Term tashmë i vjetruar për psikikën. Në psikologjinë bashkëkohore haset shumë rrallë. Në fazën paralogjike të zhvillimit të mendimit njerëzor shpirti ishte jeta që shfaqej me frymëmarrje si shenja më e dalluar e jetës. Më vonë termi shpirt emërtoi forma të ndryshme përmbajtjesh mendore. Nga këto dallojmë: 1) Shpirti është qenie e veçantë e ndarë nga trupi i njeriut dhe funksionon pavarësisht nga trupi i tij, 2) Shpirti ka origjinë hyjnore dhe është fuqi e pavdekshme, pra ai vazhdon jetën e tij në "botën tjetër", 3) Shpirti i jep trupit jetë dhe këtë e vë në lëvizje dhe në veprim, 4) Shpirti dhe funksionet e tij rrjedhin nga funksioni i sistemit nervor, përkatësisht "truri prodhon mendime ashtu sikurse sikur lukthi e zorrët që tresin ushqimin", 5) Tërësia e proceseve jetësore, pikërisht e proceseve psikike të njeriut të gjallë, që kanë lidhje të ngushtë me funksionimin e sistemit nervor, sidomos me cipën e trurit të madh, 6) Shpirti është bartës i gjithë aktivitetit psikik të njeriut. Për shkak të ngarkesës së termit shpirt me elemente mistike e religjioze sot termi shpirt në psikologji nuk përdoret.

SHPIRTËZIM, - I. m. Pikëpamje e vjetër për mendësinë e popujve primitivë. Sipas kësaj pikëpamjeje ata kanë besuar se bimët, dukuritë e natyrës, objektet fizike, shtazët etj. kanë shpirt. Shpirti është pjesë përbërëse e individualitetit të tyre.

SHPJEGIM, - I. m. Ecuri mendore e argumentimit sistematik të pikëpamjeve dhe qëndrimeve për një objekt, dukuri, veçori etj., e më tepër për raportet e caktuara ndërmjet tyre. Shpjegimi është detyrë themelore e të gjitha disiplinave shkencore, rrjedhimisht edhe e psikologjisë. Ka të bëjë me argumentimin e lidhjeve parësore ndërmjet shkakut ose shkaqeve dhe pasojave të tyre. Shpjegimi mbështetet në mendimin që depërton në thelbin e një dukurie, procesi, objekti etj. Me anën e shpjegimit njeriu përpiqet të kuptojë përse një dukuri, objekt, proces etj. është ashtu si është.

SHPJEGIMI KAUZAL. Tip i shpjegimit të dukurive psikike dhe i ndryshimeve të tyre, që mbështetet në shkakun e përcaktuar. Zakonisht ky tip i shpjegimit kuptohet duke kërkuar përgjigje në pyetjen përse? Zakonisht në

tipin e shpjegimit kauzal shkaku gjendet në rrafshin e jetës psikike, të dukurive, të proceseve dhe të funksioneve të strukturave psikike të personalitetit. Por, për shpjegim të disa dukurive psikike dhe të ndryshoreve të tyre shkaku mund të gjendet edhe në rrafshin e fiziologjisë dhe të sociologjisë.

SHPRANGER Eduard (Eduard SPRANGER). Filozof dhe psikolog gjerman. Lindi në Groslihterfeld (Berlin) më 27.06.1882 dhe vdiq në Tybingen (Tübingen) më 17.09.1963. Profesor në disa universitete, si në Lajpcig, Berlin dhe Tybingen. Konsiderohet vazhdues i pikëpamjeve të Vilhelm Diltait. Kishte koncepte të posaçme për strukturën dhe unitetin psikik të njeriut. Sipas tij përmbajtja shpirtërore zhvillohet sipas sistemit të vlerave objektive të njeriut. Duke u nisur nga një koncept i tillë Eduard Shpranger konceptoi tipologjinë e njerëzve sipas sistemit të vlerave njerëzore. Sipas këtij sistemi ai dalloi gjashtë tipa vlerash dhe personalitetesh, të tillë si: 1) Tipi ekonomik, 2) tipi eseist, 3) tipi politik, 4) tipi religjioz, 5) tipi shoqëror dhe 6) tipi teorik. Të rrallë janë tipat e pastër, por dallohet mbisundimi i njërit tip ndaj tipave të tjerë. Ka ushtruar ndikim të posaçëm në zhvillimin e mendimit pedagogjik të ngritur mbi pikëpamjet psikologjike. I përket rrymës neohumaniste në fushën e edukimit. Vepra kryesore të tij janë: "*Lebensformen*" – (*"Format e jetës"*), 1914; *"Psychologie des Jugendalters"* – (*"Psikologjia e moshës rinore"*), 1924; *"Pedagogische Perspektiven"* – (*"Perspektiva e pedagogjisë"*), 1951.

SHPREHËSI, - A. f. Njëra ndër aftësitë parësore, formë e shfaqjes së faktorit verbal që ka të bëjë me rrjedhjen manifestuese të rregullt të mendimeve dhe të ndjenjave, ku dallohet përzgjedhja e shpejtë e fjalëve dhe e termave adekuat, të qëlluara mirë, kuptimplotë dhe të shprehura rrjedhshëm.

SHPREHI, - A. f. Formë e veprimtarisë psikomotorike, lloj veprimi gati i automatizuar dhe i qëndrueshëm apo i stabilizuar i reagimit të njeriut në kushte dhe situata të caktuara. Këto shprehi formohen si rezultat i të mësuarit, i ushtrimeve të organizuara e sistematike, me qëllim të zhvillimit të lëvizjeve dhe të koordinimit të tyre në një tërësi veprimi gati të automatizuar. Ushtrimet e tilla zgjasin pak a shumë kohë, në varësi nga shkalla e ndërlikimit të shprehive. Shprehi janë: pastrimi i gojës dhe i dhëmbëve pas marrjes së ushqimit, mbajtja e rregullt e fletoreve dhe e librave shkollorë, të shkruarit bukur (shprehi të thjeshta), por shprehi janë edhe të shkruarit me të gjithë gishtërinjtë në tastierën e kompjuterit, të kënduarit me instrument muzikor, pilotimi etj. Kështu ka qenë emërtuar kuptimi i termit shprehi. Sot ky kuptim është zgjeruar, sepse përfshin edhe shprehitë e proceseve kognitive, madje edhe disa forma të reagimeve emocionale të ushtruara. Me anën e tyre njeriu kursen energji fizike dhe psikike dhe kohë në kryerjen e aktiviteteve të tij me angazhim minimal të kontrollit të vetëdijshëm të këtij aktiviteti. Për këto shkaqe shprehitë kanë përmasë të theksuar ekonomike. Shih – ***FORMIMI I SHPREHIVE.***

SHPRES/Ë, - A. f. Lloj i ndjenjës njerëzore, të drejtuar në të ardhmen e njeriut. Shpresa është ndjenja e

besimit që mbështetet në disa faktorë e rrethana, të cilat janë jashtë kontrollit të vetë njeriut dhe ai, duke i vlerësuar pozitivisht, beson se këto do të sillen në atë mënyrë, që do t`i kontribuojnë realizimit të një dëshire të caktuar. Dëshira për t`u shëruar nga një sëmundje e rëndë, për të dalë nga burgu, për t`u kthyer në vendin e punës së humbur etj. mbetet e vetmja pikëmbështetje e besimit se kjo do të ndodhë. Nuk humb dhe as nuk zhduket edhe atëherë, kur kanë shteruar të gjitha mundësitë se gjendja do të ndryshojë, madje edhe atëherë kur njeriu gjendet në prag të vdekjes. Në këto rrethana dhe raporte shpresa mbetet e vetmja pikëmbështetëse e qenies së vetë njeriut. Dallojmë shpresën adekuate dhe shpresën joadekuate. Shpresa adekuate është besimi se angazhimi i njeriut në realizimin e saj do të sjellë rezultatet e duhura. Shpresa joadekuate është shpresa pasive, kur njeriu vetëm shpreson se rrethanat do të ndryshojnë në favor të shpresës që ka, përkatësisht në favor të realizimit të dëshirës së tij. Sa më objektiv të jetë vlerësimi i faktorëve dhe i rrethanave, rrjedhimisht sa më i madh të jetë angazhimi i njeriut në realizimin e dëshirës së tij, aq më i vogël është dyshimi në atë që shpresohet.

SHQIS/Ë, - A. f. Organe ndijimi të organizmit, të tillë si: gjuha, hunda, lëkura, syri, veshi etj. Këto organe janë zhvilluar dhe specializuar për pranimin e energjisë specifike fizike e kimike të trupave dhe dukurive të një mjedisi dhe, me trupthat receptorë përbëjnë bazën organike të shndërrimit të kësaj energjie (të dritës, të ftohtësisë, të zërit etj.) në impulse nervore. Shqisat janë bartëse të modaliteteve të posaçme ndijimore.

SHQISA E GJASHTË. Vepër e mjekut Sharl Rishe (Charles Richet), ku autori jep shumë shembuj ndijimesh të ndryshme që nuk mund të shpjegohen me mekanizmin e receptorëve të pesë shqisave të njeriut normal. Sipas tij "shqisa e gjashtë është ajo që na bën të njohim një vibracion të realitetit, një vibracion të cilin shqisat tona normale nuk do të arrinin ta kapnin". Këtë e ka mbështetur në disa dukuri të hasura në vëzhgime të kontrolluara, madje edhe në prova, duke dalluar shumë dridhje apo vibracione fizike të pakapshme për shqisat tona dhe të pakapshme edhe nga aparatet e ndjeshme fizike. Megjithëkëtë, këto dridhje apo vibrime ushtrojnë ndikim mbi disa inteligjenca njerëzore. Megjithëse këto fakte nuk i njohim, Sharl Rishe i ka vendosur në fazën e parë hulumtuese që pret shpjegimet e tyre shkencore; gjithsesi këto nuk duhen mohuar. Për qëndrimet e shprehura në këtë vepër autori ka marrë çmimin Nobel në mjekësi.

SHQISA STATIKE. Shqisa e ndijimit të vendndodhjes së trupit e të pjesëve të tij në hapësirë. Gjendet në pjesën e veshit të brendshëm dhe përbëhet prej parakthinës (vestibulit) dhe kanaleve gjysmëharkorë, që së bashku me qendrën e baraspeshës së trurit, që gjendet në trurin e vogël, përbëjnë një aparat të tërësishëm, i cili rregullon vendndodhjen e trupit dhe pjesëve të tij në hapësirë.

SHQISAT KIMIKE. Shqisa e nuhatjes dhe shqisa e shijimit. Këto shqisa kanë për ngacmues të tyre substancat e caktuara kimike në gjendjen flurore, të lëngët dhe të ngurtë (erërat, sheqernat,

yndyrat etj.) që në kushte të veçanta pësojnë ndryshime duke ngacmuar njëkohësisht trupthat receptorë të këtyre shqisave. Receptorët kimikë janë të shpërndarë edhe në pjesët e brendshme të organizmit dhe reagojnë ndaj ndryshimeve në përqendrimin e sheqerit, natriumit, të kaliumit dhe ndaj disa hormoneve, por edhe në përqendrimin e oksigjenit, të dyoksidit të karbonit etj. Në grupin e shqisave kimike bëjnë pjesë edhe molekulat e proteinave të veçanta të cipës së neuroneve që lidhen me neurotransmetuesit. Ndjeshmëria e nuhatjes dhe e shijes i atribuohet edhe shqisave të tjera, sidomos receptorëve të tyre në mbështjellësit e vrimave të lëngëta të organizmit, siç është cipa mbështjellëse e brendshme e fytit. Por kjo pret vërtetimin e tyre.

SHTERN Viliem (William STERN). Psikolog e filozof gjerman. Lindi në Berlin më 29.04.1871 dhe vdiq në Durham (Karolina e Veriut) më 27.03.1938. Ka studiuar në Universitetin e Berlinit dhe pas përfundimit të studimeve kreu detyrën e lektorit dhe më pas u zgjodh docent i psikologjisë në Universitetin e Vroclavit në Poloni; më pas në Universitetin e Hamburgut. Themelues i departamentit dhe laboratorit të psikologjisë, që më vonë u shndërrua në Institut të Psikologjisë në Hamburg. Më 1933 emigroi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në Universitetin e Harvardit dhe në Universitetin Djuk u mor me gjurmimin e ndryshimeve individuale, e pikërisht me psikologjinë diferenciale, me psikologjinë zhvillimore, me psikologjinë juridike dhe me psikologjinë industriale. Kundërshtues i bihejviorizmit. Në qasjen psikologjike të njeriut kishte pikëpamje personalistike dhe sipas tij, dimensioni kryesor i njeriut është vlera dhe sistemi i vlerave shoqërore. Bashkëshortët Shtern gjurmuan zhvillimin e fëmijëve të tyre dhe treguan vlerën e këtyre gjurmimeve në njohjen e zhvillimit psikik të fëmijëve. Është zbulues i koeficientit të inteligjencës, përkatësisht i raportit ndërmjet moshës intelektuale dhe moshës kalendarike. U përpoq të zvogëlojë dallimet ndërmjet psikologjisë empirike dhe zbatuese me psikologjinë tradicionale teorike europiane. Veprat kryesore të tij janë: "*Über psychologie der Individuellen Differenze*" – (*"Mbi psikologjinë e ndryshimeve individuale"*), 1900; "*Beiträge zur psychologie der Aussage I – II*" – (*"Kontribute në psikologjinë e dëshmive I – II"*, 1902–1902*; "Person und Sahe"* – (*"Individi dhe qenia"*), 1906; *"Psychologie der frühen Kindheit"* – (*"Psikologjia e fëmijërisë së hershme"*), 1914; "*Jugendliche Zeugen*" – (*"Dëshmitë e të rinjve"*), 1926 etj.

SHTIR/JE, - JA. f. Paraqitje mashtruese e gjendjes shpirtërore nga ana e vetë njeriut. Shtirja është shprehje karakteristike e dyfytyrësisë dhe ndër tiparet e karakterit negativ të njeriut. Shtirësia bëhet për qëllime të ndryshme individuale, kryesisht për përfitime materiale dhe morale.

SHTRËNGATA REM. Dukuri e disa individëve në gjumë të thellë, kur sytë lëvizin me shpejtësi të madhe dhe të dukshme, madje shoqërohen edhe me hapje sysh, me lëvizje muskujsh të fytyrës dhe me vetulla të ngritura lart, derisa ai është në gjumë të thellë. Shtrëngata REM është dukuri më e shpeshtë te foshnjat dhe zgjat deri në moshën pesëjavëshe.

SHTRIRJA E NDIJIMEVE. Pasqyrim i cilësisë së trupave fizikë që zënë vend në hapësirë në shqisat e njeriut. Kjo është njëra nga veçoritë e disa ndijimeve, të cilën e karakterizon ndijimi i përmasave të shtrirjes së të dhënave shqisore në një shqisë të caktuar. Është karakteristike sidomos për ndijimet e lëkurës, të të parit etj. Ky term zuri fill qysh në psikologjinë strukturaliste.

SHTUMPF Karl (Carl STUMPF). Filozof dhe psikolog gjerman. Lindi në Visenhad (Wiesentheid) më 21.04.1848 dhe vdiq në Berlin më 25.12.1936. Profesor i filozofisë dhe i psikologjisë në disa institucione të larta të Gjermanisë, si në Virzburg më 1873, në Pragë më 1879, në Haleu më 1884 dhe gjatë viteve 1894–1921 në Berlin. Në Universitetin e Berlinit ngriti Institutin Psikologjik dhe qe drejtor i këtij instituti deri sa doli në pension. U mor me gjurmimin e ndjeshmërisë së toneve, të zhvillimit të muzikës dhe të krijimtarisë muzikore. Me pikëpamjet e tij i përkiste psikologjisë së akteve dhe shkollës funksionaliste të psikologjisë. Për Karl Shtumpfin psikologjia si lëndë studimi duhet të ketë funksionin e vetëdijes, por jo përmbajtjen e saj. Veprat kryesore të tij janë: *"Tonpsychologie, I - II"* – (*"Psikologjia e toneve I – II)*, 1883 dhe 1890; *"Psychologie und Erkenntnistheorie"* – (*"Psikologjia dhe teoria e njohjes"*), 1891*; "Die Anfange der Musik"* – (*"Hyrje në muzikë"*), 1911 etj.

SHTYLLA E TRURIT. Pjesë e sistemit nervor. E njohur në anatominë e sistemit nervor me termin latin *truncus cerebri* "trungu i trurit". Shtyllën e trurit e përbëjnë këto pjesë: palca e zgjatur (*medula oblongata*), ura (*pons*) dhe truri i mesëm (*mezencefalon*). Në shtyllën e trurit janë të lokalizuara bërthamat e shumicës së nervave kafkorë. Në shtyllën apo trungun e trurit grumbullohen informacionet nga lëkura, muskujt e qafës dhe të kokës. Kjo pjesë e trurit kontrollon tkurrjen e muskujve të qafës dhe të kokës. Shih - ***NERVAT KAFKORË.***

SHTYLLA KURRIZORE. Shtylla ose boshti kurrizor përbëhet nga 33 unaza kurrizore, të cilat kanë këtë renditje: 7 unaza i takojnë qafës, 12 i takojnë gjoksit, 5 janë të prapme, 5 janë ijore dhe 4 janë të eshtrës bishtore. Dy grupet e fundit janë të lidhura me eshtrën e përbashkët për secilin grup unazash. Nëpër të kalon e shtrirë vertikalisht palca kurrizore që kryen funksione të rëndësishme trunore. Shih - ***PALCA KURRIZORE.***

SHTYPJE, - A. f. Ndikimi i fuqisë së një dukurie, trupi etj. në organizëm, i cili shkakton ndijimin e të prekurit në lëkurën e njeriut. Ndijimi i të prekurit zakonisht ndodh kur ngacmuesi i ngurtë, i lëngët e deformon lëkurën, duke e shtypur këtë së brendshmi. Në psikanalizë termi shtypje ka domethënie të veçantë: ai emërton largimin nga kujtesa të dëshirave, të ideve, të përjetimeve, të ndjenjave të pakëndshme dhe të lidhura me realizimin e tyre. Kjo shtypje kryhet nga vetë njeriu. Me këtë kuptim shtypja merr përmasat e mekanizmit mbrojtës.

Burimet:

Zigmund Frojd: *"Përtej parimit të kënaqësisë",* Tiranë, 2004.

Çarls Brener: *"Themelet e psikanalizës",* Tiranë, 2008.

SHTYTËS, - I. m. Fuqi e brendshme psikologjike që ka për bazë kërkesat fiziologjike të organizmit. Shtytësi e shtyn organizmin e kafshës dhe të njeriut në një veprimtari të caktuar, të drejtuar në objektin me të cilin ai ndryshon gjendjen e tensionuar të organizmit. Lind nga ndryshimet fiziologjike të organizmit dhe ka fuqi, energji motivuese, me të cilën e vë në lëvizje, në aktivitet organizmin. Kështu janë përcaktuar shtytësit në psikologjinë klasike. Sot në grupin e shtytësve përpos kërkesave fiziologjike, hyjnë edhe disa burime të brendshme të organizmit që kanë për bazë energjinë e mësuar vepruese të organizmit. Sipas këtij kuptimi dallojmë shtytësit parësorë dhe ata dytësorë. Shtytësit parësorë janë të lidhur me nevojat biologjike të organizmit, kanë karakter të lindur dhe karakterizojnë veprimet e një lloji të caktuar të kafshëve. Shtytësit dytësorë janë të formuar. Këta shtytës energjinë motivuese e kanë të formuar në bazë të lidhjes së tyre me energjinë e shtytësve parësorë. Për këtë shkak shtytësit dytësorë janë më plastikë dhe kanë përmasa të kufizuara universale dhe specifike për një lloj të caktuar të organizmave. Shtytësit duhet dalluar nga instinktet. Në psikanalizë termi dhe koncepti shtytës është ndër termat dhe konceptet themelorë. Ky është "synim i lindur energjetik dhe veprues i organizmit të njeriut, që e shtyn, e nxit nga brenda-jashtë organizmin në veprimtari të drejtuar në objektin, me të cilin ai e realizon kërkesën e tij. Për themeluesin e psikanalizës Zigmund Frojdin (Sigmund Freud, 1856 – 1939) shtytësi është koncept kufizues ndërmjet mendjes, psikikës dhe asaj që është trupore. Sipas tij dhe ithtarëve të psikanalizës klasike shtytësit, veçanërisht shtytësi seksual, është përcaktues në veprimtarinë e gjithëmbarshme të njeriut. E gjithë veprimtaria e njeriut e merr energjinë e vet nga libido. Sot, një pikëpamje e tillë has në kundërshtime.

Burimet:

Zigmund Frojd: *"Hyrje në psikanalizë",* Tiranë, 2005.

SHTYTËSI I SOCIALIZUAR. Shtytësi parësor i veprimtarisë së njeriut i lidhur kryesisht me nevoja biologjike, që plotësohet me sjellje formash dhe me mjete të pranuara dhe të kultivuara në mjedisin e caktuar kulturor. Shtytësi seksual është tipi shtytës i socializuar, që shfaqet me faktorin nxitës të përbashkët dhe të lindur, por plotësimi i tij ndryshon nga mjediset me zhvillim nivelesh shoqërore, ekonomike e kulturore.

SHTYTËSI KOMPLEMENTAR. Term i psikanalizës që emërton konceptin e funksionit të dy shtytësve që e plotësojnë njeri-tjetrin dhe qëndrojnë njëri kundër tjetrit. Shtytës të tillë, përkatësisht shtytës komplementarë janë: shtytësi i jetës (*eros*) dhe shtytësi i vdekjes (*thanatos*).

SHTYTËSIT SHOQËRORË. Shtytësit parësorë të lidhur me nevojat biologjike të njeriut (etja, seksi, uria etj.), me shprehjen e sjelljeve të tyre, si edhe me plotësimin e tyre, që realizohet sipas modeleve të mjediseve shoqërore. Këto modele janë fituar në bazë të përvojës dhe në bazë të procesit të të mësuarit gjatë zhvillimit edukativ e arsimor, përkatësisht gjatë socializimit

të një individi në një mjedis të caktuar shoqëror.

SHUARJA E REFLEKSIT TË KUSHTËZUAR. Proces dhe produkt i dobësimit, i shuarjes graduale të refleksit të kushtëzuar, derisa ai të zhduket nga repertori i veprimeve të organizmit. Kjo shuarje shkaktohet nga ndërprerja e disahershme e dhënies së ngacmuesit natyror pas ngacmuesit artificial. Pas disa përsëritjeve të tilla kafsha vjen shkallë-shkallë duke mos reaguar ndaj ngacmuesit artificial. Procesi i shuarjes së refleksit të kushtëzuar fillon edhe me ndërprerjen e shpërblimit që i jepet kafshës ose fëmijës pas formimit të refleksit instrumental, përkatësisht të mospërforcimit të këtij refleksi me shpërblim. Shuarja e këtillë e refleksëve të kushtëzuara nuk është edhe zhdukje e tërësishme e tyre. Disa reflekse apo reagime të mësuara shuhen me vështirësi. Raste të këtilla kemi me shuarjen e disa reagimeve emocionale, sidomos të fobive. Madje, disa reagime refleksive të shuara ringjallen lehtë pas disa përsëritjeve të lidhjes ndërmjet ngacmuesit artificial dhe atij natyror**.**

SHUARJA E SHPREHIVE. Procesi i zhdukjes së shprehive, të cilat nuk përforcohen me rezultat pozitiv për njeriun dhe kur shprehia nuk përsëritet. Ky proces ka ecuri të caktuar: reagimet e karakterit të shprehisë dobësohen gradualisht derisa të zhduken nga repertori i sjelljeve të njeriut. Kjo ndodh me disa shprehi të thjeshta, ndërkaq shprehitë e ndërlikuara (të shkruarit sipas alfabetit të gjuhës amtare, të bërit not, të kënduarit me instrument muzikor etj. i rezistojnë më tepër shuarjes së tyre; këto, madje, pothuajse nuk zhduken. Madje, edhe kur nuk përdoren për një kohë të gjatë mjaftojnë dy-tri përsëritje apo ushtrime që të arrijnë në nivelin e zhvillimit maksimal të tyre.

Burimet:

David Legge and Paul J. Barber: *"Information and Skill"* – (*"Informacioni dhe shkathtësia"*), Methuen, London, 1976.

Robert Stammers and John Patrick: *"The Psychology of Training"* – (*"Psikologjia e trajnimit"*), Methuen, London, 1975.

Pajazit Nushi: *"Psikologji e përgjithshme 1"*, Prishtinë, 2002, fq. 265 – 275.

SHUMËKËNDËSHI I DENDURIVE. Formë e paraqitjes grafike të vlerave statistikore. Përbëhet nga disa shumëkëndësha që shtrihen mbi abshisë, ku lartësinë e secilit e përcakton denduria e vlerave statistikore, të cilat klasifikohen në klasa të veçanta. Kjo formë e paraqitjes së dendurive është mënyra e shfaqjes plastike të shkallës së dendurisë së vlerave statistikore.

SHUPLAKA E DORËS. Pjesa e poshtme e dorës, e cila përbëhet prej eshtrave metakarpale dhe falangave të gishtërinjve, nga grupi i posaçëm i muskujve që drejtojnë dorën e gishtërinjtë, nga enët e gjakut dhe nga nervat e veçantë. Funksioni i saj është i ndërlikuar. Me anë të lëvizjes së gishtërinjve dhe të dorës realizohet pjesa më e madhe e veprimeve të njeriut. Aftësitë psikomotorike janë të lidhura drejtpërdrejt me lëvizjet e duarve dhe të gishtërinjve.

SHURDHËSI, - A. f. Mungesa e pjesshme ose e tërësishme e dëgjimit të tingujve që është pasojë e lëndimit të receptorëve dhe nga sëmundjet e llojeve të ndryshme, të cilat godasin disa nga pjesët e shqisës së dëgjimit

dhe të lidhjeve nervore me këtë shqisë, përkatësisht me veshin. Shurdhësia mund të ketë karakter qendror organik dhe funksional. Karakteri qendror i shurdhërisë është i lidhur me disa çrregullime organike dhe funksionale të qendrës së të dëgjuarit në cipën apo koren e trurit të madh. Karakteri funksional i shurdhërisë është i lidhur me çrregullimin e mekanizmit të të dëgjuarit të tingujve. Shurdhëria shfaqet zakonisht me memecërinë.

SHURDHMEMEC, - E. mb. Që ka humbur aftësinë e dëgjimit dhe atë të të folurit.

SHUSHURIM/Ë, - A. f. Lloj tingujsh që prodhohen në natyrë, të cilët kanë gjatësi valësh ajrore të ndryshme dhe formë të parregullt. Këto formohen nga tonet me denduri joharmonike. Shushurima janë fishkëllimet, krikëllimat, krismat etj. Ndikimi i tyre në veshin e njeriut shkakton ndijimin e shushurimave.

T

TABEL/Ë, - A. f. Pasqyrë, paraqitje e të dhënave sasiore ose numerike në formë përmbledhëse në rreshta horizontale ose në shtylla vertikale. Kjo mundëson të kuptuarit e shpejtë dhe të lehtë të këtyre të dhënave dhe të raporteve elementare ndërmjet tyre. Tabela të tilla mund të jenë njëpërmasore, siç është ranxhimi i të dhënave sipas madhësisë së tyre, duke u nisur nga vlera sasiore më e ulët dhe duke arritur deri në vlerën sasiore më të lartë. Këto mund të jenë paraqitje me dy përmasa, përkatësisht tabela dypërmasore (sipas rreshtit horizontal dhe sipas shtyllave vertikale) etj.

TABELA E KONTIGJENTIT Çdo tabelë, pasqyrë apo paraqitje e sasive numerike të përftuara nga matja dhe vlerësimi i një ndryshoreje, ku në rreshtat horizontale paraqiten vlerat matëse të njërës ndryshore, kurse në tjetrën, përkatësisht në shtyllat vertikale paraqiten vlerat matëse të ndryshores tjetër. Në këtë mënyrë mund të paraqiten rezultatet e nxënësve të disa shkollave profesionale, kurse në rreshtat horizontale jepen rezultatet e këtyre nxënësve që kanë lidhje me profesionin e prindërve të tyre. Tabela e kontigjentit lehtëson të kuptuarit e përgjithshëm të raporteve ndërmjet dy llojeve të të dhënave.

TABELA E NUMRAVE TË RASTËSISHËM. Pasqyrë e të dhënave, të cilat përzgjidhen rastësisht për të hyrë në gjedhen apo kampionin e të provuarve. Zbatohet për t`iu larguar animit. Zbatimi i saj kryhet në këtë mënyrë: emërtohen numrat prej 0 – 9, ku secili numër ka të njëjtën vlerë dhe në zarin e hedhur merret ai subjekt ose ato subjekte që e kanë numrin e caktuar ndërmjet numrave nga 0 – 9. Nga rezultatet e përftuara që janë renditur në tabelën e caktuar nga hedhja e zarit bëhet përzgjedhja e gjedhes ose e kampionit për gjurmim.

TABELA KLASIFIKUESE. Tabela klasifikuese është pasqyra përmbledhëse e të dhënave të ndara në klasa të veçanta. Tabela klasifikuese mundëson përpunimin statistikor të hollësishëm të të dhënave të ndara në klasa.

TABELA SNELËN. Tabelë ose hartë që përdoret për të matur mprehtësinë

e të parit. Tabela ose harta është e formuar nga shkronja me madhësi të ndryshme. Kjo vihet para subjektit dhe nga ai kërkohet t`i identifikojë këto duke i lexuar. Në mbështetje të kësaj tabele përcaktohet mprehtësia e të parit, përkatësisht nevoja e përmirësimit të të parit me anë të syzave me dioptri të caktuar. Kjo tabelë mori emrin e oftalmologut holandez Herman Snelen (Hermann Snellen, 1834 – 1908).

TABELIMI I TË DHËNAVE SASIORE. Procesi i ndarjes, i klasifikimit të të dhënave dhe i paraqitjes së tyre në klasa të përkufizuara saktësisht. Rezultat i këtij procesi është tabela e qartë e të dhënave, që shërben si bazë e përpunimit të tyre. I tillë mund të jetë procesi i klasifikimit të suksesit të arritur në testin e matematikës së maturantëve të brezit X, ku arritjet klasifikohen në tabelën njëpërmasore sipas pikave të fituara prej 0 – 100.

TABES, - I. m. I ardhur nga latinishtja *tabes* "dobësim, shkrirje e organizmit". Degjenerim progresiv i organizmit, që karakterizon më tepër të sëmurët që vuajnë nga sëmundjet kronike. Ky degjenerim kryhet më tepër në formën e tharjes së organizmit. Dallohen disa lloje tharjesh, shkrirjesh të organizmit. Nga këto më të studiuarat janë: *tabes dorsales* "venitje shpinore", e pikërisht, venitja kurrizore që ka të bëjë me tharjen e pjesës së palcës kurrizore. Ka pasoja të rënda, nga të cilat dallohet çrregullimi progresiv i koordinimit të lëvizjeve të muskujve, që është pasojë e sifilisit nervor. Godet pjesën e fundit të boshtit kurrizor dhe shkakton çrregullime të stabilitetit trupor e të ecjes dhe përfundimisht humbjen e aftësisë së lëvizjes së trupit dhe të këmbëve. Lloj tjetër i tabesit është *tabesi infantium*. Ky lloj tabesi është tabes ose venitje shpinore e fëmijëve. Shkaktohet nga sifilisi i lindur.

TABU, - JA. f. I ardhur nga polinezishtja *tabu* "i pacenueshëm". Tabuja është ndalim shoqëror i përdorimit të një objekti, i kryerjes së një veprimi, i përdorimit të një fjale etj. Këto konsideroheshin të pacenueshme, të pashkelshme. Besohej dikur se shkelja e tyre paraqiste rrezik për individin dhe bashkësinë e tij. Burimi i tabusë është i lidhur me predikimet fetare e magjike. Ka tabu me karakter të përgjithshëm ose universal. Sot ajo ka shtrirje më të gjerë; në të folmen e përditshme ka kuptimin e asaj që është e fshehtë dhe e ndaluar të përdoret. E tillë mund të jetë një kafshë, një gjësend etj. Qëllimi i tabusë është t`i paraprijë dhe ta pengojë një të keqe, duke mos cenuar, shkelur e dëmtuar tabunë. Psikanaliza ka shpjegim të veçantë për kuptimin e termit tabu. Sipas pikëpamjes psikanalitike "tabuja është diçka e shenjtë, qëndron mbi të zakonshmen dhe është e rrezikshme, e papastër dhe e tmerrshme". Tabuja e incestit është term i psikanalizës. Ndalesat e tilla i shtyjnë, i shtypin idetë dhe veprimet e djalit ndaj nënës dhe shkaktojnë sjellje agresive ndaj të atit. Ka gjasa që ky term në psikanalizë ka ardhur nga antropologjia.

Burimet:

George Frazer: *"The Golden Bough"* – (*"Dega e Artë"*), 1904.
Cleude Levi Strauss: *"La pensee sauvage"* – (*"Mendimi i egër"*), 1921.
Sigmund Freud: *"Totem dhe tabu",* Tiranë, 2003.

TABULA RASA. I ardhur nga latinishtja *tabula rasa* "tabela e pashkruar, tabelë e dyllit të lëmuar". Ky pohim i Xhon Lokut në psikologji përdoret për të emërtuar shpirtin e pastër të fëmijës në të cilin nuk kanë filluar të ushtrojnë ndikim objektet, dukuritë, proceset, relacionet etj. të mjedisit të jashtëm. Përvoja dhe të mësuarit i regjistron në mendjen e fëmijës informacionet dhe ndërlidhjet e tyre, rrjedhimisht njeriu lind pa kurrfarë idesh. Këto ide formohen dhe zhvillohen nën ndikimin që ushtron mjedisi përreth tij. Ky mjedis është faktor themelor i zhvillimit dhe i formimit të njeriut dhe i personalitetetit të tij.

TAHISTOSKOP, - I. m. I ardhur nga greqishtja *tachys* "i (e) shpejtë" dhe *skopcin* "shikim". Instrument me anën e të cilit subjekteve u shfaqet lëndë pamore (fjalë, shkronja, vizatime etj.) brenda një kohe tejet të shkurtër, si ½, 1/5, 1/10, 1/100 pjesë e sekondës dhe ata kanë për detyrë të tregojnë atë që e kanë parë brenda paraqitjes në tahistoskop. Me anën e këtij instrumenti studiohet shkalla pamore dhe perceptimi i fjalëve, i shkronjave, i vizatimeve etj., shkalla e perceptimit nën pragun e ndjeshmërisë, vëllimi i vëmendjes etj.

TAHSINI Hasan. Filozof dhe psikolog shqiptar, si edhe studiues i shkencave të natyrës. Lindi në fshatin Ninat të Konispolit më 7.04.1811 dhe vdiq e u varros në Ysqydar (pjesa aziatike e Stambollit) më 4.07.1881. Mësimet e para i mori në fshatin Pandalejmonit dhe më pas shkollën qytetëse dhe fetare e vazhdoi në Janinë. Më pas vazhdoi mësimet në medresenë "Fatih" të Stambollit, ku i përfundoi me sukses të plotë. Më 1857 u përzgjodh ndër më të mirët për të vijuar studimet në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Universitetin e Sornës. Njihte dhe fliste arabishten, greqishten, latinishten, frëngjishten, italishten dhe besohet se ka qenë njohës edhe i anglishtes e i gjermanishtes. Më 1869 u emërua rektor i Universitetit të Stambollit, që u inaugurua më 1870. Por, në fund të këtij viti u shkarkua nga detyra e rektorit. Fushëveprimi i tij ka qenë i gjerë; me aq sa dihet deri më sot ai, krahas angazhimeve në fushën e zhvillimit të kulturës shqiptare, u mor edhe me studimin e astronomisë dhe të psikologjisë. Për këtë ka edhe dëshmi të argumentuara. Ka shkruar veprat: *"Psikologji ose "Ilmi Ruh" – "Dituri mbi shpirtin"* dhe "*Bazat e astronomisë*". Vepra "Psikologjia ose dituri mbi shpirtin ka karakter monografik dhe është vepra e parë e psikologjisë e shkruar nga një mendimtar shqiptar. Në këtë vepër, ndonëse me vëllim shkrimi të vogël, autori ka paraqitur arritjet e psikologjisë deri në kohën e tij me komente mendjemprehta për fuqitë ose kapacitetet psikike, të cilat atëherë quheshin "fakultete psikike". Ishte koha e popullarizimit të pikëpamjes së psikologjisë së fakulteteve (nga latinishtja *facultas* "aftësi, fuqi". Sipas kësaj psikologjie psikikën e njeriut e përbënin fuqitë e mendjes: intelekti, vullneti, kujtesa dhe arsyetimi. Por, Hasan Tahsini përpunoi edhe çështjen e ndijimeve, të gjuhës e të raportit të saj me mendimin, imagjinatën etj. Vepra psikologjike: *"Psikologji ose "Ilmi Ruh" – "Dituri mbi shpirtin"* u botua në osmanisht më 1894. Kjo vepër u gjet në bibliotekën e teqesë Rifainj në Gjakovë më 1950, në Bibliotekën Kombëtare

në Tiranë etj. Nën përkujdesjen e Nuri Abdiut vepra u përkthye në shqip nga Vexhi Buharaja dhe u botua në veprën e Nuri Abdiut me titull "Psikologjia" e Hasan Tahsinit më 2007.

TAKIKARDI, - A. f. I ardhur nga latinishtja *tachycardia* "përshpejtim i të rrahurit të pulsit të zemrës", zakonisht çrregullim i rrahjes së pulsit mbi 100 rrahje në një minutë. Shkaktohet nga faktorët psikikë (gjendja afektive, stresi etj.), nga angazhimi fizik i molisës, nga helmimi i organizmit etj. Mund të lërë pasoja të rënda për jetën dhe veprimtarinë e njeriut.

TAKSIS, - I. m. I ardhur nga greqishtja *τάξη* "rend, rregullim". Taksisi është reagim i thjeshtë, i lindur, specifik për llojin e caktuar të kafshëve të thjeshta. Reagimi i tillë shfaqet te organizmat e thjeshtë ndaj një ngacmuesi në formë të lëvizjes së thjeshtë të tij ndaj dritës, zërit, të nxehtit etj. Dallojmë taksisin pozitiv dhe atë negativ. Taksisi pozitiv është lëvizja e organizmit ndaj dritës dhe taksisi negativ është lëvizja në drejtim të kundërt nga ndikimi i ngacmuesit. Të tillë mund të jenë: aerotaksisi – lëvizja kah ajri me oksigjen ose largimi nga ajri (fryma), fototaksisi – lëvizja kah një burimi të dritës ose largimi prej tij, gjeotaksisi – lëvizja në drejtim të gravitetit ose largimi prej gravitetit etj. Këto lloj lëvizjesh të organizmave të thjeshtë të bimëve dhe të kafshëve të rendit të ulët janë emërtuar me termin tropizëm.

TAKSONOMI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *τάξη* "rend, rregullim" dhe *νόμος* "ligj". Disiplinë shkencore që merret me klasifikimin hierarkik të dukurive, objekteve, qenieve etj. dhe me parimet e me ligjet e klasifikimit dhe të renditjes së tyre. Fillimi i zhvillimit të taksonomisë lidhet me biologjinë. Në psikologji dallohen disa lloje taksonomish, ndër të cilat më e njohura është *taksonomia Blum*, - shih.

TAKSONOMIA BLUM. Lloj i taksonomisë, i rëndësishëm për procesin e të mësuarit dhe për teorinë e hartimit të testeve. Në funksion të të mësuarit dallojmë tri lloj informacionesh dhe të dhënash: kognitive, ndjenjore dhe psikomotorike. Informacionet e të dhënat kognitive i përkasin ndarjes së tyre sipas parimit të caktuar në kategori njohëse të veçanta, por të ndërlidhura; taksonomia ndijore i përket parimeve të ndarjes së brendshme të përjetimeve emocionale dhe taksonomia psikomotorike ka të bëjë me parimet e nivelimit të arritjeve të njeriut në zhvillimin e shpejtësisë, të zhdërvjelltësisë dhe të koordinimit të lëvizjeve të një shkathtësie e shprehie. U quajt sipas studiuesit të saj, hulumtuesit Blum.

TAKSONOMIA KOGNITIVE. Rendi hierarkik i përvetësimit të përmbajtjeve mësimore që ka gjashtë shkallë: 1) Njohja – ballafaqimi me fakte dhe mbajtja mend e tyre; 2) Kuptimi – ndryshimi i informacioneve nga një formë në tjetrën; 3) Zbatimi – përdorimi i rendit, i rregullave e i parimeve në zgjidhje të problemeve dhe të situatave problemore; 4) Analiza – zbërthimi i informacioneve në pjesët e tyre dhe të kuptuarit e lidhjeve ndërmjet tyre; 5) Sinteza – lidhja dhe kombinimi i informacioneve të vjetra me të rejat dhe 6) Vlerësimi – hartimi i kritereve në mbështetje të të cilave bën

vlerësimin dhe këtë e shpreh me llojin përkatës të gjykimeve.

TAKSONOMIA NDJENJORE. Rendi hierarkik i ndjenjave dhe i të mësuarit të reagimeve emocionale të përshtatshme, të vlerave të njeriut. Kjo taksonomi ka pesë shkallë: 1) Gatishmëria e marrjes së porosisë së mesazhit ndijor (vetëdija për atë që ndodh, demonstrim i dëshirave, kontroll i reagimeve); 2) Reagimi – pranimi në heshtje i mesazhit, reagimi duke ditur shkaqet e tij, kënaqësia e njeriut për reagimin emocional përkatës ndaj ndodhisë së caktuar; 3) Vlerësimi – kuptimi i vlerës shoqërore, pranimi i saj, shprehja e preferencës së njeriut ndaj një vlere të caktuar dhe angazhimi në zbatimin e saj; 4) Organizimi – niveli i arritur i demonstrimit të klasifikimit të emocioneve dhe të vlerave dhe 5) Shfaqja e gatishmërisë së njeriut për t`u sjellë sipas vlerave të përvetësuara.

TAKSONOMIA PSIKOMOTORIKE. Rendi hierarkik i procesit të të mësuarit dhe i përvetësimit të lëvizjeve dhe sistemit të tyre në tërësi lëvizjesh të koordinuara, përkatësisht në përvetësim veprimesh shkathtësie dhe shprehie. Mbështetet në informacionet për karakterin e lëvizjeve, qëllimin e ushtrimeve, rendin e ushtrimit të lëvizjeve dhe në lidhjen e tërësishme të tyre në një tërësi shkathtësie a shprehie të caktuar.

TAKT, - I. m. Term i dukurive fizike që ka të bëjë me shpërndarjen e njëllojtë të pjesëve të një tërësie të ritmit të caktuar, të ndarë në intervale kohore të caktuara saktësisht. Në shqip takti ka kuptimin e sjelljes së matur dhe të kujdesshme ndaj tjetrit. Kur sjellja e tillë bëhet e qëndrueshme në marrëdhënien e njeriut me të tjerët, atëherë sjellja me takt merr përmasat e tiparit. Tipari i këtillë është sjellje që kontrollohet nga ana e vetëdijes së njeriut.

TALAMUS, - I. m. Term i anatomisë dhe i fiziologjisë, si edhe i psikologjisë fiziologjike, i ardhur nga latinishtja *thalamus*. Talamusi është strukturë e veçantë e trurit të mesëm i përbërë nga dy pjesë: nga pjesa e djathtë dhe ajo e majtë. Këto shtrihen nga secila anë e masës trunore të pjesës së mesme të trurit. Përbëhet nga një numër i madh bërthamash nervore, që, sipas funksionit që kryejnë, ndahen në tri grupe: bërthamat specifike projektuese, bërthamat jospecifike projektuese dhe bërthamat asociative. Këto formojnë një "relie" qelizash pranuese të impulseve nervore. Grupi i parë i këtyre bërthamave, ai specifik, është "relie" aferente impulsesh nervore që vijnë nga periferia dhe në talamus këto impulse ndërpriten (përjashtim bëjnë impulset nervore nuhatorë). Në talamus ndërpriten edhe rrugët aferente të impulseve nervore që vijnë nga truri i vogël dhe nga ganglionet bazale. Bërthamat jospecifike projektuese pranojnë impulse nervore nga fijezat aferente të formacionit retikular të trungut të trurit. Bërthamat asociative përbëhen nga ato qeliza nervore, neuritet apo aksonet e të cilave janë të lidhura me fushat asociative të kores së trurit të madh. Bërthamat e këtyre qelizave që janë të lidhura me pjesët parietale (tepore), tëmthore e zverkore marrin pjesë në zhvillimin dhe rregullimin e proceseve kognitive të ndërlikuara (të mendimit e të të folurit). Bërthamat e qelizave

nervore të fushës asociative ballore marrin pjesë në zhvillimin, kontrollin dhe shfaqjen e emocioneve.

TALENT, - I. m. I ardhur nga greqishtja *talέntum* "njësi monetare antike". Talenti është formë dhe shkallë e zhvillimit mbimesatar të aftësisë së njeriut në një fushë të veprimtarisë dhe të aktivitetit krijues të tij. Aftësia e këtillë shfaqet kryesisht herët në zhvillimin individual, duke i mundësuar secilit të talentuar fitimin e lehtë dhe të shpejtë të shkathtësisë dhe arritjen e rezultateve të larta në fushëveprimin e tij. I tillë mund të jetë talenti për matematikë, muzikë, pikturë, skulpturë, shah etj. Këta talente nuk kanë nevojë për shumë angazhime e ushtrime për t`i mësuar dhe përvetësuar shkathtësitë në fushën e talentit të tyre. Talenti konsiderohet strukturë e aftësive të lindura. Megjithëkëtë, për shndërrimin e kësaj strukture të lindur në talent të zhvilluar kërkohet angazhim sistematik e kultivues, i shoqëruar me dashuri dhe me kënaqësi për arritjet e hershme të nivelit të lartë cilësor.

TANATOLOGJI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *autoktonía* "vdekje" dhe *logía* "shkencë". Tanatologjia është disiplinë e re shkencore, që merret me studimin e aspekteve psikologjike dhe mjekësore të procesit të vdekjes, përkatësisht me identifikimin e fazave psikologjike- mjekësore të këtij procesi.

TANATOS (THANATOS). asnj. Perëndia e vdekjes, që i përkiste nëntokës dhe urrehej nga të tjerët. Këtë kuptim ka termi tanatos në mitologji. Termi tanatos në psikanalizë emërton shtytësin destruktiv të njeriut dhe përgjithësisht të gjinisë njerëzore. Me këtë term emërtohet shtytësi i vdekjes. Është ndër dy termat e koncepteve themelorë të psikanalizës klasike (së bashku me shtytësin e jetës). Është i drejtuar në dëmtimin e shkatërrimin e vetes dhe të të tjerëve, duke u manifestuar me sjellje refuzuese ndaj trupave e dukurive që sjellin kënaqësi, si edhe me sjellje agresive dhe destruktive të njeriut ndaj të tjerëve dhe mjedisit të vet, në kthimin e organizmave në gjendje të vdekur.

T A T Shkurtesë e ardhur nga anglishtja *Thematic Aperception Test* "Test i tematikës aperceptive" që nënkupton një lloj testi projektiv për studimin e personalitetit dhe të përmasave të tipareve të tij. Testi origjinal përbëhej prej 20 fotografish bardh e zi, që ngacmojnë fantazinë dhe strukturën e mendimeve dhe të preokupimeve të njeriut (më vonë numri i fotografive u shtua në 30 të tilla). Për secilën nga këto fotografi subjekti ka detyrë të hartojë një tregim. Në hartimin e tregimit ndikojnë dëshirat, interesat, konfliktet e brendshme etj. Kështu veprohet për 19 fotografitë e paraqitura, kurse për fotografinë e 20 paraqitet kartoni i zbrazët dhe subjekti ka për detyrë ta zgjedhë vetë temën e tregimit. Në tregimet e tij subjekti duhet të tregojë çfarë sheh, si sillet dhe si ai do të sillej në situata të tilla. Në bazë të analizës së tregimeve të temave të tilla mund të konstatohen dëshirat e shtypura, orientimet, integrimet e tipareve, vuajtjet e thella të subjektit etj. U hartua nga psikologu amerikan Henri R. Marej (Henry A. Murray, 1893 – 1979) dhe u botua më 1935.

TAUTOLOGJI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *tautología* "përsëritje e së

thënës". që ka të bëjë me përsëritjen e tepërt të asaj që tashmë është thënë, duke përdorur fjalë të tjera për të shprehur të njëjtin kuptim. E tillë është shprehja "Kjo është forma e rrumbullakët e enës rrethore". Gjykimet e tilla janë të pavlefshme për nga përmbajtja ko-gnitive e tyre. Përkufizimet tautolo-gjike të koncepteve nuk kanë vlerë kognitive, si përkufizimi "Potenciali psikik është mundësia shpirtërore", "Qetësia shpirtërore është rahatia e shpirtit"," "Lëvizja mekanike është lëvizje e vetvetishme" etj.

TAUTOLOGJIA PSIKOLOGJIKE. Të thënët e përmbajtjes së një mendimi, dëshire, motivi, përfytyrimi etj. si edhe përshkrimi i përjetimit emocional në forma të ndryshme gjuhësore. Vjen në shprehje më tepër në format e mendimit analitik, sidomos në gjykimet analitike. Të këtilla janë pohimet: "Gëzimi është gjendje e gëzueshme e njeriut", "Vetë aktualizimi është aktualizim i vetvetes" etj. Tautologjia psikologjike as nuk e sqaron e aq më pak e thellon mendimin e caktuar të psikologjisë.

TEIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga greqishtja *theos* "zoti". Doktrinë religjioze e mbështetur në bindjen dhe në besimin e thellë të njeriut se zoti ka krijuar Gjithësinë, të cilën e udhëheq. Ai shkakton kudo ndryshime me vullnetin dhe me fuqinë e tij. Ndërkaq "personaliteti" i tij gjendet jashtë botës reale.

TEJBARTJA E TË MËSUARIT. Tejbartja e të mësuarit është shqipërim i procesit të transferimit të të mësuarit, kur e zgjerojmë kuptimin e fjalës tejbartje, që në shqip do të thotë "Shpie diçka nga një vend në vendin tjetër". Termi profesional për bartjen e asaj që është mësuar nga burimi ku është mësuar (nga historia në gjeografi, në politikë, në sociologji etj.) është termi i ardhur nga latinishtja *transferre* "bart".

TEJLORIZ/ËM, - MI. m. Përpjekje për organizimin, racionalizimin e procesit të punës, përkatësisht të prodhimit. Synimi i kësaj përpjekjeje ishte shkurtimi i kohës së punës në bazë të organizimit të drejtë të lëvizjeve të domosdoshme e të thjeshta, që duhej t`i bënin punëtorët e aftësuar vetëm për ato lëvizje sipas kohës, sipas rendit të lëvizjeve dhe sipas efektit të normuar. Për secilin operacion të punës përcaktohej norma. Mbi këtë bazë përcaktoheshin detyrat e secilit vend të punës, përkatësisht të secilit punëtor dhe shkalla e fitimit të të ardhurave. Ky sistem i organizimit të punës për herë të parë konsideron rolin e madh të punëtorit, pikërisht të njeriut, të aftësive të tij dhe të mundësive personale në përparimin e procesit të prodhimit. Këtij sistemi i janë atribuuar përmasat johumane, megjithëse të ardhurat e punëtorëve janë shtuar 2 – 3 herë më shumë se më parë. Ky sistem u emërtua tejlorizëm, sipas industrialistit dhe inxhinierit amerikan Tejlor (Taylor, 1856 – 191**5).**

TEJZAT ZANORË. Dy palë "kapakë" ose "tela" të formuar nga indet muskulore të laringut që hapen e mbyllen me anë të frymëmarrjes dhe që, gjatë kësaj kohe dridhen ose vibrojnë, duke prodhuar në këtë mënyrë zërin e të folurit . Shih – ***APARATI I TË FOLURIT.***

TEK/Ë, - A. f. Dëshirë, mendim, kërkesë, synim i papritur, i befasishëm,

herë-herë edhe i çuditshëm, që i imponohet njeriut dhe ai ngulmon ta plotësojë. Ka konotacion jo vetëm të befasisë, jo të pritshmërisë, por edhe të mospëlqimit nga ana e të tjerëve. Nga tekat e këtilla njeriu largohet, mënjanohet me vështirësi të madhe. Shfaqet më tepër te ata që janë të ngarkuar me inat.

TEKNIKA E ABLACIONIT. I ardhur nga latinishtja *ablation* "shkolitje, heqje". Mënyrë e vëzhgimit të ndryshimeve në sjellje kur hiqet në mënyrë kirurgjikale një pjesë e organit shqisor, e rrugëve nervore, e qendrave të trurit etj. për të konstatuar rolin dhe rëndësinë e tyre në zhvillimin dhe organizimin e sjelljeve apo të veprimeve të caktuara. Zbatohet kryesisht te kafshët e rendit të lartë.

TEKNIKAEVETËPËRSHKRIMIT. Teknikë që emërton përshkrimin e botës së brendshme (të bindjeve, të interesimeve, të ndjenjave, të pikëpamjeve, të qëndrimeve etj.), format karakteristike të sjelljes dhe përmasat e zhvillimit të tyre, të cilat një individ i rritur duhet të jetë në gjendje t'i bëjë. Kjo formë e vetnjohjes dhe e paraqitjes së botës së brendshme ndaj të tjerëve ka disa mangësi: kërkon shkallë të lartë të zhvillimit të aftësive fjalësore dhe të vetpërshkrimit. Subjektet inteligjentë mund të gjejnë lehtë forma të paraqitjes së kësaj bote ndryshe nga ajo çka ata ndiejnë.

Burimet:

Hermann Rorschach: *"Psychodiagnostics"* – (*"Psikodiagnostika"*), Bern, 1951.
Henry Murrrai: *"Explorations in Personality"* – (*"Eksplorimi i personalitetit"*), New York, 1962.
Hans J. Eysenck: *"Handbook of Abnormal Psychology"* – (*"Doracak i psikologjisë anormale"*), London, 1960.
Josip Berger: *"Psihodijagnostika"* – (*"Psikodiagnostika"*), Beograd, 1984 (pjesa XVIII, fq. 382 – 410).
Josip Berger: *"Po aty", pjesa XVI "Samoopis kao osnova procene ličnosti"* – (*"Vetëpërshkrimi si bazë e vlerësimit të personalitetit"*), Beograd, 1984.

TEKNIKA E VIRTYTETEVE DHE E TË METAVE. Veprim teknik i psikoterapeutit ndaj klientit të tij, që ka të bëjë me kërkesën që klienti duhet të hartojë një regjistër virtytesh dhe një regjistër të metash të vetes së tij. Hartimi i regjistrit të këtillë ka për qëllim saktësimin e qëllimeve të afërta dhe të largëta të klientit, duke e bërë atë të vetëdijshëm për nevojën e mënjanimit dhe të asgjësimit të të metave në repertorin e sjelljeve të tij ndaj të tjerëve. Ka përmasat e teknikës psikoterapeutike bihejviorale.

TEKNIKA ELEKTROFIZIOLOGJIKE. Formë e teknikës gjurmuese, e cila zbatohet kryesisht në psikologjinë fiziologjike. Me anën e saj studiohen format e aktivitetit dhe të ndryshimit të tyre në kushtet e ngacmimit të qelizave të caktuara nervore me ngacmimin e tyre me një rrymë elektrike me potencial shumë të ulët.

TEKNIKA IMPONUESE E PËRZGJEDHJES. Formë e procedurave gjurmuese, që shfrytëzohen me rastin e zbatimit të shkallës së vlerësimit, të inventarizimit të tipareve të personalitetit etj., kur subjekti duhet të përcaktohet dosmodoshmërisht për njërën nga (dy, tri) zgjidhjet e parashtruara. Zbatohet me rastin e kërkimit të ranxhimit të vlerave. Përparësia e kësaj teknike qëndron në domosdoshmërinë e përcaktimit për njërin

tipar të padëshirueshëm, ose me valencë vlerash të njëjta. Shfrytëzohet për studimin e vlerave sipas teknikës Olport – Vernon – Lindizie.

TEKNIKA PROJEKTIVE. Emërtim i përbashkët i teknikave, testeve dhe i veprimeve, që kanë për bazë analizën studimore të reagimeve të një subjekti ndaj një materiali të pastrukturuar, të paformësuar të cilin ai e strukturon duke i dhënë shpjegim të veçantë individual. Material ose lëndë e tillë e paformësuar mund të jenë figura, vizatime të pacaktuara, fjali të papërfunduara, tregime të pambaruara etj. dhe subjekti ka për detyrë t`u japë këtyre përmbajtje kuptimore siç ai i kupton. Forma më e përhapur e këtij materiali apo lënde të paformësuar i përket figurës që përftohet nga shpërndarja e pikës së ngjyrës së shkrimit në dy faqet e letrës së palosur. Subjekti formësimin e kësaj lënde nuk e bën mekanikisht, por sipas dëshirave, preokupimeve, prirjeve, synimeve etj. Në këtë formë ai këto struktura të brendshme dhe ndikimin e tyre e projekton, e bën të njohur për të tjerët. Ndër teknikat projektive më e njohura është teknika e psikiatrit zviceran Herman Rorshahut (Hermann Rorschach, 1884 – 1922). Shih – ***NJOLLAT E TESTIT TË RORSHAHUT.***

TEKNIKA TË GJURMIMEVE PSIKOLOGJIKE. Sistem instrumentesh që hartohet dhe zbatohet me qëllim të mbledhjes së të dhënave dhe përpunimit profesional e shkencor të tyre. Këto teknika kanë të përcaktuar edhe procedimin profesional, përkatësisht shkencor të tyre. Me këtë kuptohet veprimi që kërkon shkathtësi dhe nivel të duhur të profesionit të psikologut hulumtues.

TEKNOPSIKOFIZIOLOGJI, - A. f. Degë ndërdisiplinore, kryesisht praktike, që merret me studimin e raportit të sistemit njeri-makinë. Ka për qëllim studimin e aspekteve të përshtatjes ndaj kushteve fizike e teknologjike, aftësive të përgjithshme dhe të veçanta të punëtorit. Për lëndë studimi ka edhe njohjen e kushteve dhe të raporteve fizike e klimatike të vendit të punës, veçoritë tekniko-teknologjike të lokacionit, përkatësisht të hapësirës së punës dhe njeriun në marrëdhënie me makinën dhe me instalimet sinjalizuese. Në këtë drejtim teknopsikofiziologjia studion aftësitë, mundësitë dhe reagimet perceptive, kognitive të punëtorit, kufizimet e tyre etj., dhe, duke konstatuar shkallën e zhvillimit të tyre në raport me sistemin makinë–njeri, propozon alokimin e punëtorëve me qëllim të përshtatjes ndaj kushteve dhe rrethanave të vendit të punës. Për këtë arsye sot përdoret edhe termi psikologji e inxhinierisë.

TEKSTURA SHKAKORE. Pikëpamja e vjetër për raportin shkak-rrjedhim, të cilën e kanë zhvilluar në psikologji psikologët amerikanë, Eduard Ç. Tolman (Edward Ç. Tolman, 1886 – 1959) dhe Egon Brunsvik (Egon Brunswik, 1903 – 1955). Sipas tyre dukuritë janë në ndërlidhje rrethore ndërmjet tyre; kjo ndërlidhje sillet prej varësisë së pakufishme dhe më të vogël deri në varësi kauzale të njëmenda. Megjithëkëtë, sipas pikëpamjes së këtyre psikologëve, kjo varësi nuk ka karakter përcaktues.

TELEKINEZ/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *τηλε* "larg" dhe *κινησία* "lëvizje". "Aftësia e disa individëve që mund t`i lëvizin objektet" sipas

dëshirës dhe vullnetit të tyre, duke mos kontaktuar fare me ta dhe duke mos përdorur kurrfarë fuqie për lëvizjen e tyre. Dukuria e tillë i përket grupit të dukurive parapsikologjik**e.**

TELENCEFALON, - I. m. Shtrirja më e madhe e trurit të madh. Në këtë pjesë të trurit bëjnë pjesë: cipa apo korja e trurit (korteksi cerebral), ganglionet bazale dhe sistemi limbik i trurit. Shih - ***TRURI I MADH.***

TELEPATI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *τηλε* "larg" dhe *παθεία* "ndjenjë". Term i koncepteve parapsikologjike që ka të bëjë me dijen e fituar nga ana e një individi për ndjenjat, mendimet etj., e një individi tjetër pa ndërmjetësimin e proceseve psikike, pra dija që nuk mbështetet në funksionin e shqisave, në perceptimin. Barten përmbajtjet, ndjenjat, pikëpamjet e porositë prej një individi në tjetrin, duke qenë në largësi relativisht të madhe njeri prej tjetrit. Kështu, nëse dërguesi ia lëshon marrësit figurën e një foshnje, marrësi këtë e merr pa ndihmën e kurrfarë energjie! Telepatia karakterizon më tepër ata individë që gjenden në situata të rrezikshme.

TELERECEPTOR, - I. m. Sistem receptorësh që reagojnë ndaj ngacmuesve që gjenden në largësi relativisht të madhe nga trupi i njeriut. Kështu, ngacmuesit e largët të dritës nga syri i njeriut, ngacmuesit e burimit të zërave larg veshit, të burimit të erërave larg hundës shkaktojnë të gjithë reagim të receptorëve të të parit, të dëgjimit dhe të nuhatjes.

TELESTEZI, - A. f. Dukuri e parapsikologjisë që ka të bëjë me aftësinë jonormale të njeriut për të paraparë atë çfarë do të ndodhë, për të paraparë ndodhinë, ngjarjen që do të vijë, objektin që do të gjendet pranë shtëpisë ose në shtëpi pa e sjellë askush etj. Në këtë proces të çuditshëm nuk marrin pjesë shqisat e njeriut.

Burimet:

Milan Riz: *"Parapsikologjia – Perceptimi jashtëshqisor – Telepatia – Parashikimi – Forca e mendimit",* Tiranë, 2002.

TELODENDRON, - I. m. Pjesa fundore e neuritit ose e aksonit që formohet nga një numër i madh fijesh nervore. Nga këto fije neuriti ose aksoni degëzohet në mbarim të trupit të tij. Secila fije nervore përfundon me trashjen e saj, që quhet nyje përfunduese, e cila mbështetet në cipën e neuronit tjetër duke krijuar në këtë mënyrë sinapsën – vendin ku takohen të dy qelizave nervore, përkatësisht dy neuronet.

TEM/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *θέμα.* Term i letërsisë, i muzikës, i artit filmik etj., por edhe i psikologjisë. Në psikologji tema është përcaktimi i saktë i një trajtese shkencore që reflekton një përmbajtje të caktuar dhe shtrirjen e diskutimit të anëtarëve të një grupi shoqëror të caktuar. Tema në psikologjinë e personalitetit, në psikologjinë sociale, në psikodiagnostikë etj. është "nyja" lidhëse e bashkëveprimit ndërmjet individit që ka motivet, interesat dhe nevojat e tij dhe të faktorëve mjedisorë që ushtrojnë ndikim në të.

TEMPERAMENT, - I. m. I ardhur nga latinishtja *temperamentum* "përmbajtje, masë e duhur" që paraqet një veçori të personalitetit, të cilën e përbën tërësia e dispozitave për mënyrën e reagimit, sidomos të atij emocional,

ndaj dukurive, objekteve e situatave të caktuara. Shfaqet me shpejtësi reagimi, me intensitet dhe me ekuilibrimin dhe me tonin e sjelljeve dhe të veprimeve jetësore të personalitetit ndaj ngacmuesve të jashtëm. Temperamenti konsiderohet se është i lindur dhe faktorët e jashtëm mund të ushtrojnë ndikim të kufizuar në ndryshimin e tij. Është i lidhur me konstituimin fizik të trupit të njeriut dhe me funksionimin e sistemit nervor autonom vegjetativ, si edhe me sistemin e gjëndrave me sekretim të brendshëm. Fillesat e studimit të temperamentit i hasim që nga koha e Hipokratit, përkatësisht nga viti 460 – 377 p. e. r. Hipokrati bëri klasifikimin e parë të tipave të temperamentit duke i ndarë këta në tipa flegmatikë, kolerikë, melankolikë e sanguinë. Këtë ndarje e shpjegoi me mbisundimin e lëngjeve në organizmin e njeriut, me mbisundimin e jargëve – tipi flegmatik, të gjakut – tipi sanguin, të tëmthit të zi – tipi melankolik dhe të tëmthit të verdhë – tipi kolerik. Më pas këtë ndarje e përforcoi mjeku romak Galen në shekullin e dytë të epokës së re. Disa shekuj pas tyre fiziologu rus Ivan P. Pavllov (Ivan P. Pavlov, 1849 – 1936) u pajtua me një ndarje të tillë, duke e shpjeguar këtë me mënyrën e funksionimit të sistemit nervor të njeriut.

TEMPERAMENTI FLEGMATIK. Shih fq. 245

TEMPERAMENTI KOLERIK. Tipi kolerik është njëri nga katër tipat e temperamentit të njeriut. Tipin kolerik e karakterizon ndjeshmëria e nivelit të lartë, reagimi i shpejtë ndaj ngacmuesve të ndryshëm, paraqitja e ndjenjave intensive, hidhërimi i shpejtë, kalimi i lehtë në aksion, vrulli, këmbëngulja në mendime e në kërkesa, kontrollimi me vështirësi i emocioneve të veta etj. Ndër lëngjet e organizmit te tipi kolerik mbisundon tëmthi, prej nga vjen edhe termi *cholea* "tëmth". Termi i përket tipologjisë së Hipokratit (Hippocrates, rreth 460 – 377 p. e. r.).

TEMPERAMENTI MELANKOLIK. Një nga katër tipat e temperamentit të tipologjisë së Hipokratit. Tipin e temperamentit melankolik e karakterizojnë këto cilësi: reagon rrallë, me ritëm të ngadalshëm të sjelljeve, por me emocione të fuqishme dhe afatgjata, mbisundon mocioni i dëshpërimit, i pikëllimit, i mërzisë etj. Tipin melankolik e karakterizon mbisundimi i tëmthit të zi.

TEMPERAMENTI SANGUIN. Shih. fq. 798

TENACITET, - I. m. I ardhur nga latinishtja *tenacitas* "qëndrueshmëri". Term i psikologjisë klasike që karakterizon qëndrueshmërinë e vëmendjes dhe të ndjenjave. Tenaciteti i vëmendjes është qëndrueshmëria e gjatë e saj në një objektiv të caktuar; tenaciteti i ndjenjave duke përfshirë edhe afektet është qëndrueshmëria e një gjendjeje emocionale të njeriut për një kohë relativisht të gjatë.

TENDENC/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *tendere* "synoj". Në kuptimin e përgjithshëm nënkupton drejtimin që ka marrë dukuria e caktuar gjatë zhvillimit të saj. Në kuptimin e ngushtë tendenca është drejtim i pikëpamjeve, i mënyrave të qëndrimit dhe i sjelljeve relativisht të qëndrueshme ndaj ngacmuesve të caktuar, që zakonisht lidhen

me një përfytyrim relativisht të qartë të një qëllimi të caktuar dhe me rezultatin përfundimtar të një veprimi të caktuar. Në rastet e këtilla bëhet fjalë për prirje reale. Në psikologjinë kognitive ky term ka kuptimin e synimit të përgjithshëm të mendimit dhe në përzgjedhjen e atyre përmbajtjeve dhe mënyrave të drejtuara në zgjidhjen e një problemi të caktuar, të lidhur me veprimet që duhet të ndërmarrë për realizimin e kësaj tendence. Psikologët e shkollës së Virzburgut këtë e quajnë tendencë mbisunduese ose përcaktuese.

TENDENCA QENDRORE. Term i statistikës që emërton karakteristikën e të dhënave numerike që grumbullohen rreth vlerës së mesme të tyre. Kjo është vlera e mesme e vargut të vlerave individuale që gjendet ndërmjet vlerave të skajshme pozitive e negative.

T

TENDENCIOZ, - E. mb. Që ka përcaktim mendor e mendim të caktuar dhe sillet sipas tij, pavarësisht nga situatat konkrete dhe objektiviteti i tyre. Mund të ketë pasoja të rënda për raportet ndërmjet dy individëve, dy palëve etj. Ky term zakonisht përdoret për të emërtuar një vlerësim negativ të një individi me qëllim për të vepruar ndaj një individi tjetër.

TENDOSJ/E, - A. f. Gjendje shqetësuese dhe e acaruar e njeriut, e shkaktuar nga ngacmuesit e jashtëm, e shoqëruar me shtrëngim emocional e veprues ndaj tyre. Një tendosje e tillë në strukturën e vet ka ankthin, por edhe gatishmërinë e reagimit të menjëhershëm, herë-herë edhe me gjithë energjinë e vet ndaj ngacmuesve të tillë dhe bartësve të tyr**e.**

TENSION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *tension*. Term i ngulitur në shprehjet profesionale fizike, fiziologjike, mjekësore dhe psikologjike. Në psikologji emërton gjendjen e ngrehur, të shqetësuar, të acaruar dhe të gatshme për të filluar një veprimtari të caktuar. Gjendja e tillë shprehet më tepër në fushën e ndjenjave dhe përjetohet në formë hidhërimi, pakënaqësie dhe zemërimi për mosplotësimin e nevojave të caktuara biologjike, sociale apo psikologjike, duke e vënë organizmin në gjendje gatishmërie për të vepruar ndaj bartësve të kësaj pengese. Në psikologjinë e motivacionit tensioni ka të bëjë me gjendjen psikike të shkaktuar nga mosplotësimi i motivit të caktuar. Në psikologjinë sociale tensioni emërton gjendjen e atillë shoqërore në marrëdhëniet ndërmjet dy individëve, ku ndjenjat negative drejtuar kundër tjetrit zhvillohen më lehtë dhe më shpejt se ndjenjat pozitive.

TENSIONI FRUSTRUES. Ngarkesa e proceseve kognitive dhe e atyre emocionale e motivuese për të gjetur mjete dhe rrugë, si edhe energji të reja për ta zotëruar pengesën e shfaqur në aktivitetin e njeriut, për të arritur deri në qëllimin e synuar.

TENTATIV/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *tentare*. Term i disiplinave juridike me shtresa të mendimit psikologjik dhe motivues. Tentativa është gatishmëria e plotë e njeriut për të organizuar sjelljet e veta në drejtim të shkaktimit të një të keqe të rëndë ndaj tjetrit; ky është angazhim për kryerjen e një vepre penale, por që nuk ka arritur të realizohet.

TEORI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *theoreein* "me pa, me vënë re". Ka kuptim të përgjithshëm që përdoret kryesisht në të folmen e përditshme, e që

ka të bëjë me një mendim abstrakt, me një parim. Kuptimi i përveçëm i termit teori përdoret kryesisht në disiplinat e shkencave teorike dhe empirike. Teoria është sistem koherent i pohimeve dhe i raporteve të ndërlidhura, me të cilat përshkruhen dhe shpjegohen në formë të përgjithësuar dhe të integruar lidhjet esenciale të koncepteve, të ligjeve dhe të parimeve zhvillimore të një fushe të caktuar të realitetit objektiv. Mundëson organizimin konceptual koherent të argumenteve, kontrollin e tyre dhe parashikimin e mundësive të zhvillimit të tyre. E tillë është në psikologji teoria për personalitetin e Gordon Olportit (Gordon Allport, 1897 – 1967), teoria për emocionet e Uiliam Xhejmsit (William James, 1842 – 1910), teoria e motivacionit e Abraham Maslout (Abraham Maslow, 1908 – 1970) etj.

TEORIA ATRIBUITIVE. Qasje e veçantë e perceptimeve shoqërore apo sociale, pra e perceptimit të sjelljes së një anëtari të grupit shoqëror ndaj një anëtari tjetër. Perceptimi i tillë kryhet sipas këtij rendi: anëtari i grupit e vëzhgon sjelljen e tjetrit dhe në bazë të informacioneve të marra nga vëzhgimi i tillë i përshkruan ose i atribuon motivin, synimin e sjelljeve sociale të tij. Mori përmasat e një teorie në studimet e psikologut amerikan me prejardhje nga Austria Fric Hajder (Fritz Hajder, 1896 – 1988) dhe psikologut social, amerikanit Harold Keli (Harold Kelley, 1921). Këta i shpjeguan sjelljet e individit tjetër, duke iu atribuuar këtyre sjelljeve edhe motivet, synimet, dëshirat etj. personale. Ky lloj atribuimi kryhet sipas mbivlerësimit të cilësive dhe të tipareve të tij dhe nënvlerësimit të të tjerëve, sidomos të faktorëve të jashtëm në sjelljet e të tjerëve.

TEORIA DYFAKTORIALE E INTELIGJENCËS. Teoria dyfaktoriale e inteligjencës e shpjegon strukturën e inteligjencës në bazë të dy faktorëve. Këta faktorë janë: faktori i përgjithshëm dhe faktori special.

TEORIA E AKTIVIZIMIT. Teori e zhvillimit të sjelljeve dhe emocioneve që i shpjegon emocionet në bazë të gjendjes aktive të njeriut. Bazën e kësaj gjendjeje e përbën formacioni retikular, sidomos ai i trungut të trurit. Aktivizimi i intensitetit të ulët të organizmit nuk shpie në sjellje të caktur dhe as në përjetim dhe shfaqje emocionale të veçantë. Aktivizimi i tepërt shpie në sjellje dhe gjendje emocionale pak a shumë të pakontrolluar. Këtë sistem shpjegues të sjelljeve dhe të emocioneve e ka konceptuar psikologu amerikan Lindzl.

TEORIA E ASIMILIMIT TË QËNDRIMEVE. Shpjegim i ndryshimit të qëndrimeve në bazë të raportit ndërmjet pozicionit fillestar të qëndrimit të një individi, të angazhimit mendor të atij që orvatet ta ndryshojë këto pozicion dhe qëndrimin lidhur me të dhe të fuqisë burimore argumentuese të një qëndrimi të ri. Në mbështetje të raportit ndërmjet këtyre tre faktorëve individi e ndryshon qëndrimin, përkatësisht e asimilon atë ose mbetet në qëndrimin e pandryshuar të tij.

TEORIA E DISIPLINËS FORMALE. Të ushtruarit e dijeve, shkathësive e shprehive në një fushëveprim shpie në zhvillimin e fuqive mendore, pavarësisht nga lënda që përdoret për të ushtruar atë strukturë psikike dhe funksionin e saj. Të mësuarit e

latinishtes, të logjikës, të matematikës, të të luajturit shah etj. vetvetiu shpie në zhvillimin progresiv të strukturave mendore dhe funksioneve të tyre dhe efekti i zhvillimit të tillë tejbartet ose transferohet në fushat e tjera mendore (nga matematika në astronomi, nga të luajturit shah në gramatikë, nga latinishtja në të mësuarit e gjuhës angleze etj).

TEORIA E DISONANCËS KOGNITIVE. Ndryshimi i qëndrimeve në bazë të angazhimit motivues të njeriut për të ndryshuar qëndrimin, në mënyrë që njeriu të mos arrijë në gjendje konflikti, kur qëndrimi i caktuar nuk shoqërohet me sjellje adekuate. Në rastet e këtilla njeriu nuk e ndien veten mirë kur nuk ekziston harmoni ndërmjet qëndrimeve ose ndërmjet qëndrimit për të njëjtën situatë dhe sjelljes ndaj saj. Në situata të këtilla nejriu ka nevojë të zvogëlojë ose të eleminojë ndryshimin ndërmjet qëndrimeve, përkatësisht ndërmjet qëndrimit dhe sjelljes ndaj të njëjtit objekt. Nëse kjo nuk arrihet, atëherë përjetohet gjendja e pakënaqshme e disonancës kognitive dhe njeriu orvatet t`i largohet kësaj gjendjeje, duke ndryshuar qëndrimin e tij, ose duke baraspeshuar qëndrimin me sjelljen e vet. Kjo është konceptuar nga psikologu social Leon Festinger, 1919 – 1989).

TEORIA E ELEMENTEVE IDENTIKE. Teori e veçantë e transferimit të të mësuarit. Kjo teori e shpjegon tejbartjen apo transferimin e të mësuarit në bazë të ngjashmërisë që kanë elementet e mësuara më parë me elementet që mësohen tani. Ndërmjet dy përmbajtjeve mësimore që mësohen, sa më të ngjashëm të jenë elementet e tyre, aq më i madh është efekti i të mësuarit, përkatësisht, aq më shumë të mësuarit e mëhershëm e lehtëson të kuptuarit dhe të mësuarit e përmbajtjes së mëvonshme. Konceptues i kësaj teorie është psikologu britanik Eduard Torndajk (Edward Thorndike, 1874 – 1949).

TEORIA E EMOCIONEVE, MAKLEN. Teori që shpjegon emocionet dhe burimin anatomik e fiziologjik të emocioneve në bazë të rolit të hipotalamusit, të hipokampusit dhe të amigdalës. Shih – ***SISTEMI LIMBIK.*** Rolin e këtyre pjesëve të sistemit limbik e ka theksuar mjeku amerikan Pol D. Maklin (Paul D. Maclean, 1913). Me këtë teori i është afruar shumë pikëpamjeve teorike të anatomologut dhe fiziologut amerikan Xhejms U. Papez (James W. Papez, 1883 – 1958). Në literaturën shkollore të psikologjisë shpesh bëhet fjalë për teorinë unike Maklen – Papez. Shih – ***TEORITË E EMOCIONEVE.***

TEORIA E FAKTORËVE GRUPORË. Teori që shpjegon strukturën e inteligjencës në bazë të identifikimit të dymbëdhjetë faktorëve, përkatësisht të shtatë faktorëve, që u konsideruan se janë faktorë psikikë parësorë të pavarur. Këta faktorë janë:

a. **Faktori hapësinor** (spacial) – ose faktori **S** (nga anglishtja *spacio* "hapësirë"). Ky faktor shfaqet në aftësinë e njeriut për të përfytyruar lehtë dhe shpejt forma të ndryshme të hapësirës dhe raporte të posaçme ndërmjet tyre;
b. **Faktori verbal** – ose faktori **V** që është aftësi e posaçme e të gjendurit të lehtë të njeriut në botën e simboleve verbale;

c. **Faktori numerik** - ose faktori **N** që është aftësi e operimit të lehtë me numra dhe me veprime të shpejta dhe precize të operacioneve matematikore;

d. **Faktori i të folurit rrjedhshëm** – ose faktori **W** që është aftësia e njeriut për të kuptuar, shfrytëzuar dhe krijuar lehtë e shpejt përmbajtjen e fjalëve dhe shprehjen e plotë të përmbajtjes së tyre;

e. **Faktori perceptiv** – ose faktori **P** që është aftësia e posaçme e identifikimit të shpejtë dhe të lehtë të formave të ndryshme të objekteve dhe e dallimit të shpejtë e të lehtë të ndryshimeve të vogla ndërmjet tyre;

f. **Faktori i kujtesës** – ose faktori **M** i memories që është aftësia e mbajtjes mend shpejt e lehtë të një materiali që mësohet dhe që është pak i kuptueshëm;

g. **Faktori i rezonimit** – ose faktori **R** që është aftësia e zgjidhjes së lehtë e të shpejtë të situatave problemore, e konkludimit të drejtë mbi raportet e ndërlikuara ndërmjet gjykimeve dhe e nxjerrjes së drejtë të një gjykimi të përgjithshëm nga kuptimi i raporteve ndërmjet gjykimeve të veçanta.

TEORIA E FRUSTRIMIT. Lidhje koherente e konceptit të frustrimit dhe konceptit të agresivitetit. Sipas trajtimit të frustrimit në kuadrin e kësaj lidhjeje çdo pengesë e aktivitetit të drejtuar në arritjen e një qëllimi të caktuar shkakton agresivitet, si edhe agresiviteti është pasojë e frustrimit. Çdo lloj pengese e realizimit të dëshirave, të motiveve të njeriut shpie në agresivitet formash e intensitetesh të ndryshme. Konsiderohet se përgjithësimi i tillë i një raporti konceptesh koherente është i tepruar, sepse frustrimi vërtetë çon në agresivitet të pakontrolluar, por kjo dukuri u përket disa individëve, te disa të tjerë frustrimi ka karakter konstruktiv, ngaqë ata i rikonstruktojnë sjelljet e veta, gjejnë mjete dhe rrugë të tjera për të arritur deri në qëllimin e synuar, shtojnë energjinë në zotërimin e atij qëllimi etj., por ka edhe individë, të cilët frustrimi i bën apatikë, inertë, të turpshëm, u zhvillon ndjenjën e inferioritetit etj.

TEORIA E FUSHAVE. Shpjegim i psikologut amerikan me origjinë gjermane Kurt Levinit (Kurt Lewin, 1890 – 1947) për lidhjen dhe varësinë e sjelljeve të njeriut jo vetëm ndaj një ngacmuesi, por ndaj tërësisë së tyre që gjendjen në fushën topologjike të aktivitetit të njeriut. Ky shpjegim është në përputhje me atë që njeriu duhet konsideruar individ i pandashëm nga fusha e jetës dhe e aktivitetit dhe sjelljeve të tij, duke i shpjeguar në bazë të ndërlidhjes mjedis ose fushë-njeri.

TEORIA E INTELIGJENCËS MULTIFAKTORIALE. Pikëpamje teorike për strukturën e inteligjencës së njeriut. Sipas teorisë multifaktoriale ose teorisë shumëfaktoriale të inteligjencës kjo përbëhet nga disa faktorë të pavarur. Pra, inteligjenca nuk është aftësi unike e njeriut, por tërësi faktorësh ose aftësish të pavarura. Një pikëpamje të tillë përfaqëson teoria e aftësive parësore e Luis L. Therston (Luis L. Thurstone, 1887 – 1955) dhe teoria ose modeli morfologjik i intelektit i Xhoi P. Gilford ((Joy P. Guilford, 1897 – 1987). Shih – ***MODELET E STRUKTURËS SË INTELIGJENCËS.***

TEORIA E MALTUSIT. Teori e ekonomistit anglez Tomas R. Maltus (Thomas R. Malthus, 1744 – 1836).

Sipas kësaj teorie popullimi i një lloji të caktuar organizmash rritet ose shtohet në progresion gjeometrik, kurse sasia e ushqimit të këtij lloji organizmash shtohet në progresion aritmetik (3 : 1, 6 : 2, 9 : 3 etj.). Për këtë shkak duhen kufizuar lindjet e pjesëtarëve të llojeve të ndryshme të organizmave. Kjo arrihet duke kontrolluar shumimin e llojeve me anë të luftës, të epidemive ngjitëse, të urisë vdekjeprurëse etj. Kjo teori ka ushtruar ndikim në konceptimin e teorisë së përzgjedhjes natyrore të Çarls Darvinit (Charles Darwin, 1809 – 1882).

TEORIA E PERCEPTIMIT FILTËR. Model i vëmendjes dhe i rolit të saj në procesin e perceptimit të objekteve, të dukurive, të ngjarjeve, të proceseve etj. Sipas teorisë së filtrit perceptimi është i mundshëm ngaqë vëmendja e njeriut luan rolin e filtrit, duke lejuar të fokusohen vetëm në ngacmues ose në elementet e caktuara, kurse ngacmuesit e tjerë i refuzon nga marrja e tyre dhe shndërrimi në impulse nervore. Kjo ngjet, sepse kapaciteti i marrjes dhe ai i përpunimit të informacioneve nga ana e vëmendjes së njeriut është i kufizuar dhe nuk arrin t`i përpunojë të gjitha informacionet e ngacmuesve që e bombardojnë vazhdimisht sistemin e shqisave të njeriut. Për këtë shkak supozohet se truri i njeriut ka krijuar një mekanizëm të ngjashëm me filtrin e zakonshëm, i cili i lëshon vetëm ata ngacmues të shqisave dhe impulse nervore që për njeriun kanë rëndësi biologjike të veçantë, që janë ngacmues të rinj, që kanë intensitet të lartë, shtrirje karakteristike, vlerë psikologjike etj. Teoria e perceptimit filtër është e lidhur me emrin e psikologut D. Broadbent. Por, kjo teori ka kufizimet e saj dhe nuk është në gjendja ta shpjegojë ndërlikueshmërinë e procesit të perceptimit të realitetit dhe të fomave të ndryshme të tij.

TEORIA E PERSONALITETIT AJZENK. Teori e mbështetur në rezultatet e analizës faktoriale të personalitetit, e njohur edhe me termin teoria dimensionale e Ajzenkut për personalitetin. Sipas kësaj teorie faktorët përbërës të personalitetit janë me tri përmasa ose dimensione të përgjithësuara dhe të zhvilluara sipas zhvillimit hierarkik të tyre. Këto dimensione janë: ekstraversion – introversion, neurotizëm dhe psikotizëm me këto nivele përgjithësimi: 1) Intraversioni (niveli më i lartë), 2) Faktorët e nivelit të dytë të tipave: a) faktorët e nivelit të parë të tipareve: qëndrueshmëria, rigjiditeti, subjektivizmi, turpi dhe ngacmueshmëria; b) niveli i përgjigjeve të zakonshme dhe c) niveli i përgjigjeve specifike. Kjo teori ka ardhur deri në këtë përfundim duke zbatuar metodën e analizës faktoriale të sjelljeve fjalësore a verbale, lëvizore apo motorike dhe proceset fiziologjike të njeriut me anë të pyetësorit. Kjo është teoria e psikologut të lindur në Gjermani Hans J. Ajzenk (Hans J. Eysenck (1916 – 1997), i cli ka zhvilluar gjurmimet e veta në Britaninë e Madhe. Ka kontribuar sidomos në gjurmimin e neurozës së frikës dhe në kushtëzimin traumatik të fobive. Ka vënë themelet e terapisë bihejviorale.

TEORIA E PERSONALITETIT SIPAS HORNEI. Teori e personalitetit e konceptuar nga neofrojdistja amerikane me origjinë gjermane Karen

Hornei (Karen Horney, 1885 – 1952). Kjo teori mbështetet në konceptet e lëvizjes së njeriut kah të tjerëve, kundër të tjerëve dhe me të tjerët. Duke kundërshtuar teorinë e Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) K. Hornei ka pikëpamje, sipas së cilës faktorët shoqërorë e kulturorë kanë rëndësi parësore në zhvillimin dhe formimin e personalitetit. Në këtë kuadër ankthi themelor (jo libidoja) dhe nevojat neurotike krijojnë synimin për zhvillim të përhershëm dhe këto struktura janë struktura kryesore të lëvizjes dhe të aktivitetit të njeriut. Sipas saj njeriu ka dhjetë grupe nevojash, të cilat ajo i ka quajtur nevoja themelore. Këto janë: 1) Nevoja e simpatisë dhe e vetëmohimit, 2) Nevoja për partner – mbështetje në kujdesin e tjetrit, 3) Nevoja e modestisë, 4) Nevoja e fuqisë – e sundimit mbi të tjerët, 5) Nevoja e shfrytëzimit të të tjerëve, 6) Nevoja e famës për njohje shoqërore dhe për prestigj, 7) Nevoja e admirimit, 8) Nevoja e arritjes personale sa më të lartë, 9) Nevoja e vetëmjaftueshmërisë dhe 10) Nevoja për përsosmëri dhe pagabueshmëri.

TEORIA E PERSONALITETIT MASLOU. Teori humaniste e Abraham Maslout e përpunuar në psikologjinë e personalitetit të shëndoshë **.** Shih – ***HIERARKIA E MOTIVEVE.***

TEORIA E PERSONALITETIT MURAJ. Teoria e personalitetit sipas rezultateve hulumtuese të psikologut amerikan Henri A. Muraj (Henry A. Murray, 1893 – 1988). Teoria e tij njihet edhe me emërtimin "Personologjia sipas Muraj". Kjo teori e shpjegon personalitetin në bazë të njohjes së dinamikës së njeriut, të cilën e përbëjnë 28 motive organogjenetike dhe psikogjenetike. Sipas kësaj teorie personaliteti, struktura, funksioni dhe dinamika e tij është e pamundur të shpjegohet pa u mbështetur në tërësinë e personalitetit. Henri A. Muraj mbështetet pjesërisht në strukturën e personalitetit të Zigmund Frojdit (*idi, egoja, super egoja*) dhe rëndësinë e përjetimeve të jetës fëmijërore. Por theksimi i një motivi të përgjithshëm siç është libidoja, është i pamjaftueshëm për të kuptuar dhe shpjeguar tërësinë e personalitetit. Për njohjen dhe shpjegimin e tërësisë së personalitetit ky psikolog ka zbatuar testin e tematikës aperceptive.

TEORIA E PËRGJITHËSIMIT. Teori e transferimit gjatë të mësuarit. Sipas kësaj teorie ajo që tejbartet nga një fushë mendore në tjetrën, nga një disiplinë shkencore në disiplinën tjetër është dija e përgjithësuar, e gjeneralizuar, por jo vetëm të dhënat, faktet e veçanta. U konceptua nga ana e psikologut amerikan K. Xhad (K. Jadd). Sipas tij për të pasur përfitime nga të mësuarit, përkatësisht për të qenë tejbartja ose transferimi i të mësuarit me efekte sa më të mëdha nuk mjafton vetëm të ushtruarit e mendimit, por përgjithësimi i dijeve, duke e nxjerrë këtë nga raportet themelore dhe duke zbatuar këtë përgjithësim në zgjidhjen e çështjeve apo problemeve të veçanta**.**

TEORIA E RAJMOND KATELIT. Teori që e mbështetet në zbërthimin e strukturës së inteligjencës në dy faktorë të përgjithshëm. Këta faktorë janë:

a. Inteligjenca e kristalizuar – inteligjenca e tipit B. Lloj i aftësisë së përgjithshme, që zhvillohet nga ndikimi

reciprok i trashëgimit dhe i mjedisit të jashtëm duke shfrytëzuar edhe energjinë e inteligjencës fluide. Inteligjenca e kristalizuar shfaqet në kryerjen e shpejtë e të lehtë të detyrave dhe të problemeve, ku kërkohet dijeni, informim i përgjithshëm dhe zhvillim i shkathtësive të proceseve kognitive;

b. **Inteligjenca fluide – inteligjenca e tipit A**. Lloj i aftësisë së përgjithshme, e mbështetur në dispozita të trashëguara. Inteligjenca fluide vjen në shprehje në zgjidhjen e suksesshme të atyre situatave problemore të ndërlikuara, ku kërkohet aftësi e kuptimit të saktë të lidhjeve dhe raporteve thelbësore ndërmjet simboleve, të dhënave e fakteve të asaj situate problemore, gjetjen e lidhjeve të reja ndërmjet të dhënave e fakteve etj.

Teoria e faktorit të kristalizuar ose e faktorit B dhe e faktorit fluid ose e faktorit A është teoria e psikologut amerikan i lindur në Angli Rajmond B. Katelit (Raymond B. Cattell, 1905 – 1998).

TEORIA E TË MËSUARIT PERCEPTIV SIPAS HEB. Teori e psikologut amerikan Donald O. Heb (Donald O. Hebb, 1904 – 1985), sipas së cilës, të mësuarit e përmbajtjeve të ndryshme deri në nivelin e përvetësimit të plotë të atyre përmbajtjeve është e lidhur dhe e varur nga veprimtaria e tërësisë së qelizave nervore të trurit të mesëm – bazë organike e fiziologjike e formimit të koncepteve. Por, edhe tërësia e këtyre qelizave nervore të trurit të mesëm varet nga procesi i të mësuarit. Këtë ai e ka argumentuar me të verbrit, të cilëve pas shumë kohësh u është kthyer të parit. Te këta të verbër, vetëm pas shumë kohësh të të parit të rregullt, janë arritur të zhvillohen qelizat e trurit të mesëm dhe të zhvillohet aftësia e perceptimit të objekteve, të dukurive të mjedisit të tyre dhe mbi këtë bazë perceptive ata kanë arritur të mësojnë.

TEORIA E ZHVILLIMIT KOGNITIV, PIAZHE. Njëra nga teoritë e njohura të zhvillimit të proceseve njohëse të njeriut. Kjo teori u konceptua nga psikologu zviceran Zhan Piazhe (Jean Piaget, 1896 – 1980), sipas së cilës i tërë procesi i zhvillimit të njeriut mund të kuptohet duke njohur zhvillimin intelektual. Zhvillimi i përgjithshëm është zhvillim spontan i përcaktuar nga faktorët e brendshëm dhe nga mekanizmat vetërregullues të organizmit të njeriut. Këta janë faktorë biologjikë të lindur dhe procesi i zhvillimit të tyre ka të bëjë me organizimin e dijes, që ndikon në zhvillimin e strukturave biologjike të fëmijëve. Faktorët e jashtëm të zhvillimit të fëmijëve nuk krijojnë struktura të reja njohëse, por ushtrojnë ndikim në tempin a ritmin e zhvillimit të tyre. Fëmija gjendet vazhdimisht në procesin e brendshëm aktiv ndaj mjedisit e faktorëve të tij. Në këtë proces zhvillohet përshtatja e organizmit të fëmijës duke asimiluar e modifikuar në botën e brendshme të tij objektet dhe dukuritë mjedisore dhe, njëkohësisht, duke modifikuar strukturat njohëse dhe funksionet e këtyre ndryshimeve mjedisore. Në këtë proces të gjatë mjedisor dallohen katër faza zhvillimore të inteligjencës: 1) Faza sensomotorike; 2) Faza paraoperacionale 3) Faza e operacioneve konkrete dhe 4) Faza e formimit të operacioneve mendore

formale. Procesi i tillë i zhvillimit zgjat prej moshës 1 vjeç deri në moshën 15 – 16 vjet.

TEORIA FAKTORIALE. Sistem koherent konceptesh e gjykimesh i mbështetur në përshkrimin e dukurive, të proceseve, të sjelljeve, të strukturave psikike etj., duke u referuar në faktorët përbërës të tyre. Termi teori faktoriale ka buruar nga hulumtimi i përbërësve psikologjikë të inteligjencës dhe të përbërësve psikologjikë të personalitetit. Shih – ***TEORITË E INTELIGJENCËS; TEORITË E PERSONALITETIT***. Saktësia e teorive të tilla nuk konsiderohet se ka karakter absolut dhe të përhershëm, por mbetet e tillë derisa të mos vërtetohet e kundërta e tyre.

TEORIA FAKTORIALE E TË MËSUARIT. Shpjegim i procesit të të mësuarit nga faktorët përbërës të tij, përkatësisht nga format e të mësuarit të një përmbajtjeje të caktuar. Kështu, të mësuarit e një operacioni manual mund të zhvillohet në bazë të metodës ose të faktorit të të mësuarit operant dhe në bazë të të mësuarit me zbërthim kuptimor të lëvizjeve, të rëndësisë, të kuptimit dhe të lidhjeve ndërmjet tyre. Faktori i parë, përkatësisht faktori i të mësuarit operant i përket grupit të faktorëve të nivelit të ulët, kurse ai i dyti, përkatësisht të mësuarit me rend dhe me kuptim i përket grupit të faktorëve të nivelit të lartë të të mësuarit.

TEORIA FUNKSIONALE E QËNDRIMEVE. Teori, e cila formimin, zhvillimin dhe mbajtjen e qëndrimeve e shpjegon në bazë të funksionit që kryejnë qëndrimet në veprimtarinë e individit, duke plotësuar nevojat dhe motivet e ndryshme të njeriut. Katër janë funksionet e qëndrimeve: 1) Arritja e qëllimeve të caktuara; 2) Funksioni i mekanizmave mbrojtës; 3) Funksioni i shprehjes së vlerave dhe synimeve dhe 4) Funksioni kognitiv i qëndrimeve. Shih – ***QËNDRIMET.***

TEORIA KOGNITIVE E EMOCIONEVE. Teori që i shpjegon emocionet në bazë të njohjes së ndryshimeve trupore dhe interpretimit të tyre nga ana e proceseve njohëse ose kognitive. Sipas kësaj teorie cilësia e emocioneve, llojet e ndryshme të tyre, si edhe kohëzgjatja dhe intensiteti i emocioneve përcaktohet nga ana e vet njeriut, i cili i përjeton këto ndryshime. Ajo që përcakton kualitetin, kohëzgjatjen dhe intensitetin e emocioneve është shpjegim i asaj që njeriu e përjeton hidhërimin kur gjendet në një situatë konflikti, në një mjedis shoqëror të hareshëm, mes një grupi shokësh të frustruar etj. Ndryshimet fiziologjike janë të njëjta, por cilësia e përjetimit emocional ndryshon. Psikologu amerikan Stenli Shahter (Stanly Schachter, 1922 – 1997) u ka dhënë subjekteve injeksion adrenaline me sasi të njëjtë për të gjithë, kur këta janë gjendur në situata sociale të ndryshme. Këta subjekte kanë shfaqur ndryshime fiziologjike të njëjta (shtimi i ritmit të rrahjes së zemrës, përshpejtimi i lëvizjes së gjakut, ndryshimi i ngarkesës elektrike të lëkurës etj.), por kanë raportuar përjetim kualitetesh të ndryshme emocionale. Prandaj Steli Shahter ka përfunduar se bazën e përjetimit të kualitetit emocional nuk e përcaktojnë ndryshimet fiziologjike, siç ka menduar Uiliam Xhejmsi (William James, 1842 – 1910), por këtë e përcakton interpretimi

i këtyre ndryshimeve në varësi nga situata sociale ku gjendet individi.

TEORIA MORFOLOGJIKE E INTELIGJENCËS. Teoria morfologjike e inteligjencës e shpjegon strukturën e inteligjencës në bazë të kryqëzimit të tri përmasave esenciale të aftësive në bazë të të cilave aftësitë dallohen ndërmjet tyre. Këto tri përmasave janë: 1) Përmbajtja, 2) Operacionet dhe 3) Produktet. Me kryqëzimin e pesë llojeve të operacioneve, gjashtë lloj produkteve dhe katër lloj përmbajtjeve përftohen 120 aftësi relativisht të pavarura njëra nga tjetra. Këtë e dallojmë nga figura e mëposhtme:



Ky është model i shpjegimit të strukturës së inteligjencës i lidhur me emrin e psikologut amerikan Xhoj P. Guilford (Joy P. Guilford, 1897 – 1987).

TEORIA ORGANIZMIKE E PERSONALITETIT. Sistem konceptesh e gjykimesh të lidhura në një tërësi kuptimore, sipas së cilës organizmi është një tërësi psikofizike, sistem bashkues i organeve dhe i funksioneve të tyre të përbashkëta biologjike, motivuese, kognitive dhe emocionale. Si përfaqësues të kësaj pikëpamjeje dallohen Kurt Goldshtajn (Kurt Goltstein, 1878 – 1965) dhe Xhejms R. Ejnxhel (James R. Angell, 1869 – 1949).

TEORIA RREZATUESE E TË MËSUARIT. Teori që shpjegon procesin e të mësuarit në bazë të fuqizimit të reagimeve të dobishme për njeriun, të përzgjedhura nga shumë teori dhe që përforcohen me anë të përkrahjeve e të shpërblimeve. Reagimet e tjera shuhen, sepse nuk përkrahen, pra nuk përforcohen me shpërblime, dhurata etj. Përforcimi i këtillë i reagimeve të dobishme dhe i lidhjeve ndërmjet tyre përbën esencën e të mësuarit sipas teorisë rrezatuese të të mësuarit.

TEORIA SAPIR – VORF. Teori e paargumentuar për rolin e gjuhës në zhvillimin përmbajtjesor të proceseve psikike, sidomos të atyre kognitive. Supozohet ndikimi që ushtron gjuha e një kombi (sidomos leksiku dhe sintaksa e gjuhës) në perceptimin, në mendimin e njeriut për dukuri, trupa, situata, në kuptimin e shkakësisë së botës reale. Sipas inxhinierit dhe kimistit amerikan Benjamin L. Vorf (Benjamin L. Worf, 1897 – 1941) gramatika e një gjuhe është "mjet i formësimit të ideve, program dhe udhëheqës i veprimtarisë mendore të njeriut, të analizës dhe sintezës së përshtypjeve që ka ai në pronën mendore të vet". Më pas, nxënësi i tij linguisti amerikan Eduard Sapiri (Edward Sapir, 1884 – 1939) ka pohuar: "Është fakt që bota reale në masë të madhe është ndërtuar në mënyrë të pavetëdijshme në zakonet e gjuhës të një grupi të caktuar. . . zakonet gjuhësore të shoqërisë sonë kanë krijuar paradispozita në përzgjedhjen e disa shpjegimeve". Sipas kësaj teorie të paargumentuar eskimezët e emërtojnë borën me nuanca

të dallueshme të ngjyrës së bardhë me disa fjalë, kurse shqipja për ngjyrën e borës ka vetëm një fjalë. Kuptimi i kohës (koha e shkuar, e tashme, e ardhmja) te Indianët e fisit Hopi është e relativizuar shumë, kurse në shqipe nuk ekziston ky rast. Nuk mund të jetë e besueshme se pjesëtarët e kulturave të ndryshme që flasin gjuhët e tyre kanë koncepcione të posaçme për realitetin dhe dukuritë e botës reale.

TEORIA SHUMËSHTRESORE E INTELIGJENCËS. Teoria e psikologut amerikan Houard Gardner (Howard Gardner, 1943). Houard Gardneri ka dalluar shtatë lloje të inteligjencës:

a. **Inteligjenca gjuhësore**;
b. **Inteligjenca logjike – matematike;**
c. **Inteligjenca trupore - kinestetike**, që vjen në shprehje sidomos te atletët, pantomimikët dhe valltare(ë)t;
d. **Inteligjenca muzikore;**
e. **Inteligjenca hapësinore**;
f. **Inteligjenca vetjake**, që ka të bëjë me njohjen e ndijimeve individuale;
g. **Inteligjenca ndërnjerëzore**, që i përket njohjes dhe përjetimit të ndjeshmërisë së të tjerëve.

H. Garden më pas e shtoi numrin e tyre duke nxjerrë në pah edhe tri lloj inteligjencash. të tilla si: inteligjenca natyrore, inteligjenca shpirtërore (spirituale) dhe inteligjenca ekzistenciale. Sipas H. Gardnerit secila nga këto inteligjenca dallohet nga njëra-tjetra për nga funksioni i tyre dhe secila ka bazën e vet neurofiziologjike.

TEORIA TRIARKIKE E INTELIGJENCËS. Teori e psikologut Robert Shternberg. Sipas R. Shternbergut inteligjenca ka këtë përbërje:

a. **Inteligjenca analitike** – Aftësia e njeriut për të përshtatur sjelljet individuale ndaj kushteve dhe raporteve të jashtme;
b. **Inteligjenca krijuese** – Aftësia e njeriut për t`u ballafaquar me situata të reja dhe për t`i përpunuar automatikisht informacionet e këtyre situatave;
c. **Inteligjenca praktike** – Aftësia e fitimit të dijeve, e vetëdijes së njeriut për proceset intelektuale të tij dhe e shkathtësive të tij për shfrytëzimin e informacioneve gjatë përpunimit të tyre dhe në procesin e zgjidhjes së situatave problemore. R. Stenberg ka dalluar këto nivele të inteligjencës: a) niveli kontenkstual, b) niveli i eksperiencës dhe c) niveli komponental, që përbëhet nga fitimi i dijenive metakomponenta dhe komponenta procesore.

TEORITË E DËGJIMIT. Ekzistojnë disa teori të dëgjimit, të cilat u hartuan nga disa studiues që u përpoqën të shpjegojnë procesin e dëgjimit:

a. **Teoria e rezonancës,** që është teoria më e vjetër e lidhur me emrin e studiuesit të njohur gjerman, fizikanin Herman Helmholc (Hermann Helmholtz, 1821 - 1894). Sipas kësaj teorie ndijimi i lartësisë së tonit përcaktohet nga vendi i vibrimit (vibracionit) më të madh të membranës bazilare dhe të fijeve të saj. Pjesa e membranës bazilare e vendosur afër dritares ovale është e gatshme të reagojë në tonet e frekuencave më të larta, kurse afërsia e membranës bazilare që gjendet në skajin tjetër të membranës bazilare të organit kohlear është e gatshme të reagojë ndaj toneve me frekuencë të ulët.
b. **Teoria e periodicitetit,** që thekson rolin vendimtar të reagimit sinkronik të të gjitha neuroneve të lidhura

me fijet e membranës bazilare, gjatë dëgjimit të toneve dhe zhurmave me lartësi të ndryshme.

c. **Teoria e frekuencave** e Raderford, sipas së cilës, gjatë procesit të dëgjimit reagon e tërë membrana bazilare me fijezat e saj. Kjo teori mbështetet shumë në karakterin e reagimit të diafragmës së aparatit telefonik.

ç. **Teoria hidraulike,** që është e lidhur me emrin e fizikanit Majer, e cila thekson rolin e sipërfaqes së membranës bazilare dhe të fijezave të saj në procesin e dëgjimit të toneve dhe të zhurmave.

d. **Teoria e modeleve të toneve sipas Evald.** Në këtë teori modelet e ndryshme të vibrimeve që i mbarten membranës bazilare janë stimulues të toneve të lartësive të ndryshme. Asnjëra nga këto teori nuk është në gjendje të shpjegojë procesin e dëgjimit në tërësi. Nga këto pesë teori përmenden më tepër në literaturë teoria e Helmholcit, por edhe teoria e periodicitetit.

TEORITË E EMOCIONEVE. Sistem koherent konceptesh e gjykimesh, si edhe ndërlidhjesh të tyre, që shpjegojnë thelbin kuptimor të emocioneve. Në literaturën e psikologjisë dallojmë disa teori të emocioneve:

a. **Teoria klasike e emocioneve** – Teoria më e vjetër për shpjegimin e emocioneve, sipas së cilës emocionet janë produkt i ballafaqimit të njeriut me një situatë të papritur. Këtë situatë ai e vlerëson; më pas përjetohet cilësia e emocioneve dhe manifestohen ndryshimet fiziologjike të brendshme dhe të jashtme të organizmit të njeriut. Sipas teorisë më të vjetër emocionet zhvillohen sipas këtij cikli: informacioni i papritur, lindja e emocioneve dhe shfaqja e tyre. Kjo teori është mbështetur në trajtimin teorik të emocioneve, por jo edhe në rezultatet e hulumtimeve organike, fiziologjike dhe neurofiziologjike. Megjithëkëtë ka nxitur gjurmime të thella psikoneurofiziologjike. Kjo teori quhet edhe teoria intelektualiste e emocioneve. Kohët e fundit, një pjese të kësaj teorie i është shtuar edhe mendimi për rolin e proceseve kognitive në vlerësimin e situatave, të informacioneve, të objekteve etj., kur njeriu përjeton një emocion, i cili nuk mund të shpjegohet vetëm me argumente neurofiziologjike.

b. **Teoria e Xhejms–Lang** – Teoria e emocioneve e psikologut amerikan Uiljam Xhejms (William James, 1842 – 1910) dhe e fiziologut e psikologut danez Karl Lang (Carl G. Lange, 1834 – 1900), që arritën pothuajse në të njëjtën pikë të shpjegimit të thelbit të emocioneve. Sipas kësaj teorie thelbi i përjetimeve emocionale dhe i manifestimit të tyre ka të bëjë me përjetimin e ndryshimeve fiziologjike nga ana e njeriut, kur ky gjendet para një situate të rrezikshme, kur merr një lajm të papritur, kur befasohet nga suksesi i arritur etj. Në këto raste, situatat e jashtme shkaktojnë së pari ndryshime fiziologjike (frymëmarrje të shpejtuar, ritëm të rrahjes së zemrës dhe të pulsit të shpejtuar, ndryshime në potencialin elektrodermal etj.) dhe kur njeriu i percepton këto ndryshime trupore, atëherë përjetohet një emocion i caktuar. Në literaturën e psikologjisë shpesh pohohet: njeriu nuk qan pse është i pikëlluar, por është i pikëlluar sepse qan. Kësaj teorie i janë bërë disa kritika, ndër të cilat edhe paaftësia e

saj për të shpjeguar se si mund të ketë përjetim emocional pa aktivizim të organeve të brendshme të njeriut.

c. **Teoria e Kenon–Bard** – Teori e fiziologut amerikan Valter B. Kenon (Walter B. Cannon, 1871 – 1945) dhe e psikologut amerikan Filip Bard (Philip Bard, 1898 – 1977). Kjo teori shpjegon lindjen dhe kontrollin e shprehjes integrale të emocioneve me anë të impulseve të receptorëve që dërgohen në koren a cipën e trurit të madh, por këto impulse paraprakisht kalojnë nëpër talamus, kurse hipotalamusi në të njëjtën kohë aktivizon disa nga organet e brendshme, duke ju dërguar impulse nervore këtyre organeve. Me theksimin e rolit të ngacmimeve të organeve të brendshme kjo teori e ka plotësuar mungesën e teorisë së Xhejms – Langut.

d. **Teoria e Papez** – Teori e neuroanatomit amerikan Xhejms Papez (Jamez Papez, 1883 –1958), i cili, në hulumtimin e bazës neurofiziologjike të emocioneve ka konstatuar se në lidhjen, përjetimin dhe shfaqjen e emocioneve rol të rëndësishëm luajnë jo vetëm korja apo cipa e trurit, talamusi e hipotalamusi, por edhe pjesët e sistemit limbik, sidomos bërthama amigdaloide dhe hipokampusi. Në bërthamën amigdaloide dhe në hipokampus arrijnë dhe "regjistrohen" impulse nervore të kores, të talamusit e të hipotalamusit. Kështu, këto pjesë të sistemit limbik kontrollojnë ngacmimet e organeve të brendshme me rastin e ballafaqimit të njeriut me një situatë, p.sh., të rrezikshme, gjatë së cilës ngacmimet nervore mbarten nga receptorët në koren e trurit, në talamus e hipotalamus, por edhe në pjesët e sistemit limbik. Me reagimin e sistemit sensor, talamik e hipotalamik dhe limbik dhe me dërgimin e impulsive nervore të këtyre sistemeve në koren apo cipën e trurit të madh, njeriu bëhet i vetëdijshëm për ndryshimet e organeve të brendshme dhe për lindjen dhe shfaqjen e cilësisë së një emocioni të caktuar. Kësaj teorie i janë bashkangjitur edhe rezultatet hulumtuese të Maklinit. Sipas këtyre rezultateve në lindjen, përjetimin dhe shfaqjen e emocioneve dhe të cilësive të ndryshme të tyre, përpos sistemeve të përmendura neurofiziologjike (sistemit sensor talamik e hipotalamik dhe limbik) marrin pjesë edhe shtresat arkaike të trurit. Roli i tyre qëndron në integritetin e impulseve nervore të sistemeve të përmendura.

e. **Teoria kognitive** – Teori e mbështetur në rolin e procesit të perceptimit, të kujtesës së përvojës emocionale dhe të rolit të mendimit në vlerësimin e një situate pozitive apo negative, të mirë a të keqe, fitimprurëse apo dëmtuese etj. Sipas kësaj teorie emocionet nuk janë produkt vetëm i ndryshimeve neurofiziologjike, por edhe i proceseve kognitive. Duke vështruar ndryshimet neurofiziologjike të organeve të brendshme e periferike dallohen fakte, sipas të cilave të njëjtat ndryshime neurofiziologjike shfaqen te cilësitë e ndryshme të përjetimeve emocionale, madje edhe në rastin e përjetimit të cilësive emocionale të kundërta. Për këtë shkak shpjegimi i emocioneve duhet të mbështetet në pjesëmarrjen e proceseve kognitive, në vlerësimin e situatave objektive, në raport me njeriun dhe me sjelljet e tij ndaj situatave të tilla. Vlen të theksohet se ende asnjëra nga teoritë e mësipërme nuk

ka qenë në gjendje të japë një shpjegim të tërësishëm të jetës së ndërlikuar emocionale (zhvillimin e emocioneve, shumëllojshmërinë e përjetimeve emocionale, bazën fiziologjike e sociale të emocioneve etj).

TEORITË E HARRESËS. Teori që shpjegojnë harresën dhe procesin e të harruarit, ndër të cilat përmendim:

a. **Teoria e harresës spontane –** Teori që e shpjegon harresën dhe procesin e të harruarit të përmbajtjeve të mësuara nga mospërsëritja e atyre përmbajtjeve. Mospërsëritja shkakton humbjen e gjurmëve psikonervore, që fillojnë të zbehen dhe më në fund këto zhduken plotësisht.

b. **Teoria e harresës aktive –** Teori që shpjegon se raporti ndërmjet dy përmbajtjeve të mësuara njëra pas tjetrës është shkak i harresës, sepse gjurmët psikonervore të njërës përmbajtje i "shlyejnë" gjurmët e përmbajtjes tjetër, shih – ***INHIBICIONI*;**

c. **Teoria e ndryshimit të kushteve të riprodhimit –** Teori që shpjegon se harresa shkaktohet nga ndryshimi i kushteve dhe i rrethanave të riprodhimit të tanishëm, nga kushtet dhe rrethanat e atëhershme, kur është mësuar e njëjta përmbajtje;

d. **Teoria psikanalitike –** Teori që e shpjegon harresën si rezultat të shtypjes ose të ndrydhjes së përmbajtjeve. Sipas kësaj teorie përmbajtjet nuk harrohen, por njeriu e humb aftësinë e qasjes së tyre nga ndikimi që ushtrojnë mekanizmat mbrojtës të tij në nxjerrjen e tyre prej pavetëdijes. Kjo ndodh për shkak të mospërputhjes së përmbajtjeve të reja me mendimin, qëndrimet, ndjenjat e zhvilluara më parë;

e. **Teoria geshtaltiste –** Teori që e shpjegon harresën si rezultat i pengimit të përmbajtjeve në strukturimin e tërësisë së harmonisë. Kjo teori është pasojë e shpjegimit të perceptimit dhe të të mësuarit si organizim i tërësive të harmonishme dhe, rrjedhimisht, harresa shkaktohet nga mosarritja e organizimit të tërësisë së përmbajtjeve të harmonishme;

f. **Teoria bashkëkohore –** Teori që e shpjegon harresën sipas tipave të kujtesës. Gjatë të mësuarit njeriu merr informacione, të cilat orvatet t`i vendosë në "magazinën" e shqisave, por koha e shkurtër e mbartjes së tyre në qendrat neurale është e shkurtër dhe gjatë kësaj kohe informacionet zhduken. Për këtë shkak përmbajtja harrohet. Në kujtesën afatshkurtër "magazina" e mbajtjes mend të informacioneve është e ngushtë dhe nga mospërsëritja ato humbin e zhduken. Në kujtesën afatgjatë ruhen dhe riprodhohen ato përmbajtje që janë organizuar mirë dhe kanë fuqi koherente të madhe. Ato që nuk kanë formë organizimi të tillë nuk arrijnë të përballen me përmbajtje të organizuara mirë dhe humbin e zhduken.

TEORITË E MOTIVACIONIT. Strukturë teorish për motivacionin, llojet, funksionimin dhe manifestimin e motivacionit të njeriut. Në teoritë e motivacionit hyjnë: teoria e Abraham Maslout (Abraham Maslow, 1908 – 1970), e Erik Fromit (Erich Fromm, 1900 – 1980), e Karen Hornait (Karen Horney, 1885 – 1952) etj.

TEORITË E PERCEPTIMIT. Shpjegimi i perceptimit dhe i procesit perceptues mbështetet në disa teori. Këto janë:

a. **Teoria e Helmholcit** – Sipas kësaj teorie perceptimi është rezultat i përvojës, i dijeve dhe rezultat i të mësuarit. Perceptuesi i jep domethënie e kuptim tërësisë ngacmuese të shqisave. Kjo është teoria empirike e fizikanit gjerman Herman fon Helmholc (Herman von Helmholz, 1821 – 1894), që u konceptua në gjysmën e dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë;

b. **Teoria geshtaltiste** – Teori që e shpjegon perceptimin si përjetim të tërësisë së posaçme e jo si shumë ndijimesh, duke mbështetur shpjegimin e perceptimit dhe të procesit perceptues si gatishmëri e dhënë me lindjen e njeriut. Kjo teori u ngrit mbi pikëpamjen nativiste. Teoria geshtaltiste është e lidhur me studiuesit gjermanë të psikologjisë Volfganag Këler (Wolfgang Kohler, 1887 – 1967), Maks Verthaimer (Max Wertheimer,1880 – 1943), Kurt Kofka (Kurt Koffka, 1886 – 1941). Teoria geshtaltiste u konceptua nga fillimi i shekullit të njëzet;

c. **Teoria e Gibsonit** – Teoria e perceptimit ekologjik, sipas së cilës perceptimi mbështetet në gatishmërinë e ndjeshmërisë trupore të njeriut për t`i marrë horizontalisht të gjitha informacionit e mjedisit të tij, ku njeriu ka lindur dhe është zhvilluar e formuar. Ndjeshmëria e trupave dhe e dukurive të mjedisit është e lindur dhe ngacmimet nuk kanë nevojë të përpunohen. Këtë teori e ka konceptuar psikologu amerikan Xhejm J. Gibson (James J. Gibson, 1904 – 1979) në gjysmën e parë të shekullit të njëzet;

d. **Teoria neurofiziologjike** – Teori që e shpjegon perceptimin në bazë të funksionimit të shqisave ndijimore dhe të pjesëve të Sistemit Nervor Qendror. Rezultatet e gjurmimit të Sistemit Nervor Qendror dhe të funksionimit të pjesëve të tij gjatë perceptimit kanë treguar se në procesin e perceptimit marrin pjesë një rrjet neuronesh si tërësi e veçantë. Shumë të dhëna e argumentojnë bazën neurofiziologjike të perceptimeve, por megjithëkëtë qasja reduksioniste nuk ka arritur të shpjegojë plotësisht procesin e ndërlikuar të perceptimit dhe as perceptimin si rezultat të këtij procesi.

TEORITË E PERSONALITETIT. Teori që shpjegojnë strukturën, integritetin dhe zhvillimin e personalitetit, si edhe formimin e tij. Këto teori përfaqësojnë një mendim laik për personalitetin, për motivet e sjelljes, mënyrën a stilin e veprimit, të mendimit dhe për funksionimin e strukturave të veçanta të personalitetit. Mendimi i këtillë nuk ka karakterin e një teorie shkencore, por shpesh njerëzit arrijnë në përfundim për të tjerët në mbështetje të "teorisë" për personalitetin e tyre. Pavarësisht se teoria implicite e personalitetit nuk ka vlerë shkencore u konsiderua se është mirë të përmendet edhe në leksikun e terminologjisë psikologjike, sepse bën të mundur të kuptuarit e sjelljeve. Termi teori implicite e personalitetit u përmend për herë të parë nga psikologët amerikanë Jerome S. Bruner (Jerome S. Bruner, 1915) dhe Li J. Kronbah (Lee J. Crombach, 1916 – 2001). Në bazë të rendit kohor të zhvillimit teorik të mendimit mbi personalitetin dallojmë këto teori për personalitetin:

a. **Teoria e tipave të personalitetit** – Teori që shpjegon dallimet ndërmjet personaliteteve në bazë të përshkrimit dhe shpjegimit më të hershëm të tipave të ndryshëm të temperamentit:

të tipit sanguin, kolerik, melankolik dhe flegmatik. Kjo është teoria klasike e lidhur me emrin e mjekut grek Hipokratit (Hippocrates, rreth 460 – 377 p. e. r.). Mbi këtë bazë u zhvilluan edhe disa teori të mëvonshme, siç është teoria e Karl G. Jungut (Carl G. Jung, 1875 – 1961) dhe teoria konstitucionale e Uiliam Sheldonit (William Sheldon, 1898 – 1907). Shih – ***INTROVERSIONI; EKSTRAVERSIONI; TEORIA KONSTITUCIONALE;***

b. **Teoria e tipareve –** Teori që shpjegon tërësinë e strukturës dhe integritetin e tipareve karakteristike të mendimit, të ndjenjave dhe të mënyrave të sjelljes të një personaliteti të caktuar. Në fillim tiparet u përshkruan në bazë të regjistrimit të mbiemrave të mendimit, të ndjenjave dhe të mënyrave të sjelljeve të njeriut, kurse më vonë u zhvillua mendimi teorik i nxjerrë nga zbatimi empirik i analizës faktoriale të sjelljeve tipike të personalitetit. Shih - ***TEORIA E REJMOND B. KATELIT.***

c. **Teoria psikanalitike** – Teori që paraqet një sistem shpjegimesh të përfaqësuesve të mendimit psikanalitik dhe neopsikanalitik. Thelbi apo esenca e grupit të teorive psikanalitike ka të bëjë me motivacionin e vetëdijshëm të pavetëdijshëm dhe me faktorët integrues të sjelljeve karakteristike të personalitetit, me zhvillimin integrues të tyre dhe me rolin e përvojës së hershme në përcaktimin e formave të reagimeve të individit të rritur.

d. **Teoria bihejvioriste –** Teori sipas së cilës thelbin e shpjegimit bihejviorist të personalitetit e përbën roli shumë i rëndësishëm i faktorëve të jashtëm, përkatësisht roli i të mësuarit në zhvillimin dhe formimin e personalitetit, sidomos në formimin e sjelljeve konseguente të ngritura mbi strukturën e tipareve dhe përforcimin e tyre nga ngacmuesit pozitivë të ambientit të jashtëm. Përfaqësuesi eminent i teorisë bihejvioriste të zhvillimit e formimit të personalitetit është Xhon B. Uatson (John Watson, 1878 – 1958);

e. **Teoria humaniste –** Teori e formuar si kundërshpjegim ndaj teorisë psikanalitike dhe bihejvioriste. Teoria humaniste mbështet potencialet njerëzore të personalitetit në zhvillimin e tij, duke përkrahur qasjen fenomenologjike, holistike dhe duke theksuar rolin e faktorit potencial të vetaktualizimit në zhvillimin integrues të sjelljeve mbisunduese të personalitetit. Teoria humaniste është e lidhur posaçërisht me mendimin psikologjik të Abraham H. Malovit (Abraham H. Malow, 1908 – 1970) dhe të Karl Roxhersit (Carl Rogers, 1902). Njeriu normal nuk lind i keq, por më parë lind i mirë ose eventualisht as i mirë dhe as i keq. Shtypja e brendshme biologjike për zhvillim është synimi për vetaktualizim. Prirja për vetaktualizim gjendet në majën e hierarkisë së zhvillimit psikologjik të njeriut, kurse në fund të kësaj tendence gjendet grupi i motiveve apo nevojave fiziologjike dhe mbi këta gjenden motivet psikologjike dhe akoma më lart gjendet motivi i brendshëm – motivi i vetaktualizimit. Nëse angazhimi i njeriut për të arritur deri në këtë majë pengohet nga faktorët familjarë, socialë etj. burimi natyror i zhvillimit njerëzor të njeriut deformohet, dhe lindin pikërisht neurozat, psikozat, sjelljet psikopatike etj.

f. **Teoria e të mësuarit shoqëror –** Teori që shpjegon personalitetin dhe

zhvillimin e formimin e tij si rezultat të faktorit themelor – të të mësuarit, ku rol të rëndësishëm luajnë faktorët njohës ose kognitivë, si: kujtesa, të menduarit, të folurit etj.;

g. **Teoria situacionale –** Teori që shpjegon konsekuencën e sjelljeve të integruara në personalitetin e njeriut si rezultat i ndikimit të shpeshtë të situatave të ngjashme ose të njëjta, ku personaliteti orvatet të gjendet pozitivisht. Faktorët e brendshëm (faktorët kognitivë, aftësitë, motivacioni etj.) janë të parëndësishëm në kuptimin rregullues të konsekuencës së sjelljeve të njeriut. Përfaqësuesi i kësaj teorie është psikologu amerikan Volter Miçel, pak i njohur në literaturën e psikologjisë;

h. **Teoria e interakcionizmit –** Teori që shpjegon personalitetin dhe zhvillimin e formimin e tij si produkt ndëraktiv të faktorëve të brendshëm (të paradispozitave) dhe të mënyrave e rrugëve të ndikimit të faktorëve të jashtëm, që mundësojnë zhvillimin e faktorëve potencial psikikë. Kjo është një teori ekliktike.

TEORITË E TË MËSUARIT. Përgjithësim mendimesh mbi ligjet e të mësuarit që shpjegojnë procesin e të mësuarit dhe rezultatin e këtij procesi. Grup teorish që shpjegojnë natyrën e të mësuarit, format, mekanizmat, metodat dhe pasojat e të mësuarit. Më të njohurat janë teoria kognitive e Eduard Tolmanit (Edward Tolman, 1886 – 1959), e mbështetjes së formave të të mësuarit në të mësuarit e reflekseve të kushtëzuara, teoria geshtaltiste e të mësuarit etj**.** Nuk ekziston ndonjë teori gjithëpërfshirëse të të mësuarit. Në kuptimin e ndryshimeve relativisht të qëndrueshme në potencialin e sjelljeve të njeriut, të mësuarit shpjegohet nga disa teori:

a. **Teoria asocacioniste** – Teori përgjithësuese sipas së cilës të mësuarit është konstatim i lidhjeve ndërmjet të dhënave, fakteve e informacioneve dhe përvetësim i këtyre lidhjeve, si edhe i përbërësve të tyre;

b. **Teoria S – R e të mësuarit** – Teori e shkollës bihejvioriste, që mbështet procesin e të mësuarit në lidhjen apo në asociacionin e ngacmuesit ose të stimuluesit dhe të reagimit adekuat ndaj tij. Sipas kësaj teorie të mësuarit është lidhje e përftuar nga përsëritja S(timulues) – R(eagim). Formë e veçantë e kësaj teorie është pikëpamja mbi të mësuarit e Frederik B. Skiner (Frederick B. Skinner, 1904 – 1990), që në procesin e të mësuarit fut faktorin e përforcimit të lëvizjeve të suksesshme;

c. **Teoria koneksioniste** – Teori që mbështet të mësuarit e njeriut për të qenë i vetëdijshëm për rregullimin, sistemimin e informacioneve të një tërësie, dallimin e raporteve ndërmjet tyre dhe përforcimin e këtij procesi. I pari që e ka trajtuar këtë teori ka qenë psikologu amerikan Eduard L. Torndajk (Edward L. Thorndike, 1874 – 1949) me ligjin e efektit.

d. **Teoria geshtaltiste** – Teori që thekson rëndësinë e mëtimit të raporteve ndërmjet pjesëve dhe tërësive. E lindur në fushën e perceptimeve, teoria geshtaltiste vë në pah rolin e faktorit të kuptimit të raporteve ndërmjet përbërësve të një tërësie dhe lidhjeve të tyre;

e. **Teoria kognitive** – Teori që thekson rolin e proceseve intelektuale, njohëse ose kognitive (perceptimi, kujtesa,

mendimi, të folurit) në procesin e tërësisë së të mësuarit. Sipas kësaj teorie, të mësuarit është proces i qëllimshëm; njeriu mëson pasojat e reagimit të mençur dhe konfirmimin e tyre. Kjo është teoria e Eduard K. Tolman (Edward Ch. Tolman, 1937 – 1996).

TEORITË E TË PARIT TË NGJYRAVE. Modele shpjeguese të dukurisë së të parit dhe të ndijimit të ngjyrave dhe nuancave të shumëllojshme të tyre. Ekzistojnë disa teori për shpjegimin e gjithëmbarshëm të dukurive të të parit dhe ndijimit të ngjyrave (të cilësisë apo tonit të ngjyrës, të veçorive, të përzierjes së ngjyrave etj.), si edhe të shndërrimit të energjisë së valëve elektromagnetike në ndijimin e një ngjyre të caktuar. Ndër këto teori dallojmë:

a. **Teoria e Jang – Helmholcit** – Teori që shpjegon dukurinë e të parit të ngjyrave dhe ndijimit të tyre në bazë të rezultateve hulumtuese të mjekut dhe fizikanit anglez Tomas Jang (Thomas Yong, 1773 – 1829) dhe të fiziologut e psikologut gjerman Herman L. Helmholc (Hermann L. Helmholtz, 1821 – 1894). Sipas tyre në syrin e njeriut ekzistojnë tri lloje fotoreceptorësh të retinës, që reagojnë ndaj valëve elektromagnetike me gjatësi të ndryshme. Ndaj valëve të gjata elektromagnetike reagojnë fotoreceptorët e ngjyrës së kuqe, ndaj valëve të mesme reagojnë fotoreceptorët e ngjyrës së gjelbër dhe ndaj gjatësisë së valëve të shkurtra elektromagnetike reagojnë fotoreceptorët e ngjyrës së kaltër. Ndijimi i të gjitha ngjyrave të tjera përjetohet nga raporti ngacmues i këtyre tri fotoreceptorëve. Ndijimi i ngjyrës së verdhë shkaktohet nga ngacmimi i fotoreceptorëve të ngjyrës së kuqe e të gjelbër. Kjo teori shpjegon procesin e ndijimit të cilësisë së ngjyrave dhe përzierjen e tyre, por nuk arrin ta shpjegojë plotësisht dukurinë e përzierjes së ngjyrave dhe disa dukuri të verbimit të ngjyrave;

b. **Teoria e Heringut** – Teoria e fiziologut gjerman Hajnrih E. Hering (Heinrich E. Hering, 1866 – 1948), sipas së cilës në retinën e syrit të njeriut ekzistojnë tri lloj fetoreceptorësh për tri çifte ngjyrash: për çiftin e ngjyrave i, e kuq – i, e gjelbër; i, e verdhë – i, e kaltër dhe i bardhë – i zi. Secili prej këtyre çifteve ngjyrash shkakton procese antagoniste të asimilimit dhe të disimilimit të substancave biokimike të retinës së syrit. Ndikimi i energjisë së valëve elektromagnetike të gjata shkakton inhibimin e çiftit tjetër të fotoreceptorëve. Kjo teori shpjegon përmbajtjen e dukurive të ndijimit të ngjyrave, por jo për të gjithë spektrin e ndërlikuar të ndijimit të ngjyrave. Madje, duhet marrë në konsideratë jo vetëm procesi i ndërlikuar i retinës, por edhe procesi nervor. Përpunimi i ngacmuesve të fotoreceptorëve të retinës së syrit është i lidhur me procesin nervor dhe ky i fundit ndryshon nga përpunimi i tyre në qendrat e trurit;

c. **Teoria e Led Franklinit** – Teori që shpjegon kryesisht zhvillimin evolutiv të të parit të ngjyrave. Sipas Teorisë së Kristina Led Franklin (Christine Ladd –Franklin, 1847 – 1930) syri në fillim ka dalluar vetëm të zezën dhe të bardhën, më pas ngjyrën e verdhë dhe të kaltër dhe në fund ngjyrën e kuqe dhe të gjelbër. Kjo teori ka argumente të errëta për shpjegimin e ndërlikuar të

zhvillimit të aftësisë së të parit të ngjyrave;

d. **Teoria e R. Granitit** – Teori që shpjegon dukurinë e ndijimit të ngjyrave në bazë të strukturës fotoreceptore trireceptore. Kjo teori niset nga supozimi, sipas të cilit një strukturë fotoreceptore është dominuese në spektrin e gjerë të valëve elektromagnetike, duke reaguar ndaj valëve elektromagnetike me gjatësi të caktuar dhe, krahas kësaj, ekziston edhe një strukturë tjetër fotoreceptore, që reagon ndaj valëve me gjatësi specifike.

TEORITË E TË UDHËHEQURIT. Përgjithësime përvojash, konceptesh e ligjesh për udhëheqjen sa më produktive të një grupi shoqëror, një ekipi punëtoresh, profesionalistësh etj. nga ana e një drejtuesi ose nga ana e disa drejtuesve. Ekzistojnë këto teori: 1) Teoria e personalitetit – sipas së cilës udhëheqësi (drejtuesi) duhet të ketë disa tipare të veçanta psikologjike; 2) Teoria e stileve – sipas së cilës udhëheqësi (drejtuesi) duhet të ketë një mënyrë specifike të sjelljeve dhe të organizmit të tyre në udhëheqjen e procesit të punës, të prodhimit etj. dhe 3) Teoria situacionale – sipas së cilës realizohet ndërveprimi ose interaksioni ndërmjet stilit udhëheqës dhe situatës konkrete të atij vendi udhëheqës (drejtues). Kjo e fundit është më e pranueshme.

TEORITË E TRANSFERIMIT TË TË MËSUARIT. Shpjegim i proceseve të tejbartjes apo transferimit të të mësuarit. Tri janë teoritë e këtij procesi: Teoria e elementeve identike, teoria e disiplinës formale dhe teoria e përgjithësimit. Shih fq. 907, 908 e 911.

Burimet:

James Deese & Stewart H. Hulse: *"The Psychology of Learning"* – (*"Psikologjia e të mësuarit"*), New York – St. Luis – San Francisco – Dsseldorf – London – Mexico – Panama – Sydney – Toronto, 1967 (kryesisht, fq. 340 – 370).

Herman von Ebbinghaus: *"Über das Gedächtnis: Untersuchungen zur exprimentelen Psychologie"* – (*"Për kujtesën: Hyrje në psikologjinë eksperimentale"*), Leipzig: Duncker und Humbolt, 1885.

Edward Lee Thorndike*: "Educational Psychology"* – (*"Psikologjia e edukimit"*), New York; Lemcke & Buechner, 1905.

Edward Lee Thorndike: *"The fundamentals of Learning"* – (*"Bazat e të mësuarit"*), New York: Teachers College, 1932.

Robert S. Woodworth: *"Eksperimantal Psychology"* – (*"Psikologjia eksperimentale"*), 1938 (kryesisht, fq. 160 – 189).

Slavoljub Radonić: *"Transfer učenja"* – (*"Transferimi i të mësurit"*), Beograd, 1959.

Vid Pečjak: *"Psihologija spoznavanja"* – (*"Psikologjia e njohjes"*), Ljubljana, Državna Založba, Slovenija, 1977.

Pajazit Nushi: *"Psikologjia e përgjithshme"*, Prishtinë, 2002, fq. 289 – 303.

TEORITË E ZHVILLIMIT PSIKIK. Përmbledhje teorish dominante për zhvillimin e përgjithshëm mendor dhe shpjegimin e tij. Tri janë teoritë dalluese të këtij rrafshi: 1) Teoria psikanalitike, 2) Teoria e zhvillimit kognitiv dhe 3) Teoria e zhvillimit moral. Teoria psikanalitike është përgjithësim konceptesh apo nocionesh dhe ndërlidhjesh midis tyre. Kjo teori mbi konceptin themelor të pavetëdijes jep shpjegime për këto faza të zhvillimit psikik: faza orale, faza anale, faza falike, faza e latencës, faza e adoleshencës, faza gjenitale e pjekurisë dhe faza e pleqërimit. Teoria e zhvillimit kognitiv ka të bëjë me përshkrimin dhe shpjegimin e fazave të zhvillimit të proceseve njohëse apo kognitive, e

përgjithësisht me zhvillimin e procedurave të mendimit. Këtu mbizotëron teoria e psikologut zviceran Zhan Piazhe (Jean Piaget, 1896 – 1980), i cili e shpjegon zhvillimin e mendimit operacional në situata konkrete dhe në situatat e operacioneve mendore formale. Përgjithësimi me ndikimin më të rëndësishëm në zhvillimin e sjelljeve morale është teoria e psikologut amerikan Lorenc Kohlberg (Lawrence Kohlberg, 1927 – 1987), i cili ka arritur të identifikojë tri nivele të zhvillimit të mendimit moral, të përvetësimit dhe të përbrendësimit të parimeve dhe normave morale dhe të zhvillimit të sjelljeve morale të drejta dhe të padrejta, pozitive dhe negative. Niveli i parë është niveli paramoral, niveli i dytë është zhvillimi i sjelljeve morale nën ndikimin e sanksioneve të jashtme dhe niveli i tretë ka të bëjë me zhvillimin e gjykimit moral dhe të sjelljeve të lidhura me të mbi bazën e parimeve morale personale. Secili nga nivelet e përmendura përbëhet nga dy faza zhvillimore, që së bashku përbëjnë zhvillimin e mendimit dhe të sjelljeve morale mbi bazën e gjashtë fazave.

TEORITË KOGNITIVE TË TË MËSUARIT. Teoritë e të mësuarit, të cilat kanë si bazë kryesore aktivitetin e proceseve të larta psikike në procesin e të mësuarit. Këto procese kryesore janë: marrja dhe përpunimi i informacioneve, mbajtja mend e informacioneve dhe lidhja e tyre, si edhe krijimi i lidhjeve të reja ndërmjet tyre, qëllimi i të mësuarit të njeriut dhe kuptimi i saj nga ana e tij etj. Proceset e larta psikike të karakterit kognitiv marrin pjesë aktive në procesin e të mësuarit duke shpjeguar procesin e të mësuarit si proces të ndërlikuar. Me këtë kuptim psikologu geshtaltist gjerman Volfgang Koler (Wolfganga Kohler, 1887 – 1967), dhe psikologët amerikanë Osvald Kilpe (Oswald Kulpe, 1862 – 1915), Eduard K. Tolman (Edward Ch. Tolman, 1886 – 1959) etj. kanë pohuar se të mësuarit nuk mund të shpjegohet duke u bazuar në kushtëzimin klasik e instrumental dhe as duke u mbështetur në metodën e të mësuarit në bazë të orvatjeve dhe suksesit të rastit, por duhet marrë në konsideratë tërësia e faktorëve kognitivë dhe roli i tyre në procesin e të mësuarit.

TEORITË MBI PERSONALITETIN. Sistem shpjegues pak a shumë gjithëpërfshirës për njeriun dhe personalitetin e tij, për strukturën, zhvillimin dhe funksionimin e personalitetit. Këtu hyjnë: teoria psikanalitike, teoria ekzistencialiste, teoria faktoriale, teoria humaniste etj. Shih fq. 911

Burimet:

Calvin S. Hall. Gardner Lindzey*: "Theories of Personality"* – (*"Teoritë mbi personalitetin"*), Third Edition JohnWiley and sons, New York, 1976.

DR. C. George Boeree: *"Teoritë e personalitetit – nga Frojdi deri në ditët tona"*, Plejad, Tiranë, 2004.

Konrad Lorenz: *"Evolution and Modification of Behavior"* – (*"Evolucioni dhe modifikimi i sjelljeve"*), Chicago: University of Chicago Press, 1965.

Jean Piage: *"La psychologie de l`intelilligence"* – (*"Psikologjia e inteligjencës"*), 1947.

Lawrence Kohlberg: *"The Psychology of Moral Devepeloment: Moral Stages and the Life Cycle"* – (*"Psikologjia e zhvillimit moral: Fazat morale dhe ciklet e jetës"*), 1984.

Gordon W. Allport *"Pattern and Growth in Personality"* – ("*Matrica dhe rritja e personalitetit*"), Holt, Rinehart and Winston, New York, 1961.

Sigmund Freud: *"Psikanaliza fëmijërore",* Fan Noli, Tiranë, 2005.

TEORITË PSIKOLOGJIKE HIDRAULIKE. Teori të tilla si, teoria psikanalitike e personalitetit e Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939), teoria etologjike e Nikolas Tinbergut (Nikolaas Tinbergen, 1907 – 1988) dhe teoria e Konrad Z. Lorencit (Konrad Z. Lorenz, 1903 – 1989) u quajtën teori hidraulike, sepse sipas këtyre teorive, proceset psikike dhe funksioni i strukturave psikike përgjithësisht sillen si uji që ushtron presion për të dalë nga gypat e caktuar dhe aty ku gjen hapësirë për të dalë ai e shpejton rrjedhën e lëvizjes së tij. Teoritë hidraulike filluan të shfrytëzohen nga gjysma e parë e shekullit të njëzet dhe kuptohet, burimin e kanë nga fizika. Por, mbështetja e tyre në supozime dhe pamundësia e argumentimit empirik ka bërë që ato të konsiderohen të tejkaluara.

TEOZOFI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *θεός* "Zoti" dhe *σοφισμός* "mençuri". Term i mistikës, që ka strukturë domethënëse psikologjike. Teozofia është pikëpamje mbi besimin dhe bindjen mbi ekzistencën e Zotit, të njohjes së tij dhe të bashkimit me të. Në mbështetje të këtij besimi e bindjeje, njeriu gjoja komunikon me shpirtrat e vdekur, ka aftësi parapsikologjike etj. Njohja e Zotit dhe e mrekullive të tij kryhet me ndërmjetësimin e disa fuqive të posaçme shpirtërore, që i kanë vetëm disa individë; këta me ndihmën e ndjenjave të thella fetare arrijnë ta njohin drejtpërdrejt Zotin dhe të bashkohen me të.

TEPTISJ/E, - A. f. Emocione dhe sjellje të vrullshme, të papritura të individit, të cilat përkojnë pak nuk përkojnë fare me rregullat dhe me normat e sjelljes së mirë në shoqëri. U teptis nga gëzimi d. m. th. U gëzua kashtë mase dhe këtë nuk është në gjendje ta kontrollojë.

TERAPI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *θεραπεία* "shërim" që përmbledh të gjitha llojet dhe format e kujdesit për zbutjen dhe shërimin e çrregullimeve mendore dhe psikike dhe të sjelljeve të njeriut. Termi dhe kuptimi i tij ka të bëjë kryesisht me veprime të organizuara profesionale për shërimin e çrregullimeve dhe të sëmundjeve trupore të organizmit, duke eliminuar shkakun e saj organik dhe fiziologjik. Terapia mund të jetë aktive dhe pasive. Terapia aktive ka të bëjë me aktin e angazhimit madhor të terapeutit, i cili luan rolin e drejtuesit të procesit psikoterapeutik, përkatësisht rolin parësor. Terapia pasive është ajo formë, ku terapeuti është i tërhequr dhe orvatet të mos ndikojë në rrjedhën e mendimeve, të ndjenjave etj. të klientit. Ndryshon nga kuptimi i termit psikoterapi vetëm në objektivin e shërimit dhe të mënjanimit të shkaqeve psikike të çrregullimit të sjelljeve të njeriut. Shih – ***PSIKOTERAPIA.***

TERAPIA BIHEJVIORALE. I ardhur nga anglishtja *behavior* "sjellje". Shërim i formave të çrregullimit të sjelljeve, sidomos të sjelljeve neurotike, që mbështeten në teorinë bihejvioriste të të mësuarit, përkatësisht në formën e të mësuarit të refleksit të kushtëzuar, të të mësuarit operant etj. Terapia bihejviorale ka si pikënisje të vërtetën, se sjelljet e çrregulluara të njeriut janë kryesisht sjellje të mësuara

dhe për këtë arsye, sjelljet e çrregulluara mund të ndryshojnë në drejtimin pozitiv me zbatimin e parimeve dhe të formave të ndryshme të të mësuarit. Sjellja e çrregulluar nuk është vetëm simptomë, por përmbajtje e të mësuarit, e cila mund të shërohet me formën tjetër të të mësuarit. Meqë sjelljet e çrregulluara janë zhvilluar jo nga nevoja dhe dëshira e njeriut, duhen zëvendësuar me forma të sjelljeve të përshtatshme. Nëse ndonjë formë e sjelljes së duhur nuk është zhvilluar fare, atëherë duhet përpjekur që këtë formë ta plotësojmë. Për këtë zbatohen teknika të posaçme të të mësuarit. Terapia bihejviorale u tregua e suksesshme për shërimin e gjendjeve të fobisë, të ankthit, të çrregullimeve të të folurit, të sjelljeve seksuale etj.

T

TERAPIA BIOFIDBEK. Zbatimi i fidbekut për shërimin e disa çrregullimeve organike. Kështu, me marrjen e informacionit kthyes për presionin e rritur të gjakut njeriu me vullnetin e tij ndryshon sjelljet, duke shkaktuar ulje të këtij presioni, madje, mund të hartojë vetë një "program sjelljesh" për uljen e tensionit të gjakut, hipertensionin. Këto fakte kanë argumentuar se funksioni i sistemit nervor autonom ose vegjetativ nuk është krejtësisht i pavarur nga funksioni i Sistemit Nervor Qendror, pra ai mund ta ndryshojnë funksionin me vullnetin e vetë njeriut.

TERAPIA E ÇRREGULLIMEVE SEKSUALE. Disa nga metodat psikoterapeutike kognitive e bihejviorale me anën e zbatimit të të cilave bëhen orvatje për të eliminuar vështirësitë, pengesat dhe ankthin e sjelljeve seksuale jonormale. Vështirësitë e këtilla mund të jenë pritja e pasuksesshme, sulmet seksuale, besimi i gabuar për zvogëlimin e potencialit seksual, zvogëlimi apo humbja e përkohshme e kompetencave seksuale etj.

TERAPIA E DREJTUAR MBI KLIENTIN. Formë e psikoterapisë jodirektive. Organizohet duke nxitur klientin t`i shprehë lirisht ndjenjat, konfliktet dhe ngarkesat e veta dhe, në bashkëveprim të lirë dhe të besueshëm me psikoterapeutin, të bëhet i vetëdijshëm për ngarkesat penguese të sjelljeve normale të tij. Roli i psikoterapeutit është dëgjimi me kujdes i klientit dhe ndërhyrja e duhur, por e rrallë në shprehjet e tij, duke ia mundësuar atij kuptimin më të drejtë dhe më racional të sjelljeve dhe të veprimeve të veta. U zbatua fillimisht nga ana e psikologut amerikan Karl R. Roxhers (Carl R. Rogers, 1902 – 1987).

TERAPIA E NDJENJAVE. Terapi që ka të bëjë me thyerjen e qëndresës së pacientit, për t`i shprehur ndjenjat e tij dhe ngarkesat e veta nga ndikimi i këtyre ndjenjave. Qëllimi kryesor i kësaj forme të psikoterapisë është që njeriu t`i zotërojë ndjenjat e ndrydhura dhe të rivendosë një raport ndijor normal me të tjerët.

TERAPIA EKSPRESIVE. Formë e psikoterapisë ku pacienti shtyhet t`i shprehë lirisht konfliktet, preokupimet, problemet etj. dhe, duke i shprehur këto, ai çlirohet nga ngarkesa psikike që shkaktojnë gjendje psikike të brendshme dhe sjellje problematike të tij.

TERAPIA EKZISTENCIALISTE. Terapi që mbështetet në zgjedhjen e lirë të formave, të mjeteve dhe të llojeve të organizimit të jetës dhe të sjelljeve që i kontribuojnë zhvillimit të tij.

Kjo terapi ka për bazë sjelljet e tashme dhe zhvillimin e tyre në të ardhmen e klientit. Veprimet psikoterapeutike zhvillohen dhe organizohen me qëllim të vetëdijes të klientit, se ai është përgjegjës i drejtpërdrejtë për zhvillimin e vet, për zgjidhjen e problemeve dhe të situatave problemore të jetës dhe të aktivitetit të tij. Klienti duhet inkurajuar për ndërmarrjen e përgjegjësisë për të gjitha format, mjetet dhe proceset e zhvillimit të tij personal. Mbështetet në pikëpamjet e përgjithshme të ekzistencializmit të Zhan P. Sartrit (Jean P. Sartre, 1905 – 1994), si edhe në pikëpamjet e Ludvig Binsvangerit (Ludwig Binswanger, 1881 – 1966), të Viktor Frankelit (Viktor Frankl, 1905 – 1997) etj.

TERAPIA GESHTALT. Formë e terapisë në psikologjinë klinike e bazuar në parimet e psikologjisë geshtaltiste. Kësaj forme të terapisë i nënshtrohen ata individë, të cilët nuk kanë arritur ta zhvillojnë personalitetin e tyre të balancuar (sipas nevojave, emocioneve, motiveve etj. dhe raporteve të tërësishme të tyre me sjelljet përkatëse). Individët që i nënshtrohen kësaj terapie zakonisht nuk kanë arritur të formojnë personalitet të tërësishëm, por ka mbetur diçka e mangët, diçka çorientuese, penguese etj. Në këtë formë të terapisë individi duhet të nxitet dhe të bëjë përpjekje për të zhvilluar vetëdije sa më të plotë për këto zbrazëti, sidomos për zhvillimin emocional të tij. Terapia geshtaltiste zakonisht organizohet në formën e terapisë grupore, ku individi shpreh lirisht mendimit e veta dhe herë-herë nxitet nga psikologu klinik për të zgjeruar asociacionet e veta sa më shumë, në mënyrë që të bëhet i vetëdijshëm për tërësinë e përjetimeve të veta, e jo vetëm për pjesë të këputura të atyre përjetimeve. Terapia Geshtalt është formuluar nga psikiatri i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (i lindur në Gjermani) Fric Perls (Fritz (Frederick) Perls 1893 – 1970) dhe nga bashkëpunëtorët e tij.

TERAPIA IMPLOZIVE. I ardhur nga anglishtja *implode* "me u fut brenda". Formë e teknikës së terapisë bihejviorale, që është e përqendruar në mënjanimin e ankthit, të frikës, të të pirit duhan, alkool etj., duke "bombarduar" intensivisht frikacakun, alkoolistin etj. me ngacmues të atillë që dikur arrijnë shkallën e padurimit të mëtejshëm të ankthit, të frikës, të alkoolit etj. Në këtë kuptim alkoolistit i jepet të pijë sasi e madhe alkooli, derisa ai të ngopet mirë dhe të kërkojë të heqë dorë nga marrja e mëtejshme e alkoolit.

TERAPIA ME ANË TË ARTIT. Metodë psikoterapeutike që organizohet dhe zhvillohet me anë të muzikës, të pikturës, të skulpturës, të vizatimit etj., duke e vënë pacientin në sedër, që me anën e këtyre formave artistike të shfaqë aspiratat, emocionet dhe konfliktet e brendshme. Këto forma të shfaqjes së fantazisë, të problemeve shoqërore etj. me anë të "krijimeve" artistike pacienti mëson t`i shfrytëzojë për të vënë në lëvizje mendimin, imagjinatën dhe sjelljen e duhur të tij. Kjo formë psikoterapeutike ka vlera psikodiagnostike dhe terapeutike. Konceptimi i terapisë me anë të artit është përpunuar nga ana e psikoterapeutes Margaret Naumberg (Margarrtte Naumberg, 1966).

TERAPIA ME ANË TË LOJËS. Metodë e psikoterapisë së fëmijëve që organizohet më tepër në formën

e terapisë psikanalitike, ku fëmija me anë të lojës shfaq dhe fillon të zotërojë motivet dhe sjelljet e çrregulluara që kanë bazë të pavetëdijshme. Qëllimi kryesor i kësaj forme të terapisë është që fëmija me anë të lojës të mënjanojë disa forma të emocioneve negative, si frikën, urrejtjen, xhelozinë etj. Në këtë proces loja luan rolin e asociacioneve të lira. Lodrat e fëmijëve, si p.sh., kafshët, objektet etj. në formë lodrash shërbejnë që, nëpërmjet tyre, fëmija të shprehë botën e tij të brendshme, duke përfshirë edhe problemet psikike dhe të aftësohet që të kuptojë mendimet dhe ndjenjat e shtypura, duke i shprehur lirisht dhe duke u bërë në këtë mënyrë i vetëdijshëm për to. U konceptua nga psikanalistja austriake Melani Klajn (Melanie Klein, 1882 – 1960**).**

TERAPIA PSIKANALITIKE. Formë e psikoterapisë që mbështetet në metodën e asociacioneve të lira. Pacienti nxitet me mjete falënderuese e trimëruese për të thënë sa më shpejt atë që i kujtohet, pavarësisht nga përmbajtja dhe kuptimi i saj. Psikoterapeuti gjatë asociacioneve të lira kërkon shpjegime për ndalesat e bëra në rrjedhjen e asociacioneve të lira dhe në këtë mënyrë gjurmon ngarkesat emocionale, konfliktet e brendshme, qëndrimet etj., për ta bërë klientin të vetëdijshëm për to dhe për të shkaktuar në këtë mënyrë çlirimin nga këto ngarkesa.

TERAPIA PSIKODINAMIKE. Terapi që mbështetet në teorinë e psikanalizës dhe që jepet në katër forma: 1) Psikanaliza klasike (në mekanizmat mbrojtës), 2) Egopsikologjia (në zhvillimin e aftësive për testimin e realitetit me qëllim të adaptimit të suksesshëm), në lidhje të ngushtë me rolin e nënës, të babait etj. për zhvillimin e drejtë psikofizik që nga fëmijëria e hershme), 3) Psikologjia e marrëdhënieve me objektin dhe 4) Psikologjia e vetvetes që ka të bëjë me rolin e nënës, babait etj. për zhvillimin e drejtë psikofizik, që nga mosha e fëmijërisë dhe rolin e këtij zhvillimi në organizimin e sjelljeve të shëndosha në moshën e rritur.

TERAPIA RACIONALE. Formë e psikoterapisë, e cila mbështetet në shfrytëzimin e mënyrave të zgjidhjes së problemeve nga ana e pacientit, që vuan nga çrregullimet e procesit të emocioneve dhe të disa sjelljeve. Pacienti udhëzohet dhe forcohet për ato forma të sjelljeve që duhet të mbështeten në argumente të pakontestueshme. Ai vihet në një situatë të tillë që të mendojë dhe të zgjedhë argumente kontradiktore dhe udhëhiqet për të gjetur format më mira të mendimit të drejtë dhe të harmonizimit të sjelljeve të tij me mendimin racional. Terapia racionale haset në psikologjinë e Erik H. Eriksonit (Erik H. Erikson, 1902 – 1994).

TERAPIA RACIONALE-EMOCIONALE. Terapi e përafërt me terapinë racionale. Terapia racionale–emocionale ka të bëjë me marrjen e masave psikologjike për ndryshimin e besimeve, të bindjeve, të ideve të ngulitura etj. të një individi për veten e tij, si "Mua askush nuk më do"! Kjo formë e psikoterapisë mbështetet në pikëpamjen se çrregullimi emocional dhe i sjelljeve të lidhura me këtë lloj çrregullimi janë pasojë e mendimeve irracionale dhe pritjeve të këtilla. Për këtë shkak terapia racionale - emocionale

synon identifikimin e ankthit e të burimit të tij dhe të nxitjes së pacientit për zhvillimin e mendimeve dhe sjelljeve të njëmendësuara drejt përmirësimit të pritjeve negative për të, drejt ndryshimit të çrregullimit të emocioneve, të reagimeve dhe sjelljeve çrregulluese që lidhen me to. Bazat e kësaj terapie i ka vënë Albert Elis (Albert Ellis, 1913), psikolog dhe psikanalitik amerikan që i është kundërvënë pikëpamjeve të psikologjisë klasike të Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939).

TERAPIA RADIKS. Lloj karakteristik i terapisë, që mbështetet në modelin edukativ të terapisë dhe jo në modelin e terapisë mjekësore të shërimit të sëmundjeve dhe të çrregullimeve psikike. Sipas kësaj terapie në zhvillimin e personalitetit të shëndoshë duhen shfrytëzuar teknikat e relaksimit të thellë emocional të pacientit, duke u mbështetur në zhvillimin dhe organizimin e procesit edukativ të emocioneve dhe në përzgjedhjen e qëllimit jetësor të përshtatshëm. Këtë formë të terapisë e konceptoi psikologu amerikan Xhorxh Keli (George Kelly, 1905 – 1966).

TERAPIA RAJH. Terapi e drejtuar në organizmin e trupit të njeriut. Kjo lloj terapie niset nga supozimi se vetëm në trupin e njeriut gjendet baza energjetike e zhvillimit të shëndoshë psikik të tij. Personaliteti i shëndoshë është produkt i qarkullimit të lirë të energjisë së organizmit të njeriut. Pengimi i qarkullimit të lirë të energjisë së organizmit është shkak i çrregullimeve psikike të tij. Për këtë shkak në realizimin e kësaj terapie nevojitet analiza fjalësore e përjetimeve të personalitetit dhe mospengimi i qarkullimit të lirë të energjisë muskulare, duke synuar që njeriu të arrijë shkallën e zhvillimit gjenital. U zhvillua rreth viteve `60 të shekullit të njëzet nga ana e psikanalistit amerikan me origjinë austriake Vilhelm Rajh (Wilhelm Reich, 1897 – 1957).

TERAPIA SEMANTIKE. Nënshtrim i atyre formave të shërimit, që kanë të bëjnë me ndryshimin e përmbajtjes, përkatësisht të kuptimit të fjalëve, të termave. Terapia semantike realizohet duke ndikuar te pacienti që ai t`i perceptojë kuptimin e fjalëve dhe të termave ndryshe nga mënyra që ai i njeh dhe i përdor. Kjo formë e terapisë është e lidhur ngushtë me logoterapinë.

TERAPIA SHOK. Formë kurimi e të sëmurëve psikikë, të cilët vuajnë nga shoku. Këto janë masa dhe procedura të posaçme që zbatohen për shërimin e çrregullimeve psikofizike, në rend të parë të çrregullimeve emocionale. Ndër masat e procedurat e këtilla zakonisht zbatohen terapia elektrokonvulsive dhe terapia shok e insulinës. Këto masa dhe procedura terapeutike kanë dhënë rezultate të kufizuara.

TERATOGJEN, - I. m. Faktorë pengues të zhvillimit të fetusit, shkaktarë të zhvillimit jonormal të fetusit pas muajit të tretë të tij deri në lindje. Shkaktarë të këtillë janë: marrja e drogës nga ana e nënës, e pijeve alkoolike, e rrezatimit të organizmit të nënës shtatzënë, e stresit etj. Këta shkaktarë patogjenë prodhojnë deformime organike, por, kohët e fundit janë konstatuar një varg pasojash psikike.

TERMALGJEZI, - A. f. I ardhur nga greqishtja që tregon gjendjen e shkaktuar nga ngritja e temperaturës së

organizmit nga ngacmuesit termikë me intensitet të lartë, duke e shndërruar ngacmimin në dhembje.

TERMAN Luis (Lewis TERMAN). Psikolog amerikan. Lindi në Indiana më 1877 dhe vdiq në Kaliforni më 1956. Iu përkushtua psikologjisë që nga fillimi i studimeve dhe u doktorua për psikologji në Universitetin e Klarkut më 1905; pas pesë vitesh u zgjodh asistent dhe një vit më vonë, më 1906 u zgjodh profesor i psikologjisë në departamentin e pedagogjisë të Universitetit Stanford. Punimi më i njohur i Luis Termanit është Testi Stanford – Bine, i cili është rishikim i Testit Bine – Simon, por i përshtatur për matjen e inteligjencës së fëmijëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i botuar më 1916. Më 1937 bëri një rishikim të posaçëm të këtij testi dhe së bashku me psikologen Meril zgjeruan numrin e detyrave testore, duke shtrirë edhe më tej moshën e të testuarve. Udhëzimet e rishikimit u bën bazë e qasjes rishikuese të këtij lloj testi. Luis Termani u mor posaçërisht me studimin e zhvillimit të inteligjencës te fëmijët që kishin zhvillim të jashtëzakonshëm të inteligjencës. Me këto studime konsiderohet ndër themeluesit e parë të psikologjisë kognitive. Veprat kryesore të tij janë: *"The Measurement of Intelligence"* – (*"Matja e inteligjencës"*), *1916* (rishikimin e saj e ka bërë bashkë me psikologen Meril dhe e botuan më 1937 me titull *"Measuring intelligence: A Guide to the Administration of the New Revised Stanford – Binet Tests of Intelligence"* – (*"Matja e inteligjencës: udhërrëfyes mbi administrimin e testit të ri të rishikuar Stanford – Bine të inteligjencës"*); *"The Intelligence of School Children"* – (*"Inteligjenca e fëmijëve në shkollë*), 1919; "*Genetic Studies of Genius"* – (*"Studimi gjenetik i gjenisë"*), 1926.

TERM, - I. m. I ardhur nga greqishtja *τερμίνος* "kufi". Simbol i posaçëm, fjalë, togfjalësh që emërton konceptin e një disipline të caktuar shkencore, teknike dhe të artit. Termi dhe togfjalëshi terminologjik i nënshtrohet zhvillimit të pandërprerë të kuptimit dhe shprehjes gjuhësore. Qartësia e përmbajtjes dhe e formës së një termi nga termat e tjerë, qartësia, saktësia kuptimore, përpikëria dhe njëkuptimshmëria e tyre janë veçoritë më të rëndësishme të termit të një koncepti apo nocioni përkatës.

TERMI PSIKIKË NË SHQIP. Në gjuhën shqipe termi psikikë ka filluar të përdoret vonë. Këtë term e hasëm të shkruar në veprat e Sami Frashërit. "Në më zëntë vdekja në gurbet psikqinë (shpirtin) tim/kush vallë do të më bëjë varrë dhe do të më qepin qefinë?..." thuhet në vargjet persiane të Sami Frashrit të komentuara nga Ibrahim D. Hoxha. Ka gjasa që termi psikikë nuk është përdorur në shqip para viteve të fundit të shekullit të nëntëmbëdhjetë.

TERMI PSIKOLOGJI NË SHQIP. Koha e fillimit të përdorimit të termit psikologji në gjuhën shqipe mund t`i atribuohet Hasan Tahsinit dhe i përket viteve të fundit të shekullit të nëntëmbëdhjetë kur u botua vepra e tij në osmanisht "Psikoloji yahut Ilm- i Ruh" - "Psikologji", ose "Dituri mbi Shpirtin". Jani Vreto psikologjinë e ka emërtuar me termin "shpirtshikonjë" apo "shpirtqyrë" në veprën "Për të vërtetën edhe për shkronjënë e së

vërtetësë" të botuar më 1885. Përgjithësisht mund të thuhet se përdorimi i termit psikikë dhe psikologji lidhet me zhvillimin e mendimit shkencor në vitet e para të Rilindjes Kombëtare.

TERMI PSIKOLOGJIK. Simbol emërtues i konceptit apo nocionit përkatës i dukurisë, i gjendjes, i procesit psikik, i sjelljes, i tiparit së caktuar dhe i raporteve të caktuara ndërmjet tyre. Termi psikologjik mund të jetë i përgjithshëm dhe i veçantë. Termi psikologjik i përgjithshëm është simbol emërtues ndërkombëtar për një koncept apo nocion psikik të caktuar, i cili zbatohet së paku në tri gjuhë. Termi psikologjik i veçantë është simboli emërtues i konceptit psikologjik të caktuar, që shkruhet dhe shqiptohet saktësisht në gjuhën e një populli, në bazë të marrëveshjes së gjuhëtarëve, terminologëve dhe psikologëve. Secili term i nënshtrohet procesit zhvillimor të kuptimit dhe shprehjes së tij. Ky është procesi i përsosjes së pandërprerë të përmbajtjes dhe vëllimit të konceptit dhe i zhvillimit të gjuhës (të drejtshkrimit dhe fonetikës).

TERMINOLOGJIA E PSIKOLOGJISË. Sistem i gjithëmbarshëm i termave, me anën e të cilave emërtohen konceptet e dukurive, të gjendjeve dhe proceseve psikike, të tipareve të personalitetit dhe strukturave e funksioneve të tyre, si edhe e sjelljeve, e motiveve, e llojeve dhe e të mësuarit të tyre. Përcaktimi dhe zhvillimi i terminologjisë së psikologjisë është njëra ndër detyrat e psikologjisë profesionale dhe shkencore. Terminologjia e psikologjisë në procesin e zhvillimit të saj ka përcjellë dhe ka ndikuar në zhvillimin e mendimit psikologjik në përgjithësi. Në këtë proces dallohen katër faza karakteristike: 1) Zhvillimi i terminologjisë tradicionale deri në fillesat e zhvillimit të psikologjisë empirike; 2) Terminologjia mentaliste e psikologjisë që nga viti 1879 deri më 1913; 3) Zhvillimi i terminologjisë bihejvioriste dhe i termave e koncepteve të sistemit bihejviorist të tyre, duke përjashtuar termat dhe konceptet mentaliste dhe 4) Zhvillimi i terminologjisë së ndryshoreve intervenuese psikologjike dhe sintetizimi i kuptimit mentalist dhe bihejviorist të termave psikologjikë. Ky zhvillim ka karakterizuar kryesisht zhvillimin e terminologjisë së psikologjisë në vendet anglo-saksone, sidomos në SHBA. Por, shpejt u konstatua se vetëm me terma të koncepteve të psikologjisë bihejvioriste nuk mund të përshkruhen, dhe, aq më pak të shpjegohen shumë dukuri, procese, struktura, funksione, tipare psikike dhe forma të sjelljeve. Për këtë arsye është gati e pamundur të vihet kufi kohor ndarës ndërmjet fazave zhvillimore të përmendura. Bihejviorizmi në terminologji ka krijuar vështirësi dhe pengesa në të kuptuarit e proceseve psikike dhe të sjelljeve. Terminologjia shqipe e psikologjisë deri nga vitet e fundit të shekullit të njëzet ka qenë pak e ndikuar nga burimet bihejvioriste.

TERMINOLOGJIA SHQIPE E PSIKOLOGJISË. Në shkrimet e para shqipe ka mjaft fjalë të jetës shpirtërore. Disa nga këto u ngritën ndërkohë në terma, por kjo i përket zhvillimeve gjuhësore dhe shkencore të mëvonshme. Mendimtari dhe klerikU shqiptar Pjetër Bogdani (1625 – 1689) është ndër kontribuesit e parë

të zhvillimit të terminologjisë shqipe të psikologjisë. Në pikëpamjen e tij religjioze për gjithësinë e kësaj dhe të asaj bote ai dalloi trinitetin e shpirtit (psyche), të mendjes (mous) dhe njëshin (to hen). Po ashtu, edhe në shkrimet e vjetra të Buzukut ka fjalë të jetës shpirtërore. Por, terminologjia e psikologjisë nuk zhvillohet vetëm nga zhvillimi i gjuhës dhe as që mund të zhvillohet vetvetiu. Orvatjet e para të përcaktimit dhe të studimit të terminologjisë së psikologjisë i hasim në vepra të gjuhëtarit Aleksandër Xhuvani, që nga vitet `30 të shekullit të njëzet. Fjalorthi i tij është dokument i parë i terminologjisë shqipe të psikologjisë. Ky është fjalorth dygjuhësh. Më pas terma psikologjikë hasim edhe në disa fjalorë të shkencave natyrore (të fiziologjisë) dhe në disa fjalorë të shkencave shoqërore (të religjionit, të filozofisë dhe të pedagogjisë). Ndër mbi 30 fjalorë të botuar nga sektori i terminologjisë i Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë në Tiranë nuk dallohet ndonjë interesim dhe orvatje e posaçme për hartimin e një fjalori të psikologjisë. Udhëzuesi për hartimin e fjalorëve tekniko – shkencorë, si dhe një varg fjalorësh të tillë kanë ndikuar pozitivisht në përgatitjen e studiuesve që kanë menduar për hartimin e një fjalori të psikologjisë. Më 1985 u botua në Prishtinë vepra terminologjike "Fjalor i Psikologjisë" nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, kurse më 2010 u botua në Tiranë vepra tjetër terminologjike me titull "Fjalor i Psikologjisë". Por, këta fjalorë u botuan relativisht vonë përballë kërkesave praktike dhe teorike të shqipfolësve, nevojave arsimore dhe përkundrejt fjalorëve të disa shkencave natyrore e teknike. Këta fjalorë u botuan atëherë, kur në gjuhët e zhvilluara ishin botuar leksikonë, fjalorë enciklopedikë të psikologjisë dhe enciklopedi psikologjike.

Burimet:

Alan E. Kazdin: *"Encyclopedia of Psychology"* – (*"Enciklopedia e psikologjisë"*), Oxford University Press, 2000.

Rom Harre and Roger Lamp: *"The Enciklopedic Dictionary of Psychology"* – (*"Fjalor enciklopedik i psikologjisë"*), 1998.

Raymond J. Corsini & Alan J. Auerbach*: "Concise Encyclopedia of Psychology"* – (*"Enciklopedi e përmbledhur e psikologjisë"*), New York, Chichester, Weinheim, Brisbane, Singapore, Toronto, 1998.

Aleksandër Xhuvani: *"Fillime të pedagogjisë. Pjesa e parë. Psikologji e shtime në punë t` edukatës për shkollat normale e për mësuesit e fillorevet"*, Shtëpia Botonjëse "Luarasi", Tiranë 1933.

Pjetër Bogdani: *"Çeta e Profetëve I"*, Rilindja, Prishtinë, 1990.

Pjetër Bogdani: *"Çeta e Profetëve 2", (Jeta e Jezu Krishtit),* "Drita", Prizren, 1997.

Ibrahim Rugova: *"Vepra e Bogdanit, 1675 – 1685"*, Rilindja, Prishtinë, 1982.

Nuri Abdiu: *"Aspekti psikologjik i terminologjisë së Bogdanit"*, Buletini Shkencor i Shkodrës nr. 1, 1973.

Pajazit Nushi: *"Zhvillimi i terminologjisë psikologjike dhe baza semantike e përcaktimit të saj në gjuhën shqipe"* (në dorëshkrim), Prishtinë, 1983.

TERMOMET/ËR, - RI. m. Aparat për të regjistruar, matur dhe vlerësuar intensitetin e dridhjeve të duarve, saktësisht të muskujve të shuplakës së dorës dhe të gishtërinjve të dorës së djathtë ose të majtë, me rastin e ekzekutimit të lëvizjeve të mprehta e të sakta gjatë operacioneve të ndërlikuara të procesit të punës. Përdoret zakonisht për nevoja të orientimit dhe të përzgjedhjes profesionale të atyre kandidatëve që do të punësohen në vende

pune ku kërkohet saktësi e lëvizjeve të dorës dhe të gishtërinjve. Termometri zbatohet duke i dhënë detyrë subjektit me majën e mprehtë të një dorëze të bëjë shpime në letër, duke mos prekur fare skajet e saj. Nëse këto preken, atëherë mbyllet qarku elektrik dhe maten gabimet e tilla të shkaktuara nga çrregullimet e veprimeve të vullnetshme të subjektit.

TERMORECEPTOR, - I. m. Qeliza të posaçme të organizmit që kryejnë funksionin e shndërrimit të energjisë termike të jashtme në shqetësim, përkatësisht në impulse nervore që barten deri në qendrën e caktuar të cipës së trurit të madh, ku shkaktohet ndijimi i të ftohtit, të ngrohtit dhe të nxehtit. Këta gjenden në lëkurën e njeriut dhe, për të ftohtit receptorët janë të vendosur në shtresën e jashtme të lëkurës, kurse për nxehtësi këta gjenden në shtresën e brendshme të saj. Psikologjia fiziologjike ende nuk ka vërtetuar se a janë këta receptorë mbaresa nervore, apo gjenden edhe qeliza të tjera receptore.

TERMORREGULLUES – I. m. Rregullim i vetvetishëm i temperaturës së organizmit. Është një mekanizëm, apo tërësi procesesh që funksionon për mbajtjen e temperaturës konstante të organizmit, pavarësisht nga ndryshimet e jashtme të temperaturës. Është karakteristik për kafshët homeotermike. Nëse temperatura e jashtme bie shumë nën temperaturën normale të organizmit (nën 32 gradë Celsius), atëherë bëhet mekanikisht ngushtimi i enëve periferike të gjakut, qarkullimi i shpejtuar i gjakut, dridhja etj., duke mos lejuar harxhimin e shpejtë të temperaturës së mëvetësishme të organizmit. Nëse ngrihet temperatura e jashtme, atëherë ndodh e kundërta e funksionimit të këtij mekanizmi, përkatësisht përshpejtohet marrja e frymës, rritet shkalla e djersitjes së organizmit, ngadalësohet ritmi i qarkullimit të gjakut etj. Bartëse e rregullimit të tillë të temperaturës është pjesa ballore apo frontale e hipotalamusit.

TERMOTROPIZ/ËM, - MI. m. Reagim i mëvetësishëm automatik i organizmave të thjeshtë ndaj energjisë termike dhe burimit të saj. Kemi të bëjmë me termotropizëm pozitiv, kur organizmi i tyre ndaj ngacmuesve të nxehtë reagon mekanikisht, duke u kthyer në drejtim të ngacmuesit dhe kemi të bëjmë me termotropizëm negativ, kur organizmi i tyre ndaj ngacmuesve të ftohtë reagon mekanikisht, duke u kthyer në drejtim të kundërt të ngacmuesit.

TERROR, - I. m. Futje e frikës, e tmerrit te anëtarët e një etnie, grupi politik e social etj. Terrori kryhet me anë të ushtrimit të dhunës te anëtarët e etnisë tjetër, sektit fetar, partisë politike tjetër etj., me qëllim të realizimit të synimeve negative politike, ekonomike, fetare etj. Terrori gjithmonë prodhon frikë, lind nga frika dhe e shfrytëzon frikën e kërcënimin për arritjen e synimeve që ka terroristi, apo terroristët. Rezultatet e disa gjurmimeve të sjelljeve të të burgosurve politikë, të vendosur në kampe përqendrimesh, kanë treguar se këta kanë përjetim të terrorit edhe shumë kohë pas daljes nga burgu dhe nga terrori.

TERRORIZ/ËM, - MI. m. Dukuria e zbatimit sistematik të dhunës, të fuqisë fizike dhe të masave të

tjera nënshtruese me qëllim që, duke shkaktuar frikë e tmerr te të tjerët, t`i nënshtrojë dhe t`i sundojë. Dhuna dhe fuqia fizike e psikike kundër të tjerëve arrin deri në zhdukjen fizike të kundërshtarit të një sistemi të caktuar politik dhe të raporteve shoqërore dhe ekonomike përkatëse. Terrorizmi mund të ushtrohet edhe me anë të luftës politike terroriste individuale.

TEST, - I. m. I ardhur nga latinishtja *testor* "dëshmoj", anglisht *test* "provë". Term i disiplinave teknike, mjekësore, i biokimisë, i psikologjisë etj. Në të gjitha këto disiplina testi është prova, me të cilën vërtetohet, matet dhe vlerësohet funksioni i një strukture, shkalla e zhvillimit dhe cilësia e saj. Kështu, në ndërtimtari me anë të testit matet dhe vlerësohet struktura dhe cilësia e një lënde ndërtuese, e një objekti. Kështu, testohet ura d.m.th. ura e përfunduar provohet a është në gjendje ta mbajë peshën për të cilën është projektuar dhe është ndërtuar. Në psikologji testi është "procedurë e standardizuar me të cilën nxitet një veprimtari e caktuar; më pas efekti i asaj veprimtarie matet dhe vlerësohet në mënyrë që rezultati individual të krahasohet me rezultatet e individëve të tjerë që kanë arritur në të njëjtën situatë". Një test i tillë është hartuar për dy qëllime: 1) Njohjen e zotërimit të vetisë, të tiparit, të funksionit të një strukture psikike të caktuar dhe shkallën e zhvillimit të saj te njeriu (diagnoza) dhe 2) Në bazë të arritjeve në testin e caktuar parashihet suksesi në veprimtari praktike nga ana e të testuarit. Testi përbëhet nga sistemi i pyetjeve, i detyrave, i problemave etj. që duhen zgjidhur nga ana e subjekteve. Rezultati i përgjithshëm i arritur në zgjidhjen e tyre matet me numrin e përgjithshëm të zgjidhjeve pozitive.

TESTET ANTONIMIKE. Lloj i testit fjalësor ose verbal, ku kërkohet nga i testuari të gjejë antonimin, përkatësisht mbiemrin me kuptim të kundërt nga ai i parashtruari, si: i keq...?, i shpejtë...?, introvert...? etj. I ngjashëm me këtë lloj testi është edhe testi i sinonimeve, ku i testuari ka për detyrë të gjejë fjalën me kuptim të njëjtë, por me artikulim dhe me shkrim të një forme tjetër.

TESTET EMOCIONALE. Teste me anën e të cilëve përcaktohet mënyra e reagimit emocional të individit, përballimi i emocioneve intensive dhe zotërimi i gjendjeve emocionale. Testet emocionale kanë pyetje dhe detyra, me përgjigjet dhe zgjidhjet e të cilave përcaktohet aftësia e njeriut për të dalluar emocionet dhe gjendjet emocionale të veta, aftësia e përshtatjes së njeriut ndaj gjendjeve të caktuara emocionale, aftësia e motivimit emocional, njohja e gjendjeve emocionale të të tjerëve dhe aftësia e komunikimit emocional të këndshëm në aktivitetin e përbashkët me të tjerët.

TESTET ME DETYRA ALTERNATIVE. Testet që krahas pyetjeve dhe detyrave kanë edhe përgjigje të dhëna në dy ose tri mënyra, kurse nga i testuari kërkohet të përcaktohet cila prej përgjigjeve të dhëna është e saktë. Tip i këtyre detyrave testore është: "Familjari më i afërt i vëllait është: daja, gjyshi, motra; Bukuria e rinisë është: veshja, pranvera, lulet; Disiplinë e shkencës humanitare është: etnologjia, antropologjia, sociologjia. - Nënvizo përgjigjen e saktë".

TESTET ME DETYRA ANALOGJIKE. Teste që hartohen me qëllim të matjes së inteligjencës së përgjithshme dhe përbëhen prej detyrave dhe problemave që në përmbajtje të tyre kanë dy a tri komponente të ngjashme dhe kërkohet komponentja e tretë ose e katërt. Tip i detyrave të tilla është: ujku : dhinë = tigri : ? (me delen); 5 : 3 = 9 : ? (me 7); shkolla : ? (me drejtorin) = fakulteti : ? (me dekanin) etj.

TESTET ME FJALI TË MANGËTA. Teste detyrash me fjali të mangëta. Nga subjekti kërkohet t`i plotësojnë fjalitë me mangësi fjalësh në fillim të fjalisë, në mes ose në fund të fjalisë dhe në vend të fillimit të zbrazët të fjalisë të gjejë dhe ta shkruajë fjalën e drejtë logjike dhe sipas gramatikës. Këto lloj fjalish formojnë ato detyra testore, që i përkasin nëntestit fjalësor ose verbal për matjen e inteligjencës.

TESTET SEASHOR. Teste për gjurmimin e shkallës së zhvillimit të aftësisë së dëgjimit, përkatësisht të aftësisë së muzikës. Testet Seashor përbëhen nga gjashtë teste tingujsh dhe gruptingujsh me ritme, lartësi, me kohëzgjatje të ndryshme, si edhe me ngjyrë tonaliteti të shumëllojshme, të incizuara në pllaka gramafoni. Nga subjekti kërkohet të bëjë dallimin e pragut të ndjeshmërisë diferenciale dhe të riprodhojë tërësi tingujsh të veçantë, me qëllim të të provuarit të kujtesës muzikore. Hartuesi i këtyre testeve është psikologu amerikan Karl E. Seashor (Carl E. Seashore, 1866 – 1949).

TESTI ALFA E BETA. Lloj testi i përgjithshëm për matjen dhe vlerësimin e inteligjencës dhe zhvillimit të saj. Është seri nëntestesh e përbërë nga tetë teste të tillë. U hartua për qëllime ushtarake, përkatësisht për përzgjedhjen e rekrutëve për njësitë e armatosura amerikane të Luftës I Botërore. Seria e testeve alfa i dedikohet vlerësimit të inteligjencës fjalësore apo verbale të ushtarëve, njohës të mirë të gjuhës angleze, kurse seria beta i dedikohet ushtarëve - qytetarë të SHBA, emigrantëve, njohës të mirë të gjuhës së tyre amtare, por jo njohës të mirë edhe të gjuhës angleze dhe sistemit të grafisë angleze. Me këto teste vlerësohet shpejtësia e të kuptuarit të urdhrave dhe të realizimit të tyre. Më vonë është përshtatur edhe për nevoja joushtarake.

TESTI ANALOGJIK. Test i përbërë nga detyrat e problemat, zgjidhja e të cilëve mbështet në ngjashmërinë ndërmjet dy a tri komponentëve, si p.sh., a : b = ?(c) : d; nëse shkronja O është zanore e ngjashme me shqiptimin e shkronjës u, atëherë edhe shkronja u është e ngjashme me shqiptimin e ? (të shkronjës e), sepse o, u, e janë zanore; nxënësi x mëson sistematikisht dhe arrin rezultate të shkëlqyera, kurse nxënësi y arrin rezultate të ulëta, sepse ? etj. Në psikologjinë kognitive, si edhe në logjikë, analogjitë duhen zbatuar me kujdes të posaçëm, madje është më mirë të konsiderohet si hipotezë se sa si argumentim.

TESTI ASOCIUES. Test përmbledhës për procedurat dhe teknikat klinike dhe eksperimentuese. Testi asociativ zakonisht është test i fjalëve shoqëruese, ku subjekti ka për detyrë që në fjalën e dhënë nga ana e psikoterapistit, përkatësisht nga eksperimentuesi, të përgjigjet me fjalën e parë që

i bie në mend, duke matur saktësisht kohën prej çastit të fjalës së dhënë deri në çastin e marrjes së përgjigjes, pikërisht të fjalës së parë që i bie në mend. Në studimet e ndërlikuara eksperimentale matet jo vetëm koha reaguese ndaj fjalës së dhënë, por identifikohen edhe ndryshimet psikogalvane të lëkurës. Kjo formë u zbatua më tepër me qëllim të diagnostikimit të disa çrregullimeve psikike. Për këtë qëllim testin asociues të fjalëve e zbatoi psikiatri gjerman Emil Krepelin (Emil Kraepelin, 1856 – 1926). Termi test asociues i fjalëve u përdor për herë të parë nga shkencëtari dhe matematikani Francis Golton (Francis Golton, 1822 – 1911),kurse më vonë këtë e zbatoi edhe studiuesi gjerman Vilhelm Vunti (Wilhelm Wundt, 1832 – 1920). Studiuesi zviceran Karl G. Jung (Carl G. Jung, 1875 – 1961) me anën e testit asociues të fjalëve provoi saktësisht komplekset psikike të njeriut, e konkretisht, në rast se subjekti, në fjalën e dhënë "babai" humb më tepër kohë se në fjalët e tjera, madje jep një fjalë përgjegjëse të çuditshme ndaj fjalës babai, atëherë (përfundoi ai) subjekti vuan nga kompleksi i babait.

Burimet:

Ernon Gregg: *"Human Memory"* – (Kujtesa njerëzore"), Methuen, London, 1976.
Robert S. Woodworth: *Eksperimental Psychology"* – ("*Psikologjia eksperimentale*"), 1938.
Pajazit Nushi: *"Kujtesa dhe trajtimi i saj në literaturën shqipe nomotike"*, Prishtinë, 2008.
Herman von Ebbinghaus*: "Über das Gedächtnis*" – ("*Mbi kujtesën*"), Leipzig, 1885.
Predrag Zarevski: *"Psihologija pamćenja i učenja"* – (*"Psikologjia e kujtesës dhe e të mësuarit")*, Jastrebarsko, 1997.

TESTI BARANI. Aparat provues i funksionimit të kanaleve gjysmëharkore të vestibulumit. Individi ulet në një karrige, e cila në objektin rrotullues sillet dy herë në sekondë brenda 20 sekondave. Në këtë mënyrë arrihet që secili nga kanalet gjysmëharkorë të arrijë në pozicionin e këndit të drejtë në raport me rrotullimin e objektit dhe të karriges brenda tij. Të provuarit e këtillë të funksionimit të aparatit vestibular ka rëndësi të madhe për disa profesione, sidomos për pilotim avionësh dhe lundrim anijesh. Ky test u zbatua për herë të parë nga mjeku austriak Robert Barani (Robert Barany, 1876 – 1936).

TESTI BENDER–GESHTALT. Test i karakterit të testit projektues, por që u tregua efektiv edhe në zbulimin e lëndimeve organike të trurit dhe të pasojave të tyre. U hartua në bazë të parimeve të psikologjisë geshtaltiste dhe përbëhet nga shtatë – nëntë figura. Zbatohet sipas kësaj procedure: nga pamjet e vizatuara subjekti duhet t`i vizatojë këto figura në fletën e tij të vizatimit sipas modelit të paraqitur. Shmangiet e paraqitura në kryerjen e kësaj detyre duhet të sugjerojnë çrregullime funksionale dhe organike të sjelljeve. Testi Bender – Geshtalt u hartua nga neurologia dhe psikiatria amerikane Loreta Bender (Lauretta Bender, 1897 – 1987)**.**

TESTI BENET I AFTËSIVE MEKANIKE. Lloj i posaçëm testi, me anën e të cilit provohet prania e inteligjencës mekanike, e aftësive mekanike të njeriut dhe shkalla e zhvillimit të tyre. Testi ka formën e testeve lapës – fletë shkrimi. Përbëhet nga 60 detyra e problema figurative praktike të karakterit

mekanik. Këto detyra e problema kërkojnë një shkallë të caktuar dijesh nga fizika, e pikërisht njohje të ligjeve dhe parimeve të mekanikës. Detyra e subjektit është zgjidhja e problemeve dhe e detyrave në bazë të njohjes dhe zbatimit të drejtë të ligjeve dhe parimeve të mekanikës. Testi u hartua nga psikologu amerikan Xhorxh K. Benet (George K. Benet, 1904).

TESTI BENTON. Test për gjurmimin e kujtesës pamore të drejtpërdrejtë. Përbëhet nga tri kategori vizatimesh të ngjashme; secila nga këto kategori përmban nga dhjetë vizatime. Detyra e subjektit është: Pas vështrimit prej disa sekondash të secilit vizatim, vizatimi i ekspozuar largohet dhe subjekti ka për detyrë të vizatojë të njëjtën figurë në fletën e tij të vizatimit. Pas përfundimit maten elementet e saktë dhe ata të gabuar dhe në bazë të tyre vlerësohet shkalla e zhvillimit të kujtesës pamore. Testi Benton shfrytëzohet për diagnostikimin e dëmtimeve organike të trurit, përkatësisht të disa qendrave të cipës së trurit të madh. Testi u hartua nga neuropsikologu amerikan Artur I. Benton (Arthur I. Benton, 1900).

TESTI BETA. Test jofjalësor ose joverbal për matjen e zhvillimit të inteligjencës. U hartua dhe u zbatua për përzgjedhjen e ushtarëve për nevoja të armatës së SHBA. U zbatua për ushtarët analfabet ë dhe njohës të pakët të gjuhës angleze.

TESTI BOURDON. Test klasik i vëmendjes dhe i hulumtimit të veçorive të vëmendjes. Konsiderohet se provon përqendrimin e vëmendjes. Përbëhet prej vargje shkronjash të mëdha nga të cilat i testuari ka për detyrë t`i konstatojë dhe të nënvizojë me shpejtësi sa më të madhe dy shkronja të caktuara. Në bazë të numrit të gabimeve vlerësohet luhatja, qëndrueshmëria dhe shpejtësia e lëvizjes së vëmendjes. Testi u hartua nga psikologu francez Bourdon. I ngjashëm me këtë test është edhe testi i Henri Pieronit dhe i Tulusit. Ndryshon nga ai i Bourdonit, sepse në vend të shkronjave subjekti që testohet duhet të konstatojë sa më shpejt dy shenjat e caktuara.

TESTI BYLER – HECER. Sistem detyrash dhe problemesh të standardizuara me kryerjen dhe zgjidhjen e të cilave provohet dhe vlerësohet shkalla e zhvillimit të lëvizjeve, të shqisave, të vëzhgimit, të kuptimit të lidhjeve ndërmjet të dhënave shqisore, të kontakteve shoqërore etj. të fëmijëve prej moshës njëmujore deri në moshën gjashtëvjeçare. Ka mënyrë të posaçme të llogaritjes së raportit ndërmjet rezultatit të përgjithshëm të arritur në kryerjen e detyrave të këtij testi dhe moshës kalendarike të fëmijës. Është i njohur edhe me emërtimin testi zhvillimor. U hartua nga ana e psikologes gjermane Sharlota Byler (Charlotte Buhler, 1893 – 19 74) dhe bashkëpunëtores Hilerda Hecer.

TESTI DIAGNOSTIK. Test i hartuar nga detyrat dhe pyetjet e përzgjedhura me kujdes, me anën e të cilave synohet zbulimi dhe identifikimi i saktë i natyrës së një pengese psikike në aktivitetin e përditshëm. I tillë mund të jetë testi i identifikimit të pengesave dhe të shkaqeve të një nxënësi në pamundësinë e mësimit të përmbajtjes së një lënde mësimore, p.sh., të matematikës. Shkaqet e mbarëvajtjes së ulët të nxënësve mund të jenë ndër më të ndryshmet,

por këto kanë gjithmonë karakter individual: te njëri mund të jetë shkak dija e pamjaftueshme paraprake për të zotëruar pjesë të programit të lidhura me ato dije, te tjetri mungesa e aftësisë në matematikë, moszbatimi i metodave të përshtatshme dhe efikase për mësimin e përmbajtjes së asaj lënde etj. Testi diagnostik ose diagnostikues ka për qëllim kryesor identifikimin e burimit të shkakut ose shkaqeve të ngadalësimit zhvillimor të një procesi, veprimtarie etj.

TESTI FUQIMOR. Test provues i fuqisë së aftësive, me anë të të cilit matet shkalla e zhvillimit të fuqisë së një aftësie, në bazë të sasisë dhe shpejtësisë së zgjidhjes së detyrave dhe problemave të niveleve të ndryshme të ndërlikueshmërisë.

T

TESTI GOJOR. Sistem detyrash, problemesh dhe pyetjesh të parashtruara për t'u zgjidhur në mënyrë gojore, në të cilat kërkohet që i testuari të përgjigjet në të njëjtën mënyrë.

TESTI I AFTËSIVE. Test i formuar nga sistemi i detyrave dhe problemeve. Me anën e kryerjes së detyrave dhe zgjidhjes së problemeve të këtij sistemi të standardizuar matet dhe vlerësohet cilësia, shkalla e zhvillimit të një aftësie mendore apo intelektuale, psikomotorike dhe sensorike. Dallohen edhe disa tipa testesh të tjerë për matjen dhe vlerësimin e potencialit të aftësive që zotëron individi, si: testi i përgjithshëm, testi i specializuar dhe testi multipël. Testi i përgjithshëm mat dhe vlerëson inteligjencën dhe shkallën e zhvillimit të saj te një individ i caktuar. Testi i aftësive të specializuara mat dhe vlerëson një aftësi të veçantë, siç është aftësia muzikore, mekanike, numerike etj. Testi multipël është një bateri testesh dhe nëntestesh të cilët masin disa aftësi. Këto teste janë me kohë të pacaktuar për kryerjen e detyrave dhe për zgjidhjen e problemave, sepse këtu matet dhe vlerësohet cilësia e një aftësie e jo koha e duhur për zgjidhjen e problemeve apo të situatave problemore.

TESTI I AFTËSIVE MEKANIKE. Test që provon aftësinë e të kuptuarit të parimeve dhe të ligjeve mekanike në zgjidhjen e problemave dhe detyrave praktike. Zbatohet në këshillimin dhe përzgjedhjen profesionale. Në rastet e thjeshta testi përbëhet prej detyrave të thjeshta dhe praktike; paraqiten të vizatuar dy shula të dhëmbëzuar dhe njëri është dy herë më i madh se tjetri, kuse subjeti ka për detyrë të tregojë si e kupton dhe si e shpjegon raportin ndërmjet lëvizjeve të tyre.

TESTI I ARRITSHMËRISË. Test që mat arritjet e një subjekti në zotërimin e programit të një lënde mësimore, të një grupi lëndësh mësimore, ose përgjithësisht arritjet në zotërimin e programit mësimor të një shkalle të caktuar shkollimi, si, p.sh., testi i arritjeve pas përfundimit të shkollimit fillor. Përbëhet nga pyetjet, detyrat dhe problemat që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me programin e një lënde mësimore që testohet. Quhen edhe teste didaktike.

TESTI I FISHERIT. Test i statistikanit dhe gjenetistit anglez Arnold A. Fisher (Arnold A. Fisher, 1890 – 1962). Është herës i vlerës përfundimtare, në bazë të të cilit hulumtuesi merr vendim për hipotezën e parashtruar dhe statusin e saj (pranimin apo refuzimin e hipotezës). Testi Fisher provon vlerën e dallimit të ndryshores

ndërmjet dy mostrave. Rezultatet e ndryshores së madhe pjesëtohen me rezultatet e ndryshores së vogël dhe rezultati i përftuar lexohet në tabelën F, cilës vlerë të besueshmërisë i takon dhe në këtë mënyrë përcaktohet vlera e besueshmërisë së rezultatit të arritur. Në bazë të kësaj vlere merret vendimi i pohimit ose i mohimit të hipotezës së parashtruar.

TESTI I FRUSTRIMIT ROZENCVAJG. Formë e testit projektiv që përbëhet nga një varg figurash ku shihen dy individë në një situatë frustruese. Nga subjekti kërkohet të shpjegojë çfarë do të kishte thënë subjekti i frustruar. Në bazë të përgjigjeve të këtij subjekti vlerësohet mbizotërimi i pengesave, mbisundimi i egos së atij subjekti në zotërimin e pengesave dhe intensiteti i përjetimit të gjendjes frustruese te subjekti i caktuar etj. Testi mori emrin e hartuesit, psikologut amerikan Sol Rozencvajg (Saul Rosenzweig, 1907–).

TESTI I INTELIGJENCËS. Procedurë hulumtuese e matjes së shkallës së zhvillimit të inteligjencës të një individi ose të shumë individëve. Testi i inteligjencës përbëhet prej sistemit të detyrave, të pyetjeve dhe të problemave të shumëllojshëm që janë të standardizuara dhe të sistemuara sipas gradimit të shkallës së ndërlikimit dhe të vështirësive të tyre. Testi i inteligjencës është "procedurë e standardizuar me të cilin nxitet një veprimtari e caktuar e individit; më pas efekti i asaj veprimtarie matet dhe vlerësohet në mënyrë të tillë që rezultati i atij individi të krahasohet me rezultatet e të tjerëve që kanë arritur në një situatë të njëjtë". Numri i kryerjes me sukses të detyrave testore, i dhënies së përgjigjeve të sakta dhe i zgjidhjes së drejtë të problemeve testore mblidhet dhe si i tillë përbën rezultatin e përgjithshëm (rezultatin bruto), që më pas shndërrohet në një vlerë të normuar, siç është koeficienti i inteligjencës. Zbatimi i testit të inteligjencës ka për qëllim përcaktimin e shkallës së zhvillimit të inteligjencës te një individ i caktuar.

TESTI I KODUAR. Test i përbërë nga detyrat e posaçme, ku kërkohet shndërrimi i një sistemi shenjash në një sistem tjetër shenjash. I tillë është sistemi i shndërrimit të shkronjave në numra: nëse për shkronjën m është përcaktuar numri 7, për shkronjën o numri 9, për ll numri 5 dhe për shkronjën a është përcaktuar numri 10, atëherë numri 79510 në test duhet shndërruar në fjalën "molla".

TESTI I MANIPULIMIT. Test me anën e të cilit matet dhe vlerësohet shkalla e kryerjes së saktë të një shkathtësie dhe shprehie. Testet e këtilla zakonisht janë aparate të veçanta me anën e të cilëve maten dhe vlerësohen veprimet e thjeshta dhe të ndërlikuara motorike. Test i këtillë mund të jetë zbërthimi i një figure në pjesët e saj, ndarja e pjesëve të një arme (e pushkës) në pjesët përbërëse, ngasja e automobilit etj.

TESTI I SHPEJTËSISË. Testi me anën e të cilit matet dhe vlerësohet shpejtësia e kryerjes së detyrave, e zgjidhjes së problemave, e numrit sa më të madh të lëvizjeve të kryera brenda një kohe të caktuar që më parë. Testi i këtillë zbatohet me rastin e përzgjedhjes së kandidatëve sa më të shkathët, në shpejtësinë e tyre për kryer-

jen e detyrave të disa profesioneve të veçanta, ku krahas shkallës së zhvilluar të inteligjencës, të nivelit të duhur arsimor etj. nevojitet edhe shpejtësia e gishtërinjve, e duarve, e këmbëve etj. Të këtilla janë profesionet: piloti, sportisti i aftë për atletikë, basketboll etj.

TESTI I VIGOTSKIT. Test që përbëhet nga 32 figura drurësh në formën e paralelogramit. Këto figura dallohen sipas formës, lartësisë, gjerësisë dhe ngjyrës së tyre. Në hapësirën e poshtme të secilës figurë është shkruar një rrokje. Në këtë test ekzistojnë katër rrokje, katër fjalë të pakuptimta dhe një fjalë e tillë për të gjitha figurat e larta dhe të gjera, një fjalë e tillë (e pakuptimtë) për figurat e ulëta dhe të ngushta. Këto janë elementet kryesore, kurse ngjyra dhe forma e këtyre figurave nuk janë elemente kryesore. Subjekteve mund t`u jepen detyra të ndryshme, që vetëm duke kombinuar lartësinë, gjerësinë, ngushtësinë e figurave etj. mund të gjejnë përgjigjen e saktë. Zakonisht përdoren për studimin dhe zhvillimin e mendimit dhe të shkallës së zhvillimit të tij te fëmijët. U hartua nga psikologu rus Lav S. Vigotski (Lev S. Vygotsky, 1896 – 1934).

TESTI INDIVIDUAL. Test që i jepet vetëm një individi që testohet në kushte të njëjta, por i izoluar nga të tjerët. Testi individual i jepet një individi me qëllim testimin, diagnostikimin e saktë të tipareve të personalitetit që mat ai test. I njëjti test mund të zbatohet edhe te të tjerët, por të tjerëve mund t'u jepet në formë organizimi të veçantë, ku, në mënyrë të pavarur secili zgjidh detyrat e atij testi. Testi individual ka përparësi ndaj atij kolektiv, sepse testuesi hyn në raport të drejtpërdrejt me të testuarin, testuesi dallon më afër mënyrën e zgjidhjes së detyrave testore, por ky lloj testi kërkon kohë të gjatë dhe është i mundimshëm e jo aq ekonomik.

TESTI INFANTIL. Test diagnostikues i nivelit të zhvillimit psikik të foshnjës. Testi infantil më i njohur është testi i psikologut amerikan Najnsi Bejl (Nancy Bayley, 1899 – 1995), i cili që nga viti 1924 hartoi shkallën e matjes së zhvillimit mendor të foshnjës. Por, zakonisht, kjo shkallë diagnostikon gjendjen psikike të foshnjës dhe nuk ka arritur të përsoset për të parashikuar edhe zhvillimin e mëvonshëm psikik.

TESTI KENT – ROZANOV. Test i asociacioneve të lira, i hartuar nga psikologët amerikanë Grace H. Kent, (Grace H. Kent, 1875 - 1973) dhe Aron J. Rozanov, 1878 – 1943). Ky test ka për qëllim vlerësimin e përfytyrimeve dhe të strukturës së mendimit. Testi përbëhet prej 100 fjalëve standarde të zakonshme dhe ndaj secilës prej tyre subjekti përgjigjet me fjalën e parë që i bie në mend. Në bazë të normave të caktuara nga masa e madhe e subjekteve, përcaktohet konformiteti dhe origjinaliteti i përgjigjeve, pjesëmarrja e përfytyrimeve dhe e ideve në përcaktimin e fjalës së parë, fjalës përgjigje, që i bie në mend subjektit të caktuar.

TESTI KOHRAN Q. Test statistikor joparametrik që shërben për dallimin e rëndësisë statistikore të shpeshtësisë së dy a më shumë grupe të dhënash, ose të proporcioneve që kanë të dhënat e këtilla.

TESTI KRUSHKALL – VOLIS. Test i statistikës joparametrike që ka të

bëjë me analizën e ndryshores, duke shfrytëzuar ranxhimin e ndryshimeve vetëm të një ndryshoreje. Ky test ka nivel të lartë të ndjeshmërisë dhe këtu qëndron përparësia e tij. U quajt testi Krushkall – Volis sipas hartuesve të tij: psikologut amerikan, Uiljam H. Krushkall (William H. Krushkall, 1919 –) dhe ekonomistit e statisticienit amerikan Alen V. Volis (Allen W. Wallis, 1912 –).

TESTI KULTUROR I PAANSHËM. Test provues i një ndryshoreje psikologjike të çliruar nga ndikimet e shumëllojshme kulturore të një mjedisi të caktuar, prej nga kanë ardhur subjektet që provohen. Testet e tilla zakonisht janë teste joverbale, ku përjashtohen detyrat e problemat që kanë të bëjnë me dijet për mjedisin, me zakonet, shprehitë etj., të cilat mund të ndikojnë në përgjigjen e drejtë të detyrave, përkatësisht në zgjidhjen e drejtë të problemave të parashtruara në një test të caktuar. Testi i tillë është testi i inteligjencës, ku matet aftësia e zgjidhjes së drejtë dhe të shpejtë të problemave testore.

TESTI MANIPULUES. Test provues me anën e të cilit gjurmohet shkathtësia e duarve, e gishtërinjve dhe në raste të veçanta edhe shkathtësia e këmbëve për të vepruar lehtë e shpejt me aparate mekanikë. Testi manipulues mund të ketë edhe formën e formësimit të trupave të formave të ndryshme (me plastelinë, me rërë të qullët etj.), ku matet shpejtësia, lehtësia dhe koordinimi i lëvizjeve të duarve dhe i gishtërinjve në krijimin e figurave të trupave të ndryshëm. Ka lloje të ndryshme testesh manipuluese, që shfrytëzohen posaçërisht në këshillimoret profesionale.

TESTI ME DETYRA KLASIFIKUESE. Testi me detyra klasifikuese përbëhet prej atyre detyrave, të cilat kanë të bëjnë me të provuarit e aftësisë së subjekteve për ndarjen e nocioneve në klasa të veçanta. E tillë mund të jetë detyra: "Ndaj figurat e rreshtuara në figura gjeometrike dhe në figura të trupave gjeometrikë".

TESTI MINESOTO I AFTËSIVE MEKANIKE. Test që provon te subjektet aftësinë e përfytyrimeve hapësinore, të ashtuquajtur faktorë special. Testi është formuar nga pjesët e këputura dhe të larguara nga tërësia e tyre, kurse subjekti ka për detyrë që t`i gjejë sa më shpejt këto pjesë dhe t`i vendosë në vendet e zbrazura të asaj tërësie.

TESTI OBJEKTIV. Një ndër veçoritë metrike të testit, që sot pranohet si aspekt i besueshmërisë së një testi. Ai karakterizon pavarësinë e rezultateve të përftuara nga ata që e zbatojnë testin e caktuar dhe arrihet me përcaktimin e saktë të kushteve të zbatimit të një testi, të mënyrës së matjes të rezultateve, të vlerësimit dhe interpretimit të njëjtë të atyre rezultateve nga vlerësuesit e ndryshëm. Objektiviteti i testit përcaktohet me bashkëlidhjen e rezultateve të përftuara nga zbatimi i të njëjtit test nga ana e vlerësuesve të ndryshëm; sa më e lartë të jetë shkalla e bashkëlidhjes, aq më objektiv është testi.

TESTI OMNIBUS. Test përmbledhës i formuar nga tri ose më shumë grupe testesh, që kanë një raport statistikor të rëndësishëm ndërmjet tyre. Testi omnibus përmban disa nënteste, me anën e të cilëve provohen faktorët e

ndryshëm psikologjikë dhe niveli i funksionimit të tyre, të tillë si: testet e dijeve, të aftësive, të personalitetit etj. Nga zgjidhja e suksesshme dhe përgjigjet pozitive të detyrave dhe pyetjeve të shumëllojshme të këtyre testeve përftohet shkalla e përgjithshme e zotërimit të dijeve, ose e zhvillimit të aftësive të një individi. Testi omnibus mund të jetë testi i kulturës së përgjithshme të një individi, te i cili provohet dija e tij nga gjuha amtare, gjuha e huaj, filozofia, historia, letërsia, matematika, piktura, sporti etj.

TESTI PEDAGOGJIK. Sistem detyrash e problemesh të hartuara për vlerësimin e ndikimit të veprimtarisë edukative në realizimin e qëllimit dhe të detyrave të edukatës së një shoqërie të caktuar te grupi i posaçëm i atyre që edukohen në kushte dhe në raporte të posaçme.

TESTI PROBLEMOR. Test që hartohet me qëllimin e të provuarit të inteligjencës dhe shkallës së zhvillimit të saj te subjektet e një moshe të caktuar. Të gjitha detyrat e këtij testi janë të formuluara në atë mënyrë, që nga subjektet kërkohet të zbulojnë se ku qëndron problemi?, çfarë kërkon ai problem? dhe pastaj t`i hyjnë zgjidhjes së tij. Detyrat e testit problemor janë fjalësore (verbale), numerike dhe grafike. Rezultatet e shumë detyrave të testeve problemore kanë treguar se zgjidhja e tyre mbështetet fuqishëm në faktorin e përgjithshëm të inteligjencës.

TESTI RORSHAH. Test gjurmues i diagnostikimit të shtresave të thella psikike të pacientit, sidomos të egos dhe njeriut e fuqisë së tij, stilit kognitiv të njeriut, tolerancës ndaj frustrimit, pjekurisë emocionale, sjelljeve patologjike dhe aftësisë së vetëkontrollit të njeriut, pra të pacientit. Testi është formuar nga pikat e ngjyrës të shpërndara njësoj në të dy anët e një flete shkrimi, që japin një figurë të pastrukturuar dhe nga subjekti kërkohet të bëjë strukturimin e saj. Përbëhet nga dhjetë figura standard, nga të cilat pesë janë bardh – e zi dhe pesë figura me ngjyra kromatike. Pikënisja e këtij testi është besimi se subjekti gjatë përpjekjeve për t'u strukturuar dhe në kuptimin figurativ shpreh dëshira, motive, synime etj. të tipareve të personalitetit të tij. Të dhënat e përftuara nga interpretimi i këtyre figurave nga ana e subjekteve të caktuara përdoren si indikatorë për njohjen e përmbajtjeve të thellësive psikike të njeriut: 1) Lokalizimi i përgjigjeve në hollësi, në tërësinë e figurës ose në sfondin e saj; 2) Mbizotërimi interpretues i formës, i ngjyrës ose i pjesëve lëvizëse të saj; 3) Interpretimi i përmbajtjes së figurës së pastrukturuar: qenie njerëzore, kafshë, bimë etj. dhe 4) Shprehja e përmbajtjes së interpretimit: interpretim popullor apo burimor. Këto janë katër kategori interpretuese dhe secila prej tyre ka shenjën e vet: lokalizimi ka shenjën G, D ose S; mbizotërimi shënohet me F, C, c/n ose K; përmbajtja shënohet me H, A, Bot etj. dhe shpeshtësia me P ose O. Këtë test mund ta zbatojë profesionalisti i ushtruar mirë në lëndën e psikologjisë e të psikiatrisë. Kategoria interpretuese e formës dhe e lokalizimit tregojnë orientimin e përgjithshëm jetësor të subjektit, lëvizjet tregojnë prirjen kah introversionit, origjinaliteti i të dhënave tregon inteligjencën dhe prirjen neurotike të subjektit. Rezultatet e këtij testi u treguan

të nivelit më të ulët se janë simpatizuesit e këtij testi. Mori emrin e psikiatrit zviceran Herman Rorshah (Hermann Rorschach, 1884 – 1922).

TESTI SISHOR. Test i hartuar me qëllim të provuarit e ndijimit dëgjimor dhe aftësive muzikore të subjekteve, nga të cilët kërkohet shkallë e lartë e zhvillimit të ndijimit dëgjimor dhe e zhvillimit të aftësive muzikore. Ky test u hartua nga psikologu amerikan me prejardhje suedeze Karl E. Sishor (Carl E. Seashore, 1866 – 1949).

TESTI SOCIOMETRIK. Instrument provues dhe matës i marrëdhënieve ndërshoqërore të pjesëtarëve të grupeve të vogla shoqërore, që themeluesi i sociometrisë i ka përkufizuar: "Mjet për gjurmimin e strukturës shoqërore në dritën e tërheqjes dhe të refuzimit (social – emocional, shënim i P. N.) që paraqitet në një grup". Testi sociometrik ka më tepër formën e një pyetësori, ku secilit anëtar të grupit i parashtrohet pyetja: me cilin anëtar të grupit do të kishe dashur të merrje pjesë në një aksion shoqëror, me cilin nuk do të kishe dashur të merrje pjesë dhe cilin do të kishe dashur dhe nuk do të kishe dashur të merrte pjesë në atë aksion? ose, cilin do më shumë, cilin më pak dhe me cilin je indiferent? Përgjigjet përpunohen dhe rezultati i përpunimit paraqitet në sociogram. Zakonisht kërkohet njohja e shkaqeve të marrëdhënieve tërheqëse, refuzuese dhe të sjelljeve indiferente.

TESTI SOND. Lloj testi projektiv që përbëhet nga 6 grupe figurash dhe secili nga këto grupe ka nga 8 fotografi të tipave të sëmurë psikikë. 48 fotografitë e këtij testi ishin fotografi të tipave homoseksualë, sadistë, epileptikë, histerikë, katatonikë – skizofrenikë, paranoikë – skizofrenikë, depresivë dhe maniakë. Detyra e subjektit është që të zgjedhë nga dy fotografi parapëlqyese dhe dy të tjera refuzuese nga secili prej 6 grupeve të fotografive. Në bazë të rezultateve të përftuara përcaktohet karakteri i sëmundjes psikike të individit të testuar. Hartimi i këtij testi u mbështet në teorinë e genotropizmit, sipas së cilës dy individë me cilësi gjenesh të ngjashme kanë fuqi "magnetizuese" ndërmjet tyre. U hartua nga gjenetisti dhe psikanalisti hungarez Lipol (Leopold) Sondi (Lipot (Leopold) Szondi, 1893 – 1986).

TESTI STANDARD. Test i normuar në bazë të analizës së hollësishme empirike të të gjitha rezultateve të asaj klase rastesh.

TESTI SHTILING. Test që provon dobësimin e ndjeshmërisë së syrit ndaj ngjyrave dhe pamundësinë e dallimit të ngjyrave të caktuara. Zbatohet në këtë mënyrë: në një karton të zakonshëm janë të shkruara disa numra me ngjyra të ndryshme në formë pikash të ngjyrosura. Pikat e ngjyrosura të këtyre numrave dallohen nga sasia e madhe e pikave të tjera që gjenden përreth pikave të ngjyrosura me të cilat janë shkruar numrat e ndryshëm. Pikat përreth kanë gjithashtu ngjyra të ndryshme. Detyra e subjektit është t`i lexojë numrat e shkruar. Mirëpo, këta numra mund t`i dallojë vetëm ai që ka të parët normal të ngjyrave, kurse të tjerët nuk mund t`i dallojnë, ngaqë nuk i dallojnë ngjyrat e caktuara, ose i dallojnë këto dobët. Testi u përcaktua nga oftalmologu gjerman Jakob Shtiling (Jakob Stilling, 1842 – 1915).

TESTI TORNDAJK. Bateri testi, me anën e të cilit provohet inteligjenca e një individi. Është i përbërë nga katër teste: testi kompletues (kufizues), testi i problemeve aritmetike, testi i fjalorit – kuptimit të fjalëve dhe testi direktiv. U hartua nga psikologu britanik Eduard Torndajk (Edward Thorndike, 1874 – 1949).

TESTI VERBAL. Sistem detyrash, problemesh dhe pyetjesh të paraqitura me shprehje përkatëse fjalësore dhe numerike. Testet verbale kanë përmbajtje ngacmuese fjalësore ose numerike dhe përgjigje, përkatësisht zgjidhje detyrash e problemash nga ana e të testuarit me anë të fjalëve dhe numrave. Te këto teste aftësia e të kuptuarit të shprehjeve dhe e përdorimit të fjalëve ose numrave në përshkrimin dhe shpjegimin e dukurive të ndryshme përcakton shkallën e zhvillimit të aftësisë së përgjithshme të të testuarit. Numri më i madh i testeve të diturisë dhe i testeve për matjen e inteligjencës i përkasin tipit të testeve fjalësorë.

TESTIM, - I m. I ardhur nga latinishtja *testari* "dëshmim". Testimi është veprim i organizuar dhe standard i procesit të të provuarit të aftësive, dijeve, tipareve të personalitetit etj., i administrimit të këtij procesi, i vlerësimit dhe i shpjegimit të rezultateve të arritura. Ky veprim i ndërlikuar mund të bëhet në formën individuale ose kolektive. I këtillë mund të jetë testimi i hipotezës, ku zbatohen procese statistikore (testi T, kuadrati HI) për vërtetimin e të dhënave të përftuara dhe përputhshmërinë ose mospërputhshmërinë e tyre me atë çfarë ka pritur ose supozuar hulumtuesi.

Burimet:

Charles Jackson:*"Understanding Psychological Testing"* – (*"Të kuptuarit e testimit psikologjik*"), The Britissh Psychological Society, London, 1996.

Save the Children: *"Si të hartojmë një test"?*, Tiranë, 2002.

Kiro Popovski & Zoran Stojanovski: *"Testet e diturisë*", Botimi i dytë, Aza – SSsoft, Tetovë, 1996.

TESTIMI I HIPOTEZËS. Proces i ndërlikuar mendor me anën e të cilit hulumtuesi ka bërë orvatje gjurmuese për argumentimin e supozimeve shkencore të caktuara. Veprimi i testimit të hipotezës mund të bëhet me anën e testit T, analizës së variancës, hipotezës nul etj. Nëse hulumtuesi konstaton se dallimi në rezultatet e arritura ndërmjet dy gjurmimeve të së njëjtës ndryshore në kushte e rrethana të ngjashme ose të njëjta është i nivelit të ulët statistikor, atëherë hipoteza e tij argumentohet. Nëse dallimi statistikor është më i madh se 5 %, atëherë hipoteza është e paqëndrueshme, pikërisht e pamundur për t`u argumentuar.

TESTIS, - I m. Gjëndrat seksuale te meshkujt që kryejnë dy funksione: sekretojnë në masë të madhe hormonin seksual mashkullor testosteronin, e në masë të vogël edhe hormonin estrogjen të vezoreve dhe prodhojnë spermatozoidin**.**

TESTOSTERON, - I. m. Hormoni seksual kryesor i meshkujve që prodhohet nga cipa mbiveshkore dhe korteksi i adrenalinës, por sasia më e madhe sintetizohet në testikuj. Testosteroni e përshpejton zhvillimin e indeve të organizmit, shkakton pjekurinë e organeve gjenitale të meshkujve, ndikon në zhvillimin e tipareve parësore dhe dytësore seksuale. Disa nga rezultatet e

arritura kanë treguar se sasia e testosteronit është e lidhur edhe me zhvillimin e nivelit të sjelljeve agresive.

TETANUS, - I. m. I ardhur nga latinishtja *tetanus* "sharrëz". Tetanusi është ngërç, tkurrje e pandërprerë e një muskuli.

TËRBIM, - I. m. Term me kuptim të posaçëm në psikologji në ndryshim nga i njëjti term në mjekësi. Tërbimi është zemërim me intensitet shumë të lartë, kur njeriu humb aftësinë e mbajtjes nën kontroll të sjelljeve dhe veprimeve të tij. Shfaqet me britma të pazakonshme, me veprime të shfrenuara, me shpërthime të vrullshme dhe të pamatura ndaj shkaktarit të tërbimit, përkatësisht ndaj atij, i cili vlerësohet se ia kërcënon dhe mohon vlerat e mëdha që mendon se ai i ka.

TËRËSI, - A. f. Objekt, trup i krijuar dhe i formësuar si tërësi e plotë, ku secila pjesë mund të konceptohet vetëm në kuadrin e asaj tërësie. Tërësia e tillë është integritet i posaçëm, në të cilin elementet e saj janë "shkrirë" në një organizim të pandashëm dhe gjithëpërfshirës. Ky organizim nuk është prej shumë elementesh, ku këta mund ta ndryshojnë vendin, por tërësi e organizuar e tyre. Elementet përbërëse të kësaj tërësie e kanë të humbur individualitetin e tyre, madje këta nuk mund të kuptohen po qe se ndahen nga kjo tërësi. Qasja holistike e studimit të një dukurie, situate etj. ka për bazë tërësinë karakteristike të tyre. Tërësia e këtillë është koncepti kryesor i psikologjisë geshtaltiste.

TIÇENER B. Eduard (Edward B. TITCHENER). Psikolog anglez dhe amerikan. Lindi në Chichester, Angli më 1867 dhe vdiq në Ithaca, Nju Jork më 1927. Përfaqësuesi eminent i psikologjisë eksperimentale strukturaliste-introspektive. Studioi filozofi dhe fiziologji në Universitetin e Oksfordit dhe pas vitit 1920 ndoqi me kujdes pikëpamjet psikologjike të Vilhelm Vuntit, pranë të cilit mbrojti edhe doktoratën. U shpërngul nga Anglia dhe u vendos në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku punoi si profesor i psikologjisë në Universitetin Kornel; themelues i shoqatës për psikologjinë eksperimentale prej vitit 1904 dhe redaktor tridhjetëvjeçar i revistës "The American Journal of Psychology". Ka qenë ndër studiuesit e dalluar që ka lënë disa vepra të rëndësishme psikologjike, ndër të cilat më kryesoret janë: *"An autline of psychology"* – (*"Ravijëzimi i psikologjisë*"), 1896; *"Experimental Psychology I – IV"* – (*"Psikologjia eksperimentale l – IV"*), 1901 - 1905*; "A Primer of Psychology"* – (*"Bazat e psikologjisë"*), 1903; "*Lectures on the Elementary Psychology of Feeling and Attention"* – (*"Leksione të psikologjisë elementare mbi ndjenjat dhe vëmendjen*"), 1908; *Lectures on the Experimental Psychology of the Thought Processes*" – (*"Leksione të psikologjisë eksperimentale mbi proceset e mendimit"*), 1909; *"A Textbook of Psychology"* – (*"Libër tekstesh psikologjike"*), 1910 dhe *"A Beginner's Psychology"* – (*"Fillesat e psikologjisë"*), 1919.

TIFLOLOGJI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *τύφλωση* "i verbër" dhe *logos* "mendim". Degë e grupit të disiplinave të defektologjisë, e cila merret me studimin e verbërimit të pjesshëm dhe të tërësishëm. Në kuadrin studimor të saj hyn edhe gjurmimi i metodave, I mjeteve dhe i formave të organizuara të aftësimit sa më të përshtatshëm

të të verbërve, për t`u inkuadruar sa më shpejt në rrjedhat e jetës së përditshme.

TIFLOPEDAGOGJI, - A. f. Degë e pedagogjisë speciale, e cila merret me arsimimin dhe edukimin e fëmijëve tërësisht ose pjesërisht të verbër. Synon zhvillimin e mundshëm të aftësive për të mësuar dhe njohjen e dukurive e të objekteve të mjedisit të ngushtë dhe të gjerë, formimin e shkathtësive dhe të shprehive dhe përgjithësisht organizimin e sjelljeve për plotësimin e nevojave dhe të motiveve të tij, si edhe aftësimin e mundshëm profesional për t`u inkuadruar në punë.

TIK, - E. m. I ardhur nga frëngjishtja *tic* "ngërç. Tiket janë ngërçe, kontraksion i pakontrolluar i muskujve të një, ose disa organeve të trupit. Zakonisht bëhet fjalë për ngërçe të pakontrolluar të herëpashershëm të fytyrës, të qafës, të duarve ose të këmbëve. Tiket janë pasojë e dëmtimit të disa indeve të trurit, por mund të jenë pasojë edhe e disa shkaqeve psikike. Ka tekste psikologjike ku tiket konsiderohen lëvizje të pakontrolluara, të shpejta dhe stereotipe muskujsh të organeve të ndryshme, si rrudhja e krahëve, "shkelja e syrit", shtrembërimi i muskujve etj. Shfaqen më tepër në moshën e adoleshencës dhe janë më të shpeshta te adoleshentët e gjinisë mashkullore. Si të tillë tiket humbin e zhduken vetvetiu. Këto mund të jenë me prejardhje psikogjene (nga agresiviteti i shtypur i njeriut, nga ndjenja e fajit etj.), por mund të kenë edhe origjinë organike.

TIMBRI I TINGULLIT. Natyra e tingullit, tonaliteti i tij që njeriu i përjeton si harmoni e rezonancë tonesh, të cilin e shkaktojnë përbërësit më të lartë se toni kryesor dhe kombinimi i harmonishëm i tyre.

TIMBRI I TONIT ZANOR. Cilësia e tonit të një zëri, ngjyra e tonit të cilin e përcakton struktura e valëve zanore të ajrit, pra ndërlikueshmëria e valëve të larta ajrore, të cilat shoqërojnë tonin kryesor. Sipas kësaj cilësie dallojmë tonet me intensitet dhe me lartësi të lartë kur këta prodhohen nga instrumentet muzikorë të ndryshëm (toni A i violinës nga toni A i kitarës, i pianos etj.). Shih – ***TONI.***

TIMPAN, - I. m. Cipa ndërmjet pjesës së veshit të jashtëm dhe të mesëm e njohur në të folurin e përditshëm edhe me termin daullja e veshit. Kjo mbart efektet e valëve zanore te eshtrat e dëgjimit të veshit të mesëm, duke i vënë këta në veprim me anën e dridhjes së saj. Kjo dridhje ngacmon receptorët e dëgjimit të pjesës së veshit të brendshëm. Shih – ***VESHI.***

TIMUS, - I. m. I ardhur nga latinishtja *thymus* "trumzë". Është term i psikologjisë fiziologjike që emërton gjëndrën me sekretim të brendshëm, që është e vendosur në mediastinin e përparmë, në pjesën e sipërme të gjoksit, duke zënë vend para dhe mbi muskulin e zemrës. Sekreton hormonin timozinë, që ndikon në zhvillimin e imunitetit të organizmit. Timusi rritet gjatë moshës fëmijërore, sidomos pas dy viteve të para pas lindjes dhe arrin kulmin e zhvillimit në moshën e pubertetit, kurse më pas, pas moshës së pubertetit, pra pas moshës 12 – 14-vjeçare kjo gjëndër zvogëlohet.

TINBERGEN Nikola (Nikolaas TINBERGEN). Etolog hollandez. Lindi në Hagë më 1907 dhe vdiq në

Londër më 1988. Kreu studimet në Universitetin e Leiden-it, ku u mor me studimin e sjelljes së insekteve. Nga viti 1949 ka gjurmuar sjelljet e insekteve në departamentin e zoologjisë të Universitetit të Oksfordit, ku në vitin 1966 u zgjodh dhe profesor. Vuri themelet e etologjisë në Angli me karakteristikat e një disipline shkencore moderne. Më 1973 së bashku me Konrad Lorencin dhe me Karl fon Frishin mori çmimin Nobel për fiziologji dhe mjekësi. Rezultatet e studimeve të tij kanë ushtruar ndikim në zhvillimin e studimeve për sjelljet dhe bazën fiziologjike të tyre. Vepra kryesore e tij është: "*The Study of Instinct*" – (*"Studimi i instinkteve"*), 1951; *"The Animal in its World; Explorations of an Ethologist 1932–1972" – "Kafshët në botën e tyre: eksplorimi nga etologjisti më 1912–1972"*), 1972 – 1973.

TINGULL, - I. m. Dukuri akustike që shkaktohet nga dridhja e trupave elastikë, të cilët shkaktojnë dendësinë ose rrallimin e ajrit në formë valësh ajrore. Fortësia dhe lartësia e këtyre valëve të ajrit përcaktojnë intensitetin dhe fuqinë e një tingulli. Tingulli është ngacmuesi adekuat i shqisës së dëgjimit. Ndijimi i tij është përvoja e njeriut për kapjen e ndryshimeve të valëve ajrore nga ana e shqisës së dëgjimit dhe e qendrës akustike të cipës së trurit të madh.

TINITUS AURIUM. I ardhur nga latinishtja *innere* "kumboj" dhe *auris* "vesh". Term i psikofiziologjisë së shqisës dëgjimore që emërton kumbimin e veshit, megjithëse ndikimi i tingullit të jashtëm nuk vepron në veshin e njeriut. Kjo dukuri shkaktohet zakonisht pas ndikimit të gjatë që ushtron në vesh zhurma e madhe.

TIP, - I. m. I ardhur nga greqishtja *τύπος* "formë, model". Term përmbledhës për konceptin e formës, të strukturës, të tipareve karakteristike e të përgjithshme e të përbashkëta të një grupi apo klase të dukurive, individëve, objekteve etj., që shërben si përfaqësues i atij grupi apo asaj klase të tyre. Tipi në psikologji emërton konceptin për unitetin e strukturës së karakteristikave të proceseve psikike dhe të sjelljeve të një kategorie individësh. Tipi i këtillë në psikologjinë empirike mënjanon individualitetin psikik të njeriut, pra personalitetin. Megjithëkëtë, tipi është term që haset në psikologjinë e personalitetit, të karakterit, të temperamentit etj., duke emërtuar tërësinë e tipareve karakteristike të një kategorie individësh. Kështu, në fushën e ndijimeve – perceptimeve dallojmë tipat dëgjimorë, pamorë, motorikë etj., në psikologjinë e personalitetit dallojmë tipin introvert, ekstravert, ambivert; në psikologjinë e temperamentit dallojmë tipin flegmatik, kolerik, melankolik dhe sanguin etj.

TIPARET E KARAKTERIT. Sjellje të qëndrueshme dhe karakteristike për një individ të caktuar, që bëjnë të dallohet një individ nga të tjerët. Disa nga psikanalistët me termin tipare të karakterit emërtojnë tendencat e lindura të njeriut për sjellje të veçanta ndaj të tjerëve.

TIPARET E PERSONALITETIT. Cilësi thelbësore, të përgjithshme dhe relativisht të qëndrueshme, të cilat karakterizojnë personalitetin e caktuar të njeriut, duke shfaqur shkallë relativisht

të lartë konsekuence në sjelljet e tij. Këto tipare mund të jenë zhvilluar në shkallë të ndryshme, duke u shtrirë nga shkalla e lartë deri në shkallën më të ulët të zhvillimit të tyre. Mbi këtë bazë bëhet fjalë për përmasat e zhvillimit të tipareve. Për Gordon Alportin (Gordon Allport, 1897 – 1967) tipari i personalitetit "është strukturë neuropsikike e përgjithshme (karakteristike për individin), e aftë që shumë ngacmues t`i bëjë në mënyrë funksionale ekuivalent me sjelljet e njeriut ndaj tyre (shënim i P. N.) dhe të fusë e të drejtojë forma konsekuente të sjelljeve dhe të stileve të përshtatjes". Sipas tij dallohen disa tipare qendrore dhe një tipar kryesor apo kardinal. Këto mund të jenë *tipare të karakterit*, që shpjegojnë përse dikush vepron në atë mënyrë ndaj të tjerëve, *tipare të temperamentit*, që shpjegojnë mënyrën e sjelljes së njeriut, përkatësisht që japin përgjigje si e në ç`mënyrë ai reagon ndaj të tjerëve dhe *tipare të aftësive të njeriut*, që tregojnë se sa është i suksesshëm njeriu në realizimin e qëndrimeve, të synimeve, të sjelljeve etj. Sipas psikologut amerikan me origjinë britanike Rajmond B. Katel (Raymond B. Catell, 1905 – 1998) dallohen dy lloj tiparesh të personalitetit: *tiparet sipërfaqësore* – ndryshore sjelljesh manifestuese të ndërlidhura dhe *tiparet burimore*, pra *thellësore*, të cilat janë përcaktuese në sjelljet konseguente të njeriut. Në bazë të njohjes dhe identifikimit të këtyre tipareve mund të parashikohen sjelljet dhe reagimet e personalitetit në të ardhmen e tij. Tiparet e personalitetit mund të jenë tipare konstitucionale, të zhvilluara nga ndikimi i faktorëve të brendshëm të zhvillimit të trupit të njeriut dhe tipare të zhvilluara dhe të formuara nga ndikimi i parimeve dhe i normave kulturore të mjedisit ku zhvillohet njeriu.

TIPARET KARDINALE TË PERSONALITETIT. Tiparet më të gjera, të cilat drejtojnë sjelljet e përgjithshme të njeriut dhe në bazë të funksionimit të këtyre tipareve individi tjetër është në gjendje të parashohë sjelljet e tij në situata të caktuara. Termi tipare kardinale të personalitetit është term i psikologjisë së personalitetit i psikologut amerikan Gordon Olport.

TIPAT E KARAKTERIT. Ndarja e tipave sipas sjelljeve etike të tyre. Në këtë ndarje flitet për tipin autoritar, eksplorues, për tipin neurotik etj.

TIPAT E KONSTITUCIONIT TRUPOR. Ndarje sipas gjatësisë, trashësisë trupore të njeriut dhe cilësive të tjera të lidhura me formën dhe konstitucionin trupor të njeriut dhe me lidhjen e tyre me tiparet e temperamentit të njeriut. Shih – ***TIPOLOGJIA E KREÇMERIT; TIPOLOGJIA E SHELDONIT.***

TIPAT E PERSONALITETIT. Tipa të klasifikuar sipas strukturës së synimeve të përgjithshme të sjelljeve dhe të aktivitetit të përgjithshëm, duke marrë për bazë karakteristikat psikologjike mbisunduese në veprimtarinë e gjithëmbarshme të tyre (ndarja sipas proceseve psikike dhe formave të sjelljeve, me të cilat ai shërbehet më tepër në jetën dhe në veprimtarinë e tij, ndarja sipas qëndrimeve mbisunduese, si: tipi i intraversionit dhe ekstraversionit etj. Shih – ***TIPARET E PERSONALITETIT.***

TIPAT E TEMPERAMENTIT. Ndarja e tipave sipas intensitetit, forcës

dhe shpejtësisë së reagimeve, në radhë të parë të reagimeve emocionale të tyre. E tillë është ndarja në tiparin flegmatik, kolerik, melankolik e sanguin. Shih – ***TEMPERAMENTI.***

TIPAT FUNKSIONALË. Term i psikologjisë komplekse të Karl Jungut (Carl Jung, 1875 – 1961), që karakterizon tipologjinë e tij. Sipas kësaj tipologjie ekzistojnë katër tipa të personalitetit, që i përgjigjen katër funksioneve të strukturave psikike të njeriut. Këto struktura funksionale janë: mendimi, ndjenjat, shqisa dhe intuita. Mendimi dhe ndjenjat kanë karakter të vetëdijshëm, kurse shqisa dhe intuita janë të pavetëdijshme. Secili individ i ka të zhvilluara këto katër funksione, por mbizotërimi i njërës mbi të tjerat e bën atë individ tip të posaçëm, që ndryshon nga të tjerët.

TIPAT RACIONALË. Term i psikologjisë analitike ose komplekse të Karl Jungut (Carl Jung, 1875 – 1961), që i ka klasifikuar njerëzit në katër tipa funksionalë, që i ndihmojnë njerëzit "të drejtohen në botë dhe në raporte ndërnjerëzore". Ndër tipat mendorë, emotivë, intuitivë dhe sensitivë Karl Jungu dalloi dy tipa racionalë: tipin mendor dhe tipin emotiv. Tipi mendor i njeriut është ai te i cili mbisundon mënyra funksionale e mendimit për njohjen e realitetit dhe të formave e raporteve të tij. Ky tip mund t`i përkasë tipit introvert ose ekstravert.

TIPI A. Tip i personalitetit që emërton karakteristikat e temperamentit, që kanë të bëjnë me njeriun ambicioz, energjik, me ndjenjën e përshpejtimit të kohëzgjatjes së një veprimtarie, me njeriun e padurueshëm, të gatshëm që të kryejë disa punë, tip që i jep rëndësi më të madhe sasisë dhe jo cilësisë së sjelljeve të tij. Konsiderohet se është tip i lidhur me çrregullime koronare. Rreth 40 % e njerëzve i përkasin këtij tipi. Te ky tip janë dalluar edhe disa karakteristika fiziologjike, nga të cilat dallohen: pulsi i lartë gjatë kohës së pushimit, ngritja e presionit të gjakut gjatë gjendjes së stresit, me shkallë besueshmërie se do të përjetojë sëmundje të zemrës dy herë më shumë se tipi B.

TIPI ASTENIK. Njeriu me konstruksion trupor të gjatë e të dobët, me energji të pakët për të zhvilluar aktivitetin e vet dhe me sjellje karakteristike, që ka elemente të sjelljeve skizotike. Shih – ***TIPOLOGJIA E KREÇMERIT***.

TIPI ATLET. Një nga tipat e tipologjisë së psikiatrit gjerman Ernest Kreçmerit (Ernst Kretschmer, 1888 – 1964). Tipi atlet ka këto karakteristika trupore: ndërtim të baraspeshuar ndërmjet pjesëve të trupit me zhvillim psikik normal, gjymtyrë me madhësi proporcionale në raport me trupin e tij, supe të gjëra, muskuj të zhvilluar të duarve etj. Këto karakteristika trupore Ernest Kreçmeri i ka konstatuar te meshkujt. Nëse tipi trupor me këto karakteristika sëmuret nga ana mendore, atëherë ai do të sëmuret nga skizofrenia. Shih – ***TIPOLOGJIA E KREÇMERIT.***

TIPI AUDITIV. Tip i njeriut, i cili kupton, mëson dhe mban mend më lehtë, më shpejt dhe më mirë përmbajtjet që i dëgjon se ato që vetëm i sheh, i lexon (tipi pamor apo vizual).

TIPI B. Tip i personalitetit me karakteristika të temperamentit të kundërt me

tipin A. Këtë tip e karakterizojnë këto tipare: i ngadalshëm në sjelljet dhe në veprimet e tij, jo ambicioz dhe energjik në aktet e tij ndaj të tjerëve, i përkushtuar për cilësinë e mirë të sjelljeve dhe të punës së tij, me stil të zhvilluar të sjelljeve me të tjerët, me frymë garuese të dobët etj. Rreth 60 % e njerëzve i përkasin tipit B të personalitetit.

TIPI EIDETIK. Individi që ka aftësi të përfytyrimit të gjallë të objektit të perceptuar. Një tip i tillë është i rrallë te të rriturit, por haset shumë më shpesh te fëmijët. Besohet se te të rriturit tipa eidetikë ka një në njëmijë vetë, kurse te fëmijët, tipa të tillë ka 5 % - 8 %. Te këta tipa përfytyrimet eidetike mund të riprodhohen edhe disa muaj pas perceptimit të një objekti të caktuar. Dallohen dy lloje tipash eidetikë: tipi B dhe T, përkatësisht tipi Basedit dhe tipi Tetanoid.

TIPI ESTETIK. Tip i njeriut, i cili adhuron në rend të parë të bukurën në natyrë dhe në art. Për tipin estetik e bukura është vlera më e madhe dhe më e lartë e atij objekti. Për tipin estetik bukuria e një objekti, dukurie, procesi etj., është mbi të gjitha dhe para së gjithave (para të dobishmes, të fuqishmes, të vërtetës etj.). Në tipologjinë e personalitetit të Eduard Shprangerit (Eduard Spranger, 1882 – 1963) tipi estetik është njëri nga gjashtë tipat e tjerë (tipi ekonomik, tipi estetik, tipi fetar, tipi politik, tipi shoqëror dhe tipi teorik). Shih – ***TIPOLOGJIA E SHPRANGERIT.***

TIPI I PERSONALITETIT AMBIVERT. Term i psikologjisë komplekse të Karl G. Jungut (Carl G. Jung, 1875 – 1961). Tip i personalitetit ambivert është ai, i cili ka tipare të përziera të tipit ekstravert dhe introvert, përkatësisht të atij me qëndrime të përhershme të drejtuara kah botës së jashtme dhe e tipit me qëndrime të qëndrueshme të kthyera kah vetja e tij. Prania e këtyre qëndrimeve të kundërta te tipi ambivert vërteton se kanë masë të ngjashme të pranisë së njërit qëndrim dhe qëndrimit tjetër.

TIPI IDEAL. Masë teorike e vlerësimit të një individi sipas një "skeme mendore" që përcakton se sa ky individ i afrohet karakterit tipik të admiruar në mjedisin e tij. Me këtë kuptim emërtohet karakteri i Shqiptarit tipik, i Anglezit tipik dhe i Gjermanit tipik.

TIPI INTROVERT. Tip personaliteti që karakterizohet nga mbisundimi dhe preokupimi i qëndrimit motivues të sjelljeve pozitive ndaj vetes dhe botës mendore të brendshme të tij. Ndaj botës së jashtme dhe ndryshimeve të saj tipi introvert është pasiv dhe i tërhequr, shumë i ndjeshëm dhe emocionet e tij di t`i kontrollojë, është i përmbajtur ndaj të tjerëve, i mbyllur në veten e tij, ka prirje imagjinuese etj. Individi i tipit introvert i mirëfilltë është vetëm ai, i cili ka formë të përhershme dhe të qëndrueshme të sjelljeve dhe të proceseve psikike të tij, të drejtuara kah vetja e tij, por me vështirësi të posaçme në përshtatjen e tij ndaj botës së jashtme dhe ndryshimeve të saj. Termi tip introvert i përket psikologjisë komplekse të Karl Jungut. Tipi introvert i personalitetit ka disa forma të intensitetit të tij, që e bëjnë të dallohet me vështirësi nga tipi patologjik.

TIPI INTUITIV I PERSONALITETIT. Term i tipologjisë së personalitetit

të Karl Jungut (Carl Jung, 1875 – 1961), i cili ka dalluar katër tipa (tipin mendor, tipin ndijor, tipin shqisor dhe tipin intuitiv). Një prej këtyre tipave është tipi intuitiv, që i përket grupit të tipave irracionalë. Te tipi intuitiv libidoja (energjia psikike) është e drejtuar në perceptimin e pavetëdijshëm të dukurive, objekteve e proceseve. Procesi i njohjes te tipi intuitiv është e dhënë e vetë njeriut.

TIPI IRRACIONAL. Term i psikologjisë komplekse ose analitike të Karl G. Jungut (Carl G. Jung, 1875 – 1961). Sipas tipologjisë së tij tipi mendor, emotiv, intuitiv dhe sensitiv i ka funksionet cilësore themelore. Sipas këtyre funksioneve tipi mendor, emotiv, intuitiv dhe sensitiv mund të jenë racional dhe irracional. Për tipin irracional të personalitetit është karakteristike mbisundimi i funksioneve irracionale (i intuitës dhe i perceptimit) në sjelljet e përgjithshme të tij. Me anën e këtyre funksioneve tipi irracional njeh atë që është unike, konkrete.

TIPI KRIMINAL. Term i vjetër i personalitetit me tipare kriminale. U quajt tip kriminal ai që edhe pas dënimeve të njëpasnjëshme kryen krime në forma të ndryshme. Sipas pikëpamjes së kriminologut italian Çezare Lombrozo (Cesare Lombroso, 1836 – 1909), tipi kriminal është tip i lindur.

TIPI MAGJIK. Tip i njeriut të mbyllur që jeton në botën e përjetimeve të tij me besimin e madh dhe në bindjen se, në këtë mënyrë ai siguron jetën shpirtërore të tij, si dhe zhvillimin personal. Shih – ***PERSONALITETI MANA***.

TIPI MENDOR. Në psikologjinë analitike të psikiatrit dhe psikanalistit zviceran Karl G. Jung (Carl G. Jung, 1875 – 1961) klasifikon katër tipa të personalitetit. Kjo ndarje është bërë sipas strukturave dhe funksioneve të këtyre strukturave psikologjike: sipas ndjenjave, mendimeve, shqisave dhe intuitës. Te të gjithë njerëzit funksionojnë strukturat e përmendura, por te secili mbisundon funksioni i njërës strukturë psikologjike. Tipi mendor i personalitetit është ai tip, tek i cili mbisundon të menduarit.

TIPI PIKNIK. Tip me zhvillim të posaçëm trupor, që i përket tipologjisë së psikiatrit gjerman Ernest Kreçmer (Ernst Kretschmer, 1888 – 1964). Tipi piknik në pikëpamjen antropologjike dallohet me trupin e tij të shkurtër e të rrumbullakët, me qafën e shkurtër, gjoksin e gjerë, lukthin me përmasa jo të zakonshme etj. Ky tip haset më tepër te ata që vuajnë nga mania depresive. Shih – ***TIPOLOGJIA E KREÇMERIT.***

TIPI RELIGJIOZ. Tip i njeriut i përcaktuar në tipologjinë e psikologut dhe filozofit gjerman Ernest Shpranger. Sipas tipologjisë së tij "tipi religjioz është ai që ka strukturë mendore të drejtuar përherë në krijimin e vlerës më të lartë absolute të përjetimeve të kënaqshme për të".

TIPI SKIZOTIM. Tip me sjellje normale, por me tendencë sjelljesh të ngjashme me personalitetin skizoid. Një prirje e tillë ka këto karakteristika: asketizmin, fanatizmin, ftohtësinë emocionale, individualizmin, sjelljet introverte, ironike, tërheqjen nga komunikimi me të tjerët etj. I përket tipologjisë së psikiatrit gjerman Ernest Kreçmer (Ernst Kretschmer, 1888 – 1964).

Burimet:

Sir David Henderson, R. D. Gillespie: *"A text – Book of Psychiatry for Students and Practitioners"*– (*"Libër mbi psikiatrinë për studentët dhe praktikantët"*), London – New York – Toronto, 1950;
Ylli Pango: *"Psikoterapi",* Tiranë, 2004 (Kapitulli XII, Skizofrenia, fq. 407 – 457);
Spencer A. Rathus: *"Essentials of Psychology"*- (*"Temelji Psihologije"*), (Përkthyer në kroatisht, fq. 536 – 538).
Sadik Lala: *"Psikopatologjia",* Tiranë, 2013, fq.182 – 218.

TIPI TRADICIONAL. Tip i njeriut me mendime, qëndrime, sjellje, vlera dhe modele që mbështeten në traditën e vendit dhe të banorëve paraardhës me kulturë të përbashkët. Një tip i tillë nuk shfaq gatishmëri për të ndryshuar mendimet, pikëpamjet, qëndrimet dhe sjelljet e lidhura me to, por u qëndron besnik atyre. Ky tip formohet në bazë të socializimit të brezave të rinj në mjedisin e tyre mbi themelet e kulturës tradicionale.

TIPOLOGJI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *τύπος* "tipi" dhe *λογία* "shkenca" që përfaqëson orvatjen e përgjithshme të klasifikimit të njerëzve në tipa të posaçëm dhe rezultatin e klasifikimit në një kategori të posaçme sipas një kriteri të caktuar. Ky term haset më tepër në psikologjinë e personalitetit, e pikërisht në psikologjinë e tipareve të personalitetit. Supozohet se këto tipare mund të ndahen në dy (tipologji bimodale), tri, katër e më shumë kategori (tipologji multimodale). Tipologjia bimodale është tipologjia e Karl G. Jungut (Carl G. Jung, 1875 – 1961), sipas së cilës njerëzit ndahen në tipa intravert dhe në tipa ekstravert. Grupim më të gjerë tipash hasim në psikologjinë e Ernst Kreçmerit (Ernst Kretchmer, 1888 – 1904), ku përcaktohen këto grupe të tipave të personalitetit: tipi leptozom – skizoid dhe tipi piknik – maniako-depresiv, si edhe në klasifikimin somatopsikik të Uiliam Sheldonit (William Sheldon, 1898 – 1907), ku përcaktohen tipat ektomorfë – cerebrotonikë, mezomorfë – somatotonikë dhe endomorfë – viscerotonikë etj. Por, klasifikimet e këtilla kanë dy të meta: janë thjeshtëzim i tepruar i personalitetit dhe ndarjet e përmendura paraqesin më tepër grupe të skajshme tipash e jo shpërndarje normale të tipareve të tyre. Për këto arsye psikologjia bashkëkohore i largohet ndarjes në tipa psikologjikë të njerëzve.

TIPOLOGJIA E KREÇMERIT. Tipologjia e Kreçmerit është emërtim i klasifikimit të tipave, e hartuar në bazë të lidhjes së konstitucionit organik të trupit të njeriut dhe të tipareve unike psikike të personalitetit. Themelues i kësaj tipologjie është psikiatri gjerman Ernst Kreçmer (Ernst Kretchmer, 1888 – 1964). Ernst Kreçmeri studioi strukturën fizike ose organike të 260 të sëmurëve psikikë dhe arriti në këtë përfundim: ekzistojnë katër tipa të ndryshëm me konstitucion të ndryshëm fizik, organik apo trupor. Këta janë: tipi piknik, tipi atlet astenik ose leptozomik dhe tipi displastik. Këtyre tipave u përgjigjen edhe sëmundjet kryesore psikike "skizofrenia dhe mania depresive". Te të sëmurët nga skizofrenia Kreçmeri konstatoi se këta të sëmurë kanë konstitucion fizik apo trupor karakteristik; këta janë të gjatë dhe të hollë. Prandaj tipit të të sëmurit skizofrenik i përgjigjet konstitucioni

i trupit leptozomik. Të sëmurët nga psikoza e manisë–depresive kanë konstitucion fizik, organik ose trupor të tipit piknik (tipa me zhvillim muskulor, të trashë). Shkalla relativisht e lartë e ndërlidhjes (e korrelacionit) ndërmjet trupit dhe sëmundjes psikike ka shkaktuar ndarjen në tipin leptozomik – skizofren dhe në tipin piknik – maniako-depresiv. Ernst Kreçmeri ka qenë i mendimit se ndërmjet tipit të shëndetshëm nga ana psikike dhe atij të sëmurë ekziston ndryshimi në shkallën e zhvillimit të proceseve psikike dhe sjelljeve të tyre. Duke filluar nga kjo pikënisje E. Kreçmeri e shtriu tipologjinë e tij edhe në gjithë popullatën dhe i ka ndarë tipat e temperamentit të njerëzve në tipin skizotim dhe në tipin ciklotim. Tipi skizotim karakterizohet me zhvillim leptozomik ose atleti, kurse tipi ciklotim karakterizohet me zhvillim trupor të tipit piknik. Dy tipat e tjera të konstitucionit fizik apo trupor (tipi atlet dhe ai displastik) nuk kanë pasur lidhje të veçantë me ndonjërin nga temperamentet e përmendura. Tipologjia e Ernst Kreçmerit i është nënshtruar një kritike të posaçme. U kritikua më tepër nga pikëpamja metodologjike, sepse ai nuk e ka kontrolluar ndryshoren e moshës së pacientëve të tij. Skizofrenia është e lidhur kryesisht me moshën e rinisë, kur njerëzit janë të hollë dhe shëndetlig, kurse psikoza maniako–depresive është e lidhur më tepër me njerëz të moshës së thyer, kur këta fillojnë të shtojnë në peshë. Verifikimi i tipologjisë nga hulumtuesit e tjerë nuk ka dëshmuar lidhjen e ngushtë trupore me psikozën e sikozofrenisë e të manisë depresive, si edhe me zhvillimin moshor ndërmjet tyre. Përpos kësaj, dallimi ndërmjet të sëmurëve psikikë dhe të shëndoshëve psikikë nuk ka vetëm përmasën e intensitetit të shtuar ose të ulët të zhvillimeve psikike.

TIPOLOGJIA E SHPRANGERIT. Tipologjia e psikologut dhe e filozofit gjerman Eduard Shpranger (Edward Spranger, 1882 – 1963), sipas së cilës tipat e njerëzve ndahen sipas prirjeve dhe preferencave të vlerave njerëzore. Në sistemin e vlerave ka dalluar gjashtë vlera kryesore dhe, rrjedhimisht edhe gjashtë tipa njerëzish që anojnë kah këtyre vlerave, duke shfaqur sjellje konkrete kah vlerave të posaçme. Këto gjashtë tipa njerëzish janë: 1) tipi ekonomik – tip i angazhuar në realizimin e interesave lëndore, i interesuar për anën praktike të jetës dhe të veprimtarisë, si edhe për anën e dobishme të të mirave materiale për të; 2) tipi estetik – tip që anon kah bukuria, e cila është për të vlera më e lartë. Bukuria për këtë tip të njeriut është mbi të vërtetën dhe të dobishmen; 3) tipi politik – tip i interesuar për pushtet, për sundim mbi të tjerët, që dallohet me dëshirën dhe orvatjet për të qenë drejtor, përgjegjës, udhëheqës, si edhe profesionalist në sistemin politik dhe në hierarkinë e tij; 4) tipi religjioz – tip i interesuar dhe i pushtuar me mendime, pikëpamje e qëndrime religjioze dhe me shpjegimin e dukurive hyjnore; 5) tipi shoqëror – tip i pushtuar me interesimet, me sjelljet shoqërore ndaj të tjerëve dhe të të tjerëve ndaj tij, aktiv në aktivitetet e përbashkëta; për këtë tip vlera më e lartë është altruizmi dhe 6. tipi teorik – tipi i njeriut për të cilin vlera më e lartë është e vërteta mbi atë të bukurisë, të dobisë, të fuqisë etj. Për

këtë ai angazhohet në fitimin e dijeve sa më të gjera e të thella, në zbulimin e së vërtetës. Është vështirë të gjendet tipi i pastër i të të përshkruarve. Për këtë shkak bëhet fjalë për mbisundimin e një prirjeje, një angazhimi më të madh drejt një vlere, kur njeriu atë e çmon si vlerën më të rëndësishme se të tjerat.

Burimet:

Edward Spranger: *"Lebensformen"* – (*"Format e jetës"*), Berlin, 1925.

TIREOTOKSIKOZ/Ë, - A. f. Sëmundje psikosomatike klasike, e lidhur me çrregullimin e strukturës dhe të funksionimit të gjëndrës tiroide. Shfaqet me simptoma të ankthit, si edhe me çrregullime të këtyre simptomave. Këto çrregullime janë cilësuar shkaktarë të sëmundjes së gjëndrës tiroide. Pohohet se diagnostikimi i saj është i ndërlikuar dhe se shërimi me barna farmaceutike është joproduktiv.

TIREOTROPIN/Ë, - A. f. Njëri nga hormonet që i prodhon pjesa e sipërme e hipofizës. Funksioni kryesor i hormonit tireotropinë është të shtyjë prodhimin e hormonit të tiroksinës nga ana e gjëndrës tiroide dhe ta kontrollojë prodhimin dhe funksionimin e këtij hormoni. Në prodhimin dhe funksionimin e këtij hormoni ka ndikim të posaçëm hipofiza.

TIROIDE, - T. f. I ardhur nga greqishtja *θυρεο* "mburojë" dhe *ειδής* "formë". Gjëndër me sekretim të brendshëm, që është e vendosur në indin qafor para trakesë dhe ka formën e shkronjës H. Kjo rritet në moshën e pjekurisë dhe është e ndarë në dy pjesë, njëra në anën e djathtë dhe tjetra në anën e majtë të trakesë. Prodhon hormonin e tiroksinës, që kryen funksionin e rritjes trupore dhe kontrollon proceset metabolike të organizmit në bashkëveprim me disa hormone të tjera. Vepron drejtpërdrejt në pjekurinë e cipës së trurit të madh dhe në zhvillimin e funksioneve psikike. Nëse prodhon sasi më të vogla të këtij hormoni nga ato që i nevojiten proceseve metabolike të organizmit, atëherë shkaktohet hipotireoza, ku organizmit i mungon energjia e duhur, lëvizjet e tij janë të ngadalësuara dhe të vrazhda. Nëse prodhon tiroksinë më tepër se sa i nevojitet proceseve metabolike të organizmit, atëherë shkaktohet sëmundja e Bazedovit me hiperaktivitet të organizmit.

TIROIDIZ/ËM, - MI. m. Çrregullim i funksionit të gjëndrës tiroide, që shfaqet në funksionin e tepruar ose të pakësuar të gjëndrës tiroide. Funksionimi i tepruar i saj emërtohet me termin hipertiroizëm. Kjo shkakton sëmundjen e Bazedovit që manifestohet me daljen jonormale të kokërdhokëve nga zgavrat e syve, përshpejtimin e proceseve metabolike, ngacmimin e tepruar të sistemit nervor etj. Mungesa e lindur e sekretimit të gjëndrës tiroide, përkatësisht hipotiroizmi shkakton kretenizmin, që manifestohet me zhvillimin e pamjaftueshëm fizik dhe me ritmin e vonuar dhe të kufizuar të zhvillimit të strukturave dhe të proceseve psikike.

TIROKSIN/Ë, - A. f. Hormon i gjëndrës tiroide që kontrollon proceset metabolike duke ndikuar njëkohësisht në shkallën e aktivitetit të organizmit. Ndikon në përforcimin e eshtrave, në aktivitetin e trurit, në peshën e organizmit, përshpejton ritmin e të rrahurit të zemrës etj. Mungesa e sasisë së

duhur të tiroksinës në fëmijëri shpie në ngadalësimin e zhvillimit të proceseve fiziologjike dhe psikike. Ndërkaq, hiperprodhimi i saj shpie shpesh në depresion, në frikë dhe në panik.

Burimet:

Aleksander R. Luria: *"The Working Brain"* – (*"Veprimtaria e trurit"*), Harmondsworth Penguin, 1973.

Carl Wernicke: *"Grundriss der Psychiatri. Psychophysiologische Einleitung"* – (*"Bazat e psikiatrisë. Hyrje në psikofiziologji"*), Wiesbaden , 1887.

Spencer A. Rathus: *"Essentials of Psychology"* – (*"Bazat e psikologjisë"*), Harcourt Brace College Publishers", 1994, fq. 97 – 101.

TIS, - I. m. Cipë e hollë mbështjellëse e një organi të trupit. Tisi i syrit është mbështjellësja e hollë e syrit të njeriut. Kjo është cipa e parë e syrit, përkatësisht brisi ose koroida. Shih – ***SYRI.***

TJETËRSIM, - I. m. Term i ardhur në psikologji nga filozofia që shpreh dukurinë e shndërrimit të njeriut, të punës e fryteve të tij në fuqi të huaja e armiqësore të vetë njeriut. Në psikologji tjetërsimi është çrregullim i përjetimeve, të cilat, megjithëse i janë bërë të njohura njeriut, përmbajtja e tyre bëhet e huaj dhe e panjohur për vetë atë, sepse rezultatet e veprimtarisë së tij i janë larguar kontrollit të vetëdijshëm nga ana e tij dhe janë bërë fuqi e jashtme, ku veprojnë ligjet e panjohura; situatat e tilla shkaktojnë përjetimin e pamundësisë të njeriut që të shfaqë potencialin krijues të tij. Tjetërsimi përjetohet si ndjenjë e papërshtatshme e moskuptimitë, e pafuqisë dhe e izolimit të personalitetit në raportet e caktuara ekonomike, politike e shoqërore të mjedisit të caktuar të personalitetit, të aktivitetit e zhvillimit të tij. Në rastet e përjetimeve të tjetërsimit njeriu ka ndjenjën se vetvetja dhe të tjerët janë më tepër sende tregu e malli, të qëruar nga natyra njerëzore e tyre**.**

TMERR, - I. m. Ndjenja e frikës së madhe, që shkaktohet në situata të rrezikshme, ndaj të cilave njeriu reagon me ndjenjën e sigurisë së madhe se ato situata për të janë të pazotërueshme, se këtyre situatave njeriu nuk mund t`ju shmanget dhe nuk ka rrugëdalje për të. Tmerri është strukturë e ndërlikuar ndjesore afektive e përbërë nga afekti ndaj objektit dhe situatës së rrezikshme, nga përjetimi kognitiv se kësaj situate njeriu nuk ia del t`i shmanget dhe, ngaqë nuk ka rrugëdalje, njeriu i lëshohet fatit të tij. Vlerësimi i tillë i situatave të rrezikshme kryhet shpejt, madje edhe në mënyrë të pavetëdijshme, duke u aktivizuar sistemi parasimpatik deri në atë masë, sa shkakton ndryshime të mëdha fiziologjike periferike e qendrore, si: humbje të aftësisë së mbajtjes së drejtpeshimit psikik e trupor, paralizë të pjesëve të trupit, depersonalizim etj.

TOGFJALËSHI PSIKOLOGJIK. Term psikologjik i përbërë nga dy ose më shumë fjalë që kanë kuptim të mirëfilltë psikologjik. Togfjalëshi psikologjik emërton konceptin e caktuar të psikologjisë. Të tillë janë togfjalëshat: procese psikike, tipi i temperamentit flegmatik, kujtesa afatgjatë etj.

TOKSIKOMANI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *τοξικο* "helm" dhe *μανία* "çmenduri". Toksikomania është gjendje psikike e çrregulluar e varësisë kronike ose periodike e marrësit të alkoolit, drogave, duhanit etj. Karakterizohet me pasionin e madh

dhe të shfrenuar për marrjen e lëndëve helmuese apo toksike, me rënie të aftësive fizike dhe mendore dhe me çrregullim të sjelljeve. Formë e rëndë e toksikomanisë është psikoza toksike, si dhe psikoza alkoolike.

TOLERANC/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *tolerare* "durim". Ka kuptim të përgjithshëm dhe të veçantë. Kuptimi i përgjithshëm ka të bëjë me qëndrimin e njeriut ndaj të tjerëve, dukurive shoqërore e pikëpamjeve të caktuara, të cilat i konsiderojmë më të vlefshme, më të rëndësishme dhe nuk dëshirojmë që këto t`i pengojmë e të vështirësojmë procesin e zhvillimit të tyre. Ky kuptim ka përbërësin kognitiv dhe atë emocional. Përbërësi kognitiv ka të bëjë me pranimin, durimin e qëndrimit të një individi tjetër, por duke mbajtur qëndrim të pashprehur të vetin. Përbërësi emocional ka të bëjë me kontrollin e emocioneve negative dhe moslejimin e shprehjes së tyre. Në psikologji toleranca ka kuptim të veçantë dhe zakonisht shprehet ndaj frustrimit, ndaj pengesave që i shfaqen njeriut në procesin e realizimit të dëshirës, të synimit etj.

TOLERANCA NDAJ FRUSTRIMIT. Gatishmëria e njeriut për të duruar gjendjen frustruese të shkaktuar nga pengesat fizike, morale, psikike etj., e paraqitur gjatë realizimit të dëshirës, të nevojës etj. Shkalla e tolerancës, përkatësisht e durimit të pengesave është e lidhur me pjekurinë e emocionale të njeriut, me zhvillim të duhur të inteligjencës, me përvojën e fituar gjatë jetës etj. Por, shkalla e tolerancës ose e durimit të gjendjes frustruese varet nga situata shoqërore penguese, nga gjendja momentale psikike e individit etj.; pragu i tolerancës ndryshon varësisht nga karakteri i pengesave dhe rëndësia e tyre për jetën dhe aktivitetin e njeriut dhe kjo ndryshon herë pas here. Ky prag është më i stabilizuar te ata që kanë përvojë të madhe jetësore.

TOLMAN Eduard (Edward TOLMAN). Psikolog amerikan. Lindi në West Newton (Masaçusets) më 14.04.1886 dhe vdiq në Berkeley (Kaliforni) më 19.11.1959. Pas përfundimit të studimeve për teknologji dhe mori drejtimin për psikologji pasi ndoqi me kujdes ligjëratat e Uiliam Xhejmsit. Më 1905 mbrojti tezën e doktoratës "Mbi kujtesën", ku trajtoi raportin ndërmjet kujtesës dhe ndjenjës. Para Luftës II Botërore kreu detyrën e asistentit të psikologjisë, të profesorit në Universitetin Berkli dhe në Universitetin e Çikagos. Ishte kryetar i Shoqatës Amerikane të Psikologëve më 1937. Gjatë Luftës II Botërore ka kryer edhe detyra ushtarake. U dallua në gjurmimet psikologjike për sjelljet dhe të mësuarit. Në mbështetje të rezultateve të hulumtimit të sjelljeve ai e korrigjoi bihejviorizmin klasik, duke hapur një horizont të ri neobihejviorist. Në psikologjinë e të mësuarit ka trajtuar konceptin "purposive behavior" – "sjellje e drejtuar në qëllim". Nga pikëpamja e neobihejvioristit ai konceptoi teorinë kognitive të të mësuarit – "Cognitive learning theory". Këtë teori të njohur edhe si Teori e orientimit – "Orientierungs Theory" e trajtoi në disa vepra, ndër të cilat më kryesoret janë: "*Purposive Behavior in Animals and Men*" – (*"Synimi i sjelljeve të kafshëve dhe njerëzve"*), 1932; "*Collected Papers in Psychology*" –

(*"Koleksion shkrimesh për psikologjinë"*), 1951; *"Principles of Purposive Behavior"* – (*"Parimet e synimit të sjelljeve"*), (botuar në kuadrin e veprës *"Psychology: A Study of Science"* – (*"Psikologjia: Një studim mbi shkencën*"), 1959.

TOMSON Godfri (Godfrey THOMSON). Psikolog skocez. Lindi më 1881 dhe vdiq më 1955. Qysh herët u mor me studime mbi filozofinë dhe kreu studimet universitare për filozofi në Strasburg më 1906. Në Universitetin e Edinburgut filloi punën si profesor në filozofi e psikologji, duke punuar 26 vjet prej vitit 1925 deri në vitin 1951. Tomson Godfri la gjurmë në zhvillimin e psikologjisë, sidomos në zhvillimin e psikometrisë në vendet anglosaksone. Gjurmimet psikometrike i drejtoi në studimet e strukturës së inteligjencës mbi bazën e gjurmimit sipas kampionit, gjedhes apo mostrës. Sipas rezultateve të gjurmimeve ai pohoi se inteligjenca nuk përbëhet vetëm prej dy faktorëve, siç kishte menduar Sirmani dhe as prej grup faktorësh, por nga shumë faktorë, të cilët nuk duhen konsideruar entitete të veçanta. Veprat kryesore të tij janë: *"The essentials of mental measurement"* – (*"Thelbi i matjeve mendore"*), 1911 (me bashkautor); "*Instinct, Intelligence and Character"* – (*"Instinkti, inteligjenca dhe karakteri"*), 1924; "*The factorial analysis of human ability"* – (*"Analiza faktoriale e aftësive të njeriut"*), 1938 etj.

TONALITET, - I. m. Formë e ndijimit dëgjimor apo akustik, që ka të bëjë me tonin ndikues në shqisën e dëgjimit dhe me oktavat e ndryshme të një toni të caktuar. Zakonisht tonaliteti emërton tonet shtesë të tonit themelor.

TON, - I. m. I ardhur nga greqishtja *tóvoç* "zë". Toni është zëri me një frekuencë të caktuar të dridhjeve të rregullta e harmonike të valëve ajrore. Në ndryshim nga zhurma, toni prodhohet nga dridhjet e parregullta të valëve ajrore, që prodhohen nga burimet akustike të ndryshme natyrore dhe artificiale. Veshi i njeriut është i ndjeshëm vetëm për ato tone që shkaktohen nga dridhjet mekanike dhe kanë dendësi dridhjesh prej 16 – 20.000 Hz në sekondë. Në psikoakustikë bëhet dallimi ndërmjet tonit të thjeshtë apo të pastër dhe atij të ndërlikuar. Toni i thjeshtë është ai ton që ka dridhje burimore me shpejtësi të barabartë, pra që është i përbërë vetëm prej një frekuence. Toni i ndërlikuar është toni i prodhuar nga burimi me dridhje të disa frekuencave, e pikërisht ai është i përbërë nga dy ose më shumë tone të thjeshta ose të pastra.

TONI EMOCIONAL. Tipar, përmasë e ndjenjës së kënaqësisë-pakënaqësisë, e cila shoqëron gjendjen dhe proceset psikike të njeriut, si edhe sjelljet e lidhura me to. Termi i përket psikologjisë strukturaliste të Eduard Tiçenerit (Edward Titchener, 1907 – 1988). Përfaqësuesit e psikologjisë strukturaliste e kanë emërtuar shtrirjen e përjetimit emocional nga skaji i kënaqësisë në skajin e pakënaqësisë. Në të folmen kolokviale, shpesh edhe në atë profesionale, termi shok emocional emërton ngjyrosjen emocionale të gjendjeve kognitive dhe të motivimit të njeriut me kënaqësi, me gëzim, me neveri etj.

TONI HEDONIST. Përmasa emocionale e ndijimeve dhe e disa formave

të aktivitetit të njeriut, e cila është e lidhur me kënaqësi dhe me pakënaqësi.

TONI I NGJYRËS. Cilësi specifike e ngjyrës, në bazë të së cilës një ngjyrë dallohet nga ngjyra tjetër. Tonin e ngjyrës e përcakton gjatësia e valëve elektromagnetike, kurse ndijimin e tonit të ngjyrës e përjetojmë si ngjyrë me shkallë të lartë ndriçimi. Valët elektromagnetike me gjatësi prej rreth 700 milimikronësh përcaktojnë tonin e ngjyrës së kuqe, valët elektromagnetike me gjatësi prej rreth 580 milimikronësh përcaktojnë tonin e ngjyrës së verdhë etj.

TONI ONTOGJENETIK. Përjetim i tonit të caktuar, që lind nga proceset fiziologjike të veshit, megjithëse ngacmuesi akustik i veshit mungon dhe nuk ka si të ushtrojë ndikim në shqisën e të dëgjuarit.

T

TONUS, - I. m. I ardhur nga latininishtja *tonus* "ngritje, tendosje". Tonusi në psikologjinë fiziologjike emërton shkallën normale të aktivizimit të indeve të organizimit të gjallë, pra gjendjen normale të tendosjes së muskujve. Kur është fjala për tonus të muskujve dhe për një ndjeshmëri të tillë, atëherë këtu kemi të bëjmë me ndijime proprioreceptive.

TONUSI MUSKULOR. Shkalla e tensionit të muskujve. Në kuptimin e ngushtë tonusi muskulor është tensioni i muskujve skeletorë, që është i pranishëm në këta muskuj, kur muskujt skeletorë janë në qetësi, pra nuk janë në veprim**.**

TOPIK/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *topos* "vend, pozicion i një argumenti në kuadrin e një klase argumentesh të caktuara". Termi topikë u përdor më tepër në psikanalizë. Me këtë term emërtohet pozicioni i shtresave të personalitetit. Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1939) në zhvillimin e mendimit të tij termin topikë e ka përdorur më 1900 – 1920, ku ka emërtuar të pavetëdijshmen, të paravetëdijshmen dhe të vetëdijshmen. Në konceptin e dytë (1920 – 1939) topikën e ka përdorur për të emërtuar shtresën e idit, të egos dhe të super egos, në aparatin psikik dhe në zhvillimin e proceseve psikike dhe të sjelljeve të njeriut.

Burimet:

Sigmund Freud: *"Hyrje në psikanalizë",* Tiranë, 2005.

Sigmund Freud: *"Metapsikologjia",* Tiranë, 2003.

TOPITJA MENDORE. Term i vjetër për shkallën e ulët të zhvillimit të aftësive intelektuale. Këtë e karakterizon ajo shkallë e zhvillimit të aftësive intelektuale, kur njeriu në përgjithësi, gjendet ndërmjet shkallës së fundit të zhvillimit normal dhe fillimit të shkallës së prapambetjes mendore. Ata që vuajnë nga topitja mendore kanë një koeficient të inteligjencës ndërmjet 70 – 84. Topitja mendore shfaqet zakonisht me mungesë të kërshërisë, të nismës për të ditur dhe për të vepruar, me mungesë të plotë të ndonjë forme të mendimit krijues. Këta individë arrijnë ta kryejnë shkollimin fillor me angazhimin e posaçëm të tyre, të prindërve dhe të arsimtarëve, por, megjithëkëtë, mezi arrijnë të fitojnë sjellje për t`u kujdesur për veten e tyre dhe për të kaluar një jetë relativisht normale, në varësi nga kushtet shoqërore, nga zhvillimi i proceseve emocionale etj.

TOPOGRAFI, - A. f. Term i psikologjisë i ardhur nga gjeografia, e pikërisht nga greqishtja *τοπο* "vend" dhe *γραφία* "grafi". Në psikologji emërton marrëdhëniet hapësinore ndërmjet strukturave psikike dhe vendndodhjes së tyre në zhvillimin e tërësishëm psikonervor të proceseve psikike dhe të sjelljeve. Termi shfrytëzohet më shumë në psikologjinë fiziologjike, ku bëhet fjalë për lokalizimin e proceseve psikike në trurin e madh dhe në cipën mbështjellëse të tij.

TORNDAJK Eduard (Edward THORNDIKE). Psikolog amerikan. Lindi më 1874 dhe vdiq më 1949. Studioi në Universitetin e Harvardit, ku u përqendrua në studimet e filozofit dhe psikologut amerikan Uiliam Xhejms dhe mbrojti doktoratën me tezën "Inteligjenca e kafshëve: studim eksperimental mbi proceset asociative të kafshëve" – "Animal Intelligence: An Experimental Study of the Associative Processes in Animals". Themeloi laboratorin për hulumtimin e sjelljeve të kafshëve në Universitetin e Kolumbias, ku punoi nën drejtimin e Bernard R. Katelit. Në gjurmimin e inteligjencës së kafshëve zbatoi metoda të reja hulumtuese, duke e vendosur macen e uritur në një kafaz, për të vëzhguar si ajo mëson të dalë nga kafazi dhe të arrijë deri te ushqimi. Pas shumë provash vuri re se macja nuk veproi sipas mësimit (gjetjes së raporteve ndërmjet derës, dorezës së derës së kafazit dhe ushqimit të vënë jashtë kafazit), por ajo mësoi të dalë jashtë kafazit pas shumë lëvizjeve të pasuksesshme, të verbëta dhe gjetjes rastësisht të vendit ku duhej prekur susta që të hapej dera e kafazit e që ajo t`i vërsulej ushqimit, mishit. Këtë e quajti metoda e të mësuarit sipas orvatjeve të gabuara dhe suksesit të rastit – "trial and error". Eduard Torndajk arriti në konkluzionin se kafshët mësojnë sipas kësaj metode dhe ky mësim ka karakter instrumental, duke u kryer sipas ligjit të efektit të të mësuarit. Në bazë të ligjit të efektit kafsha i mëson lëvizjet e reja, pra ndryshon sjelljet, kur këto shkaktojnë kënaqësi te ajo; kënaqësia siguron përsëritjen e sjelljeve dhe kafsha në bazë të përsëritjeve, gradualisht i mënjanon lëvizjet e pasuksesshme, duke përforcuar ato të suksesshmet dhe lidhjet ndërmjet tyre. Me këto rezultate ushtroi ndikim pozitiv në zhvillimin e psikologjisë, sidomos të psikologjisë bihejvioriste, duke i dhënë shkas konceptimit të të mësuarit operant. Pikëpamjet e tij për procesin e të mësuarit kanë ushtruar ndikim edhe në zhvillimin e pedagogjisë. Është hartues i disa testeve, ndër të cilët duhet dalluar testi i dendësisë së fjalëve të gjuhës angleze. Veprat kryesore të tij janë: *An Introduction to the Theory of Mental and Social Measurement"* – (*"Hyrje në teorinë e matjes mendore dhe shoqërore"*), 1904*; "The elements of psychology"* – (*"Elementet e psikologjisë"*), 1905; *"The Psychology of Learning"* – (*"Psikologjia e të mësuarit"*); *"The measurement of intelligence"* – (*"Matja e inteligjencës"*), 1926; "*Human Learning"* – (*"Të mësuarit e njeriut"*), 1931; "*The Fundamentals of Learning"* – (*"Bazat e të mësuarit"*), 1932 etj.

TORTUR/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *torquere* "lëviz". Tortura është mundim fizik i njeriut me vuajtje psikike të rënda, që i shkaktohen tjetrit (kryesisht fajtorit) me ndërmarrjen e

masave të posaçme për ta detyruar atë t`i tregojë të fshehtat bashkëvepruesit etj.

TOTEM, - I. m. I ardhur nga gjuha e fisit Indian të Amerikës Veriore, Oxhibua, *ototeman* "i fisit të tij". Kafshë, bimë dhe sende adhuruese të shenjta të fisit, me të cilat anëtarët e fisit e lidhin prejardhjen e tyre dhe totemi përfaqëson simbolin kryesor të tyre. Zakonisht bimëve e kafshëve të caktuara anëtarët e një fisi apo grupi u atribuojnë rol të posaçëm. Totemi (adhuruesi) konsiderohej mbrojtës i fuqishëm i anëtarëve të fisit dhe nuk mund të prekej (të dëmtohej). Për këtë shkak ai adhurohej. Në psikanalizë totemi është konsideruar ati (babai) i parë simbolik.

TOTEMIZ/ËM, - MI. m. Besëtytni e bazuar në totem, përkatësisht në lidhjen farefisnore të tyre me ndonjë kafshë, send apo bimë, e cila adhurohet nga anëtarët e një fisi të caktuar, ngaqë i pari i tyre konsiderohet kult. Karakterizon fiset e nivelit të ulët zhvillimor e kulturor. Totemizmi ka organizim të veprimeve, të zakoneve të ndalesave etj., që janë të lidhura ngushtë me mbrojtjen e me ardhmërinë e totemit të tyre. Për këtë shkak në totem askush nuk ka të drejtë të ngrejë dorën, totemi i tyre nuk guxon të vritet, të përdoret për ushqim etj. Konsiderohet se është forma më e vjetër e religjionit. Ka lindur nga ndjenja e pendimit për krimin e bërë nga ana e djemve të padëgjueshëm, apo djemve rebelë.

TRADIT/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *tradition* "bartje, dorëzim". Zakone, shprehi, virtyte, modele sjelljesh dhe veçori sjelljesh karakteristike të një populli, kombi që janë formuar gjatë zhvillimit të tij, duke u mbartur brez pas brezi dhe, duke pasur vazhdimësinë, i kanë dhënë identitet kulturës së një populli. Burimi i traditës është e kaluara e një populli me tërësinë e besimeve, të dijeve, të sjelljeve, të virtyteve etj. Kjo trashëgimi shoqërohet ose mbartet prej një brezi në tjetrin falë edukatës, në radhë të parë asaj familjare, dhe përgjithësisht procesit të shoqërizimit. Zakonisht bëhet ndarja e traditës në traditën pozitive dhe në atë negative. Tradita pozitive është bartje e përvojës pozitive, e të mirave të kultivuara kulturore, e parimeve, e modeleve të sjelljeve të mira. Tradita negative ka të bëjë me bartjen e modeleve të ngurosura të mendimeve, pikëpamjeve, qëndrimeve dhe sjelljeve prej një brezi në tjetrin.

TRAJNIM, - I. m. Term i anglishtes i futur rishtas në terminologjinë e kulturës fizike dhe në atë të psikologjisë. Haset shpesh në përkthimin e përmbajtjeve psikologjike nga anglishtja në shqipe. Trajnimi është proces i organizuar e sistematik veprimesh, ushtrimesh e stërvitjesh të një ose disa individëve që realizohet praktikisht me përsëritje të sakta, derisa këta të mos e zotërojnë plotësisht veprimtarinë e caktuar (shkathtësinë apo shprehinë e posaçme). Kjo veprimtari zotërohet atëherë, kur ekzekutohet saktësisht, shpejt dhe e koordinuar në mënyrë të përkryer. Mbështetet në reagimin e saktë, të shpejtë, të koordinuar dhe të sigurtë të individit ndaj një ngacmuesi të caktuar.

TRAJNIMI SPECIFIK. Term i psikologjisë së sportit që emërton të

ushtruarit e atyre shkathtësive që janë karakteristike vetëm për një garë sportive kulmore, si: çiklizmi, noti, vrapimi në atletikë etj. Ky lloj të ushtruari ka sukses kur ka të bëjë vetëm me një disiplinë sportive, madje edhe me ato të ngjashme. Falë trajnimit specifik arritjet e sportistëve kulmorë dallojnë nga arritjet e sportistëve mesatarë dhe atyre nën mesatarë.

TRAJTIMI PSIKOLOGJIK. Mënyrë veprimi dhe procedimi profesional e përpunimit të një sjelljeje dhe e motiveve të saj, që konsiderohet se është çështje individuale dhe kërkon angazhim të posaçëm profesional të një psikologu, zakonisht të një psikologu klinik. Ekzistojnë forma të përgjithshme për kategoritë e veçanta të sjelljeve të çrregulluara, që mund t'i përshtaten nevojave personale.

TRAKE, - JA. f. Term i anatomisë i ardhur nga latinishtja *trachea* "skërfyell". Gyp elastik i organeve të frymëmarrjes i gjatë rreth 12 cm dhe i gjerë rreth 2 cm. Trakeja shtrihet në mes të gurmazit dhe vendit ku ndahen bronket. Struktura e saj është formuar prej 16 – 20 unazash kërcore që janë të lidhura ndërmjet tyre. Pjesa e parë është e lëvizshme në drejtimin lart–poshtë. Është e hapur për kalimin e ajrit.

TRAKOM/Ë, - A f. Sëmundje e konjuktivës së kokërdhokut apo bulbit të syrit që ka të bëjë me çarjen e vezikulave të mbushura me virusin filtrues. Pasojat e saj në rast mosmjekimi mund të jenë të rënda për procesin e të parit: turbullimi i të parit të brisit ose kornesë, deformimi i kapakëve të syrit, ndijimi i cilësive pamore të trupave dhe perceptimi i tyre në fillim të zhvillimit të kësaj sëmundje (sidomos në fazën e tretë dhe të katërt) turbullohet gjithnjë e më shumë dhe, nëse nuk mjekohet, ky proces shpie deri në verbim. Zona endemike në Kosovë ka qenë Rrafshi i Dukagjinit, Lushnja e Fieri. Falë zhvillimit të oftalmologjisë dhe punës së përkushtuar të mjekëve në Kosovë dhe në Shqipëri trakoma po shfaqet gjithnjë e më pak.

TRAKT, - I. m. I ardhur nga latinishtja *tractus* që emërton gërshetën e fijezave nervore, duke formuar një tërësi anatomike e fiziologjike rrugore të posaçme, që ka formën e një gypi. I tillë është trakti i fijezave nervore kortikoshpinore.

TRAKTI PAMOR. Emërtim i asaj pjese të rrugës së nervit pamor që fillon nga kiazma pamore dhe përfundon në trupat anësorë të formës së bërrylit të qendrës pamore.

TRANS, - I. m. I ardhur nga latinishtja *transitus* "kaloj nëpër. . ". Në kuptimin burimor transi është kalimi nga jeta në vdekje. Transi është gjendje psikofizike e posaçme, e ngjashme me gjumin, që paraqet këto veçori: zvogëlim i ndjeshmërisë ndaj ngacmuesve të jashtëm, dalja e njeriut nga vetvetja dhe "shkrirja" e tij në një kult të lartë, entuziazmi i nivelit të lartë, me halucinacione, me sjellje të pakontrolluara, me ritëm të përshpejtuar të rrahjes së zemrës, me presion të rritur të gjakut etj. Në disa besime religjioze gjendja e transit shkaktohet nga ritualet e veçant**a.**

TRANSAKCION, - I. m. Term i përgjithshëm, që në psikologji përdoret në disa fusha të proceseve psikike dhe të sjelljeve. Emërton shndërrimin e

një ane apo të një funksioni të proceseve psikike dhe të sjelljeve ndërmjet bartësit dhe individëve të tjerë të një mjedisi. Thelbin e këtyre ndryshimeve të proceseve psikike dhe të sjelljeve e përcakton raporti ndërmjet dy apo disa individëve të një mjedisi shoqëror.

TRANSAKCIONI I PERCEPTIMEVE. Varësia e perceptimit të objekteve, dukurive dhe situatave nga përvoja dhe dija e përftuar në aktivitetin reciprok ndërmjet individit dhe mjedisit. Sipas kësaj pikëpamjeje perceptimi i objekteve, i dukurive, i situatave etj. shkaktohet nga transaksioni i përmbajtjeve perceptuese mbi bazën e raportit ndërmjet bartësit të perceptimit dhe mjedisit të tij. Sipas kësaj pikëpamje perceptimi nuk është pasqyrim aktiv i objekteve, i proceseve dhe situatave reale, por ai është rezultat i supozimeve, madje edhe i atyre të pavetëdijshme të njeriut**.**

TRANSDUKSION, - I. m. Term me kuptim të posaçëm në biologji (bartje e lëndës gjenetike prej një qelize në tjetrën), në fizikë (shndërrimi i një forme të materies në tjetrën) etj. Ky term në psikologji haset në shkrimet e psikologut gjerman Vilhelm Shtern (Wilhelm Stern, 1871 – 1938). Në psikologji është term i psikofiziologjisë, që emërton shndërrimin e energjisë fizike (të valëve elektromagnetike, të nxehtësisë, të energjisë mekanike etj.) në impulse nervore nga ana e receptorëve dhe bartjen e tyre në qendrat e posaçme të cipës së trurit të madh, ku lindin ndijimet e perceptimet. Në psikologjinë kognitive transduksioni është shndërrimi i një informacioni në formën tjetër të tij.

TRANSFERIM, – I. m. I ardhur nga latinishtja *transferre* "tejbartje". Ka kuptimin e bartjes së qëndrimeve, të emocioneve nga një individ (nga psikoterapeuti) te individi tjetër (te pacienti). Transferimi mund të jetë pozitiv – tejbartje e qëndrimeve dhe emocioneve nga një subjekt në tjetrin dhe mund të jetë negativ – frenimi i bartjes së përvojës, të emocioneve etj. nga njëri subjekt në tjetrin. Kjo varet nga lidhja miqësore ose armiqësore ndërmjet psikoterapeutit dhe pacientit. Në psikanalizë transferimi shpjegohet si tejbartje e përmbajtjeve të pavetëdijshme të emocioneve dhe qëndrimeve ndaj prindërve që nga fëmijëria e deri në moshën madhore, përmbajtje të cilat i bart edhe te të tjerët.

TRANSFERIMI I TË MËSUARIT. Funksion i veçantë dhe shumë i rëndësishëm i të mësuarit që ka të bëjë me ndikimin që ushtron të mësuarit e një lënde mësimore në të mësuarin e përmbajtjes së një lënde tjetër, tejbartje e asaj që është mësuar dikur në të mësuarin e tanishëm dhe në veprimtarinë e përgjithshme të njeriut. Thelbi i procesit të transferimit të të mësuarit qëndron në bartjen e përvojës prej një fushëveprimi në fushëveprimin tjetër. Ajo që bartet mund të jetë dija, metodat e të mësuarit, qëndrimet e formuara për parimet dhe format e të mësuarit etj. Kjo bartje ushtron ndikim në zhvillimin dhe në përsosjen e vëzhgimit, të kujtesës, të mendimit etj., në organizimin racional të jetës psikike dhe të sjelljeve të njeriut. Sikur të mos kishte transferim në procesin e të mësuarit nuk do të kishte kuptim mbështetja e të mësuarit të lëndëve të shkollës së mesme në të mësuarit dhe

të zotëruarit e lëndëve të shkollës fillore, madje edhe ndërlidhja e teorisë me praktikën mund të kuptohej dhe të shpjegohej me vështirësi.

TRANSFERIMI NEGATIV. Bartja ose transferimi i përvojës, i metodave, i përmbajtjeve etj. që e vështirësojnë dhe e pengojnë zhvillimin e përvojave të reja, formimin e koncepteve të reja dhe të lidhjeve ndërmjet tyre, zhvillimin e shkathtësive të reja etj. Transferimi i tillë i përvojës dallohet sidomos në fushën e psikomotorikës: ai që ka mësuar të ngasë makinën familjare me timon nga e majta mëson më me vështirësi ta ngasë të njëjtën makinë me timon nga e djathta etj.

TRANSMETIMI KIMIK. Procesi i bartjes së stimujve informativë nga një neuron në neuronin tjetër. Në procesin e transmisionit kimik marrin pjesë neurotransmetuesit, neuromodulatorët, hormonet dhe feromonët, që njëkohësisht kontrollojnë aktivitetin e qelizave, të organeve dhe të organizmit.

TRANSMETUES, - I. m. Në psikologjinë fiziologjike transmetuesi është substanca me strukturë të veçantë biokimike, e cila vë në lëvizje mbartjen e impulseve nervore, duke ngacmuar apo eksituar neuronin më të afërt me atë të ngacmuarin. Shih – ***NEUROTRANSMETUESIT.***

TRANSPOZICION – I. m. I ardhur nga latinishtja *transpositio* "tejvendosje". Në psikologji transpozicioni (tejvendosja) është dukuria e bartjes së elementeve të një raporti nga një sistem në një sistem tjetër. Kështu, në psikologjinë geshtaltiste një melodi mund të tejvendoset nga një tonalitet në tjetrin, por ajo perceptohet si e njëjtë, e pandryshueshme, sepse konfigurimi tonal mbetet i pandryshueshëm. Në sistemin e përkthimit të përmbajtjes së një koncepti, përkthyesi mund të përdorë fjalë të tjera për të njëjtin koncept, e pikërisht mund të bëjë edhe tejvendosje fjalësh, por kuptimi i tyre nuk ndryshon.

TRANSVERTIZ/ËM – MI. m. I ardhur nga latinishtja *trans* "nëpër" dhe *vestiv* "veshje". Çrregullim i përgjithshëm mendor i individit, që shfaq sjelljen e të veshurit të rrobave të gjinisë së kundërt, por nuk ka të bëjë me dëshirën e ndryshimit të gjinisë. Ka lidhje të ngushtë me dëshirën për ndryshimin e identitetit gjinor. Ka përmasën e sjelljes së çrregulluar, e cila në klasifikimin e përgjithshëm të çrregullimeve mendore bën pjesë në grupin ICD – 10.

TRASHËGIMI, - A. f. Bartje biologjike e veçorive gjenetike prej prindërve te fëmijët e tyre. Njëra ndër karakteristikat e qenieve të gjalla, që ka të bëjë me tërësinë anatomike, fiziologjike dhe psikike të zhvillimit individual – bartës i aftësive gjenetike të njeriut për të zhvilluar tiparet e paraardhësve (të prindërve) të tyre. Trashëgimia në psikologji ka të bëjë me bartje të tipareve psikofizike nga prindërit te pasardhësit e tyre. Në këtë pikëpamje trashëgimia biologjike duhet ndarë nga trashëgimia psikologjike. Në psikologji bëhet fjalë për shkallët e ndryshme të trashëgimisë së tipareve të disa strukturave të personalitetit, në radhë të parë të përbërjes së trupit të njeriut, të inteligjencës dhe të temperamentit, si edhe për bartjen

e disa sëmundjeve dhe çrregullimeve psikike, si: daltonizmi, prapambetja mendore, ndoshta edhe për ndonjë psikozë. Bartës të trashëgimisë janë pjesërisht gjenet e prindërve; secili nga prindërit i jep pasardhësit numër të njëjtë gjenesh, por këto nuk shkrihen në organizmin e pasardhësit.

TRASHËGIMIA – MJEDISI. Në psikologjinë gjenetike apo zhvillimore konsiderohet problem fondamental ndikimi i trashëgimisë dhe i mjedisit në zhvillimin psikofizik të individit. Ky problem në të kaluarën është shtruar në formën e ngutshme dhe të vrazhdë: individi a është produkt i trashëgimisë apo i faktorëve mjedisorë shoqërorë, ekonomikë, kulturorë etj. Sot problemi trashëgimi-mjedis shtrohet në formën e raportit të këtyre faktorëve dhe në masën e ndikimit të njërit dhe të tjetrit në zhvillimin e tipareve psikofizike të personalitetit. Shih ***– PROBLEMI TRASHËGIMI – MJEDIS – EMPIRIZËM.***

TRAUM/Ë, - A. f. I ardhur nga greqishtja *τραύμα* "plagë". Term i mjekësisë dhe i psikologjisë klinike. Në mjekësi emërton plagën ose lëndimin fizik apo trupor të njeriut. Prej këtej ka ardhur në psikologji duke emërtuar përvojën negative të individit, e cila godet unitetin e personalitetit e tij, duke shkaktuar frikë dhe trishtim intensiv me rrjedhime negative në procesin e përshtatjes së individit ndaj mjedisit ku ai jeton dhe vepron. Shkak i pasojave të tilla mund të jenë përjetimi i një ngjarje të dhimbshme, të rëndë për njeriun, që lë pasoja psikike negative të përhershme, përkatësisht të qëndrueshme, prania e individit në ceremoninë e një vdekjeje tepër të rëndë, dhuna fizike etj. Traumat në psikologji janë të lidhura më tepër me "plagët" emocionale dhe me reflektimet e tyre në sjelljet e papërshtatshme të njeriut. Kur traumat përjetohen në fëmijërinë e hershme, atëherë këto lënë gjurmë të thella dhe të dëmshme për jetën psikike të njeriut dhe për sjelljet e tij në moshën e mëvonshme, duke mos arritur të ruajnë kontrollin ndaj sjelljeve të veta. Kjo pengon zhvillimin psikik, duke shkaktuar edhe disa forma sjelljesh të çrregulluara, sidomos kur këto janë përjetuar në fazën e fëmijërisë së hershme dhe të vonshme të moshës fëmijërore.

TRAUMA E LINDJES. Dhembje e shkaktuar gjatë lindjes së foshnjës nga vrulli i shkëputjes së organizmit të fetusit nga mitra dhe fillimi i përshtatjes së të porsalindurit ndaj kushteve dhe rrethanave të një ambienti krejtësisht tjetër, për të cilin thuhet se është ambient me "pamje" armiqësore për të. Sjelljet neurotike dhe vështirësitë e përjetuara më vonë janë edhe pasojë e kësaj traume dhe e prirjes së organizmit për t`u kthyer në gjendjen e mëparshme. Këtë e ka theksuar psikanalisti austriak Oto Rank (Otto Rank, 1884 – 1939), si edhe Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1938), duke theksuar që "i porsalinduri kalon shpejt nga mjedisi i qëndrueshëm, i ngrohtë dhe i mbrojtur, që është model i mirëqenies së nivelit më të lartë, në një mjedis të ri shumë të pakëndshëm, të ftohtë dhe të rrezikshëm, ku është i bombarduar nga një numër i madh ngacmuesish; ai tashmë gjendet në gjendje shoku, sepse është ndarë nga simbioza organike e lidhjes me nënën dhe fillon të marrë frymë

me mushkëri të papërgatitura". Kjo gjendje konsiderohet se është gjendje e përgjithshme apo universale. Nga gjendja e tillë e të porsalindurit zhvillohen më vonë format e ndryshme të frikës prej ndarjes nga të tjerët, nga situatat e qëndrueshme, madje edhe nga vdekja.

TRAZIMI NERVOR. Proces i shkurtër ndryshimesh elektrobiokimike i neuroneve dhe i pjesëve të tyre. Shkaktohet nga ndikimi që ushtron ngacmuesi i jashtëm në qelizën nervore dhe në pjesët e saj. Ky trazim përhapet dhe bartet prej një neuroni në neuronin tjetër me një shpejtësi rreth 100 m në sekondë.

TREDHJ/E, - A f. Rrëgjim, dobësim, zvogëlim, largim i organit mashkullor dhe i gjëndrave seksuale të një kafshe ose njeriut – kusht i riprodhimit të tyre. Në psikanalizë termi tredhje ose kastrim ka domethënie të veçantë. Sipas themeluesit të psikanalizës Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) tredhja a kastrimi është kompleks i ndjenjës së rrezikut që përjeton fëmija, kur ai konstaton dallimet anatomike ndërmjet pjesëtarëve të gjinisë mashkullore e asaj femërore. Ky kompleks shfaqet me frikën e fëmijës 3 – vjeç, kur ai kërcënohet se do të dënohet me prerje të organit seksual. Ka përmasë të hershme filogjenetike.

TREGIMI PSIKOLOGJIK. Vepër letrare që i kushtohet një ngjarjeje të veçantë, sidomos tipareve të personazheve të asaj ngjarjeje. Në tregimin psikologjik përshkruhen tiparet më të rëndësishme të karakterit dhe të personazhit, për të cilin bën fjalë ky tregim. Këtu tërësia e ngjarjes e përshkruar dhe e shpjeguar në artin e letërsisë pothuajse reduktohet gati e tëra në psikologjizim, përkatësisht në reduktimin e begatisë së sjelljeve njerëzore në shprehjen e jetës shpirtërore dhe të tipareve të personazheve të tregimit (Anton Çehov, Ernest Heminguei, Sterio Spasse etj.).

TREKSION, - I. m. Term i veçantë i psikologjisë së Rajmond B. Katelit (Reymond B. Cattell (1905 – 1998). Me këtë term emërtohet skaji negativ i tiparit të personalitetit ose i faktorit H. Ky skaj negativ i tiparit apo faktorit H shfaqet me këto forma sjelljesh të qëndrueshme, madje edhe të lindura: frika e madhe dhe përjetimi i ndjenjës së rrezikut të shoqëruara me raporte ftohtësie ndaj të tjerëve, me qëndrime dhe sjellje të turpshme dhe pak të interesuar ose aspak të interesuar për raporte seksuale. Këtë faktor Rajmond B. Kateli e ka shënuar me shkronjën H, që ndryshon nga tipari ose faktori parmia, të cilin e ka shënuar me shkronjën H+.

TREMB/Ë, - A. f. Lloj frike e shkaktuar nga një situatë e papritur që paraqet rrezik për individin ose së paku ai mendon dhe beson se ajo është e rrezikshme për të. Ka karakter të përkohshëm dhe paraqitet me ndryshime fiziologjike, madje herë-herë të shoqëruara edhe me disa lëvizje e dridhje duarsh të pakontrolluara.

TREMOR, - I. m. I ardhur nga greqishtja *τρέμω* "dridhje". Tremori emërton dukurinë e dridhjeve të pakontrolluara të muskujve të disa organeve, dridhjen e gishtërinjve, të kapakëve të syrit, të kokës, madje edhe të gjithë trupit. Rrjedh nga shkaqet fiziologjike,

sëmundjet nervore, sëmundjet e gjëndrave, nga helmimi i organizmit etj. Kjo dukuri e rrallë shkaktohet edhe nga faktorët psikogjenë, si: frika e madhe, tmerri, çrregullimet mendore etj. Mbështetet në ngërçin e përkohshëm të muskulit agonist dhe të atij antagonist .

TRENIM, - I. m. Gjendje çmendurie e individit që karakterizohet nga paaftësia e përmbajtjes së vetes, të mendimeve, të veprimeve dhe të ndjenjave. Gjendja e tillë shfaqet me shfrenim të ndjenjave dhe të aktiviteteve të njeriut që vuan nga trenimi. Shfrenimi i këtillë ushtron ndikim negativ në rrjedhën e mendimeve dhe të veprimeve.

TRIADA DEPRESIVE. Strukturë psikike kognitive e atyre individëve që vuajnë nga depresioni. Këtë e përbëjnë: mendimet dhe qëndrimet negative për vetveten, për mjedisin rrethues të gjerë (bota është e padrejtë) dhe mendimet e qëndrimet negative për të ardhmen (e ardhmja është e pashpresë, e zymtë dhe dëmprurëse). Proceset njohëse kontrollojnë një pjesë të mirë të ndjenjave dhe sjelljeve. Ndryshimi pozitiv i këtyre proceseve shkon në të mirë të reagimeve emocionale dhe sjelljeve të lidhura me to.

TRIKOTOMI, - A. f. Ndarje e një tërësie në tri pjesë, kryesisht për qëllime studimore. E tillë mund të jetë ndarja e qëndrimeve dhe e vlerave shoqërore në ato pozitive, negative dhe asnjanëse apo neutrale; teoria trishtresore e inteligjencës, struktura trishtresore psikike e Zigmund Frojdit etj. Të dhënat e përftuara nga matja e një ndryshoreje psikologjike mund të ndahen në tri kategori të dhëna mbi të mesmen aritmetike, nën të dhe në të dhëna të skajshme të njërës apo tjetrës kategori.

TRILL, - I. m. Dëshirë me përmasa ndjenjash të vrullshme që shfaqet në formë nevoje dhe kërkese të rastit për individin e caktuar, të gjendur në një situatë ku pritet aktivitet me fuqi shtytëse drejtuar në realizimin e trillit. Ky term ka përdorim të rrallë.

TRILLIM, - I. m. Mendim i pavërtetë për qëndrimin, sjelljen dhe punën e tjetrit, që hartohet me qëllim të cenimit të famës, të nderit, të respektit të tjetrit. Në krijimet letrare trillimi është mjet i përdorur nga shkrimtari për të krijuar figura letrare në bazë të studimit të thellë të ngjarjes së një tregimi, të ngjarjeve të një novele etj.

TRINATOPI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *τρίτος* dhe *ανοψία* "verbim". Formë e verbimit të pjesshëm ose të tërësishëm për disa ngjyra kromatike. Është formë e trashëguar e dikromisë, përkatësisht e çrregullimit të perceptimit të ngjyrës së kuqe dhe të gjelbër. Trinatopia shfaqet me humbjen e aftësisë së dallimit të cilësisë së ngjyrës së kaltër dhe pamundësinë e dallimit të ngjyrës vjollcë nga ajo e gjelbër–e verdhë. Është dukuri e rrallë dhe është e treta në radhën e verbimit të tillë të ngjyrave (përpos deuteranopisë – pamundësi e perceptimit të ngjyrës së gjelbër dhe e dallimit të së kuqes dhe të së gjelbrës dhe protanopisë – paaftësi e dallimit të ngjyrës së kuqe nga ngjyra e gjelbër). Shkaktohet nga mungesa e pigmenteve për absorbimin e ngjyrës së kaltër (e kaltra konsiderohet ngjyra e tretë e grupit të ngjyrave parësore).

TRISHTIM, - I. m. Ndjenjë me intensitet të lartë frike, mërzie, vuajtje etj.

Përjetohet në formë afekti te individi që mendon dhe beson se objekti ose situata me të cilën ai është ballafaquar është e tillë, që ai nuk mund ta zotërojë, nga kjo situatë nuk mund të largohet dhe nuk ka dalje normale prej saj. Ushtron ndikim të fuqishëm në aktivitetin e njeriut, duke çrregulluar tërësisht sistemin e reagimit, duke e paralizuar atë dhe duke kërkuar në mënyrë të pavetëdijshme largim nga ajo situatë prej së cilës objektivisht nuk mund të largohet. Pohohet se kjo është rudiment i një mekanizmi të hershëm, që paraqitet edhe te kafshët e rendit të lartë. Te kafshët trishtimi shkakton gjendjen e nënshtrimit të saj ndaj sjelljeve agresive të kafshës tjetër.

TRIZOMI, - A. f. Çrregullim gjenetik i kromozomeve me pasoja psikike të rënda. Dallohen dy forma karakteristike: trizomia 18 dhe trizomia 21. Te forma e parë paraqitet anomalia e kromozomit të tretë dhe e kromozomit 18, kurse te forma e dytë paraqitet anomalia e kromozomit 21. Trizomia 18 shfaqet me këto çrregullime psikofizike: trupshkurtësia, zhvillimi i parregullt i veshëve, gishtërinjtë e kthyer etj., zhvillim i kufizuar mendor. Trizomia 21 ka të bëjë me sindromën Daun – forma më e shpeshtë e zhvillimit mendor të nivelit të ulët. Shih – ***SINDROMA DAUN.***

TRONDITJA PSIKIKE. Gjendje emocionale e shkaktuar nga shqetësimi i ardhur nga e keqja e papritur (fatkeqësia në komunikacion, lajmi për vdekjen e shokut të ngushtë etj.). Gjendjen e tillë emocionale e karakterizon pushtimi i njeriut, nga dhembja e pikëllimi. Nga gjendja e tillë njeriu çlirohet ngadalë dhe me vështirësi.

TROPIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga greqishtja *τροπισμός* "kthim". Tropizmi është formë e reagimit automatik të disa pjesëve të bimës ndaj ngacmuesve të caktuar të tyre. Shfaqet në disa forma, nga të cilat më të njohurat janë: fototropizmi – kthimi i bimës ndaj burimit të dritës, heliotropizmi – kthim i bimës ndaj diellit, gjeotropizmi – kthim i bimës në drejtim të tokës. Tropizmi mund të shfaqet edhe në formën negative të bimës ndaj një ngacmuesi të caktuar. Kështu, disa bimë largohen nga burimi i dritës, i zërit, i nxehtësisë etj.

TRUHJE, - A. f. Përkushtim i thellë i një individi ndaj mikut, shokut dhe veprës së tij. Truhja ka për bazë ndjenjën e adhurimit. Është pjesë përbërëse e mekanizmit psikik të lidhjes emocionale që ngrihet mbi ndjenjën e dashurisë shoqërore. Por, truhja është cilësi e posaçme e dashurisë shoqërore të shoqëruar me adhurim të tjetrit dhe të veprës së tij.

TRUNGU I TRURIT. Pjesa e mesme e sistemit nervor, përkatësisht pjesa e poshtme e trurit që është në lidhje të drejtpërdrejtë me palcën e kurrizit. Trungun e trurit e përbëjnë këto pjesë: pjesa vazhduese e palcës së kurrizit, e njohur me termin latin *medulla oblongata*, ura e trurit (pons) dhe truri i mesëm (mezencefalon). Përgjatë trungut të trurit shtrihet formacioni apo substanca retikulare. Qendrat trunore të trungut kontrollojnë disa nga funksionet kryesore të jetës së njeriut.

TRUPAT MAMILARË. I ardhur nga latinishtja *corpora mamilaria.* Grup qelizash nervore anësore të hipotalamusit. Trupat mamilarë kanë lidhje të

ngushta dhe të ndërlikuara me pjesët e tjera të trurit të madh. Këta trupa qelizorë kryejnë disa funksione, ndër të cilat edhe funksionin e rregullimit të jetës emocionale të njeriut, të funksionimit të rregullt të kujtesës së njeriut etj.

TRUPAT MEDIALË GJUNJËZORË. Në psikologjinë fiziologjike secila nga dy bërthamat qelizore që gjenden në afërsi të anës së pasme të talamusit dhe janë qeliza të rëndësishme sinaptike në hyrje të rrugëve të dëgjimit.

TRUPI I VIJËZUAR. Pjesë e bazës së hemisferës së djathtë e të majtë të trurit. Është i përbërë nga pjesët e bërthamës së qelizave nervore dhe prej fijezave nervore.

TRUPI KALLOR. Trup i ndërlikuar fijezash trunore të substancës së bardhë që ka formën e trupit në trajtë lythi. Gjendet në fund të plasës gjatësore të trurit të madh dhe lidh hemisferat trunore ndërmjet tyre. Shkëputja e një hemisfere nga tjetra për qëllime studimore bëhet duke asgjësuar trupin kallor.

TRUPI QELQOR. Pjesa më e madhe e bërthamës së kokërdhokut apo bulbit të syrit. Përbëhet prej një lënde të tejdukshme, të pangjyrë dhe pa enë të gjakut. Mbush hapësirën që gjendet ndërmjet thjerrëzës së syrit, të lidhjes varëse të saj dhe të rrjetës apo retinës së syrit.

TRUPTHAT MAJSNER.

Puçrra të vogla receptorësh që gjenden afër sipërfaqes së lëkurës së njeriut, pikërisht në ato vende ku lëkura nuk ka qime dhe përbëhet prej mbaresave nervore. Këto të fundit reagojnë ndaj shtypjes mekanike të trupave të botës së jashtme në gjendje të ngurtë, të lëngshme dhe flurore, me intensitet të mjaftueshëm nxitës të tyre. Besohet se trupthat Majsner janë bartës të ndijimeve të të prekurit dhe të shtypjes së lëkurës. Emrin e tyre këta trupthа e kanë marrë sipas zbuluesit të tyre, fiziologut dhe anatomologut gjerman Georg Majsner (Georg Maissner, 1829 – 1905). Ende gjurmohet për vërtetimin e rolit të këtyre trupthave në ndijimin e të prekurit, sidomos të ndijimit të shtypjes së lëkurës.

TRU, - RI. m. Organ i sistemit nervor, qendra koordinuese e sistemit nervor, që së bashku me palcën e kurrizit përbëjnë Sistemin Nervor Qendror. Është i vendosur në hapësirën e brendshme të kafkës dhe është i mbështjellë me cipën e hollë, të mesme dhe me cipën enëzore. Ka një peshë prej 1400 – 1500 gr dhe është bartës i aktivitetit të gjithëmbarshëm organik e psikik. Përbëhet nga qelizat nervore dhe nga zgjatimet e tyre. Qelizat nervore përbëjnë lëndën e përhimët të trurit, e cila formon cipën apo koren e trurit të madh, ku gjenden rreth 14 miliardë qeliza të tilla. Fijezat dhe tubat e fijezave të qelizave nervore përbëjnë lëndën e bardhë të trurit. Sipërfaqja e trurit është e përbërë prej brazdave apo hullive të trurit dhe dredhave apo rrudhave të trurit. Me anën e të çarës gjatësore ndahet në dy hemisfera që kanë faqet dhe skajet e tyre. Sipas strukturës, formës dhe funksionit që kryen ndahet në trurin e madh, trurin e vogël, trurin e ndërmjetëm, trurin e mesëm dhe trurin e pasmë.

TRURI I MADH. I njohur me termin latin *cerebellum*. Truri i madh është

pjesë e trurit dhe e Sistemit Nervor Qendror. Është i përbërë nga pjesa e përparme e trurit dhe nga truri i ndërmjetëm. Truri i madh është i ndarë në dy hemisfera: në hemisferën e djathtë dhe në hemisferën e majtë. Këto hemisfera lidhen njëra me tjetrën me anën e tubës së fijeve nervore të trupit kallor (*corpus callosum*). Ndarja e njërës hemisferë nga tjetra bëhet me anën e çarjes së thellë e të gjatë, që është e njohur me termin latin *fissura longitudinalis cerebri.* Hemisfera e djathtë kontrollon pjesën e majtë të trupit dhe gjithë veprimtarinë e organeve të kësaj pjese, kurse hemisfera e majtë kontrollon dhe udhëheq pjesën e djathtë të trupit, të organeve të kësaj pjese dhe të veprimtarisë së tyre. Funksioni i dy hemisferave ka karakter integral. Truri i madh mbulohet me cipën ose koren e trurit. Truri i madh me cipën mbështjellëse u zhvillua te njeriu më pas, dhe kësaj pjese të trurit i atribuohet aktiviteti i ndërlikuar i jetës psikike të njeriut. Sfera e majtë dhe sfera e djathtë e trurit të madh është e ndarë në katër pjesë, vriguj ose lobe. Këto janë: pjesa ballore (frontale), zverkore (oksipitale), tepore (parietale) dhe pjesa tëmthore ose tëmblore (temporale). Këtë ndarje e paraqesim në figurën e mëposhtme:



Pjesa ose vrigulli ballor (lobi frontal) është bartëse e këtyre proceseve, sjelljeve dhe veprimeve të njeriut: proceset e kujtesës, të menduarit me zgjidhjen e problemeve ose situatave problemore, proceseve të socializimit të njeriut, të veprimeve motorike (veprimet e vullnetshme, shkathtësive, shprehive dhe veprimeve spontane) dhe të sjelljeve seksuale.

TRURI I MESËM. Gjendet nën trurin e madh, është i mbuluar nga lënda e trurit të madh dhe i vendosur mbi trungun e trurit. Me pjesët e tij të përparme dhe të pasme si edhe me strukturat anatomike dhe fiziologjike (bërthama e kuqe, pjesa e formacionit retikular, krahët nervore me bërthamën e zezë) kryejnë funksionin e organizimit të lëvizjeve, të kontrollit të tyre, si edhe organizimin dhe kontrollimin e veprimeve të vullnetshme.

TRURI I NDËRMJETËM. I ardhur nga latinishtja *diencephalon*. Pjesa e pasme e trurit të përparmë. Në trurin e ndërmjetëm gjendet talamusi dhe hipotalamusi, që kanë strukturë dhe funksione të posaçme . Shih – ***TALAMUSI; HIPOTALAMUSI.***

TRURI I PASMË. Formacion i veçantë anatomik i trurit, përbërës i pjesës së fundit të sistemit nervor. Në trurin e pasmë hyjnë këto pjesë: pjesa e zgjatur e palcës së kurrizit, ura e Varolit, truri i vogël dhe formacioni retikular. Secila nga këto pjesë kryen funksione të veçanta, shih – ***PJESA E ZGJATUR E PALCËS SË KURRIZIT; URA E VAROLIT; TRURI I VOGËL; FORMACIONI RETIKULAR.*** Këtë e ilustron figura e mëposhtme:



Burimet:

George J. Slegel, et al., eds.: *"Basic Neurochemistry"* – (*"Baza e neurokimisë"*), Boston, 1981.
B. K. Siesjo: *"Brain Energy Metabolism"* – (*"Energjia trunore e metabolizmit"*), Chichester and New York: John Wiley, 1978.
D. Ferrier: *"The Functions of the Brain"* – (*"Funksionet e trurit"*), London, 1876.
A. R. Luria: *"The Working Brain"* – (*"Veprimtaria e trurit"*), Harmonswoth: Penguin, 1973.
A. Muralt: *"Einführung in die praktische Physiologie"* – (*"Hyrje në fiziologjinë praktike"*), Berlin, 1944.
Roger Gil*: "Neuropsikologjia","* Dituria", Tiranë, 2002.
Mimoza Shahini*: "Seminare të zgjedhura nga lënda e psikofiziologjisë",* Prishtinë, 2007.
Ethem Ruka: *"Fiziologjia e gjallesave shtazore",* (Dhuratë e Qeverisë Italiane, Shtypur në Shqipëri), shblu, Tiranë, 1998, fq. 22 – 156.
Tony Buzan: *"Truri i fëmijës",* Gazeta "Shekulli", Tiranë, 2007 (fq. 15 – 80).

TRURI I VOGËL. I ardhur nga latinishtja *cerebellum*. Truri i vogël është pjesë e Sistemit Nervor Qendror. Ky sistem është i përbërë nga dy hemisfera, të ndara me një formacion anatomik që quhet *vermis* – formacion i veçantë i trurit. Pjesa e sipërme e këtyre hemisferave është e përbërë nga qelizat nervore, përkatësisht nga trupi i qelizave nervore, pra nga lënda e përhimët e trurit, kurse pjesa e brendshme është e përbërë nga lënda e bardhë e trurit dhe në të janë të përqendruara disa grup qelizash të veçanta. Truri i vogël është rregullator i lëvizjeve të trupit dhe pjesëve të tij, si edhe kontrollues i këtyre lëvizjeve. Çrregullimi i funksionit të trurit të vogël shfaqet në çrregullimin e lëvizjeve të organeve të trupit, sidomos në çrregullimin e koordinimit të lëvizjeve, të saktësisë ekzekutive të tyre dhe të baraspeshës apo ekuilibrit të trupit.

TRURI NUHATOR. Në terminologjinë e anatomisë i ardhur nga latinishtja *rhinencephalon*. Përfshin bulbin nuhator, fijet nervore olfaktoriale, pjesën e trurit që i përngjet formës së dardhës dhe pjesët e kompleksit të amigdalës. Truri nuhator është zhvilluar në nivel të lartë te disa kafshë dhe luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e aktivitetit të tyre.

TRURI OLFAKTOR. Pjesë përbërëse e trurit, ku përpunohen impulse nervore që bartin informacione që kanë të bëjnë me cilësinë e aromës së trupave flurorë dhe me intensitetin e aromës së tyre. Truri olfaktor shtrihet në një pjesë të trurit ballor dhe atij tëmthor.

TRYSNIA PSIKIKE. Term i konceptit themelor të psikanalizës. Trysnia psikike është mekanizëm mbrojtës, i cili ka të bëjë me përjashtimin nga përmbajtja e vetëdijes e të gjithë atyre përfytyrimeve dhe përjetimeve të pakëndshme që lidhen me dëshirat e penguara në procesin e plotësimit të tyre. Nën ndikimin e trysnisë së tillë psikike të këtyre përmbajtjeve zhvillohet aktiviteti i pengimit të paraqitjes së tyre. Por, me këtë rast kujtimi apo kujtimet e përmbajtjes së asaj dëshire (ideja, përfytyrimi, konceptet

etj.) të zhdukur nga trysnia psikike, nuk e kanë humbur energjinë e tyre vepruese, përkatësisht energjia e tyre vepron si energji e pavetëdijshme, madje kjo manifestohet në ëndrra, në lajthitje, në simptoma të ndryshme etj. Trysnia psikike kryhet me qëllim të pengimit të asaj energjie për të depërtuar në përmbajtjet e vetëdijshme. Trysnia apo shtypja psikike mund të jetë primale, parësore dhe dytësore. Trysnia primale ka të bëjë me ndalimin e energjisë së idit që të depërtojë në vetëdije; trysnia parësore është pengimi i shfaqjes së përmbajtjeve psikike ankthore për t`u paraqitur në vetëdije; trysnia dytësore ka të bëjë me angazhim që edhe ato elemente që mund të na kujtojnë të kaluarën e ngrysur, të shtypur, të pengohen për t`u ringjallur. Pra, në trysninë psikike, ajo që është shtypur ka ruajtur energjinë e vet vepruese në nivelin e pavetëdijes dhe kjo energji shfaqet në formë ëndrrash dhe gabimesh të papritura dhe befasuese.

Burimet:

Sigmund Freud: *"Ese mbi psikanalizën",* Tiranë, 2006.

Sigmund Freud: *"Uvod u psihoanalizu"* – (*"Hyrje në* psikanalizë"), Novi Sad, 1988.

Çarls Brener: *"Themelet e psikanalizës",* Tiranë, 2008

TUBTHI MEDIAL I TRURIT TË MESËM. Në psikologjinë fiziologjike aksonet e qelizave nervore që lidhin strukturat e trurit të mesëm me trurin e përparmë.

TURM/Ë, - A. f. Term i sociologjisë dhe i psikologjisë sociale. Turma është grup i madh individësh që veprojnë të shtyrë nga një motiv, nga ndjenja e forcës që mbështetet në një masë të madhe individësh me ndjenjë të përbashkët, duke u sjellë në mënyrë të njëjtë ose të ngjashme ndaj një qëllimi të tyre. Shembuj turmash dallohen në demonstrata, protesta, lëvizje politike, fetare etj., ku pjesëmarrësit shprehin gatishmëri për një aktivitet të përbashkët, duke vënë në rrezik qenien e tyre, sidomos në turmat revolucionare. Turmat mund të jenë shpërthyese me agresivitetin e tyre si, turma e tifozëve të futbollit, e protestuesve etj. Turmë është edhe grupi i madh i individëve të bashkuar për një qëllim, si turma e pjesëmarrësve në një koncert të muzikës bashkëkohore etj. Këta të fundit, në ndryshim nga turma protestuese, sillen në përputhje me normat dhe rregullat normale të sjelljeve.

TURP, - I. m. Lloj ndjenje e ndërlikuar, që shkaktohet nga vlerësimi i sjelljeve tona, kur këto nuk përkojnë me parimet dhe me rregullat morale të bashkësisë dhe kryerësi i tyre vlerëson se me to e ka prishur imazhin e vet ndaj individëve të rëndësishëm të atij mjedisi, ose e ka vërtetuar imazhin negativ të të tjerëve për atë individ. Turpi përçohet me frikën e njeriut dhe kjo lind nga vlerësimi i njeriut se sjelljet e kryera janë sjellje shmangieje nga përfytyrimi që ai dëshironte ta kishin të tjerët për të. Kjo është formë e turpit në kuadrin e raportit ndaj të tjerëve. Por, turpi shfaqet edhe ndaj vetes. Njeriu turpërohet ndaj vetes atëherë, kur vlerëson se i ka kryer ato sjellje, të cilat nuk përkojnë me normat vetjake. Strukturën e turpit e përbëjnë vlerësimi i tërësishëm pozitiv për veten dhe nevoja që ai ndien, që edhe të tjerët, sidomos personalitetet e larta të atij mjedisi, duhet ta kenë

për të. Rrjedhimisht, sa më të lartë të jenë personalitet e tjera në shkallën shoqërore të atij mjedisi, aq më e madhe është dëshira e njeriut që ai të pranohet, ashtu dhe aq mirë nga ana e të tjerëve. Kjo ndjenjë ndryshon nga shumë të tjera, sepse zhvillohet në lidhje me të tjerët dhe shfaqet me qëndrimin e të tjerëve ndaj unit të njeriut dhe me disa ndryshime fiziologjike (skuqje të fytyrës, sjellje të ngadalësuar, të shoqëruara me falje ndaj të tjerëve etj. Luan rol të rëndësishëm në shoqërizimin e njeriut dhe forma e shfaqjes së tyre është e varur nga kultura e popullit të një mjedisi të caktuar.

Burimet:

P. T. Young: *"Motivation and Emotion: A Survey of the Determinants of Human and Animal Activity"* – (*"Motivimi dhe emocioni: Një vështrim mbi përcaktuesit e aktivitetit njerëzor dhe shtazor"*), New York 1961.
Begoña Ibarrola: *"Tregime për ndjenjat"*, Tiranë, 2009, fq. 171 – 191.
Zoran Milivojević: *"Emocije"* – (*"Emocionet"*), Novi Sad, 2007.

TUT/Ë, - A. f. Lloj i frikës me intensitet të ulët. Këtë frikë njeriu e përjeton kur pret një gjendje dhe një situatë, që dyshon se mund ta zotërojë lehtë. Në ndryshim prej frikës që lind nga objekti dhe situata që njeriu e konsideron të rrezikshme për qenien e tij, tremori më tepër ka të bëjë me vlerësimin e mundësisë së njeriut për t`iu përballuar objektit apo situatës. Njeriu mund të tutet nga situatat e reja pak të njohura ose fare të panjohura për të, por me to ai do të ballafaqohet.

TUTORI, - A. f. Dukuria e përkujdesjes së tepërt për tjetrin, zakonisht për fëmijët, duke kaluar kufirin maksimal të nevojës për zhvillimin e pavarësisë së tij dhe të organizimit të sjelljeve të pavarura ndaj të tjerëve. Në raste të tilla dinjiteti, liria e mendimit dhe e veprimit të lirë të tjetrit ndrydhet seriozisht dhe cenohet rëndë. Pengon procesin e shoqërizimit të njeriut dhe zhvillimin e pavarur të personalitetit të tij.

TH

THARBËTIM, - I. m. Përbërje elementesh kimike të një lënde të caktuar në gjendje agregate të ngurtë dhe të lëngët, molekulat e të cilave, kur treten, formojnë jone hidrogjeni. Lëndët e këtilla kanë shije të tharbët – njëra nga katër cilësitë e shijes. Shih – ***SHIJA.***

THEKSIM, - I. m. Ndryshimi i zërit gjatë shqiptimit të një fjale, të një fjalie, gjegjësisht të një koncepti dhe të një gjykimi të posaçëm, duke shqiptuar me një zë me intensitet më të lartë zanoret e fjalëve të caktuara. Zbatohet për të vënë në spikamë rëndësinë kuptimore, vlerën emocionale të shprehjes, ritmikën e shprehjes etj.

THEKSH/ËM, - ME (I, E). mb. Që përcakton zërin, fortësinë e lartësinë specifike të tij gjatë shprehjes së një mendimi, ndjenje etj., me të cilin/cilën ushtrohet ndikim te të tjerët.

THELBËSOR, - E. mb. Që përcakton brendinë, veçorinë e përgjithshme, të përhershme e të patjetërsueshme të një dukurie, në procesi etj.

THELLËSIA E PERCEPTIMIT. Përmasa e trupave, lartësia e trupave në drejtimin poshtë – lart. Kjo përmasë e trupave perceptohet duke përqendruar shikimin prej një pike në sipërfaqe deri në pikën më të lartë ose më të ulët të tij. Perceptimin e thellësisë së trupave e bën të mundur të parët me dy sy, të dhënat kinestetike, si edhe përvoja e individit.

THERORI, - A. f. Vlerësimi më i lartë i një qëllimi të caktuar, i një ideali, i një bindjeje etj., që individi ia nënshtron aktivitetin e gjithëmbarshëm dhe flijon jetën për të.

THERSTON Leon Luis (**Leon Louis THURSTONE).** Psikolog amerikan. Lindi në Çikago (Ilinois) më 1887 dhe vdiq më 1955. U shqua për kontributin e tij për matjet në psikologji, duke përfshirë në përgjithësi matjet psikofizike, të aftësive, të qëndrimeve, të tipareve të personalitetit etj. Zhvilloi analizën faktoriale të shumëfishtë (multiple) dhe filloi të interesohet për psikologji pas përfundimit të studimeve për elektronikë. Kreu studimet e psikologjisë në Universitetin e Çikagos dhe prej vitit 1924 u zgjodh profesor inordinar e më pas profesor ordinar i psikologjisë; nga viti 1932 për Kryetar i Shoqatës Amerikane të Psikologëve. Themelues dhe

kryetar i parë i Shoqatës Amerikane të Psikometrisë, një ndër themeluesit e revistës "Psikometria" – "Psichometric". U mor posaçërisht me studimin e strukturës së inteligjencës dhe në këtë lëmi mbeti i njohur me teorinë e faktorëve parësorë apo gruporë të inteligjencës. Në këtë fushë identifikoi shtatë faktorë: 1) Të kuptuarit e të folurit, 2) Lehtësinë e gjetjes së fjalëve dhe të folurit e lehtë të tyre, 3) Shkathtësinë e të llogariturit, 4) Aftësinë e përfytyrimit të hapësirës, 5) Shpejtësinë e të kuptuarit, 6) Kujtesën asociative dhe 7) Aftësinë e të menduarit. Shumë teste për matjen e inteligjencës që u hartuan ndërmjet viteve 1940–1950 morën për bazë faktorët parësorë apo gruporë të inteligjencës. Veprat kryesore të tij janë: "*Primary mental Abilities*" – (*"Aftësitë parësore mendore"*), 1938; "*A Factorial Study of Perception*" – (*"Studimi faktorial i perceptimit"*), 1944; *"Multiple Factor Analysis"* – (*"Analiza multiple e faktorëve"*), 1947 etj.

TH

THITHJA E GISHTIT TË MADH. Një ndër shprehitë negative të fëmijëve të vegjël. Rreth 25 % e fëmijëve të moshës prej tre muajsh deri në moshën dyvjeçare e thithin gishtin e madh të dorës së tyre. Shumë fëmijë të tjerë këtë e bëjnë kohë pas kohe, por te pak fëmijë këtë shprehi e dallojmë në moshën e rritur. Këtë dukuri të karakterit të një shprehie psikanaliza e shpjegon në bazë të teorisë së libidos. Sipas psikanalizës thithja e gishtit të madh është pasojë e zhvillimit të libidos, kur energjia e libidos është e përqendruar në trupin e vetë fëmijës, përkatësisht në buzët e tij.

THJERRËZA E SYRIT. Pjesë përbërëse e kokërdhokut ose e bulbit të syrit e njohur me termin latin *lens crystalline*. Ka formën bikonvekse dhe gjendet para trupit qelqor, prapa ylberthit ose irisit. Thjerrëza e syrit ndryshon vendndodhjen sipas të parit të objektit të largët apo të afërt. Kur shikimi i drejtohet objektit të largët, atëherë thjerrëza e syrit bëhet më e rrafshët dhe kur shikimi i drejtohet objektit të afërt, atëherë thjerrëza e syrit merr formë konvekse më të dukshme. Këtë e mundëson aparati lidhës dhe tkurrja e lëshimi i muskulit biliar. Shih –***AKOMODIMI.***

THJESHTËSI, - A. f. Tipar pozitiv i i karakterit që shfaqet me qëndrime dhe me sjellje të individit ndaj vetes, duke e vlerësuar veten e tij realisht, pa u mburrur për aftësitë e veta, për rëndësinë e punëve të tij dhe pa parashtruar kërkesa për veten dhe për të tjerët**.**

THYERJA E QËNDRESËS PSIKIKE. Angazhimi profesional i psikoterapeutit i drejtuar dhe i përqendruar në identifikimin e qëndresës psikike, në përpunimin dhe në asgjësimin e saj. Ky angazhim ka të bëjë drejtpërdrejt me rikonstruktimin e drejtimit të atyre fuqive psikike që kanë çuar në çrregullimin e sjelljeve, në simptoma karakteristike të sjelljeve. Me shpjegimin e këtyre simptomave nga aktiviteti i ndërsjellë psikoterapeut-pacient duhet të arrihet në identifikimin e dëshirave dhe të konflikteve të shtypura, të ndrydhura, të qëndresës për të mos e treguar fajin, të turpit, të frikës e zemërimit të lidhur me to dhe, përfundimisht, në thyerjen e kësaj qëndrese. Kjo thyerje do të thotë ndërgjegjësim i pacientit për të gjitha këto pengesa dhe qëndresë për fshehjen e tyre dhe çlirimin e pacientit nga ngarkesa me to, pra shërim të tij nga shkaktarët e sjelljeve të çrregulluara.

U

UDUORTH S. Robert (Robert S. WOODWORTH). Psikolog amerikan. Lindi në Masaçusets më 1869 dhe vdiq në Nju Jork më 1962. Kreu studimet për filozofi dhe psikologji në Universitetin e Harvardit ku dhe mbrojti doktoratën për psikologji me tezën "Mbi lëvizjet e vullnetshme". Ka drejtuar katedrën e psikologjisë në Universitetin e Kolumbias në Nju Jork (1903–1953). Më 1956 mori "Dekoratën e Artë" të Fondacionit për kontribute të jashtëzakonshme në zhvillimin e psikologjisë. Gjatë veprimtarisë së tij ka mbledhur dhe sistemuar lëndë të rëndësishme nga shumë burime, duke përfshirë edhe ato nga Anglia dhe Gjermania. Këtë e ka argumentuar me botimin e dy veprave të rëndësishme nga psikologjia eksperimentale, që kanë shërbyer për një kohë të gjatë si libra universitarë për psikologji në vendet anglosaksone. Nga përmbajtja e tyre kuptohet vështrimi eklektik i psikologjisë nga këndvështrimi i një funksionalisti. Veprat kryesore të tij janë: *"Experimental Psychology"* – (*"Psikologjia eksperimentale"*), 1938 (rishikuar dhe e botuar më 1954); *"Contemporary Schools of Psychology"* – (*"Shkollat bashkëkohore të psikologjisë"*), rishikim i botuar më 1948.

UDHËHEQJE, - A. f. Organizimi dhe drejtimi i veprimtarisë së një ekipi profesionalistësh, grupi shoqëror, punëtorësh etj., nga ana e një individi udhëheqës ose nga bashkëpunimi i një grupi të përzgjedhur anëtarësh, që marrin vendime për organizmin dhe drejtimin më të mirë të veprimtarisë së përbashkët, për arritjen e rezultateve sa më të larta cilësore në realizimin e detyrave të atij grupi, të atij ekipi etj. Shih – ***TEORITË E TË UDHËHEQURIT.***

UDHËHEQJA AUTOKRATE. Drejtim i veprimtarisë dhe i bartësve të saj nga ana e një individi që gjendet në krye të një grupi, ekipe, partie etj. Në këtë sistem udhëheqjeje porositë dhe urdhrat e organizmit të punëve, të sjelljeve të të gjithëve jepen nga ana e udhëheqësit më të lartë, kurse realizuesit e tyre nuk kanë të drejtë të japin propozime, sugjerime dhe as ndryshime të porosive dhe urdhrave të tij. Në raste të tilla përgjegjësitë

për rezultatet dhe mirëvajtjen e veprimeve, të punëve i atribuohen vetëm urdhërdhënësit, pikërisht drejtuesit autokrat.

UDHËHEQJA DEMOKRATIKE. Drejtim i aktiviteteve, i punës etj. nga ana e njërit ndër të barabartët e një grupi, ekipi, partie etj., që porositë e kërkesat e tij i arsyeton, pranon ndryshime, plotësime të tyre etj. Madje, kërkesat, porositë dhe vendimet i merr pas diskutimeve të gjera dhe të lira me bashkëpunëtorët e barabartë në procesin e drejtimit. Por, përgjegjësia për rezultatet e arritura ka përmasa kolektive.

ULCER, - A. f. I ardhur nga latinishtja *ulcus* "plagë". Plaga e njohur në të folmen e përditshme me fjalën "i thatë" (i thati në lukth, i thati në zorrën dymbëdhjetëgishtore). Term i terminologjisë së mjekësisë, por në psikologji përdoret për të emërtuar atë lloj sëmundje, e cila shkaktohet nga brengat, nga përgjegjësia e lartë dhe e vazhdueshme, nga stresi etj. Hasen disa lloj ulcerash: ulcerë e gastritit ose ventrikuli – ulcerë e stomakut; ulcera e duodenit - ulcerë e zorrës dymbëdhjetëgishtore (puçërr që del në mukozën e zorrës dymbëdhjetëgishtore, duke shkaktuar humbje të lëndës indore duodenale; ulcerë gastroduodenale – ulcerë e stomakut dhe e zorrës dymbëdhjetëgishtore.

ULTRATINGULL, - I. m. Tingull i prodhuar me denduri valësh ajrore mbi 20 000 herc, të cilin veshi i njeriut nuk është në gjendje ta kapë, ngaqë ai e tejkalon aftësinë dëgjimore të tij, por ka disa kafshë që reagojnë edhe ndaj tingullit të tillë.

UNI. asnj. Tërësi e integruar tiparesh karakteristike të personalitetit dhe tërësi integrale e përvojës së tij, që ka të bëjë drejtpërdrejt me pjesën e vetëdijshme të personalitetit të një njeriu të caktuar. Uni i tillë bashkon në një përjetim të tërësishëm vlerat qendrore, qëndrimet, tiparet, motivet, emocionet dhe rolin individual në mjedisin ku jeton dhe zhvillohet. Uni është subjekti që percepton, ka ndjesi, mendon, vlerëson dhe i kontrollon sjelljet e tij. Përjetimi i tillë është subjekt i veprimtarisë dhe objekt i vëzhgimit, përkatësisht i vetvëzhgimit. Uni i këtillë përjetohet edhe në vazhdimësi relativisht të pandryshueshme në hapësirë dhe në kohë të ndryshueshme, duke përforcuar vazhdimisht identitetin e vet. Uni fillon të zhvillohet qysh nga mosha e fëmijërisë, kur individi fillon ta ndajë, ta dallojë veten nga objektet e tjera dhe ta njohë atë. Kjo tërësi e integruar pasurohet vazhdimisht me ndijime kinestetike, taktile, me përfytyrime, mendime, me ndjenja të drejtuara kah organizmi i personalitetit, duke formuar perceptimin unik të njeriut për personalitetin e tij. Ky është koncepti real i unit, që ndryshon nga egoja.

UNI I PERCEPTUAR. Tërësi e përvojës intime për personalitetin e vetvetes dhe të vetëdijes së njeriut për qenien trupore, shoqërore dhe psikologjike të tij. Vetëdija e tillë bën që në një çast të dhënë njeriu e dallon personalitetin e tij nga të tjerët.

UNI IDEAL. Koncept i një individi për personalitetin e tij, para së gjithash për atë çfarë duhet të jetë ai dhe çfarë duhet të bëjë në të ardhmen për t`ia arritur këtij qëllimi. Uni ideal është një "normë" abstrakte me fuqi motivuese

dhe emocionale të rëndësishme për zhvillimin e personalitetit të shëndoshë. Formimi i konceptit të tillë është rezultat i ndikimit të shumë faktorëve shoqërorë të mjedisit, por në rend të parë ky është produkt i zhvillimit psikologjik të njeriut**.**

UNI SHOQËROR. Një nga aspektet e unit. Ky është perceptim i unit të njeriut në bazë të reagimeve të të tjerëve për "mua", të vlerësimeve dhe të sjelljeve të të tjerëve ndaj "meje" dhe qëndrimet të formuara me sjelljet përkatëse të "unit" ndaj të tjerëve. Uni shoqëror është produkt i mjedisit social dhe i raporteve të atij mjedisi ku zhvillohet dhe formohet individualiteti psikologjik, shoqëror e trupor i njeriut.

UNI TRUPOR. Të qenit i vetëdijshëm për qenien fizike të vetes, për trupin dhe karakteristikat antropologjike personale që ka njeriu për veten e tij. Strukturën kryesore të kësaj vetëdije për unin trupor e përbën përfytyrimi i njeriut për vetveten. Ky përfytyrim zhvillohet dhe formohet në bazë të integritetit të përvojës dhe të ndijimeve kinestetike, proprioceptive dhe taktile, të shoqëruara me përjetim të kënaqësisë ose të pakënaqësisë së njeriut për organizmin e tij. Integriteti i këtillë përbën themelin e identitetit të njeriut. Sipas Gordon Olportit (Gordon Allport, 1897 – 1967) "ndjesia e vetë trupit është argument kryesor i ekzistencës sonë". Qëndrim të përafërt ka edhe Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1938) që ka trajtuar egon, superegon dhe idin. Sipas tij "egoja në fund të fundit është nxjerrë nga ndijimet trupore, kryesisht nga ato të sipërfaqes së trupit".

UOTSON Xhon B. (John B. WATSON). Psikolog amerikan, themelues i bihejviorizmit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Lindi në Karolinën e Jugut më 1878 dhe vdiq më 1958. Kreu studimet për psikologji në Universitetin e Çikagos, ku mbrojti doktoratën me tezën mbi pjekurinë neurologjike dhe psikologjike të minjve të bardhë dhe mundësinë e të mësuarit të tyre. Punoi si asistent deri më 1908, kur u emërua profesor i psikologjisë në Universitetin "Xhon Hopkins" të Baltimores. Për rreth tridhjetë vjet ka qenë mësimdhënës i psikologjisë eksperimentale dhe krahasuese, si edhe drejtor i laboratorit të psikologjisë. Por, karrierën akademike e ndërpreu në një moshë relativisht të re për shkaqe personale. Pikëpamjet e tij u përhapën me shpejtësi pas mbajtjes së ligjëratës në Universitetin e Kolumbias në vitin 1912. Është pohuar se pas mbajtjes së kësaj ligjërate është konceptuar dhe është botuar punimi "Psikologjia, si e sheh bihejvioristi" - "Psychology as the Behaviorist Sees it" në një revistë për psikologjinë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës më 1913. Ky punim qe si një manifest për bihejviorizmin. Pasojat e kësaj pikëpamjeje kanë shtrirje të gjerë në karakterin dhe natyrën shkencore të psikologjisë; këto ndikuan në ndryshimin e kahes zhvillimore të psikologjisë, duke shkaktuar një kthesë të madhe në zhvillimet studimore të psikologjisë. Kjo dallohet në përmbajtjen e mendimit të tij: *"Psikologjia sipas bihejvioristëve është një lëndë e bazuar në degët e ndryshme të shkencave natyrore. Qëllimi kryesor i saj është parashikimi dhe kontrolli i sjelljeve. Analiza e vetvetes nuk formon asnjë pjesë të metodave të psikologjisë,*

sepse vlera shkencore e të dhënave të saj varet nga gatishmëria me të cilat ato e japin hua veten e tyre për interpretimin (e vetes P. N.) nga aspekti i vetëdijes. Bihejvioristi, në përpjekjet e tij për të ndërtuar një skemë unike të reagimit të kafshëve, ka cilësuar se nuk dallon një vijë ndarjeje ndërmjet njeriut dhe kafshëve. Sjellja e njeriut me tërë qenien dhe kompleksitetin e tij formon vetëm një pjesë të skemës së përgjithshme kërkimore për bihejvioristët." Sipas tij psikologjia duhet ta ndryshojë lëndën, qëllimin dhe metodën e studimit. Lënda e saj duhet t`i përkasë shkencave natyrore, kurse qëllimi i psikologjisë duhet të jetë studimi i kontrollit të sjelljeve dhe parashikimi i tyre. Metoda studimore duhet të jetë metoda e vëzhgimit objektiv, sistematik dhe eksperimental të sjelljeve. Zhvillimi i tillë i psikologjisë duhet të mbështetet në parimet shkencore objektive, që përjashtojnë konceptin e vetëdijes, të përmbajtjes, të strukturës dhe të funksionit të saj, si edhe të qëllimit të organizmit. Nga psikologjia duhen larguar rezultatet e arritura të psikologjisë introspektive dhe të gjitha termat e koncepteve mendore. Veprat kryesore të tij janë: *"Behavior: An Introduction to Animal Psychology"* – (*"Sjellja: Hyrje në psikologjinë e kafshëve"*), 1914; *"Psychology from the Standpoint of a Biheviorist"* – (*"Psikologjia nga pikëpamja e bihejvioristit"*), 1919; *"Behaviorism"* – (*"Bihejviorizmi"*), 1925; *"Psychological Care of Infant and Child"* – (*"Kujdesi psikologjik ndaj foshnjës dhe fëmijës* "), 1928. David Cohen ka botuar veprën *"John Broadus Watson: The founder of behaviorurism"* – (*"Xhon Brouds Uotson: Bazat e bihejviorizmit"*), 1979.

URA E VAROLIT. Formacion fijezash nervore që ka formën e urës në miniaturë. Gjendet mbi palcën kurrizore, përpara trurit të vogël dhe ndërmjet pjesës vazhduese të palcës së kurrizit dhe trurit të mesëm. Ura e Varolit formon një sektor të trungut të trurit. Kjo ndahet në pjesën e përparme dhe të pasme. Pjesa e përparme përbëhet nga bërthamat e qelizave trunore, që kontrollojnë aktivitetin e vullnetshëm të njeriut. Pjesa e pasme ka tube fijezash nervore dhe bërthama të disa çifteve nervore të kafkës (V, VI, VII e VIII) dhe të formacionit retikular. Ura e Varolit lidh trurin e madh me trurin e vogël dhe me trurin e zgjatur. Fijezat e këtij sektori përçojnë impulse nervore ndërmjet trurit dhe palcës së kurrizit. Në terminologjinë e mjekësisë është e njohur me termin "*Pons varolli*".

URI, - A. f. Gjendje e brendshme, fiziologjike e organizmit e shkaktuar nga mungesa e lëndëve ushqimore të organizmit dhe e përjetuar në formë ndjesie e përvoje për të marrë ushqim dhe për të vënë në drejtpeshim sasinë e cilësinë e lëndëve ushqyese me nevojën e organizmit për to. Qendra trunore e urisë dhe e ngopjes është hipotalamusi dhe ky aktivizohet kur nevoja për glukozë bie nën vlerën mesatare. Gjendja e tillë është në raport të drejtë me kohëzgjatjen e mosmarrjes së ushqimit: sa më e gjatë të jetë koha e mosmarrjes së ushqimit, aq më serioze bëhet gjendja e organizmit. Uria mund të jetë specifike në kuptimin e nevojës që ndien njeriu vetëm për lëndë minerale, për proteinë etj. Gjendja e tillë ka përmasë të dallueshme motivuese: e shtyn organizmin e njeriut të ndërmarrë veprime për marrjen e ushqimit. Uria është nevojë dhe shtytës i lindur dhe i përgjithshëm për gjininë

njerëzore, kurse format e sjelljeve për marrjen e ushqimit dhe për llojet e tyre mësohen nga kultura e të ushqyerit të një mjedisi shoqëror.

URTËSI, - A. f. Strukturë e integruar e aftësisë, e diturisë dhe përvojës së thellë, e qëndrimeve, e motiveve dhe sjelljeve morale të njeriut të organizuara dhe të drejtuara drejt së mirës dhe përparimit të tij, si edhe të mjedisit të ngushtë dhe të gjerë të tij. Është një virtyt me strukturë të ndërlikuar mendore e motivuese, i zhvilluar mbi themelin e së mirës, guximit dhe progresit, ku përjetimet emocionale (cilësia dhe intensiteti) varen nga kuptimi i veçantë i sjelljes së urtë të njeriut.

URREJTJ/E, - A. f. Ndjenjë negative dhe e fuqishme e një individi ndaj një individi tjetër, objekti, situate etj. Kjo ndjenjë me qëndrimet dhe me sjelljet e tij mund t'i rrezikojë një individi tjetër vlerën mendore, diturore dhe morale dhe, si e tillë, ka fuqi motivuese negative ndaj atij individi që i shkakton dëm dhe e pengon në realizimin e vlerave. Urrejtja shfaqet me sjellje destruktive ndaj individit tjetër, sjellje këto, që e çojnë atë në mundime dhe në vuajtje. Sipas intensitetit urrejtja shfaqet në tri shkallë: 1) Sjellje shqetësuese, 2) Sjellje dëmprurëse (asgjësim i shkrimeve, i librave dhe i pasurisë së individit që urren) dhe 3) Goditje fizike dhe asgjësim të individit që urren. Strukturën kognitive të urrejtjes e formojnë këto procese: dija e rrezikimit pa shkas dhe pa arsye e një vlere të individit tjetër, e shoqëruar me njohjen e veprimtarisë së qëllimshme të atij për t`i bërë keq njeriut – objektit të urrejtjes. Urrejtja e shkallës së lartë i tejkalon caqet kognitive. Kjo fuqizohet me ndjenja negative si edhe me veprime asgjësuese ndaj atij që urrehet. Këtë e ka trajtuar edhe psikologu zviceran Pjer Zhanet (Pierre Janet, 1859 – 1947). Sipas tij urrejtja ka qëllim të caktuar, ky është "asgjësimi, vrasja e individit që urrehet".

USHQYERJ/E, - A. f. Veprimi i marrjes së ushqimit dhe e heqjes së gjendjes së urisë të organizmit të njeriut. Ky veprim është produkt i të mësuarit, i kulturës së marrjes së lëndëve ushqimore sipas kohës dhe vendit të caktuar. Njeriu nuk ushqehet tri herë brenda 24 orëve sepse ka nevojë për një ritëm të këtillë, por ushqehet kështu, sepse është model i të ushqyerit në mjedisin e caktuar dhe ky model është përvetësuar dhe është shndërruar në një shprehi të rëndomtë të marrjes së ushqimit.

USHTIM/Ë, - A.f. Zhurmë tingujsh me intensitet të fuqishëm, që njeriu i përjeton në formë ndijimesh dëgjimore të shoqëruara me pakënaqësi, me drojë dhe frikë (zhurma e aeroplanëve), sidomos kur zhurma e largët ndodh në situata të rrezikshme (jehona e zhurmës së kërcitjeve të minave, minahedhësve, topave ushtarakë etj.). Shih – ***JEHONA.***

USHTIMA NË VESH. Ndijim i çuditshëm i tingujve, i zhurmave dhe i kombinimeve të intensiteteve të ndryshme të tyre, që njeriu i përjeton në raste të veçanta të sëmundjes së ndonjë pjese të veshit ose të dëmtimit të nervit të dëgjimit. Ushtima në veshë mund të shkaktohet edhe nga ndikimi i disa barnave (aspirinë, kininë etj.).

USHTRIM, - I. m. Veprim i organizuar me plan dhe i drejtuar në formimin e shkathtësive dhe shprehive

të caktuara dhe përsosja e tyre. Ka të bëjë me organizimin e përsëritjeve me qëllim të përvetësimit të saktë të një shkathtësie dhe shprehie nga ana e subjekteve që ushtrohen. Objekt ushtrimesh mund të jetë fitimi i një shkathtësie a shprehie perceptuese dhe motorike në shkallën më të lartë të saktësisë së lëvizjeve, të shpejtësisë dhe të koordinimit të tyre. Ushtrimet shfaqen edhe në sferën e proceseve njohëse apo kognitive, si: ushtrimi i kujtesës – ngritja në nivel më të lartë të mbajtjes mend dhe riprodhimit sa më të saktë të asaj që mësohet; ushtrimi i të menduarit – zhvillimi i shkathtësisë së saktë dhe të shpejtë të dallimit të asaj që është parësore, kryesore dhe që ka të bëjë me konstatimin e raportit themelor për zgjidhje të suksesshme të problemeve etj.

UTERUS, - I. m. I ardhur nga latinishtja *uterus* "mitër". Organi femëror ku zhvillohet embrioni dhe ka strukturë të posaçme anatomike. Embrioni zhvillohet brenda intervalit kohor prej nëntë muajsh që nga koncepitimi i qelizës femërore. Zhvillimi i embrionit gjatë kësaj kohe ka rëndësi jo vetëm organike e fiziologjike, por edhe psikike, sepse ky zhvillim reflektohet në forma të ndryshme edhe gjatë zhvillimit psikik pas lindjes së foshnjës.

UTILITARIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *utilitas* "dobi". Parim i sistemit etik, sipas të cilit sjellja dhe veprimtaria e njerëzve udhëhiqen nga dobia dhe leverdia. Utilitarizmi mund të jetë individual dhe kolektiv. Utilitarizmi individual – dobia individuale nga veprimi apo sjellja morale e njeriut. Utilitarizmi kolektiv – dobia për të gjithë anëtarët e një mjedisi shoqëror. Në psikologji flitet më tepër për natyrën e strukturën mendore të utilitarizmit individual, kurse psikologjia sociale bën fjalë edhe për dobinë e leverdinë e sjelljeve të përbashkëta të një mjedisi shoqëror. Ushtron ndikim në procesin e të menduarit.

UTOPI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *u* "parashtesë mohimi" dhe *topos* "vend, vend që s`ndodhet kurrkund". Është term i ardhur nga filozofia dhe ka përdorim më të shpeshtë në mendimet filozofike. U mor nga vepra e Tomas Morit, ku bëhet fjalë për shoqërinë ideale. Termi utopi përkon edhe me shtresa kuptimore psikologjike. Në këtë rrafsh bëhet fjalë për mendimin abstrakt, që nuk ka gjasë dhe as mundësi të realizohet.

UTRIKUL, - I. m. I ardhur nga latinishtja *utriculus* "kacek, shakull i vogël ashtëror". Utrikuli është strukturë anatomike në formën e mitërzës, të qeskës e labirintit cipor të veshit të brendshëm, që ka formë rrethore dhe në fund ka një shtresë receptorësh që reagojnë ndaj ndryshimeve të lëvizjeve të kokës. Utrikuli së bashku me qeskën më të vogël – shkulinë, me kanalet gjysmërrethore dhe me qendrën trunore të ekuilibrit rregullojnë vendndodhjen e trupit të njeriut dhe të pjesëve të tij në hapësirë, e pikërisht njeriu bëhet i vetëdijshëm për vendndodhjen e trupit të tij.

V

V simbol i faktorit verbal (i kuptimit të shprehjeve verbale ose fjalësore). Shih – ***AFTËSITË PARËSORE.***

VAGINIZ/ËM, - MI. m. Formë e çrregullimit seksual, e shkaktuar nga spazma e muskujve rrethuese të vaginës. Orvatjet për depërtim në të shkaktojnë dhembje të padurueshme. Është e metë anatomike e fiziologjike, por mund të shkaktohet edhe nga prapambetja e zhvillimit të marrëdhënieve seksuale. Në rastet e rënda të spazmave të pavullnetshme të muskujve marrëdhënia seksuale bëhet e pamundur.

VAGUS, - I. m. Emërtim latin i nervit endacak – çifti i nervave kafkorë. Ky nerv i përket çiftit X të nervave kafkorë dhe ka shumë degëzime qendërprurëse dhe qendërnxjerrëse që inervojnë këto organe: fytin, lukthin, mëlçinë, mushkëritë, shpretkën, veshin e jashtëm, veshkat, zemrën dhe zorrët.

VAJTIM, - I. m. Të qarët e njeriut e shoqëruar me britmë dhe me ulërimë që shpreh dhembje e pikëllim të madh për humbjen e njeriut më të dashur, për vdekjen e prindit, të fëmijës etj. Vajtimi i këtillë është forma e shprehjes së dhembjes dhe e pikëllimit në mjedisin dhe kulturën e popullit të një vendi. Shqiptarët e shprehin dhembjen e pikëllimin e tyre me vajtim, por këtë formë të shprehjes së dhembjes dhe të pikëllimit nuk e hasim te të gjithë popujt dhe as te anëtarët e dy gjinive të të njëjtit popull. Madje, te ne ekziston tradita e të kënduarit të këngëve të vajtimit, që i këndojnë vajtojca të vdekurit. Ndër vajtojcat hasen edhe ato me prirje poetike popullore.

VALENC/Ë, - A. f. I ardhur nga latinishtja *valere* "i, e vyer, me pas vlerë, me pas rëndësi". Termi valencë në psikologji ka ardhur nga kimia. U përdor kryesisht në psikologjinë tipologjike të psikologut amerikan me origjinë gjermane Kurt Levinit (Kurt Lewin, 1890 – 1931). Valenca emërton veçorinë tërheqëse ose refuzuese të një dukurie, objekti, një veprimi etj. për njeriun në hapësirën jetësore të tij. Është një konstrukt dinamik për njeriun, që ka të bëjë me vlerën pozitive ose negative të një ngjarjeje, individi, situate etj. të

fushës psikologjike të tij. Vlera pozitive ose negative e dukurisë, e individit, e situatës etj. në hapësirën psikologjike të njeriut përcaktohet nga nevojat momentale të tij. Këto kanë intensitet të ndryshueshëm varësisht nga gjendja e nevojave përkatëse të njeriut. Rrjedhimisht intensiteti i valencave mund të jetë i dobët, mesatar dhe i lartë.

VALENCA E QËNDRIMEVE. Përmasa pozitive ose negative e qëndrimeve të njeriut ndaj objektit të qëndrimit të tyre. Përcakton shkallën e intensitetit të qëndrimit pozitiv ose negativ të një qëndrimi ndaj objektit të vet, përkatësisht ndaj dukurisë, situatës, zhvillimeve etj.

VALËT AKUSTIKE. Dridhje longitudinale të cilat i shkakton trupi tingëllues dhe, në kushte të posaçme fizike, ngacmojnë receptorët e veshit dhe, duke u shndërruar në impulse nervore barten deri në qendrën e dëgjimit të cipës së trurit të madh, ku shkaktohet ndijimi dëgjimor apo akustik i tingullit të caktuar. Valët akustike janë shpeshtim dhe rrallim i valëve ajrore, duke shkaktuar ndijim të caktuar të intensitetit dhe të fuqisë së atij tingulli.

VALËT ALFA. Formë e valëve të trurit me frekuencë prej 8 – 13 valësh në sekondë dhe me amplitudë 5 - 15 mikrovolt. Karakterizojnë gjendjen e qetë të organizmit të zgjuar, kur njeriu mbyll sytë dhe truri i tij nuk është i sulmuar me impulse nervore të ngacmuesve të shqisave, të muskujve dhe të gjëndrave.

VALËT BETA. Lloj valësh elektrike të trurit me dendësi a frekuencë prej 14 -25 Hz dhe me ngarkesë elektrike prej 5 – 25 mikrovolt. Këto valë janë karakteristike për njeriun në gjendje zgjimi dhe veprimtarie.

VALËT DELTA. Lloj i valëve elektroencefalografike të trurit me frekuencë shumë të ulët, që sillet nga 0, 5 – 3,5 Hz dhe me amplitudë prej 150 valësh. Delta valët karakterizojnë valët elektroencefalografike të trurit të fëmijëve të vegjël. Këto valë shfaqen edhe te të rriturit, por vetëm atëherë kur këta janë në gjumë të thellë.

VALËT ELEKTROMAGNETIKE. Energji rrezatuese, e cila shpërndahet drejt dhe thyhet nga trupat e caktuar. Valët elektromagnetike kanë gjatësi të ndryshme dhe, në kushte të posaçme fizike ngacmojnë fotoreceptorët duke u shndërruar në impulse nervore. Më tej, duke u bartur në qendrën e të parit të cipës së trurit të madh, shkaktojnë ndijimin e të parit.

VALËT NERVORE. Fuqi potenciale me karakter bioelektrik që zhvillohen në trurin e madh të njeriut. Intensiteti dhe shpeshtësia e këtyre valëve mund të matet me anë të elektroencefalografit. Shih – ***ELEKTROENCEFALOGRAFIA.***

VALËT TRUNORE. Ndryshimet në ngarkesën e mundshme elektrike të trurit. Këto ndryshime përcaktohen qartë me anën e elektrodave përkatëse që vihen në lëkurën e kafkës dhe janë të lidhura me një oshilator specifik, e pikërisht me elektroencefalografin. Në këtë oshilator ndryshimet e ngarkesave elektrike të trurit dallohen në formë valësh elektrike. Ndryshimet e tilla janë të lidhura sistematikisht me angazhimin e veprimtarisë së njeriut në punën intelektuale dhe fizike.

VALËT ZANORE. Ndryshime të trysnisë së ajrit të shkaktuara nga ndërveprimi fluid i molekulave të ajrit dhe nga largimi i mëpasshëm i tyre. Në kushte të caktuara fizike këto valë ndikojnë në veshin e njeriut dhe ngacmojnë receptorët e dëgjimit.

VAMPIRIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga gjuhët sllave. Emërton qenie që supozohet se ngrihen nga varri, shkojnë nga një shtëpi në tjetrën dhe thithin gjakun e njerëzve. Është besim i lashtë, haset te shumë popuj. Haset edhe në disa gojëdhëna të Shqiptarëve. Në disa tekste ky term përdoret për të emërtuar perversionin seksual të drejtuar për shfrytëzimin e të vdekurve apo të të vdekurave si objekte marrëdhëniesh seksuale.

VANDALIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga italishtja *vandalismo*. Sjellje e egër dhe barbare e papërmbajtur; asgjësim i qëllimshëm i të mirave materiale e shpirtërore, plaçkitje e shoqëruar me mizori e vrasje. Ky term e ka burimin nga fisi vandal i gjermanëve, që për 14 ditët e para të vitit 155 e shkatërruan dhe e grabitën Romën dhe veprat artistike.

VARËSIA PSIKOLOGJIKE. Gjendja e organizmit të njeriut që karakterizohet me nevojën organike, psikologjike dhe me dëshirën e papërballueshme për të konsumuar drogë, alkool, etj. Megjithëse organizmi nuk ka nevojë biologjike për substanca të këtilla, ai mësohet dhe njeriu bëhet i varur nga këto substanca. Varësia e këtillë dallohet nga sjelljet e çuditshme të individit që ka varësi nga substanca të tilla.

VARIABËL. Shih – ***NDRYSHORJA.***

VARIACION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *variatia* "ndryshim". Nënkupton ndryshimin e cilësisë, të funksionit, të gjendjes, të trajtës së një dukurie, të një procesi etj. dhe përmasat e këtij ndryshimi.

VARIANCË, - A. f. Masë statististikore e përcaktimit të ndryshimit ndërmjet rezultateve të anëtarëve të një grupi të caktuar të arritura në procesin e testimit. Varianca përfaqëson shmangien mesatare të secilës vlerë nga mesatarja aritmetike e ngritur në katror. Kjo është shmangia standard e ngritur në katror. Kjo masë statistikore gjendet sipas formulës:

$$S^2 = \frac{\sum (X - M)^2}{N}$$

(S në katror është varianca, X = secili rezultat individual, M = e mesmja aritmetike e rezultateve dhe N = numri i përgjithshëm i rezultateve.

VAZOJA RUBIN. Figurë ilustruese e raportit ndërmjet fytyrës së vizatuar të objektit perceptues (të një vazoje) dhe sfondit, mbi të cilin është vizatuar fytyra e objektit perceptues. Këtë raport e dallojmë në figurën e mëposhtme:

Në këtë figurë raporti ndërmjet fytyrës së vizatuar të objektit perceptues dhe sfondit mbi të cilën është vizatuar kjo figurë është raport i papërcaktuar, sepse nuk ka shenja dalluese ndërmjet figurës dhe sfondit dhe, për këtë shkak, perceptuesi mund të perceptojë

herë vazon, herë profilin e dy fytyrave të njerëzve, të vendosura njëra përballë tjetrës. Kjo figurë mori emrin e filozofit danez Edgar Rubinit (Edgar Rubin, 1886 – 1951).

VAZOMOTORIK, – E. mb. I ardhur nga latinishtja *vasomotorius* që ka të bëjë me ngushtim ose me zgjerim të enëve të gjakut, përkatësisht të venave dhe arterieve të gjakut, që gjenden nën ndikimin e drejtpërdrejtë të sistemit nervor simpatik. Zgjerimi i enëve të gjakut quhet vazodilatacion, kurse zvogëlimi i tyre emërtohet me termin vazokonstruksion. Ndryshimet e këtilla janë të lidhura edhe me ndryshimin e gjendjeve emocionale të njeriut.

VAZHDIMËSI, – A. m. Term i përgjithshëm që ka kuptimin e një procesi apo dukurie të pandërprerë. Në psikologji është seri e pandërprerë ndryshimesh të një ndryshoreje psikologjike. Zakonisht vazhdimësia në psikologji shfaqet në formën e ndryshimeve të pandërprera që sillen prej një skaji vlerash në skajin tjetër të vlerave negative. E tillë është vazhdimësia e ndjenjës së kënaqësisë dhe pakënaqësisë dhe ndryshimet ndërshkallëzore të tyre.

VDEKJ/E, - A.f. Ndërprerje e pakthyeshme e funksionit biologjik e psikik të organizmit, të cilin e shkakton moskëmbimi i përhershëm i lëndëve biokimike të organizmit. Gjendje kur organizmi ka humbur përfundimisht aftësinë e mbajtjes në jetë të vetes. Çasti i humbjes së kësaj aftësie sot përcaktohet me mosfunksionim të trurit. E tillë konsiderohet se është vdekja absolute. Në psikopatologji bëhet fjalë edhe për vdekjen klinike e natyrore.

VEBER H. Ernst (Ernst H. VEBER). Anatom dhe fiziolog gjerman. Lindi në Vitenberg më 14.06.1795 dhe vdiq në Lajpcig më 26.01.1878. Profesor i anatomisë dhe i fiziologjisë së njeriut në Fakultetin e Mjekësisë në Lajpcig. Themelues i psikofiziës dhe ndër themeluesit e fiziologjisë bashkëkohore të fillimit të shekullit të nëntëmbëdhjetë. U mor me gjurmimin e raportit ndërmjet intensitetit të ngacmuesit dhe ndijimit përkatës, pra ndërmjet intensitetit të ngacmuesit dhe rritjes së tij për të hetuar një ndijim të një niveli tjetër. Ky do të ishte pragu i ndryshimit ose pragu diferencial. Këtë u angazhua ta përcaktojë në bazë të provave eksperimentale. Ndërkaq, rezultatet e këtyre gjurmimeve i shpjegoi kolegu i tij Gustav Fehneri dhe këtë e quajti "Ligji Veber - Fehner". Sipas këtij ligji rritja e intensitetit të ngacmuesit dhe ngritjes së intensitetit të tij për të bërë dallimin ndërmjet intensitetit të parë ngacmues dhe ngritjes së intensitetit të tij që shkakton dallim ndijimor ndërmjet intensitetit të parë dhe shtimit të tij për të shkaktuar ndryshim të ndijimit tyre është rritje konstante. Kjo do të thotë nëse intensiteti i ngacmuesit është 10 gr subjekti ka ndijimin e një peshe të caktuar, por rritja e tij prej 11, 14, 16, 18 gramësh nuk shkakton ndijim të peshës tjetër. Këtë ndryshim subjekti e heton vetëm kur intensiteti i peshës arrin në nivelin prej mbi 20 gramësh. Kështu ngjet edhe ndërmjet peshës 20 e 30 gramë; subjekti e përjeton ndijimin tjetër vetëm kur kjo peshë është mbi 30 gramë. Këtë raport 10, 20, 30 etj. me 1, 2 , 3 etj. Ernst Veberi e quajti raport konstant dhe mbeti në psikologji i emërtuar si

konstantja e Veberit. Por një raport i tillë ka ndryshime prej një shqise në tjetrën, madje edhe përbrenda kufirit ngacmues : ndijim. Rezultatet e mëvonshme kanë treguar se raportet e tilla vlejnë kryesisht në kuadrin e vlerave mesatare; për ngacmuesit me intensitet shumë të lartë dhe shumë të vogël raporti i tillë nuk vlen. Vepra kryesore e tij është: *"Handvorterbuch der Physiologie, I – IV"* – (*"Fjalor i fiziologjisë, I – IV"*), 1842 – 1853.

VEÇANTIA E PERSONALITETIT. Karakteristikë themelore e personalitetit (përpos integritetit dhe qëndrueshmërisë). Veçantia e personalitetit ka të bëjë me llojin e tipareve e të veçorive të sjelljeve të personalitetit dhe me shkallën e lidhjes dhe të organizimit të tyre. Në bazë të kësaj karakteristike themelore personaliteti i njërit individ ndryshon nga personaliteti i të gjithë të tjerëve.

VEÇIM, - I. m. Shkëputje e një cilësie, e një objekti, përvoje individuale etj. nga të tjerët. Kryhet me angazhim të posaçëm mendor dhe ka të bëjë me njohjen e thellë të asaj që njeriu e shkëput mendërisht, duke i kushtuar vëmendje të posaçme njohjes së identitetit të saj, veçorive dhe përmasave të asaj që njeriu e ka shkëputur nga të tjerët.

VEÇORITË E NGJYRAVE. Secila ngjyrë kromatike ka tri veçori themelore, të cilat janë:

a. **Çeltësia e ngjyrës** – Shkalla e ngjashmërisë së ngjyrës me ngjyrën e bardhë; sa më afër ngjyrës së bardhë të jetë një ngjyrë kromatike, aq më e çelët është ajo ngjyrë dhe, përkundrazi, sa më afër ngjyrës së zezë të jetë një ngjyrë, aq më e murrme, e mbyllët, e aq më pak e çelët është ajo ngjyrë. Çeltësinë e ngjyrës e përcakton intensiteti i saj.

b. **Ndritshmëria e ngjyrës** – Shkalla e shprehjes së tonit apo cilësisë së një ngjyre. Sa më e pastër të jetë një ngjyrë, aq më e ndritshme është ngjyra.

c. **Toni i ngjyrës** – Cilësia e një ngjyre që e bën të dallohet një ngjyrë nga ngjyra tjetër. Toni ose cilësia e ngjyrës varet në rend të parë nga gjatësia e valëve elektromagnetike. Kështu, cilësinë e ngjyrës së kuqe e përcakton gjatësia e valëve elektromagnetike prej rreth 700 nanometër, të gjelbrën e përcakton gjatësia e valëve prej rreth 510 nanometër, të verdhën e përcakton gjatësia e valëve prej rreth 580 nanometër dhe të kaltrën gjatësia e valëve prej rreth 480 nanometër.

VEÇORITË E PERCEPTIMIT. Perceptimi si rezultat i procesit të ndërlikuar fizik, fiziologjik e psikologjik ka këto veçori:

a. **Karakteri aktiv i perceptimit** – Perceptimi është produkt i angazhimit të vëmendjes, të kujtesës, të interesimit, të mendimit, të folurit, të qëndrimit dhe të motivimit të njeriut;

b. **Karakteri tërësor i perceptimit** – Përjetim i vetëdijshëm i tërësisë së një dukurie, objekti, situate etj.;

c. **Objektiviteti i perceptimit** – Vetëdija e njeriut për ekzistencën e dukurisë, të objektit, të procesit, të situatës etj. që perceptohet;

d. **Karakteri konstant i perceptimit** – Perceptimi është i pandryshueshëm, pavarësisht nga ndryshimet e vogla fizike që pëson objekti, procesi, situata etj. Libri ka formë katërkëndëshe, pavarësisht nga figura e kapakut të atij

libri; kur ai vështrohet anash edhe kjo figurë ka formën e trapezit;

e. **Karakteri organizues** – Perceptimi ka bazë të sigurt të tërësisë së trupit perceptues. Perceptimi nuk mund të jetë renditje e thjeshtë e elementeve shqisore njëri pranë tjetrit;

f. **Karakteri përzgjedhës i perceptimit** – Nga shumësia e dukurive, e objekteve, e proceseve etj. të një mjedisi perceptues njeriu zgjedh për perceptim atë që i intereson, atë që pret, që ka rëndësi të veçantë për të etj. Përzgjedhja i jep karakter aktiv perceptimit dhe nën ndikimin e faktorëve psikikë (të interesimit, të qëndrimit, të pritjes etj.) njeriu thuajse shpesh arrin deri në dukurinë e emërtuar "verbim perceptues".

VEÇORITË E PERSONALITETIT. Veçoritë kryesore të personalitetit janë tri: 1) Integriteti i tipareve të personalitetit; 2) Qëndrueshmëria e tipareve të personalitetit dhe 3) Veçantia e personalitetit. Integriteti i tipareve të personalitetit ka të bëjë me tërësinë e organizuar të tipareve karakteristike që shfaqen në sjelljet e njeriut. Qëndrueshmëria e tipareve të personalitetit kupton mosndryshimin thelbësor të tipareve të sjelljeve, që shfaqen në situata të ngjashme dhe në situata të ndryshme të njeriut. Veçantia e personalitetit është uniteti i tipareve karakteristike, ndërlidhja si edhe mos përsëritja e tyre.

VEÇORITË E TESTIT. Vlera, besueshmëria, objektiviteti dhe ndjeshmëria e testit. Shih – ***KARAKTERISTIKAT METRIKE TË TESTIT.***

VEÇORITË PSIKIKE. Gjendje, proces, sjellje karakteristike, përbërëse kryesore e individualitetit të asaj gjendjeje dhe procesi psikik dhe e sjelljeve të caktuara, në bazë të të cilave ajo gjendje, ai proces psikik dhe ajo sjellje ndryshon nga të tjerat. Veçoritë psikike mund të jenë të shumëllojshme. Nga këto dallohen veçoritë filogjenetike dhe ato ontogjenetike. Veçoritë filogjenetike kanë të bëjnë me karakteristikat e përgjithshme të proceseve, të gjendjeve dhe të sjelljeve të të gjithë gjinisë njerëzore (disa nevoja organike, reflekse natyrore). Veçoritë filogjenetike karakterizojnë individin e caktuar dhe këto janë kryesisht produkt i përvojës dhe i procesit të të mësuarit.

VEGULLIM, - I. m. Momenti kur syri, veshi, hunda, etj. sapo arrijnë të kapin ngacmuesin fizik (dritën, zërin, aromën, etj.) dhe reagojnë ndaj tij. Ky moment është pragu minimal i ndjeshmërisë së shqisave. Nën këtë prag njeriu nuk e ndien erën, syri nuk e sheh as në mjegull burimin e dritës, veshi nuk ndjen tinguj me intensitet nën këtë prag. Vegullimi ka karakter individual.

VEHBIU Ylvi. Mjek psikiatër shqiptar. Lindi në Gjirokastër më 1931. Pas përfundimit të studimeve për mjekësi u specializua për neuropsikiatri në Institutin e Parë të Mjekësisë "A. Seçenov" në Moskë (1950 – 1956). Nga viti 1956 punoi në klinikën e psikiatrisë të Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Tiranës, ku qe dhe përgjegjës i kësaj klinike gjatë viteve 1971–1993. Profesor i lëndës psikiatri ligjore në Fakultetin e Shkencave Politiko- Juridike të Universitetit të Tiranës nga viti 1956. Në vitet 1995 – 2005 ka shërbyer si psikiatër në një spital psikiatrik në Nju Jork. Është autor i disa studimeve nga fushat e ndryshme të mjekësisë, si:, patofiziologjia, epidemiologjia

etj. Ka konceptuar dhe zbatuar metodat eksperimentale për mjekimin dhe shërimin e sëmundjeve mendore; për nevoja studimore dhe mjekuese zbatoi edhe metodën biologjike. Zbatoi i pari metodën psikoterapeutike për mjekimin e gjendjes së ankthit. Veprat kryesore të tij janë: *"Psikiatria ligjore*" (me bashkautor), Tiranë, 1975; *"Psikiatria",* 1973 (me bashkautor); "Manual etimologjik psikiatrik", 1975.

VEKSLER Dejvid (David Wecksler). Psikolog amerikan me prejardhje rumune. Lindi më 1896 dhe vdiq më 1981. I njohur më tepër me studimet e tij për inteligjencën dhe matjen e zhvillimit të saj te të rriturit dhe te fëmijët. Pas përfundimit të kolegjit të Nju Jorkut vazhdoi studimet në Paris te psikologu Anri Pieron. U diplomua për psikologji në Universitetin e Kolumbisë në Nju Jork te studiuesit e njohur të këtij Universiteti Xhejms M. Katel dhe Eduard Torndajk, ku më pas dhe doktoroi. Më 1932 u emërua shef i shërbimit psikologjik në "Spitalin Belvi" të Nju Jorkut, ku kreu gjurmime përmasash të jashtëzakonshme me të rritur dhe me fëmijë. U zgjodh profesor i psikologjisë klinike në universitetin e Nju Jorkut. Veprat kryesore të tij janë: "*Measurement of Adult Intelligence"* – ("*Matja e inteligjencës së të rriturve*"), Baltimor, 1939; *"Wecksler Intelligence Scale for Children"* – (*"Shkalla Veksler e inteligjencës për fëmijë"* (mosha 6 – 16 vjeç)), Nju York, 1949; *Wecksler Adult Intelligence Scale"* – (*"Shkalla Veksler e inteligjencës për të rritur"* Nju York, 1955. shkalla I Veksler – Belvi u botua më 1929, kurse botimi i rishikuar i shkallës II Veksler – Belvi u botua më 1946. Nga viti 1955 u përpunuan rishikime të gjëra për matjen e inteligjencës së të rriturve. Shkalla Veksler për fëmijë njihet me shkurtesën WISC (rishikimi i fundit WISC III. R.), ndërkaq, rishikimi i fundit i vitit 1981 për matjen e inteligjencës së të rriturve njihet me shkurtesën WAIS – III. R.

VEKTORI, - I. m. I ardhur nga latinishtja *vector* "bartës". Vektori është madhësia e një trupi, dukurie etj. me intensitet dhe me drejtim të caktuar. Ky term ka ardhur nga matematika dhe në psikologji emërton lëvizje e zhvillime procesesh dhe sjelljesh me drejtim dhe me intensitet të caktuar. Ka formë grafike të caktuar dhe paraqitet me formën e shigjetës, gjatësia e së cilës tregon intensitetin, kurse maja e saj tregon drejtimin.

VELETI, - A. f. Zgjuarsi. Ende ka trajtën e të folurit të përditshëm në disa zona shqipfolëse, por ka mundësi të ngrihet në nivelin e termit psikologjik, duke emërtuar konceptin e shkathtësisë inteligjente të njeriut për t`u gjendur shpejt dhe lehtë në situata problemore. Shih – ***ZGJUARSIA.***

VENDI I KOERULEUSIT. Pozicioni i një organi trunor në urën e Varolit, i njohur me termin latin "*locus coeruleus*". Përbëhet prej grup qelizash nervore, që me neuritet e tyre lidhin këtë organ të trurit me trurin e madh. Neuritet e këtyre grupeve qelizore kryejnë funksionin e rregullimit të fjetjes dhe të gjendjes së zgjuar të organizmit. Këto marrin pjesë edhe në zhvillimin e proceseve emocionale.

VENDI RECEPTOR. Vendi specifik i cipës apo membranës së ndjeshme ndaj një neurotransmetuesi dhe hormoni të caktuar. Prania e substancave

neurotransmetuese dhe hormonale në këtë vend dhe ndjeshmëria e tyre ndaj impulseve nervore shkakton ndryshime karakteristike të qelizave nervore që rrjedhin njëra pas tjetrës.

VENDIM, - I. m. Fazë e veprimtarisë së vullnetshme që karakterizohet nga përcaktimi i qëndrimit përfundimtar të një individi për një qëllim të caktuar, për mjetin dhe rrugën që shpie drejt realizimit të atij qëllimi, pas shqyrtimit të hollësishëm të tyre dhe të mundësive e kushteve të realizmit të atij qëllimi. Marrjes së vendimit i paraprijnë proceset e ndërlikuara motivuese, intelektuale dhe emocionale. Vendimi i qëndrueshëm është i lidhur me ekzekutimin e tij, dhe, së bashku përbëjnë fazat e ndërlidhura të veprimtarisë së vullnetshme. Ky shpjegim i përket psikologjisë klasike të lidhur me proceset konotative. Sot kjo fazë e veprimtarisë së vullnetshme mbështetet në teorinë e përmbajtjes dhe proceseve të motivimit. Teoria e përmbajtjes i përket fazës së hershme të zhvillimit të psikologjisë, të bazuar kryesisht në përmbushjen apo plotësimin e nevojave organike të njeriut. Teoria e proceseve të marrjes së vendimit mbështetet në përjetimin e shkallës së sigurisë, se një qëllim mund të arrihet dhe në atë se vendimmarrja për arritjen e një qëllimi varet nga vlera e atij qëllimi për njeriun dhe aktivitetin e tij.

VENDOSMËRIA SOCIALE. Pikëpamje e përgjithshme sipas së cilës njeriu zhvillohet dhe formohet si qenie e posaçme, falë faktorëve shoqërorë dhe ndikimit mbisundues të tyre ndaj të gjithë faktorëve të tjerë. Në formimin e njeriut si qenie sociale janë vendimtare normat, rregullsitë, parimet e standardet e mjedisit social dhe vlerat sociale të atij mjedisi**.**

VENITJA E PËRFYTYRIMEVE. Veçori e përfytyrimeve që shfaqet në humbjen e gjallërisë, të freskisë së përfytyrimit, në dobësimin e tyre dhe në humbjen graduale të objekteve e dukurive të përjetuara dikur.

VENTRIKUL, - I. m. I ardhur nga latinishtja *ventriculis* "që ka trajtën e barkushes. Term i anatomisë që emërton secilën prej dy barkusheve të poshtme të zemrës dhe secilën prej katër barkusheve të trurit të mbushura me lëngun cerebrospinal, i cili mbush edhe kanalin qendror të trurit, si edhe boshllëkun e vogël ndërmjet cipave që mbulojnë trurin. Funksioni kryesor i lëngut të barkusheve të trurit është mbrojtja e trurit dhe e të gjitha pjesëve të tij nga sulmet dhe tronditjet e ndryshme, si edhe marrja pjesë e tij në proceset metabolike të qelizave nervore.

VEPRIM, - I. m. Njësi e veprimtarisë apo aktivitetit të caktuar të njeriut që ka strukturë të ndërlikuar elementesh intelektuale, emocionale dhe konotative. Kjo njësi shfaqet drejtpërdrejt me aktivitetin konkret të njeriut ndaj objektit, dukurisë, procesit të caktuar të mjedisit ku jeton dhe vepron. Veprimi ka për pasojë ndryshimin e dukurisë, të objektit, të raportit ose të cilësive të tyre.

VEPRIMET IDEOMOTORIKE. I ardhur nga greqishtja *ιδέα* "ide", nga latinishtja *motus* "lëvizje" dhe *activus* "veprues". Veprime të shkaktuara e të bashkangjitura drejtpërdrejt me një ide, me një mendim të caktuar, me një perceptim të paraqitur, por që realizohen pa pjesëmarrjen e vullnetit

të njeriut. Zakonisht veprimet ideomotorike janë veprime me intensitet shumë të ulët dhe vështirë se mund të regjistrohen me aparate të ndjeshme. Të tilla janë: veprimi i përkujtimit të vargjeve të një poezie që shoqërohet me lëvizje tejzash të zërit e buzësh, të kujtuarit e notit gjatë kohës së shtrirjes në shtrat që shoqërohet me disa lëvizje të imta të gjymtyrëve, siç ngjet edhe me përkujtimin e një "meçi" boksi që shkakton lëvizje të duarve etj. Mbi bazën e ekzistencës së veprimeve ideomotorike është ngritur edhe pohimi i ndërprerjes jo të menjëhershme i aktivitetit të një individi që merret me punë fizike, nga aktiviteti i një individi tjetër që merret me punë mendore. Në punën fizike mbisundon aktiviteti motorik, kurse në punën mendore mbisundon aktiviteti psikik, të cilit i bashkëngjiten lëvizjet trupore. Aktivitetin ideomotorik e ka theksuar posaçërisht psikologu dhe mendimtari amerikan Uiliam Xhejms (William James, 1842 – 1910).

VEPRIMET SIMPTOMATIKE. Veprime të rastësishme dhe të natyrës së pavetëdijshme, si: prekja e hundës, përdorimi i çelësave të makinës në dyqan apo në zyrë, rregullimi i kravatës etj. Për psikanalizën veprimet e tilla kanë motivin e tyre. Zakonisht motiv i veprimeve të këtilla është dëshira e pavetëdijshme e njeriut për të prekur hundën e një njeriu tjetër, për të ngarë makinën, për t`u treguar i rregullt, i bukur etj.

VEPRIMI I DHUNSHËM. Veprim i pakuptimshëm i njeriut që shkaktohet nga disa ndjenja, prej të cilave ai çlirohet me shumë vështirësi (numëron vazhdimisht dritaret e shtëpisë, muret e saj, gurët e pragut të shtëpisë, pastron vazhdimisht të njëjtat objekte, përsërit me të njëjtat fjalë përmbajtje të caktuara etj.). Disa nga këto veprime janë shumë të mundimshme dhe kanë pasoja të rënda (nëna vazhdimisht fsheh brisqet, thikat, sëpatën, etj. nga frika e përdorimit vend e pavend të tyre, p.sh., nga frika e prerjes së fëmijëve të saj etj.).

VEPRIMI INSTINKTIV. Veprim që ka bazë instinktive. Termi veprim instinktiv shpesh përdoret gabimisht edhe në gjuhën shqipe, kur emërton ato sjellje të mësuara që momentalisht njeriu nuk i kontrollon me vetëdijen e tij. Veçoria e pavetëdijshme e veprimeve është njëra ndër karakteristikat e instinkteve; të shkruarit vazhdimisht të një fjale me gabime nuk është veprim instinktiv, ndonëse shpesh themi e shkrova instinktivisht, pikërisht e shkrova pa kontrollin e duhur të vetëdijes. Një veprim i tillë nuk ka bazë të lindur, ka karakter individual dhe të shkruarit është shkathtësi e mësuar.

VEPRIMI NERVOR. Depolarizimi dhe polarizimi rishtas i cipës apo i membranës së neuroneve që shkaktohet nga ndikimi i ngacmuesve të posaçëm. Veprimi i këtillë merr formën impulsive nervore që shpërndahet, e pikërisht zgjerohet në trurin e njeriut, duke përfshirë edhe qendrat e trurit. Shpërndarja apo zgjerimi i impulseve të tilla nervore bëhet me anë të angazhimit të posaçëm të fijezës nervore. Ky veprim në psikofiziologji është i njohur edhe me emrin potenciali veprues i nervit.

VEPRIMTARI, - A. f. Sistem veprimesh fiziologjike, psikologjike e shoqërore të ndërlidhura dhe të organizuara në një

tërësi të caktuar, që kryhet nga ana e një individi në një fushëveprim të caktuar. Veprimtaria e këtillë zakonisht është e organizuar dhe e drejtuar në arritjen e një qëllimi dhe në zotërimin e tij. Ka shkallë të ndryshme të angazhimit të energjisë fizike, psikike dhe shoqërore, duke filluar nga ajo me angazhim minimal të kësaj energjie të njeriut në gjendje të fjetur, e duke ardhur deri në atë të veprimtarisë që kërkon energji maksimale në punën profesionale fizike dhe mendore.

VEPRIMTARIA E LARTË E SISTEMIT NERVOR QENDROR. Baza organike e aftësisë për të mësuar, mbajtur mend, përfytyruar, menduar dhe folur. Kjo është e lidhur me veprimtarinë e cipës apo kores së gjysmërruzujve të trurit të madh, rrjedhimisht me funksionin e pjesës ballore të kësaj cipe. Kjo strukturë anatomike dhe funksionet fiziologjike të saj përbëjnë strukturën anatomike dhe fiziologjike të proceseve njohëse. Shih **– *TRURI; KORJA E TRURIT TË MADH.***

VEPRIMTARIA E LARTË NERVORE. Term i shkollës fiziologjike ruse që përfshin proceset neurofiziologjike e psikike të cipës së trurit, kurse më vonë shtrirja e kuptimit të këtij termi ka përfshirë edhe qendrat subkortikale. Ky term në pikëpamjen funksionale emërton aktivitetin e lidhjes së organizmit me botën e jashtme dhe me ndikuesit e tij në sistemin nervor. Brenda këtij kuptimi termi ka për bazë lidhjen e ngacmuesve me reagimin nervor dhe zhvillimin e formave të reagimit refleksiv, mbi të cilin zhvillohen format e ndërlikuara të veprimtarive të njeriut. Baza themelore e veprimtarisë së lartë nervore është sistemi i reflekseve të kushtëzuara. Sipas këtij sistemi proceset nervore të lidhjes së tyre me ngacmuesit e mjedisit të jashtëm zhvillohen në bazë të kundërshtive natyrore të funksionimit të nervave: veprim–inhibim, duke krijuar në këtë mënyrë funksionin e analizës–sintezës dhe atë të diferencimit–përgjithësimit. Zbulimet neuropsikologjike të kohëve të fundit tregojnë se veprimtaria e lartë nervore i përket kohës kur mori hov zhvillimi i teorisë së rëndësisë së reflekseve të kushtëzuara në lidhjen e njeriut me mjedisin e jashtëm dhe me ndryshimet e tij, si edhe zhvillimin e sjelljeve të njeriut për përshtatjen e tij ndaj mjedisit, por edhe ndaj ndryshimeve të tij. Termi veprimtari e lartë nervore lidhet me veprimtarin e shkollës fiziologjike ruse, sidomos me rezultatet e gjurmimeve të Ivan P. Pavllovit (Ivan P. Pavlov, 1849 – 1936).

VEPRIMTARIA E VULLNETSHME. Kompleks veprimesh individuale të shkaktuara nga motive të ndryshme dhe të drejtuara në arritjen e një qëllimi të caktuar dhe në zotërimin e tij, qëllim ky, i paraparë dhe i miratuar nga ana e një individi, duke u mbështetur në dijeninë mbi kushtet, mjetet, rrethanat dhe rrugët që mundësojnë realizimin e atij qëllimi. Shih – ***VULLNETI.***

VEPRIMTARIA INTELEKTUALE. Struktura të shumëllojshme të aktiviteteve të njeriut, ku dominon mendja dhe proceset mendore, ndërsa aktiviteti i muskujve, fuqia dhe energjia e tyre vihen më pak në dukje.

VEPRIMTARIA PSIKIKE. Tërësia e proceseve psikike dhe e të gjitha formave të sjelljeve. Këtu bëjnë llojet e

proceseve psikike (proceset njohëse apo kognitive, emocionale dhe konotative), struktura e zhvillimi i tyre, sjelljet me format e shumëllojshme, zhvillimi dhe formimi i tyre, si edhe baza anatomike - fiziologjike dhe shoqërore e proceseve psikike dhe e sjelljeve të njeriut.

VERBALIZIM, - I. m. Procesi i shprehjes së përmbajtjeve psikologjike të njeriut me anë të fjalëve dhe fjalive, të lidhjeve ndërmjet tyre dhe artikulimit të rrjedhshëm të tyre. Përmbajtjet psikologjike (mendimet, ndjenjat, marrja e vendimit etj.) bëhen të kuptueshme dhe të sakta, atëherë kur këto formulohen me një sistem fjalësor të duhur dhe të rrjedhshëm.

VERBALIZ/ËM, - MI. m. Zbatim i tepruar i fjalëve në përshkrimin dhe shpjegimin e dukurive, të objekteve dhe të raporteve të njohura, që e pushtojnë situatën komunikuese ndërmjet individëve pa kuptimin përkatës dhe pa një kuptim të vlefshëm. Shfaqet më tepër te ata që kanë besim të madh në rolin dhe në rëndësinë e fjalëve dhe në kombinime të panumërta të tyre, duke "bombarduar" me shprehje të shumëllojshme që në thelb nuk thonë asgjë të re dhe të mençur.

VERBALIZMI MËSIMOR. Formë e dëmshme e të mësuarit në shkollë që karakterizohet nga të mësuarit e thatë të fjalëve e lidhjeve të tyre, por jo edhe të përmbajtjeve e kuptimeve që kanë ato. Shfaqet gjatë të mësuarit përmendësh të përmbajtjeve në lëndën e letërsisë, historisë, matematikës etj.

VERBËR (I, E). mb. Që ka humbur aftësinë e të parit duke mos qenë në gjendje të dallojë të thuash asgjë nga objektet, dukuritë, proceset objektive të fushës së të parit. Verbëria e tillë ndryshon nga 0 – 5 % e shikimit normal dhe karakterizohet nga ngushtimi i fushës së të parit deri në 15 %. Verbëria mund të jetë e pjesshme dhe manifestohet në pamundësinë e zhvillimit të mprehtësisë së të parit. Të parit normal mundëson dallimin e një objekti në largësi prej rreth 20 m, kurse ai me verbëri të pjesshme mezi e dallon këtë objekt edhe në largësi prej 1 m.

VERBËRI, - A. f. Gjendje organike dhe psikike e atij që humb aftësinë e të shikuarit, të cilën e karakterizon pamundësia e dallimit të errësirës nga drita dhe paaftësia e leximit të tekstit me syza. Në kuptimin e ngushtë verbëria ka të bëjë me zvogëlimin e mprehtësisë së të parit prej 20/200, ose kufizimin e fushës së të parit në më pak se 20 gradë pamjeje nga largësia këndore.

VERBËRIA NDAJ NGJYRAVE. Verbëria e njeriut ndaj ngjyrave është gjendja organike dhe psikike e tij, që humb aftësinë e dallimit të ngjyrave, ose të disa prej tyre. Një verbëri e tillë shfaqet në këto forma:

a. **Verbëria monokromatike** – Lloj i rrallë i verbërimit të plotë për ngjyra, kur njeriu dallon vetëm një nuancë;
b. **Verbëria ndaj ngjyrave kromatike** – Paaftësia e dallimit të ngjyrave themelore (të ngjyrës së gjelbër, të kuqe, të kaltër dhe të verdhë). Këto ngjyra i sheh në nuancën e përhimët. Në rastet e tilla në retinën e syrit të njeriut mungojnë qelizat receptore në formë konesh. Shih - ***AKROMATOPSIA***;
c. **Verbëria e pjesshme ndaj ngjyrave** – Paaftësia e dallimit të disa lloj ngjyrash kromatike, ku dallohet sidomos paaftësia

e dallimit të ngjyrës së kuqe dhe të gjelbër. Shih - ***DALTONIZMI; PROTANOPIA; DEUTERANOPIA.***

VERBIGJERACION, - I. m. I ardhur nga latinishtja *verbum* "fjalë" dhe *gerere* "prodhoj" që nënkupton stereotipinë foljore. Formë e të folurit dhe të menduarit, të cilën e karakterizon përsëritja ritmike dhe me ton të njëjtë e fjalëve dhe e frazave të pakuptimta. Ata që vuajnë nga kjo e metë ruajnë të njëjtin tonalitet të zërit gjatë përsëritjeve të të njëjtave fjalë dhe fraza.

VERBIMI KULTUROR. Emërtim i perceptimit dhe i vlerësimit të kulturave të tjera nga këndvështrimi i normave dhe i standardeve të sjelljes kulturore të mjedisit kulturor të atij individi. Individi i tillë ka vështirësi të bëhet i vetëdijshëm se mjediset e ndryshme kanë kultura, norma dhe standarde kulturore të vetat, që ndryshojnë nga normat dhe standardet kulturore të individit të atij mjedisi prej nga ai vjen. Duke iu përmbajtur perceptimit dhe vlerësimit të zhvillimeve kulturore të mjediseve të të tjerëve sipas këndvështrimit të tij, të normave dhe standardeve kulturore të tij ai has në konflikte ndërnjerëzore që mund të jenë të rënda, herë-herë edhe me pasoja të paparashikueshme.

VERBIMI PSIKIK. Paaftësi e mbajtjes mend të kuptimit dhe rëndësisë së një objekti dhe e sjelljes ndaj tij sipas vlerës dhe rëndësisë së objektit, ngaqë dëmtohet qendra e të parit në pjesën parietale ose tepore trurit të madh të kafshës. Në raste të tilla kafsha sheh, por nuk është gjendje të mbajë mend përse shërben dera e gardhit të bagëtive, gjatë kohës kur ajo i drejton sytë në këtë derë.

VERDHË (I, E). mb. Që ka ngjyrë ari, limoni të pjekur etj. Këtë cilësi të ngjyrës e përcaktojnë valët elektromagnetike me gjatësi prej rreth 580 milimikronësh.

VERIFIKIM, - I. m. I ardhur nga latinishtja *verificatio* "vërtetim i së vërtetës". Verifikimi është proces i kontrollimit, i vërtetimit të saktësisë së një hipoteze, të një përfundimi, të një teorie në bazë të argumenteve objektive dhe empirike. Është proces i domosdoshëm për të përcaktuar vërtetësinë e supozimeve, për të përforcuar vlefshmërinë e formave të mendimit. Në psikologjinë e mendimit krijues verifikimi është faza përfundimtare e tij. Kjo është faza praktike e miratimit të vërtetësisë së zgjidhjes së një situate problemore, përkatësisht e aktit krijues përfundimtar.

VERMIS, - I. m. I ardhur nga latinishtja *vermis* "krimb". Formacion anatomik i trurit të vogël, i vendosur në pjesën e mesme të trurit të vogël apo cerebelumit. Nga "çatia" e vermisit vijnë impulset nervore dëgjimore dhe pamore, kurse nga palca kurrizore vijnë impulset nervore të lëkurës dhe ato kinestetike. Nëpërmjet bërthamës së këtij formacioni anatomik, në trurin e vogël të quajtur "nukleus", fijezat nervore shtrihen deri në traktin apo tufën e zgjatur nervore vestibulo-spinale dhe retikulo-spinale.

VERTIGO, - JA. asnj. I ardhur nga latinishtja *vertigo* "marrje mendsh". Haset në psikopatologji dhe në psikiatri. Ka kuptimin e marramendjes së njeriut, që shkaktohet nga çrregullimi i mekanizmit sensorik të baraspeshës së organizmit lidhur me sëmundje të

organeve të pjesës së veshit të mesëm. Shfaqet me sjellje të turbullta dhe çorientuese të njeriut ndaj objekteve të mjedisit të tij dhe me përjetim të lëvizjeve të çrregulluara të trupit të tij.

VERTHAIMER Maks (Max WERTHEIMER). Psikolog çek, një ndër themeluesit e Shkollës së Berlinit të psikologjisë geshtaltiste. Lindi në Pragë më 15.04.1880 dhe vdiq në Nju Jork më 12.10.1943. Studioi psikologji në Pragë, në Berlin dhe në Vjenë dhe kreu doktoratën në psikologji në shkollën e Virzburgut. Gjurmues i perceptimeve dhe i iluzioneve, si dhe i psikologjisë së të menduarit. Lektor në Universitetin e Frankfurtit, docent në Universitetin e Berlinit, profesor në Universitetin e Frankfurtit. Redaktor i revistës "Gjurmime psikologjike" – "Psychologische Forschungen". Mërgoi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës më 1933 dhe punoi si profesor i psikologjisë në "New School of Social Research" – "Shkolla e Re për Gjurmime Sociale" në Nju Jork. Rezultatet e gjurmimeve të tij në fushën e perceptimeve dhe të të menduarit kanë argumentuar se disa nga dukuritë psikologjike të njeriut nuk mund të shpjegohen me psikanalizë. Është ndër psikologët origjinalë për shpjegimin e proceseve dhe të disa llojeve të sjelljeve. Veprat kryesore të tij janë: "*Experimentelle Studien uber das Sehen von Bewegung* " – (*"Studim eksperimental mbi të parit e lëvizjeve"*), 1912; *"Untersuhungen zur Lehren von Gestalt"* – (*"Gjurmime mbi të mësuarit geshtalt"*), 1921; *"Productive Thinking"* – (*"Mendimi produktiv"*), 1959.

VES, - I.m. Prirje sjelljesh të nxitura nga motivi keqbërës i tjetrit. Është tipar i sjelljeve të dëmshme e të pamoralshme të disa individëve. Përbën tiparin e keq të karakterit të njeriut. Veset zhvillohen dhe formohen gjatë procesit të socializimit dhe edukimit të njeriut.

VESANI, - A. f.I ardhur nga latinishtja *ve* "mohim" dhe *sanus* "me mendje të shëndoshë". Vesania është gjendje shpirtërore e sëmurë e njeriut. Është psikozë karakteristike, e cila ka karakter funksional. Në kuptimin e gjerë kjo psikozë ka të bëjë me humbjen e mendjes, të arsyes.

VESTIBUL, - I. m. Në anatominë e veshit i ardhur nga latinishtja *vestibulum* "parakthinë". Vestiubuli është pjesë e veshit të brendshëm, pjesë e labirintit ashtëror, parakthinë e labirintit. Këtu gjenden dy qeska: utrikuli dhe sakuli. Ka formë vezake dhe është e lidhur me kanalet gjysmërrethore.

VESH, - I. m. Organi i dëgjimit të tingujve dhe i drejtpeshimit të trupit të njeriut dhe të disa lloj kafshësh. Përbëhet nga pjesa e veshit të jashtëm, të mesëm dhe të brendshëm. Pjesën e veshit të brendshëm e përbëjnë lapra (aurikula) dhe gypi auditor i jashtëm ose kanali i jashtëm i veshit, i emërtuar me termin latin *meatus acusticus externus*. Ndërmjet pjesës së jashtme të veshit dhe pjesës së mesme të veshit gjendet cipa apo membrana e njohur si timpani. Pjesa e veshit të mesëm përbëhet nga tri qeska të ndërlidhura: kudhra, çekani dhe yzengjia, kurse pjesën e veshit të brendshëm e përbëjnë labirinti i përbërë nga labirinti ashtëror që prek labirintin cipor. Në labirintin ashtëror gjendet vestibuli me cipën bazilare, kanalet gjysmërrethore dhe kërmilli (koklea). Labirinti cipor shtrihet përbrenda atij ashtëror

dhe është i mbushur me lëngun endolimfë. Kërmilli është pjesa qendrore e dëgjimit. Në bazën e tij gjendet organi i kortit, që është i vendosur në kanalin ashtëror në formë spiraleje. Në të gjenden trupthat receptorë të ndijimit të tingujve dhe strukturat e tjera receptore të lidhura me membranën bazilare. Strukturat receptore kanë formën e shkopthave të imët dhe formojnë disa harqe rreth këtij organi. Këto janë të lidhura me pjesët e mbaresave të nervit të dëgjimit. Tingujt me gjatësi dhe intensitet valësh adekuate depërtojnë deri në mbarimin e kanalit të pjesës së veshit të jashtëm, ku shkaktojnë dridhje të timpanit. Këto dridhje vënë në lëvizje endolimfën e labirintit cipor, ku janë të shtrira mbaresat e fijeve nervore të dëgjimit. Këto i bartin impulset nervore deri në qendrën trunore të dëgjimit, ku shkaktohet ndijimi i dëgjimit. Por, në pjesën e veshit të brendshëm gjenden edhe sakuli, utrikuli dhe kanalet gjysmërrethore me receptorët e posaçëm që reagojnë ndaj ndryshimeve të vendndodhjes së trupit dhe të organeve të tij, pikërisht të kokës në hapësirën e caktuar. Strukturën e tillë të veshit e dallojmë në figurën e mëposhtme:



Veshi i njeriut është në gjendje të kapë tinguj me cikël dridhjesh në sekondë, që shtrihen ndërmjet 20 – 18 – 20 000 Hz. Intensiteti i valëve zanore matet me decibel (1 bel = intensiteti i tingullit të dhënë: intensiteti i tingullit standard) dhe sipas kësaj shkalle dallohen këta tinguj të zakonshëm: pragu i dëgjimit të njeriut = 0,0002 din/cm^2. Murmuritja deri në 40 decibel, biseda normale e njerëzve prej 40 – 80 decibel, trafiku i ngarkuar dhe treni prej 80 – 100 decibel, shqetësimi prej 100 deri në 120 decibel, dhembja prej mbi 120 – 140 decibel dhe intensiteti i tingujve të aeroplanit reaktiv deri në rreth 160 decibel. Gjatë një bisede lartësia e zërit shtrihet rreth 120 Hz për meshkujt dhe rreth 250 Hz për zërin e femrave.

VESHI MUZIKAL. Aftësia e dallimit të saktë të toneve sipas lartësisë, gjatësisë dhe tërësive ritmike të tyre. Veshi muzikal është komponent përbërës i muzikalitetit që zhvillohet që nga mosha e hershme me ushtrime të këndimit të melodive sipas dëgjimit të thjeshtë të tyre, me dëgjim të burimeve të toneve të ndryshme, me dëgjim dhe me përsëritje të sakta të tërësive të toneve të një kompozimi të thjeshtë etj.

VESHTUESH/ËM, - ME (I, E). mb. Që vë veshin, që ka kujdes të veçantë. Përcakton aftësinë e zhvilluar të të vënit re dhe të angazhimit mendor për të kuptuar saktësisht përmbajtjen e shprehjes (të kërkesës, të porosisë, të urdhrit etj.) të asaj që dëgjon nga tjetri dhe sillet në përputhje me atë që dëgjon. Ky term rrjedh më tepër nga të folurit e përditshëm të Shqiptarëve të Shqipërisë Veriore dhe të Kosovës. Mund të ketë prejardhje nga sllavishtja *vesht* "i shkathët"**.**

VETADHURIM, - I. m. Ndjenjë e individit e drejtuar në personalitetin e tij. Këtë e karakterizon mbivlerësimi

i aftësive dhe i tipareve të tjera të tij. Shfaqet në kënaqësinë, dashurinë dhe respektin e tepruar ndaj vetes.

VETAKTUALIZIM, - I. m. Prirje e njeriut për afirmimin e pavarësisë së personalitetit të tij nga vetë ai dhe para të tjerëve. Kjo prirje është e shtyrë nga nevoja e lindur e njeriut për ta aktualizuar vazhdimisht personalitetin e tij në situata të ndryshme ku ai gjendet. Ky është një proces që shfaqet ose manifestohet në "orvatjet e vazhdueshme të individit për të realizuar gjithë potencialin e vet dhe për të zhvilluar të gjithë personalitetin e tij". U përmend për herë të parë nga Karl G. Jungu (Carl G. Jung, 1875 – 1961) në kuptimin e zhvillimit harmonik të të gjitha funksioneve psikike të njeriut. Më pas u theksua nga Karl R. Roxhers (Carl R. Rogers, 1902 – 1987), nga psikologu gjerman Kurt Goldshtajn (Kurt Goldstein, 1878 – 1965) dhe u bë koncept themelor duke u përpunuar hollësisht nga psikologu amerikan Abraham Maslou (Abraham Maslow, 1908 – 1970). Ky i fundit vetaktualizimin e cilësoi motiv më të lartë të personalitetit në hierarkinë e shkallës së motiveve të njeriut. Sipas Abraham Maslout " .... duket sikur kishte një vlerësim përfundimtar të vetëm për njerëzimin, një synim të largët drejt të cilit përpiqen të gjithë njerëzit. Ky është quajtur në mënyrë të ndryshme nga autorë të ndryshëm vetaktualizim, vetrealizim, integrim..., por të gjithë pajtohen se kjo ka vlerë në realizimin e potencialeve të individit, çka do të thotë në të bërët e individit tërësisht njerëzor". Për Karl R. Roxhersin mjedisi ekonomik, shoqëror, kulturor etj. është ai që ka ndikim të fuqishëm në vetaktualizimin e njeriut. Për Kurt Goldshtajnin vetaktualizimi është forma jetike e çdo njeriu, që shfaqet në fuqinë e madhe motivuese për përcaktimin e rrugës së zhvillimit të njeriut dhe në angazhimin maksimal e të qëndrueshëm të zhvillimit të kapaciteteve të tij.

VETAKUZIM, - I. m. Akuzim i arsyeshëm ose i paarsyeshëm i dëshirave, i qëndrimeve dhe i sjelljeve të individit nga ai vetë. Mund të jetë simptomë e melankolisë dhe e depresionit. Sipas psikanalizës vetakuzimi mund të shkaktohet nga ashpërsia e super egos ndaj egos së dobët.

VETANKIM, - I. m. Lloj ndjenje negative e individit për veten e tij, ankim në vete dhe në sjelljet e tij. Shkaktohet nga humbja e pësuar, e cila ia ka ndryshuar thellësisht aktivitetin dhe përgjithësisht jetën e tij. Përbëhet nga hidhërimi e pikëllimi ndaj të tjerëve dhe ndaj vetes dhe këto së bashku kur zhvillohen në formë spirale, pikëllimi arrin kulmin e përjetimit dhe të shfaqjes së tij.

VETASGJËSIM, - I. m. Zhdukje fizike dhe psikike e individit nga ana e tij. Shkaktohet nga mungesa e kuptimësisë për vetveten dhe për personalitetin e tij, gjegjësisht nga mospërjetimi i personalitetit të vet, rrjedhimisht nga mungesa e motiveve dhe orientimi i veprimeve për mbrojtjen dhe zhvillimin e personalitetit të tij.

VETËBESIM, - I. m. Ndjenja e sigurisë së individit ndaj aftësive, përjetimeve të veta dhe ndaj sjelljeve dhe veprimeve të tij, e shoqëruar me qëndrueshmëri afatgjatë të kësaj ndjenje. Në këtë rrafsh vetëbesimi merr përmasat e tiparit të personalitetit. Shkalla

e zhvillimit të këtij tipari varet nga përvoja e individit në zotërimin e vështirësive dhe të pengesave gjatë procesit të zhvillimit të vet. Sa më shumë të ketë sukses në zotërimin e tyre, aq më i nderuar do të jetë nga të tjerët dhe aq më të lartë e ka vetëbesimin.

VETËDASH/JE, - JA. f. Ndjenja pozitive e njeriut ndaj vetes e shfaqur me dashuri të posaçme ndaj saj. Kjo ndjenjë është rezultat i vetëvlerësimit se ai është qenie e mirë dhe e vlefshme. Vetëdashja përbëhet nga dashuria e vetvetes dhe të dashuruarit e qëndrueshëm në veten e tij. Dashuria ndaj vetes është zhvilluar nga përvetësimi i dashurisë prindërore dhe mbështetet në vlerat reale.

VETËDASHURIM, - I. m. Ndjenjë që ka të bëjë me vlerat ideale të trilluara për veten. Vetëdashurimi shfaqet me admirim ose adhurim të vetes dhe të sjelljeve të tij, ndaj të cilave ai nuk është kritik dhe mburret me personalitetin e tij jo objektiv. Këtij individi i mungon pak a shumë vetëdija për unin e vet objektiv. Vetëdashurimi duhet dalluar nga dashuria objektive e njeriut ndaj vetes. Individi është i vetëdijshëm për karakterin burimor a autentik të tij, sepse e njeh veten dhe është në gjendje t`i dojë edhe të tjerët. I vetëdashuruari trillues e dashuron veten dhe mburret vetëm me figurën ideale të personalitetit të vet. Për të të tjerët kanë vlerë vetëm nëse e përkrahin.

VETËDËNIM, - I. m. Një nga format e sjelljeve irracionale të njeriut ndaj vetes. Shfaqet me shkallë të ndryshme të intensitetit duke u shtrirë prej qortimit, përjetimit të ndjenjës së inferioritetit, vetakuzimit deri te vetëvrasja. Psikanaliza këtë e shpjegon si degë të shtytësit të destruktivitetit të njeriut ndaj vetes.

VETËDIJ/E, - A. f. Aftësia e përjetimit të përmbajtjes psikike momentale të individit nga vetë ai, në një çast të caktuar që lidhet me aktivitetin e posaçëm të trurit kur njeriu e përqendron vëmendjen në atë përmbajtje. Dija e individit për vetveten dhe për unitetin e personalitetit të tij, duke qenë në gjendje ta dallojë veten nga të tjerët dhe nga bota e jashtme. Në këtë kuadër vetëdija përfshin tërësinë e përjetimeve psikike (ndijimet, perceptimet, përfytyrimet, kujtimet, mendimin me format e përmbajtjet e veta, ndjenjat, motivet, nevojat, sjelljet etj.) kur jemi në gjendje t`i perceptojmë këto dhe t`i shprehim në mënyrë relativisht të qartë. Gjendja e vetëdijshme e njeriut shtrihet nga intensiteti i plotë i qartësisë së përmbajtjes së saj, në gjendje relativisht të turbullt të të qenit të vetëdijshëm (përgjumësia) dhe mund të shkojë deri në gjendje të pjesshme ose plotësisht të errët të njeriut për veten dhe për mjedisin e tij (gjumi, koma). Në zhvillimin e psikologjisë dallohen dy koncepte kryesore për vetëdijen: 1) Koncepti introspeksionist dhe 2) Koncepti psikanalitik. Sipas konceptit introspeksionist vetëdija është strukturë e mendjes së njeriut me përmbajtjen e saj, kur kjo është në gjendje t`i ekspozohet vetëvëzhgimit apo introspekcionit dhe kur këtë njeriu është në gjendje ta përshkruajë me fjalët e tij. Në formimin e kësaj vetëdije ushtrojnë ndikim disa faktorë, nga të cilët dallohen: të folurit, aftësia e të vërejturit të të tjerëve e sidomos ajo e vetëvëzhgimit të përvojës, të sjelljeve

që ushtrojnë ndikim te të tjerët, vlerësimi i pasqyrimit vetjak në mjedisin e vet etj. Sipas teorisë psikanalitike vetëdija e njeriut është ajo anë e mendjes së njeriut që përfshin gjithë ato përmbajtje, të cilat në çastin e dhënë ai është në gjendje t`i dallojë dhe t`i kontrollojë. Kjo anë e mendjes së tij duhet dalluar nga përmbajtjet dhe sjelljet e pavetëdijshme.

VETËDIJA FONOLOGJIKE. Formimi i pasqyrës së qartë nga ana e fëmijës për lidhjen e pashkëputur të shenjës pamore e grafike të shkronjës me zërin përkatës së saj. Formimi i pasqyrës së alfabetit të shqipes te fëmija, kur ai bëhet plotësisht i vetëdijshëm se secila shkronjë ka zërin e saj dhe se në kombinimin e tyre gjatë leximit të fjalëve e fjalive zëri i shkronjës e lidhja e zërave në fjalën e në fjalinë e lexuar ruan zërin karakteristik të saj. Vetëdija fonologjike luan rol të pazëvendësueshëm në zhvillimin dhe formimin e shkathtësisë së leximit, të rrjedhshëm, logjik e të bukur.

VETËDIJA GRUPORE. Strukturë e veçantë e vetëdijes së njeriut e përbashkët për anëtarët e një grupi shoqëror. Përmbajtja e saj ka të bëjë me shoqëroren, e cila jeton dhe vepron te anëtarët e grupit. Përjetohet në trajtën e ndjenjës së përbashkësisë, karakteristike për një familje, organizatë, shoqatë etj. Është term i konceptit të sociologut Emil Durkem. Për zhvillimin e vetëdijes grupore E. Durkem ka theksuar posaçërisht rolin e kulturës dhe zhvillimin e përbashkët të saj. Vetëdija grupore ka shtrirje dhe intensitet të ndryshëm në grupet shoqërore dhe në sistemet e tyre. Por, përmbajtja e saktë e saj ende është e pacaktuar dhe e paidentifikuar. Për këtë shkak sot termi vetëdija grupore në psikologji përdoret rrallë.

VETËDIJA KOLEKTIVE. Cilësi e vetëdijes që është e përbashkët për anëtarët e një bashkësie shoqërore. Vetëdijen kolektive e përbën sistemi i bindjeve, i botëkuptimit, i mendësisë, i parimeve morale, i qëndrimeve të përbashkëta etj. Sistemi i tillë është karakteristik për pjesëtarët e një bashkësie shoqërore dhe ky sistem në masë të madhe përcakton mënyrën e të menduarit dhe të sjelljeve të tyre. Vetëdija kolektive është term i teorisë sociologjike të Emil Durkemit (Emile Durkheim, 1858 – 1917).

VETËDIJA NË PSIKOLOGJINË ANALITIKE. Në psikologjinë analitike të Karl G. Jungut vetëdija zë një vend të rëndësishëm. Sipas mendimtarit zviceran Karl G. Jung (Carl G. Jung, 1875 – 1961) "Vetëdija është lidhja e përmbajtjeve psikike me unin, nëse uni këtë lidhje e ndien si të tillë". Lidhjet me unin, nëse njeriu nuk i ndjen si të tilla, janë të pavetëdijshme. . . Vetëdija është në rend të parë organ për orientim në botën e rrethanave të jashtme dhe të brendshme (të njeriut)" (shënim i autorit). Ky ka bërë dallimin ndërmjet vetëdijes dhe psikikës dhe këtë e konstatojmë në pohimin e tij "Vetëdija nuk është identike me psikiken".

VETËDIJA PËR VETEN. Përmbajtja diturore e njeriut për veten e tij, për unin e vet me të gjitha anët fizike, morale, psikike, shoqërore, madje, edhe dijet për sjelljet dhe motivet e sjelljeve të veta. Kjo përbën një entitet

karakteristik të posaçëm për njeriun dhe përfshin dijen për cilësitë fizike, sociale dhe morale të tij, duke u shtrirë edhe në sferën e sjelljeve aktuale të tij, në zhvillimin, organizimin dhe kontrollin e tyre nga ana e këtij entiteti. Vetëdija për unin është angazhimi, drejtimi dhe përqendrimi i vetëdijes në personalitetin e vetë njeriut. Vetëdija për veten zhvillohet që nga viti i parë pas lindjes dhe në fillim ka të bëjë me vetëdijen për trupin e fëmijës, kurse më vonë zhvillohet aftësia e tyre për njohjen e gjendjeve dhe të proceseve psikike të veta. Në tekstet psikologjike në gjuhë të tjera ekziston termi i veçantë "vetëvetëdije" (në anglisht *self–consciousness*, në gjermanisht *Selbstbewustensein*, në serbisht *samosvest*).

Burimet:

Wilhelm Wundt: *"Sprachgeschichte und Sprachpsychologie"* – (*"Historia e gjuhës dhe psikologjia e gjuhës"*), 1901.

Edward Titchener: *"Lectures on the Elementary Psychology of Feeling and Attention"* – ("*Leksione nga psikologjia elementare mbi ndjenjat dhe vëmendjen"*), 1908.

William James: *"The Varieties of Religious Experience a Study in Human Nature"* – (*"Varietetet e përvojës fetare dhe studimi i natyrës së njeriut"*), 1902.

Sigmund Freud: *"Interpretimi i ëndrrave",* Shtëpia Botuese "Fan Noli", Tiranë, 2010.

Sigmund Freud: *"Metapsikologjia",* Shtëpia Botuese "Fan Noli", Tiranë, 2003.

John Watson: *"Psychology as the Behaviorist sees it"* – (*"Psikologjia, si e sheh bihejvioristi"*), 1913.

John Watson: *"Psychology from the Standpoint of a Behaviorist"* – (*"Psikologjia nga pikëpamja e bihejvioristit"*), 1919.

Paul Guillaume: *"Manuel de Psychologie"* – (*"Psikologjia"*), (Përkthim në kroatisht), Zagreb, 1958 *(Kapitulli i dymbëdhjetë: "Vetëdija dhe kufijtë e saj",* fq. 300 – 306)

Alekso Qendro, Nuri Abdiu, Salaudin Çarçani, Sinan Tafai: *"Psikologjia", Për shkollat e larta (Maket),* Tiranë, 1971.

David G. Myers: *"Socialpsikologjia",* Tiranë, 2003, fq. 35 – 66; 158 – 189.

Spenser A. Rathus: *"Essentials of Psychology"* – (*"Bazat e psikologjisë"*), Harccourt Brace & Company, 1994, fq. 167 – 197.

Charles G. Morris, Albert A. Maisto: *"Psikologjia – Shkenca e proceseve mendore dhe e sjelljes njerëzore",* Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë, 2008, fq. 128 – 161.

VETËDYSHIM, - I. m. Ndjenjë e dyshimit në aftësitë dhe në bamirësinë e motiveve, të qëndrimeve dhe të sjelljeve të vetes**.**

VETËKËNAQËSI, - A. f. Ndjenjë pozitive ndaj vetes e përbërë nga kënaqësia, e shkaktuar nga veprimi që i ka sjellë individit një e mirë, që njëkohësisht ai vlerëson se me këtë ia ka arritur të plotësojë një shkallë të lartë të vlerës personale.

VETËKONTROLL, - I. m. Aftësia dhe gatishmëria e individit për të penguar disa dëshira, ndjenja, sjellje, si edhe veprimet impulsive, duke i vendosur këto nën kontrollin e vetëdijshëm të ti**j.**

VETËMASHTRIM, - I. m. Mashtrim i vetes i shkaktuar nga paaftësia e individit për të përcaktuar saktësisht atë që ka lidhje me të. Mund të jetë i pavetëdijshëm, kur është i shtyrë nga motivet dhe tiparet për ta parë veten në dritën e negativizmit dhe ka si karakteristikë mekanizmin mbrojtës. Në raste të posaçme, në ndonjë sëmundje psikike, individi nuk arrin të çlirohet nga presioni emocional, që shkakton pamundësinë e të parit real të vlerave të tij.

VETËMOHIM, - I. m. Flijim i qëllimshëm i dëshirave, i interesave, i motiveve etj. të një individi për qëllime e ideale më të larta, më fisnike, më të

vlefshme etj. Shpesh është formë e shfaqjes së ndjenjës së fajit që ai ndien ndaj vetes e sjelljeve të tij. Është karakteristik për mazohistët.

VETËMONITORIM, - I. m. Proces i vetërregullimit dhe përsosjes së sjelljeve nga ana e vetë njeriut, duke pasur mbikëqyrje të vazhdueshme mbi sjelljet e veta, me qëllim që të bjerë në sy të mirë dhe për këtë të favorizohet nga të tjerët. Termi i përket psikologjisë së personalitetit dhe u përdor nga psikologu Mark Snyder.

VETËNDERIM, - I. m. Komponent përbërës i vetëdijes së njeriut për veten e tij. Ka të bëjë me qëndrimin e individit ndaj vetes në bazë të vlerësimit të motiveve, qëndrimeve e sjelljeve të tij në lidhje me normat morale . Zhvillimi dhe ruajtja e këtij qëndrimi ka rëndësi për qëndrueshmërinë emocionale të njeriut.

VETOBJEKTIVIZIM, - I. m. Tipar i personalitetit të pjekur. Vetëobjektivizimi shfaqet në sjelljet objektive të njeriut ndaj vetes, duke u mbështetur në formimin e pasqyrës për veten e tij, duke njohur vlerat, qëndrimet e sjelljet pozitive dhe negative të tij. Madje, shpreh gatishmërinë ta thumbojë me humor veten e vet, pikërisht sjelljet e tij në një situatë të caktuar. Ky tipar u theksuar nga psikologu amerikan Gordon Olport (Gordon Allport, 1897 – 1967).

VETËPËRMBAJT/E, - A. f. Përcaktimi dhe organizimi i sjelljeve të individit sipas dëshirës, nismës, pikëpamjes etj. të tij në një situatë të caktuar, duke mënjanuar rrethanat dhe ndikimet nga jashtë dhe duke kontrolluar me kujdes sjelljet e veta.

VETËPOHIM, - I. m. Sjellje karakteristike e njeriut, e motivuar nga dëshira e theksimit të personalitetit për të qenë i nderuar dhe i respektuar nga ana e të tjerëve. Kjo kryhet me qëllim të arritjes së besimit të personalitetit në sytë e të tjerëve, si edhe në sytë e vetes. Luan rol të rëndësishëm në sjelljet e gjithëmbarshme të individit gjatë zhvillimit të tij.

VETËSENTIMENT, - I. m. Dispozita komplekse e njeriut e bazuar në ndjenjat e tij ndaj vetes. Në psikologji është i njohur edhe me termin ndjenja e unit. Ka strukturë të ndërlikuar qëndrimesh personale, qendra objektive e të cilëve është uni i njeriut, qëndrime këto që janë të shoqëruara me dëshirën e ruajtjes së përfytyrimit pozitiv për veten dhe paraqitjen e këtij përfytyrimi ndaj të tjerëve. Luan rol të rëndësishëm në integrimin e qëndrimeve, të interesimeve, të motiveve të vetvetes dhe zhvillimin e tij në mbështetje të ruajtjes së statusit të vet moral dhe shoqëror në mjedisin social. U përmend nga ana e psikologut Uiljam Mekdugal (William McDougall, 1871 – 1938). Për psikologun amerikan Robert Katelin kjo është "Ndjenjë ndaj vetes", një prej ndjenjave më të rëndësishme.

VETËVEPRIM, - I. m. Sjellje a veprim i individit i shkaktuar nga dëshirat, motivet, nevojat etj. të tij dhe i përshpejtuar nga nxitësit e jashtëm. Është i drejtuar në dukurinë, objektin, procesin etj. të jashtëm, por edhe në ndryshimin e mënyrës së veprimit të tij të deriatëhershëm.

VETËVËZHGIM, - I. m. Proces i vëzhgimit të përvojave psikike a mendore të njeriut, përkatësisht vëzhgimi i

vetes, i brendisë psikike të tij nga ana e vetë njeriut, vëzhgimi i përmbajtjes së vetëdijes së njeriut nga ana e tij. Njeriu mund t`i vëzhgojë proceset psikike, përmbajtjen dhe rrjedhën e tyre, përjetimet e ndryshme të tij, tiparet e personalitetit të vet, motivet e sjelljeve, përvojën e fituar etj. Për këto mund të raportojë para studiuesve, dhe pikërisht këto mund t`i përshkruajë dhe t`i shpjegojë. Kur vetëvëzhgimi bëhet me qëllim studimor, sipas formës, rendit dhe sistemit të organizimit, vetëvëzhgimi merr karakterin e metodës hulumtuese**.**

VETËVËZHGIMI FENOMENOLOGJIK. Formë e metodës së vetëvëzhgimit ose e introspeksionit, që zbatohet në identifikimin e rrjedhës së një vetëvëzhgimi të një përvoje të caktuar dhe në regjistrimin e saktë të të dhënave të paraqitura që zhvillohen mbi themelin e përvojës së një individi. Vetëvëzhgimi fenomenologjik duhet dalluar nga vetëvëzhgimi i psikologëve të strukturalizmit në psikologjinë e tipit të Eduard Tiçenerit (Edward Titchener, 1867 – 1917).

VETËVLERËSIM, - I. m. Vlerësimi i individit për tiparin e personalitetit të tij. Zakonisht kryhet në bazë të rezultatit të sjelljes a veprimtarisë së vet, duke zbatuar shkallën e vetëvlerësimit. Është një prej masave të përcaktimit të shkallës së pjekurisë së personalitetit. Shmangia nga vetëvlerësimi objektiv tregon drejtimin e sjelljeve të njeriut. Vetëvlerësimi ka rëndësi të madhe për të kuptuar çfarë mendon njeriu për veten e vet.

VETËVRASJ/E, - A. f. Veprim i qëllimshëm i njeriut me të cilin ai ia merr jetën vetes nga motivet e ndryshme; zhduk përgjithmonë vetveten. Shfaqet te ata që nuk kanë kuptim të formuar për tërësinë e personalitetit të tyre dhe për rolin rregullator të personalitetit në veprimtarinë e gjithëmbarshme të tyre. Haset me shpeshtësi të ndryshme në gjininë mashkullore dhe femërore; te meshkujt është më e shpeshtë dhe, kryesisht, te këta shfaqet dy herë më shumë se në botën femërore. Zakonisht, shfaqet në periudhat kritike të jetës dhe të zhvillimit të tyre, përkatësisht te meshkujt shfaqet më tepër në fazën e pubertetit, kurse te femrat në fazën e klimakteriumit. Në vendet me nivel të lartë ekonomik dhe në mjediset urbane shfaqet më e shpeshtë se në vendet rurale me nivel të ulët ekonomik e social. Ka dallime të mëdha ndërmjet mjediseve të ndryshme në raportin ndërmjet numrit prej 1 000 000 banorësh dhe numrit të atyre që bëjnë vetëvrasje. Por, nuk ka krahinë ku nuk është e pranishme dukuria e vetëvrasjes me ndryshime sasiore të ndryshme ndërmjet tyre. Ka trajtime të ndryshme: në disa vende konsiderohet vepër patologjike dhe kriminale, në disa të tjera trajtohet vepër me vlerë pozitive. Studiohet nga psikologët, sociologët, psikiatrit etj. Me gjithë paraqitjen e hershme të kësaj dukurie, studimet e para të vetëvrasjes janë të lidhura me periudhën e gjysmës së dytë të shekullit XIX, me emrin e sociologut francez Emil Durkeim (Emile Durkheim, 1858 – 1917).

VETËZHVILLIM, - I. m. Zhvillimi burimor i nxitur nga fuqitë e brendshme të organizmit të njeriut, nga mekanizmat autorregullues të vetë organizmit, duke mos u mbështetur

në faktorët e mjedisit të jashtëm të tij. Zhvillimi i këtillë përfshin bërthamën e brendshme të zhvillimit, diferencimin e strukturave psikike dhe të funksioneve të tyre, rrjedhimisht zhvillimin diferencial dhe integral të proceseve psikike dhe të sjelljeve gjithnjë e më të ndërlikuara të njeriut.

VETIA PSIKIKE. Cilësi thelbësore, e qëndrueshme dhe e veçantë e proceseve dhe e sjelljeve të njeriut, që karakterizon personalitetin e tij. Veti psikike janë: aftësitë, interesat, karakteri, nevojat, qëndrimet, temperamenti, shprehitë. Shih – ***TIPARET E PERSONALITETIT.***

VETIDEALIZIM, - I. m. Mekanizëm psikik me anën e të cilit krijohet figura dhe besimi në egon ideale dhe kjo ruhet për një kohë të gjatë. Ka të bëjë me zmadhimin e përmasave të tipareve pozitive dhe minimalizimin e tipareve negative, duke zhvilluar njëkohësisht besimin dhe bindjen në tiparet pozitive. Shfaqet kryesisht te nevrikët, të cilët përpiqen ta zgjidhin konfliktin neurotik të tyre, duke zmadhuar tiparet pozitive e zvogëluar ato negative. Ky term ka ardhur nga Karen Hornai (Karen Horney, 1834 – 1952).

VETMI, - A. f. Gjendje psikike e atij që jeton dhe vepron i ndarë, i izoluar nga të tjerët. Gjendja e këtillë është më tepër e lidhur ndjesinë e njeriut, i cili vlerëson se nuk gjendet në shoqëri me ata me të cilët ai dëshiron të ishte, përkatësisht këtij i është pamundësuar realizimi i dëshirës për të qenë me të tjerët, të cilët janë të rëndësishëm dhe të vlefshëm për të. Zakonisht bëhet fjalë për vetmi situacionale dhe për vetmi strukturore. Vetmia situacionale përjetohet nga ana e atyre që në situatën e caktuar nuk i ka shokët dhe miqtë e dëshiruar; vetia strukturore është ndjenjë e qëndrueshme e njeriut, kur ai vlerëson se ai nuk ka persona të afërt me të cilët do të ishte i lidhur shoqërisht.

VETMIA EMOCIONALE. Ndjenja e pakënaqësisë së një individi të vetmuar, e shkaktuar nga ndarja e tij prej të tjerëve (vetmia në qelinë e burgut, në ujdhesë të panjohur dhe pa pjesëtarë, në gjurmime nëndetare etj.). Shkaktohet nga mosplotësimi i nevojës së përgjithshme njerëzore për të jetuar në afërsi me të tjerët, në raporte të shumëllojshme me të afërmit, në pamundësinë e zhvillimit të një raporti intim me një të afërm, një shok etj.

VIGOTSKI Lev (VIGOTSKIJ Lev). Psikolog rus. Lindi në Bjellorusinë e sotme më 1896 dhe vdiq në Moskë më 1934. Studioi filozofi, gjuhë e art në fakultetet e Universitetit të Moskës. Pas përfundimit të studimeve u punësua si gjurmues në Institutin e Psikologjisë Eksperimentale në Moskë; themeloi Institutin për Defektologji në Moskë. Profesor i psikologjisë në Institutin Psikologjik të Moskës. U mor me gjurmimin e shumë çështjeve dhe rezultatet e studimeve u botuan pas vdekjes së tij më 1956 në gjashtë vëllime të gjera, madje arritën të përkthehen edhe në disa gjuhë të popujve të Europës Perëndimore. Studimit të zhvillimit të çështjeve psikologjike i është qasur në bazë të metodës historike–kulturore të mjedisit zhvillimor të njeriut. Studimet e tij kanë zënë vend në psikologjinë zhvillimore dhe në psikologjinë pedagogjike. Në studimet e tij dallohet

interesimi për studimin e të menduarit dhe të të folurit, sidomos studimi i raportit ndërmjet mendimit – të të folurit. Veprat kryesore të tij janë: *"Pedagogiceskaja Psihologija"* – (*"Psikologjia Pedagogjike"*), 1926; *"Umstvennoe razvitie detej v processe obucenija"* – (*"Zhvillimi mendor i fëmijës dhe procesi i edukimit"*), 1935; *"Voprosi Teoriji i istoriji psihologiii"* – (*"Çështjet teorike dhe historia e psikologjisë"*), 1982 etj.

VLEFSHMËRI, - A. m. I ardhur nga latinishtja *valid* "i vyer, i vlefshëm". Haset gjithnjë e më shumë në tekstet e përkthyera në shqip. Vlefshmëria në psikologji emërton vlefshmërinë e një instrumenti matës të psikologjisë; Sa ai instrument mat atë për të cilën është krijuar.

VLEFSHMËRIA HIPOTETIKE. Procesi i vlerësimit vlefshmërisë së një testi. Vlefshmëria hipotetike duhet të vërtetojë shkallën e detyrave, të problemave etj. përbërës të një testi dhe të japë përgjigje për pyetjen: Në çfarë mase ato detyra e problema masin konstruktin psikologjik që synojmë ta arrijmë me atë test? Testi i vlefshmërisë hipotetike shërben si mjet argumentimi për konceptet dhe termat e një entiteti, të një ndryshoreje psikologjike që supozohet se është shkak i një lloj sjelljeje. Nëse bëhet fjalë për një test të inteligjencës duhet nisur nga supozimi se, cilat janë konstruktet përbërëse të atij testi dhe këto konstrukte a janë gjetur dhe përfshirë në masë të duhur nga ana e detyrave dhe problemeve të atij testi?

VLERA ESTETIKE. Tipare të harmonizuara në tërësinë simetrike të një objekti, të një njeriu, të një akti krijues, që shkakton shije dhe ndjenja estetike të posaçme me objektivitetin harmonik të tij. Kur perceptohet një grua e bukur, bukuria e saj imponohet para cilësive të zakonshme të çdo gruaje, para gjatësisë trupore dhe cilësive të tjera të çdo gruaje.

VLERA MAKSIMALE. Vlera e nivelit më të lartë të përgjigjes së dhënë në shkallën e vlerësimit të një qëndrimi, interesimi etj., në kuadrin e shkallës vlerësuese të gjurmimit të tyre.

VLERA MBIZOTËRUESE. Vlerë që përsëritet ose ka frekuencë më të lartë se vlerat e tjera numerike. Kjo vlerë në psikometri emërtohet me termin mod dhe është njëra ndër tri llojet e vlerës mesatare.

VLERA PROGNOSTIKE. Instrument matës i psikologjisë. Vlera prognostike e një testi, pyetësori, shkallës matëse të interesimeve etj. emërton parashikimin e zhvillimit të një funksioni, procesi, sjelljeje në mbështetje të analizës së rezultateve të arritura nga ana e atij individi në testin e caktuar. Vlera prognostike llogaritet në mbështetje të zbatimit të metodës statistikore të ndërlidhjes ose korrelacionit ndërmjet rezultateve të arritura në testin e caktuar dhe në veprimtarinë e caktuar me të cilën ka të bëjë prognoza. Sa më e lartë të jetë shkalla ose koeficienti i ndërlidhjes ose i korrelacionit ndërmjet këtyre rezultateve, aq më e madhe është vlera prognostike e atij parashikimi, përkatësisht e instrumentit matës të vlerës prognostike të tij.

VLERA STATISTIKORE. Vlerë që përcakton rëndësinë statistikore të dallimit sasior ndërmjet dy të mesmeve aitmetike, kur këto janë përcaktuese të grupeve të vogla të të dhënave

statistikore. Formula për gjetjen e këtij dallimi sasior është:

$$t = \frac{M_1 - M_2}{\sqrt{\left(\frac{\sum x_1^2 + x_2^2}{N_1 + N_2 - 2}\right)\left(\frac{N_1 + N_2}{N_1 N_2}\right)}}$$

Në këtë formulë M1 dhe M2 paraqesin të mesmen aritmetike të dy gjedheve, përkatësisht të dy kampioneve, x1 dhe x2 paraqesin shmangien e secilit rezultat individual nga e mesmja aritmetike e vlerave sasiore të ndryshores që provohet. N1 dhe N2 rezultatin e përgjithshëm të secilës ndryshore. Kjo është formula e statistikanit anglez Uiliam S. Goset (William S. Gosset, 1867 – 1947), i njohur më tepër me pseudonimin Student. Shfrytëzohet më tepër për të përcaktuar "raportin kritik" të dallimit ndërmjet dy të mesmeve aritmetike dhe të rëndësisë statistikore të këtij dallimi. Kur kemi të bëjmë me gjedhe apo kampion të madh nëse vlera t është (dallimi dy herë më i madh se gabimi i saj në llogaritje, saktësisht nëse vlera t është 1,96, konsiderohet se kjo vlerë ka rëndësi statistikore të rëndësishme, sepse rreziku që nuk është i saktë është 5 %. Kur kemi të bëjmë me dallimet statistikore ndërmjet dy gjedheve a kampioneve të vogla vlera t është dallimi ndërmjet vlerës së mesme dhe gabimit statistikor të tyre.

VLERA Z. Njësia e bazhdarimit të testeve e llogaritur në bazë të shmangies kuadratike ose shmangies standarde nga vlera e mesme e arritjeve individuale në një test të caktuar.

VLERAT KULTURORE. Vlerat kulturore të një mjedisi, mendimet e sjelljet dhe sistemi i tyre i pranuar dhe i përkrahur si sistem i dëshiruar, i mirë, pozitiv etj., sepse ka synime njerëzore. Vlerat e tilla përbëjnë sistemin edukativ dhe arsimor të një vendi dhe fëmijët këto vlera i mësojnë dhe i përvetësojnë falë angazhimit të individit, të edukatës familjare, shkollore etj. Vlerat e tilla përbëjnë sistemin karakteristik të vlerave të një vendi. Për Shqiptarët vlera të tilla janë besa, nderi, mikpritja etj., por, ka edhe vlera kulturore universale, si: altruizmi, e drejta, liria njerëzore etj.

VLERËSIM, – I. m. I ardhur nga latinishtja dhe ka gjetur zbatim edhe në psikologji. Vlerësimi është procesi i matjes dhe i vlerësimit të suksesit të një instrumenti, të një programi, vlerësimi i arritjeve arsimore, edukative, testore etj. Ky proces kryhet duke marrë për bazë qëllimin e një programi të caktuar.

VOKACION, **- I**. m. I ardhur nga latinishtja *vocatio* "thirrje", në mënyrë figurative "prirje". Në psikologji vokacioni emërton përkushtimin jetësor e natyror për një profesion, lloj krijimtarie, artistike, degë sportive, etj. Vokacioni ka fuqi nxitëse dhe drejtuese në qëllim të caktuar. Arsimtari me vokacion e kryen detyrën arsimore dhe edukative me cilësi të lartë, pavarësisht nga kushtet fizike të rënda për punë.

VRETO Jani. Mendimtar shqiptar i Rilindjes Kombëtare. Lindi në Postenan të Leskovikut më 1822 dhe vdiq në Greqi më 1900. Ushtroi ndikim në zhvillimin e mendimit psikologjik shqiptar. Veproi në shoqata kulturore e diturore të shqiptarëve në Stamboll, në Bukuresht dhe në Egjipt. U mor më tepër me mendime filozofike, përkatësisht etike dhe, në kuadrin tyre shtjelloi edhe përmbajtjen e karakterit psikologjik. Ishte mbështetës i psikologjisë

introspektive – aktuale për kohën e veprimtarisë mendore të tij. Në përmbajtjen e veprave të tij, sidomos me ato që përkojnë me psikologjinë, dallohet ndikimi i psikologjisë së fakulteteve ose i fuqive shpirtërore në trajtimin e jetës psikike të njeriut dhe të frymës së tij. Në këtë kuadër ai ka trajtuar tri fuqi shpirtërore: Mendjen, kujtimin dhe dashurinë. Mbi këtë bazë ka zhvilluar përsiatjet për rolin e proceseve njohëse në njohjen e realitetit dhe të dukurive të tij, duke zbërthyer në mënyrën e tij procesin e perceptimit, të kujtesës dhe të të menduarit, si edhe, pjesërisht, edhe raportet ndërmjet tyre. Lidhur me këtë ai ka trajtuar edhe format e shfaqjes së psikikës së njeriut. Sipas tij psikika e njeriut shfaqet "Mbi të kupëtuarit, o të kuptimit. Mbi Të kujtuarit, o të kujtuomit. Mbi të faniturit, o të fanitunit. Mbi të menduarit, o të menduomit...". Ndoqi rrugën e përdorimit të fjalëve shqipe në vend të fjalëve të huaja. Kështu, termin psikologji e zëvendësoi me fjalën "shpirt – shikonjë" a "shpirtqyrë". Pavarësisht nga shkalla e të kuptuarit të shprehjeve filozofike, pra të shprehjeve etike të ndërlikuara, ai ka trajtuar edhe jetën psikike dhe fuqitë shpirtërore e shfaqjen e tyre, nga ana e njeriut, shtjellimin e dijeve mbi psikikën në zhvillimin e mendimit psikologjik te shqipfolësit. Veprat kryesore të tij janë: *"Apologji"*, 1878; *"Për të vërtetën edhe për shkronjën e së vërtetës*", 1885; *"Mirëvetija*", 1886 etj.

V

VUNT Vilhelm (Wilhelm WUNDT). Psikolog gjerman. Lindi në Neckarau (Mannheim) më 16.08.1832 dhe vdiq në Grosbothen (Großbothen, Leipzig) më 31.08.1920. Kreu studimet për mjekësi në Fakultetin e Heidelbergut, ku dhe mbrojti doktoratën më 1856. U zgjodh po në këtë fakultet docent dhe profesor. U mor me studime nga fusha e fiziologjisë së shqisave dhe proceseve nervore. Më 1879 themeloi në Lajpcig Institutin e parë gjerman për psikologji eksperimentale, i njohur edhe si Laboratori psikologjik i Lajpcigut. Më pas u emërua profesor i filozofisë në Universitetin e Zyrihut, ku dhe punoi sistematikisht deri në fund të karrierës universitare. Iu përkushtua studimeve psikologjike eksperimentale dhe në Institutin (laboratorin) psikologjik të drejtuar prej tij u zbatuan metoda e procedura hulumtuese objektive, u përdorën mjete matëse ekzakte etj. Prej këtej morën mësime edhe disa psikologë të njohur, si: Eduard Tiçener, Stenli Hol, Emil Krepelin, Hygo Mynsterberg, Osvald Kylpe, Karl Marbe etj. Veprat kryesore të tij janë: *"Grundzüge der physiologischen Psychologie"* – (*"Bazat e Psikologjisë Fiziologjike"*), 1874; *"System der Philosophie"* – (*"Sistemi i filozofisë*"), 1889; *"Grundriss der Psychologie"* – (*"Themelet e psikologjisë"*), 1896; "*Sprachgeschichte und Sprachpsychologie"* – (*"Historia e gjuhës dhe psikologjia e gjuhës"*), 1901; *"Völkerpsychologie"* – (*"Psikologjia e popujve"*), 1900–1920 etj.

VULGARIZ/ËM, - MI. m. I ardhur nga latinishtja *vulgaris* "i vrazhdë". Përdorim i fjalëve dhe shprehjeve të vrazhda gjatë procesit të komunikimit me të tjerët. Shprehje gjuhësore që vështirësojnë dhe pengojnë zhvillimin e të folurit dhe të të menduarit të rrjedhshëm, elokuent. Hasen edhe në vepra letrare, por janë të papëlqyeshme.

X

X ose **x** Shenjë statistikore që emërton rezultatin e caktuar të matjes individuale të një ndryshoreje.

X Shenjë statistikore e së mesmes aritmetike njësoj si edhe M.

XIXËLLUES, - E. mb. Që përcakton ndijimin pamor karakteristik, të shkaktuar nga burimi i vogël ndriçues, i cili ndizet e shuhet brenda intervaleve të shkurtra kohore, saqë mezi dallohet një pikël e veçantë xixëlluese nga pika tjetër.

XIXËMIM, - I. m. Lloj ndijimi i dhembjes që karakterizohet nga intensiteti i lartë i dhembjes së lokalizuar në një pjesë të caktuar të lëkurës së trupit. Këtë e shkakton ngacmimi therës i një trupi me majë të mprehtë, që ushtron ndikim prerës në një pjesë të caktuar të trupit, duke dëmtuar fijezat nervore të kësaj pjese të trupit.

XH

XHEJMS UILIAM (William JAMES). Psikolog dhe filozof amerikan, themelues i pragmatizmit. Lindi në Nju Jork më 11.01.1842 dhe vdiq në Nju Hampshire më 26.08.1910. Së bashku me Vilhelm Vuntin konsiderohen themelues të psikologjisë. Uiliam Xhejms pati ndikim të theksuar në zhvillimin e psikologjisë, sidomos ndikoi indirekt në zhvillimin e bihejviorizmit. Ia doli mbanë të harmonizonte së bashku teoritë e shkollës psikologjike gjermane, angleze dhe franceze. Kreu studimet për mjekësi. Karrierën shkencore e filloi dhe e përfundoi në Universitetin e Harvardit. Më 1867 qe profesor inordinar i fiziologjisë, kurse më 1898 profesor i psikologjisë. Qe përgjithësisht nën ndikimin e kulturës europiane, e sidomos nën ndikimin e zhvillimit të mendimit psikologjik europian. Themelues i laboratorit të parë psikologjik në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pranë tij kanë studiuar disa psikologë, si: Eduard Torndajk, Xhon Devei etj. Sipas Xhejms "Psikologjia është shkenca për jetën shpirtërore, pra shkenca mbi mendjen e trupin e caktuar, që ekzistojnë në kohë dhe në hapësirë, mendje kjo që ka mendime dhe ndjenja për botën lëndore ku jetojmë. Në anën tjetër, shpjegimi i mendimeve si krijime, si fuqi të thella, si shpirti ose egoja, kanë qenë kryesisht fusha të metafizikës ose të filozofisë". Uiliam Xhejmsi nuk u mor me studimin e elementeve të vetëdijes, por më shumë me studimin e personalitetit duke e ndarë këtë në unë material, social, frymor dhe unë të identitetit. Disa koncepte dhe terma të tyre psikologjike kanë shënuar edhe pikëpamjen e tij. Ndër to dallohen: "rrymimi i vetëdijes" – që trajton procesin e pandërprerë të funksionimit të vetëdijes, e jo gjendjen statike të vetëdijshme, që për të nuk ekziston. Ky proces vërtetë është i errët, jokoherent dhe gati i pakapshëm. U mor edhe me studimin e vullnetit të njeriut. Konceptoi zhvillimin fiziologjik të emocioneve, që në psikologji është formuluar si teoria fiziologjike e Xhejms-Langut, megjithëse Uiliam Xhejmsi e ka konceptuar teorinë e tij ndaras nga studiuesi danez Karl Lange. Sipas kësaj teorie "njeriu është i gëzueshëm, sepse qesh, por jo qesh sepse është i gëzueshëm".

Gjurmimi empirik i proceseve psikike bëhet i mundur, duke zbatuar edhe matjen e intensitetit, të shtrirjes, të ndryshimeve të tyre, si edhe matjen e sjelljeve, të kushteve dhe të raporteve ndërmjet tyre. Një ndër klasikët e rrallë në histori të psikologjisë. Rrënues i strukturalizmit, ndikoj në zhvillimin e funksionalizmit, të bihejvijorizmit, të psikologjisë humaniste etj. Ka lënë pas disa vepra të rëndësishme psikologjike, ndër të cilat më kryesoret janë: *"The Principles of Psychology" – ("Parimet e psikologjisë")* New York, 1890; *"Textbook of Psychology" – ("Tekst mësimor i psikologjisë"),* 1892; *"The Varieties of Religious Experience a Study in Human Nature" – ("Varietetet e përvojës fetare në studimin e natyrës së njeriut"),* 1902 etj.

XHELOZI, - A. f. Lloj i ndërlikuar i ndjenjave që ka të bëjë me ndrojtjen, frikën, hidhërimin dhe pakënaqësinë, kur njeriu përjeton dyshime në besnikërinë e personit të dashur dhe rrezikun se ndjenja e tij do të pakësohet, aq sa ta humbë këtë person të cilin e dashuron, pasi ky i fundit mund të dashurojë një të tretë. Xhelozia fillon të shfaqet atëherë kur një person i tretë trondit marrëdhëniet intime ndërmjet dy individëve me shfaqje të sjelljeve që kanë elemente të simpatisë dhe të dashurisë ndaj njërit prej tyre. Dashuria me cilësinë e saj të dëshirës për vazhdimësi kohore dhe ndrojtja e frika nga humbja e subjektit të dashurisë përbëjnë themelin e xhelozisë; pa dashuri të zhvilluar ndaj tjetrit nuk mund të ketë xhelozi. Xhelozia zakonisht është e shoqëruar me inat dhe me zili ndaj individit të tretë. Xhelozia shfaqet në këto situata: kur nuk e kemi atë që na pëlqen dhe këtë tjetri e ka, kur dimë se të tjerët marrin më shumë dashuri e vëmendje, kur tjetri arrin rezultate të larta e ne këto nuk i arrijmë etj.

XHELOZIA NDËRFËMIJËRORE. Formë e veçantë e dashurisë që shfaqet ndërmjet vëllezërve e motrave dhe ndaj fëmijës së porsalindur. Vërehet në përpjekjet e fëmijës për të fituar dashurinë e nënës e të babait. Lind nga pozita rivale e fëmijës ndaj fëmijës tjetër. Kjo shfaqet në formë të fshehtë dhe të hapur. Fillon rreth moshës 18-mujore dhe shpeshtohet ndërmjet moshës 3 – 4 vjeç. Pas kësaj moshe zvogëlohet krahas rritjes së fëmijës. Xhelozia me intensitet të lartë dhe me vazhdimësi kohore është shenjë e mospjekurisë emocionale të fëmijës**.**

XHELOZIA NDËRMJET ÇIFTEVE TË MARTUAR. Ndjenjë me pasoja të rënda për jetën bashkëshortore që shfaqet me dobësimin e dashurisë ndërmjet burrit e gruas së martuar dhe zhvillimin e dashurisë së gruas ose të burrit ndaj një të treti. Po merr përmasat e një dukurie në shumë vende të zhvilluara. Në këto vende gruaja e martuar shfaq xhelozi ndaj bashkëshortit dhe këtë e shpreh me sjellje të fshehta raportesh seksuale me të tjerë, duke shpallur se për këtë nuk ndjen kurrfarë përgjegjësie dhe, madje, as që e bren ndërgjegjja që shkon dhe jeton herë pas here tek një shok i ri. Reagimet e bashkëshortit ndaj dyshimeve për sjellje të tilla simptomatike kanë treguar ndryshime të mëdha individuale, që sillen prej njërit skaj (indiferentizmi ndaj dyshimit) deri në skajin e reagimit agresiv ndaj rasteve të sjelljeve të dyshimta të bashkëshortes, madje edhe në sjellje kriminale ndaj bashkëshortes.

Në mjediset shqiptare nuk kemi raporte të sakta mbi këtë dukuri.

XHELOZIA PATOLOGJIKE. Shpërthim sjelljesh të pakontrolluara dhe të ashpra ndaj njeriut më të dashur, por njëkohësisht shfaqje sjelljesh të dyshimta, ku ky individ humbet cilësitë e tij si subjekt kryesor i dashurisë dhe shndërrohet në pronë të tjetrit. Kufiri ndërmjet sjelljeve normale të xhelozisë dhe sjelljeve patologjike përcaktohet me vështirësi. Megjithëkëtë, vëzhgimet e kryera tregojnë se "helmi i dyshimit kontrollohet vazhdimisht, ndiqet këmba këmbës me pyetje, ankthe që të bëjnë të mos flesh gjumë natën".

Burimet:

Willy Pasini: *"Xhelozia", Skanderbeg books,* Tiranë, 2006.

Begoña Ibarrola: *"Tregime për ndjenjat",* DASARA*,* Tiranë, 2009, fq.127 – 145.

Herman Hobmair/herausgegeben: *"Psychologie"*– (*"Psikologjia"*)*,* Stam Verlag, 1997, fq. 153 – 180.

XHUVANI Aleksandër. Gjuhëtar, pedagog dhe psikolog shqiptar. Lindi në Elbasan më 1880 dhe vdiq në Tiranë më 1961. Ashtu si në mjediset e tjera psikologjia ndër shqipfolësit e nisi zhvillimin e saj nga filozofët (Hasan Tahsini), mjekët (Gabriel Bukola), gjuhëtarët e pedagogët (Aleksandër Xhuvani). Në ndryshim prej të tjerëve këta psikologë zhvilluan mendimet e tyre psikologjike në vendet ku këta kishin mërguar (me përjashtim të Aleksandër Xhuvanit që konsideronte se veprimtaria edukative duhet të mbështetet në njohjen psikofizike të nxënësve dhe të tipareve të personalitetit të tyre. Ka dhënë lëndën e psikologjisë në Normalen e Elbasanit. Për nevoja të nxënësve të kësaj shkolle shkroi veprën "Psikologjia" botuar më 1933, që shërbeu si libër shkollor për disa vjet në të gjitha viset shqipfolëse. Është autor i disa punimeve nga fusha e psikologjisë që u botuan në revista, kryesisht në Tiranë. Ndër këto dallohet punimi "Personalitetit" botuar më 1938, "Fantazia", 1925 – 1926. Është ndër të rrallët që u mor me çështjen e terminologjisë psikologjike, duke kontribuar drejtpërdrejt në zhvillimin e saj edhe në formulimet e drejta gjuhësore të dukurive, proceseve dhe vetive psikike. Vepra kryesore e tij është: *"Fillime të pedagogjis. Pjes` e parë. Psikologji e shtime në punë t` edukatës" për shkollat normale e për mësuesit e filloreve"*, Shtëpia botuese "Luarasi", Tiranë, 1933.

Y

YLBERTH, - I. m. Pjesa përbërëse e shtresës së mesme të kokërdhokut të syrit e njohur në psikologjinë fiziologjike me termin *latiniris* ose *irida,* që rrethon beben ose pupilën e syrit. Ylberthi ka ngjyra të ndryshme dhe ndikon në zhvillimin e funksionit të bebes apo pupilës së syrit, përkatësisht në ndryshimin e hapësirës së vogël të hapjes së saj ose të ngushtimit të kësaj hapësire, në varësi nga intensiteti i burimit të dritës: kur rrezet e dritës kanë intensitet të ulët bebja e syrit zgjerohet dhe kur rrezet e dritës kanë intensitet të lartë bebja e syrit ngushtohet. Shih ***– SYRI.***

YSHTJ/E, - A. f. Formë e ndikimit me fjalë e lutje që kanë fuqi magjike në përmirësimin e gjendjes fizike e psikike te një individ i sëmurë. Yshtja predikohet edhe në raste të tjera si: për të shpëtuar dikë që gjendet para një situate të rrezikshme, por të cilët kanë besim në peshën e fjalëve që i shqipton ai që bën yshtjen. Në yshtje dhe në fuqinë e yshtjeve e mbështesin aktivitetin e tyre të gjithë ata që besojnë në mrekullinë që do të bëjnë fjalët, për të ndryshuar në të mirë gjendjen e individit të sëmurë.

YZENGJI, - A. f. Pjesë e veshit të mesëm, asht ose kockë me formë harku të vogël, që më tepër i përngjet një yzengjie të lidhur me dy kockat e tjera të kësaj pjese të veshit të mesëm, përkatësisht me kudhrën dhe me çekanin. Gjendet ndërmjet çekanit dhe dritares hyrëse të veshit të brendshëm. Dridhjet e cipës apo membranës që ndan pjesën e veshit të mesëm nga pjesa e veshit të jashtëm vënë në veprim dridhës çekanin, kudhrën dhe yzengjinë, prej nga dridhjet barten në pjesën e veshit të brendshëm, përkatësisht në organin e kortit, ku këto dridhje shndërrohen në impulse nervore dhe vënë në veprim qelizat receptore, kurse këto të fundit, me anë të nervit dëgjimor, barten në qendrën e dëgjimit të cipës së trurit të madh. Shih – ***VESHI.***

Z

ZAKON, - I. m. Formë gati e automatizuar dhe e qëndrueshme e sjelljeve të një individi, e zhvilluar dhe e formuar në mbështetje të përsëritjeve të shpeshta të asaj sjelljeje. Formë zakoni merr sjellja e njeriut, kur sjellja e këtillë përsëritet shpesh në të njëjtën trajtë në kohën e caktuar dhe në një situatë të posaçme. I tillë është zakoni i pastrimit të dhëmbëve në mëngjes dhe në mbrëmje, vënia e secilit gjësend në vendin e vet, përdorimi i fjalëve të qarta dhe të matura gjatë komunikimit me të tjerët etj. Kontrolli i vetëdijes në zbatimin e këtyre zakoneve është i pranishëm, por në formë të kufizuar.

ZAKONET SHOQËRORE. Sjellje të njëtrajtshme të popullit të një mjedisi që janë zhvilluar dhe formuar gjatë një procesi relativisht të gjatë të zhvillimit historik të atij populli dhe kanë marrë formën e sjelljeve detyruese, pavarësisht se këto nuk janë të shkruara, por barten brez pas brezi. Mbajtja e besës, mikpritja, zakonet familjare e më gjerë zakonet e lindjes së fëmijëve etj. janë disa nga format e zakoneve të tilla.

ZBATIMI I VENDIMIT. Faza e fundit e veprimtarisë së vullnetshme që karakterizohet nga vënia në jetë e vendimit të marrë. Veprimet me të cilat realizohet vendimi i marrë përbëjnë njërën nga fazat e rëndësishme të veprimtarisë së vullnetshme. Marrja përfundimtare e vendimit krijon gatishmëri në sistemin nervor të njeriut. Në bazë të tij njeriu e drejton aktivitetin e vet në një qëllim të paracaktuar dhe të miratuar. Përpjekja e bërë për realizimin e vendimit është e lidhur me tensionin muskularo-nervor të tij. Pa zbatim të vendimit nuk ka veprim të vullnetshëm.

ZBEHTË (I, E). mb. Që ka ngjyrë të dobësuar, të zverdhur në drejtim të së bardhës. Ky mbiemër ka kuptim më të zgjeruar: i (e) zbehtë thuhet edhe për shprehje jo bindëse, për qëndrime të paqarta, për synime të papërkufizuara saktësisht dhe për sjellje të paorganizuara mirë.

ZBËRTHIMI I PROBLEMIT. Term i psikologjisë së njohjes ose i psikologjisë kognitive. Zbërthimi i problemit është ndarja e një problemi,

e një situate problemore në pjesët përbërëse të tij, me qëllim shqyrtimin e secilës prej tyre dhe, për më tepër, të konstatimit të raporteve ndërmjet tyre që do të lehtësojnë të gjeturit e mënyrave dhe të metodave të zgjidhjes së drejtë të atij problemi apo asaj situate problemore.

ZBULIM, - I. m. Rezultati përfundimtar i mendimit krijues të njeriut, i zgjidhjes përfundimtare të një situate të ndërlikuar. Me anën e rezultatit të tillë vërtetohet diçka pak e njohur ose fare e panjohur deri atëherë. Disa nga rezultatet e zbulimeve kanë vërtetuar se deri në zbulim mund të arrihet befas, papritmas. Ka edhe rezultate që kanë treguar se zbulimi mund të sigurohet me angazhim të mundimshëm dhe të gjatë.

ZELL, - I. m. Term i psikologjisë kunative që emërton dëshirën e madhe të shoqëruar me gatishmëri e këmbëngulje të një individi për ta kryer detyrën, punën e caktuar me durim, me përpikëri dhe me angazhim, shpesh të jashtëzakonshëm.

ZEM/ËR, - RA. f. Organ muskulor i veçantë i aparatit kardiovaskular të gjakut. Masën kryesore të zemrës e përbën miokardi, që është i formuar nga shtresat e shumta muskulore. Miokardi është i përbërë nga fibroqelizat kardiake, që janë të shkurtra, kanë një bërthamë të vetme dhe janë të lidhura ngushtë ndërmjet tyre me anë të urave protoplazmatike. Funksioni i ndërlikuar i zemrës nuk i nënshtrohet veprimtarisë së vullnetshme dhe as mendimit të njeriut. Por, zemra, truri dhe veshkat përbëjnë sistemin e rëndësishëm të jetës. Me ndërprerjen e funksionimit të zemrës ndërpritet edhe jeta. Dikur jeta shpirtërore, sidomos të menduarit dhe emocionet e zhvillimi i tyre ishin të lidhura me zemrën dhe me funksionimin e saj, por sot kjo pikëpamje i takon së kaluarës.

ZEMËRIM, - I. m. Lloj i ndjenjave parësore që përjeton njeriu, atëherë kur vlerëson se tjetri sillet pa të drejtë ndaj tij, duke ia rrezikuar ndonjë nga vlerat personale që ai i konsideron të rëndësishme për jetën, zhvillimin dhe përgjithësisht për qenien e tij. Kjo gjendje shpesh shoqërohet me përjetimin e aftësisë së kundër-reagimit duke besuar se në këtë ai ka të drejtë. Shfaqet me ndryshime fiziologjike dhe psikike të dallueshme: ngrihet lart gatishmëria e aktivitetit të zemërimit për të këmbëngulur, madje edhe me agresivitet në vlerat dhe rëndësinë e sjelljeve të tij përballë atij, i cili i vë në dyshim ndonjë nga vlerat e tij. Zemërimi përmban në mënyrë të fshehtë gatishmërinë e individit për të sulmuar shkaktarin e zemërimit. Zakonisht shfaqet në këto situata: kur sjelljet e individit tjetër ndaj nesh i vlerësojmë të padrejta, kërcënuese; kur dështojmë në planet tona, kur jemi të mashtruar ose të manipuluar nga një individ tjetër, duke na kërcënuar vlerat tona etj.

ZEROJA FIZIOLOGJIKE. Temperatura e sipërfaqes së lëkurës e cila sillet prej 32 – 33 gradë Celsius. Objektet në gjendje të ngurtë, të lëngët, madje edhe në gjendje flurore, që veprojnë në lëkurën e njeriut me temperaturë ndërmjet 32 e 33 gradë Celsius nuk shkaktojnë ndijime të temperaturës, kurse ato që kanë temperaturën nën 32 gradë Celsius shkaktojnë ndijim të ftohtësisë,

e mbi 32 gradë Celsius shkaktojnë ndijim të vakët, pra të nxehtësisë. Zeroja fiziologjike ndryshon sipas ndryshimit të temperaturës së trupit të njeriut.

ZË, - RI. m. Tërësi tingujsh që prodhohen në natyrë, të cilët, kur kanë denduri, intensitet dhe shpejtësi të duhur, shkaktojnë ndijimin e të dëgjuarit. Burimet e zërit janë të ndryshme: zëri i njeriut është tërësi tingujsh që prodhohen nga dridhja e tejzave zanorë gjatë kalimit nëpër laring të rrymës së ajrit që kalon nëpër këto tejza. Jo të gjithë zërat veshi i njeriut është në gjendje t`i ndiejë. Fusha e ndjeshmërisë së veshit të njeriut shtrihet prej rreth 20 Hz deri në 20.000 Hz.

ZËRI I TË FOLURIT. Zë i artikuluar i shprehjes së fjalëve dhe fjalive që ka denduri të ndryshme. Denduria më e ulët e zërit të të folurit te njeriu shtrihet prej 80 Hz (te meshkujt) deri në 120 Hz (te femrat). Secila nga zanoret ka një denduri të caktuar: zanorja *u* prej 300 – 400 Hz, zanorja *o* prej 400 – 600 Hz, zanorja *a* prej 800–1200 Hz etj. Bashkëtingëlloret kanë denduri tingujsh kryesisht të lartë.

ZËVENDËSIMI I QËLLIMIT. Formë e reagimit të njeriut ndaj një qëllimi të paramenduar, kur vlerëson se ai është i parritur për të. Në raste të këtilla shpesh qëllimi burimor zëvendësohet me një tjetër qëllim, sipas sistemit të funksionimit të mekanizmave mbrojtës.

ZGJEDHJA E OBJEKTIVUAR. Emërtim i përzgjedhjes së atij objekti nga ana e individit, i cili do të investojë energjinë e libidos së tij në atë objekt. Objekti mund të jetë njeri tjetër, pjesa e trupit të tij, madje edhe gjësend i caktuar. Në terminologjinë e psikanalizës zgjedhja e objektivuar e objektit emërtohet si kateks i objektivuar. Shih – ***KATEKSI I OBJEKTIVUAR.***

ZGJEDHJA E PROFESIONIT. Vendimi përfundimtar i një individi për profesionin e vet, i shoqëruar me veprime për realizimin e atij vendimi, të cilit i kushton gjithë jetën. Zgjedhja e profesionit është proces i gjatë dhe i ndërlikuar, që realizohet nga psikologët profesionalë. Ka të bëjë me informimin e saktë për natyrën e profesionit dhe shkollimin për të, për aftësitë profesionale nga diagnoza psikologjike e mjekësore, me informacionet e këshillimit dhe orientimit profesional. Vendimin e merr vetë kandidati duke ia plotësuar vetes dëshirën dhe synimin jetësor të tij.

Burimet:

Andre Bussing*: "Organizationsstruktur, Tatigkeit und Individum"* – (*"Struktura organizuese, veprimtaria dhe individi"*), Bern, 1992.
Hugo Münsterberg*: "Grundzuge der Psychotechnik"* – (*"Bazat e psikoteknikës"*), Berlin, 1914.
Hugo Münsterberg*: "Psychologie und Wirtschaftsleben"* – (*"Psikologjia dhe jeta ekonomike"*), Leipzig, 1912.
Walter Moede*: "Lehrbuch der Psychotecnik"* – (*"Libri për psikoteknikën"*), Berlin, 1930.
Monika Schaub*: "Psychologie für Pflegeberuf"* – (*"Psikologjia për profesionin e përkujdesjes shëndetësore"*), Springer – Verlag, Berlin, Heidelberg, New York, London, Paris, Tokyo, Hong Kong, Barcelona, Budapest.
Pajazit Nushi: *"Orientimi professional dhe individualiteti psikofiziologjik i zgjedhësit të profesionit"*, Shtëpia botuese "Libri shkollor, Prishtinë, 2004.

ZGJEDHJA E RASTËSISHME E KAMPIONIT. Term i statistikës që emërton mënyrat e zgjedhjes së anëtarëve të një kampioni nga popullata

e caktuar. Për këtë ekzistojnë disa mënyra, nga të cilat dallojmë: përcaktimi i numrit të pandryshueshëm të atyre rasteve që e kanë atë numër, p.sh., një në çdo pesë raste në regjistrin e përbashkët të të gjitha rasteve, sipas tabelës së numrave të rastësishëm, sipas kriterit të baraspeshuar ndërmjet rasteve të cilësive e përmasave të ndryshme etj.

ZGJIDHJA E PROBLEMIT. Proces i ndërlikuar intelektual me anën e të cilit kuptohet ajo që kërkohet nga elementet e dhëna. Lidhur me këtë individi bën përpjekje për njohjen e marrëdhënieve apo të raporteve parësore dhe thelbësore ndërmjet të dhënave të problemit të shtruar, si edhe për zbulimin e raporteve të reja me anën e të cilave problemi zgjidhet. Rezultatet e gjurmimit të kësaj çështjeje kanë treguar se zgjidhja e problemit dhe e një situate problemore mund të arrihet në formë të thjeshtë dhe të ndërlikuar. Forma e thjeshtë ka të bëjë me riprodhimin e drejtpërdrejt dhe pa gabim të dijeve që kërkon situata e parashtruar në formë problemi; forma e ndërlikuar i përket angazhimeve mendore të drejtuara dhe të organizuara në shndërrimin apo transformimin e dijeve të fituara në dije funksionale që çojnë në zgjidhje të problemit. Zakonisht procedura mendore e qasjes së zgjidhjes së një problemi fillon me identifikimin e asaj që një problem kërkon, mandej procedura vazhdon me përpjekjet për caktimin e strategjisë dhe përfundon me ecurinë shkallë-shkallë (hap pas hapi). Studiuesi i këtij procesi Karl Dunker ka dalluar tri lloj përpjekjesh për zgjidhjen e problemit: 1) Përpjekje të përgjithshme, me anën e të cilave përcaktohet kërkesa e problemit dhe drejtimi i mendimit kah zgjidhja e tij; 2) Përpjekje funksionale që drejtohen kah përcaktimi i ngushtë i mënyrës së zgjidhjes së problemit dhe 3) Përpjekje specifike për kuptimin e raporteve thelbësore ndërmjet të dhënave kryesore dhe të dhënave specifike, të cilat shpien në zgjidhjen përfundimtare të problemit.

ZGJIDHJA E PROBLEMIT NË PSIKOLOGJINË KOGNITIVE. Psikologjia kognitive në fushën e zgjidhjes së problemeve i ka kushtuar kujdes të posaçëm analizës së vështirëve dhe pengesave në procesin e zgjidhjes së problemeve. Në këtë proces ka rolin e një strukture të veçantë të mendimit që është quajtur "insight" – "insajt" që në shqip mund të emërtohet me fjalën *mëtim*. Natyra e kësaj strukture ka të bëjë më tepër me vështrimin e thellë të problemit, duke angazhuar strukturat e larta mendore, me qëllim zbulimin e lidhjeve dhe raporteve thelbësore ndërmjet elementeve të dhënë në problem. Në këtë proces dallohet rikonceptimi i problemit, riformulimi i tij dhe përcaktimi i strategjisë së zgjidhjes, ku dallohet kodimi përzgjedhës i të dhënave me ato të kujtesës, krahasimi përzgjedhës i tyre, si dhe kombinimi i tyre. Shih – ***INSAJTI***.

ZGJIDHJA E PROBLEMIT – TEORIA GESHTALTISTE. Shpjegim karakteristik i procesit të zgjidhjes së një problemi apo situate problemore sipas psikologjisë së tërësisë. Në këtë çështje kanë punuar në mënyrë eksperimentale dy psikologë geshtaltistë: Maks Vertaimer dhe Karl Dunker. Sipas tyre ecuria e zgjidhjes së një

problemi ka këtë rrjedhë: 1) Të kuptuarit e problemit si pjesë e një tërësie të gjerë; 2) Riorganizimi i situatës problemore me qëllim të zbulimit të lidhjeve dhe raporteve të reja ndërmjet të dhënave të atij problemi; 3) Riformulimi i problemit – përcaktimi i qarkut të mundshëm të zgjidhjeve, në kuadrin e të cilit njeriu bën orvatje funksionale dhe përcakton orvatjet specifike, që shpien në zgjidhje të atij problemi; 4) Shfrytëzimi i përvojave pozitive në zgjidhjen e problemeve të ngjashme dhe 5) Ndryshimi i strukturave të problemit me qëllim të dallimit të zbrazëtive të problemit, kërkimi i strukturave që pengojnë zgjidhjen dhe ndryshimin e hierarkisë në lidhjet dhe marrëdhëniet thelbësore ndërmjet elementeve të dhënë në problem.

ZGJIDHJA GJITHËPËRFSHIRËSE. Formë e lehtësimit të gjendjes së konfliktit dhe të sjelljeve të lidhura me këtë gjendje, si edhe e mënjanimit të kësaj gjendjeje, duke shtyrë individin ta konceptojë veten si ideal. Është koncept dhe term i psikologjisë së psikanalistes amerikane me prejardhje gjermane Karen Hornei (Karen Horney, 1883 – 1952).

ZGJIDHJA NEUROTIKE E SITUATËS PROBLEMORE. Në teorinë e personalitetit të Karen D. Hornei (Karen D. Horney, 1883 – 1952) nënkupton çlirimin nga ngarkesa e madhe e ankthit të njeriut neurotik për të dalë nga një situatë problemore, duke u larguar nga situatat problemore ose duke neutralizuar situata të tilla. Zgjidhja e këtyre situatave mund të jetë zgjidhje kryesore, kur njeriu me angazhim maksimal kompulsiv arrin të çlirohet nga konflikti karakteristik për këto situata. Forma e dytë e zgjidhjes neurotike të situatave problemore është zgjidhja ndihmëse, që ka të bëjë me daljen e përkohshme nga situatat e tilla, duke mos i zgjidhur përfundimisht situatat problemore. Forma e tretë e zgjidhjes neurotike të situatave problemore ka të bëjë me zgjidhjen gjithëpërfshirëse, duke u çliruar plotësisht nga ankthi e frika.

ZGJIDHJA RACIONALE E PROBLEMEVE. Sipas psikologjisë kognitive emërton kuptimin e rëndësisë së zgjidhjes së problemeve dhe të situatave problemore me anë të zbatimit të drejtpërdrejtë dhe sistematik të procesit të mendimit dhe të operacioneve mendore, duke mënjanuar çdo formë tjetër të zgjidhjes së tyre.

ZGJIM, - I. m. Gjendja e zgjuar e njeriut që karakterizohet nga ndryshime fiziologjike dhe psikike të ndryshme, si: valët beta të trurit me aktivitet prej 12 Hz deri 30 Hz, gatishmëria aktuale e ndërmarrjes së veprimeve të ndryshme, e reagimit të organizmit apo të organeve përkatëse ndaj ngacmuesve të caktuar, angazhimi në bashkërenditjen e lëvizjeve të organeve të trupit dhe në koordinimin e tyre për plotësimin e një motivi të posaçëm, gjendja e të kuptuarit të mjedisit, të ndryshimeve të tij si dhe e të kuptuarit të vetes në këtë mjedis.

ZGJUARSI, - A. f. Ndjeshmëria e individit ndaj çështjeve problematike, kuptimi i lehtë i tyre dhe mendjemprehtësia e perceptimit të lehtë mendor të raporteve parësore e dytësore, si dhe shpejtësia e të gjeturit të rrugëve dhe të mjeteve që kontribuojnë në zgjidhjen e tyre. Zgjuarsia është tipar i personalitetit, me anën e të cilit njeriu

gjen lehtë dhe shpejt rrugëdalje në situata problemore, i organizon lehtë dhe shpejt sjelljet për arritjen e zotërimin e një qëllimi të parashikuar, kur para tij dalin pengesa e vështirësi të mëdha, duke ruajtur qëndrueshmërinë emocionale dhe motorike të tij.

ZI, - A. f. Ndjenjë e ndërlikuar e hidhërimit, e dëshpërimit, e pikëllimit për të afërmin, për të dashurin, për fëmijën e humbur, për të zhdukurin, për atë që vdes. Një ndjenjë e tillë shprehet në forma të ndryshme, në varësi nga mjedisi kulturor dhe tradita e vendit, si me vajtim, me lot, me gjendje frustruese, me biseda të kufizuara dhe me përmbajtje që kanë të bëjnë kryesisht me të humburin, me pasardhësit e tij, me veshje rrobash të zeza, me vënie të fjongos së zezë, të rrethores së zezë në mëngën e rrobave etj. Zia e këtillë ushtron ndikim ngadalësues në veprimtarinë e gjithëmbarshme të njeriut, por me kalimin e kohës kjo gjendje fillon të mënjanohet gradualisht.

ZI (I), – ZEZË (E). mb. Që ka ngjyrë të zezë, që është i/e përbërë nga reflektimi i një pjese shumë të vogël të valëve elektromagnetike nga sipërfaqja e një trupi të caktuar. Qymyri ka ngjyrë të theksuar të zezë (ulliri, rrushi i zi etj.). E zeza ka shkallë shumë të ulët çeltësie (përballë të bardhës me shkallë të lartë çeltësie) dhe në kushte të posaçme, shkakton ndijim përkatës akromatik.

ZIGOT/Ë, - A. f. Vezë e pllenuar ose e fekonduar nga spermatozoidi që përbën fillimin e zhvillimit të një embrioni, të një organizmi në fazën e parë, përkatësisht në fazën më të hershme të zhvillimit paranatal.

ZILI, - A. f. Ndjenjë negative që lind nga pakënaqësia e njeriut, kur dallon se tjetri ka diçka që dëshiron ta ketë edhe ai, kur heton se tjetri ka diçka më tepër, më të zhvilluar se ai. Kështu tek ai ngjallet inati, lakmia, hidhërimi, zemërimi etj. Në këtë kuptim një individ mund të ketë zili ndaj individit tjetër që ka synime, të cilat ai nuk i ka ose nuk arrin t`i realizojë, që merr më shumë dashuri se ai ose ajo, që mund të ketë zili ndaj motrës më të aftë etj.

ZONA AUDITIVE. Fusha e cipës apo kores së trurit të madh e pjesës parietale ose tepore, ku arrijnë impulset nervore të shkaktuara nga receptorët e veshit të brendshëm, duke u shndërruar në ndijime dëgjimore. Në këtë proces rolin kryesor e luan nervi i dëgjimit – dega VIII e nervave kafkorë.

ZONA BROK. Zonë e cipës së trurit – bartëse e funksionit të të folurit, saktësisht bartëse e artikulimit të të folurit, e pikërisht e të folurit motorik. Është e vendosur në pjesën ballore të majtë të cipës së trurit te djathtakët. Lëndimi i kësaj qendre shkakton pamundësinë e artikulimit të fjalëve dhe shprehjen e qartë të tyre. U zbulua nga mjeku francez, fiziologu dhe kirurgu Pol P. Broka (Paul P. Broca, 1824 – 1880). Është rënë dakord që emërtimi i shtrirjes me termin zonë është i papërshtatshëm dhe përdoret më tepër termi qendra e Brokut, që është njëra ndër strukturat e zonës Brok.

ZONA GJENITALE. Pjesa e jashtme e organeve gjenitale dhe pjesët përkufizuese të organeve seksuale të mashkullit dhe të femrës që formojnë zonën erogjene. Ngacmimi i pjesëve të këtyre zonave shpie në shqetësim seksual

të fuqishëm. Psikanaliza e Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939) ka treguar se zona gjenitale në fillim të zhvillimit psikoseksual të fëmijëve nuk është e dallueshme, por kjo merr pozicion të theksuar në fazën gjenitale të zhvillimit psikoseksual.

ZONA MEDIALE E TË PARIT. Në psikologjinë fiziologjike fushë nervore e trurit të mesëm në pjesën anësore të hipotalamusit.

ZONAT ASOCIATIVE. Zonat trunore të përbëra nga qelizat nervore dhe nga degët e tyre, të cilat lidhin pjesët e ndryshme të cipës apo kores së trurit të madh, duke mundësuar integrimin e impulseve nervore dhe realizimin e proceseve të ndërlikuara psikike dhe të sjelljeve të njeriut. Zonave asociative nuk u përkasin qendrat motorike dhe ato sensorike. Zonat asociative gjenden më dendur në pjesën ballore (frontale) dhe në atë zverkore (parientale).

ZONAT BRODMAN. Harta e ndarjes së trurit në zona të posaçme e hartuar sipas strukturës së qelizave nervore, histologjisë së tyre dhe sipas trashësisë së shtresave të cipës së trurit. Në kohën e përpilimit të saj, përkatësisht në vitin 1909 kjo hartë përbëhej prej 52 zonave dhe zonat e tilla shënohen prej 1 – 52. Secili numër tregon funksionin e asaj zone të trurit. Kështu, zona 4 ka të bëjë me nënfushën parësore motorike, zona 17 është nënfusha parësore e ndijimeve pamore etj. U hartua nga neurologu gjerman Korbinian Brodman (Korbinian Brodmann, 1868 – 1918). Rezultatet e hulumtimeve më të reja nuk përputhen plotësisht me këtë hartë dhe, megjithëkëtë, harta e zonave Brodman ka përdorim edhe sot, sidomos kur bëhet fjalë për lokalizimin e qendrave trunore. Këtë e tregon qartë figura e mëposhtme:



ZONAT DYTËSORE TË TRURIT. Pjesë të cipës së trurit të madh të ndërlidhura me zonat parësore, si në pikëpamjen e strukturës anatomike, ashtu edhe në pikëpamjen e funksionit të tyre. Zonat dytësore ndahen në dy grupe: 1) Zonat dytësore motorike dhe 2) Zonat dytësore sensorike. Zonat dytësore motorike kryejnë funksionin e zhvillimit rendor të lëvizjeve dhe lidhjen e tyre në sjellje të tërësishme të vullnetit, duke dërguar impulse nervore nga zonat parësore të cipës së trurit të madh në muskujt skeletorë. Zonat dytësore sensorike kryejnë funksionin e lidhjes së strukturave të ndijimeve në tërësi perceptive.

ZONAT E CIPËS SË TRURIT TË MADH. Zona qendrash të cipës së trurit të madh që kryejnë funksione të veçanta në tërësinë e aktivitetit të cipës dhe të trurit. Zona të tilla janë: 1) Zona asociative – zonë qelizash e fijezash nervore që lidhin pjesët e trurit dhe qendrat e cipës së trurit, duke mundësuar funksionimin integral të trurit; 2) Zona motorike – zonë e qendrave lëvizore nga të cilat dalin fijet nervore qendërsjellëse ose eferente që lidhin qendrat lëvizore të kësaj zone me muskuj dhe me gjëndra, duke përcjellë në muskuj dhe në gjëndra impulse nervore të qendrave të kësaj zone dhe mundësojnë ekzekutimin e një sjelljeje a veprimi të caktuar; 3) Zona sensorike – zona qendrash shqisore të vendosura në pjesën e prapme të trurit, ku përfundojnë rrugët nervore që janë të lidhura me fijet nervore të shqisave, përkatësisht të receptorëve dhe ku impulset nervore të tyre shndërrohen në aktivitet psikonervor, në ndijime. Sipas rolit të këtyre qendrave këto ndahen në qendra parësore – të vendosura në pjesën e prapme të trurit; kryejnë funksionin e analizës së impulseve nervore; në qendra dytësore ose sekondare – të lidhura me zonën parësore dhe kryejnë funksionin e integrimit të ndijimeve shqisore në tërësi të organizuar, në perceptime; në qendra terciare – ku integrohen informacionet e qendrave shqisore të ndryshme dhe i japin kuptim përjetimit të atij perceptimi.

ZONAT E NGJYRAVE. Rrjetëza ose retina e syrit ka zona të posaçme të reagimit ndaj valëve elektromagnetike me gjatësi të ndryshme, përkatësisht ndaj ngjyrave të ndryshme. Zona më e ndjeshme e retinës për ngjyra është gropa qendrore e syrit, e njohur në terminologjinë e anatomisë me termin *fovea centralis retinae*. Në këtë zonë janë përqendruar qelizat receptore në formë konesh. Në mesin e kësaj zone qelizat receptore reagojnë ndaj ngjyrës së kaltër, të verdhë etj.; këtu ngjyrat parësore (e kuqe dhe e gjelbër) përjetohen si ngjyra të murrme. Në periferi të gropës qendrore të retinës janë të vendosura vetëm qelizat receptore në formë thupërzash, të cilat reagojnë vetëm ndaj të bardhës dhe të zezës.

ZONAT SENSORIKE TË TRURIT. Fusha të sistemit nervor qendror ku arrijnë impulset nervore të shqisave dhe shndërrohen në ndijime dhe në perceptime. Dallohen zona e të parit, e dëgjimit, e nuhatjes etj. Këtu përfundojnë rrugët nervore aferente dhe impulseve nervore u jepet kuptimi i ndijimit dhe i perceptimit. Dallojmë tri lloj zonash: zona parësore apo primare, dytësore apo sekondare dhe zonat terciare. Zonat e tilla gjenden në pjesën e fundit të cipës së trurit të madh. Zonat sensorike emërtohen edhe me termin korteksi sensorik. Shih – ***STRUKTURAT SENSOMOTORIKE.***

ZONAT TERCIARE TË TRURIT. Pjesët e cipës apo kores së trurit të madh (pas atyre parësore dhe dytësore), që konsiderohet se janë bartëse të funksioneve të larta psikike të njeriut. Këtu integrohen të dhënat e zonave të ndryshme ndijimore dhe shkaktohet përjetimi i kuptimit dhe i rëndësisë së tyre; këtu lindin e zhvillohen proceset e ndërlikuara psikike: perceptimi, të mësuarit, proceset e kujtesës, proceset e të menduarit dhe të të folurit.

ZOOMORFIZ/ËM, - MI.m. I ardhur nga greqishtja *ζωο* "kafshë" dhe *μορφισμός* "formë". Zoormorfizmi është atribut i njerëzve me karakteristika, tipare, cilësi jonjerëzore. Zakonisht përdoret për përshkrimin e origjinës së sjelljeve njerëzore nga zhvillimi i veprimtarisë, kur njeriu është gjendur në një shkallë të ulët të zhvillimit dhe disa mekani-zma dhe parime të përgjithshme të sjelljeve dhe veprimeve të tij nxirren nga vëzhgimi i natyrshëm dhe eksperimental i kafshëve.

ZOOPSI, - A. f. I ardhur nga greqishtja *ζωο* "kafshë" dhe *όψης* "të parë". Lloj i halucinacionit, të cilin e karakterizon dukuria e përjetimit të figurave të kafshëve nga ana e njeriut të sëmurë dhe mbrojtja e tij prej tyre. Karakterizon më tepër psikozën e alkoolit.

ZOOPSIKOLOGJI, - A. f. Degë e disiplinave të psikologjisë që merret me studimin e jetës dhe të aktivitetit të kafshëve prej formave elementare deri te format e ndërlikuara të aktivitetit psikik të tyre**.**

ZOT, - I. m. Koncept dhe term i psikologjisë idealiste i marrë nga terminologjia religjioze. Emërton qenien absolute, krijuesin e Gjithësisë, rrjedhimisht krijuesin e jetës shpirtërore dhe sunduesin e saj. Themeluesi i psikanalizës Zigmund Frojdi (Sigmund Freud, 1856 – 1938) ka besuar në Zot. Sipas tij Zoti në jetën shpirtërore të njeriut ka disa funksione, nga të cilat dallohen: ta pajtojë njeriun me fatin e tij, ta largojë atë nga frika prej pafuqisë së tij, t`ia kompensojë vuajtjet e kësaj jete etj. Psikoterapistët kanë konstatuar se frika nga Zoti është frikë e natyrshme për ata që besojnë në Zot.

ZOTËSI, - A. f. Të qenët i zoti për të kryer lehtë, shpejt dhe në shkallë të përkryer një veprimtari profesionale, shkencore dhe artistike. Shih – ***AFTËSIA***.

ZULM, - I. m. Fama e përhapur e një personaliteti që zgjon lavdi, respekt dhe nderim të posaçëm nga ana e të tjerëve.

ZYMTËSI, - A. f. Gjendje e ndjenjave të një individi që karakterizohet nga përjetimi i gjatë i ndjenjave të përziera të brengosjes, të mërzisë, të hidhërimit etj.

ZH

ZHAME VY. I ardhur nga frëngjishtja *jamais vu* **"**kurrë e parë". Formë e paraamnezisë. Përjetim i karakterit iluzor që ka të bëjë me dukurinë psikike ku çka është e njohur, e parë dhe e përjetuar disa herë më parë në jetën e njeriut, tashmë perceptohet si e panjohur, e paparë, e papërjetuar. Përjetimi iluzor "zhame vy" – "kurrë e parë" shfaqet shpeshherë në fazën paraprake të epilepsisë. Shih **– *PARA-AMNEZIA*.**

ZHANE Pjer (Pierre JANET). Mjek psikiatër dhe psikolog francez. Lindi më 30.05.1859 dhe vdiq në Paris më 24.02.1947. Kreu studimet për filozofi dhe më 1889 mbrojti me sukses tezën e doktoratës për filozofi me temën "Mbi automatizmin psikologjik" para komisionit me kryetari Emil Butru dhe anëtar Anri Bergson. Pasi përfundoi studimet edhe në mjekësi mbrojti doktoratën me temë "Gjendja mendore e histerikëve (Shenjat dhe mospranimi)") – "L`Etat mentale des hysteriques (Stigmates et accidents mentaux)". Më 1903 shërbeu si profesor në "College de France"; më 1904 themeloi në bashkëpunim me Zhorzh Dyma "Revistën për psikologjinë normale dhe patologjike" – "Journal de psychologie normale et pathologique". Ndërkohë Zhan Marten Sharko e emëroi drejtor të laboratorit psikologjik në spitalin Salpetrier (Salpêtrière). Më 1913 u zgjodh anëtar i Akademisë së Shkencave Franceze. Botimi i tekstit të plotë të doktoratës tërhoqi vëmendjen e shumë studiuesve, me trajtimin e histerisë si sëmundje e pastër psikologjike, por etiologjinë e kësaj sëmundjeje nuk e lidhi me seksualitetin. Pas shumë diskutimeve konceptoi metodën psikoterapeutike – metodën e analizës psikologjike, të cilën e mbështeti në tri shtylla mendore: Gjurmimin e pacientit sy më sy, gjurmimin e së kaluarës dhe trajtimin që i është nënshtruar pacienti. Më pas iu vu analizës së neurastenisë. Pjer Zhane ishte kundërshtar i prerë i psikanalizës së Zigmund Frojdit, të cilën e konsideronte "Obsesion të Vjenës". Madje, "tepër të gjermanizuar sa të jetë në gjendje t`i përshtatet frymës latine". Psikologjia e Pjer Zhanes ka përmasa të theksuara të psikologjisë mbi sjelljet, por jo si psikologjia bihejvioriste. Për të personaliteti zhvillohet dhe formohet

në sistemin hierarkik nga reflekset e thjeshta dhe ngritjen e zhvillimit në nivelin e proceseve të larta mendore. Sipas tij një zhvillim i tillë mbështetet në reagimet ndaj ngacmuesve të jashtëm dhe të brendshëm dhe secili reagim plotëson energjinë specifike të tij. Reagimet e nivelit më të ulët kanë fuqi apo potencial energjetik më të fuqishëm se reagimet e nivelit më të lartë. Veprimtaria e njeriut është e lidhur me përvojën e së kaluarës dhe me fuqinë krijuese të njeriut. Pjer Zhane konsiderohet si klasifikues i neurozave dhe i gjendjeve neurotike, si edhe ndër të parët që u mor me shërimin e neurozave dhe të gjendjeve neurotike. Ai ka trajtuar edhe formën e neurozës psikastenike. Çrregullimet psikike shfaqen sipas shkallëzimit të strukturave dhe të funksioneve psikike; nëse tensioni i organizmit prek nivelet e larta psikike, atëherë bëhet fjalë për neuroza. Neurozat janë pasojë e angazhimit të pamjaftueshëm të energjisë psikike të tensionuar në nivel të ulët; në rastet e tilla organizmi i njeriut nuk është i aftë të angazhojë energji të mjaftueshme psikike për t`iu kundërvënë vështirësive që has njeriu në aktivitetin e tij. Nëse tensioni psikik i organizmit shtrihet deri në shtresat e ulëta psikike, atëherë shkaktohen çrregullime të rënda që kanë të bëjnë me funksionin e veprimeve të vetëdijshme të mendimit e të gjuhës, të gjendjeve emocionale dhe të vullnetit. Por, nëse tensioni i organizmit dhe fuqia e tij depërton deri në shtresat e reagimeve refleksive, atëherë shfaqen çrregullime organike. Vështruar nga shtrirja e pikëpamjeve të tij mund të thuhet se Pjer Zhane është ndër kontribuesit e zhvillimit të psikologjisë së personalitetit, të psikopatologjisë dhe të psikiatrisë. Veprat kryesore të tij janë: *" L` Automatisme psychologique"* – (*"Automatizmi psikologjik"*), 1889; *"Les obsessions ett la psychastenie"* – (*"Obsesioni psikastenik"*), 1903; *"Nevroses et idees fixes"* – (*"Neurozat e ideve fikse"*), 1904 etj.

ZHARGON, - I. m. I ardhur nga frëngjishtja *jargon* "të folurit popullor". Tërësi fjalësh e shprehjesh karakteristike, me anën e të cilave komunikon një rreth i ngushtë njerëzish që i takojnë një grupi të caktuar komunikuesish ose profesionalistësh të një fushe të caktuar veprimtarie (zhargoni i aristokratëve, i kallajxhinjve, i muratorëve etj.). Në këtë zhargon hyjnë fjalët e shprehjet e huaja të krijuara posaçërisht për emërtimin e kuptimeve të veçanta dhe për shprehjen e mendimeve karakteristike. Për ata individë që nuk i takojnë rrethit të tillë komunikues "zhargoni" është i folur i pakuptimtë. Ky term ka filluar të përdoret nga shekulli XIV.

ZHDËRVJELLTËSI, - A. f. Aftësia e posaçme e njeriut për të reaguar dhe kryer kryesisht veprime motorike me shpejtësinë dhe saktësinë e duhur. Në shqipe kuptimi i këtij termi shtrihet përtej fushës motorike, duke përfshirë edhe shkathtësinë e të menduarit të shpejtë dhe të saktë për një problem apo situatë problemore dhe për zgjidhjen e drejtë të tij. Me kuptim të posaçëm haset ky term në shprehjet "punë e zhdërvjellët", "mendim i zhdërvjellët"**.**

ZHGËNJIM, - I. m. Humbje e besimit, e shpresës dhe e kënaqësisë së një individi ndaj një individi tjetër, nga i cili është pritur të bënte diçka të drejtë, të mirë, pozitive, kurse ai ka bërë atë

që është e padrejtë, e keqe, negative. Zhgënjimi është ndryshimi i qëndrimit pozitiv të një individi ndaj të tjerëve në qëndrim negativ.

ZHURM/Ë, - A. f. Përjetim dëgjimor i kompleksit të valëve të parregullta ajrore të tingujve të çrregulluar që prodhohen në natyrë duke u përplasur në veshin e njeriut. Njeriu përjeton zhurmë atëherë, kur zëri prodhohet me dridhje valësh ajrore jo vetëm të parregullta, por edhe të ndryshueshme në pikëpamje të intensitetit dhe kohëzgjatjes së tyre. E tillë është zhurma e automobilave, e lumenjve, e shiut etj.

ZHVENDOSJ/E, - A. f. Veprimi që lëviz objektin, pikëpamjen, qëndrimin, vëmendjen nga një pozitë apo situatë në një pozitë apo situatë tjetër, zhvendos emocionin e hidhërimit nga një individ te individi tjetër. Ky kuptim e bën zhvendosjen të konsiderohet mekanizëm mbrojtës. Në psikologjinë bihejvioriste ka edhe kuptimin e zëvendësimit të një reagimi me reagim tjetër. Në psikanalizë zhvendosja është koncepti i termit me kuptim të posaçëm që ka të bëjë me zhvendosjen e libidos nga një objekt në tjetrin, përkatësisht me shpjegimin e ëndrrave, kur elementet origjinale të një përmbajtjeje shndërrohen në elemente dytësore manifestuese të asaj ëndrre**.**

ZHVENDOSJA E BARASPESHËS ORGANIKE. Ndryshim i njërit nga kushtet që caktojnë gjendjen e baraspeshës funksionale të organizmit. Kështu, mungesa e ushqimit, e oksigjenit, urina e tepërt etj. prish baraspeshën e funksionimit të organizmit, duke u zhvendosur nga njëri kah në kahun tjetër. Termi është i lidhur kryesisht me homeostazën, përkatësisht me procesin e ndryshimit të gjendjes së organizmit për ta vënë organizmin në gjendje funksionale të baraspeshuar. Shih – ***HOMEOSTAZA.***

ZHVILLIM, - I. m. Term me kuptim të gjerë. Në psikologji emërton procesin e pareshtur të ndryshimeve sasiore e cilësore të strukturave organike, biologjike e psikike gjatë gjithë cikleve të jetës së njeriut. Kuptimi burimor i këtij procesi në psikologjinë zhvillimore ka përfshirë, që nga fillesat e para të zhvillimit te saj gjatë dhjetëvjeçarëve të parë të shekullit njëzet, gjurmimin e ndryshimeve strukturore e funksionale organike, biologjike e psikike prej lindjes deri në pleqëri dhe në vdekje. Procesi i këtillë ka të bëjë me njohjen e këtyre ndryshimeve, që sillen prej atyre të thjeshtave kah të ndërlikuarave, prej atyre të shkallës më të ulët në ato të shkallës më të lartë, nga më të vjetrat kah të më të rejave. Të gjitha këto ndryshime janë ndryshime progresive psikofizike, që kanë të bëjnë me zhvillim pozitiv të aftësive, të jetës emocionale, të proceseve kognitive, konotative, të qëndrimeve, të vlerave dhe të personalitetit. Por, zhvillimi psikik e organik mund të ketë edhe kahe negative. Sot më tepër dallohet kuptimi i ngushtë i termave dhe i shprehjeve që kanë të bëjnë me zhvillim të posaçëm psikik, si: zhvillimi i afazisë, i personalitetit, i prapambetjes mendore, zhvillimi i sistemit nervor etj.

ZHVILLIMI I EMOCIONEVE. Proces i ndërlikuar bio-psikologjik dhe social sipas të cilit zhvillohen emocionet. Foshnja lind me një gjendje të pacaktuar emocionale, e cila fillon të diferencohet shpejt në gjendje të dobishme për organizmin

e që shoqërohet me kënaqësi dhe në gjendje të dëmshme për organizmin e saj dhe që shoqërohet me pakënaqësi. Nga përforcimi i këtyre reagimeve të organizmit fillon kristalizimi i kënaqësisë dhe ai i pakënaqësisë dhe pas tri muajsh emocionet fillojnë të krijohen si emocione pozitive të lidhura me kënaqësi (gëzimi, hareja etj.) dhe si emocione negative të lidhura me pakënaqësi (frika, hidhërimi, zemërimi etj.). Në zhvillimin e emocioneve ushtrojnë ndikim të fuqishëm dy faktorë: faktori i pjekurisë së organizmit, sidomos pjekuria e sistemit nervor dhe faktori i të mësuarit.

ZHVILLIMI I IDENTITETIT TË PERSONALITETIT. Procesi i njohjes dhe i përcaktimit të vetëdijshëm të vetes nga ana e njeriut. Ky zhvillim i atribuohet psikologut amerikan Erik Erikson (Erik Erikson, 1902 – 1994) dhe realizohet sipas fazave gjenetike të përcaktuara, ku bëhet fjalë edhe për krizën e identitetit psiko-social të personalitetit. Këto faza janë: 1) Fitimi i besimit në vetvete; 2) Fitimi i autonomisë në sjelljet e veta; 3) Gatishmëria e dhënies së nismave; 4) Kujdesi për veten; 5) Formimi i identitetit për veten; 6) Intimiteti; 7) Krijimtaria dhe 8) Integriteti. Secila nga tetë fazat e zhvillimit psiko-social të njeriut i ka edhe anët e veta negative, si 1a) mosbesimi në vetvete; 2b) Turpi e dyshimi; 3c) Ndjenja e fajit; 4ç) Ndjenja e vlerës më të vogël; 5d) Turbullimi i vetëdijes për veten; 6dh) Izolimi; 7e) Vendnumërimi dhe 8f) Dëshpërimi. Erik Erikson konsideron se këto faza të zhvillimit të identitetit psikosocial kanë karakter të trashëgueshëm dhe të përgjithshëm.

ZHVILLIMI I INTELIGJENCËS. Inteligjenca zhvillohet në raport të caktuar me zhvillimin fizik të organizmit. Zhvillimi i inteligjencës ka të bëj me ndryshimet sasiore e cilësore të saktësisë dhe shpejtësisë së kuptimit të situatës problemore dhe të zgjidhjes së mirëfillët të saj. Ritmi i zhvillimit të inteligjencës ndryshon nga ritmi i zhvillimit të organizmit. Inteligjenca zhvillohet deri në fund të dekadës së dytë të jetës së njeriut, përkatësisht deri rreth moshës tetëmbëdhjet vjeçare.

Faktorët kryesorë që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e inteligjencës janë dy: 1.faktori i trashëgimisë dhe 2. Faktori i ndikimeve të rrethit ku zhvillohet dhe formohet personaliteti. Rezultatet e hulumtimit të koeficientit të inteligjencës (IQ) të binjakëve njëqelizor (kodi i njëtë njëqelizor) dhe të IQ të foshneve të përvetësuara (kodi krejtësisht i ndryshuar gjenetik i prindërve biologjik dhe i prindërve përvetësues të foshnjës) kanë treguar ndërlidhjen ndikuese të drejtpërdrejtë të faktorit të trashëgimit dhe të atij të mjedisit në zhvillimin e inteligjencës, por në proporcione të ndryshme. Shkallët e ndërlidhjes (korrelacionit) ndërmjet koeficinetit të inteligjencës të të provuarve me afërsi gjenetike të ndryshme janë: ndërmjet binkakëve njëqelizorë të edukuar në të njëjtin ambient 0,87; binjakëve njëqelizor të edukuar në ambiente të ndryshme 0, 75; fëmijëve dhe prindërve të tyre 0, 50; fëmijëve të rritur në familje me prindër të ndarë 0, 32; fëmijëve dhe përvetësuesve të tyre 0, 19; fëmijëve pa kurrfarë afërsie farefisnie të edukuar bashjakrisht 0, 23. Ka përcaktime se variansat e zhvillimit të inteligjencës

i atribuohen 60% trashëgimisë dhe 40% ndikimit të faktorëve mjedisorë.

ZHVILLIMI I PAMJAFTUSHËM MENDOR. Shkalla më e ulët e zhvillimit mendor nga ajo normale, përkatësisht shpërputhja ndërmjet moshës kalendarike të zhvillimit fizik dhe "moshës" mendore, e cila është në nivele të ulëta dhe shumë të ulëta të zhvillimit. Shih – ***DEBILITETI; IMBECILITETI; IDIOTIZMI.***

ZHVILLIMI I PERSONALITETIT. Ndryshimet cilësore progresive të tipareve, të strukturës, të organizimit dhe të ndërlidhjes së tipareve karakteristike në një unitet të posaçëm psikik dhe organik të njeriut prej lindjes deri në pjekuri, përkatësisht deri në fund të jetës së tij. Zhvillimi i personalitetit rrjedh nga ndikimi që ushtrojnë te faktorët e lindjes, pikërisht ata faktorë që kanë të bëjnë kryesisht me ndryshimet organike e fiziologjike (sidomos të sistemit nervor), me rritjen e pjekurinë e organizmit, me faktorët mjedisorë dhe me veprimtarinë e vetë njeriut**.**

ZHVILLIMI I SISTEMIT NERVOR. Procesi i ndryshimeve anatomike e fiziologjike të sistemit nervor qendror, periferik dhe autonom apo vegjetativ. Një proces i tillë ka ritëm të caktuar, por edhe ndryshime prej një individi në tjetrin; ritmi i ndryshimeve strukturore e funksionale i sistemit nervor ndryshon nga ritmi i të gjitha sistemeve të tjera të organizmit. Zhvillimi intensiv i sistemit nervor fillon që nga mosha e paralindjes dhe zgjat deri rreth moshës gjashtëvjeçare, kur truri i fëmijës arrin gati 90 % të peshës së trurit të të rriturit. Më pas kemi zhvillim ritmik karakteristik që zgjat deri në vitin e nëntë e të dhjetë të jetës, kur truri i fëmijës i ka proporcionet e njëjta me trurin e të rriturit. Zhvillimi i mëvonshëm ka të bëjë më tepër me ndryshime të strukturës nervore të tij dhe të ndërlidhjes funksionale të qendrave e fushave të cipës së trurit të madh.

ZHVILLIMI I VETËDIJES PËR VETEN. Term i psikologjisë eklektike për personalitetin e Gordon Olportit (Gordon Allport, 1897 – 1967). Sipas tij zhvillimi i vetëdijes së njeriut kalon nëpër këto faza: 1) Viti i parë: përjetim i urisë, i etjes, i dhembjes, i gjumit etj. dhe fitimi i njohurive të para të fëmijës për trupin e vet; 2) Viti i dytë: fitimi i dijes se ai ka emër të veçantë dhe për këtë ai është krenar – bazë për zhvillimin e identitetit të tij; 3) Deri në vitin e pestë: shtrirje e vetëdijes për veten duke pohuar se këto lodra, veshje etj. janë të tij e jo të të tjerëve; 4) Rreth vitit të pestë: figura ende e pazhvilluar plotësisht, e turbullt për veten e tij; 5. Në fazën e zhvillimit parashkollor: lindja e "xixave" të para për vete si njeri i lindur për njohje dhe për të mësuar; 6) Në fazën e shkollimit fillor: lindja e vetëdijes se ai është subjekt i njohjes – njeri me arsye, me mendje; 7) Adoleshenca me synimet e veta zhvillimore – kurorë e mbarë zhvillimit ose, siç e quajti Erik Erksoni (Erik Erikson, 1902 – 1994), kurorë e propriumit**.**

